

# *KURANI I SHQIPËRUAR*

shqipëruar nga Ridvan Bunjaku  
korrik 2015 – mars 2022

## Përmbajtja

HYRJE .....	6
1: HAPJA (EL-FÂTIHA) .....	9
2: LOPA (EL-BEKARE) .....	16
3: FAMILJA E IMRANIT (ÂL ‘IMRÂN) .....	62
4: GRATË (EN-NISÂ’) .....	87
5: TRYEZA E GOSTISË (EL-MÂ‘IDE).....	114
6: BAGËTITË (EL-EN‘ÂM) .....	131
7: LARTËSITË (EL-A‘RÂF) .....	153
8: FITIMET E BETEJËS (EL-ENFÂL).....	175
9: PENDIMI (ET-TEUBE) .....	181
10: JUNUSI (JÛNUS).....	192
11: HUDI (HÛD).....	200
12: JUSUFI (JÛSUF).....	209
13: BUBULLIMA (ER-RA‘D) .....	217
14: IBRAHIMI (IBRÂHÎM, ABRAHAM).....	222
15: HIXHRA (EL-HIXHR) – TERRENI SHKËMBOR.....	227
16: BLETA (EN-NAHL) .....	231
17: UDHËTIMI I NATËS (EL-ISRÂ‘).....	240
18: SHPELLA (EL-KEHF).....	248
19: MERJEMJA (MERJEM).....	270
20: TA HA .....	275
21: PROFETËT (EL-ENBIJÂ‘) .....	283
22: HAXHI/PELEGRINAZHI (EL-HAXHXH).....	294
23: BESIMTARËT (EL-MU‘MINÛN) .....	300
24: DRITA (EN-NÛR).....	305
25: DALLUESI (EL-FURKÂN) .....	314
26: POETËT (ESH-SHU‘ARÂ‘) .....	319
27: MILINGONAT (EN-NEML).....	326
28: RRËFIMI (EL-KASAS).....	332
29: MERIMANGA (EL-‘ANKEBÛT).....	339
30: BIZANTINËT (ER-RÛM) .....	344

*Kurani i shqipëruar*

31: LUKMANI (LUKMÂN).....	356
32: PËRKULJA NË ADHURIM (ES-SEXHDE).....	364
33: FORCAT E BASHKUARA (EL-AHZÂB).....	367
34: SHEBA (SEBE').....	373
35: KRIJUESI (EL-FÂTIR).....	385
36: JA SIN (JÂ SÎN).....	389
37: TË VENDOSUR NËPËR RRESHTA (ES-SÂFFÂT).....	405
38: SAD (SÂD).....	410
39: TURMAT E MËDHA (EZ-ZUMER).....	415
40: FALËSI (EL-GÂFIR).....	421
41: [VARGJET] TË BËRA TË DALLUESHME (FUSSILET).....	427
42: KONSULTIMI (ESH-SHÛRA).....	432
43: ORNAMENTET E ARTA (EZ-ZUHRUF).....	437
44: TYMI (ED-DUHÂN).....	442
45: GJUNJËZIMI (EL-XHÂTHIJE).....	445
46: KODRAT E RËRËS (EL-AHKÂF).....	449
47: MUHAMEDI (MUHAMMED).....	453
48: TRIUMFI (EL-FET'H).....	457
49: DHOMAT PRIVATE (EL-HUXHURÂT).....	461
50: KAF (KÂF).....	464
51: [ERËRAT] SHPËRHAPËSE (EDH-DHÂRIJÂT).....	467
52: MALI (ET-TÛR).....	470
53: YLLI (EN-NEXHM).....	473
54: HËNA (EL-KAMER).....	476
55: ZOTI I MËSHIRËS (ER-RAHMÂN).....	479
56: AJO QË PO VJEN (EL-UÂKI'A).....	483
57: HEKURI (EL-HADÎD).....	486
58: POLEMIKA (EL-MUXHÂDILE).....	501
59: GRUMBULLIMI [I FORCAVE] (EL-HASHR).....	505
60: GRATË TË SPROVUARA (EL-MUMTEHINE).....	508
61: RRESHTAT SOLIDË (ES-SAFF).....	511
62: DITA E MBLËDHIMIT (EL-XHUMU'A).....	513
63: HIPOKRITËT (EL-MUNÂFIKÛN).....	515
64: SHPËRFILLJA RECIPROKE (ET-TEGÂBUN).....	517

65: DIVORCI (ET-TALÂK) .....	520
66: NDALESA (ET-TAHRÎM).....	523
67: KONTROLI (EL-MULK) .....	526
68: PENA (EL-KALEM) .....	529
69: ORA E PASHMANGSHME (EL-HÂKKA).....	532
70: RRUGËT E NGJITJES (EL-ME‘ÂRIXH) .....	535
71: NUHU (NÛH) .....	537
72: XHINDET (EL-XHINN).....	539
73: I MBËSHTJELLURI (EL-MUZZEMMIL).....	544
74: I MBULUARI ME PETKUN E TIJ (EL-MUDDETHTHIR) .....	546
75: RINGJALLJA (EL-KIJÂME).....	549
76: NJERIU (EL-INSÂN).....	551
77: [ERËRAT] TË ÇUARA PËRPARA (EL-MURSELÂT).....	554
78: LAJMI I MADH (EN-NEBE‘).....	559
79: KUAJT E FUQISHËM TË LUFTËS (EN-NÂZI‘ÂT) .....	561
80: AI U MRROL (‘ABESE).....	563
81: MBËSHTJELLË NË ERRËSIRË (ET-TEKUÎR).....	565
82: SHKATËRRUAR COPA-COPA (EL-INFITÂR) .....	567
83: ATA QË MATIN PADREJTËSISHT (EL-MUTAFFIFÎN) .....	569
84: SHQYER COPA-COPA (EL-INSHIKÂK).....	571
85: YJËSITË VIGANE (EL-BURÛXH) .....	573
86: AI QË VJEN NATËN (ET-TÂRIK) .....	575
87: MË I LARTI (EL-A‘LÂ) .....	577
88: NGJARJA E FUQISHME MADHORE (EL-GÂSHIJE) .....	581
89: AGU (EL-FEXHR) .....	583
90: QYTETI (EL-BELED).....	589
91: DIELLI (ESH-SHEMS) .....	593
92: NATA (EL-LEJL).....	595
93: SHNDRITJA E MËNGJESIT (ED-DUHÂ).....	599
94: LEHTËSIMI (EL-INSHIRÂH).....	601
95: FIKU (ET-TÎN) .....	604
96: FORMA NGJITËSE – RECITO! (EL-‘ALAK) .....	606
97: NATA E LAVDISË – NATA E FUQISË (EL-KADR) .....	610
98: PROVA E QARTË (EL-BEJJINE).....	613

99: TËRMETI – TRONDITJA (EZ-ZELZELE).....	615
100: ATLLARËT E SHPEJTË SULMUES – ATKINAT E SHPEJTA SULMUESE (EL-‘ÂDIJÂT) .....	618
101: GODITJA SHPARTALLUESE – KATASTROFA (EL-KÂRI‘A) .....	621
102: STËRMUNDIMI PËR MË TEPËR – GARIMI I MUNDIMSHËM PËR GJITHNJË E MË SHUMË (ET-TEKÂTHUR) .....	624
103: DITA NË MBARIM E SIPËR – EPOKA (EL-‘ASR).....	627
104: SHPIFËSI (EL-HUMEZE).....	630
105: ELEFANTI – ELEFANTËT (EL-FÎL) .....	633
106: KUREJSHËT (EL-KUREJSH) .....	636
107: MIRËSITË E RËNDOMTA – NEVOJAT (EL-MÂ‘ÛN).....	639
108: BEGATIA (EL-KEUTHER).....	642
109: MOSBESIMTARËT (EL-KÂFIRÛN) .....	644
110: NDIHMA (EN-NASR) .....	646
111: FIJA E PALMËS – FLAKA (EL-MESSED).....	649
112: PASTËRTIA [E BESIMIT] – E VËRTETA E PASTËR (EL-IHLÂS).....	652
113: AGU (EL-FELEK).....	655
114: NJERËZIT – NJERËZIMI (EN-NÂS).....	658
PËR PËRKTHIMET ANGLISHT.....	661
BIBLIOGRAFIA E PËRMbledhur e TËRË BOTIMIT .....	676

## Hyrje

Ky botim i përmban kaptinat (suret) e shqipëruara të Kuranit, që nga korriku 2015 kur kam filluar me kaptinën Jusufi, pastaj me një radhë sipas frymëzimit deri në gusht 2021 kur, me ndihmën e Zotit, e kam mbaruar kaptinën Nuhu. Pastaj teksti është redaktuar gjatë shtatorit dhe tetorit 2021. Teksti ka kaluar edhe nëpër një redaktim nga tetori 2021 deri në shkurt 2022.

Në vizitën që ia bëra hoxhë Ekrem Avdiut në Mitrovicë në nëntor 2020, ai më këshilloi që fjala Allah nuk përkthehet, prandaj të gjitha instancat ku anglisht është God janë përkthyer **Allah**. Këtë këshillë ma pati dhënë edhe Radije Hoxha në tetor, gjatë redaktimit të Shpellës, kur më tha se fjalës Lord (ang.) i përshtatet fjala Zot, e fjalës God – fjala Allah. Po ashtu një falënderim të veçantë e kam për mikun e kahershëm, Blerton Hoxhën, i cili më ka përkrahur që nga fillimi, e ka lexuar çdo version të çdo botimi, më ka dhënë komente e këshilla rregullisht dhe më ka inkurajuar se kjo që po e bëj është e vlefshme. Zoti ua shpërbleftë mundin për këshillat e vlefshme!

**Krahas këtij versionit, mund t'i shkarkoni edhe versionet ku për God (ang.) përdoret fjala Zoti, versionin ku përdoret fjala Perëndia dhe versionin ku përdoret fjala Hyji.**

Gjithsesi teksti mund të ketë lëshime të natyrave të ndryshme për të cilat kërkoj ndjesë paraprakisht dhe i ftoj të gjithë ata që gjejnë lëshime të tilla të më njoftojnë në emailin [rbunjaku@hotmail.com](mailto:rbunjaku@hotmail.com) apo përmes kanaleve të tjera të komunikimit.

Dhe, e fundit dhe më e rëndësishmja: lavdet e falënderimet janë për **Zotin**, I Cili është burimi i të gjitha të mirave e frymëzimeve.

Tetor 2021

## **Përmbledhje e parathënieve të të gjitha botimeve**

### **Gjuha e Kuranit**

Përgjithësisht pranohet se Kurani nuk mund të përkthehet në mënyrë të plotë dhe pikë për pikë për shkak të lidhjes së ngushtë ndërmjet formës së tij gjuhësore dhe përmbajtjes së tij kuptimore dhe për shkak të joproportionalitetit të arabishtes dhe gjuhëve jo-arabe. (...)

Për shkak se ky lloj i përqendrimit, i mundësuar nga natyra e gjuhës arabe klasike, nuk mund të riprodhohet në anglisht, jam përpjekur ta kompensoj disi me shtimin e shënimeve gjuhësore që i plotësojnë kuptimet e fjalëve të caktuara duke iu referuar rrënjëve të tyre dhe derivateve të ndërlidhura. Këto shënime prandaj do të duhej të shiheshin si pjesë e qenësishme e vetë përkthimit.

(Thomas Cleary, 1993, në parathënie)

### **Veçori stilistike**

Një nga veçoritë e dukshme të Kuranit është përdorja e kalimeve gramatike nga një përemër vetor në një tjetër (p.sh. nga veta e tretë tek e dyta tek e para e folësit; nga njëjës në shumës të madhështisë) dhe në kohët e foljeve. Kjo është praktikë e pranuar retorike në arabisht, e ngjashme me veçoritë e përdorura në disa letërsi evropiane.

(Abdel Haleem në parathënie)

### **Çështje të interpretimit**

Interpretimi komplikohet [tutje] nga stili tepër i ngjeshur i Kuranit. Një varg mund t'i përmbajë disa fjali shkurtimisht, stil proverbial, me referenca përemërore që i ndërlidhin ato me kontekst më të gjerë. Për më tepër formulimet proverbiale mund të nxirren nga teksti dhe të përdoren më vete, të izoluara nga konteksti i tyre dhe të paudhëzuara nga referenca të tjera në Kuran që do të mund të ofronin shpjegim të mëtejshëm. Edhe jo-myslimanët e etur për ta kritikuar Islamin edhe disa ekstremistë islamikë e kanë përdorur historikisht këtë teknikë për t'i arsyetuar pikëpamjet e tyre.

(Abdel Haleem në parathënie)

## **Shënime të shqipëruesit**

Burimet kryesore të përdorura për shqipërim janë:

*The Qur'an, A new translation* by M. A. S. Abdel Haleem, Oxford world's classics (Oxford University Press), originally published: 2004.

*The essential Koran: the heart of Islam: an introductory selection of readings from the Qur'an.* Cleary, Thomas F., HarperCollins, 1993

Aty ku ka pasur dallime thelbësore në nuansa është vendosur versioni i Abdel Haleem. Ndërsa për kontrollim në gjuhën shqipe burimi kryesor ka qenë:

*Kurani i madhërishëm*, përktheu kuptimet e tij nga gjuha arabe: Prof. Hasan I. Nahi, përgatiti për botim: Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam, Tiranë, 2006

Vëreni që në versionin e Abdel Haleem-it, Kurani është i shpërndarë nëpër fjali e paragrafe, ndërsa në versionin e Thomas Cleary-t ajetet janë kthyer në strofa e vargje në mënyrën më të përshtatshme për recitim. Ky format është ruajtur edhe gjatë shqipërimit. Çdo paragraf i Abdel Haleem fillon si paragraf. Çdo ajet i përzgjedhur nga Thomas Cleary është në formë të strofës e vargjeve. Në pjesët ku paragrafi i Abdel Haleem fillon në mes të strofave të Thomas Cleary-t, është futur një “krye-rresht” në atë varg për ta shenjuar fillimin e paragrafit.

Po ashtu, në këtë version, çdo i dhjeti varg e përmban edhe numrin e kaptinës, p.sh. ...<sup>7, 8, 9, 22:10, 11, 12</sup>... që të mund të gjendet më lehtë një varg, me kërkim në dokument. P.sh. nëse më duhet vargu 22:12, e kërktoj 22:10 dhe pastaj shkoj pak më poshtë. Kjo ndihmon edhe ta di se në cilën sure jam nëse jam diku në mes të librit.

Të gjitha fusnotat janë nga Abdel Halim, me përjashtime të rralla, me ç'rast theksohet burimi. Për më shumë informacion, ju lutem shihni shtojcat në fund.



## 1: Hapja (EL-FÂTIHA)

<sup>1</sup> Në emrin e **Allahut**, Zotit të Mëshirës,<sup>a</sup> Dhënësit<sup>b</sup> të Mëshirës!<sup>c</sup> <sup>2</sup> Lâvdi i përket **Allahut**, Zotit<sup>d</sup> të Botëve<sup>e</sup>, <sup>3</sup> Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës,<sup>4</sup> Kontrolluesit të Ditës së Gjykimit. <sup>5</sup> Je Ti që të adhurojmë; je Ti që të kërkojmë ndihmë. <sup>6</sup> Udhëzoni në rrugën e drejtë: <sup>7</sup> në rrugën e atyre që Ti i ke bekuar, që nuk pësojnë zemërim<sup>f</sup> dhe që nuk kanë devijuar.

---

<sup>a</sup> Shumica e paraqitjeve të këtij termi – *rahman* – në Kuran janë në kontekst Të Tij që është i fuqishëm dhe i madhërishëm si dhe mëshirëplotë. Shtuarja e fjalës ‘Zot’ këtu e ka synimin ta komunikojë këtë aspekt të termit.

<sup>b</sup> Ky term – *rahim* – është formë intensive që sugjeron se cilësia e dhënies së mëshirës është e qenësishme në natyrën e Zotit.

<sup>c</sup> Ky është rasti i vetëm ku kjo formulë, prezente në fillim të secilës sure pos njërës, numërohet si vargu i parë i numërtuar.

<sup>d</sup> Rrënja arabike *r-b-b* ka konotacione të kujdesit dhe të kultivimit përtej atij të zotërimit dhe kjo do të duhej të sillte ndërmend sa herë që shfaqet termi dhe është përkthyer ‘Zot’.

<sup>e</sup> *Al-‘alamin* në arabisht domethënë të gjitha botët: e njerëzimit, e engjëjve, e kafshëve, e bimëve, kjo botë, tjetra, e kështu me radhë.

<sup>f</sup> Vëreni se këtu folja nuk i është atribuar Zotit.

Abdel Haleem, 2004:

*Kjo sure duket të jetë tabelë precize e përmbajtjes së mesazhit Kuranik. Është shumë e rëndësishme në adhurimin Islamik, duke qenë pjesë e obligueshme e faljes ditore, e përsëritur disa herë gjatë ditës.*

*Hapja*

NË EMRIN E **ALLAHUT**, DHEMBSHURUESIT, MËSHIRËPLOTIT

Tërë lâvdi i përket **Allahut**,  
Zotit të të gjitha botëve,

Dhembshuruesit, Mëshirëplotit,

Kontrolluesit të Ditës së Gjykimit.

Je Ti që të adhurojmë,  
Dhe te Ti apelojmë për ndihmë.

Tregona rrugën e drejtë,

rrugën e atyre që Ti i ke nderuar,  
jo të atyre mbi të cilët është zemërata Jote,  
as të atyre që devijojnë.

Thomas Cleary, 1993:

## Shënimet

“Hapja” nganjëherë, në lidhje me popullaritetin e saj, krahasohet me Lutjen e Zotit të thënë nga Isai (Jezusi). Vetë Profeti thuhet ta ketë deklaruar Hapjen të jetë më i miri nga kapitujt në Kuran. Shtatë vargjet e saj janë rreshtat e Kuranit të përsëritur më së shpeshti dhe ajo i paraqet disa nga cilësitë e Zotit që përdoren më së shpeshti.

- 2 “Tërë lāvdi i përket Zotit” (*al hamdu li l Laah*): Nyja e shquar këtu është në kuptimin e bërjes së formulimit kategorik; si burim i gjithçkaje që është, i vetmi Zoti është përfundimisht i denjë për lavd. Lāvdi është aspekt i mirënjohjes, që sipas Al-Ghazalit e përbën gjysmën e “rrugës së drejtë” kah Zoti.

“Zotit të të gjitha botëve” (*Rabi l !aalamina*): Fjala për “Zot” është nga rrënja R-B-B, folja primitive e të cilës domethënë të jesh pronar, të jesh zotërues, të kesh posedim të, ta kontrollosh, të kesh komandë apo autoritet ndaj diçkaje. Fjala për “botë”, që në shumësin e shquar domethënë gjithësi apo kozmos, vjen nga e njëjta rrënjë si “dije” dhe “shenjë dalluese” (!-L-M), fakt me interes të lartë nga pikëpamja e filozofisë budiste e *vixhnaptimaatrataa*, apo “veç paraqitjes”, që thotë se bota siç e dimë përbëhet nga paraqitjet apo konstruktet mendore. Gjiganti sufi Muhiyuddin Ibn al Arabi shkruan po ashtu në *Fuhuus al Hikaam*-in e tij se gjithësia e krijuar është esencialisht imagjinatë.

- 3 “Dhembshuruesit, Mëshirëplotit” (*ar Rahmaan ar Rahiim*): Këta emra të Zotit janë derivate intensive të rrënjës R-H-M, që sugjeron dhembshuri dhe mëshirë. E kam përkthyer nyjën e shquar si treguese e Zotit që të karakterizohet nga mishërimi i këtyre cilësive, format intensive të të cilave i referohen lartësimi të Zotit pafundësisht përtej cilësive përkatëse njerëzore apo, subjektivisht, ngritjes së meditimit deri te përsosja ideale e Zotit. Dhembshuria dhe Mëshira i referohen aspekteve universale dhe të veçantëruara të bujarisë hyjnore. Al-Ghazali e konsideron me rëndësi të madhe faktin që Kurani nis me përmendjen e atributit dhembshurues dhe mëshirëplotë të Zotit, të cilat cilësi thotë që i bëjnë të nevojshme – në mënyrë të qenësishme – të gjitha atributet e tjera të Zotit dhe prandaj përmenden të parat në Kuran. “Dhembshuria” universale e Zotit është arsyeja se pse

ekziston gjithçka; “mëshira” e veçantëruar e Zotit është manifestimi providencial (i kujdesit dhe i udhëzimit hyjnor) i bujarisë së burimit të qenies.

- 6 “Tregona rrugën e drejtë” (*ihdinaa as\_siraat al mustaqiim*): Fjala për “e drejtë”, *mustaqiim*, vjen nga rrënja Q-W-M, që në formën e saj primitive i ka kuptimet si të rrish drejt, të performosh, të përmbushësh. *Mustaqiim*, pjesëza veprare e së tashmes e masës së tetë të kësaj rrënje ka nuanca të tilla si vertikal (në këmbë), i drejtë, korrekt, në gjendje të mirë, që ka rregull, i rrafshët, i rregullt, simetrik, proporcional, harmonik, i ndershëm, i çiltër, i drejtë, i respektueshëm: të gjitha këto kuptime duhet të lexohen në shprehjen “rruga e drejtë” siç përdoret në Kuran.

## 1. Hapja

- <sup>1</sup> Në emrin e **Allahut**,  
Dashmirësit,  
Mëshirëplotit.
- <sup>2</sup> Lâvdi i denjon **Allahut**,  
Zotit të gjithësisë,
- <sup>3</sup> Dashmirësit,  
Mëshirëplotit,
- <sup>4</sup> Kontrolluesit të Ditës së Shpagimit.
- <sup>5</sup> Je Ti që të shërbejmë,  
Ty të drejtohem për ndihmë.
- <sup>6</sup> Tregona rrugën e drejtë,
- <sup>7</sup> rrugën e atyre që Ti i ke nderuar,  
jo të atyre që janë caqe të zemërimit,  
as të atyre që devijojnë.

(Thomas Cleary, 2004)

## 1. Hyrja

Në emrin e **Allahut**, Të Mëshirshmit, Dhembshuruesit!

- <sup>1</sup> Ty, **Allahun**, Zotin e botëve, të lavdërojmë,
- <sup>2</sup> Të Mëshirshmin, Dhembshuruesin.
- <sup>3</sup> Kontrolluesin e Ditës së gjykimit.
- <sup>4</sup> Ty të adhurojmë dhe nga Ti ndihmë kërkojmë!
- <sup>5</sup> Udhëzona në Rrugën e Drejtë,
- <sup>6</sup> në Rrugën e atyre të cilëve ua ke dhuruar mëshirën Tënde
- <sup>7</sup> e jo të atyre që kundër vetes provokuan zemërim, as të atyre që kanë devijuar!

(Besim Korkut - nga boshnjakishtja)

## 2: Lopa (EL-BEKARE)

Në emrin e **Allahut**, Dashamirësit, Mëshirëplotit

- 1 Elif Lam Mim<sup>a</sup>
- 2 Ky është Libri, pa dyshim<sup>b</sup>,  
në të udhërrëfim për të vetëdijshmit<sup>c</sup> për **Allahun**,
- 3 ata që besojnë në të padukshmen<sup>d</sup>,  
që falen rregullisht<sup>e</sup>,  
dhe që japin<sup>f</sup> nga ajo  
që Ne ua kemi furnizuar;
- 4 dhe ata që besojnë  
në atë që të është shpallur [Muhamed],  
dhe atë që është shpallur para se të ishe,  
dhe që janë të sigurt për Të Përtejmen.
- 5 Ata e ndjekin udhërrëfimin nga Zoti i tyre;  
dhe janë të suksesshmit.
- 6 Sa për ata që tallen,  
për ta është njëjtë  
i paralajmërove apo jo –  
nuk besojnë.

---

<sup>a</sup> Këta janë emrat e tri shkronjave arabe: a, l dhe m. Njëzet e nëntë sure të Kuranit nisin me shkronja të veçanta të alfabetit si këto, diku nga një shkronjë individuale e diku deri në pesë. Janë ofruar interpretime të ndryshme. Mjafton t'i përmendim dy këtu: (1) këto shkronja u tregonin arabëve që dëgjuan fillimisht për Kuranin se Kurani përbëhet nga shkronja dhe fjalë të gjuhës së tyre, megjithëse ishte superior ndaj çfarëdo ligjërimi i tyre, duke qenë me origjinë hyjnore; (2) ato janë mjet thirrmos i synuar ta tërheqë vëmendjen e dëgjuesve, i ngjashëm me zakonet e nisjes së poezive me një "Jo!" apo "Vërtet!" empatike. Interpretuesit ekzegjetë normalisht shtonin, pas shpjegimit të teorive të tyre: "**Allahu** e di më së miri."

<sup>b</sup> Konstrukti arab *la rayba fihi* e bart më shumë se një kuptim, duke përfshirë 'nuk ka asgjë të diskutueshme për/në të' dhe 'nuk është për t'u dyshuar' sa i përket origjinës apo përmbajtjes së tij. (A.H.)

<sup>c</sup> Rrënja *w-q-y* në këtë formë morfologjike e ka kuptimin e të qenët i vetëdijshëm apo të qenët syçelë për diçka. E kundërta e të qenët i vetëdijshëm për **Allahun** është të injorohet Ai apo të mos kesh referencë ndaj Tij në mendimin, ndjenjën apo veprimin tënd. Ky është koncept themeltar për **Allahun** dhe për relacionin e besimtarëve me Të. Shumë përkthyes e përkthejnë termin si 'ata që i frikësohen **Allahut**', por kjo është shprehje e tepruar e termit dhe nuk e komunikon në mënyrë korrekte kuptimin e konceptit, i cili është shumë i përhapur në Kuran. (A.H.)

<sup>d</sup> Ajo që është përtej perceptimit të tyre, fjalë për fjalë 'që mungon' – kjo i adresohet natyrës së **Allahut**, Të Përtejmes, informacionit historik të paparë, etj. (A.H.)

<sup>e</sup> Kjo domethënë kryerje e rregullt dhe e duhur e lutjes formale (salah), siç është mësuar nga Profeti Muhamed. (A.H.)

<sup>f</sup> *Yunfiquna* në arabishten e Kuranit fjalë për fjalë domethënë 'të shpenzosh', në të tjerët, në kauzat e mira, në rrugën e **Allahut**. (A.H.)



7 **Allahu** ua ka vulosur zemrat,  
dhe të dëgjuarit e të pamurit e tyre  
kanë shtresë mbuluese;  
dhe ka vuajtje tmerrësisht tronditëse<sup>a</sup> për ta.

## II.

8 Dhe ka njerëz që thonë:  
"Besojmë në **Allahun** dhe në Ditën e Fundit,"  
por nuk besojnë.

9 Mundohen ta mashtrojnë **Allahun**  
dhe ata që besojnë,  
por e mashtrojnë veç veten,  
pa qenë të vetëdijshëm.

2:10 Në zemrat e tyre ka sëmundje,  
dhe **Allahu** i ka bërë më të sëmurë;  
dhe i pret torturë plot dhembje,  
se kanë gënjyer vazhdimisht.

11 Dhe kur u thuhet  
të mos bëjnë korrupsion në tokë,  
thonë: "Jemi veç reformues."

12 A s'janë ata –  
ata që bëjnë korrupsion  
qoftë edhe pavetëdijshëm?

13 Dhe kur u thuhet  
të besojnë siç besojnë njerëzit,  
thonë: "A të besojmë siç bëjnë të pamendët?"  
A s'janë vetë ata të pamendët,  
e që nuk e dinë?

---

<sup>a</sup> Kuptimi themelor i '*adhab*' është 'të kufizohet (që të mos bëjë keq)', që zgjerohet në kuptimin e çfarëdo gjëje të vështirë apo të dhembshme, ndëshkim, krizë për ushqim (shih 23:78). Shih *Majaz al-Qur'an*, nga 'Izz al-Din Ibn 'Abdul-Salam (London: Al-Furqan Foundation, 1999), 194 dhe E. W. Lane, *Arabic-English Lexicon* (Beirut: Librairie du Liban, 1968). (A.H.)

- 14 Dhe kur i takojnë besimtarët,  
thonë: "Besojmë,"  
por kur janë vetëm me të ligët e tyre  
thonë: "Në fakt jemi me ju –  
veç po mashtronim!"
- 15 **Allahu** tallet me ta,  
dhe i lejon të shkojnë tutje  
tek bredhin në teprimet e tyre.
- 16 Ata e kanë tregtuar gabimin  
me udhërrëfimin;  
prandaj shkëmbimi i tyre nuk u sjell fitim,  
dhe nuk janë të udhëzuar si duhet.
- 17 Mënyra si janë ata  
është si dikush që ndezi zjarr,  
dhe kur gjithçka përreth ishte ndriçuar  
**Allahu** ua mori dritën  
dhe i la në terr, pa mundur të shohin;
- 18 të shurdhër, memecë e të verbër,  
dhe të pakthyesëm.
- 19 Apo si [nën] re shiu nga qielli,  
që përmbajnë errësirë, bubullimë e vetëtimë.  
I fusin gishtat në veshë  
nga rrufetë,  
nga frika e vdekjes.  
Por **Allahu** i rrethon përqeshësit.
- 2:20 Vetëtima desh ua verbon sytë.  
Sa herë që ndriçon mbi ta,  
ecin atypari;  
dhe kur errësohet mbi ta,  
rrinë pa lëvizur.  
Dhe po të donte **Allahu**,  
do t'ua merrte  
dëgjimin dhe të pamurit.  
Se **Allahu** ka pushtet mbi gjithçka.

III.

- 21 O njerëzim! Shërbeni Zotit tuaj,  
që ju krijoi juve  
dhe ata para jush,  
që të mund të jeni të vetëdijshëm;
- 22 që e ka bërë tokën  
divan për ju dhe qiellin kulm,  
dhe ka pikëluar ujë nga qielli  
dhe u ka dhënë jetë frutave kështu,  
ushqim jetësor për ju.  
Pra mos i ngritni konkurrentë **Allahut**,  
se tash e dini.
- 23 Dhe nëse keni dyshime për atë  
se çka i kemi shpallur Ne shërbyesit Tonë,  
atëherë silleni një poemë si ajo;  
dhe thirrni përkrahësit<sup>a</sup> tuaj përveç **Allahut**,  
në qofshi të sinqertë.
- 24 Por nëse s'e bëni këtë  
– dhe s'do ta bëni –  
atëherë ruajuni zjarrit që lëndë djegëse  
i ka qeniet njerëzore dhe gurët,  
i përgatitur për ata që përqeshin.
- 25 Dhe lumturoji ata që besojnë  
dhe bëjnë vepra të mira,  
me lajmin se ka Kopshte për ta,  
nën të cilat rrjedhin lumenj;  
sa herë që furnizohen  
me fruta nga atje për t'u ushqyer,  
do të thonë: "Kjo është ajo  
që na është furnizuar më parë,"

---

<sup>a</sup> Fjalë për fjalë 'çfarëdo dëshmuesish'. Razi e interpreton këtë se i referohet ose idhujve të tyre ose udhëheqësve të tyre. (A.H.)

dhe do t'u jepet kjo si ngjasim<sup>a</sup>;  
dhe do të kenë bashkëshortë të pastër,  
dhe do të banojnë aty.

<sup>26</sup> Se **Allahu** nuk turpërohet ta shpikë një ngjashmëri,  
qoftë mushkonjë apo çkado më të lartë.<sup>b</sup>

Ata që besojnë e dinë

se është e vërtetë nga Zoti i tyre,

gjersa ata që tallen thonë:

"Çka ka nënkuptuar **Allahu** me këtë ngjashmëri?"

**Allahu** mashtron shumë njerëz kështu;

dhe udhëzon shumë njerëz kështu;

dhe **Allahu** nuk e mashtron askë kështu

pos të shtururit moralisht –

<sup>27</sup> ata që e shkelin marrëveshjen me **Allahun**

pas miratimit të saj,

dhe e përçajnë atë që **Allahu** ka urdhëruar të jetë e bashkuar,

dhe bëjnë korrupsion në tokë;

ata janë humbësit.

<sup>28</sup> Si mund ta mohoni **Allahun**,

kur ishit pa jetë dhe **Allahu** ju dha jetë?

Mandej **Allahu** do të bëjë të vdisni,

dhe pastaj t'ju ringjallë,

dhe pastaj do t'ju kthejnë te **Allahu**.

<sup>29</sup> Është **Allahu** Ai që krijoi për ju

gjithçka që është në tokë,

pastaj iu kthye lartësive

dhe i formësoi në shtatë qiej.

Dhe **Allahu** i di të gjitha gjërat.

#### IV.

---

<sup>a</sup> Një interpretim është se ata e shijojnë çdo ushqim kaq shumë sa që kënaqen t'i shohin pjatat e preferuara përsëri; një interpretim tjetër është se ushqimi i Parajsës i ngjan në pamje hijeshive të kësaj bote. (A.H.)

<sup>b</sup> Krahasimet siç janë ato të dhëna këtu janë parë nga disa si të pavend për **Allahun** dhe kjo është përgjigjja për ato kritika. (A.H.)

- 2:30 [Profet,] kur Zoti yt u tha engjëjve:  
"Do ta vendos një përfaqësues kujdestar<sup>a</sup> në tokë,"  
ata thanë: "Si mund ta vendosësh<sup>b</sup> dikë  
që do të bëjë telashe atje dhe të derdhë gjak?  
Dhe kjo gjersa ne e festojmë lavdërimin Tënd  
dhe të adhurojmë Ty?"  
**Allahu** tha: "Unë di gjëra që ju nuk i dini."  
31 Dhe **Allahu** ia mësoi Ademit të gjithë emrat,  
pastaj iu drejtua engjëjve dhe tha:  
"M'i tregoni këta emra, në qofshi të vërtetë."  
32 Ata thanë: "Lâvdi Ty!  
Nuk kemi njohuri  
pos asaj që na e ke mësuar Ti.  
Je Ti I Gjithë-Dijshmi, I Gjith'-Urti."  
33 **Allahu** tha: "Adem, tregojua emrat."  
Dhe kur ai ua tregoi emrat,  
**Allahu** tha: "A nuk ju thashë që e di  
fshehtësinë e qiejve dhe të tokës?  
Dhe e di çka shfaqni  
dhe çka keni qenë duke fshehur."  
34 Dhe kur Ne u thamë engjëjve  
të përkulen para Ademit në nderim,  
ata u përkulën; pos Iblisit  
ai refuzoi, duke shfaqur arrogancë;  
dhe ishte tallës.  
35 Dhe Ne thamë: "Adem,  
bano te kopshti,  
ti dhe gruaja jote,

---

<sup>a</sup> Termi *khalifa* normalisht përkthehet si 'mëkëmbës' (qeveritar në emër të dikujt) apo 'zëvendësues'. Gjersa ky është një kuptim i termit, kuptimi i tij themelor është 'pas-ardhës' – Kurani flet shpesh për gjeneratat dhe individët që janë pas-ardhës të njëri-tjetrit, krahaso me 6:165, 7:129, etj. – apo 'kujdestar' të cilit i jepet përkohësisht një përgjegjësi, krahaso Musain (Moses) dhe Harunin (Aaron), 7:142. (A.H.)

<sup>b</sup> Kjo është *istifham inkari* në arabisht, dmth. jo fjali pyetëse po thirrrore që normalisht shpreh mospajtim, më së miri e përkthyer 'Si mund'. Ka shembuj të shumtë të kësaj në Kuran. (A.H.)

dhe hani nga aty rehat,  
kur të doni dhe si të doni.  
Por mos iu qasni kësaj peme të caktuar,  
se bëheni keqbërës."

<sup>36</sup> Pastaj Satani i bëri të dy  
që kjo t'u rrëshqasë nga vetëdija  
dhe i bëri ta lënë  
gjendjen në të cilën ishin.

Dhe Ne thamë: "Uluni në nivel,  
në mospëlqim të ndërsjellë<sup>a</sup>;  
e prapë do të keni vend-banim  
dhe zotërime në tokë për ca kohë."

<sup>37</sup> Pastaj Ademi mësoi fjalë<sup>b</sup> nga Zoti i tij,  
I Cili e fali; se **Allahu** është Gjithmonë-Falësi, Mëshirëploti.

<sup>38</sup> Ne thamë: "Zbritni nga aty, të gjithë ju!  
E nëse udhërrëfimi ju vjen  
nga Unë, siç do të vijë patjetër,  
atëherë kushdo që e ndjek udhërrëfimin Tim  
nuk do të ketë asgjë që t'i frikësohet dhe nuk do të dëshpërohet.

<sup>39</sup> "Sa për ata që i përqeshin  
dhe nuk i pranojnë shenjat Tona,  
janë të burgosur të zjarrit të ferrit,  
ku edhe do të mbesin."

<sup>2:40</sup> Fëmijë të Izraelit, kujtojeni si ju kam bekuar Unë. Mbajeni premtimin tuaj ndaj Meje dhe Unë do ta mbaj premtimin Tim ndaj jush: Unë jam Ai të cilit duhet t'ia keni frikën. <sup>41</sup> Besoni në mesazhin që e kam zbritur duke e vërtetuar atë që tashmë e posedoni. Mos jini të parët që nuk besojnë në të dhe mos i shitni mesazhet E Mia për çmim të vogël: Unë jam Ai për të cilin duhet të jeni të vetëdijshëm.

<sup>42</sup> Dhe mos e turbulloni të vërtetën me pavërtetësi,  
apo ta fshihni të vërtetën kur e dini;

<sup>43</sup> dhe faluni rregullisht,

---

<sup>a</sup> Iblisi është armiku i njerëzimit dhe anasjelltas. Iblisi njihet edhe si Shejtan/Satan. (A.H.)

<sup>b</sup> Fjalë që e mësojnë Ademin si të pendohet, shih 7:23. (A.H.)

dhe jepni lëmoshë,  
dhe përkulni kokat [në adhurim]  
me ata që i përkulin të tyre.

44 Si i urdhëroni njerëzit të jenë të drejtë  
kur vetë harroni  
edhe pse e lexuat Librin?  
Tash a s'do të kuptoni?

45 Dhe kërkoni ndihmë  
të qëndrueshëm e duke u falur;  
edhe pse është vërtet rëndë  
pos për modestët,

46 ata që e dinë<sup>a</sup>  
se do ta takojnë Zotin e tyre  
dhe se do të kthehen tek Ai.

<sup>47</sup> Fëmijë të Izraelit, kujtojeni si ju kam bekuar Unë dhe si ju kam favorizuar ndaj popujve të tjerë.

48 Dhe jini syçelë për një Ditë  
kur asnjë shpirt nuk mund ta kompensojë  
fare një shpirt tjetër,  
dhe asnjë ndërmjetësim nuk pranohet për të,  
dhe asnjë çmim për çlirim nuk merret për të,  
dhe nuk do t'u ndihmohet atyre.

<sup>49</sup> Kujtojeni kur Ne ju shpëtuan nga populli i Faraonit, që ju nënshtruan me torturë të tmerrshme, duke jua vrarë djemtë brutalisht e duke jua kursyer veç gratë – kjo ishte sprovë e madhe nga Zoti juaj – <sup>2:50</sup> dhe kur Ne e ndamë detin mëdysh për ju, duke ju shpëtuar kështu dhe duke e fundosur popullin e Faraonit mu para syve tuaj. <sup>51</sup> Ne i caktuam dyzet net për Musain [në Malin Sinai] dhe pastaj, gjersa ai ishte larg, ju nisët ta adhuroni viçin – gabim i tmerrshëm. <sup>52</sup> Madje edhe atëherë Ne ju falëm, që të mund të ishit falënderues.

<sup>53</sup> Kujtojeni kur Ne ia dhamë Musait Shkrimin e Shenjtë dhe mënyrën për të dalluar [të drejtën dhe të gabuarën], që të mund të ishit të udhëzuar. <sup>54</sup> Musai i

---

<sup>a</sup> Një nga kuptimet klasike të *zanna* është 'të dish' në vend se kuptimi bashkëkohor dominues 'të mendosh'. Ky term përdoret në kuptimin e dijes disa herë në Kuran. (A.H.)

tha popullit të tij: 'Populli im, e keni dëmtuar veten duke e adhuruar viçin, kështu që pendohuni te Bërësi juaj dhe vritni [fajtorët ndërmjet] jush. Kjo është më e mira që mund ta bëni në sytë e Bërësit tuaj.' Ai e pranoi pendimin tuaj: Ai është Gjithmonë-I Dhembshuri dhe Më Mëshirëploti. <sup>55</sup> Kujtojeni kur thatë: 'Musa, nuk do të të besojmë deri kur ta shohim **Allahun** ballë për ballë.' Për shkak të kësaj, ju goditën rrufe gjersa vështronit. <sup>56</sup> Pastaj Ne ju ringjallëm pas vdekjes suaj, që të mund të ishit falënderues. <sup>57</sup> Ne i bëmë retë t'ju mbulojnë me hije dhe zbritëm mana dhe thëllëza, duke thënë: 'Hani gjërat e mira që Ne i kemi furnizuar për ju.' Nuk ishim Ne të dëmtuarit; ata e dëmtuan veten.

<sup>58</sup> Kujtojeni kur Ne thamë: 'Hyni në këtë qytet dhe hani lirshëm aty si t'jua ketë ëndja, por hyni në portën e tij me modesti dhe thoni: "Na lehtëso!" Pastaj Ne do t'jua falim mëkatet tuaja dhe do t'i rrisim shpërblimet e atyre që bëjnë mirë.' <sup>59</sup> Por keqbërësit e ndërruan me një fjalë ndryshe nga ajo që u ishte dhënë. Prandaj, meqë vazhdimisht ishin në mosbindje, Ne e zbritëm një murtajë nga qiejt mbi keqbërësit.

<sup>2:60</sup> Kujtojeni kur Musai lutej për ujë për popullin e tij dhe Ne i thamë: 'Godite shkëmbin me shkopin tënd.' Dymbëdhjetë burime shpërthyen dhe secili grup e dinte vendin e tij të pirjes. 'Hajeni dhe pijeni ushqimin jetik që e ka furnizuar **Allahu** dhe mos bëni korrupsion në vend.' <sup>61</sup> Kujtojeni kur thatë: 'Musa, nuk mund të durojmë të hamë veç një lloj të ushqimit, prandaj lutju Zotit tënd t'i sjellë për ne disa nga prodhimet e tokës, bimët dhe trangujt e saj, hudhurat, bishtajat dhe qepët e saj.' Ai tha: 'A do ta shkëmbenit atë që është më e mirë për atë që është më e keqe? Shkoni në Egjipt dhe atje do të gjeni ç'keni kërkuar.' Ata ishin goditur me poshtërim e mjerim dhe e pësuan zemërimin e **Allahut** se vazhdimisht i refuzuan mesazhet E Tij dhe vranë profetë në kundërshtim me çdo të drejtë. E tërë kjo ndodhi se nuk u bindën dhe ishin shkelës të ligjit.



<sup>62</sup> Qofshin myslimanë, çifutë,  
të krishterë a sabianë<sup>a</sup>,  
ata që besojnë në **Allahun** dhe në Ditën e Fundit  
dhe që bëjnë mirë  
e kanë shpërblimin e tyre me Zotin e tyre.  
S'ka frikë për ta,  
dhe nuk do të pikëllohen.

<sup>63</sup> Kujtojeni kur Ne e morëm premtimin tuaj dhe e bëmë kullën e malit lart mbi ju dhe thamë: 'Mbahuni fort për atë që Ne jua kemi dhënë dhe mbajeni në mend përmbajtjen e saj, që të mund të jeni të vetëdijshëm për **Allahun**.' <sup>64</sup> Madje edhe pas kësaj u larguat. Po të mos kish qenë mirësia dhe mëshira e **Allahut** mbi ju, sigurisht që do të ishit të humbur. <sup>65</sup> Ju e dini për ata nga ju që e prishën Sabathin e shenjtë dhe kështu Ne u thamë: 'Jini si majmunë!<sup>b</sup> Jini të dëbuar!' <sup>66</sup> Ne e bëmë këtë shembull për ata njerëz që ishin aty në atë kohë dhe për ata që erdhën pas tyre dhe mësim për të gjithë ata që janë të vetëdijshëm për **Allahun**.

<sup>67</sup> Kujtojeni kur Musai i tha popullit të tij: '**Allahu** ju urdhëron ta flijoni një lopë.' Ata thanë: 'A po tallesh me ne?' Ai u përgjigj: '**Allahu** më ruajttë të mos jem kaq i paditur!' <sup>68</sup> Ata thanë: 'Thirre Zotin tënd për ne, të na tregojë se çfarë lloj lope duhet të jetë.' Ai u përgjigj: '**Allahu** thotë se nuk duhet të jetë as tepër e vjetër as tepër e re, por mesatare, pra veproni siç ju urdhërohet.' <sup>69</sup> Ata thanë: 'Thirre Zotin tënd për ne, të na tregojë se çfarë ngjyre duhet të jetë.' Ai u përgjigj: '**Allahu** thotë se duhet të jetë lopë e verdhë e ndritshme, e këndshme për syrin.' <sup>2:70</sup> Ata thanë: 'Thirre Zotin tënd për ne, të na tregojë [saktësisht] se si është: të gjitha lopët janë pak a shumë të ngjashme për ne. Me vullnetin e **Allahut**, do të udhëzohemi.' <sup>71</sup> Ai u përgjigj: 'Është lopë e përsosur dhe pa asnjë njollë, e pamësuar në punët e tokës apo në ujitjen e fushave.' Ata thanë: 'Tash e ke sjellë të vërtetën' dhe kështu e prenë atë, edhe pse pothuajse dështuan ta bëjnë këtë. <sup>72</sup> Pastaj, kur ju [Izraelitët] e vratë dikë dhe nisët ta fajësonit njëri-tjetrin – edhe pse **Allahu** do ta nxirrte në dritë atë që e patët fshehur – <sup>73</sup> Ne thamë: 'Godite [trupin] me një pjesë [të lopës]': kështu **Allahu** i sjell të vdekurit në jetë dhe i tregon shenjat E Tij që të mund të kuptoni. <sup>74</sup> Edhe pas kësaj, zemrat tuaja u bënë të forta si shkëmbinj, apo edhe më të forta, se ka shkëmbinj nga të cilët gufojnë burime dhe disa nga të cilët del uji kur çahen mëdysh dhe të tjerë që bien

---

<sup>a</sup> Sabianët ishin komunitet religjioz monoteist. Shih M. Asad, *The Message of the Qur'an* (Gibraltar: Dar al-Andalus, 1997), 40 n. 49. (A.H.)

<sup>b</sup> Kjo kuptohet nga disa si 'fizikisht kthehuni në majmunë' por në fakt është figurë e ligjëratës – struktura 'jini majmunë' është si 'jini shkëmbinj/hekur' te 17:50. Siç i përshkruan Kurani mosbesimtarët si të verbër, të shurdhër dhe memecë, këtu shkelësit janë majmunë.

poshtë në respekt të thellë për **Allahun**: Ai nuk është i painformuar për atë që e bëni.

<sup>75</sup> Pra a mundeni ju [besimtarë] të shpresoni se njerëz të tillë do t'ju besojnë, kur disa nga ta i patën dëgjuar fjalët e **Allahut** dhe pastaj me qëllim i shtrembëruan, madje edhe kur i kuptuan ato? <sup>76</sup> Kur i takojnë besimtarët, thonë: 'Edhe ne besojmë.' Por kur janë vetëm me njëri-tjetrin thonë: 'Si mundët t'u tregonit atyre për shpalljen e **Allahut** [te ne]? Ata do të jenë në gjendje ta përdorin këtë për të argumentuar kundër jush para Zotit tuaj! Ku e keni mendjen?' <sup>77</sup> A nuk e dinë se **Allahu** është i informuar mirë për atë që e fshehin dhe atë që e zbulojnë? <sup>78</sup> Disa nga ta janë të paedukuar dhe e dinë Shkrimin e Shenjtë veç përmes interpretimit sipas dëshirës së tyre. Mbështeten në hamendje. <sup>79</sup> Pra mjerë ata që shkruajnë diçka me duart e tyre dhe pastaj deklarojnë: 'Kjo është nga **Allahu**', që të nxjerrin ndonjë përfitim të vogël. Mjerë ta për atë që e kanë shkruar duart e tyre! Mjerë ta për krejt atë që e kanë nxjerrë fitim! <sup>2:80</sup> Thonë: 'Zjarri do të na prekë veç për ca ditë.' Thuajuni: 'A keni marrë premtim nga **Allahu** – se **Allahu** nuk e shkel kurrë premtimin E Tij – apo po thoni gjëra për Të për të cilat nuk keni dije të vërtetë?' <sup>81</sup> Vërtet ata që bëjnë keq dhe janë të rrethuar nga mëkatet e tyre do të jenë banorë të Zjarrit, të mbetur aty, <sup>82</sup> gjersa ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira do të jenë banorë të Kopshtit, të mbetur aty.

<sup>83</sup> Kujtojeni kur Ne e morëm një zotim nga Fëmijët e Izraelit:

Mos adhuroni gjë pos **Allahut**;  
jini të mirë me prindërit dhe të afërmit tuaj,  
dhe ndaj jetimëve dhe të varfërve.  
Thoni njerëzve fjalë të mira,  
faluni rregullisht,  
dhe jepni lëmoshë.

Pastaj të gjithë ju pos disave u larguat dhe nuk i kushtuat vëmendje kësaj.

<sup>84</sup> Dhe kur Ne e morëm premtimin tuaj  
se nuk do të derdhnit gjak tuajin,  
dhe nuk do t'i dëbonit tuajt nga shtëpitë e tyre,  
pastaj e konfirmuat,  
siç jeni dëshmitarë vetë.

<sup>85</sup> Por pastaj ju vetë  
i vratë njerëzit tuaj,  
dhe e dëbuan një grup nga ju  
prej shtëpive të tyre,  
duke i ndihmuar përpjekjet kundër tyre  
me ligësi e agresion të fortë.

Nëse ju vijnë si robër lufte, ju ende paguani për t'i çliruar, edhe pse nuk patët asnjë të drejtë t'i dëbonit.<sup>a</sup> Pra a besoni në disa pjesë të Shkrimit të Shenjtë e jo në të tjerat? Ndëshkimi për ata nga ju që e bëjnë këtë do të jetë asgjë tjetër pos turp në këtë jetë, dhe në Ditën e Ringjalljes ata do të ndëshkohen me torturën më të ashpër: **Allahu** nuk është i painformuar për atë që e bëni.<sup>86</sup> Këta janë njerëzit që e blejnë jetën e kësaj bote me çmimin e Të Përtejmes: tortura e tyre nuk do të lehtësohet, as s'do të ndihmohen.

<sup>87</sup> Ne ia dhamë Musait Librin,  
dhe çuam të dërguar të vijnë pas tij.  
Dhe i dhamë dëshmi të qarta  
Isait, të birit të Merjemes,  
dhe e fuqizuan  
me Shpirtin e Shenjtë.  
A s'jeni mendjemëdhenj e arrogantë  
kurdo që ju vjen një i dërguar  
me diçka që vetë nuk e keni merak?  
Disa i keni damkosur si rrenësa,  
të tjerë i keni vrarë.

<sup>88</sup> Thonë: 'Zemrat tona janë të mbështjella në mënyrë të padepërtueshme [nga çkadoqoftë që thoni]', por **Allahu** i ka refuzuar<sup>b</sup> për shkak të mosbesimit të tyre: ata kanë besim pak.<sup>89</sup> Kur u erdhi një Shkrim i Shenjtë nga **Allahu** duke e vërtetuar atë që tashmë e kishin dhe kur po luteshin për fitore ndaj mosbesimtarëve, madje edhe kur atyre u erdhi diçka që e dinin [se është e vërtetë], patën mosbesim në të: **Allahu** i refuzon ata që kanë mosbesim.

---

<sup>a</sup> Razi: edhe pse çifutët luftonin kundër njëri-tjetrit në aleancë me fise të ndryshme arabe, kur ana e tyre e zinte rob një çifut nga një anë tjetër, ata do të paguanin për t'i çliruar, sepse siç thonin kjo ishte kërkesë nga Torah.

<sup>b</sup> *La'ana* në fjalorët arabë e jep kuptimin e *tarada*: 'të refuzosh', 'të largosh' e jo 'të mallkosh'.

<sup>2:90</sup> E pështirë është ajo për të cilën janë shitur,  
që ta mohojnë atë që e ka zbritur **Allahu**  
nga zilia që Ai  
i dhuron nga mirësia E Tij  
kujtdo nga shërbyesit E Tij  
që vendos.  
Prandaj i kanë shkaktuar vetes  
zemëratë pas zemërate;  
dhe për mosbesimtarët  
ka vuajtje turpëruese.

<sup>91</sup> Kur u thuhet: ‘Besoni në shpalljet e **Allahut**’, përgjigjen: ‘Ne besojmë në atë që na është shpallur neve’, por ata nuk besojnë në atë që erdhi më pas, edhe pse është e vërteta që e konfirmon atë që e kanë tashmë. Thuaj [Muhamed]: ‘Pse i keni vrarë profetët e **Allahut** në të shkuarën nëse keni qenë besimtarë të vërtetë?’  
<sup>92</sup> Musai ju solli shenja të qarta, por pastaj, gjersa ishte larg, vendosët ta adhuronit viçin – keni gabuar.’

<sup>93</sup> Kujtojeni kur Ne e morëm zotimin tuaj, duke e bërë kullën e malit mbi ju, dhe thamë: ‘Mbahuni fort për atë që jua kemi dhënë dhe dëgjoni [atë që e themi Ne].’ Thanë: ‘Dëgjojmë dhe nuk bindemi’ dhe përmes mosbesimit të tyre u detyruan ta pinë [dashurinë për] viçin thellë në zemrat e tyre. <sup>94</sup> Thuaj: ‘Sa të liga janë gjërat që besimi juaj ju urdhëron t’i bëni, në qofshi vërtet besimtarë!’ Thuaj: ‘Nëse shtëpia e fundit me **Allahun** është për të qenë veç për ju dhe askë tjetër, atëherë do të duhej ta dëshironit vdekjen fort, nëse pretendimi i juaj është i vërtetë.’ <sup>95</sup> Por ata nuk do ta dëshirojnë kurrë vdekjen fort, për shkak të veprave të grumbulluara me duart e tyre: **Allahu** është i informuar plotësisht për keqbërësit.  
<sup>96</sup> [Profet,] me siguri do t’i glesh duke u kapur për jetën më me zell se sa cilëtdo njerëz tjerë, madje edhe se politeistët. Secili nga ta do të donte t’i jepej jetë prej njëmijë vitësh, megjithëse edhe një jetë kaq e gjatë nuk do t’i shpëtonte nga tortura: **Allahu** sheh gjithçka që bëjnë.

<sup>97</sup> Thuaj [Profet]: ‘Nëse dikush është armik i Xhebrailit (Gabrielit) – që me lejen e **Allahut** e zbriti Kuranin në zemrën tënde duke i vërtetuar shkrimet e shenjta të mëparshme si udhëzues dhe lajm i mirë për besimplotët – <sup>98</sup> nëse dikush është armik i **Allahut**, i engjëjve Të Tij dhe i të dërguarve Të Tij, i Xhebrailit dhe Mikailit, atëherë **Allahu** është sigurisht armik i mosbesimtarëve të tillë.’ <sup>99</sup> Se Ne të kemi zbritur mesazhe të qarta dhe veç ata që [e] refuzojnë [**Allahun**] do të refuzonin t’i besonin ato. <sup>2:100</sup> Si ndodh që kurdo që e bëjnë një

besëlidhje apo zotim, disa nga ta e flakin tutje? Në fakt, shumica nga ta nuk besojnë.

<sup>101</sup> Kur **Allahu** ua çoi një të dërguar që i vërteton Shkrimet e Shenjta që i kishin tashmë, disa nga ta që e patën pranuar Shkrimin e Shenjtë më parë e hodhën Librin e **Allahut** pas shpine sikur të mos kishin kurrfarë njohurie <sup>102</sup> dhe në vend të kësaj e ndoqën atë që e kishin shpikur të ligët për Mbretërinë e Sulejmanit.

Sulejmani nuk ishte mosbesimtar,

po të ligët ishin mosbesimtarë;

u mësuan njerëzve magji

dhe çka u zbriti

engjëjve në Babiloni,

Harutit e Marutit.

Por këta dy nuk e mësuan kurrë askë

pa thënë:

“Jemi veç sprovë joshëse,

pra mos jini mosbesues.”

Por pastaj, megjithatë, ata mësuan nga këta dy

çka do ta ndante burrin dhe gruan;

e prapë nuk e lëndojnë askë me këtë

pos me leje të **Allahut**.

Dhe e mësuan atë që do t’i dëmtonte,

jo atë që do t’u bënte mirë.

Dhe tashmë e dinin

se ata që fituan [nga kjo njohuri]

nuk kishin hise në Të Përtejmen.

Dhe e pështirë ishte ajo për të cilën u shitën,

ah po ta dinin!

<sup>103</sup> Dhe ah sikur ata

të ishin besues

e të vetëdijshëm për **Allahun**,

shpërblimi nga prezenca E Tij

do të ishte sigurisht më i mirë;

ah po ta dinin!

<sup>104</sup> Besimtarë, mos [i] thoni [Profetit]: ‘*Ra`ina*’, por thoni: ‘*Undhurna*’<sup>a</sup> dhe dëgjo[je]ni [atë]: torturë e dhembshme i pret ata që [i] injorojnë [fjalët e **Allahut**].  
<sup>105</sup> As ata Njerëz të Librit që kanë mosbesim as idhujtarët nuk do të donin që juve t’ju zbritej asgjë e mirë nga Zoti juaj, por **Allahu** e zgjedh për mirësinë E Tij atë që do ta zgjedhë: bujaria E Tij nuk ka kufij. <sup>106</sup> Cilëndo shpallje që Ne bëjmë të mbishkruhet apo të harrohet, e zëvendësojmë me diçka më të mirë apo të ngjashme. A nuk e di [Profet] se **Allahu** ka pushtet ndaj çdo gjëje? <sup>107</sup> A nuk e di se kontrolli i qiejve dhe i tokës i përket Atij? Ju [besimtarë] nuk keni mbrojtës apo ndihmues pos **Allahut**. <sup>108</sup> A dëshironi të kërkonit nga i dërguari juaj diçka të ngjashme me atë që ishte kërkuar nga Musai?<sup>b</sup> Kushdo që e ndërron besimin me mosbesim ka devijuar larg nga rruga e duhur. <sup>109</sup> Madje edhe pasi t’u jetë qartësuar e vërteta, shumë nga Njerëzit e Librit do të donin të mund t’ju kthenin në mosbesim pasi keni besuar, për shkak të zilisë së tyre vetjake. Falini dhe kini durim deri kur **Allahu** ta japë urdhrin E Tij: Ai ka pushtet ndaj të gjitha gjërave. <sup>2:110</sup> Faluni rregullisht dhe jepni lëmoshë. Çfarëdo të mire që me vepra e grumbulloni për veten, do ta gjeni me **Allahun**: Ai sheh gjithçka që bëni.

<sup>111</sup> Ata thonë edhe: ‘Askush nuk do të hyjë në Parajsë pos nëse është çifut apo i krishterë.’ Ky është interpretimi i tyre sipas dëshirës. [Profet,] thuaj: ‘Prodhojeni dëshminë tuaj, nëse po e thoni të vërtetën.’ <sup>112</sup> Në fakt, cilëndo që e drejtojnë veten<sup>c</sup> plotësisht kah **Allahu** dhe bëjnë mirë do ta kenë shpërblimin e tyre me Zotin e tyre: s’ka frikë për ta, as s’do të pikëllohen. <sup>113</sup> Çifutët thonë: ‘Të krishterët nuk kanë kurrfarë baze ku të qëndrojnë’ dhe të krishterët thonë: ‘Çifutët nuk kanë kurrfarë baze ku të qëndrojnë’, edhe pse të dyja palët e kanë lexuar Shkrimin e Shenjtë dhe ata që nuk kanë njohuri e thonë të njëjtën; **Allahu** do të gjykojë mes tyre në Ditën e Ringjalljes në lidhje me dallimet e tyre.

<sup>114</sup> Kush do të mund të ishte më i lig se ata që e ndalojnë përmendjen e emrit të **Allahut** në vendet E Tij të adhurimit<sup>d</sup> dhe që përpiqen t’i bëjnë ata të dezertojnë? Njerëzit e tillë nuk do të duhej të futen brenda tyre pa frikë: ka turp për ta në këtë botë dhe ndëshkim të dhembshëm në të përtejmen.

---

<sup>a</sup> Fjala *ra`ina* mund të përdoret me mirësjellje si shprehje për ‘na shikoni’. Mirëpo, një grup i çifutëve në Medinë që ishin armiqësorë ndaj Muhamedit e ndërruan pak shqiptimin e saj për të nënkuptuar ‘ti je budalla’ apo ‘ti i kullot delet tona’ në mënyrë që ta shanin Profetin. Prandaj besimtarët këshillohen ta shmangin atë fjalë dhe në vend të saj ta përdorin *undhurna*, që po ashtu domethënë ‘na shikoni’. Shih 4:46.

<sup>b</sup> Shih 2:55 dhe 4:153.

<sup>c</sup> Fjalë për fjalë: ‘fytyrat e tyre’. Një kuptim i *wahj* (fytyra) është ‘drejtimi’ dhe kuptimi themelor i *aslama* është ‘përkushtimi’. Shih shënimin për 2:128.

<sup>d</sup> Razi sugjeron se kjo me gjasë aludon në vërejtjet e çifutëve për ndryshimin e *kiblës* (drejtimit të lutjeve) nga Jerusalemi në Mekë dhe përpjekjet e tyre t’i ndalin njerëzit të luten drejt Mekës në xhaminë e Profetit në Medinë (shih 2:115 dhe 142).

115 **Allahut** i përkasin Lindja dhe Perëndimi;  
dhe ngado që të ktheheni,  
është Fytyra E Tij.<sup>a</sup>  
Se **Allahu** është kudo-prezent, i gjithë-dijshëm.

116 E thonë<sup>b</sup> **Allahu** ka fëmijë.  
Lavduar qoftë Ai!  
Jo! Atij i përkasin të gjitha  
në qiej dhe në tokë;  
gjithçka i bindet Atij.

117 Ai është zanafillësi  
i qiejve dhe i tokës;  
dhe kurdo që urdhëron diçka,  
veç thotë: “Ji!”  
dhe është.

<sup>118</sup> Ata që nuk kanë njohuri thonë po ashtu: ‘Ah veç po të na fliste **Allahu!**’ apo ‘Ah po të na vinte një shenjë mrekullie!’ Njerëzit para tyre i thanë gjërat e njëjta: zemrat e tyre janë krejt njëlloj. Ne i kemi bërë shenjat Tona mjaft të qarta për ata që kanë besim të fortë. <sup>119</sup> Ne të kemi dërguar ty [Profet] me të vërtetën, duke sjellë lajm të mirë dhe paralajmërim. Ti nuk do të jesh përgjegjës për banorët e Flakës. <sup>2:120</sup> Çifutët dhe të krishterët nuk do të jenë kurrë të kënaqur me ty pos nëse i ndjek rrugët e tyre. Thuaj: ‘Udhëzimi i **Allahut** është udhëzimi i vetëm i vërtetë.’ Po t’i ndiqje dëshirat e tyre pasi të ka ardhur dituria, nuk do ta gjeje askë të të mbrojë nga **Allahu** apo të të ndihmojë. <sup>121</sup> Ata të cilëve Ne ua kemi dhënë Shkrimin e Shenjtë, që e ndjekin atë siç e meriton,<sup>c</sup> janë ata që vërtet besojnë në të. Ata që e refuzojnë të vërtetën e tij do të jenë humbësit.

<sup>122</sup> Fëmijë të Izraelit, kujtojeni se si ju bekova Unë dhe ju favorizova ndaj popujve të tjerë, <sup>123</sup> dhe kini kujdes nga një Ditë kur asnjë shpirt nuk mund ta bëjë punën e një shpirti tjetër. As një kompensim nuk do të pranohet, as ndërmjetësimi nuk do të jetë i dobishëm dhe askush nuk do të ndihmohet. <sup>124</sup> Kur Zoti i Ibrahimit e sprovoi me urdhëresa të caktuara, të cilat ai i plotësoi, Ai tha: ‘Unë do të të bëj udhëheqës të popullit.’ Ibrahim pyeti: ‘Dhe a do të bësh

---

<sup>a</sup> Apo ‘Drejtimi I Tij’.

<sup>b</sup> Razi sugjeron se kjo i referohet arabëve paganë (shih 16:57) dhe (disa) të krishterëve dhe çifutëve (shih 9:30).

<sup>c</sup> Kjo mund ta ketë edhe kuptimin ‘që e lexojnë siç do të duhej të lexohet’.

Ti udhëheqës edhe nga pasardhësit e mi?’ **Allahu** u përgjigj: ‘Premtimi Im nuk vlen për ata që bëjnë keq.’

<sup>125</sup> Ne e bëmë Shtëpinë<sup>a</sup> vend-pushim dhe të shenjtë për njerëzit, duke thënë: ‘Merreni pikën ku qëndroi Ibrahim si vendin tuaj të lutjeve.’ E urdhëruam Ibrahim dhe Ismailin: ‘Pastrojeni Shtëpinë Time për ata që ecin përreth saj, për ata që rrinë aty dhe për ata që përkulen dhe gjunjzohen në adhurim.’

<sup>126</sup> Ibrahim tha: ‘Zoti im, bëje këtë tokë të sigurt dhe furnizoji me prodhime ata nga populli i tyre që besojnë në **Allahun** dhe në Ditën e Fundit.’ **Allahu** tha: ‘Sa për ata që nuk besojnë, do t’u dhuroj kënaqësi për një kohë të shkurtër dhe pastaj do t’i nënshtroj në torturën e Zjarrit – destinacion i keq.’

<sup>127</sup> Gjersa Ibrahim dhe Ismaili i ndërtonin themelet e Shtëpisë[, u lutën]: ‘Zoti ynë, prano[je këtë] nga ne. Ti je Gjithë-Dëgjuesi, I Gjithë-Dijshmi. <sup>128</sup> Zoti ynë, na bëj të përkushtuar<sup>b</sup> ndaj Teje; bëji pasardhësit tanë komunitet të përkushtuar ndaj Teje. Na trego si të adhurojmë dhe pranoje pendimin tonë, se Ti je I Gjithë-Buti, Më Mëshirëploti. <sup>129</sup> Zoti ynë, bëje një të dërguar të tyrin të ngritet nga mesi i tyre, që t’ua recitojë shpalljet e Tua, t’ua mësojë Shkrimin e Shenjtë dhe urtinë dhe t’i pastrojë: Ti je I Fuqishmi, I Urti.’

<sup>2:130</sup> Kush pos një budalla do ta braktiste fenë e Ibrahimit? Ne e kemi zgjedhur atë në këtë botë dhe ai do të renditet ndër të ndershmit në Të Përtejmen. <sup>131</sup> Zoti i tij i tha: ‘Përkushtomu Mua.’ Ibrahim u përgjigj: ‘I përkushtohem Zotit të Gjithësisë’ <sup>132</sup> dhe i urdhëroi bijtë e tij ta bëjnë të njëjtën, siç bëri Jakubi: ‘Bijtë e mi, **Allahu** e ka zgjedhur fenë [tuaj] për ju, prandaj sigurohuni t’i përkushtoheni Atij, deri në momentin tuaj të vdekjes.’

<sup>133</sup> A ishit [ju çifutë] aty të shihni kur i erdhi vdekja Jakubit? Kur ai u tha bijve të tij: ‘Çka do të adhuroni pasi të kem shkuar?’ ata u përgjigjën: ‘Do ta adhurojmë **Allahun** tënd dhe **Allahun** e etërve tu: Ibrahimit, Ismailit dhe Is’hakut, një Zot i vetëm: ne i përkushtohemi Atij.’<sup>c</sup> <sup>134</sup> Ai komunitet vdiq. Ajo që e kanë fituar u përket atyre dhe ajo që e fitoni ju – ju përket juve: nuk do të jeni të përgjegjshëm për veprat e tyre.

<sup>135</sup> Thonë: ‘Bëhuni çifutë apo të krishterë dhe do të jeni të udhëzuar si duhet.’ Thuaj [Profet]: ‘Jo, [e jona është] feja e Ibrahimit, të drejtit, që nuk adhuroi asnjë zot pos **Allahut**.’

---

<sup>a</sup> Qaben në Mekë.

<sup>b</sup> *Aslama* këtu e ka kuptimin ta përkushtosh veten ndaj **Allahut** që është një i vetëm, ashtu që Ibrahim do të vijë te Zoti i tij me zemrën e tij plotësisht të përkushtuar ndaj Tij: 3:64, 26:89, 37:84.

<sup>c</sup> ‘Një **Zot** i vetëm’ e përforcon interpretimin e *islam*-it si ‘përkushtim’, një kuptim i *aslama* (al-Mu`jam al-Wasit).



<sup>136</sup> Pra [ju besimtarë] thoni:  
‘Besojmë në **Allahun**,  
dhe në atë që na është zbritur neve,  
dhe në atë që i është zbritur Ibrahimit dhe Ismailit  
dhe Is’hakut dhe Jakubit dhe Fiseve  
dhe në atë që i është dhënë Musait dhe Isait,  
dhe në atë që i është dhënë profetëve  
nga Zoti i tyre.  
Dhe nuk bëjmë ndonjë dallim  
në mes të individëve ndër ta,  
se i përkushtohemi Atij.’

<sup>137</sup> Pra nëse besojnë siç bëni ju, do të jenë të udhëzuar drejt. Por nëse e kthejnë shpinën, atëherë do të jenë të fiksuar në kundërshtim. **Allahu** do t’ju mbrojë nga ta: Ai është Gjithë-Dëgjuesi, I Gjithë-Dijshmi. Dhe thoni [besimtarë]: <sup>138</sup> ‘[Jeta jonë] e merr ngjyrën e saj nga **Allahu** dhe kush jep ngjyrë më të mirë se **Allahu**? Është Ai – Ai që e adhurojmë.’

<sup>139</sup> Thuaj [Profet] [çifutëve dhe të krishterëve]: ‘Si mund të kundërshtoheni me ne për **Allahun** kur Ai është Zoti ynë dhe Zoti juaj? Veprat tona na përkasin neve dhe tuajat juve. Ne i përkushtohemi plotësisht Atij. <sup>2:140</sup> Ose a po thoni se Ibrahim, Ismaili, Is’haku, Jakubi dhe Fiset ishin çifutë apo të krishterë?’ [Profet,] pyeti: ‘Kush di më mirë: ju apo **Allahu**? Kush do të mund të ishte më i ligë se ata që e fshehin një pohim [që e pranuan] nga **Allahu**? **Allahu** nuk është i pavëmendshëm për atë që e bëni.’ <sup>141</sup> Ai komunitet vdiq: ajo që e kanë fituar u përket atyre dhe ajo që e fitoni ju – ju përket juve. Nuk do të jeni të përgjegjshëm për veprat e tyre.

<sup>142</sup> Njerëzit e pamend do të thonë: ‘Çka i ka larguar ata nga drejtimi i lutjeve kah i cili ktheheshin?’<sup>a</sup> Thuaj: ‘Lindja dhe Perëndimi i përkasin **Allahut**. Ai e udhëzon këdo që do ta udhëzojë në rrugën e drejtë.’ <sup>143</sup> Ne ju kemi bërë [juve besimtarë] komunitet të drejtë,<sup>b</sup> që të mund të dëshmoni [të vërtetën] para të tjerëve dhe që I Dërguari të mund të dëshmojë [për të] para jush. Ne veç e bëmë drejtimit atë që [ti Profet] e përdore për ta kthyer fytyrën për t’i dalluar ata që e ndjekin Të Dërguarin nga ata që u ndanë befas: ajo provë ishte e vështirë, pos për ata që i ka udhëzuar **Allahu**. **Allahu** nuk do ta linte kurrë besimin tuaj [besimtarë] të shkonte kot,<sup>c</sup> se **Allahu** është më i dhembshuri dhe më

---

<sup>a</sup> Kjo i referohet ndërrimit në drejtimin e lutjes së myslimanëve nga Jerusalemi në Mekë në vitin e dytë të Hixhra-s.

<sup>b</sup> Fjalë për fjalë: ‘komb i mesëm’

<sup>c</sup> Kjo i siguroi ata që pyetën se a kishin shkuar kot lutjet e thëna drejt Jerusalemit.

mëshirëploti ndaj njerëzve.<sup>144</sup> Shumë herë të kemi parë [Profet] ta kthesh fytyrën kah Qielli, kështu që Ne po të kthejmë kah një drejtim i lutjes që të kënaq.<sup>a</sup> Ktheje fytyrën tënde në drejtimin e Xhamisë së Shenjtë: kudo qofshi [besimtarë], kthejeni fytyrën tuaj kah ajo. Ata të cilëve u është dhënë Shkrimi i Shenjtë e dinë me siguri se kjo është E Vërteta nga Zoti i tyre: **Allahu** nuk është i painformuar për atë që e bëjnë.<sup>145</sup> E prapë edhe po t'ua sillnit çdo vërtetim atyre të cilëve u ishte dhënë Shkrimi i Shenjtë, ata nuk do ta ndiqnin drejtimin tuaj të lutjeve, as ju nuk do ta ndiqni të tyrin dhe në të vërtetë asnjëri nga ta nuk do ta ndiqte drejtimin e tjetrit. Nëse [ti Profet] do t'i ndiqje dëshirat e tyre, pas njohurisë që të është sjellur, do të ishe duke vepruar gabim.<sup>146</sup> Ata të cilëve Ne ua dhamë Shkrimin e Shenjtë e njohin atë po aq mirë sa ç'i njohin bijtë e tyre, por disa nga ta e fshehin të vërtetën që e dinë.<sup>147</sup> E vërteta është nga Zoti yt, pra mos ji nga ata që dyshojnë.<sup>148</sup> Secili komunitet e ka drejtimin e tij kah i cili kthehet: garoni për të bërë vepra të mira dhe kudoqofshi, **Allahu** do t'ju bëjë bashkë.<sup>b</sup> **Allahu** ka fuqi të bëjë gjithçka.

<sup>149</sup> [Profet,] kudoqoftë të kesh filluar, ktheje fytyrën tënde në drejtimin e Xhamisë së Shenjtë – kjo është e vërteta nga Zoti yt: Ai nuk është i painformuar për atë që e bën ti – <sup>2:150</sup> kudoqoftë të kesh filluar, ktheje fytyrën tënde në drejtimin e Xhamisë së Shenjtë; kudoqofshi cilido nga ju, ktheni fytyrat tuaja drejt saj, që njerëzit të mos mund të kenë argument kundër jush<sup>c</sup> – përveç keqbërësve ndër ta: mos ua keni frikën atyre; ma keni frikën Mua – kështu që Unë të mund ta përsosi mirësinë Time mbi ju dhe të mund të jeni të udhëzuar,<sup>151</sup> sikur që Ne<sup>d</sup> e kemi dërguar në mesin tuaj një Të Dërguar tuajin t'jua recitojë shpalljet Tona, t'ju pastrojë dhe t'jua mësojë Shkrimin e Shenjtë, urtinë dhe gjërat [e tjera] që nuk i keni ditur.<sup>152</sup> Pra kujtomëni Mua; Unë do t'ju kujtoj juve. Jini falënderues ndaj Meje dhe kurrë mosmirënjohës.

<sup>153</sup> Ju që besoni, kërkoni ndihmë përmes qëndrueshmërisë dhe lutjeve, se **Allahu** është me të qëndrueshmit.<sup>154</sup> Mos thuani se ata që janë vrrarë në çështjen e **Allahut** janë të vdekur; ata janë të gjallë, megjithëse ju nuk e kuptoni.<sup>155</sup> Ne sigurisht që do t'ju sprovojmë me frikë e uri dhe humbje të pronës, të jetëve e të korrave. Por [Profet,] jepju lajm të mirë atyre që janë të qëndrueshëm,<sup>156</sup> ata që, kur preken nga një fatkeqësi, thonë: '**Allahut** i përkasim dhe tek Ai do të kthehemi.'<sup>157</sup> Këtyre do t'u jepen bekime dhe mëshirë nga Zoti i tyre dhe këta janë ata që janë të udhëzuar drejt.

---

<sup>a</sup> Profeti në fshehtësi shpresonte të lejohej ta kthente fytyrën kah Xhamia në Mekë gjatë lutjeve, meqë ishte e dashur për të, duke qenë e ndërtuar nga Ibrahim i dhe Ismaili, siç shihet nga vargu 127 e tutje.

<sup>b</sup> Në Ditën e Gjykimit, krahaso me 5:48.

<sup>c</sup> Edhe çifutët edhe politeistët e kontestonin zgjedhjen e *kiblës* (drejtimit të lutjeve) për arsyet e tyre.

<sup>d</sup> Vërejeni zhvendosjen në përemër nga njëjës në shumës të madhësisë

<sup>158</sup> Safa dhe Marwa<sup>a</sup> janë ndër ritet e **Allahut**, pra për ata që bëjnë haxh të madh apo të vogël<sup>b</sup> te Shtëpia<sup>c</sup> nuk është fyerje të qarkullohet ndërmjet tyre<sup>d</sup>. Kushdo që bën mirë vullnetarisht do të shpërblehet, se **Allahu** i shpërblen veprat e mira dhe di gjithçka. <sup>159</sup> Sa për ata që i fshehin vërtetimet dhe udhëzimin që Ne e zbresim, pasi ua kemi bërë ato të qarta njerëzve në Shkrimin e Shenjtë, **Allahu** i refuzon dhe po kështu veprojnë edhe të tjerët, <sup>2:160</sup> pos nëse ata pendohen, bëjnë kompensime dhe e deklarojnë të vërtetën. Unë do ta pranoj sigurisht pendimin e tyre: Unë jam Gjithmonë-I-Buti, Më Mëshirëploti. <sup>161</sup> Sa për ata që nuk besojnë dhe vdesin si mosbesimtarë, **Allahu** i refuzon, siç bëjnë edhe engjëjt dhe të gjithë njerëzit. <sup>162</sup> Ata do të mbesin në këtë gjendje të refuzimit: ndëshkimi i tyre nuk do të lehtësohet, as s'do të anulohet.

<sup>163</sup> Dhe **Allahu** yt është **Allahu një**:

nuk ka zot pos Tij,

Dashamirësit,

Mëshirëplotit.

<sup>164</sup> Vëreje, në krijim

të qiejve e të tokës,

dhe në ndërrimin e natës dhe ditës,

dhe në anijet që lundrojnë në det

që të përfitojnë njerëzit,

dhe në ujin që **Allahu** e pikëlon nga qiejt,

duke e gjallëruar tokën kështu

pasi të ketë vdekur,

dhe në shpërndarjen e gjallesave të çdo lloji

pas kësaj nëpër të

dhe në ndryshimin e erërave

dhe të reve

që shkojnë nëpër drejtimet e caktuara

ndërmjet qiejve dhe tokës:

aty ka shenja

për ata që i përdorin mendjet.

---

<sup>a</sup> Dy kodra ngjitur me Qaben ndërmjet të cilave një haxhi (pelegrin) dhe një vizitor duhet të ecin përpjetë dhe teposhtë në përkujtim të asaj që e bëri Haxherja (Hagar) në kërkim të foshnjes së saj, Ismailit.

<sup>b</sup> Haxhi i vogël (*umra*) mund të bëhet gjatë sezonit të haxhit apo në çfarëdo kohe gjatë vitit.

<sup>c</sup> Qabja, që është qendrore edhe për drejtimin e lutjeve edhe për ritet e haxhit siç janë përcaktuar nga Ibrahimimi me urdhër të **Allahut**.

<sup>d</sup> Myslimanët nuk dëshironin ta kryejnë këtë rit, meqë politeistët i kishin instaluar dy idhuj në këto kodra. Këtu kjo rivendoset për **Allahun**.

<sup>165</sup> E prapë, ka disa që zgjedhin të adhurojnë të tjerë pos **Allahut** si rivalë ndaj Tij, duke i dashur ata me dashurinë që i përket **Allahut**, por besimtarët kanë dashuri më të madhe për **Allahun**. Ah sikur të mund ta shihnin idhujtarët – siç do ta shohin kur të përballen me torturën – se tërë fuqia i përket **Allahut** dhe se **Allahu** ndëshkon ashpër. <sup>166</sup> Kur ata që janë ndjekur nga të tjerët i mohojnë ndjekësit e tyre, kur të gjithë e shohin vuajtjen, kur tërë lidhjet ndërmjet tyre ndërpriten, <sup>167</sup> ndjekësit do të thonë: ‘Ah po ta kishim edhe një shans të fundit, do t’i mohonim siç po na mohojnë ata.’ Në këtë mënyrë, **Allahu** do t’i bëjë t’i shohin veprat e tyre si burim të pishmanit të hidhur: ata nuk do të largohen nga Zjarri.

<sup>168</sup> Njerëz, hajeni atë që është e mirë dhe e ligjshme nga toka dhe mos i ndiqni gjurmët e Satanit, se ai është armik i juaji i betuar. <sup>169</sup> Ai gjithmonë ju nxit ta bëni atë që është e keqe dhe e pahijshme, të thoni për **Allahun** gjëra që në të vërtetë nuk i dini.<sup>a</sup> <sup>2:170</sup> Por kur atyre u thuhet: ‘Ndiqeni mesazhin që e ka zbritur **Allahu**’, përgjigjen: ‘Ne i ndjekim rrugët e etërve tanë.’ Çka?! Edhe pse etërit e tyre nuk kuptonin asgjë dhe nuk ishin të udhëzuar? <sup>171</sup> T’i thërrasësh mosbesimtarët është si një bari që thërret gjëra që nuk dëgjojnë asgjë pos një britmë dhe një klithmë: ata janë të shurdhër, memecë dhe të verbër dhe nuk kuptojnë asgjë. <sup>172</sup> Ju që besoni, hajini gjërat e mira që Ne i kemi furnizuar për ju dhe i jini mirënjohës **Allahut**, nëse është Ai – Ai që e adhuron. <sup>173</sup> Ai jua ka ndaluar veç kafshën e ngordhur, gjakun, mishin e dërrit dhe kafshët mbi të cilat është thirrur çfarëdo emri tjetër pos i **Allahut**. Por nëse kushdo detyrohet të hajë gjëra të tilla nga uria, e jo nga dëshira a teprimi, nuk bën asnjë mëkat: **Allahu** është më mëshirëploti dhe më falësi.

<sup>174</sup> Sa për ata që e fshehin Shkrimin e Shenjtë që e zbriti **Allahu** dhe e shesin për një çmim të vogël, veç do ta mbushin barkun me Zjarr. **Allahu** nuk do t’u flasë në Ditën e Ringjalljes, as s’do t’i pastrojë: i pret një torturë plot dhimbje. <sup>175</sup> Këta janë ata që e shkëmbejnë udhëzimin me gabim dhe faljen me torturë. Çka mund t’i bëjë të durueshëm përballë Zjarrit? <sup>176</sup> Kjo sepse **Allahu** e ka dërguar Shkrimin e Shenjtë me Të Vërtetën; ata që i gjurmojnë dallimet në Shkrimin e Shenjtë janë të fiksuar fort në kundërshtim.

---

<sup>a</sup> Shih 6:138, 145

177

Nuk është mirësi  
të kthyerit e fytyrave  
kah Lindja e Perëndimi:  
por janë të mirë ata  
që e besojnë **Allahun**  
dhe Ditën e Fundit,  
dhe engjëjt dhe Librin,  
dhe profetët;  
dhe që u dhurojnë të mira e pará  
për dashurinë e **Allahut**  
të afërmve dhe jetimëve,  
dhe njerëzve në nevojë,  
dhe udhëtarëve dhe të varfërve,  
dhe për t'i çliruar robërit;  
ata që falen rregullisht  
dhe japin lëmoshë për mirëqenie,  
dhe i përmbushin premtimet e tyre  
kur i japin ato,  
dhe që janë të qëndrueshëm  
në vuajtje, në fatkeqësi dhe në kohë të rrezikut.  
Ata janë të vërtetët,  
dhe ata janë të vetëdijshmit për **Allahun**.

<sup>178</sup> Ju që besoni, ndëshkimi<sup>a</sup> i drejtë është urdhëruar për ju në raste të vrasjes: njeriu i lirë për njeriun e lirë, skllavi për skllavin, femra për femrën.<sup>b</sup> Por nëse fajtori falet nga vëllai i tij i dëmtuar, kjo do të respektohet me drejtësi dhe fajtori do ta paguajë atë që i takon në një mënyrë të mirë. Kjo është lehtësim nga Zoti juaj dhe vepër e mëshirës. Nëse kushdo pastaj i tejkalon këta kufij, e pret vuajtje e rëndë. <sup>179</sup> Ndëshkimi i drejtë e shpëton jetën për ju, njerëz që kuptoni, që të mund të ruheni nga ajo që është e gabuar.

Kur vdekja i afrohet dikujt nga ju që lë pasuri, <sup>2:180</sup> është urdhëruar që ai duhet të lërë trashëgimi të duhur për prindërit dhe të afërmit e ngushtë – obligim që u bie atyre që janë të vetëdijshëm për **Allahun**. <sup>181</sup> Nëse dikush e ndryshon testamentin pasi ta ketë dëgjuar, faji i ndryshimit do të bjerë mbi ta: **Allahu** është

---

<sup>a</sup> *qisas* etimologjikisht domethënë 'ta gjesh dikë duke e gjurmuar'

<sup>b</sup> Para Islamit, arabët nuk e respektonin barazinë në ndëshkim, por një fis më i fortë do të kërkonte më shumë, p.sh. një burrë për një grua, një njeri të lirë për një skllav, apo disa njerëz për një njeri dhe po kështu për kompesim financiar. Synimi i këtij vargu është të këmbëngulet në barazi.

gjithë-dëgjues dhe i gjithë-ditur.<sup>182</sup> Por nëse dikush e di se lënësi i testamentit e ka bërë një gabim, apo ka vepruar keq dhe kështu i rregullon gjërat me drejtësi ndërmjet palëve, ai nuk do të pësojë mëkat: **Allahu** është më falësi dhe mëshirëploti.

<sup>183</sup> Ju që besoni, agjërimi është urdhëruar për ju, siç ishte urdhëruar për ata para jush, që të mund të jeni të vetëdijshëm për **Allahun**.<sup>184</sup> Agjëroni për një numër të caktuar të ditëve, por nëse dikush nga ju është i sëmure, apo në udhëtim – në ditë të tjera më vonë. Për ata që mund të agjërojnë veç me vështirësi të jashtëzakonshme, ka mënyrë për kompensim: ushqejeni një person në nevojë. Por nëse dikush bën mirë vullnetarisht, është më mirë për të dhe agjërimi është më i mirë për ju, veç po ta dinit.<sup>185</sup> Ishte pikërisht muaji i Ramazanit në të cilin Kurani u shpall si udhëzim për njerëzimin, si mesazhe të qarta që japin udhëzim dhe që bëjnë dallim ndërmjet të drejtës dhe të gabuarës. Pra kushdo nga ju që është prezent në atë muaj do të duhej të agjërojë dhe kushdo që është i sëmure apo në udhëtim duhet t'i kompensojë ditët e humbura duke agjëruar në ditë të tjera më vonë. **Allahu** do lehtësi për ju, e jo vështirësi. Ai do që ju ta përfundoni periudhën e përcaktuar dhe ta madhëroni Atë që ju ka udhëzuar, që të mund të jeni falënderues.<sup>186</sup> [Profet,] nëse shërbyesit E Mi të pyesin për Mua, Unë jam afër. Unë i përgjigjem atyre që më thërrasin Mua, pra le të më përgjigjen Mua dhe le të besojnë në Mua, që të mund të jenë të udhëzuar.

<sup>187</sup> [Juve besimtarëve] ju lejohet të shtrihenit me gratë tuaja gjatë natës së agjërimit: ato janë [afër] si rrobat për ju, siç jeni ju për to. **Allahu** ishte i informuar se ju po e tradhtonit veten,<sup>a</sup> kështu që Ai u kthye kah ju në mëshirë dhe ju fali: tani mund të shtrihenit me to – kërkojeni atë që **Allahu** e ka caktuar për ju – hani dhe pini deri kur fija e bardhë e agimit bëhet e dallueshme nga e zeza. Pastaj agjëroni deri në muzg. Mos u shtrini me to gjatë netëve kur tërhiqeni për përkushtim të xhamitë: këta janë kufijtë e caktuar nga **Allahu**, pra mos shkoni afër tyre. Në këtë mënyrë **Allahu** i bën mesazhet E Tij të qarta për njerëzit, që të mund të mbrohen nga të bërit gabim.<sup>188</sup> Mos e konsumoni pronën tuaj padrejtësisht, as mos e përdorni për t'i korruptuar gjykatësit, duke synuar në mënyrë të mëkatshme dhe me vetëdije të konsumoni pjesë të pronës së njerëzve të tjerë.

<sup>189</sup> Të pyesin [Profet] për gjysmëhënat. Thuaj: 'Ato i tregojnë kohët e përcaktuara për njerëzit dhe për haxhillëkun.' Mirësia nuk qëndron në atë të hyni nëpër shtëpi nga [dera] prapa;<sup>b</sup> personi vërtet i mirë është ai që është i vetëdijshëm për **Allahun**. Pra hyni në shtëpitë tuaja kah dyert e tyre [kryesore]

---

<sup>a</sup> Disa myslimanë ia pranuan Profetit se e kishin prishur agjërimin e tyre duke pasë marrëdhënie seksuale gjatë netëve të Ramazanit.

<sup>b</sup> Ishte zakoni i disa arabëve gjatë kthimit nga haxhi të hyjnë në shtëpitë e tyre nga dera e prapme, duke e konsideruar këtë si veprim të nderimit të thellë.

dhe jini të vetëdijshëm për **Allahun** që të mund të përparoni. <sup>2:190</sup> Luftoni në çështjen e **Allahut** kundër atyre që ju luftojnë, por mos i tejkalo ni kufijtë:<sup>a</sup> **Allahu** nuk i do ata që i tejkalojnë kufijtë. <sup>191</sup> Vritni ata kudo që t'i hasni,<sup>b</sup> dhe dëbojini nga aty ku ju dëbuan, se përndjekja është më serioze se vrasja.<sup>c</sup> Mos i luftoni ata në Xhaminë e Shenjtë pos nëse ata ju luftojnë aty. Nëse ju luftojnë, vritni – kjo është ajo që e meritojnë mosbesimtarët e tillë – <sup>192</sup> por nëse ndalen, atëherë **Allahu** është më falësi dhe mëshirëploti. <sup>193</sup> Luftoni ata deri kur të mos ketë më përndjekje dhe adhurimi <sup>d e</sup> t'i përkushtohet **Allahut**. Nëse i ndalin armiqësitë, nuk mund të ketë armiqësi [të mëtejme], përveç ndaj agresorëve. <sup>194</sup> Një muaj i shenjtë për një muaj të shenjtë: shkelja e shenjtërisë [kërkon] ndëshkim të drejtë. Pra nëse kushdo bën agresion ndaj jush, sulmoheni siç ju ka sulmuar, por jini të vetëdijshëm për **Allahun** dhe dijeni se Ai është me ata që janë të vetëdijshëm për Të. <sup>195</sup> Shpenzoni në çështjen e **Allahut**: mos kontribuoni në shkatërrimin tuaj me duart tuaja,<sup>f</sup> po bëni mirë, se **Allahu** i do ata që bëjnë mirë.

<sup>196</sup> Përfundoni haxhet, të madhin e të voglin, për hir të **Allahut**. Nëse jeni të penguar [për ta bërë këtë], atëherë [dërgoni] çfarëdo oferte për flijim që mund ta bëni dhe mos i rruani kokat tuaja<sup>g</sup> deri kur oferta ta ketë arritur vendin e flijimit. Nëse dikush nga ju është i sëmurë, apo lëkurën e kokës e ka në gjendje të keqe, ai duhet ta kompenzojë përmes agjërimit, apo duke e ushqyer të varfrin, apo duke ofruar flijim. Kur të jeni në gjendje të sigurt, kushdo që dëshiron të bëjë ndërprerje<sup>h</sup> midis haxhit të vogël dhe të madh duhet ta bëjë ofertën që mund ta përballojë. Nëse i mungojnë mjetet, ai duhet të agjërojë tri ditë gjatë haxhit dhe shtatë ditë pasi të kthehet, duke i bërë dhjetë ditë gjithsej. Kjo vlen për ata që nuk e kanë familjen afër Xhamisë së Shenjtë. Gjithmonë jini të vetëdijshëm për **Allahun** dhe dijeni se Ai është i rreptë në ndëshkimin E Tij.

<sup>197</sup> Haxhi ndodh gjatë muajve të përcaktuar. Nuk duhet të ketë të folur të pahijshëm, sjellje të gabuar, apo grindje për askë që e ndërmerr haxhin – çfarëdo

---

<sup>a</sup> Komanda arabe *la ta`tadu* është kaq e përgjithshme sa që komentuesit janë pajtuar se e përfshin ndalimin e fillimit të armiqësive, luftimin kundër jo-luftëtarëve, reagimi joproporcional ndaj agresionit etj.

<sup>b</sup> Myslimanëve u interesonte se a ishte e lejuar të hakmerreshin kur sulmoheshin brenda ambienteve të shenjta në Mekë gjatë haxhit (shih 2:196 dhe *Tafsir*-in e Razit). Këtu u jepet leja të luftojnë kur sulmohen kudo që i hasin sulmuesit e tyre: në ambiente apo jashtë tyre.

<sup>c</sup> 'Ata t'ju përndjekin në mënyrë të paligjshme është më keq se sa ju t'i vrisni ata në ambiente në vetëmbrojtje.' Nyja *al-* në arabisht nganjëherë e merr vendin e një përemri, si këtu 'përndjekja e tyre' dhe 'ju t'i vrisni ata' (Tammam Hassan, al-Bayan, Cairo, 1993, 118–45); nuk është *al-* e përgjithshme, krahaso me 2:217. Shih edhe 2:217.

<sup>d</sup> Adhurimi në xhaminë e shenjtë.

<sup>e</sup> Krahaso me 8:39 dhe shënimin e dytë për 2:191 më lart.

<sup>f</sup> Nëse ata nuk janë të gatshëm ta paguajnë çmimin për t'u mbrojtur, atëherë do t'i sjellin shkatërrim vetes. Vargu po ashtu kuptohet përgjithësisht për ta ndaluar vetëvrasjen dhe format tjera të dëmtimit të vetes.

<sup>g</sup> Rruajtja e kokës apo prerja e flokëve është njëri nga ritet e bëra nga haxhinjtë meshkuj pasi të jenë kryer shumica e riteve të tjera.

<sup>h</sup> Kjo e nënkupton thyerjen e kufizimeve të *ihram*-it (shenjtërimit) e quajtur *tamattu`*.

të mire që e bëni, **Allahu** është fare mirë i informuar për të. Furnizohuni mirë për veten: furnizimi më i mirë është të jeni të vetëdijshëm për **Allahun** – gjithmonë jini të vetëdijshëm për Mua, ju që mund të kuptoni – <sup>198</sup> por nuk është ofendim të kërkonit ca bujari nga Zoti juaj<sup>a</sup>. Kur shpejtoni teposhtë nga Arafati kujtojeni **Allahun** te vendi i shenjtë.<sup>b</sup> Kujtojeni Atë: Ai ju ka udhëzuar. Para kësaj ishit të devijuar. <sup>199</sup> Shpejtoni teposhtë ku shkojnë njerëzit e tjerë<sup>c</sup> dhe kërkonit falje nga **Allahu**: Ai është më falësi dhe mëshirëploti. <sup>2:200</sup> Kur t'i keni kryer ritet tuaja, kujtojeni **Allahun** po aq sa i kujtoni etërit tuaj, apo edhe më shumë. Janë disa që luten: 'Zoti ynë, na jep të mira në këtë botë' dhe ata nuk do të kenë fare hise në Të Përtejmen; <sup>201</sup> të tjerë luten: 'Zoti ynë, na jep të mira në këtë botë dhe në Të Përtejmen dhe na mbroj nga tortura e Zjarrit.'<sup>202</sup> Ata do ta kenë hisen për të cilën kanë punuar: **Allahu** është i shpejtë në llogaritje.

<sup>203</sup> Kujtojeni **Allahun** në ditët e caktuara.<sup>d</sup> Nëse dikush është për ngut për t'u larguar pas dy ditësh, nuk i vihet faj, as nuk i vihet faj kujtdo që rri, përderisa janë të vetëdijshëm për **Allahun**. Jini të vetëdijshëm për **Allahun** dhe kujtojeni se do të jeni të tubuar tek Ai. <sup>204</sup> Është [një lloj i] njeriu[t] pikëpamjet e të cilit për jetën në këtë botë mund të të kënaqin [Profet,] ai madje e thërret **Allahun** për ta dëshmuar atë që e ka në zemrën e tij, e prapë është më i hidhuri nga kundërshtarët. <sup>205</sup> Kur largohet, niset të shpërndajë korrupsion në vend, duke i shkatërruar të korrat dhe bagëtitë – **Allahu** nuk e do korrupsionin. <sup>206</sup> Kur i thuhet: 'Ruaju nga **Allahu**', arroganca e tij e çon në mëkat. Ferri është i mjaftueshëm për të: vend i tmerrshëm i qëndrimit. <sup>207</sup> Por është po ashtu edhe një lloj i njeriut që e jep jetën e tij për ta kënaqur **Allahun** dhe **Allahu** është më i dhembshuri ndaj shërbyesve Të Tij. <sup>208</sup> Ju që besoni, hyni me gjithë zemër në nënshtrim ndaj **Allahut**<sup>e</sup> dhe mos i ndiqni gjurmët e Satanit, se ai është armiku juaj i betuar. <sup>209</sup> Nëse tërhiqeni pasi t'ju ketë ardhur vërtetim i qartë, atëherë ta dini se **Allahu** është i plotfuqishëm dhe i urtë.

<sup>2:210</sup> A po e presin këta njerëz **Allahun** t'u vijë në hijet e reve, bashkë me engjëjt? Por çështja do të ishte vendosur deri atëherë:<sup>f</sup> të gjitha çështjet kthehen te **Allahu**. <sup>211</sup> [Profet,] pyeti Fëmijët e Izraelit se sa shenja të qarta ua kemi sjellur. Nëse dikush i ndryshon bekimet e **Allahut** pasi t'i ketë pranuar, **Allahu** është i ashpër në ndëshkim. <sup>212</sup> Jeta e kësaj bote është bërë t'u duket magjepsëse mosbesimtarëve dhe ata qeshin me besimtarët. Por ata që janë të vetëdijshëm për **Allahun** do të jenë mbi ta në Ditën e Ringjalljes: **Allahu** furnizon pamasë për këdo që dëshiron. <sup>213</sup> Njerëzimi ishte komunitet i vetëm, pastaj **Allahu** dërgoi

---

<sup>a</sup> Është e ligjshme të bëni tregti gjatë haxhit.

<sup>b</sup> Ky është një nga vendet e haxhit ndërmjet Arafatit dhe Mina-s – një rrafsh i quajtur Muzdalifa.

<sup>c</sup> Disa fise arrogante i binin një rruge tjetër ndryshe nga masat.

<sup>d</sup> Këto vijnë pas ditës së flijimit, kur dy-tri ditë janë kaluar në Mina për ta kryer ritin e gurëzimit të Djallit.

<sup>e</sup> *Silm*, që po ashtu domethënë 'paqe'.

<sup>f</sup> Do të jetë tepër vonë për ta të pendohen.



profetë për të sjellë lajme të mira dhe paralajmërim dhe me ta e dërgoi Shkrimin e Shenjtë me Të Vërtetën, për të gjykuar ndërmjet njerëzve në mosmarrëveshjet e tyre. Veç ata të cilëve u ishte dhënë ai ishin të tillë që nuk pajtoheshin në lidhje me të pasi u kishin ardhur shenja të qarta, për shkak të rivalitetit mes vete. Prandaj me lejen E Tij **Allahu** i udhëzoi besimtarët kah e vërteta për të cilën dallonin: **Allahu** e udhëzon këdo që do ta udhëzojë në rrugë të drejtë.

<sup>214</sup> A supozoni se do të hyni në Kopsht pa pasë vuajtur fillimisht si ata para jush? Ata u prekën nga fatkeqësia dhe vështirësia dhe u tronditën kaq shumë sa që madje edhe i dërguari [i tyre] dhe besimtarët me të thërrisnin: ‘Kur do të arrijë ndihma e **Allahut**?’ Vërtet, ndihma e **Allahut** është afër. <sup>215</sup> Të pyesin [Profet] se çka duhet të japin. Thuaj: ‘Çkado që jepni duhet të jetë për prindërit, të afërmit e ngushtë, jetimët, njerëzit në nevojë dhe udhëtarët. **Allahu** është i informuar mirë për çfarëdo të mire që e bëni.

<sup>216</sup> Luftimi është caktuar për ju, megjithëse nuk ju pëlqen. Mund të mos ju pëlqejë diçka edhe pse është e mirë për ju, apo t’ju pëlqejë diçka edhe pse është e keqe për ju: **Allahu** di dhe ju nuk dini.’ <sup>217</sup> Të pyesin [Profet] për luftimin në muajin e ndaluar. Thuaj: ‘Të luftosh në atë muaj është ofendim i madh, por t’i pengosh të tjerët nga rruga e **Allahut**, që të kenë mosbesim në Të, ta pengosh qasjen te Xhamia e Shenjtë dhe t’i dëbosh njerëzit e saj, janë ofendime edhe më të mëdha në sytë e **Allahut**: përndjekja është më e keqe se sa vrasja.’<sup>a</sup> Ata nuk do të ndalen duke ju luftuar [besimtarë] deri kur t’ju bëjnë ta anuloni besimin tuaj, nëse munden. Nëse cilëndo nga ju e anuloni besimin tuaj dhe vdisni si mosbesimtarë, veprat tuaja do të bëhen asgjë në këtë botë dhe në Të Përtejmen dhe do të jeni banorë të Zjarrit, për të mbetur aty. <sup>218</sup> Por ata që kanë besuar, kanë mërguar dhe janë përpjekur për çështjen e **Allahut**, janë pikërisht ata që mund ta presin mëshirën e **Allahut**: **Allahu** është më falësi dhe mëshirëploti.

<sup>219</sup> Të pyesin [Profet] për materiet dehëse dhe kumarin – thuaj: ‘Ka mëkat të madh në të dyja dhe ca përfitim për njerëzit: mëkati është më i madh se përfitimi.’ Të pyesin se çka duhet të japin – thuaj: ‘Jepeni atë që ju tepron nga nevojat.’ Në këtë mënyrë, **Allahu** i bën mesazhet E Tij të qarta për ju, që të mund të reflektoni <sup>2:220</sup> për këtë botë dhe tjetrën. Të pyesin për jetimët [pronën e tyre] – thuaj: ‘Është mirë t’i bëni gjërat drejt për ta. Nëse i kombinoni punët e tyre me tuajat, kujtojeni se ata janë vëllezërit dhe motrat tuaja: **Allahu** i njeh ata që i prishin gjërat dhe ata që i përmirësojnë ato. Po të kishte dashur, Ai do të mund t’ju bënte të cënueshëm edhe juve: Ai është i plotfuqishëm dhe i urtë.’

<sup>221</sup> Mos u martoni me idhujtare deri kur të besojnë: një grua skllave besimtare është gjithsesi më e mirë se një idhujtare, edhe pse mund t’ju kënaqë. Dhe mos i jepni gratë tuaja në martesë me idhujtarë deri kur të besojnë: një skllav besimtar

---

<sup>a</sup> T’i përndjekësh njerëzit sepse e besojnë **Allahun** është ofendim më i keq se sa për palën e dëmtuar të kundërluftojë në muajin e ndaluar. Kjo e shpjegon tutje vargun 191.

është gjithsesi më i mirë se një idhujtar, edhe pse mund t'ju kënaqë. Njerëzit e tillë [ju] thërrasin në Zjarr, gjersa **Allahu** [ju] thërret në Kopsht dhe falje me lejen E Tij. Ai i bën mesazhet E Tij të qarta për njerëzit, që të mund t'i mbajnë mend ato.

<sup>222</sup> Të pyesin [Profet] për menstruacionin. Thuaj: 'Menstruacioni është gjendje e dhembshme, pra rrini larg nga gratë gjatë tij. Mos iu afroni atyre deri kur të jenë pastruar; kur të jenë pastruar, mund t'u afroheni siç e ka caktuar **Allahu**.<sup>a</sup> **Allahu** i do ata që kthehen kah Ai dhe i do ata që mbahen të pastër. <sup>223</sup> Gratë tuaja janë fushat tuaja, pra shkoni në fushat tuaja në cilëndo mënyrë që ju pëlqen,<sup>b</sup> dhe dërgoni [diçka të mirë] përpara për veten. Jini të vetëdijshëm për **Allahun**: kujtojeni se do ta takoni Atë.' [Profet,] jepju lajm të mirë besimtarëve.

<sup>224</sup> [Besimtarë,] mos lejoni që betimet tuaja në emër të **Allahut** t'ju pengojnë nga të bërit mirë, nga të qenët të vetëdijshëm për **Allahun** dhe nga të bërit paqe ndërmjet njerëzve. **Allahu** dëgjon dhe di gjithçka: <sup>225</sup> Ai nuk do t'ju kërkojë llogari për betimet që i keni shqiptuar pa qëllim, por do t'ju kërkojë llogari për atë që e synoni në zemrat tuaja. **Allahu** është më falësi dhe më i durueshmi. <sup>226</sup> Për ata që betohen se nuk do t'u afrohen grave të tyre, do të ketë periudhë të pritjes prej katër muajsh:<sup>c</sup> nëse kthehen, kujtojeni se **Allahu** do të jetë më falësi dhe mëshirëploti,<sup>227</sup> por nëse janë të vendosur të ndahen, kujtojeni se **Allahu** i dëgjon dhe i di të gjitha. <sup>228</sup> Gratë e ndara duhet të presin tri periudha mujore para se të rimartohen, dhe, nëse vërtet besojnë në **Allahun** dhe në Ditën e Fundit, nuk është e ligjshme që ta fshehin atë që e ka krijuar **Allahu** në barkun e tyre: burrat e tyre do të bënin më mirë t'i kthenin ato gjatë kësaj periudhe, me kusht që ata të dëshirojnë t'i rregullojnë gjërat. Gratë kanë [të drejta] të ngjashme me [obligimet] e tyre, sipas asaj që njihet se është e drejtë dhe burrat e kanë një shkallë [të të drejtës] ndaj tyre: [të dytë duhet ta kujtojnë se] **Allahu** është i plotfuqishëm dhe i urtë.

<sup>229</sup> Divorci mund të ndodhë dy herë dhe [secilën herë] gratë ose mbahen në mënyrë të pranueshme ose lëshohen në mënyrë të mirë. Nuk është e ligjshme për ju të ktheni çkado që u keni dhënë [grave tuaja], përveç aty ku të dytë kanë frikë se nuk mund ta mbajnë [martesën] brenda kufijve të vendosur nga **Allahu**: nëse ju [arbitra] dyshoni se çifti mund të mos jetë në gjendje ta bëjë këtë, atëherë nuk bie faj në asnjërin prej tyre nëse gruaja përcaktohet të japë diçka për lirimin e saj.<sup>d</sup> Këta janë kufijtë e vendosur nga **Allahu**: mos i tejkaloni. Janë ata që i tejkalojnë kufijtë e **Allahut** që po gabojnë. <sup>2:230</sup> Nëse një burrë e ri-divorcon gruan

---

<sup>a</sup> Shprehjet arabe të përdorura këtu janë eufemizma të qarta për 'mos bëni marrëdhënie seksuale me to'.

<sup>b</sup> Kur myslimanët emigruan në Medinë, dëgjuan nga çifutët se një fëmijë i lindur nga një grua e qasur nga prapa do të ketë sy të vëngër.

<sup>c</sup> Para Islamit, burrat do të mund ta bënin një betim të tillë dhe ta pezullojnë gruan për kohë të pacaktuar. Në Islam, nëse nuk kthehen pas katër muajsh, divorci bëhet efektiv.

<sup>d</sup> Duke e paguar tërë dhuratën e nuses apo një pjesë të saj në këmbim të divorcit.

e tij pas divorcit të dytë, ajo nuk do të jetë e ligjshme për të deri kur ta ketë marrë një burrë tjetër; nëse ai e divorcon atë, nuk do të ketë faj nëse ajo dhe burri i parë i kthehen njëri-tjetrit, me kusht që ata ndihen se mund të qëndrojnë brenda kufijve të vendosur nga **Allahu**. Këta janë kufijtë e **Allahut**, të cilët Ai i bën të qartë për ata që dinë.

<sup>231</sup> Kur i divorconi gratë dhe ato e kanë arritur kohën e tyre të caktuar, atëherë ose mbajini ose lëshojini në mënyrë të drejtë. Mos iu qepni me synimin t'i dëmtoni dhe të bëni agresion: kushdo që e bën këtë i bën dëm vetes. Mos u tallni me shpalljet e **Allahut**; kujtojeni mirësinë me të cilën ju bekoj dhe Shkrimin e Shenjtë dhe urtinë që e dërgoi t'ju mësojë. Jini të vetëdijshëm për **Allahun** dhe dijeni se ka njohuri të plotë për gjithçka. <sup>232</sup> Kur i divorconi gratë dhe e kanë arritur kohën e tyre të caktuar, mos i pengoni të rimartohen me burrat e tyre nëse të dy pajtohen ta bëjnë këtë në mënyrë të drejtë.<sup>a</sup> Le ta marrin për zemër këtë ata nga ju që besojnë në **Allahun** dhe në Ditën e Fundit: kjo është më e dobishme dhe më e pastër për ju. **Allahu** di dhe ju nuk dini.

<sup>233</sup> Nënata u japin gji fëmijëve të tyre për dy vite të plota, nëse duan ta kryejnë periudhën, dhe veshjet e mirëmbajtja duhet të përballohen nga babai në mënyrë të drejtë. Askush nuk duhet të rëndohet me më shumë se që mund të mbajë: asnjë nënë nuk do dëmtohet në llogari të fëmijës së saj, dhe asnjë baba në llogari të fëmijës së tij. I njëjti obligim bie mbi trashëgimtarët e babait.<sup>b</sup> Nëse, me pëlqim të ndërsjellë dhe konsultim, çifti dëshirojnë t'ia ndalin gjirin [fëmijës], ata nuk do të fajësohen, as s'do të ketë ndonjë faj nëse dëshironi ta angazhoni një gjidhënëse, me kusht që të paguani siç jeni marrë vesh në mënyrë të drejtë. Jini të vetëdijshëm për **Allahun**, duke e ditur se Ai sheh gjithçka që bëni.

<sup>234</sup> Nëse dikush nga ju vdes dhe lë të veja, të vejat duhet të presin katër muaj e dhjetë net para se të rimartohen. Kur ta kenë kryer këtë kohë të caktuar, ju nuk do të fajësoheni për çfarëdo gjëje të arsyeshme që ato mund të zgjedhin të bëjnë me veten. **Allahu** është plotësisht i informuar për atë që e bëni. <sup>235</sup> Nuk do të fajësoheni qoftë nëse aludoni se doni të martoheni me ato gra, apo e mbani për vete – **Allahu** e di se synoni t'u propozoni<sup>c</sup>. Mos bëni marrëveshje të fshehtë me to; flisjuni atyre me nder dhe mos e konfirmoni lidhjen martesore deri kur të përfundojë periudha e përcaktuar. Kujtojeni se **Allahu** e di atë që është në shpirtit tuaj, pra jini të vetëdijshëm për Të. Kujtojeni se **Allahu** është më falësi dhe më i duruari.

<sup>236</sup> Nuk do të fajësoheni nëse i divorconi gratë kur ende nuk e keni konsumuar martesën apo nuk keni caktuar dhuratë të nuses për to, por bëni

---

<sup>a</sup> Nganjëherë babai apo vëllau i gruas do të ndërhynte për ta ndalur atë të pajtohej me burrin e saj. Këtu Kurani e dënon ndërhyrjen e tillë.

<sup>b</sup> Nëse ai vdes.

<sup>c</sup> *Dhakara* në arabishten klasike e kishte kuptimin 'të propozosh'.

furnizim të drejtë për to, i pasuri sipas mjeteve të tij dhe i varfi sipas të vetave – kjo është detyrë për ata që bëjnë mirë.<sup>237</sup> Nëse i divorconi gratë para konsumimit të martesës por pasi ta keni caktuar dhuratën e nuses për to, atëherë jepjuani gjysmën e asaj që e keni caktuar paraprakisht, pos nëse ato heqin dorë [nga e drejta e tyre], apo nëse ai që e mban lidhjen e martesës heq dorë [nga e drejta e tij]. Heqja dorë [nga e drejta juaj] është më së afërmi hyjnores, pra mos harroni të jeni zemërgjerë ndaj njëri-tjetrit: **Allahu** e sheh atë që e bëni.<sup>238</sup> Kujdesuni t'i bëni lutjet tuaja,<sup>a</sup> duke u lutur në mënyrën më të mirë,<sup>b</sup> dhe qëndroni para **Allahut** në përkushtim.<sup>239</sup> Nëse jeni në rrezik, lutuni kur jeni duke ecur apo duke vozitur/kalëruar; kur jeni të sigurt përsëri, kujtojeni **Allahun**, se Ai jua ka mësuar atë që nuk e keni ditur.

<sup>2:240</sup> Nëse ndonjë nga ju vdes dhe lë vejusha, lini trashëgimi për to: një vit mjete për të jetuar dhe pa dëbim nga shtëpitë e tyre [për atë kohë]. Por nëse shkojnë vetë, nuk do të fajësoheni për atë që mund të zgjedhin të bëjnë në mënyrë të arsyeshme me veten: **Allahu** është i gjithëfuqishëm dhe i urtë.<sup>241</sup> Gratë e divorcuara do të kenë po ashtu mjete të tilla për të jetuar siç konsiderohet e drejtë: kjo është detyrë për ata që janë të vetëdijshëm për **Allahun**.<sup>242</sup> Në këtë mënyrë **Allahu** jua bën të qarta shpalljet E Tij, që të mund të zhvilloheni në të kuptuar.

<sup>243</sup> [Profet,] mendo për ata njerëz që e braktisën atdheun e tyre nga frika e vdekjes,<sup>c</sup> edhe pse ishin me mijëra. **Allahu** u tha: 'Vdisni!' dhe pastaj i ktheu në jetë përsëri; **Allahu** tregon mirësi të vërtetë për njerëzit, por shumica nga ta janë mosmirënjohës.<sup>244</sup> Luftoni<sup>d</sup> për çështjen e **Allahut** dhe kujtojeni se Ai është gjithë-dëgjues dhe i gjithë-ditur.<sup>245</sup> Kush do t'i japë **Allahut** hua të mirë, të cilën Ai do t'ia rrisë shumë herë? Është **Allahu** Ai që refuzon të japë dhe është **Allahu** Ai që jep me bollëk dhe është pikërisht Ai tek I Cili do të ktheheni.

<sup>246</sup> [Profet,] mendo për udhëheqësit e Fëmijëve të Izraelit që erdhën pas Musait, kur i thanë njërit prej profetëve të tyre: 'Na e cakto një mbret dhe ne do të luftojmë për çështjen e **Allahut**.' Ai tha: 'Por a mund të ndodhë që nuk do të luftonit, po t'ju urdhërohej?' Ata thanë: 'Si nuk do të luftonim për çështjen e **Allahut** kur ne dhe fëmijët tanë jemi dëbuar nga atdheu ynë?' E prapë kur u urdhëruan të luftojnë, të gjithë pos disa nga ta u larguan: **Allahu** ka njohuri të plotë për ata që bëjnë gabim.<sup>247</sup> Profeti i tyre u tha: '**Allahu** tash e ka caktuar Talutin<sup>e</sup> të jetë mbreti juaj', por ata thanë: 'Si mund të jetë ai mbret mbi ne kur

---

<sup>a</sup> Për të siguruar se palët në një situatë kaq të hidhur do t'i përmbahen mësimëve të Kuranit ato udhëzohen të luten dhe të qëndrojnë para **Allahut**.

<sup>b</sup> Një interpretim tjetër është 'duke e përfshirë lutjen e mesme', me opinione të ndryshme për atë se për cilën lutje është fjala.

<sup>c</sup> Shih vargun 246 më poshtë.

<sup>d</sup> Pas trajtimit të çështjeve martesore, Kurani i kthehet çështjes së kundërsulmit ushtarak.

<sup>e</sup> Emri arab për Saul.

ne kemi më shumë të drejtë për të sunduar se ai? Ai madje nuk ka as pasuri të madhe.’ Ai tha: ‘**Allahu** e ka zgjedhur atë mbi ju dhe i ka dhënë njohuri të madhe dhe shtat të madh. **Allahu** ia jep autoritetin E Tij kujt të dojë: **Allahu** është madhështor, i gjithëdijsëm.’<sup>248</sup> Profeti i tyre u tha: ‘Shenja e autoritetit të tij do të jetë se Arka [e Besëlidhjes] do të vijë te ju. Në të do të jetë [dhurata me] qetësi nga Zoti juaj dhe reliket e ndjekësve të Musait dhe të Harunit, të bartura nga engjëjt. Ka shenjë në këtë për ju nëse besoni.’

<sup>249</sup> Kur Taluti u nis me forcat e tij, u tha atyre: ‘**Allahu** do t’ju sprovtojë me një lumë. Kushdo që pi prej tij nuk do ta ketë vendin me mua, por kushdo që përmbahet ta shijojë atë, do të jetë me mua; nëse ai e mbledh veç një grusht [do të shfajësohet].’ Por të gjithë ata pinë [shumë] nga ai, përveç disave. Kur ai e kaloi atë me ata që e patën mbajtur besimin, ata<sup>a</sup> thanë: ‘Nuk kemi fuqi sot kundër Xhalutit (Goliatit) dhe luftëtarëve të tij.’ Por ata që e dinin se do ta takonin Zotin e tyre thanë: ‘Sa shpesh një forcë e vogël e ka mposhtur një ushtri të madhe me lejen e **Allahut**! **Allahu** është me ata që janë të qëndrueshëm.’<sup>2:250</sup> Dhe kur e takuan Xhalutin dhe luftëtarët e tij, thanë: ‘Zoti ynë, lësho durim mbi ne, na bëj të qëndrojmë fort dhe na ndihmo kundër mosbesimtarëve’,<sup>251</sup> dhe kështu me lejen e **Allahut** ata i mundën. Dauti (Davidi) e vrau Xhalutin (Goliatin) dhe **Allahu** i dha sovranitet e urti dhe ia mësoi atë që i pëlqeu Atij. Po të mos i largonte **Allahu** disa përmes të tjerëve toka do të ishte plotësisht e korruptuar, por **Allahu** është bujar me të gjithë.

<sup>252</sup> Këto janë shpalljet e **Allahut** që Ne t’i recitojmë [Muhamed] me të vërtetën dhe ti je vërtet një nga të dërguarit.<sup>253</sup> Ne i favorizuem disa nga këta të dërguar mbi të tjerët. **Allahu** u foli disave nga ta; të tjerë i ngriti në rang; Ne ia dhamë Isait, të birit të Merjemes, shenjat Tona të qarta dhe e forcuam me shpirtin e shenjtë. Po të kishte dashur **Allahu**, ata që erdhën pas tyre nuk do të kishin luftuar me njëri-tjetrin pasi u ishin sjellë shenja të qarta. Por ata nuk u pajtuan: disa besuan dhe disa nuk besuan. Po të kishte dashur **Allahu**, nuk do ta luftonin njëri-tjetrin, por **Allahu** e bën atë që do ta bëjë.

<sup>254</sup> Besimtarë besnikë,  
jepni nga ajo që Ne e kemi furnizuar për ju,  
para se të vijë një Ditë  
në të cilën nuk ka shkëmbim  
dhe as miqësi  
dhe as ndërmjetësim.  
Dhe janë mosbesimtarët  
ata që janë gabim.

---

<sup>a</sup> Ata që e kishin pirë ujin apo disa nga të paktët që shkuan me Talutin.

255

**Allahu!**

Nuk ka zot pos Tij,  
Gjithmonë-Jetuesi, Gjithmonë-Vigjilenti<sup>a</sup>:  
dremitja nuk e kap Atë,  
as gjumi.  
Atij i përket  
ajo që është në qiej dhe në tokë:  
kush mund të jetë  
që mund të ndërmjetësojë me Të  
pos me leje Të Tij?  
Ai e di atë që është para tyre,  
dhe atë prapa tyre;  
por ata nuk kuptojnë  
asnjë gjë nga dija E Tij  
pos çka vendos Ai.  
Froni I Tij  
shtrihet përgjatë qiellit dhe tokës,  
dhe mirëmbajtja e që të dyve  
nuk është rënduese për Të,  
se Ai është Më I Larti, Madhështori.

256

Nuk ka detyrim në fe.  
Udhëzimi i vërtetë është bërë i dallueshëm nga gabimi:  
pra kushdo që i refuzon zotat e rremë  
dhe beson në **Allahun**  
e ka kapur  
mbajtësen më të sigurt,  
që nuk thyhet kurrë.  
Se **Allahu** është gjithë-dëgjues dhe i gjithëditur.

<sup>257</sup> **Allahu** është aleati i atyre që besojnë: Ai i nxjerr nga thellësitë e errësirës dhe i sjell në dritë. Sa për mosbesimtarët, aleatët e tyre janë zota të rremë që i marrin ata nga drita në thellësitë e errësirës, ata janë banorë të Zjarrit dhe aty do të mbesin.

---

<sup>a</sup> Krahaso me 13:33

<sup>258</sup> [Profet,] a nuk ke menduar për njeriun që u grind me Ibrahimin për Zotin e tij, se **Allahu** i pat dhënë pushtet për të sunduar? Kur Ibrahim i tha: ‘Është Zoti im që jep jetë dhe vdekje’, ai tha: ‘Edhe unë jap jetë dhe vdekje.’ Kështu Ibrahim i tha: ‘**Allahu** e sjell diellin nga lindja; pra ti sille nga perëndimi.’ Mosbesimtari u shtang pa fjalë: **Allahu** nuk i udhëzon ata që bëjnë keq.

<sup>259</sup> Apo shihe për shembull atë që kaloi nëpër një qytezë të rrënuar. Tha: ‘Si do t’i japë **Allahu** jetë kësaj kur ka vdekur?’ Kështu **Allahu** e bëri atë të vdesë për njëqind vjet dhe pastaj e ringjalli, duke thënë: ‘Sa kohë ke qëndruar ashtu?’ Ai u përgjigj: ‘Një ditë, apo një pjesë të ditës.’ **Allahu** tha: ‘Jo, ke qëndruar ashtu për njëqind vjet. Shikoje ushqimin dhe pijen tënde: nuk janë prishur. Shikoje gomarin tënd – Ne do të të bëjmë ty shenjë për njerëzit – shikoji eshtrat: shih si i bashkojmë dhe i veshim me mish!’ Kur gjithçka iu bë e qartë, tha: ‘Tash e di se **Allahu** ka pushtet mbi gjithçka.’

<sup>2:260</sup> Dhe kur Ibrahim i tha: ‘Zoti im, më trego se si u jep jetë të vdekurve’, Ai tha: ‘Pra a s’po beson?’ ‘Po’, tha Ibrahim, ‘por veç për ta qetësuar zemrën time.’ Kështu **Allahu** tha: ‘Merri katër zogj dhe stërviti të kthehen te ti. Pastaj vendosi në maje të kodrave të ndara,<sup>a</sup> thirri të kthehen dhe do të vijnë duke fluturuar te ti: dije se **Allahu** është i gjithëfuqishëm dhe i urtë.’

<sup>261</sup> Ata që e shpenzojnë pasurinë e tyre për çështjen e **Allahut** janë si kokrra të misrit që i prodhojnë shtatë kallinj, ku secili i mban njëqind kokrra. **Allahu** i jep rritje të shumëfishtë kujtdo që dëshiron: Ai është i pakufi dhe i gjithëdijsëm.

<sup>262</sup> Ata që e shpenzojnë pasurinë e tyre  
në rrugën e **Allahut**  
dhe pastaj nuk e pasojnë atë që e shpenzojnë  
me kujtues të bujarisë së tyre  
a me fjalë lënduese,  
e kanë shpërblimin e tyre  
me Zotin e tyre.  
S’ka frikë për ta  
dhe nuk do të pikëllohen.

---

<sup>a</sup> Shumica e komentuesve klasikë e kanë qëndrimin që Ibrahim i do t’i duhej t’i priste zogjtë së pari nëse ata vërtet do të ngriheshin nga të vdekurit, duke e përkthyer këtë frazë: ‘pastaj vendosi ndaras në maje të kodrave’. Mirëpo, Ebu Muslimi mendonte se pjesa e rëndësishme e imazhit ishte se është po aq lehtë për shpirtrat të kthehen në trup sa ç’ishte për zogjtë të kthehen tek Ibrahim (Razi). Krahaso me: ‘Tek Ai do të ktheheni’, në shumë vende, p.sh. 2:245 dhe 285.

- 263 Një fjalë e këndshme dhe falja  
është më e mirë se një vepër bamirëse  
e pasuar me fjalë lënduese:  
Dhe **Allahu**,  
duke qenë i vetë-mjaftueshëm,  
është falës i duruar  
në mënyrën më supreme.
- 264 Ju që besoni,  
mos i bëni të pavlera veprat tuaja bamirëse  
me kujtues të bujarisë suaj,  
a me fjalë lënduese,  
siç bëjnë ata që e shpenzojnë pasurinë e tyre  
veç për t'u parë nga njerëzit,  
pa besuar në **Allahun**  
dhe në Ditën e Fundit.  
Personat e tillë janë  
si një shkëmb me dhé përmbi  
në të cilin bie shi i madh  
dhe e lë bosh:  
s'mund të bëjnë asgjë  
me atë që e kanë fituar.  
Dhe **Allahu** nuk i udhëzon  
mosbesimtarët.
- 265 Dhe shembulli i atyre  
që e shpenzojnë pasurinë e tyre  
për ta fituar miratimin e **Allahut**  
dhe si pohim të besimit të tyre  
është si ai  
i një kopshti në kodrinë  
mbi të cilin bie shi i madh  
dhe e prodhon dyfishin e frutave të tij;  
apo nëse nuk bie shi i madh,  
ujitet me vesë.  
Dhe **Allahu** sheh çkado që bëni.



<sup>266</sup> A do të donit dikush nga ju ta keni një kopsht me palma e me hardhi, të hijeshuar me lumenj rrjedhës dhe me të gjitha llojet e prodhimeve, i cili, kur të jeni prekur nga pleqëria dhe me pasardhës të dobët, goditet nga një stuhi e zjarhtë dhe digjet? Në këtë mënyrë **Allahu** jua bën të qarta mesazhet E Tij, që të mund të reflektoni për to.

<sup>267</sup> Ju që besoni, jepni bamirësisht nga gjërat e mira që i keni fituar dhe që Ne i kemi prodhuar për ju nga toka. Mos i jepni falas gjërat e këqija që ju vetë do t'i pranoni veç me sytë mbyllur: kujtojeni se **Allahu** është i vetë-mjaftueshëm, i denjë për tërë lândin. <sup>268</sup> Satani ju kërcënon me gjasën që mund të varfëroheni dhe ju porosit të bëni vepra të gabuara; **Allahu** jua premtan faljen E Tij dhe begatinë E Tij: **Allahu** është i pakufi dhe i gjithë-dijshëm, <sup>269</sup> dhe i jep urti kujtdo që do t'i japë. Kushdo të cilit i është dhënë urti i janë dhënë vërtet shumë të mira, por veç ata me njohuri intuitive e mbajnë mend këtë. <sup>2:270</sup> Çkado që mund të jepni, apo betoheni ta jepni, **Allahu** e di mirë dhe ata që bëjnë gabim nuk do ta kenë askë t'u ndihmojë. <sup>271</sup> Nëse jepni bamirësi haptas, është mirë, por nëse e mbani të fshehtë dhe ia jepni privatisht njeriut në nevojë, kjo është më e mirë për ju dhe do t'i shlyejë disa nga veprat tuaja të këqija: **Allahu** është fare mirë i informuar për gjithçka që bëni. <sup>272</sup> Nuk është e jotja [Profet] t'i udhëzosh ata; është **Allahu** Ai që e udhëzon këto që do ta udhëzojë. Çfarëdo bamirësie që e jepni është përfitim për shpirtin tuaj, me kusht që ta bëni për hir të **Allahut**: çkado që jepni do t'ju shpaguhet plotësisht dhe nuk do të dëmtoheni. <sup>273</sup> [Jepjuni] atyre në nevojë që janë plotësisht të preokupuar në rrugën e **Allahut** dhe nuk mund të udhëtojnë nëpër vend [për tregti]. Të panjohurve mund t'u duken të pasur për shkak të vetëpërmbajtjes së tyre, por ju do t'i njihni nga karakteristika e tyre që nuk lypin me këmbëngulje. **Allahu** është fare mirë i informuar për çdo të mirë që e jepni.

<sup>274</sup> Ata që japin, nga pasuritë e tyre, natën dhe ditën, privatisht apo publikisht, do ta kenë shpërblimin e tyre me Zotin e tyre: nuk ka frikë për ta, as s'do të pikëllohen. <sup>275</sup> Por ata që marrin fajde do të ngriten në Ditën e Ringjalljes si dikush që mundohet nga prekja e Satanit. Kjo për shkak se thonë: 'Tregtia dhe fajtja janë e njëjta gjë', <sup>276</sup> por **Allahu** e ka lejuar tregtinë dhe e ka ndaluar fajden. Kushdo, që kur e merr paralajmërimin e **Allahut**, e ndal marrjen e fajdes mund t'i mbajë fitimet e tij të shkuara – **Allahu** do të jetë gjykatësi i tij – por kushdo që i kthehet fajdes do të jetë banor i Zjarrit, për të mbetur aty. **Allahu** e kalb fajden, por i bekon veprat bamirëse me rritje të shumëfishtë: Ai nuk e do mëkatarin mosmirënjohës. <sup>277</sup> Ata që besojnë, bëjnë vepra të mira, falen vazhdimisht dhe e paguajnë lëmshën e caktuar do ta kenë shpërblimin e tyre me Zotin e tyre: s'ka frikë për ta, as s'do të pikëllohen. <sup>278</sup> Ju që besoni, kini kujdes nga **Allahu**: hiqni dorë nga çfarëdo obligimi i papaguar nga fajtja, në qofshi besimtarë të vërtetë. <sup>279</sup> Nëse nuk e bëni këtë, atëherë jini të paralajmëruar për luftën nga **Allahu** dhe I Dërguari I Tij. Do ta keni kapitalin tuaj nëse pendoheni dhe pa pësuar humbje as

pa i shkaktuar humbje të tjerëve. <sup>2:280</sup> Nëse borxhmarrësi është në vështirësi, atëherë shtyni gjërat deri kur çështjet të bëhen më të lehta për të; e prapë, nëse do ta shkruanit si akt bamirësie, kjo do të ishte më mirë për ju, ah po ta dinit. <sup>281</sup> Kujdes nga një Ditë kur do t'ju kthejnë te **Allahu**: çdo shpirt do të paguhet plotësisht për atë që e ka fituar dhe askujt nuk do t'i bëhet padrejtësi.

<sup>282</sup> Ju që besoni, kur ta kontraktoni një borxh për një afat të caktuar, bëjeni me shkrim: merreni një shkruar ta shkruajë atë me drejtësi ndërmjet jush. Asnjë shkruar nuk duhet të refuzojë të shkruajë: le të shkruajë siç e ka mësuar **Allahu**, borxhmarrësi le të diktojë dhe le t'i druhet **Allahut**, Zotit të tij dhe mos ta zvogëlojë [borxhin] fare. Nëse borxhmarrësi është me mendje të mangët, i dobët, apo i paaftë për të diktuar, le të diktojë kujdestari i tij me drejtësi. Thirrni dy burra si dëshmitarë. Nëse nuk ka dy burra, atëherë thirreni një burrë dhe dy gra nga ato që i miratoni si dëshmitare, që nëse ndodh që njëra nga dy gratë të harrojë<sup>a</sup>, tjetra mund t'ia përkujtojë. Dëshmitarët të mos refuzojnë kur të ftohen. Mos e përbuzni të shkruarit e borxhit, qoftë i vogël apo i madh, bashkë me afatin e kthimit: kjo mënyrë është më e paanshme në sytë e **Allahut**, më e besueshme si dëshmi dhe ka më shumë gjasa t'i parandalojë dyshimet që lindin mes jush. Por nëse malli është aty dhe e dorëzoni, nuk ju vihet faj nëse nuk e shkruani. Kini dëshmitarë të pranishëm kurdo që tregtoni me njëri-tjetrin dhe mos t'i bëhet dëm as shkruarit as dëshmitarit, se po t'u bënit dëm, do të ishte krim nga ana juaj. Jini të vetëdijshtë për **Allahun** dhe Ai do t'ju mësojë: Ai ka njohuri të plotë për gjithçka. <sup>283</sup> Nëse jeni në udhëtim dhe nuk mund të gjeni shkruar, diçka duhet të dorëzohet si garancë, por nëse vendosni t'i besoni njëri-tjetrit, atëherë ai të cilit i besohet le ta përmbushë besimin e tij; le të jetë i vetëdijshtë për **Allahun**, Zotin e tij. Mos i fshehni provat: kushdo që e bën këtë ka zemër mëkatore dhe **Allahu** është plotësisht i informuar për gjithçka që bëni. <sup>284</sup> Çkado që është në qiej dhe në tokë i përket **Allahut** dhe, pavarësisht a i zbuloni a i fshehni mendimet tuaja, **Allahu** do t'ju kërkojë llogari për to. Ai do ta falë këdo që do ta falë dhe do ta ndëshkojë këto që do ta ndëshkojë: Ai ka pushtet mbi të gjitha gjërat.

---

<sup>a</sup> Kuptim klasik i *dalla*.

285

I Dërguari beson  
në atë që i është zbritur  
nga Zoti i tij,  
siç bëjnë edhe besimplotët.  
Të gjithë ata besojnë në **Allahun**  
dhe në engjëjt E Tij  
dhe në Librat E Tij  
dhe në Të Dërguarit E Tij.  
“Nuk bëjmë dallim  
ndërmjet të dërguarve individualë Të Tij”,  
dhe thonë:  
“Dëgjojmë dhe bindemi.  
E kërkojmë faljen Tënde, Zoti ynë;  
se te Ti kthehemi të gjithë!”

286

**Allahu** nuk e ngarkon një shpirt  
përtej mundësive të tij:  
secili fiton për çka ka bërë mirë,  
dhe e vuan të keqen e tij.  
“Zoti ynë,  
të lutemi mos na kritiko ashpër  
nëse harrojmë apo lajthitim.  
Dhe të lutemi, Zoti ynë,  
mos na ngarko  
siç i ke ngarkuar  
ata para nesh.  
Dhe të lutemi, Zoti ynë,  
mos na ngarko  
me atë për të cilën  
na mungon forca.  
Dhe të lutemi na e dhuro ndjesën  
dhe falna dhe ki mëshirë mbi ne.  
Ti je Mbrojtësi ynë;  
pra na ndihmo  
kundër mosbesimtarëve.”

## **Përshkrimi para kaptinës 2 nga Abdel Haleem:**

*Kjo është sure medinase dhe më e gjata në Kuran, që përmban material të shpallur gjatë disa viteve dhe është emëruar sipas rrëfimit të lopës që Izraelitët ishin urdhëruar ta therin (vargjet 67 e tutje). Kaptina hapet me një përgjigje ndaj përgjërimit për udhëzim në Suren 1, 'Hapja', duke e ndarë njerëzimin në tri grupe në reagimin e tyre ndaj këtij udhëzimi – besimtarët, mosbesimtarët dhe hipokritët – dhe mbyllet duke i konfirmuar parimet e besimit të dhëna në vargjet hyrëse (3-5). Ata të cilëve u adresohet teksti ndryshojnë gjersa përparon kaptina: në kohë të ndryshme teksti i adresohet njerëzimit në përgjithësi (vargjet 21 e tutje), ku nxiten t'i shërbejnë **Allahut** që ka qenë kaq dashamirës për ta (u sillen ndërmend se **Allahu** e krijoi Ademin dhe e favorizoi ndaj engjëjve); pastaj Fëmijëve të Izraelit (vargjet 40 e tutje), të cilëve u sillen ndërmend mirësitë e veçanta të **Allahut** ndaj tyre dhe nxiten të besojnë në libra të shenjtë që në të vërtetë e konfirmojnë të tyrin; dhe pastaj besimtarëve (vargjet 136 e tutje), të cilëve u jepen udhëzime në shumë fusha: lutje, agjërim, haxh (pelegrinazh), mbrojtje, ligj martesor dhe çështje financiare.*

## **Shënimet gjuhësore (Thomas Cleary)**

Shpallja e “Lopës” nisi në vitin e parë të emigrimit të Profetit në Medinë dhe ishte kryer afër fundit të misionit të tij.

- 2 “Ky është Libri, pa dyshim, në të udhërrëfim . . .”: Kjo mund të lexohet edhe “Ky libër, pa dyshim, ka udhërrëfim në të. ...”

“të vetëdijsmit” (*muttaqina*): Kjo është nga rrënja W-Q-Y, që i ka domethëniet primitive të kujdesit për, ruajtjes, sigurimit, mbrojtjes. *Muttaqina* vjen nga masa e pestë apo e tetë e rrënjës dhe domethënë të ruhesh, të jesh syçelë, të vigjilosh, të mbrohesh dhe t'i frikësohesh zemëratës së **Allahut**. E kam përdorur fjalën “të vetëdijsmit” për ta përkthyer këtë në shumë raste, për shkak se domethënia e saj origjinale i kombinon këto ide goxha mirë dhe për shkak se fjala “të vetëdijsmëm” është dobësuar në asi shkalle në përdorimin bashkëkohor sa që lidhja ndërmjet detyrës ndaj **Allahut** dhe detyrës ndaj njerëzimit më nuk është e qartë dhe ka nevojë të rigjallërohet duke e përdorur fjalën në asi mënyre që ta rifitojë domethënien dhe forcën origjinale. Tjetërkund, në përputhje me rrethanat specifike, i kam përdorur shprehjet “admirues ndaj **Allahut**” dhe “të kujdesshëm për **Allahun**” për t'i përkthyer masat e njëjta të rrënjës së njëjtë, por nuk mendoj se këto shprehje janë të plota apo mjaft bindëse në idiomën aktuale për ta përligjur huqjen e shansit për ta kthyer atë kuptim më të plotë të shprehjes “të vetëdijsmëm”

përmes përdorimit të duhur në përkthimin e fragmenteve nga Kurani në anglishten (përkatësisht shqipen) bashkëkohore.

- 3 “ata që besojnë në të padukshmen”: Një nga manifestimet e arrogancës njerëzore është ta besojmë dijen tonë si të shtrirë njësoj – si saktësisht të njëjtë – me realitetin, të supozojmë se nuk ka asgjë me domethënie apo me vlerë përtej konceptimit apo njohjes sonë. Në traditën myslimane thuhet se pranimi “**Allahu** e di më mirë” (apo “**Allahu** është më i dijshtëm”) është vetë pjesë e dijes; vetëdijesimi për asgjësinë e dijes njerëzore në lidhje me dijen hyjnore është një lloj modestie e thellë që e ndihmon udhëtarin t’i tejkalojë kufizimet e vetë-reflektimit njerëzor dhe të ngritet në reflektimin mbi **Allahun** dhe përfundimisht në reflektimin e **Allahut**.

“që falen rregullisht [në mënyrë të qëndrueshme]”: Fjala për “që falen rregullisht”, *yuqimu*, vjen nga rrënja Q-W-M. Këtu folja nxirret nga masa e katërt e rrënjës, që përfshin kuptime të tilla si të drejtosh, të vësh në rregull, të ringjallësh, të të sjellin në qenie, të fillosh, të gjallërohesh, të festosh, të vazhdosh me qëndrueshmëri, të preokupohesh vazhdimisht me diçka. Lutja (të falurit) është njëra nga shtyllat e Islamit, pjesë esenciale e jetës së brendshme dhe të jashtme, mënyrë e pastrimit të mendjes rregullisht nga preokupimet tokësore dhe rigjallërimit të të kujtuarit e realitetit më të madh.

“dhe që japin nga ajo që Ne ua kemi furnizuar”: të menduarit islamik e njej dhe e pranon me mirënjohje privilegjin e shijimit të gjërave të mira të kësaj bote; përgjegjësia e ndarjes së bekimeve me të tjerët është pjesë e shabllonit natyral të këtij fenomeni. Kjo është arsyeja pse madje edhe për gjërat e mira flitet si provë apo test për njerëzimin. Klasiku i lashtë kinez *I Ching* thotë: “Ata lart i sigurojnë shtëpitë e tyre përmes mirësisë ndaj atyre poshtë.”

- 4 “në atë që të është shpallur [ty]”: Këtu “ty” i referohet Muhamedit-Profetit dhe po ashtu në përgjithësi atyre që e hasin Kuranin. Në mënyrë përkatëse, “atë që është shpallur para se të ishe” i referohet shpalljeve të mëhershme, siç është Tora dhe Ungjilli. Mirëpo duhet të vërejmë se Ungjilli, që domethënë shpallja që i është besuar Isait (Jezusit), të cilit Kurani i referohet si *Injiil*, nuk konsiderohet saktësisht identik me Dhjatën e Re të krishterë si tërësi, as me Katër Ungjijtë siç gjenden tani në Biblën e krishterë.

“Të Përtejmen” (*al’ Aakhira*): apo “Fundin”. Kjo i referohet llogaritjes dhe shpagimit final. Këto përjetime, duke i përfshirë përjetimet shoqëruese të vetë kohës dhe pushimit të saj, ndjehen dhe interpretohen natyrshëm në mënyra të ndryshme sipas niveleve të ndryshme të vetëdijesisë dhe të të kujtuarit.

- 5 “të suksesshmit [të lumturit]” (*al muflihuuna*): Kjo fjalë nxirret nga rrënja F-L-H, që në formën e saj primitive domethënë të plugosh, të lërosh, të

kultivosh; “të lumtur” vjen nga masa e katërt, që domethënë të përparosh, të lulëzosh, të jesh i suksesshëm, të bëhesh i lumtur. Ideja është që mirëqenia reale nuk është veç materiale por ka edhe dimension shpirtëror, që në fakt është ajo që i jep kuptim dhe lidhje logjike gjithëpërfshirëse përpjekjeve dhe arritjeve të jetës në botë.

- 6 “ata që tallen [mosmirënjohësit që refuzojnë]” (*alladhiina kafaruu*): Rrënja K-F-R, këtu në masën e saj të parë, domethënë të refuzosh (**Allahun**), të jesh mosmirënjohës, të jesh mosrespektues për **Allahun**, të mos besosh. Mirënjohja, besimi dhe feja janë kaq të rëndësishme për lidhjen islamike me **Allahun** dhe me dhuratat e **Allahut** sa që shpesh i kam përfshirë të dy idetë: të mosmirënjohjes dhe të mospranimit në përkthimin e derivateve të K-F-R nëpër këto fragmente nga Kurani.

“për ta është njëjtë – i paralajmërove apo jo”: Misioni i Muhamedit ishte “veç të dërgojë mesazh të qartë”, jo t’i detyrojë njerëzit në besim të deklaruar; se a beson dikush apo jo është çështje e **Allahut** si dhe e arsyes së dhënë nga **Allahu** dhe e vullnetit të lirë të individit.

- 7 “**Allahu** ua ka vulosur zemrat”: Bota e krijuar vepron si vello për ata që e kanë vëmendjen të tejfiksuar aty, duke i bllokuar nga perceptimi i realitetit përtej çështjeve të drejtpërdrejta të kësaj jete.

“ka vuajtje tmerrësisht tronditëse për ta”: Kjo është vuajtja e të qenët i bllokuar nga e vërteta reale, se veç në të gjenden siguria dhe paqja.

- 10 “Në zemrat e tyre ka sëmundje dhe **Allahu** i ka bërë më të sëmurë”: Ata që shtiren me devocion dhe me besimtari në **Zot** por realisht janë refuzues të besimit në **Zot** – e që i përkushtohen kënaqësive tokësore – nuk përmirësohen përmes shoqërimit të tyre me fe. Përkundrazi, vetëkënaqësia dhe krenaria që e nxjerrin nga shoqërimi i tyre me fenë në të vërtetë ua zmadhojnë të metat. Mashtrimi i fesë së rrejshme bart “torturë plot dhembje” se i ndan njerëzit nga e vërteta fillimisht dhe pastaj sjelljet mendjemëdha të saj të rrejshme i lenë njerëzit në baltë dhe i zhgënjejnë në fund.

- 11-12 “bëjnë korrupsion [telashe]”: Kjo shprehje është nxjerrë nga rrënja F-S-D, që në masën e parë domethënë të jesh apo të bëhesh i keq, i kalbur, i prishur, i korruptuar, i paarsyeshëm, i rremë, i gabuar. Këtu është nxjerrë nga masa e katërt që domethënë të çosh dëm, të prishësh, të korruptosh, ta prishësh moralin, të çorodisësh, të shtrembërosh, të shkatërrosh, të pengosh, të minosh, të dobësosh, ta ndalosh dikë. Budallenjtë fanatikë dhe hipokritët që shtiren se

janë besimtarë fetarë mund t'i shkaktojnë të gjitha llojet e degradimit dhe të korrupsionit përmes falsiteteve të tyre, madje pa e kuptuar këtë, duke qenë të hipnotizuar nga fasadat e tyre.

- 13 “të pamendët [torollakët]” (*sufahaa’*; njëjës *safih*): Kjo domethënë budallenjtë, të pamendët, teveqelët, të paditurit, të trashët, të pazotët. Ata, besimi i deklaruar hapur i të cilëve është ushqim për arrogancën e tyre e mendojnë fenë ku i jepesh **Allahut** si fe të atyre që dinë pak për botën, por mbivlerësimi i tyre për veten i bën budallenjtë e vërtetë.
- 14 “të ligët [obsesionet]” (*shayaatiin*, shumës i *shaytaan*): Nga kjo nxirret Satani anglisht (dhe shqip), njëri nga emrat e djallit. Ky emër arabik vjen nga domethënia rrënjësore të jesh i mbrapshtë apo kokëfortë i paarsyeshëm (karakteristikat esenciale të obsesionit apo manisë), që i referohet kryengritjes satanike kundër **Allahut**, të manifestuar si arrogancë, mosmirënjohje dhe obsesion posesiv me gjërat e botës. Një emër i djallit vjen nga rrënja W-S-W-S, që i ka kuptimet e pëshpëritjes apo sugjerimit, që i referohet obsesionit si mishërim i karakteristikës dhe i aktivitetit satanik. Ky varg i caktuar i përshkruan budallenjtë që e deklarojnë publikisht besimin e tyre në **Zot**, e këndej privatisht e deklarojnë devotshmërinë e tyre ndaj ideve dhe obsesioneve të tyre personale, qoftë statusi, pasuria apo çkado qoftë tjetër që mund ta preokupojë mendjen.
- 15 Pikërisht mendjelehtësia, me të cilën hipokritët dhe budallenjtë e trajtojnë fenë e tyre si formulim të besimit pa realitet, i lë të shkojnë krejtësisht tutje edhe në teprimet (mizoritë) e bëra haptas nën maskën e devocionit – edhe në ato të bëra fshehtas nën nxitjen e obsesioneve private. “Teprimet” (“mizoritë”) e përkthen fjalën *tughyaan*, nga rrënja foljore T-GH-Y, që domethënë shkelje religjioze, kapërcim i kufijve të duhur, devijim nga sfera e duhur e veprimtarisë, të jesh teprues, të jesh tiranik apo i egër, të shtypësh, të terrorizosh.
- 17 Kjo e përshkruan dritën e pambështetshme të dijes artificiale, nga e cila feja e rreme është një variacion. “**Allahu** ua mori dritën” në kuptimin që falsiteti nuk qëndron në prezencë të realitetit; projektimet subjektive nuk mbesin të paprekura përballë të vërtetës objektive; mendimi i fundëm i bërë nga njeriu dështon ta kuptojë e ta përthejojë të pafundmen.

- 18 “të pakthyeshem [nuk do të kthehen prapa]” në realitet, apo në burimin e tyre, përderisa janë plotësisht të preokupuar me trillimet e tyre.
- 19 Manifestimi i fesë përfshin mister, paralajmërim, përndritje dhe ushqyerje-kultivim; këto simbolizohen me errësirë, bubullimë, vetëtimë dhe shi. Mosmirënjohësit janë kryesisht të preokupuar me injorimin e paralajmërimit, nga frika se ai do të dalë i vërtetë kundër tyre. Ajo që nuk e kuptojnë është se realiteti i rrethon dhe i gjykon qofshin apo jo të vëmendshëm me vetëdije për këtë fakt.
- 20 Qartësia e shpalljes hyjnore është verbuese për syrin e mësuar me errësirën e hutisë njerëzore. Me çdo përtëritje të shpalljes, apo rigjallërim të dijes së vërtetë, njerëzimi e bën njëfarë përparimi; mirëpo kur infuzioni i frymëzimit bie, njerëzimi ngec përsëri. Edhe pse ky proces duket i paqartë dhe i çrregullt, të paktën njerëzimi ka shans t’i përdorë zotësitë e dhëna nga **Allahu** që ta njohë shpalljen dhe të jetojë në dritën e saj; nuk është njëjtë sikur po të mos kishim fare sens për inteligjencë dhe për vendimmarrje.
- 22 “Pra mos i ngritni konkurrentë **Allahut**, se tash e dini”: Duke e ditur se **Allahu** është burimi i vetëm i tërë krijimit, mos e barazoni Krijuesin me asnjë gjë të krijuar.
- 30 “një kujdestar në tokë”: dmth. Ademi/njerëzimi. Vërejeni opinionin e engjëjve për racën njerëzore.
- 31-33 Sipas liderit të madh religjioz Ibn al Arabi, natyra e mënyrës së formimit të njeriut, e përfaqësuar nga Ademi, njeriu i parë, është dalluar me integrimin e tërë ekzistencës, që përfaqësohet nga **Allahu** që ia mëson Ademit tërë emrat apo cilësitë që e përbëjnë gjithësinë. Engjëjt, gjersa kanë perceptim shumë të rafinuar, nuk e kanë këtë natyrë të integruar dhe prandaj u mungon dija e plotë.
- 34 Arroganca dhe mosmirënjohja e Iblis-it, engjëllit jorespektues, në refuzimin që ta ndjekë dizajnin hyjnor, është modeli i rënies njerëzore në gabim përmes mendjemadhësisë. Iblis-i u bë kështu personifikim i Djallit.
- 35 “se bëheni keqbërës [tiranë abuzues]”: Ata do të bëheshin ashtu duke e keqpërdorur dijen dhe duke e përvetësuar padrejtësisht vullnetin e **Allahut**. “Tiranë abuzues” e përkthen pjesoren veprorë të masës së parë të rrënjës DH-L-M, që domethënë t’i bësh keq dikujt, ta lëndosh dikë, të jesh i padrejtë,



shtypës apo tiranik ndaj dikujt, të keqtrajtosh. Nga e njëjta rrënjë nxirret edhe *dhulma*, “errësira”, e përdorur shpesh në kuptim të keq.

36 Vëreni se në rikujtimin Kuranor Ademi nuk joshet në rënie nga gruaja e tij, si në versionin e njohur Jude-Krishterë të këtij rrëfimi; në Kuran, Ademi dhe gruaja e tij të dy mashtrohen nga sugjerimi tinëzar i djallit (“Obsesorit”), pëshpëritja e mbrapshtisë dhe e obsesionit.

“Uluni në nivel . . .”: Njerëzimi nuk do të jetonte më në dëlirësinë e lartësuar të Kopshtit.

“në mospëlqim të ndërsjellë”: Të qenët në gjendje të tëhuajësimit nga njëri-tjetri si nga burimi ynë i përbashkët.

37 Këtu përsëri shpallja në Kuran dallon nga tradita Jude-Krishterë në imazhin e saj të Ademit. Shpallja e mëhershme fokusohet në dobësinë e natyrës njerëzore dhe në nevojën për shlyerje të fajit; shpallja Kuranore fokusohet në realitetin gjithmonë-prezent të shlyerjes së fajit, në fuqinë dhe në mëshirën e **Allahut**, në kthimin e Ademit në gjendje të shëndoshë mendore dhe në bërjen e tij Të Dërguarin e parë.

38 Sikur Ademi dhe gruaja e tij, tërë njerëzimi e lë gjendjen e dëlirësisë së pastër por i paraqitet mundësia e kthimit të burimi duke i ndjekur shenjat e tërthorta të të vërtetës që rrezatohen nga ajo.

43 “Adhurim” këtu është përkthim i lirë nga R-K-!, që fjalë për fjalë domethënë përkulje poshtë, paraqitje fizike e dorëzimit ndaj përcaktimit të **Allahut**.

44 Teksti i madh budist i njohur si “*Shkrimi i Shenjtë i Zbukurimit të Lules*” shpreh ide të ngjashme: “Si dikush në qosh që i thotë krejt llojet e gjërave të mira gjersa nuk ka fare virtyt real të brendshëm – të tillë janë ata që nuk praktikojnë” (Libri X).

48 Një nga imazhet më të fuqishme të ditës së gjykimit është ai i të qenët krejtësisht vetëm në prezencë të Të Vërtetës pa asnjë nga mbështetjet e njohura të jetës së përditshme.

62 Shih vargun 256 nga ky kapitull: “Nuk ka detyrim në fe.” Nuk është e sigurt se kush ishin saktësisht këta sabianët; Penrice thotë se ata e konsideronin veten ndjekës të profetit Noah (Nuhi). Gjersa Islami shpërndahej nëpër glob

pas vdekjes së Profetit Muhamed, termi “sabian” duket të jetë kuptuar, varësisht nga koha dhe situata, se përfshin fe të tjera të mëdha Lindore si Zoroastrianizmi dhe Budizmi. Folja primare nga rrënja S-B-’ domethënë ngritje, si e një ylli. Ky mund të jetë burimi i idesë së Penrice-s se sabianët i kanë adhuruar trupat qiellorë. Duke e përdorur kuptimin e rrënjës si referim për yjet që ngriten, emri dhe imazhi i admirimit të trupave qiellorë do të mund t’i paraqiste figurativisht edhe pasuesit e “dritave” të largëta apo shpalljeve që ishin më të largëta nga komuniteti i hershëm i Islamit se që ishin Judaizmi dhe Krishterimi.

83 Ky varg, nga i cili e kam përkthyer veç një pjesë, e përmban një përmbledhje të bukur të relacionit të besimtarit me **Allahun** dhe me njerëzimin.

84-85 Këto vargje kanë ngjarje historike specifike si pika të referencës së drejtpërdrejtë, por i adresohen tërë njerëzimit dhe e japin një përshkrim të përgjithshëm të një modeli specifik të përsëritur në histori të njerëzimit. Kjo është figurë stilistike e shpeshtë në Kuran. Veç pjesa e parë e vargut 85 është përkthyer këtu.

87 Thirrja e zanafillave hyjnore të mësimëve dhe psikologjia e mbrapshtë njerëzore e njerëzve kokëfortë përsëritet shumë herë në Kuran. Fraza kryesore këtu është “diçka që vetë nuk e keni merak” (*maa laa tahwaa anfusukum*). Njerëzit priren ta refuzojnë atë që nuk e përforcon ndjesinë e vetes apo nuk i plotëson meraket e menjëhershme.

Shprehja “mendjemadh e arrogantë” e përkthen foljen nga masa e dhjetë e K-B-R, duke i pasur kuptimet e të qenët mendjemadh apo krenar, të konsiderimit të vetes (tepër) të madh (për diçka) dhe po ashtu të konsiderimit të rëndësishme diçka. Referenca është për njerëzit që e bëjnë veten dhe meraket e tyre tepër të rëndësishëm për të qenë të aftë ta pranojnë të vërtetën objektive. Shkalla në të cilën kanë investuar njerëzit në subjektivitetin e tyre shfaqet në tërbimin e reagimit të tyre ndaj Të Dërguarve dhe mesazheve të tyre: “Disa i keni damkosur si rrenësa, të tjerë i keni vrarë.”

90 “zemëratë pas zemërate”: Ky varg e përshkruan fatin e keq të interesit pronësor në sistem religjioz: ata që kanë pranuar shpallje shkaktojnë “zemëratë pas zemërate” kur bëhen posesivë dhe xhelozë, se qëndrimi i tyre jo vetëm që i pengon ta pranojnë përfitimin e qartësimeve të shpalljes së re, por edhe i pengon ta çmojnë plotësisht përmbajtjen e brendshme të shpalljes së mëhershme, për shkak të fokusit në pronësuesin apo pronësinë njerëzore dhe harresën rezultuese të **Allahut**, burimit.

102-103 Ky pasazh e jep njerën nga imazhet më kthjellëse të shpërdorimit të dijes. E kam lënë jashtë hapjen e vargut 102, që është vazhdim i 101-shit, që flet për njerëzit e larguar nga rruga e drejtë që e ndjekin përgojimin e obsesivëve për fuqinë e Mbretit Sulejman (Solomon). Ky përgojim ishte dukshëm për magjinë, apo operimin e dijes përtej kufijve të asaj që nevojitet për mbijetesë të thjeshtë në jetë të përditshme. Kurani e mbron Sulejmanin dhe e dallon atë nga obsesivët dhe të mbrapshtit, manipuluesit që “i mësuan njerëzve magji”, që operon përmes sugjestionit dhe obsesionit dhe “çka u zbriti engjëjve në Babiloni,” apo dije e jashtëzakonshme që mbahet nga njerëzit e fuqishëm të kohërave të lashta.

Është i diskutueshëm kuptimi i “engjëjve” këtu; vjen nga rrënja M-L-K, siç vjen edhe fjala “mbret”. Kuptimet e rrënjës e përfshijnë të pasurit pushtet apo të qenët i aftë dhe ka shumë derivate që lidhen me zotërimin dhe sundimin. Haruti dhe Maruti dhe Babiloni, duken se e simbolizojnë dijen e jashtëzakonshme që “rrodhi” në pjesën e zakonshme të njerëzimit: në fillim u bë e qartë se kjo ishte sprovë, përmes të cilës njerëzit ose mund ta vërtetonin gjithëfuqinë e **Allahut** përtej dyshimit ose ta shkatërronin veten me shpërdorim; pastaj “rrjedhja” u doli duarsh dhe me paralajmërimin fillestar të harruar, njerëzit zgjodhën gjëra të caktuara për veten, me pasoja katastrofale për shkak të paplotshmërisë së dijes së tyre dhe natyrës obsesive të interesave të tyre. Ata “nuk kishin hise në Të Përtejmen” pikërisht për shkak të kësaj prirjeje të llastohen obsesivisht në manipulim të gjërave të kësaj bote. Kështu njerëzimi e bëri magjinë lodër shkatërruese, duke e harruar zanafillën dhe kontekstin e plotë të tërë dijes.

“Por pastaj, megjithatë, ata mësuan nga këta dy çka do ta ndante burrin dhe gruan”: Gjersa ka forma të magjisë që merren specifikisht me krijimin dhe/ose shkatërrimin e lidhjeve njerëzore, jam i prirë të mendoj se ky pasazh mund t’i referohet më përgjithësisht kërkimit obsesiv të dijes dhe të pushtetit, përmes të cilës njeriu përfshihet në tentimin ta kontrollojë dhe ta manipulojë botën, duke u bërë i tëhujësuar nga âma kultivuese e tokës dhe familja e paraqitur në gruan.

“nuk e lëndojnë askë me këtë pos me leje të **Allahut**”: Vetëdashja është pjesë e natyrës njerëzore të dhënë nga **Allahu**: pa vetëdashje nuk do të kishte “provë” apo “test”, as mjete për njerëzimin që të zgjohet dhe të bëhet i vetëdijshëm për potencialin e tij të dhënë nga **Allahu**.

“ata që fituan [nga kjo njohuri] nuk kishin hise në Të Përtejmen”: Ata që e mësuan dijen e dëmshme, apo u bënë fanatikë të magjisë së dëmshme, e shkëputën veten nga realiteti përmes obsesionit me magjepsjet dhe ambiciet e tyre.

103 Fuqitë që ia ofron njerëzimit dija e jashtëzakonshme mund ta zbehin apo ta rrisin respektin për fuqinë e **Allahut** dhe mund ta shmangin apo ta ngrisin ngjytjen e shpirtit kah **Allahu**. Meqë **Allahu** është burimi i tërë fuqisë, shpërblimet e adhurimit ekskluziv të **Allahut** ia kalojnë atyre të përkushtimit ndaj çfarëdo forme specifike të dijes apo të fuqisë.

136 “se i kushtohemi Atij.”: Pranimi Islamik i tërë traditës Abrahamike (të Ibrahimit) nuk bazohet në trashëgiminë e thjeshtë historike por në njohjen e zanafillës hyjnore të frymëzimit dhe në profecinë nga e cila nxirret.

164 Shumë nga përbetimet në Kuran bëhen përmes fenomeneve natyrale. Ligjet e natyrës shihen si shenja të **Allahut**, dëshmi e një fuqie të gjallë inteligjente kozmike.

177 Ja një nga përmbledhjet më të bukura të besimeve dhe praktikave thelbësore Islamike.

“Nuk është mirësi t’i ktheni fytyrat kah Lindja e Perëndimi”: Kjo duket ta ketë domethënien që zemra e fesë nuk përcaktohet nga deklarimi apo besnikëria sipërfaqësore siç definohet në terma tokësore. Disa përkthyes e përkthejnë wa-në këtu si “ose”, por “e”-ja që është më e zakonshme më duket më përfshirëse dhe kështu më sugjестive për aspektin transcendental (kapërcyes) të përkushtimit madje edhe gjersa praktikohet brenda jetës së përditshme. I shumëçmuari Vargu i Dritës (i përkthyer po ashtu në shqip nga Ridvan Bunjaku) thotë se drita e **Allahut** është si llambë e ndezur me vaj nga një “pemë e bekuar ulliri” që është “as e Lindjes as e Perëndimit.”

“për dashurinë e **Allahut**” (*!alaa hubbihi*). Kjo mund të lexohet edhe “përkundër dashurisë për to (të mirat/paratë).” Origjinali e përdor një përemër që mund të interpretohet ose t’i referohet **Allahut** ose pasurisë. Kështu pasazhi mund të lexohet se po flet për dhënien e të mirave dhe parave për dashurinë e **Allahut** (për dallim nga dhënia për motive personale), apo për dhënie të të mirave dhe parave përkundër vlerësimit të shtrenjtë për to (e jo veç faljen e atyre për të cilat nuk të intereson). Bashkë këto kuptime e shprehin edhe doktrinën Budiste të “zbrazëtisë së tri sferave” në dhënien e përsosur, që thuhet ta tejkalojë lidhjen me tri sferat e ndenjës apo të konceptimit: vetes si bamirës, tjetrit si përfitues dhe dhuratës si bamirësi.

255 Ky është i shumëçmuari Vargu i Fronit (*Aayat al Kursiy*), që e përshkruan **Allahun** si realitet të gjallë unik që kujdeset për gjithësinë.

256 Nuk ka detyrim në fe (reale) se e vërteta është objektivist e dallueshme nga gabimi nga vetë natyra e saj. Esenca e gabimit është idhujtaria, që domethënë të trajtosh diçka relative sikur të ishte absolute.

262-265 Këtu prapë janë disa paraqitje veçanërisht të qarta dhe konkrete të asaj që Budistët e quajnë “zbrazëtia e tri sferave” në bamirësi të përsosur. Bujaria reale nuk është kalkuluese. Një herë një dervish, lypës religjioz mysliman, shkoi te një berber në Mekë dhe kërkoi të rruhej. Berberi, që në atë kohë punonte me pagesë nga klientët, u pajtua menjëherë dhe ia ofroi një rruajtje dervishit. I impresionuar me këtë bujari kaq fetare, dervishi u kthye më vonë me një çantë prej ari që ia kish dhënë dikush si lëmoshë. Berberi e refuzoi pagesën, duke thënë: “A nuk të vjen turp të ofrosh para për diçka të bërë për hir të **Allahut?**”

285-286 Sipas traditës për fjalët e urta dhe zakonet e Profetit Muhamed, ai ka thënë se nëse njeriu i reciton dy vargjet e fundit të “Lopës” në një natë, ato do të mjaftojnë (“*Al aayataani aakhiri suurati l baqarati man qara’a bihimaa fi laylatin kafataahu.*”) (Bukhari, *Sahhih.*) Këto lutje të bukura e prodhojnë aromën e modestisë së çiltër përballë Të Vërtetës.

285 Ky varg e ripohon fokusin suprem në **Allahun**, Të Vërtetën të cilës i referohen të gjithë Të Dërguarit e sinqertë.

286 Ky varg e ripohon drejtësinë dhe paanësinë precize të Realit, që e sprovon dhe e teston shpirtin individual përmes ndërveprimit të potencialit të tij të lindur dhe ndikimeve të shanseve që i ka dhe zgjedhjeve që i bën.

### 3: Familja e Imranit (ÂL ‘IMRÂN)

Në emrin e **Allahut**, Dashamirësit, Mëshirëplotit

<sup>1</sup> *Elif Lâm Mîm.*

<sup>2</sup> **Allahu:**

nuk ka asgjë që ia vlen të adhurohet pos **Allahut**  
Gjithmonë-Jetuesi, Gjithmonë-Vigjilenti.

<sup>3</sup> Hap pas hapi, Ai ta zbriti Librin

ty [Profet] me Kriterin,  
duke e konfirmuar Të Vërtetën e asaj që i parapriu atij.  
Dhe Ai e dërgoi Teuratin dhe Ungjillin

<sup>4</sup> më parë, si udhëzim për njerëzimin;

dhe Ai e dërgoi Kriterin  
[dallimin ndërmjet të mirës e të keqes].<sup>a</sup>

Sigurisht për ata që i refuzojnë

shenjat e **Allahut**

ka një torturë nga më e ashpra;

dhe **Allahu** është hakmarrës i fuqishëm.

<sup>5</sup> Asgjë nuk është e fshehur nga **Allahu**,

as në tokë as në qiell.

<sup>6</sup> **Allahu** është Ai që ju formon

në mitra,

si të dojë Ai:

nuk ka asgjë që ia vlen të adhurohet pos Tij,

Të Gjithë-Fuqishmit, Të Gjith’urtit.

<sup>7</sup> Është **Allahu** Ai që ta zbriti

këtë Libër ty [Profet]:

në të ka vargje

me kuptim të përcaktuar qartë,

këto e bëjnë gurthemelin<sup>b</sup> e Librit;

---

<sup>a</sup> Shih edhe 5:48, 25:1

<sup>b</sup> Fjalë për fjalë ‘nënën’

gjersa të tjerat janë metaforike.

Dhe ata në zemrat e të cilëve ka shtrembërim  
e ndjekin metaforiken duke kërkuar mospërputhje në të,  
duke kërkuar interpretim ezoterik.

Por askush nuk e di  
kuptimin e saj origjinal  
pos **Allahut**.

Dhe ata me rrënjë të thella në dituri thonë:

“Ne besojmë në të;  
i gjithi është nga Zoti ynë.”

Por askush nuk do të jetë i kujdesshëm

pos atyre që janë me zemër

[me perceptim real] –

<sup>8</sup> ‘O Zoti ynë, mos lejo që zemrat tona të devijojnë pasi na ke udhëzuar. Na e dhuro mëshirën Tënde: Ti je Gjithmonë-Dhënësi. <sup>9</sup> O Zoti ynë, Ti do t’i mbledhësh të gjithë njerëzit në Ditën për të cilën nuk ka dyshim:<sup>a</sup> **Allahu** nuk e shkel kurrë premtimin E Tij.’

<sup>3:10</sup> As pasuritë e tyre as fëmijët e tyre nuk do t’u hyjnë në punë mosbesimtarëve kundër **Allahut**. Mosbesimtarët do të jenë lëndë djegëse për Zjarrin, <sup>11</sup> mu sikur njerëzit e Faraonit dhe para-ardhësit e tyre që i mohuan shpalljet Tona dhe **Allahu** i ndëshkoi për mëkatet e tyre: **Allahu** është i ashpër në ndëshkim. <sup>12</sup> [Profet,] thuaju mosbesimtarëve: ‘Do t’ju mundin dhe do t’ju përzënë bashkë në Ferr, një vend i urryer për të qëndruar. <sup>13</sup> Tashmë e keni parë një shenjë në dy ushtritë që u takuan në betejë, njëra duke luftuar për çështjen e **Allahut** dhe tjetra e përbërë nga mosbesimtarë. Me sytë e tyre [të parët] i panë [të dytët] se janë sa dyfishi i numrit të tyre<sup>b</sup>, por **Allahu** i ndihmon kujtdo që do t’i ndihmojë. Vërtet ka mësim në këtë për të gjithë ata që kanë sy për të parë.’

<sup>14</sup> Dashuria e gjërave të dëshirueshme është bërë tërheqëse për burrat – gratë, fëmijët, thesaret e arit e të argjendit të grumbulluara deri lart, kuajt me ngjyra të bukura, bagëtitë dhe tokat bujqësore – këto mund të jenë gëzimet e kësaj jete, por **Allahu** e ka vendin më të mirë për t’u kthyer. <sup>15</sup> [Profet,] thuaj: ‘A do të donit t’ju tregoj për gjërat që janë më të mira se të gjitha këto? Atyre që janë të vetëdijsëm për **Allahun** – Zoti i tyre do t’u japë Kopshte të hijeshuara me lumenj rrjedhës,

---

<sup>a</sup> Dhe në vetë atë ditë më nuk do të ketë ndonjë dyshim (shih 102:3-8)

<sup>b</sup> Ky është aludim në Betejën e Bedrit, ku ushtria myslimane ishte dukshëm më e vogël në numër por prapë fitimtare (shih 8:43-4).

ku do të rrinë me bashkëshortë të pastër dhe kënaqësinë e mirë të **Allahut** – **Allahu** është plotësisht i vetëdijshëm për shërbyesit E Tij – <sup>16</sup> atyre që thonë: “Zoti ynë, besojmë, pra falna mëkatet tona dhe mbrona nga vuajtja në Zjarr”, <sup>17</sup> atyre që janë të qëndrueshëm, besnikë, vërtet të përkushtuar, që japin [në çështjen e **Allahut**] dhe luten para agimit për falje.’

<sup>18</sup> **Allahu** e deklaron të vërtetën

se në fakt nuk ka

asgjë që ia vlen të adhurohet pos **Allahut**,

dhe po kështu bëjnë edhe engjëjt

dhe ata me njohuri.

Ai i mbahet drejtësisë.

Nuk ka asgjë që ia vlen të adhurohet pos **Allahut**,

Të Gjithë-Fuqishmit, Të Gjith’-Urtit.

<sup>19</sup> Feja E Vërtetë me **Allahun**

është dorëzimi

[*islami*: t’i përkushtohesh veç Atij].

dhe ata të cilëve u është dhënë Libri

nuk dalluan

deri pasi u erdhi njohuria,

nga mendjemadhësia e zilia në mes vete.

Dhe sa për ata që i refuzojnë

shenjat e **Allahut**,

**Allahu** është vërtet i shpejtë në shqyrtim të fakteve.

<sup>3:20</sup> Dhe nëse ata grinden me ty [Profet],

atëherë thuaj:

“Unë ia kam dorëzuar qenien time<sup>a</sup> veç **Allahut**,

dhe po kështu kanë bërë edhe ata që më ndjekin.”

Dhe thuaju atyre

të cilëve u është dhënë Libri,

dhe popullit të palibër:

“A i dorëzoheni edhe ju veç **Allahut**?”

Dhe nëse janë dorëzuar,

---

<sup>a</sup> Fjalë për fjalë ‘ia kam dorëzuar fytyrën time’



do të udhëzohen si duhet.  
Por nëse ta kthejnë shpinën,  
përgjegjësia jote e vetme  
është ta transmetosh një mesazh;  
dhe **Allahu** i sheh shërbyesit E Tij.

- <sup>21</sup> Sa për ata që i refuzojnë shpalljet e **Allahut**  
dhe i vrasin profetët padrejtësisht,  
të tëhuajësuar nga e vërteta,  
dhe i vrasin ata që thërrasin për drejtësi nga njerëzit,  
informoni ata për një dhembje të jashtëzakonshme.
- <sup>22</sup> Të tillët janë ata që përpjekjet i kanë të kota  
në këtë botë dhe në të përtejmen;  
dhe nuk kanë ndihmës a mbrojtës.

<sup>23</sup> A i ke marrë parasysh ata të cilëve iu dha një hise nga Shkrimi i Shenjtë? Kur nga ta kërkohet ta pranojnë gjykimin nga Shkrimi i Shenjtë i **Allahut**, disa nga ta e kthejnë shpinën dhe largohen, krejt kjo se deklarojnë: <sup>24</sup> ‘Zjarri do të na prekë veç për një numër të kufizuar të ditëve.’ Gënjeshttrat që i kanë shpikur ata i kanë çuar në devijim në fenë e tyre. <sup>25</sup> Si do të përballen kur Ne t’i mbledhim bashkë për një Ditë për të cilën nuk ka dyshim, kur secili shpirt do të paguhet plotësisht për atë që e ka bërë dhe nuk do t’u bëhet e padrejtë?

<sup>26</sup> Thuaj: ‘**Allah**, mbajtës i tërë kontrollit, Ti i jep kontroll kujt do që do t’i japësh dhe ia heq atë kujt do të do t’ia heqësh; Ti e lartëson këdo që do ta lartësosh dhe e përul këdo që do ta përulësh. Gjithçka që është e mirë qëndron në dorën Tënde: Ti ke pushtet ndaj gjithçkaje. <sup>27</sup> Ti e shkrin natën në ditë dhe ditën në natë; Ti i sjell të gjallët nga të vdekurit dhe të vdekurit nga të gjallët; Ti furnizon pakufishëm për këdo që do të furnizosh.’

<sup>28</sup> Besimtarët nuk duhet t’i bëjnë aleatë të tyre mosbesimtarët në vend të besimtarëve të tjerë – kushdo që e bën një gjë të tillë do ta izolojë veten plotësisht nga **Allahu** – përveç kur ju duhet të mbroheni nga ta. **Allahu** ju paralajmëron t’i ruheni Atij: Kthimi Përfundimtar është te **Allahu**.

<sup>29</sup> Thuaj [, Profet]:  
“Qoftë nëse e fshihni  
atë që është në zemrat tuaja  
apo e zbuloni,  
**Allahu** e di.  
Dhe Ai e di  
se çka ka në qiej  
dhe çka ka në tokë;  
dhe **Allahu** ka pushtet ndaj të gjitha gjërave.

<sup>3:30</sup> “Në ditën kur secili shpirt  
do të sillet ballë-për-ballë  
me të mirën që e ka bërë  
dhe me të keqen që e ka bërë,  
do të dojë të kishte një largesë të madhe  
ndërmjet vetes dhe të keqes së tij.  
Dhe **Allahu** ju bën të kujdesshëm ndaj Tij:  
dhe **Allahu** është dashamirës ndaj shërbyesve Të Tij.”

<sup>31</sup> Thuaj: ‘Nëse e doni **Allahun**, më ndiqni dhe **Allahu** do t’ju dojë dhe do t’jua falë mëkatet tuaja; **Allahu** është më falësi, më mëshirëploti.’ <sup>32</sup> Thuaj: ‘Bindjuni **Allahut** dhe Të Dërguarit’, por nëse e kthejnë shpinën, [dije se] **Allahu** nuk i do ata që [i] injorojnë [urdhrat E Tij].

<sup>33</sup> **Allahu** e zgjodhi Ademin, Nuhun, familjen e Ibrahimit<sup>a</sup> dhe familjen e ‘Imranit, mbi të gjithë njerëzit e tjerë, <sup>34</sup> në një vijë të pasardhësve – **Allahu** i dëgjon dhe i di të gjitha. <sup>35</sup> Gruaja e ‘Imranit tha: ‘Zot, atë që po rritet në barkun tim ta kam kushtuar plotësisht Ty; pra pranoje këtë nga unë. Ti je Ai që i dëgjon dhe i di të gjitha,’ <sup>36</sup> por kur ajo lindi, tha: ‘Zoti im! E kam lindur një vajzë’ – **Allahu** e dinte më së miri se çka ka lindur ajo: mashkulli nuk është si femra – ‘Po ia lë emrin Merjeme asaj dhe e lë atë dhe pasardhësit e saj në besim në mbrojtjen Tënde nga Satani i refuzuar.’ <sup>37</sup> Zoti i saj e pranoi dashamirësisht atë dhe e bëri të rritet në mirësi dhe ia besoi atë përgjegjësisë së Zekirjasë.

Kurdo që Zekirjai hynte për ta parë atë në shenjtoreshën e saj, e gjente të furnizuar me furnizime. Ai tha: ‘Merjeme, si po ndodh që po i ke këto furnizime?’ dhe ajo tha: ‘Janë nga **Allahu**: **Allahu** furnizon pakufishëm për këdo

---

<sup>a</sup> Kjo domethënë familjen në kuptimin më të gjerë të termit.

që do të furnizojë.’<sup>38</sup> Aty dhe në atë çast Zekirjai iu lut Zotit të tij, duke thënë: ‘Zot, nga dashamirësia Jote më dhuro pasardhës të virtytshëm: Ti e ndien çdo lutje.’<sup>39</sup> Engjëjt i thirrën atij, gjersa po lutej në këmbë në shenjto: ‘**Allahu** ta jep lajmin e Jahjait (Gjonit), që e vërteton një Fjalë nga **Allahu**.<sup>a</sup> Ai do të jetë fisnik e i dëlirë, profet, nga të ndershmit.’<sup>3:40</sup> Ai tha: ‘Zoti im, si mund të kem djalë kur jam kaq i vjetër dhe gruaja ime është shterpë?’ [Një engjëll] tha: ‘Do të jetë kështu: **Allahu** bën çkado që do të bëjë.’<sup>41</sup> Ai tha: ‘Zoti im, ma jep një shenjë.’ ‘Shenja jote’, tha [engjëlli], ‘është se nuk do të komunikosh me askë për tri ditë, pos me gjeste. Kujtoje Zotin tënd shpesh; festoje lavdinë E Tij në mbrëmje dhe në agim.’

<sup>42</sup> Dhe engjëjt i thanë Merjemes:

“Oj Merjeme! **Allahu** të ka zgjedhur  
dhe të bëri të pastër,  
të zgjodhi në mesin e grave  
të të gjitha kombeve.

<sup>43</sup> “Oj Merjeme, bindju Zotit tënd,  
përulu dhe përkulu në lutje  
bashkë me ata që luten rregullisht!”

<sup>44</sup> Ky është tregim i gjërave përtej njohurisë sate [Muhamed] që ta zbulojmë: nuk ishte i pranishëm ndër ta<sup>b</sup> kur hodhën short për ta parë se cili prej tyre duhet ta marrë përgjegjësinë e Merjemes, nuk ishte i pranishëm me ta kur u grindën [për të].

<sup>45</sup> Dhe engjëjt thanë:

“Oj Merjeme, **Allahu** të shpall lajm të mirë  
për një Fjalë nga Ai  
të quajtur Mesih (Mesia), Isa i biri i Merjemes,  
i nderuar në këtë botë  
dhe në të përtejmen,  
dhe në mesin e Të Afërmve Intimë të **Allahut**.”

---

<sup>a</sup> Vargu 45 më poshtë: Isait iu dha epiteti ‘Fjalë nga **Allahu**’. Një shpjegim është se kjo ishte kështu sepse ishte urdhri i **Allahut** që e solli atë në qenie, në vend se ndërhyrja e një babai njeri (Razi).

<sup>b</sup> Priftërinjtë

<sup>46</sup> Ai do t'u flasë njerëzve në fëmijëri<sup>a</sup> dhe në moshën e rritur. Do të jetë një nga të ndershmit.<sup>47</sup> Ajo tha: 'Zoti im, si mund të kem djalë kur asnjë burrë nuk më ka prekur?' [Engjëlli] tha: 'Kështu **Allahu** e krijon atë që do ta krijojë: kur Ai ka paracaktuar diçka, veç thotë: "Ji" dhe ajo është.

<sup>48</sup> 'Dhe **Allahu** do t'ia mësojë atij  
Librin dhe urtinë,  
Teuratin dhe Ungjillin'

<sup>49</sup> Ai do t'ua çojë atë si të dërguar Fëmijëve të Izraelit: "Kam ardhur te ju me një shenjë nga Zoti juaj: do ta bëj për ju formën e një shpendi nga balta, pastaj të fryj në të dhe, me lejen e **Allahut**, do të bëhet shpend i vërtetë; do ta shëroj të verbrin dhe lebrozin dhe do t'i kthej të vdekurit në jetë me lejen e **Allahut**; do t'ju tregoj se çka mund të hani dhe çka mund të ruani në shtëpitë tuaja.<sup>b</sup> Vërtet është një shenjë për ju në këtë, në qofshi besimtarë.<sup>3:50</sup> Kam ardhur ta konfirmoj të vërtetën e Teuratit që më parapriu dhe t'jua bëj të ligjshme ca gjëra që më parë ishin të ndaluara. Kam ardhur te ju me një shenjë nga Zoti juaj. Jini të vetëdijshëm për **Allahun**, bindmuni: <sup>51</sup> **Allahu** është Zoti im dhe Zoti juaj, pra shërbeni Atij – kjo është rruga e drejtë."'

<sup>52</sup> Kur Isai e kuptoi se [ende] nuk besuan, tha: 'Kush do të më ndihmojë në çështjen e **Allahut**?' Dishepujt thanë: 'Ne do të jemi ndihmës të **Allahut**; ne besojmë në **Allahun** – dëshmoje përkushtimin tonë ndaj Tij.<sup>53</sup> Zot, ne besojmë në atë që e ke shpallur dhe e ndjekim të dërguarin: na regjistro me ata që dëshmojnë [për Të Vërtetën]'.<sup>54</sup> [Mosbesimtarët] planifikuan fshehtas por edhe **Allahu** planifikoi fshehtas; **Allahu** është Më i Miri nga Planifikuesit e Fshehtë.

---

<sup>a</sup> Krahaso me 19:29-30. Fjala *mahd* domethënë një vend i zbutur për një fëmijë të vogël për të fjetur aty. Nuk është pjesë e mobiljeve si djep.

<sup>b</sup> Një përkthim tjetër i mundshëm është 'të ju tregoj se çka hani dhe çka ruani . . .'

<sup>55</sup> **Allahu** tha:

“Isa!

Unë do të të kthej prapa te Vetja,

dhe do të të ngris tek Unë

dhe do të të pastroj

nga mosmirënjohësit që nuk besojnë.

Dhe deri në Ditën e Ringjalljes

do t’i bëj ata që të ndjekin

superiorë mbi ata që nuk besuan.

Pastaj të gjithë do të ktheheni tek Unë,

dhe Unë do të gjykoj mes jush

për dallimet tuaja.

<sup>56</sup> Do t’i bëj mosbesimtarët të vuajnë ashpër në këtë botë dhe në tjetrën; askush nuk do t’i ndihmojë.” <sup>57</sup> **Allahu** do t’i paguajë ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira me shpërblimin e tyre të plotë; **Allahu** nuk i do keqbërësit.

<sup>58</sup> Ne ta tregojmë [ty Muhamed] këtë shpallje, një deklaratë vendimtare. <sup>59</sup> Në sytë e **Allahut** Isai është mu sikur Ademi: Ai e krijoi nga pluhuri, i tha: ‘Ji’ dhe ishte.

<sup>3:60</sup> Kjo është e vërteta nga Zoti yt,  
pra mos ji dyshues.

<sup>61</sup> Nëse dikush e kundërshton këtë me ty tani që të është dhënë kjo njohuri, thuaj: ‘Eja, t’i mbledhim bijtë tanë dhe bijtë tuaj, gratë tona dhe gratë tuaja, vetet tona dhe vetet tuaja dhe të lutemi me zell dhe ta thërrasim refuzimin e **Allahut** mbi ata nga ne që po gënjejnë.

<sup>62</sup> Vërtet, ky është rrëfimi i vërtetë;  
se nuk ka zot pos **Allahut**,  
dhe **Allahu** është sigurisht  
suprem në fuqi e urti.  
[I Lartësuar, Ai që Vendos<sup>a</sup>].’

---

<sup>a</sup> Ky përkthim i termit *hakim* sugjerohet nga Razi.

<sup>63</sup> Nëse largohen, [dije se] **Allahu** është fare mirë i informuar për këdo që bën korrupsion.<sup>a</sup> <sup>64</sup> Thuaj: ‘Njerëz të Librit, le të arrijmë te një deklaratë që është e përbashkët për të gjithë ne: e adhurojmë veç **Allahun**, nuk i bashkëngjisim asnjë partner dhe askush nga ne nuk merr për Zot të tjerë pos **Allahut**.’ Nëse largohen, thuaj: ‘Dëshmojeni përkushtimin tonë ndaj Tij.’

<sup>65</sup> Njerëz të Librit, pse grindeni për Ibrahimin kur Teurati dhe Ungjijtë nuk u shpallën deri pas kohës së tij? A nuk po kuptoni? <sup>66</sup> Grindeni për ca gjëra për të cilat keni ca njohuri, po pse grindeni për gjëra për të cilat nuk dini asgjë? **Allahu** di e ju jo. <sup>67</sup> Ibrahimin nuk ishte as çifut as i krishterë. Ishte i drejtë dhe i përkushtuar ndaj **Allahut**, kurrë idhujtar <sup>68</sup> dhe njerëzit që janë më së afërmi tij janë ata që vërtet i ndjekin rrugët e tij, këtë Profet dhe besimtarët [e vërtetë] – **Allahu** është afër besimtarëve [të vërtetë].

<sup>69</sup> Disa nga Njerëzit e Librit me shumë dëshirë do të donin t’ju devijojnë [juve besimtarëve], por e devijojnë veç veten, edhe pse nuk e kuptojnë. <sup>3:70</sup> Njerëz të Librit, pse i mohoni shpalljet e **Allahut** kur mund ta shihni se janë të vërteta? <sup>71</sup> Njerëz të Librit, pse e përzieni të vërtetën me gënjeshtren? Pse e fshihni të vërtetën kur e njihni? <sup>72</sup> Disa nga Njerëzit e Librit thonë: ‘Në fillim të ditës, besoni në atë që u është shpallur këtyre besimtarëve [myslimanëve], pastaj në fund të ditës refuzojeni, që edhe ata të mund të kthehen prapa, <sup>73</sup> por mos besoni sinqerisht në askë pos nëse ai e ndjek fenë tuaj’ – [Profet,] thuaju: ‘Udhëzimi i vërtetë është udhëzimi i **Allahut**’ – [ata thonë:] – ‘Mos besoni se dikujt tjetër do të mund t’i jepej shpallje e ngjashme me atë që ju është dhënë juve, apo se ata do të mund ta përdornin atë për të argumentuar kundër jush në praninë e Zotit tuaj.’ [Profet,] thuaju: ‘Gjithë mirësia është në duart e **Allahut**: Ai ia dhuron atë kujtdo që do t’ia dhurojë – Ai është gjithë-përfshirësi, i gjithë-dituri – <sup>74</sup> dhe Ai e veçon për mëshirën E Tij këdo që do ta veçojë. Mirësia e tij është e pafund.’

<sup>75</sup> Ka Njerëz të Librit që, nëse [ti Profet] ua beson një thes me ar, do të ta kthejnë të paprekur, por ka të tjerë nga ta që, nëse ua beson një dinar të vetëm, nuk do të ta kthejnë nëse nuk shkel mbi ta, se thonë: ‘Nuk kemi kurrfarë obligimi ndaj joçifutëve.’ Ata e thonë një gënjeshtër kundër **Allahut** dhe e dinë këtë. <sup>76</sup> Jo në fakt! **Allahu** i do ata që i mbajnë premtimet e tyre dhe janë të vetëdijshëm për Të, <sup>77</sup> por ata që e shesin besëlidhjen e **Allahut** dhe betimet e tyre për çmim të vogël nuk do të kenë hise në jetën e ardhshme. **Allahu** as s’do t’u flasë as s’do t’i shikojë në Ditën e Ringjalljes – Ai nuk do t’i pastrojë [nga mëkatet e tyre] – ata i pret torturë plot dhembje. <sup>78</sup> Janë disa që e shtrembërojnë Shkrimin e Shenjtë me gjuhët e tyre për t’ju bërë [juve njerëz] të mendoni se ajo që e thonë është pjesë e Shkrimit të Shenjtë kur nuk është; thonë se kjo është nga **Allahu** kur nuk është; i atribuojnë gënjeshtër **Allahut** dhe e dinë këtë.

---

<sup>a</sup> Korrupsion të besimeve dhe të gjitha ato që pasojnë nga ai.

79 Asnjë qenie njerëzore  
që **Allahu** ia kishte dhënë Librin  
dhe urtinë e profetësinë,  
nuk do t'u thoshte kurrë njerëzve:  
“Më jini shërbyes mua  
në vend të **Allahut**.”

Përkundrazi, do të thoshte:  
“Duhet të jeni të përkushtuar ndaj **Allahut**  
se ua keni mësuar Librin të tjerëve,  
dhe e keni studiuar me kujdes.

3:80 Dhe ai nuk do t'ju udhëzonte  
t'i merrnit engjëjt a profetët si zota;  
si do t'ju udhëzonte në mosbesim  
pasi t'i jeni përkushtuar **Allahut**?

<sup>81</sup> **Allahu** e mori një premtim nga profetët, duke thënë: ‘Nëse, pasi t’jua kem dhuruar Shkrimin e Shenjtë dhe urtinë, një i dërguar vjen duke e vërtetuar atë që ju është dhënë, duhet të besoni në të dhe ta përkrahni. A e pohoni këtë dhe a e pranoni premtimin Tim si obligues për ju?’ Ata thanë: ‘E pranojmë.’ Ai tha: ‘Atëherë jini dëshmitar dhe edhe Unë do të jem dëshmitar.’ <sup>82</sup> Ata që largohen pas kësaj janë ata që i shkelin premtimet. <sup>83</sup> A kërkojnë ata diçka tjetër përveç nënshtrimit ndaj **Allahut**? Të gjithë në qiej dhe në tokë i nënshtrohen Atij, me dëshirë a pa dëshirë; të gjithë do t'i kthejnë tek Ai.

84 Thuaj [Muhamed]:  
“Ne [myslimanët] besojmë në **Allahun**  
dhe në atë që na e zbriti Ai,  
dhe në atë që ia zbuloi Ibrahimit dhe Ismailit  
dhe Isakut dhe Jakubit dhe Fiseve,  
dhe në atë që u ishte dhënë  
Musait dhe Isait dhe Profetëve  
nga Zoti i tyre.  
Nuk bëjmë dallime ndërmjet  
individëve ndër ta;  
i përkushtohemi **Allahut**.”

<sup>85</sup> Nëse dikush kërkon fe tjetër përveç [islamit] përkushtimit të plotë ndaj **Allahut**, ajo nuk do t'i pranohet: ai do të jetë një nga humbësit në Të Përtejmen. <sup>86</sup> Pse do t'i udhëzonte **Allahu** njerëzit që e mohojnë të vërtetën, pasi kanë besuar dhe e kanë pranuar se I Dërguari është i vërtetë dhe pasi u janë treguar prova të qarta? **Allahu** nuk i udhëzon keqbërësit: <sup>87</sup> njerëzit e tillë do të shpërblehen me refuzim nga **Allahu**, nga engjëjt, nga tërë njerëzit, <sup>88</sup> dhe ashtu do të mbesin, pa asnjë lehtësim a pushim për vuajtjet e tyre. <sup>89</sup> Por jo ata që më pas pendohen dhe i rregullojnë rrugët e tyre – **Allahu** është më falësi dhe mëshirëploti – <sup>3:90</sup> [edhe pse] pendimi i atyre që, pasi besuan, pastaj e rrisin mosbesimin e tyre, nuk do të pranohet. Ata janë të tillët që kanë devijuar [larg]: <sup>91</sup> ata që nuk besojnë dhe vdesin mosbesimtarë nuk do të shpëtohen edhe nëse ofrojnë mjaft ar për ta mbushur tërë tokën. Ata i pret tortura me vuajtje dhe nuk do të ketë kush t'u ndihmojë. <sup>92</sup> Askush nga ju [besimtarë] nuk do ta arrijë përkushtimin e vërtetë pos nëse jepni nga ato që i doni fort: çkado që jepni, **Allahu** e di për të fare mirë.

<sup>93</sup> Përveç asaj që Izraeli e bëri të paligjshme për veten, të gjitha ushqimet ishin të ligjshme për Fëmijët e Izraelit para se të shpallej Teurati.<sup>a</sup> Thuaj: 'Silleni Teuratin dhe lexojeni me zë [pasazhin përkatës] nëse po e thoni të vërtetën. <sup>94</sup> Ata që vazhdojnë në trillimin e gënjeshtreve dhe atribuimin e tyre **Allahut** pas kësaj janë keqbërësit.' <sup>95</sup> [Profet,] thuaj: '**Allahu** e flet të vërtetën, pra ndiqeni fenë e Ibrahimit: ai kishte besim të vërtetë dhe nuk ishte kurrë idhujtar.' <sup>96</sup> E para Shtëpi [e adhurimit] që do të ndërtohej për njerëzit ishte ajo në Mekë.<sup>b</sup> Ajo është vend i bekuar; burim i udhëzimit për tërë njerëzit; <sup>97</sup> ka shenja të qarta në të; është vendi ku Ibrahimit qëndronte për t'u lutur; kushdo që hyn në të është i sigurt. Haxhi te Shtëpia është detyrë që ia kanë borxh **Allahut** njerëzit që janë të aftë ta ndërmarrin. Ata që e refuzojnë këtë [duhet ta dinë se] **Allahu** nuk ka nevojë për askë. <sup>98</sup> Thuaj: 'Njerëz të Librit, pse i refuzoni shpalljet e **Allahut**? **Allahu** është dëshmitar i gjithçkaje që e bëni.' <sup>99</sup> Thuaj: 'Njerëz të Librit, pse i largoni besimtarët nga rruga e **Allahut** dhe provoni ta dredhoni atë, kur ju vetë [duhet të jeni] dëshmitarë [të të vërtetës]? **Allahu** nuk është i pavëmendshëm për asgjë që bëni.'

<sup>3:100</sup> Ju që besoni, disa nga ata të cilëve iu dha Shkrimi i Shenjtë do t'ju shndërronin në mosbesimtarë po t'u dorëzoheshit. <sup>101</sup> Si mund të mos besoni kur po ju recitohen shpalljet e **Allahut** dhe I Dërguari I Tij po jeton mes jush? Kushdo që mbahet fort për **Allahun** do të udhëzohet në rrugën e drejtë.

---

<sup>a</sup> Komentuesit shpjegojnë se Izraeli/Jakubi (nipi i Ibrahimit) u zotua të heqë dorë nga mish i devesë dhe qumështi i devesë nëse do të çlirohej nga dhimbja e nervit shiatik dhe çifutët në Medinë i argumentuan Muhamedit: 'Ti pretendon se po e ndjek fenë e Ibrahimit. Po të ishte kështu ti nuk do të haje mish të devesë dhe ta pije qumështin e saj, meqë këto janë të ndaluara në fenë e Ibrahimit.' Ky varg i përgjigjet këtij argumenti (Razi).

<sup>b</sup> Në origjinal shkruan *Bakka*, që ishte emër i vjetër për Mekën.



- 102 Besimtarë plot besim!  
nderojeni **Allahun** me nderim të duhur,  
dhe mos vdisni  
pa nënshtrim të vetëdijshtëm ndaj **Allahut**.
- 103 Dhe mbahuni fort për litarin e **Allahut**,  
të gjithë ju,  
dhe mos u ndani.  
Dhe kujtojeni mirësinë e **Allahut** ndaj jush:  
se ishit armiq,  
dhe Ai jua bashkoi zemrat;  
dhe u bëtë vëllezër  
prej mirësisë së **Allahut**.  
Dhe ishit në buzë  
të një grope të Zjarrit,  
dhe Ai ju shpëtoi nga ajo.  
Kështu **Allahu** i bën të dukshme  
shenjat E Tij për ju,  
që të mund të udhëzoheni.
- 104 Dhe jini<sup>a</sup> bashkësi  
që thërret në të mirë  
dhe e urdhëron atë që është e denjë  
dhe e ndalon atë që është kundërshtuese;  
ata janë të lumturit [e të suksesshmit].
- 105 Dhe mos jini sikur ata  
që ndajnë dhe bëjnë dallime  
pasi u kanë ardhur qartësimet;  
se ata i pret torturë e tmerrshme.

<sup>106</sup> Në Ditën kur disa fytyra shkëlqejnë dhe të tjera errësohen, do t'u thuhet atyre me fytyra të errësuar: 'Si mund ta refuzonit besimin tuaj pas të besuarit? Shijojeni torturën se vepruat ashtu', <sup>107</sup> por ata me fytyra të shkëlqyera do të jenë

---

<sup>a</sup> Razi shpjegon se parafjala *min* në arabisht, e përkthyer zakonisht si 'le të ketë në mesin tuaj', këtu vlen për tërë bashkësinë, e jo vetëm për një pjesë të tij.

në mirësinë e **Allahut**, për të mbetur aty.<sup>108</sup> Këto janë shpalljet e **Allahut**: Ne t'i recitojmë [Profet] me Të Vërtetën. **Allahu** nuk do padrejtësi për krijesat E Tij.<sup>109</sup> Gjithçka në qiej dhe në tokë i përket **Allahut**; është Ai tek I Cili kthehen të gjitha gjërat.

<sup>3:110</sup> [Besimtarë,] ju jeni bashkësia më e mirë e veçuar për njerëzit: e urdhëroni atë që është e drejtë, e ndaloni atë që është e gabuar dhe besoni në **Allahun**. Nëse edhe Njerëzit e Librit do të besonin, do të kish qenë më mirë për ta. Se megjithëse disa nga ta besojnë, shumica nga ta janë shkelës të ligjit –<sup>111</sup> ata nuk do t'ju bëjnë shumë dëm: edhe nëse vijnë t'ju luftojnë, së shpejti do të kthehen e të ikin me frikë; nuk do të marrin kurrfarë ndihme –<sup>112</sup> dhe, nëse nuk mbahen fort te një litar i shpëtimit nga **Allahu** dhe nga njerëzimi, ata i errëson cenueshmëria kudo që të gjenden. Ata e kanë tërhequr zemërimin e **Allahut** mbi veten. I errëson edhe dobësia se vazhdimisht nuk kanë besuar në shpalljen e **Allahut** dhe kanë vrarë profetë pa asnjë të drejtë, vetëm e vetëm për shkak të mosbindjes së tyre dhe shkeljes së pakufishme morale.<sup>113</sup> Por nuk janë të gjithë njësoj. Janë disa nga Njerëzit e Librit që janë të drejtë, që i recitojnë shpalljet e **Allahut** gjatë natës, që përkulen në adhurim,<sup>114</sup> që besojnë në **Allahun** dhe në Ditën e Fundit, që e urdhërojnë atë që është e drejtë dhe e ndalojnë atë që është e gabuar, që janë të shpejtë për të bërë vepra të mira. Këta njerëz janë ndër të ndershmit<sup>115</sup> dhe nuk do të [u] refuzohen [shpërblimet] për çfarëdo vepra të mira që bëjnë: **Allahu** e di saktësisht se kush është i vetëdijshëm për Të.

<sup>116</sup> Sa për ata që nuk besojnë, as pasuritë e tyre as fëmijët e tyre nuk do t'u ndihmojnë kundër **Allahut** – ata do të jenë shokë në Zjarr, për të mbetur aty –<sup>117</sup> dhe çkado që dhurojnë në këtë jetë do të jetë pa vlerë; një erë e ftohtë i godet dhe i shkatërron të korrat e njerëzve që e kanë dëmtuar veten. Nuk ishte **Allahu** që i dëmtoi; ata e dëmtuan veten.

<sup>118</sup> Ju që besoni, mos u bëni të afërm intimë me të huaj të tillë që nuk e kursejnë asnjë përpjekje për t'ju shkatërruar dhe që duan t'ju shohin të vuani: urrejtja e tyre është e qartë nga gojët e tyre, por ajo që e fshehin zemrat e tyre është shumë më e keqe. Ne jua kemi bërë të qarta shpalljet Tona; a nuk do ta përdorni arsyen tuaj?<sup>119</sup> Ja si është kjo: ja ku jeni, i doni ata, por ata nuk ju duan; ju besoni në të gjitha Shkrimet e Shenjta dhe kur ata ju takojnë, thonë: 'Besojmë', por kur janë vetëm, i kafshojnë majat e gishtave në zemërim ndaj jush. [Profet,] thuaj: 'Vdisni nga tërbimi [nëse doni]!' **Allahu** e di saktësisht se çka ka në zemrat e secilit.<sup>3:120</sup> Ata hidhërohen për çdo të mirë që bie mbi ju [besimtarë] dhe gëzohen për fatkeqësitë tuaja. Por në qofshi të qëndrueshëm dhe të vetëdijshëm për **Allahun**, planifikimi i tyre i fshehtë nuk do t'ju dëmtojë aspak: **Allahu** rrethon gjithçka që bëjnë ata.

<sup>121</sup> [Profet,] kujtoje kur dole nga shtëpia jote në agim për t'i caktuar pozicionet e betejës për besimtarët: **Allahu** dëgjon dhe di gjithçka.<sup>122</sup> Kujtoje kur dy grupe

nga ju ishin afër ta humbnin besimin për sukses dhe **Allahu** i mbrojti – le ta mbështesin besimtarët besimin e tyre në **Allahun** – <sup>123</sup> **Allahu** ju ndihmoi në Bedër kur ishit të dobët. Jini të vetëdijshëm për **Allahun**, që të mund të jeni mirënjohës. <sup>124</sup> Kujtoje kur u the besimtarëve: ‘A do të jeni të kënaqur nëse Zoti juaj ju përforcon duke i zbritur tre mijë engjëj? <sup>125</sup> Epo, në qofshi të qëndrueshëm dhe të vetëdijshëm për **Allahun**, Zoti juaj do t’ju përforcojë me pesë mijë engjëj që sulmojnë shpejt nëse armiku do t’ju sulmonte befas!’ dhe **Allahu** e rregulloi ashtu, <sup>126</sup> si mesazh të shpresës për ju [besimtarë] që t’jua qetësojë zemrat – ndihma vjen veç nga **Allahu**, I Fuqishmi, I Urti – <sup>127</sup> dhe për t’i prishur krahët e ushtrisë së mosbesimtarëve dhe për t’i zhgënjyer, për t’i bërë të tërhiqen në humbje të plotë. <sup>128</sup> Nuk të takon [ty Profet] të vendosësh se a zbutet **Allahu** ndaj tyre apo i ndëshkon: ata janë keqbërës. <sup>129</sup> Gjithçka në qiej dhe në tokë i përket **Allahut**. Ai e fal këdo që do ta falë dhe e ndëshkon këdo që do ta ndëshkojë: **Allahu** është më falësi dhe mëshirëploti.

3:130      Besimtarë besnikë,  
mos merrni interes me fajde,  
të shumëzuar e të përbërë;  
dhe ruajuni nga **Allahu**,  
që të mund të përparoni.

<sup>131</sup> Ruajuni nga Zjarri i përgatitur për ata që [e] injorojnë [Atë] – <sup>132</sup> dhe bindjuni **Allahut** dhe Profetit që të mund t’ju jepet mëshirë.

<sup>133</sup>      Dhe shpejtoni kah falja  
nga Zoti juaj,  
dhe kah një Kopsht  
i gjerë sa qiejt dhe toka,  
i përgatitur për të ndershmit,

<sup>134</sup>      ata që janë zemërgjerë  
në kohë të mira e të këqija,  
dhe që e përmbajnë zemërimin,  
dhe që i falin njerëzit.  
Se **Allahu** i do ata që bëjnë mirë.

<sup>135</sup>      Dhe ata që e kujtojnë **Allahun**  
dhe kërkojnë falje për mëkatet e tyre

kur e kanë bërë një vepër të pandershme  
apo i kanë dëmtuar shpirtrat e tyre  
— dhe kush i fal mëkatet pos **Allahut**? –  
dhe që nuk e vazhdojnë me vetëdije gabimin që e kanë bërë.

136 Shpërblimi i tyre është falja nga Zoti i tyre,  
dhe Kopshte nën të cilat rrjedhin lumenj,  
duke qenë atje përherë:  
sa i këndshëm [e i shkëlqyeshëm]  
shpërblimi për ata që punojnë!

137 **Rrugët e Allahut** kanë kaluar para jush,  
pra udhëtoni nëpër tokë dhe shihni  
se si kanë përfunduar tallësit.

138 Ky është mësim i qartë për njerëzit dhe udhëzim e mësim për ata që janë të vetëdijshëm për **Allahun**.<sup>139</sup> Mos e humbni toruan apo të dëshpëroheni – në qofshi besimtarë të vërtetë keni më shumë fuqi se kushdo tjetër –<sup>3:140</sup> nëse e keni pësuar një goditje, edhe ata e kanë pësuar një si ajo.<sup>a</sup> Ne veçojmë ditë të tilla ndërmjet njerëzve njëri pas tjetrit, që **Allahu** ta zbulojë se kush beson vërtet, që t'i zgjedhë martirët<sup>b</sup> ndërmjet jush – **Allahu** nuk i do keqbërësit –<sup>141</sup> që t'i pastrojë ata që besojnë dhe që t'i shkatërrojë mosbesimtarët.<sup>142</sup> A mendonit se do të hynit në Kopsht pa e provuar së pari **Allahu** se cili nga ju do të mundohej për çështjen E Tij dhe të mbahej i qëndrueshëm?<sup>143</sup> Para se ta hasnit vdekjen, po shpresonit për të. Epo, tani e keni parë me sytë tuaj.

<sup>144</sup> Muhamedi është veç i dërguar para të cilit kanë qenë e kanë shkuar shumë të dërguar. Po të vdiste apo të vritej,<sup>c</sup> a do t'ju riktheheshit rrugëve tuaja të vjetra? Po ta bënte dikush këtë, nuk do ta dëmtonte **Allahun** aspak. **Allahu** do t'i shpërblejë mirënjohësit.<sup>145</sup> Asnjë shpirt nuk mund të vdesë përveç me lejen e **Allahut** në një kohë të paracaktuar. Nëse dikush përpiqet për shpërblimet e kësaj bote, Ne do t'ia japim disa nga to. Nëse dikush përpiqet për shpërblimet e Të Përtejmes, Ne do t'ia japim disa nga to: Ne do t'i shpërblejmë mirënjohësit.

---

<sup>a</sup> Kjo pjesë e sures i referohet Betejës së Uhud-it, ku myslimanët u patën mposhtur, pasi nuk iu patën bindur urdhrave të Profetit.

<sup>b</sup> Emri *shëhid* është shumë më i ndërlikuar sesa termi "martir" i zgjedhur për ta përkthyer në këtë kontekst. Rrënja *sh-h-d* e përçon kuptimin 'të dëshmosh, të jesh prezent, të marrësh pjesë', por edhe "të dëshmosh" ose "të japësh evidencë". Kështu, "martirët" këtu janë zgjedhur nga Zoti për ta dëshmuar Atë në qiell, u jepet mundësia të japin evidencë të thellësisë së besimit të tyre duke e sakrifikuar jetën e tyre të kësaj bote dhe do të dëshmojnë me profetët në Ditën e Gjykimit.

<sup>c</sup> Në betejën e Uhudit, përflitej se Muhamedi ishte vvarë.

<sup>146</sup> Shumë profetë kanë luftuar bashkë me grupe të mëdha të njerëzve hyjnorë përkrah tyre të cilët, përballë vuajtjeve të tyre për çështjen e **Allahut**, nuk e humbën toruan apo të dobësohen a të dorëzohen: **Allahu** i do ata që janë të qëndrueshëm. <sup>147</sup> Krejt çka thanë ishte: ‘Zoti ynë, na i fal mëkatet tona dhe teprimet tona. Na i bëj këmbët të qëndrueshme dhe na jep ndihmë kundër mosbesimtarëve’, <sup>148</sup> dhe kështu **Allahu** ua dha edhe shpërblimet e kësaj bote edhe shpërblimet e shkëlqyeshme të Të Përtejmes: **Allahu** i do ata që bëjnë mirë.

<sup>149</sup> Ju që besoni, nëse u bindeni mosbesimtarëve, do t’ju bëjnë t’u ktheheni rrugëve tuaja të vjetra dhe do të shndërroheni në humbës. <sup>3:150</sup> Jo në fakt! Është **Allahu** Ai që është mbrojtësi juaj: Ai është më i miri nga ndihmuesit. <sup>151</sup> Ne do t’i godasim me panik zemrat e mosbesimtarëve se i atribuojnë partnerë **Allahut** edhe pse Ai nuk ka dërguar asnjë autoritet për këtë: strehimi i tyre do të jetë Zjarri – sa e mjerueshme është shtëpia e njerëzve të këqij! <sup>152</sup> **Allahu** e përmbushi premtimin E Tij ndaj jush: ju po i bënit ata të tërhiqen në panik, me lejen E Tij, por pastaj u ligështuat, e kontestuat urdhrin dhe nuk u bindët, posa Ai ju solli brenda pamjes së qëllimit tuaj<sup>a</sup> – disa nga ju i kanë merak fitimet e kësaj bote dhe të tjerët e kanë merak botën tjetër – dhe pastaj Ai ju pengoi nga [ajo që t’i mundnit] ata si ndëshkim. Ai ju ka falur tash: **Allahu** është më dashamirësi për besimtarët. <sup>153</sup> Ju ikët pa e kthyer kokën gjersa I Dërguari po ju thërriste nga pas dhe **Allahu** ju shpërbleu me pikëllim për pikëllimin. [Ai tani ju ka falur] që të mund të mos hidhëroheni për atë që e humbët apo për atë që ju ndodhi. **Allahu** është fare mirë i informuar për gjithçka që bëni. <sup>154</sup> Pas pikëllimit, Ai bëri që qetësia të zbresë në ju, një gjumë që i pushtoi disa nga ju.

Një grup tjetër, të interesuar veç për veten, sollën nëpër mendje mendime të rrejshme për **Allahun**, mendime më të përshtatshme për injorancën pagane dhe thanë: ‘A na dëgjohet fjala neve fare në këtë?’ [Profet,] thuaju: ‘Gjithçka në lidhje me këtë çështje është në duart e **Allahut**.’ Ata fshehin në zemrat e tyre gjëra që nuk do t’jua zbulojnë. Thonë: ‘Po të na dëgjohej fjala neve, askush nga ne nuk do të vritej këtu.’ Tregoj: ‘Edhe po të kishit vendosur të qëndronit në shtëpi, ata që ishin destinuar të vriten do të dilnin prapë për t’i takuar vdekjet e tyre.’ **Allahu** e bëri këtë në mënyrë që të sprovonte gjithçka brenda jush dhe në mënyrë që ta vërtetonte se çka ka në zemrat tuaja. **Allahu** i di fare mirë mendimet tuaja më të brendshme. <sup>155</sup> Sa për ata nga ju që u tërhoqën në ditën kur dy ushtritë u takuan në betejë, ishte Satani që i bëri të rrëshqasin, përmes disa veprimeve të tyre. **Allahu** tash i ka falur ata: **Allahu** është më falësi dhe më i buti.

<sup>156</sup> Ju që besoni, mos jini si ata që nuk besuan dhe thanë për vëllezërit e tyre që u nisën në udhëtim apo sulm: ‘Ah po të rrinin me ne, nuk do të vdisnin apo të

---

<sup>a</sup> Shigjetarët nuk iu bindën urdhrin të Profetit për të qëndruar në pozicionet e tyre deri në fund. Ata menduan se myslimanët kishin fituar dhe u turrën për ta marrë prenë. Kjo u lejoi armiqve të tyre të riorganizohen dhe të sulmojnë, duke e fituar kështu betejën.

vriteshin', se **Allahu** do t'i bëjë mendimet e tilla burim të ankthit në zemrat e tyre. Është **Allahu** Ai që jep jetë dhe vdekje; **Allahu** sheh gjithçka që bëni. <sup>157</sup> Qoftë nëse vriteni për çështjen e **Allahut**, apo vdisni, falja dhe mëshira e **Allahut** janë më të mira se çkado që grumbullojnë njerëzit. <sup>158</sup> Qoftë nëse vdisni apo vriteni, është **Allahu** Ai tek I Cili do t'ju mbledhin.

<sup>159</sup> Përmes një veprimi të mëshirës nga **Allahu**, [ti Profet] ishe i butë kur u more me ta – po të ishe i ashpër a zemërgur, do të shpërndareshin dhe do të të linin – pra fali dhe kërko [nga **Allahu**] të falen. Këshillohu me ta për çështjet, pastaj, kur të kesh vendosur për drejtimin e veprimit, mbështete besimin tënd në **Allahun**: **Allahu** i do ata që e mbështesin besimin e tyre në Të.

<sup>3:160</sup> [Besimtarë,] nëse **Allahu** ju ndihmon,  
askush s'mund t'ju mposhtë;  
dhe nëse **Allahu** ju braktis,  
kush mund t'ju ndihmojë pastaj?  
Pra le ta kenë besimtarët besimin në **Allahun**.

<sup>161</sup> Është e paimagjinueshme që një profet do të merrte ndonjëherë diçka nga fitimet e betejës në mënyrë të pandershme. Kushdo që bën kështu do ta bartë atë me vete në Ditën e Ringjalljes, kur secili shpirt do të shpaguhet plotësisht për atë që e ka bërë: askush nuk do të dëmtohet. <sup>162</sup> A mundet njeriu që e ndjek kënaqësinë e **Allahut** të jetë si njeriu që e ka sjellë zemërimin e **Allahut** mbi veten dhe shtëpia e të cilit do të jetë Ferri – destinacion i keq? <sup>163</sup> Ata janë në klasë tjetër në sytë e **Allahut**; **Allahu** e sheh saktësisht atë që e bëjnë.

<sup>164</sup> **Allahu** ka qenë vërtet dashamirës ndaj besimtarëve duke ua çuar një Të Dërguar nga njerëzit e tyre, që t'ua recitojë shpalljet E Tij, t'i bëjë të jenë gjithnjë e më të pastër dhe t'ua mësojë Shkrimin e Shenjtë dhe urtinë – para kësaj ishin qartë të devijuar. <sup>165</sup> Pse [ju besimtarë] thoni, kur ju ndodh një fatkeqësi, madje edhe pasi ta keni bërë dyfishin e atij dëmi [në armikun tuaj]: 'Si ndodhi kjo?' ? [Profet,] thuaj: 'Ja sollët vetes!' **Allahu** ka pushtet mbi gjithçka: <sup>166</sup> ajo që ju ndodhi në ditën kur dy ushtritë u takuan në betejë ndodhi me lejen e **Allahut** dhe që ta shohë se kush ishin besimtarët e vërtetë dhe kush ishin hipokritët që, <sup>167</sup> kur u ishte thënë: 'Ejani, luftoni për çështjen e **Allahut**, apo të paktën mbrohuni', u përgjigjën: 'Ne do të të ndiqnim po ta dinim se do të kishte luftime.' Në atë ditë ata ishin më afër mosbesimit se sa besimit. Ata e thonë me gjuhët e tyre atë që nuk është në zemrat e tyre: **Allahu** e di saktësisht se çka fshehin.

<sup>168</sup> Sa për ata që ndenjën prapa dhe u thanë vëllezërve të tyre: 'Ah po të na dëgjonin, nuk do të vriteshin', thuaju [Profet]: 'Largojeni vdekjen nga vetja, në

qoftë e vërtetë ajo që e thoni.’<sup>169</sup> [Profet,] mos i mendo si të vdekur ata që janë vrarë në rrugën e **Allahut**. Ata janë të gjallë me Zotin e tyre, të furnizuar mirë,<sup>3:170</sup> të lumtur me atë që **Allahu** ua ka dhënë nga mirësia E Tij; duke u gëzuar se për ata që i kanë lënë prapa e që do t’u bashkohen në ndërkohë nuk ka frikë, as s’do të pikëllohen; <sup>171</sup> [duke u gëzuar] në bekimin dhe mirësinë e **Allahut** dhe se **Allahu** nuk do të lejojë që shpërblimi i besimtarëve të humbet. <sup>172</sup> Ata që iu përgjigjën **Allahut** dhe Të Dërguarit pasi pësuan disfatë, që bëjnë mirë dhe mbahen të vetëdijshëm për **Allahun**, do të kenë shpërblim të madh. <sup>173</sup> Ata besimi i të cilëve veçse u rrit kur njerëzit thanë: ‘Frikësojuni armikut tuaj: ata e kanë grumbulluar një ushtri të madhe kundër jush’ dhe që u përgjigjën: ‘**Allahu** është i mjaftueshëm për ne: Ai është mbrojtësi më i mirë’, <sup>174</sup> u kthyen me dhunti e mirësi prej **Allahut**; asnjë dëm nuk u ndodhi. Ata e ndoqën kënaqësinë e mirë të **Allahut**. Mirësia e **Allahut** është vërtet e madhe. <sup>175</sup> Është Satani ai që ju nxit t’i frikësoheni ndjekësve të tij; mos iu frikësoni atyre, por m’u frikësoni Mua, në qofshi besimtarë të vërtetë.

<sup>176</sup> [Profet,] mos u hidhëro me ata që nxitojnë për të mos besuar. Nuk do ta dëmtojnë **Allahun** aspak; është vullnet i **Allahut** që nuk do të kenë hise në Të Përtejmen – i pret një torturë e tmerrshme. <sup>177</sup> Ata që e shesin besimin e tyre për mosbesim nuk do ta dëmtojnë **Allahun** në asnjë mënyrë; i pret torturë plot dhembje. <sup>178</sup> Mosbesimtarët nuk duhet të mendojnë se për ta është më mirë që Ne t’u japim më shumë kohë: kur u japim më shumë kohë bëhen më mëkatarë – i pret një torturë turpëruese. <sup>179</sup> As nuk ishte qëllimi i **Allahut** t’ju linte siç ishit, pa ndarje ndërmjet të keqes dhe të mirës.<sup>a</sup> **Allahu** nuk do t’ju tregonte [juve njerëz] se çka është e fshehur; **Allahu** i zgjedh si të dërguar Të Tij cilëndo që do t’i zgjedhë. Pra besoni në **Allahun** dhe të dërguarit E Tij: nëse besoni dhe mbeteni të vetëdijshëm për **Allahun**, do të keni shpërblim të madh. <sup>3:180</sup> Ata që janë dorështrënguar me atë që **Allahu** ua ka dhuruar nga mirësia E Tij nuk duhet të mendojnë se ajo është mirë për ta; përkundrazi, është keq për ta. Çkado që e ndalin do të jetë e varur poshtërsisht rreth qafave të tyre në Ditën e Ringjalljes. Është **Allahu** Ai që do t’i trashëgojë qiejt dhe tokën: **Allahu** është fare mirë i informuar për gjithçka që bëni.

<sup>181</sup> Sigurisht që **Allahu** i ka dëgjuar fjalët e atyre që tallen: ‘Pra **Allahu** është i varfër, gjersa ne jemi të pasur’.<sup>b</sup> Ne do të regjistrojmë gjithçka që thonë – si dhe vrasjen e tyre të profetëve në kundërshtim me gjithçka që është e drejtë – dhe do t’u themi: ‘Shijojeni torturën e zjarrit djegës. <sup>182</sup> Kjo është për shkak të asaj që e keni rezervuar për veten me duart tuaja: **Allahu** nuk është kurrë i padrejtë ndaj shërbyesve Të Tij.’<sup>183</sup> Atyre që thonë: ‘**Allahu** na ka urdhëruar të mos besojmë në asnjë të dërguar pos nëse na e sjell një ofertë që zjarri [nga parajsja] e konsumon’,

---

<sup>a</sup> Me hipokritët që i përziënin ato (Razi). Shih vargjet 166-7.

<sup>b</sup> Një përgjigje për 2:245, që u citua shpesh nga Profeti kur kërkonte kontribute financiare për çështjen (kauzën).

thuaju [Profet]: ‘Të dërguarit para meje ju kanë ardhur me shenja të qarta, duke e përfshirë edhe atë person që po e përmendni. Në qofshi të sinqertë, pse i keni vrarë ata?’<sup>184</sup> Nëse të refuzojnë, po kështu janë refuzuar edhe të dërguarit tjerë para teje, edhe pse erdhën me dëshmi të qartë, libra me urti dhe shkrim të shenjtë ndriçues.<sup>185</sup> Secili shpirt do ta shijojë vdekjen dhe ju do të shpaguheni plotësisht veç në Ditën e Ringjalljes. Kushdo që mbahet larg Zjarrit dhe pranohet në Kopsht do të ketë triumfuar. Bota e tanishme është veç një kënaqësi iluzore:

<sup>186</sup> sigurisht që do të sprovoheni  
në pasuritë tuaja dhe në veten tuaj;  
dhe sigurisht që do të dëgjoni shumë fyerje  
nga ata të cilëve Libri u ishte dhënë para jush,  
dhe nga ata që i idhullizojnë gjërat.  
Por në qofshi të durueshëm  
dhe të ndërgjegjshëm,  
atëherë kjo është vendosmëria  
që do t’i zgjidhë çështjet.

<sup>187</sup> **Allahu** mori zotim nga ata të cilëve iu dha Shkrimi i Shenjtë – ‘Bëjeni atë të njohur për njerëzit; mos e fshihni’ – por ata e hodhën zotimin e tyre pas shpine, e shkëmbyen për çmim të vogël: çfarë pazari të keq që bënë!

<sup>188</sup> [Profet,] mos supozo për ata  
që gëzohen për atë që e kanë shkaktuar  
dhe që duan t’i lavdërojnë për atë që nuk e kanë bërë,  
mos supozo  
që i kanë ikur torturës;  
se i pret një ndëshkim i dhembshëm.

<sup>189</sup> **Allahut** i takon sundimi  
mbi qiejt dhe tokën,  
dhe **Allahu** ka pushtet mbi gjithçka.

<sup>3:190</sup> Vërtet në krijimin  
e qiejve dhe të tokës,  
dhe në ndërrimin e natës dhe ditës  
ka shenja për ata me zemër,



<sup>191</sup> që e kujtojnë **Allahun**  
gjersa janë në këmbë, ulur dhe në prehje,  
dhe meditojnë për krijimin  
e qiejve dhe të tokës:  
'Zoti ynë,  
Ti nuk e ke krijuar këtë kot.  
Lavdí Ty!  
Na mbaj të sigurt  
nga tortura e Zjarrit.'

<sup>192</sup> 'Zoti ynë! Ti vërtet do t'i poshtërosh ata që i dërgon te Zjarri. Keqbërësit nuk e kanë askë t'u ndihmojë. <sup>193</sup> Zoti ynë! E kemi dëgjuar dikë duke na thirrur në besim – "Besoni në Zotin tuaj" – dhe kemi besuar. Zoti ynë! Na i fal mëkatet tona, na i shlyej veprat tona të këqija dhe na e mundëso t'u bashkohemi të ndershmeve kur të vdesim. <sup>194</sup> Zoti ynë! Lëshoji mbi ne të gjitha ato që na i ke premtuar përmes të dërguarve Tu – mos na poshtëro në Ditën e Ringjalljes – Ti nuk e shkel kurrë premtimin Tënd.'

<sup>195</sup> Dhe Zoti i tyre iu përgjigj:  
"Unë sigurisht nuk e anashkaloj  
punën e asnjë punëtori midis jush,  
qoftë mashkull a femër:  
ju vini nga njëri-tjetri  
[secili është si tjetri në shpërblime].  
Dhe sa për ata që kanë ikur  
apo janë dëbuar nga shtëpitë e tyre  
apo janë lënduar në çështjen Time,  
apo kanë luftuar a janë vrarë,  
Unë sigurisht që do t'ua shlyej mëkatet e tyre  
dhe do t'i fus në Kopshte  
nën të cilat rrjedhin lumenj  
si shpërblim  
nga prezenca e **Allahut**  
dhe në prezencën e **Allahut**

është më i miri nga shpërblimet.”

<sup>196</sup> [Profet,] mos u mashtro nga tregtia [fitimprurëse] e mosbesimtarëve andej-këndej nëpër tokë: <sup>197</sup> kjo është veç një kënaqësi e shkurtër, pas të cilës Ferri do të jetë shtëpia e tyre – vend i mjerueshëm i qëndrimit! <sup>198</sup> Por ata që ishin të vetëdijshëm për Zotin e tyre do të kenë Kopshte të hijeshuara me lumenj rrjedhës ku do të rrinë si shpërblim nga **Allahu**. Ajo që e ka **Allahu** është më e mira për ata që janë vërtet të mirë.

<sup>199</sup> Dhe ka në fakt  
ndër njerëzit e Librit  
asi që besojnë në **Allahun**  
dhe në atë që ju është zbritur juve  
dhe në atë që u është zbritur atyre,  
asi që janë të përlulur ndaj **Allahut**:  
ata nuk i shesin shenjat e **Allahut**  
për një çmim të vockël.  
Ata e kanë shpërblimin e tyre me Zotin e tyre;  
dhe **Allahu** është i shpejtë në llogari.

<sup>3:200</sup> Besimtarë,  
jini të durueshëm dhe ngulmoni  
dhe jini të fortë, të qëndrueshëm e të gatshëm:<sup>a</sup>  
dhe jini gjithmonë të vetëdijshëm për **Allahun**,  
që të mund të përparoni të lumtur.

---

<sup>a</sup> ‘Për lutje’ apo ‘t’i kundërviheni një sulmi’.

### **Përshkrimi para kaptinës 3 nga Abdel Haleem:**

*Sure medinase që e merr titullin nga familja e Imranit që përmendet në vargun 33. Fillon duke theksuar se Kurani i vërteton shkrimet e shenjta të mëhershme dhe vazhdon të thotë më vonë se parimi qendror i besimit është përkushtimi ndaj **Allahut** (vargjet 19-20). Rrëfimi i Zekirjasë, Merjemes dhe Isait jepet në vargjet 35-64 dhe theksohet fakti se Isai ishte pa baba, siç ishte krijuar edhe Ademi pa baba. Përshkruhen aspekte të betejave të Bedrit dhe Uhudit, veçanërisht kjo e fundit, ku myslimanët nuk iu bindën Profetit dhe u mundën. Surja së pari e dokumenton tensionin që u shfaq ndërmjet myslimanëve dhe disa nga çifutët dhe të krishterët (vargjet 65-85 dhe 98-101), pasaj përmbillet duke e theksuar unitetin e besimit dhe sjelljen ndërmjet myslimanëve dhe disa nga këta Njerëz të Librit, duke shpjeguar se këta do ta kenë shpërblimin e tyre nga **Allahu** (vargu 199).*

### **Shënimet gjuhësore (Thomas Cleary)**

*Familja e Imraan-it ( `Aal-i !Imraan)*

Kjo sure u shpall në Medinë. Imrani ishte i ati i profetit Musa; kjo sure e ndjek fillin e traditës profetike dhe mësimet thelbësore të saj.

- 2 “Gjithmonë-jetuesi” (“Vetë-mirëmbajtësi”, al Qayyuum): apo “I Përhershmi.” Ky është një nga epitetet e Zotit dhe është një intensiv që nxirret nga rrënja Q-W-M, me kuptimet thelbësore të mbetesh duke qëndruar, të jesh, të ekzistosh. Ky epitete shkon çift përsosmërisht me *al Hayy*, Jetuesi.
- 3 “Kriteri” (*Al Furqaan*): Ky është një emër i Kuranit, veçanërisht në funksionin e tij të dallimit të të vërtetës origjinale nga shtesat e rreme në shpalljet e mëhershme ndërsa kishin zbritur përgjatë historisë. Emri nxirret nga rrënja F-R-Q, që nis me kuptimet themelore të: të shkëputësh apo të ndash, pra të bësh dallim, të diferencosh, të dallosh.
- 7 Kërkimi i interpretimit subjektiv të paqartësive nuk refuzohet, me sa duket, si kërkim i diturisë në vete, por refuzohet kur shkalla e interpretimit e përfshin projektimin e paragjytimeve dhe përpjekjeve për ta minimizuar pajtimin dhe për të shkaktuar ndarje.

18 Vetë E Vërteta Absolute, Reali, e dëshmon, apo e vërteton veten, unikalitetin E Tij.

19 Ky varg i përshkruan ata nxënia e të cilëve i bën ata mendjemëdhenj para njerëzve në vend se të përlur para Zotit dhe ata që arrijnë në gjendjen t'i vlerësojnë idetë dhe opinionet e tyre më shumë se vetë të vërtetën.

“Zoti është vërtet i shpejtë në shqyrtim të fakteve”: Velloja e mendjes refuzuese është e menjëhershme në veprimin dhe qëndrimin e vetë refuzimit; pasojat vazhdojnë nga aty.

30 Kur bie velloja e falsitetit, E Vërteta është e vetëkuptueshme.

42 Kjo përzgjedhje e paraqet një përmbledhje elegante të misionit të Isait. Sipas Ungjillit të Merjemes, nëna e Isait ishte pasardhëse e një familjeje priftërore prejardhja e të cilës gjurmohet prapa deri te Imraani, babai i Musait dhe Harunit. Bijë e vetme e një prifti pa djem, Merjemja ishte virgjëreshë e tempullit; ajo dhe veçanërisht Isai janë figura të rëndësishme në Kuran.

45 Kurani i referohet Isait si Logosi dhe Mesia dhe po ashtu Shpirt (apo Frymë) nga Zoti. “Të Afërmit Intimë” janë ata që janë më së afërmi Zotit.

60 Domethënë, shpallja hyjnore nuk është trillim njerëzor dhe nuk mund të trajtohet si duhet në mënyrën e njëjtë si idetë e trilluara nga njerëzit.

79-80 Diku tjetër në Kuran, Isai pyetet nga Zoti se a u tha ai njerëzve ta adhuronin atë në vend të Zotit. Engjëjt janë pyetur ngjashëm dhe po kështu të gjithë profetët, si dhe kushdo te i cili ka arritur njohuria.

“Nuk i takon një qenieje njerëzore . . .”: Nuk është privilegji i duhur i një profeti (që mbetet qenie njerëzore përkundër gjendjes së lartë të profetësisë) të presë apo të kërkojë që ta adhurojnë.

“Përkundrazi, jini të edukuar në ligjin hyjnor” (*kuunuu rabbaaniyiina*): Të dërguarit ose mësuesit e ligjit hyjnor, apo të diturisë së hyjnores, duhet vetë të jenë ndjekës të hyjnores, jo pretendues të hyjnoritetit.

“ai nuk do t’ju udhëzonte t’i merrnit engjëjt a profetët si Zot”: Një profet besnik ndaj besimit të Zotit nuk do të ndërfaqte objekte të tjera të adhurimit, goftë personi i një profeti apo qeniet subtile. Mësimi budist thotë ngjashëm: “Mbështetu në të vërtetën, jo në personalitet” (sutra Mahaparinirvana).

Teologu mysliman Al-Ghazali gjithashtu shkroi: “Gjykoji njerëzit sipas të vërtetës, e jo të vërtetën sipas njerëzve” (*Kitaab al !Ilm*, “Libri i Diturisë”).

105 “ata që ndajnë dhe bëjnë dallime pasi u kanë ardhur qartësimet”: Kjo i referohet Kuranit në funksionin e tij të qartësimit të shpalljeve të mëhershme.

137 Kurani vazhdimisht i nxit njerëzit ta studiojnë historinë e botës për t’i vëzhguar pasojat e qëndrimeve të ndryshme ndaj jetës.

186 “Sigurisht që do të sprovoheni në pronat tuaja dhe në veten tuaj”: Pasuritë tona dhe vetet tona janë teste, apo prova, për ta përcaktuar se si do t’i përdorim dhuratat që na janë dhënë, që janë tonat si hua. Fjala për provë është *balaa*, që domethënë të provosh, të vërtetosh, të përjetosh. Pasuritë tona dhe vetet tona janë prova se si i menaxhojmë ato; ne pashmangshëm kalojmë nëpër ngritje e ulje në begatitë tona materiale e psikologjike dhe kurrë nuk i kemi të gjitha plotësisht sipas mënyrës sonë. Në të gjitha këto aspekte ne sigurisht që do të sprovohemi. Ekziston edhe mesazhi specifik për myslimanët e hershëm se bashkësia e re sigurisht do të sulmohej, edhe fizikisht edhe psikologjikisht, nga konzervatorët xhelozë të rendeve më të vjetra hyjnore, si dhe nga materialistët që ishin të kërcënuar nga mesazhi i Zotit në lidhje me natyrën dhe statusin e gjërave të kësaj bote. Ky nivel i interpretimit të fragmentit do të mund të merrej edhe si përshkrim i përgjithshëm i ngjarjeve tipike që e shoqërojnë çdo reformë shoqërore.

“sigurisht që do të dëgjoni shumë fyerje”: E adresuar për myslimanët e hershëm, kjo gjithashtu i referohet përsëri përgjithësisht posesivitetit dhe xhelozisë në fe, apo konzervatorizmit automatik në çështjet e diturisë dhe të kulturës.

“kjo është vendosmëria që do t’i zgjidhë çështjet” (*inna dhaa-lika min !azmi l’umuur*): Durimi dhe nderimi i ndërgjegjshëm ndaj Zotit e përbëjnë vendosmërinë (*!azm*) që i zgjidh (*!azama*) çështjet (*al’umuur*) se këto fuqi shpirtërore u qëndrojnë dhe kështu i tejkalojnë sprovat materiale dhe fizike.

190 “ata me zemër” (*‘uuluu l’albaab*): Fjala *‘albaab* është shumësi i *lubb*, që domethënë zemra, të kuptuarit, intelekti, mendja, arsyeja. Është po ashtu interesant të vërejmë se *lubb* me shumësin *lubuub* domethënë bërthama, palca, thelbi, esenca, më e brendshmja.

195 “ju vini nga njëri-tjetri”: Sipas Jalaalayn-it, kjo domethënë se burrat vijnë nga gratë dhe anasjelltas; dhe se burrat dhe gratë janë të barabartë në lidhje

*Kurani i shqipëruar*

me të drejtën e kompensimit për punë si dhe me obligimin për ta shmangur shpenzimin pa hesap e më kot të fitimeve të tyre.

## 4: Gratë (EN-NISÂ')

Në emrin e **Allahut**, Dashmirësit, Mëshirëplotit

- <sup>1</sup> O njerëzim,  
jini të vetëdijshëm për Zotin tuaj  
që ju krijoi nga një shpirt  
dhe e krijoi bashkëshorten e tij nga ai<sup>a</sup> [shpirt]  
dhe nga këta dy  
shpërndau shumë burra e gra.  
Jini të vetëdijshëm për **Allahun**  
nga I Cili e kërkoni njëri-tjetrin,  
dhe jini nderues ndaj lidhjeve njerëzore;<sup>b</sup>  
se **Allahu** po ju vëzhgon.
- <sup>2</sup> Dhe jepjuani jetimëve pasurinë e tyre  
pa e shkëmbyer të mirën [e tyre] me të keqe  
as pa ua shpenzuar pasurinë  
të përzier me tuajën,  
se kjo është keqbërje e rëndë.
- <sup>3</sup> Dhe nëse keni frikë  
se mund të mos jeni në gjendje  
të bëni drejtësi për vajzat jetime,<sup>c</sup>  
atëherë martohuni me gra [të tjera] që ju pëlqejnë,  
dy, tri, apo katër;  
por nëse keni frikë  
se mund të mos jeni në gjendje  
t'i trajtoni ato barabarësisht,  
atëherë martohuni me një,  
apo me një vajzë nën kujdestarinë tuaj:<sup>d</sup>

---

<sup>a</sup> 'Nga esenca e njëjtë'. Razi arriti në këtë përfundim në mënyrë bindëse duke u bazuar në krahasimin me shumë raste kur përdoret *min anfusikum* në Kuran.

<sup>b</sup> Fjalë për fjalë 'lidhjet e mitrës', d.m.th. të gjithë ata me të cilët keni lidhje familjare. Kjo shprehje shfaqet përsëri në 47:22.

<sup>c</sup> Në Arabinë para-islamike, disa kujdestarë të vajzave jetime martoheshin me to me qëllim që t'ua merrnin pasurinë (shih 4:127).

<sup>d</sup> Fjalë për fjalë: 'çka posedon dora juaj e djathtë'.

kjo do të ishte më e përshtatshme,  
që ta shmangni animin.

- 4 Dhe jepjuani grave  
dhuratat e tyre për nuse;  
por nëse ju nderojnë  
me diçka nga ajo  
me pajtimin e tyre,  
atëherë shijojeni atë  
si të shëndetshme dhe që ju bën mirë.

- 5 Dhe mos ua jepni të paaftëve mendorë  
pasurinë tuaj që **Allahu** jua ka dhënë për jetesë,  
por furnizoni ata nga ajo dhe vishni ata,  
dhe foljuni fjalë të këndshme.

- 6 Dhe sprovoni jetimët  
deri kur ta arrijnë moshën e martesës  
dhe nëse e perceptoni në ta  
integritetin dhe arsyen,  
atëherë dorëzojuani pasuritë e tyre.  
Dhe mos e shpenzoni atë me tepri,  
a me nxitim para pjekurisë së tyre.  
Dhe ai që është i pasur  
le të mos marrë asgjë nga ajo,  
dhe ai që është i varfër  
le të marrë nga ajo në mënyrë të drejtë.  
Dhe pastaj kur t'ua dorëzoni  
pasurinë e tyre,  
kini dëshmi apo dëshmitar të kësaj,  
megjithëse **Allahu** është i mjaftueshëm  
në shqyrtimin e fakteve.<sup>a</sup>

---

<sup>a</sup> *kaffa bi* këtu përdoret në mënyrë idiomatike.



- 7 Është një hise për meshkujt  
nga ajo që mbetet nga prindërit dhe farefisi më i afërt,  
dhe është një hise për femrat  
nga ajo që mbetet nga prindërit dhe farefisi më i afërt:  
qoftë pati pak apo shumë,  
është një pjesë e përcaktuar.
- 8 Dhe kur të afërmit, jetimët, apo të varfrit  
janë të pranishëm kur bëhet ndarja,  
jepjuni diçka nga ajo,  
dhe flisjuni fjalë të këndshme.
- 9 Dhe jini po aq të shqetësuar sa ata  
që pas vetes lënë fëmijë të pafuqishëm e që frikësohen për ta;  
dhe jini të vëmendshëm për **Allahun**,  
dhe flisni me ta për drejtësi.
- 4:10 Se sigurisht ata që e shpenzojnë  
padrejtësisht pasurinë e jetimëve  
përpijnë veç zjarr;  
dhe do të jenë duke u djegur  
në një flakë të tërbuar.

<sup>11</sup> Në lidhje me fëmijët tuaj, **Allahu** ju urdhëron që një djalë duhet ta ketë hisen e barasvlershme të dy vajzave. Nëse ka veç vajza, dy apo më shumë duhet t'i ndajnë dy-të-tretat e trashëgimisë, e nëse një, ajo duhet ta ketë gjysmën. Prindërit e trashëgojnë nga një të gjashtën secili nëse i ndjeri lë fëmijë; nëse ai nuk lë fëmijë dhe prindërit e tij janë trashëgimtarët e vetëm, nëna e tij e ka një-të-tretën, pos nëse ai ka vëllezër, me ç'rast ajo e ka një të gjashtën. [Në të gjitha rastet, shpërndarja vjen] pas pagesës së testamenteve apo borxheve. Nuk mund ta dini se cili nga prindërit apo fëmijët tuaj është më i dobishëm për ju: ky është ligj nga **Allahu** dhe Ai është i gjithë-dijshëm, i gjithë-urtë. <sup>12</sup> Ju e trashëgoni gjysmën e asaj që e lënë gratë tuaja, nëse ato nuk kanë fëmijë; nëse kanë fëmijë, e trashëgoni një çerek. [Në të gjitha rastet, shpërndarja vjen] pas pagesës së testamenteve apo borxheve. Nëse nuk keni fëmijë, hisja e grave tuaja është një çerek; nëse keni fëmijë, gratë tuaja e marrin një-të-tetën. [Në të gjitha rastet, shpërndarja vjen] pas pagesës së testamenteve apo borxheve. Nëse një burrë apo grua vdes pa lënë fëmijë apo prindër, por e lë një vëlla apo motër të vetme, ai apo ajo duhet ta marrë një-të-gjashtën e trashëgimisë; nëse ka më shumë vëllezër-a-motra, ata e ndajnë

një-të-tretën mes vete. [Në të gjitha rastet, shpërndarja vjen] pas pagesës së testamenteve apo borxheve, pa i bërë dëm askujt: ky është urdhër nga **Allahu: Allahu** është i gjithë-dijshëm dhe dashamirës ndaj të gjithëve.<sup>13</sup> Këta janë kufijtë e caktuar nga **Allahu: Allahu** do t'i pranojë ata që i binden Atij dhe Të Dërguarit Të Tij në Kopshte të hijeshuara me lumenj rrjedhës dhe aty do të rrinë – ky është triumfi suprem!<sup>14</sup> Por ata që nuk i binden **Allahut** dhe Të Dërguarit Të Tij dhe i tejkalojnë kufijtë E Tij do të dërgohen nga **Allahu** te Zjarri dhe aty do të rrinë – një torturë poshtëruese i pret ata!

<sup>15</sup> Nëse ndonjë nga gratë tuaja bëjnë akt të turpshëm seksual, thirrni katër dëshmitarë ndërmjet jush, pastaj, nëse ata dëshmojnë për fajin e tyre, mbajini gratë në shtëpi deri kur t'u vijë vdekja apo deri kur **Allahu** t'ua tregojë një mënyrë tjetër.<sup>a</sup> <sup>16</sup> Nëse dy burra bëjnë akt të turpshëm seksual, ndëshkujini të dytë; nëse pendohen dhe i përmirësojnë rrugët e tyre, lërinë rehat – **Allahu** është gjithmonë i gatshëm ta pranojë pendimin, Ai është plot mëshirë.<sup>17</sup> Por **Allahu** merr përsipër të pranojë pendim veç nga ata që bëjnë keq nga padituria dhe shumë shpejt pas kësaj pendohen: këta janë ata që do t'i falë **Allahu**, Ai është i gjithëdijshmi, i gjith' -urti.<sup>18</sup> Nuk është pendim i vërtetë kur njerëzit vazhdojnë të bëjnë keq deri kur vdekja t'u dalë përballë dhe pastaj thonë: 'Tani pendohem', as kur vdesin mospërfillës: Ne kemi përgatitur torturë të dhembshme për këta.

<sup>19</sup> Ju që besoni, nuk është e ligjshme që t'i trashëgoni gratë kundër vullnetit të tyre,<sup>b</sup> as nuk duhet t'i trajtoni gratë tuaja ashpër, duke shpresuar të merrni prapa ca nga dhurata e nuses që ua keni dhënë, pos nëse janë fajtore për diçka qartësisht fyese. Jetoni me to në përputhje me atë që është e drejtë dhe e sjellshme: nëse nuk ju pëlqejnë, ndodh fare mirë që nuk ju pëlqen diçka në të cilën **Allahu** ka vendosur shumë të mira.<sup>4:20</sup> Nëse dëshironi ta zëvendësoni një grua me një tjetër, mos merrni prapa aspak nga dhurata e saj e nuses, edhe nëse i keni dhënë sasi të madhe të arit.<sup>21</sup> Si do të mund ta merrnit kur ky është mëkat i padrejtë dhe i pacipë? Si do të mund ta merrnit kur jeni shtrirë me njëri-tjetrin dhe ato kanë marrë premtim solemn nga ju?

<sup>22</sup> Mos u martoni me gra me të cilat u martuan etërit tuaj – me përjashtim të asaj që është e shkuar – kjo është vërtetë gjë e turpshme për ta bërë, e neveritshme dhe që çon në të keqe.<sup>23</sup> E keni të ndaluar t'i merrni bashkëshorte nënat tuaja, bijat, motrat, hallat dhe tezë, bijat e vëllezërve dhe bijat e motrave, nënat tuaja të qumështit dhe motrat e qumështit<sup>c</sup>, nënat e grave tuaja, thjeshtat (vajzat e bashkëshortes) nën kujdesin tuaj – ato të lindura nga gratë me të cilat e keni

---

<sup>a</sup> Përmes një rregulloreje tjetër, ose martesës, ose çfarëdo mënyre tjetër. Shih gjithashtu fundin e 65:2, që përdor fjalë pothuajse identike.

<sup>b</sup> Në Arabinë para-Islame, nëse një burrë vdiste duke e lënë një të ve, thjeshtri i saj (djali i burrit të saj me një grua tjetër) apo një burrë tjetër nga familja e tij mund ta trashëgonte atë (për grua).

<sup>c</sup> Islami i konsideron gratë që i ushqejnë me gji foshnjat e njerëzve të tjerë si 'nëna të qumështit', e jo thjesht infermiere gji-dhënëse.

konsumuar martesën, e nëse nuk e keni konsumuar martesën, atëherë nuk do të fajësoheni – gratë e bijve tuaj të lindur, dy motra njëkohësisht – me përjashtim të asaj që është e shkuar: **Allahu** është më falësi dhe mëshirëploti – <sup>24</sup> gratë tashmë të martuara, pos skllaveve tuaja.<sup>a</sup> **Allahu** i ka paracaktuar të gjitha këto për ju. Gratë e tjera janë të ligjshme për ju, përderisa i kërkon për martesë, me dhurata nga prona juaj, duke kërkuar martesë e jo kurvëri. Nëse dëshironi t'i shijoni gratë përmes martesës, jepjuani dhuratën e tyre të nuses – kjo është e detyrueshme – edhe pse nëse, pas përmbushjes së këtij detyrimi, të dy zgjedhni të veproni ndryshe [me dhuratën e nuses], nuk do të fajësoheni: **Allahu** është i gjithë-dijshëm dhe i gjith'-urtë.

<sup>25</sup> Nëse dikush nga ju nuk ka mjete për t'u martuar me një grua të lirë besimtare, atëherë martohuni me një skllave besimtare – **Allahu** e di më së miri [thellësinë në] besimin tuaj: ju jeni [të gjithë] pjesë e familjes së njëjtë<sup>b</sup> – pra martohuni me to me pëlqimin e njerëzve të tyre dhe me dhuratat e tyre të duhura për nuse. [Bëjini ato] gra të martuara, e jo kurorë-shkelëse apo dashnore. Nëse e shkelin kurorën kur janë të martuara, ndëshkimi i tyre do të jetë sa gjysma e atij të grave të lira. Kjo është për ata nga ju që keni frikë se mos po bëni mëkat; është më mirë për ju ta praktikoni vetë-përmbajtjen. **Allahu** është më falësi dhe mëshirëploti,

<sup>26</sup> Ai dëshiron t'jua qartësojë  
dhe t'ju udhëzojë në rrugët e ndershme  
të atyre që ishin para jush,  
dhe të kthehet kah ju në mëshirë:  
se Ai është më i dituri, më i urti.

<sup>27</sup> Ai dëshiron të kthehet kah ju,  
por dëshira e atyre që i ndjekin epshet e tyre  
është të largoheni,  
të largoheni plotësisht nga Ai.

<sup>28</sup> **Allahu** dëshiron t'jua lehtësojë barrën  
se njerëzimi u krijua i dobët.

---

<sup>a</sup> Gratë skllave shpesh ishin robër lufte pa pronar, që nuk do të ishin në pozitë t'i jepnin fund ndonjë martese paraprake. Një pronar nuk lejohej ta prekte një grua skllave burri i së cilës ishte me të (Ebu Hanifa, te Razi).

<sup>b</sup> Fjalë për fjalë 'ju jeni nga njëri-tjetri'.

- 29 O besimtarë!  
mos e shpenzoni padrejtësisht  
pasurinë e njëri-tjetrit,  
por mund të bëni tregti  
nga pajtimi i ndërsjellë mes jush.  
Dhe mos e vritni veten [njëri-tjetrin];  
se vërtet **Allahu** është i mëshirshëm ndaj jush.
- 4:30 Këdo që i bën këto  
përmes armiqësisë e shtypjes  
Ne do ta ekspozojmë në zjarr;  
dhe kjo është e lehtë për **Allahun**.
- 31 Nëse i shmangni më të rëndat  
e atyre që ju janë ndaluar,  
do t'ju shlyejmë keqbërjet e vogla  
dhe do t'ju udhëheqim  
në një vend-hyrje fisnike.
- 32 Dhe mos e kini merak atë me të cilën  
**Allahu** i ka nderuar disa nga ju më shumë se të tjerët:  
burrat e kanë pjesën që e kanë fituar<sup>a</sup>  
dhe gratë e kanë pjesën që e kanë fituar.  
Por kërkoni **Allahut**  
nga mirësitë hyjnore,  
se Ai di gjithçka.

<sup>33</sup> Ne kemi caktuar trashëgimtarë për gjithçka që lënë prapa prindërit dhe të afërmit, duke i përfshirë edhe ata të cilëve ua keni çuar dorën [për martesë], pra jepjuani hisen e tyre: **Allahu** është dëshmitar i gjithçkaje.

<sup>34</sup> Burrat duhet të kujdesen mirë për gratë e tyre, me<sup>b</sup> [mirësitë] që **Allahu** ua ka dhënë disave më shumë se të tjerëve dhe me atë që e shpenzojnë nga paratë e tyre. Gratë e ndershme janë të devotshme dhe e ruajnë atë që **Allahu** do t'i linte ta ruanin kur burrat e tyre nuk janë të pranishëm. Nëse i frikësoheni mospërfilljes nga gratë tuaja, kujtojuani atyre [mësimet e **Allahut**], pastaj injorojini kur shkoni

---

<sup>a</sup> Parafjala *min* këtu kuptohet si funksion shpjegues e jo pjesor, që do ta jepte përkthimin 'një pjesë nga ajo që e kanë fituar'.

<sup>b</sup> *bi* interpretohet si ndihmës e jo si shkakor.

në shtrat, pastaj goditini<sup>a</sup>. Nëse ju binden, nuk keni asnjë të drejtë të veproni kundër tyre: **Allahu** është më i larti dhe më i madhi. <sup>35</sup> Nëse [ju besimtarë] keni frikë se një çift mund të ndahet, caktojini një arbitër nga familja e tij dhe një nga e saj. Pastaj, nëse çifti dëshiron t'i rregullojë gjërat, **Allahu** do të sjellë pajtim mes tyre: Ai është i gjithë-dijshmi, i gjith'-informuari.

<sup>36</sup> Adhurojeni **Allahun**,  
dhe mos shoqëroni  
asgjë me Të.  
Dhe jini të mirë me prindërit tuaj  
dhe të afërmit,  
dhe me jetimët e të varfrit,  
dhe me fqinjët e afërt  
dhe me fqinjët e largët,  
dhe me shoqëruesin përkrah,  
dhe me udhëtarin,  
dhe me të miturit për të cilët kujdeseni.

Se **Allahu** nuk i do  
arrogantët, kryelartët,  
<sup>37</sup> ata që janë koprracë,  
apo i bëjnë të tjerët koprracë,  
dhe e fshehin atë që ua ka dhënë **Allahu**  
nga mirësia hyjnore.

Dhe  
Ne kemi përgatitur  
torturë poshtëruese  
për mosmirënjohësit.

<sup>38</sup> [Dhe Ai nuk i do as]  
ata që i shpenzojnë paratë e tyre  
për t'u parë nga njerëzit  
pa besuar në Të  
apo në Ditën e Fundit.  
Ata të cilëve

---

<sup>a</sup> Kjo domethënë një goditje të vetme, siç është e qartë nga rrethanat e shpalljes së këtij vargu. Shih edhe Abdel Haleem, *Understanding the Qur'an*, 46-54.

Satani u është i afërm,  
kanë shoqërues të mjerë!

<sup>39</sup> Dhe çfarë barre do të ishte mbi ta  
po të besonin në **Allahun** dhe Ditën e Fundit  
dhe të shpenzonin bamirësisht  
nga ajo që **Allahu** ua ka furnizuar?  
Dhe **Allahu** ka njohuri të plotë për ta.

<sup>4:40</sup> Vërtet Ai nuk shtyp padrejtësisht  
as në masën më të vogël:  
se nëse ka ndonjë të mirë,  
Ai e përforcon atë,  
duke dhënë shpërblim të madh  
nga prezenca hyjnore.

<sup>41</sup> Çka do të bëjnë kur Ne ta sjellim nga një dëshmitar nga secili komunitet, me ty [Muhamed] si dëshmitar kundër këtyre njerëzve? <sup>42</sup> Në atë ditë, ata që nuk besuan dhe nuk iu bindën Profetit do të dëshirojnë që toka të mund t'i përpinte: nuk do të mund të fshehin asgjë nga **Allahu**.

<sup>43</sup> Ju që besoni, as mos iu afroni lutjes nëse jeni të dehur a të droguar,<sup>a</sup> jo deri kur ta dini se çka po thoni; as nëse jeni në gjendje të papastërtisë madhore rituale – megjithëse mund të kaloni nëpër xhami<sup>b</sup> – jo deri kur të jeni larë; nëse jeni të sëmurë, në udhëtim, e keni kryer nevojën natyrore (me urinë apo feces), apo keni pasur marrëdhënie seksuale dhe nuk mund të gjeni ujë, atëherë gjejini ca rërë të pastër<sup>c</sup> dhe fshijini fytyrat dhe duart me të. **Allahu** është gjithmonë gati të falë ndëshkime dhe gabime.

<sup>44</sup> [Profet,] a s'e ke marrë parasysh se si ata që u është dhënë një hise e Shkrimit të Shenjtë përvetësojnë keqduhëzim dhe duan që edhe ju [besimtarë] ta humbni rrugën e drejtë? <sup>45</sup> **Allahu** i njeh armiqtë tuaj më së miri: **Allahu** është i mjaftueshëm për t'ju mbrojtur dhe për t'ju ndihmuar. <sup>46</sup> Disa çifutë e shtrembërojnë kuptimin e fjalëve [të shpallura] – thonë: 'Dëgjojmë dhe nuk bindemi' dhe 'Dëgjo', [duke e shtuar ofendimin] 'he mos dëgjofsh!' dhe '*Ra`ina* [Na shiko]', duke e përdredhur atë në mënyrë fyese me gjuhët e tyre që ta nënçmojnë fenë. Po të thoshin: 'Dëgjojmë dhe bindemi', 'Dëgjo' dhe '*Unzurna*

---

<sup>a</sup> Ndalimi i materieve dehëse e droguese ishte prezentuar me faza dhe përfundimisht u bënë të paligjshme. Krahaso me 2:219, 5:90-1.

<sup>b</sup> apo 'pos nëse jeni në udhëtim'

<sup>c</sup> Termi *sa`id* domethënë pluhur apo tokë apo dhé apo rërë.

[Na shiko]', kjo do të kish qenë më mirë dhe më e duhur për ta. Por **Allahu** i ka refuzuar me përbuzje për shkak të kundërshtimit të tyre; ata besojnë shumë pak.

<sup>47</sup> Njerëz të Librit, besoni në atë që Ne e kemi zbritur për ta vërtetuar atë që tashmë e keni para se ta shlyejmë [sënsin tuaj për] drejtimin,<sup>a</sup> t'ju kthejmë prapa, apo t'ju refuzojmë, siç i kemi refuzuar ata që e shkelën Sabathin: vullneti i **Allahut** bëhet gjithmonë.

<sup>48</sup> **Allahu** nuk e fal

t'i bëni partnerë Atij  
por fal gjithçka tjetër  
për këdo, përmes vullnetit hyjnor.  
Dhe kushdo që i atribuon  
partnerë **Allahut**  
ka shpikur gabim serioz.

<sup>49</sup> [Profet,] a s'i ke vërejtur

ata që pretendojnë pastërti për veten?  
**Allahu**, përkundrazi,  
e pastron këdo që do ta pastrojë:  
dhe askush nuk do të trajtohet padrejtësisht  
as në shkallën më të vogël.

<sup>4:50</sup> Shih se si shpikin

gënjeshtër për **Allahun**;  
dhe kjo është e vetëmjaftueshme  
për të qenë gabim i rëndë.

<sup>51</sup> A nuk i ke vërejtur

ata të cilëve iu dha  
një pjesë e Shkrimit të Shenjtë?  
Besojnë në idhuj dhe hyjni të rreme,  
dhe u thonë mosbesimtarëve  
se janë më mirë të udhëzuar në një rrugë  
se ata që besojnë.<sup>b</sup>

<sup>52</sup> Ata janë ata që i ka refuzuar **Allahu**.

Dhe për ata që i ka refuzuar **Allahu**

---

<sup>a</sup> Fjalë për fjalë 't'jua fshijmë fytyrat'. Një kuptim tjetër i *wujuh* (fytyrat) është 'drejtimet' (Razi).

<sup>b</sup> Kjo është marrë se i referohet një ngjarjeje aktuale në të cilën një grup i mekasve mosbesimtarë shkuan te dy figura eminente çifute për t'u këshilluar mbi të vërtetën e mësimëve të Muhamedit dhe ata u thanë se paganët ishin më të drejtë se myslimanët.

[ti Profet] nuk do të gjesh ndihmë.

<sup>53</sup> A kanë hise në atë që e posedon Ai?

Epo pra, shihni –

nuk u japin njerëzve asgjë.

<sup>54</sup> A i kanë zili njerëzit [e tjerë] për dhuratën bujare<sup>a</sup> që **Allahu** ua ka dhënë? Ne ua dhamë pasardhësve të Ibrahimit Shkrimit të Shenjtë dhe urtinë – dhe u dhamë mbretëri të madhe – <sup>55</sup> por disa nga ta besuan në të<sup>b</sup> dhe disa u larguan nga ai. Ferri ndizet mjaft ashpër. <sup>56</sup> Ne do t'i dërgojmë te Zjarri ata që i refuzojnë shpalljet Tona. Kur lëkurat e tyre të jenë djegur, Ne do t'i zëvendësojmë ato me të reja që ata të mund të vazhdojnë ta ndiejnë dhembjen: **Allahu** është i fuqishëm dhe i urtë. <sup>57</sup> Sa për ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, do t'i pranojmë në Kopshte të hijeshuara me lumenj rrjedhës dhe aty do të mbesin përgjithmonë. Do të kenë bashkëshortë të pastër aty dhe do t'i lejojmë nën hije të këndshme freskuese.

<sup>58</sup> [Njerëz,] **Allahu** ju udhëzon

t'i ktheni gjërat

që ju janë besuar –

te pronarët e tyre të ligjshëm;

dhe kur gjykoni ndërmjet njerëzve,

të gjykoni me drejtësi.

E shkëlqyeshme është vërtet ajo

që **Allahu** jua këshillon:

se Ai i dëgjon dhe i sheh të gjitha.

<sup>59</sup> Ju që besoni, bindjuni **Allahut** dhe Të Dërguarit dhe atyre me autoritet në mesin tuaj. Nëse jeni në mosmarrëveshje për ndonjë çështje, referojani atë **Allahut** dhe Të Dërguarit, nëse vërtet besoni në **Allahun** dhe në Ditën e Fundit: kjo është më e mirë dhe më e drejtë në fund. <sup>4:60</sup> A nuk i sheh [Profet] ata që pretendojnë se besojnë në atë që të është zbritur dhe në atë që ishte zbritur para teje, e prapë duan të kthehen te tiranët e padrejtë<sup>c</sup> për gjykim, edhe pse u ishte dhënë urdhër t'i refuzojnë ata? Satani dëshiron t'i devijojë shumë larg. <sup>61</sup> Kur u

---

<sup>a</sup> d.m.th. Profetësinë që i është dhënë Muhamedit.

<sup>b</sup> Përemri *hi* këtu i referohet (i) Shkrimit të Shenjtë ose (ii) Ibrahimit.

<sup>c</sup> Fjala arabe *taghut* është interpretuar në mënyra të ndryshme se i referohet idhujve, një tirani specifik, një orakulli, apo një kundërshtari të Profetit.



thuhet: ‘Kthehjuni shpalljeve të **Allahut** dhe Të Dërguarit [për gjykim]’, i sheh hipokritët si largohen menjëherë nga ti [Profet].<sup>62</sup> Nëse i godet fatkeqësia për shkak të asaj që e kanë bërë vetë, do të vijnë te ti, duke u betuar në **Allah**: ‘Ne veç donim të bënim mirë dhe të arrinim harmoni’.<sup>63</sup> **Allahu** e di mirë atë që është në zemrat e atyre njerëzve, prandaj injoroje atë që e thonë, udhëzoji dhe folju në lidhje me ta duke përdorur fjalë depërtuese.

<sup>64</sup> Të gjithë të dërguarit që i kemi çuar ishin me synimin që [njerëzit] t’u bindeshin, me lejen e **Allahut**. Ah po të kishin ardhur [hipokritët] te ti [Profet] kur e dëmtuan veten dhe të luteshin për faljen e **Allahut**, do ta kishin kuptuar se **Allahu** e pranon pendimin dhe është më mëshirëploti.<sup>65</sup> Pasha Zotin tënd, ata nuk do të jenë besimtarë të vërtetë deri kur të të lejojnë të vendosësh ndërmjet tyre në të gjitha çështjet e mosmarrëveshjeve dhe të mos gjejnë asnjë rezistencë në shpirtrat e tyre ndaj vendimeve tua, duke i pranuar plotësisht –<sup>66</sup> po të kishim urdhëruar Ne: ‘Hiqni dorë nga jetët tuaja’ apo ‘Lini shtëpitë tuaja’, ata nuk do të vepronin ashtu, pos pak prej tyre – do të kish qenë shumë më mirë për ta dhe vërtetim më i fortë i besimit të tyre, po të kishin vepruar siç u ishte thënë,<sup>67</sup> dhe Ne do t’ua kishim dhënë një shpërblim Tonin të madh<sup>68</sup> dhe do t’i udhëzonim në rrugë të drejtë.<sup>69</sup> Kushdo që i bindet **Allahut** dhe Të Dërguarit do të jetë ndërmjet atyre që Ai i ka bekuar: të dërguarit, besnikët, ata që e dëshmojnë të vërtetën,<sup>a</sup> dhe të ndershmit – çfarë bashkëmiq të shkëlqyeshëm që janë!<sup>4:70</sup> Kjo është mirësia e **Allahut**. Askush nuk di më mirë se Ai.

<sup>71</sup> Ju që besoni, kini kujdes. Marshoni [në betejë] në grupe të vogla apo si një trup i vetëm.<sup>72</sup> Ndërmjet jush është lloji i personit që sigurisht do të mbetet prapa: nëse ju ndodh një fatkeqësi, ai thotë: ‘**Allahu** ka qenë i mirësishëm me mua që nuk isha atje me ta’,<sup>73</sup> e në anën tjetër, nëse favorizoheni nga **Allahu**, sigurisht thotë: ‘Ah po të kisha qenë me ta, do të mund të kisha fitime të mëdha’ – thua se nuk ka fare lidhje emocionale midis jush dhe tij.<sup>74</sup> Ata nga ju që janë të gatshëm ta këmbëjnë jetën e kësaj bote për jetën tjetër, le të luftojnë në rrugën e **Allahut**. Për këdo që lufton në rrugën e **Allahut**, qoftë i vrarë apo fitimtar, Ne do ta japim një shpërblim të madh.<sup>75</sup> Pse të mos luftonit në çështjen e **Allahut** dhe për ata burra, gra e fëmijë që thërrasin: ‘Zot, na shpëto nga ky qytet – njerëzit e të cilit janë shtypës! Pashë mirësinë Tënde, na e jep një mbrojtës dhe na e jep një ndihmues!’? <sup>76</sup> Besimtarët luftojnë për çështjen e **Allahut**, gjersa ata që e refuzojnë besimin luftojnë për çështje të padrejtë.<sup>b</sup> Luftoni aleatët e Satanit: strategjitë e Satanit janë vërtet të dobëta.

<sup>77</sup> [Profet,] a nuk i sheh ata të cilëve u ishte thënë: ‘Përmbahuni nga luftimi, kryeni lutjet dhe paguajeni lëmoshën e përcaktuar’? Kur u caktua luftimi për ta, disa nga ta u frikësoheshin njerëzve po aq, apo madje edhe më shumë se sa i frikësoheshin **Allahut**, duke thënë: ‘Zot, pse na e ke caktuar luftimin? Ah sikur të

---

<sup>a</sup> Dëshmorët e dëshmojnë të vërtetën me jetët e tyre (Razi).

<sup>b</sup> Përsëri ky është termi *taghut*, që ka një mori të kuptimeve. Shih shënimin e vargut 60.

na jepje veç edhe pak më shumë kohë.’ Thuaju: ‘E vogël është kënaqësia në këtë botë, E Përtejma është shumë më e mirë për ata që janë të vetëdijshëm për **Allahun**: nuk do t’ju bëhet e padrejtë as sa fija në bërthamë të hurmës.<sup>78</sup> Vdekja do t’ju marrë pavarësisht ku mund të jeni, madje edhe brenda kullave të larta.’ Kur u vjen fati i mirë, thonë: ‘Kjo është nga **Allahu**’, por kur u ndodh dëmi, thonë: ‘Kjo është nga ti [Profet]’. Thuaju: ‘Të dyja vijnë nga **Allahu**’. Si është puna me këta njerëz që mezi mund të kuptojnë se çka u thuhet?<sup>79</sup> Çfarëdo e mire që të ndodh [ty Profet] është nga **Allahu**; çfarëdo e keqe është [përfundimisht] nga vetja. Ne të kemi çuar si të dërguar te njerëzit; **Allahu** është dëshmitar i mjaftueshëm.<sup>4:80</sup> Kushdo që i bindet Të Dërguarit – i bindet **Allahut**. Nëse disa nuk janë të vëmendshëm, Ne nuk të kemi dërguar të jesh rojtar i tyre.<sup>81</sup> Thonë: ‘Ne të bindemi’, por posa ta lënë praninë tënde, disa nga ta bëjnë plane të fshehta natën, kështu që lëri rehat dhe kije besimin tënd në **Allahun**: Ai është mbrojtës i mjaftueshëm.

<sup>82</sup> A nuk do të mendojnë ata për këtë Kuran? Po të kish qenë nga kushdo tjetër pos **Allahut**, do të kishin gjetur shumë mospërputhje në të.<sup>83</sup> Kurdo që u vijnë lajme për çfarëdo çështje, qoftë në lidhje me paqen apo luftën, ata e përhapin përreth; po t’ia referonin Të Dërguarit dhe atyre me autoritet midis tyre, ata që e kërkojnë kuptimin e saj do ta zbulonin nga ta. Po të mos ishte bollëku dhe mëshira e **Allahut** ndaj jush, pothuajse të gjithë do ta kishit ndjekur Satanin.

<sup>84</sup> Pra [Profet] lufto në rrugën e **Allahut**. Je përgjegjës veç për veten. Nxiti besimtarët. **Allahu** fare mirë mund ta frenojë fuqinë e mosbesimtarëve, se Ai është më i fortë në fuqi dhe më i tmerrshëm në ndëshkim.

<sup>85</sup> Kushdo që flet për<sup>a</sup>  
një çështje të mirë  
merr pjesë nga ajo;  
dhe kushdo që flet për  
një çështje të keqe  
ka hise në të:  
dhe është **Allahu**  
Ai që kontrollon gjithçka.

<sup>86</sup> Dhe kur [juve besimtarëve] ju përshëndesin  
[qoftë edhe në betejë]  
me një përshëndetje,

---

<sup>a</sup> Raportohet se një individ i kërkoi Profetit që ta përjashtonte një tjetër nga të shkuarit në betejë. "Flet për" është një nga kuptimet e *shafa'a* siç shpjegohet nga Razi dhe është më i përshtatshëm këtu për kontekstin e nxitjes së besimtarit të luftojë për çështjen e Zotit. Kuptimi tjetër, 'ndërmjetëson', i miratuar nga shumica e përkthyesve nuk përshtatet me kontekstin.

ofrojeni një përshëndetje edhe më të mirë,  
apo të paktën kthejeni;<sup>a</sup>  
se **Allahu** merr parasysh gjithçka.

<sup>87</sup> Ai është **Allahu**:

nuk ka zot pos Tij:  
Ai do t'ju mbledhë bashkë  
në Ditën e Ringjalljes,  
për të cilën nuk ka dyshim.

Dhe fjala e kujt mund të jetë më e vërtetë se e **Allahut**?

<sup>88</sup> [Besimtarë,] pse ndaheni në dysh për hipokritët, kur Vetë **Allahu** i ka refuzuar për shkak të asaj që e kanë bërë? A po doni t'i udhëzoni ata që **Allahu** i ka lënë të devijojnë? Nëse **Allahu** e lë dikë të devijojë, [ti Profet] nuk do ta gjesh kurrë rrugën për të. <sup>89</sup> Ata do të kishin qejf shumë që ju ta refuzonit besimin, siç kanë bërë vetë, të jeni sikur ata. Pra mos i bëni aleatë deri kur të migrojnë [në Medinë] për çështjen e **Allahut**. Nëse [ju] sulmojnë<sup>b</sup>, atëherë kapini dhe vritini kudo që t'i hasni<sup>c</sup>. Mos e bëni aleat apo përkrahës asnjë nga ta. <sup>4:90</sup> Por sa për ata që kërkojnë strehim te njerëzit me të cilët keni traktat, apo që vijnë te ju se zemrat u tkurren nga lufta kundër jush apo kundër popullit të tyre, **Allahu** do të kishte mundur t'u jepte fuqi ndaj jush dhe do t'ju kishin mundur. Pra nëse tërhiqen dhe nuk ju luftojnë dhe ju ofrojnë paqe, atëherë **Allahu** nuk jua jep asnjë rrugë kundër tyre. <sup>91</sup> Do të gjeni të tjerë që duan të jenë të sigurt nga ju dhe nga populli i tyre, por kurdo që kthehen në situatë ku tundohen [t'ju luftojnë], i nënshtrohen asaj. Pra nëse as nuk tërhiqen, as nuk ju ofrojnë paqe, as nuk përmbahen të mos ju luftojnë, kapini dhe vritini kudo që t'i hasni: Ne ju japim autoritet të qartë kundër njerëzve të tillë.

<sup>92</sup> Kurrë një besimtar nuk duhet ta vrasë një besimtar tjetër, përveçse gabimisht. Nëse dikush e vret një besimtar gabimisht, duhet ta çlirojë një skllav mysliman dhe t'ia paguajë kompensimin të afërmve të viktimës, përveç nëse ata heqin dorë bamirësisht; nëse viktimë i përkiste një populli në luftë me ju por është besimtar, atëherë kompensimi është veç të çlirohet një skllav besimtar; nëse i përkiste një populli me të cilët keni traktat, atëherë kompensimi duhet t'i dërgohet të afërmve të tij dhe të çlirohet një skllav besimtar. Kushdo që i mungojnë mjetet për ta bërë këtë duhet të agjërojë dy muaj rresht me mënyrën e pendimit të **Allahu**: **Allahu** është i gjithëdijshëm, i gjith'-urtë. <sup>93</sup> Nëse dikush e vret një besimtar me paramendim, ndëshkimi për të është Ferri dhe aty do të

---

<sup>a</sup> Shih 4:94 dhe komentin e Razi-t.

<sup>b</sup> Se 'sulmojnë me agresion' është kuptimi i synuar është e qartë nga konteksti. Krahaso me 4:91.

<sup>c</sup> Shih 2:191.

mbetet: **Allahu** është i zemëruar me të dhe e refuzon dhe ka përgatitur torturë të tmerrshme për të.<sup>94</sup> Pra, ju që besoni, kini kujdes kur shkoni të luftoni në rrugën e **Allahut** dhe mos i thoni dikujt që ju ofron përshëndetje të paqes: ‘Nuk je besimtar’,<sup>a</sup> nga dëshira për përfitimet e mundshme të kësaj jete – **Allahu** ka përfitime me bollëk për ju. Ju vetë ishit në pozitën e njëjtë [një herë], por **Allahu** ishte dashamirës ndaj jush, pra kini kujdes: **Allahu** është plotësisht i informuar për atë që e bëni.

<sup>95</sup> Ata besimtarë që rrinë në shtëpi, përveç atyre me aftësi të kufizuara, nuk janë të barabartë me ata që e përkushtojnë veten dhe pasuritë e tyre në përpjekjen në rrugën e **Allahut**. **Allahu** i ka ngritur njerëzit e tillë në një gradë mbi ata që rrinë në shtëpi – edhe pse Ai u ka premtuar të gjithë besimtarëve shpërblim të mirë, ata që përpiqen favorizohen me shpërblim të jashtëzakonshëm mbi ata që rrinë në shtëpi – <sup>96</sup> grada të larta të dhëna nga Ai, si dhe falje e mëshirë: **Allahu** është më falësi dhe mëshirëploti.

<sup>97</sup>       Atyre që engjëjt ua marrin jetën  
gjersa janë të padrejtë ndaj shpirtave të tyre,<sup>b</sup>  
engjëjt u thonë:  
“Si ishte situata juaj?”  
Ata thonë:  
“Ishim të shtypur në tokë.”  
Engjëjt thonë:  
“A nuk ishte toka e **Allahut** mjaft e gjerë  
që ju të iknit?”  
Dhe strehimi i tyre është Ferri,  
strehë e mjerueshme.

<sup>98</sup>       Përrjashtim bëjnë  
burrat, gratë dhe fëmijët e shtypur  
që vërtet nuk mund të bëjnë asgjë për këtë  
dhe nuk janë të udhëzuar në asnjë mënyrë:

<sup>99</sup>       ata ka të ngjarë  
që **Allahu** do t’i falë,  
se Ai shlyen ndëshkime,

---

<sup>a</sup> Një mysliman e vrau dikë në betejë që ia kishte dhënë përshëndetjen myslimane, duke menduar se burri po përpiquej të shpëtonte, por Profeti e kundërshtoi këtë.

<sup>b</sup> Duke jetuar në një vend ku nuk janë në gjendje ta praktikojnë fenë e tyre.

është shumë falës.

4:100 Dhe kushdo që ik  
për shkak të çështjes së **Allahut**  
do të gjejë në tokë  
shumë strehë të gjera;  
dhe kujt do që e lë shtëpinë e tij  
si refugjat për **Allahun**  
dhe Të Dërguarin  
dhe pastaj e merr vdekja  
i përket shpërblimi i tij i sigurt nga **Allahu**;  
dhe **Allahu** është më falësi,  
më mëshirëploti.

<sup>101</sup> Kur [ju besimtarë] jeni duke udhëtuar nëpër vend, nuk do të fajësoheni për shkurtimin e lutjeve tuaja, nëse druani se mund t'ju dëmtojnë mosbesimtarët: ata janë armiqtë tuaj të betuar. <sup>102</sup> Kur [ti Profet] je me besimtarët, duke i udhëhequr në lutje, një grup nga ta le të rrijë në këmbë në lutje me ty, duke i marrë armët me vete dhe kur ta kenë kryer gjunjëzimin, le t'i zënë pozitën e tyre në pjesën e prapme. Pastaj grupi tjetër, që nuk janë lutur ende, le të luten me ty, po ashtu në gjendje gatishmërie dhe të armatosur me armët e tyre: mosbesimtarët do të donin shumë që të jeni pa vëmendje për armët dhe bagazhet tuaja, që t'ju mbarojnë me një sulm të vetëm. Nuk do të fajësoheni nëse i leni anash armët tuaja kur ju përfshin shiu i fortë apo sëmundja, por jini në gjendje gatishmërie. Vërtet, **Allahu** ka përgatitur ndëshkim poshtërues për mosbesimtarët. <sup>103</sup> Pasi ta keni kryer lutjen rituale, vazhdoni ta kujtoni **Allahun** – kur jeni në këmbë, ulur dhe të shtrirë në anët tuaja – dhe posa të jeni të sigurt, vazhdojeni lutjen e rregullt, se lutja është e obligueshme për besimtarët në kohët e përcaktuara. <sup>104</sup> Mos jini të druajtur në ndjekjen e armikut: nëse ju po vuani vështirësi, edhe ata po vuajnë, por ju shpresoni të pranoni diçka nga **Allahu** për të cilën ata nuk mund të shpresojnë. **Allahu** është i gjithë-dijshëm dhe i urtë.

<sup>105</sup> Ne ta kemi dërguar Librin [, Profet,]  
me të vërtetën,  
që të mund të gjykosh ndërmjet njerëzve  
me atë që ta ka treguar **Allahu**;  
pra mos u bëj avokat

- i atyre që e tradhtojnë mirëbesimin.<sup>a</sup>
- 106 Dhe kërkoje faljen e **Allahut**,  
se Ai është më falësi,  
më mëshirëploti.
- 107 Dhe mos e argumento çështjen  
e atyre që i tradhtojnë shpirtat e tyre;  
se **Allahu** nuk i do  
ata që u jepen tradhtisë e mëkatit.
- 108 Ata mundohen të fshehen nga njerëzit,  
por nuk mund të fshehen nga **Allahu**;  
se Ai është me ta kur planifikojnë fshehtas natën  
me fjalë që nuk e kënaqin.  
Dhe Ai kupton plotësisht  
gjithçka që bëjnë.

109 Ja ku jeni [ju besimtarë], duke argumentuar në emër të tyre në këtë jetë, por kush do të argumentojë në emër të tyre me **Allahun** në Ditën e Ringjalljes? Kush do të jetë mbrojtësi i tyre? <sup>4:110</sup> E prapë kushdo që bën keq apo e dëmton shpirtin e tij dhe pastaj e lut **Allahun** për falje do ta shohë se Ai është më falësi dhe mëshirëploti. <sup>111</sup> Ai që bën mëkat e bën këtë kundër shpirtit të tij – **Allahu** është i gjithë-dijshëm dhe i urtë – <sup>112</sup> dhe kushdo që bën shkelje apo mëkat dhe pastaj ia hedh fajin ndonjë personi të pafajshëm, e ka rënduar veten me mashtrim si dhe me mëkat tronditës.

<sup>113</sup> Po të mos ishte mirësia e **Allahut** dhe mëshira E Tij për ty [Profet], një parti nga ta do të kishte provuar të të devijojë; ata veç e devijojnë veten dhe nuk mund të të dëmtojnë në asnjë mënyrë, meqë **Allahu** ta ka zbritur Shkrimin e Shenjtë dhe Urtinë dhe ta ka mësuar atë që nuk e dije. Dhurata bujare e **Allahut** për ty është vërtet e madhe.

- 114 Nuk ka gjë të mirë  
në shumicën e bisedave të tyre të fshehta,  
pos atyre që urdhërojnë  
bamirësi a drejtësi

---

<sup>a</sup> Një burrë nga Medina e vodhi një kostum të parzmores dhe e akuzoi një çifut se këtë e kishte bërë ai. Ai burrë e solli familjen e tij për t'i kërkuar Profetit që të vendosë kundër çifutit dhe Profeti ishte gati ta bënte këtë kur u shpallën këto vargje (Razi).

apo pajtim ndërmjet njerëzve:  
dhe kujt do që i bën këto,  
duke e kërkuar kënaqësinë e **Allahut**,  
Ne do t'i japim shpërblim të madh;

<sup>115</sup> e nëse dikush e kundërshton Të Dërguarin, pasi t'i jetë qartësuar udhëzimi dhe ndjek rrugë tjetër nga ajo e besimtarëve, Ne do ta lëmë në rrugën e tij të zgjedhur – do ta djegim në Ferr, një destinacion i keq.

<sup>116</sup> **Allahu** nuk e fal adhurimin e të tjerëve përveç Tij – megjithëse Ai e fal këdo që do ta falë për mëkate më të vogla – se kushdo që e bën këtë ka devijuar shumë, shumë larg. <sup>117</sup> Në vend Të Tij idhujtarët thërrasin veç femra<sup>a</sup> dhe Satanin, rebelin <sup>118</sup> që **Allahu** e refuzoi, i cili tha: 'Sigurisht që do ta marr hisen time të shërbyesve të Tu; <sup>119</sup> do t'i çorientoj dhe do të nxis merake të kota në ta; do t'i urdhëroj t'ua presin veshët bagëtive;<sup>b</sup> do t'i urdhëroj të ngatërrohen me krijimin e **Allahut**.' Kushdo që e zgjedh Satanin si mbrojtës në vend të **Allahut** është i shkatërruar plotësisht: <sup>4:120</sup> ai u jep premtime dhe u krijon shpresa të rreme, por premtimet e Satanit s'janë gjë pos deluzion. <sup>121</sup> Njerëzit e tillë do ta kenë Ferrin si shtëpi të veten dhe nuk do të gjejnë shpëtim nga ai, <sup>122</sup> por Ne do t'i pranojmë ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira në Kopshte të hijeshuara me lumenj rrjedhës, për të mbetur aty përgjithmonë – premtim i vërtetë nga **Allahu**. Kush flet më vërtet se **Allahu**? <sup>123</sup> Nuk do të ndodhë sipas shpresave tuaja apo të atyre të Njerëzve të Librit: kushdo që bën keq do t'i merret haku për të dhe nuk do ta gjejë askë që ta mbrojë apo t'i ndihmojë kundër **Allahut**;

<sup>124</sup> cilido, mashkull a femër,  
që bën vepra të mira  
dhe është besimtar-e  
do të hyjë në Parajsë  
dhe nuk do të dëmtohet  
as sa një gropëz  
në bërthamën e hurmës.

<sup>125</sup> E kush është më mirë në fe  
se ata që ia dorëzojnë  
qenien e tyre plotësisht **Allahut**

---

<sup>a</sup> Shih edhe 53:19-20 (në lidhje me hyjneshat pagane arabe – shënim i shqipëruarit nga fusnota e 53:20)

<sup>b</sup> Një shembull i praktikave pagane besëtyte: ia kushtonin bagëtitë zotave të tyre duke ua prerë veshët.

dhe bëjnë mirë  
dhe e ndjekin fenë e Ibrahimit,  
që ishte besnik në besim  
[e kërkonte të vërtetën]?  
Se **Allahu** e mori Ibrahimin  
si një mik.

126 Dhe **Allahut** i përket  
gjithçka në qiej  
dhe gjithçka në tokë;  
dhe **Allahu** është plotësisht i informuar për të gjitha.

<sup>127</sup> Të pyesin [Profet] për një vendim për gratë. Thuaj: ‘Vetë **Allahu** jua jep një vendim për to. Tashmë e keni atë që ju është recituar në Shkrimin e Shenjtë për vajzat jetime [nën përgjegjësinë tuaj] nga të cilat i ndalni hiset e përcaktuara [të trashëgimisë së tyre] dhe me të cilat doni të martoheni dhe po ashtu edhe për fëmijët e pafuqishëm – **Allahu** ju udhëzon t’i trajtoni jetimët me drejtësi: Ai është fare mirë i informuar për çfarëdo të mire që e bëni.’

<sup>128</sup> Nëse një grua i frikësohet mospërfilljes apo ftohjes tëhuajësuese nga burri i saj, asnjëri nga ta nuk do të fajësohet nëse arrijnë në një zgjidhje paqësore, se paqja është më e mira. Edhe pse shpirtrat njerëzorë janë të prirë për egoizëm, nëse bëni mirë dhe jeni të vetëdijsëm për **Allahun**, Ai është fare mirë i informuar për gjithçka që bëni. <sup>129</sup> Kurrë nuk do të mund t’i trajtoni gratë tuaja me drejtësi të barabartë, sado të mund të keni merak ta bëni këtë, por mos e injoroni një grua krejtësisht, duke e lënë pezull [ndërmjet martesës dhe ndarjes]. Nëse përmirësoheni dhe mbeteni të vetëdijsëm për **Allahun**, Ai është më falësi dhe mëshirëploti, <sup>4:130</sup> por nëse burri dhe gruaja ndahen, **Allahu** do të furnizojë për secilin nga bollëku I Tij: Ai është i pakufi në bollëk dhe i gjith’-urtë. <sup>131</sup> Gjithçka në qiej dhe në tokë i përket **Allahut**.

Ne i kemi urdhëruar ata të cilëve u ishte dhënë Shkrimi i Shenjtë para jush, dhe ju urdhërojmë juve, të jeni të vetëdijsëm për **Allahun**. Madje edhe nëse e injoroni Atë, gjithçka në qiej dhe në tokë i përket Atij dhe Ai është i vetëmjaftueshëm, i denjë për tërë lavdet. <sup>132</sup> Po, vërtet, gjithçka në qiej dhe në tokë i përket **Allahut** dhe Ai është i mjaftueshëm për ata që besojnë në Të. <sup>133</sup> Po të donte, do të mund t’ju hiqte krejtësisht dhe t’ju zëvendësonte me njerëz të rinj: Ai ka fuqi të plotë për ta bërë këtë. <sup>134</sup> Nëse disa i duan shpërblimet e kësaj bote, shpërblimet e kësaj bote dhe të tjetrës i takojnë të dyja **Allahut** për t’i dhënë: Ai dëgjon dhe sheh gjithçka.



<sup>135</sup> Ju që besoni, mbështeteni drejtësinë dhe dëshmojeni **Allahun**, edhe nëse është kundër jush, prindërve tuaj, apo familjarëve tuaj të afërm. Qoftë personi i pasur a i varfër, **Allahu** mund të kujdeset më së miri për të dytë. Përbahuni nga ndjekja e merakut tuaj, që të mund të veproni drejt – nëse e shtrembëroni apo e shpërfillni drejtësinë, **Allahu** është plotësisht i informuar për atë që e bëni. <sup>136</sup> Ju që besoni, besoni në **Allahun** dhe në Të Dërguarin E Tij dhe në Shkrimin e Shenjtë që ia zbriti Të Dërguarit Të Tij, si dhe në atë që e ka zbritur më parë. Kushdo që nuk beson në **Allahun**, në engjëjt E Tij, në Shkrimet E Tij të Shenjta, në të dërguarit E Tij dhe në Ditën e Fundit – ka devijuar shumë, shumë larg. <sup>137</sup> Sa për ata që besojnë, pastaj e refuzojnë besimin, pastaj besojnë përsëri, pastaj e refuzojnë besimin përsëri dhe bëhen gjithnjë e më provokues, **Allahu** nuk do t'i falë, as s'do t'i udhëzojë në ndonjë rrugë. <sup>138</sup> [Profet,] tregoj hipokritëve të tillë se i pret një torturë e dhembshme.

<sup>139</sup> Athua ata që bëhen aleatë me mosbesimtarët në vend se me besimtarët kërkojnë pushtet përmes tyre? Në realitet çdo pushtet i takon **Allahut** që ta japë. <sup>4:140</sup> Siç jua ka shpallur Ai tashmë [juve besimtarëve] në Shkrimin e Shenjtë, nëse i dëgjoni njerëzit duke e refuzuar dhe përqeshur shpalljen e **Allahut**, mos u ulni me ta pos nëse nisin të flasin për gjëra të tjera, përndryshe ju vetë do të bëheni si ta.<sup>a</sup> **Allahu** do t'i mbledhë bashkë të gjithë hipokritët dhe mosbesimtarët në Ferr. <sup>141</sup> [Hipokritët] presin ta shohin se çka ju ndodh juve dhe, nëse **Allahu** ju sjell sukses, thonë: 'A nuk ishim në anën tuaj?' por nëse mosbesimtarët kanë ca sukses, u thonë atyre: 'A nuk e kishim kontrollin mbi ju dhe [prapë] ju mbrojtëm nga besimtarët?' **Allahu** do të gjykojë ndërmjet juve të gjithëve në Ditën e Ringjalljes dhe nuk do t'u japë mosbesimtarëve kurrfarë mjetesh për t'i tejkaluar besimtarët.

<sup>142</sup> Hipokritët provojnë ta mashtrojnë **Allahun**, por është Ai që i bën ata të mashtrohen. Kur ngriten në këmbë për t'u lutur, e bëjnë këtë kaq ngadalë, duke u kallëzuar para njerëzve dhe e kujtojnë **Allahun** veç pak, <sup>143</sup> duke u lëkundur tërë kohën ndërmjet kësaj dhe asaj, duke mos i takuar as njërës anë as tjetrës. Nëse **Allahu** e lë dikë të devijojë, [ti Profet] nuk do t'ia gjesh kurrë një rrugë. <sup>144</sup> Ju që besoni, mos i merrni mosbesimtarët për aleatë dhe mbrojtës në vend të besimtarëve: a doni t'i ofroni **Allahut** provë të qartë kundër jush? <sup>145</sup> Hipokritët do të jenë në thellësitë më të ulëta të Ferrit dhe nuk do ta gjeni askë t'iu ndihmojë. <sup>146</sup> Kjo nuk vlen për ata që pendohen, i përmirësojnë rrugët e tyre, mbahen fort për **Allahun** dhe ia kushtojnë fenë e tyre plotësisht Atij: këta do t'i bashkojnë me besimtarët dhe **Allahu** do t'u japë besimtarëve shpërblim të fuqishëm. <sup>147</sup> Pse do t'ju bënte **Allahu** të vuanit torturë nëse jeni falënderues dhe besoni në Të? **Allahu** e shpërblen gjithmonë mirënjohjen dhe di gjithçka. <sup>148</sup> **Allahut** nuk i pëlqen që fjalët e këqija të bëhen publike pos nëse dikush është

---

<sup>a</sup> Shih 6:68 – një sure e mëhershme, mekase.

dëmtuar: Ai është gjithë-dëgjues dhe i gjithë-ditur. <sup>149</sup> Nëse bëni mirë, haptas a në fshehtësi, apo nëse e falni ndëshkimin për diçka të keqe,<sup>a</sup> atëherë **Allahu** është më falësi dhe fuqiploti.

<sup>4:150</sup> Sa për ata që e injorojnë **Allahun** dhe të dërguarit E Tij dhe duan të bëjnë dallim ndërmjet tyre, duke thënë: ‘Ne besojmë në disa por jo në të tjerët’, duke e kërkuar një rrugë të mesme, <sup>151</sup> ata janë realisht mosbesimtarë: Ne kemi përgatitur ndëshkim poshtërues për ata që nuk besojnë.

<sup>152</sup> Por për ata që besojnë  
në **Allahun** dhe Të Dërguarit E Tij,  
dhe nuk bëjnë dallime  
ndërmjet Të Dërguarve,  
shpërblimi i tyre është i shpejtë;  
se **Allahu** është më falësi,  
më mëshirëploti.

<sup>153</sup> Njerëzit e Librit kërkojnë që [ti Profet] të bësh që një libër të zbresë fizikisht poshtë te ta nga qielli, por ata kërkuan edhe më shumë se kjo nga Musai kur thanë: ‘Na e shfaq **Allahun** ballë për ballë’ dhe ishin goditur nga rrufeja për teprimin e tyre. Madje edhe pasi iu patën zbritur shpallje të qarta, e morën viçin si objekt të adhurimit, e prapë Ne ua falëm ndëshkimin për këtë dhe i dhamë Musait autoritet të qartë; <sup>154</sup> e bëmë kullën e malit lart mbi ta me rastin e premtimit të tyre; u thamë: ‘Hyni në portë me përulësi’ dhe ‘Mos e shkelni Sabathin’ dhe morëm premtim solemn nga ta. <sup>155</sup> Dhe kështu, për shkak se e shkelën premtimin, se i vranë profetët e tyre padrejtësisht, se thanë ‘Mendjet tona janë të mbyllura’ – Jo! **Allahu** i ka vulosur në mosbesimin e tyre, kështu që besojnë veç pak – <sup>156</sup> dhe për shkak se nuk besuan dhe e lëshuan një shpifje të tmerrshme kundër Merjemes <sup>157</sup> dhe thanë: ‘E kemi vranë Mesihun, Isain, të birin e Merjemes, Të Dërguarin e **Allahut**.’ (Ata nuk e vranë, as nuk e kryqëzuan, megjithëse ishte bërë që atyre t’u dukej ashtu; ata që patën mospajtime për të janë plot dyshim, pa dije për të ndjekur, veç supozim: natyrisht që nuk e vranë – <sup>158</sup> **Allahu** e ngriti te Vetja. **Allahu** është i gjithëfuqishëm dhe i urtë. <sup>159</sup> Nuk ka as edhe një nga Njerëzit e Librit që nuk do të besojë në [Isain] para vdekjes së tij dhe në Ditën e Ringjalljes ai do të jetë dëshmitar kundër tyre.) <sup>4:160</sup> Për keqbërjet nga çifutët, Ne ua ndaluan gjërat e mira të caktuara që iu patën lejuar më parë: për shkak se i kanë penguar shpesh të tjerët nga rruga e **Allahut**; <sup>161</sup> se kanë marrë

---

<sup>a</sup> Razi sugjeron që kjo domethënë: nëse hipokritët pendohen, besimtarët nuk duhet t’i thumbojnë për atë që e kanë bërë në të shkuarën.

fajde kur e kishin të ndaluar ta bënë këtë; dhe se e kishin zhvatur pronën e njerëzve të tjerë. Për ata nga ta që e refuzojnë të vërtetën kemi përgatitur torturë agonizuese.<sup>162</sup> Por ata nga ta – që kanë rrënjë të mira në dije dhe kanë besim – besojnë në atë që të është shpallur [ty Muhamed] dhe në atë që ishte shpallur para teje – ata që i kryejnë lutjet, e paguajnë lëmshën e përcaktuar dhe besojnë në **Allahun** dhe Ditën e Fundit – atyre Ne do t’u japim shpërblim të madh.

<sup>163</sup> Ne ta kemi dërguar shpalljen [Profet],

siç ia kemi dërguar Nuhut

dhe profetëve pas tij,

Ibrahimit dhe Ismailit dhe Is’hakut

dhe Jakubit dhe Fiseve

dhe Isait dhe Ejupit

dhe Junusit dhe Harunit

dhe Sulejmanit;

dhe Ne ia dhamë Dautit

librin [e Psalmeve, Zeburin] –

<sup>164</sup> dhe të dërguarve të tjerë

që t’i kemi përmendur

dhe disa të dërguarve

që nuk t’i kemi përmendur.

Dhe Musait **Allahu** i foli drejtpërdrejt.

<sup>165</sup> Ka pasur të dërguar

që sollën lajme të gëzuara

dhe që paralajmëruan,

që njerëzimi të mos ketë arsytim

para **Allahut**

pasi kishin ardhur të dërguarit.

Dhe **Allahu** është më i fuqishmi, më i urti.

<sup>166</sup> Por **Allahu** Vetë dëshmon

për atë që ta ka zbritur –

Ai e zbriti

me dijen E Tij të plotë –

dhe engjëjt dëshmojnë,

megjithëse **Allahu**

është dëshmitar i mjaftueshëm.

<sup>167</sup> Ata që nuk kanë besuar dhe i kanë ndaluar të tjerët nga rruga e **Allahut** kanë devijuar larg; <sup>168</sup> **Allahu** nuk do t'i falë ata që nuk kanë besuar dhe bëjnë keq, as s'do t'i udhëzojë në ndonjë rrugë <sup>169</sup> pos asaj të Ferrit, ku do të mbesin përgjithmonë – kjo është e lehtë për **Allahun**.

<sup>4:170</sup> I Dërguari ju ka ardhur [njerëz] me të vërtetën nga Zoti juaj, pra besoni – kjo është më e mira për ju – se edhe nëse nuk besoni, gjithçka që është në qiej dhe në tokë prapë i përket **Allahut** dhe Ai është i gjithë-dijshmi dhe i gjith'-urti.

<sup>171</sup> Njerëz të Librit,  
mos e teproni  
në fenë tuaj,  
dhe mos thoni për **Allahun**  
asgjë pos të vërtetës.  
Mesihu,  
Isai, i biri i Merjemes,  
nuk ishte asgjë më shumë  
se I Dërguar i **Allahut**  
dhe Fjalë nga Ai  
e drejtuar në Merjemen,  
dhe shpirt nga Ai.  
Pra besoni në **Allahun**  
dhe të dërguarit E Tij,  
dhe mos flisni për 'Trini',  
se është më mirë për ju të ndaleni.  
**Allahu** është i vetmi **Zot**,  
i vetmi i denjë për adhurim:  
lavdia **Allahut**,  
Ai është larg mbi të pasurit djalë,  
të gjitha në qiej dhe në tokë;  
i përkasin Atij  
dhe Ai është i mjaftueshëm

për t'i menaxhuar të gjitha.  
172 Mesihu  
nuk do ta përbuzte kurrë  
të jetë shërbyes i **Allahut**,  
dhe këtë s'do ta bënin as engjëjt intimë.  
Sa për ata që e përbuzin  
adhurimin e **Allahut**  
dhe që janë arrogantë,  
**Allahu** do t'i mbledhë  
të gjithë.

173 Por atyre që besojnë  
dhe bëjnë vepra të mira  
do t'ua japë shpërblimet e tyre  
dhe madje edhe më shumë  
nga mirësia E Tij hyjnore.  
Dhe ata që janë  
përbuzës dhe arrogantë  
do t'i disiplinojë  
me torturë të ashpër;  
dhe ata nuk do të gjejnë  
veç **Allahut**  
mbrojtës apo ndihmës për ta.

174 Njerëzim,  
ka ardhur një provë e qartë  
nga Zoti juaj:  
se Ne jua kemi dërguar  
një dritë të qartë.

175 Pra ata që besojnë në **Allahun**  
dhe i mbahen besnikë  
do t'i pranojë  
në mëshirën E Tij,  
dhe në mirësi.  
Dhe do t'i udhëzojë

kah Ai

në një rrugë të drejtë.

<sup>176</sup> Ata ta kërkojnë [ty Profet] një vendim. Thuaj: ‘**Allahu** jua jep një vendim<sup>a</sup> për trashëgiminë nga dikush që vdes pa fëmijë dhe pa prindër që janë gjallë. Nëse një burrë vdes dhe e lë një motër, asaj i takon gjysma e trashëgimisë; nëse ajo nuk ka fëmijë vëllai i saj është trashëgimtari i saj i vetëm; nëse janë dy motra, atyre u takojnë dy-të-tretat e trashëgimisë midis tyre, por nëse ka motra e vëllezër që janë gjallë, mashkullit i takon dyfishi i hises së femrës. **Allahu** jua bën këtë të qartë që të mos bëni gabime: Ai ka njohuri të plotë për gjithçka.’

---

<sup>a</sup> Shih edhe vargun 12.

## **Përshkrimi para kaptinës 4 nga Abdel Haleem:**

*Sure medinase që e merr titullin nga referencat e shumta për gratë përgjatë sures (vargjet 3-4, 127-30). I jep disa udhëzime, duke kërkuar drejtësi për fëmijët dhe jetimët dhe duke i përmendur ligjet e trashëgimisë dhe të martesës. Vargjet 5-12 të kaptinës i japin vendimet mbi pasurinë dhe trashëgiminë dhe po kështu vepron vargu që e përmbyll kaptinën. Kaptina flet edhe për tensionet midis bashkësisë myslimane në Medinë dhe disave nga Njerëzit e Librit (vargjet 44, 61), duke kaluar në një diskutim të përgjithshëm për luftën: ajo i paralajmëron myslimanët të jenë të kujdesshëm dhe t'i mbrojnë të dobëtit dhe të pafuqishmit (vargjet 71-6). Një tjetër temë e ngjashme është ajo e intrigave të hipokritëve (vargjet 88-91, 138-46).*

## **Shënimet gjuhësore (Thomas Cleary)**

*Gratë (al Nisaa') (Kaptina 4)*

Kjo sure u shpall në Medinë

- 1 “nga i cili e kërkon njëri-tjetrin”: Burrat dhe gratë duhet të kërkojnë nga njëri-tjetri marrëdhënie seksuale, në emër të Zotit.  
“jini nderues ndaj lidhjeve njerëzore”: Fjala për “lidhje njerëzore”, *al arhaam*, specifikisht domethënë lidhje gjaku (në shumës); gjithashtu domethënë mitra (në shumës). Fjalët për mirësi, dhembshuri dhe mëshirë vijnë po ashtu nga e njëjta rrënjë R-H-M. Ideja e përgjithshme e vargut është respekti për natyrën e shenjtë të lidhjeve njerëzore, duke i përfshirë lidhjet seksuale dhe riprodhimin.
- 3 Sipas Zonjës Ajshe, gruas së Profetit dhe Nënës së Besimtarëve, ky pasazh ua ndalon burrave të martohen me vajza jetime me pronë veç për pasurinë e tyre, pa ofruar dhuratë të drejtë të nuses. Një “vajzë nën kujdestarinë tuaj” fillimisht e kishte kuptimin e skllaves, të burgosurës së luftës.
- 4 Dhurata e nuses është për pavarësinë ekonomike të gruas; burri është i obliguar ta ofrojë këtë madje edhe nëse nusja e tij është e pasur tashmë. Nëse ajo është mirë dhe nuk ka nevojë për dhuratën e nuses, ajo mund t’ia japë vullnetarisht burrit të saj një pjesë apo tërë atë, por ky vendim është veç i saj.

- 5 Kjo e siguron kujdesin e atyre pa substancë apo mjete, të paaftë për t'u kujdesur për veten.
- 6 Këto janë udhëzime për kujdestarinë dhe disponimin e pasurisë trashëgimore të jetimëve: ata që vetë nuk janë në nevojë nuk duhet të marrin asnjë shpërblim për kujdestari, ndërsa njerëzit e varfër përgjegjës për jetimë kanë të drejtë ta pranojnë një kompensim të drejtë që janë kujdesur për çështjet e tyre. Në asnjë rast kujdestarët nuk duhet ta konsumojnë me ngut pasurinë e jetimëve në përpjekje për ta shijuar atë sa më shumë që është e mundur para se jetimët ta arrijnë moshën dhe të kenë të drejtë ta pranojnë trashëgiminë e tyre.
- 7 Pjesët për burra dhe për gra dallojnë se një burrë familjar është i obliguar t'i përkrahë të tjerët, gjersa një grua jo.
- 8 Është po ashtu një dispozitë për të bërë akte bamirësie nga një trashëgim sipas rrethanave dhe nevojave të situatës.
- 9 Kujdesuni për çështjet e jetimëve mu siç do të donit që për fëmijët tuaj të kujdeseshin po ta hasnit një fund të parakohshëm dhe t'i linit jetimë ata.
- 28 Si qenie e vdekshme, e përkohshme, njeriu është i dobët për nga natyra. Si vetëdije subjektive e ndjeshme ndaj shqetësimit emocional, kushtëzimit dhe varësisë, njeriu është i dobët psikologjikisht. Rrugët e jetës të përshkruara në ligjin e shenjtë janë mënyra të menaxhimit të këtyre dobësive më lehtë.
- 29 “Dhe mos e vritni veten”: Këtu, “veten” domethënë njëri-tjetrin, duke e theksuar unitetin e besimtarëve dhe po ashtu unitetin e njerëzimit si tërësi, të cilin Zoti “e bëri nga një shpirt”.
- 48 Zoti nuk e fal idhujtarinë, apo shoqërimin e çfarëdo gjëje me Zotin, se ai shoqërim është vetë shmangie e vëmendjes që qenësisht e tëhuajëson (e ftoh) individin nga Zoti. Prandaj vargu 50 thotë: “kjo është e vetëmjaftueshme për të qenë gabim i rëndë”.



- 53 A kanë ndonjë rol idhujt dhe hyjnitë e rreme në funksionimin e universit të vërtetë? Idhujt dhe idhujtarët nuk u japin njerëzve asgjë; ata veç marrin nga njerëzit.
- 97 Kur njerëzit e komprometojnë veten, mund të kërkojnë arsyeime nga situata e tyre, pa i eksploruar alternativat e tyre reale.
- 125 Rruga e Ibrahimit e nënkupton pranimin vetëm të realitetit absolut si Zot. Shprehja “kërkimi i të vërtetës” është parafrazim i *haniifan*, “të qenët të prirë për”, emër që u është dhënë kërkuesve të të vërtetës në kohën e Muhamedit.
- 164 Tradita Islame thotë se kanë qenë 128,000 profetë në tokë dhe 104 libra të zbritur. Tevrati, Psalmet, Ungjilli dhe Kurani konsiderohen katër më të rëndësishmit nga këta Libra nga pikëpamja e Traditës Islame. Jo të gjithë profetët ishin figura të mëdha publike si Musai, Isai dhe Muhamedi. Kurani thotë: “Ne kemi çuar të dërguar të tjerë para teje [Profet] – disa t’i kemi përmendur dhe disa jo” (40:78).
- 171 “mos e teproni në fenë tuaj”: Një nga shoqëruesit e Profetit tregoi se nuk e ka parë Profetin kaq të zemëruar sa në një rast kur dëgjoi se një Imam i caktuar po e zgjaste lutjen e mëngjesit aq shumë sa që e bënte të lodhshme për të tjerët.
- “shpirt nga Ai”: Duke iu referuar Isait si “shpirt nga Zoti”, fjala shpirt e përkthen fjalën *ruuh*, që domethënë frymë e jetës apo shpirt. Diku tjetër fjala “shpirt” (apo “xhind”) e përkthen fjalën *jinn*, “genii” dhe duhet të dallohet nga ky shpirt nga Zoti, i cili ishte Isai. Kurani e pohon unitetin e pakomromis të Zotit pa e zvogëluar dinjitetin e Isait – Mesihut si Fjalë, Shpirt, apo Frymë e Jetës nga Zoti.

## 5: Tryeza e gostisë (EL-MÂ'IDE)

Në emrin e **Allahut**, Dashmirësit, Mëshirëplotit

<sup>1</sup> Ju që besoni, përmbushni obligimet<sup>a</sup> tuaja. Kafshët e bagëtisë janë të ligjshme si ushqim për ju, me përjashtim të atyre që do t'ju njoftohen tani. E keni të ndaluar të vrisni gjah gjersa jeni në haxh – **Allahu** e urdhëron atë që do ta urdhërojë, <sup>2</sup> prandaj, ju që besoni, mos e shkelni shenjtërinë e riteve të **Allahut**, Muajin e Shenjtë, kafshët që theren si kurban, qaforet e tyre, as ata që po shkojnë në Shtëpinë e Shenjtë për ta kërkuar bollëkun dhe kënaqësinë e Zotit të tyre – por kur t'i keni kryer ritet e haxhit mund të bëni gjueti. Mos e lejoni urrejtjen tuaj për njerëzit që ju penguan për te Xhamia e Shenjtë t'ju nxisë ta shkelni ligjin: ndihmoni njëri-tjetrit ta bëni atë që është e drejtë dhe e mirë; mos e ndihmoni njëri-tjetrin drejt mëkatit dhe armiqësisë. Jini të vetëdijsëm për **Allahun**, se ndëshkimi I Tij është i ashpër.

<sup>3</sup> E keni të ndaluar të hani cofëtinë; gjak; mish të derrit; çfarëdo kafshe mbi të cilën është thirrur çfarëdo emri i ndryshëm nga i **Allahut**; çfarëdo kafshe të mbytur duke ia zënë frymën, apo viktimë e një goditjeje të dhunshme apo një rënieje, apo të shpuar me brirë apo të sulmuara ashpër nga një egërsirë, pos nëse prapë-se-prapë e preni atë [në mënyrën korrekte]; apo çkado të flijuar në altarë idhujtarë. Po ashtu e keni të ndaluar të shpërndani hise [të mishit] duke vizatuar shigjeta të shenjua<sup>b</sup> – një praktikë e neveritshme – sot mosbesimtarët e kanë humbur tërë shpresën se do të hiqni dorë nga feja juaj. Mos u frikësoni nga ta: m'u frikësoni Mua. Sot e kam përsosur fenë tuaj për ju, e kam kompletuar bekimin Tim mbi ju dhe e kam zgjedhur si fe tuajën *islamin*: [përkushtimin e plotë ndaj **Allahut**]; por nëse dikush nga ju detyrohet nga uria të hajë ushqim të ndaluar, pa asnjë synim të veprojë gabim, atëherë **Allahu** është më falësi dhe mëshirëploti.

<sup>4</sup> Të pyesin, Profet, çka është e ligjshme për ta. Thuaju: 'Të gjitha gjërat e mira janë të ligjshme për ju.' [Kjo i përfshin] ato që ua keni mësuar shpezëve dhe bishave tuaja të presë për t'i zënë, duke i mësuar siç ju ka mësuar **Allahu**, pra hajeni atë që ato e zënë për ju, por së pari shqiptojeni emrin e **Allahut** mbi të. Jini të vetëdijsëm për **Allahun**: Ai është i shpejtë në shqyrtim. <sup>5</sup> Sot të gjitha gjërat e mira janë bërë të ligjshme për ju. Ushqimi i Njerëzve të Librit është i ligjshëm për ju siç është ushqimi i juaj i ligjshëm për ta. Po kështu janë edhe gratë e dëlira,

---

<sup>a</sup> Obligimet që pasojnë me rastin e pranimit të besimit, duke i përfshirë ndalesat e tij në të ushqyer. Shih vargun 7, 'zotimi'.

<sup>b</sup> Zakon pagan arab. Shigjetat përdorëshin edhe për të marrë vendime të tjera, si në lojëra të fatit, për ta përcaktuar vullnetin e idhujve (shih vargun 90).

besimtare si dhe gratë e dëlira të njerëzve të cilëve u ishte dhënë Shkrimi i Shenjtë para juve, përderisa ua keni dhënë dhuratat e tyre të nuses dhe jeni martuar me to, e jo duke i marrë si dashnore apo konkubine të fshehta. Veprat e kujtdo që e refuzon besimin do të kthehen në asgjë dhe në Të Përtejmen do të jetë një nga humbësit.

<sup>6</sup> Ju që besoni, kur doni të luteni, lani fytyrat tuaja dhe duart tuaja deri te bërrylat, fshini kokat, lani shputat deri te nyjat dhe, nëse duhet,<sup>a</sup> lajeni tërë trupin tuaj. Nëse dikush nga ju është i sëmurë apo në udhëtim, apo sapo është çliruar nga një nevojë natyrore, apo kishte kontakt intim me një grua dhe nuk mund të gjejë ujë, atëherë merreni ca rërë të pastër dhe fshijeni fytyrën dhe duart me të. **Allahu** nuk dëshiron t'ju bëjë fare ngarkesë: Ai veç dëshiron t'ju pastrojë dhe ta përsosë bekimin E Tij në ju, që të mund të jeni falënderues.<sup>b</sup> <sup>7</sup> Kujtojeni bekimin e **Allahut** në ju dhe zotimin që e dhatë kur thatë: 'Dëgjojmë dhe bindemi.' Jini të vetëdijsëm për **Allahun**: **Allahu** ka njohuri të plotë për fshehtësitë e zemrës.

<sup>8</sup> Ju që besoni, jini të vendosur në përkushtimin tuaj ndaj **Allahut** dhe dëshmoni në mënyrë të paanshme: mos lejoni që urrejtja ndaj të tjerëve t'ju largojë nga drejtësia, por mbajuni drejtësisë, se kjo është më afër vetëdijesisë për **Allahun**. Jini të vetëdijsëm për **Allahun**: **Allahu** është fare mirë i informuar për gjithçka që bëni. <sup>9</sup> **Allahu** ka premtuar falje dhe shpërblim të shtrenjtë për ata që kanë besim dhe bëjnë punë të mira; <sup>5:10</sup> ata që e kundërshtojnë besimin dhe i refuzojnë shpalljet Tona do të bëhen banorë të Zjarrit flakëruës.

<sup>11</sup> Ju që besoni, kujtoni bekimet e **Allahut** në ju kur një popull i caktuar pothuajse i ngritën duart kundër jush dhe Ai i frenoi. Jini të vetëdijsëm për **Allahun**: besimtarët le ta kenë besimin e tyre në Të.

<sup>12</sup> **Allahu** mori zotim nga Fëmijët e Izraelit. Ne bëmë që dymbëdhjetë udhëheqës të ngriten ndër ta dhe **Allahu** tha: 'Unë jam me ju: nëse i mbani lutjet, e paguani lëmoshën e përcaktuar, besoni në të dërguarit E Mi dhe i përkrahni dhe ia huazoni **Allahut** një hua të mirë,<sup>c</sup> Unë do t'i fshij mëkatet tuaja dhe do t'ju pranoj në Kopshtet e hijeshuara me lumenj rrjedhës. Kushdo nga ju që tash e injoron këtë [zotim] do të jetë larg nga rruga e duhur. <sup>13</sup> Por ata e shkelën zotimin e tyre, kështu që i distancuam [nga Ne] dhe ua ngurtësuam zemrat. Ata e shtrembërojnë kuptimin e fjalëve [të shpallura] dhe i kanë harruar disa nga ato që ishin porositur t'i kujtonin: [ti Profet] gjithmonë do të gjesh tradhti te të gjithë

---

<sup>a</sup> p.sh. pas marrëdhënies seksuale apo shkarkimit të spermës.

<sup>b</sup> 'Përsosja e bekimit' shihet në udhëzimin e besimtarëve që ta shmangin atë që është e papastër në ushqim dhe të pastrohen para adhurimit. Kjo vërehet edhe në 4:43, ku është një udhëzim për t'u pastruar para lutjes duke e pasuar një udhëzim për të qenë larg nga ndotja e veprave të pamoralshme të përmendura në vargjet e mësipërme.

<sup>c</sup> Zoti e shpagueu atë që është dhënë për hir Të Tij, shumë-fish. Kurani e përdor këtë figurë të ligjëratës në shumë raste. Shih, për shembull, 57:18, 64:17.

ata pos pak prej tyre. Anashkaloje këtë dhe fali: **Allahu** i do ata që bëjnë mirë.<sup>14</sup> Ne po ashtu morëm zotim nga ata që thonë: ‘Jemi të krishterë’, por edhe ata i harruan disa nga ato që ishin porositur t’i kujtonin, kështu që shkaktuam armiqësi dhe urrejtje ndërmjet tyre deri në Ditën e Ringjalljes, kur **Allahu** do t’u tregojë se çka kanë bërë.

<sup>15</sup> Njerëz të Librit, I Dërguari Ynë ka ardhur t’jua qartësojë pjesën dërmuese të Shkrimit të Shenjtë që e keni mbajtur të fshehtë dhe ta anashkalojë [ta falë] shumicën [e asaj që e keni bërë]. Tani ju ka ardhur dritë nga **Allahu** dhe një Shkrim i Shenjtë që i qartëson gjërat,<sup>16</sup> me të cilin **Allahu** i udhëzon në rrugët e paqes ata që e ndjekin atë që e kënaq Atë, duke i nxjerrë nga errësira në dritë, me vullnetin E Tij dhe duke i udhëzuar në rrugë të drejtë.<sup>17</sup> Ata që thonë: ‘**Allahu** është Mesihu, i biri i Merjemes’ po e kundërshtojnë haptas të vërtetën. Thuaj: ‘Po të kish qenë vullneti i **Allahut**, a do të mundte kushdo ta ndalte Atë ta shkatërrojë Mesihun, të birin e Merjemes, bashkë me nënën e tij dhe gjithkë tjetër në tokë? Kontrolli i qiejve dhe i tokës dhe i tërë asaj që është ndërmjet tyre i përket **Allahut**: Ai krijon çkado që do të krijojë.<sup>a</sup> **Allahu** ka pushtet ndaj çdo gjëje.’<sup>18</sup> Çifutët dhe të krishterët thonë: ‘Ne jemi fëmijët e **Allahut** dhe të dashur për Të’. Thuaj: ‘Atëherë pse Ai ju ndëshkon për mëkatet tuaja? Ju jeni thjesht qenie njerëzore, pjesë e krijimit Të Tij: Ai e fal këdo që do ta falë dhe e ndëshkon këdo që do ta ndëshkojë. Kontrolli i qiejve dhe i tokës dhe i tërë asaj që është ndërmjet tyre i përket Atij: të gjitha udhëtimet çojnë tek Ai.’<sup>19</sup> Njerëz të Librit, I Dërguari Ynë vjen te ju tani, pas një ndërprerjeje në vargun e të dërguarve, për t’i bërë gjërat të qarta për ju në rast se do të thoshit: ‘Askush nuk ka ardhur të na japë lajm të mirë apo të na paralajmërojë.’ Pra dikush ju ka ardhur, t’ju japë lajm të mirë dhe t’ju paralajmërojë: **Allahu** e ka fuqinë t’i bëjë të gjitha gjërat.

<sup>5:20</sup> Musai i tha popullit të tij: ‘Populli im, kujtojeni bekimin e **Allahut** mbi ju: si ngriti Ai profetë midis jush dhe caktoi mbretër për ju dhe jua dha atë që nuk ia kishte dhënë asnjë populli tjetër.’<sup>21</sup> Populli im, shkoni në tokën e shenjtë të cilën e ka caktuar **Allahu** për ju – mos e ktheni shpinën përndryshe do të jeni humbësit.’<sup>22</sup> Ata thanë: ‘Musa, është një popull i frikshëm në atë tokë. Nuk do të shkojmë atje deri kur të largohen. Nëse largohen, atëherë do të hyjmë.’<sup>23</sup> Megjithatë dy burra të cilët **Allahu** i kish bekuar midis atyre që kishin frikë thanë: ‘Hyni te ta përmes portës dhe kur të hyni do t’i mposhtni. Në qofshi besimtarë të vërtetë, kijeni besimin tuaj në **Allahun**.’<sup>24</sup> Ata thanë: ‘Musa, ne kurrë nuk do të hyjmë gjersa janë ende aty, kështu që ti dhe Zoti yt futuni dhe luftoni dhe ne do të rrimë këtu.’<sup>25</sup> Ai tha: ‘Zot, unë nuk kam autoritet ndaj askujt pos vetes dhe vëllait tim: gjyko ndërmjet neve dyve dhe këtyre njerëzve të pabindur.’<sup>26</sup> **Allahu** tha: ‘Atyre u është ndaluar vendi për dyzet vite: do të bredhin nëpër tokë pa drejtim. Mos u pikëllo për ata që janë të pabindur.’

---

<sup>a</sup> Duke e përfshirë edhe krijimin E Tij të Isait pa baba (3:47 dhe 59).

<sup>27</sup> [Profet,] tregojua të vërtetën për rrëfimin e dy bijve të Ademit: secili nga ta ofroi flijim dhe njërit i ishte pranuar e tjetrit jo. Njëri tha: ‘Do të të vras’, por tjetri tha: ‘**Allahu** e pranon veç flijimin e atyre që janë të vetëdijshëm për Të.’  
<sup>28</sup> Nëse e ngrit dorën të më vrasësh, unë nuk do ta ngris timen të të vras. I frikësohem **Allahut**, Zotit të të gjitha botëve,<sup>29</sup> dhe për mua do të ishte më mirë që ti të ngarkoheshe me mëkatet e mija si dhe me tuat dhe të bëheshe banor i Zjarrit: i tillë është shpërblimi i keqbërësve.’<sup>5:30</sup> Por shpirti i tij e nxiti ta vrasë vëllain e tij: e vrau dhe u bë një nga humbësit.<sup>31</sup> **Allahu** e dërgoi një korb ta gërvishtë tokën dhe t’i tregojë se si ta mbulojë kufomën e vëllait të tij dhe ai tha: ‘I mjeri unë! A s’do të mund të isha si ky korb e ta mbuloja trupin e vëllait tim?’ U bë i penduar.<sup>32</sup> Për shkak të [veprës së tij], Ne i lëshuam urdhër Fëmijëve të Izraelit që nëse dikush e vret një person – pos si ndëshkim për vrasje apo për shpërndarje të korrupsionit në vend – është sikur ta vraste tërë njerëzimin, ndërsa nëse dikush e shpëton një jetë është sikur t’i shpëtonte jetët e tërë njerëzimit. Të dërguarit Tanë u erdhën me shenja të qarta, por shumë nga ta vazhduan të bëjnë teprime në vend.<sup>33</sup> Ata që bëjnë luftë kundër **Allahut** dhe Të Dërguarit Të Tij dhe përpiqen të përhapin korrupsion në vend duhet të ndëshkohen me vdekje, me kryqëzim, me amputim të një dore dhe shpute të tërthortë<sup>a</sup>, apo me dëbim nga vendi: një turp për ta në këtë botë dhe pastaj një ndëshkim i tmerrshëm në Të Përtejmen,<sup>34</sup> pos nëse pendohen para se t’i mposhtni – në atë rast kujtojeni se **Allahu** është falës dhe mëshirëplotë.

<sup>35</sup> Ju që besoni, jini të vetëdijshëm për **Allahun**, kërkoni mënyra t’i afroheni dhe përpiquni për çështjen E Tij, që të mund të përparoni.<sup>36</sup> Po ta posedonin mosbesimtarët tërë atë që është në tokë dhe edhe dyfishin e saj dhe po ta ofronin si pagesë për t’u çliruar nga tortura në Ditën e Ringjalljes, nuk do të pranohej nga ta – do të kenë torturë të dhembshme.<sup>37</sup> Do të duan të dalin nga Zjarri por nuk do të jenë në gjendje ta bëjnë këtë: tortura e tyre do të jetë e përhershme.

<sup>38</sup> Pritini duart e hajdutëve, qofshin burra a gra, si ndëshkim për atë që e kanë bërë – një frenues nga **Allahu**: **Allahu** është i gjithëfuqishëm dhe i urtë.<sup>39</sup> Por nëse dikush pendohet pas veprave të tyre të gabuara dhe bën përmirësime, **Allahu** do ta pranojë pendimin e tij: **Allahu** është më falësi, më mëshirëploti.<sup>5:40</sup> A nuk e di [Profet] se kontrolli i qiejve dhe i tokës i përkasin veç **Allahut**? Ai e ndëshkon këdo që do ta ndëshkojë dhe e fal këdo që do ta falë: **Allahu** ka pushtet mbi gjithçka.

<sup>41</sup> I Dërguar, mos u pikëllo nga ata që garojnë ta tejkalojnë njëri-tjetrin në mosbesim – ata që thonë me gojën e tyre: ‘Besojmë’, por nuk kanë besim në zemrat e tyre dhe çifutët që i dëgjojnë me etje rrenat dhe i dëgjojnë ata që madje as s’të kanë takuar, që i shtrembërojnë kuptimet e fjalëve [të shpallura] dhe [i]

---

<sup>a</sup> Dora e majtë dhe shputa e djathtë apo e kundërta.

thonë [njëri-tjetrit]: ‘Nëse ju jepet ky vendim, pranojeni, por nëse nuk ju jepet, atëherë kini kujdes!’<sup>a</sup> – nëse **Allahu** synon që disa njerëz të jenë kaq të devijuar, do të jesh i pafuqishëm kundër **Allahut** në emër të tyre. Këta janë ata zemrat e të cilëve **Allahu** nuk synon t’i pastrojë – një turp për ta në këtë botë dhe pastaj një ndëshkim i rëndë në Të Përtejmen – <sup>42</sup> ata i dëgjojnë me etje rrenat dhe e konsumojnë atë që është e paligjshme. Nëse vijnë te ti [Profet] për gjykim, ose mund të gjykosh ndërmjet tyre, ose të refuzosh – nëse refuzon, ata nuk do të të dëmtojnë në asnjë mënyrë, por nëse gjykon ndërmjet tyre, gjyko drejt: **Allahu** i do të drejtët – <sup>43</sup> por pse të vijnë te ti për gjykim kur e kanë Teuratin me gjykimin e **Allahut** dhe madje edhe atëherë prapë e kthejnë shpinën? Këta nuk janë besimtarë.

<sup>44</sup> Jemi Ne

që e dërguam Teuratin,  
në të udhëzim e dritë.  
Profetët që iu dorëzuan **Allahut**  
gjykuan sipas tij për çifutët,  
dhe po kështu bënë edhe rabinët dhe dijetarët,  
në pajtim me atë pjesë  
të Shkrimit të Shenjtë të **Allahut**  
që u ishte besuar ta ruanin  
dhe për të cilin ishin dëshmitarë.  
Prandaj [rabinë e dijetarë]  
mos kini frikë nga njerëzit  
por m’u frikësoni Mua;  
dhe mos i shitni shenjat E Mija  
për çmim të vockël.  
Dhe ata që nuk gjykojnë  
sipas asaj që e ka shpallur **Allahu**  
janë [përçmues mosmirënjohës]  
duke [i] refuzuar [mësimet e **Allahut**].

---

<sup>a</sup> Sipas shumicës së interpretuesve, kjo i referohet një rasti ku një çifut i shquar dhe një grua bënë marrëdhënie jashtëmartesore. Komuniteti çifut nuk donte ta zbatonte ndëshkimin biblik të gjuajtjes me gurë, kështu që dërguan përfaqësues te Profeti për ta kërkuar një vendim, duke thënë: ‘Nëse ju urdhëron ta zbatoni rrahjen me kamzhik pranojeni, por nëse e urdhëron gjuajtjen me gurë, mos e pranoni’ (Razi).

<sup>45</sup> Në Teurat Ne e përcaktuam për ta një jetë për një jetë, një sy për një sy, një hundë për një hundë, një vesh për një vesh, një dhëmb për një dhëmb, një plagë të njëjtë për një plagë: nëse dikush vendos të heqë dorë nga këto për shkak të bamirësisë, kjo do të shërbejë si shlyerje për veprat e tyre të këqija. Ata që nuk gjykojnë sipas asaj që e ka shpallur **Allahu** po bëjnë gabim të rëndë.

<sup>46</sup> Ne bëmë që Isai, i biri i Merjemes,  
t'u vijojë gjurmëve të tyre  
për ta konfirmuar të vërtetën  
e Teuratit para tij;  
dhe ia dhamë Ungjillin,  
në të udhëzim e dritë,  
duke e konfirmuar edhe të vërtetën  
e Teuratit para tij,  
si udhëzim e këshillë  
për të vetëdijshtmit për **Allahun**.

<sup>47</sup> Dhe njerëzit e Ungjillit  
le të gjykojnë sipas asaj që **Allahu** shpalli aty;  
dhe ata që nuk gjykojnë  
sipas asaj që e ka shpallur **Allahu**,  
janë shkelësit e ligjit.

<sup>48</sup> Dhe Ne ta dërguam Librin [ty Muhamed]  
me të vërtetën, duke i vërtetuar  
Shkrimet e Shenjta para tij  
dhe me autoritet final mbi to  
[dhe duke i ruajtur ato].  
Pra gjyko ndërmjet tyre  
sipas asaj që e ka shpallur **Allahu**;  
dhe mos i ndiq tekat e meraket e tyre  
larg nga e vërteta  
që të ka ardhur.  
Për secilin nga ju  
e kemi përcaktuar një ligj

dhe një rrugë të hapur.  
Dhe po të donte **Allahu**  
do t'ju bënte  
një popull të vetëm;  
por Ai po ju sprovon  
në atë që jua ka dhënë.  
Pra shpejtoni [kah virtytet]  
për të bërë mirë:  
të gjithë do të ktheheni te **Allahu**  
dhe Ai do t'jua qartësojë  
çështjet në të cilat patët dallime.

<sup>49</sup> Prandaj [Profet]  
gjyko midis tyre  
sipas asaj që e ka shpallur **Allahu**,  
dhe mos i ndjek teket e merakët e tyre,  
dhe ruaju nga ta  
të të mos joshin  
të largohesh nga ndonjë pjesë  
e asaj që ta ka shpallur **Allahu**.  
Dhe nëse largohen,  
kujtoje se **Allahu** synon t'i ndëshkojë  
për disa nga mëkatet që i kanë bërë.  
Dhe në fakt shumica e njerëzimit janë shkelës të ligjit.

<sup>5:50</sup> Pra a e duan gjykimin  
e kohës së padijes pagane?  
Dhe kush është më i mirë se **Allahu** në gjykim  
për një popull me besim të qëndrueshëm?

<sup>51</sup> Ju që besoni, mos i bëni aleatë çifutët dhe të krishterët:<sup>a</sup> ata janë aleatë veç të njëri-tjetrit. Kushdo që i bën aleatë bëhet një nga ta – **Allahu** nuk i udhëzon keqbërësit e tillë – <sup>52</sup> megjithatë [ti Profet] do t'i shohësh të çoroditurit në zemër duke u turrur kah ta për mbrojtje, duke thënë: 'Kemi frikë se fati mund të

---

<sup>a</sup> D.m.th. ata që janë kundër kampit mysliman, siç është e qartë nga vargjet në vijim, deri te 59. 'Mos u ktheni kah ta si aleatë duke i preferuar para myslimanëve' (shiko 4:144).



kthehet kundër nesh.’ Por **Allahu** fare mirë mund ta sjellë një triumf apo ndonjë ngjarje tjetër të shkaktuar nga Ai: atëherë do të pendohen për fshehtësitë që i ushqyen në zemrat e tyre,<sup>53</sup> dhe besimtarët do të thonë: ‘A janë këta njerëzit që u betuan për **Allahun** – duke i përdorur betimet e tyre më të forta – se ishin me ju?’ Krejt çka bënë ishte e kotë: kanë humbur gjithçka.

<sup>54</sup> Besimtarë,  
nëse cilido nga ju  
ia ktheni shpinën besimit tuaj,<sup>a</sup>  
**Allahu** do t’ju zëvendësojë me një popull  
që i do  
dhe që e duan:  
modestë ndaj besimtarëve  
të fortë kundër mosbesimtarëve,  
dhe që përpiqen në rrugën e **Allahut**  
pa frikë nga qortimi i kujtdo.  
Kjo është mirësia e **Allahut**,  
që e dhuron te kushdo që do ta dhurojë;  
dhe **Allahu** ka bollëk e dije të pafund.

<sup>55</sup> Aleatët tuaj të vërtetë  
janë **Allahu**, I Dërguari I Tij,  
dhe ata që besojnë,  
ata që falen vazhdimisht  
dhe e japin lëmoshën e përcaktuar,  
dhe i përkulen **Allahut** në adhurim.

<sup>56</sup> Ata që i kthehen për mbrojtje  
**Allahut**, Të Dërguarit Të Tij  
dhe besimtarëve  
[janë pala e **Allahut**]:  
vërtet pala e **Allahut**  
sigurisht që triumfon.

---

<sup>a</sup> Ajo që synohet në këtë kontekst është ‘duke i bërë aleatë ata’.

- 57 Ju që besoni,  
mos i bëni aleatë  
ata që me fenë tuaj  
bëjnë tallje e lojë,  
qofshin prej atyre  
që Libri u ishte dhënë para jush,  
apo qofshin mosbesimtarë.  
Dhe jini të vetëdijsëm për **Allahun**,  
në qofshi besimtarë të vërtetë.
- 58 Se kur thirrni për lutje  
kjo u duket tallje e lojë;  
se janë njerëz  
që nuk kuptojnë.
- 59 Thuaj [Profet]:  
“Njerëz të Librit!  
A na e keni inat për çkado qoftë  
pos për atë se besojmë në **Allahun**  
dhe në atë që na është zbritur  
dhe në atë që është zbritur më parë,  
gjersa shumica nga ju jeni të pabindur?”
- 5:60 Thuaj:  
“A t’ju tregoj  
se kush meriton ndëshkim më të keq nga **Allahu**  
sesa [ai që e doni mbi] ne?  
Ata që **Allahu** i distancoi nga Vetja,  
dhe me të cilët ishte i zemëruar,  
dhe i ndëshkoi si majmunë e derra,<sup>a</sup>  
dhe ata që adhurojnë idhuj:  
ata janë më të këqij në gradë  
dhe kanë devijuar më larg  
nga rruga e drejtë.”

---

<sup>a</sup> Tabari (në komentin e tij për 2:65) e konsideron këtë si metaforike në kuptimin e ‘si majmunët, derrat’. Krahasoje përdorimin metaforik të ‘të verbër, të shurdhër e memecë’ – 2:18; 5:71; 8:22; 43:40 etj.

<sup>61</sup> Kur vijnë te ju [besimtarë], thonë: ‘Besojmë’, por vijnë mosbesues dhe shkojnë mosbesues – **Allahu** e di më së miri se çka po fshehin. <sup>62</sup> Ti [Profet] i sheh shumë nga ta duke nxituar në mëkat dhe armiqësi dhe duke e konsumuar atë që është e paligjshme. Sa të këqija janë praktikat e tyre! <sup>63</sup> Pse rabinët dhe dijetarët e tyre nuk i ndalojnë të flasin në mënyrë mëkatore dhe ta konsumojnë atë që është e paligjshme? Sa të këqija janë veprat e tyre! <sup>64</sup> Çifutët kanë thënë: ‘**Allahu** është koprrac’, por janë ata që janë koprracë dhe ata janë refuzuar për atë që e kanë thënë. Vërtet, duart e **Allahut** janë të hapura gjerësisht: Ai jep si të dojë. Ajo që të është zbritur nga Zoti yt sigurisht që do ta rrisë paturpësinë dhe kundërshtimin e hapur të shumë nga ta. Ne kemi mbjellë armiqësi dhe urrejtje mes tyre deri në Ditën e Ringjalljes. Kurdoherë që e ndezin zjarrin e luftës, **Allahu** do ta shuajë. Përpiqen të përhapin korrupsion në vend, por **Allahu** nuk i do ata që korruptojnë.

<sup>65</sup> Por sikur njerëzit e Librit  
të besonin dhe të ishin të vetëdijsëm për **Allahun**,  
Ne sigurisht që do t’ua fshinin mëkatet e tyre  
dhe do t’i sillnim  
në Kopshtet e Kënaqësisë.

<sup>66</sup> Po ta përkrahnin Teuratin dhe Ungjillin dhe atë që iu zbrit atyre nga Zoti i tyre, do t’u jepej begati nga lart dhe nga poshtë: disa nga ta janë në drejtimin e duhur, por shumë nga ta bëjnë keq.

<sup>67</sup> I Dërguar,  
shpall gjithçka që të është zbritur  
nga Zoti yt –  
se nëse nuk e bën këtë,  
ti nuk e ke komunikuar  
mesazhin E Tij –  
dhe **Allahu** do të të mbrojë  
nga njerëzit;  
se **Allahu** nuk i udhëzon  
ata që e refuzojnë Atë.

- 68 Thuaj:  
“Njerëz të Librit,  
nuk keni bazë të vërtetë  
[për fenë tuaj]  
deri kur ta përkrahni  
Teuratin dhe Ungjillin  
dhe atë që ju është zbritur  
nga Zoti juaj.”  
Por te shumica nga ta  
ajo që të është zbritur  
nga Zoti yt  
sigurisht që e rrit  
paturpësinë dhe kundërshtimin:  
mos u shqetëso  
për ata që [e] kundërshtojnë [**Allahun**].
- 69 Vërtet, qofshin besimtarë [myslimanë],  
çifutë, sabianë,<sup>a</sup> a të krishterë,  
ata që besojnë në **Allahun**  
dhe në Ditën e Fundit  
dhe bëjnë vepra të mira  
nuk kanë pse të frikësohen:  
nuk do të pikëllohen.

<sup>5:70</sup> Ne morëm zotim nga Fëmijët e Izraelit dhe ua çuam disa të dërguar. Sa herë që një i dërguar u sillte diçka që nuk u pëlqente, disa i akuzonin për gënjeshtria dhe të tjerët i çonin në vdekje;<sup>71</sup> menduan se nuk mund t’u vinte asnjë dëm dhe kështu u bënë të verbër e të shurdhër [ndaj **Allahut**]. **Allahu** u kthye kah ta në mëshirë por shumë nga ta përsëri u bënë të verbër e të shurdhër: **Allahu** është plotësisht i informuar për veprimet e tyre.<sup>72</sup> Ata që thonë: ‘**Allahu** është Mesihu, i biri i Merjemes’, e kanë kundërshtuar haptas **Allahun**. Vetë Mesihu tha: ‘Fëmijë të Izraelit, adhurojeni **Allahun**, Zotin tim dhe Zotin tuaj.’ Nëse dikush shoqëron të tjerë me **Allahun**, **Allahu** do ta ndalojë nga Kopshti, dhe Ferri do të jetë shtëpia e tij. Askush nuk do t’u ndihmojë keqbërësve të tillë.

---

<sup>a</sup> Shih shënimin për 2:62: sabianët ishin komunitet religjioz monoteist. Shih M. Asad, *The Message of the Qur’an* (Gibraltar: Dar alAndalus, 1997), 40 n. 49.)

<sup>73</sup> Ata njerëz që thonë se **Allahu** është i treti nga tre po [e] kundërshtojnë haptas [të vërtetën]: është veç Një **Zot**. Nëse ngulin këmbë në atë që po e thonë, një ndëshkim i dhembshëm do t'i kapë ata nga ta që ngulin këmbë. <sup>74</sup> Pse nuk kthehen kah **Allahu** dhe ta kërkojnë faljen E Tij, kur **Allahu** është më falësi, më mëshirëploti? <sup>75</sup> Mesihu, i biri i Merjemes, ishte veç i dërguar; para tij patën ardhur dhe shkuar të dërguar të tjerë; nëna e tij ishte grua e virtytshme; të dy hanin ushqim [si vdekatarët e tjerë]. Shihni sa të qarta i kemi bërë Ne këto shenja për ta; shihni se sa të mashtruar janë. <sup>76</sup> Thuaj: 'Si mund të adhuroni diçka tjetër pos **Allahut**, e cila nuk ka fuqi t'ju bëjë dëm apo mirë? Veç **Allahu** është Gjithë-Dëgjuesi dhe I Gjithë-Dijshmi.' <sup>77</sup> Thuaj: 'Njerëz të Librit, mos i tejkaloni kufijtë e së vërtetës në fenë tuaj dhe mos i ndiqni tekat e atyre që devijuan para jush – ata devijuan shumë të tjerë dhe vetë vazhdojnë të devijojnë nga rruga e lëmueshme.'

<sup>78</sup> Ata Fëmijë të Izraelit që [e] kundërshtuan haptas [**Allahun**] u refuzuan përmes fjalëve të Dautit dhe të Isait, të birit të Merjemes, se ishin të pabindur, i tejkaluan me këmbëngulje kufijtë, <sup>79</sup> dhe nuk e ndaluan njëri-tjetrin të bëjnë gabime. Sa të ndyra ishin veprat e tyre! <sup>5:80</sup> Ti [Profet] i sheh shumë nga ta duke u bërë aleatë me mosbesimtarët. Sa e tmerrshme është ajo që shpirtrat e tyre e kanë depozituar për vete: **Allahu** është i zemëruar me ta dhe do të mbesin të torturuar. <sup>81</sup> Po të kishin besuar në **Allahun**, në Profetin dhe në atë që i ishte zbritur atij, nuk do të bëheshin kurrë aleatë me mosbesimtarët, por shumica nga ta janë rebelë.

<sup>82</sup> [Ti Profet] sigurisht që do ta shohësh se më armiqësorët ndaj besimtarëve janë çifutët dhe ata që shoqërojnë hyjni të tjera me **Allahun**; sigurisht që do ta shohësh se më të afërmit në përkushtim ndaj besimtarëve janë ata që thonë: 'Jemi të krishterë' se ka ndërmjet tyre njerëz të përkushtuar ndaj mësimit dhe asketë.<sup>a</sup> Këta njerëz nuk u janë dhënë arrogancës, <sup>83</sup> dhe kur dëgjojnë se çka i është zbritur Të Dërguarit, do t'i shihni sytë e tyre të mbushur me lotë se e njohin Të Vërtetën [në të]. Thonë: 'Zoti ynë, besojmë, prandaj na llogarit në mesin e dëshmitarëve.

<sup>84</sup> Dhe pse të mos besonim në **Allahun**  
dhe Të Vërtetën që na ka zbritur  
kur jemi të etur që Zoti ynë  
të na lejojë të jemi  
në shoqërinë e të ndershmëve?'

---

<sup>a</sup> Shumica e përkthyesve i përkthejnë këto si 'priftërinj dhe murgj', që janë kuptimet e tyre bashkëkohore, e jo domethëniet etimologjike të fjalëve (al-Raghib, *Mufradat*).

<sup>85</sup> Për shkak se e thonë këtë, **Allahu** i ka shpërblyer me Kopshte të hijeshuara me lumenj rrjedhës dhe aty do të rrinë: ky është shpërblimi për ata që bëjnë mirë.

<sup>86</sup> Ata që e kundërshtojnë të vërtetën dhe i mohojnë mesazhet Tona do të jenë banorë të Zjarrit të Ferrit.

<sup>87</sup> Ju që besoni, mos i ndaloni gjërat e mira që **Allahu** i ka bërë të ligjshme për ju – mos i tejkaloji kufijtë: **Allahu** nuk i do ata që i tejkalojnë kufijtë – <sup>88</sup> por hani gjërat e ligjshme e të mira që **Allahu** i furnizon për ju. Jini të vetëdijsëm për **Allahun**, në të cilin besoni. <sup>89</sup> **Allahu** nuk ju merr [në përgjegjësi] për atë që është e pamend në betimet tuaja,<sup>a</sup> veç për betimet obliguese: shlyerja për shkeljen e një betimi është t'i ushqeni dhjetë njerëz të varfër me ushqim të barasvlefshëm me atë që normalisht do t'ju jepnit familjeve tuaja, apo t'i vishni, apo ta çlironi një skllav – nëse një person nuk mund t'i gjejë mjetet, duhet të agjërojë tri ditë. Kjo është shlyerja për shkeljen e betimeve tuaja – mbani betimet tuaja. Në këtë mënyrë **Allahu** jua qartëson shpalljet E Tij, që të mund të jeni falënderues.

<sup>5:90</sup> Ju që besoni, materiet dehëse dhe bixhozi, praktikat idhujtare dhe [parashikimi me]<sup>b</sup> shigjetat janë vepra të neveritshme – veprime të Satanit – shmangiuni që të mund të përparoni. <sup>91</sup> Me materie dehëse dhe bixhoz, Satani kërkon veç të nxisë armiqtë dhe urrejtje mes jush dhe t'ju ndalë ta kujtoni **Allahun** dhe lutjet. A nuk do të hiqni dorë nga to? <sup>92</sup> Bindjuni **Allahut**, bindjuni Të Dërguarit dhe gjithmonë kini kujdes: nëse nuk jeni të vëmendshëm, mbani mend se detyra e vetme e Të Dërguarit Tonë është ta japë mesazhin qartë. <sup>93</sup> Ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira nuk do të fajësohen për atë që mund ta kenë konsumuar [në të shkuarën]<sup>c</sup> përderisa janë të vetëdijsëm për **Allahun**, besojnë dhe bëjnë vepra të mira, pastaj janë të vetëdijsëm për **Allahun** dhe besojnë, pastaj janë të vetëdijsëm për **Allahun** dhe bëjnë vepra të mira: **Allahu** i do ata që bëjnë vepra të mira.

<sup>94</sup> Ju që besoni, sigurisht që **Allahu** do t'ju sprovtojë me kafshë gjahu aty ku mund të arrijnë duart dhe shtizat tuaja, për ta zbuluar se kush i frikësohet Atij edhe pse nuk mund ta shohin Atë: tash e tutje, kushdo që bën shkelje do të ketë ndëshkim të dhembshëm.<sup>d</sup> <sup>95</sup> Ju që besoni, mos vrisni kafshë gjahu gjersa jeni në gjendje të shenjtërimit [për haxh]. Nëse dikush e bën këtë me qëllim, ndëshkimi është ofrimi i një kafshe shtëpiake të sjellur në Qabe, të barasvlefshme me atë që e ka vrarë – siç gjykohet nga dy njerëz të drejtë midis jush; alternativisht, ai mund

---

<sup>a</sup> Disa myslimanë u betuan të hiqnin dorë nga bota dhe të mos hanin ushqime të caktuara të mira as të vishnin rroba të mira dhe kur atyre iu tha se kjo ishte e gabuar, e pyetën Profetin se çka do të mund të bënin për betimet e tyre.

<sup>b</sup> Shih shënimin për vargun 3 më lart.

<sup>c</sup> Ishte raportuar se kur ishte ndaluar vera, disa shoqërues e pyetën Profetin: 'E çka për ata besimtarë që kanë pirë dhe tashmë kanë vdekur? Në çfarë gjendje do të jenë ata?' Kjo është përgjigje për atë pyetje, dhe vlen edhe për të gjallët.

<sup>d</sup> Në botën tjetër.

të shlyhet duke ushqyer njerëz në nevojë apo duke agjëruar numër të barasvlefshëm të ditëve, që të mund ta ndiejë peshën e plotë të veprës së tij. **Allahu** e fal atë që është e shkuar, por nëse dikush bën rishkelje, **Allahu** do ta detyrojë ndëshkimin për të: **Allahu** është i fuqishëm dhe i aftë për ta detyruar ndëshkimin.<sup>96</sup> Ju është lejuar të zini dhe të hani ushqim të detit – një kënaqësi për juve dhe udhëtarin – por gjuetia e kafshëve të egra në tokë është e ndaluar gjersa jeni në gjendje të shenjtërimit [për haxh]. Jini të vetëdijsëm për **Allahun** tek I Cili do t'ju mbledhin.

<sup>97</sup> **Allahu** e ka bërë Qaben – Shtëpinë e Shenjtë – mjet të përkrahjes për njerëzit,<sup>a</sup> dhe Muajt e Shenjtë, kafshët për flijim dhe dekorimet e tyre: tërë këtë. Dijeni se **Allahu** ka dije për tërë atë që është në qiej dhe në tokë dhe se është plotësisht i informuar për të gjitha gjërat.<sup>98</sup> Dijeni po ashtu se **Allahu** është i ashpër në ndëshkim e megjithatë më falësi dhe më mëshirëploti.<sup>b</sup> <sup>99</sup> Detyra e Të Dërguarit është veç ta dërgojë mesazhin: **Allahu** e di se çka shfaqni dhe çka fshehni.

<sup>5:100</sup> Thuaj [Profet]: 'E keqja nuk mund të krahasohet me të mirën, megjithëse mund të mahniteni se sa e begatshme është e keqja. Jini të vetëdijsëm për **Allahun**, o njerëz të t'kuptuarit, që të mund të përparoni.'<sup>101</sup> Ju që besoni, mos pyetni për çështje të cilat, nëse ju bëhen me dije, mund t'i vështirësojnë gjërat për ju – nëse pyetni për to gjersa Kurani është duke u shpallur, ato do t'ju bëhen të qarta – se **Allahu** ka qenë i heshtur për to: **Allahu** është më falësi dhe i duruari.<sup>102</sup> Para jush, disa njerëz pyetën për gjëra, pastaj [i] injoruan [përgjigjet].<sup>103</sup> **Allahu** nuk e ka inicuar përkushtimin e gjërave të tilla si *bahira*, *sa'iba*, *wasila*, apo *ham*<sup>c</sup> për idhujt; por mosbesimtarët shpikin rrena për **Allahun**. Shumica nga ta nuk e përdorin arsyen: <sup>104</sup> kur u thuhet: 'Ejani tek ajo që e ka zbritur **Allahu** dhe tek I Dërguari', thonë: 'Ajo që e kemi trashëguar nga paraardhësit tanë është mjaft e mirë për ne' edhe pse paraardhësit e tyre nuk dinin asgjë dhe nuk ishin të udhëzuar.<sup>105</sup> Ju që besoni, jeni përgjegjës për shpirtrat tuaj; nëse dikush tjetër devijon kjo nuk do t'ju dëmtojë përderisa e ndiqni udhëzimin; të gjithë do të ktheheni te **Allahu** dhe Ai do t'ju bëjë ta kuptoni se çka keni bërë.

<sup>106</sup> Ju që besoni, kur vdekja t'i afrohet dikujt nga ju, le të bëhen dëshmitarë dy njerëz të drejtë nga ju për ta bërë testamentin, apo dy njerëz nga një popull tjetër nëse jeni duke udhëtuar nëpër vend kur afrohet vdekja. Mbani dy dëshmitarë pas lutjeve, nëse keni ndonjë dyshim dhe bëjini të dytë të betohen në **Allahun**:

---

<sup>a</sup> Qabja është qendra e haxhit, duke i sjellë njerëzit nga të gjitha anët e botës, ku myslimanët lejohen të bëjnë tregti – Muajt e Shenjtë e garantuan sigurinë e tyre. Flijimet sigurojnë mjete të jetesës për të varfërit dhe njerëzit në nevojë dhe zakoni i dekorimit të një kafshe i jep asaj mbrojtje të veçantë. Përveç të gjitha këtyre përfitimeve materiale, janë përfitimet shpirtërore të adhurimit të **Allahut**. Ky është një shembull i bashkimit të njerëzve në paqe (Razi).

<sup>b</sup> Ky është paralajmërim për ata që i shkelin këto rite dhe i referohet vargut 2 në këtë sure.

<sup>c</sup> Klasë të ndryshme të kafshëve të liruara nga puna apo përdorimi si ushqim, për nder të idhujve dhe të respektuara nga arabët paganë.

‘Nuk do ta shesim dëshminë tonë për asnjë çmim, madje edhe nëse është përfshirë një i afërm i ngushtë. Nuk do ta fshehim dëshminë e **Allahut**, se pastaj do të ishim duke bërë keq.’<sup>107</sup> Nëse zbulohet se këta dy janë fajtorë [për dëshmi të rreme nën betim], dy nga ata të cilëve u është bërë e padrejtë kanë më shumë të drejtë të dëshmojnë në vend të tyre. Le të betohen në **Allahun**: ‘Dëshmia jonë është më e vërtetë se e tyrja. Nuk kemi thënë asgjë tjetër pos të vërtetës, se ndryshe do të bëheshim keqbërës’:<sup>108</sup> kjo do ta bëjë më të pritshme që ata do të japin dëshmi të vërtetë dhe të duhur, apo të frikësohen se betimet e tyre mund të përgënjeshtrohen nga të tjerët më vonë. Jini të vetëdijsëm për **Allahun** dhe dëgjoni; **Allahu** nuk i udhëzon ata që i shkelin ligjet E Tij.

<sup>109</sup> Në ditën kur **Allahu** i mbledh të gjithë të dërguarit<sup>a</sup> dhe pyet: ‘Çfarë përgjigje keni marrë?’ do të thonë: ‘Nuk e kemi atë njohuri: veç Ti i di gjërat që nuk mund të shihen.’<sup>5:110</sup> Pastaj **Allahu** do të thotë: ‘Isa, i biri i Merjemes! Kujtoje favorin Tim për ty dhe për nënën tënde: si të forcova me shpirtin e shenjtë, ashtu që u fole njerëzve në mituri dhe si i rritur; si ta mësova Shkrimin e Shenjtë dhe urtinë dhe Teuratin e Ungjillin; si, me lejen Time, e formësove nga balta trajtën e një shpendi, fryve në të dhe u bë, me lejen Time, shpend; si, me lejen Time, e shërove personin e verbër dhe lebrozin; si, me lejen Time, e ktheve të vdekurin në jetë; si i frenova Unë Fëmijët e Izraelit nga ti [që të të dëmtojnë] kur u solle shenja të qarta dhe ata nga ta që nuk besuan thanë: “Kjo qartë nuk është asgjë tjetër pos magji”;<sup>111</sup> dhe si i frymëzova dishepujt të besonin në Mua dhe në të dërguarit E Mi – ata thanë: “Besojmë dhe dëshmojmë se [i] përkushtohemi [**Allahut**]”<sup>b</sup>’

<sup>112</sup> Kur dishepujt thanë: ‘Isa, i biri i Merjemes, a mundet Zoti yt të na e zbresë një gosti nga qielli?’ ai tha: ‘Ruajuni nga **Allahu** në qofshi besimtarë të vërtetë.’

<sup>113</sup> Ata thanë: ‘Duam të hamë nga ajo; t’i kemi zemrat e qetësuar; ta dimë se na e ke thënë të vërtetën; dhe të jemi dëshmitarë të saj.’<sup>114</sup> Isai, i biri i Merjemes, tha: ‘Zot, na e zbrit një gosti nga qielli që të mund të kemi festë – i pari dhe i fundit nga ne – dhe një shenjë nga Ti. Furnizo për ne: Ti je furnizuesi më i mirë.’

<sup>115</sup> **Allahu** tha: ‘Do t’jua zbres, por kushdo që nuk beson pas kësaj do të ndëshkohet me një ndëshkim të cilin nuk do t’ia shkaktoj askujt tjetër në botë.’

<sup>116</sup> Kur **Allahu** thotë: ‘Isa, i biri i Merjemes, a u ke thënë njerëzve: “Më merrni mua dhe nënën time si dy zota përkrah **Allahut**”?’ ai do të thotë: ‘Qofsh i lartësuar! Kurrë nuk do ta thosha atë që nuk kam të drejtë ta them – po ta kisha thënë një gjë të tillë Ti do ta kishe ditur: Ti e di tërë atë që është përbrenda meje,

---

<sup>a</sup> Siç ka thënë me të drejtë Razi, është zakoni i Kuranit që pasi të ketë folur gjerësisht për legjislacionin, ta pasojë atë me përkujtues të fuqisë së **Allahut**, me rrëfime të profetëve të mëhershëm, apo me atë që ndodh në Ditën e Gjykimit, në mënyrë që t’i motivojë njerëzit t’i përmbahen legjislacionit. Kjo sure, pasi i ka përmendur më herët pretendimet e të krishterëve, kërkon që më tej t’i hedhë poshtë ato duke treguar se Isai do t’i refuzojë si të tijat pretendimet e tyre në Ditën e Gjykimit.

<sup>b</sup> Krahaso me 2:131-3.



megjithëse unë nuk e di se çka ka përbrenda Teje, veç Ti ke njohuri të plota për gjërat e padukshme – <sup>117</sup> atyre ua thashë veç ato që m'i urdhërove Ti: “Adhurojeni **Allahun**, Zotin tim dhe Zotin tuaj.” Unë isha dëshmitar mbi ta gjatë kohës sime në mesin e tyre. Që kur ma more shpirtin, veç Ti ke qenë vëzhgues mbi ta: Ti je dëshmitar për të gjitha gjërat <sup>118</sup> dhe nëse i ndëshkon, ata janë shërbyesit e Tu; nëse i fal, Ti je I Gjithë-Fuqishmi, I Urti.’ <sup>119</sup> **Allahu** do të thotë: ‘Kjo është Ditë kur të vërtetët do të përfitojnë nga vërtetësia e tyre. Ata do të kenë Kopshte të hijeshuara me lumenj rrjedhës, për të mbetur aty përgjithmonë. **Allahu** është i kënaqur me ta dhe ata me Të: ky është triumfi suprem.’ <sup>5:120</sup> Kontrolli i qiejve dhe i tokës dhe i çdo gjëje në to i përket **Allahut**: Ai ka pushtet ndaj të gjitha gjërave.

## **Përshkrimi para kaptinës 5 nga Abdel Haleem:**

*Titulli ndërlidhet me ushqimin dhe një temë kryesore e kësaj kaptine medinase është caktimi i rregullave të ushqimit të ligjshëm dhe të paligjshëm, bindja ndaj të cilave është pjesë e zotimit ndërmjet **Allahut** dhe besimtarëve (vargjet 1-5, 87-108). Një pjesë e sures ka të bëjë me gjuetinë për ushqim gjatë haxhit dhe me respektimin e riteve të haxhit. **Allahu** kishte marrë zotime edhe nga çifutët dhe të krishterët dhe pjesa midis vargjeve 13 dhe 86 merret me atë që këto dy bashkësi kanë bërë me zotimet e tyre dhe me relacionet e tyre me myslimanët. Pasazhi nga vargu 109 e deri në fund merret me jetën e përtejme dhe me verdiktin e të dërguarve mbi sjelljen e bashkësive të tyre përkatëse. Këtu i është dhënë rëndësi Isait veçanërisht: përmendet gostia për të cilën dishepujt e tij i kërkuan t'i lutej **Allahut**, e cila ia jep titullin sures dhe përmendet heqja dorë e tij nga çfarëdo pretendimi për hyjnoritet.*

## **Shënimet gjuhësore (Thomas Cleary)**

*Tryeza e gostisë (al Maa'ida) (Kaptina 5)*

Kjo sure u shpall në Medinë

46 Sipas Ungjillit, Isai tha se shpallja që e solli ai nuk ishte kundërshtuese ndaj shpalljes së mëparshme por në fakt e vërtetonte të vërtetën e saj. Kurani ia njeh këtë mision Isait dhe ngjashëm e paraqet veten si vërtetues dhe qartësuesi i mesazhit thelbësor të shpalljeve të mëparshme të transmetuara nga çifutët dhe të krishterët.

48 “dhe mos i ndiq tekat e meraket e tyre”: Domethënë, mos i ndiq merakat e rebelëve të cilët nuk gjykojnë sipas asaj që e ka shpallur Zoti.

## 6: Bagëtitë (EL-EN'ÂM)

Në emrin e **Allahut**, Dashamirësit, Mëshirëplotit

<sup>1</sup> Tërë lavdet i përkasin **Allahut**,  
që i krijoi qiejt dhe tokën,  
dhe e bëri errësirën e dritën;  
e prapë mosbesimtarët  
barazojnë të tjerë me Zotin e tyre!

<sup>2</sup> Ai është Ai që ju krijoi nga balta  
pastaj e vendosi një afat [për ju].  
dhe një kohë tjetër të caktuar,<sup>a</sup>  
të njohur veç për Të;  
e ju prapë dyshoni!

<sup>3</sup> Ai është **Allahu**  
në qiejt dhe në tokë,  
Ai i di fshehtësitë tuaja  
dhe atë që e shfaqni  
dhe e di se çka bëni;

<sup>4</sup> por sa herë që atyre u vjen shpallja nga Zoti i tyre, ia kthejnë shpinën. <sup>5</sup> Kështu e mohuan të vërtetën kur u erdhi, por pikërisht gjëja me të cilën qeshën do t'u silllet në shtëpi.

<sup>6</sup> A nuk e kuptojnë se sa breza i shkatërroam Ne para tyre? Ne i sistemuum ata në tokë më shumë se ju, u zbritëm shi të begatshëm nga qielli dhe bëmë lumenj të rrjedhshëm t'u kalonin te këmbët, e prapë i shkatërroam për veprat e tyre të këqija dhe ngritëm breza të tjerë pas tyre. <sup>7</sup> Edhe nëse do të ta zbrisnim [ty Profet] një libër të skalitur në pergamenë dhe do ta preknin me duart e tyre, mosbesimtarët prapë do të thoshin: 'Kjo nuk është asgjë pos magji krejtësisht e paturpshme.' <sup>8</sup> Ata thonë: 'Pse nuk u zbrit asnjë engjëll për [ta mbështetur] atë?'<sup>b</sup> Por po ta zbrisnim një engjëll, gjykimi i tyre do të vinte menjëherë pa asnjë shtyrje të afatit. <sup>9</sup> Në të vërtetë, po ta zbrisnim një engjëll si të dërguar, prapë do ta dërgonim në formë të një njeriu, duke e rritur kështu hutinë e tyre.

---

<sup>a</sup> Këto i referohen jetëgjatësisë së caktuar të individëve dhe Ditës së Gjykimit.

<sup>b</sup> Ata gjithmonë argumentonin kundër Profetit se ai ishte veç njeri dhe i kërkonin ta prodhonte një engjëll për ta mbështetur. Krahaso me 25:7.

6:10 Të dërguarit i kanë përqeshur para teje [Muhamed] dhe ata që talleshin me ta u gllabëruan pikërisht nga ndëshkimi që e kishin përqeshur.

11 Thuaj:

“Udhëtoni nëpër tokë dhe shihni  
se çfarë fati u ra atyre  
që e refuzuan të vërtetën.”

12 Thuaj:

“Kujt i përket  
tërë ajo që është në qiej dhe në tokë?”

Thuaj:

**“Allahut.**

Ai e ka marrë përsipër të jetë mëshirëplotë.  
Ai sigurisht që do t’ju mbledhë të gjithëve  
në Ditën e Ringjalljes  
për të cilën s’ka asnjë pikë dyshimi.  
Ata që e mashtrojnë veten  
nuk do të besojnë.

13 “Dhe gjithçka që pushon

natën dhe ditën

i përket Atij.

Dhe Ai është Gjithë-Dëgjuesi, I Gjithë-Dijshmi.”

14 Thuaj:

“A do ta marr për mbrojtës  
dikë tjetër pos **Allahut**,  
Krijuesit të qiejve dhe të tokës,  
që ushqen por nuk e ushqejnë?”

Thuaj:

“Jam urdhëruar të jem i pari [nga ju]  
t’i përkushtohem [Atij].”

Mos ji një nga idhujtarët.

<sup>15</sup> Thuaj: ‘Kam frikë nga ndëshkimi i një Dite të tmerrshme nëse nuk i bindem Zotit tim. <sup>16</sup> **Allahu** do të ketë qenë vërtet mëshirëplotë me këdo që kursehet atë Ditë: ai është triumfi më i qartë.

<sup>17</sup> [Profet,] nëse **Allahu** të prek me vuajtje serioze, askush nuk mund ta heqë atë pos Tij dhe nëse Ai të prek me mirësi, Ai ka pushtet ndaj të gjitha gjërave: <sup>18</sup> Ai është Kontrolluesi Suprem ndaj krijesave Të Tij, I Gjith’-Urti, I Gjith’-Informuari. <sup>19</sup> Thuaj: ‘Çka vlen më së shumti si dëshmitar?’ Thuaj: ‘**Allahu** është dëshmitar mes jush dhe meje. Ky Kuran ishte shpallur për mua që t’ju paralajmëroj juve [njerëz] dhe këdo që e arrin ai. A vërtet dëshmoni se ka zota të tjerë pos **Allahut**?’ Thuaj: ‘Unë për vete nuk dëshmoj [për diçka të tillë].’ Thuaj: ‘Ai është veç një **Zot** dhe distancohem nga çkado që bashkoni me Të.’ <sup>6:20</sup> Ata të cilëve Ne ua kemi dhënë Shkrimin e Shenjtë e dinë këtë po aq mirë sa i njohin bijtë e tyre. Ata që i kanë humbur shpirtrat e tyre nuk do të besojnë. <sup>21</sup> Kush bën gabim më të madh se sa dikush që sajon gënjeshtër kundër **Allahut** apo e mohon shpalljen E Tij? Ata që bëjnë gabim të tillë nuk do të përparojnë. <sup>22</sup> Kur Ne t’i mbledhim të gjithë bashkë dhe t’u themi politeistëve: ‘Ku janë ata që pretendonit se ishin partnerë me **Allahun**?’ në ankthin e tyre të plotë <sup>23</sup> ata veç do të thonë: ‘Pasha **Allahun**, Zotin tonë, nuk kemi mvëshur partnerë përkrah Tij!’ <sup>24</sup> Shih si gënjejnë kundër vetes dhe si ata që ishin shpikur nga ta i kanë braktisur.

<sup>25</sup> Ndër ta janë disa që [duket se] të dëgjojnë, por Ne kemi vendosur mbulesa mbi zemrat e tyre – kështu që nuk e kuptojnë Kuranin – dhe shurdhim në veshët e tyre. Edhe po ta shihnin çdo shenjë nuk do të besonin në to. Pra, kur vijnë te ti, grinden me ty: mosbesimtarët thonë ‘Këto nuk janë gjë tjetër pos fabula të lashta’, <sup>26</sup> dhe u thonë të tjerëve të mos [e] dëgjojnë [Kuranin], gjersa vetë i rrinë larg. Por nuk e shkatërrojnë askë pos vetes, megjithëse nuk arrijnë ta kuptojnë këtë. <sup>27</sup> Po të mundje veç t’i shihje, kur dërgohen të qëndrojnë para Zjarrit, si do të thonë: ‘Ah po të mund të na kthenin prapa, nuk do t’i refuzonim shpalljet e Zotit tonë, por do të ishim në mesin e besimtarëve.’ <sup>28</sup> Jo! E vërteta që dikur e fshihnin do të bëhet krejt e qartë për ta. Edhe po t’i kthenin, veç sa do të ktheheshin pikërisht te gjëja që ishte e ndaluar për ta – janë gënjeshtarë kaq të mëdhenj! <sup>29</sup> Thonë: ‘Nuk ka asgjë përtej jetës sonë në këtë botë: nuk do të ngritemi nga të vdekurit.’ <sup>6:30</sup> Po të mundje veç t’i shihje, kur dërgohen të qëndrojnë para Zotit të tyre, si do të thotë Ai: ‘A nuk është reale kjo?’ Ata do të thonë: ‘Po, në fakt, pasha Zotin tonë.’ Ai do të thotë: ‘Atëherë provojeni torturën për shkak të mosbesimit.’ <sup>31</sup> Vërtet janë të humbur ata që e mohojnë takimin me Zotin e tyre deri kur, atëherë kur befas vjen Ora, thonë: ‘Mjerë ne që e shpërfillëm këtë!’ Do t’i bartin në kurriz barrët e tyre. Sa të tmerrshme do të jenë ato barrë!

<sup>32</sup> Dhe jeta e kësaj bote  
nuk është gjë tjetër pos lojë e hutim;  
Shtëpia në Të Përtejmen  
është më e mira për ata  
që janë të vetëdijshëm për **Allahun**.  
Pra [ju njerëz] a s' do të kuptoni?

<sup>33</sup> Ne e dimë mirë se ato që i thonë ata të pikëllojnë [Profet]. Nuk është se kanë mosbesim në ty: keqbërësit e refuzojnë shpalljen e **Allahut**. <sup>34</sup> Para teje, për të dërguarit e tjerë kishte mosbesim dhe ata e duruan refuzimin dhe persekutimin e tyre me qëndresë deri kur arriti ndihma Jonë – askush nuk mund t'i ndryshojë premtimet e **Allahut**. Tashmë ke marrë shpjegime për këta të dërguar. <sup>35</sup> Nëse refuzimi nga mosbesimtarët të duket kaq i vështirë për t'u duruar, atëherë kërkoje një tunel në tokë apo një shkallë në qiell, po munde dhe sjelljua një shenjë: **Allahu** do të mund t'i sillte të gjithë ata në udhëzim po të ishte vullneti I Tij, kështu që mos u bëj me injorantët. <sup>36</sup> Veç ata që mund të dëgjojnë do të përgjigjen; sa për të vdekurit, **Allahu** do t'i ngrisë dhe tek Ai do të kthehen të gjithë.

<sup>37</sup> Ata gjithashtu thonë: 'Pse nuk iu ka zbritur atij asnjë shenjë nga Zoti i tij?' Thuaj: 'Sigurisht që **Allahu** e ka fuqinë ta zbresë një shenjë', edhe pse shumica nga ta nuk e dinë:

<sup>38</sup> të gjitha krijesat që zvarriten në tokë  
dhe ato që fluturojnë me krahët e tyre  
janë bashkësi si ju.  
Ne nuk kemi harruar asgjë  
jashtë Regjistrin –  
në fund  
ata do të mblidhen  
te Zoti i tyre.

<sup>39</sup> Ata që i kundërshtojnë shenjat Tona janë të shurdhër, memecë dhe në errësirë të plotë. **Allahu** e lë këdo që do ta lërë të devijojë dhe e vendos këdo që do ta vendosë në rrugë të drejtë. <sup>6:40</sup> Thuaj: 'Mendoni: po t'ju vinte ndëshkimi i **Allahut** apo Ora, a do ta thirrnit dikë tjetër pos **Allahut**, nëse po jeni të sinqertë?'

<sup>41</sup> Jo në fakt, është Ai Të Cilin do ta thirrnit. Po të ishte vullneti I Tij, do të mund

ta hiqte çfarëdo dëmi që ju bëri ta thirrnit Atë dhe pastaj do ta harronit atë që tani e shoqëroni me Të.

42 Ne u kemi çuar të dërguar  
shumë komuniteteve para teje [Profet],  
dhe i kemi mbërthyer  
njerëzit e tyre  
me vuajtje e vështirësi,  
që të mund ta mësojnë përlësinë.

43 Ah po ta mësonin përlësinë  
kur u erdhi vuajtja nga Ne!  
Por jo,  
zemrat e tyre u bënë të forta,  
dhe Satani ua bëri tërheqëse  
veprat e tyre të pista.

44 Kështu, kur e kishin harruar  
paralajmërimin që e kishin marrë,  
Ne i hapëm për ta  
dyert e gjithçkaje.  
Pastaj, gjersa u shfrenuan në festim  
në atë që u ishte dhënë  
befas i goditëm  
dhe u shtangën.

45 Keqbërësit u fshinë  
nga faqja e dheut:  
lavdet i përkasin **Allahut**,  
Zotit të Botëve!

46 Thuaj [Profet]: “Mendoni:  
po t’jua hiqte **Allahu** dëgjimin  
dhe të pamurit  
dhe t’jua vuloste zemrat,  
çfarë zoti tjetër pos Tij  
do të mund t’i rikthente ato?”

Vëreje se si Ne i shpjegojmë Shpalljet Tona  
në mënyra të ndryshme,  
e ata prapë largohen.

47 Thuaj: “Mendoni:  
po t’ju vinte  
ndëshkimi i **Allahut**  
befas apo haptas,  
a do të shkatërrohej dikush  
pos keqbërësve?”

48 Ne i çojmë të dërguarit  
veç për të dhënë lajme të mira  
dhe për të paralajmëruar;  
pra për ata që besojnë  
dhe bëjnë vepra të mira  
nuk do të ketë frikë,  
as s’do të pikëllohen.

49 Sa për ata që i refuzuan shenjat Tona, do t’i godasë tortura si rezultat i kundërshtimit të tyre.

6:50 Thuaj: “Nuk i kam  
thesaret e **Allahut**;  
as nuk e di atë që nuk shihet,  
as nuk ju them  
se jam engjëll.  
Unë veç e ndjek  
atë që më është shpallur.”  
Thuaj: “A është personi i verbër  
si ai që mund të shohë?  
Pra a nuk do të reflektoni?”

51 Përdore Kuranin  
për t’i paralajmëruar ata që frikësohen  
se do të mblidhen para Zotit të tyre –  
pos Tij nuk do të ketë për ta



as mbrojtës as ndërmjetës –  
që të kenë kujdes.

- 52 Dhe mos i dëbo  
ata që e thërrasin Zotin e tyre  
mëngjes-e-mbrëmje  
duke e kërkuar Fytyrën [apo Esencën] E Tij<sup>a</sup>  
ti nuk je në asnjë mënyrë  
përgjegjës për ta,  
as ata për ty;  
po t'i dëboje besimtarët,  
do të bëheshe një nga keqbërësit.

- 53 Ne i kemi bërë disa nga ta  
sprovë për të tjerët,  
për t'i bërë mosbesimtarët të thonë:  
“A janë këta ata njerëz  
që **Allahu** i ka favorizuar  
nga mesi ynë?”  
A nuk e di **Allahu** më së miri  
se kush janë mirënjohësit?

- 54 Dhe kur vijnë te ti [Profet]  
ata që besojnë në shpalljet Tona,  
thuaj: “Paqja qoftë mbi ju!  
Zoti juaj e ka marrë përsipër  
të jetë mëshirëplotë:  
nëse dikush nga ju  
ka bërë budallakisht vepër të keqe,  
dhe pastaj është penduar  
dhe i ka përmirësuar rrugët e tij,  
**Allahu** është më falësi  
dhe më mëshirëploti.”

---

<sup>a</sup> ‘Kënaqësinë/miratimin E Tij’, apo ‘ta shohin fytyrën E Tij’ (shih ‘The Face, Divine and Human in the Qur’an’, tek Abdel Haleem, *Understanding the Qur’an*, 107–22); shih edhe 92:19-21.

<sup>55</sup> Kështu Ne i shpjegojmë shpalljet, që rruga për mëkatarët të mund të bëhet e qartë.<sup>a</sup>

<sup>56</sup> Thuaj:

“E kam të ndaluar t’i adhuroj  
ata të cilët i thirrni  
pos **Allahut**.”

Thuaj:

“Nuk i ndjekni meraket tuaja të kota;  
se po ta bëja, do të devijoj nga rruga,  
dhe nuk do të isha më ndër të udhëzuarit.”

<sup>57</sup> Thuaj:

“Veprojmë mbi evidencën e qartë  
nga Zoti im,  
megjithëse e mohoni atë.  
Ajo që kërkoni ta shpejtoni  
nuk është në dorën time.  
Veç **Allahu** e bën gjykimin:  
Ai e tregon të vërtetën  
dhe është më i miri nga gjykatësit.”

<sup>58</sup> Thuaj: ‘Po të ishte në dorën time ajo që kërkoni të shpejtohet, çështja do të zgjidhet mes jush dhe meje, por **Allahu** e di më së miri se kush bën gabim.’

<sup>59</sup> Ai i ka

çelësat e të padukshmes;  
askush nuk i njeh ata  
pos Tij.  
Dhe Ai e di  
se çka ka në tokë  
dhe në det.  
Asnjë gjeth nuk bie

---

<sup>a</sup> Një interpretim tjetër i këtij vargu është se rruga e mëkatarëve këtu bëhet e dalluar nga rruga e të ndershmeve.

pa e ditur Ai,  
dhe s'ka asnjë kokërr të vetme  
në errësirat e tokës,  
dhe asgjë të gjelbër apo të tharë,  
që s'është shkruar në një Regjistër të qartë.

<sup>6:60</sup> Dhe është Ai

që jua merr shpirtrat natën,  
dhe e di se çka keni bërë gjatë ditës;  
pastaj ju ngrit përsëri ditën,  
deri kur të përmbushet afati juaj i caktuar.  
Është Ai tek I Cili  
do të ktheheni në fund  
dhe pastaj do t'ju tregojë  
se çka keni bërë.

<sup>61</sup> Ai është Kontrolluesi Suprem ndaj të sunduarve Të Tij. Ai dërgon regjistruet t'ju vëzhgojnë deri kur, atëherë kur vdekja e zë dikë nga ju, ata që janë dërguar nga Ne e marrin shpirtin e tij – kurrë nuk dështojnë në detyrën e tyre. <sup>62</sup> Pastaj të gjithë ata do t'i kthejnë te **Allahu**, Zoti i tyre i vërtetë. Gjykimi vërtet i përket Atij dhe Ai është më i shpejti nga llogaritësit.

<sup>63</sup> Thuaj [Profet]: 'Kush është që ju shpëton nga thellësitë e errëta të tokës e të detit kur me përlulje e fshehtas i thërrisni Atij [dhe thoni]: "Nëse Ai na shpëton nga kjo, do të jemi vërtet falënderues?"' <sup>64</sup> Thuaj: '**Allahu** ju shpëton nga ky dhe nga çdo shqetësim; e prapë ende adhuronit të tjerë përkrah Tij.' <sup>65</sup> Thuaj: 'Ai e ka fuqinë ta dërgojë ndëshkimin mbi ju nga lart apo pikërisht nga nën shputat tuaja, apo t'ju ndajë në fraksione të papajtueshme dhe t'i bëjë disa ta provojnë dhunën e të tjerëve'. Shihni si e shpjegojmë Ne shpalljen Tonë në mënyra të ndryshme, që ata të mund të kuptojnë, <sup>66</sup> e megjithatë populli yt prapë e refuzon edhe pse është e vërteta. Thuaj: 'Nuk më kanë bërë përgjegjës për ju. <sup>67</sup> Çdo profeci e ka kohën e saj të caktuar për t'u përmbushur: do ta kuptoni këtë.'

<sup>68</sup> Kur has njerëz që flasin me përçmim për shpalljet Tona, largohu nga ta deri kur të kalojnë në temë tjetër. Nëse Satani të bën të harrosh, atëherë, kur të kujtohesh, mos u ul me ata që po bëjnë gabim. <sup>69</sup> Të ndershmit në asnjë mënyrë nuk mbahen përgjegjës për keqbërësit; detyra e tyre e vetme është t'ua kujtojnë, që të jenë të vëmendshëm për **Allahun**. <sup>6:70</sup> Lërin me veten ata që e marrin fenë e tyre si lojë të thjeshtë dhe zbavitje dhe janë të mashtruar nga jeta e kësaj bote, por vazhdoni t'ua kujtoni [Kuranin], që të mos mallkohet ndonjë shpirt nga ajo që e

ka bërë – nuk do ta ketë askë ta mbrojë nga **Allahu** dhe askë të ndërmjetësojë; nuk do të pranohet kurrfarë pagese për çlirim që mund ta ofrojë. Të tillë janë ata që janë mallkuar nga veprimet e tyre: do të kenë ujë të valë për të pirë dhe ndëshkim të dhembshëm, se [e] kundërshtonin [**Allahun**].

<sup>71</sup> Thuaj: ‘A duhet që, në vend të **Allahut**, ta thërrasim atë që nuk na sjell as dobi as dëme? [A duhet] ta kthejmë shpinën pasi na ka udhëzuar **Allahu**, si dikush plotësisht i hutuar, pasi është tunduar nga djajtë në përroskë shkretëtire<sup>a</sup>, megjithëse shoqëruesit e tij e thërrasin në udhëzim [duke thënë]: “Eja te ne”?’ Thuaj: ‘Udhëzimi i **Allahut** është udhëzimi i vërtetë. Jemi urdhëruar t’i kushtohemi Zotit të Botëve,<sup>72</sup> të falemi rregullisht dhe të jemi të vetëdijshëm për Të.’ Është Ai tek I Cili do t’ju mbledhin të gjithëve.<sup>73</sup> Është Ai që i krijoi qiejt dhe tokën për qëllim të vërtetë. Në Ditën kur thotë: ‘Ji’, do të jetë: fjala E Tij është e vërteta. Tërë kontrolli në Ditën kur fryhet trumpeta i përket Atij. Ai e di të dukshmen dhe të padukshmen; Ai është I Gjith’-Urti, I Gjith’-Informuari.

<sup>74</sup> Kujtoje kur Ibrahim i tha të atit, Azerit: ‘Si mund t’i marrësh idhujt si zota? E shoh që ti dhe populli yt keni devijuar qartas.’<sup>75</sup> Kështu Ne ia treguam Ibrahimit sundimin e fuqishëm [të **Allahut**] ndaj qiejve dhe tokës, që të mund të jetë besimtar i vendosur.<sup>76</sup> Kur nata u errësua rreth tij e pa një yll dhe tha: ‘Ky është Zoti im’, por kur perëndoi, tha: ‘Nuk më pëlqejnë gjërat që perëndojnë.’<sup>77</sup> Dhe kur e pa hënën të lindte tha: ‘*Kjo* është Zoti im’ por kur edhe ajo perëndoi, tha: ‘Nëse Zoti im nuk më udhëzon, do të jem nga ata që devijojnë.’<sup>78</sup> Pastaj e pa diellin të lindte dhe bërtiti: ‘Ky është Zoti im! Ky është më i madh.’ Por kur dielli perëndoi, tha: ‘Populli im, distancohem nga të gjitha ato që i adhuroni përkrah **Allahut**.<sup>79</sup> E kam kthyer fytyrën time si besimtar i vërtetë kah Ai që i krijoi qiejt dhe tokën. Nuk jam një nga politeistët.’

<sup>6:80</sup> Populli i tij u grindën me të dhe ai tha: ‘Si mund të grindeni me mua për **Allahun** kur Ai më ka udhëzuar? Nuk i frikësohem asgjëje që e shoqëroni me Të: [asgjë nuk mund të ndodhë] pos nëse Zoti im do. Zoti im përfshin gjithçka në dijen E Tij. Si mund të mos e keni mendjen?’<sup>81</sup> Pse do të duhej të kem frikë nga ajo që e shoqëroni me Të? Pse nuk keni frikë të shoqëroni me të gjëra për të cilat Ai nuk ju ka dërguar kurrfarë autoriteti? Më tregoni, nëse e dini përgjigjen, se cila anë ka më shumë të drejtë të ndihet e sigurt?’<sup>82</sup> Pikërisht ata që kanë besim dhe nuk e përziejnë besimin e tyre me idhujtari<sup>b</sup> – janë ata që do të jenë të sigurt dhe të tillët janë ata që udhëzohen si duhet.’<sup>83</sup> I tillë ishte argumenti që Ne ia dhamë Ibrahimit kundër popullit të tij – Ne e ngrisim në gradë këdo që do ta ngrisim – Zoti yt është i gjith’-urtë, i gjithë-dijshëm.

<sup>84</sup> Ne ia dhamë atij Isakun dhe Jakubin, ku secilin e udhëzuam, siç e patëm udhëzuar Nuhun më parë dhe ndër pasardhësit e tij ishin Daudi, Sulejmani,

<sup>a</sup> Ky interpretim i frazës ‘në tokë’ preferohet nga Razi.

<sup>b</sup> Profeti e shpjegoi se *zulm* (keqbërja) këtu është *shirk* (idhujtari), duke iu referuar 31:13.

Ejubi, Jusufi, Musai dhe Haruni – kështu i shpërblejmë ata që bëjnë mirë –<sup>85</sup> Zekerijai, Jahjai, Isai dhe Iljazi – secili nga ta ishte i ndershëm –<sup>86</sup> Ismaili, Eljesai, Junusi dhe Luti. Ne i favorizuar secilin nga ta mbi njerëzit e tjerë,<sup>87</sup> dhe po ashtu edhe disa nga paraardhësit e tyre, pasardhësit e tyre dhe vëllezërit e tyre: i zgjodhëm dhe i udhëzuar në rrugë të drejtë.<sup>88</sup> I tillë është udhëzimi i **Allahut**, me të cilin i udhëzon cilëtdo shërbyes Të Tij që do t'i udhëzojë. Po të kishin shoqëruar zota të tjerë me Të, të gjitha veprat e tyre do të ktheheshin në asgjë.<sup>89</sup> Këta janë ata të cilëve ua dhamë Shkrimin e Shenjtë, urtinë dhe profetësinë. Edhe nëse këta njerëz tani nuk besojnë në ta, Ne ua kemi besuar ata atyre që nuk kanë mosbesim.<sup>6:90</sup> Ata ishin njerëzit që i udhëzoi **Allahu**: '[Profet,] ndiqe udhëzimin që e pranuan.' Thuaj: 'Nuk kërkoj asnjë shpërblim për të nga ju: është mësim për të gjithë njerëzit.'

<sup>91</sup> Ata nuk e kanë kuptuar fare masën e vërtetë të **Allahut** kur thonë: '**Allahu** nuk i ka zbritur asgjë një vdekatarit të thjeshtë.' Thuaj: 'Kush ishte ai që e zbriti Shkrimin e Shenjtë, të cilin Musai e sollti si dritë dhe udhëzim për njerëzit, të cilën e shndërruar në fleta të veçanta, duke i treguar disa por duke fshehur shumë nga to? Juve ju ishin mësuar gjëra që as ju as paraardhësit tuaj nuk i keni ditur.' Thuaj: '**Allahu** [e zbriti]', pastaj lëri të preokupuar plotësisht me fjalimin e tyre të kotë.<sup>92</sup> Ky është Shkrimi i Shenjtë i bekuar që Ne e kemi zbritur për ta vërtetuar atë që erdhi para tij dhe për ju që ta paralajmërosh Nënë e Qyteteve<sup>a</sup> dhe tërë ato përreth saj. Ata që besojnë në Të Përtejmen besojnë në këtë Shkrim të Shenjtë dhe nuk i lënë pas dore lutjet e tyre.<sup>93</sup> Kush do të mund të ishte më i lig se dikush që e shpik një rrenë kundër **Allahut**, apo pretendon: 'Më ka ardhur një shpallje', kur nuk i është çuar asnjë shpallje, apo thotë: 'Edhe unë mund të shpall diçka të barabartë me shpalljen e **Allahut**'? Po të mund t'i shihnit të ligët në agonitë e vdekjeve të tyre, gjersa engjëjt i shtrijnë duart e tyre [kah ta], duke thënë: 'Dorëzoni shpirtrat tuaj. Sot do të shpagueheni me një ndëshkim poshtërues se keni thënë gjëra të rreme për **Allahun** dhe i keni refuzuar me arrogancë shpalljet E Tij.'<sup>94</sup> [**Allahu** do të thotë:] 'Tani ktheheni te Ne, vetëm, siç ju kemi krijuar fillimisht: i keni lënë pas të gjitha ato që jua kemi dhënë dhe as nuk po i shohim ata ndërmjetësues tuajt që pretendonit se ishin partnerë të **Allahut**. Të gjitha lidhjet midis jush janë shkëputur dhe ata për të cilët bënit pretendime të tilla ju kanë braktisur.'

<sup>95</sup> Sigurisht që është **Allahu**

Ai që e çan në mugullim

farën dhe bërthamën e frutit:

Ai e sjell të gjallën prej të vdekurës;

---

<sup>a</sup> Mekën.

dhe të vdekurën prej të gjallës –

është **Allahu** –

pra si mund të largoheni

nga e vërteta?

- <sup>96</sup> Ai bën që agimi të çelë;  
Ai e bën natën për pushim;  
dhe Ai e bëri diellin e hënën në masë precize.  
Ky është projektimi  
i Të Gjithë-Fuqishmit, Të Gjithë-Dijshmit.

- <sup>97</sup> Është Ai që i bëri yjet për ju  
që të mund t’ju udhëzojnë  
kur toka dhe deti janë në terr:  
Ne i kemi bërë shenjat të qarta  
për ata që kanë njohuri.

- <sup>98</sup> Është Ai që fillimisht ju prodhoi  
nga një shpirt i vetëm,  
pastaj jua dha një vend-qëndrim [në jetë]  
dhe një vend-pushim [pas vdekjes].  
Ne i kemi bërë shpalljet Tona të qarta  
për ata që kuptojnë.

- <sup>99</sup> Është Ai që e zbret ujin nga qielli. Me të Ne i prodhojmë sythat e secilës bimë,  
pastaj e sjellim gjelbërimin nga ajo dhe nga ajo i nxjerrim kokrrat, njëren hipur  
mbi tjetrën në rreshta të ngjeshur.

Nga palma me hurma vijnë kalaveshët e varur ulët dhe ka kopshte me  
vreshta, ullinj e shega, të ngjashme e prapë të ndryshme. Shikoni frutat e tyre  
gjersa rriten e piqen! Në tërë këtë ka shenja për ata që do të besonin. <sup>6:100</sup> E prapë  
ata i bënë xhindet<sup>a</sup> partnerë me **Allahun**, megjithëse Ai i krijoi, dhe pa asnjë  
njohuri të vërtetë i atribuojnë Atij bij e bija. Lavdet qofshin për Të! Ai është  
shumë më i lartë se sa ajo që ia mvëshin Atij, <sup>101</sup> krijuesit të qiejve dhe të tokës! Si  
do të mund të kishte fëmijë kur nuk ka bashkëshorte, kur i krijoi të gjitha gjërat  
dhe ka njohuri të plotë për të gjitha gjërat? <sup>102</sup> Ky është **Allahu**, Zoti juaj, nuk ka  
**Zot** pos Tij, Krijuesit të të gjitha gjërave, prandaj adhurojeni Atë; Ai është

---

<sup>a</sup> Qenie të padukshme (që nganjëherë thuhet se shfaqen) të bëra nga ‘zjarri pa tym’ (shih 38:76; 55:15).

mbikëqyrës i gjithçkaje. <sup>103</sup> Asnjë shikim nuk mund ta përfshijë Atë, por Ai e përfshin tërë shikimin.<sup>a</sup> Ai është Gjithë-Subtili, I Gjith'-Informuari.

<sup>104</sup> Tash ju ka ardhur dëshmi e qartë nga Zoti juaj: nëse dikush e sheh atë, kjo do të jetë në avantazhin e tij; nëse dikush është i verbër ndaj saj, kjo do të jetë në dëm të tij – [thuaj:] ‘Nuk jam kujdestari juaj.’ <sup>105</sup> Kështu i shpjegojmë shpalljet Tona në mënyra të ndryshme – megjithëse<sup>b</sup> ata do të thonë: ‘Ti [Muhamed] ke qenë duke studiuar’ – për t’i bërë ato të qarta për ata që dinë. <sup>106</sup> Ndiqe atë që të është shpallur nga Zoti yt, nuk ka **Zot** tjetër pos Tij. Largohu nga ata që bashkojnë zota të tjerë me Të. <sup>107</sup> Po të kish qenë vullnet i **Allahut**, ata nuk do të bënin kështu, por Ne nuk të kemi bërë kujdestar të tyre, as nuk je roje e tyre.

<sup>108</sup> [Besimtarë,] mos i fjeni ato që ata i thërrasin përkrah **Allahut** në rast se ata, në armiqësinë dhe paditurinë e tyre, e fyejnë **Allahun**. Secilit komunitet Ne ua bëjmë veprimet e tyre t’u duken tërheqëse, por në fund do të kthehen te Zoti i tyre dhe Ai do t’i informojë për gjithçka që kanë bërë. <sup>109</sup> Ata betohen për **Allahun** me betimet e tyre më solemne se po t’u vinte një shenjë mrekullie do të besonin në të. Thuaj [Profet]: ‘Shenjat janë veç në pushtetin e **Allahut**.’ Çka do t’ju bëjë [juve besimtarëve] ta kuptoni se edhe po t’u vinte një shenjë ata prapë nuk do të besonin? <sup>6:110</sup> Ne do t’i bënim zemrat e tyre dhe sytë e tyre të largohen, pikërisht siç nuk besuan herën e parë dhe do t’i linim të ngecin në kokëfortësinë e tyre. <sup>111</sup> Edhe po t’i zbritnim engjëjt te ta dhe po t’u flisnin të vdekurit dhe po t’i mblidhnim të gjitha gjërat mu para tyre, prapë nuk do të besonin, pos po të donte **Allahu**, por shumica nga ta janë të paditur [për këtë]. <sup>112</sup> Në të njëjtën mënyrë Ne ia caktuam secilit profet një armik, njerëz të këqij dhe xhinde të këqij. Ata i sugjerojnë njëri-tjetrit fjalë tërheqëse për të mashtruar – po të kish qenë vullneti i Zotit tënd, [Profet,] ata nuk do ta kishin bërë këtë: lëri në trillimet e tyre – <sup>113</sup> ashtu që zemrat e atyre që nuk besojnë në Të Përtejmen të mund të priren nga mashtrimi i tyre, të jenë të kënaqur me të dhe kështu ta bëjnë dëmin që e bëjnë.

---

<sup>a</sup> Asnjë sy njerëzor nuk është në gjendje ta shohë **Allahun**, por **Allahu** sheh gjithçka që shohim ne: ky është edhe një ilustrim i pafuqisë sonë krahasuar me Të.

<sup>b</sup> Shih Razi; parafjala *li* në arabisht këtu tregon rezultat e jo qëllim.

- 114 [Thuaj:] “Pra a do të kërkoj gjykatës  
tjetër pos **Allahut**,  
pikërisht Atij  
që jua ka zbritur [juve njerëzve]  
Librin e shpjeguar qartë?”  
Dhe ata të cilëve  
Ne ua dhamë Librin  
e dinë se ky [Kuran] është shpallur  
nga Zoti yt [, Profet,]  
me të vërtetën,  
pra mos ji  
një nga ata që dyshojnë.
- 115 Dhe fjala e Zotit tënd është e plotë  
në vërtetësinë e drejtësinë e saj.  
Askush nuk mund t’i ndryshojë fjalët E Tij:  
Ai është Gjithë-Dëgjuesi, I Gjithë-Dijshmi.
- 116 Por po t’u bindeshit  
shumicës së atyre që janë në tokë,  
do t’ju shmangnin  
nga rruga e **Allahut**.  
Se nuk ndjekin gjë pos spekulimit;  
thjesht po hamendësojnë.
- 117 Sigurisht që Zoti juaj e di më së miri  
se kush ka devijuar nga rruga E Tij  
dhe kush është udhëzuar si duhet.

<sup>118</sup> Pra [besimtarë] hani çfarëdo [kafshe] mbi të cilën është shqiptuar emri i **Allahut**, nëse besoni në shpalljet E Tij. <sup>119</sup> Pse të mos hanit kafshë të tilla kur **Allahu** tashmë e ka shpjeguar plotësisht se çka ju ka ndaluar, përveç kur detyroheni nga uria? Por shumë njerëz i devijojnë të tjerët sipas dëshirave të tyre, pa ndonjë dije të vërtetë: Zoti juaj e di më së miri se kush e tejkalon kufirin.

- 6:120 Pra braktisni të gjitha mëkatet,  
edhe të hapëtat edhe të fshehtat;  
se ata që bëjnë mëkat



do të shpaguhen  
për atë që e kanë bërë,

<sup>121</sup> dhe mos hani asgjë mbi të cilën nuk është shqiptuar emri i **Allahut**, se kjo është shkelje e ligjit.

Të këqijtë i nxisin ndjekësit e tyre të debatojnë me ju:<sup>a</sup> nëse i dëgjoni, edhe ju do të bëheni idhujtarë.

<sup>122</sup> A është një person i vdekur  
i kthyer në jetë nga Ne,  
që i është dhënë dritë me të cilën  
të ecë mes njerëzve  
i krahasueshëm me dikë  
të kurthuar në errësirë të thellë  
e që nuk mund të shpëtojë?  
Kështu veprat e këqija  
të mosbesimtarëve  
janë bërë t'u duken tërheqëse atyre.

<sup>123</sup> Dhe kështu Ne kemi vënë keqbërës kryesorë në çdo qytet për t'i zbatuar planet e tyre të fshehta aty – por ata bëjnë plane të fshehta veç kundër vetes, pa e kuptuar. <sup>124</sup> Kur u sillen një shpallje përpara thonë: 'Nuk do të besojmë pos nëse vetë neve na jepet një shpallje si të dërguarve të **Allahut**.' Por **Allahu** e di më së miri ku t'i vendosë mesazhet E Tij: poshtërimi para **Allahut** dhe tortura e ashpër do të bie mbi keqbërësit për planifikimet e tyre të fshehta. <sup>125</sup> Kur **Allahu** dëshiron ta udhëzojë dikë, ua hap gjoksin e tyre ndaj *islamit*,<sup>b</sup> kur dëshiron t'i devijojë, ua mbyll gjoksin dhe ua shtrëngon sikur të ishin duke u ngjitur lart deri te qiejt. Kështu **Allahu** e bën ligësinë e atyre që nuk besojnë t'u kthehet kundër tyre.

<sup>126</sup> [Profet,] kjo është rruga e Zotit tënd, e bërë përsosmërisht drejt. Ne ua kemi shpjeguar shpalljet Tona atyre që janë të vëmendshëm. <sup>127</sup> Ata do ta kenë Shtëpinë e Paqes me Zotin e tyre dhe Ai do të kujdeset për ta si shpërblim për veprat e tyre.

---

<sup>a</sup> Duke thënë se nuk ka asgjë të gabuar në lidhje me mishin e flijuar për një idhull.

<sup>b</sup> Përkushtimit ndaj **Allahut** (shih 2:131-2)

<sup>128</sup> Në ditën kur Ai i mbledh bashkë të gjithë [duke thënë]: ‘O grup i xhindeve! Ju e keni joshur një pjesë të madhe të njerëzve’, përkrahësit e tyre ndër njerëzit do të thonë: ‘Zot, ne kemi përfituar nga njëri-tjetri, por tani e kemi arritur kohën e caktuar që e ke dekretuar për ne.’ Ai do të thotë: ‘Shtëpia juaj është Zjarri dhe aty do të mbeten!’ – pos nëse **Allahu** dëshiron diçka tjetër: [Profet,] Zoti yt është i gjith’-urtë, i gjithë-dijshëm. <sup>129</sup> Në këtë mënyrë, Ne i bëjmë disa keqbërës të kenë pushtet ndaj të tjerëve përmes veprave të tyre të këqija.

6:130 “O grup i xhindeve dhe i njerëzimit!

A nuk ju kanë ardhur

të dërguar nga mesi juaj

t’ju recitojnë shpalljet E Mija

dhe t’ju paralajmërojnë

se do ta arrini këtë Ditë?”

Ata do të thonë:

“Ne dëshmojmë kundër vetes.”

Jeta e botës i joshi me shpresa të kota,

por do të dëshmojnë kundër vetes

se e refuzuan të vërtetën:

<sup>131</sup> Zoti yt nuk do t’i shkatërronte qytetet për shkak të veprimeve të tyre të gabuara po të mos ishin paralajmëruar. <sup>132</sup> Secilit i caktohet një gradë sipas veprave të tij; Zoti yt nuk është i painformuar për asnjë gjë që e bëjnë. <sup>133</sup> Zoti yt është i vetë-mjaftueshëm dhe plot mëshirë. Po të donte, do të mund t’ju hiqte dhe të vendoste të tjerë në vendin tuaj, siç ju ka prodhuar juve nga pjella e njerëzve të tjerë. <sup>134</sup> Ajo që ju premtohet sigurisht që do të vijë dhe nuk mund të ikni. <sup>135</sup> [Profet,] thuaj: ‘Populli im, ju vazhdoni siç jeni dhe po ashtu do të vazhdoj edhe unë: do ta merrni vesh se kush do të ketë kthim të lumtur në shtëpi në Të Përtejmen.’ Keqbërësit nuk do të përparojnë.

<sup>136</sup> Ata ia ndajnë **Allahut** një hisë të prodhimit dhe të bagëtive që i krijoi, duke thënë: ‘Kjo është për **Allahun**’ – kështu pretendojnë! – ‘dhe kjo është për idhujt tanë.’ Hisja e idhujve të tyre nuk e arrin **Allahun**, por hisja e **Allahut** i arrin idhujt e tyre: sa keq gjykojnë! <sup>137</sup> Në mënyrën e njëjtë, idhujt e tyre i kanë nxitur shumë paganë t’i vrasin fëmijët e tyre,<sup>a</sup> duke u sjellë shkatërrim dhe hutim në besimin e tyre: po të kishte dashur **Allahu** ndryshe – ata nuk do ta kishin bërë

---

<sup>a</sup> Razi shpjegon se ose xhindët ose shërbyesit e idhujve të caktuar nga paganët e sugjeruan këtë infanticid.

këtë, kështu që [Profet] lëri me planet e tyre të fshehta. <sup>138</sup> Gjithashtu thonë: ‘Këto bagëti dhe të korra janë të rezervuara dhe veç ata që i lejojmë mund t’i hanë’ – kështu pretendojnë! Janë disa kafshë që i përjashtojnë nga puna dhe disa mbi të cilat nuk e shqiptojnë emrin e **Allahut** [gjatë therjes], duke ia mvëshur në mënyrë të rrejshme këto [rregullore] Atij: Ai do t’i shpaguajë për të pavërtetat që i trillojnë. <sup>139</sup> Gjithashtu thonë: ‘Përmbajtja e mitrave të këtyre kafshëve do të jetë e rezervuar veç për burrat tanë dhe e ndaluar për gratë tona, megjithëse nëse pjella është e vdekur ato mund ta kenë një hise të saj.’ Ai do t’i ndëshkojë për atë që ia mvëshin: Ai është i gjith’-urtë, i gjith’-informuar. <sup>6:140</sup> Të humbur janë vërtet ata që i vrasin fëmijët e tyre nga marrëzia, pa bazë në dije,<sup>a</sup> duke e ndaluar atë që **Allahu** e ka furnizuar për ta, duke trilluar rrena kundër Tij: ata kanë devijuar shumë dhe nuk kanë pasur vëmendje për asnjë udhëzim.

<sup>141</sup> Është Ai që i prodhon kopshtet edhe me korniza mbështetëse për bimët edhe pa to, palmat me hurma, të korrat me shije të larmishme, ullirin e shegën – të ngjashme e prapë të ndryshme. Pra kur japin fryte, hani ca nga to, duke e paguar atë që duhet në ditën e vjelje-korrjes, por mos shpenzoni kot: **Allahut** nuk i pëlqejnë njerëzit që shpenzojnë kot. <sup>142</sup> [Ai jua dha] bagëtitë, si kafshë për bartje dhe si ushqim. Pra hajeni atë që jua ka furnizuar **Allahu** dhe mos i ndiqni gjurmët e Satanit: ai është armiku juaj i betuar. <sup>143</sup> [**Allahu** jua dha] tetë kafshë, në [katër] çifte: një çift të deleve dhe një çift të dhive – pyeti [Profet]: ‘A jua ka ndaluar Ai dy meshkujt, dy femrat, apo të rinjtë në mitrat e dy femrave? Më tregoni bazuar në dijen tuaj nëse po e tregoni të vërtetën.’ <sup>144</sup> Dhe një çift të deveve dhe një çift të gjedheve – pyeti [Profet]: ‘A jua ka ndaluar Ai dy meshkujt, dy femrat, apo të rinjtë në mitrat e dy femrave? A ishit të pranishëm kur **Allahu** jua dha këta urdhra?’ Pra kush është më i lig se ai që trillon rrena kundër **Allahut** pa asnjë bazë në dije ashtu që t’i devijojë njerëzit? **Allahu** nuk i udhëzon keqbërësit.

<sup>145</sup> [Profet,] thuaj: ‘Në tërë atë që më është shpallur, nuk gjej asgjë të ndaluar për ta ngrënë njerëzit, pos cofëtinës, gjakut të derdhur, mishit të dërrit – është i neveritshëm – apo një flijimi mëkatar mbi të cilin është thirrur çfarëdo emri tjetër përveç i **Allahut**.’ Por nëse dikush është i detyruar nga uria, e jo nga merak apo teprimi, atëherë **Allahu** është më falësi dhe më mëshirëploti. <sup>146</sup> Ne e ndaluan për çifutët çdo kafshë me kthetra dhe dhjamin e gjedheve dhe deleve, pos asaj që është në kurrizin e tyre dhe në zorrët e tyre, apo që ngjitet në eshtrat e tyre. Kështu i ndëshkuam për mosbindjen e tyre: Ne jemi besnikë ndaj fjalës Sonë. <sup>147</sup> Nëse ata [mosbesimtarët] të akuzojnë [Profet] se po gënjen, thuaj: ‘Zoti juaj ka mëshirë gjithë-përfshirëse, por ndëshkimi I Tij nuk mund të shmanget nga keqbërësit.’ <sup>148</sup> Idhujtarët do të thonë: ‘Po të donte **Allahu**, nuk do t’i mvëshnim partnerë Atij – as etërit tanë nuk do ta bënë këtë – as s’do ta

---

<sup>a</sup> d.m.th. dëshmi të shkrimit të shenjtë, krahaso me vargjet 143, 144 dhe 148.

deklaroni të ndaluar ndonjë gjë.’ Në mënyrën e njëjtë, ata para tyre [e] mohuan vazhdimisht [të vërtetën] deri kur e provuan ndëshkimin Tonë. Thuaj: ‘A e keni ndonjë njohuri që mund të na e tregoni? Ju veç e ndiqni supozimin dhe thoni veç rrena.’<sup>149</sup> Thuaj: ‘Argumenti përfundimtar i përket veç **Allahut**. Po të donte, do t’ju kishte udhëzuar të gjithëve.’<sup>6:150</sup> Thuaj: ‘Sillni dëshmitarët tuaj për të dëshmuar se **Allahu** i ka ndaluar të gjitha këto.’ Nëse dëshmojnë, mos dëshmoni me ta. Mos i ndiqni tekat e atyre që e kanë mohuar shpalljen Tonë, që nuk besojnë në Të Përtëjmen dhe që sajojnë [gjëra] të barabarta me Zotin e tyre.

<sup>151</sup> Thuaj: ‘Ejani! Do t’ju tregoj se çka ju ka ndaluar vërtet Zoti juaj. Mos i atribuoni Atij asgjë si partner; jini të mirë me prindërit tuaj; mos i vrisni fëmijët tuaj nga frika e varfërisë’ – Ne do t’ju furnizojmë juve dhe ata – ‘qëndroni larg nga bërja e veprave të turpshme, qoftë haptas apo fshehtas; mos ia merrni tjetrit jetën që **Allahu** e ka bërë të shenjtë, përveç me të drejtë. Kjo është çka ju urdhëron Ai të bëni: mbase do ta përdorni arsyen tuaj.’<sup>152</sup> Qëndroni larg nga prona e jetimëve, pos me më të mirat [qëllime], deri kur ta arrijnë moshën; bëni matje dhe peshim të plotë, sipas drejtësisë’ – Ne nuk e ngarkojmë asnjë shpirt me më shumë se që mund të durojë – ‘kur flisni, jini të drejtë, edhe nëse bëhet fjalë për një të afërm; mbani çfarëdo premtimes që i jepni në emrin e **Allahut**. Kjo është ajo që Ai ju urdhëron ta bëni, që të mund të dëgjoni me vëmendje’ –<sup>153</sup> kjo është rruga Ime, që udhëheq drejt, pra ndiqeni dhe mos ndiqni rrugë të tjera: ato do t’ju largojnë nga ajo – ‘Kjo është çka ju urdhëron Ai të bëni, që të mund të përmbaheni nga veprimet e këqija.’

<sup>154</sup> Edhe një herë:<sup>a</sup> Ne ia dhamë Musait Shkrimin e Shenjtë, duke [e] përsosur [favorin Tonë] për ata që bëjnë mirë, duke shpjeguar gjithçka qartë, si udhëzim e mëshirë, ashtu që ata të mund të besojnë në takimin me Zotin e tyre.<sup>155</sup> Ky, gjithashtu, është Shkrim i Shenjtë i bekuar që Ne e kemi zbritur – ndiqeni dhe jini të vetëdijsëm për Zotin tuaj, ashtu që të mund të mëshiroheni –<sup>156</sup> që të mos thoni pastaj: ‘Shkrimet e Shenjta i janë zbritur veç dy komuniteteve para nesh: ne nuk ishim të informuar se çka studiuan ata’,<sup>157</sup> apo ‘Ah po të na zbritej Shkrimi i Shenjtë, do të ishim më të udhëzuar se sa ata.’ Tash nga Zoti juaj ju kanë ardhur dëshmia e qartë, udhëzimi dhe mëshira. Kush do të mund të ishte më i gabuar se dikush që i refuzon shpalljet e **Allahut** dhe largohet nga to? Ata që largohen do t’i shpaguajmë me ndëshkim të dhembshëm.<sup>158</sup> A po presin që t’u vijjnë vetë engjëjt, apo Vetë Zoti juaj, apo mbase disa nga shenjat E Tij? Por në Ditën që vijnë disa nga shenjat<sup>b</sup> e Zotit tuaj, asnjë shpirt nuk do të përfitojë nga besimi nëse më parë nuk kishte fare, apo nuk ka fituar tashmë ca të mira përmes besimit të tij. Thuaj: ‘Pritni po të doni: edhe ne po presim.’

---

<sup>a</sup> Kjo e përsërit deklaraten në vargjet 91-3 si përgjigje ndaj mohimit të tyre se **Allahu** ka zbritur shpallje ndonjëherë.

<sup>b</sup> Shenjat e Ditës së Gjykimit.

159 Sa për ata që e përçanë fenë e tyre  
dhe u ndanë në fraksione,  
[ti Profet] s'ke të bësh fare me ta.  
Çështja e tyre varet veç nga **Allahu**:  
me kohë do t'u tregojë  
për veprat e tyre.

6:160 Kushdo që e ka bërë<sup>a</sup>  
një vepër të mirë  
do ta ketë dhjetëfish më shumë  
në llogarinë e tij,  
por kushdo që ka bërë vepër të keqe  
do të shpaguehet  
veç me barasvlerën e saj –  
nuk do t'u bëhet e padrejtë.

<sup>161</sup> Thuaj: 'Zoti im më ka udhëzuar në rrugë të drejtë, në fe të ndershme, besimin e Ibrahimit – njeri i besimit të pastër. Ai nuk ishte politeist.'

162 Thuaj:  
"Vërtet lutjet dhe flijimi im i plotë  
dhe jeta ime dhe vdekja ime  
janë për **Allahun**,  
Zotin e të gjitha Botëve;

163 Ai nuk ka partner:  
kështu jam urdhëruar,  
dhe jam i pari<sup>b</sup>  
që i kushtohem Atij."

---

<sup>a</sup> Fjalë për fjalë: Kushdo që e *sjell*, dmth. në Gjykim

<sup>b</sup> I pari 'nga ju': krahaso me vargun 14 dhe shumë të tjerë.

164 Thuaj:  
“A do të kërkoj Zot  
tjetër pos **Allahut**,  
kur ai është Zoti i të gjitha gjërave?”  
Dhe secili shpirt është përgjegjës  
për veprimet e tij;  
asnjë shpirt nuk do ta bartë barrën e tjetrit.  
Ju të gjithë do të ktheheni  
te Zoti juaj në fund,  
dhe Ai do t’jua tregojë  
të vërtetën për dallimet tuaja.”

165 Është Ai që ju bëri pasardhës<sup>a</sup> [të njëri-tjetrit] në tokë dhe i ngrit në rang disa nga ju mbi të tjerët, t’ju sprovtojë përmes asaj që jua jep. [Profet,] Zoti yt është i shpejtë në ndëshkim, e megjithatë Ai është më falësi dhe mëshirëploti.

---

<sup>a</sup> Termi *khalifa* normalisht përkthehet si ‘mëkëmbës’ (qeveritar në emër të dikujt) apo ‘zëvendësues’. Gjersa ky është një kuptim i termit, kuptimi i tij themelor është ‘pas-ardhës’ – Kurani flet shpesh për gjeneratat dhe individët që janë pas-ardhës të njëri-tjetrit, krahaso me 2:30, 7:129, etj. – apo ‘kujdestar’ të cilit i jepet përkohësisht një përgjegjësi, krahaso Musain (Moses) dhe Harunin (Aaron), 7:142.

**Përshkrimi para kaptinës 6 nga Abdel Haleem:**

*Sure mekase që e merr titullin nga vargjet 136-9. Adresohen plotësisht pretendimet e rreme që i bënë politeistët për bagëtinë: surja në tërësinë e saj e bën të qartë se është **Allahu** ai që krijon, kontrollon dhe sheh gjithçka dhe se Atij i drejtohem në kohëra nevoje. Kështu u jep përgënjeshtër të gjatë pretendimeve të idhujtarëve.*

**Shënimet gjuhësore (Thomas Cleary)**

*Bagëtitë (al ‘An‘aam) (Kaptina 6)*

Kjo sure u shpall në Mekë.

2 “pastaj e vendosi një afat [për ju]”: Fjala “afat” e përkthen fjalën ‘*ajal*, që domethënë një afat i caktuar apo një periudhë e paracaktuar. Këtu i referohet një afati për evolucionin e individit dhe një afati për evolucionin e racës njerëzore.

42-48 Këto pasazhe ofrojnë model të *fitna*, “sprovës”, edhe nga fatkeqësia edhe nga lumturia, duke i përfshirë reflektimet përmes të cilave njerëzimi mund ta shfrytëzojë më së miri sprovën. Ata që ishin “mbërthyer” me “vuajtje e vështirësi” ishin “komunitetet para teje”.

50 Këto janë udhëzime për Muhamedin dhe me zgjerim për çdo profet apo mësues fetar, për ta shmangur ndërfitjen e vetes ndërmjet Zotit dhe njerëzimit si objekt i adhurimit dhe për ta referuar tërë të vërtetën te burimi i saj real.

52 “duke e kërkuar Esencën E Tij”: Fjala për “esencë” këtu, *wajh*, i bart edhe kuptimet e qenies, fytyrës, synimit, qëllimit, objektivit, sensit, kuptimit, favorit, nderit, konsideratës.

53 Dallimi ndërmjet elitës shpirtërore dhe elitës shoqërore është po ashtu provë për vetë-vlerësimin e elitës shoqërore.

- 116 Ky varg e thekson dallimin ndërmjet imagjinimit subjektiv dhe realitetit objektiv.
- 117 Sufiu i madh Najmuddin Kubraa thoshte: “E vërteta e vetmja e di se çka është e vërtetë.”
- 122 “veprat e këqija të mosbesimtarëve janë bërë t’u duken tërheqëse atyre”: Kjo e përshkruan natyrën e shprehisë, të obsesionit dhe të vetë-deluzionit.
- 130 “xhindet dhe njerëzimi” (*al jinn w al ‘ins*): Xhindet, si njerëzimi, dallojnë ndërmjet vete në cilësinë e tyre të karakterit dhe të vëmendësisë për Zotin.  
“do ta arrini këtë Ditë”: Kjo shprehje i referohet ditës së ringjalljes dhe gjykimit.  
“shpresa të kota”: Kjo i referohet mosmirënjohjes ndaj Zotit se e ngatërrojnë imagjinaren me realen.
- 159 Ata që e fragmentojnë fenë e vënë njerëzoren në vend të hyjnore; opinionet dhe besnikëritë e tyre ndaj grupit marrin më shumë rëndësi për ta sesa realiteti unik i Zotit.
- 160 “Kushdo që e ka bërë një vepër të mirë do ta ketë dhjetëfish më shumë në llogarinë e tij”: Shpërblimi i së mirës është dhjetëfish më shumë se që e meriton; kjo i atribuohet kënaqësisë dhe mirësisë së Zotit, shembullit të përsosur të bujarisë dhe dashamirësisë.



## 7: Lartësitë (EL-A‘RÂF)

Në emrin e **Allahut**, Dashamirësit, Mëshirëplotit

<sup>1</sup> *Elif Lam Mim Sad*

<sup>2</sup> Ky Libër të është zbritur ty [Profet],  
pra le të mos ketë shtrëngim  
në gjoksin tënd nga ai<sup>a</sup>,  
që të mund të paralajmërosh me të,  
dhe t’ua përkujtosh besimtarëve:

<sup>3</sup> 'Ndiqeni atë që ju është zbritur  
nga Zoti juaj,  
dhe mos ndiqni mbrojtës pos Tij.  
Sa rrallë jeni të vëmendshëm!'

<sup>4</sup> Sa shumë qytete i kemi rrënuar Ne!  
Dhe i kemi vizituar me hakmarrjen Tonë  
në shtëpitë e tyre natën  
apo gjersa flinin ditën:

<sup>5</sup> dhe thirrja e vetme e tyre,  
kur u vinte hakmarrja Jonë ishte:  
“Sa gabim kemi qenë!”

<sup>6</sup> Dhe do t’i marrim në pyetje ata  
të cilëve u ishin çuar të dërguar –  
dhe do t’i marrim në pyetje vetë të dërguarit –

<sup>7</sup> dhe, me njohuri të plotë,  
se nuk ishim të pavëmendshëm kurrë,  
do t’u tregojmë se çka kanë bërë.

<sup>8</sup> Në atë Ditë peshimi i veprave  
do të jetë i vërtetë dhe i drejtë:  
ata me vepra të mira peshë-rënda  
do të jenë ata që përparojnë,

---

<sup>a</sup> Shih 6:33-6, 20:2

<sup>9</sup> dhe ata me vepra të mira peshë-lehta  
do të jenë ata që i kanë humbur shpirtrat e tyre  
përmes refuzimit të tyre të gabueshëm  
të mesazheve Tona.

<sup>7:10</sup> *Ne* ju sistemua në tokë,  
dhe *Ne* jua kemi siguruar jetesën aty –  
e paktë është mirënjohja juaj!

<sup>11</sup> Dhe *Ne* ju krijuam dhe ju formësua:  
dhe pastaj u thamë engjëjve:  
“Përkuluni para Ademit”,  
dhe ata u përkulën.  
Por jo Iblisi:  
ai nuk ishte nga ata që u përkulën.

<sup>12</sup> **Allahu** tha:  
“Çka të pengoi të mos përkulesh  
siç të urdhërova?”  
dhe ai tha:  
“Unë jam më i mirë se ai:  
mua më krijove nga zjarri  
dhe atë nga balta.”

<sup>13</sup> **Allahu** tha:  
“Zbrit nga këtu!  
Nuk të takon të jesh arrogant këtu<sup>a</sup>.  
Dil pra!  
Je i neveritshëm!”

<sup>14</sup> por Iblisi tha:  
“Më jep afat  
deri në Ditën kur njerëzit  
ngriten nga të vdekurit”,

---

<sup>a</sup> Në Kopsht, krahaso me 20:117.

- 15 dhe **Allahu** u përgjigj:  
“E ke afatin.”
- 16 Dhe pastaj Iblisi tha:  
“Duke e marrë parasysh faktin  
se më bëre të devijoj,  
unë do t’u rri në pritë atyre  
në rrugën Tënde të drejtë:
- 17 Dhe do t’u vij papritmas –  
në fytyrat e tyre dhe pas shpinës  
dhe nga e djathta e nga e majta –  
dhe do ta shohësh  
se shumica nga ta  
janë mosmirënjohës.”
- 18 **Allahu** tha:  
“Dil nga këtu!  
Je i përçmuar dhe i dëbuar!  
Beto hem se do ta mbushi ferrin  
me ty dhe të gjithë ata që të ndjekin!
- 19 “Por ti dhe gruaja jote, Adem,  
banoni në Kopsht.  
Të dy hani çka të doni;  
por mos iu afroni kësaj peme,  
se mandej bëheni mëkatarë.”

7:20 Pastaj Satani  
u pëshpëriti sugjerime  
që t’ua shfaqë lakuriqësinë e tyre<sup>a</sup>,  
që kish qenë e fshehur nga ta,  
dhe tha:  
“Zoti juaj jua ka ndaluar këtë pemë  
veç t’ju parandalojë të bëheni engjëj apo të pavdekshëm”,

---

<sup>a</sup> Tradicionalisht e përkthyer si ‘pjesët private’, por arabishtja nuk e ka domosdoshmërisht këtë kuptim.

- 21 dhe iu betua atyre:  
“Po ju jap këshillë të singertë” –
- 22 i joshi me rrena.  
Kur e provuan pemën,  
atyre iu shfaq lakuriqësia e tyre:  
nisën të qepin bashkë  
gjethe nga Kopshti  
për t’u mbuluar.  
Dhe Zoti i tyre u thirri:  
“A s’jua ndalova t’i afroheni asaj peme?  
A s’ju paralajmërova se Satani  
ishte armiku juaj i betuar?”
- 23 Ata u përgjigjën:  
“Zoti ynë,  
e kemi shtypur veten:  
nëse nuk na fal  
dhe nuk ke mëshirë për ne,  
do të jemi të humbur.”
- 24 Ai tha:  
“Të gjithë dilni jashtë!  
Jeni armiq të njëri-tjetrit<sup>a</sup>.  
Në tokë do të keni vend-banim  
dhe furnizime – për ca kohë.”
- 25 Ai tha:  
“Aty do të jetoni,  
aty do të vdisni;  
nga aty do t’ju nxjerrin.”

---

<sup>a</sup> Iblisi është armiku i njerëzimit dhe anasjelltas.

26 Fëmijë të Ademit,  
Ne ju kemi dhënë veshje  
për ta mbuluar lakuriqësinë tuaj  
dhe si zbukurim për ju;  
veshja e vetëdijes për **Allahun** është më e mira nga veshjet.  
Kjo është një nga shenjat e **Allahut**,  
që njerëzit të mund të jenë të vëmendshëm.

27 Fëmijë të Ademit,  
mos e lejoni Satanin t'ju joshë  
siç kishte bërë me të parët tuaj,  
duke i bërë ta lënë Kopshtin,  
duke i zhveshur nga veshjet e tyre<sup>a</sup>  
për t'ua shfaqur lakuriqësinë e tyre:  
ai dhe hordhitë e tij  
mund t'ju shohin  
nga aty ku s'mund t'i shihni:  
se Ne i kemi bërë të ligët  
aleatë të atyre që nuk besojnë.

28 E kur [këta njerëz] bëjnë diçka të turpshme<sup>b</sup>,  
thonë: "I gjetëm paraardhësit tanë duke e bërë këtë",  
dhe "**Allahu** na ka urdhëruar ta bëjmë këtë."  
Thuaj [Profet]: "Zoti im  
nuk urdhëron vepra të turpshme.  
Si mund të thoni për **Allahun**  
gjëra që nuk i dini [se a janë të vërteta]?"

29 Thuaj:  
"Zoti im urdhëron ndershmëri.  
Drejtojani adhurimin tuaj Atij  
kudo që luteni;  
përkushtojani fenë tuaj plotësisht Atij.  
Siç ju krijoi herën e parë,  
ashtu do të ktheheni [në jetë] përsëri."

---

<sup>a</sup> Të vetëdijes për Zotin. Kjo është njëra nga pikëpamjet e raportuara nga Razi.

<sup>b</sup> Është sugjeruar që kjo mund t'i referohet zakonisht pagan të burrave dhe grave që ecin rreth Qabesë lakuriq (Razi).

7:30 Disa i ka udhëzuar,  
ndërsa disa janë dënuar të devijojnë:  
ata i morën të ligët  
në vend të **Allahut**,  
si padronë të tyre,  
duke menduar se janë të udhëzuar si duhet.

31 Fëmijë të Ademit,  
vishuni mirë<sup>a</sup>  
kurdo që jeni në adhurim,  
dhe hani e pini  
[siç e kemi lejuar Ne]  
por mos e teproni:  
**Allahu** nuk i do  
njerëzit që e teprojnë.

32 Thuaj [Profet]: ‘Kush e ka ndaluar zbukurimin dhe ushqyerjen që **Allahu** e ka furnizuar për shërbyesit E Tij?’ Thuaj: ‘Ato janë [të lejuara] për ata që besojnë gjatë jetës së kësaj bote: ato do të jenë veç të tyre në Ditën e Ringjalljes.’ Kështu Ne e bëjmë shpalljen Tonë të qartë për ata që kuptojnë.

33 Thuaj [Profet]:  
“Zoti im i ndalon  
veç veprat e turpshme –  
qofshin të hapura a të fshehta –  
dhe mëkatën dhe agresionin e paarsyeshëm;  
dhe, pa autorizimin E Tij, të shoqëroni gjëra me Të,  
dhe të thoni gjëra për Të  
pa pasur njohuri.<sup>b</sup>”

34 Është një kohë e caktuar për çdo popull: ata s’mund ta ngusin, as, kur të vijë, s’do të mund ta vonojnë as për një çast të vetëm.

---

<sup>a</sup> Fjalë për fjalë ‘visheni zbukurimin tuaj’, por kjo është qartë referencë për rroba dhe jo për stoli; krahaso me 7:26. Shih gjithashtu referencat për ushqimin në 6:135, 145, 148.

<sup>b</sup> Njohuri të shpallur, krahaso me 6:148.

<sup>35</sup> Fëmijë të Ademit,  
kur të dërguarit nga mesi juaj  
ju vijnë duke jua recituar shpalljet E Mija,  
ata që janë të vetëdijsëm për **Allahun**  
dhe jetojnë ndershëm si duhet  
nuk kanë pse të frikësohen  
dhe nuk do të pikëllohen.

<sup>36</sup> Por ata që i refuzojnë shpalljet Tona  
dhe i përçmojnë me arrogancë  
janë njerëz të Zjarrit,  
dhe aty do të mbesin.

<sup>37</sup> Kush është më gabim se sa personi që shpik rrena kundër **Allahut** apo i refuzon shpalljet E Tij? Njerëzit e tillë do ta kenë hisen e tyre të paracaktuar [në këtë botë], por pastaj, kur engjëjt Tanë të vijnë për t'i marrë prapa, duke thënë: 'Ku janë ata që i thirrnit përkrah **Allahut**?' do të thonë: 'Na kanë braktisur.' Do ta pranojnë se ishin mosbesimtarë dhe <sup>38</sup> **Allahu** do të thotë: 'Bashkojuni turmave të xhindeve dhe njerëzve që kanë shkuar para jush në Zjarr.' Çdo turmë e mallkon turmën e saj të afërt gjersa hyn, e pastaj, kur të mblidhen të gjithë brenda, e fundit nga to do të thotë për të parën: 'Zoti ynë, ishin ata që na kanë devijuar: jepu atyre ndëshkim të dyfishtë në Zjarr' – **Allahu** thotë: 'Secila nga ju do të ketë ndëshkim të dyfishtë, megjithëse nuk e dini' – <sup>39</sup> dhe e para nga to do t'i thotë asaj të fundit: 'Ju nuk ishit më të mirë se ne: provojeni ndëshkimin që e keni fituar.'

<sup>7:40</sup> Portat e Parajsës nuk do të jenë të hapura për ata që i refuzuan shpalljet Tona dhe i shqelmuuan me arrogancë; madje edhe po të kalonte një litar i trashë<sup>a</sup> nëpër vrimën e gjilpërës ata nuk do të hynin në Kopsht. Kështu i ndëshkojmë fajtorët – <sup>41</sup> Ferri do të jetë vendi i tyre i pushimit dhe mbulesa e tyre, shtresë mbi shtresë – kështu i ndëshkojmë ata që bëjnë keq. <sup>42</sup> Por ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira – dhe Ne nuk e ngarkojmë asnjë shpirt me më shumë se që mund të durojë – janë njerëzit e Kopshtit dhe aty do të mbesin. <sup>43</sup> Do t'ua kemi hequr tërë ndjesinë e keqe nga zemrat e tyre; lumenjtë do të rrjedhin te këmbët e tyre. Do të thonë: 'Lavdet qofshin për **Allahun**, që na ka udhëzuar për këtu: po të mos na udhëzonte **Allahu**, nuk do ta kishim gjetur rrugën kurrë. Të dërguarit e Zotit tonë e sollën Të Vërtetën.' Një zë do t'u thërrasë: 'Ky është Kopshti që ju është dhënë si i juaji për shkak të veprave tuaja.' <sup>44</sup> Njerëzit e Kopshtit do t'u thërrasin

---

<sup>a</sup> Jo 'deve'. Rrënjët e fjalëve për 'deve' dhe 'litar i trashë i dredhur' janë të njëjta në arabisht dhe 'litari' ka më shumë kuptim këtu (Razi).

njerëzve të Ferrit: ‘Ne e kemi zbuluar se është e vërtetë ajo që na e premtoi Zoti ynë. Po ju a e keni zbuluar a është e vërtetë ajo që jua premtoi Zoti juaj?’ dhe ata do të përgjigjen: ‘Po’. Një zë do të shpallë nga mesi i tyre: ‘Refuzimi i **Allahut** [rri varur] mbi keqbërësit: <sup>45</sup> ata që i larguan të tjerët nga rruga e **Allahut** dhe u përpoqën ta shtrembëronin atë, ata që e mohuan Të Përtejmen.’

<sup>46</sup> Një barrierë i ndan dy grupet, me njerëz në lartësitë e tyre të cilët e njohin secilin grup nga shenjat e tij: ata do t’u thërrasin njerëzve të Kopshtit: ‘Paqja qoftë me ju!’ – ata nuk do të jenë futur, por do të jenë duke shpresuar, <sup>47</sup> dhe kur t’u bie shikimi mbi njerëzit e Zjarrit, do të thonë: ‘Zoti ynë, mos na lër t’u bashkohemi keqbërësve!’ – <sup>48</sup> dhe njerëzit e lartësive do t’u thërrasin njerëzve të caktuar që i njohin sipas shenjave të tyre: ‘Çka ju hynë në punë numrat tuaj të mëdhenj dhe krenaria juaj e rreme? <sup>49</sup> Dhe a janë këta njerëzit për të cilët u betuat se **Allahu** nuk do t’i bekonte kurrë? [Tani këtyre njerëzve po u thuhet:] “Hyni në Kopsht! S’ka frikë për ju, as s’do të pikëlloheni.”’

<sup>7:50</sup> Njerëzit e Zjarrit do t’u thërrasin njerëzve të Parajsës: ‘Na jepni pak ujë, apo çfarëdo furnizimi që jua ka dhuruar **Allahu**!’ dhe ata do të përgjigjen: ‘**Allahu** ua ka ndaluar të dyjat mosbesimtarëve – <sup>51</sup> atyre që e morën fenë e tyre si zbavitje, thjesht lojë dhe ishin mashtruar nga jeta tokësore.’ Sot Ne do t’i injorojmë<sup>a</sup>, pikërisht siç e kanë injoruar ata takimin e tyre me këtë Ditë dhe i kanë mohuar Shpalljet Tona.

<sup>52</sup> Ne ua kemi sjellë njerëzve një Libër të Shenjtë – e kemi shpjeguar atë në bazë të dijes së vërtetë – si udhëzim dhe mëshirë për ata që besojnë. <sup>53</sup> Çka po presin pos përmbushjes së [profecisë përfundimtare të] tij? Në Ditën që përmbushet, ata që e kishin injoruar do të thonë: ‘I dërguari i Zotit tonë e foli të vërtetën. A ka dikush të ndërmjetësojë tash për ne? Ose a mund të na dërgojnë prapa që të sillemi ndryshe nga mënyra si u sollëm më parë?’ Ata vërtet do t’i kenë shkapërderdhur shpirtrat e tyre dhe të gjithë [idhujt] që ata i shpikën do t’i kenë braktisur ata.

<sup>54</sup> Zoti juaj është **Allahu**, që i krijoi qiejt dhe tokën për gjashtë Ditë, pastaj u vendos në fron; Ai e bën natën ta mbulojë ditën në ndjekje të shpejtë; Ai e krijoi diellin, hënën dhe yjet që të jenë nën-shërbyes ndaj komandës Së Tij; tërë krijimi dhe komanda i përkasin Atij. Lartësuar qoftë **Allahu**, Zoti i të gjitha botëve! <sup>55</sup> Thirreni Zotin tuaj përlësisht dhe privatisht – Ai nuk i do ata që i kalojnë kufijtë E Tij: <sup>56</sup> mos e korruptoni vendin pasi të jetë ndrequr si duhet – thirreni Atë duke u frikësuar dhe duke shpresuar. Mëshira e **Allahut** është pranë atyre që bëjnë mirë. <sup>57</sup> Është **Allahu** që i dërgon erërat, duke e sjellë lajmin e mirë të mirësisë Së Tij që po vjen dhe kur ato t’i kenë mbledhur retë e rënda, Ne i çojmë në tokë të vdekur kur bëjmë të bjerë shi, duke i nxjerrë të gjitha llojet e të

---

<sup>a</sup> ‘Injoroj’ është një nga kuptimet e *nasiya*-s arabe që normalisht përkthehet ‘harroj’.



korrave, pikërisht siç do t'i nxjerrim të vdekurit. A nuk do të reflektoni?  
<sup>58</sup> Bimësia del me bollëk nga toka e mirë, nga vullneti i Zotit të saj, por nga toka e keqe del veç pakicë: Ne ua shpjegojmë Shpalljet Tona në mënyra të ndryshme atyre që falënderojnë.

<sup>59</sup> Ne e dërguam Nuhun te populli i tij. Ai tha: 'Populli im, shërbeni **Allahut**: nuk keni zot tjetër pos Tij. I druhem për ju ndëshkimit të një Dite të frikshme!' <sup>7:60</sup> por udhëheqësit e shquar të popullit të tij thanë: 'Besojmë se ke devijuar shumë.' <sup>61</sup> Ai u përgjigj: 'Populli im, nuk ka asgjë të devijuar në lidhje me mua! Përkundrazi, jam i dërguar nga Zoti i të gjitha Botëve: <sup>62</sup> po jua përcjelli mesazhet e Zotit tim dhe po ju jap këshillë të sinqertë. Di gjëra nga **Allahu** që ju nuk i dini. <sup>63</sup> A ju duket kaq e çuditshme që një mesazh do të vinte nga Zoti juaj – përmes një njeriu në mesin tuaj – t'ju paralajmërojë dhe t'ju bëjë të vetëdijshëm për **Allahun** që të mund t'ju jepet mëshirë?' <sup>64</sup> por ata e quajtën gënjeshtar. Ne e shpëtuam atë dhe ata që ishin me të, në Arkë dhe i përmbytëm ata që i mohuan shpalljet Tona – ata ishin të verbër me dashje.

<sup>65</sup> Popullit të Adit ua dërguam vëllanë e tyre, Hudin. Ai tha: 'Populli im, shërbeni **Allahut**: nuk keni zot tjetër pos Tij. A nuk do të jeni të vëmendshëm?' <sup>66</sup> por udhëheqësit mosbesimtarë të popullit të tij thanë: 'Besojmë se je budalla' dhe 'Mendojmë se je gënjeshtar.' <sup>67</sup> Ai tha: 'Populli im, nuk ka asgjë budallaqe në lidhje me mua! Përkundrazi, jam i dërguar nga Zoti i të gjitha Botëve: <sup>68</sup> po jua përcjelli mesazhet e Zotit tim. Jam këshillues i juaji i sinqertë dhe i ndershëm. <sup>69</sup> A ju duket kaq e çuditshme që një mesazh do të vinte nga Zoti juaj, përmes një njeriu në mesin tuaj, t'ju paralajmërojë? Kujtojeni se si Ai ju bëri trashëgues pas popullit të Nuhut dhe jua ka rritur shkallën e zhvillimit: kujtoni dhuratat e **Allahut**, që të mund të përparoni.' <sup>7:70</sup> Ata thanë: 'A vërtet ke ardhur të na thuash t'i shërbejmë veç **Allahut** dhe ta braktisim atë të cilës i shërbyen paraardhësit tanë? Nëse kjo që po e thua është e vërtetë, na e sill ndëshkimin me të cilin po kërcënon.' <sup>71</sup> Ai tha: 'Tashmë e keni bërë veten për ta marrë neverinë dhe zemërimin e Zotit tuaj. A po grindeni me mua për emra të thjeshtë që i shpikët ju dhe paraardhësit tuaj, emra për të cilët **Allahu** nuk ka dhënë asnjë autoritet? Veç pritni; edhe unë po pres.' <sup>72</sup> Ne e shpëtuam atë dhe ata që ishin me të, përmes mëshirës Sonë; i shkatërruam ata që i mohuan shpalljet Tona dhe që nuk do të besonin.

<sup>73</sup> Popullit të Themudit ua dërguam vëllanë e tyre, Salihun. Ai tha: 'Populli im, shërbeni **Allahut**: nuk keni zot tjetër pos Tij. Tash ju ka ardhur një shenjë e qartë nga Zoti juaj: kjo është deveja e **Allahut** – shenjë për ju – pra lëreni të kullojë në tokën e **Allahut** dhe mos i bëni dëm në asnjë mënyrë, ose do të goditeni nga një torturë e dhembshme. <sup>74</sup> Kujtojeni se si Ai ju bëri trashëgues pas Adit dhe ju rehatoi në atë vend që të ndërtoni kështjella në fushat e saj dhe të gdhendni shtëpi nga malet: kujtoni bekimet e **Allahut** dhe mos përhapni

korrupsion në vend’,<sup>75</sup> por udhëheqësit arrogantë në mesin e popullit të tij u thanë besimtarëve për të cilët mendonin se janë të parëndësishëm: ‘A mendoni sinqerisht se Salihu është i dërguar nga Zoti i tij?’ Ata thanë: ‘Po. Besojmë në mesazhin e dërguar përmes tij’,<sup>76</sup> por udhëheqësit arrogantë thanë: ‘E mohojmë atë në të cilën besoni’,<sup>77</sup> dhe pastaj e gjymtuan devenë. E kundërshtuan urdhrin e Zotit dhe thanë: ‘Salih, zbritë ndëshkimin me të cilin po kërcënon, në qofsh vërtet i dërguar!’<sup>78</sup> Një tërmet i mbërtheu: në mëngjesin tjetër ishin të vdekur në shtëpitë e tyre.<sup>79</sup> Kështu ai u largua nga ta, duke thënë: ‘Populli im, jua përcolla mesazhet e Zotit tim dhe ju dhashë këshillë të sinqertë, por nuk ju pëlqyen ata që dhanë këshillë të sinqertë.’

<sup>7:80</sup> Ne e dërguam Lutin dhe ai i tha popullit të tij: ‘Si mund ta praktikoni këtë shkelje? Askush në botë nuk jua ka kaluar në këtë.’<sup>81</sup> Epushoni për meshkuj në vend se për femra! I kaloni të gjithë kufijtë!’<sup>82</sup> E vetmja përgjigje që e dha populli i tij ishte të thonë [njëri-tjetrit]: ‘Dëboni jashtë qytetit tuaj! Këta burra duan ta mbajnë veten të dëlirë!’<sup>83</sup> Ne e shpëtuam atë dhe të afërmit e tij – përveç gruas së tij që ndejti prapa –<sup>84</sup> dhe e lëshuam mbi [pjesën tjetër nga] ta një shi [të shkatërrimit]. Shiheni fatin e keqbërësve.

<sup>85</sup> Popullit të Medjenit ua dërguam vëllanë e tyre, Shuajbin. Ai tha: ‘Populli im, shërbeni **Allahut**: nuk keni zot tjetër pos Tij. Një shenjë e qartë ju ka ardhur nga Zoti juaj. Bëni matje dhe peshime të plota dhe mos i nënvlerësoni mallrat e njerëzve; mos bëni korrupsion në vend pasi të jetë ndrequr si duhet: kjo është më e mirë për ju, në qofshi besimtarë.’<sup>86</sup> Mos qëndroni në çdo shteg, duke i kërcënuar dhe penguar nga rruga e **Allahut** ata që besojnë në Të, duke u përperjekur ta shtrembëroni. Kujtojeni si ishit të paktë dikur dhe Ai ju bëri të shumëfishoheshit. Mendoni për fatin e atyre që e përhapnin korrupsionin.

<sup>87</sup> Nëse disa nga ju  
e besoni mesazhin që e sjell unë  
dhe të tjerët nuk e besojnë,  
atëherë kini durim deri kur **Allahu** të gjykojë mes nesh.  
Ai është më i miri nga krejt gjykatësit.’

<sup>88</sup> Udhëheqësit arrogantë të popullit të tij thanë: ‘Shuajb, do t’ju dëbojmë ty dhe bashkë-besimtarët e tu nga qyteti ynë nëse nuk ktheheni në fenë tonë.’ Ai tha: ‘Çka?! Edhe nëse na neverit?’<sup>89</sup> Po të ktheheshim në fenë tuaj pasi **Allahu** na shpëtoi nga ajo, do të shpiknim rrena për Të: nuk ka shanse se do të mund t’i ktheheshim – pos me vullnet të **Allahut**, Zotit tonë: në dijen E Tij Ai përfshin gjithçka. E vëmë besimin tonë në **Allahun**. Zoti ynë, vëre në dukje të vërtetën [dhe gjyko] ndërmjet nesh dhe popullit tonë, se Ti je gjykatësi më i mirë.’

<sup>7:90</sup> Udhëheqësit mosbesimtarë nga populli i tij thanë: ‘Sigurisht do të jeni humbës nëse e ndiqni Shuajbin’ – <sup>91</sup> i mbërtheu një tërmet: në mëngjesin tjetër ishin të vdekur në shtëpitë e tyre; <sup>92</sup> dukej sikur ata që e patën refuzuar Shuajbin të mos kishin jetuar kurrë aty; ishin ata që e patën refuzuar Shuajbin - ata që ishin humbësit – <sup>93</sup> kështu ai u largua nga ta, duke thënë: ‘Populli im, jua përcolla mesazhet e Zotit tim dhe ju dhashë këshillë të sinqertë, pra pse do të duhej të pikëllohem për njerëzit që refuzuan të besojnë?’

- <sup>94</sup> Sa herë që i dërgonim profet një qyteti,  
Ne i mundonim njerëzit e tij [mosbesimtarë]<sup>a</sup>  
me vuajtje dhe vështirësi,  
që të mund të përuleshin [para **Allahut**],
- <sup>95</sup> dhe pastaj e ndërronim vështirësinë me përparim  
deri kur shumëfishoheshin. Por pastaj thoshin:  
“Edhe paraardhësit tanë u patën prekur  
nga vështirësia dhe mundimi”,  
kështu që Ne i mbërthenim befas,  
gjersa ishin të pavetëdijsëm.
- <sup>96</sup> Sikur njerëzit e atyre qyteteve  
të kishin besuar dhe të ishin të vetëdijsëm për **Allahun**,  
sigurisht që do t’i mbulonim  
me bekime nga qiejt e toka:  
por e refuzuan të vërtetën  
prandaj i dënuam  
për veprat e tyre të këqija.

<sup>97</sup> A ndihen të sigurt njerëzit e këtyre qyteteve se ndëshkimi Ynë nuk do t’u vijë natën, gjersa janë në gjumë? <sup>98</sup> A ndihen të sigurt njerëzit e këtyre qyteteve se ndëshkimi Ynë nuk do t’u vijë ditën, gjersa janë në lojë? <sup>99</sup> A ndihen të sigurt kundrejt planit të **Allahut**? Veç humbësit ndihen të sigurt kundrejt planit të **Allahut**. <sup>7:100</sup> A s’është e qartë për ata që e trashëgojnë vendin nga brezat e mëparshëm se Ne mund t’i ndëshkojmë edhe ata për mëkatet e tyre nëse duam? Dhe t’ua vulosim zemrat që të mos mund të dëgjojnë? <sup>101</sup> Ne t’i kemi treguar [Profet] rrëfimet e atyre qyteteve: të dërguarit u erdhën, dhe shenjat e qarta, por nuk do të besonin në atë që tashmë e kishin refuzuar – kështu **Allahu** i vulos

---

<sup>a</sup> Kjo nënkuptohet në arabisht (Razi).

zemrat e mosbesimtarëve. <sup>102</sup> Ne e pamë se shumica nga ta nuk i respektuan zotimet e tyre; e pamë se shumica nga ta ishin mospërfillës.

<sup>103</sup> Pas këtyre, Ne e dërguam Musain me shenjat Tona te Faraoni dhe mbështetësit e tij udhëheqës, por i refuzuan ato. Shiheni fatin e atyre që dikur përhapnin korrupsion. <sup>104</sup> Musai tha: ‘Faraon, jam i dërguar nga Zoti i të gjitha Botëve, <sup>105</sup> i obliguar ta them për **Allahun** veç të vërtetën dhe asgjë tjetër dhe ta kam sjellë një shenjë të qartë nga Zoti yt. Lejoji Fëmijët e Izraelit të vijnë me mua.’ <sup>106</sup> Ai tha: ‘Prodhoje këtë shenjë që e ke sjellë, nëse po e tregon të vërtetën.’ <sup>107</sup> Kështu, Musai e hodhi shkopin e tij dhe – shih! – ishte gjarpër, i qartë për të gjithë, <sup>108</sup> dhe pastaj e nxori dorën e tij the – shih! – ishte e bardhë që ta shohin të gjithë. <sup>109</sup> Udhëheqësit në mesin e njerëzve të Faraonit thanë: ‘Ky njeri është magjistar i ditur!’ <sup>7:110</sup> E ka ndërmend të të dëbojë nga vendi yt!’ Faraoni tha: ‘Çka po sugjeroni?’ <sup>111</sup> Ata thanë: ‘Mbaje atë dhe vëllanë e tij për ca kohë dhe ço të dërguar në të gjitha qytetet <sup>112</sup> për ta thirrur çdo magjistar të ditur te ti.’

<sup>113</sup> Magjistarët erdhën te Faraoni dhe thanë: ‘A do të shpërblehemi nëse fitojmë?’ <sup>114</sup> dhe ai u përgjigj: ‘Po dhe do t’i bashkoheni oborrit tim të brendshëm.’ <sup>115</sup> Kështu ata thanë: ‘Musa, a do të hedhësh ti i pari apo të hedhim ne?’ <sup>116</sup> Ai tha: ‘Hidhni ju’ dhe ata e bënë këtë, duke i magjepsur sytë e njerëzve, duke u hedhur frikë dhe duke shkaktuar magji të madhe. <sup>117</sup> Pastaj Ne e frymëzuam Musain: ‘Hidhe shkopin tënd’ dhe – shih! – ai i gëlltiti falsitetet e tyre. <sup>118</sup> E vërteta ishte konfirmuar dhe ajo që e kishin prodhuar ata u kthye në asgjë: <sup>119</sup> ata ishin të mundur aty dhe plotësisht të turpëruar. <sup>7:120</sup> Magjistarët ranë në gjunjë <sup>121</sup> dhe thanë: ‘Ne besojmë në Zotin e Botëve, <sup>122</sup> Zotin e Musait dhe të Harunit!’ <sup>123</sup> por Faraoni tha: ‘Si guxonit të besoni në Të para se t’jua kem dhënë lejen unë? Ky është komplot që e keni kurdisur për t’i dëbuar njerëzit nga ky qytet! Tash do ta shihni: <sup>124</sup> do t’jua pres duart dhe shputat tuaja alternative<sup>a</sup> dhe pastaj do t’ju kryqëzoj të gjithëve!’ <sup>125</sup> Ata thanë: ‘Dhe kështu ne do të kthehemi te Zoti ynë – <sup>126</sup> ankesa jote e vetme kundër nesh është se ne besuam në shenjat e Zotit tonë kur ato erdhën te ne. Zoti ynë, na mbush me qëndresë dhe na lejo të vdesim të përkushtuar ndaj Teje.’

<sup>127</sup> Udhëheqësit ndër njerëzit e Faraonit i thanë atij: ‘Por a do ta lejosh Musain dhe popullin e tij të përhapin korrupsion në vend dhe të të braktisin ty dhe zotat e tu?’ Ai u përgjigj: ‘Do t’i vrasim fëmijët e tyre meshkuj, duke i kursyer veç femrat: kemi pushtet të plotë ndaj tyre.’ <sup>128</sup> Musai i tha popullit të tij: ‘Kthehjuni **Allahut** për ndihmë dhe jini të qëndrueshëm: toka i përket **Allahut** – Ai ia jep atë si pronë të veten cilëve do shërbyes Të Tij që i zgjedh – dhe e ardhmja e lumtur u përket atyre që janë të vetëdijshëm për Të’, <sup>129</sup> dhe ata u përgjigjën: ‘Na kanë përndjekur shumë kohë para se ti të vije te ne dhe edhe që

---

<sup>a</sup> Dorën e majtë dhe shputën e djathtë apo të kundërtat.

nga ajo kohë.’ Ai tha: ‘Zoti juaj mund ta shkatërrojë fare mirë armikun tuaj dhe t’ju bëjë pasardhës në vend për ta parë se si silleni.’

<sup>7:130</sup> Ne sollëm vite të thatësirës dhe dështimit të të korrave në popullin e Faraonit, që të mund të jenë të vëmendshëm, <sup>131</sup> pastaj, kur u vinte diçka e mirë, thoshin: ‘Kjo është për shkakun tonë!’. Kur vinte diçka e keqe, ia atribuonin ogurit të zi të Musait dhe të atyre që ishin me të, por ‘oguri’ i tyre ‘i zi’ ishte realisht nga **Allahu**, megjithëse shumica nga ta nuk e kuptonin. <sup>132</sup> Ata thanë: ‘Ne nuk do të besojmë në ty, pavarësisht se çfarë shenja prodhon për të na bërë magji’, <sup>133</sup> dhe kështu Ne lejuam mbi ta lirshëm përmbytje, karkaleca, morra, bretkosa, gjak – të gjitha shenja të qarta. Ishin njerëz arrogantë, të ligë. <sup>134</sup> Ata do të thoshin, sa herë që i godiste një fatkeqësi: ‘Musa, lutju Zotit tënd për ne duke u thirrur në premtimin që ta ka dhënë: nëse na çliron nga fatkeqësia, do të të besojmë dhe do t’i lejojmë Fëmijët e Izraelit të vijnë me ty’, <sup>135</sup> por kur Ne i çlironim nga fatkeqësia dhe u jepnim periudhë të caktuar [në të cilën do ta përmbushnin premtimin e tyre] – shih! – e shkelnin atë. <sup>136</sup> Dhe kështu, meqë i refuzuan shenjat Tona dhe nuk u kushtuan vëmendje fare, ua nxorëm ndëshkimin: i përmbytëm në det <sup>137</sup> dhe i bëmë ata që ishin të shtypur të kenë sukses edhe në lindje edhe në perëndim të tokës që e patëm bekuar. Premtimi i mirë i Zotit tuaj për Fëmijët e Izraelit ishte përmbushur, për shkak të durimit të tyre dhe Ne e shkatërruam atë që po e bënin dhe atë që po e ndërtonin Faraoni dhe njerëzit e tij.

<sup>138</sup> Ne i kaluam Fëmijët e Izraelit matanë detit, por kur e hasën një popull që adhuronte idhuj, thanë: ‘Musa, bëje një zot për ne si të tyrin.’ Ai tha: ‘Ju vërtet jeni njerëz budallenj: <sup>139</sup> [kulti për] çka këta njerëz praktikojnë është dënuar për shkatërrim dhe kjo që po e bënin është e padobishme. <sup>7:140</sup> Pse do të duhej të kërkoja ndonjë zot tjetër pos **Allahut** për juve, kur Ai ju ka favorizuar mbi të gjithë popujt e tjerë?’ <sup>141</sup> Kujtojeni se si Ne ju shpëtuam nga njerëzit e Faraonit, që ju nënshtronin në vuajtjet më të këqija, duke jua vrarë fëmijët meshkuj, e duke jua kursyer veç femrat – kjo ishte sprovë jashtëzakonisht e rëndë nga Zoti juaj.

<sup>142</sup> Ne i caktuam tridhjetë net për Musain, e pastaj i shtuam edhe dhjetë të tjera: afati i caktuar nga Zoti i tij u krye për dyzet net. Musai i tha të vëllait Harunit: ‘Më zëvendëso te populli im: vepro drejt dhe mos e ndiq rrugën e atyre që përhapin korrupsion.’ <sup>143</sup> Kur Musai erdhi për takimin dhe Zoti i tij i foli, ai tha: ‘Zoti im, shfaqmu: më lejo të të shoh!’ Ai tha: ‘Mua nuk do të më shohësh kurrë, por shikoje atë mal: nëse mbetet i patundur, do të më shohësh’ dhe kur Zoti i tij iu zbulua malit, e bëri copë e grimë: Musai ra pa ndjenja. Kur u këndell, tha: ‘Lavdet qofshin për Ty! Të kthehem me pendesë! Jam i pari që besoj!’ <sup>144</sup> Ai tha: ‘Musa, Unë të kam ngritur mbi njerëzit e tjerë me mesazhet E Mija [duke të t’i dhënë] dhe duke të të folur: mbahju asaj që ta kam dhënë; ji nga ata që falënderojnë.’

<sup>145</sup> Ne skalitëm gjithçka për të në Pllakat që mësonin dhe shpjegonin gjithçka, duke thënë: ‘Mbahju atyre vendosmërisht dhe nxite popullin tënd t’u përmbahen fuqishëm mësimëve të tyre të shkëlqyeshme. Do të ta tregoj fundin e atyre që rebelohen.’ <sup>146</sup> Do t’i mbaj të pavëmendshëm ndaj shenjave të Mija ata që sillen me arrogancë në Tokë pa kurrfarë të drejte dhe që, madje edhe nëse e shohin secilën shenjë, nuk do të besojnë në to; ata nuk do ta marrin rrugën e udhëzimit të duhur nëse e shohin, por do ta marrin rrugën e gabimit nëse e shohin. Kjo për shkak se i mohuan shenjat Tona dhe nuk u kushtuan vëmendje aspak: <sup>147</sup> veprat e atyre që i mohuan shenjat Tona dhe Takimin e Të Përtejmes do të kthehen në asgjë – pse do të duhej të shpaguhen për çkado tjetër pos për atë që e kanë bërë?’

<sup>148</sup> Në mungesë të Musait, populli i tij nisën ta adhurojnë një formë të thjeshtë që lëshonte tinguj si lopë – një viç i bërë nga stolitë e tyre. A s’mund ta shihnin se ajo nuk u fliste as s’i udhëzonte në asnjë mënyrë? E megjithatë nisën ta adhuronin: ishin keqbërës. <sup>149</sup> Kur – me shumë shtrydhje të duarve – e kuptuan se po bënin gabim, thanë: ‘Nëse Zoti ynë nuk ka mëshirë dhe të na falë, do të jemi humbësit.’ <sup>7:150</sup> Pas kthimit të tij te populli i tij, i zemëruar e i hidhëruar, Musai tha: ‘Sa e ndyrë dhe e ligë është ajo që e keni bërë në mungesën time! A ishit kaq të etur që ta përshpejtonit gjykimin e Zotit tuaj?’ I hodhi pllakat dhe e kapi vëllanë e tij për flokësh, duke e tërhequr kah vetja. Haruni tha: ‘O bir i nënës sime, këta njerëz më mposhtën! Desh më vranë! Mos u jep armiqve të mi arsye të gëzohen! Mos më përfshij me këta keqbërës!’ <sup>151</sup> Musai tha: ‘Zoti im, më fal mua dhe vëllanë tim; na prano në mëshirën Tënde: Ti je Më Mëshirëploti nga të gjithë ata që tregojnë mëshirë.

<sup>152</sup> Ata që nisën ta adhurojnë viçin  
do të vuajnë nga zemërimi i Zotit të tyre,  
dhe përçmimi në këtë jetë.’  
Kështu Ne i shpaguajmë  
ata që shpikin rrena të tilla,  
<sup>153</sup> por për ata që bëjnë gabim  
dhe më pas pendohen dhe besojnë vërtet,  
Zoti juaj është më falësi  
dhe më mëshirëploti.

<sup>154</sup> Kur Musait i kaloi zemërimi, i mori Pllakat, në të cilat ishin të skalitura udhëzimi dhe mëshira për ata që kishin frikë-respekt për Zotin e tyre.

<sup>155</sup> Musai i zgjodhi nga populli i tij  
shtatëdhjetë njerëz për takimin Tonë,

dhe kur u mbërthyen nga lëkundja e dhunshme,  
ai u lut: “Zoti im, po të doje,  
tashmë do të kishe mundur  
t’i shkatërroje shumë kohë më parë,  
po edhe mua,  
pra a do të na shkatërrosh tani  
për atë që e kanë bërë  
budallenjtë në mesin tonë?  
Kjo është veç sprovë nga Ti –  
përmes saj e çorienton këdo që do ta çorientosh  
dhe e udhëzon këdo që do ta udhëzosh –  
dhe Ti je Mbrojtësi ynë,  
pra na fal dhe ki mëshirë ndaj nesh.  
Ti je më i miri nga ata që falin.

156 “Na i dhuro gjërat e mira  
në këtë botë dhe në jetën e përtejme.  
Ne kthehemi kah Ti.”

**Allahu** tha:

“Unë e godas me ndëshkimin Tim  
këdo që e godas,  
por mëshira Ime i përfshin të gjitha gjërat.

157 “Unë do ta urdhëroj mëshirën Time  
për ata që janë të vetëdijshëm për **Allahun**  
dhe e paguajnë lëmoshën e caktuar;  
që besojnë në Shpalljet Tona;  
ata që e ndjekin Të Dërguarin –  
profetin e pa-arsimuar<sup>a</sup>,  
të cilin e gjejnë të përshkruar  
në Teuratin që është me ta  
dhe në Ungjill –  
që i urdhëron të veprojnë drejt  
dhe i ndalon të bëjnë keq,

---

<sup>a</sup> *Ummi* mund ta ketë kuptimin "i pa-arsimuar, i pamësuar" ose "dikush që nuk është çifut".

që i bën të ligjshme gjërat e mira për ta  
dhe gjërat e këqija të paligjshme,  
dhe i liron nga barrët e tyre,  
dhe zgjedhat<sup>a</sup> që ishin në ta.  
Pra ata që kanë besim në të,  
dhe që e nderojnë e i ndihmojnë,  
dhe që e ndjekin dritën  
e zbritur me të –  
ata do të kenë sukses.”

<sup>158</sup> Thuaj [Muhamed]: ‘Njerëz, jam I Dërguari I **Allahut** për të gjithë ju, nga Ai që ka kontroll mbi qiejt dhe tokën. Nuk ka **Zot** tjetër pos Tij; Ai jep jetë dhe vdekje, pra besoni në **Allahun** dhe Të Dërguarin E Tij, profetin e pa-arsimuar që beson në **Allahun** dhe në fjalët E Tij dhe ndiqeni atë që të mund të gjeni udhëzim.’

<sup>159</sup> Është një grup në popullin e Musait që udhëzojnë me të vërtetën dhe që veprojnë drejt sipas saj. <sup>7:160</sup> Ne i ndamë në dymbëdhjetë fise si bashkësi [të dallueshme], dhe, kur populli i tij i kërkoi ujë, e frymëzuam Musain ta godasë shkëmbin me shkopin e tij [ashtu që] gufuan dymbëdhjetë burime. Secili fis e dinte vendin e tij për pirje; Ne ua dhamë hijen e reve dhe u zbritëm mana dhe thëllëza [duke thënë]: ‘Hani gjërat e mira me të cilat ju kemi furnizuar.’ Ata nuk na dëmtuan Neve; e dëmtuan veten. <sup>161</sup> Kur u ishte thënë: ‘Hyni në këtë qytet dhe hani lirshëm aty si të doni, por thoni: “Na lehtëso!” dhe hyni në portën e tij me përulje: atëherë Ne do t’jua falim mëkatet tuaja dhe do ta rrisim shpërblimin e atyre që bëjnë mirë’, <sup>162</sup> keqbërësit ndër ta e zëvendësuan një thënie tjetër në vend të asaj që u ishte dhënë, andaj ua dërguam një ndëshkim nga qielli për keqbërjen e tyre.

<sup>163</sup> [Profet,] pyeti ata për qytetin buzë detit; si njerëzit e tij e shkelën Sabathin kur peshqit e tyre dilnin në sipërfaqe për ta veç atë ditë, kurrë në ditët e punës – Ne i sprovuam në këtë mënyrë: për shkak të mosbindjes së tyre – <sup>164</sup> si, kur disa nga ta [i] pyetën [predikuesit e tyre]: ‘Pse lodheni t’u predikoni njerëzve që **Allahu** do t’i shkatërrojë, apo të paktën do t’i ndëshkojë ashpër?’ [predikuesit] u përgjigjën: ‘Për të qenë të lirë nga fajësimi i Zotit tuaj dhe ashtu që ata mbase mund të jenë të vëmendshëm.’ <sup>165</sup> Kur ata [e] injoruan [paralajmërimin] që u ishte dhënë, Ne i shpëtuam ata që e ndalonin të keqen dhe i dënuam ashpër keqbërësit për shkak të mosbindjes së tyre. <sup>166</sup> Kur, në arrogancën e tyre, këmbëngulnin ta bënin atë që ishin ndaluar ta bënin, u thamë: ‘Jini si majmunë!’<sup>b</sup>

---

<sup>a</sup> Krahaso me 6:146. Nga interpretuesit thuhet se kjo i referohet obligimeve të vështira që u janë ngarkuar Fëmijëve të Izraelit.

<sup>b</sup> Krahaso me shënimin për 2:65:



Jini të dëbuar!’<sup>167</sup> Dhe pastaj Zoti juaj deklaroi se, deri në Ditën e Ringjalljes, Ai do të dërgonte njerëz kundër tyre për t’u shkaktuar vuajtje të tmerrshme. Zoti juaj është i shpejtë në ndëshkim por është më falësi dhe mëshirëploti.

<sup>168</sup> Ne i shpërndamë ata nëpër tokë në bashkësi të ndara – disa janë të ndershëm e disa më pak: i sprovuam me bekime e fatkeqësi, ashtu që të gjithë të mund të ktheheshin [në ndershmëri] –<sup>169</sup> dhe u pasuan nga breza që, megjithëse e trashëguan Shkrimin e Shenjtë, i morën fitimet e shkurta kalimtare të kësaj bote më të ulët, duke thënë: ‘Do të na falin’, e në fakt duke i marrë prapë po t’u vinin fitime të tilla të tjera. A nuk ishte marrë zotim nga ta, i shkruar në Shkrimin e Shenjtë, ta thonë të vërtetën për **Allahun** dhe asgjë tjetër? Dhe e kanë studiuar mirë përmbajtjen e tij. Për ata që janë të vetëdijshëm për **Allahun**, E Përtejtmja është më e mirë. ‘Pse nuk e përdorni arsyen tuaj?’<sup>7:170</sup> Por sa për ata që i mbahen fort Shkrimit të Shenjtë dhe i mbajnë lutjet në vazhdimësi, Ne nuk ua mohojmë njerëzve të ndershëm shpërblimet e tyre.<sup>171</sup> Kur e bëmë malin të shfaqet lart mbi ta si hije dhe menduan se do t’u binte përmbi, Ne thamë: ‘Mbahuni fort për atë që jua kemi dhënë dhe kujtojeni se çka përmban, që të mund të mbeteni të vetëdijshëm për **Allahun**.’

<sup>172</sup> [Profet,] kur Zoti yt i nxori pasardhësit  
nga ijët e Fëmijëve të Ademit  
dhe i bëri të dëshmojnë  
në lidhje me veten,  
Ai tha: ‘A NUK JAM UNË ZOTI JUAJ?’  
dhe ata u përgjigjën: ‘Oh po, kështu dëshmojmë.’  
Pra nuk mund të thoni në Ditën e Gjykimit:  
‘Nuk ishim të informuar për këtë’,

<sup>173</sup> ose ‘Ishin paraardhësit tanë ata që, para nesh, i atribuonin partnerë **Allahut** dhe ne jemi veç pasardhës që erdhëm pas tyre: a do të na shkatërroni për shkak të falsiteteve që i shpikën ata?’<sup>174</sup> Kështu Ne i shpjegojmë mesazhet, ashtu që ata të mund të kthehen [në rrugë të drejtë].

---

Kjo kuptohet nga disa si ‘fizikisht kthehuni në majmunë’ por në fakt është figurë e ligjëratës – struktura ‘jini majmunë’ është si ‘jini shkëmbinj/hekur’ te 17:50. Siç i përshkruan Kurani mosbesimtarët si të verbër, të shurdhër dhe memecë, këtu shkelësit janë majmunë.

<sup>175</sup> [Profet,] tregojua rrëfimin e njeriut të cilit ia dhamë mesazhet Tona: ai i hoqi qafe, kështu që Satani e mori si ndjekës të vetin dhe ai devijoi – <sup>176</sup> po të kish qenë vullnet I Yni, do të mund t'i përdornim këto shenja për ta ngritur lart, por në vend të kësaj ai iu qep tokës dhe i ndoqi merakët e tij – ishte si qen që gulçon me gjuhë të nxjerrë jashtë qoftë e dëbove apo e le rehat. I tillë është imazhi i atyre që i refuzojnë shenjat Tona. Tregojua rrëfimin që të mund të reflektojnë.

<sup>177</sup> Sa i pështirë është imazhi i atyre  
që i refuzojnë shenjat Tona!  
Ata i shtypin kështu shpirtrat e tyre:

<sup>178</sup> ata që **Allahu** i udhëzon  
janë pra ata që udhëzohen vërtet,  
dhe ata që **Allahu** i lejon të devijojnë  
janë ata që humbin.

<sup>179</sup> Ne kemi krijuar shumë xhinde dhe njerëz  
që janë të destinuar për Ferr,  
ata kanë zemra,  
por nuk i përdorin për të kuptuar;  
dhe kanë sy,  
por nuk i përdorin për të parë;  
dhe kanë veshë,  
por nuk i përdorin për të dëgjuar.  
Ata janë si bagëtitë,  
jo, madje edhe më të devijuar;  
këta janë ata  
që janë plotësisht të pavëmendshëm.

<sup>7:180</sup> Emrat Më Të Shkëlqyeshëm i përkasin **Allahut**:  
përdorni ata për ta kërkuar Atë,  
dhe rrini larg nga ata që i përdhosin këta emra –  
ata do të shpaguhen  
për atë që e bëjnë.

<sup>181</sup> Dhe ndër ata që i kemi krijuar Ne  
janë një grup që udhëzojnë me të vërtetën  
dhe veprojnë drejt sipas saj.

<sup>182</sup> Por Ne i joshim në vështirësi ata që i refuzojnë mesazhet Tona, hap pas hapi, pa e kuptuar ata: <sup>183</sup> Unë do t'u jap afat, por plani Im është i sigurt. <sup>184</sup> A nuk u ka shkuar në mend se shoqëruesi<sup>a</sup> i tyre nuk është i çmendur por po jep paralajmërim të qartë? <sup>185</sup> A nuk kanë menduar thellë për mbretërinë e qiejve dhe të tokës dhe për tërë atë që e krijoi **Allahu** dhe se fundi i kohës së tyre mund të jetë afër? Në çfarë [shpallje tjetër] do të besojnë nëse nuk besojnë në këtë? <sup>186</sup> Askush nuk mund t'i udhëzojë ata që **Allahu** i lejon të devijojnë: Ai i lë të bredhin verbërisht në paturpësinë e tyre.

<sup>187</sup> Të pyesin [Profet] për Orën: 'Kur do të ndodhë?' Thuaj: 'Veç Zoti im ka njohuri për të: veç Ai do ta zbulojë kur të vijë koha e saj, kohë që është tejet e rëndësishme<sup>b</sup> edhe në qiej edhe në tokë. Do t'ju vijë krejt befas.' Të pyesin për të sikur të ishe i etur [për ta zbuluar]. Thuaj: 'Veç **Allahu** ka njohuri për të [se kur do të vijë], megjithëse shumica e njerëzve nuk e kuptojnë.' <sup>188</sup> Thuaj [Profet]: 'Nuk kam kurrfarë kontrolli ndaj përfitimit apo dëmit, [madje as] ndaj vetes, përveç siç mund të dojë **Allahu**: po të kisha njohuri të asaj që është e fshehur, do të kisha gjëra të mira të begatshme dhe asnjë dëm nuk do të mund të më prekte. Nuk jam asgjë më shumë se bartës i paralajmërimit dhe i lajmit të mirë për ata që besojnë.'

<sup>189</sup> Është Ai që ju krijoi të gjithëve nga një shpirt dhe nga ai e bëri bashkëshorten që ai të mund të gjejë rehati tek ajo: kur njëri [nga ta] shtrihet me gruan e tij dhe ajo e ngjiz një barrë të lehtë, duke lëvizur lirshëm përreth, pastaj rëndohet, të dytë i luten **Allahut**, Zotit të tyre: 'Nëse na e jep një fëmijë të mirë sigurisht që do të jemi mirënjohës', <sup>7:190</sup> e megjithatë kur Ai ua jep një fëmijë të mirë ata ua atribuojnë të tjerëve ca nga ajo që Ai ua ka dhuruar. <sup>191</sup> **Allahu** është larg mbi partnerët që i sajojnë përkrah Tij! Si mund t'i sajojnë këta partnerë me Të të cilët nuk krijojnë asgjë dhe vetë janë të krijuar, <sup>192</sup> që nuk mund t'u ndihmojnë fare atyre, madje as vetes?

<sup>193</sup> Nëse [ju besimtarë] i thirrni njerëzit e tillë në udhëzim, nuk ju ndjekin: nuk çon peshë a i thirrni apo mbeteni të heshtur. <sup>194</sup> Ata që [ju idhujtarë] i thirrni në vend të **Allahut** janë qenie të krijuara si ju. Thirrini ata, pra dhe le t'ju përgjigjen nëse ajo që e thoni është e vërtetë. <sup>195</sup> A kanë këmbë që të ecin, duar që të godasin, sy që të shohin, apo veshë që të dëgjojnë? Thuaj [Profet]: 'Thirrini "partnerët" tuaj! Bëni plane të fshehta kundër meje! Mos më kurseni! <sup>196</sup> Mbrojtësi im është **Allahu**: Ai e ka shpallur Shkrimin e Shenjtë dhe është Ai që i mbron të ndershmit, <sup>197</sup> por ata që i thirrni në vend Të Tij nuk mund t'ju ndihmojnë juve madje as vetes.' <sup>198</sup> Nëse [ju besimtarë] i thirrni njerëzit e tillë në

---

<sup>a</sup> Kjo i referohet Profetit Muhamed.

<sup>b</sup> Alternativisht, Suddi e jep përkthimin 'e fshehur nga' si interpretim i *thaqulat* (Razi). Fjalë për fjalë: 'peshon rëndë'.

udhëzim, nuk dëgjojnë. [Ti Profet] mund ta vëresh se si të shikojnë, por nuk mund të shohin. <sup>199</sup> Ji tolerant dhe urdhëroje atë që është e drejtë: mos u kushto vëmendje budallenjve. <sup>7:200</sup> Nëse Satani do të të nxisë të bësh diçka, kërko strehë te **Allahu** – Ai është gjithë-dëgjuesi, i gjithë-dituri – <sup>201</sup> ata që janë të vetëdijsëm për **Allahun** mendojnë për Të kur Satani i nxit të bëjnë diçka dhe menjëherë mund të shohin [drejt]; <sup>202</sup> pasuesit e dajve<sup>a</sup> futen në gabim pa pushim nga ta dhe nuk mund të ndalen.

<sup>203</sup> Kur ti nuk u sjell shpallje të freskët, thonë: ‘Por a s’mundesh thjesht ta kërkosh një?’ Thuaj: ‘Unë thjesht e përsëris atë që më shpallet nga Zoti im: kjo shpallje ju sjell njohuri intuitive nga Zoti juaj dhe udhëzim e mëshirë për ata që besojnë,

<sup>204</sup> pra kur të recitohet Kurani,  
dëgjojeni me vëmendje e në qetësi  
që të mund të bekoheni me mëshirë.’

<sup>205</sup> [Profet,] kujtoje Zotin tënd  
përbrenda shpirtit  
me tërë përvullësinë e frikë-respektin,  
pa e ngritur zërin,  
mëngjeseve e mbrëmjeve –  
mos ji nga të pavëmendshmit –

<sup>206</sup> [madje edhe] ata që jetojnë  
në prezencën e Zotit tënd  
nuk janë tepër krenarë ta adhurojnë Atë:  
ata e lavdojnë dhe përkulen para Tij.

---

<sup>a</sup> *Ikhwan*: ‘vëllezër’ – krahaso me 17:27, ku pasuesit e dajve përshkruhen si *ikhwan* të tyre

## **Përshkrimi para kaptinës 7 nga Abdel Haleem:**

*Sure mekase e emëruar sipas lartësive të barrierës që do t'i ndajë të ndershmit nga të mallkuarit në Ditën e Gjykimit (vargu 46). Surja nis duke iu drejtuar Profetit, duke e siguruar atë për shpalljet e tij dhe mbyllet duke e theksuar faktin se ai thjesht e përsërit atë që i shpallet. Ajo i paralajmëron mosbesimtarët për fatin e tyre përmes tregimeve të shumta të komuniteteve të pabindura në të shkuarën, me shpresën se mund të jenë të vëmendshëm dhe të pendohen para se të jetë shumë vonë. Të dy temat shërbejnë edhe për t'i dhënë inkurajim Profetit dhe besimtarëve.*

## **Shënimet gjuhësore (Thomas Cleary)**

*Lartësitë (al 'A'raaf) (Kaptina 7)*

Kjo sure u shpall në Mekë.

6 “Ne do t'i marrim në pyetje vetë të dërguarit”: Ata do të merren në pyetje për atë se a i kanë përcjellë mesazhet e tyre dhe se a kanë pretenduar ndonjë gjë për veten, siç është hyjnoriteti.

11-25 Tregimi i rënies së njerëzimit është ritreguar këtu nga një kënd tjetër, bazuar në rënien e Iblisit, ku ilustrohen shenjat e tij të paragjykimit, arrogancës dhe hakmarrësisë. Po ashtu këtu bëhet qartë e dukshme përdorja djallëzore e shpresës së kotë dhe e turpfit për veten për ta shkaktuar uljen në nivel të njerëzve të parë.

23 “ne e kemi shtypur veten”: Njerëzimi tëhuajësohet nga burimi i tij përmes veprimit mashtrues të tejpreakupimit obsesiv me veten.

24 “Rënia në nivel” nga gjendja e pafajësisë.

“armiqtë e njëri-tjetrit”: të qenët të turpshëm për veten dhe prandaj garues dhe grindavecë.

25 “nga aty do t'ju nxjerrin”: Jeta dhe vdekja në botë janë sprovë e përkohshme; kthimi përfundimtar në të vërtetën vendimtare e çon shpirtin përtej arealit të jetës tokësore dhe vdekjes.

36 “njerëz të Zjarrit”: të lidhurit me ferrin, apo banorët e ferrit; se “mbesin aty” është përgjegjësi e vetja, siç tregohet nga pjesorja e tashme aktive në origjinal, për shkak se krijojnë kushte për torturë ferri të vullnetit të tyre të lirë.

157 “Profeti i Palexuar (i pa-arsimuar)” (an Nabiyy al ‘Ummiy): Muhamedi njihet si Profeti i Palexuar. Ai nuk dinte as të lexonte as të shkruante. Kjo në kuptimin e drejtpërdrejtë dhe figurativ e paraqet pafajësinë dhe çiltërsinë dhe pastërtinë e tij të mendjes. Pikërisht në bazë të kësaj çiltërsie dhe pastërtie ai ishte pranues ndaj mesazhit të Zotit dhe iu dha mundësia ta bartë atë te populli i tij. Referimi i Muhamedit në Teurat thuhet të jetë në Ligjin e Përtërirë (Deuteronomy) 18; Ngushëlluesi (the Paraclete) i traditës së krishterë (Gjoni 14) po ashtu besohet se është Profeti Muhamed.

172 “A NUK JAM UNË ZOTI JUAJ?”: Kujtimi i zanafillës së tij dhe të fundit vendimtar e ngrit njerëzimin nga idhujtaria e lidhjes me gjërat e përkohshme dhe shpikjet njerëzore.

177-181 Krijimi i Zotit ofron zotësi dhe aftësi edhe për të kuptuar edhe për t’u hutuar, duke e përfshirë perceptimin, arsyetimin (rezonimin) dhe vullnetin e lirë përmes të cilit njerëzimit i mundësohet të zgjedhë ndërmjet “dy autostradave” apo dy përdorimeve të mundshme të këtyre aftësive – rrugës së përndritjes dhe rrugës së mashtrimit (deluzionit). Ata që janë si bishat janë “edhe më të devijuar” për shkak se bishat nuk e kanë zgjedhjen që u është lejuar njerëzve.

206 “përkulen para Tij”: Ky është “varg i rënies në gjuhë”, gjatë recitimit të të cilit recituesi apo lexuesi i zellshëm i përkulet Zotit.

## 8: Fitimet e betejës (EL-ENFÂL)

Në emrin e **Allahut**, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës

<sup>1</sup> Të pyesin [Profet] për [shpërndarjen për] fitimet e betejës. Thuaj: ‘Është çështje për **Allahun** dhe Të Dërguarin E Tij, pra jini të vetëdijshëm për **Allahun** dhe rregulloni gjërat mes jush. Bindjuni **Allahut** dhe Të Dërguarit Të Tij në qofshi besimtarë të vërtetë: <sup>2</sup> besimtarët e vërtetë janë ata zemrat e të cilëve dridhen me frikë-respekt kur përmendet **Allahu**, besimi i të cilëve rritet kur u recitohen shpalljet E Tij, që e kanë besimin e tyre në Zotin e tyre, <sup>3</sup> që vazhdojnë të falen dhe u japin të tjerëve nga ajo që Ne e furnizojmë për ta. <sup>4</sup> Ata janë të tillët që besojnë vërtet. Ata kanë reputacion të lartë me Zotin e tyre, falje dhe furnizim bujar.’

<sup>5</sup> Se<sup>a</sup> ishte Zoti yt që të bëri [ty Profet] të rrezikosh të largohesh nga shtëpia jote për qëllim të vërtetë – megjithëse një grupi të besimtarëve nuk u pëlqeu <sup>6</sup> dhe diskutonin me ty për të vërtetën pasi ishte bërë e qartë, sikur të ishin shtyrë kah një vdekje që do të mund ta shihnin me sytë e tyre. <sup>7</sup> Kujtojeni si ju premtoi **Allahu** [juve besimtarëve] se një nga dy grupet armike do t’ju binte në dorë: ju donit që grupi i paarmatosur të ishte i juaji, por ishte vullneti i Zotit ta vendosë të vërtetën sipas Fjalës Së Tij dhe t’i shfarosë mosbesimtarët – <sup>8</sup> për ta vërtetuar Të Vërtetën si të vërtetë dhe gënjeshtërën si gënjeshtër, sado që fajtorëve mund të mos u pëlqejë. <sup>9</sup> Kur e lutët Zotin tuaj për ndihmë, Ai ju përgjigj: ‘Do t’ju përforcoj me një mijë engjëj radhazi.’ <sup>8:10</sup> **Allahu** e bëri këtë mesazh të shpresës për t’ju qetësuar zemrat: ndihma vjen veç nga **Allahu**, Ai është i fuqishëm e i urtë. <sup>11</sup> Kujtojeni kur Ai ju dha gjumë si siguri nga Ai dhe zbriti ujë nga qielli për t’ju pastruar, për ta hequr ndotjen e Satanit nga ju, për t’ju bërë zemrat të forta dhe këmbët të vendosura. <sup>12</sup> Zoti juaj u shpalli engjëjve: ‘Unë jam me ju: jepuni qëndrueshmëri besimtarëve; do të fus terror në zemrat e mosbesimtarëve – goditini mbi qafa dhe godituni të gjitha majat e gishtave.’ <sup>13</sup> Kjo për shkak se e kundërshtuan **Allahun** dhe Të Dërguarin E Tij dhe kushdo që e kundërshton **Allahun** dhe Të Dërguarin E Tij, **Allahu** i ndëshkon ashpër – <sup>14</sup> ‘Këtë e merrni! Shijojeni!’ – dhe tortura e Zjarrit i pret mosbesimtarët.

<sup>15</sup> Besimtarë, kur t’i hasni mosbesimtarët në betejë, kurrë mos ua ktheni shpinën: <sup>16</sup> nëse dikush e bën këtë në një ditë të tillë – pos nëse manovron për të luftuar apo për t’iu bashkuar një grupi të luftës – e shkakton zemërimin e **Allahut** dhe Ferri do të jetë shtëpia e tij, destinacion i mjerë! <sup>17</sup> Nuk ishit ju që i vratë po **Allahu** dhe kur [ti Profet] gjuajte [rërë në ta]<sup>b</sup> nuk ishte gjuajtja jote [që i mposhti

---

<sup>a</sup> Kjo lidhet me vargun 1.

<sup>b</sup> Para betejës Profeti u lut dhe ia gjuajti një grusht rërë armikut si simbol i mposhtjes së tyre.

ata] po e **Allahut**, për t'ua bërë një favor besimtarëve: **Allahu** është gjithë-pamësi dhe i gjithë-dituri – <sup>18</sup> ‘Këtë e merrni!’ – dhe **Allahu** do t'i dobësojë skemat e mosbesimtarëve. <sup>19</sup> [Mosbesimtarë,] nëse po kërkonit vendim, tash keni qenë dëshmitarë të njërit: nëse ndaleni këtu, do të jetë më mirë për ju. Nëse ktheheni, edhe Ne do të kthehemi dhe forcat tuaja, megjithëse më të mëdha në numër, nuk do t'ju hyjnë në punë fare. **Allahu** është me besimtarët.

<sup>8:20</sup> Besimtarë, bindjuni **Allahut** dhe Të Dërguarit Të Tij: mos u largoni kur jeni duke e dëgjuar atë; <sup>21</sup> mos jini si ata që thonë: ‘Dëgjuam’ megjithëse në fakt nuk po dëgjonin – <sup>22</sup> krijesat më të këqija në sytë e **Allahut** janë ato që janë [me dëshirë] të shurdhra dhe memece, që nuk e përdorin arsyen. <sup>23</sup> Po ta dinte **Allahu** se kishte sado mirësi në ta, do t'i bënte të dëgjonin, por edhe po ta bënte këtë, prapë do të largoheshin dhe nuk do të ishin fare të vëmendshëm. <sup>24</sup> Besimtarë, përgjigjuni **Allahut** dhe Të Dërguarit Të Tij kur ju thërret tek ajo që ju jep jetë. Dijeni se **Allahu** ndërhyt ndërmjet njeriut dhe zemrës së tij<sup>a</sup> dhe se do t'ju mbledhin tek Ai. <sup>25</sup> Kujdes nga mosmarrëveshja që i dëmton jo vetëm keqbërësit nga ju: dijeni se **Allahu** është i ashpër në ndëshkimin E Tij.

<sup>26</sup> Kujtoni kur ishit të paktë në numër, të viktimizuar në vend, të frikësuar se njerëzit mund t'ju kapnin, por **Allahu** ju strehoi dhe ju forcoi me ndihmën E Tij dhe ju furnizoi me gjëra të mira që të mund të ishit mirënjohës. <sup>27</sup> Besimtarë, mos e tradhtoni **Allahun** dhe Të Dërguarin, apo me qëllim ta tradhtoni besimin [e njerëzve të tjerë] në ju. <sup>28</sup> Jini të vetëdijsëm se pasuritë tuaja dhe fëmijët tuaj janë veç sprovë dhe se ka shpërblim të jashtëzakonshëm me **Allahun**. <sup>29</sup> Besimtarë, nëse qëndroni të vetëdijsëm për **Allahun**, Ai do t'ju japë një kriter [për ta dalluar të drejtën nga e gabuara] dhe do t'ju shlyejë veprat tuaja të këqija dhe do t'ju falë: favorin e **Allahut** është i madh vërtet.

<sup>8:30</sup> Kujtoje [Profet] kur mosbesimtarët komplotuan të t'zënë rob, të t'vrasin apo të t'dëbojnë. Ata planifikuan fshehtas dhe po kështu bëri edhe **Allahu**: Ai është më i miri nga planifikuesit e fshehtë. <sup>31</sup> Kurdo që u recitohet Shpallja Jonë, thonë: ‘I kemi dëgjuar të gjitha këto më parë – edhe ne do të mund të thoshim diçka të tillë po të donim – këto nuk janë gjë pos fabula të lashta.’ <sup>32</sup> Ata thanë po ashtu: ‘**Allah**, nëse kjo është përnjëmend e vërteta nga Ti, atëherë lësho nga qiejt shi të gurëve mbi ne, apo na e dërgo ndonjë ndëshkim tjetër të dhembshëm.’ <sup>33</sup> Por **Allahu** nuk do t'ua çonte ndëshkimin gjersa [ti Profet] ishte në mesin e tyre, as s'do t'i ndëshkonte po të kërkonin falje, <sup>34</sup> e megjithatë pse të mos i ndëshkonte **Allahu** ata kur i përjashtojnë njerëzit nga Xhamia e Shenjtë, megjithëse nuk janë kujdestarët e saj [të ligjshëm]? Veç ata që janë të vetëdijsëm për **Allahun** janë kujdestarët e saj të ligjshëm, por shumica e mosbesimtarëve nuk e kuptojnë këtë. <sup>35</sup> Lutjet e tyre para Shtëpisë nuk janë gjë pos fishkëllima dhe përplasje duarsh.

---

<sup>a</sup> Ka mënyra të ndryshme të interpretimit të kësaj, duke e përfshirë atë se, përmes vdekjes, **Allahu** e ndan njeriun nga meraku i zemrës së tij, dmth. jetës.



‘Pra shijojeni ndëshkimin<sup>a</sup> për mosbesimin tuaj.’<sup>36</sup> Ata e përdorin pasurinë e tyre për t’i ndaluar njerëzit nga rruga e **Allahut** dhe do të vazhdojnë ta bëjnë këtë. Në fund kjo do të jetë burim i pishmanit të madh për ta: do të mposhten dhe do t’i grumbullojnë kah Ferri.<sup>37</sup> **Allahu** do t’i ndajë të mirët nga të këqijtë, do t’i vendosë të këqijtë mbi njëri-tjetrin – duke i palosur një-mbi-një të gjithë bashkë – dhe duke i vendosur në Ferr. Ata do të jenë humbësit.<sup>38</sup> [Profet,] tregoju mosbesimtarëve se nëse heqin dorë nga e kaluara e tyre do të falen, por nëse këmbëngulin, e kanë një shembull në fatin e atyre që shkuan më parë.<sup>39</sup> [Besimtarë,] luftoni ata deri kur të mos ketë më përndjekje dhe tërë adhurimi<sup>b</sup> i përkushtohet veç **Allahut**: nëse heqin dorë, atëherë **Allahu** sheh gjithçka që bëjnë,<sup>8:40</sup> por nëse nuk janë të vëmendshëm, jini të sigurt se **Allahu** është mbrojtësi juaj, më i miri mbrojtës dhe më i miri ndihmës.

<sup>41</sup> Dijeni se një e pesta e fitimeve tuaja të betejës i përket **Allahut** dhe Të Dërguarit, të afërmeve dhe jetimëve, njerëzve në nevojë dhe udhëtarëve, nëse besoni në **Allahun** dhe në shpalljen që Ne e zbritëm te shërbyesi Ynë në ditën e vendimit, ditën kur dy forcat u takuan në betejë. **Allahu** ka pushtet ndaj të gjitha gjërave.<sup>42</sup> Kujtojeni kur ishit afër skajit të luginës dhe ata ishin në anën e largët dhe karvani ishte poshtë jush. Po të kishit caktuar takim për të luftuar, do të kishit dështuar ta mbanit [por beteja ndodhi] ashtu që **Allahu** të mund të shkaktojë diçka tashmë të paracaktuar, ashtu që ata që do të vdisnin të mund të vdisnin pasi ta shihnin një provë të qartë dhe ashtu që ata që do të jetonin të mund të jetonin pasi ta shihnin një provë të qartë – **Allahu** është gjithë-dëgjues dhe gjithë-pamës.

<sup>43</sup> [Profet,] kujtoje kur **Allahu** të bëri t’i shohësh në gjumë si pakicë: po t’jua shfaqte [juve besimtarëve] si shumicë, sigurisht që do të dekurajoheshit dhe do të grindeshit rreth kësaj, por **Allahu** ju shpëtoi. Ai i di fshehtësitë e zemrës.<sup>44</sup> Kur u takuat Ai jua shfaqti si pakicë dhe ju bëri pakicë në sytë e tyre, ashtu që të mund ta shkaktonte atë që ishte paracaktuar: gjithçka kthehet tek **Allahu**.

<sup>45</sup> Besimtarë, kur e hasni një forcë në betejë, rrini të qëndrueshëm dhe mbajeni **Allahun** fort në mendje, që të mund të përparoni.<sup>46</sup> Bindjuni **Allahut** dhe Të Dërguarit Të Tij dhe mos u grindni me njëri-tjetrin, ndryshe mund të dekurajoheni dhe shpirti mund t’ju dezertojë. Jini të qëndrueshëm: **Allahu** është me të qëndrueshmit.<sup>47</sup> Mos jini si ata që dolën nga shtëpitë e tyre plot mendjemadhësi, duke iu lavdëruar njerëzve dhe duke i ndaluar të tjerët nga rruga e **Allahut** – **Allahu** ka njohuri të plotë për gjithçka që bëjnë.<sup>48</sup> Satani i bëri veprat e tyre të ndyra t’u duken të drejta dhe tha: ‘Askush nuk do t’ju mposhtë sot, se unë do të jem mu pranë jush’, por kur ushtritë erdhën brenda pamjes së njëra-tjetrës ai i ktheu gishtat kah thembrat, duke thënë: ‘Ky është vendi ku ju lë: po

<sup>a</sup> Kjo do të mund të aludonte në humbjen e tyre në betejë.

<sup>b</sup> Në Shtëpinë e Shenjtë; krahaso me 2:191-3, 2:17.

shoh çka nuk shihni ju dhe ia kam frikën **Allahut** – **Allahu** është i ashpër në ndëshkimin E Tij.’

<sup>49</sup> Hipokritët dhe ata që kanë sëmundje në zemrat e tyre thanë: ‘Këta njerëz [besimtarët] me siguri janë në deluzion nga feja e tyre’, por nëse dikush e ka besimin e tij në **Allahun**, **Allahu** është i fuqishëm e i urtë. <sup>8:50</sup> Veç po të mund ta shihje [Profet] kur engjëjt i marrin shpirtrat e mosbesimtarëve, si i godasin në fytyrë dhe në shpinë – do të thuhet: ‘Shijojeni ndëshkimin e Zjarrit. <sup>51</sup> Kjo është shkaktuar nga ajo që e kanë grumbulluar duart tuaja për ju: **Allahu** nuk është kurrë i padrejtë ndaj krijesave Të Tij.’ <sup>52</sup> Ata janë si populli i Faraonit dhe ata para tyre që i injoruan shenjat e **Allahut**, prandaj **Allahu** i ndëshkoi për mëkatet e tyre: **Allahu** është i fuqishëm e i ashpër në ndëshkimin E Tij. <sup>53</sup> [E bëri] këtë se **Allahu** nuk do ta ndryshonte kurrë një favor që e kishte akorduar mbi një popull përveç kur e ndryshojnë atë që e kishin brenda. **Allahu** është gjithë-dëgjues, i gjithë-ditur. <sup>54</sup> Ata janë vërtet si populli i Faraonit dhe ata para tyre, që i refuzuan shenjat e Zotit të tyre: Ne i shkatërruam për mëkatet e tyre dhe e fundosëm popullin e Faraonit – ishin keqbërës.

<sup>55</sup> Krijesat më të këqija në pamjen e **Allahut** janë ato që e refuzojnë Atë dhe nuk do të besojnë; <sup>56</sup> që, kurdo që [ti Profet] e bën një traktat me ta, e shkelin, se nuk ia kanë frikën **Allahut**. <sup>57</sup> Nëse i has në betejë, bëji ata shembull të frikshëm për ata që vijnë pas tyre, që të mund të jenë të vëmendshëm. <sup>58</sup> Dhe nëse merr vesh për tradhtinë në pjesën e cilitdo popull, përplasja prapa traktatin e tyre, se **Allahu** nuk i do tradhtarët. <sup>59</sup> Mosbesimtarët nuk duhet të mendojnë se kanë fituar; nuk mund të ikin e të shpëtojnë. <sup>8:60</sup> Përgatitni çfarëdo forca që [ju besimtarë] mund t’i grumbulloni, duke përfshirë kuaj të luftës, për t’i trembur armiqtë e **Allahut** dhe tuajt dhe paralajmëroni të tjerët që janë të panjohur për ju por të njohur për **Allahun**. Çkado që jepni në kauzën e **Allahut** do t’ju shpaguhet plotësisht dhe nuk do të dëmtoheni. <sup>61</sup> Por nëse priren kah paqja, edhe ti [Profet] duhet të priresh kah ajo dhe ta kesh besimin tënd në **Allahun**: Ai është Gjithë-Dëgjuesi, I Gjithë-Dijshmi. <sup>62</sup> Nëse synojnë të të mashtrojnë, **Allahu** është i mjaftueshëm për ty: ishte Ai që të forcoi me ndihmën E Tij, <sup>63</sup> dhe me besimtarë dhe i përbashkoi zemrat e tyre. Edhe po të kishe falur gjithçka në tokë nuk do të mund ta bëje këtë, por **Allahu** i përbashkoi: **Allahu** është i fuqishëm e i urtë. <sup>64</sup> Profet, **Allahu** është i mjaftueshëm për ty dhe për besimtarët që të ndjekin. <sup>65</sup> Profet, nxiti besimtarët të luftojnë: nëse janë njëzet nga ju që janë të qëndrueshëm, do t’i mposhtin dyqind dhe njëqind nga ju, nëse janë të qëndrueshëm, do t’i mposhtin një mijë nga mosbesimtarët, se janë njerëz që nuk kuptojnë. <sup>66</sup> Por **Allahu** jua ka lehtësuar barrën tash për tash, duke e ditur se ka dobësi në ju – një qindëshe e qëndrueshme nga ju do t’i mundë dyqind dhe një mijëshe e qëndrueshme nga ju do t’i mundë dy mijë, me lejen e **Allahut**: **Allahu** është me të qëndrueshmit.

<sup>67</sup> Nuk është e drejtë për një profet të marrë robër para se ta ketë pushtuar fushën e betejës. Ju [njerëz] i keni merak të mirat kalimtare të kësaj bote, por **Allahu** e ka merak Të Përtejmen [për ju] – **Allahu** është i fuqishëm e i urtë – <sup>68</sup> dhe po të mos ishte e paracaktuar nga **Allahu**, një ndëshkim i ashpër do të kishte ardhur mbi ju për atë që e keni marrë. <sup>69</sup> Pra shijoni<sup>a</sup> në mënyrë të mirë e të ligjshme gjërat që i keni fituar në luftë dhe jini të vetëdijshëm për **Allahun**: Ai është falës dhe mëshirëplotë.

<sup>8:70</sup> Profet, tregoju atyre që i ke zënë robër: ‘Nëse **Allahu** di për ndonjë mirësi në zemrat tuaja, do t’ju japë diçka më të mirë se sa ajo që ju është marrë dhe do t’ju falë: **Allahu** është falës dhe mëshirëplotë.’ <sup>71</sup> Por nëse synojnë të të tradhtojnë, e kanë tradhtuar **Allahun** më parë dhe Ai të ka dhënë zotërim mbi ta: Ai është i gjithë-dituri, i gjith’-urti.

<sup>72</sup> Ata që besuan dhe emigruan [në Medinë] dhe u përpoqën për kauzën e **Allahut** me pasuri dhe personalisht dhe ata që dhanë strehë dhe ndihmë, janë të gjithë aleatë të njëri-tjetrit. Sa për ata që besuan por nuk emigruan, nuk je përgjegjës për mbrojtjen e tyre deri kur ta kenë bërë këtë. Por nëse kërkojnë ndihmë nga ju ndaj persekutimit, është detyra e juaj t’u ndihmoni, përveç kundër njerëzve me të cilët keni traktat: **Allahu** sheh gjithçka që bëni.

<sup>73</sup> Mosbesimtarët e përkrahin njëri-tjetrin. Nëse ju nuk e bëni të njëjtën, do të ketë persekutim në vend dhe korrupsion të madh. <sup>74</sup> Ata që besuan dhe emigruan dhe u përpoqën për kauzën e Zotit dhe ata që dhanë strehë dhe ndihmë – janë besimtarë të vërtetë dhe do të kenë falje dhe furnizim bujar. <sup>75</sup> Dhe ata që më vonë besuan më në fund dhe emigruan dhe u përpoqën përkrah jush, janë pjesë e juaja, por të afërmit prapë kanë pretendime paraprake ndaj njëri-tjetrit në Shkrimin e Shenjtë të **Allahut**: **Allahu** ka njohuri të plotë për të gjitha gjërat.

---

<sup>a</sup> Fjalë për fjalë: ‘hajini’

**Përshkrimi para kaptinës 8 nga Abdel Haleem:**

*Pjesa kryesore e kësaj sureje medinase është një koment mbi Betejën e Bedrit (afër Medinës), e para e bërë ndërmjet myslimanëve dhe kundërshtarëve të tyre mekasë në vitin e dytë pas Migrimit. Myslimanët, disa nga të cilët në fillim ishin hezitues për të luftuar, fituan përkundër që ishin shumë më të paktë në numër dhe nisën ta shqyrtojnë shpërndarjen e fitimeve. Surja ua kujton se ishte **Allahu** që e solli fitoren. Vargu 41 tregon se si do të shpërndaheshin fitimet. Ajo i këshillon myslimanët dhe komenton për rolin e hipokritëve dhe për ata që gjithmonë i shkelin traktatet e tyre (vargu 56), duke përfunduar me një deklaratë për besnikëritë dhe aleancat.*

## 9: Pendimi (ET-TEUBE)

<sup>1</sup> [Shpallet] lirim nga **Allahu** dhe I Dërguari I Tij prej traktatit që [ju besimtarë] e bëtë me idhujtarët – <sup>2</sup> [ju idhujtarë] mund të lëvizni lirshëm nëpër vend për katër muaj, por duhet ta keni parasysh edhe se nuk do t'i shpëtoni **Allahut**, edhe se **Allahu** do t'i turpërojë ata që [e] refuzojnë [Atë].<sup>a</sup> <sup>3</sup> Në Ditën e Pelegrinazhit të Madh [do të ketë] shpallje nga **Allahu** dhe I Dërguari I Tij për të gjithë njerëzit: 'Allahu dhe I Dërguari I Tij lirohen nga obligimet [e traktatit] ndaj idhujtarëve. Do të jetë më mirë për ju [idhujtarë] po të pendoheni: dijeni se nuk mund t'i shpëtoni **Allahut** nëse largoheni.' [Profet,] paralajmëroji ata që [e] injorojnë [Allahun] se do të kenë ndëshkim të dhembshëm. <sup>4</sup> Sa për ata që e kanë respektuar traktatin që e bëtë me ta dhe që nuk e kanë mbështetur askë kundër jush: përmbushe marrëveshjen tënde me ta deri në fund të afatit të tyre. **Allahu** i do ata që janë të vetëdijsëm për Të.

<sup>5</sup> Kur të mbarojnë [katër] muajt e ndaluar, kudo<sup>b</sup> që t'i hasni idhujtarët<sup>c</sup>, vritini, kapini, rrethojini, rrini në pritje për ta në çdo post vëzhgimi; por nëse kthehen [kah **Allahu**], falen rregullisht dhe e paguajnë lëmshën e caktuar, lërinin të shkojnë rrugës së tyre, se **Allahu** është më falësi dhe mëshirëploti. <sup>6</sup> Nëse dikush nga idhujtarët do ta kërkojë mbrojtjen tënde [Profet], jepja që të mund ta dëgjojë fjalën e **Allahut**, pastaj çoje në një vend të sigurt për të, se janë njerëz pa njohuri [për të]. <sup>7</sup> Si do të mund të kishte traktat me **Allahun** dhe Të Dërguarin E Tij për idhujtarë të tillë? Por sa për ata me të cilët keni bërë traktat te Xhamia e Shenjtë, përderisa ju mbeten besnikë, jini besnik ndaj tyre; **Allahu** i do ata që janë të vetëdijsëm për Të. <sup>8</sup> [Si,] kur ata, po ta fitonin avantazhin mbi ju, nuk do ta respektonin asnjë detyrim me ju, qoftë i fafëfisnisë apo i traktatit? Ata ju kënaqin me gjuhët e tyre, por zemrat e tyre janë kundër jush dhe shumica nga ta janë shkelës të ligjit. <sup>9</sup> E kanë shitur porosinë e **Allahut** për fitim të vockël dhe i kanë penguar të tjerët nga rruga E Tij. Sa të këqija janë veprimet e tyre! <sup>9:10</sup> Kur është fjala për besimtarë, nuk respektojnë asnjë detyrim të fafëfisnisë a të traktatit. Janë ata që po bëjnë agresion. <sup>11</sup> Nëse i kthehen **Allahut**, falen rregullisht dhe e paguajnë lëmshën e përcaktuar, atëherë janë vëllezër tuaj në besim: Ne i bëjmë mesazhet të qarta për njerëzit që janë të gatshëm të mësojnë. <sup>12</sup> Por nëse e shkelin betimin e tyre pasi të kenë bërë marrëveshje me ju, nëse jua

---

<sup>a</sup> 'Kafara bi (diçka)' në arabisht mund ta ketë kuptimin 'distancim (nga diçka)' (*al-Mu'jam al-Wasit*), kështu që *kuffar* këtu mund ta ketë kuptimin edhe 'ata që distancohen [nga traktati]'

<sup>b</sup> Brenda apo jashtë Shenjtores në Mekë. Shih shënimin 'd' në 2:191:

Myslimanëve u interesonte se a ishte e lejuar të hakmerreshin kur sulmoheshin brenda ambienteve të shenjta në Mekë gjatë haxhit (shih 2:196 dhe *Tafsir-in* e Razit). Këtu u jepet leja të luftojnë kur sulmohen kudo që i hasin sulmuesit e tyre: në ambiente apo jashtë tyre.

<sup>c</sup> Në këtë kontekst, kjo definitivisht u referohet atyre që e shkelën traktatin. Nyja këtu është 'ahdiya' (specifike) duke iu referuar asaj që është thënë tashmë.

fyejnë fenë, atëherë luftoni udhëheqësit e mosbesimit – zotimet nuk kanë asnjë kuptim për ta – që të mund të ndalen.<sup>13</sup> Si të mos e luftonit një popull që i kanë shkelur zotimet e tyre, që u përpoqën ta dëbonin Të Dërguarin, që ju sulmuan të parët? A ua keni frikën? **Allahu** duhet t'ia keni frikën në qofshi besimtarë të vërtetë.<sup>14</sup> Luftoni ata: **Allahu** do t'i ndëshkojë në duart tuaja, do t'i turpërojë, do t'ju ndihmojë t'i mposhtni, do t'i shërojë ndjenjat e besimtarëve<sup>15</sup> dhe do ta heqë tërbimin nga zemrat e tyre. **Allahu** i kthehet kujtdo që i kthehet në mëshirën E Tij; **Allahu** është i gjithë-ditur dhe i urtë.<sup>16</sup> A po mendoni se do të mbeteni të pasprovuar<sup>a</sup> pa e identifikuar **Allahu** se cilët nga ju do të përpiqen për çështjen E Tij dhe nuk do të marrin kurrfarë përkrahës pos **Allahut**, Të Dërguarit Të Tij dhe besimtarëve të tjerë? **Allahu** është plotësisht i informuar për të gjitha veprimet tuaja.

<sup>17</sup> Nuk është e drejtë që idhujtarët të kujdesen për faltoret e **Allahut** gjersa dëshmojnë për mosbesimin e tyre: veprat e njerëzve të tillë do të kthehen në asgjë dhe ata do të qëndrojnë në Ferr.<sup>18</sup> Të vetmit që duhet të kujdesen për vendet e **Allahut** për adhurim janë ata që besojnë në **Allahun** dhe në Ditën e Fundit, që falen rregullisht, që e paguajnë lëmshën e përcaktuar dhe që nuk ia kanë frikën askujt pos **Allahut**: njerëzit e tillë mund të shpresojnë të jenë ndër të udhëzuarit si duhet.<sup>19</sup> A ju duket dhënia e ujit pelegrinëve dhe kujdesi për Xhaminë e Shenjtë e barabartë me veprat e atyre që besojnë në **Allahun** dhe në Ditën e Fundit dhe që përpiqen në rrugën e **Allahut**? Ata nuk janë baraz në sytë e **Allahut**. **Allahu** nuk udhëzon njerëz të tillë të padijshëm.<sup>9:20</sup> Ata që besojnë, që mërguan dhe u përpoqën fort në rrugën e **Allahut** me pasuritë e tyre dhe qeniet e tyre, janë në sytë e **Allahut** shumë më të lartë në gradë; janë ata që do të triumfojnë;<sup>21</sup> dhe Zoti i tyre ua jep lajmin e mirë të mëshirës dhe të kënaqësisë Së Tij, Kopshte ku do të kenë lumturi të qëndrueshme<sup>22</sup> dhe ku do të mbesin përgjithmonë: vërtet, ka shpërblim të jashtëzakonshëm me **Allahun**.

<sup>23</sup> Besimtarë, mos i bëni aleatë<sup>b</sup> etërit e vëllezërit tuaj nëse e preferojnë mosbesimin para besimit: ata nga ju që bëjnë kështu po bëjnë keq.<sup>24</sup> Thuaj [Profet]: 'Nëse etërit, bijtë, vëllezërit, gratë, fiset, pasuria që e keni fituar, tregtia që keni frikë se do të bie dhe vendet e banimit që i doni janë më të dashura për ju se sa **Allahu** dhe I Dërguari I Tij në këtë qasje, atëherë pritni deri kur **Allahu** ta shkaktojë ndëshkimin E Tij.' **Allahu** nuk i udhëzon ata që ikin.<sup>25</sup> **Allahu** ju ka ndihmuar [juve besimtarë] në shumë fushë-beteja, madje edhe në ditën e Betejës së Huneinit.<sup>c</sup> Ishit të kënaqur shumë me numrat tuaj të mëdhenj, por s'ju hynë në punë fare: toka dukej se do të mbyllej përkundër hapësirësisë së saj dhe e keni kthyer shpinën e ia keni mbathur.<sup>26</sup> Pastaj **Allahu** e zbriti qetësinë E Tij tek I

---

<sup>a</sup> Shih edhe 29:2

<sup>b</sup> Kundër myslimanëve. Krahaso me 4:144.

<sup>c</sup> Kjo ndodhi në një luginë midis Mekës dhe Ta'if-it në vitin AH 8/630 CE.

Dërguari I Tij dhe besimtarët dhe zbriti forca të padukshme. Ai i ndëshkoi mosbesimtarët – këtë e meritojnë mosbesimtarët – <sup>27</sup> por **Allahu** e kthen mëshirën E Tij te kushdo që do ta kthejë. **Allahu** është më falësi dhe mëshirëploti.

<sup>28</sup> Besimtarë, ata që i përshkruajnë partnerë **Allahut** janë vërtet të papastër: mos i lejoni t'i afrohen Xhamisë së Shenjtë pas këtij viti. Nëse keni frikë se mund të bëheni të varfër, [ta keni parasysh se] **Allahu** do t'ju pasurojë nga mirësia E Tij nëse do: **Allahu** është i gjithë-dijshëm dhe i urtë. <sup>29</sup> Luftojini ata nga Njerëzit e Librit që nuk besojnë [vërtet]<sup>a</sup> në **Allahun** dhe Ditën e Fundit, që nuk e ndalojnë atë që **Allahu** dhe I Dërguari I Tij e kanë ndaluar, që nuk i binden rregullit të drejtësisë,<sup>b</sup> deri kur ta paguajnë taksën<sup>c</sup> dhe pajtohen të nënshtrohen.<sup>d</sup> <sup>9:30</sup> Çifutët thanë: 'Uzejri (Ezra) është i biri i **Allahut**'<sup>e</sup> dhe të krishterët thanë: 'Mesihu është i biri i **Allahut**': ata e thanë këtë me gojën e tyre, duke e përsëritur atë që e kishin thënë mosbesimtarët e mëhershëm. **Allahu** i hutoftë! Sa shumë që janë devijuar! <sup>31</sup> I marrin rabinët dhe priftërinjtë e tyre si zota, si dhe Krishtin, të birin e Merjemes. Por ata ishin urdhëruar t'i shërbejnë veç një Zoti: nuk ka zot pos Tij; Ai është larg mbi çkado që ia mvëshin si partnerë Të Tij! <sup>32</sup> Ata përpiqen ta shuajnë dritën e **Allahut** me gojët e tyre, por **Allahu** këmbëngul ta sjellë dritën E Tij në plotni, edhe nëse mosbesimtarët e urrejnë atë. <sup>33</sup> Është Ai që e ka çuar Të Dërguarin E Tij me udhëzimin dhe fenë e të vërtetës, për të treguar se është mbi të gjitha fetë [e tjera], mirëpo shumica e idhujtarëve mund ta urrejnë këtë. <sup>34</sup> Besimtarë, shumë rabinë e murgj i konsumojnë padrejtësisht pronat e njerëzve dhe i largojnë njerëzit nga rruga e **Allahut**. [Profet,] tregojni atyre që grumbullojnë ar e argjend në vend se të japin në çështjen e **Allahut** – se do të kenë ndëshkim të rëndë: <sup>35</sup> në Ditën që nxehet Zjarri i Ferrit dhe përdoret për t'ua shenjuar ballin, anën dhe kurrizin, do t'u thuhet: 'Kjo është çka keni grumbulluar për veten! Tash ndjejeni dhembjen e asaj që e grumbulluat!'

<sup>36</sup> **Allahu** dekreton se janë dymbëdhjetë muaj – të paracaktuar në Librin e **Allahut** në Ditën kur Ai i krijoi qiejt dhe tokën – katër muaj nga të cilët janë të

---

<sup>a</sup> 'Vërtet' nënkuptohet, siç është në shumë thënie të tjera në Kuran, p.sh. 2:32; 8:41 dhe 65:3

<sup>b</sup> Kuptimi kryesor i *dana*-s arabe është 'ai u bind'. Po ashtu domethënë 'të sillësh mirë' dhe 'ta ndjekësh një rrugë të jetës a të fesë' (*Qamus* dhe Lane)

<sup>c</sup> Etimologjikisht, *jizya* domethënë 'pagesa kompensuese', e ndërlidhur me *jaza*' që domethënë 'shpërblim', dmth. si kompensim për mbrojtjen e shtetit mysliman me të gjitha përfitimet e përllogaritura dhe përjashtimin nga shërbimi ushtarak dhe taksat e tilla mbi myslimanët si *zakah*. Kjo taksë ishte vjelë vetëm nga njerëzit e lirë me trupa të aftë (pa ndonjë aftësi të kufizuar) që mund ta përballonin dhe murgjit ishin përjashtuar. Sasia ishte përgjithësisht e ulët (p.sh. një dinar në vit).

<sup>d</sup> Komentuesit në të shkuarën përgjithësisht e kuptonin *wa hum saghirun* ta ketë kuptimin se ata duhet të poshtërohen kur paguajnë. Mirëpo, është e qartë nga konteksti se ata nuk ishin të gatshëm të paguanin dhe klauzola thjesht domethënë se duhet t'i nënshtrohen pagimit të kësaj takse.

<sup>e</sup> Qartas kjo i referohet një grupi të caktuar që, me gjasë në kohën e Profetit apo më herët, e bënë këtë deklaram.

shenjtë:<sup>a</sup> kjo është llogaritja korrekte.<sup>b</sup> Mos i dëmtoni shpirtrat tuaj në këta muaj – megjithëse mund t'i luftoni idhujtarët në çdo kohë,<sup>c</sup> nëse ju luftojnë të parët – kujtojeni se **Allahu** është me ata që janë të vëmendshëm për Të.<sup>37</sup> Shtyrja e muajve të shenjtë është një akt tjetër i mosbindjes me të cilin ata që [e] shpërfillin [**Allahun**] devijohen: ata do ta lejojnë një vit dhe do ta ndalojnë në një tjetër ashtu që jashtësisht të përputhen me numrin e muajve të shenjtë të **Allahut**, por duke e bërë këtë e lejojnë atë që **Allahu** e ka ndaluar. Veprat e tyre të këqija u bëhen tërheqëse: **Allahu** nuk i udhëzon ata që [e] nënvlerësojnë [Atë].

<sup>38</sup> Besimtarë, pse, kur ju thuhet: 'Shkoni dhe luftoni në rrugën e **Allahut**', ndiheni të rënduar për tokë? A e preferoni këtë botë më shumë se jetën që pason? Sa e vogël është kënaqësia e kësaj bote, krahasuar me jetën që pason!<sup>39</sup> Nëse nuk dilni e të luftoni, **Allahu** do t'ju ndëshkojë ashpër dhe do të vërë të tjerë në vendin tuaj, por Atë nuk mund ta dëmtoni assesi: **Allahu** ka pushtet ndaj të gjitha gjërave.<sup>9:40</sup> Madje edhe nëse nuk i ndihmoni Profetit, **Allahu** i ndihmoi kur e dëbuan mosbesimtarët: kur dy nga ta<sup>d</sup> ishin në shpellë, ai [Muhamedi] i tha shokut të tij: 'Mos u shqetëso, **Allahu** është me ne' dhe **Allahu** e zbriti qetësinë E Tij në të, i ndihmoi me forca të padukshme për ju dhe e prishi planin e mosbesimtarëve. Plani i **Allahut** është më i lartë: **Allahu** është i gjithë-fuqishëm dhe i urtë.<sup>41</sup> Pra dilni, pavarësisht a jeni të armatosur lehtë a rëndë dhe përpiquni në rrugën e **Allahut** me pasuritë tuaja dhe qeniet tuaja: kjo është më e mirë për ju, veç po ta dinit.<sup>42</sup> Ata sigurisht që do të të vinin prapa [Profet] po të ishte përfitimi në horizont dhe udhëtimi i shkurtër, por largësia u dukej tepër e madhe. Do të betohen për **Allahun**: 'Po të mundnim, sigurisht që do të dilnim [në betejë] me ty', por e shkatërrojnë veten se **Allahu** e di se po gënjejnë.

<sup>43</sup> **Allahu** të faltë [Profet]! Pse u dhe leje të rrinë në shtëpi para se të të bëhej e qartë se cilët nga ta e flisnin të vërtetën e cilët ishin gënjeshtarë?<sup>44</sup> Ata që kanë besim në **Allahun** dhe në Ditën e Fundit nuk të kërkojnë përjashtim nga përpjekjet me pasuritë e tyre dhe qenien e tyre – **Allahu** e di saktësisht se kush është i vetëdijshëm për Të –<sup>45</sup> veç ata që nuk kanë besim në **Allahun** dhe në Ditën e Fundit ta kërkojnë lejen të rrinë në shtëpi: kanë dyshim në zemrat e tyre kështu që lëkunden.<sup>46</sup> Po të donin vërtet të dilnin [në betejë] me ty, do t'i kishin bërë përgatitjet, por **Allahu** ishte i neveritur t'i lërë të ngriten dhe i bëri të qëndrojnë prapa. Ishte thënë: 'Rrini me ata që rrinë prapa.'<sup>47</sup> Ata veç do t'ju sillnin telashe po të dilnin [në betejë] me ju: do të ishin të zhurmshëm, duke u munduar të mbillnin përçarje mes jush dhe disa nga ju do t'i dëgjonit me dëshirë – **Allahu** e di saktësisht se kush bën keq.<sup>48</sup> Vërtet, patën provuar para kësaj të

---

<sup>a</sup> Këta janë Rexhepi, Dhu'l-Qa'da, Dhu'l-Hijjah dhe Muharremi në kalendarin hënor mysliman. Luftimet nuk lejoheshin gjatë këtyre muajve (pos në vetë-mbrojtje). Krahaso me 2:194.

<sup>b</sup> Një nga kuptimet e *din* është 'llogaritja' apo 'vlerësimi'.

<sup>c</sup> Një interpretim tjetër i *kafatan* është 'të gjithë bashkë'.

<sup>d</sup> Profeti dhe shoqëruesi i tij Ebu Bekri.



nxisnin përçarje: kurdisën komplete kundër teje [Profet] deri kur e vërteta u shfaq dhe vullneti i **Allahut** triumfoi, duke i neveritur. <sup>49</sup> Disa nga ta thanë: ‘Më jep leje të rri në shtëpi: mos më qit telashe.’ Ata janë tanimë në telashe: Ferri do t’i gllabërojë mosbesimtarët. <sup>9:50</sup> Nëse [ti Profet] ke fat të mirë, kjo do t’i pikëllojë, por nëse të vjen fatkeqësia, do t’i thonë vetes: ‘Ne morëm masa paraprake për këtë’ dhe do të largohen duke u gëzuar. <sup>51</sup> Thuaj: ‘Do të na ndodhë veç ajo që e ka dekretuar **Allahu**. Ai është Padroni ynë: besimtarët le ta kenë besimin e tyre në **Allahun**.’ <sup>52</sup> Thuaj: ‘A pritni diçka tjetër pos të na ndodhë njëra nga dy gjërat më të mira?’ <sup>a</sup> Epo, ne presim që **Allahu** ta shkaktojë ndëshkimin mbi ju, ose nga Vetë Ai ose në duart tona. Pra pritni; edhe ne po presim.’ <sup>53</sup> Thuaj: ‘Pavarësisht a jepni me dashje a pa dashje, ajo që e jepni nuk do të pranohet, se jeni njerëz të pabindur.’ <sup>54</sup> E vetmja pengesë që ajo që e japin të pranohet është fakti që e refuzojnë **Allahun** dhe Të Dërguarin E Tij, i kryejnë lutjet veç përtueshëm dhe japin veç pa qejf. <sup>55</sup> Pra [Profet] mos lejo të të bëjnë përshtypje pasuritë e tyre a fëmijët e tyre: përmes tyre **Allahu** synon t’i ndëshkojë në këtë botë dhe që shpirtrat e tyre të largohen gjersa nuk besojnë.

<sup>56</sup> Ata betohen për **Allahun** se përkasin te ju [besimtarë], por nuk përkasin. Janë qyqarë: <sup>57</sup> po të mund ta gjenin një vend të strehës, a një shpellë, a diku për t’u zvarritur, do të iknin atje me nxitim të madh. <sup>58</sup> Disa nga ta të gjejnë gabime [Profet] në lidhje me shpërndarjen e lëmoshës: janë të kënaqur nëse u jepet një hise, por të zemëruar nëse nuk u jepet. <sup>59</sup> Ah po të ishin të kënaqur me atë që ua ka dhënë **Allahu** dhe I Dërguari I Tij dhe të thoshin: ‘**Allahu** na mjafton – Ai do të na japë ca nga mirësia E Tij dhe po kështu edhe I Dërguari I Tij – veç **Allahut** i kthehemi me shpresë.’ <sup>9:60</sup> Lëmosha është dedikuar veç për të varfrit, njerëzit në nevojë, ata që e administrojnë atë, ata zemrat e të cilëve duhet të fitohen, për të çliruar skllëvër dhe për t’u ndihmuar atyre në borxhe, për çështjen e **Allahut** dhe për udhëtarët në nevojë. Kjo është paracaktuar nga **Allahu**; **Allahu** është i gjithë-dijshëm dhe i urtë.

<sup>61</sup> Ka të tjerë që e fyejnë Profetin duke thënë: ‘Ai do të dëgjojë çkado.’ Thuaj: ‘Ai dëgjon për të mirën tuaj: beson në **Allahun**, u beson besimtarëve dhe është mëshirë për ata nga ju që besojnë.’ Ata që e fyejnë Të Dërguarin e **Allahut** i pret torturë vuajtëse. <sup>62</sup> Betohen për **Allahun** ashtu që t’ju kënaqin juve [besimtarë]: po të ishin besimtarë të vërtetë do të ishte më e përshtatshme për ta që ta kënaqin **Allahun** dhe Të Dërguarin E Tij. <sup>63</sup> A s’e dinë se kushdo që i kundërvihet **Allahut** dhe Të Dërguarit Të Tij do të shkojë te Zjarri i Ferrit dhe të rrijë aty? Ky është turpi suprem.

<sup>64</sup> Hipokritët kanë frikë se do të shpallet një sure që do ta ekspozojë atë që është në zemrat e tyre – thuaj: ‘Vazhdoni me shakatë tuaja: **Allahu** do ta

---

<sup>a</sup> Fitorja apo shpërblimi në botën tjetër.

shkaktojë atë së cilës ia keni frikën!’ – <sup>65</sup> e megjithatë po t’i pyesnit, sigurisht do të thoshin: ‘Veç po bisedonim, veç po argëtoheshim.’ Thuaj: ‘A po bënit shaka me **Allahun**, Shpalljet E Tij dhe Të Dërguarin E Tij?’ <sup>66</sup> Mos u mundoni të arsyetoheni; keni shkuar nga besimi në mosbesim.’ Ne mund t’i falim disa nga ju, por do t’i ndëshkojmë të tjerët: ata janë keqbërës. <sup>67</sup> Hipokritët, edhe burrat edhe gratë, janë të gjithë të njëjtë: e urdhërojnë atë që është e gabuar dhe e ndalojnë atë që është e drejtë; janë dorështrënguar. E kanë injoruar **Allahun**, kështu që Ai i ka injoruar ata.<sup>a</sup> Hipokritët janë ata të pabindurit. <sup>68</sup> **Allahu** e premtton Zjarrin e Ferrit si shtëpi të përhershme për hipokritët – edhe burrat edhe gratë – dhe për mosbesimtarët: kjo mjafton për ta. **Allahu** i refuzon dhe ata i pret një ndëshkim i përhershëm. <sup>69</sup> ‘Ju<sup>b</sup> jeni si ata që jetuan para jush: ata ishin edhe më të fortë se ju, me më shumë pasuri e fëmijë; ata e shijuan hisen e tyre në këtë jetë dhe ju e keni shijuar tuajën; sikur ata, ju jeni kënaqur në biseda boshe.’ Veprat e tyre shkojnë kot në këtë botë dhe tjetrën; janë ata që do t’i humbin të gjitha në jetën që pason. <sup>9:70</sup> A nuk i kanë dëgjuar kurrë rrëfimet për paraardhësit e tyre, popujt e Nuhut, Adit, Themudit, Ibrahimit, Medjenit dhe të qyteteve të shkatërruara? Të dërguarit e tyre u erdhën me dëshmi të qarta për të vërtetën: **Allahu** nuk do t’i mashtronte; e mashtruan veten.

<sup>71</sup> Besimtarët, edhe burrat edhe gratë, e përkrahin njëri-tjetrin; e urdhërojnë atë që është e drejtë dhe e ndalojnë atë që është e gabuar; falen rregullisht dhe e paguajnë lëmshën e caktuar; i binden **Allahut** dhe Të Dërguarit Të Tij. **Allahu** do t’ua japë mëshirën E Tij njerëzve të tillë: **Allahu** është i gjithë-fuqishëm dhe i urtë. <sup>72</sup> **Allahu** u ka premtuar besimtarëve, edhe burrave edhe grave, Kopshte të hijeshuara me lumenj rrjedhës ku do të mbesin; shtëpi të mira, paqësore në Kopshte me lumturi të përhershme; dhe – mbi të gjitha – kënaqësinë e mirë të **Allahut**. Ky është triumfi suprem.

<sup>73</sup> Profet, lufto kundër mosbesimtarëve dhe hipokritëve dhe ji i ashpër me ta. Ferri është shtëpia e tyre e fundit – destinacion i keq! <sup>74</sup> Ata betohen për **Allahun** se nuk kanë folur, por sigurisht që kanë folur fjalë të mospërfilljes dhe u bënë mospërfillës pasi ishin nënshtruar; provuan të bënin diçka,<sup>c</sup> megjithëse nuk e arritën, – të qenët keqbërës ishte përgjigjja e tyre e vetme ndaj **Allahut** dhe Të Dërguarit Të Tij duke i përjashtuar ata nga mirësia E Tij. Do t’u binte më mirë po të ktheheshin [kah **Allahu**]: nëse largohen, **Allahu** do t’i ndëshkojë në këtë botë dhe në Të Përtejmen dhe nuk do të ketë askush në tokë që t’i mbrojë a t’u ndihmojë.

<sup>75</sup> Janë disa ndër ta që i janë zotuar **Allahut**, duke thënë: ‘Nëse **Allahu** na jep ca nga mirësia E Tij, sigurisht që do të japim lëmshë dhe do të jemi të

---

<sup>a</sup> Shih shënimin për 7:51

<sup>b</sup> Një shembull tjetër i *iltifat*: **Allahu** kthehet t’u adresohet atyre.

<sup>c</sup> Ta dëmtonin Profetin.

ndershëm', <sup>76</sup> e megjithatë kur Ai u dha ca nga mirësia E Tij, u bënë të këqij dhe u larguan me kokëfortësi. <sup>77</sup> Për shkak se e shkelën premtimin e tyre ndaj **Allahut**, për shkak të të gjitha gënjeshtreve që i thanë, Ai e bëri hipokrizinë të vendosë në zemrat e tyre deri në Ditën kur ta takojnë Atë. <sup>78</sup> A nuk e kuptojnë se **Allahu** i di fshehtësitë e tyre dhe diskutimet e tyre private? Se **Allahu** e di tërë atë që është e fshehur? <sup>79</sup> Janë ata që i kritikojnë besimtarët që japin lirshëm dhe të tillët që mund të japin veç pak me shumë mund: i përqeshin njerëzit e tillë, por është **Allahu** që i përqesh ata – i pret një ndëshkim i dhembshëm. <sup>9:80</sup> Nuk çon peshë [Profet] a kërkon falje për ta apo jo: **Allahu** nuk do t'i falë edhe nëse ti kërkon shtatëdhjetë herë, se e refuzojnë **Allahun** dhe Të Dërguarin E Tij. **Allahu** nuk i udhëzon ata që rebelohen kundër Tij.

<sup>81</sup> Ata që u lanë prapa ishin të lumtur të rrinë kur u nis I Dërguari I **Allahut**; e urrenin mendimin e përpjekjes në rrugën e **Allahut** me pasuritë e tyre dhe qenien e tyre. I thoshin njëri-tjetrit: 'Mos shkoni [në luftë] në këtë vapë.' Thuaj: 'Zjarri i ferrit është më i nxehtë.' Veç po ta kuptonin! <sup>82</sup> Le të qeshin pak; do të qajnë shumë në këmbim të asaj që e kanë bërë. <sup>83</sup> Pra [Profet], nëse **Allahu** ta kthen një grup nga ta, që kërkojnë leje nga ti për të dalë [në betejë], thuaj: 'Kurrë nuk do të dilni e ta luftoni një armik me mua: zgjodhët të rrinë në shtëpi herën e parë, pra tash rrinë me ata që rrinë prapa.'

<sup>84</sup> Mos mbani lutje për asnjërin nga ta nëse vdesin dhe mos qëndroni pranë varreve të tyre: nuk besuan në **Allahun** dhe Të Dërguarin E Tij dhe vdiqën rebelë. <sup>85</sup> Mos lejoni t'ju bëjnë përshtypje pasuritë e tyre dhe fëmijët e tyre: **Allahu** synon t'i ndëshkojë përmes këtyre në këtë botë dhe që shpirtat e tyre të largohen gjersa nuk besojnë. <sup>86</sup> Kur një sure shpallet [duke thënë]: 'Besoni në **Allahun** dhe përpiquni fort përkrah Të Dërguarit Të Tij', pasanikët e tyre ta kërkojnë lejen [të përjashtohen], duke thënë: 'Na lejoni të rrimë prapa me të tjerët': <sup>87</sup> preferojnë të jenë me ata që rrinë prapa. Zemrat e tyre janë vulosur: nuk kuptojnë. <sup>88</sup> Por I Dërguari dhe ata që besojnë me të përpiqen fort me pasuritë e tyre dhe me qenien e tyre. Gjërat më të mira u përkasin atyre; janë ata që do të përparojnë. <sup>89</sup> **Allahu** ka përgatitur Kopshte të hijeshuara me lumenj rrjedhës për ta dhe aty do të rrinë. Ky është triumfi suprem.

<sup>9:90</sup> Edhe disa nga arabët e shkretëtirës erdhën që të arsyetohen, duke kërkuar t'u lejohet përjashtimi. Ata që e gënjyen **Allahun** dhe Të Dërguarin E Tij qëndruan prapa në shtëpi. Një ndëshkim i dhembshëm do t'i mendojë ata nga ta që nuk besuan, <sup>91</sup> por nuk ka asnjë faj për të dobëtit, të sëmuret dhe ata që nuk kanë mjete për të shpenzuar, me kusht që janë besnikë ndaj **Allahut** dhe Të Dërguarit Të Tij – nuk ka arsye për t'i fyer ata që bëjnë mirë: **Allahu** është më falësi dhe mëshirëploti. <sup>92</sup> Dhe nuk ka asnjë faj për ata që erdhën te ti [Profet] për t'i kalëruar kafshët dhe të cilëve u the: 'Nuk mund të gjej kafshë kalëruese për ju': u kthyen me sytë e mbushur me lot të pikëllimit që nuk kishin me çka të

kontribuonin.<sup>93</sup> Ata që janë të hapur ndaj fajësimit janë ata që kërkuan nga ti përjashtim përkundër pasurisë së tyre dhe që preferuan të jenë me ata që rrinë prapa. **Allahu** ua ka vulosur zemrat: nuk kuptojnë.

<sup>94</sup> Kur të ktheheni nga ekspedita ata do të vazhdojnë të vijnë te ju [besimtarë] me justifikime. Thuaj: ‘Mos bëni justifikime. Nuk ju besojmë: **Allahu** na ka treguar për ju. **Allahu** dhe I Dërguari I Tij do t’i vëzhgojnë veprimet tuaja tani dhe në fund do t’ju kthejnë tek Ai që e njuh të dukshmen dhe të padukshmen. Ai do t’ju përballë me atë që e keni bërë.’<sup>95</sup> Kur të ktheheni te ta, do t’ju betohen për **Allahun** në mënyrë që t’ju bëjnë t’i lini rehat – pra lërin rehat: ata janë të neveritshëm dhe Ferri do të jetë shtëpia e tyre si shpërblim për veprimet e tyre –<sup>96</sup> do t’ju betohen ashtu që t’ju bëjnë t’i pranoni, por madje edhe nëse ju i pranoni, **Allahu** nuk do t’i pranojë njerëzit që rebelohen kundër Tij.

<sup>97</sup> Arabët e shkretëtirës janë më kokëfortët nga të gjithë popujt në mosbesimin dhe hipokrizinë e tyre. Ata kanë më së paku gjasa t’i njohin kufijtë që **Allahu** ia ka zbritur Të Dërguarit Të Tij. **Allahu** është i gjithë-dijshëm dhe i gjith’-urtë.<sup>98</sup> Disa nga arabët e shkretëtirës e konsiderojnë atë që e japin si të ishte imponim; po presin që fati të kthehet kundër jush, por fati do të kthehet kundër tyre. **Allahu** është gjithë-dëgjues dhe i gjithë-ditur.<sup>99</sup> Por ka edhe disa arabë të shkretëtirës që besojnë në **Allahun** dhe Ditën e Fundit dhe i konsiderojnë kontributet e tyre si asi që i sjellin më afër **Allahut** dhe lutjeve të Të Dërguarit: ato vërtet do t’i sjellin ata më afër dhe **Allahu** do t’i pranojë në mëshirën E Tij. **Allahu** është më falësi dhe mëshirëploti.

<sup>9:100</sup> **Allahu** do të jetë shumë i kënaqur me mërgimtarët dhe ndihmësit<sup>a</sup> e parë dhe njerëzit që i ndoqën ata në vepra të mira dhe ata do të jenë të kënaqur shumë me Të: Ai ka përgatitur Kopshte të hijeshuara me lumenj rrjedhës për ta, për të mbetur aty përgjithmonë. Ky është triumfi suprem.

<sup>101</sup> Disa nga arabët e shkretëtirës rreth jush janë hipokritë, siç janë edhe disa nga njerëzit e Medinës – janë kokëfortë në hipokrizinë e tyre. Ti [Profet] nuk i njuh, por Ne i njohim mirë: do t’i ndëshkojmë dyfish dhe pastaj do të kthehen [të përballen] te një ndëshkim i dhembshëm [në të Përtejmen].<sup>102</sup> Dhe ka të tjerë që janë rrëfyer për keqbërjen e tyre, që i kanë bërë disa vepra të ndershme dhe disa të këqija: **Allahu** mund ta pranojë fare mirë pendimin e tyre, se **Allahu** është më falësi dhe mëshirëploti.<sup>103</sup> Për t’i larë e pastruar ata [Profet], pranoje<sup>b</sup> një dhuratë nga pasuria e tyre [për t’i bërë përmirësimet] dhe lutu për ta – lutjet tua do të jenë ngushëllim për ta. **Allahu** është gjithë-dëgjues, i gjithë-ditur.<sup>104</sup> A s’e dinë se është Vetë **Allahu** që e pranon pendesën nga shërbyesit E Tij dhe e pranon atë që është dhënë lirshëm për hir Të Tij? Ai është gjithmonë gati ta pranojë pendesën, më i mëshirshmi.<sup>105</sup> Thuaj [Profet]: ‘Veproni! **Allahu** do t’i shohë veprimet tuaja

<sup>a</sup> Myslimanët medinas që i mirëpritën e i përkrahën mërgimtarët nga Meka.

<sup>b</sup> Fjalë për fjalë: ‘merre’

– siç do t’i shohë I Dërguari I Tij dhe besimtarët – dhe pastaj do të ktheheni tek Ai që e di atë që është e dukshme dhe e padukshme dhe do t’ju tregojë se çka po bënit.<sup>106</sup> Dhe ka të tjerë që po e presin dekretin e **Allahut**, ose t’i ndëshkojë ose t’u shfaqë mëshirë. **Allahu** është i gjithë-dijshëm dhe i urtë.

<sup>107</sup> Pastaj janë ata që e ndërtuan një xhami<sup>a</sup> – duke tentuar të shkaktojnë dëm, mosbesim dhe përçarje mes besimtarëve – si kamp ushtarak për roje nga sulmet e befasishme për ata që e luftuan **Allahun** dhe Të Dërguarin E Tij më parë – ata betohen: ‘Synimet tona ishin veç të mira’, por **Allahu** dëshmon se ishin gënjeshtarë.<sup>108</sup> [Profet,] kurrë mos u fal në atë xhami. Në vend të kësaj duhet të falesh në një xhami të themeluar që nga dita e parë mbi vetëdijesinë për **Allahun**: në këtë xhami ka njerëz që kanë merak ta rrisin pastërtinë – **Allahu** i do ata që kërkojnë të pastrohen.<sup>109</sup> Cili është më i mirë: personi që e themelon ndërtesën e tij mbi vetëdijesinë e **Allahut** dhe merakun për kënaqësinë E Tij të mirë, apo personi që e themelon ndërtesën e tij mbi pragun e një gremine të thërrmuar që do të shembet në Zjarrin e Ferrit, duke e marrë atë me vete? **Allahu** nuk i udhëzon keqbërësit: <sup>9:110</sup> ndërtesa që e kanë themeluar do të jetë gjithmonë burim i dyshimit brenda zemrave të tyre, deri kur zemrat t’u ndahen në copa. **Allahu** është i gjithë-dijshëm dhe i urtë.

<sup>111</sup> **Allahu** i ka blerë qeniet dhe pronat e besimtarëve në këmbim të Kopshtit – ata luftojnë në rrugën e **Allahut**: vrasin dhe vriten – ky është premtim i vërtetë i dhënë nga Ai në Teurat, në Ungjill dhe në Kuran. Kush do të mund të ishte më besnik ndaj premtimit të tij se **Allahu**? Pra jini të lumtur me shit-blerjen që e keni bërë: ky është triumfi i vërtetë.<sup>112</sup> [Besimtarët janë] ata që kthehen kah **Allahu** në pendesë; që e urdhërojnë atë që është e drejtë dhe e ndalojnë atë që është e gabuar dhe që i respektojnë kufijtë e **Allahut**. Jepu lajm të mirë besimtarëve të tillë.

<sup>113</sup> Nuk i ka hije Profetit dhe besimtarëve të kërkojnë falje për idhujtarët – edhe nëse janë të afërm të tyre – pasi është treguar se janë banorë të Flakës:<sup>114</sup> Ibrahim i kërkoi falje për babanë e tij se ia kishte dhënë një premtim, por posa e kuptoi se babai i tij ishte armik i **Allahut**, hoqi dorë nga ai. Ibrahim ishte zemër-butë dhe i durueshëm.<sup>115</sup> **Allahu** nuk do t’i ndëshkonte për devijim ata që i ka udhëzuar tashmë [në besim] para se t’ua bënte plotësisht të qartë se çka duhej të shmangnin. **Allahu** ka njohuri për gjithçka;<sup>116</sup> kontrolli i qiejve dhe i tokës i përket **Allahut**; veç Ai jep jetë dhe vdekje; nuk keni asnjë aleat a ndihmës pos Tij.

<sup>117</sup> Në mëshirën E Tij **Allahu** është kthyer kah Profeti dhe mërgimtarët e ndihmësit që e ndoqën në orën e fatkeqësisë kur disa zemra pothuajse u lëkundën: Ai u kthye kah ta; Ai është më i këndshmi dhe mëshirëploti për ta.

---

<sup>a</sup> Ebu ‘Amir al-Rahib u tha hipokritëve ta ndërtojnë një xhami rivale ashtu që të mbillnin përçarje në komunitet.

<sup>118</sup> Dhe tre burrave që qëndruan prapa: kur toka, me tërë hapësirësinë e saj, u mbyll rreth tyre, kur vetë shpirtrat e tyre u mbyllën rreth tyre, kur e kuptuan se streha e vetme nga **Allahu** ishte me Të, Ai iu kthye atyre me mëshirë që të kthehen [tek Ai]. **Allahu** është Gjithmonë-i-Buti, Më Mëshirëploti.

<sup>119</sup> Ju që besoni, jini të vetëdijsëm për **Allahun**: qëndroni me ata që janë besnikë. <sup>9:120</sup> Njerëzit e Medinës dhe arabët e shkretëtirës së tyre fqinje nuk duhet të përmbahen në pasimin e Të Dërguarit të **Allahut**, as s'duhet t'u interesojë për veten më shumë se për të: nëse ndonjëherë pësojnë ndonjë etje, lodhje a uri në çështjen e **Allahut**, ndërmarrin ndonjë hap që i zemëron mosbesimtarët, apo ia shkaktojnë ndonjë dëm një armiku, një vepër e mirë regjistrohet në favorin e tyre në llogari të kësaj – **Allahu** kurrë nuk e çon kot shpërblimin e atyre që bëjnë mirë – <sup>121</sup> nëse shpenzojnë pak apo shumë për çështjen e **Allahut**, nëse e përshkojnë një qafë të malit, krejt kjo regjistrohet në meritat e tyre ashtu që **Allahu** të mund t'i shpërblejë në përputhje me më të mirat e veprave të tyre.

<sup>122</sup> E megjithatë nuk është e drejtë për të gjithë besimtarët të dalin [në betejë] bashkë: nga secili komunitet, një grup duhet të dalë ta thellojë kuptimin e fesë, që të mund ta mësojnë popullin e tyre kur të kthehen dhe që të mund të ruhen nga e keqja. <sup>123</sup> Ju që besoni, luftoni mosbesimtarët afër jush dhe le t'ju gjejnë duke qëndruar fort: ta dini se **Allahu** është me ata që janë të vetëdijsëm për Të.

<sup>124</sup> Kur shpallet një sure, disa [hipokritë] thonë: 'A i është forcuar besimi ndokujt nga ju për shkak të saj?' Sigurisht që ajo e forcon besimin e atyre që besojnë dhe ata gëzohen, <sup>125</sup> por, sa për ata që janë të ligë në zemër, çdo sure e re ua shton tutje ligësinë e tyre. Ata vdesin duke mos besuar. <sup>126</sup> A s'mund ta shohin se bëhen të vuajnë një apo dy herë në vit? As nuk pendohen, as nuk janë të vëmendshëm. <sup>127</sup> Kurdo që shpallet një sure, e shikojnë njëri-tjetrin dhe thonë: 'A po ju shikon dikush?' dhe pastaj largohen – **Allahu** ua ka larguar zemrat se janë njerëz që nuk e përdorin arsyen.

<sup>128</sup> Një I Dërguar ju ka ardhur nga mesi juaj. Vuajtja juaj e shqetëson: është i brengosur thellësisht për ju dhe plot mirësi e mëshirë ndaj besimtarëve. <sup>129</sup> Nëse largohen, [Profet,] thuaj: '**Allahu** më mjafton: nuk ka zot pos Tij; e kam besimin tim në Të; Ai është Zoti i Fronit të Fuqishëm.'

**Përshkrimi para kaptinës 9 nga Abdel Haleem:**

*Sure medinase që e merr titullin nga vargu 106. Surja hapet duke njoftuar për shkëputjen e traktatit me idhujtarët se e kishin shkelur atë, por pjesa më e madhe e sures merret me përgatitjet dhe rekrutimet për ekspeditën në Tabuk, e cila u zhvillua në vapën e verës së AH 9 (631 CE). Hipokritët dhe ata që qëndruan prapa dhe dështuan ta përkrahin Profetin janë censuruar të gjithë. Kjo është surja e vetme që nuk fillon me formulën ‘Në emrin e Allahut, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës’; ka një opinion se suret 8 dhe 9 janë në fakt vetëm një sure.*

## 10: Junusi (JÛNUS)

Në emrin e **Allahut**, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës

<sup>1</sup> Elif Lam Ra

Këto janë vargjet e Librit të urtë<sup>a</sup>. <sup>2</sup> A është kaq befasuese për njerëzit që Ne i kemi shpallur një njeriu ndër ta se duhet t'i paralajmërojë njerëzit dhe t'u japë lajm të gëzueshëm atyre që besojnë, se janë në rrugë të sigurt me Zotin e tyre? [E prapë] ata që nuk besojnë thonë: 'Ky njeri është qartë magjistar.'

<sup>3</sup> Zoti juaj është **Allahu** që i krijoi qiejt dhe tokën për gjashtë Ditë,<sup>b</sup> pastaj u vendos te Froni, duke qeverisur gjithçka; s'ka kush që mund të ndërmjetësojë me Të, pa e dhënë Ai lejen së pari: ky është **Allahu**, Zoti juaj pra adhurojeni Atë. Si mund të mos jeni të vëmendshëm? <sup>4</sup> Është Ai tek I Cili do të ktheheni të gjithë – ky është premtim i vërtetë nga **Allahu**. Ishte Ai që [ju] krijoi fillimisht dhe do ta bëjë këtë përsëri, ashtu që të mund t'i shpërblejë drejtësisht ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira. Por mosbesimtarët do të kenë pije me ujë përvëlues dhe torturë munduese, se vazhdimisht nuk besuan.

<sup>5</sup> Është Ai që e bëri diellin rrezatim ndriçues dhe hënën dritë, duke i përcaktuar fazat për të që të mund ta dinit numrin e viteve dhe si ta llogaritni kohën. **Allahu** nuk i krijoi të gjitha këto pa destinim të vërtetë; Ai ua shpjegon shenjat E Tij atyre që kuptojnë. <sup>6</sup> Në ardhjen e njëpasnjëshme të natës dhe ditës dhe në atë që e krijoi **Allahu** në qiej dhe tokë vërtet ka shenja për ata që janë të vetëdijshëm për Të. <sup>7</sup> Ata që nuk presin<sup>c</sup> të na takojnë dhe janë të kënaqur me jetën e kësaj bote, duke u kënaqur me të dhe duke mos ua vënë veshin shenjave Tona, <sup>8</sup> do ta kenë Zjarrin për shtëpi të veten për shkak të asaj që e kanë bërë dikur. <sup>9</sup> Por sa u përket atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, Zoti i tyre do t'i udhëzojë për shkak të besimit të tyre. Lumenjtë do të rrjedhin te këmbët e tyre në Kopshtet e Lumturisë Supreme. <sup>10:10</sup> Lutja e tyre në to do të jetë: 'Lâvdi qoftë për Ty, **Allah!**', përsëritja e tyre: 'Paqe' dhe pjesa e fundit e lutjes së tyre: 'Lâvdi e falënderimi qoftë për **Allahun**, Zotin e Botëve.'

<sup>11</sup> Po ta nxitonte **Allahu** për njerëzit dëmin [që e kanë merituar] siç duan ta nxitojnë të mirën, koha e tyre tashmë do të kishte mbaruar. Por Ne i lëmë ata që nuk presin të na takojnë – të bredhin verbërisht në teprimet e tyre. <sup>12</sup> Kur njeriu e ka një hall na thërret, qoftë shtrirë në krah, ulur a në këmbë, por posa ta çlirojmë nga halli i tij vazhdon rrugës së tij sikur të mos na kishte thirrur kurrë për t'ia

---

<sup>a</sup> *Hakim* kuptohet në mënyra të ndryshme: ta ketë domethënieën 'plot urti', të sugjerojë se jep vendime në çështje dhe të komunikojë se është i perfeksionuar dhe i formuar mirë.

<sup>b</sup> Jo lloji i ditëve që i njohim ne – shih 32:5; 70:4.

<sup>c</sup> Apo 'frikësohen' (një nga kuptimet e *yarjuna*).



hequr hallin. Kështu u bëhen tërheqëse veprat e njerëzve të tillë që nuk janë të vëmendshëm.<sup>13</sup> Para juve njerëz, Ne kemi shkatërruar breza të tërë kur kanë bërë keq – të dërguarit e tyre u sollën shenja të qarta por refuzuan të besojnë. Kështu i shpaguajmë fajtorët.<sup>14</sup> Më vonë ju bëmë pasardhës të tyre në tokë, për ta parë se si do të silleshit.

<sup>15</sup> Kur u recitohen shpalljet Tona të qarta, ata që nuk presin të takohen me Ne thonë: '[Na] sill Kuran tjetër, apo ndryshoje.' [Profet,] thuaj, 'Nuk më takon ta ndryshoj sipas qejfit tim; unë veç e ndjek atë që më shpallet, se i frikësohem torturës së një Dite të tmerrshme, po të mos i bindesha Zotit tim.'<sup>16</sup> Thuaj: 'Po të donte **Allahu**, nuk do t'jua recitoja atë, as s'do t'jua bënte të njohur. Kam jetuar një jetë të tërë në mesin tuaj para se të më vinte. Si s'mund ta përdorni arsyen?'

<sup>17</sup> Kush do të mund të ishte më i lig se dikush që shpik rrena kundër **Allahut** apo i mohon shpalljet E Tij? Fajtorët nuk do të përparojnë kurrë.<sup>18</sup> Krahas **Allahut** adhurojnë gjëra që as s'mund t'i dëmtojnë ata – as të përfitojnë nga to – dhe thonë: 'Këto janë ndërmjetësueset<sup>a</sup> tona te **Allahu**.' Thuaj: 'A po mendoni se mund t'i tregoni **Allahut** për diçka që Ai nuk e di se ekziston në qiej apo në tokë? Lâvdi qoftë për Të! Ai është larg mbi zot-partnerët që i shoqërojnë me Të!<sup>19</sup> Të gjithë njerëzit ishin fillimisht nga një komunitet i vetëm, por më vonë u ndanë në mendime. Po të mos kish qenë një fjalë<sup>b</sup> nga Zoti juaj, tashmë do të bëhej gjykimi i paracaktuar ndërmjet tyre në lidhje me dallimet e tyre.<sup>10:20</sup> Thonë: 'Pse nuk i është zbritur asnjë shenjë e mbinatyrshe nga Zoti i tij?' Thuaj [Profet]: 'Veç **Allahu** e njeh të padukshmen, pra pritni – edhe unë po pres.'<sup>21</sup> Jo më shpejt Ne i lejojmë njerëzit të shijojnë ca mëshirë pasi i ka vrerosur një vuajtje, se sa që ata nisin të thurin plane kundër shpalljeve Tona. Thuaj: '**Allahu** planifikon edhe më shpejt'. Të dërguarit<sup>c</sup> Tanë e regjistrojnë tërë planifikimin tuaj.

<sup>22</sup> Është Ai që jua mundëson të udhëtoni në tokë dhe det deri kur, gjersa po lundroni nëpër anije dhe po dëfreheni në erën e favorshme, arrin një stuhi: valët vijnë te ta në anije nga të gjitha anët dhe ndihen se nuk ka shpëtim. Pastaj i luten **Allahut**, duke pretenduar besnikëri të singertë ndaj Tij: 'Nëse Ti na shpëton nga kjo, do të jemi vërtet falënderues.'<sup>23</sup> E prapë jo më shpejt se që Ai i shpëton, të kthyer në tokë, sillen egërsisht kundër çdo gjëje që është e drejtë. Njerëz! Sjellja juaj e egër punon veç kundër vetes suaj. Shijojeni kënaqësinë tuaj të vogël në këtë jetë të tanishme; në fund do të ktheheni te Ne dhe do t'ju përballim me gjithçka që keni bërë.

<sup>24</sup> Jeta e kësaj bote është kështu: shiu që e Ne e zbresim nga qielli përthithet nga bimët në tokë, nga të cilat hanë njerëzit dhe kafshët. Por kur toka e ka marrë pamjen e saj më të shkëlqyer dhe zbukurohet dhe njerëzit e saj mendojnë se kanë

---

<sup>a</sup> Shih më lart, vargu 3.

<sup>b</sup> Shtyrja e gjykimit.

<sup>c</sup> Engjëjt

pushtet ndaj saj, pastaj fati që e kemi urdhëruar i vjen, natën a ditën dhe e zvogëlojmë në kashtë, sikur të mos kishte lulëzuar veç një ditë më parë. Kjo është mënyra si i shpjegojmë shpalljet për ata që reflektojnë.

<sup>25</sup> Por **Allahu** [e] fton [secilin] në Shtëpinë e Paqes dhe e udhëzon këdo që do ta udhëzojë në rrugën e drejtë. <sup>26</sup> Ata që vepruan mirë do ta kenë shpërblimin më të mirë dhe edhe më tepër. As terri as turpi nuk do t'ua mbulojë fytyrat: ata janë bashkëshoqëruesit në Parajsë dhe aty do të qëndrojnë. <sup>27</sup> Sa për ata që bënë keq, secila vepër e keqe do të shpaguehet me të barabartën e saj dhe ata do t'i mbulojë poshtërimi – askush nuk do t'i mbrojë kundër **Allahut** – sikur fytyrat e tyre të ishin mbuluar me vello të prera nga errësira e natës. Këta janë të burgosurit e Zjarrit dhe aty do të mbesin.

<sup>28</sup> Në Ditën që Ne i mbledhim të gjithë së bashku, do t'u themi atyre që shoqërojnë partnerë me **Allahun**: 'Rrini në vendin tuaj, ju dhe zot-partnerët tuaj.' Pastaj do t'i ndajmë, dhe zot-partnerët e tyre do të thonë: 'Nuk ishim ne që na adhuroat – <sup>29</sup> **Allahu** është dëshmitar i mjaftueshëm ndërmjet nesh e jush – as që kishim ide se na keni adhuroar.' <sup>10:30</sup> Çdo shpirt do ta kuptojë, atëherë dhe aty, se çka ka bërë në të shkuarën. Ata do t'i kthejnë te **Allahu**, Zoti i tyre legjitim dhe [zotat] e tyre të shpikur do t'i dezertojnë.

<sup>31</sup> Thuaj [Profet]: 'Kush furnizon për ju nga qielli dhe toka? Kush e kontrollon dëgjimin dhe të pamurit? Kush i prodhon të gjallët nga të vdekurit dhe të vdekurit nga të gjallët dhe kush qeveris gjithçka?' Ata thonë të sigurt: '**Allahu**.' Pastaj thuaj: 'Pra pse nuk e dëgjoni Atë?' <sup>32</sup> Ai është **Allahu**, Zoti juaj, E Vërteta. Përveç Të Vërtetës, çka ka pos gabimit? Pra si jeni të bindur për të kundërtën?' <sup>33</sup> Në këtë mënyrë, fjala e Zotit tuaj për ata që [e] sfidojnë [Të Vërtetën] është vërtetuar – nuk besojnë. <sup>34</sup> Pyeti: 'A mundet cilido nga zot-partnerët tuaj ta nisë krijimin, pastaj ta kthejë në jetë përsëri në fund?' Thuaj: 'Është **Allahu** që e nis krijimin dhe pastaj e kthen në jetë, pra si mund të çorientoheni?' <sup>35</sup> Thuaj: 'A mundet cilido nga zot-partnerët tuaj ta tregojë rrugën kah E Vërteta?' Thuaj: '**Allahu** e tregon rrugën kah E Vërteta. A është më i merituar të ndiqet dikush që e tregon rrugën kah E Vërteta, apo dikush që nuk mund ta gjejë rrugën pos nëse vetë atij i tregohet? Si është puna me ju? Si gjykoni?' <sup>36</sup> Shumica nga ta nuk ndjekin asgjë pos supozimeve, por supozimet mund të jenë fare pa vlerë kundër Të Vërtetës: **Allahu** është fare mirë i vetëdijshëm për atë që e bëjnë.

<sup>37</sup> As ky Kuran nuk do të mund të sajohej nga askush tjetër pos **Allahut**. Është konfirmim i asaj që është zbuluar para tij dhe shpjegim i Librit të Shenjtë – le të mos ketë dyshim për të – është nga Zoti i Botëve. <sup>38</sup> Apo a thonë: 'Ai e ka shpikur?' Thuaj: 'Atëherë prodhoheni një sure si ai dhe thirreni këdo që mundeni pos **Allahut** nëse po e tregoni të vërtetën.' <sup>39</sup> Por ata po e refuzojnë atë që nuk mund ta kapin me mend – profecia e tij do kohë të përmbushet për ta. Në

mënyrën e njëjtë, ata para tyre refuzuan të besojnë – shihni çfarë ishte fundi i atyre keqbërësve!

<sup>10:40</sup> Disa nga ta besojnë në të dhe disa nuk besojnë: Zoti yt i njeh më së miri ata që bëjnë korrupsion. <sup>41</sup> Nëse nuk të besojnë [Profet], thuaj: ‘Unë veproj për veten time dhe ju për veten tuaj. As ju s’jeni përgjegjës për veprimet e miya as unë s’jam përgjegjës për tuajat.’ <sup>42</sup> Disa nga ta ju dëgjojnë: por a mund t’i bëni të shurdhërit të dëgjojnë nëse nuk do t’i përdorin mendjet e tyre? <sup>43</sup> Disa nga ta ju shikojnë: por a mund t’i udhëzoni të verbrit nëse nuk do të shohin? <sup>44</sup> **Allahu** nuk i dëmton fare njerëzit – janë ata që e dëmtojnë veten.

<sup>45</sup> Në Ditën që Ai i mbledh së bashku, do të jetë sikur të kenë qëndruar [në botë] jo më shumë se një orë të vetme dhe do ta njohin njëri-tjetrin. Ata që e refuzuan takimin me **Allahun** do të jenë humbësit, se nuk e ndoqën udhëzimin e duhur. <sup>46</sup> Pavarësisht a të lejojmë Ne të shohësh [Profet] ca nga ndëshkimi me të cilin i kemi kërcënuar, apo të bëjmë të vdesësh [së pari], ata do të kthehen te Ne: **Allahu** është dëshmitar i asaj që e bëjnë. <sup>47</sup> Çdo komuniteti i është çuar një i dërguar dhe kur i dërguari i tyre vjen,<sup>a</sup> do të gjykohen drejtësisht; nuk do t’u bëhet e padrejtë. <sup>48</sup> Pyesin: ‘Kur do të përmbushet ky premtim, nëse ajo që e thua është e vërtetë?’ <sup>49</sup> Thuaj [Profet]: ‘Nuk mund ta kontrolloj asnjë dëm a përfitim që më vjen, pos siç vendos **Allahu**. Ka afat të caktuar për secilin komunitet dhe kur të arrihet as s’mund ta vonojnë as ta ngutin, as për një çast.’ <sup>10:50</sup> Thuaj: ‘Mendoni: nëse ndëshkimi I Tij do të ishte duke ju ardhur, gjatë natës a gjatë ditës, çfarë pjese të tij do të dëshironin ta ngutnin fajtorët?’ <sup>51</sup> A do të besoni në të, kur të ndodhë vërtetë?’ Do të thuhet: ‘Tash [besoni], kur [më parë] kërkonit ta ngutnit?’ <sup>52</sup> Do t’u thuhet keqbërësve: ‘Shijojeni ndëshkimin e përhershëm. Pse do të duhej të shpërbleheshit për çkadoqoftë pos për ato që i keni bërë?’

<sup>53</sup> Të pyesin [Profet]: ‘A është e vërtetë?’ Thuaj: ‘Po, pasha Zotin tim, është e vërtetë dhe nuk mund t’i ikni.’ <sup>54</sup> Çdo shpirt që ka bërë keq, po të posedonte gjithçka që ka në tokë, do ta ofronte me gëzim si shpërblese për lirim. Kur ta shohin ndëshkimin, do të pendohen në fshehtësi, por do të gjykohen me drejtësi dhe nuk do t’u bëhet e padrejtë. <sup>55</sup> Është **Allahu** Ai Të Cilit i përket vërtet gjithçka në qiej dhe në tokë: premtimi i **Allahut** është i vërtetë, por shumica e njerëzve nuk e kuptojnë. <sup>56</sup> Është Ai që jep jetë dhe e merr atë dhe të gjithëve do t’ju kthejnë tek Ai.

<sup>57</sup> Njerëz, ju ka ardhur një mësim nga Zoti juaj, shërim për atë që është në zemra [tuaja] dhe udhëzim e mëshirë për besimtarët. <sup>58</sup> Thuaj [Profet]: ‘Le të kënaqen në mirësinë e mëshirën e **Allahut**: këto janë më të mira se gjithçka që grumbullojnë ata.’ <sup>59</sup> Thuaj: ‘Mendoni për furnizimin që e ka zbritur **Allahu** për

---

<sup>a</sup> Te Gjykimi. Të dërguarit do të dëshmojnë, shih 39:69.

ju, ca nga i cili e keni bërë të paligjshëm dhe ca të ligjshëm<sup>a</sup> Thuaj: ‘A ju ka dhënë **Allahu** leje [për ta bërë këtë], apo po shpikni rrena për **Allahun**?’<sup>10:60</sup> Çka do të mendojnë në Ditën e Ringjalljes ata njerëz që shpikin rrena për Të? **Allahu** është bujar ndaj njerëzve, por shumica nga ta nuk falënderojnë.

<sup>61</sup> Në çfarëdo çështje të mund të jesh i angazhuar [Profet] dhe çfarëdo pjese të Kuranit qofsh duke e recituar, çfarëdo punë që po bëni [ju njerëz], Ne ju jemi dëshmitarë kur jeni të angazhuar në të. Madje as pesha e një pikle pluhuri në tokë a qiell nuk i ik Zotit tuaj, as asgjë më e vogël a më e madhe: e tëra është e shkruar në regjistër të qartë. <sup>62</sup> Por për ata që janë në anën e **Allahut** nuk ka frikë, as s’do të pikëllohen. <sup>63</sup> Për ata që besojnë dhe janë të vetëdijshëm për **Allahun**, <sup>64</sup> për ta ka lajm të mirë në këtë jetë dhe në Të Përtejmen – nuk ka ndryshim të premtimeve të **Allahut** – ky është vërtet triumfi suprem. <sup>65</sup> Mos i lejo fjalët e tyre të të pikëllojnë [Profet]. Pushteti i përket plotësisht **Allahut**; Ai i dëgjon të gjitha dhe i di të gjitha; <sup>66</sup> vërtet, të gjithë ata që janë në qiej dhe në tokë i përkasin Atij. Ata që bëjnë kërkesa nga të tjerë pos **Allahut** nuk janë vërtet duke ndjekur zot-partnerë; veç po ndjekin supozime dhe po tregojnë rrena. <sup>67</sup> Është Ai që e bëri natën ashtu që të mund të pushoni në të dhe dritën e ditës që të mund të shihni – vërtet ka shenja në këtë për ata që dëgjojnë.

<sup>68</sup> Thonë: ‘**Allahu** ka fëmijë!’ Qoftë i lartësuar Ai! Ai është I Vetë-Mjaftueshmi; gjithçka në qiej dhe në tokë i përket Atij. Nuk keni autoritet për ta thënë këtë. Si guxoni të thoni gjëra për **Allahun** pa asnjë njohuri? <sup>69</sup> Thuaj [Profet]: ‘Ata që shpikin rrena për **Allahun** nuk do të përparojnë.’<sup>10:70</sup> Ata mund të kenë paksa kënaqësi në këtë botë, por pastaj do të kthehen te Ne. Pastaj do t’i bëjmë të shijojnë ndëshkim të ashpër për këmbënguljen në blasfemi.

<sup>71</sup> Tregojua rrëfimin e Nuhit. Ai i tha popullit të tij: ‘Populli im, nëse prezenca ime ndërmjet jush dhe kjo që po jua kujtoj shenjat e **Allahut** është tepër për ju, atëherë e kam besimin tim në **Allahun**. Pajtohuni për drejtimin tuaj të veprimit, ju dhe zot-partnerët tuaj – mos jini ngurrues apo të fshehtë për këtë – pastaj zbatoheni vendimin tuaj në mua dhe mos më jepni shtyrje të afatit. <sup>72</sup> Por nëse largoheni, nuk kam kërkuar shpërblim nga ju; shpërblimi im është veç me **Allahun** dhe jam urdhëruar të jem një nga ata që i kushtohen Atij.’<sup>73</sup> Por e refuzuan. Ne e shpëtuan atë dhe ata që ishin me të në Arkë dhe i lamë të mbesin gjallë; dhe i fundosëm ata që i refuzuan shpalljet Tona – shih çfarë ishte fundi i atyre që ishin paralajmëruar!

<sup>74</sup> Pastaj, pas tij, Ne çuam të dërguar te popujt e tyre duke u sjellur shenja të qarta. Por nuk do të besonin në asgjë që tashmë e kishin refuzuar: në këtë mënyrë i vulosim zemrat e atyre që janë plot armiqësi. <sup>75</sup> Pas tyre e dërguam Musain dhe Harunin me shenjat Tona te Faraoni dhe përkrahësit e tij udhëheqës, por ata

---

<sup>a</sup> Shih 5:103

vepruan me arrogancë – ishin njerëz të ligë. <sup>76</sup> Kur e vërteta u erdhi nga Ne, thanë: ‘Kjo është magji pacipërisht e dukshme.’ <sup>77</sup> Musai tha: ‘A kjo është ajo që e thoni për Të Vërtetën kur ju vjen? A është kjo magji? Magjistarët nuk përparojnë kurrë.’ <sup>78</sup> Ata thanë: ‘A keni ardhur të na largoni nga besimi të cilin e kemi gjetur duke u ndjekur nga etërit tanë, ashtu që ti dhe vëllai yt të fitoni madhështi në këtë tokë? Nuk do të besojmë kurrë në ju.’ <sup>79</sup> Dhe Faraoni tha: ‘Ma sillni çdo magjistar të ditur.’ <sup>10:80</sup> Kur erdhën magjistarët, Musai u tha: ‘Gjuani në tokë çka që të keni.’<sup>a</sup> <sup>81</sup> Kur e bënë këtë, Musai tha: ‘Gjithçka që keni sjellur është magji dhe **Allahu** do ta tregojë se është e rreme. **Allahu** nuk e bën të mirë punën e ngatërrestarëve; <sup>82</sup> Ai do ta mbështesë Të Vërtetën me fjalët E Tij, edhe nëse keqbërësit e urrejnë atë.’ <sup>83</sup> Por askush nuk besoi në Musain pos disa nga njerëzit e tij, nga frika se Faraoni dhe udhëheqësit e tyre do t’i keqtrajtonin: Faraoni po tiranizonte në vend dhe ishte i prirur për ta tepruar.

<sup>84</sup> Musai tha: ‘Populli im, nëse keni besim në **Allahun** dhe i jeni kushtuar Atij, mbështeteni besimin tuaj në Të.’ <sup>85</sup> Ata thanë: ‘E kemi mbështetur besimin tonë në **Allahun**. Zot! Mos na bëj objekt të keqtrajtimit për shtypësit. <sup>86</sup> Shpëtona, në mëshirën Tënde, nga ata që [e] refuzojnë [mesazhin Tënd].’ <sup>87</sup> Ne i shpallëm Musait dhe vëllait të tij: ‘Strehoheni popullin tuaj në Egjipt dhe bëni këto shtëpi vende të adhurimit; faluni rregullisht; jepuni lajm të mirë besimtarëve!’ <sup>88</sup> Dhe Musai tha: ‘Zoti ynë, Ti i ke dhënë Faraonit dhe parisë së tij shkëlqim dhe pasuri në këtë jetë të tanishme dhe ja ku janë, Zot, duke i udhëhequr të tjerët në shmangie nga rruga Jote. Zoti ynë, shkatërroje pasurinë e tyre plotësisht dhe ngurtësoji zemrat e tyre ashtu që të mos besojnë deri kur ta shohin torturën munduese.’ <sup>89</sup> **Allahu** tha: ‘Lutjet tuaja kanë marrë përgjigje, kështu që rrini në drejtimin e duhur dhe mos e ndiqni rrugën e atyre që nuk dinë.’

<sup>10:90</sup> Ne i çuam Fëmijët e Izraelit matanë detit. Faraoni dhe trupat e tij i ndoqën me arrogancë dhe agresion. Por gjersa po fundosej, ai thirri: ‘Besoj se nuk ka **Zot** pos atij në të cilin besojnë Fëmijët e Izraelit. I gjunjëzohem Atij.’ <sup>91</sup> ‘Tash? Kur gjithmonë ke qenë rebel dhe ngatërrestar!’ <sup>92</sup> Sot Ne do të ta shpëtojmë veç kufomën si shenjë për tërë brezat e ardhshëm. Një numër i madh i njerëzve dështojnë t’i marrin parasysh shenjat Tona.’ <sup>93</sup> Ne i sistemuar Fëmijët e Izraelit në një vend të mirë dhe furnizuar gjëra të mira si mjete jetese për ta. Veç pasi te ta kishte ardhur njohuria ndodhi që nisën të dallojnë ndërmjet vete. Zoti juaj do të gjykojë ndërmjet tyre në Ditën e Ringjalljes në lidhje me dallimet e tyre.

<sup>94</sup> Pra nëse [ti Profet] ke dyshime për atë që Ne ta kemi shpallur, pyeti ata që kanë qenë duke i lexuar librat e shenjta para teje. E Vërteta të ka ardhur nga Zoti yt, pra mos ki dyshime dhe mos i refuzo shenjat e **Allahut** – <sup>95</sup> pastaj do të

---

<sup>a</sup> Shkopinjte apo shtizat tuaja – shih 20:66-9

bëheshe një nga humbësit. <sup>96</sup> Ata kundër të cilëve është shqiptuar ndëshkimi nga Zoti yt nuk do të besojnë, <sup>97</sup> edhe nëse u vjen çdo shenjë, deri kur ta shohin torturën munduese. <sup>98</sup> Sikur veç një qytet i vetëm të kishte besuar dhe të kishte përfituar nga besimi i tij! Veç populli i Junusit bënë kështu dhe kur besuan, Ne i çliruam nga ndëshkimi i turpërimit në jetën e kësaj bote dhe i lejuam ta shijojnë jetën për një kohë. <sup>99</sup> Po të kishte dashur Zoti yt, tërë njerëzit në tokë do të kishin besuar. Pra a mundesh [Profet] t'i detyrosh njerëzit të besojnë? <sup>10:100</sup> Asnjë shpirt nuk mund të besojë pos me vendim të **Allahut** dhe Ai sjell turpërim mbi ata që nuk e përdorin arsyen e tyre. <sup>101</sup> Thuaj: 'Shiheni atë që është në qiej dhe në tokë.' Por çfarë dobie kanë shenjat dhe paralajmërimet për njerëzit që nuk do të besojnë? <sup>102</sup> Çka po presin pos ndëshkimit që u erdhi atyre para tyre? Thuaj: 'Pritni pra, edhe unë po pres.' <sup>103</sup> Në fund Ne do t'i shpëtojmë të dërguarit dhe besimtarët Tanë. Ne e marrim përsipër Vetë t'i shpëtojmë besimtarët.

<sup>104</sup> [Profet] thuaj: 'Njerëz, edhe nëse keni dyshime për fenë time, nuk i adhuroj ata që i adhuronin ju pos **Allahut**, por e adhuroj **Allahun** që do të bëjë të vdisni dhe jam urdhëruar të jem besimtar.' <sup>105</sup> [Profet,] ktheje fytyrën tënde kah feja si njeri i besimit të pastër. Mos ji nga ata që shoqërojnë partnerë me **Allahun**; <sup>106</sup> mos iu lut asnjë tjetri [zot] që as s'mund të të bëjë dobi as të të dëmtojë: nëse e bën këtë, do të jesh një nga keqbërësit. <sup>107</sup> Nëse **Allahu** shkakton dëm mbi ty, askush nuk mund ta heqë pos Tij dhe nëse Ai synon diçka të mirë për ty, askush s'mund ta largojë bujarinë E Tij; Ai ia dhuron bujarinë E Tij cilitdo nga shërbyesit E Tij që do t'ia dhurojë. Ai është Më Falësi, Më Mëshirëploti. <sup>108</sup> Thuaj: 'Njerëz, E Vërteta ju ka ardhur nga Zoti juaj. Kushdo që e ndjek rrugën e duhur e ndjek për të mirën e tij dhe kushdo që shmanget e bën këtë në dëm të tijin: nuk jam kujdestari juaj.' <sup>109</sup> [Profet,] ndiqe atë që të është shpallur dhe mbahu i qëndrueshëm deri kur **Allahu** ta japë gjykimin E Tij, se Ai është Më i Miri nga Gjykatësit.

**Përshkrimi para kaptinës nga 10 Abdel Haleem:**

*Sure mekase që e merr titullin nga referimi i Junusit në vargun 98. Ajo e thekson pushtetin e Allahut, vërtetësinë e Kuranit dhe fatin e keqbërësve. Bëhet i qartë zemërimi i Allahut me ata që e refuzojnë vazhdimisht të vërtetën e shpalljeve dhe shenjave Të Tij, si dhe fakti që, po të mos ishte vendimi I Tij për ta pritur Ditën e Ringjalljes, gjykimi I Tij tashmë do të kishte rënë mbi ta. Profeti inkurajohet të jetë i durueshëm dhe i kujtohet fakti se nuk mund t'i detyrojë njerëzit të besojnë.*

## 11: Hudi (HÛD)

Në emrin e **Allahut**, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës

<sup>1</sup> Elif Lam Ra

[Ky është] Libër i Shenjtë vargjet e të cilit janë përsosur, pastaj janë përshtuar qartë, nga Ai që është i gjith’-urtë, i gjithë-informuar. <sup>2</sup> [Thuaj, Profet:] ‘Mos e adhuroni askë pos **Allahut**. Jam dërguar te ju nga Ai për të paralajmëruar dhe për të dhënë lajm të mirë. <sup>3</sup> Kërkoni falje nga Zoti juaj, pastaj kthehuni Atij. Ai do t’ju dhurojë kënaqësi të dobishme deri në një kohë të caktuar dhe do t’ia japë mirësinë E Tij çdokujt që ka meritë. Por nëse largoheni, kam frikë se do të keni torturë në një Ditë të tmerrshme: <sup>4</sup> është **Allahu** tek i cili do të ktheheni të gjithë dhe Ai ka pushtet ndaj gjithçkaje.’

<sup>5</sup> Shihni si [pabesimtarët] e mbështjellin veten, për t’i fshehur ndjenjat e tyre nga Ai. Por edhe kur mbulohen me rrobat e tyre, Ai e di se çka fshehin dhe çka shfaqin: Ai i di mirë fshehtësitë më të thella të zemrës. <sup>6</sup> Nuk ka krijesë që lëviz në tokë furnizimi i të cilës nuk është interesim I Tij. Ai e di se ku jeton ajo dhe vendin e saj [përfundimtar] të pushimit: është e tëra [atje] në regjistër të qartë. <sup>7</sup> Është Ai që i krijoi qiejt dhe tokën për gjashtë Ditë<sup>a</sup> – qeverisja<sup>b</sup> E Tij shtrihet edhe mbi ujërat<sup>c</sup> po ashtu – për të testuar se cili nga ju vepron më së miri.

E prapë [Profet], nëse u thua: ‘Do të ringjallen pas vdekjes’, pabesimtarët janë të sigurtë në përgjigje: ‘Kjo qartë s’është asgjë pos magji’. <sup>8</sup> Nëse Ne e shtyjme ndëshkimin e tyre për një kohë të caktuar, ata janë të sigurtë të thonë: ‘Çka po e frenon atë?’ Por në Ditën që u vjen, asgjë nuk do ta shmangë atë nga ta; ajo me të cilën talleshin do të jetë kudo rreth tyre. <sup>9</sup> Sa i paarsyeshëm e jomirënjohës bëhet njeriu kur Ne e lëmë ta shijojë mëshirën Tonë dhe pastaj e ndalim atë! <sup>11:10</sup> Dhe nëse e lëmë ta shijojë mëshirën pasi e ka prekur ndonjë dëm, ai i sigurt thotë: ‘Fatkeqësia u largua nga unë.’ Bëhet i ngazëllyer e mburracak. <sup>11</sup> Por jo ata që janë të qëndrueshëm dhe bëjnë vepra të mira: ata do të kenë falje dhe shpërblim të madh.

<sup>12</sup> Pra [Profet] a do të<sup>d</sup> heqësh dorë nga ndonjë pjesë e asaj që të është shpallur dhe ta lësh zemrën tënde të jetë ngushtohet nga kjo, se thonë: ‘Pse nuk i është zbritur asnjë thesar? Pse nuk ka ardhur asnjë engjell me të?’ ? Ti je aty veç për të paralajmëruar; është **Allahu** Ai që është mbikëqyrës i gjithçkaje. <sup>13</sup> Nëse thonë:

---

<sup>a</sup> Shih po ashtu 22:47, 32:4, 41:9 e tutje.

<sup>b</sup> ‘Qeverisja’ është njëri nga kuptimet e fjalës arabe ‘arsh, që normalisht përkthehet si ‘fron’ (*al-Mu{jam al-Wasit*).

<sup>c</sup> Krahaso me 21:30.

<sup>d</sup> Fjalë për fjalë: ‘Mbase do të . . .’, por kjo është figurë sfiduese e ligjëratës.



‘Ai [Muhamedi] e ka shpikur vetë [Kuranin]’, thuj: ‘Atëherë prodhoni dhjetë sure të shpikura si ai dhe ftojini kë të mundeni pos **Allahut**, në qofshi të singertë.’<sup>14</sup> Nëse nuk ju përgjigjen, atëherë të gjithë do ta dini se është zbritur duke përmbajtur dije nga **Allahu** dhe se nuk ka zot pos Tij. Pra a do t’i jepeni Atij?<sup>15</sup> Nëse cilëtdo e kanë merak [veç] jetën e kësaj bote me tërë stolitë e saj, Ne do t’i shpaguajmë plotësisht në këtë jetë për veprat e tyre – nuk do t’u jepet më pak –<sup>16</sup> por njerëzit e tillë nuk do të kenë asgjë në Të Përtejmen pos Zjarrit: puna e tyre këtu do të jetë e pafrytshme dhe veprat e tyre të kota.<sup>17</sup> A mund të krahasohen këta me ata që kanë provë të qartë nga Zoti i tyre,<sup>a</sup> të recituar prej një dëshmitari nga Ai,<sup>b</sup> dhe para saj Librin e Musait, si udhëzim dhe mëshirë? Këta njerëz besojnë në të, ndërsa atyre grupeve që e mohojnë të vërtetën e saj u premtohet Zjarri. Pra mos ki dyshim për të [Profet]: është E Vërteta nga Zoti yt, edhe pse shumica e njerëzve nuk besojnë kështu.

<sup>18</sup> Kush mund të sillet më keq se sa dikush që shpik rrena për **Allahun**? Njerëzit e tillë do të sillen para Zotit të tyre dhe dëshmitarët do të thonë: ‘Këta janë ata që gënjen për Zotin e tyre. Refuzimi i **Allahut** është për shkak të atyre që sillen keq kështu,<sup>19</sup> që i pengojnë të tjerët për kah rruga e **Allahut**, duke u munduar ta bëjnë atë të përdredhur dhe e refuzojnë jetën e ardhshme.<sup>11:20</sup> Nuk do të ikin në tokë dhe nuk do të ketë askush tjetër t’i mbrojë pos **Allahut**. Ndëshkimi i tyre do të dyfishohet. S’kanë mundur të dëgjojnë dhe nuk kanë parë.<sup>21</sup> Janë ata që do t’i kenë humbur shpirtrat e tyre dhe ajo që e kanë shpikur do t’i ketë dezertuar.<sup>22</sup> Nuk ka dyshim se do të jenë të tillët që do të humbin më së shumti në jetën e ardhshme.<sup>23</sup> Por ata që besuan, bënë vepra të mira dhe u përlën para Zotit të tyre do të jenë bashkëshoqërues në Parajsë dhe aty do të rrinë.<sup>24</sup> Këto dy grupe janë si të verbrit e të shurdhrit në krahasim me ata që mund të shohin dhe të dëgjojnë mirë: a mund të jenë të ngjashëm? Si s’mund të jeni të vëmendshëm?

<sup>25</sup> Ne e dërguam Nuhun te populli i tij të thotë: ‘Kam ardhur te ju për të dhënë paralajmërim të qartë: <sup>26</sup> mos e adhroni askë pos **Allahut**. Kam frikë se do të keni torturë në një Ditë të vështirë.’<sup>27</sup> Por pabesimtarët e spikatur në popullin e tij thanë: ‘Mund ta shohim se s’je asgjë pos vdekatar si ne dhe shihet qartë se të ndjekin veç më të pamoralshmit nga ne. Nuk mund ta shohim se si je më i mirë se ne. Në fakt, mendojmë se je rrenacak.’<sup>28</sup> Ai tha: ‘Populli im, mendoni: po të kisha pasur shenjë të qartë nga Zoti im dhe po të më kishte dhënë Ai mirësi nga E Tija, megjithëse do të ishte e fshehur nga ju, a do të mund t’ju detyronim ta pranoni kundër vullnetit tuaj?’<sup>29</sup> Populli im, nuk jua kërkoj asnjë shpërblim për të; shpërblimi im vjen veç nga **Allahu**. Nuk do t’i largoj nga vetja besimtarët: është e sigurt se do ta takojnë Zotin e tyre. Mund ta shoh se jeni budallenj.

---

<sup>a</sup> Kurani.

<sup>b</sup> Engjëlli Xhebrail

11:30 Populli im, kush do të mund të më ndihmonte kundër **Allahut** po t'i largoja besimtarët nga vetja? A nuk do të jeni të vëmendshëm? <sup>31</sup> Nuk po ju them se kam thesare të **Allahut**, apo se di ndonjë njohuri të asaj që është e fshehur, apo se jam engjëll. As s'po them se Zoti nuk do t'u dhurojë asnjë të mirë atyre që janë të përbuzur në sytë tuaj: Vetë **Allahu** e di më së miri atë që është në shpirtrat e tyre. Po ta bëja këtë do të isha një nga keqbërësit.' <sup>32</sup> Ata thanë: 'Nuh! Je grindur me neve tepër gjatë. Na e sill ndëshkimin me të cilin po na kërcënon, nëse po e tregon të vërtetën.' <sup>33</sup> Ai tha: 'Është **Allahu** që do ta sjellë, nëse Ai do dhe nuk do të jeni në gjendje të shpëtoni. <sup>34</sup> Këshilla ime nuk do t'ju hyjë në punë nëse **Allahu** dëshiron t'ju lërë me deluzionet tuaja: Ai është Zoti juaj dhe tek Ai do t'ju kthejnë.'

<sup>35</sup> Nëse [këta pabesimtarë]<sup>a</sup> thonë: 'Ai [Muhamedi] e ka shpikur këtë', thuaj [Muhamed]: 'Nëse e kam shpikur këtë, jam përgjegjës për krimin tim, por jam i pafajshëm për krimet që i bëni ju.'

<sup>36</sup> Nuhut i ishte shpallur: 'Asnjë nga populli yt nuk do të besojnë, pos ata që tashmë kanë besuar, kështu që mos u tensiono me atë që e bëjnë. <sup>37</sup> Ndërtoje Arkën nën sytë Tanë [vigjilues] dhe me frymëzimin Tonë. Mos m'u lut Mua me kërkesa për ata që kanë bërë keq – ata do të përmyten.' <sup>38</sup> Kështu ai nisi ta ndërtojë Arkën dhe kurdo që kalonin udhëheqësit e popullit të tij, qeshnin me të. Ai tha: 'Mund të na përbuzni tash, por ne do të vijmë t'ju përbuzim juve: <sup>39</sup> do ta zbuloni se kush do të marrë ndëshkim poshtërues dhe mbi kë do të zbresë vuajtje e gjatë.' <sup>11:40</sup> Kur erdhi urdhri Ynë dhe uji gufoi përpjetë<sup>b</sup> nga toka, Ne thamë: 'Vendosi në këtë Arkë nga një çift të secilit lloj dhe familjen tënde – përveç atyre ndaj të cilëve është shqiptuar ndëshkimi tashmë – dhe ata që kanë besuar', edhe pse veç pak nga ta besuan me të. <sup>41</sup> Ai tha: 'Hipni në Arkë. Në emrin e **Allahut** ajo do të lundrojë dhe do të ankorohet. **Allahu** im është më falësi dhe mëshirëploti.' <sup>42</sup> Ajo lundroi me ta mbi valë si male dhe Nuhu i thirri të birin, që nuk erdhi: 'Eja në anije me ne, biri im, mos rri me pabesimtarët.' <sup>43</sup> Por ai u përgjigj: 'Do të kërkoj strehim në një mal për të më shpëtuar nga uji.' Nuhu tha: 'Sot nuk ka strehim nga urdhri i **Allahut**, pos për ata mbi të cilët Ai ka mëshirë.' Valët i ndanë nga njëri-tjetri dhe ai ishte nga të përmyturit.

<sup>44</sup> Pastaj është thënë: 'Tokë, gëlltite ujin tënd dhe qiell, frenohu' dhe uji u tërhoq – urdhri ishte përmbushur. Arka u ndal në Malin Xhudij dhe është thënë: 'Të shkuar janë ata njerëz keqbërës!' <sup>45</sup> Nuhu i thirri Zotit të tij, duke thënë: 'Zoti im, biri im ishte një nga familja ime, edhe pse premtimi<sup>c</sup> Yt është i vërtetë dhe Ti je më i drejti nga të gjithë gjykatësit.' <sup>46</sup> **Allahu** tha: 'Nuh, ai nuk ishte një nga familja jote. Ajo që e bëri nuk ishte e drejtë. Mos kërko nga Unë gjëra për të cilat

---

<sup>a</sup> Në Mekë

<sup>b</sup> Fjalë për fjalë: 'stufa e derdhte ujin nga ena duke vuar'

<sup>c</sup> Për ta shpëtuar familjen e Nuhut; shih vargun 40

ti nuk di asgjë. Po të paralajmëroj të mos jesh budalla.’<sup>47</sup> Ai tha: ‘Zoti im, marr strehim me Ty nga kërkimi i gjërave për të cilat nuk di asgjë. Nëse Ti nuk më fal dhe nuk ke mëshirë mbi mua, do të jem një nga humbësit.’<sup>48</sup> Dhe është thënë: ‘Nuh, zbrit në paqe nga Ne, me bekime mbi ty dhe mbi disa nga komunitetet që do të burojnë nga ata që janë me ty. Do të ketë të tjerë që Ne do t’i lejojmë ta shijojnë jetën për një kohë, por pastaj do ta vuajnë një ndëshkim të dhembshëm nga Ne.’<sup>49</sup> Këto përshkrime janë pjesë e asaj që ishte përtej njohurisë sate [Muhamed]. Ne t’i zbuluam. As ti as populli yt nuk i keni ditur para të tashmes, pra ji i durueshëm: e ardhmja u përket atyre që janë të vetëdijshëm për **Allahun**.

<sup>11:50</sup> Ad-ëve, Ne ua dërguam vëllain e tyre, Hudin. Ai tha: ‘Populli im, adhurojeni **Allahun**. Nuk keni zot tjetër pos Tij; veç sa po shpikni rrena.’<sup>51</sup> Nuk kërkoi asnjë shpërblim nga ju, populli im; shpërblimi im më vjen veç nga Ai që më krijoi. Pse s’e përdorni arsyen tuaj?<sup>52</sup> Populli im, kërkoni falje nga Zoti juaj dhe kthehuni tek Ai. Ai do të zbresë për ju shi të begatshëm nga qielli dhe do t’ju japë fuqi shtesë. Mos u largoni me refuzim e të humbeni në mëkatet tuaja.’<sup>53</sup> Ata u përgjigjën: ‘Hud, nuk na ke sjellë ndonjë provë të qartë. Nuk do t’i braktisim zotat tanë bazuar veç në fuqinë e fjalës sate, as s’do të t’besojmë.’<sup>54</sup> Krejt çka mund të themi është se njëri nga zotat tanë mund të ta ketë shkaktuar ndonjë dëm.’ Ai tha: ‘E thërras **Allahun** për të dëshmuar dhe edhe ju më jeni dëshmitarë, se nuk i pranoj si të mitë ata që i caktoni si partnerë me **Allahun**.’<sup>55</sup> Pra komplotoni kundër meje, të gjithë ju dhe mos ma shtyni afatin.<sup>56</sup> E kam besimin tim në **Allahun**, Zotin tim dhe Zotin tuaj. Nuk ka krijesë që lëviz të cilën nuk e kontrollon Ai<sup>a</sup>. Rruga e Zotit tim është e drejtë.’<sup>57</sup> Por nëse largoheni me refuzim, atëherë unë e kam komunikuar mesazhin me të cilin jam dërguar te ju dhe Zoti im do të sjellë popull tjetër në vendin tuaj. Nuk mund t’i bëni asnjë dëm Atij: është Zoti im ai që mbron gjithçka.’<sup>58</sup> Dhe kështu, kur ndodhi gjykimi Ynë, me mirësinë Tonë e shpëtuam Hudin dhe miqtë e tij besimtarë. I shpëtuam nga një ndëshkim i ashpër.<sup>59</sup> Këta ishin Ad-ët: i refuzuan shenjat e Zotit të tyre, nuk iu bindën të dërguarve Të Tij dhe e ndoqën urdhrin e çdo tirani kokëfortë.<sup>11:60</sup> Janë refuzuar në këtë jetë dhe po ashtu do të refuzohen në Ditën e Gjykimit. Po, Ad-ët e refuzuan Zotin e tyre – pra thyeni qafën Ad-ë, popull i Hudit!

<sup>61</sup> Themud-ëve, Ne ua dërguam vëllain e tyre, Salihun. Ai tha: ‘Populli im, adhurojeni **Allahun**. Nuk keni zot pos Tij. Ishte Ai që nga toka ju solli në qenie dhe ju bëri ta banoni atë, pra kërkoni falje nga Ai dhe kthehuni kah Ai: Zoti im është afër dhe i gatshëm të përgjigjet.’<sup>62</sup> Ata thanë: ‘Salih, kemi shpresuar kaq shumë në ty. A do të na e ndalosh ta adhurojmë atë që e kanë adhuruar etërit tanë? Jemi në dyshim shumë serioz në lidhje me atë që po kërkon ta bëjmë.’<sup>63</sup> Ai tha: ‘Populli im, veç mendoni: po të mos kisha provë të qartë nga Zoti im dhe po të mos më kishte dhënë Ai mëshirë nga E Tija, kush do të mund të më mbronte

---

<sup>a</sup> Fjalë për fjalë: ‘e mbërthen për flokët e saj të ballit’

nga **Allahu** po të mos i bindesha? Veç sa do ta bënit humbjen time më të madhe. <sup>64</sup> Populli im, kjo deve i përket Zotit, shenjë për ju, pra lëreni të kullojë në tokën e **Allahut** dhe mos e lëndoni, ndryshe do të ndëshkoheni së shpejti.’ <sup>65</sup> Por ata e gjymtuan, prandaj ai tha: ‘Shijojeni jetën<sup>a</sup> edhe për tri ditë: <sup>66</sup> ky paralajmërim nuk do të dalë i rremë.’ Dhe kështu, kur urdhri Ynë u përmbush, me mëshirën Tonë e shpëtuan Salihun dhe miqtë e tij besimtarë nga turpërimi i asaj dite. [Profet,] është Zoti yt që është I Forti, I Fuqishmi. <sup>67</sup> Shpërthimi i goditi keqbërësit dhe mbetën të vdekur në shtëpitë e tyre, <sup>68</sup> sikur të mos kishin jetuar dhe përparuar kurrë aty. Po, Themudët e refuzuan Zotin e tyre – pra thyeni qafën Themudë!

<sup>69</sup> Ibrahimit i sollën lajm të mirë të dërguarit Tanë. Thanë: ‘Paqe.’ Ai u përgjigj: ‘Paqe’ dhe pa vonesë e solli një viç të pjekur. <sup>11:70</sup> Kur e pa se duart e tyre nuk u zgjatën kah ushqimi, kjo iu duk e çuditshme dhe nisi të frikësohej nga ta. Por ata thanë: ‘Mos ki frikë. Jemi dërguar kundër popullit të Lutit.’ <sup>71</sup> Gruaja e tij po rrinte [afër] dhe qeshi. Ne i dhamë asaj lajmin e mirë për Isakun dhe, pas tij, për Jakubin. <sup>72</sup> Ajo tha: ‘E mjera unë! Si do të lind fëmijë kur jam grua e vjetër dhe burri im këtu është burrë i vjetër? Kjo do të ishte gjë e pazakonshme!’ <sup>73</sup> Ata thanë: ‘A jeni të mahnitur me atë që e urdhëron **Allahu**? Mirësia e **Allahut** dhe bekimet E Tij qofshin mbi ju, njerëz të kësaj shtëpie! Se Ai është i denjë për tërë lândin dhe admirimin.’ <sup>74</sup> Pastaj, kur Ibrahimit iu largua frika dhe i erdhi lajmi i mirë, na u lut Neve për popullin e Lutit, <sup>75</sup> se Ibrahimisi ishte i durueshëm, zemërdhembshur dhe i devotshëm. <sup>76</sup> ‘Ibrahim, ndale lutjen tënde: ajo që e ka urdhëruar Zoti yt ka ndodhur; po u vjen ndëshkimi, që nuk mund të kthehet mbrapsht.’

<sup>77</sup> Dhe kur të dërguarit Tanë erdhën te Luti, ai ishte i shqetësuar për ta, duke u ndier i pafuqishëm për t’i mbrojtur dhe tha: ‘Kjo është vërtet ditë e tmerrshme!’ <sup>78</sup> Populli i tij erdhën duke u vërsulur kah ai; zakonisht bënin vepra të turpshme. Ai tha: ‘Populli im, ja ku janë bijat e mija.<sup>b</sup> Ato janë më të dobishme për ju, pra kini ca frikë nga **Allahu** dhe mos më koritni me mysafirët e mi. A s’ka as edhe një njeri me mend ndërmjet jush?’ <sup>79</sup> Ata thanë: ‘Ti e di shumë mirë se nuk kemi të drejtë ndaj bijave tua. E di shumë mirë se çka duam.’ <sup>11:80</sup> Ai tha: ‘Ah veç ta kisha fuqinë t’ju ndal apo të mund të mbështetesh në përkrahje të fortë!’ <sup>81</sup> Ata [të dërguarit] thanë: ‘Lut, ne jemi të dërguarit e Zotit tënd. Ata nuk do të të zënë. Largohu me familjen tënde në pikë të natës dhe le të mos kthehet prapa asnjëri nga ju. Veç gruaja jote do ta vuajë fatin që u ndodh të tjerëve. Koha e tyre e caktuar është mëngjesi: a s’është mëngjesi afër?’ <sup>82</sup> Dhe kështu kur ndodhi ajo që Ne e patëm urdhëruar, ua kthyem përmbys qytetin dhe lëshuam mbi të shi të

---

<sup>a</sup> Fjalë për fjalë: ‘vazhdoni të jetoni në shtëpitë tuaja’.

<sup>b</sup> Disa komentues e interpretojnë këtë t’i referohet bijave të popullit të tij, në vend se bijave të vetë profetit.

gurëve të argjilës së pjekur, shtresë mbi shtresë,<sup>83</sup> të shenjuar nga Zoti yt. Nuk është larg nga keqbërësit.<sup>a</sup>

<sup>84</sup> Dhe Medjen-ëve, Ne ua dërguam vëllain e tyre Shuajbin. Ai tha: ‘Populli im, adhurojeni **Allahun**. Nuk keni zot tjetër pos Tij. Mos mashtroni në matje të gjatësisë as të peshës. E shoh se po përparoni, por kam frikë se do të keni torturë në një Ditë tronditëse.’<sup>85</sup> Populli im, me drejtësi, bëni matje të plotë të gjatësisë e të peshës. Mos ua hani hakun njerëzve dhe mos shpërndani korrupsion në tokë.<sup>86</sup> Ajo që zgjat me **Allahun** është më e mira për ju, në qofshi besimtarë: nuk jam kujdestari juaj.’<sup>87</sup> Ata thanë: ‘Shuajb, a të tregon lutja jote se duhet t’i braktisim ato që i kanë adhuroar stërgjyshërit tanë dhe të përmbahemi e të mos bëjmë çka të duam me pronën tonë? Në të vërtetë ti je njeri tolerant dhe i arsyeshëm.’<sup>88</sup> Ai u përgjigj: ‘Populli im, a s’mund ta shihni? Çka nëse po veproj sipas provës së qartë nga Zoti im? Ai Vetë më ka dhënë furnizim të mirë: nuk dua ta bëj atë që po jua ndaloj juve, veç po dua t’i rregulloj gjërat për aq sa mundem. Nuk mund t’ia dal pa ndihmën e **Allahut**: besoj në Të dhe gjithmonë i kthehem Atij.’<sup>89</sup> Populli im, mos e lejoni kundërshtinë tuaj ndaj meje të sjellë mbi ju fat të ngjashëm me popujt e Nuhut a të Hudit a të Salihut; populli i Lutit nuk janë shumë larg nga ju.<sup>b</sup> <sup>11:90</sup> Kërkoni falje nga Zoti juaj dhe kthehuni në pendim: Zoti im është mëshirëplotë dhe më i përzemërti.’

<sup>91</sup> Ata thanë: ‘Shuajb, nuk e kuptojmë shumicën e asaj që e thua dhe na dukesh shumë i dobët në mesin tonë. Po të mos ishte familja jote do të të gjuanim me gurë, se nuk ke status të madh ndër ne.’<sup>92</sup> Ai tha: ‘Populli im, a është në vlerësimin tuaj familja ime më e fortë se sa **Allahu**? Dhe a e keni vënë Atë prapa jush? Zoti im rrethon gjithçka që bëni.’<sup>93</sup> Populli im, bëni çkado që është në fuqinë tuaj dhe unë do të veproj njëjtë. Së shpejti do ta dini se kush do të marrë ndëshkim turpëruës dhe kush është rrenacak. Ruajuni dhe po kështu do të bëj edhe unë.’<sup>94</sup> Kur ndodhi ajo që Ne e patëm urdhëruar, në mëshirën Tonë e shpëtuam Shuajbin dhe miqtë e tij besimtarë, por një shpërthim i fuqishëm i goditi keqbërësit. Kah mëngjesi ata mbetën të vdekur në shtëpitë e tyre,<sup>95</sup> sikur të mos kishin jetuar dhe përparuar kurrë aty. Po, thyeni qafën popull i Medjenit, mu sikur Themudët!

<sup>96</sup> Ne e dërguam edhe Musain, me shenjat Tona dhe me autoritet të qartë,<sup>97</sup> te Faraoni dhe përkrahësit e tij, por ata i ndoqën urdhrat e Faraonit dhe urdhrat e Faraonit ishin në rrugë të gabuar.<sup>98</sup> Ai do të jetë në ballë të popullit të tij në Ditën e Ringjalljes, duke i udhëhequr ata teposhtë kah Zjarri. Në çfarë vendi të ndyrë për të pirë do t’i çojnë!<sup>99</sup> Ata i ka ndjekur refuzimi i **Allahut** në këtë jetë dhe do t’i ndjekë edhe në Ditën e Ringjalljes. Çfarë dhurate e pistë do t’u jipet!

---

<sup>a</sup> Ky qytet nuk është larg nga keqbërësit e Mekës, brenda fushëveprimit të tyre të tregtimit (shih 37:137-8), as ndëshkimi nuk është larg nga ta.

<sup>b</sup> Në kohë apo vend. Shih 7:85, 7:93.

<sup>11:100</sup> Ne t'i rrëfejme [Muhamed] përshkrimet e tilla të qyteteve të mëhershme: disa nga to janë ende duke qëndruar; disa janë shkatërruar masovikisht; <sup>101</sup> Ne nuk i kemi dëmtuar; ata e dëmtuan veten. Zotat e tyre, të cilët i thirrën pos **Allahut**, ishin të padobishëm për ta kur ndodhi ajo që e kishte urdhëruar Zoti yt; ata veç sa e rritën shkatërrimin e tyre. <sup>102</sup> I tillë është ndëshkimi i Zotit tënd për qytetet pikërisht gjatë mëkateve të tyre: ndëshkimi I Tij është i tmerrshëm dhe i ashpër. <sup>103</sup> Vërtet ka shenjë në këtë për këdo që i druhet ndëshkimit të Të Përtejmes. Ajo është një Ditë në të cilën të gjithë njerëzit do të mblidhen bashkë, Ditë që ta shohin të gjithë. <sup>104</sup> Ne po e vonojmë veç për një periudhë të caktuar, <sup>105</sup> dhe kur të vijë ajo Ditë, asnjë shpirt nuk do të flasë pos me leje Të Tij dhe disa nga ta do të jenë të mjerë e disa të lumtur. <sup>106</sup> Të mjerët do të jenë në Zjarr, duke ofsharë e rënkuar, <sup>107</sup> për të mbetur atje për aq kohë sa qëndrojnë qiejt e toka, pos nëse Zoti juaj vendos ndryshe: Zoti juaj zbaton çkado që vendos. <sup>108</sup> Sa u përket atyre që kanë qenë të bekuar, do të jenë në Parajsë, për të mbetur atje për aq kohë sa qëndrojnë qiejt e toka, pos nëse Zoti juaj vendos ndryshe – dhuratë e pandërprerë.<sup>a</sup>

<sup>109</sup> [Profet,] mos ki dyshim për atë që e adhurojnë këta njerëz: është thjesht ajo që e adhuroan etërit e tyre para tyre dhe Ne sigurisht do t'ua japim hisen e tyre plotësisht, pa ndonjë zvogëlim. <sup>11:110</sup> Ne ia dhamë Musait Librin e Shenjtë para teje, por dolën dallime për të dhe po të mos kish qenë një fjalë e mëparshme nga Zoti yt, tashmë do të ishte marrë një vendim ndërmjet tyre, edhe pse janë në dyshim shumë serioz për të. <sup>111</sup> Zoti yt do t'ua japë të gjithëve hakun e plotë për çkado që të kenë bërë: Ai është i informuar për gjithçka që bëjnë. <sup>112</sup> Pra mbahju drejtimit të duhur siç je urdhëruar, bashkë me ata që i janë kthyer **Allahut** me ty. Mos i tejkalo kufijtë, se Ai sheh gjithçka që ti bën. <sup>113</sup> Mos u mbështet në ata që bëjnë keq, ndryshe mund të t'prekë Zjarri dhe pastaj nuk do ta kesh askë të t'mbrojë nga **Allahu**, as s'do të ndihmohesh.

<sup>114</sup> [Profet,] vazhdo të falesh në të dy skajet e ditës dhe gjatë pjesëve të natës, se gjërat e mira i largojnë të këqijat – ky është kujtues për ata që janë të vetëdijshëm. <sup>115</sup> Ji i qëndrueshëm: **Allahu** nuk i lë të shkojnë kot shpërblimet e atyre që bëjnë mirë. <sup>116</sup> Ah po të kishte, ndër brezat para kohës sate, njerëz që u tepron arsyeja e shëndoshë, për ta ndaluar korrupsionin në tokë! Ne i shpëtuan veç ca nga ta, gjersa të padrejtët e ndoqën kënaqësinë e bollëkut dhe vazhduan njësoj në mëkat. <sup>117</sup> Zoti yt nuk do ta shkatërronte asnjë qytet pa shkak po të vepronte populli i tij ndershmërisht. <sup>118</sup> Po të kishte dashur Zoti yt, do t'i kishte bërë të gjithë popujt një komunitet të vetëm, por ata vazhdojnë t'i kenë dallimet e tyre – <sup>119</sup> përveç ata mbi të cilët ka mëshirë Zoti yt – se Ai i krijoi të jenë kështu

---

<sup>a</sup> Fjalë për fjalë: 'dhënie e pashkëputur'.

dhe fjala e Zotit tënd është përfundimtare: ‘Definitivisht Unë do ta mbushi Ferrin edhe me xhinde edhe me njerëz.’

<sup>11:120</sup> Pra [Muhamed], Ne t’i kemi treguar rrëfimet e profetëve për të ta bërë zemrën të qëndrueshme dhe në këto përshkrime të ka ardhur e vërteta, si dhe mësimet e kujtues për besimtarët. <sup>121</sup> Thuaju atyre që nuk besojnë: ‘Bëni çka të mundeni: edhe ne po bëjmë çka të mundemi’, <sup>122</sup> dhe ‘Pritni: edhe ne po presim.’ <sup>123</sup> Gjithçka që është e fshehur në qiej dhe në tokë i përket **Allahut** dhe tërë autoriteti<sup>a</sup> kthehet tek Ai. Pra [Profet], adhuroje Atë dhe kije besimin tënd në Të: Zoti yt nuk është kurrë i painformuar për atë që po e bëni [ju njerëz].

---

<sup>a</sup> Apo ‘të gjitha gjërat’

**Përshkrimi para kaptinës 11 nga Abdel Haleem:**

*Sure mekase e emëruar sipas profetit Hud rrëfimi i të cilit është dhënë në vargjet 50-60. Nis duke njoftuar se Profeti është dërguar edhe për të paralajmëruar edhe për të dhënë lajm të mirë dhe pjesa kryesore e sures përqendrohet në aspektin e paralajmërimit: **Allahu** mbikëqyr gjithçka dhe është i vetëdijshëm për të gjitha ato që i bëjnë njerëzit (vargjet 5-6, 111-12, 123). Po ashtu, shumë rrëfime të profetëve të shkuar, që shërbejnë për t'i paralajmëruar pabesimtarët, i japin zemër Profetit (vargu 120).*



## 12: Jusufi (JÛSUF)

Në emrin e Allahut, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës

<sup>1</sup> *Elif Lam Ra*

Këto janë shenjat e Shkrimit të Shenjtë që i qartësojnë gjërat – <sup>2</sup>Ne e kemi zbritur si Kuran arabik ashtu që [ju njerëz] të mund të kuptoni.

<sup>3</sup>Ne ta tregojmë [ty Profet] më të mirin nga rrëfimet në zbulimin e këtij Kurani për ty<sup>a</sup>. Para kësaj<sup>b</sup> ishte një nga ata që nuk dinin asgjë për ta. <sup>4</sup>Jusufi i tha të atit: ‘Baba, i pashë në ëndërr njëmbëdhjetë yje dhe diellin dhe hënën: i pashë të gjithë tek përkuleshin para meje’ <sup>5</sup>dhe ai u përgjigj: ‘Biri im, mos u trego vëllezërve tu asgjë për këtë ëndërr, përndryshe mund të komplotojnë për të t’dëmtuar – Satani është qartë armiku i betuar i njeriut. <sup>6</sup>Kjo ka të bëjë me atë se si Zoti yt do të të zgjedhë, të të mësojë t’i interpretosh ëndrrat dhe ta përsosë bekimin E Tij në ty dhe në Shtëpinë e Jakubit, ashtu siç e ka përsosur më herët në para-ardhësit e tu Ibrahimin dhe Is’hakun: Zoti yt është i gjithëdijsëm dhe i urtë.’

<sup>7</sup>Në rrëfimin e Jusufit dhe vëllezërve të tij ka mësim për të gjithë ata që i kërkojnë ato. <sup>8</sup>Vëllezërit [i] thanë [njëri-tjetrit], ‘Edhe pse ne jemi shumë, Jusufi dhe vëllai i tij janë më të dashur për babanë tonë se sa ne – babai ynë është qartë gabim.’ <sup>9</sup>[Njëri nga ta tha:] ‘Vriteni Jusufin apo dëbojeni në tokë tjetër dhe vëmendja e babait tuaj do të jetë e lirë të kthehet kah ju. Pas kësaj mund të jeni të ndershëm.’ <sup>12:10</sup>[Një tjetër] tha: ‘Mos e vrisni Jusufin, por, nëse është patjetër, hidheni në thellësitë e fshehta të një bunari ku mund ta nxjerrë ndonjë karvan.’

<sup>11</sup>Ata i thanë të atit: ‘Pse nuk na zë besë në lidhje me Jusufin? Ne ia duam të mirën. <sup>12</sup>Dërgoje nesër me ne të kënaqet e të luajë – do të kujdesemi mirë për të.’ <sup>13</sup>Ai u përgjigj: ‘Më brengos mendimi që ju ta merrni me vete: kam frikë se mund ta hajë ndonjë ujk teksa nuk i kushtoni vëmendje.’ <sup>14</sup>Ata thanë: ‘Po të mund ta hante ndonjë ujk kur ne jemi kaq shumë, vërtet do të ishim dështakë!’

<sup>15</sup>Pastaj kur e morën me vete, vendosën ta gjuajnë në thellësitë e fshehta të një bunari (pusi) – Ne e frymëzuam, duke i thënë: ‘Do t’u tregosh për krejt këtë [dikur] kur të mos e kuptojnë [se kush je]!’ – <sup>16</sup>dhe në muzg u kthyen tek i ati duke qarë. <sup>17</sup>Thanë: ‘Baba, nisëm të garojmë mes vete, duke e lënë Jusufin prapa me gjërat tona dhe një ujk e hëngri! Nuk do të na zësh besë, edhe pse po e tregojmë të vërtetën!’ <sup>18</sup>dhe ia treguan këmishën e tij, të njollosur dinakërisht me

---

<sup>a</sup> Shumë përkthyes e shtojnë ‘ndonëse’ (‘...ta kemi frymëzuar në këtë Kuran, ndonëse para kësaj...’), duke menduar se *in* është kushtëzues, kur në fakt këtu është për të vënë theks, siç konfirmohet edhe nga *lam* vijues theksues.

<sup>b</sup> Krahaso me 11:49 dhe 42:52.

gjak të rremë. Ai klithi: ‘Jo! Shpirtrat tuaj ju kanë nxitur të bëni keq! Por më së miri është të jem i durueshëm: veç nga **Allahu** kërkoj ndihmë për ta duruar dhimbjen e kësaj që po e thoni.’

<sup>19</sup> Erdhi një karvan. E çuan dikë të nxjerrë ujë dhe ai e lëshoi kovën e tij. ‘Lajm i mirë!’ bërtiti. ‘Qenka një djalë!’ E fshehën si artikull të mallrave – **Allahu** ishte krejt në dijeni për atë që e bënë – <sup>12:20</sup> dhe pastaj e shitën për një çmim të vogël, disa monedha argjendi: kaq pak e vlerësuan.

<sup>21</sup> Egjiptiani që e bleu i tha të shoqes: ‘Kujdesu mirë për të! Mund të jetë i dobishëm për ne, apo mund ta birësojmë.’ Dhe kështu Ne e sistemuam Jusufin në atë tokë dhe më vonë e mësuam si t’i shpjegojë ëndrrat: **Allahu** gjithmonë ka kontroll të plotë ndaj çështjeve, por shumica e njerëzve nuk e dinë.

<sup>22</sup> Kur e arriti pjekurinë, Ne i dhamë urtësi gjykuese dhe dije: kështu i shpërblejmë ata që bëjnë mirë. <sup>23</sup> Gruaja në shtëpinë e së cilës po jetonte, provoi ta joshte: ua vuri shulin dyerve dhe tha: ‘Eja tek unë’ dhe ai u përgjigj: ‘Ruana Zot! Kërkoj strehë te **Allahu**, Ai është Zoti im, Ai ma ka bërë të mirë qëndrimin; keqbërësit nuk përparojnë kurrë’. <sup>24</sup> Ajo iu afrua dhe ai do t’i jepej po të mos kish parë dëshmi të Zotit të tij – Ne e bëmë këtë që t’ia mbajmë larg të keqen dhe paturpësinë, se ishte vërtet njëri nga shërbyesit Tanë besnikë. <sup>25</sup> Dhe ndërsa vrapuan kah dera, ajo ia shqeu këmishën nga prapa dhe te dera e gjetën burrin e saj fisnik. Ajo tha: ‘Çka, pos burgut apo ndëshkimit të dhembshëm, do të duhej të ishte shpërblimi për dikë që provoi të ta çnderojë familjen?’ <sup>26</sup> por ai tha: ‘Ishte ajo që provoi të më joshte.’ Një anëtar i familjes së saj sugjeroi: ‘Nëse kjo këmishë është shqyer përpara, atëherë ajo po e tregon të vërtetën dhe ai po rren, <sup>27</sup> por nëse është shqyer nga prapa, atëherë ajo po rren dhe ai po e tregon të vërtetën.’ <sup>28</sup> Kur burri e pa se këmisha ishte shqyer prapa, tha: ‘Kjo është nga intrigat tua femërore, intriga jote femërore është vërtet e madhe. <sup>29</sup> Jusuf, injoroje këtë; dhe ti [grua], kërko falje për mëkatin tënd – ke bërë keq.’

<sup>12:30</sup> Disa gra të qytetit thanë: ‘Gruaja e qeveritarit po mundohet ta joshë të riun e saj! Dashuria për të po ia djeg zemrën! Është e qartë se ka devijuar.’ <sup>31</sup> Kur ajo dëgjoji për fjalët e tyre të liga, e përgatiti një gosti dhe i ftoi, duke ia dhënë secilës nga një thikë. I tha Jusufit, ‘Dil dhe shfaqju atyre!’ dhe kur gratë e panë, u tronditën nga bukuria e tij dhe i prenë duart e tyre, duke bërtitur: ‘Lavduar qoftë **Allahu**! Ky nuk është njeri, por engjëll i bekuar!’ <sup>32</sup> Ajo tha: ‘Ky është ai për të cilin më keni fajësuar. E kam joshur por donte të mbetej i delirë. Nëse nuk e bën atë që e urdhëroj, do të futet në burg dhe do të përbuzet.’ <sup>33</sup> Jusufi tha: ‘Zoti im! Për mua është më i mirë burgu se sa kjo që po më kërkojnë ta bëj. Dhe nëse Ti nuk më mbron nga intriga e tyre, do t’u jepem dhe do të bëj keq,’ <sup>34</sup> dhe Zoti i tij iu përgjigj lutjes së tij dhe e mbrojti nga intriga e tyre – Ai është Gjithëdëgjuesi, Gjithëditësi.

<sup>35</sup> Në fund atyre<sup>a</sup>, edhe pasi i panë të gjitha shenjat e çiltërsisë së tij, më së miri iu duk ta burgosnin për ca kohë. <sup>36</sup> Dhe me të në burg hynë edhe dy djelmosha. Njëri nga ta tha: ‘Kam parë ëndërr se shtypja kokrra rrushi’; tjetri tha: ‘Kam parë ëndërr se në kokë bartja bukë dhe se e hanin zogjtë.’ [Ata thanë]: ‘Tregona çka domethënë kjo – po e vërejmë se je njeri i ditur.’<sup>b</sup>

<sup>37</sup> Ai tha: ‘Mund t’ju them se çka domethënë kjo para se të arrijë ndonjë racion i ushqimit: kjo është pjesë e asaj që ma ka mësuar Zoti im. E refuzoj besimin e atyre që nuk besojnë në **Allahun** dhe e mohojnë jetën tjetër, <sup>38</sup> dhe e ndjek besimin e para-ardhësve të mi Ibrahimit, Is’hakut dhe Jakubit. Për shkak të mirësisë së **Allahut** ndaj nesh dhe tërë njerëzimit, nuk do të adhuronim asgjë krahas **Allahut**, por shumica e njerëzve janë mosmirënjohës. <sup>39</sup> Miq të qelisë, a do të ishin shumë zota të lloj-llojshëm më të mirë se **Allahu** që është Një, I Gjithë-Fuqishmi? [Jo, në fakt!] <sup>12:40</sup> Të gjitha ato që i adhuronin në vend Të Tij janë emra të thjeshtë që i keni shpikur ju dhe para-ardhësit tuaj, emra për të cilët **Allahu** nuk ka zbritur kurrfarë leje. Autoriteti i takon veç **Allahut** dhe Ai urdhëron të mos e adhuronin askë pos Tij: ky është besimi i vërtetë, megjithëse shumica e njerëzve nuk e kuptojnë. <sup>41</sup> Miq të qelisë, njëri nga ju do ta shërbejë padronin e tij me verë, ndërsa tjetri do të kryqëzohet dhe zogjtë do të hanë nga koka e tij. Ky është konkluzioni i çështjes për të cilën ma kërkua mendimin.’ <sup>42</sup> Dhe i tha atij që ia merrte mendja se do të shpëtonte: ‘Më përmend te padroni yt,’ por Satani e bëri të harrojë t’ia përmendë padronit dhe kështu Jusufi mbeti në burg edhe për disa vite.

<sup>43</sup> Mbreti tha: ‘I kam parë në ëndërr shtatë lopë të majme duke u ngrënë nga shtatë të dobëta dhe shtatë kallinj të gjelbër dhe [shtatë] të tjerë të tharë. Këshilltarë, nëse mund t’i shpjegoni ëndrrat, tregomani kuptimin e ëndrrës sime.’ <sup>44</sup> Ata thanë: ‘Këto janë ëndrra ngatërruese dhe nuk jemi të shkathtë në interpretim të ëndrrave,’ <sup>45</sup> por i burgosuri që u pat liruar më në fund u kujtua [për Jusufin] dhe tha: ‘Unë do t’ju tregoj se çka domethënë kjo. Më jepni leje të shkoj.’

<sup>46</sup> ‘Jusuf i singertë! Na e trego kuptimin e shtatë lopëve të majme që hahen nga shtatë të dobëta dhe të shtatë kallinjve të gjelbër dhe [shtatë] të tjerëve të tharë, <sup>47</sup> pastaj mund të kthehem te populli t’i informoj.’ Jusufi tha: ‘Do të mbillni për shtatë vite me radhë si zakonisht. Vendoseni në depo tërë atë që e korrni, të lënë në kalli, pos asaj pak që e hani. <sup>48</sup> Pas kësaj do të vijnë shtatë vite të vështira që do t’i harxhojnë të gjitha ato që i keni mbjellë pos ato që i keni ruajtur; <sup>49</sup> pas kësaj do të vijë një vit kur njerëzit do të kenë shi të begatshëm dhe do të mund shtypin rrush.’

---

<sup>a</sup> Qeveritarit dhe familjes së tij

<sup>b</sup> Razi e jep këtë interpretim për *muhsinin*.

<sup>12:50</sup> Mbreti tha: ‘Ma sillni’, por kur korrieri erdhi ta marrë Jusufin, ai tha: ‘Kthehu te padroni yt dhe pyete për atë se çka u ndodhi atyre grave që i prenë duart e tyre – Zoti im i di të gjitha për tradhtinë e tyre.’ <sup>51</sup> Mbreti i pyeti gratë: ‘Çka ndodhi kur u munduat ta joshnit Jusufin?’ Ato thanë: ‘**Allah** ruana! Nuk dimë asgjë të keqe për të!’ dhe gruaja e qeveritarit tha: ‘Tash e vërteta doli në shesh: isha unë ajo që u mundova ta josh – ai është njeri i ndershëm.’ <sup>52</sup> [Jusufi tha: ‘Kjo ishte] për padronin tim që ta dijë se nuk e kam tradhtuar pas shpinës: **Allahu** nuk i udhëzon dinakëritë e tradhtarëve. <sup>53</sup> Nuk pretendoj se jam i pafajshëm, se vetë shpirti i njeriut e nxit kah e keqja nëse Zoti im nuk tregon mëshirë: Ai është më falësi, më mëshirëploti.’

<sup>54</sup> Mbreti tha: ‘Ma sillni: do të më shërbejë personalisht,’ dhe pastaj, pasi kishte folur me të: ‘Prej tash e tutje e ke besimin dhe favorin tonë.’ <sup>55</sup> Jusufi tha: ‘Më bëj përgjegjës për depot kombëtare të drithit: do t’i administroj kursyeshëm dhe me kujdes.’ <sup>56</sup> Kështu Ne e sistemua Jusufin në atë vend, për të jetuar ku të donte: Ne ia dhurojmë mëshirën Tonë kujtdo që ia dhurojmë dhe nuk dështojmë t’i shpërblejmë ata që bëjnë mirë. <sup>57</sup> Shpërblimi i Të Përtejmes është më i mirë për ata që besojnë dhe janë të vetëdijshëm për **Allahun**.

<sup>58</sup> Vëllezërit e Jusufit erdhën dhe u shfaqën para tij. Ai i njohu – megjithëse ata nuk e njohën – <sup>59</sup> dhe pasi ua dha furnizimet e tyre, tha: ‘Ma sillni vëllain tuaj [që e keni lënë me] babanë tuaj!<sup>a</sup> A nuk po e shihni si po ju jap porcion të bollshëm dhe si po jam më i miri nga nikoqirët? <sup>12:60</sup> Nëse nuk ma sillni, nuk do të keni më drithë nga unë dhe nuk do të lejoheni të më afroheni.’ <sup>61</sup> Ata thanë: ‘Do të bëjmë çmos për ta bindur babanë e tij ta dërgojë atë me ne, vërtet do ta bëjmë.’ <sup>62</sup> Jusufi u tha shërbyesve të tij: ‘Ktheni mallrat e tyre [të shkëmbyera] në torbat e tyre, që të mund t’i njohin kur të kthehen në familjen e tyre dhe [të jenë të etur] të kthehen.’

<sup>63</sup> Kur u kthyen tek i ati i tyre, thanë: ‘Baba, nuk do të na japin më drithë, po çoje vëllain tonë prapa me ne dhe do të na jepet edhe një porcion me drithë. Do ta ruajmë me kujdes.’ <sup>64</sup> Ai tha: ‘A t’jua lë në besë siç bëra me Jusufin më parë? **Allahu** është ruajtësi më i mirë dhe Më Mëshirëploti nga mëshirëplotët.’ <sup>65</sup> Pastaj, kur i hapën pakot e tyre, e zbuluan se u ishin kthyer mallrat dhe thanë: ‘Baba! Nuk na duhen më [mallra për shkëmbim]<sup>b</sup>: shiko, mallrat tona na qenkan kthyer. Do ta marrim drithin për familjen tonë; do ta ruajmë vëllain tonë; do të na takojë edhe një barrë-deve e porcionit të drithit – porcion shtesë i arritur kaq lehtë!’ <sup>66</sup> Ai tha: ‘Nuk do ta dërgoj kurrë me ju, jo pa u betuar në **Allahun** se do të ma ktheni nëse kjo është e mundur njerëzisht.’ <sup>c</sup> Pastaj, kur ia dhanë zotimin e tyre, tha: ‘Fjalët tona i janë besuar **Allahut**.’ <sup>67</sup> Tha: ‘Bijtë e mi, mos hyni të gjithë

---

<sup>a</sup> Apo atë që e keni vëlla vetëm nga babai (Benjaminin)

<sup>b</sup> Ky kuptim i frazës *ma nabghi* përkrahet nga Razi.

<sup>c</sup> Fjalë për fjalë, ‘pos nëse jenë të rrethuar plotësisht’. Razi sugjeron nga vdekja apo nga armiku.

nëpër një portë – përdorni porta të ndryshme. Por nuk mund t’ju ndihmoj kundër vullnetit të **Allahut**: tërë pushteti është në duart e **Allahut**. Kam besim në Të; le të kenë besim të gjithë në Të,<sup>68</sup> dhe, kur hynë siç u pat thënë i ati, kjo nuk u ndihmoi kundër vullnetit të **Allahut**, thjesht e plotësoi një dëshirë të Jakubit. Ai e dinte mirë se çka e patëm mësuar Ne, megjithëse shumica e njerëzve nuk e dinë.

<sup>69</sup> Pastaj, kur u shfaqën para Jusufit, ai e veçoi vëllain e tij<sup>a</sup> dhe i tha: ‘Unë jam vëllai yt, kështu që mos u pikëllo nga veprat e tyre të shkuara,’<sup>12:70</sup> dhe, pasi ua dha furnizimet e tyre, e futi gotën e pijes në torbën e vëllait të tij. Një njeri bërtiti: ‘Njerëz të karvanit, ju qenkeni hajna!’<sup>71</sup> dhe ata u kthyen e thanë: ‘Çka ju ka humbur?’<sup>72</sup> Ata u përgjigjën: ‘Gota e mbretit po mungon,’ dhe ‘Kushdo që e kthen do ta fitojë një barrë-deve [të drithit],’ dhe: ‘Jua jap fjalën time.’<sup>73</sup> Ata thanë: ‘Për **Allahun!** Duhet ta dini se nuk kemi ardhur të bëjmë ligësi në vendin tuaj: nuk jemi hajna.’<sup>74</sup> Ata i pyetën: ‘E nëse e zbulojmë se po rreni, çfarë ndëshkimi t’jua japim?’<sup>75</sup> dhe ata u përgjigjën: ‘Ndëshkimi do të jetë [robërimi i] personit në çantën e të cilit gjendet gota: kështu i ndëshkojmë keqbërësit.’<sup>76</sup> [Jusufi] nisi t’i hallakasë çantat e tyre, pastaj të vëllait të tij dhe e nxori nga çanta e të vëllait.

Kështu Ne e bëmë një plan për Jusufin – po të mos donte **Allahu**, ai nuk do të mund ta mbante në arrest të vëllain si ndëshkim nën ligjin e mbretit – Ne ia rrisim gradën kujt do që ia rrisim. Mbi secilin që ka dije është Ai që është i gjithëdijshtëm.

<sup>77</sup> [Vëllezërit e tij] thanë: ‘Nëse ai është hajn atëherë vëllai i tij ishte hajn para tij,’ por Jusufi i mbajti të fshehtat e tij dhe nuk u zbuloi asgjë. Tha: ‘Jeni në pozitë shumë më të keqe. **Allahu** e di më së miri të vërtetën e asaj që po e pohoni.’<sup>78</sup> Ata thanë: ‘Qeveritar i fuqishëm, ai e ka babanë të shtyrë në moshë. Merre njërin nga ne në vend të tij. Po e shohim se je njeri shumë i mirë.’<sup>79</sup> Ai u përgjigj: ‘**Allah** ruana, ta marrim dikë tjetër e jo personin tek i cili e gjetëm pronën tonë: kjo do të ishte e padrejtë nga ne.’<sup>12:80</sup> Kur e humbën shpresën për [ta bindur] atë, u tërhoqën të këshilloheshin me njëri-tjetrin: më i vjetri nga ta tha: ‘A nuk po ju kujtohet që babai juaj mori betim solemn nga ju në emër të **Allahut** dhe para kësaj dështuat në obligimin tuaj në lidhje me Jusufin? Nuk do ta lëshoj këtë vend deri sa babai im të më japë leje apo **Allahu** të vendosë për mua – Ai është vendosësi më i mirë –<sup>81</sup> pra kthehuni te babai i juaj dhe thoni: ‘Djali yt vodhi. Mund të të tregojmë veç çka pamë. Si mund të ruajmë kundër të

---

<sup>a</sup> Fjalë për fjalë, ‘e akomodoi’ apo ‘e mori si mysafir’. Disa e interpretojnë këtë si sugjerim që vëllezërve u janë ofruar dhoma në çifte dhe Benjaminit, si tek që ka mbetë vetëm, i është dhënë dhoma me Jusufin; një sugjerim tjetër është se dy vëllezërit e plotë (Jusufi dhe Benjamin) kanë darkuar bashkë; në cilindo variant sensi është se Jusufi e veçoi Benjaminin nga të tjerët.

paparashikuarës? <sup>82</sup> Pyet në qytetin ku kemi qenë; pyeti njerëzit e karvanit me të cilin udhëtuam: po e tregojmë të vërtetën.” ’

<sup>83</sup> Babai i tyre tha: ‘Jo! Shpirtrat tuaj ju kanë tunduar të bëni keq! Por më së miri është të jem i duruar: **Allahu** m’i ktheftë të gjithë<sup>a</sup> – Ai është I Gjithëdijshmi, I Gjithurti,’ <sup>84</sup> dhe ua ktheu shpinën, duke thënë: ‘I mjeri Jusuf!’ Sytë iu zbardhën me pikëllim dhe u mbush me ankth. <sup>85</sup> Ata thanë: ‘Pashë **Allahun!** Do ta shkatërrosh shëndetin nëse nuk ndalesh së menduari për Jusufin, ose edhe do të vdesësh!’ <sup>86</sup> Ai tha: ‘E parashtraj pikëllimin dhe dhimbjen time para **Allahut**. Kam dije nga **Allahu** që ju nuk e keni. <sup>87</sup> Bijtë e mi, shkoni dhe kërkoni lajme për Jusufin dhe vëllain e tij dhe mos e humbni shpresën për mëshirën e **Allahut** – veç pabesimtarët e humbin shpresën për mëshirën e **Allahut**.’

<sup>88</sup> Pastaj, kur u shfaqën para Jusufit, thanë: ‘Qeveritar i pushtetshëm, mjerimi na ka bërë vrer neve dhe familjen tonë. Kemi sjellë veç pak mallra, por na jep porcion të plotë. Ji bamirës ndaj nesh: **Allahu** i shpërblen bamirësit.’ <sup>89</sup> Ai tha: ‘A po e kuptoni tash se çka i bëtë Jusufit dhe vëllait të tij kur ishit të paditur?’ <sup>12:90</sup> dhe ata klithën: ‘A është e mundur që ti je Jusufi?’ Ai tha: ‘Unë jam Jusufi. Ky është vëllai im. **Allahu** ka qenë dashamirës ndaj nesh: **Allahu** nuk ia refuzon askujt që është i vetëdijshëm për **Allahun** dhe i qëndrueshëm në fatkeqësi shpërblimet e atyre që bëjnë mirë.’ <sup>91</sup> Ata thanë: ‘Për **Allahun!** **Allahu** vërtet ju ka përkrahur ndaj neve të gjithëve dhe ishim gabim!’ <sup>92</sup> por ai tha: ‘Nuk do të dëgjoni qortime sot. **Allahu** ju faltë: Ai është Më Mëshirëploti nga mëshirëplotët. <sup>93</sup> Merreni këmishën time dhe shtrijeni mbi fytyrën e babait tim: do t’i kthehet të pamurit. Pastaj merreni tërë familjen tuaj tek unë.’

<sup>94</sup> Më vonë, kur karvani u nis, babai i tyre tha: ‘Mund të mendoni se jam matufosur por mund t’ia ndjej erën Jusufit,’ <sup>95</sup> por [njerëzit] thanë: ‘Për **Allahun!** Ende je i humbur në atë iluzionin tënd të vjetër!’ <sup>96</sup> Pastaj, kur bartësi i lajmit të mirë erdhi dhe e vuri këmishën mbi fytyrën e Jakubit, të pamurit iu kthye dhe tha: ‘A nuk ju thashë se kam dije nga **Allahu** që ju nuk e keni?’ <sup>97</sup> [Vëllezërit] thanë: ‘Baba, kërk falje për mëkatet tona – ishim vërtet gabim.’ <sup>98</sup> Ai u përgjigj: ‘Do t’i lutem Zotit tim t’ju falë: Ai është Më Falësi, Më Mëshirëploti.’

<sup>99</sup> Më vonë, kur u paraqitën te Jusufi, ai i afrooi prindërit e tij dhe tha: ‘Mirë se vini në Egjipt: të gjithë do të jeni të sigurt këtu, dhashtë **Allahu**’ – <sup>12:100</sup> dhe i mori lart te froni [i tij]. Të gjithë u përkulën para tij dhe ai tha: ‘Baba, kjo është përmbushja e asaj ëndrrës që e kam parë dikur moti. Zoti im e ka përmbushur dhe ka qenë dashamirës ndaj meje – Ai më liroi nga burgu dhe ju solli këtu nga shkretëtira – pasi Satani mbolli përçarje mes meje dhe vëllezërve të mi. Zoti im është më subtili në arritjen e asaj që do ta arrijë; Ai është I Gjithëdijshmi, Vërtet I Urti. <sup>101</sup> Zoti im! Ti më ke dhënë autoritet; më ke mësuar diçka për

---

<sup>a</sup> Razi sugjeron për Jusufin, Benjaminin dhe djalin më të vjetër që pat mbetur në Egjipt.

interpretimin e ëndrrave; Krijues i qiejve dhe i tokës, je mbrojtësi im në këtë botë dhe në Të Përtejmen. Më lejo të vdes në përkushtim të plotë ndaj Teje. Më bashko me të ndershmit.’

<sup>102</sup> Këto shpjegime janë pjesë e asaj që ishte përtej dijes sate [Muhamed]. Ne t’i shpallëm: nuk ishe i pranishëm me vëllezërit e Jusufit kur i bënë planet e tyre tradhtarë. <sup>103</sup> Sado të flaktë ta kesh merakun, shumica e njerëzve nuk do të besojnë. <sup>104</sup> Ti nuk u kërkon kurrfarë shpërblimi për këtë: është veç kujtues për të gjithë njerëzit, <sup>105</sup> dhe ka shumë shenja në qiej dhe në tokë që i shpërfillin dhe nuk u kushtojnë vëmendje – <sup>106</sup> shumica nga ta do të besojnë në **Allah** gjersa i bashkangjesin edhe të tjerë Atij. <sup>107</sup> A janë kaq të sigurt që nuk do të bjerë mbi ta një ndëshkim tronditës nga **Allahu**, apo se nuk do t’u vijë befasi Ora e Fundit kur e presin më së paku? <sup>108</sup> Thuaj: ‘Kjo është rruga ime: duke u bazuar në evidencë të qartë, unë dhe të gjithë ata që më ndjekin [i] ftojnë [njerëzit] te **Allahu** – lëndi qoftë për **Allahun!** – unë nuk bashkoj të tjerë me Të.’

<sup>109</sup> Të gjithë të dërguarit që Ne i kemi çuar para teje [Muhamed] ishin njerëz të cilëve u kemi dhënë shpallje, njerëz të zgjedhur nga populli i qyteteve të tyre. A nuk kanë udhëtuar [pabesimtarët] nëpër vend dhe ta kenë parë fundin e atyre që shkuan para tyre? Për ata që janë të vetëdijshëm për **Allahun**, Shtëpia në Të Përtejmen është më e mirë. A nuk e përdorni arsyen [ju njerëz]? <sup>12:110</sup> Kur të dërguarit e humbnin tërë shpresën dhe e kuptonin se janë përjashtuar si gënjeshtarë, u vinte ndihma Jonë: Ne e shpëtonim këdo që donim, por ndëshkimi Ynë nuk do të largohet nga njerëzit fajtorë. <sup>111</sup> Është një mësim në rrëfimet e njerëzve të tillë për ata që kuptojnë. Kjo shpallje nuk është trillim: është konfirmim i të vërtetës së asaj që ishte dërguar para saj; shpjegim i gjithçkaje<sup>a</sup>; udhërrëfyes dhe bekim për ata që besojnë.

---

<sup>a</sup> Janë dy interpretime të kësaj fraze: (i) ‘të gjitha gjërat në lidhje me rrëfimin e Jusufit’; dhe (ii) ‘të gjitha gjërat në lidhje me fenë’.

**Përshkrimi para kaptinës 12 nga Abdel Haleem:**

*Sure mekase që merret kryesisht me rrëfimin e Jusufit, por e kornizuar nga një hyrje tri-vargëshe për Kuranin dhe një epilog dhjetë-vargësh për përgjigjen e mekasve, ndëshkimin e marrë nga pabesimtarët e mëhershëm dhe inkurajimin për Profetin.*



## 13: Bubullima (ER-RA'D)

Në emrin e **Allahut**, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës

<sup>1</sup> *Elif Lam Ra*

Këto janë shenja të Librit të Shenjtë. Ajo që [ty Profet] ta ka zbritur **Allahu** është e vërteta, e prapë shumica e njerëzve nuk besojnë. <sup>2</sup> Është **Allahu** Ai që i ngriti qiejt pa shtylla të dukshme dhe pastaj u vendos në fron; Ai ka shkaktuar që edhe dielli edhe hëna ta ndjekin shtegun e tyre për një kohë të caktuar; Ai e kontrollon funksionimin e të gjitha gjërave dhe i bën shpalljet të qarta ashtu që të mund të jeni të sigurt se do ta takoni Zotin tuaj; <sup>3</sup> është Ai që e shtriu tokën, vendosi male të qëndrueshme dhe lumenj në të dhe i bëri dy nga çdo lloj i frutit; Ai e tërheq vellon e natës mbi ditën. Vërtet ka shenja në këtë për njerëzit që reflektojnë. <sup>4</sup> Ka, në dhé, ngastra fqinje, kopshte me vreshta, fusha të misrit, pemë të palmës në tufa apo ndryshe, të gjitha të ujitura me ujin e njëjtë, e prapë Ne i bëjmë disa nga to të kenë shije më të mirë sesa të tjerat: vërtet ka shenja në këtë për njerëzit që reflektojnë.

<sup>5</sup> Nëse mund të të mahnisë diçka, [Profet,] çkado qoftë, atëherë sigurisht do të duhej të mahniteshe kur pyesin: 'Çka? Kur të bëhemi pluhur, a do të krijohemi rishtas?' Këta janë ata që e mohojnë Zotin e tyre, që do të mbajnë qafore të vargonjta rreth qafës së tyre dhe do të jenë banorë të Zjarrit, për të mbetur aty. <sup>6</sup> Ata të kërkojnë ta shkaktosh ndëshkimin në vend se ndonjërin nga shpërblimet e premtuara, edhe pse ka pasur shumë shembuj para tyre – Zoti yt është plot falje për njerëzit, përkundër keqbërjes së tyre, por është vërtet i ashpër në ndëshkim. <sup>7</sup> Pabesimtarët thonë: 'Pse s'i është zbritur asnjë mrekulli nga Zoti i tij?' Por ti je aty veç për të paralajmëruar: komunitetet [e mëhershme] e kishin secili udhërrëfyesin e tij.

<sup>8</sup> **Allahu** e di se çka mbart çdo femër dhe se sa tkurren apo zgjerohen mitrat e tyre – gjithçka e ka masën e vet me Të; <sup>9</sup> Ai e di atë që nuk shihet si dhe atë që shihet; Ai është I Madhi, Më I Larti. <sup>13:10</sup> Nuk ka rëndësi a flisni cilido nga ju fshehtas apo me zë të lartë, a po fshiheni nën mbulesën e natës apo po ecni vërdallë gjatë ditës: <sup>11</sup> secili person ka engjëj mbrojtës para tij dhe prapa, duke e ruajtur sipas urdhrin të **Allahut**. **Allahu** nuk e ndryshon gjendjen e një populli [për të keq]<sup>a</sup> pos nëse e ndryshojnë atë që është në ta, por nëse Ai dëshiron t'i bëjë dëm një populli, askush s'mund t'i shmanget – pos Tij, nuk kanë mbrojtës.

<sup>12</sup> Është Ai që jua shfaq vetëtimën, duke frymëzuar frikë e shpresë; Ai i ndërton retë duke i rënduar me shi; <sup>13</sup> bubullima i prodhon himnet E Tij, siç

---

<sup>a</sup> Krahaso me 8:53; 16:112.

bëjnë engjëjt në admirim të madh për Të; Ai dërgon rrufe për ta goditur këdo që do ta godasë. E prapë kanë mospajtim rreth **Allahut** – Ai ka plane të fuqishme.<sup>14</sup> E vetmja lutje e vërtetë është ajo që i bëhet Atij: ata të cilëve u luten përveç Tij u japin përgjigje jo më shumë se uji që e arrin gojën e dikujt i cili veç i zgjat duart për të – ai nuk mund ta bëjë këtë: lutjet e pabesimtarëve krejt shkojnë kot.<sup>15</sup> Krejt ato që janë në qiell dhe në tokë i jepen<sup>a</sup> veç **Allahut**, me qejf apo pa qejf, siç bëjnë hijet e tyre në mëngjese dhe në mbrëmje.

<sup>16</sup> Thuaj [Profet]: ‘Kush është Zoti i qiejve dhe i tokës?’ Thuaj: ‘**Allahu.**’ Thuaj: ‘Pse merrni mbrojtës të tjerë e jo Atë, të cilët as s’mund të bëjnë mirë as dëm madje as vetes?’ Thuaj: ‘A janë të verbrit të barabartë me ata që mund të shohin? Dhe a janë thellësitë e errësirës të barabarta me dritën?’ A kanë krijuar partnerët – që ia atribuojnë **Allahut** – çkado qoftë të ngjashme me krijimin E Tij ashtu që krijimi i tyre të jetë i padallueshëm nga I Tij? Thuaj: ‘**Allahu** është Krijuesi i të gjitha gjërave: Ai është *Ai*, Gjithë-Imponuesi.’<sup>17</sup> Ai e dërgon ujin nga qielli që i mbush shtretërit e lumenjve deri kur tejmbushen, secili sipas masës së tij. Rrjedha e bart në sipërfaqen e saj një shtresë të shkumës që rritet vazhdimisht, si shkuma që shfaqet kur njerëzit i shkrijnë metalet në zjarr për të bërë stoli dhe mjete: në këtë mënyrë **Allahu** e ilustron të vërtetën dhe pavërtetësinë – shkuma zhduket, por ajo që është për të mirën e njeriut mbetet prapa – kështu jep ilustrime **Allahu**.<sup>18</sup> Më të mirat nga shpërblimet do të jenë për ata që i përgjigjen Zotit të tyre; ata që nuk i përgjigjen do ta falnin me qejf dy herë përmbajtjen e tokës, po ta kishin, për ta paguar çlirimin e tyre, kaq i tmerrshëm do të jetë vlerësimi për ta. Ferri do të jetë shtëpia e tyre dhe i mjeruar shtrati i tyre.

<sup>19</sup> A mund të jetë dikush që e di se shpallja nga **Allahu** juaj është E Vërteta – i barabartë me dikë që është i verbër? Veç ata me aftësi për të kuptuar do ta mendojnë seriozisht këtë; <sup>13:20</sup> ata që i përmbushin marrëveshjet që i bëjnë në emër të **Allahut** dhe nuk i shkelin zotimet e tyre; <sup>21</sup> që i shoqërojnë bashkë ato që **Allahu** urdhëron të shoqërohen; ata që janë në admirim për Zotin e tyre dhe i druhen ashpërsisë së Vlerësimi; <sup>22</sup> që mbahen të qëndrueshëm për shkak të merakut për fytyrën e Zotit të tyre; që falen vazhdimisht; që japin fshehtas dhe haptas nga ajo që Ne e kemi dhënë për ta; që e shmangin të keqen me të mirë. Këta do ta kenë shpërblimin e shtëpisë [së vërtetë]: <sup>23</sup> ata do të futen në Kopshte të përhershme, bashkë me paraardhësit, bashkëshortët dhe pasardhësit e tyre të ndershëm; engjëjt do t’u shkojnë nga secila portë: <sup>24</sup> ‘Paqja qoftë me ju, se jeni mbajtur të qëndrueshëm. Çfarë shpërblimi i shkëlqyeshëm është kjo shtëpi e juaja!’ <sup>25</sup> Por do të ketë refuzim për ata që i shkelin marrëveshjet e tyre të konfirmuara të bëra në emrin e **Allahut**, që e ndajnë atë që **Allahu** ka urdhëruar

---

<sup>a</sup> Apo ‘i përulen me respekt’: hijet i përulen ligjeve të Zotit në natyrë dhe po ashtu shtrihen në tokë sikur po përulen. *Sajada* i ka të dy kuptimet.

të shoqërohet dhe që shpërndajnë korrupsion në tokë: e tyre është shtëpia e tmerrshme – <sup>26</sup> **Allahu** i jep në mënyrë të begatshme kujt do që i jep dhe në mënyrë të kursyer kujt do që i jep – dhe megjithëse ata mund të argëtohen shfrenueshëm në jetën e kësaj bote, ajo është veçse komoditet i shkurtër në krahasim me Jetën që do të vijë.

<sup>27</sup> Pabesimtarët thonë: ‘Pse nuk i është zbritur asnjë mrekulli atij nga Zoti i tij?’ [Profet,] thuj: ‘**Allahu** e lë të devijojë këdo që e lë dhe i udhëzon kah Vetja ata që kthehen kah Ai, <sup>28</sup> ata që kanë besim dhe zemrat e të cilëve gjejnë paqe në të kujtuarit e **Allahut** – vërtet në të kujtuarit e **Allahut** e gjen zemra paqen – <sup>29</sup> ata që besojnë dhe që bëjnë vepra të ndershme: gëzimi i pret këta dhe kthimi i tyre përfundimtar në shtëpi do të jetë i shkëlqyeshëm.’ <sup>13:30</sup> Pra të kemi dërguar [ty Profet] te një komunitet – komunitete të tjera kanë ndërruar jetë shumë kohë para tyre – për t’ua recituar atë që ta zbulojmë. E prapë nuk besojnë në Zotin e Mëshirës. Thuj: ‘Ai është Zoti im: nuk ka zot pos Tij. E kam besimin tim në Të dhe tek Ai është kthimi im.’ <sup>31</sup> Po të kishte ndonjëherë Kuran me të cilin do të mund të lëvizeshin malet, të mund të shpartallohej toka, apo të mund të bëheshin të vdekurit të flisnin [do të kish qenë ky]<sup>a</sup>, por gjithçka është vërtet në duart e **Allahut**. A nuk e vërejnë besimtarët se po të donte **Allahu**, do të kishte mundur t’i udhëzonte tërë njerëzimin? Sa u përket pabesimtarëve, për shkak të krimeve të tyre, katastrofa nuk do të ndalet duke u shkaktuar vuajtje apo duke u rënë afër shtëpive të tyre deri kur të përmbushet premtimi i **Allahut**: **Allahu** nuk dështon kurrë në mbajtjen e premtimit Të Tij.

<sup>32</sup> Shumë të dërguar para teje [Muhamed] i tallën, por Unë e kam plotësuar kërkesën për shtyrje të afatit për pabesimtarët: në fund, i kritikova ashpër – sa i tmerrshëm ishte ndëshkimi Im! <sup>33</sup> A është Ai që e mbikëqyr secilin shpirt duke e shënuar veprimin e tij [në nevojë për ndonjë partner]? E prapë i atribuojnë partnerë **Allahut**. Thuj: ‘Emëroni ata’, apo: ‘A mund t’i tregoni Atij për diçka në tokë që Ai nuk e di se ekziston, apo kjo është veç shfaqje argëtuese e fjalëve?’ Por gjërat që i sajojnë janë bërë joshëse për pabesimtarët dhe u është bllokuar rruga [e drejtë]: askush nuk mund t’i udhëzojë ata që **Allahu** i lë të devijojnë. <sup>34</sup> Ka ndëshkim për ta në këtë botë, por ndëshkimi i Jetës së Përtejme do të jetë më i rëndë – askush nuk do t’i mbrojë kundër **Allahut**.

<sup>35</sup> Ja një pikturë e Kopshtit që u është premtuar atyre që janë të vetëdijshëm për **Allahun**: lumenj rrjedhës dhe ushqim e hije të përhershme. Ky është shpërblimi që i pret ata që janë të vetëdijshëm për **Allahun**; shpërblimi i pabesimtarëve është Zjarri. <sup>36</sup> Ata të cilëve Ne ua dërguam Librin e Shenjtë lumturohen në atë që të është zbuluar [Profet]; disa fraksione mohojnë pjesë të tij. Thuj: ‘Jam urdhëruar t’i falem **Allahut** dhe të mos shoqëroj asgjë me Të kur

---

<sup>a</sup> Apo ‘[ata prapë nuk do të besonin]’.

falem: tek Ai [i] thërras [të tjerët] dhe tek Ai do të kthehem.’<sup>37</sup> Kështu Ne e kemi dërguar Kuranin për të dhënë gjykim në gjuhën arabe. Po t’i ndiqnit meraket e tyre, pasi juve ju ka ardhur dituria, nuk do ta kishit askë t’ju ruajë a t’ju mbrojë nga **Allahu**.<sup>38</sup> Ne çuam të dërguar para teje dhe u dhamë gra dhe pasardhës; asnjë të dërguari nuk i është dhënë pushteti për të prodhuar mrekulli pos me autorizim të **Allahut**. Kishte Libër të Shenjtë për çdo epokë:<sup>a</sup> <sup>39</sup> **Allahu** fshin apo konfirmon çkado që do të fshijë a të konfirmojë dhe burimi i Librit të Shenjtë është me Të.<sup>13:40</sup> Qoftë nëse Ne të lejojmë [Profet] ta shohësh një pjesë të asaj me të cilën i kërcënojmë, apo të bëjmë të vdesësh [para kësaj], detyra jote është veç ta dërgosh mesazhin: Vlerësimi është I Yni.<sup>41</sup> A nuk e shohin se si u vijmë në tokë [të tyre] dhe i tkurrim kufijtë e saj? **Allahu** vendos – askush nuk mund ta kthejë prapa vendimin E Tij – dhe Ai është i shpejtë në vlerësim.<sup>42</sup> Edhe ata para tyre kanë bërë plane të fshehta, por plani i fshehtë gjithëpërfshirës i përket **Allahut**: Ai e di atë që e bën secili shpirt. Në fund, pabesimtarët do ta marrin vesh se kush do ta ketë shtëpinë e shkëlqyeshme.<sup>43</sup> Thonë: ‘Ti nuk je dërguar.’ Thuaj: ‘**Allahu** është dëshmitar i mjaftueshëm ndërmjet meje dhe jush: tërë dituria e Librit të Shenjtë vjen nga Ai.’<sup>b</sup>

---

<sup>a</sup> Një interpretim tjetër është ‘ka kohë të dekretuar për gjithçka’.

<sup>b</sup> Alternativisht, ‘**Allahu** – dhe ata që kanë dituri [të vërtetë] të Librit të Shenjtë – janë dëshmitarë të mjaftueshëm ndërmjet nesh.’

**Përshkrimi para 13 kaptinës nga Abdel Haleem:**

*Sure medinase që e merr titullin nga bubullima që e himnizon **Allahun** në vargun 13. Kaptina dallohet me përshkrimin e saj emocionues të fuqisë dhe të dijes së **Allahut**. Theksohet vendi i Muhamedit në traditën e gjatë të profetëve, prej të cilëve asnjëri nuk mund të prodhonte mrekulli kur i kërkohej dhe nënvizohet roli i tij: është veç që ta bartë mesazhin. **Allahu** është Ai që do t'u kërkojë llogari njerëzve për veprat e tyre dhe Ai është dëshmitari për të vërtetën e mesazhit.*

## 14: Ibrahim (IBRÂHÎM, ABRAHAM)

Në emrin e **Allahut**, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës

<sup>1</sup> *Elif Lam Ra*

Ky është Libër i Shenjtë të cilin Ne ta kemi zbritur [Profet] ashtu që – me autorizimin e Zotit të tyre – të mund t’i shpësh njerëzit nga thellësitë e errësirës në dritë, në rrugën e Të Plotfuqishmit, Të Admirueshmit, <sup>2</sup> **Allahut**, Të Cilit i përket gjithçka në qiej dhe në tokë. Sa e tmerrshme do të jetë dhembja që do ta vuajnë ata që [e] injorojnë [Atë], <sup>3</sup> ata që e preferojnë jetën e kësaj bote më shumë se jetën e ardhshme, që i largojnë të tjerët nga rruga e **Allahut**, duke u munduar ta shtrembërojnë rrugën: njerëzit e tillë kanë devijuar shumë larg. <sup>4</sup> Ne kurrë nuk kemi çuar të dërguar që nuk e ka përdorur gjuhën e popullit të tij për t’ua qartësuar gjërat. Por prapë **Allahu** e lë të devijojë këdo që do ta lërë dhe e udhëzon këdo që do ta udhëzojë: Ai është i Plotfuqishmi, I Gjithëdituri.

<sup>5</sup> Ne e dërguam Musain me shenjat Tona: ‘Nxirre popullin tënd nga thellësitë e errësirës në dritë. Kujtoju Ditët e **Allahut**<sup>a</sup>: vërtet në këtë ka shenja për çdo person të qëndrueshëm e falënderues.’ <sup>6</sup> Dhe kështu Musai i tha popullit të tij: ‘Kujtojeni bekimin e **Allahut** mbi ju kur ju shpëtoi nga njerëzit e Faraonit, që po ju shkaktonin vuajtje të tmerrshme, duke jua therur djemtë dhe duke jua kursyer veç gratë – kjo ishte sprovë e rëndë nga Zoti juaj! <sup>7</sup> Kujtojeni se Ai premtoi: "Në qofshi falënderues, Unë absolutisht ju siguroj se do t’ju jap më shumë, por në qofshi jofalënderues...<sup>b</sup> Ndëshkimi Im është vërtet i tmerrshëm."’ <sup>8</sup> Dhe Musai tha: ‘Edhe nëse ju, bashkë me të gjithë të tjerët në tokë, jeni jofalënderues, **Allahu** është i vetë-mjaftueshëm, i denjë për tërë admirimin.’

<sup>9</sup> A nuk keni dëgjuar për ata që shkuan para jush, për popullin e Nuhut, të Adit, të Themudit dhe për ata që jetuan pas tyre, të njohur veç për **Allahun**? Të dërguarit e tyre u erdhën me dëshmi të qartë, por ata u munduan t’ua mbyllnin gojën<sup>c</sup>, duke thënë: ‘Nuk e besojmë mesazhin me të cilin jeni dërguar. Kemi dyshime shqetësuese për atë që po na kërkoni ta bëjmë.’ <sup>14:10</sup> Të dërguarit e tyre u përgjigjën: ‘A mund të ketë ndonjë dyshim për **Allahun**, Krijuesin e qiejve dhe të tokës? Ai ju fton tek Ai në mënyrë që t’jua falë mëkatet tuaja dhe t’ju lërë ta shijoni jetën tuaj deri në orën e caktuar.’ Por ata thanë: ‘Ju jeni veç njerëz si ne. Dëshironi të na largoni nga ajo që paraardhësit tanë e adhuronin dikur. Na sillni dëshmi të qartë pra [, në mundshi].’ <sup>11</sup> Të dërguarit e tyre u përgjigjën: ‘E vërtetë,

<sup>a</sup> Kohët kur **Allahu** i veçoi për favor të veçantë apo për vuajtje (krahaso me 2:30-61).

<sup>b</sup> Këtu Nouman Ali Khan te ligjëratat “Gratitude: A Way of Life” tregon se në arabisht janë tri pika dhe se fjalia vijuese është e ndarë nga kjo. Kjo fjali është “nëse...” pa “atëherë...”. Po ashtu, Nouman thekson se është ndër herat e rralla ku Zoti i referohet vetes me Unë në vend se me Ne (shënime të shqipëruarit).

<sup>c</sup> Fjalë për fjalë 'ua futën duart në gojë të profetëve'.

ne jemi veç njerëz si ju, por **Allahu** i favorizon cilëtdo nga shërbyesit E Tij që i zgjedh. Nuk mund t'jua sjellim asnjë dëshmi pa e autorizuar **Allahu**, prandaj le ta mbështesin besimtarët tërë besimin e tyre në Të – <sup>12</sup> pse të mos e mbështesnim besimin tonë në **Allahun** kur Ai është Ai që na ka udhëzuar në këtë rrugë që e ndjekim? Sigurisht që do ta durojmë në mënyrë të qëndrueshme çfarëdo dëmi që na e shkaktoni. Kushdo që ka besim, le të besojë në **Allahun**.'

<sup>13</sup> Mosbesimtarët u thanë të dërguarve të tyre: 'Do t'ju dëbojmë nga vendi ynë nëse nuk ktheheni në fenë tonë.' Por Zoti i tyre i frymëzoi të dërguarit: 'Ne do t'i shkatërrojmë keqbërësit, <sup>14</sup> dhe do t'ju lëmë të rroni në vend pas tyre. Ky shpërblim është për ata që kanë frikë-respekt për takimin me Mua dhe për paralajmërimet E Mija.' <sup>15</sup> Ata e lutën **Allahun** të vendosë dhe çdo tiran kokëfortë dështoi – <sup>16</sup> Ferri e pret secilin; atij do t'i jepet të pijë ujë të fëlliqtë, <sup>17</sup> të cilin do të mundohet ta përpijë por mezi do të mund ta kalojë nëpër fyt; vdekja do ta marrë gradualisht nga çdo anë, por nuk do të vdesë; do të ketë ende vuajtje të madhe. <sup>18</sup> Veprat e atyre që e refuzojnë Zotin e tyre janë si hi që era e shtyn furishëm në ditë të stuhishme: nuk kanë pushtet ndaj asgjëje që e kanë fituar. Kjo është të devijosh shumë, shumë larg. <sup>19</sup> [Profet,] a nuk e sheh se **Allahu** i krijoi qiejt dhe tokën për një destinim? Ai do të mund t'ju hiqte të gjithëve dhe t'ju zëvendësonte me krijim të ri po të donte: <sup>14:20</sup> kjo nuk është e vështirë për **Allahun**. <sup>21</sup> Kur të shfaqen të gjithë para Tij, të dobëtit do t'u thonë atyre që kërkonin të ndikonin te ta: 'Ne ishim ndjekësit tuaj. A mund të na mbronin prej ndonjë ndëshkimi të **Allahut**?' Ata do të përgjigjen: 'Po të na udhëzonte **Allahu** neve, ne do t'ju udhëzonim juve. Tani s'ka rëndësi se a tërbohemi apo durojmë: nuk ka shpëtim.' <sup>22</sup> Kur të jetë vendosur gjithçka, Satani do të thotë: '**Allahu** ju bëri premtim të vërtetë. Edhe unë kam bërë premtime por ishin të rrejshme: nuk kisha pushtet ndaj jush pos t'ju thërras dhe ju iu përgjigjët thirrjes sime, kështu që mos më fajësoni mua; fajësojeni veten. Nuk mund t'ju ndihmoj, as s'mund të më ndihmoni. E refuzoj mënyrën se si më keni shoqëruar me **Allahun** më parë.' Keqbërësit e tillë i pret dhembje e vuajtshme, <sup>23</sup> por ata që besuan dhe bënë vepra të mira do të dërgohen në Kopshte tërheqëse të zbukuruara me lumenj rrjedhës, për të mbetur aty me leje të Zotit të tyre: përshëndetja e tyre atje është 'Paqe'.

<sup>24</sup> [Profet,] a nuk e sheh se si bën krahasime **Allahu**? Një fjalë e mirë është si pemë e mirë – rrënja e saj është e qëndrueshme dhe degët e saj janë lart në qiell, <sup>25</sup> duke dhënë fryte të vazhdueshme me miratim të Zotit të saj – **Allahu** bën krahasime të tilla për njerëzit që të mund të reflektojnë – <sup>26</sup> por një fjalë e keqe është si pemë e kalbur, e çrrënjësuar nga sipërfaqja e tokës, pa asnjë fuqi për të qëndruar. <sup>27</sup> **Allahu** do t'u japë vendosmëri atyre që besojnë në fjalën e rrënjësuar

vendosmërisht<sup>a</sup>, edhe në këtë botë edhe në Të Përtejmen, por keqbërësit i lë të devijojnë: **Allahu** e bën atë që do ta bëjë.

<sup>28</sup> [Profet,] a nuk po i sheh ata që, në këmbim për të mirën e **Allahut**, ofrojnë veç mosmirënjohje dhe bëjnë që njerëzit e tyre të përfundojnë në shtëpinë e shkatërrimit, në Ferr, <sup>29</sup> ku digjen? Çfarë vendi i keq për të qëndruar! <sup>14:30</sup> Ata përpilojnë [perëndi të rrejshme si] të barabartë me **Allahun** për t'i devijuar njerëzit nga rruga E Tij. Thuaj: 'Kënaquni tash, se destinacioni juaj është Zjarri.'  
<sup>31</sup> Tregoju shërbyesve të Mi – që kanë besuar – që të vazhdojnë të falen dhe të japin, fshehurazi dhe haptazi, nga ajo që ua kemi dhënë Ne, para se të vijë një Ditë kur nuk do të ketë as shkëmbime as miqësi.

<sup>32</sup> Është **Allahu** që i krijoi qiejt dhe tokën, që ka lëshuar ujë nga qielli dhe që me të bëri prodhime për t'ju ushqyer; Ai jua ka bërë të dobishme anijet, që lundrojnë nëpër det me urdhrin E Tij dhe lumenjtë po ashtu; <sup>33</sup> Ai jua ka bërë të dobishëm diellin dhe hënën, stabilë në rrugët e tyre; Ai jua ka bërë të dobishme natën dhe ditën <sup>34</sup> dhe ca nga gjithçka që i keni kërkuar Atij. Po të provonit t'i numëronit të mirat e **Allahut** nuk do të mund t'i llogaritnit kurrë: njeriu është vërtet i padrejtë dhe mosmirënjohës.

<sup>35</sup> Kujtojeni kur Ibrahim i tha: 'Zot, bëje të sigurt këtë qytet! Mbromë mua dhe pasardhësit e mi nga idhujtaria, <sup>36</sup> Zot, [idhujt] kanë devijuar shumë njerëz! Kushdo që më ndjek është me mua, por sa i përket kujt do që nuk më bindet – Ti je sigurisht falës dhe mëshirëplotë. <sup>37</sup> Zoti Ynë, i kam vendosur disa nga pasardhësit e mi në një luginë të papunuar, afër Shtëpisë Sate të Shenjtë, Zot, ashtu që të mund të vazhdojnë të falen. Bëri zemrat e njerëzve të kthehen kah ata dhe furnizoi me produkte, ashtu që të mund të jenë falënderues. <sup>38</sup> Zoti Ynë, Ti e di mirë atë që e fshehim dhe atë që e shfaqim: asgjë prej gjëje nuk është e fshehur nga **Allahu**, as në tokë as në qiell. <sup>39</sup> Admirimi qoftë për **Allahun**, që ma ka dhuruar Ismailin dhe Is'hakun në pleqërinë time: Zoti im i dëgjon të gjitha lutjet! <sup>14:40</sup> Zot, bëj që unë dhe pasardhësit e mi të mund të falemi vazhdimisht. Zoti ynë, pranoje lutjen time. <sup>41</sup> Zoti ynë, më fal mua, prindërit e mi dhe besimtarët në Ditën e Vlerësimit.'

<sup>42</sup> Mos mendo [Profet] se **Allahu** është i pavetëdijshëm për atë që e bëjnë mosbesimtarët: Ai veçse ua shtyn afatin deri në një Ditë kur sytë e tyre do të shikojnë të hutuar në tmerr. <sup>43</sup> Do të turren përpara, duke i zgjatur qafat, të paaftë ta heqin shikimin e tyre nga ajo që e shohin, zbrastësi shumë e madhe në zemrat e tyre. <sup>44</sup> Pra paralajmëroji njerëzit për Ditën kur do t'u vijë ndëshkimi dhe kur mosbesimtarët do të thonë: 'Zoti ynë, jepna pak më shumë kohë: do t'i përgjigjemi thirrjes Sate dhe do t'u bindemi të dërguarve.' A nuk u përbetuat në të shkuarën [ju mosbesimtarë] se pushteti juaj nuk do të kishte fund? <sup>45</sup> Jetuat në

---

<sup>a</sup> Me gjasë Librin e Shenjtë, të rrënjësor vendosmërisht në dijen nga **Allahu**.



vendet e njëjta si ata që e mashtruan veten më parë dhe ju është treguar qartë se si i trajtuam ata – Ne ju dhamë shumë shembuj. <sup>46</sup> Ata i bënë komplotet e tyre, por edhe po të mund t'i lëviznin malet me komplotet e tyre, **Allahu** e kishte përgjigjen. <sup>47</sup> Pra mos mendo [Profet] se **Allahu** do ta shkelë premtimin E Tij ndaj të dërguarve Të Tij: Ai është i fuqishëm dhe i aftë për ndëshkim. <sup>48</sup> Një Ditë – kur toka kthehet në një tokë tjetër, qiejt në një qiell tjetër dhe njerëzit të gjithë shfaqen para **Allahut**, Atij, Gjithë-Kontrolluesit – <sup>49</sup> [ti Profet] do t'i shohësh fajtorët atë Ditë, të lidhur bashkë në vargonj, <sup>14:50</sup> me rroba nga zifti, fytyrat të mbuluara me zjarr. <sup>51</sup> [Të gjithë do të gjykohen] ashtu që **Allahu** të mund ta kompensojë secilin shpirt siç e meriton: **Allahu** është i shpejtë në vlerësimin E Tij.

<sup>52</sup> Ky është mesazh për të gjithë njerëzit, që të mund të paralajmërohen me të dhe ta dinë se Ai është **Allahu** i vetëm dhe që ata që kanë mendje të mund ta marrin parasysh seriozisht.

**Përshkrimi para 14 kaptinës nga Abdel Haleem:**

*Sure mekase e emëruar sipas Ibrahimit (vargjet 35-41), i cili i lutet **Allahut** që Meka të mund të lulëzojë ashtu që njerëzit e saj të mund të jenë falënderues dhe të vazhdojnë t'i falen **Allahut**. Nëpër sure, për mosmirënjohësit mbahet qëndrim kundërshtues dhe për mirënjohësit ka lëvdata. Ibrahimit po ashtu kërkon që ai dhe pasardhësit e tij të mund të mbrohen nga idhujtaria. Kjo shërben për t'ua kujtuar mekasve se duhet t'i shmangen adhurimit të idhujve.*

## 15: Hixhra (EL-HIXHR) – terreni shkëmbor

Në emrin e **Allahut**, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës

<sup>1</sup> *Elif Lam Ra*

Këto janë vargjet e Librit të Shenjtë, Kuran që i qartëson gjërat. <sup>2</sup> Mosbesimtarët mund të kujtohen të kishin dashur t'i përulëshin **Allahut**, <sup>3</sup> pra [Profet] lëri të hanë dhe të kënaqen. Le t'ua tërheqin vëmendjen shpresat [e rrejshme]: do ta marrin vesh. <sup>4</sup> Ne nuk e kemi shkatërruar kurrë një komunitet që nuk ka pasur kohë të caktuar; <sup>5</sup> asnjë komunitet nuk mund ta shpejtojë kohën e tij, e as ta ngadalësojë. <sup>6</sup> Thonë: 'Të ka ardhur Kurani! Je vërtet i marrë. <sup>7</sup> Pse s'po na i sjell engjëjt, nëse po e thua të vërtetën?' <sup>8</sup> Por Ne i zbresim engjëjt veç për të vënë drejtësi dhe pastaj atyre njerëzve nuk do t'u shtyhet ekzekutimi. <sup>9</sup> Ne e kemi zbritur Kuranin Vetë dhe Vetë do ta ruajmë. Edhe para teje [Profet], <sup>15:10</sup> kemi çuar të dërguar nëpër komunitete të ndryshme të dikurshme, <sup>11</sup> por e tallën secilin të dërguar që u erdhi: <sup>12</sup> kështu e bëjmë mesazhin të rrëshqasë nga zemra e keqbërësve. <sup>13</sup> Nuk do të besojnë në të. Kjo është ajo që u ndodhi popujve të dikurshëm, <sup>14</sup> dhe madje edhe po t'ua hapnim një portë në Parajsë dhe të ngritëshin nëpër të, lart e më lart, <sup>15</sup> prapë do të thoshin: 'Sytë po na halucinojnë. Na kanë bërë magji.'

<sup>16</sup> Ne kemi rregulluar yjësi lart në qiell dhe e kemi bërë të bukur për të gjithë që ta shohin, <sup>17</sup> dhe e kemi mbrojtur nga çdo djall i gurtë:<sup>a</sup> <sup>18</sup> çdo përgjues do të ndiqet nga një zjarr që duket qartë. <sup>19</sup> Sa i përket tokës, e kemi shtrirë, kemi rregulluar male të qëndrueshme në të dhe kemi bërë gjithçka të rritet aty në balans të duhur. <sup>15:20</sup> Kemi furnizuar ushqim e pije në të për ju dhe për krejt ato krijesa për të cilat nuk furnizoni. <sup>21</sup> Nuk ka asnjë gjë – furnizimet e të cilës nuk janë me Ne. I zbresim vetëm sipas një mase të përcaktuar mirë: <sup>22</sup> i dërgojmë erërat për të polenizuar dhe e zbresim ujin nga qielli për ju që ta pini – ju nuk i kontrolloni burimet e tij. <sup>23</sup> Jemi Ne që japim jetë dhe vdekje; jemi Ne që trashëgojmë [gjithçka]. <sup>24</sup> Ne i dimë saktësisht ata nga ju që vijnë të parët dhe ata që vijnë më vonë. <sup>25</sup> [Profet,] është Zoti yt që do t'i tubojë të gjithë bashkë: Ai është i gjith'-urti, i gjithë-dijshmi.

<sup>26</sup> Ne e krijuam njeriun nga balta e tharë e formuar nga lloçi i errët – <sup>27</sup> xhindët i krijuam më parë, nga zjarri i frymës së tejnxehtë. <sup>28</sup> Zoti juaj u tha engjëjve: 'Do ta krijoj një vdekatar nga balta e tharë, të formuar nga lloçi i errët. <sup>29</sup> Kur ta kem formësuar dhe të kem fryrë shpirt Timin në të, përkuluni para tij,' <sup>15:30</sup> dhe engjëjt të gjithë vepruan ashtu. <sup>31</sup> Por jo Iblisi: ai refuzoi të përkulet si të

---

<sup>a</sup> Shih 72:8-9

tjerët. <sup>32</sup> **Allahu** tha: ‘Iblis, pse nuk u përkule si të tjerët?’ <sup>33</sup> dhe ai u përgjigj: ‘Nuk do t’i përkulem një vdekatari që e krijove nga balta e tharë, të formuar nga lloçi i errët.’ <sup>34</sup> ‘Dil nga këtu!’ tha **Allahu**. ‘Je i dëbuar, <sup>35</sup> i refuzuar deri në Ditën e Gjykimit.’ <sup>36</sup> Iblisi tha: ‘Zoti im, ma shtyj afatin deri në Ditën kur ata të gjithë zgjohen nga të vdekurit.’ <sup>37</sup> ‘E ke shtyrjen e afatit,’ tha **Allahu**, <sup>38</sup> ‘deri në Ditën e Kohës së Caktuar.’ <sup>39</sup> Iblisi pastaj i tha **Allahut**: ‘Meqë më bërë të jem gabim, do ta josh njerëzimin në tokë dhe do t’i bëj të jenë gabim, <sup>15:40</sup> të gjithë përveç shërbyesve Tu të devotshëm.’ <sup>41</sup> **Allahu** tha: ‘[Devotshmëria] është rrugë e drejtë kah Unë: <sup>42</sup> nuk do të kesh fare pushtet ndaj shërbyesve të Mi, veç ndaj atyre që devijojnë dhe të ndjekin. <sup>43</sup> Ferri është vendi i premtuar për të gjithë ata, <sup>44</sup> me shtatë porta, ku secila portë e ka hisen e saj të caktuar të tyre. <sup>45</sup> Por të ndershmit do të jenë në Kopshte me burime – <sup>46</sup> "Hyni aty në paqe dhe siguri!" – <sup>47</sup> dhe Ne do t’ua heqim çfarëdo zhgënjimi nga zemrat: [ata do të jenë si] vëllezër, të ulur në divane, ballë për ballë. <sup>48</sup> Asnjë lodhje nuk do t’i kapë kurrë aty, as kurrë s’do të dëbohen.’ <sup>49</sup> [Profet] tregoj shërbyesve të Mi se Unë jam Falësi, Mëshirëploti, <sup>15:50</sup> por vuajtja nga Unë është ajo që është vërtet dhembje-plotë.

<sup>51</sup> Tregoj edhe për mysafirët e Ibrahimit: <sup>52</sup> kur i erdhën e i thanë: ‘Paqe,’ ai tha: ‘Po jua kemi frikën’. <sup>53</sup> ‘Mos u frikëso,’ thanë ata: ‘Të sjellim lajme të mira për një djalë që do të ketë dije të madhe.’ <sup>54</sup> Ai tha: ‘Si mund të më jepni kesi lajmi kur më ka ardhur pleqëria? Çfarë lloj lajmi është ky?’ <sup>55</sup> Ata thanë: ‘Ne ta kemi treguar të vërtetën, prandaj mos i humb shpresat.’ <sup>56</sup> Ai tha: ‘Kush pos të keqduhëzuarve i humb shpresat për mëshirën e Zotit të tij?’ <sup>57</sup> dhe pastaj pyeti: ‘Të dërguar, cila është porosia juaj?’ <sup>58</sup> Ata u përgjigjën: ‘Jemi dërguar te një popull që janë fajtorë.’ <sup>59</sup> Por Ne do ta shpëtojmë familjen e Lutit, <sup>15:60</sup> të gjithë pos gruas së tij: Ne kemi dhënë urdhër që ajo do të jetë ndër ata që mbesin prapa.

<sup>61</sup> Kur të dërguarit erdhën te familja e Lutit, <sup>62</sup> ai tha: ‘Jeni të panjohur.’ <sup>63</sup> Ata thanë: ‘Ta kemi sjellë atë që thoshin se nuk do të ndodhte kurrë: <sup>64</sup> ta kemi sjellë Të Vërtetën. E kemi përnjëmend, <sup>65</sup> kështu që kur nata të jetë më e errëta largohu me familjen tënde dhe ec prapa tyre. Asnjëri nga ju mos të shikojë prapa. Shkoni ku po ju urdhërohet.’ <sup>66</sup> Ne ia kemi bërë të ditur këtë dekret: mbetjet e fundit të atyre njerëzve do të shkatërrohen plotësisht në mëngjes. <sup>67</sup> Njerëzit e qytetit erdhën, duke u argëtuar shfrenueshëm, <sup>68</sup> dhe ai u tha: ‘Këta janë mysafirë të mi, mos më turpëroni. <sup>69</sup> Frikësojuni **Allahut** dhe mos më çnderoni.’ <sup>15:70</sup> Ata u përgjigjën: ‘A nuk të kemi thënë të mos ndërhyjë askush tjetër [dhe as ndërmjet nesh]?’ <sup>71</sup> Ai tha: ‘Bijat e mija janë këtu, nëse e keni patjetër.’ <sup>72</sup> Pasha jetën tënde [Profet], brodhën të dehur çmendurisht <sup>73</sup> dhe shtrëngata e ashpër i kaploi në agim: <sup>74</sup> Ne ua kthyem qytetin përmbys dhe ua lëshuam përmbi një breshëri gurësh të deltinës. <sup>75</sup> Vërtet ka shenjë në këtë për ata që mund të mësojnë – <sup>76</sup> është ende atje në rrugën kryesore – <sup>77</sup> vërtet ka shenjë në këtë për ata që besojnë.

<sup>78</sup> Edhe banorët e pyllit<sup>a</sup> (Ejkes) ishin keqbërës <sup>79</sup> dhe Ne i dënuam; të dyja janë ende atje në rrugë kryesore, të dukshme për të gjithë. <sup>15:80</sup> Edhe njerëzit e Hixhrës<sup>b</sup> i refuzuan të dërguarit Tanë: <sup>81</sup> ua dhamë shenjat Tona, por na e kthyen shpinën. <sup>82</sup> I ngritën shtëpitë për banim në male dhe jetonin në siguri – <sup>83</sup> shtrëngata e ashpër i dërrmoi herët në mëngjes. <sup>84</sup> Ajo që e kishin fituar ishte e padobishme për ta.

<sup>85</sup> Ne nuk i kemi krijuar qiejt dhe tokën dhe gjithçka ndërmjet tyre pa destinim të vërtetë: Ora [e Gjykimit] do të vijë patjetër, prandaj [Profet] ji i duruar me ta me mirësjellje. <sup>86</sup> Zoti yt është Krijuesi I Gjithë-Dijshëm. <sup>87</sup> Ne t'i kemi dhënë shtatë vargjet e recituara shpesh<sup>c</sup> dhe tërë Kuranin e lavdishëm. <sup>88</sup> Mos i shiko me dëshirim gjërat e mira që ua kemi dhënë disave t'i shijojnë. Mos i vajto [mosbesimtarët], por sillu butë me besimtarët <sup>89</sup> dhe thuaj: 'Jam këtu për të dhënë paralajmërim të qartë,' <sup>15:90</sup> si [paralajmërimi] që e zbritëm për ata që ndahen në grupe të interesit<sup>d</sup> <sup>91</sup> dhe e shpërdorjnë Kuranin<sup>e</sup> – <sup>92</sup> pasha Zotin tuaj, do t'i marrim në pyetje të gjithë <sup>93</sup> për veprat e tyre. <sup>94</sup> Pra shpalle haptas atë që je urdhëruar [ta thuash] dhe injoroi idhujtarët. <sup>95</sup> Ne jemi të mjaftueshëm për ty kundër të gjithë atyre që tallen me mesazhin tënd, <sup>96</sup> që përpilojnë zot tjetër përkrah Allahut – do ta marrin vesh. <sup>97</sup> Jemi fare mirë të vetëdijshëm se zemra të është rënduar nga ajo që e thonë. <sup>98</sup> Lartësoje lavdinë e Zotit tënd dhe ji ndër ata që i përkulen Atij: <sup>99</sup> falju Zotit tënd deri kur të të vijë ajo që është e sigurt.

---

<sup>a</sup> Krahaso me 26:176-191, 38:13, 50:14.

<sup>b</sup> Fisi i Themudit që jetonte në veri të Medinës. *Al-Hijr* domethënë 'qytet i gurtë', si Petra në Jordan.

<sup>c</sup> Sipas shumicës së përkthyesve kjo i referohet *al-Fatiha*-s – 'Hapjes' (Kaptinës 1).

<sup>d</sup> Kjo i referohet disa mosbesimtarëve që u organizuan në grupe për t'i takuar pelegrinët (haxhinjtë) dhe për t'i paralajmëruar kundër Kuranit.

<sup>e</sup> Janë dy interpretime të fjalës `idina të dhëna nga Razi. Njëri është 'pjesët/copat', tjetri është 'rrenat/trillimet': 'shpërdorimi' (abuzimi) i mbulon të dyjat.

**Përshkrimi para kaptinës 15 nga Abdel Haleem:**

*Sure mekase që e merr titullin nga referimi i njerëzve të Hixhrës (vargjet 80-84). Këta janë shembull i shumë njerëzve që nuk u besuan profetëve të tyre dhe i refuzuan. Secili e ka kohën e tij për ndëshkim kështu që Profeti duhet ta pranojë këtë me durim – e jo të mërzitet për atë që e thonë pabesimarët – dhe të vazhdojë të falet. Kaptina e përdor shembullin e natyrës dhe këmbënguljen e Iblisit për korruptimin e njerëzve për ta treguar, pastaj, mirësinë e **Allahut** dhe rrezikun të cilin e personifikon Satani.*

## 16: Bleta (EN-NAHL)

Në emrin e **Allahut**, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës

<sup>1</sup> Gjikimi i **Allahut** po vjen<sup>a</sup>, pra mos kërkoni që ta sjellë më herët. Lâvdi qoftë për Të! Ai është larg mbi çkado që bashkojnë me Të! <sup>2</sup> Ai u zbret engjëj me frymëzim nën komandën E Tij cilëvedo shërbyes Të Tij që i zgjedh, për t'ua dhënë paralajmërimin [E Tij]: 'Nuk ka zot pos Meje, pra m'u ruani Mua.' <sup>3</sup> Ai i krijoi qiejt dhe tokën për një qëllim të vërtetë dhe është lart mbi çkado që bashkojnë me Të! <sup>4</sup> Ai e krijoi njeriun nga një pikë e lëngut, e prapë njeriu e sfidon Atë haptas! <sup>5</sup> Dhe bagëtitë – Ai i krijoi edhe ato. Ju nxjerrni ngrohtësi dhe përfitime të tjera nga to: merrni ushqim nga to; <sup>6</sup> gjeni bukuri në to kur i ktheni në shtëpi për të pushuar dhe kur i nxirrni jashtë për të kullotur. <sup>7</sup> Ato jua bartin ngarkesat në vise që vetë nuk do të mund t'i arrinin pa vështirësi të madhe – vërtet Zoti juaj është i mirë dhe mëshirëplotë – <sup>8</sup> kuaj, mushka e gomarë për ju që t'i kalëroni dhe t'i përdorni për dukje dhe gjëra të tjera për të cilat s'dini asgjë. <sup>9</sup> **Allahu** e nxjerr në pah rrugën e duhur, se disa rrugë çojnë në drejtimin e gabuar: po të donte, Ai do të mund t'ju udhëzonte të gjithëve.

<sup>16:10</sup> Është Ai që e zbret ujin për ju nga qielli, nga i cili vjen një pije për ju dhe shkurret me të cilat i ushqeni kafshët tuaja. <sup>11</sup> Me të Ai rrit për ju drithëra, ullinj, palma, hardhi dhe të gjitha llojet e kulturave të tjera. Vërtet ka shenjë në këtë për ata që reflektojnë. <sup>12</sup> Me komandën E Tij i ka bërë ditën dhe natën, diellin, hënën dhe yjet – të gjitha për përfitimin tuaj. Vërtet ka shenja në këtë për ata që e përdorin gjykimin e tyre të shëndoshë. <sup>13</sup> Ai i ka bërë për përfitimin tuaj gjërat e shumë-ngjyrta që i ka shumëfishuar në tokë. Vërtet ka shenja në këtë për ata që e marrin shumë seriozisht. <sup>14</sup> Është Ai që e bëri detin në dobi tuajën: ju hani peshq të freskët nga ai dhe nxirrni stoli të çmuara për t'i bartur; i shihni anijet tek i çajnë valët e tij ashtu që të mund të shkoni në kërkim të dhuratave bujare Të Tij dhe të falënderoheni. <sup>15</sup> Ai i ka bërë malet të qëndrojnë fort në tokë, për ta parandaluar të lëkundet nën ju dhe lumenjtë e shtigjet që të mund ta gjeni rrugën tuaj, <sup>16</sup> dhe objektet e dalluara të peisazhit dhe yjet për t'i udhëzuar njerëzit. <sup>17</sup> A mund të krahasohet Ai që krijon me atë që s'mund të krijojë? Pse nuk po jeni të vëmendshëm?

<sup>18</sup> Po të provonit t'i numëronit bekimet e **Allahut**, kurrë s'do të mund t'i përfshinit të gjitha: Ai është vërtet më falësi dhe më mëshirëploti. <sup>19</sup> Ai e di atë që e fshihni dhe atë që e zbuloni. <sup>16:20</sup> Ata të cilët i thirrin përveç **Allahut** s'krijojnë asgjë; janë vetë të krijuar. <sup>21</sup> Janë të vdekur, jo të gjallë. Nuk e dinë se kur do t'i ngritin. <sup>22</sup> **Zoti** juaj është **Allahu** Një. Sa u përket atyre që e refuzojnë jetën tjetër,

---

<sup>a</sup> Folja arabike *ata* është në kohën e shkuar për të shprehur pashmangshmëri dhe afërsi.

zemrat e tyre refuzojnë ta pranojnë të vërtetën dhe janë arrogantë. <sup>23</sup> Nuk ka dyshim se **Allahu** e di atë që e fshehin dhe atë që e zbulojnë. Ai nuk i do arrogantët.

<sup>24</sup> Kur i pyesin: ‘Çka ka zbritur Zoti juaj?’ thonë: ‘Përralla të lashta.’ <sup>25</sup> Në Ditën e Ringjalljes do ta mbajnë peshën e plotë të barrës së tyre, si dhe ca nga barra e atyre të cilët i çorientuan pa dije të vërtetë. Sa e tmerrshme do të jetë barra e tyre! <sup>26</sup> Edhe ata që shkuan para tyre thurën intriga, por **Allahu** i sulmoi direkt themelet e asaj që e ndërtoan. Kulmi u ra përmbi: ndëshkimi u erdhi përmbi nga drejtime të paimagjinuara. <sup>27</sup> Në fund, në Ditën e Ringjalljes, Ai do t’i turpërojë, duke thënë: ‘Ku janë këta “partnerët” E Mi në llogarinë e të cilëve [më] keni kundërshtuar?’ Ata të cilëve u është dhënë dije do të thonë: ‘Turp dhe mjerim mbi pabesimtarët sot!’ <sup>28</sup> Ata që engjëjt ua marrin jetën gjersa po e dëmtojnë veten do të tregojnë nënshtrim: ‘Nuk po bënim keq.’ ‘Po, po bënit: **Allahu** e di plotësisht atë që e keni bërë, <sup>29</sup> pra hyni në portat e Ferrit. Aty do të mbeteni – shtëpia e arrogantëve është vërtet e keqe.’

<sup>16:30</sup> Por kur të ndershmit i pyesin: ‘Çka ka zbritur Zoti juaj?’ do të thonë: ‘Gjithçka që është e mirë.’ Ka shpërblim në këtë botë të tashme për ata që bëjnë mirë, por shtëpia e tyre në Të Përtejmen është shumë më e mirë: shtëpia e të ndershmëve është e shkëlqyeshme. <sup>31</sup> Ata do të futen në Kopshte të përhershme të hijeshuara me lumenj të rrjedhshëm. Aty do të kenë gjithçka që duan. Kjo është mënyra si i shpërblen **Allahu** të ndershmit, <sup>32</sup> ata që engjëjt ua marrin jetën në gjendje të mirësisë. Do t’u thonë: ‘Paqja qoftë me ju! Futuni në Kopsht si shpërblim për atë që e keni bërë.’ <sup>33</sup> A po presin pabesimtarët t’u vijnë engjëjt, apo Gjykimin e Zotit tuaj? Ata që shkuan para tyre e bënë të njëjtën. **Allahu** nuk i dëmtoi; e dëmtuan veten. <sup>34</sup> Pra e keqja që e patën bërë i goditi dhe ishin rrethuar pikërisht nga gjëja që e patën përqeshur.

<sup>35</sup> Ata që adhuruan të tjerë përveç **Allahut** thonë: ‘Po të donte **Allahu**, nuk do të adhuronim asgjë pos Tij, as etërit tonë nuk do ta bënin. Nuk do të deklaronim asgjë të ndaluar pa lejen E Tij.’ Ata para tyre e thanë të njëjtën. A janë të dërguarit të obliguar të bëjnë ndonjë gjë tjetër pos të shpërndajnë [mesazhin e tyre] qartë? <sup>36</sup> Ne i kemi çuar të dërguar çdo komuniteti, duke thënë: ‘Adhurojeni **Allahun** dhe largohjuni zotave të rremë.’ Ndër ta ishin disa që i udhëzoi **Allahu**; të tjerët i kapi çorientimi. Pra udhëtoni nëpër botë dhe shihni se çfarë ishte fati i atyre që e mohuan të vërtetën. <sup>37</sup> Edhe pse [ti Profet] mund të jesh fort i etur t’i udhëzosh, **Allahu** nuk i udhëzon ata që çorientojnë [të tjerë]<sup>a</sup>, as s’do ta kenë askë t’u ndihmojë. <sup>38</sup> Ata janë betuar në **Allahun** me betë e tyre më të forta se Ai nuk do t’i ringjallë të vdekurit. Por Ai do ta bëjë – është premtim I Tij obligues, edhe pse shumica e njerëzve nuk e kuptojnë – <sup>39</sup> që ta bëjë të qartë për ta se për çka

---

<sup>a</sup> Krahaso me vargun 25.



kanë dalluar dhe që pabesimtarët të mund ta kuptojnë se ajo që e kanë thënë ishte e rreme. <sup>16:40</sup> Kur Ne duam të ndodhë diçka, krejt çka themi është: ‘Ji’ dhe ajo është. <sup>41</sup> Sa për ata që emigruan për kauzën e **Allahut** pasi iu bë e padrejtë, Ne do t’u japim shtëpi të mirë në këtë botë, por shpërblimi i Të Përtejmes do të jetë shumë më i madh, veç po ta dinin. <sup>42</sup> Ata janë të tillët që janë të qëndrueshëm dhe e kanë besimin e tyre në Zotin e tyre.

<sup>43</sup> [Profet,] të gjithë të dërguarit që i çuam para teje ishin thjesht njerëz që Ne ua patëm dhënë Shpalljen: [ju njerëz] mund t’i pyesni ata që kanë dije nëse nuk e dini. <sup>44</sup> Ne i çuam me shenja dhe libra të shenjta të qarta. Ne ta kemi zbritur mesazhin edhe ty [Profet], që të mund t’ua shpjegosh njerëzve atë që u është dërguar, që të mund të reflektojnë.

<sup>45</sup> A janë ata që e planifikojnë të keqen kaq të sigurt se **Allahu** nuk do ta bëjë tokën t’i përpijë, se ndëshkimi nuk do t’u vijë nga ndonjë drejtim i paimagjinuar, <sup>46</sup> se nuk do t’i zërë befaz në ardhje-shkuarjet e tyre – sepse nuk mund ta frustrojnë **Allahun** – <sup>47</sup> apo se nuk do t’i zërë gradualisht? Vërtet Zoti juaj është i mirë dhe mëshirëplotë. <sup>48</sup> A nuk i vërejnë [pabesimtarët] gjërat që i ka krijuar **Allahu**, duke i hedhur hijet e tyre djathtas e majtas, duke iu nënshtruar **Allahut** me bindje? <sup>49</sup> Është **Allahu** Ai të cilit i nënshtrohet gjithçka në qiej e tokë, çdo egërsirë që lëviz, madje edhe engjëjt: janë të lirë nga arroganca, <sup>16:50</sup> i frikësohen Zotit të tyre mbi ta dhe bëjnë siç komandohen.

<sup>51</sup> **Allahu** tha: ‘Mos i merrni dy zota’ – se Ai është **Allahu** Një – ‘Unë i vetëm jam Ai për të cilin duhet të keni frikë-respekt.’ <sup>52</sup> Gjithçka në qiej e tokë i përket Atij: bindja e përhershme është e drejta E Tij. A do t’ia dëgjoni këshillat ndokujt tjetër pos **Allahut**? <sup>53</sup> Çfarëdo gjëra të mira që posedoni vijnë nga **Allahu** dhe kur ju shkaktohet vështirësia, veç tek Ai kërkoni ndihmë me ngulm, <sup>54</sup> e kur Ai ju ka çliruar nga vështirësia juaj – shih! – disa nga ju i atribuojnë partnerë Zotit tuaj. <sup>55</sup> Le të shfaqin mosmirënjohje për të mirat që Ne ua kemi shfaqur; ‘Shijojeni kohën tuaj të shkurtër – së shpejti do ta dini.’

<sup>56</sup> Ata e vënë mënjane një pjesë të mjeteve të jetës që ua japim Ne, për [idhujt] për të cilët nuk kanë njohuri të vërtetë<sup>a</sup>. Pasha **Allahun**! Do të merreni në pyetje për shpikjet tuaja të rreme. <sup>57</sup> Ata ia caktojnë bijat **Allahut**<sup>b</sup> – qoftë i lartësuar Ai! – dhe vetes [bijtë] që i duan. <sup>58</sup> Kur njërit nga ta i jepet lajmi i lindjes së një foshnjeje vajzë, i errësohet fytyra dhe mbushet me mërzi. <sup>59</sup> Nga turpi fshehet nga njerëzit e tij për shkak të lajmit të keq që ia kanë dhënë. A duhet ta mbajë dhe të vuajë përbuzje apo ta varrosë në dhe? Sa keq gjykojnë! <sup>16:60</sup> Ata që nuk besojnë në Të Përtejmen duhet ta kenë imazhin e përbuzshëm dhe **Allahu** duhet ta ketë më

---

<sup>a</sup> Arabët paganë u jepnin hyjnive të tyre pjesë të të korrave dhe bagëtive të tyre (6:136).

<sup>b</sup> Disa nga arabët paganë i quanin engjëjt - bijat e Zotit. Kjo është dyfish blasfemuere për shkak të neverisë në të cilën mbareshin bijat në komunitet luftëtarësh, deri në masën e infanticidit (vrasjes së fëmijëve) siç është përshkruar më poshtë.

të lartin<sup>a</sup>: Ai është I Fuqishmi, I Urti. <sup>61</sup> Po t'i kritikonte **Allahu** ashpër njerëzit për të keqen që e bëjnë, nuk do ta linte as një krijesë të gjallë në tokë, por Ai ua shtyn afatin e ndëshkimit deri në një kohë të caktuar: kur u vjen koha nuk mund ta vonojnë për asnjë moment as s'mund ta ngutin. <sup>62</sup> Ia atribuojnë **Allahut** atë që vetë atyre nuk u pëlqen gjersa gjuhët e tyre e shprehin rrenën se më e mira<sup>b</sup> u përket atyre. Pa dyshim është Zjarri ai që u përket: atyre do t'u jepet përparësi atje!<sup>c</sup>

<sup>63</sup> Pasha **Allahun**<sup>d</sup>, Ne u kemi çuar të dërguar para teje [Muhamed] komuniteteve tjera, por Satani ua bëri veprat e tyre të pista t'u duken tërheqëse. Ai është përkrahësi edhe i këtyre pabesimtarëve<sup>e</sup> të tashëm dhe ata të gjithë i pret një ndëshkim i dhembshëm. <sup>64</sup> Ne ta kemi zbritur Librin e Shenjtë veç për t'ua qartësuar atyre se në lidhje me çka dallojnë dhe si udhëzim e mëshirë për ata që besojnë.

<sup>65</sup> Është **Allahu** Ai që e zbret ujin nga qielli dhe me të e rigjallëron tokën kur është e vdekur. Vërtet ka shenjë në këtë për njerëzit që dëgjojnë. <sup>66</sup> Në bagëti, po ashtu, e keni një mësim – Ne jua japim juve një pije nga përmbajtja e barkut të tyre, ndërmjet lëndës së mbetur dhe gjakut, qumësht i pastër, i ëmbël për pirësin. <sup>67</sup> Nga frutat e palmave dhe të hardhive e merrni lëngun e ëmbël<sup>f</sup> dhe furnizime të shëndetshme. Vërtet ka shenjë në këtë për njerëzit që e përdorin arsyen e tyre. <sup>68</sup> Dhe Zoti juaj e frymëzoi bletën, duke thënë: 'Ndërto për vete shtëpi në male dhe në pemë dhe në ato që i ndërtojnë njerëzit. <sup>69</sup> Pastaj ushqehu nga të gjitha llojet e frutave dhe ndiqi rrugët e bëra të lehta për ty nga Zoti yt.' Nga barku i tyre vjen një pije me ngjyra të ndryshme në të cilën ka shërim për njerëzit. Vërtet ka shenjë në këtë për ata që mendojnë.

<sup>16:70</sup> Është **Allahu** Ai që ju ka krijuar dhe me kohë do të bëjë të vdisni. Disa nga ju do të dobësohen, në moshë të shtyrë, në gjendjen më të mjerë, ashtu që, pasi të kenë pasur dije, nuk do të dinë asgjë: **Allahu** është vërtet i gjithëdijshëm dhe i gjithëfuqishëm. <sup>71</sup> **Allahu** u ka dhënë disave nga ju më shumë furnizim se të tjerëve. Ata të cilëve u është dhënë më shumë nuk janë të gatshëm t'ia kalojnë furnizimin e tyre skllëvërve që i posedojnë që të bëhen të barabartë me ta. Si mund të refuzojnë t'i njohin publikisht bekimet e **Allahut**? <sup>72</sup> Dhe është **Allahu** Ai që ju ka dhënë bashkëshortë nga njerëzit ndërmjet jush dhe përmes tyre ju ka dhënë fëmijë dhe nipa e mbesa dhe ju ka furnizuar me gjëra të mira. Si mund të besojnë në falsitet dhe t'i refuzojnë bekimet e **Allahut**?<sup>g</sup> <sup>73</sup> Ata që adhurohen nga

---

<sup>a</sup> Imazhi i tyre për Zotin është se Ai mund të ketë vetëm bija, edhe pse ata vetë kanë neveri për bijat e tyre.

<sup>b</sup> dmth. bijtë.

<sup>c</sup> Ky kuptim i *farata* përkrahet nga Razi.

<sup>d</sup> Pabesimtarët bënin be në idhujt e tyre, prandaj këtu Zoti bën be në Vetën.

<sup>e</sup> Kjo i referohet pabesimtarëve të Mekës.

<sup>f</sup> Fjala arabe *sakar* domethënë 'verë', 'lëng' apo 'uthull' (*al-Mu'jam al-Wasit*).

<sup>g</sup> dmth. të pretendojnë se partnerët që ia mveshin Zotit janë ata që u japin bekime të tilla.

ta pos **Allahut** nuk kanë pushtet për të furnizuar asgjë për ta nga qiejt a toka: s'mund të bëjnë asgjë. <sup>74</sup> Pra mos trilloni imazhe për **Allahun**: **Allahu** di dhe ju nuk dini.

<sup>75</sup> **Allahu** e paraqet këtë ilustrim: një skllav i kontrolluar nga zotëria i tij, pa pushtet ndaj asgjëje dhe një njeri tjetër që Ne e kemi furnizuar me furnizim të mirë, nga i cili jep lëmoshë privatisht dhe haptas. A mund të konsiderohen të barabartë? Tërë lëndë i përket **Allahut**, por shumica nga ta nuk e pranojnë këtë.

<sup>76</sup> **Allahu** e paraqet edhe një ilustrim tjetër: dy njerëz, njëri nga ta i pamend, i paaftë të bëjë asgjë, barrë për bartësin e tij – çfarëdo pune që e drejton ai ta bëjë, ky nuk arrin asgjë të mirë – a mund të konsiderohet ai i barabartë me atë që urdhëron drejtësi dhe është në rrugën e drejtë? <sup>77</sup> Gjithçka që është e fshehur nga pamja në qiej e tokë i përket **Allahut**. Ardhja e Orës së Gjykimit është si kapsitja e syrit, apo edhe më e shpejtë: **Allahu** ka pushtet ndaj gjithçkaje.

<sup>78</sup> Është **Allahu** Ai që ju nxori nga brendësia e nënave tuaja duke mos ditur ju asgjë dhe ju dha dëgjim e të pamur e mendje, që të mund të ishit falënderues. <sup>79</sup> A nuk i shohin shpezët që janë bërë të fluturojnë nëpër ajrin në qiell? Asgjë nuk i mban lart pos **Allahut**. Vërtet ka shenja në këtë për ata që besojnë. <sup>16:80</sup> Është **Allahu** Ai që ju ka dhënë vend të pushimit në shtëpitë tuaja dhe nga lëkurat e kafshëve ju ka ndërtuar shtëpi që ju duken të lehta [të merreni me to] kur udhëtoni dhe kur e ngritni një kamp; veshje dhe komoditet për ca kohë nga leshi, gëzofi dhe jelet e tyre. <sup>81</sup> Është **Allahu** Ai që ju ka dhënë hije nga ato që i ka krijuar dhe vende të strehimit në male; veshje për t'ju mbrojtur nga nxehtësia dhe veshje për t'ju mbrojtur në luftërat tuaja. Në këtë mënyrë Ai i përsos bekimet E Tij mbi ju, që të mund t'i kushtoheni. <sup>82</sup> Por nëse shmangen [Profet], obligimi yt i vetëm është ta përcjellësh mesazhin qartë. <sup>83</sup> Ata i dinë bekimet e **Allahut**, por refuzojnë t'i njohin publikisht: shumica nga ta janë mosmirënjohës.

<sup>84</sup> Do të vijë dita kur Ne e ngritim nga një dëshmitar nga secili komunitet, kur pabesimtarët nuk do të lejohen të bëjnë arsyetime a ndryshime. <sup>85</sup> Kur keqbërësit përballen me ndëshkimin ai nuk do të zbutet për ta as s'do t'u jepet ndonjë shtyrje e afatit. <sup>86</sup> Kur idhujtarët i shohin partnerët që i bashkonin me **Allahun** do të thonë: 'Zoti ynë, këta janë partnerët që u luteshim dikur krahas Teje', por partnerët do të përgënjeshtrojnë: 'Jeni rrenacakë', <sup>87</sup> dhe në atë Ditë do të ofrojnë nënshtrim të plotë ndaj **Allahut**: hyjnitë e tyre të rreme do t'i braktisin. <sup>88</sup> Për shkak të korrupsionit që e shpërndajnë, do të shtojmë torturë pas torture për ata që nuk besuan dhe i ndaluan të tjerët nga rruga e **Allahut**.

<sup>89</sup> Do të vijë dita kur Ne e ngritim në çdo komunitet një dëshmitar kundër tyre dhe do të të sjellim [ty Profet] si dëshmitar kundër këtyre njerëzve, se ta kemi zbritur Librin e Shenjtë duke shpjeguar gjithçka dhe si udhëzim e mëshirë e lajm të mirë për ata që i kushtohen **Allahut**.

<sup>16:90</sup> **Allahu** urdhëron drejtësi, të bësh mirë dhe zemërgjerësi ndaj të afërmeve dhe e ndalon atë që është e turpshme, e qortueshme dhe tiranike. Ai ju mëson, që të mund të jeni të vëmendshëm. <sup>91</sup> Përmbusheni çfarëdo premtimi që e bëni në emrin e **Allahut** dhe mos i shkelni betimet pasi të jeni betuar, se e keni bërë **Allahun** garantues tuajin: **Allahu** di gjithçka që bëni. <sup>92</sup> Mos i përdorni betimet tuaja për ta mashtruar njëri-tjetrin – si një grua që e shtur fillin që e ka tjerë fort – veç sepse njëra palë mund të jetë më e numërt se tjetra. **Allahu** ju sprovon me këtë dhe në Ditën e Ringjalljes do t’jua bëjë të qarta ato gjëra për të cilat dallonit.

<sup>93</sup> Po të donte **Allahu**, do t’ju bënte të gjithëve një popull, por Ai e lë të devijojë këdo që do ta lërë dhe e udhëzon këdo që do ta udhëzojë. Do të merreni në pyetje për veprat tuaja. <sup>94</sup> Mos i përdorni betimet tuaja për ta mashtruar njëri-tjetrin, siç nuk do të duhej ndonjë këmbë të rrëshqasë pasi të ketë shkelur fort, përndryshe duhet ta shijoni ndëshkimin për pengimin e të tjerëve nga rruga e **Allahut** dhe të vuani torturë të tmerrshme. <sup>95</sup> Mos e shitni për çmim të vogël asnjë zotim të bërë në emrin e **Allahut**: ajo që e ka **Allahu** [për ta dhënë] është më e mirë për ju, veç po ta dinit. <sup>96</sup> Ajo që e keni harxhohet por ajo që e ka **Allahu** zgjat dhe Ne sigurisht do t’i shpërblejmë ata që mbahen të qëndrueshëm sipas veprimeve të tyre më të mira. <sup>97</sup> Kujtdo qoftë, mashkull a femër, që bën vepra të mira dhe ka besim, do t’i japim jetë të mirë dhe do ta shpërblejmë sipas veprave të tij më të mira.

<sup>98</sup> [Profet,] kur e reciton Kuranin, kërkoje mbrojtjen e **Allahut** nga i dëbuari, Satani. <sup>99</sup> Ai nuk ka pushtet ndaj atyre që besojnë dhe mbështeten në Zotin e tyre; <sup>16:100</sup> pushteti i tij është veç ndaj atyre që shoqërohen me të dhe ata që, për shkak të tij, bashkojnë partnerë me **Allahun**. <sup>101</sup> Kur Ne e zëvendësojmë një shpallje me një tjetër – dhe **Allahu** e di më së miri atë që e zbulon – thonë: ‘Ti veç po e sajoni’, por shumica nga ta nuk kanë dije. <sup>102</sup> Thuaj që Shpirti i Shenjtë<sup>a</sup> e ka sjellë Shpalljen me Të Vërtetën hap pas hapi nga Zoti juaj, për t’i forcuar besimtarët dhe si udhëzim e lajm të mirë për të devotshmit. <sup>103</sup> Ne e dimë shumë mirë se thonë: ‘Është një njeri që e mëson atë’, por gjuha e personit për të cilin aludojnë është e huaj, gjersa kjo shpallje është në arabishte të pastër. <sup>104</sup> Nëse njerëzit nuk besojnë në shpalljen e **Allahut**, **Allahu** nuk i udhëzon dhe i pret një ndëshkim i dhembshëm. <sup>105</sup> Falsiteti trillohet veç nga ata që nuk besojnë në shpalljen e **Allahut**: ata janë rrenacakë. <sup>106</sup> Me përjashtim të atyre që detyrohen të thonë se nuk besojnë, edhe pse zemrat e tyre mbahen të qëndrueshme në besim, ata që e refuzojnë **Allahun** pasi të kenë besuar në Të dhe ia hapin zemrat e tyre mosbesimit do ta kenë zemërimin e **Allahut** mbi ta dhe do të jetë duke i prituri një ndëshkim i trishtueshëm. <sup>107</sup> Kjo për shkak se e duan jetën e kësaj bote më shumë se atë që do të vijë dhe **Allahu** nuk i udhëzon ata që e refuzojnë Atë.

---

<sup>a</sup> Kjo i referohet Engjëllit Xhebrail.

<sup>108</sup> Këta janë njerëz për të cilët zemrat, dëgjimi dhe të pamurit janë mbyllur nga **Allahu**: janë të pavëmendje <sup>109</sup> dhe nuk ka dyshim se do të jenë humbësit në Të Përtejmen. <sup>16:110</sup> Por Zoti juaj do të jetë më falësi dhe më mëshirëploti për ata që i lënë shtëpitë e tyre pas përndjekjes, pastaj bëjnë përpjekje dhe mbahen të qëndrueshëm. <sup>111</sup> Në Ditën kur çdo shpirt do të vijë të argumentojë për mbrojtjen e tij, çdo shpirt do të paguhet plotësisht për të gjitha veprimet e tij – nuk do t'u bëhet e padrejtë. <sup>112</sup> **Allahu** e paraqet shembullin e një qyteti që ishte i sigurt dhe i qetë, me furnizime duke i ardhur me bollëk nga të gjitha anët. Pastaj u bë mosmirënjohës ndaj bekimeve të **Allahut**, kështu që **Allahu** e pikëlloi me veshjen e urisë dhe të frikës, për atë që e kishin bërë njerëzit e tij. <sup>113</sup> Një i dërguar që ishte një nga ta u erdhi, por e quajtnë rrenacak. Prandaj ndëshkimi i tronditi pikërisht gjatë keqbërjes së tyre.

<sup>114</sup> Pra hani nga gjërat e mira e të ligjshme që jua ka siguruar **Allahu** dhe jini falënderues për bekimet E Tij,<sup>a</sup> nëse është Ai - ai që e adhuroni. <sup>115</sup> Ai jua ka ndaluar veç këto gjëra: cofëtinën, gjakun, mishin e derrit dhe kafshët mbi të cilat është thirrur çfarëdo emri tjetër pos i **Allahut**. Por nëse kushdo detyrohet nga uria, duke mos e dëshiruar atë as duke mos e tejkaluar nevojën e tij urgjente, **Allahu** është falës dhe mëshirëplotë. <sup>116</sup> Mos thoni gabimisht: 'Kjo është e ligjshme dhe ajo është e ndaluar', duke shpikur rrenë për **Allahun**: ata që shpikin rrena për **Allahun** nuk do të përparojnë – <sup>117</sup> mund të kenë pak kënaqësi, por i pret ndëshkim i dhembshëm. <sup>118</sup> [Profet,] Ne ua ndaluam çifutëve ato për të cilat të treguam.<sup>b</sup> Nuk i kemi dëmtuar; e dëmtuan veten. <sup>119</sup> Por ndaj atyre që bëjnë gabim nga padituria dhe pastaj pendohen e bëjnë përmirësime, Zoti juaj është më falësi dhe më mëshirëploti.

<sup>16:120</sup> Ibrahim i ishte vërtet shembull: i bindur devotshmërisht ndaj **Allahut** dhe i sinqertë në besim. Nuk ishte idhujtar; <sup>121</sup> ishte falënderues për bekimet e **Allahut** që e zgjodhi dhe e udhëzoi në rrugë të drejtë. <sup>122</sup> Ne i dhamë bekime në këtë botë dhe është ndër të ndershmit në Të Përtejmen. <sup>123</sup> Pastaj të shpallëm [Muhamed]: 'Ndiqe mënyrën e besimit të Ibrahimit, njeri i besimit të pastër që nuk ishte idhujtar.' <sup>124</sup> Sabathi ishte bërë i detyrueshëm veç për ata që kishin dallime rreth tij. Në Ditën e Ringjalljes Zoti juaj do të gjykojë ndërmjet tyre në lidhje me dallimet e tyre.

<sup>125</sup> [Profet,] thirr [njerëzit] në rrugën e Zotit tënd me urti dhe mësimdhënie të mirë. Argumento me ta në mënyrën më të sjellshme, se Zoti yt e di më së miri se kush ka devijuar nga rruga E Tij dhe kush është i udhëzuar si duhet. <sup>126</sup> Nëse [ju besimtarë] duhet t'i reagoni një sulmi, bëjeni reagimin tuaj proporcional, por më së miri është të qëndroni fort. <sup>127</sup> Pra [Profet] ji i qëndrueshëm: qëndrueshmëria

---

<sup>a</sup> Për dallim nga njerëzit mosmirënjohës që sapo u përmendën.

<sup>b</sup> Në një shpallje të mëhershme (shih 6:146).

jote vjen veç nga **Allahu**. Mos i vajto; mos u shqetëso nga intrigat e tyre, <sup>128</sup> se **Allahu** është me ata që janë të vetëdijshëm për Të dhe që bëjnë mirë.

**Përshkrimi para kaptinës 16 nga Abdel Haleem:**

*Sure mekase. E merr titullin nga bleta (vargjet 68-9) e frymëzuar në mënyrën e saj të jashtëzakonshme nga **Allahu**. Ky është veç një nga shembujt e shumtë të dhënë në këtë sure të mirësisë së **Allahut** dhe të shumë gjërave për të cilat njeriu duhet të jetë mirënjohës. Kaptina i ndëshkon idhujtarët që ia atribuojnë bujarinë e **Allahut** fuqive të tjera dhe adhurojnë hyjni të rreme. Ibrahim i jepet në fund si shembull për ta ndjekur për komunitetin mysliman. Deri në vargun 88 kaptina i drejtohet politeistëve; nga vargu 90 e tutje u jep mësimë myslimanëve në mënyra të ndryshme. Vargu 89 i lidh dy pjesët duke e përmendur Profetin si dëshmitar të besimtarëve dhe pabesimtarëve të komunitetit të tij.*

## 17: Udhëtimi i natës (EL-ISRÂ')

Në emrin e **Allahut**, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës

<sup>1</sup> Lâvdi është për Atë që e bëri shërbyesin E Tij të udhëtojë natën nga vendi i shenjtë i adhurimit në vendin më të largët të adhurimit, ambientet e të cilit Ne i kemi bekuar, për t'ia treguar disa nga shenjat Tona: veç Ai është Gjithë-Dëgjuesi, Gjithë-Pamësi. <sup>2</sup> Ne po ashtu ia dhamë Musait Shkrimin e Shenjtë dhe e bëmë udhëzues për Fëmijët e Izraelit. 'Mos ia besoni veten askujt pos Meje, <sup>3</sup> ju pasardhës të atyre që i bartëm me Nuhun: ai ishte vërtet shërbyes falënderues.'

<sup>4</sup> Ne u deklaruar Fëmijëve të Izraelit në Shkrimin e Shenjtë: 'Dy herë do të përhapni korrupsion në vend dhe do të bëheni shumë arrogantë.' <sup>5</sup> Kur u përmbush i pari nga këto paralajmërime, dërguam kundër jush shërbyes Tanët me forcë të madhe dhe jua shkatërruan shtëpitë. Ai paralajmërim u pat përmbushur, <sup>6</sup> por pastaj ju lejuam ta mbizotëroni armikun tuaj. Jua rritëm pasurinë dhe pasardhësit dhe ju bëmë më të numërt – <sup>7</sup> kurdo që bëni mirë apo keq kjo është për shpirtrat tuaj – dhe kur u përmbush paralajmërimi i dytë [i dërguam ata] t'jua turpërojnë fytyrat dhe të futen në vendin e adhurimit siç bënë herën e parë dhe të shkatërrojnë plotësisht gjithçka që u ra në dorë. <sup>8</sup> Zoti juaj mund të ketë ende mëshirë për ju, por nëse e bëni të njëjtën prapë, po ashtu do të bëjmë edhe Ne: e kemi bërë Ferrin burg për ata që [e] shpërfillin [paralajmërimin Tonë].

<sup>9</sup> Ky Kuran vërtet e tregon rrugën më të drejtë. Ai ua jep besimplotëve që bëjnë mirë lajmin e mirë se do të kenë shpërblim të madh dhe <sup>17:10</sup> paralajmëron se Ne kemi përgatitur ndëshkim plot vuajtje për ata që nuk besojnë në botën tjetër. <sup>11</sup> E megjithatë njeriu lutet për dëm, siç lutet për të mirë: njeriu është gjithnjë i nxituar. <sup>12</sup> Ne e kemi bërë natën dhe ditën si dy shenja, pastaj e errësuam natën dhe e bëmë dritën e ditës për të parë, që ta kërkoni mirësinë e Zotit tuaj dhe ta dini si t'i numëroni vitet dhe të llogaritni. Kemi shpjeguar gjithçka në hollësi. <sup>13</sup> E kemi lidhur fatin e secilës qenie njerëzore për qafën e vet. Në Ditën e Ringjalljes, do ta nxjerrim një regjistër për secilin nga ta, të cilin do ta gjejnë të hapur gjerë-e-gjatë: <sup>14</sup> 'Lexoje regjistrin tënd. Sot shpirti yt është i mjaftueshëm për ta llogaritur vlerësimin tënd.'

<sup>15</sup> Kushdo që e pranon udhëzimin e bën këtë për të mirën e tij; kushdo që devijon e bën në rrezik të vetin. Asnjë shpirt nuk do ta bartë barrën e tjetrit dhe Ne nuk ndëshkojmë deri kur ta kemi çuar një të dërguar. <sup>16</sup> Kur vendosim ta shkatërrojmë një qytet, i urdhërojmë ata që janë korruptuar me pasuri [për t'u reformuar], por ata rrinë [duke këmbëngulur] në mos-bindjen [e tyre]; vendimi Ynë dënues përmbushet dhe i shkatërrojmë plotësisht. <sup>17</sup> Sa shumë breza i kemi



shkatërruar që nga Nuhu! Zoti yt i njeh dhe i vëzhgon mëkatet e shërbyesve Të Tij fare mirë. <sup>18</sup> Nëse dikush e ka merak [veç] jetën që kalon shpejt, shpejtojmë çkado që shpejtojmë në të, për këdo që duam; në fund e kemi përgatitur Ferrin për të që të digjet në të, i çnderuar e i refuzuar. <sup>19</sup> Por nëse dikush e ka merak jetën vijuese dhe përpiket për të si duhet, si besimtar i vërtetë, përpjekja e tij do të falënderohet. <sup>17:20</sup> Edhe këtyre të dytëve edhe atyre të parëve, ua japim ca nga mirësitë e Zotit tënd. [Profet,] mirësia e Zotit tënd nuk është e kufizuar – <sup>21</sup> shih si u kemi dhënë disave më shumë se të tjerëve – por E Përtejma mban grada më të larta dhe favore më të mëdha.

<sup>22</sup> Mos merrni<sup>a</sup> për zot asgjë tjetër pos **Allahut**, përndryshe do të përfundoni të turpëruar dhe të braktisur. <sup>23</sup> Zoti juaj ju ka urdhëruar që nuk duhet të adhuroni asgjë pos Tij dhe të jeni të këndshëm me prindërit tuaj. Nëse njëri apo të dytë e arrijnë pleqërinë me ju, mos e thoni asnjë fjalë që tregon padurim me ta dhe mos jini të ashpër me ta, por foljuni me respekt <sup>24</sup> dhe silluni butë e me modesti ndaj tyre në mirësi dhe thuani: ‘Zot, ki mëshirë ndaj tyre, siç janë kujdesur për mua në vegjëli.’ <sup>25</sup> Zoti juaj e di më së miri se çka ka në zemrën tuaj. Në qofshi të mirë, Ai është më falësi për ata që kthehen tek Ai. <sup>26</sup> Jepuani të afërmeve atë që u takon dhe atyre në nevojë dhe udhëtarëve – mos e shkapërderdhni pasurinë tuaj kot: <sup>27</sup> ata që shkapërderdhin janë vëllezërit e Satanit dhe Satani është më mosmirënjohësi ndaj Zotit të tij – <sup>28</sup> por nëse, gjersa jeni duke e kërkuar ndonjë mirësi që e pritni nga Zoti juaj, i refuzoni, atëherë të paktën thuajani atyre ndonjë fjalë të qetësisë. <sup>29</sup> Mos jini dorë-shtrënguar, as kaq dorë-lirë sa që të përfundoni të fajësuar dhe të tronditur me pishman. <sup>17:30</sup> Zoti juaj i jep begatshëm kujtdo që do t’i japë dhe me masë kujtdo që do t’i japë: Ai i njeh dhe i vëzhgon hollësisht shërbyesit E Tij.

<sup>31</sup> Mos i vrisni fëmijët tuaj nga frika e varfërisë<sup>b</sup> – Ne do të furnizojmë për ta dhe për ju – vrasja e tyre është mëkat i madh. <sup>32</sup> Dhe as mos iu afroni fare shkeljes së kurorës: është tepër zemëruese dhe rrugë e ligë. <sup>33</sup> Mos merrni jetë, të cilën **Allahu** e ka bërë të shenjtë, pos me të drejtë: nëse dikush vritet padrejtësisht, Ne i kemi dhënë autoritet mbrojtës të të drejtave të tij, por ai nuk duhet të jetë teprues në marrjen e jetës, se tashmë është i ndihmuar [nga **Allahu**]. <sup>34</sup> Mos iu afroni pronës së jetimit,<sup>c</sup> pos me më të mirat [qëllime], deri kur ta arrijë moshën e pjekurisë. Mbani zotimet tuaja: do të merreni në pyetje për zotimet tuaja. <sup>35</sup> Jepni masë të plotë kur të matni dhe peshoni me peshore të sakta: kjo është më e mirë dhe më e drejtë në fund. <sup>36</sup> Mos e ndiqni verbërisht atë që nuk e dini se a është e vërtetë: veshët, sytë dhe zemra – do të merreni në pyetje për të gjitha këto. <sup>37</sup> Mos u krekosni me arrogancë nëpër tokë: nuk mund ta çani atë, as të mateni me malet

---

<sup>a</sup> Kjo folje i drejtohet njerëzimit si tërësi (Razi).

<sup>b</sup> Shih 81:8-9

<sup>c</sup> Krahaso me 4:2

për nga lartësia. <sup>38</sup> E liga e të gjitha këtyre veprimeve është e urrejtshme për Zotin tuaj.

<sup>39</sup> [Profet,] kjo është ca nga urtia që ta ka shpallur Zoti yt: mos merr për zot diçka tjetër krahas **Allahut**, përndryshe do të të hedhin në Ferr, të fajësuar e të refuzuar. <sup>17:40</sup> Çka? A ju ka favorizuar Zoti juaj juve njerëzve me djem dhe i ka marrë vajzat për Vete nga engjëjt?<sup>a</sup> Çfarë gjëje monstrooze del nga goja juaj!

<sup>41</sup> Ne i kemi shpjeguar gjërat në mënyra të ndryshme në këtë Kuran, ashtu që njerëzit e tillë të mund ta kenë parasysh, por kjo veçse i ka larguar më shumë. <sup>42</sup> Thuaj: ‘Po të kishte zota të tjerë krahas Tij, siç thonë se ka, atëherë do të kishin provuar ta gjejnë një rrugë për te Zoti i Fronit.’ <sup>43</sup> Lâvdi është për Të! Ai është shumë lart mbi atë që e thonë! <sup>44</sup> Shtatë qiejt dhe toka dhe çdokush në to e lavdojnë Atë. Nuk ka as një gjë të vetme që nuk e feston lavdërimin E Tij, megjithëse ju nuk e kuptoni lavdërimin e tyre: Ai është më i durueshmi, më falësi.

<sup>45</sup> [Profet,] kur e lexon Kuranin, Ne vëmë pengesë të padukshme ndërmjet teje dhe atyre që nuk besojnë në jetën tjetër. <sup>46</sup> Kemi vënë mbulesa në zemrat e tyre që u pengojnë ta kuptojnë atë, dhe rëndesë në veshët e tyre. Kur e përmend Zotin tënd në Kuran dhe veç Atë, e kthejnë shpinën dhe largohen me vrap. <sup>47</sup> Ne e dimë më së miri mënyrën se si dëgjojnë, kur të dëgjojnë dhe kur bisedojnë në fshehtësi dhe ata keqbërës thonë: ‘Ju veç po e ndiqni një njeri që është i magjepsur.’ <sup>48</sup> Shih çka mendojnë se je! Por ata janë të humbur dhe nuk mund ta gjejnë rrugën. <sup>49</sup> Thonë edhe: ‘Çka? Kur të kthehemi në eshtra e pluhur, vërtet do të ngritemi në një vepër të re të krijimit?’ <sup>17:50</sup> Thuaj: ‘[Po] edhe po të ishit [të fortë si] gur, apo hekur, <sup>51</sup> apo çfarëdo substance tjetër që ju duket e vështirë të sillet në jetë.’ Pastaj do të thonë: ‘Kush do të na kthejë prapa?’ Thuaj: ‘Ai që ju krijoi herën e parë.’ Pastaj do t’ju tundin kokat dhe do të thonë: ‘Kur do të ndodhë kjo?’ Thuaj: ‘Mund të ndodhë shumë shpejt: <sup>52</sup> do të jetë Dita kur Ai ju thërret dhe ju përgjigjeni duke e lavdëruar dhe mendoni se keni qëndruar [në tokë] veç pak.’

<sup>53</sup> [Profet,] thuaju shërbyesve të Mi ta thonë atë që është më e mira.<sup>b</sup> Satani mbjell përçarje mes tyre: Satani është armik i betuar i njeriut. <sup>54</sup> Zoti yt e ka njohurinë më të madhe për të gjithë ju: nëse Ai do – do të ketë mëshirë për ju dhe nëse Ai do – do t’ju ndëshkojë. [Profet,] Ne nuk të kemi dërguar të marrësh përgjegjësi për ta. <sup>55</sup> Zoti yt e di më së miri për secilin në qiej dhe në tokë. Ne u dhamë disa profetëve më shumë se të tjerëve: Ne ja dhamë Daudit një libër [të Psalmeve].<sup>c</sup> <sup>56</sup> Thuaj: ‘Thirrni ata që pretendoni se janë hyjni krahas **Allahut**: nuk kanë pushtet ta heqin a ta shmangin asnjë dëm nga ju.’ <sup>57</sup> Ata [engjëj]<sup>d</sup> të

---

<sup>a</sup> Shih edhe 16:57-62

<sup>b</sup> Gjatë argumentimit rreth fesë dhe vërtetimit të saj siç e ka treguar **Allahu** këtu. Shih 16:125; 29:46.

<sup>c</sup> Shih edhe 4:163-6

<sup>d</sup> Shih vargun 40.

cilëve u luten janë vetë duke e kërkuar një rrugë te Zoti i tyre, madje edhe ata që janë më së afërmi me Të. Shpresojnë për mëshirën E Tij dhe ia kanë frikën ndëshkimit Të Tij. Ndëshkimi i Zotit tuaj është për t'ia pasë frikën fort: <sup>58</sup> nuk ka komunitet<sup>a</sup> që Ne nuk do ta shkatërrojmë, apo nuk do ta ndëshkojmë ashpër, para Ditës së Ringjalljes – kjo është e shkruar te Libri.<sup>b</sup>

<sup>59</sup> Asgjë nuk na pengon të dërgojmë shenja mrekullie,<sup>c</sup> përveç faktit se popujt e mëparshëm i mohuan ato. Ne ia dhamë popullit të Themudit devenë si shenjë të qartë, e megjithatë e keqtrajtuam. Ne dërgojmë shenja veç për të çuar paralajmërim. <sup>17:60</sup> [Profet,] të kemi thënë se Zoti yt i di të gjitha për qeniet njerëzore. Vegimi<sup>d</sup> që ta treguam ishte veç sprovë për njerëzit, siç ishte pema e mallkuar [e përmendur] në Kuran.<sup>e</sup> Ne i paralajmërojmë, por kjo veç sa ua rrit mendjen.

<sup>61</sup> Kur Ne u thamë engjëjve: 'Përkuluni para Ademit', të gjithë u përkulën, por jo Iblisi. Ai kundërshtoi: 'Pse do të duhej t'i përkulem dikujt që Ti e ke krijuar nga balta?' <sup>62</sup> dhe [pastaj] tha: 'A e sheh këtë qenie që e ke nderuar mbi mua? Nëse ma anulon ndëshkimin me vdekje deri në Ditën e Ringjalljes, do t'i ngreh për hunde të gjithë pos disa nga pasardhësit e tij.' <sup>63</sup> **Allahu** tha: 'Largohu! Ferri do të jetë shpërblimi yt dhe shpërblimi i cilëve nga ta që të ndjekin – shpërblim i bollshëm. <sup>64</sup> Aktivizoji cilëtdo nga ta që mundesh me zërin tënd, mbledhe kalorësinë dhe këmbësorinë tënde kundër tyre, hyrju në hise në pasurinë dhe fëmijët e tyre dhe jepu premtime – Satani nuk u premtonte asgjë pos deluzionit – <sup>65</sup> por nuk do të kesh kurrfarë autoriteti ndaj shërbyesve të Mi [të vërtetë]: Zoti yt mund të kujdeset për ta fare mirë.'

<sup>66</sup> [Njerëz,] është Zoti juaj Ai që i bën anijet të ecin lëmueshëm për ju në det ashtu që të mund ta kërkonit mirësinë E Tij: Ai është më mëshirëploti ndaj jush. <sup>67</sup> Kur ju kap fatkeqësia në det, ata të cilëve u luteni krahas Tij ju braktisin, por kur Ai ju kthen të sigurt në tokë largoheni: njeriu është gjithmonë mosmirënjohës. <sup>68</sup> A mund të jeni të sigurt se **Allahu** nuk do t'ju bëjë të gllabëruar në dhë kur të ktheheni në tokë, apo se nuk do ta dërgojë një stuhi të rërës kundër jush? Pastaj nuk do ta gjeni askë t'ju mbrojtë. <sup>69</sup> Apo a mund të jeni të sigurt se nuk do t'ju kthejë në det dhe ta dërgojë një stuhi të fortë kundër jush që t'ju fundosë se jeni kaq mosmirënjohës? Nuk do ta gjeni asnjë ndihmës kundër Nesh atje. <sup>17:70</sup> Ne i kemi nderuar fëmijët e Ademit dhe i bartëm nëpër tokë e det; kemi furnizuar mjete të mira jetese për ta dhe i kemi favorizuar veçanërisht përmbi shumë nga ato që i kemi krijuar.

---

<sup>a</sup> Të keqbërësve. Shih 18:16; 7:101

<sup>b</sup> Regjistri hyjnor i **Allahut**.

<sup>c</sup> Shih 2:118 për shenjat e kërkuara nga ata pa njohuri.

<sup>d</sup> Vegimi që i ishte shfaqur në Udhëtimin e Natës.

<sup>e</sup> Thuhet se i referohet pemës së Zaqqum-it në Ferr (shih 56:52; 44:43-6). Ai që i ha do t'i mallkojë frutat e saj (Razi). Edhe vegimi edhe pema në Pemë ishin objekte të talljes për mosbesimtarët.

<sup>71</sup> Në Ditën kur Ne e thërrasim secilin komunitet, bashkë me udhëheqësin e tyre,<sup>a</sup> ata të cilëve u jepet regjistri i tyre në dorën e djathtë do ta lexojnë [me kënaqësi].<sup>b</sup> Por askush nuk do të dëmtohet aspak: <sup>72</sup> ata që ishin të verbër në këtë jetë do të jenë të verbër edhe në Të Përtejmen dhe madje edhe më larg rrugës. <sup>73</sup> [Profet,] mosbesimtarët u munduan të të tundonin larg asaj që ta kemi shpallur, që të shpikje ndonjë shpallje tjetër dhe të na e atribuojë Neve dhe pastaj do të të merrnin për mik. <sup>74</sup> Po të të mos bënim të qëndroje fort, pothuajse do të anoheshe pak kah ta. <sup>75</sup> Në atë rast, do të të kishim bërë të shijosh ndëshkim të dyfishtë në këtë jetë dhe ndëshkim të dyfishtë pas vdekjes dhe pastaj nuk do ta gjeje askë të të ndihmonte kundër Nesh. <sup>76</sup> Ata planifikuan të të trembin nga vendi, por nuk do t'u zgjaste veçse pak pas teje. <sup>77</sup> E tillë ishte mënyra Jonë me të dërguarit që i çuam para teje dhe nuk do të gjesh ndryshim në mënyrat Tona.

<sup>78</sup> Pra kryeji lutjet e faljet e rregullta në periudhën prej kohës kur dielli e ka kaluar zenitin deri në errësirën e natës dhe [recitaje] Kuranin në agim – recitimi i agimit dëshmohet gjithmonë<sup>c</sup> – <sup>79</sup> dhe gjatë natës çohu dhe falu, si ofertë shtesë e jotja, që Zoti yt të mund të të ngrisë në status të lavdëruar [shumë]. <sup>17:80</sup> Thuaj: ‘Zoti im, më bëj të hyj sinqerisht dhe të dal sinqerisht dhe më dhuro autoritet përkrahës nga Ti.’ <sup>81</sup> Dhe thuaj: ‘E vërteta ka ardhur dhe gënjeshtria ka vdekur: gënjeshtria është e destinuar të vdesë.’

<sup>82</sup> Ne e zbresim Kuranin si shërim e mëshirë për ata që besojnë; sa për ata që nuk besojnë, veç sa ua rrit humbjen. <sup>83</sup> Kur e favorizojmë njeriun ai kthehet me arrogancë në një anë, por kur e prek dëmi, bie në dëshpërim. <sup>84</sup> Thuaj: ‘Çdokush i bën gjërat në mënyrën e tij, por Zoti juaj është plotësisht i informuar se kush e ndjek rrugën e udhëzuar më së miri.’

<sup>85</sup> [Profet,] të pyesin për Shpirtin. Thuaj: ‘Shpirti është pjesë e domenit të Zotit tim. Juve ju është dhënë veç pak njohuri.’ <sup>86</sup> Po të donim, Ne do të mund të ta merrnim atë që ta kemi shpallur – pastaj nuk do ta gjeje askë të lutej për ty kundër Nesh – <sup>87</sup> po të mos ishte mëshira e Zotit tënd: favori I Tij ndaj teje ka qenë vërtet i madh. <sup>88</sup> Thuaj: ‘Edhe po të bashkoheshin tërë njerëzimi dhe xhindet për të prodhuar diçka si ky Kuran, nuk do të mund të prodhonin asgjë si ai, sado që do t'i ndihmonin njëri-tjetrit.’ <sup>89</sup> Në këtë Kuran, Ne i kemi dhënë të gjitha llojet e shembujve për njerëzit, e megjithatë shumica nga ta këmbëngulin në mosbesim. <sup>17:90</sup> Thonë: ‘Ne nuk do të besojmë për ty [Muhamed] deri kur ta bësh një burim të gufojë nga toka për ne; <sup>91</sup> apo deri kur ta kesh një kopsht me palma hurme e hardhi dhe të bësh lumenj të rrjedhin nëpër to; <sup>92</sup> apo ta bësh qiellin të bijë mbi ne në copa, siç pretendove se do të ndodhë; apo ta sjellësh

---

<sup>a</sup> Shih 16:89.

<sup>b</sup> Krahaso me 69:19-24.

<sup>c</sup> Nga engjëjt. Shih Bukhari, *Sahih*, ‘*Mawaqit*’, 16.

**Allahun** dhe engjëjt para nesh ballë-për-ballë; <sup>93</sup> apo ta kesh një shtëpi të ndërtuar nga ari; apo të ngritesh në qiell – madje edhe atëherë, nuk do të besojmë në ngritjen tënde deri kur ta zbresësh një libër të vërtetë që ta lexojmë.’ Thuaj: ‘Lâvdi qoftë për Zotin tim! A jam ndojgjë tjetër pos vdekatar, i dërguar?’ <sup>94</sup> E vetmja gjë që i pengonte këta njerëz të besojnë, kur u erdhi udhëzimi, ishte kur thanë: ‘Si do të mund të kishte dërguar **Allahu** qenie njerëzore si të dërguar?’ <sup>95</sup> Thuaj: ‘Po të kishte engjëj që ecin përreth nëpër tokë, duke u ndier si në shtëpi, Ne do t’ua kishim çuar atyre një engjëll nga Parajsa si të dërguar.’ <sup>96</sup> Thuaj: ‘**Allahu** është dëshmitar i mjaftueshëm ndërmjet meje dhe jush. Ai i njeh dhe i vëzhgon mirë shërbyesit E Tij.’

<sup>97</sup> [Profet,] kushdo të cilin e udhëzon **Allahu** është i udhëzuar vërtet, dhe nuk do të gjesh asnjë mbrojtës pos Tij për askë që Ai e lë të devijojë. Në Ditën e Ringjalljes Ne do t’i grumbullojmë, me fytyra përtokë, të verbër, memecë e të shurdhër. Ferri do të jetë Shtëpia e tyre. Sa herë që Zjarri nis të fiket, Ne do ta bëjmë të ndizet më ashpër për ta. <sup>98</sup> Kjo është ajo që do ta marrin për refuzimin e shenjave Tona dhe për thënien: ‘Çka? Kur të kthehemi në eshtra e pluhur, si mund të ngritemi në akt të ri të krijimit?’ <sup>99</sup> A nuk e shohin se **Allahu**, që i krijoi qiejt dhe tokën, mund t’i krijojë të ngjashmit e tyre [përsëri]? Ai e ka caktuar një kohë për ta – nuk ka dyshim për këtë – por keqbërësit refuzojnë gjithçka pos mosbesimit. <sup>17:100</sup> Thuaj: ‘Po t’i zotëronit edhe vetë depot e mirësisë së Zotit tim, do t’i kursenit nga frika e shpenzimit: njeriu është gjithmonë dhënës pa qejf.’

<sup>101</sup> Në të shkuarën, Ne ia dhamë Musait nëntë shenja të qarta – pyeti Fëmijët e Izraelit. Kur Musai u erdhi [egjiptianëve], Faraoni i tha: ‘Musa, mendoj se je magjepsur.’ <sup>102</sup> Ai tha: ‘Ti e di shumë mirë se veç Zoti i qiejve dhe i tokës do të mund t’i dërgonte këto shenja si provë të qartë. Mendoj se ti, Faraon, je i destinuar të mbarosh keq.’ <sup>103</sup> Kështu ai deshi t’i fshinte prej [fytyrës së] tokës, por Ne e fundosëm atë dhe ata që ishin me të. <sup>104</sup> Pas vdekjes së tij, u thamë Fëmijëve të Izraelit: ‘Jetoni në vend dhe kur të plotësohet premtimi i Të Përtejmes, do t’ju sjellim në grumbullin e të gjithë njerëzve.’

<sup>105</sup> Ne e zbritëm Kuranin me të vërtetën dhe me të vërtetën ka ardhur – [Profet,] ty të dërguam veç për të dhënë lajm të mirë dhe paralajmërim – <sup>106</sup> ai është recitim që e kemi shpallur në pjesë, që të mund t’ua recitosh njerëzve kohë pas kohe; e kemi zbritur pak-nga-pak. <sup>107</sup> Thuaj: ‘Besuat apo jo, ata të cilëve u është dhënë dije më herët bien me fytyrë përtokë kur u recitohet, <sup>108</sup> dhe thonë: “Lâvdi është për Zotin tonë! Premtimi i Zotit tonë është përmbushur.” <sup>109</sup> Bien me fytyrë përtokë, duke qarë dhe [Kurani] ua rrit përlësinë.’ <sup>17:110</sup> Thuaj[u]: ‘Thirreni **Allahun**, apo Zotin e Mëshirës – me çfarëdo emra që e thirrni Atë, emrat më të mirë i perkasin Atij.’ [Profet,] mos ji tepër i zhurmshëm në lutjet e faljet e tua, apo tepër i qetë, por kërkoje një mënyrë të mesme <sup>111</sup> dhe thuaj: ‘Lavdet i perkasin **Allahut**, që nuk ka fëmijë as partner në sundimin E Tij. Ai

nuk është kaq i dobët sa të ketë nevojë për mbrojtës. Shpalle madhësinë E Tij të pakufishme!’

**Përshkrimi para kaptinës 17 nga Abdel Haleem:**

*Sure mekase e kornizuar nga referencat për fëmijët e Izraelit në fillim dhe për Faraonin në fund. Pjesa më e madhe e sures merret me Kuranin si udhëzim dhe paralajmërim, Muhamedin dhe natyrën e profecisë, veçanërisht faktin se ai është qenie njerëzore dhe i paaftë që vetë të prodhojë mrekulli. Po ashtu paralajmëron për premtimin e Iblisit për ta tunduar njerëzimin dhe për fatin e mosbesimtarëve dhe e jep një seri të urdhëresave (vargjet 22-39). Udhëtimi i Natës, që ia jep titullin sures, përmendet në vargun 1 dhe përsëri në vargun 60. Kah fundi i periudhës mekase, **Allahu** shkaktoi që Muhamedi, brenda një nate të vetme, të udhëtojë nga Meka në Jerusalem dhe nga aty në parajsë dhe prapa.*

## 18: Shpella (EL-KEHF)

Në emrin e **Allahut**, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës

- <sup>1</sup> Lavdet qofshin për **Allahun**,  
që ia zbriti Shkrimin e Shenjtë shërbyesit Të Tij  
dhe e bëri të drejtë saktësisht,
- <sup>2</sup> paralajmërim të ndëshkimit të ashpër nga Ai  
dhe [që u jep] lajm të mirë besimtarëve  
që bëjnë vepra të mira –  
shpërblim të shkëlqyeshëm
- <sup>3</sup> që do ta shijojnë gjithmonë.
- <sup>4</sup> Ai [Kurani] i paralajmëron ata njerëz që pohojnë:  
‘**Allahu** ka fëmijë.’<sup>a</sup>
- <sup>5</sup> Ata nuk kanë njohuri për këtë,  
as s’kishin paraardhësit e tyre –  
ai është pohim i tmerrshëm që del nga goja e tyre:  
ajo që e thonë nuk është gjë tjetër pos rrena.
- <sup>6</sup> Por [Profet] a do të shkatërrohesh nga shqetësimi për ta  
nëse nuk besojnë në këtë mesazh?
- <sup>7</sup> Ne e kemi zbukuruar tokën me gjëra tërheqëse  
që të mund t’i sprovovjmë njerëzit  
për ta zbuluar se cili nga ta vepron më së miri,
- <sup>8</sup> por tërë këtë do ta shndërrojmë në pluhur të shkretë.
- <sup>9</sup> [Profet,] a të duken Shokët në Shpellë dhe Rakimi<sup>b</sup> kaq mahnitës,  
ndër të gjitha shenjat Tona të tjera?
- <sup>18:10</sup> Kur të rinjtë kërkuan strehim në shpellë dhe thanë:  
‘Zoti ynë, na e dhuro mëshirën Tënde  
dhe na e gjej një rrugëdalje të mirë nga vuajtja jonë e madhe’,
- <sup>11</sup> Ne ua mbyllëm veshët [me gjumë] në shpellë për shumë vite.

---

<sup>a</sup> *Walad* në arabishten klasike vlen për mashkulloren dhe femëroren, njëjës dhe shumës. Meqë kjo sure është mekase, me gjasë të madhe i referohet pretendimeve të mekasve se engjëjt janë bija të Zotit.

<sup>b</sup> El-Rakimi interpretohet në mënyra të ndryshme si emri i malit në të cilin ndodhej shpella, emri i qenit të tyre apo një mbishkrim me emrat e tyre.



- 12 Pastaj i zgjuam që të mund ta bënim të qartë se cila nga dy palët<sup>a</sup> ishte më e aftë ta gjejë se sa kohë kishin qenë aty.
- 13 [Profet,] Ne do të ta tregojmë rrëfimin e tyre siç ishte në të vërtetë.  
Ata ishin të rinj që besonin në Zotin e tyre dhe i udhëzuan gjithnjë e më shumë.
- 14 U dhamë forcë zemrave të tyre kur u ngritën e thanë:  
‘Zoti ynë është Zoti i qiejve dhe i tokës.  
Kurrë nuk do ta thërrasim asnjë zot tjetër pos Tij,  
se kjo do të ishte vepër jashtëzakonisht fyese.
- 15 Ky populli ynë ka marrë zota të tjerë pos Tij.  
Pse nuk japin dëshmi të qartë për ta?  
Kush do të mund të ishte më i padrejtë se dikush që shpik gënjeshtër për **Allahun?**
- 16 Tani që i keni lënë njerëzit e tillë dhe atë që e adhuronin në vend të **Allahut**, strehohuni në shpellë.  
**Allahu** do t’ju japë shumë mëshirë Të Vetën dhe do t’jua bëjë një rrugëdalje të mirë nga vuajtja juaj e madhe.’
- 17 Do të mund ta shihje diellin [me dritën e tij] teksa lindte, duke u larguar në të djathtë të shpellës së tyre dhe kur perëndonte, duke u larguar në të majtë të tyre, gjersa shtriheshin në hapësirën e gjerë brenda shpellës.  
(Kjo është një nga shenjat e **Allahut**: ata njerëz që i udhëzon **Allahu** janë të udhëzuar drejt, por nuk do ta gjesh asnjë mbrojtës që do t’i çonte në rrugë të duhur ata që i lë të devijojnë.)

---

<sup>a</sup> Shih vargun 19.

- 18 Do të mendoje se ishin zgjuar, megjithëse flinin të shtrirë.  
Ne i rrotullonim, djathtas e majtas  
dhe qenin e tyre që i shtrinte këmbët e parme në hyrje.  
Po t'i kishe parë, do të ktheheshe e të ikje,  
i kapluar nga frika prej tyre.
- 19 Dikur Ne i zgjuam dhe nisën ta pyesnin njëri-tjetrin.  
Njëri nga ta pyeti: 'Sa kohë keni qenë këtu?'  
dhe [disa] u përgjigjën: 'Një ditë apo një pjesë të ditës',  
por pastaj [të tjerët] thanë:  
'Zoti juaj e di më së miri se sa kohë keni qenë këtu.  
Shko në qytet njëri nga ju me monedhat e argjendta,  
gjeje se ku është ushqimi më i mirë atje dhe na e sill ca.  
Por ki kujdes të mos e marrë vesh askush për ty:  
18:20 nëse të zbulojnë, do të t'gurëzonin  
apo do të t'detyronin të ktheheshe në fenë e tyre,  
ku nuk do ta kesh asnjë të mirë.'
- 21 Kështu Ne i sollëm ata në vëmendjen e njerëzve që të mund ta dinin  
se premtimi i **Allahut** [për ringjallje] është i vërtetë  
dhe se nuk ka dyshim për Orën e Fundit,  
[megjithëse] njerëzit grinden ndërmjet vete.
- [Disa] thanë: 'Ndërtojeni një ndërtesë mbi ta:  
Zoti i tyre di më së miri për ta.'  
Ata që mbizotëruan thanë:  
'Do ta ndërtojmë një faltore mbi ta.'
- 22 [Disa] thonë: 'Fjetësit ishin tre, e qeni i katërti',  
e të tjerë thonë: 'Ishin pesë, e qeni i gjashti' –  
duke hamendësuar në terr – dhe disa thonë:  
'Ishin shtatë, e qeni i teti.'  
Thuaj [Profet]: 'Zoti im e di më së miri se sa ishin.'  
Veç disa kanë njohuri reale për ta,  
pra mos u grind, por mbaju asaj që është e qartë  
dhe mos e pyet asnjë nga këta njerëz për ta;

- <sup>23</sup> për asgjë mos thuaj: ‘Do ta bëj nesër’,<sup>a</sup>
- <sup>24</sup> pa shtuar: ‘dashtë **Allahu**’  
dhe, kurdo që harron, kujtoje Zotin tënd dhe thuaj:  
‘Zoti im më udhëzofte më afër asaj që është e drejtë.’
- <sup>25</sup> [Disa thonë:] ‘Fjetësit qëndruan treqind vjet në shpellën e tyre’,  
e disa i shtuan edhe nëntë.
- <sup>26</sup> Thuaj [Profet]: ‘**Allahu** e di më së miri se sa qëndruan.’  
E Tij është njohuria e tërë asaj që është e fshehur në qiej dhe në tokë –  
Ah, sa mirë sheh Ai! Sa mirë dëgjon Ai! –  
dhe nuk e kanë askë t’i mbrojë pos Tij;  
Ai nuk e lejon askë t’i përzihet në qeverisjen E Tij.
- <sup>27</sup> [Profet,] ndiqe atë që të është shpallur  
nga Shkrimi i Shenjtë i Zotit tënd:  
nuk ka ndryshim të fjalëve Të Tij,  
as s’mund të gjesh ndonjë strehë pos tek Ai.
- <sup>28</sup> Kënaqu me ata që i falen Zotit të tyre mëngjes-e-mbrëmje,  
duke e kërkuar miratimin E Tij  
dhe mos i lejo sytë të të shmangen nga ta  
prej merakut për llukset e kësaj jete tokësore:<sup>b</sup>  
mos ua vër veshin atyre zemrat e të cilëve  
Ne i kemi bërë mospërfillëse ndaj Kuranit Tonë,  
atyre që i ndjekin merakun e tyre të ulëta,  
atyre që i kanë rrugët të shfrenuara.
- <sup>29</sup> Thuaj: ‘Tani e vërteta ka ardhur nga Zoti juaj:  
ata që besojnë në të – le ta besojnë  
dhe ata që duan ta refuzojnë – le ta refuzojnë.’  
Për keqbërësit e kemi përgatitur një Zjarr  
që do t’i mbështjellë nga të gjitha anët.

---

<sup>a</sup> Kur Profeti u sfidua nga mekasit, të nxitur nga çifutët, që ta shpjegojë rrëfimin e Fjetësve, ai premtoi se do ta bëjë ‘nesër’, por nuk pranoi shpallje për të disa ditë radhas më pas.

<sup>b</sup> Njerëzit e shquar të Mekës përpiqeshin ta bindnin Profetin t’u afrohej dhe t’i largonte ndjekësit e tij të përlulur. Shih 17:73-4, 80:1-10

Nëse kërkojnë lehtësim, do të lehtësohen me ujë  
si metal i shkrirë, që ua përvëlon fytyrat.

Çfarë pije e tmerrshme!

Çfarë vendi i dhembshëm për pushim!

18:30 Sa për ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira –

Ne nuk e lëmë të shkojë huq

shpërblimin e kujt do që bën vepër të mirë –

31 do të kenë Kopshte të lumturisë së qëndrueshme

të hijeshuar me lumenj që rrjedhin.

Atje do të stolisen me byzylykë ari.

Atje do të vishen me rroba të gjelbra

nga mëndafshi dhe pëlhura e mirë.

Atje do të ulen rehat në ulëse të buta.

Çfarë shpërblimi i bekuar!

Çfarë vendi i këndshëm për pushim!

32 Tregojua alegorinë e dy njerëzve:

për njërin nga ta Ne i bëmë dy kopshte vreshtash,

i rrethuar me hurma dhe vendosëm fusha të misrit në mes;

33 të dy kopshtet dhanë fruta dhe nuk dështuan assesi;

e bëmë një përrua të rrjedhë përmes tyre,

34 dhe kështu ai kishte fruta të bollshme.

Një ditë, gjersa po fliste me mikun e tij, tha:

‘Unë kam më shumë pasuri se sa ti dhe rreth më të madh të njerëzve.’

35 Ai hyri në kopshtin e tij dhe e dëmtoi veten duke thënë:

‘Nuk ma merr mendja se kjo do të zhduket ndonjëherë,

36 apo se do të vijë ndonjëherë Ora e Fundit –

edhe po të më kthenin te Zoti im,

me siguri do të gjeja diçka edhe më të mirë atje.’

37 Shoku i tij ia ktheu:

‘A nuk ke besim në Atë që të krijoi nga pluhuri,

nga një pikë e vogël e lëngut, mandej të formësoi në njeri?

38 Se, për mua, Ai është **Allahu**, Zoti im dhe kurrë nuk do t’i bëj shok.

- <sup>39</sup> Ah sikur, kur hyre në kopshtin tënd, të thoshe:  
“Ky është vullneti i **Allahut**.  
Nuk ka fuqi që nuk është [dhënë] nga **Allahu**.”  
Megjithëse po e sheh se kam më pak pasuri dhe pasardhës se ti,  
<sup>18:40</sup> Zoti im fare mirë mund të më japë diçka më të mirë se kopshti yt  
dhe të dërgojë në kopshtin tënd rrufe nga qielli,  
që të bëhet hi e pluhur;
- <sup>41</sup> ose ujin e tij mund ta pijë toka kaq thellë  
sa që nuk do të mund ta arrish më kurrë.’
- <sup>42</sup> Dhe kështu ndodhi: frytet e tij u shkatërruan plotësisht  
dhe ja ku ishte ai, duke i shtrënguar duart nga shqetësimi  
për gjithçka që kishte investuar në to,  
gjersa thaheshin në thurjet e drunjtë dhe duke thënë:  
‘Ah sikur të mos i kisha bërë shok Zotit tim!’
- <sup>43</sup> Nuk kishte kurrfarë forcash për ta ndihmuar pos **Allahut** –  
s’mund t’i ndihmonte madje as vetes.
- <sup>44</sup> Në atë situatë, mbrojtja e vetme  
është ajo e **Allahut**, e Zotit Të Vërtetë:  
Ai i jep shpërblimet më të mira dhe rezultatit më të mirë.
- <sup>45</sup> Tregoju atyre, po ashtu, se në çka ngjan jeta e kësaj bote:  
Ne e zbresim ujin nga qiejt dhe bimësia e tokës e përthith,  
por së shpejti bimët kthehen në kashtë të thata  
të shkapërderdhura nga era:  
**Allahu** ka pushtet mbi çdo gjë.
- <sup>46</sup> Pasuria dhe fëmijët janë llukset e kësaj jete tokësore,  
por veprat e mira të qëndrueshme  
kanë shpërblim më të mirë me Zotin tënd  
dhe japin baza më të mira për shpresë.
- <sup>47</sup> Një ditë do t’i bëjmë malet të lëvizin  
dhe do ta shihni tokën si fushë të hapur.  
Do t’i tubojmë të gjithë njerëzit bashkë,  
duke mos e përjashtuar askë.

- 48 Ata do të rreshtohen përpara Zotit tuaj:  
‘Tani keni ardhur te Ne siç ju kemi krijuar herën e parë,  
megjithëse pretendonit se nuk patëm caktuar  
kurrfarë takimi të tillë për ju.’
- 49 Regjistri i veprave të tyre do të hapet dhe do t’i shohësh fajtorët,  
të tronditur nga përmbajtjet e tyre, duke thënë:  
‘Mjerë ne! Çfarë regjistri është ky!  
Nuk lë asnjë vepër, të vogël a të madhe, të pallogaritur!’  
Do të gjejnë gjithçka që kanë bërë ndonjëherë  
të hapur para tyre:  
Zoti juaj nuk do të jetë i padrejtë me askë.
- 18:50 Ne u thamë engjëjve: ‘Përkuluni përpara Ademit’  
dhe u përkulën të gjithë, por jo Iblisi:  
ai ishte një nga xhindet dhe nuk iu bind urdhrin të Zotit të tij.  
A do t’i merrni [ju njerëz] atë dhe pasardhësit e tij  
për padronë tuajt në vend se Mua,  
edhe pse janë armiqtë tuaj?  
Çfarë pazari i keq për keqbërësit!
- 51 Unë nuk i bëra ata dëshmitarë të krijimit të qiejve dhe të tokës,  
as të krijimit të vetë atyre;  
nuk i marr për përkrahës të Mi ata që i devijojnë të tjerët.
- 52 Në Ditën që **Allahu** do të thotë:  
‘Thirrni ata që pretenduat se ishin shokët E Mi’,  
këta do t’i thërrasin por ata nuk do të përgjigjen;  
Ne do ta vendosim një humnerë vdekjeprurëse ndërmjet tyre.
- 53 Keqbërësit do ta shohin Zjarrin  
dhe do ta kuptojnë se pothuajse kanë rënë në të:  
nuk do të gjejnë shpëtim nga ai.
- 54 Në këtë Kuran Ne e kemi paraqitur çdo lloj përskrimi për njerëzit  
por njeriu është më grindavec se çdo krijesë tjetër.

- 55 Tani që u ka ardhur udhëzimi, çka i ndal ata njerëz të besojnë dhe të kërkojnë falje nga Zoti i tyre para se t'i asgjësojë fati i njerëzve të mëparshëm apo të ballafaqohen me torturën e tyre?
- 56 Ne çojmë të dërguar veç për të sjellë lajme të mira dhe për të dhënë paralajmërim, e megjithatë mosbesimtarët duan ta hedhin poshtë të vërtetën me argumente të rreme dhe bëjnë shaka me mesazhet dhe paralajmërimet E Mija.
- 57 Kush do të mund të ishte më i gabuar se personi që ia përkujtojnë mesazhet e Zotit të tij dhe ai ua kthen shpinën, duke e injoruar atë që po e depozitojnë duart e tij për të [në të Përtejmen]? Ne u kemi vënë perde zemrave të tyre, kështu që nuk mund ta kuptojnë Kurandin dhe Ne ua rënduam veshët: edhe pse [ti Profet] i thërret në udhëzim nuk do ta pranojnë kurrë.
- 58 Zoti yt është Më Falësi dhe plot mëshirë: po t'i qortonte për gabimet që i kanë bërë, do ta shpejtonte ndëshkimin e tyre. Ata e kanë një kohë të caktuar nga e cila nuk do të kenë shpëtim,
- 59 [mu sikur] komunitetet e shkuara që i shkatërroam se bënë keq: Ne e caktuam kohën për shkatërrimin e tyre.
- 18:60 Musai i tha shërbyesit të tij:  
'Nuk do të pushoj deri kur ta arrij vendin ku takohen dy detet, edhe po të më duhen vite!'
- 61 por kur e arritën vendin ku takohen dy detet, i kishin harruar krejtësisht peshqit e tyre, që e gjetën rrugën për në det dhe u larguan duke notuar.

62 Ata e vazhduan udhëtimin dhe pastaj Musai i tha shërbyesit të tij:  
‘Na e jep drekën tënde! Ky udhëtimi ynë është shumë i lodhshëm’,

63 dhe [shërbyesi] tha:

‘A të kujtohet kur po pushonim pranë shkëmbit?

I harrova peshqit –

Satani më bëri të harroj t’u kushtoj vëmendje –

dhe [me siguri] e kanë gjetur rrugën për në det.’

‘Sa çudi!’

64 tha Musai,

‘Atëherë ai ishte vendi që po e kërkonim.’

Kështu të dytë u kthyen prapa,

i ripërshkuan gjurmët e tyre të këmbëve,

65 dhe e gjetën një nga shërbyesit Tanë –

një burrë të cilit Ne ia patëm dhënë mëshirën Tonë

dhe të cilit i patëm dhënë dije nga E Jona.

66 Musai i tha:

‘A mund të të ndjek që të mund të më mësosh  
ca nga udhëzimi i duhur që të është mësuar?’

67 Burri i tha:

‘Nuk do të jesh në gjendje të përmbahesh me mua me durim.

68 Si do të mund të ishe i durueshëm

në çështjet përtej dijes sate?’

69 Musai tha: ‘Dashtë **Allahu**,

do ta shohësh se jam i duruar.

Nuk do të t’shfaq mosbindje në asnjë mënyrë.’

18:70 Burri tha: ‘Nëse më ndjek pra,

mos pyet për asgjë që bëj para se të ta përmendi vetë.’

71 Udhëtuan tutje.

Më vonë, kur hipën në një barkë

dhe burri e bëri një vrimë në të,

Musai tha:

‘Si munde të bësh vrimë në të?’



A po do t'i fundosësh udhëtarët e saj?

Çfarë vepre e çuditshme!

72 Ai u përgjigj:

‘A nuk të thashë se nuk do të ishe kurrë në gjendje të përmbahesh me mua me durim?’

73 Musai tha:

‘Më fal që harrova.

Mos ma bëj tepër të vështirë të të ndjek.’

74 Dhe kështu udhëtuan tutje.

Pastaj, kur e takuan një djalë të ri dhe burri e vrau,

Musai tha:

‘Si munde ta vrasësh një person të pafajshëm?

Ai nuk e ka vrarë askë!

Çfarë vepre e tmerrshme!’

75 Ai u përgjigj:

‘A nuk të thashë se nuk do të ishe kurrë në gjendje të përmbahesh me mua me durim?’

76 Musai tha: ‘Prej tash e tutje,

nëse pyes për çkado që bën,

më dëbo nga shoqërimi me ty –

mjaft më ke duruar.’

77 Dhe kështu udhëtuan tutje.

Pastaj, kur erdhën te një qytet

dhe u kërkuan ushqim banorëve por iu refuzua mikpritja,

e panë një mur që pothuaj ish rrëzuar dhe burri e ndreqi.

Musai tha:

‘Por po të doje

do të mund të paguheshe për ta bërë këtë.’

78 Ai tha: ‘Këtu ti dhe unë i ndajmë rrugët.

Do të ta tregoj kuptimin e gjërave

për të cilat nuk munde të përmbahesh me durim:

79 barka u përkiste disa njerëzve në nevojë

që e nxirrnin jetesën nga deti

dhe e dëmtova se e dija që po vinte një mbret  
që po e merrte me forcë çdo barkë [të dobishme].

18:80 Djali i ri kishte prindër që ishin njerëz të besimit dhe kështu,  
duke u frikësuar se do t'i shqetësonte me ligësi e mosbesim,  
81 ne deshëm që Zoti i tyre t'ua jepte një fëmijë tjetër –  
më të pastër dhe më dashamirës –  
në vend të tijin.

82 Muri u përkiste dy jetimëve të rinj në qytet  
dhe nën të kishte thesar të fshehur që u përkiste.  
Babai i tyre kish qenë njeri i ndershëm,  
kështu që Zoti yt synoi që ta arrinin pjekurinë  
dhe pastaj ta nxirrnin thesarin e tyre si mëshirë nga Zoti yt.  
Nuk i kam bërë [këto gjëra] me dëshirën time:  
këto janë shpjegimet për ato gjëra për të cilat  
nuk munde të përmbaheshe me durim.'

83 [Profet,] të pyesin për Dhulkarnejnin.<sup>a</sup>  
Thuaj: 'Do t'ju tregoj diçka për të.'  
84 Ne e vendosëm pushtetin e tij në atë vend  
dhe ia dhamë mjetet për të arritur gjithçka.  
85 Ai udhëtoi në një rrugë të caktuar;  
86 pastaj kur arriti te perëndimi i diellit,  
e vërejti se [dukej sikur] po perëndon në një burim të turbullt.  
Aty afër i gjeti disa njerëz dhe Ne thamë:  
'Dhulkarnejn, mund të zgjedhësh  
[se cilët nga ta] t'i ndëshkosh apo t'u shfaqësh mirësi.'  
87 Ai u përgjigj: 'Ne do t'i ndëshkojmë ata që kanë bërë keq  
dhe kur t'i kthejnë te Zoti i tyre  
Ai do t'i ndëshkojë [edhe më] ashpër,  
88 gjersa ata që besuan dhe bënë vepra të mira  
do t'i kenë më të mirat nga shpërblimet:  
do t'i urdhërojmë ta bëjnë atë që është e lehtë për ta.'

---

<sup>a</sup> Fjalë për fjalë 'ai me dy brirë', që nga disa thuhet të jetë Aleksandri i Madh.

89 Ai udhëtoi tutje;  
18:90 pastaj, kur arriti te lindja e diellit,  
e pa të lindte mbi një popull  
për të cilin Ne nuk patëm furnizuar kurrfarë strehimi prej diellit.  
91 Dhe kështu ishte: Ne dinim gjithçka për të.

92 Ai udhëtoi tutje;  
93 pastaj, kur e arriti një vend mes dy pengesave malore,  
e gjeti rrëzë tyre një popull që mezi e kuptonin.  
94 Ata thanë:  
'Dhulkarnejn, Jexhuxhët dhe Mexhuxhët  
po e shkatërrojnë këtë vend.  
A do ta ndërtosh një pengesë ndërmjet atyre dhe neve  
nëse të paguajmë haraç?'

95 Ai u përgjigj: 'Fuqia që ma ka dhënë Zoti im  
është më e mirë se çfarëdo haraçi,  
por nëse ma jepni forcën tuaj,  
do ta vendos një fortifikim midis jush dhe tyre:  
96 më sillni blloqe të hekurit!'  
dhe pastaj, kur e kishte mbushur hapësirën  
ndërmjet dy anëve të malit [tha]:  
'Fryni zjarrit!' dhe pastaj,  
kur e kishte bërë hekurin të shkëlqente si zjarr, tha:  
'Ma sillni metalin e shkrirë ta derdhim mbi të!'

97 Armiqtë e tyre nuk mund t'i ngjiteshin pengesës,  
as s'mund ta shponin,  
98 dhe ai tha: 'Kjo është mëshirë nga Zoti im.  
Por kur të përmbushet premtimi i Zotit tim,  
Ai do ta bëjë këtë pengesë rrafsh me tokë:  
premtimi i Zotit tim realizohet gjithmonë.'

99 Në atë Ditë,  
Ne do t'i lëmë të vërshojnë kundër njëri-tjetrit si dallgë  
dhe pastaj do t'i fryhet Trumpetës  
dhe do t'i tubojmë të gjithë së bashku.

18:100 Do t'ua tregojmë Ferrin mosbesimtarëve,  
101 atyre që sytë i kishin të verbër ndaj shenjave të Mija,  
atyre që nuk ishin në gjendje të dëgjonin.  
102 A menduan se mund t'i merrnin shërbyesit E Mi për padronë  
në vend se Mua?  
Ferrin e kemi përgatitur  
si vend-pushim të mosbesimtarëve.

103 Thuaj [Profet]:  
'A t'ju tregojmë [ne]<sup>a</sup>  
se cilët kanë më së shumti për të humbur nga veprimet e tyre,  
104 përpjekjet e të cilëve në këtë botë janë të keqdhëzuara,  
madje edhe kur mendojnë se po bëjnë vepra të mira?  
105 Janë ata që nuk besojnë në mesazhet e Zotit të tyre  
dhe refuzojnë se do ta takojnë Atë.'  
Veprat e tyre tkurren në asgjë:  
në Ditën e Ringjalljes Ne nuk do t'u japim kurrfarë peshe.  
106 Shpagimi i tyre për atë se nuk besuan  
dhe u tallën me mesazhet E Mija dhe të dërguarit E Mi –  
do të jetë Ferri.  
107 Por atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira  
do t'u jepen Kopshtet e Parajsës.  
108 Aty do të mbesin, duke mos dashur të largohen kurrë.

109 Thuaj [Profet]:  
'Sikur tërë oqeani<sup>b</sup> të ishte bojë  
për t'i shkruar fjalët e Zotit tim,  
do të thahej para se të shtereshin ato fjalë' –  
madje edhe po t'ia shtonim edhe një oqean.

---

<sup>a</sup> Kjo 'ne' me sa duket i referohet Profetit dhe komunitetit të tij të besimtarëve.

<sup>b</sup> Termi *bahr* i referohet të gjitha ujërave të gjera.

18:110 Thuaj: ‘Jam veç qenie njerëzore, si ju,  
të cilës i është shpallur se **Allahu** juaj është Një.  
Kushdo që frikësohet<sup>a</sup> ta takojë Zotin e tij  
duhet të bëjë vepra të mira  
dhe të mos i japë askujt hise  
në adhurimin që i takon Zotit të tij.’

---

<sup>a</sup> Shih shënimin për 10:7: “apo ‘pret’ (një nga kuptimet e *yarjuna*).”

## 18. SHPELLA (EL-KEHF)

(versioni në paragrafe)

Në emrin e **Allahut**, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës

<sup>1</sup> Lavdet qofshin për **Allahun**, që ia zbriti Shkrimin e Shenjtë shërbyesit Të Tij dhe e bëri të drejtë saktësisht, <sup>2</sup> paralajmërim të ndëshkimit të ashpër nga Ai dhe [që u jep] lajm të mirë besimtarëve që bëjnë vepra të mira – shpërblim të shkëlqyeshëm <sup>3</sup> që do ta shijojnë gjithmonë. <sup>4</sup> Ai [Kurani] i paralajmëron ata njerëz që pohojnë: ‘**Allahu** ka fëmijë.’<sup>a</sup> <sup>5</sup> Ata nuk kanë njohuri për këtë, as s’kishin paraardhësit e tyre – ai është pohim i tmerrshëm që del nga goja e tyre: ajo që e thonë nuk është gjë tjetër pos rrena. <sup>6</sup> Por [Profet] a do të shkatërrohesh nga shqetësimi për ta nëse nuk besojnë në këtë mesazh?

<sup>7</sup> Ne e kemi zbukuruar tokën me gjëra tërheqëse që të mund t’i sprovojmë njerëzit për ta zbuluar se cili nga ta vepron më së miri, <sup>8</sup> por tërë këtë do ta shndërrojmë në pluhur të shkretë. <sup>9</sup> [Profet,] a të duken Shokët në Shpellë dhe Rakimi<sup>b</sup> kaq mahnitës, ndër të gjitha shenjat Tona të tjera? <sup>18:10</sup> Kur të rinjtë kërkuan strehim në shpellë dhe thanë: ‘Zoti ynë, na e dhuro mëshirën Tënde dhe na e gjej një rrugëdalje të mirë nga vuajtja jonë e madhe’, <sup>11</sup> Ne ua mbyllëm veshët [me gjumë] në shpellë për shumë vite. <sup>12</sup> Pastaj i zgjuam që të mund ta bënim të qartë se cila nga dy palët<sup>c</sup> ishte më e aftë ta gjejë se sa kohë kishin qenë aty.

<sup>13</sup> [Profet,] Ne do të ta tregojmë rrëfimin e tyre siç ishte në të vërtetë. Ata ishin të rinj që besonin në Zotin e tyre dhe i udhëzuam gjithnjë e më shumë. <sup>14</sup> U dhamë forcë zemrave të tyre kur u ngritën e thanë: ‘Zoti ynë është Zoti i qiejve dhe i tokës. Kurrë nuk do ta thërrasim asnjë zot tjetër pos Tij, se kjo do të ishte vepër jashtëzakonisht fyese. <sup>15</sup> Ky populli ynë ka marrë zota të tjerë pos Tij. Pse nuk japin dëshmi të qartë për ta? Kush do të mund të ishte më i padrejtë se dikush që shpik gënjeshtër për **Allahun**? <sup>16</sup> Tani që i keni lënë njerëzit e tillë dhe atë që e adhuronin në vend të **Allahut**, strehohuni në shpellë. **Allahu** do t’ju japë shumë mëshirën Të Vetën dhe do t’jua bëjë një rrugëdalje të mirë nga vuajtja juaj e madhe.’

---

<sup>a</sup> *Walad* në arabishten klasike vlen për mashkulloren dhe femëroren, njëjës dhe shumës. Meqë kjo sure është mekase, me gjasë të madhe i referohet pretendimeve të mekasve se engjëjt janë bija të Zotit.

<sup>b</sup> El-Rakimi interpretohet në mënyra të ndryshme si emri i malit në të cilin ndodhej shpella, emri i qenit të tyre apo një mbishkrim me emrat e tyre.

<sup>c</sup> Shih vargun 19.

<sup>17</sup> Do të mund ta shihje diellin [me dritën e tij] teksa lindte, duke u larguar në të djathtë të shpellës së tyre dhe kur perëndonte, duke u larguar në të majtë të tyre, gjersa shtriheshin në hapësirën e gjerë brenda shpellës. (Kjo është një nga shenjat e **Allahut**: ata njerëz që i udhëzon **Allahu** janë të udhëzuar drejt, por nuk do ta gësh asnjë mbrojtës që do t'i çonte në rrugë të duhur ata që Ai i lë të devijojnë.) <sup>18</sup> Do të mendoje se ishin zgjuar, megjithëse flinin të shtrirë. Ne i rrotullonim, djathtas e majtas dhe qenin e tyre që i shtrinte këmbët e parme në hyrje. Po t'i kishe parë, do të ktheheshe e të ikje, i kapluar nga frika prej tyre.

<sup>19</sup> Dikur Ne i zgjuam dhe nisën ta pyesnin njëri-tjetrin. Njëri nga ta pyeti: 'Sa kohë keni qenë këtu?' dhe [disa] u përgjigjën: 'Një ditë apo një pjesë të ditës', por pastaj [të tjerët] thanë: 'Zoti juaj e di më së miri se sa kohë keni qenë këtu. Shko në qytet nga ju me monedhat e argjendta, gjeje se ku është ushqimi më i mirë atje dhe na e sill ca. Por ki kujdes të mos e marrë vesh askush për ju: <sup>18:20</sup> nëse të zbulojnë, do të t'gurëzonin apo do të t'detyronin të ktheheshe në fenë e tyre, ku nuk do ta kesh asnjë të mirë.' <sup>21</sup> Kështu Ne i sollëm ata në vëmendjen e njerëzve që të mund ta dinin se premtimi i **Allahut** [për ringjallje] është i vërtetë dhe se nuk ka dyshim për Orën e Fundit, [megjithëse] njerëzit grinden ndërmjet vete.

[Disa] thanë: 'Ndërtojeni një ndërtesë mbi ta: Zoti i tyre di më së miri për ta.' Ata që mbizotëruan thanë: 'Do ta ndërtojmë një faltore mbi ta.' <sup>22</sup> [Disa] thonë: 'Fjetësit ishin tre, e qeni i katërti', e të tjerë thonë: 'Ishin pesë, e qeni i gjashti' – duke hamendësuar në terr – dhe disa thonë: 'Ishin shtatë, e qeni i teti.' Thuaj [Profet]: 'Zoti im e di më së miri se sa ishin.' Veç disa kanë njohuri reale për ta, pra mos u grind, por mbaju asaj që është e qartë dhe mos e pyet asnjë nga këta njerëz për ta; <sup>23</sup> për asgjë mos thuaj: 'Do ta bëj nesër',<sup>a</sup> <sup>24</sup> pa shtuar: 'dashtë **Allahu**' dhe, kurdo që harron, kujtoje Zotin tënd dhe thuaj: 'Zoti im më udhëzofte më afër asaj që është e drejtë.' <sup>25</sup> [Disa thonë:] 'Fjetësit qëndruan treqind vjet në shpellën e tyre', e disa i shtuan edhe nëntë. <sup>26</sup> Thuaj [Profet]: '**Allahu** e di më së miri se sa qëndruan.' E Tij është njohuria e tërë asaj që është e fshehur në qiej dhe në tokë – Ah, sa mirë sheh Ai! Sa mirë dëgjon Ai! – dhe nuk e kanë askë t'i mbrojnë pos Tij; Ai nuk e lejon askë t'i përzihet në qeverisjen E Tij.

<sup>27</sup> [Profet,] ndiqe atë që të është shpallur nga Shkrimi i Shenjtë i Zotit tënd: nuk ka ndryshim të fjalëve Të Tij, as s'mund të gësh ndonjë strehë pos tek Ai. <sup>28</sup> Kënaqu me ata që i falen Zotit të tyre mëngjes-e-mbrëmje, duke e kërkuar miratimin E Tij dhe mos i lejo sytë të të shmangen nga ta prej merakut për llukset e kësaj jete tokësore:<sup>b</sup> mos ua vër veshin atyre zemrat e të cilëve Ne i kemi bërë mospërfillëse ndaj Kuranit Tonë, atyre që i ndjekin meraket e tyre të ulëta,

---

<sup>a</sup> Kur Profeti u sfidua nga mekasit, të nxitur nga çifutët, që ta shpjegojë rrëfimin e Fjetësve, ai premtoi se do ta bëjë 'nesër', por nuk pranoi shpallje për të disa ditë radhas më pas.

<sup>b</sup> Njerëzit e shquar të Mekës përpiqeshin ta bindnin Profetin t'u afrohej dhe t'i largonte ndjekësit e tij të përrulur. Shih 17:73-4, 80:1-10

atyre që i kanë rrugët të shfrenuara. <sup>29</sup> Thuaj: ‘Tani e vërteta ka ardhur nga Zoti juaj: ata që besojnë në të – le ta besojnë dhe ata që duan ta refuzojnë – le ta refuzojnë.’ Për keqbërësit e kemi përgatitur një Zjarr që do t’i mbështjellë nga të gjitha anët. Nëse kërkojnë lehtësim, do të lehtësohen me ujë si metal i shkrirë, që ua përvëlton fytyrat. Çfarë pije e tmerrshme! Çfarë vendi i dhembshëm për pushim! <sup>18:30</sup> Sa për ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira – Ne nuk e lëmë të shkojë huq shpërblimin e kujtdo që bën vepër të mirë – <sup>31</sup> do të kenë Kopshte të lumturisë së qëndrueshme të hijeshuar me lumenj që rrjedhin. Atje do të stolisen me byzylykë ari. Atje do të vishen me rroba të gjelbra nga mëndafshi dhe pëlhura e mirë. Atje do të ulen rehat në ulëse të buta. Çfarë shpërblimi i bekuar! Çfarë vendi i këndshëm për pushim!

<sup>32</sup> Tregojua alegorinë e dy njerëzve: për njërin nga ta Ne i bëmë dy kopshte vreshtash, i rrethuan me hurma dhe vendosëm fusha të misrit në mes; <sup>33</sup> të dy kopshtet dhanë fruta dhe nuk dështuan assesi; e bëmë një përrua të rrjedhë përmes tyre, <sup>34</sup> dhe kështu ai kishte fruta të bollshme. Një ditë, gjersa po fliste me mikun e tij, tha: ‘Unë kam më shumë pasuri se sa ti dhe rreth më të madh të njerëzve.’ <sup>35</sup> Ai hyri në kopshtin e tij dhe e dëmtoi veten duke thënë: ‘Nuk ma merr mendja se kjo do të zhduket ndonjëherë, <sup>36</sup> apo se do të vijë ndonjëherë Ora e Fundit – edhe po të më kthenin te Zoti im, me siguri do të gjeja diçka edhe më të mirë atje.’ <sup>37</sup> Shoku i tij ia ktheu: ‘A nuk ke besim në Atë që të krijoi nga pluhuri, nga një pikë e vogël e lëngut, mandej të formësoi në njeri? <sup>38</sup> Se, për mua, Ai është **Allahu**, Zoti im dhe kurrë nuk do t’i bëj shok. <sup>39</sup> Ah sikur, kur hyre në kopshtin tënd, të thoshe: “Ky është vullneti i **Allahut**. Nuk ka fuqi që nuk është [dhënë] nga **Allahu**.” Megjithëse po e sheh se kam më pak pasuri dhe pasardhës se ti, <sup>18:40</sup> Zoti im fare mirë mund të më japë diçka më të mirë se kopshti yt dhe të dërgojë në kopshtin tënd rrufe nga qielli, që të bëhet hi e pluhur; <sup>41</sup> ose ujin e tij mund ta pijë toka kaq thellë sa që nuk do të mund ta arrish më kurrë.’ <sup>42</sup> Dhe kështu ndodhi: frytet e tij u shkatërruan plotësisht dhe ja ku ishte ai, duke i shtrënguar duart nga shqetësimi për gjithçka që kishte investuar në to, gjersa thaheshin në thurjet e drunjtja dhe duke thënë: ‘Ah sikur të mos i kisha bërë shok Zotit tim!’ <sup>43</sup> Nuk kishte kurrfarë forcash për ta ndihmuar pos **Allahut** – s’mund t’i ndihmonte madje as vetes. <sup>44</sup> Në atë situatë, mbrojtja e vetme është ajo e **Allahut**, e Zotit Të Vërtetë: Ai i jep shpërblimet më të mira dhe rezultatin më të mirë.

<sup>45</sup> Tregojua atyre, po ashtu, se në çka ngjan jeta e kësaj bote: Ne e zbresim ujin nga qiejt dhe bimësia e tokës e përthith, por së shpejti bimët kthehen në kashtë të thata të shkapërderdhura nga era: **Allahu** ka pushtet mbi çdo gjë. <sup>46</sup> Pasuria dhe fëmijët janë llukset e kësaj jete tokësore, por veprat e mira të qëndrueshme kanë shpërblim më të mirë me Zotin tënd dhe japin baza më të mira për shpresë. <sup>47</sup> Një ditë do t’i bëjmë malet të lëvizin dhe do ta shihni tokën si fushë të hapur. Do t’i



tubojmë të gjithë njerëzit bashkë, duke mos e përjashtuar askë. <sup>48</sup> Ata do të rreshtohen përpara Zotit tuaj: ‘Tani keni ardhur te Ne siç ju kemi krijuar herën e parë, megjithëse pretendonit se nuk patëm caktuar kurrfarë takimi të tillë për ju.’ <sup>49</sup> Regjistri i veprave të tyre do të hapet dhe do t’i shohësh fajtorët, të tronditur nga përmbajtjet e tyre, duke thënë: ‘Mjerë ne! Çfarë regjistri është ky! Nuk lë asnjë vepër, të vogël a të madhe, të pallogaritur!’ Do të gjejnë gjithçka që kanë bërë ndonjëherë të hapur para tyre: Zoti juaj nuk do të jetë i padrejtë me askë.

<sup>18:50</sup> Ne u thamë engjëjve: ‘Përkuluni përpara Ademit’ dhe u përkulën të gjithë, por jo Iblisi: ai ishte një nga xhindet dhe nuk iu bind urdhrin të Zotit të tij. A do t’i merrni ju [njerëz] atë dhe pasardhësit e tij për padronë tuajt në vend se Mua, edhe pse ata janë armiq të tuaj? Çfarë pazari i keq për keqbërësit! <sup>51</sup> Unë nuk i bëra ata dëshmitarë të krijimit të qiejve dhe të tokës, as të krijimit të vetë atyre; nuk i marr për përkrahës të Mi ata që i devijojnë të tjerët. <sup>52</sup> Në Ditën që **Allahu** do të thotë: ‘Thirrni ata që pretenduat se ishin shokët E Mi’, këta do t’i thërrasin ata por ata nuk do të përgjigjen; Ne do ta vendosim një humnerë vdekjeprurëse ndërmjet tyre. <sup>53</sup> Keqbërësit do ta shohin Zjarrin dhe do ta kuptojnë se pothuajse kanë rënë në të: nuk do të gjejnë shpëtim nga ai.

<sup>54</sup> Në këtë Kuran Ne e kemi paraqitur çdo lloj përskrimi për njerëzit por njeriu është më grindavec se çdo krijesë tjetër. <sup>55</sup> Tani që u ka ardhur udhëzimi, çka i ndal ata njerëz të besojnë dhe të kërkojnë falje nga Zoti i tyre para se t’i asgjësojë fati i njerëzve të mëparshëm apo të ballafaqohen me torturën e tyre? <sup>56</sup> Ne çojmë të dërguar veç për të sjellë lajme të mira dhe për të dhënë paralajmërim, e megjithatë mosbesimtarët duan ta hedhin poshtë të vërtetën me argumente të rreme dhe bëjnë shaka me mesazhet dhe paralajmërimet E Mija. <sup>57</sup> Kush do të mund të ishte më i gabuar se personi që ia përkujtojnë mesazhet e Zotit të tij dhe ai ua kthen shpinën, duke e injoruar atë që po e depozitojnë duart e tij për të [në të Përtejmen]? Ne u kemi vënë perde zemrave të tyre, kështu që nuk mund ta kuptojnë Kuranin dhe Ne ua rënduam veshët: edhe pse [ti Profet] i thërret në udhëzim nuk do ta pranojnë kurrë. <sup>58</sup> Zoti yt është Më Falësi dhe plot mëshirë: po t’i qortonte për gabimet që i kanë bërë, do ta shpejtonte ndëshkimin e tyre. Ata e kanë një kohë të caktuar nga e cila nuk do të kenë shpëtim, <sup>59</sup> [mu sikur] komunitetet e shkuara që i shkatërroam se bënë keq: Ne e caktuam kohën për shkatërrimin e tyre.

<sup>18:60</sup> Musai i tha shërbyesit të tij: ‘Nuk do të pushoj deri kur ta arrij vendin ku takohen dy detet, edhe po të më duhen vite!’ <sup>61</sup> por kur e arritën vendin ku takohen dy detet, i kishin harruar krejtësisht peshqit e tyre, që e gjetën rrugën për në det dhe u larguan duke notuar. <sup>62</sup> Ata e vazhduan udhëtimin dhe pastaj Musai i tha shërbyesit të tij: ‘Na e jep drekën tënde! Ky udhëtimi ynë është shumë i lodhshëm’, <sup>63</sup> dhe [shërbyesi] tha: ‘A të kujtohet kur po pushonim pranë shkëmbit? I harrova peshqit – Satani më bëri të harroj t’u kushtoj vëmendje –

dhe [me siguri] e kanë gjetur rrugën për në det.’ ‘Sa çudi!’<sup>64</sup> tha Musai, ‘Atëherë ai ishte vendi që po e kërkonim.’ Kështu të dytë u kthyen prapa, i ripërkthuan gjurmët e tyre të këmbëve,<sup>65</sup> dhe e gjetën një nga shërbyesit Tanë – një burrë të cilit Ne ia patëm dhënë mëshirën Tonë dhe të cilit i patëm dhënë dije nga E Jona.<sup>66</sup> Musai i tha: ‘A mund të të ndjek që të mund të më mësosh ca nga udhëzimi i duhur që të është mësuar?’<sup>67</sup> Burri i tha: ‘Nuk do të jesh në gjendje të përmbahesh me mua me durim.’<sup>68</sup> Si do të mund të ishe i durueshëm në çështjet përtej dijes sate?’<sup>69</sup> Musai tha: ‘Dashtë **Allahu**, do ta shohësh se jam i duruar. Nuk do të t’shfaq mosbindje në asnjë mënyrë.’<sup>18:70</sup> Burri tha: ‘Nëse më ndjek pra, mos pyet për asgjë që bëj para se të ta përmendi vetë.’

<sup>71</sup> Udhëtuan tutje. Më vonë, kur hipën në një barkë dhe burri e bëri një vrimë në të, Musai tha: ‘Si munde të bësh vrimë në të? A po do t’i fundosësh udhëtarët e saj? Çfarë vepre e çuditshme!’<sup>72</sup> Ai u përgjigj: ‘A nuk të thashë se nuk do të ishe kurrë në gjendje të përmbahesh me mua me durim?’<sup>73</sup> Musai tha: ‘Më fal që harrova. Mos ma bëj tepër të vështirë të të ndjek.’<sup>74</sup> Dhe kështu udhëtuan tutje. Pastaj, kur e takuan një djalë të ri dhe burri e vrau, Musai tha: ‘Si munde ta vrasësh një person të pafajshëm? Ai nuk e ka vrarë askë! Çfarë vepre e tmerrshme!’<sup>75</sup> Ai u përgjigj: ‘A nuk të thashë se nuk do të ishe kurrë në gjendje të përmbahesh me mua me durim?’<sup>76</sup> Musai tha: ‘Prej tash e tutje, nëse pyes për çkado që bën, më dëbo nga shoqërimi me ty – mjaft më ke duruar.’<sup>77</sup> Dhe kështu udhëtuan tutje. Pastaj, kur erdhën te një qytet dhe u kërkuan ushqim banorëve por iu refuzua mikpritja, e panë një mur që pothuaj ish rrëzuar dhe burri e ndreqi. Musai tha: ‘Por po të doje do të mund të paguheshe për ta bërë këtë.’<sup>78</sup> Ai tha: ‘Këtu ti dhe unë i ndajmë rrugët. Do të ta tregoj kuptimin e gjërave për të cilat nuk munde të përmbahesh me durim:’<sup>79</sup> barka u përkiste disa njerëzve në nevojë që e nxirrnin jetesën nga deti dhe e dëmtova se e dija që po vinte një mbret që po e merrte me forcë çdo barkë [të dobishme].<sup>18:80</sup> Djali i ri kishte prindër që ishin njerëz të besimit dhe kështu, duke u frikësuar se do t’i shqetësonte me ligësi e mosbesim,<sup>81</sup> ne deshëm që Zoti i tyre t’ua jepte një fëmijë tjetër – më të pastër dhe më dashamirës – në vend të tijin.<sup>82</sup> Muri u përkiste dy jetimëve të rinj në qytet dhe nën të kishte thesar të fshehur që u përkiste. Babai i tyre kish qenë njeri i ndershëm, kështu që Zoti yt synoi që ta arrinin pjekurinë dhe pastaj ta nxirrnin thesarin e tyre si mëshirë nga Zoti yt. Nuk i kam bërë [këto gjëra] me dëshirën time: këto janë shpjegimet për ato gjëra për të cilat nuk munde të përmbaheshe me durim.’

<sup>83</sup> [Profet,] të pyesin për Dhulkarnejnin.<sup>a</sup> Thuaj: ‘Do t’ju tregoj diçka për të.’<sup>84</sup> Ne e vendosëm pushtetin e tij në atë vend dhe ia dhamë mjetet për të arritur gjithçka.<sup>85</sup> Ai udhëtoi në një rrugë të caktuar; <sup>86</sup> pastaj kur arriti te perëndimi i

---

<sup>a</sup> Fjalë për fjalë ‘ai me dy brirë’, që nga disa thuhet të jetë Aleksandri i Madh.

diellit, e vërejti se [dukej sikur] po perëndon në një burim të turbullt. Aty afër i gjeti disa njerëz dhe Ne thamë: ‘Dhulkarnejn, mund të zgjedhësh [se cilët nga ta] t’i ndëshkosh apo t’u shfaqësh mirësi.’<sup>87</sup> Ai u përgjigj: ‘Ne do t’i ndëshkojmë ata që kanë bërë keq dhe kur t’i kthejnë te Zoti i tyre Ai do t’i ndëshkojë [edhe më] ashpër,<sup>88</sup> gjersa ata që besuan dhe bënë vepra të mira do t’i kenë më të mirat nga shpërblimet: do t’i urdhërojmë ta bëjnë atë që është e lehtë për ta.’<sup>89</sup> Ai udhëtoi tutje;<sup>18:90</sup> pastaj, kur arriti te lindja e diellit, e pa të lindte mbi një popull për të cilin Ne nuk patëm furnizuar kurrfarë strehimi prej diellit.<sup>91</sup> Dhe kështu ishte: Ne dinim gjithçka për të.

<sup>92</sup> Ai udhëtoi tutje; <sup>93</sup> pastaj, kur e arriti një vend mes dy pengesave malore, e gjeti rrëzë tyre një popull që mezi e kuptonin. <sup>94</sup> Ata thanë: ‘Dhulkarnejn, Jexhuxhët dhe Mexhuxhët po e shkatërrojnë këtë vend. A do ta ndërtosh një pengesë ndërmjet atyre dhe neve nëse të paguajmë haraç?’<sup>95</sup> Ai u përgjigj: ‘Fuqia që ma ka dhënë Zoti im është më e mirë se çfarëdo haraçi, por nëse ma jepni forcën tuaj, do ta vendos një fortifikim midis jush dhe tyre: <sup>96</sup> më sillni blloqe të hekurit!’ dhe pastaj, kur e kishte mbushur hapësirën ndërmjet dy anëve të malit [tha]: ‘Fryni zjarrit!’ dhe pastaj, kur e kishte bërë hekurin të shkëlqente si zjarr, tha: ‘Ma sillni metalin e shkrirë ta derdhim mbi të!’<sup>97</sup> Armiqtë e tyre nuk mund t’i ngjiteshin pengesës, as s’mund ta shponin,<sup>98</sup> dhe ai tha: ‘Kjo është mëshirë nga Zoti im. Por kur të përmbushet premtimi i Zotit tim, Ai do ta bëjë këtë pengesë rrafsh me tokë: premtimi i Zotit tim realizohet gjithmonë.’<sup>99</sup> Në atë Ditë, Ne do t’i lëmë të vërshojnë kundër njëri-tjetrit si dallgë dhe pastaj do t’i fryhet Trumpetës dhe Ne do t’i tubojmë të gjithë së bashku.<sup>18:100</sup> Do t’ua tregojmë Ferrin mosbesimtarëve,<sup>101</sup> atyre që sytë i kishin të verbër ndaj shenjave të Mija, atyre që nuk ishin në gjendje të dëgjonin.<sup>102</sup> A menduan se mund t’i merrnin shërbyesit E Mi për padronë në vend se Mua? Ferrin e kemi përgatitur si vend-pushim të mosbesimtarëve.

<sup>103</sup> Thuaj [Profet]: ‘A t’ju tregojmë [ne]<sup>a</sup> se cilët kanë më së shumti për të humbur nga veprimet e tyre, <sup>104</sup> përpjekjet e të cilëve në këtë botë janë të keqduhëzuara, madje edhe kur mendojnë se po bëjnë vepra të mira?’<sup>105</sup> Janë ata që nuk besojnë në mesazhet e Zotit të tyre dhe refuzojnë se do ta takojnë Atë.’ Veprat e tyre tkurren në asgjë: në Ditën e Ringjalljes Ne nuk do t’u japim kurrfarë peshe.<sup>106</sup> Shpagimi i tyre për atë se nuk besuan dhe u tallën me mesazhet E Mija dhe të dërguarit E Mi – do të jetë Ferri.<sup>107</sup> Por atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira do t’u jepen Kopshtet e Parajsës.<sup>108</sup> Aty do të mbesin, duke mos dashur të largohen kurrë.

---

<sup>a</sup> Kjo ‘ne’ me sa duket i referohet Profetit dhe komunitetit të tij të besimtarëve.

<sup>109</sup> Thuaj [Profet]: ‘Sikur tërë oqeani<sup>a</sup> të ishte bojë për t’i shkruar fjalët e Zotit tim, do të thahej para se të shtereshin ato fjalë’ – madje edhe po t’ia shtonim edhe një oqean. <sup>18:110</sup> Thuaj: ‘Jam veç qenie njerëzore, si ju, të cilës i është shpallur se **Allahu** juaj është Një. Kushdo që frikësohet<sup>b</sup> ta takojë Zotin e tij duhet të bëjë vepra të mira dhe të mos i japë askujt hise në adhurimin që i takon Zotit të tij.’

---

<sup>a</sup> Termi *bahr* i referohet të gjitha ujërave të gjera.

<sup>b</sup> Shih shënimin për 10:7: “apo ‘pret’ (një nga kuptimet e *yarjuna*).”

Kaptina “Shpella” është redaktuar nga Radije Hoxha në tetor 2020.

**Përshkrimi para kaptinës 18 nga Abdel Haleem:**

*Sure mekase që e merr emrin nga Fjetësit e Shpellës, rrëfimi i të cilëve zë vend të spikatur në sure (vargjet 9–26). Kjo sure merret edhe me dy rrëfime të tjera: takimin e Musait me një figurë të paidentifikuar (vargjet 60–82) dhe rrëfimin e Dhulkarnejnit (vargjet 83–99). Për njerëzit e Mekës është parashtruar një alegori: alegoria e kopshteve të lezetshme që i përkasin një njeriu arrogant e mosmirënjohës, të cilin **Allahu** e shndërron në pluhur. Kaptina hapet dhe mbyllet me referenca në vetë Kuranin.*

## 19: Merjemja (MERJEM)

Në emrin e **Allahut**, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës

<sup>1</sup> *Kaf Ha Ja `Ajn Sad*

<sup>2</sup> Ky është rrëfim përshkrues i mirësisë së Zotit tënd ndaj shërbyesit Të Tij, Zekerijasë, <sup>3</sup> kur i thirri Zotit të tij, duke thënë: <sup>4</sup> ‘Zot, eshtrat më janë dobësuar dhe flokët më janë thinjur, por kurrë, Zot, nuk të jam lutur kot: <sup>5</sup> kam frikë [për atë që do ta bëjnë] të afërmit e mi kur të kem shkuar, se gruaja ime është shterpë, andaj ma dhuro një pasardhës – dhuratë nga Ti – <sup>6</sup> të jetë trashëgimtari im dhe trashëgimtari i familjes së Jakubit. Zot, bëje të kënaqshëm [për Ty].’ <sup>7</sup> ‘Zekerija, Ne ta sjellim lajmin e mirë për një djalë që do të quhet Jahja (Gjon) – nuk e kemi zgjedhur këtë emër për askë tjetër para tij.’ <sup>8</sup> Ai tha: ‘Zot, si mund të kem djalë kur gruaja ime është shterpë e unë jam plak e i dobët?’ <sup>9</sup> Ai tha: ‘Ja çka ka thënë Zoti yt: “Është lehtë për Mua: të krijova ty, megjithëse nuk ishe asgjë më parë.”’

<sup>19:10</sup> Tha: ‘Ma jep një shenjë, Zot.’ Tha: ‘Shenja jote është se nuk do të [jesh në gjendje të] flasësh me askë për tri [ditë e] net të plota.’ <sup>11</sup> Doli nga faltarja, shkoi te populli i tij dhe i sinjalizoi ta lavdojnë **Allahun** mëngjes-e-mbrëmje.

<sup>12</sup> [Ne thamë:] ‘Jahja, mbahju fort Shkrimin të Shenjtë.’ Gjersa ishte ende çun, i dhuruam urti, <sup>13</sup> butësi nga Ne dhe pastërti. Ishte i përkushtuar, <sup>14</sup> i sjellshëm me prindërit e tij, jo dominues a rebel. <sup>15</sup> Paqja ishte në të në ditën kur u lind, në ditën kur vdiq dhe do të jetë në të në ditën që kthehet në jetë përsëri.

<sup>16</sup> Përmende në Kuran rrëfimin e Merjemes. Ajo u tërhoq nga familja e saj në një vend kah ana lindore <sup>17</sup> dhe u vetmua larg; Ne e dërguam Shpirtin Tonë të shfaqet para saj në formë të një njeriu të përsosur. <sup>18</sup> Ajo tha: ‘E kërkoj mbrojtjen e Zotit të Mëshirës ndaj teje: nëse ke sadopak frikë nga Ai [mos u afro]!’ <sup>19</sup> por ai tha: ‘Jam veç I Dërguar nga Zoti yt, [i ardhur] të ta shpall dhuratën e një djali të pastër.’ <sup>19:20</sup> Ajo tha: ‘Si mund të kem djalë kur s’më ka prekur asnjë burrë? Nuk kam qenë e padëlitë’, <sup>21</sup> dhe ai tha: ‘Ja çka tha Zoti yt: “Është lehtë për Mua – Ne do ta bëjmë atë shenjë për të gjithë njerëzit, bekim nga Ne.”’ <sup>22</sup> Dhe kështu u paracaktua: ajo e ngjizi. U tërhoq në një vend të largët <sup>23</sup> dhe, kur dhembjet e lindjes e shtynë [të kapet] te trangu i një peme të palmës, bërtiti: ‘Do të doja të kisha qenë e vdekur dhe e harruar shumë kohë para gjithë kësaj!’ <sup>24</sup> por një zë i thirri nga poshtë: ‘Mos u shqetëso: Zoti yt e ka furnizuar një rrjedhë te këmbët e tua <sup>25</sup> dhe, nëse e shkund trangu të palmës kah ti, do të të furnizojë me hurma të freskëta, <sup>26</sup> pra ha, pi, ji e lumtur dhe kujtdo që e sheh thuaji: “I jam betuar Zotit të Mëshirës të përmbahem nga biseda dhe sot nuk do të flas me askë.”’

<sup>27</sup> Ajo u kthye te populli i saj duke e mbajtur fëmijën dhe ata thanë: ‘Merjeme! Ke bërë diçka të tmerrshme!’ <sup>28</sup> Motër e Harunit! Babai yt nuk ishte njeri i keq; nëna jote nuk ishte e padëlirë!’ <sup>29</sup> Ajo tregoi me gisht kah ai. Ata thanë: ‘Si mund të bisedojmë me një fëmijë?’ <sup>a</sup> <sup>19:30</sup> [Por] ai tha: ‘Jam shërbyes i Allahut. Ai ma ka dhuruar Shkrimin e Shenjtë; më bëri profet; <sup>31</sup> më bëri të bekuar kudo që të jem. Më urdhëroi të falem, të jap lëmoshë sa të jem gjallë, <sup>32</sup> të kujdesem me butësi për nënën time. Nuk më bëri tiran a të pamirësi. <sup>33</sup> Paqja ishte në mua në ditën kur u linda dhe do të jetë në mua në ditën që vdes dhe në ditën që rikthehem në jetë.’ <sup>34</sup> I tillë ishte Isai, i biri i Merjemes. <sup>35</sup> Nuk do t’i kishte hije Allahut të kishte fëmijë. Ai është larg mbi atë: kur dekreton diçka, veç thotë: ‘Ji’ dhe është. <sup>36</sup> ‘Allahu është Zoti im dhe Zoti juaj, pra shërbeni Atij: kjo është rruga e drejtë.’ <sup>b</sup> <sup>37</sup> Por fraksionet kanë ndryshuar ndërmjet vete. Çfarë vuajtje do t’u vijë atyre që e errësojnë të vërtetën kur të arrijë një Ditë e tmerrshme! <sup>38</sup> Sa të mprehtë në dëgjim, sa të mprehtë në të pamur do të jenë kur të vijnë te Ne, megjithëse tani janë qartas jashtë drejtimit! Paralajmëroji [Muhamed] për Ditën e Pendimit kur çështja do të vendoset, <sup>39</sup> se janë të pavëmendshëm dhe nuk besojnë. <sup>19:40</sup> Jemi Ne që do ta trashëgojmë tokën dhe të gjithë ata që janë në të: të gjithë do t’i kthejnë te Ne.

<sup>41</sup> Përmende në Kuran edhe rrëfimin e Ibrahimit. Ishte njeri i së vërtetës, profet. <sup>42</sup> I tha babait të tij: ‘Baba, pse po adhuron diçka që as s’mund të dëgjojë as të shohë as të jetë i dobishëm për ty në asnjë mënyrë?’ <sup>43</sup> Baba, dija që nuk të ka arritur ty më ka ardhur mua, pra ndiqmë: do të të udhëzoj në një rrugë të drejtë. <sup>44</sup> Baba, mos e adhuro Satanin – Satani është rebeluar kundër Zotit të Mëshirës. <sup>45</sup> Baba, kam frikë se mund të të godasë një ndëshkim nga Zoti i Mëshirës dhe se mund të bëhesh shoqëruar i Satanit [në Ferr].’ <sup>c</sup> <sup>46</sup> Babai iu përgjigj: ‘Ibrahim, a i refuzon zotat e mi? Do të të gurëzoj nëse nuk e ndal këtë. Lëshoma rrugën dhe lërmë rehat!’ <sup>47</sup> Ibrahim tha: ‘Paqja qoftë me ty: do ta lus Zotin tim të të falë – Ai është gjithmonë dashamirës me mua – <sup>48</sup> por tash për tash do t’ju lë juve dhe idhujt që u luteni ju të gjithë dhe do t’i lutem Zotit tim dhe besoj se lutja ime nuk do të shkojë kot.’ <sup>49</sup> Kur e la popullin e tij dhe idhujt të cilëve u shërbenin pos Allahut, Ne ia dhuruam Is’hakun dhe Jakubin dhe i bëmë profetë që të dy: <sup>19:50</sup> ua dhuruam mirësinë Tonë të gjithë atyre dhe u dhamë reputacion fisnik.

<sup>51</sup> Përmende në Kuran edhe rrëfimin e Musait. Ishte zgjedhur posaçërisht, i dërguar dhe profet: <sup>52</sup> Ne i thirrëm atij nga ana e djathtë e malit dhe e sollëm afër Nesh në komunikim të fshehtë intim; <sup>53</sup> nga mirësia Jonë ia dhamë vëllain e tij

---

<sup>a</sup> Shih shënimin për 3:46: “Krahaso me 19:29-30. Fjala *mahd* domethënë një vend i zbutur për një fëmijë të vogël për të fjetur aty. Nuk është pjesë e mobileve si djep.”

Këtu përsëri termi *mahd* i referohet vendit të çdo niveli e jo ‘djepit’ konkret.

<sup>b</sup> Disa sugjerojnë se Muhamedi është urdhëruar ta bëjë këtë deklaratë; të tjerët se është duke folur Isai.

<sup>c</sup> Apo ‘se do të jesh përkrahës i Satanit’.

Harunin si profet. <sup>54</sup> Përmende në Kuran edhe rrëfimin e Ismailit. I qëndroi besnik premtimit të tij, i dërguar e profet. <sup>55</sup> E urdhëroi familjen e tij të falen dhe të japin lëmoshë dhe Zoti i tij ishte i kënaqur me të. <sup>56</sup> Përmende në Kuran edhe rrëfimin e Idrizit. Ishte njeri i të vërtetës, profet. <sup>57</sup> Ne e ngritëm në pozitë të lartë.

<sup>58</sup> Këta ishin profetët që i bekoj **Allahu** – nga fara e Ademit, nga ata që Ne i bartëm në Arkë me Nuhun, nga fara e Ibrahimit dhe Izraelit – dhe ata që i udhëzuam e i zgjodhëm. Kur u recitoheshin shpalljet e Zotit të Mëshirës, binin në gjunjë dhe qanin, <sup>59</sup> por pas tyre erdhën breza që i shpërfillën lutjet dhe nxiteshin nga merakët e tyre. Këta do të vijnë ballë për ballë me të keqen e tyre, <sup>19:60</sup> por ata që pendohen, që besojnë, që bëjnë vepra të ndershme, do të hyjnë në Parajsë. Nuk do t’u bëhet e padrejtë aspak: <sup>61</sup> do të hyjnë në Kopshtet e Lumturisë së Vazhdueshme, të premtuar nga Zoti i Mëshirës për shërbyesit E Tij – ende nuk është parë por vërtet premtimi I Tij do të përmbushet. <sup>62</sup> Atje do të dëgjojnë veç biseda paqësore, asgjë të keqe; aty do t’u jepen furnizime mëngjes-embrëmje. <sup>63</sup> Ai është Kopshti që do t’ua japim si të vetin shërbyesve Tanë që ishin të përkushtuar.

<sup>64</sup> [Xhebraili tha:]<sup>a</sup> ‘Ne zbresim [me shpallje] me urdhrin e Zotit tënd – gjithçka para nesh, gjithçka prapa nesh, gjithçka ndërmjet, të gjitha i përkasin Atij – Zoti yt kurrë nuk është harrues. <sup>65</sup> Ai është Zoti i qiejve dhe i tokës dhe i gjithçkaje ndërmjet, pra adhuroje: ji i qëndrueshëm në adhurimin E Tij. A e njeh ndokë të barabartë me Të?’

<sup>66</sup> Njeriu thotë: ‘Çka? Pasi të jem i vdekur, do të kthehem prapë në jetë?’ <sup>67</sup> por a nuk e mban mend njeriu se Ne e krijuam kur nuk ishte asgjë më parë? <sup>68</sup> Pasha Zotin tënd [Profet] do t’i mbledhim ata dhe djajtë bashkë dhe do t’i vëmë në gjunjë përreth Ferrit; <sup>69</sup> do t’i kapim nga secili grup ata që ishin më të pabindurit ndaj Zotit të Mëshirës – <sup>19:70</sup> e dimë më së miri se kush e meriton më së shumti të digjet në Ferr – <sup>71</sup> por secili nga ju<sup>b</sup> do t’i afrohet, dekret nga Zoti juaj që duhet të përmbushet. <sup>72</sup> Do t’i kursejmë të përkushtuarit dhe do t’i lëmë keqbërësit atje në gjunjë.

<sup>73</sup> Kur u lexohen shpalljet Tona me gjithë qartësinë e tyre, [krejt çka] mosbesimtarët u thonë besimtarëve [është]: ‘Cila anë është në situatë më të mirë? Cila anë ka rreth më të mirë të ndjekësve?’ <sup>74</sup> Ne kemi shkatërruar shumë breza para tyre që ua tejkalonin me pasuri dhe vezullim të jashtëm! <sup>75</sup> Thuaj [Profet]: ‘Zoti i Mëshirës ua zgjat [jetët] të kequdhëzuarve, deri kur të përballen me atë për të cilën ishin paralajmëruar – ose me ndëshkimin [në këtë jetë] ose me Orën [e

---

<sup>a</sup> Kjo është përgjigje e Xhebrailit në kërkesën e Profetit për vizita më të shpeshta (shih Bukhari, *Sahih*, Libri i Tefsirit, Surja 19).

<sup>b</sup> Kjo është marrë se i referohet mosbesimtarëve të përmendur këtu, apo tërë njerëzimit.



Gjykimit] – ata e kuptojnë se kush është në situatë më të keqe dhe kush i ka forcat më të dobëta.’<sup>76</sup> Por **Allahu** u jep më shumë udhëzim atyre që janë të udhëzuar, dhe veprat e mira të meritës së qëndrueshme janë më të mirat dhe më të shpërblyeshmet nga pikëpamja e Zotit tuaj.<sup>77</sup> A ke reflektuar për njeriun që e refuzon shpalljen Tonë, që thotë: ‘Sigurisht që do të më jepet pasuri dhe fëmijë’?<sup>78</sup> A e ka depërtuar të panjohurën apo a ka marrë zotim për këto nga Zoti i Mëshirës?<sup>79</sup> Jo! Ne sigurisht që do ta regjistrojmë atë që e thotë dhe do t’ia zgjasim ndëshkimin: <sup>19:80</sup> do t’i trashëgojmë nga ai krejt ato për të cilat flet dhe do të vijë te Ne krejt i vetëm.

<sup>81</sup> Ata kanë marrë zota të tjerë krahas **Allahut** për t’u dhënë pushtet,<sup>82</sup> por ata zota do ta refuzojnë adhurimin e tyre dhe madje do t’u kthehen kundër.<sup>83</sup> A nuk e ke parë [Profet] se si Ne dërgojmë djaj për t’i nxitur mosbesimtarët të mëkatojnë?<sup>84</sup> Nuk ka nevojë të jesh i padurueshëm me ta: po ua numërojmë kohën e tyre [të caktuar].<sup>85</sup> Në Ditën që i mbledhim të ndershmit si shoqëri e nderuar para Zotit të Mëshirës<sup>86</sup> dhe i dëbojmë mëkatarët si tufë të etur në Ferr,<sup>87</sup> askush nuk do të ketë pushtet të ndërmjetësojë pos atyre që kanë leje<sup>a</sup> nga Zoti i Mëshirës.

<sup>88</sup> Mosbesimtarët thonë: ‘Zoti i Mëshirës ka fëmijë të lindur.’<sup>b</sup> <sup>89</sup> Sa e tmerrshme është kjo që e pohoni: <sup>19:90</sup> pothuajse i bën qiejt të copëtohen, tokën të çahet, malet të shkatërrohen në thërmia,<sup>91</sup> se ata i atribuojnë pasardhës të lindur Zotit të Mëshirës.<sup>92</sup> Nuk i ka hije Zotit të Mëshirës [të ketë pasardhës të lindur]:<sup>93</sup> nuk ka asnjë në qiej a në tokë që nuk do të vijë te Zoti i Mëshirës si shërbyes –<sup>94</sup> Ai ua ka bërë llogarinë të gjithëve: i ka numërtuar saktësisht –<sup>95</sup> dhe secili nga ta do të kthehet krejtësisht i vetëm tek Ai në Ditën e Ringjalljes.

<sup>96</sup> Por Zoti i Mëshirës do t’u japë dashuri atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të ndershme: <sup>97</sup> Ne e kemi bërë atë<sup>c</sup> të lehtë, në gjuhën tënde [Profet], që të mund t’u sjellësh lajme të mira të ndershmëve dhe paralajmërime një populli kokëfortë.<sup>98</sup> Sa shumë breza Ne i kemi shkatërruar para tyre! A po e percepton qoftë edhe një nga ta tani, apo të dëgjosh ndojgjë qoftë edhe sa një pëshpërimë?

---

<sup>a</sup> Për kuptimin e ‘ahd si ‘leje’ *idhn* shih Baydawi. Krahaso me 10:3; 78:38.

<sup>b</sup> Shumë përkthyes këtu thonë ‘bir’, duke mos e kuptuar se *walad* në arabishten klasike domethënë ‘një fëmijë’ apo ‘shumë fëmijë’. Diskutimi këtu është për paganët e Mekës, që thanë se engjëjt ishin bija të **Allahut**.

<sup>c</sup> Ose atë që është thënë në këtë sure ose tërë Kurandin.

**Përshkrimi para kaptinës 19 nga Abdel Haleem:**

*Sure mekase që e merr emrin nga rrëfimi i Merjemes (vargjet 16-35). Ajo e rrëfen mirësinë që ua ka dhënë **Allahu** disa profetëve dhe tregon aspekte të rrëfimeve të tyre. Pretendimi se Isai është i biri i **Allahut** mohohet vendosmërisht, si edhe pohimi i paganëve të Mekës se engjëjt janë bija të **Allahut**. Nga vargjet 66 deri 98 surja i diskuton pohimet arrogante të mosbesimtarëve të Mekës. Profetit i thuhet se ndëshkimi i **Allahut** po u vjen dhe këshillohet të mos jetë i paduruar për arritjen e tij apo për pranimin e shpalljes (vargjet 64-65).*

## 20: Ta Ha

Në emrin e **Allahut**, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës

- <sup>1</sup> *Ta Ha*<sup>a</sup>
- <sup>2</sup> Ne nuk ta kemi zbritur Kuranin [, Profet]  
se duhej të trishtoheshe,
- <sup>3</sup> po veç si përkujtues  
për ata që kanë frikë-respekt për **Allahun**,
- <sup>4</sup> shpallje nga Krijuesi  
i tokës e i qiellit të lartë,
- <sup>5</sup> Dashmirësi Mëshirëplotë  
i vendosur në Fron.
- <sup>6</sup> Gjithçka në qiej dhe në tokë,  
dhe ajo që është ndërmjet tyre,  
dhe ajo që është nën tokë,  
i përket Atij.
- <sup>7</sup> Pra nëse e flet fjalën me zë të lartë,  
sigurisht që Ai e di fshehtësinë,  
madje edhe atë që fshehet edhe më thellë.
- <sup>8</sup> **Allahu** – nuk ka zot pos Tij –  
emrat më të bukur i përkasin Atij.

<sup>9</sup> A të ka ardhur [Profet] rrëfimi i Musait?<sup>b</sup> <sup>20:10</sup> Ai e pa një zjarr dhe u tha njerëzve të tij: ‘Rrini këtu – mund ta shoh një zjarr. Ndoshta mund t’jua sjell një copë dru të ndezur nga ai apo të gjej ndonjë udhëzim atje.’ <sup>11</sup> Kur erdhi te zjarri, ai u thirr: ‘Musa! <sup>12</sup> Jam Zoti yt. Zbathi këpucët: je në luginën e shenjtë të Tuvasë. <sup>13</sup> Të kam zgjedhur, kështu që dëgjoje atë që po shpallet. <sup>14</sup> Unë jam **Allahu**; nuk ka zot pos Meje. Pra adhuromë dhe lutu e falu vazhdimisht që të më kujtosh. <sup>15</sup> Ora po vjen – megjithëse zgjedha<sup>c</sup> ta mbaj të fshehur – për çdo shpirt

---

<sup>a</sup> Është një opinion se *ta ha* nuk janë shkronja të izoluar por ‘O njeri!’ në dialektin Jemen të ‘Akk (Razi). Për rëndësinë e shkronjave të izoluar si tërësi, shih shënimin për 2:1.

<sup>b</sup> Ky konstrukt është idiomë në arabisht që nënkupton ‘mendo mirë për të’ apo ‘merr mësim nga kjo’.

<sup>c</sup> Ebu Muslimi e interpreton *akadu* si *uridu*: ‘dëshiroj’ apo ‘zgjedh’ (Razi).

që të shpërblehet për punën e tij. <sup>16</sup> Mos e lejo askë që nuk beson në të dhe i ndjek meraket e tij të të shpërqendrojë nga ajo dhe kështu të të sjellë në shkatërrim.’

<sup>17</sup> ‘Musa, ç’është ajo në dorën tënde të djathtë?’ <sup>18</sup> ‘Është shkopi im’, tha ai, ‘mbështetem në të; i ruaj delet e mia me të;<sup>a</sup> e përdori edhe për gjëra të tjera.’ <sup>19</sup> **Allahu** tha: ‘Hidhe në tokë, Musa.’ <sup>20:20</sup> E hodhi në tokë dhe – shih sa çudi! – u bë gjarpër i shpejtë. <sup>21</sup> Tha: ‘Kape pa frikë: Ne do ta kthejmë në gjendjen e tij të mëparshme. <sup>22</sup> Tash fute dorën nën sqetull dhe do të dalë e bardhë, megjithëse e padëmtuar: kjo është një shenjë tjetër. <sup>23</sup> Ne e bëjmë këtë për të t’i treguar disa nga shenjat Tona më të mëdha. <sup>24</sup> Shko te Faraoni, se vërtet është bërë tiran.’

<sup>25</sup> Musai tha:

‘Zot, më jep zemër

<sup>26</sup> dhe ma lehtëso detyrën.

<sup>27</sup> Zgjidhma nyjën e gjuhës,

<sup>28</sup> që të mund t’i kuptojnë fjalët e mija,

<sup>29</sup> dhe ma jep një ndihmës

nga familja ime,

<sup>20:30</sup> vëllain tim Harunin –

<sup>31</sup> ma shto forcën përmes tij.

<sup>32</sup> Le ta kemi bashkë detyrën me të

<sup>33</sup> që të mund të t’lartësojmë shumë

<sup>34</sup> dhe të t’kujtojmë shpesh:

<sup>35</sup> se Ti po na mbikëqyr gjithmonë.’

<sup>36</sup> **Allahu** tha: ‘Musa, kërkesa jote pranohet. <sup>37</sup> Vërtet Ne të dhamë përparësi të dukshme më parë. <sup>38</sup> E frymëzua nënën tënde, duke thënë: <sup>39</sup> “Fute fëmijën tënd në arkë, pastaj vendose në lumë. Le ta çojë uji te bregu i tij dhe ai do të merret nga një armik I Imi dhe i tij.” Ta dhurova dashurinë Time të begatshme dhe planifikova që do të edukoheshe nën syrin Tim vigjilent. <sup>20:40</sup> Motra jote doli duke thënë: “Do t’jua tregoj dikë që do të kujdeset për të”, pastaj Ne të kthyem te nëna jote që të mund të gëzohej e të mos pikëllohej. Më vonë e vrave një njeri, por të shpëtua nga ankthi dhe të sprovua me prova të tjera. Ndenje ndër njerëzit e Medjenit me vite, pastaj erdhe këtu siç urdhërova Unë. <sup>41</sup> Të kam zgjedhur për Vete. <sup>42</sup> Shkoni, ti dhe vëllai yt, me shenjat E Mija dhe sigurohuni të

---

<sup>a</sup> Ose ‘i shkundi gjethet për delet e mija me të’

më kujtoni. <sup>43</sup> Shkoni, të dytë, te Faraoni, se i ka tejkualuar të gjithë kufijtë. <sup>44</sup> Flisni butë me të që të mund të jetë i vëmendshëm, apo të tregojë respekt.’

<sup>45</sup> Ata thanë: ‘Zot, kemi frikë se ai do të na lëndojë shumë apo t’i tejkalojë të gjithë kufijtë.’ <sup>46</sup> Ai tha: ‘Mos kini frikë, Unë jam me ju të dy, duke dëgjuar dhe duke parë gjithçka. <sup>47</sup> Shkoni dhe i thoni: “Jemi të dërguarit e Zotit tënd, pra lëshoji Fëmijët e Izraelit me ne dhe mos i shtyp. Ta kemi sjellë një shenjë nga Zoti yt. Paqja qoftë mbi këdo që e ndjek udhëzimin e duhur; <sup>48</sup> na është shpallur se ndëshkimi bie mbi këdo që e refuzon të vërtetën dhe ia kthen shpinën.” ’

<sup>49</sup> [Faraoni] tha: ‘Musa, kush është ky farë Zoti yt?’ <sup>20:50</sup> Musai tha: ‘Zoti ynë është Ai që i dha gjithçkaje formën e saj, pastaj i dha udhëzim.’ <sup>51</sup> Tha: ‘E brezat e mëparshëm?’ <sup>52</sup> Musai tha: ‘Veç Zoti im ka njohuri për ta, të gjitha në një regjistër; Zoti im nuk gabon as s’harron.’ <sup>53</sup> Është Ai që e shtriu tokën për ju dhe i shenjoji rrugët në të. Ai e zbriti ujin nga qielli. Me atë ujë Ne e nxjerrim çdo lloj bime, <sup>54</sup> pra hani dhe kullotni bagëtitë tuaja. Ka vërtet shenja në tërë këtë për njerëz që kuptojnë. <sup>55</sup> Nga toka ju krijuam, në të do t’ju kthejmë dhe nga ajo do t’ju ringjallim për herë të dytë.

<sup>56</sup> Ne ia treguam Faraonit të gjitha shenjat Tona, por i mohoi dhe refuzoi [të ndryshojë]. <sup>57</sup> Tha: ‘Musa, a ke ardhur të na dëbosh nga vendi ynë me magji?’ <sup>58</sup> Do të t’kundërvihemi me magji për t’iu përgjigjur tëndes: bëje një takim ndërmjet nesh të cilin asnjëri nga ne nuk do të dështojë ta mbajë, në një vend të pajtueshëm për të dy palët.’ <sup>59</sup> Tha: ‘Takimi juaj do të jetë në ditën e festës, pra le të mblidhen njerëzit kur dielli të jetë ngritur lart.’

<sup>20:60</sup> Faraoni u tërhoq dhe i mblodhi resurset e tij,<sup>a</sup> pastaj u kthye. <sup>61</sup> Musai u tha: ‘Ruajuni, mos shpikni rrena kundër Allahut përndryshe do t’ju shkatërrojë me ndëshkimin E Tij. Kushdo që shpik rrena do të dështojë.’ <sup>62</sup> Kështu e diskutuan planin e tyre ndërmjet vete, duke folur fshehtas, <sup>63</sup> duke thënë: ‘Këta dy njerëz janë magjistare. Qëllimi i tyre është t’ju dëbojnë nga vendi juaj me magjinë e tyre dhe t’i japin fund mënyrës suaj të kahmotshme të jetës. <sup>64</sup> Pra mblidhni resurset tuaja dhe rreshtohuni për garën. Kushdo që fiton sot sigurisht që do të përparojë.’ <sup>65</sup> Thanë: ‘Musa, a do të hedhësh ti i pari apo të hedhim ne?’ <sup>66</sup> ‘Hidhni ju’, tha Musai dhe – shih sa çudi! – përmes magjisë së tyre, litarët dhe shkopinjët e tyre i dukeshin se po lëviznin. <sup>67</sup> Musai u shqetësua përbrenda, <sup>68</sup> por Ne thamë: ‘Mos ki frikë, e ke epërsinë. <sup>69</sup> Hidhe në tokë atë që e ke në dorën e djathtë: do t’i gllabërojë ato që i kanë prodhuar. Kanë prodhuar veç truqe të një magjistari dhe një magjistar nuk do të përparojë, kahdo që të shkojë.’

---

<sup>a</sup> Fjalë për fjalë: ‘ligësinë e tij’, *kajdah*. Kjo do të mund t’u referohej magjistarëve të tij apo kompleteve që i kishte bërë.

<sup>20:70</sup> [Kështu ndodhi, dhe] magjistarët ranë poshtë në nënshtrim. ‘Besojmë’, thanë, ‘në Zotin e Harunit dhe të Musait.’ <sup>71</sup> Faraoni tha: ‘Si guxoni të besoni në të para se t’jua kem dhënë lejen unë? Ky duhet të jetë mjeshtri juaj, njeriu që jua mësoi magjinë. Sigurisht që do t’jua pres duart dhe shputat alternative,<sup>a</sup> pastaj do t’ju kryqëzoj në trunget e pemëve të palmave. Do ta dini sigurisht se cili nga ne ka ndëshkim më të ashpër dhe më të përhershëm.’ <sup>72</sup> Thanë: ‘Nuk do të të preferojmë kurrë para shenjës së qartë që na ka ardhur, as para Atij që na krijoi. Pra vendos çkado që të vendosësh: mund të vendosësh veç për çështje të kësaj jete të tashme – <sup>73</sup> besojmë në Zotin tonë, [duke shpresuar se] Ai mund të na i falë mëkatet tona dhe magjinë që na detyrove ta praktikojmë – **Allahu** është më i mirë dhe më i përhershëm.’

<sup>74</sup> Ferri do të jetë shpërblimi i atyre që kthehen te Zoti i tyre si keqbërës: aty do të rrinë, as duke jetuar as duke vdekur. <sup>75</sup> Por ata që kthehen te Zoti i tyre si besimtarë me vepra të ndershme do të shpërblehen me gradat më të larta, <sup>76</sup> me Kopshte me lumturi të përhershme të hijeshuara me mirësinë e lumenjve rrjedhës dhe aty do të rrinë. I tillë është shpërblimi i atyre që pastrohen.

<sup>77</sup> Ne i shpallëm Musait: ‘Dil gjatë natës me shërbyesit E Mi dhe godite një shteg të thatë për ta përgjatë detit.<sup>b</sup> Mos ki frikë se do t’ju zënë dhe mos u tmerroni.’ <sup>78</sup> Faraoni i ndoqi me ushtritë e tij dhe u përmyt nga deti. <sup>79</sup> Faraoni vërtet i çoi në devijim popullin e tij; nuk i udhëzoi.

<sup>20:80</sup> Fëmijë të Izraelit, Ne ju shpëtuam nga armiqtë tuaj. E bëmë një zotim me ju në anën e djathtë të malit. Zbritëm mana dhe thëllëza për ju: <sup>81</sup> ‘Hani nga gjërat e mira që i kemi furnizuar për ju, por mos i tejkalonit kufijtë, se zemërimi Im do të zbresë mbi ju. Kushdo mbi të cilin zbret zemërimi Im ka rënë vërtet. <sup>82</sup> E megjithatë Unë jam më falësi ndaj atyre që pendohen, besojnë, bëjnë vepra të ndershme dhe rrinë në rrugën e drejtë.

<sup>83</sup> [Allahu tha:] ‘Musa, çka të shtyri të vish para popullit tënd me kaq nxitim?’ <sup>c</sup> <sup>84</sup> dhe ai tha: ‘Ata po i ndjekin gjurmët e mija. Nxitova te Ti, Zot, të të kënaq’, <sup>85</sup> por Allahu tha: ‘Ne e kemi sprovuar popullin tënd në mungesën tënde: Samiriu<sup>d</sup> i ka çuar në devijim.’ <sup>86</sup> Musai u kthye te populli i tij, i zemëruar dhe i pikëlluar. Tha: ‘Populli im, a s’jua dha Zoti juaj një premtim të mirësishëm? A ishte mungesa ime tepër e gjatë për ju? A deshët që zemërimi t’ju binte nga Zoti juaj dhe kështu e shkelët fjalën që ma dhatë?’ <sup>87</sup> Ata thanë: ‘Ne nuk e kemi shkelur fjalën tonë me qëllim. Ishim të ngarkuar me peshën e stolive të njerëzve, kështu që

---

<sup>a</sup> Shih shënimin për 5:33: Dora e majtë dhe shputa e djathtë apo e kundërta.

<sup>b</sup> *Bahr*, ‘det’, domethënë çfarëdo hapësire e ujit, i ëmbël apo i kripur. Krahaso me 35:12.

<sup>c</sup> Musai e kishte lënë popullin e tij në përgjegjësi të Harunit që ai të mendohej thellë në malin Sinai. Shih 7:142 e tutje.

<sup>d</sup> Razi sugjeron identitete të ndryshme të paverifikuara për Samiriun.

i hodhëm ato [në zjarr] dhe kështu bëri edhe Samiriu’,<sup>88</sup> por ai [i përdori stolitë e shkrira dhe] e prodhoi një imazh të një viçi që lëshonte tingull pëllitës dhe ata thanë: ‘Ky është zoti yt dhe zoti i Musait, por ai ka harruar.’<sup>89</sup> A s’e shihnin se [viçi] nuk u jepte asnjë përgjigje, se nuk kishte pushtet t’i dëmtojë apo t’u sillte dobi?<sup>20:90</sup> Haruni u tha: ‘Populli im, ky viç është sprovë për ju. Zoti juaj i vërtetë është Zoti i Mëshirës, pra më ndiqni dhe bindjuni urdhrave të mi’,<sup>91</sup> por ata u përgjigjën: ‘Nuk do të heqim dorë nga përkushtimi ynë ndaj tij deri kur të kthehet Musai te ne.’

<sup>92</sup> Musai tha: ‘Kur e kuptove se kishin devijuar, çka të pengoi, Harun,<sup>93</sup> të vish tek unë? Si munde të mos i bindeshe urdhrave të mi?’<sup>94</sup> Ai tha: ‘O bir i nënës sime – lëshomi mjekrën dhe flokët! – kisha frikë se do të thoshe: “Ti ke shkaktuar përçarje ndërmjet fëmijëve të Izraelit dhe nuk më ke dëgjuar çka kam thënë.”’<sup>95</sup> Musai tha: ‘Dhe si ishte puna me ty, Samiri?’<sup>96</sup> Ai u përgjigj: ‘Unë pashë diçka që ata nuk e panë; i mora disa nga mësimet e Të Dërguarit por i hodha mënjanë:<sup>a</sup> shpirti im më nxiti ta bëj atë që e bëra.’<sup>97</sup> Musai tha: ‘Largohu nga këtu! Shorti yt në këtë jetë është të thuash: “Mos më prekni”,<sup>b</sup> por e ke një takim nga i cili nuk ka shpëtim. Shikoje zotin tënd që ke vazhduar ta adhurosh – ne do ta bluajmë<sup>c</sup> dhe do ta shpërndajmë në det.’<sup>98</sup> [Njerëz,] zoti juaj i vërtetë është **Allahu** Një – nuk ka zot tjetër pos Tij – dija e Të Cilit përfshin gjithçka.’

<sup>99</sup> Kështu Ne t’i tregojmë [Profet] rrëfimet e asaj që ka ndodhur më parë. Të kemi dhënë Kuran nga Ne.<sup>20:100</sup> Kushdo që largohet nga ai do të bartë barrë të rëndë në Ditën e Ringjalljes<sup>101</sup> dhe do të mbetet nën të. Çfarë barre e rëndë për ta bartur në atë Ditë!<sup>102</sup> Kur t’i bihet trumpetës dhe t’i mbledhim mëkatarët, të verbrit,<sup>d</sup><sup>103</sup> do t’i murmurisin njëri-tjetrit: ‘Keni qëndruar veç dhjetë ditë [në tokë]’ –<sup>104</sup> Ne e dimë më së miri atë që e thonë – por ata që janë më perceptues ndër ta do të thonë: ‘Qëndrimi juaj [në tokë] ishte veç një ditë e vetme.’

<sup>105</sup> Të pyesin [Profet] për malet – thuaj: ‘[Në atë Ditë] Zoti im do t’i shndërrtojë në pluhur<sup>106</sup> dhe do ta lërë një fushë të rrafshët,<sup>107</sup> pa breg a lug për t’u parë.<sup>108</sup> Në atë Ditë, njerëzit do ta ndjekin thirrësin nga i cili nuk ka shpëtim; secili zë do të heshtet për Zotin e Mëshirës; veç pëshpërimit do të dëgjohen.’<sup>109</sup> Në atë Ditë, ndërmjetësimi do të jetë pa dobi pos nga ata që u ka dhënë leje Zoti i Mëshirës dhe fjalët e të cilëve i miraton –<sup>20:110</sup> Ai e di atë që është para dhe prapa tyre, megjithëse ata nuk e kuptojnë Atë –<sup>111</sup> dhe [të gjitha] fytyrat<sup>e</sup> do të përulen para Të Gjallit, Gjithmonë-Vigjilentit. Të ngarkuarit me vepra të këqija do të dëshpërohen,<sup>112</sup> por kushdo që ka bërë vepra të nderhme dhe ka besuar nuk ka

<sup>a</sup> Fjalë për fjalë: ‘Mora pak nga gjurma e të dërguarit dhe e hodha poshtë me forcë...’

<sup>b</sup> Një interpretim tjetër është se Samiriu do të bëhet i dëbuar nga shoqëria.

<sup>c</sup> *Harraqa* në përdorimin klasik e ka kuptimin ‘bluaj’, siç përdoret këtu, e jo ‘djeg’.

<sup>d</sup> *Zurq* nga *azraq*, që domethënë, ndër të tjera, ‘i verbër’. Krahaso me vargjet 124-126.

<sup>e</sup> Kjo mund ta ketë edhe kuptimin ‘fytyrat e tyre’.

nevojë të ketë frikë nga padrejtësia a privimi.’<sup>113</sup> Ne e kemi zbritur Kuranin në gjuhën arabe dhe i kemi dhënë të gjitha llojet e paralajmërimeve në të, që ata të mund të kenë kujdes apo të jenë të vëmendshëm –<sup>114</sup> lartësuar qoftë **Allahu**, Ai që e ka kontrollin vërtet.

[Profet,] mos nxito të recitosh para se shpallja të ketë përfunduar plotësisht<sup>a</sup> por thuaj: ‘Zot, rritma njohurinë!’<sup>115</sup> Ne e urdhëruam edhe Ademin para teje, por ai harroi dhe na doli i munguar në qëndrueshmëri.<sup>116</sup> Kur u thamë engjëjve: ‘Përkuluni para Ademit’, ata e bënë. Por Iblisi refuzoi,<sup>117</sup> kështu që thamë: ‘Adem, ky është armiku yt, i yti dhe i gruas sate: mos e lejoni t’ju nxjerrë nga kopshti dhe t’ju bëjë të mjerë.’<sup>118</sup> Në kopsht kurrë nuk do të uritesh, të ndihesh lakuriq,<sup>119</sup> të ndihesh i etur, a ta vuash vapën e diellit.’<sup>20:120</sup> Por Satani i pëshpëriti Ademit, duke thënë: ‘Adem, a të ta tregoj pemën e pavdekësisë dhe fuqinë që nuk shuhet kurrë?’<sup>121</sup> dhe hëngrën të dytë nga ajo. U bënë të vetëdijshëm për lakuriqësinë e tyre dhe nisën të mbulohen me gjethe nga kopshti. Ademi nuk iu bind Zotit të tij dhe ishte devijuar –<sup>122</sup> më vonë Zoti i tij e afroi, ia pranoi pendimin dhe e udhëzoi –<sup>123</sup> **Allahu** tha: ‘Dilni nga kopshti si armiq të njëri-tjetrit.’<sup>b</sup>

Kushdo që e ndjek udhëzimin Tim, kur bëhet fjala për ju [njerëz], nuk do të devijojë as s’do të bjerë në mjerim,<sup>124</sup> por kushdo që largohet nga ai do të ketë jetë me vështirësi të mëdha. Ne do ta sjellim të verbër në Mbledhimin në Ditën e Ringjalljes<sup>125</sup> dhe do të thotë: ‘Zot, pse më ke sjellë këtu të verbër? Më parë shihja!’<sup>126</sup> **Allahu** do të thotë: ‘Kjo është kështu: i injorove shpalljet Tona kur të erdhën, kështu që sot do të injorohesh.’<sup>127</sup> Kështu i shpërblejmë ata që shkojnë tepër larg dhe që nuk besojnë në shpalljet e Zotit të tyre. Ndëshkimi më i madh dhe më i qëndrueshëm është në Të Përtejmen.<sup>128</sup> A nuk nxjerrin mësim nga shumë breza që i shkatërroam para tyre, nëpër vendbanimet e të cilëve ecin tani? Vërtet ka shenja në këtë për këdo të mençur!

<sup>129</sup> Po të mos ishte një Fjalë e paracaktuar nga Zoti yt, [Profet,] ata do të ishin shkatërruar tashmë. Koha e tyre është caktuar,<sup>20:130</sup> kështu që [Profet] ki durim me atë që e thonë – festoje lavdimin e Zotit tënd, para lindjes dhe perëndimit të diellit, festoje lavdimin E Tij gjatë natës dhe në fillimin dhe mbarimin e ditës, që të mund të gjesh kënaqësi –<sup>131</sup> dhe mos i shiko me merak ato që ua kemi dhënë disave nga ta që të kënaqen, stoli të kësaj jete të tashme: Ne i sprovovmë përmes kësaj, por furnizimi i Zotit tënd është më i mirë dhe më i qëndrueshëm.<sup>132</sup> Urdhëroje popullin tënd<sup>c</sup> të falen dhe ti vetë falu me qëndrueshmëri. Nuk po

---

<sup>a</sup> Muhamedi, kur ia përsëriste Xhebrailit secilën shpallje, pasi e jepte engjëlli atë, nganjëherë prej zellit niste t’ia përsëriste madje edhe para se Xhebraili ta përfundonte shpalljen. Shih edhe 75:16-19.

<sup>b</sup> Të dy palët, krahaso me 2:36 dhe shënimin.

<sup>c</sup> Apo ‘familjen tënde’.



të kërkojmë të na japësh furnizim; <sup>a</sup> Ne furnizojmë për ty dhe shpërblimet e Të Përtejmes u përkasin të përkushtuarve.

<sup>133</sup> Mosbesimtarët thonë: ‘Pse nuk na e sjell ai një shenjë nga Zoti i tij?’ A nuk u është dhënë provë e qartë që e vërteton atë që ishte në shkrimet e shenjta të mëhershme? <sup>134</sup> Po t’i kishim shkatërruar përmes ndëshkimit para se të vinte ky I Dërguar, do të kishin thënë: ‘Zot, veç po ta kishe çuar një të dërguar, do të mund t’i ndiqnim shpalljet e Tua para se të vuanim poshtërim e turpërim!’ <sup>135</sup> [Profet,] thuaj: ‘Të gjithë po presim, kështu që vazhdoni të pritni: do ta merrni vesh se kush e ka ndjekur rrugën e drejtë dhe ka qenë i udhëzuar drejt.’

---

<sup>a</sup> Krahaso me 51:57.

**Përshkrimi para kaptinës 20 nga Abdel Haleem:**

*Sure mekase që edhe nis edhe mbaron me përmendjen e Kuranit: nuk i ishte dërguar Profetit për t'i shkaktuar pikëllim por është provë e qartë nga Zoti i tij. Shembulli i Musait jepet si tregim i gjatë për ta inkurajuar Profetin dhe për ta treguar fundin e mosbesimtarëve. Shkatërimi i brezave të mëhershëm citohet si mësim nga i cili do të duhej të mësojnë mosbesimtarët. Profeti urdhërohet të jetë i durueshëm dhe ta vazhdojë adhurimin e tij me qëndrueshmëri.*

## 21: Profetët (EL-ENBIJÂ')

Në emrin e **Allahut**, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës

- <sup>1</sup> Njerëzve u afrohet gjithnjë e më shumë llogaria e tyre,  
gjersa largohen, të pavëmendshëm.
- <sup>2</sup> Kurdo që u vjen  
një shpallje e freskët nga Zoti i tyre,  
e përqeshin gjersa e dëgjojnë,  
<sup>3</sup> me zemra të pavëmendshme.  
Dhe keqbërësit i mbajnë të fshehta  
këshillimet e tyre:  
'A s'është ky njeri veç vdekatar si ju?  
A do të bini në magjinë e tij, syhapur?'
- <sup>4</sup> [Profeti] tha<sup>a</sup>:  
'Zoti im di gjithçka që thuhet  
në qiej e në tokë;  
Ai është Gjithë-Dëgjuesi, I Gjithë-Dijshmi.'
- <sup>5</sup> Disa thonë: 'lëmsh ëndrrash';  
të tjerë: 'Ai e shpiki.'  
e të tjerë: 'Është veç poet.  
La të na e tregojë një shenjë  
siç bënë të dërguarit e mëparshëm.'
- <sup>6</sup> Por nga komunitetet që Ne i shkatërruam më parë  
as edhe një nuk besoi:  
pra a do të besojnë këta tani?
- <sup>7</sup> Dhe edhe para kohës sate [Profet],  
të gjithë të dërguarit që i çuam  
ishin veç njerëz që i frymëzuam –  
nëse [ju mosbesimtarë] nuk e dini,  
pyetini njerëzit që e njohin Shkrimin e Shenjtë –
- <sup>8</sup> nuk u dhamë trupa

---

<sup>a</sup> Këtu dhe në vargun 112 një lexim alternativ është urdhërorja, *qul* ('thuj').

që nuk hanin ushqim;  
dhe nuk ishin të pavdekshëm.

- 9 Ne e përmbushëm premtimin Tonë në fund:  
i shpëtuam ata, si dhe të tjerët që deshëm t'i shpëtonim,  
dhe i shkatërruam shpërdoruesit  
që i tejkaluan të gjithë kufijtë.

21:10 Dhe tani Ne jua kemi zbritur [juve njerëzve]

një Shkrim të Shenjtë  
në të cilin ka përkujtues për ju të gjithë:  
pra a s'do të kuptoni?

- 11 Sa shumë komunitete të keqbërësve  
i kemi shkatërruar!  
Sa shumë të tjerë i kemi ngritur  
në vend të tyre?

- 12 Kur ata e ndien forcën Tonë,  
duke u ardhur,  
shihni si provuan t'i shpëtonin!

- 13 'Mos provoni të shpëtoni.  
Kthehjuni shtëpive tuaja  
dhe kënaqësisë në të cilën argëtoheshit:  
mund t'ju marrin në pyetje.'

- 14 Thanë: 'Mjerë ne!  
Paskemi qenë gabim!'

- 15 dhe kjo nuk u ndal së qeni klithma e tyre  
deri kur i shfarosëm,  
i shndërruam në hi të djegur.

- 16 Dhe Ne nuk i krijuam për lojë qiejt dhe tokën  
dhe gjithçka ndërmjet tyre.
- 17 Po të kishim dashur argëtim,  
do të mund ta gjenim brenda Nesh  
po të kishim dashur diçka të tillë.
- 18 Jo! Ne e shpejtojmë Të Vërtetën kundër falsitetit,  
dhe Ajo e shfaros – shih si tretet falsiteti!  
Dhe mjerë ju [njerëz]  
për mënyrën që e përshkruani **Allahun!**
- 19 Atij i përket gjithçka në qiej dhe në tokë:  
dhe ato në prezencën Hyjnore  
nuk janë kurrë tepër krenare për ta adhuruar Atë,  
as nuk mërzhiten:
- 21:20 e lavdojnë **Allahun** pa u lodhur,  
natë e ditë.
- 21 A janë tërheqës për ta zotat nga toka  
që i ringjallin të vdekurit?
- 22 Po të kishte në qiej apo tokë  
zota të tjerë pos **Allahut**,  
edhe qiejt edhe toka do të shkatërroheshin:  
**Allahu**, Zoti i Fronit,  
është larg mbi gjërat që i thonë:
- 23 Ai nuk mund të thirret të japë llogari  
për asgjë që bën,  
ndërsa ata do të thirren të japin llogari.
- 24 A kanë zgjedhur të adhurojnë  
zota të tjerë në vend se Atë?  
Thuaj: ‘Silleni provën tuaj.  
Ky është Shkrimi i Shenjtë  
për ata që janë me mua,  
dhe Shkrimi i Shenjtë  
për ata që shkuan para meje.’  
Por shumica nga ta

nuk e njohin të vërtetën,  
dhe kështu nuk janë të vëmendshëm.

25 Ne kurrë nuk çuam të dërguar para teje [Muhamed]  
pa i shpallur atij:

‘Nuk ka zot pos Meje, pra më shërbeni Mua.’

26 Dhe thonë:

‘Zoti i Mëshirës ka marrë për Vete fëmijë të lindur’<sup>a</sup>

Qoftë i lartësuar Ai!

Jo! Ata janë veç shërbyesit E Tij të nderuar:

27 ata nuk flasin para se të flasë Ai,  
dhe veprojnë sipas urdhrit Të Tij.

28 Ai e di atë që është para tyre dhe atë prapa tyre:  
dhe nuk mund të ndërmjetësojnë pa lejen<sup>b</sup> E Tij –  
vërtet ata vetë kanë frikë-respekt për Të.

29 Nëse cilido nga ta do të pretendonte:

‘Jam zot krahas Tij’,

Ne do ta shpërblenim me Ferr:

kështu i shpërblejmë keqbërësit.

21:30 A nuk janë të vetëdijshëm mosbesimtarët  
se qiejt dhe toka kanë qenë të bashkuar në një,  
dhe se Ne i ndamë veç e veç,  
se e bëmë çdo gjallesë nga uji?

A nuk do besojnë?

31 Dhe vumë në tokë male të qëndrueshme,  
që të mos lëkundet nën to;  
dhe caktuam shtigje të gjera në të,  
që ata të mund ta ndjekin drejtimin e duhur,

32 dhe e bëmë qiellin kulm të siguruar mirë –  
e megjithatë largohen nga mrekullitë e tij.

33 Është Ai që i krijoi natën dhe ditën,

---

<sup>a</sup> Politeistët mekasë pretendonin se engjëjt ishin bija të Allahut.

<sup>b</sup> Shih 20:109.

- diellin dhe hënën,  
secili duke pluskuar në orbitën e vet.
- <sup>34</sup> Nuk i kemi dhënë jetë të përhershme  
asnjë qenieje as para teje [Muhamed] –  
nëse ti vdes, a do të jetojnë [mosbesimtarët] përgjithmonë?
- <sup>35</sup> Sigurisht që çdo shpirt do ta shijojë vdekjen:  
Ne ju sprovovmë të gjithëve përmes të keqes dhe të mirës  
dhe te Ne do të ktheheni të gjithë.
- <sup>36</sup> Kur të shohin mosbesimtarët,  
qeshin me ty:  
“A është ky ai që flet për zotat tuaj?”  
E refuzojnë çdo këshillë të Zotit të Mëshirës.
- <sup>37</sup> Njeriu është krijuar i ngutshëm:  
Unë do t’jua tregoj së shpejti shenjat E Mija,  
pra mos më kërkoni t’i nxitoj.
- <sup>38</sup> Thonë:  
‘Kur do të përmbushet ky premtim,  
nëse kjo që po e thoni është e vërtetë?’
- <sup>39</sup> Ah po ta dinin mosbesimtarët,  
do të vijë koha kur nuk do të mund ta shmangin Zjarrin  
nga fytyrat a shpinat e tyre,  
dhe nuk do të marrin kurrfarë ndihme.
- <sup>21:40</sup> Do t’u vijë befas dhe do t’i trullosë;  
do të jenë të pafuqishëm për ta larguar;  
nuk do t’u shtyhet afati.
- <sup>41</sup> Të Dërguarit para teje [Muhamed]  
i kanë tallur po ashtu,  
por tallësit janë tronditur  
pikërisht nga ajo që e patën tallur.
- <sup>42</sup> Thuaj: ‘Kush do të mund t’ju mbronte  
natën dhe ditën nga Zoti i Mëshirës?’

E megjithatë largohen  
kur përmendet Zoti i tyre.

43 A kanë zota që mund t'i mbrojnë nga Ne?

Zotat e tyre nuk kanë fuqi t'i ndihmojnë vetes,  
as s'mund të mbrohen nga Ne.

44 I kemi lëmë këta mëkatarë dhe paraardhësit e tyre  
ta shijojnë jetën për kohë të gjatë.

Por a nuk e shohin se si po ua tkurrim kufijtë?

A janë ata që do të triumfojnë?

45 Thuaj: 'Ju paralajmëroj veç përmes Shpalljes.'

Të shurdhërit nuk do ta dëgjojnë thirrjen paralajmëruese,

46 e megjithatë nëse i prek

një frymë e thjeshtë e ndëshkimit të Zotit tuaj,  
sigurisht që do të thirrin:

'Mjerë ne! Paskemi gabuar!'

47 Do t'i rregullojmë peshoret e drejtësisë

për Ditën e Ringjalljes

që askujt mos t'i bëhet e padrejtë aspak,

dhe në qoftë madje edhe pesha e farës së sinapit,

do ta paraqesim –

Ne bëjmë llogari të shkëlqyeshme.

48 Ne ia dhamë Musait dhe Harunit

atë [Shkrimin e Shenjtë]

që e dallon të drejtën nga e gabuara,

dritë dhe përkujtues për ata

që janë të vetëdijshëm për **Allahun**,

49 që kanë frikë-respekt për Zotin e tyre,

megjithëse Ai është i padukshëm,

dhe që i druhen Orës.

21:50 Edhe ky [Kuran] është mesazh i bekuar

që e kemi zbritur –

a do ta refuzoni [ju njerëz]?



<sup>51</sup> Kohë më parë i dhuruam Ibrahimit aftësi për të gjykuar drejt dhe e njihnim mirë. <sup>52</sup> Ai i tha babait të tij dhe popullit të tij: ‘Çka janë këto imazhe ndaj të cilave jeni kaq të përkushtuar?’ <sup>53</sup> U përgjigjën: ‘I kemi gjetur etërit tanë duke i adhuruar ato.’ <sup>54</sup> Tha: ‘Ju dhe etërit tuaj keni devijuar qartë.’ <sup>55</sup> Pyetën: ‘A na e ke sjellë të vërtetën a veç po luan?’ <sup>56</sup> Tha: ‘Dëgjoni! Zoti juaj i vërtetë është Zoti i qiejve dhe i tokës, Ai që i krijoi ato dhe unë jam dëshmitar i kësaj. <sup>57</sup> Pasha **Allahun** me siguri do të komplotoj kundër idhujve tuaj posa ta keni kthyer shpinën!’ <sup>58</sup> I theu të gjithë copë e grimë, por e la më të madhin nga ta që ata t’i kthehen. <sup>59</sup> Thanë: ‘Kush ia ka bërë këtë zotave tanë? Sa i ligë duhet të jetë ai!’ <sup>21:60</sup> Disa thanë: ‘E kemi dëgjuar një djalë të ri të quajtur Ibrahim duke folur për ta.’ <sup>61</sup> Thanë: ‘Silleni para syve të popullit, që të mund të jenë dëshmitarë [të gjyqit të tij].’ <sup>62</sup> E pyetën: ‘A ishe ti, Ibrahim, që ia bërë këtë zotave tanë?’ <sup>63</sup> Tha: ‘Jo, kjo u bë nga më i madhi i tyre – ky. Pyetini, nëse mund të flasin.’ <sup>64</sup> U kthyen kah njëri-tjetri, duke thënë: ‘Jeni ju që e keni gabim’, <sup>65</sup> por pastaj gabuan përsëri dhe thanë: ‘Ti e di fare mirë se këta zota s’mund të flasin.’ <sup>66</sup> Ibrahim tha: ‘Si mund të adhuroni diçka që as nuk mund t’ju sjellë dobi as dëm, në vend të **Allahut**?’ <sup>67</sup> Turp për ju dhe për gjërat që i adhuroni në vend të **Allahut**. A s’keni mend?’ <sup>68</sup> Thanë: ‘Digjeni dhe hakmerruni për zotat tuaj, nëse do ta bëni gjënë e duhur.’ <sup>69</sup> Por Ne thamë: ‘Zjarr, ji i ftohtë dhe i sigurt për Ibrahimin.’ <sup>21:70</sup> Planifikuan ta dëmtojnë, por i bëmë ta vuajnë humbjen më të madhe. <sup>71</sup> E shpëtuaam atë dhe Lutin [dhe i çuam] në tokën që e bekuam për të gjithë njerëzit, <sup>72</sup> dhe ia dhamë Is’hakun dhe Jakubin si dhuratë shtesë dhe i bëmë secilin nga ta të ndershëm. <sup>73</sup> I bëmë ata të gjithë udhëheqës, duke i udhëzuar të tjerët sipas urdhrit Tonë dhe i frymëzuam të bëjnë vepra të mira, të falen rregullisht dhe ta japin lëmoshën: ishin adhurues Tanët të vërtetë. <sup>74</sup> I dhamë Lutit urti dhe dije të shëndoshë dhe e shpëtuaam nga komuniteti që praktikonte poshtërime – ishin njerëz të paturp që e shkelën ligjin e **Allahut**! <sup>75</sup> E pranuaam në mëshirën Tonë; ishte njeri i ndershëm.

<sup>76</sup> Shumë kohë para kësaj, Ne iu përgjigjëm Nuhut kur na thirri: e shpëtuaam atë dhe familjen e tij nga fatkeqësia e madhe <sup>77</sup> dhe i ndihmuam kundër njerëzve që i refuzuan shenjat Tona – ishin popull i keq, kështu që i fundosëm të gjithë.

<sup>78</sup> Dhe kujtoje Dautin dhe Sulejmanin, kur gjykuan në lidhje me fushën në të cilën endeshin e kullotnin delet. Ne e dëshmuam gjykimin e tyre <sup>79</sup> dhe e bëmë Sulejmanin ta kuptojë rastin [më mirë], megjithëse i dhamë urti dhe njohuri të shëndoshë të dyve. I bëmë malet dhe shpezët t’i festojnë lavdet Tona me Dautin – i bëmë të gjitha këto gjëra – <sup>21:80</sup> e mësuam si të bëjë parzmore të blinduara për të mirën tuaj [njerëz], për t’ju mbrojtur në luftërat tuaja, por a jeni mirënjohës për këtë? <sup>81</sup> E shfrytëzuam erën e stuhishme për Sulejmanin, ashtu që shpejtoi sipas urdhrit të tij në tokën që e patëm bekuar – Ne kemi njohuri për të gjitha gjërat –

<sup>82</sup> dhe i bëmë disa nga xhindët<sup>a</sup> të nënshtruar ndaj tij, të zhyten për të dhe të bëjnë punë të tjera. Ne po i mbikëqyrnim.

<sup>83</sup> Kujtoje Ejubin, kur i thirri Zotit të tij: ‘Vuajtja më ka munduar vërtet, por ti je Më Mëshirëploti i mëshirëplotëve.’ <sup>84</sup> Ne iu përgjigjëm, ia hoqëm vuajtjen dhe ia rikthyem familjen, bashkë me më shumë si ta, si vepër e mirësisë nga Ne dhe përkujtues për të gjithë ata që na shërbejnë. <sup>85</sup> Dhe kujtoje Ismailin, Idrizin dhe Dhu’l-Kifl-in:<sup>b</sup> ishin të gjithë të qëndrueshëm. <sup>86</sup> I pranua në mëshirën Tonë; ishin vërtet të ndershëm. <sup>87</sup> Dhe kujtoje njeriun me balenë,<sup>c</sup> kur u largua zemërueshëm, duke menduar se nuk mund ta kufizonim, por pastaj thirri në terrin e thellë: ‘Nuk ka Zot pos Teje, lëndi qoftë për Ty, paskam qenë gabim.’ <sup>88</sup> Ne iu përgjigjëm dhe e shpëtuam nga fatkeqësia: kështu i shpëtojmë besimplotët. <sup>89</sup> Kujtoje Zekerijanë, kur i thirri Zotit të tij: ‘Zoti im, mos më lër pa fëmijë, megjithëse Ti je më i miri nga trashëgimtarët.’ <sup>21:90</sup> Ne iu përgjigjëm – ia dhamë Jahjain dhe e shëruam gruan e tij nga shterpësia – ata ishin gjithmonë të etur të bëjnë vepra të mira. Na thirrën nga përmallimi dhe frikë-respekti dhe u përlën para Nesh. <sup>91</sup> Kujtoje atë që e ruajti dëlirësinë e saj.<sup>d</sup> Ne frymë brenda saj nga Shpirti Ynë dhe e bëmë atë dhe të birin e saj shenjë për të gjithë njerëzit.

<sup>92</sup> [Të Dërguar,]<sup>e</sup> ky komunitet i juaji është një komunitet i vetëm dhe Unë jam Zoti juaj, pra më shërbeni Mua. <sup>93</sup> Ata e kanë bërë copash unitetin e tyre, por të gjithë do të kthehen te Ne. <sup>94</sup> Nëse dikush bën vepra të mira dhe është besimtar, përpjekjet e tij nuk do të injorohen: Ne i regjistrojmë për të. <sup>95</sup> Asnjë komunitet i shkatërruar nga Ne nuk mund t’i shpëtojë kthimit të tij,<sup>f</sup> <sup>96</sup> dhe kur popujt e Gogut e të Magogut [Jexhuxhët dhe Mexhuxhët] lihen të lirë dhe turren në turma nga çdo malësi, <sup>97</sup> kur të afrohet Premtimi I Vërtetë, sytë e mosbesimtarëve do të zgurdullohen me tmerr dhe do të thonë: ‘Mjerë ne! Nuk paskemi qenë fare të vetëdijshëm për këtë. Paskemi qenë gabim.’ <sup>98</sup> Ju [mosbesimtarë] dhe ajo që e adhuron në vend të Allahut do të jeni lëndë djegëse për Ferr: ai është vendi ku do të shkoni – <sup>99</sup> po të kishin qenë këta [idhuj] zota realë ata nuk do të kishin shkuar atje – të gjithë do të rrini atje. <sup>21:100</sup> Atje mosbesimtarët do të rënkojnë mjerueshëm, por [idhujt] nuk do të dëgjojnë asgjë.

<sup>101</sup> Por ata të cilëve Ne ua kemi dekretuar Parajsën do të mbahen larg Ferrit – <sup>102</sup> nuk do të dëgjojnë asnjë murmuritje nga ai – dhe do të kënaqen pafund me gjithçka që shpirtrat ua kanë merak. <sup>103</sup> Nuk do të kenë asnjë frikë nga Terrori i

---

<sup>a</sup> Krahaso me 34:12-13

<sup>b</sup> Disa komentues sugjerojnë se kjo i referohet profetit Ezekiel. Shih tek *Encyclopaedia of Islam* nën *Dhu’l-Kifl*.

<sup>c</sup> Junusi (Dhun-Nuni, Jonah). Krahaso me 37:139-148.

<sup>d</sup> Merjemen. Krahaso me 66:12.

<sup>e</sup> Krahaso me 23:51-53.

<sup>f</sup> Interpretime të tjera janë: ‘nuk do të kthehen në botë’; ‘nuk do të largohen nga keqbërjet e tyre’.

madh<sup>a</sup>: engjëjt do t'i pranojnë me fjalët: 'Kjo është Dita që ju ishte premtuar!'  
<sup>104</sup> Në atë Ditë, do t'i mbështjellim rrotull qiejt siç i mbështjell një shkrimtar dorëshkrimet [e tij]. Do ta riprodhojmë krijimin siç e prodhuam herën e parë: ky është premtimi Ynë i zotuar. Sigurisht që do t'i bëjmë të gjitha këto gjëra.

<sup>105</sup> Ne shkruam në Zebur [Psalme], siç bëmë në Shkrim të Shenjtë [të mëhershëm]: 'Shërbyesit e mi të ndershëm do ta trashëgojnë tokën.'<sup>106</sup> Vërtet ka mesazh në këtë për shërbyesit e **Allahut!** <sup>107</sup> Ishte veç si mëshirë që të dërguam [Profet] te të gjithë njerëzit.<sup>b</sup> <sup>108</sup> Thuaj: 'Ajo që më është shpallur është se **Allahu** juaj është një Zot – a do t'i nënshtroheni?' <sup>109</sup> Por nëse largohen, thuaj: 'Jua kam shpallur mesazhin qartë të gjithë juve. Nuk e di se a është afër apo larg gjykimi që ju është premtuar,<sup>21:110</sup> por Ai e di atë që e zbuloni dhe që e fshehni.<sup>111</sup> Unë nuk e di: kjo [kohë] mund të jetë fare mirë sprovë për ju, kënaqësi për ca kohë.'<sup>112</sup> Tha:<sup>c</sup> 'Zoti im, bëje gjykimin e vërtetë.' Dhe: 'Zoti ynë është Zoti i Mëshirës. E kërkojmë ndihmesën E Tij ndaj asaj që e thoni [ju mosbesimtarë].'

---

<sup>a</sup> Dita e Gjykimit.

<sup>b</sup> Apo 'Ne të dërguam [Profet] veç si mëshirë për të gjithë njerëzit.'

<sup>c</sup> Shih shënimin për vargun 4.

**Përshkrimi para kaptinës 21 nga Abdel Haleem:**

*Sure mekase që e merr emrin nga lista e profetëve që përmenden nga vargu 48 deri në vargun 91. E thekson faktin se Muhamedi është njeri si profetët e mëhershëm dhe i është dhënë mesazhi i njëjtë për ta deklaruar unitetin e **Allahut**. I paralajmëron mosbesimtarët për Gjykimin që po afrohet, nga i cili nuk ka shpëtim.*

**Shënimet gjuhësore (Thomas Cleary)**

*Profetët (al ‘Anbiyaa’) (Kaptina 21)*

Kjo sure u shpall në Mekë

- 2 Psikologjia budiste flet për një “barrierë të dijes” (*jnaanaavarana*) që përbëhet nga përshtypja se dija ekzistuese e njeriut është e plotë dhe përfundimtare.
- 3 “dhe i mbajnë të fshehta këshillimet e tyre”: Ata që i abuzonin dhe i shtypnin profetët dhe ndjekësit e tyre po vepronin me paragjykime private, jo me sinqeritet e paanësi. Mundohen ta bëjnë të duket sikur Mesazhi po vjen nga një qenie njerëzore dhe asi që është i çmendur apo i pushtuar në këtë. Vargu i pestë e vazhdon listën e mërzitshme të ideve subjektive që përdoren si justifikime të përmendura për injorimin e komunikimeve hyjnore.
- 7 Kurani e pohon në mënyrë të përsëritur se profetët ishin njerëz, për ta kundërshtuar besimin apo akuzën se pretendonin status më të lartë se ai. Ai po ashtu pohon se profetët janë të frymëzuar nga **Allahu**, për ta kundërshtuar besimin e idhujtarëve se natyra njerëzore e një Të Dërguari e hedh poshtë burimin hyjnor të Mesazhit.
- 12 Sprova e botës nuk tejkalohet duke provuar t’i shmangemi, por duke e jetuar jetën sa më mirë që mundemi, që të mund ta zbulojmë se kush jemi në procesin e marrjes së përgjegjësisë për jetët dhe fatet tona.
- 16 “Dhe Ne nuk i krijuam për lojë”: Proceset e jetës dhe të vdekjes dhe natyra nuk janë ngjarje të rastësishme apo të pakuptim: madje edhe nëse i shikojmë

si të pakuptim, ai veprim i zgjedhjes efektivisht ka kuptim, me implikime për të ardhmen tonë.

- 17 “Po të kishim dashur argëtim . . .”: Po ta kishte pasur merak **Allahu** dëfrimin, ai do të kish qenë i natyrës qiellore e jo tokësore. Përdorja e ulësisë relative dhe vrazhdësisë së ekzistencës së zakonshme si provë e një kuptimi më të lartë dhe më subtil është asi që e tërheq vëmendjen veçanërisht për shkak të paradoksit të dukshëm.
- 18-19 “ato në prezencën Hyjnore nuk janë kurrë tepër krenare për ta adhuruar Atë”: Përsëri gjendjet më të larta shpirtërore të qasshme për njerëzit, shpirtrat dhe engjëjt i nënrrëshohen realitetit të pafund të **Allahut**, Absolutit; dhe ndriçimi i tyre shkëlqen pikërisht me kuptimin e kësaj.
- 21 “A janë tërheqës për ta zotat . . .”: Subjekti këtu zhvendoset: këtu “ata” i referohet njerëzimit.
- 22 “larg mbi gjërat që i thonë”: Folja është masa e parë e W-S-F “të përshkruash, të pohosh”. Poenta është të kuptuarit se **Allahu**, apo Realiteti, është përtej të gjitha pohimeve dhe përshkrimeve njerëzore.
- 26 “Dhe ata thonë: ‘Zoti i Mëshirës ka marrë fëmijë të lindur për Vete’ ”: Kjo i referohet apoteozës së profetit Jezus-Isa në Krishterimin sektar.
- 26-29 “Jo! Ata janë veç shërbyesit E Tij të nderuar”: Jezusi-Isai dhe profetët e tjerë nuk konsiderohen hyjni, por “shërbyes të nderuar” të **Allahut**.
- 34 “Njeriu është krijuar i ngutshëm”: Qeniet njerëzore janë të paduruara nga natyra; kjo është pjesë e “sprovës”, përmes së cilës mund të ndihen të detyruar të marrin më shumë përgjegjësi se që është e mundur për ta.
- 44-45 “Por a nuk e shohin se si po ua tkurrim kufijtë?”: Mbretëritë dhe perandoritë njerëzore rriten e zbehen dhe asnjëra nuk fiton sundim të përhershëm. Popujt me dëshmi kolektive të historive e traditave të gjata duhet të jenë gjithnjë e më të vetëdijshëm për ndryshueshmërinë dhe jopërherësinë e zotërimeve tokësore.

## 22: Haxhi/Pelegrinazhi (EL-HAXHXH)

Në emrin e **Allahut**, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës

<sup>1</sup> Njerëz, jini të vetëdijshëm për Zotin tuaj, se tërmeti i Orës së Fundit do të jetë gjë e fuqishme: <sup>2</sup> në Ditën që e shihni atë – asnjë nënë gjidhënese nuk do të mendojë më për foshnjën e saj, çdo femër shtatzënë do të abortojë, do të mendoni se njerëzit janë të dehur pa qenë fare, kaq e ashpër do të jetë tortura e **Allahut**. <sup>3</sup> E megjithatë janë disa që, pa kurrfarë dije, grinden për **Allahun**, që e ndjekin çdo rebel djallëzor <sup>4</sup> të destinuar t'i devijojnë ata që e marrin anën e tij dhe t'i udhëzojnë te vuajtja e zjarrit flakërues.

<sup>5</sup> Njerëz [kujtojeni] – nëse keni dyshime për Ringjalljen – se Ne ju krijuam nga pluhuri, pastaj një pikë lëngu, pastaj forma ngjitëse, pastaj grumbulli i mishit, edhe i formësuar edhe i paformësuar: e kemi ndërmend t'ju bëjmë të qartë fuqinë Tonë. Çkado që zgjedhim – bëjmë të mbetet në mitër për një kohë të caktuar, pastaj ju nxjerrim si foshnje dhe pastaj rriteni dhe e arrini pjekurinë. Disa vdesin të rinj dhe disa lihen të jetojnë deri në aso moshe sa që e harrojnë tërë atë që e dinin dikur. Nganjëherë e shihni tokën të pajetë, e megjithatë kur zbresim ujë ajo trazohet dhe gufon dhe e prodhon çdo lloj bime të gëzueshme: <sup>6</sup> kjo për shkak se **Allahu** është E Vërteta; Ai i kthen të vdekurit në jetë; Ai ka pushtet mbi gjithçka.

<sup>7</sup> Nuk ka dyshim se Ora e Fundit do të vijë gjithsesi, as se **Allahu** do t'i ngritë të vdekurit nga varret e tyre, <sup>8</sup> e megjithatë janë disa që, pa dije apo udhëzim apo ndonjë libër të përndritjes, grinden për **Allahun**, <sup>9</sup> duke u larguar me përbuzje për t'i udhëhequr të tjerët larg nga rruga e **Allahut**. Personin e tillë e pret turpi në këtë botë dhe, në Ditën e Ringjalljes, do ta bëjmë ta shijojë vuajtjen e Zjarrit. <sup>22:10</sup> [Do të thuhet:] 'Kjo është për telashet që ia ke sjellë vetes me duart e tua: **Allahu** nuk është kurrë i padrejtë ndaj krijesave Të Tij.'

<sup>11</sup> Janë edhe disa që i shërbejnë **Allahut** me besim të paqëndrueshëm: nëse rrugës u vjen diçka e mirë, janë të kënaqur, por nëse sprovohen, u kthehen mënyrave të tyre të vjetra, duke e humbur edhe këtë botë edhe tjetrën – kjo është humbja më e qartë. <sup>12</sup> Në vend të **Allahut**, thirrin në atë që as s'mund t'i dëmtojë as t'u ndihmojë – kjo është të devijosh shumë larg – <sup>13</sup> apo e thërrasin atë dëmtimi i të cilit është më afër se ndihma e tij: padron i keq dhe shoqëruar i keq. <sup>14</sup> Por ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira **Allahu** do t'i pranojë në Kopshte të hijeshuara me lumenj rrjedhës. **Allahu** bën çka të dëshirojë. <sup>15</sup> Kushdo që mendon se **Allahu** nuk do ta përkrahë në këtë botë dhe në tjetrën duhet ta zgjasë një litar deri në

qiell, t'i ngjitet krejtësisht përpjetë,<sup>a</sup> dhe ta shohë se a e heq kjo strategji shkakun e zemërimit të tij. <sup>16</sup> Kështu, Ne e zbresim Kuranin si mesazhe të qarta dhe **Allahu** e udhëzon këdo që do ta udhëzojë.

<sup>17</sup> Sa për besimtarët, ata që e ndjekin besimin çifut, sabianët,<sup>b</sup> të krishterët, magjianët<sup>c</sup> (Mexhusitë) dhe idhujtarët, **Allahu** do të gjykojë ndërmjet tyre në Ditën e Ringjalljes; **Allahu** është dëshmitar i të gjitha gjërave. <sup>18</sup> A nuk po e kupton [Profet] se gjithçka në qiej dhe në tokë i nënshtrohet<sup>d</sup> **Allahut**: dielli, hëna, yjet, malet, pemët dhe kafshët? Po ashtu edhe shumë qenie njerëzore, megjithëse për shumë të tjerë ndëshkimi është plotësisht i merituar. Kushdo të cilin e turpëron **Allahu** nuk do ta ketë askë për ta nderuar: **Allahu** bën çkado që do të bëjë. <sup>19</sup> Këto dy lloje të njerëzve nuk pajtohen për Zotin e tyre. Rrobat e zjarrit do të përshtaten për ata që nuk besojnë; uji përvëlues do të derdhet mbi kokat e tyre, <sup>22:20</sup> duke i shkrirë brendësitë e tyre si dhe lëkurat e tyre; <sup>21</sup> do të ketë doreza hekuri për t'i zaptuar; <sup>22</sup> kurdo që, në ankthin e tyre, provojnë të ikin, do të shtyhen prapa dhe do t'u thuhet: 'Shijojeni vuajtjen e Zjarrit.' <sup>23</sup> Por ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira **Allahu** do t'i pranojë në Kopshte të hijeshuara me lumenj rrjedhës; aty do të zbukurohen me byzylykë dhe perla të arta; aty do të kenë rroba mëndafshi. <sup>24</sup> Ata u udhëzuan të flasin mirë dhe në rrugën e Atij që është I Denjë Për Të Gjitha Lavdet.

<sup>25</sup> Sa për mosbesimtarët, që i pengojnë të tjerët nga rruga e **Allahut** dhe nga Xhamia e Shenjtë – të cilën Ne e bëmë të njëjtë për të gjithë njerëzit, banorët dhe vizitorët – dhe që provojnë ta dhunojnë me keqbërje, do t'i bëjmë ta shijojnë një ndëshkim të dhembshëm. <sup>26</sup> Ne ia treguam Ibrahimit lokacionin e Shtëpisë, duke thënë: 'Mos më bëj partnerë Mua. Pastroje Shtëpinë Time për ata që sillen rreth saj, ata që luten në këmbë dhe ata që përkulen dhe bien në gjunjë. <sup>27</sup> Shpalle Haxhin (Pelegrinazhin) për të gjithë njerëzit. Ata do të vijnë te ti në këmbë dhe në çdo lloj përpjetëze të shpejtë, që del nga çdo kalim i thellë malor <sup>28</sup> për t'i arritur përfitimet dhe për ta festuar emrin e **Allahut**, në ditët e caktuara, mbi bagëtitë që Ai i ka furnizuar për ta – ushqejeni veten dhe të varfrit dhe të mjerët – <sup>29</sup> pra le t'i kryejnë pelegrinët veprat e tyre të pastrimit, le t'i përmbushin zotimet e tyre dhe le të sillen rreth Shtëpisë së Lashtë.' <sup>22:30</sup> Gjithë kjo [është përcaktuar nga **Allahu**]: kushdo që i nderon urdhëresat e shenjta të **Allahut** do të ketë shpërblime të mira nga Zoti i tij.

---

<sup>a</sup> Shih edhe 6:35. Një interpretim tjetër i këtij vargu është 'ta zgjasë një litar deri në tavan dhe të varet'.

<sup>b</sup> Shih shënimin për 2:62: Sabianët ishin komunitetet religjioz monoteist. Shih M. Asad, *The Message of the Qur'an* (Gibraltar: Dar al-Andalus, 1997), 40 n. 49.

<sup>c</sup> Ndjekës të një feje të lashtë Perse dhe Medjene, të bazuar në monoteizëm, e identifikuar me Zoroastrianët.

<sup>d</sup> Fjalë për fjalë, i gjunjëzohet.

Bagëtitë janë bërë të ligjshme për ju, pos ato që janë ndaluar shprehimisht. Shmangeni ndyrësinë e besimeve dhe të praktikave idhujtare dhe shmangni thirrjet e rreme.<sup>a 31</sup> Përkushtojuni **Allahut** dhe mos i caktoni partnerë, se personi që e bën këtë është si dikush që është hedhur nga qiejt dhe është rrëmbyer nga shpezët apo është çuar nga era në një vend të largët.<sup>32</sup> Tërë kjo [është caktuar nga **Allahu**]: ata që i nderojnë ritet e **Allahut** e shfaqin përkushtimin e zemrave të tyre.<sup>33</sup> Bagëtitë janë të dobishme për ju deri në kohën e caktuar. Pastaj vendi i tyre i flijimit është afër Shtëpisë së Lashtë:<sup>34</sup> Ne kemi caktuar akte të përkushtimit për çdo komunitet, që ta festojnë emrin e **Allahut** mbi bagëtitë që i ka furnizuar për ta: **Allahu** juaj është Një, pra përkushtojuni Atij. [Profet,] jepu lajm të mirë modestëve<sup>35</sup> zemrat e të cilëve mbushen me frikë-respekt sa herë që përmendet **Allahu**, që i qëndrojnë me durim çfarëdo gjëje që u ndodh, që luten e falen rregullisht, që u japin të tjerëve nga furnizimi Ynë për ta.

<sup>36</sup> Ne i kemi bërë devetë<sup>b</sup> pjesë të riteve të shenjta të **Allahut** për ju. Ka shumë të mira në to për ju, pra thirreni emrin e **Allahut** mbi to gjersa rreshtohen për flijim, pastaj, kur të kenë rënë të vdekura, ushqejeni veten dhe ata që nuk kërkojnë, si edhe ata që kërkojnë. Ne jua kemi nënshtruar ato që të mund të jeni falënderues.<sup>37</sup> As mishi as gjaku i tyre nuk e arrin **Allahun** por përkushtimi juaj. Ai jua ka nënshtruar ato që të mund ta lavdoni **Allahun** se ju ka udhëzuar.

Jepu lajme të mira atyre që bëjnë mirë:<sup>38</sup> **Allahu** do t'i mbrojë besimtarët; **Allahu** nuk i do mosbesimtarët apo mosmirënjohësit.<sup>39</sup> Ata që janë sulmuar lejohet t'i rrokin armët se u është bërë e padrejtë – **Allahu** ka fuqi t'u ndihmojë –<sup>22:40</sup> ata që janë dëbuar padrejtësisht nga shtëpitë e tyre veç se kanë thënë: 'Zoti ynë është **Allahu**.' Po të mos i zmbapste **Allahu** disa njerëz përmes të tjerëve, shumë manastire, kisha, sinagoga dhe xhami, ku thirret shumë emri i **Allahut**, do të ishin shkatërruar. **Allahu** sigurisht që u ndihmon atyre që e ndihmojnë çështjen E Tij – **Allahu** është i fortë e i fuqishëm –<sup>41</sup> ata që, kur i mirë-vendosim në tokë, falen vazhdimisht, e paguajnë lëmoshën e caktuar, e urdhërojnë atë që është e drejtë dhe e ndalojnë atë që është e gabuar: **Allahu** e kontrollon rezultatin e të gjitha ngjarjeve.

<sup>42</sup> Nëse të refuzojnë [Profet], po kështu bënë edhe populli i Nuhut para tyre dhe ata të Adit, Themudit,<sup>43</sup> Ibrahimit, Lutit,<sup>44</sup> Medjenit. Edhe Musain e quajtën gënjeshtar. Unë u dhashë kohë mosbesimtarëve, por në fund i ndëshkova. Sa ashpër i gjykova!<sup>45</sup> Sa e sa qytete të zhytura në keqbërje i kemi shkatërruar dhe i kemi lënë në shkatërrim të plotë; sa e sa puse të braktisura; sa e sa pallate të larta!<sup>46</sup> A nuk kanë udhëtuar këta njerëz [të Mekës] nëpër vend me zemra që

---

<sup>a</sup> Kushtimi i kafshëve idhujve.

<sup>b</sup> Termi *budn* mund t'u referohet ose deveve ose lopëve.



kuptojnë dhe veshë që dëgjojnë? Nuk janë sytë e njerëzve të verbër, por zemrat e tyre brenda gjokseve të tyre.

<sup>47</sup> Ata do të të sfidojnë [Profet] për ta nxituar ndëshkimin. **Allahu** nuk do të dështojë në premtimin E Tij – një Ditë me Zotin tuaj është si njëmijë vite sipas llogarisë suaj. <sup>48</sup> Shumë qytezave të zhytura në keqbërje u dhashë ende kohë dhe pastaj i godita: ata të gjithë kthehen tek Unë në fund.

<sup>49</sup> Thuaj [Profet]: ‘Njerëz, jam dërguar veç t’ju jap paralajmërim të qartë.’ <sup>22:50</sup> Ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira do të falen dhe do të kenë shpërblim bujar, <sup>51</sup> por ata që përpiqen t’i kundërshtojnë mesazhet Tona dhe provojnë më kot të na mposhtin janë të destinuar për Zjarrin. <sup>52</sup> Nuk kemi çuar kurrë asnjë të dërguar a profet para teje [Muhamed] në dëshirat e të cilit Satani nuk ka sugjeruar diçka dinakërisht, por **Allahu** e heq<sup>a</sup> atë që Satani e sugjeron dinakërisht dhe pastaj **Allahu** e pohon mesazhin E Tij. **Allahu** është i gjithë-ditur dhe i urtë: <sup>53</sup> Ai i bën sugjerimet dinake të Satanit tundim veç për të tejdëshpëruarit e sëmure në zemër dhe për ata me zemra të ngurtësuar – keqbërësit janë thellësisht kundër [Të Vërtetës] – <sup>54</sup> dhe Ai bën që ata që u është dhënë dije ta kuptojnë se kjo Shpallje është E Vërteta e Zotit tuaj, kështu që mund të besojnë në të dhe t’ia përuhin zemrat e tyre Atij: **Allahu** i udhëzon besimplotët në rrugën e drejtë. <sup>55</sup> Mosbesimtarët do të mbesin në dyshim për të deri kur t’i mbizotërojë Ora apo deri kur në ta të zbresë tortura në një Ditë të cilës i mungon çdo fije shprese. <sup>56</sup> Në atë Ditë kontrolli do t’i përkasë **Allahut**: Ai do të gjykojë ndërmjet jush. Ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira do të pranohen në Kopshtet e Kënaqësisë, <sup>57</sup> gjersa ata që nuk besojnë dhe i refuzojnë shpalljet Tona do të marrin torturë poshtëruese.

<sup>58</sup> Ai do t’u japë furnizim bujar atyre që mërguan në rrugën e **Allahut** dhe u vranë apo vdiqën. Ai është Furnizuesi Më i Mirë. <sup>59</sup> Do t’i pranojë ata në një vend që do t’i kënaqë: **Allahu** është i gjithë-dituri dhe më i durueshmi. <sup>22:60</sup> Kështu do të jetë. **Allahu** do t’i ndihmojë ata që kundër një akti agresiv hakmerren thjesht me të ngjashmin e tij dhe pastaj përsëri u bëhet e padrejtë: **Allahu** është falës ndaj gabimeve dhe më falësi ndaj pendimeve. <sup>61</sup> Kështu do të jetë, se **Allahu** e bën natën të kalojë në ditë dhe ditën në natë dhe Ai është gjithë-dëgjuesi dhe gjithë-pamësi. <sup>62</sup> Kështu do të jetë, se është veç **Allahu** që është E Vërteta dhe çkado tjetër që e thërrasin është falsitet i pastër: është **Allahu** që është Më I Larti, Më I Madhi.

<sup>63</sup> A nuk e ke vërejtur [Profet] si e zbret **Allahu** ujin nga qielli dhe në mëngjesin tjetër toka gjelbërohet? **Allahu** është vërtet më subtili, i gjithë-informuari; <sup>64</sup> gjithçka në qiej dhe në tokë i përket Atij; veç **Allahu** është i vetëmjaftueshëm, i denjë për tërë lavdet. <sup>65</sup> A nuk e ke vërejtur si **Allahu** ka bërë gjithçka në tokë në shërbimin tuaj? Se anijet e lundrojnë detin me urdhrin E Tij?

---

<sup>a</sup> Kuptimi themelor i *nasakha* është ‘hequr’ e jo ‘shfuqizuar’ (al-Mu`jam al-Wasit).

Se Ai i mban qiejt të mos bien në tokë pa lejen E Tij? **Allahu** është më dashamirësi dhe më mëshirëploti ndaj njerëzimit – <sup>66</sup> është Ai që ju dha [juve njerëzve] jetë, do t’ju bëjë të vdisni dhe pastaj do t’ju japë jetë përsëri – por njeriu është mosmirënjohës.

<sup>67</sup> Ne kemi caktuar akte të përkushtimit për çdo komunitet për t’i zbatuar, pra mos i lejo të grinden me ty [Profet] për këtë çështje. Thirri te Zoti yt – je në rrugën e duhur – <sup>68</sup> dhe nëse grinden me ty, thuaj: ‘**Allahu** është fare mirë i informuar për atë që po e bëni.’ <sup>69</sup> Në Ditën e Ringjalljes, **Allahu** do të gjykojë midis jush në lidhje me dallimet tuaja. <sup>22:70</sup> A nuk je [Profet] i vetëdijshëm se **Allahu** di gjithçka që është në qiej dhe në tokë? Gjithçka është e shkruar në një Regjistër, kjo është e lehtë për **Allahun**.

<sup>71</sup> E megjithatë përkrah **Allahut** e shërbejnë atë për të cilën Ai nuk ka dërguar kurrfarë autoriteti dhe për të cilën nuk kanë kurrfarë njohurie:<sup>a</sup> keqbërësit nuk do ta kenë askë t’u ndihmojë. <sup>72</sup> [Profet,] mund ta shohësh armiqësinë në fytyrat e mosbesimtarëve kur mesazhet Tona u recitohen qartë: është sikur pothuajse do t’i sulmojnë ata që ua recitojnë mesazhet Tona. Thuaj: ‘A t’ju tregoj se çka është shumë më keq se kjo që po e ndieni tani? Zjarri që **Allahu** ua ka premtuar mosbesimtarëve! Çfarë fundi i shëmtuar!’ <sup>73</sup> Njerëz, ja një ilustrim, andaj dëgjoni me kujdes: ata që i thirrni përkrah **Allahut** nuk do të mundnin – edhe po t’i kombinonin të gjitha forcat e tyre – ta krijonin një mizë dhe nëse një mizë do t’u merrte diçka – nuk do të ishin të aftë ta rimerrnin. Sa të dobët janë përgjëruesit dhe sa të dobët janë ata të cilëve u përgjërohen! <sup>74</sup> Nuk kanë ide për masën e vërtetë të **Allahut**: **Allahu** është vërtet më i forti dhe më i fuqishmi.

<sup>75</sup> **Allahu** zgjedh të dërguar ndër engjëj dhe ndër njerëz. **Allahu** është gjithë-dëgjues, gjithë-pamës: <sup>76</sup> Ai e di se çka qëndron para dhe prapa tyre. Të gjitha çështjet kthehen tek Ai. <sup>77</sup> Besimtarë, përkuluni, gjunjëzohuni, adhurojeni Zotin tuaj dhe bëni mirë – që të mund t’ia dilni. <sup>78</sup> Përpiquni fort për **Allahun** siç i takon Atij: Ai ju ka zgjedhur dhe nuk ka vënë asnjë vështirësi në fenë tuaj, besimin e paraardhësit tuaj Ibrahimit. **Allahu** ju ka quajtur myslimanë<sup>b</sup> – edhe në të shkuarën edhe në këtë [mesazh] – ashtu që I Dërguari të mund të jetë dëshmitar për ju dhe që ju të mund të jeni dëshmitarë për njerëzit e tjerë. Pra faluni rregullisht, jepeni lëmshën e përcaktuar dhe kërkoni strehim në **Allahun**: Ai është mbrojtësi juaj – mbrojtës i shkëlqyeshëm dhe ndihmues i shkëlqyeshëm.

---

<sup>a</sup> dmth. ‘njohuri nga shkrimet e shenjta’.

<sup>b</sup> dmth. ‘të përkushtuar **Allahut**’.

**Përshkrimi para kaptinës 22 nga Abdel Haleem:**

*Sure medinase që e merr titullin nga referimi në ritin e shenjtë të haxhit/pelegrinazhit të jetësuar së pari nga Ibrahim (vargu 27). Kjo temë paraqitet përmes ndëshkimit të atyre që i pengojnë besimtarët t'i qasen Xhamisë së Shenjtë dhe pasohet nga leja për të luftuar kur sulmohen. Surja nis me Ditën e Gjykimit dhe i qorton ata që adhurojnë idhuj të padobishëm, duke i përshkruar më vonë si të pafuqishëm për ta krijuar qoftë edhe një mizë. Surja mbaron duke i nxitur myslimanët të jenë ngulmues në ndjekjen e besimit të Ibrahimit.*

## 23: Besimtarët (EL-MU'MINÛN)

Në emrin e **Allahut**, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës

<sup>1</sup> [Sa] të begatë janë besimtarët! <sup>2</sup> Ata që falen me përulësi, <sup>3</sup> që i shmangen të folurit të kotë, <sup>4</sup> që e paguajnë lëmoshën e përcaktuar, <sup>5</sup> që e ruajnë dëlirësinë e tyre <sup>6</sup> përveç me bashkëshortët apo skllëverit<sup>a</sup> e tyre – me këta nuk fajësohen, <sup>7</sup> por kushdo që kërkon më shumë se kjo po i tejkalon kufijtë – <sup>8</sup> që janë besnikë ndaj besatimeve dhe zotimeve të tyre <sup>9</sup> dhe që falen rregullisht, <sup>23:10</sup> me të drejtë do t'u jepet <sup>11</sup> Parajsa si pronë e vetja<sup>b</sup>, për të mbetur aty.

<sup>12</sup> Ne e krijuam njeriun nga një esencë e argjilës, <sup>13</sup> pastaj e vendosëm si pikë lëngu në një vend të sigurt, <sup>14</sup> pastaj e kthym atë pikë në formë ngjitëse dhe e kthym atë formë në copë mishi dhe e kthym atë copë në eshtra dhe i veshëm ata eshtra me mish dhe më vonë e kthym në forma të tjera<sup>c</sup> – lãvdi qoftë për **Allahun**, më të mirin nga krijuesit! – <sup>15</sup> pastaj do të vdisni <sup>16</sup> dhe pastaj, në Ditën e Ringjalljes, do të ringjalleni përsëri.

<sup>17</sup> Ne i krijuam shtatë nivele<sup>d</sup> mbi ju: nuk jemi kurrë të pavetëdijshëm për krijimin Tonë. <sup>18</sup> Zbritëm ujë nga qielli në masë të duhur dhe e vendosëm në tokë – kemi fuqi ta heqim të tërin nëse duam – <sup>19</sup> me të prodhuam për ju kopshte me hurma e hardhi, me shumë fruta aty për ju që t'i hani, <sup>23:20</sup> dhe një pemë, që rritet nga Mali Sinai, që prodhon vaj dhe erëza për ushqimin tuaj. <sup>21</sup> Ka mësim për ju në bagëti: prodhojmë qumësht për ju që ta pini nga barku i tyre. Dhe ato kanë shumë dobi të tjera: i hani <sup>22</sup> dhe udhëtoni me to, siç bëni nëpër anije.

<sup>23</sup> Ne e dërguam Nuhun te populli i tij. Ai tha: 'Populli im, shërbeni **Allahut**, se Ai është zoti juaj i vetëm. A nuk do të jeni të vëmendshëm për Të?' <sup>24</sup> Por mosbesimtarët udhëheqës në popullin e tij thanë: 'Ky është thjesht vdekatar si ju, duke u munduar të fitojë ca superioritet mbi ju. **Allahu** do t'i kishte zbritur engjëjt po të donte; përveç kësaj, kurrë s'kemi dëgjuar diçka të tillë nga paraardhësit tanë. <sup>25</sup> Ai është veç një i çmendur, pra le të presim dhe ta shohim se çka po ndodh me të.' <sup>26</sup> Nuhu tha: 'Zoti im, më ndihmo! Ata më quajnë gënjeshtar', <sup>27</sup> dhe kështu Ne i shpallëm atij: 'Ndërtoje Arkën nën syrin Tonë vigjilent dhe sipas shpalljes Sonë. Kur të vijë urdhri Ynë dhe uji të gufojë nga toka,<sup>e</sup> merr çifte

---

<sup>a</sup> Krahaso me 4:25

<sup>b</sup> Fjalë për fjalë: 'do të jenë trashëgimtarë që do ta "trashëgojnë" Parajsën', por nuk e trashëgojnë nga dikush që vdes.

<sup>c</sup> Razi e citon Ibn `Abasin për ta shpjeguar se 'format e tjera' i referohet të gjitha fazave të ndryshme të foshnjërisë, fëmijërisë dhe pjekurisë – krahaso me 22:5; 40:67.

<sup>d</sup> *Tara`iq*: 'nivelet (e qiellit)' apo 'autostradat' (Razi).

<sup>e</sup> Fjalë për fjalë: 'furra tejlvoln'.

nga çdo specie në anije dhe familjen tënde, përveç atyre për të cilët është marrë vendimi dënues – mos m'u lut për keqberësit: do të fundosen – <sup>28</sup> dhe kur ti dhe shoqëruesit e tu të jeni sistemuar në Arkë, thuaj: “Lâvdi qoftë për **Allahun**, që na çliroi nga populli i lig” <sup>29</sup> dhe thuaj: “Zoti im, më lejo të zbarkoj me bekimin Tënd: je Ti që i ofron zbarkimet më të mira”.<sup>23:30</sup> Ka shenja në tërë këtë: gjithmonë [i] kemi vënë [njerëzit] në sprovë.

<sup>31</sup> Pastaj Ne e ngritëm një brez tjetër pas tyre, <sup>32</sup> dhe ua çuam njërin nga ta si të dërguar: ‘Shërbeni **Allahun**, se Ai është zoti juaj i vetëm. A nuk do të jeni të vëmendshëm për Të?’ <sup>33</sup> Por mosbesimtarët udhëheqës në mesin e popullit të tyre, që e mohuan Takimin në të Përtejmen, të cilëve u patëm dhënë lehtësi dhe bollëk në këtë jetë, thanë: ‘Ai është thjesht vdekatar si ju – ai ha çka hani ju dhe pi çka pini ju – <sup>34</sup> dhe do të jeni vërtet humbës nëse i bindeni një vdekatar si ju. <sup>35</sup> Si mund t’ju premtojë se pasi të vdisni dhe të bëheni pluhur e eshtra do të rinxirreni të gjallë? <sup>36</sup> Ajo që po ju premtohet është shumë e pabesueshme. <sup>37</sup> Është veç jeta e kësaj bote: vdesim, jetojmë,<sup>a</sup> por nuk do të ringjallemi kurrë. <sup>38</sup> Ai është thjesht njeri që po trillon gënjeshtër për **Allahun**. Kurrë nuk do të besojmë në të.’ <sup>39</sup> Profeti tha: ‘Zoti im, më ndihmo! Më quajnë gënjeshtar’, <sup>23:40</sup> dhe kështu **Allahu** tha: ‘Së shpejti do të mbushen me pishman.’ <sup>41</sup> Shpërthimi i goditi me të drejtë dhe i shkatërruam plotësisht si shkumë. Thyeni qafën keqberës! <sup>42</sup> Ngritëm breza të tjerë pas tyre – <sup>43</sup> asnjë komunitet nuk mund ta përshpejtojë a ta zvarrisë kohën e tij – <sup>44</sup> dhe i çuam të dërguarit Tanë një pas një: kurdo që një i dërguar u vinte një komuniteti gjithmonë pa ndryshim e quanin gënjeshtar, kështu që i shkatërruam njërin pas tjetrit dhe i bëmë rrëfime paralajmëruese. Thyeni qafën mosbesimtarë!

<sup>45</sup> Pastaj Ne e dërguam Musain dhe vëllain e tij Harunin, me shenjat Tona dhe me autoritet të qartë, <sup>46</sup> te Faraoni dhe udhëheqësit e tij të shquar, por ata u përgjigjën me arrogancë: ishin njerëz përbuzës. <sup>47</sup> Thanë: ‘A duhet të besojmë në dy vdekatarë si ne? Dhe populli i tyre janë shërbyesit tanë?’ <sup>48</sup> dhe kështu i quajtën të dytë gënjeshtarë: u bënë edhe një popull tjetër i shkatërruar. <sup>49</sup> Ia dhamë Musait Shkrimin e Shenjtë, që ata<sup>b</sup> të mund të udhëzoheshin drejt. <sup>23:50</sup> E bëmë shenjë djalin e Merjemes dhe nënën e tij; u dhamë strehë në një kodër paqësore me ujë të rrjedhshëm.<sup>c</sup>

<sup>51</sup> Të dërguar, hani gjëra të mira dhe bëni vepra të mira: Unë jam plotësisht i informuar për atë që e bëni. <sup>52</sup> Ky komunitet i juaji është një – dhe Unë jam Zoti juaj: jini të vetëdijshëm për Mua – <sup>53</sup> por ata e kanë ndarë komunitetin e tyre në sekte, secili duke u ngazëllyer më vete. <sup>54</sup> Pra [Muhamed] lëri për ca kohë të

<sup>a</sup> Razi e interpreton këtë renditje ta ketë kuptimin e brezave të njëpasnjëshëm.

<sup>b</sup> ‘Populli i tij’ – Musait iu dha Shkrimi i Shenjtë më vonë, kështu që ‘ata’ u referohet vetëm fëmijëve të Izraelit.

<sup>c</sup> Ku Merjemja e bëri lindjen; shih 19:22-6.

zhytur [në padijen e tyre].<sup>55</sup> A llogarisin se, duke u dhënë pasuri e djem, <sup>56</sup> Ne shpejtojmë t'u japim gjëra të mira? Vërtet nuk kanë ide! <sup>57</sup> Ata që kanë frikë-respekt për Zotin e tyre, <sup>58</sup> që besojnë në mesazhet E Tij, <sup>59</sup> që nuk i përshkruajnë partnerë, <sup>23:60</sup> që gjithmonë japin me zemrat që u dridhen nga mendimi se duhet të kthehen tek Ai, <sup>61</sup> janë ata që shpejtojnë kah gjërat e mira dhe do të jenë të parët që do t'i marrin. <sup>62</sup> Nuk e ngarkojmë asnjë shpirt më shumë sesa mund të bartë – e kemi një Regjistër që e tregon të vërtetën – atyre nuk do t'u bëhet e padrejtë. <sup>63</sup> Por zemrat e mosbesimtarëve janë të zhytura në [padije për] tërë këtë; dhe ka gjëra të tjera përveç kësaj që i bëjnë. <sup>64</sup> Kur e sjellim ndëshkimin Tonë mbi ata që janë të korruptuar me pasuri, do të thirrën për ndihmë: <sup>65</sup> 'Mos thirrni sot: nuk do të merrni kurrfarë ndihme nga Ne. <sup>66</sup> Mesazhet E Mija ju janë recituar përsëri e përsëri, por e kthenit shpinën me arrogancë, <sup>67</sup> dhe e kalonit mbrëmjen duke u tallur [me Kurandin].'

<sup>68</sup> A nuk kanë reflektuar për Fjalën e **Allahut**? A u ka ardhur diçka që nuk u kishte ardhur të parëve të tyre? <sup>69</sup> A nuk e njohin Të Dërguarin e tyre? Pra pse ta refuzojnë? <sup>23:70</sup> Pse thonë se është i pushtuar shpirtërisht? Ai ua ka sjellë të vërtetën dhe shumica nga ta e urrejnë [të vërtetën], <sup>71</sup> por po të ishte e vërteta në përputhje me meraket e tyre – qiejt, toka dhe çdokush në to do të shpërbëhej. Ne ua kemi sjellë Përkujtuesin e tyre dhe largohen prej tij. <sup>72</sup> A u kërkon [ti Profet] ndonjë pagesë? Pagesa e Zotit tënd është më e mira: Ai është Më i Miri nga Furnizuesit. <sup>73</sup> Ti i thërret në rrugë të drejtë <sup>74</sup> dhe ata që nuk besojnë në Të Përtejmen largohen nga ajo rrugë. <sup>75</sup> Edhe po t'ua tregonim mëshirën dhe t'i çlironim nga ankthi, do të këmbëngulnin verbërisht në shkeljen e tyre. <sup>76</sup> I kemi munduar tashmë, e megjithatë nuk iu nënshtuan Zotit të tyre: nuk do të përulen <sup>77</sup> deri kur t'ia hapim një portë torturës së ashpër për ta – pastaj do të futen në dëshpërim të plotë.

<sup>78</sup> Është **Allahu** që ju pajisi me dëgjim, shikim dhe zemra – sa rrallë jeni mirënjohës! <sup>79</sup> Është Ai që ju bëri të shumoheni në tokë. Është Ai tek i cili do t'ju mbledhin: <sup>23:80</sup> është Ai që jep jetë dhe vdekje; ndërrimi i natës dhe ditës varet nga Ai; a nuk do t'i përdorni mendjet? <sup>81</sup> Por, si të tjerët para tyre, <sup>82</sup> thonë: 'Çka? Kur vdesim dhe kthehem në pluhur e eshtra, vërtet do të ringjallemi?' <sup>83</sup> Kemi dëgjuar premtime të tilla më parë, si edhe para-ardhësit tanë. Këto janë veç fabula të lashta.' <sup>84</sup> Thuaj [Profet]: 'Kush e zotëron tokën dhe tërë ato që jetojnë në të, nëse dini [kaq shumë]?' <sup>85</sup> dhe do të përgjigjen: '**Allahu.**' Thuaj: 'A nuk do të jeni të vëmendshëm?' <sup>86</sup> Thuaj: 'Kush është Zoti i shtatë qiejve? Kush është Zoti i Fronit të Fuqishëm?' <sup>87</sup> dhe do të përgjigjen: '**Allahu.**' Thuaj: 'A nuk do të jeni të vëmendshëm?' <sup>88</sup> Thuaj: 'Kush e mban kontrollin e gjithçkaje në dorën E Tij? Kush mbron, gjersa nuk ka mbrojtje ndaj Tij, nëse dini [kaq shumë]?' <sup>89</sup> dhe do të përgjigjen: '**Allahu.**' Thuaj: 'Atëherë si mund të jeni kaq thellë në deluzion?' <sup>23:90</sup> Ç'është e vërteta, Ne ua sollëm të vërtetën dhe ata po gënjejnë. <sup>91</sup> **Allahu** nuk

ka pasur fëmijë kurrë. As nuk ka ndonjë zot krahas Tij – po të kishte, secili zot do ta ndante anash krijimin e tij dhe do të provonte t'i mposhtte të tjerët. **Allahu** qoftë i lartësuar mbi atë që e përshkruajnë!<sup>92</sup> Ai e di atë që është e padukshme si dhe atë që është e dukshme; Ai është larg mbi çdo partner që e pretendojnë për Të.<sup>93</sup> Thuaj: 'Zot, nëse do të ma shfaqësh ndëshkimin që ua ke premtuar,<sup>94</sup> atëherë Zot, mos më përfshij ndër keqbërësit!' <sup>95</sup> Sigurisht që jemi të aftë të ta shfaqim ndëshkimin që ua kemi premtuar. <sup>96</sup> Zmbrapse të keqen me të mirë – Ne jemi plotësisht të informuar për atë që na e mveshin – <sup>97</sup> dhe thuaj: 'Zot, strehohem me Ty nga nxitjet zemëruese të të këqijve; <sup>98</sup> kërkoj strehë me ty, Zot, që të mos më vijnë pranë.'

<sup>99</sup> Kur i vjen vdekja njërit nga ta, thërret: 'Zoti im, më lejo të kthehem <sup>23:100</sup> t'i ndreqi gjërat që i kam lënë pas dore.' Kurrë! Kjo nuk do të shkojë përtej fjalëve të tij: prapa njerëzve të tillë qëndron një pengesë deri në vetë Ditën kur ringjallen. <sup>101</sup> Në atë Ditë kur t'i fryhet Trumpetës, lidhjet mes tyre do të jenë si asgjë dhe nuk do të pyesin për njëri-tjetrin: <sup>102</sup> ata veprat e mira të të cilëve peshojnë rëndë do të jenë të suksesshëm, <sup>103</sup> por ata me balans të lehtë do t'i kenë humbur shpirtrat përgjithmonë dhe do të rrinë në Ferr – <sup>104</sup> Zjarri do t'ua djegë fytyrat, dhe buzët e tyre do të përdredhen në dhembje. <sup>105</sup> 'A nuk ju janë recituar mesazhet E Mija përsëri e përsëri dhe prapë i refuzuat?' <sup>106</sup> Do të thonë: 'Zot, çoroditja jonë na mposhti dhe devijua. <sup>107</sup> Zot, na largo nga kjo dhe nëse kthehemi në rrugët tona të vjetra, do të jemi vërtet keqbërës.' <sup>108</sup> Ai do të thotë: 'Thyeni qafën! Brenda hyni! Mos më flisni! <sup>109</sup> Ndër shërbyesit e mi ishin ata që thanë: "Zot, ne besojmë. Na fal dhe ki mëshirë për ne: Ti je më mëshirëploti nga të gjithë." <sup>23:110</sup> Por ju vazhdonit të qeshnit me ta: kaq të vendosur ishit të qeshnit me ta sa që ju bëri ta harronit paralajmërimin Tim. <sup>111</sup> Sot Unë i kam shpërblyer ata për durimin e tyre: janë ata që do të kenë sukses.' <sup>112</sup> Ai do të thotë: 'Sa vite ishit në tokë?' <sup>113</sup> dhe ata do të përgjigjen: 'Qëndruam një ditë apo një pjesë të ditës, por pyeti ata që mbajnë llogari.' <sup>114</sup> Ai do të thotë: 'Keni ndenjor veç pak, veç po ta kishit ditur. <sup>115</sup> A menduat se ju patëm krijuar kot dhe se nuk do t'ju kthenin te Ne?'

<sup>116</sup> Lartësuar qoftë **Allahu**, Mbreti i vërtetë – nuk ka zot pos Tij – Zoti i Fronit të Lavdishëm! <sup>117</sup> Kushdo që i lutet një zoti tjetër përkrah Tij – zot për ekzistencën e të cilit nuk ka provë – do të përballet me llogarinë e tij me Zotin e tij. Ata që e refuzojnë të vërtetën nuk do të përparojnë. <sup>118</sup> Thuaj [Profet]: 'Zot, fal dhe ki mëshirë: Ti je më mëshirëploti nga të gjithë.'

**Përshkrimi para kaptinës 23 nga Abdel Haleem:**

*Sure mekase që thekson se besimtarët janë ata që do të kenë sukses, ndërsa mosbesimtarët do të ndëshkohen për arrogancën dhe talljen e tyre. Jepen disa prova për Njeshmërinë e Allahut dhe fuqinë E Tij dhe theksohet pashmangshmëria e Ringjalljes.*



## 24: Drita (EN-NÛR)

Në emrin e **Allahut**, Dashamirësit, Mëshirëplotit

<sup>1</sup> Kjo është sure që e kemi zbritur dhe e kemi bërë të detyrueshme: Ne kemi zbritur shpallje të qarta në të, që të mund të jeni të vëmendshëm. <sup>2</sup> Kurorë-shkelësen dhe kurorë-shkelësin<sup>a</sup> goditini njëqind herë<sup>b</sup>. Mos lejoni që dhembshuria për ta t’jua ndalë zbatimin e ligjit të **Allahut** – nëse besoni në **Allahun** dhe Ditën e Fundit – dhe sigurohuni që një grup i besimtarëve të jenë dëshmitarë të ndëshkimit. <sup>3</sup> Kurorë-shkelësi është [i përshtatshëm] për t’u martuar<sup>c</sup> veç me kurorë-shkelëse apo idhujtare: sjellja e tillë u është ndaluar besimtarëve. <sup>4</sup> Ndërsa ata që i akuzojnë gratë e dëlira për kurvëri dhe pastaj dështojnë t’i sigurojnë katër dëshmitarë, goditini tetëdhjetë herë dhe refuzojeni dëshminë e tyre në të ardhmen: ata janë shkelës të ligjit, <sup>5</sup> pos ata që pendohen më vonë dhe përmirësohen – **Allahu** është më falësi dhe mëshirëploti.

<sup>6</sup> Sa për ata që i akuzojnë gratë e tyre për shkelje të kurorës, por nuk kanë dëshmitarë të tjerë, secili nga ta le ta thërrasë **Allahun** katër herë për të dëshmuar se po e thotë të vërtetën, <sup>7</sup> dhe, herën e pestë, le ta thërrasë **Allahun** ta refuzojë nëse po rren; <sup>8</sup> ndëshkimi do të hiqet nga gruaja e tij nëse ajo po ashtu e thërret **Allahun** katër herë për të dëshmuar se burri i saj po rren <sup>9</sup> dhe, herën e pestë, e thërret **Allahun** ta refuzojë nëse i shoqi po e tregon të vërtetën.

<sup>24:10</sup> Po të mos ishte bujaria dhe mëshira e **Allahut** ndaj jush, po të mos ishte që **Allahu** e pranon pendimin dhe është i urtë . . . !<sup>d</sup> <sup>11</sup> Ishte një grup në mesin tuaj që e sajoi rrenën<sup>e</sup> – mos e konsideroni atë gjë të keqe për ju [njerëz]; ishte gjë e mirë – dhe secili nga ta do të ngarkohet me mëkatin që e ka fituar. Ai që e mori hisen më të madhe në të do të ketë ndëshkim të dhembshëm. <sup>12</sup> Kur e dëgjuat rrenën, pse burrat dhe gratë besimtare nuk menduan mirë për njerëzit e tyre dhe të deklarorin: ‘Qartas kjo është rrenë?’ <sup>13</sup> Dhe pse akuzuesit nuk i sollën katër dëshmitarë? Nëse nuk mund të prodhojnë dëshmitarë të tillë, janë rrenësa në sytë e **Allahut**. <sup>14</sup> Po të mos ishte bujaria dhe mëshira e **Allahut** ndaj jush në këtë botë dhe në tjetrën, tanimë do të ishit prekur nga vuajtje të tmerrshme se jeni lëshuar

---

<sup>a</sup> Krimi i *zina*-së në arabisht i përfshin të gjitha marrëdhëniet seksuale jashtë-martesorë midis një burri e një gruaje.

<sup>b</sup> *Jalada* në arabisht domethënë ‘godite lëkurën’ me dorë apo diçka tjetër, çkadoqoftë. Ka raportime se njerëzit përdornin këpucë, rroba etj. (Bukhari, *Hudud* 4)

<sup>c</sup> Ky nuk është urdhër juridik por deklarim i faktit, duke e theksuar fajësinë e të dyve. Është një opinion tjetër se *jankihu* përdoret në kuptimin e tij origjinal të ‘angazhimit në marrëdhënie seksuale’. Cilido përkthim që përdoret, kjo nuk është pjesë e ndëshkimit por kundërshtim jomiratues i krimit.

<sup>d</sup> Deklarata ‘Po të mos ishte bujaria dhe mëshira e Zotit’ përsëritet katër herë në këtë kontekst, por disa pjesë përmbyllëse të fjalisë janë pezulluar në vargjet 10 dhe 20. Ky pezullim retorik funksionon në anglisht dhe në arabisht. (Shih vargjet 14, 20 dhe 21).

<sup>e</sup> Kjo aludon në akuzën e bërë kundër Aishes, gruas së Profetit.

në kënaqësinë e të folurit të tillë. <sup>15</sup> Kur i përdorët gjuhët tuaja dhe folët me gojën tuaj gjëra që nuk i dinit [se a janë të vërteta], menduat se ishte imtësi por për **Allahun** ishte shumë serioze. <sup>16</sup> Kur e dëgjuat rrenën, pse nuk thatë: ‘Nuk duhet ta përsërisim këtë – **Allah** mos e bëj! – është shpifje monstruoze?’ <sup>17</sup> **Allahu** ju paralajmëron të mos bëni më kurrë diçka të tillë, në qofshi besimtarë të vërtetë. <sup>18</sup> **Allahu** jua qartëson mesazhet E Tij: **Allahu** është i gjithë-dijshëm, i gjith’-urtë. <sup>19</sup> Një ndëshkim plot dhembje i pret në këtë botë dhe në tjetrën ata që u pëlqen që e pahijshmja të përhapet mes besimtarëve: **Allahu** di dhe ju nuk dini. <sup>24:20</sup> Po të mos ishte bujaria dhe mëshira e **Allahut** dhe fakti se Ai është dashamirës dhe mëshirëplotë . . . ! <sup>21</sup> Besimtarë, mos i ndiqni gjurmët e Satanit – nëse e bëni këtë, do t’ju nxisë në të pahijshme dhe ligësi. Po të mos ishte bujaria dhe mëshira e **Allahut** ndaj jush, asnjëri nga ju nuk do ta kish arritur pastërtinë ndonjëherë. **Allahu** e pastron këdo që do ta pastrojë: **Allahu** është gjithë-dëgjues, gjithë-pamës.

<sup>22</sup> Ata që janë nderuar me bujari dhe bollëk nuk duhet të betohen se nuk do t’u japin [më] të afërmve, të varfërve, atyre që mërguan në rrugën e **Allahut**:<sup>a</sup> le t’ua falin gabimin e ta ndalin inatin. A nuk do të donit që **Allahu** t’ju falte? **Allahu** është më falësi dhe mëshirëploti.

<sup>23</sup> Ata që i akuzojnë gratë besimtare që janë të ndershme por të pamatura – refuzohen nga **Allahu**, në këtë jetë dhe në tjetrën. Një ndëshkim i dhembshëm i pret <sup>24</sup> në Ditën kur gjuhët, duart dhe këmbët e tyre do të dëshmojnë kundër tyre për atë që e kanë bërë – <sup>25</sup> në atë Ditë, **Allahu** do t’i shpaguajë plotësisht – dhe do ta kuptojnë se **Allahu** është E Vërteta që qartëson gjithçka. <sup>26</sup> Gratë e korruptuara janë për burra të korruptuar dhe burrat e korruptuar janë për gra të korruptuara; gratë e mira janë për burra të mirë dhe burrat e mirë janë për gra të mira. Të mirët janë të pafajshëm për ato që janë thënë kundër tyre; ata do të kenë falje dhe furnizim bujar.

<sup>27</sup> Besimtarë, mos hyni në shtëpitë e të tjerëve deri sa të keni kërkuar leje dhe t’i keni përshëndetur ata që janë brenda – kjo është më e mira për ju: mbase do ta keni parasysh këtë. <sup>28</sup> Nëse nuk e gjeni askë brenda, mos hyni pos nëse ju kanë dhënë leje. Nëse ju thonë: ‘Largohuni’, ashtu bëni – kjo është më e duhur për ju. **Allahu** e di mirë atë që e bëni. <sup>29</sup> Nuk do të fajësoheni që hyni në shtëpitë e pabanuara dhe që do të mund t’jua ofronin ndonjë shërbim të dobishëm. **Allahu** di gjithçka që bëni haptas dhe gjithçka që fshihni. <sup>24:30</sup> [Profet,] thuaju burrave besimtarë t’i ulin shikimet e tyre dhe të kenë kujdes për pjesët private: kjo është më e pastër për ta. **Allahu** është fare mirë i informuar për gjithçka që bëjnë. <sup>31</sup> Dhe thuaju grave besimtare që duhet t’i ulin shikimet e tyre, të kenë kujdes për pjesët private dhe të mos i shfaqin hijeshitë e tyre përtej asaj që është [e

---

<sup>a</sup> Ebu Bekri (Abu Bakr), babai i Aishes, që dikur e mbështeste një të afërm të quajtur Mistah, u betua, kur Mistahu mori pjesë në përhapjen e thashethemeve, se nuk do ta mbështeste më kurrë Mistahun.

pranueshme] të zbulohet;<sup>a</sup> ato duhet t'i lënë shomitë e tyre të bien që t'i mbulojnë dekoltetë e tyre dhe të mos i zbulojnë hijeshitë e tyre pos bashkëshortëve të tyre, baballarëve të tyre, vjehërrve të tyre, bijve të tyre, bijve të bashkëshortëve të tyre, vëllezërve të tyre, bijve të vëllezërve të tyre, bijve të motrave të tyre, grave të familjes së tyre, skllëvërve të tyre, burrave që kujdesen për to që nuk kanë dëshirë seksuale apo fëmijëve që nuk janë ende të vetëdijshëm për lakuriqësinë e grave; nuk duhet të kërcasin me këmbë që të tërheqin vëmendje kah ndonjë hijeshi e fshehur. Besimtarë, të gjithë ju, kthehuni kah **Allahu** që të mund të përparoni.

<sup>32</sup> Martoni<sup>b</sup> të pamartuarit në mesin tuaj dhe ata nga skllëvërit tuaj meshkuj e femra që janë të përshtatshëm [për martesë].<sup>c</sup> Nëse janë të varfër, **Allahu** do të furnizojë për ta nga bujaria E Tij: bujaria e **Allahut** është e pafund dhe Ai është i gjithë-dijshëm. <sup>33</sup> Ata që nuk janë në gjendje të martohen duhet ta ruajnë dëlirësinë deri kur **Allahu** t'u japë mjaftueshëm nga bujaria E Tij. Nëse dikush nga skllëvërit tuaj dëshiron ta paguajë lirinë e tij, bëni kontratë me ta përkatësisht, nëse e dini se kanë mirësi në vete dhe jepuni ca nga pasuria që jua ka dhënë **Allahu**. Mos i detyroni skllavet tuaja vajza në prostitucion, kur ato vetë duan të mbahen të ndershme, në kërkimin tuaj për përfitimet afat-shkurtra të kësaj bote, megjithëse, nëse ato detyrohen, **Allahu** do të jetë falës dhe mëshirëplotë ndaj tyre.

<sup>34</sup> Ne ju kemi zbritur [juve njerëz] vargje që e qartësojnë rrugën e duhur, shembuj të atyre që kanë ndërruar jetë para jush dhe këshilla për ata që janë të vetëdijshëm për **Allahun**.

<sup>35</sup> **Allahu** është Drita  
e qiejve dhe e tokës.  
Përgjasimi me Dritën E Tij  
është si një vend në mur ku është një llambë,  
llamba në një rruzull xhami,  
rruzulli i xhamtë si yll shkëlqyes,  
ndezur nga një pemë e bekuar ulliri  
as e Lindjes as e Perëndimit,  
drita e saj pothuaj shumë e ndritshme  
edhe pa e prekur zjarri.

---

<sup>a</sup> Fjalë për fjalë: 'përtej asaj që shfaqet [zakonisht]'. Kjo frazë është dykuptimëshe në arabisht. Zakonisht i jepet mbështetje *hadithit* (traditës profetike), që e përdor foljen e njëjtë *dhahara* në kuptimin se është e lejueshme për një grua ta shfaqë vetëm fytyrën dhe duart para të huajve.

<sup>b</sup> Është një interpretim tjetër që e përkthen si 'martohuni me'.

<sup>c</sup> Apo 'të ndershëm'.

Dritë mbi dritë!

**Allahu** e udhëzon kah Drita E Tij

këdo që do ta udhëzojë:

dhe **Allahu** u jep kësi shembuj njerëzve;

dhe **Allahu** i di krejt gjërat.

<sup>36</sup> Drita është në shtëpitë

që **Allahu** ka lejuar të ngriten

që të kujtohet emri I Tij aty,

ku e lavdojnë

mëngjeseve e mbrëmjeve,

<sup>37</sup> njerëz që nuk i trullos

as biznesi as tregtia

nga të kujtuarit e **Allahut**

dhe nga vazhdimësia në lutje

dhe nga dhënia e lëmoshës,

meqë i frikësohen një dite në të cilën

zemrat e sytë do të shndërrohen,

<sup>38</sup> që **Allahu** të mund t'i shpërblejë

për më të mirën e asaj që e bënë,

dhe t'u dhurojë edhe më shumë

nga mirësia E Tij hyjnore.

Dhe **Allahu** i jep pa masë

kujtdo që do t'i japë.

<sup>39</sup> Sa për mosmirënjohësit që s'kanë besim,

veprat e tyre janë si mirazh në shkretëtirë,

që njeriut të etur i duket ujë

deri kur t'i afrohet dhe të mos gjejë gjë aty –

por e gjen **Allahun** në prezencën E Tij,

dhe Ai ia paguan fitimin;

dhe **Allahu** i mban llogaritë aty-për-aty –

<sup>24:40</sup> apo si errësirat  
në oqean të thellë e të gjerë  
të mbuluar me dallgë,  
mbi to dallgë,  
përmbi to re.  
Errësirat njëra mbi tjetrën;  
po ta zgjaste dorën dikush  
mezi do ta shihte.  
Dhe kushdo që **Allahu** s'i jep dritë  
s'ka dritë fare.

<sup>41</sup> A nuk e sheh [Profet]  
se **Allahun** e lavdojnë  
të gjitha qeniet në qiej e në tokë,  
madje edhe shpezët në fluturim?  
Secila e di mënyrën e saj  
si të falet e të lavdojë:  
dhe **Allahu** është i dijshtëm  
për gjithçka që bëjnë.

<sup>42</sup> Se **Allahut** i përket kontrolli  
i qiejve dhe i tokës;  
dhe kthimi përfundimtar  
është te **Allahu**.

<sup>43</sup> A nuk e sheh se **Allahu** i drejton retë, pastaj i mbledh së bashku e i grumbullon deri kur ta shihni shiun të derdhet nga mesi i tyre? E zbret breshrin nga malet [e tilla] në qiell, duke e derdhur mbi këdo që dëshiron dhe duke e shmangur nga kushdo që dëshiron – shkëlqimi i vetëtimës së tij gati t'i merr sytë. <sup>44</sup> **Allahu** e ndërron ditën dhe natën – vërtet ka mësim në [tërë] këtë për ata që kanë sy për të parë – <sup>45</sup> dhe **Allahu** e krijoi secilën kafshë nga lëngu [i saj]:<sup>a</sup> disa nga to zvarriten në bark, disa ecin në dy këmbë dhe disa në katër. **Allahu** krijon çkado që do të krijojë; **Allahu** ka pushtet ndaj gjithçkaje.

---

<sup>a</sup> Kjo *ma'* nuk është 'ujë', që do ta kishte *al-* të përgjithshëm (krahaso me 21:30), por është për secilën kafshë një lëng i veçantë, thelbësor dhe kështu secila krijesë është e ndryshme, siç është e qartë nga ajo që vijon.

<sup>46</sup> Ne kemi dërguar vargje që e qartësojnë rrugën e duhur: **Allahu** e udhëzon këdo që do ta udhëzojë në rrugë të drejtë. <sup>47</sup> Thonë: ‘Besojmë në **Allahun** dhe në Të Dërguarin; bindemi’, por pastaj disa nga ta largohen: këta njerëz nuk janë besimtarë të vërtetë <sup>48</sup> dhe kur i thërrasin te **Allahu** dhe I Dërguari I Tij që ai të gjykojë ndërmjet tyre, disa nga ta largohen. <sup>49</sup> Po ta pretendonin të drejtën e tyre, do të vinin me qejf [te Profeti]. <sup>24:50</sup> A kanë sëmundje në zemrat e tyre? A janë plot dyshime? A kanë frikë se **Allahu** dhe I Dërguari I Tij mund t’i trajtojnë padrejtësisht? Jo, pikërisht ata janë të padrejtë. <sup>51</sup> Kur besimtarët e vërtetë i thërrasin te **Allahu** dhe I Dërguari I Tij që ai të gjykojë ndërmjet tyre, thonë: ‘Dëgjojmë dhe bindemi.’ Këta janë ata që do të përparojnë: <sup>52</sup> kushdo që i bindet **Allahut** dhe Të Dërguarit Të Tij, ka frikë-respekt për **Allahun** dhe i përmbahet obligimit të tij ndaj Tij – do të jetë triumfues. <sup>53</sup> [Të tjerët] betohen solemnisht në **Allahun** se po t’i komandoje [ti Profet], do të marshonin. Thuaju: ‘Mos u betoni: ajo që kërkohet është të bindurit e arsyeshëm dhe **Allahu** është i informuar për gjithçka që bëni.’ <sup>54</sup> Thuaj: ‘Bindjuni **Allahut**; bindjuni Të Dërguarit. Nëse largoheni, [dijeni se] ai është përgjegjës për detyrën që i është dhënë dhe ju jeni përgjegjës për detyrën që ju është dhënë. Nëse i bindeni, do të jeni të udhëzuar si duhet, por detyra e Të Dërguarit është veç ta përcjellë mesazhin qartë.’

<sup>55</sup> **Allahu** u dha premtim atyre midis jush që besojnë dhe bëjnë vepra të mira: do t’i bëjë trashëgues të vendit, siç i bëri ata që erdhën para tyre; do ta fuqizojë fenë që e ka zgjedhur për ta; do t’u japë siguri për ta zëvendësuar frikën e tyre. ‘Do të më adhurojnë Mua dhe nuk do të bashkojnë asgjë me Mua.’ Ata që janë kundërshtues të hapur pas kësaj do të jenë rebelët – <sup>56</sup> [Njerëz,] lutuni vazhdimisht, paguajeni lëmshën e caktuar dhe bindjuni Të Dërguarit, që të mund t’ju jepet mëshirë. <sup>57</sup> Mos mendo [Profet] se mosbesimtarët mund t’i ikin **Allahut** në tokë; Zjarri do të jetë shtëpia e tyre e fundit, një fund i keq.

<sup>58</sup> Besimtarë, skllëverit tuaj dhe kushdo që nuk e ka arritur pubertetin ende duhet t’ju kërkojnë leje për të hyrë në tri kohë të ditës: para lutjes së agimit; kur i lini rrobat tuaja mënjane në vapën e mesditës; dhe pas lutjes së mbrëmjes. Këto janë tri kohët tuaja për privatësi; në kohët tjera, nuk fajësoheni as ju as ata nëse lëvizni lirshëm rreth njëri-tjetrit. Kështu **Allahu** i qartëson mesazhet: **Allahu** është i gjithë-dijshëm, i gjith’-urtë. <sup>59</sup> Kur fëmijët tuaj e arrijnë pubertetin, [gjithmonë] duhet t’ju kërkojnë leje për të hyrë, siç bëjnë më të vjetrit. Kështu **Allahu** jua qartëson mesazhet E Tij: **Allahu** është i gjithë-dijshëm, i gjith’-urtë. <sup>24:60</sup> Asnjë faj nuk do t’u vihet grave më të vjetra që nuk janë duke shpresuar për seks, nëse i heqin rrobat e tyre të jashtme pa u mburrur me hijeshitë e tyre, por preferohet që mos ta bëjnë këtë: **Allahu** është gjithë-dëgjues, gjithë-pamës.

<sup>61</sup> Asnjë faj nuk do t'u vihet të verbërve, atyre me aftësi të kufizuara, të sëmurëve.<sup>a</sup> Pavarësisht a hani në shtëpitë tuaja apo ato të etërve tuaj, të nënave, të vëllezërve, të motrave, të xhaxhallarëve, të hallave, të dajëve, të tezeve, shtëpitë për të cilat i keni çelësat apo ndonjë nga shtëpitë e miqve tuaj, nuk do të fajësoheni: nuk do të fajësoheni pavarësisht a hani bashkë a veçmas.<sup>b</sup> Kur hyni në ndonjë shtëpi, përshëndetuni me përshëndetje të bekimit e të mirësisë siç përcaktohet nga **Allahu**. Kështu **Allahu** jua qartëson mesazhet E Tij që të mund të kuptoni.

<sup>62</sup> Besimtarët e vërtetë janë ata që besojnë në **Allahun** dhe Të Dërguarin E Tij, që, kur mblidhen me të për një çështje të bashkësisë, nuk largohen deri kur t'i kenë kërkuar leje atij – ata që të kërkojnë leje [Profet] janë ata që vërtet besojnë në **Allahun** dhe Të Dërguarin E Tij. Kur të kërkojnë leje për t'u marrë me çështjet e tyre private, lejoje këdo që e sheh të arsyeshme dhe lute **Allahun** t'i falë. **Allahu** është më falësi dhe mëshirëploti. <sup>63</sup> [Njerëz,] mos i trajtoni ftesat e Të Dërguarit për juve si ato kur e ftoni njëri-tjetrin – **Allahu** është fare mirë i informuar për ata nga ju që përvihen tinëzisht për t'u larguar – dhe ata që shkojnë kundër urdhrin të tij duhet të kenë kujdes se mos po i pikëllon ndonjë sprovë apo mos po marrin ndëshkim të dhembshëm.

<sup>64</sup> Gjithçka në qiej dhe në tokë i përket **Allahut**: Ai e di se në çfarë gjendje jeni – në Ditën kur të gjithë i kthejnë tek Ai, do t'u tregojë gjithçka që kanë bërë – **Allahu** ka njohuri të plotë për gjithçka.

---

<sup>a</sup> Komentuesit deklarojnë se të verbrit etj. përmbaheshin nga të ngrënit me të shëndetshmit apo se të shëndetshmit refuzonin të hanin me ta dhe shumë nga ta e lidhin këtë deklaratë me vijuesen.

<sup>b</sup> Disa komentues e marrin këtë si kualifikim të 4:29, që u interpretua nga disa myslimanë si ndalesë për të ngrënë në shtëpitë e njëri-tjetrit pa ftesë.

**Përshkrimi para kaptinës 24 nga Abdel Haleem:**

*Kjo sure medinase i qartëson disa rregullore për komunitetin mysliman, që kryesisht kanë të bëjnë me martesën, modestinë, bindjen ndaj Profetit dhe sjelljen e duhur në familje. Konteksti fillestar është thashethemi i rremë kundër Aishes, gruas së Profetit, që padashur u la nga bashkudhëtarët e saj pasi u largua për ta kërkuar një gjerdan që i kish rënë. Atë e ktheu në Medinë një burrë mysliman që erdhi më vonë dhe e gjeti aty. Surja është emëruar sipas Vargut të Dritës (vargjet 35-6) ku drita e Allahut kontrastohet me errësirën në të cilën mosbesimtarët e gjejnë veten të gllabëruar.*

**Shënimet gjuhësore (Thomas Cleary)**

*Drita (al Nuur) (Kaptina 24)*

Kjo sure ishte shfaqur në Medinë. E nisi përzgjedhjen time (këtu flet Thomas Cleary) nga Vargu i famshëm i Dritës, ndër fragmentet më të çmuara nga Kurani. Vargjet e mëhershme i trajtojnë doket e shoqërisë, duke i përfshirë temat e moralit seksual, të privatësisë, të modestisë dhe të mbajtjes së dëlirësisë nga përgojimi i lig.

36 “në shtëpitë që Zoti ka lejuar të ngriten”: Fjala “ngriten” mund të kuptohet në sensin konkret të “ndërtimit”, që domethënë shtëpitë e lutjes të ndërtuara veçanërisht për kujtuarje të vazhdueshme të Zotit; dhe në sensin abstrakt të “lartësimi”, që domethënë shtëpitë e fisnikëruara nga të kujtuarit e vazhdueshëm të Zotit.

37 “njerëz që nuk i trullojnë”: Disa e kuptojnë këtë se u referohet njerëzve që i lënë profesionet tokësore për t’iu kushtuar plotësisht të kujtuarit të Zotit; të tjerë e kuptojnë se u referohet njerëzve të cilëve profesionet e tyre tokësore nuk ua heqin mendjen nga përkushtimi i vazhdueshëm dhe i plotë ndaj Zotit.

39 “veprat e tyre janë si mirazh n’shkretëtirë”: Veprat që burojnë nga budallallëku njerëzor bazohen në gjykime subjektive dhe kështu përfundimisht dalin josubstanciale objektivisht.

40 “apo si errësirat”: Kjo prapë i referohet veprave të mosmirënjohësve që refuzojnë ta pranojnë burimin e tërë ekzistencës. Oqeani është vetëdijësia e



tyre, errësirat janë shtresat e padijes, dallgët janë fantazimet e rrëmbyera, dallgët mbi dallgë janë shpjegimet e arsyeshme të fantazimeve të tyre, retë janë paragjykimet dhe lëmitë ku s'kuptojnë asgjë.

“po ta zgjaste dorën dikush, mezi do ta shihte”: padituria dhe verbëria e mosmirënjohësve jo vetëm që ua pengon njohjen e qëllimit vendimtar, por ua maskon edhe të vërtetën për atë që është afër e që kapet lehtë.

“kushdo që Zoti s'i jep dritë s'ka dritë fare”: Tërë dija e vërtetë është nga E Vërteta: fantazia njerëzore subjektive nuk ka lidhje me realitetin themelor.

## 25: Dalluesi (EL-FURKÂN)

Në emrin e **Allahut**, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës

<sup>1</sup> I lartësuar<sup>a</sup> është Ai që ia ka zbritur Dalluesin<sup>b</sup> shërbyesit Të Tij që të mund të jetë paralajmërim për të gjithë njerëzit. <sup>2</sup> Është Ai – Ai që ka kontroll mbi qiejt dhe tokën dhe nuk ka fëmijë të lindur – askush nuk e ndan kontrollin me Të – dhe që i krijoi të gjitha gjërat dhe i bëri në masë të saktë. <sup>3</sup> E megjithatë mosbesimtarët marrin për zota të tyre gjëra nën Të që nuk krijojnë asgjë e edhe vetë janë krijuar, që as s'mund të dëmtojnë as t'i ndihmojnë vetes dhe nuk kanë kontroll mbi vdekjen, lindjen a ringjalljen.

<sup>4</sup> Mosbesimtarët thonë: 'Kjo mund të jetë veç gënjeshtër që e ka trilluar ai me ndihmën e të tjerëve' – ata vetë kanë bërë shumë keq dhe kanë thënë gënjeshtër – <sup>5</sup> dhe thonë: 'Janë veç fabula të lashta, të cilat i ka pasë të shkruara: i diktohen mëngjes e mbrëmje.' <sup>6</sup> Thuaj: 'Është zbritur nga Ai që i di fshehtësitë e qiejve dhe të tokës. Ai është gjithë-falës, i gjithë-mëshirshëm.' <sup>7</sup> Po ashtu thonë: 'Çfarë lloj i dërguari është ky? Ha ushqim dhe shëtit nëpër tregje! Pse nuk është zbritur asnjë engjëll t'i ndihmojë në paralajmërimet e tij?' <sup>8</sup> Pse nuk i është dhënë thesar apo kopsht për t'ia furnizuar ushqimin?' dhe keqbërësit thonë: 'Njeriu që e ndiqni është thjesht nën efektin e një magjie.' <sup>9</sup> Shih çka mendojnë se je! Kanë devijuar dhe nuk mund ta gjejnë rrugën e duhur. <sup>25:10</sup> I lartësuar është Ai që mundet, nëse do, t'ju japë gjëra më të mira se këto: Kopshte të hijeshuara me lumenj rrjedhës si dhe pallate. <sup>11</sup> Në të vërtetë e refuzojnë ardhjen e Orës: Ne kemi përgatitur zjarr flakërues për ata që e refuzojnë Orën. <sup>12</sup> Kur ai t'i shohë nga larg, do ta dëgjojnë duke u tërbuar e duke gjëmuar, <sup>13</sup> dhe kur të hidhen në një pjesë të ngushtë të tij, të lidhur me zinxhirë së bashku, do të vajtojnë për vdekjen. <sup>14</sup> 'Mos vajtoni në këtë ditë për një vdekje, por për shumë.' <sup>15</sup> Thuaj: 'Cila është më e mirë, kjo apo Kopshti i qëndrueshëm që u është premtuar atyre që janë të vetëdijshëm për **Allahun** si shpërblim dhe fund i udhëtimit?' <sup>16</sup> Aty do të gjejnë gjithçka që dëshirojnë dhe aty do të rrinë. [Profet,] ky është premtim obligues nga Zoti yt. <sup>17</sup> Në Ditën që i mbledh ata të gjithë bashkë me ata që i adhurojnë krahas Tij, Ai do të thotë: 'A ishit ju [zota të rrejshëm] që i devijuat këto krijesa Të Mijat, apo devijuan vetë nga rruga?' <sup>18</sup> Ata do të thonë: 'Qofsh i lartësuar! Ne vetë nuk do të merrnim padronë të tjerë pos Teje! Por ti u dhurove atyre dhe para-ardhësve të tyre kënaqësi në këtë jetë, deri kur e harruan Përkujtuesin Tënd dhe u shkatërruan.' <sup>19</sup> [Allahu do të thotë:] 'Tani zotat tuaj i kanë denoncuar si gënjeshtër ato që i thoni: nuk mund t'i shmangeni ndëshkimit; nuk do të merrni

<sup>a</sup> Ky kuptim i *tabarak* përkrahet nga Razi dhe është më i përshtatshëm këtu se sa 'i bekuar'

<sup>b</sup> *Al-furqaan*, një emër tjetër për Kuranin. Fjala domethënë 'ajo që e dallon të drejtën nga e gabuara'.

kurrfarë ndihme.’ Nëse dikush nga ju bën të keqe të tillë, do ta bëjmë ta shijojë torturën agonizuese.

<sup>25:20</sup> Nuk ka asnjë të dërguar që Ne e kemi çuar para teje [Muhamed] që nuk ka ngrënë ushqim dhe nuk ka shëtitur nëpër treg. Por disa nga ju i kemi bërë mjet për t’i sprovuar të tjerët – a do të jeni të qëndrueshëm? Zoti juaj është gjithmonë duke vëzhguar. <sup>21</sup> Ata që nuk druhen të na takojnë Neve thonë: ‘Pse nuk na janë zbritur engjëjt?’ apo ‘Pse nuk mund ta shohim Zotin tonë?’ Janë tepër krenarë për veten dhe tepër të paturp. <sup>22</sup> Nuk do të ketë lajme të mira për fajtorët në Ditën kur t’i shohin engjëjt. Engjëjt do të thonë: ‘Nuk mund ta kaloni pengesën e ndaluar’,<sup>a</sup> <sup>23</sup> dhe Ne do t’u kthehemi veprave që i kanë bërë dhe do t’i shpartallojmë ata si pluhur. <sup>24</sup> Por ata që shoqërohen në Kopsht do të kenë shtëpi më të mirë në atë Ditë dhe vend më të drejtë për të pushuar. <sup>25</sup> Në Ditën kur qielli dhe retë e tij ndahen në pjesë dhe engjëjt lëshohen si lumenj, <sup>26</sup> në atë Ditë, autoriteti i vërtetë i përket Zotit të Mëshirës. Do të jetë Ditë e pikëllueshme për mosbesimtarët. <sup>27</sup> Në atë Ditë keqbërësi do ta kafshojë dorën e tij e do të thotë: ‘Ah ta kisha marrë rrugën e njëjtë si I Dërguari. <sup>28</sup> I mjeri unë! Ah mos ta kisha bërë shok këtë e atë – <sup>29</sup> ai më devijoi nga Shpallja pasi më erdhi. Satani e ka tradhtuar njerëzimin gjithmonë.’

<sup>25:30</sup> I Dërguari ka thënë: ‘Zot, njerëzit e mi e trajtojnë këtë Kuran si diçka që duhet të shmanget’, <sup>31</sup> por Ne gjithmonë kemi caktuar kundërshtarë nga të ligët, për secilin profet: Zoti yt është udhëzues dhe ndihmues i mjaftueshëm. <sup>32</sup> Mosbesimtarët thonë edhe: ‘Pse nuk iu zbrit Kurani krejt njëherësh?’ Ne e kemi dërguar në këtë mënyrë për të ta forcuar zemrën [Profet]; ta dhamë në shpallje graduale. <sup>33</sup> Ata nuk mund të ta paraqesin asnjë argument pa ta sjellë Ne të vërtetën dhe shpjegimin më të mirë. <sup>34</sup> Janë ata të shtyrët [në rënie], në fytyrat e tyre<sup>b</sup>, në Ferr që do të jenë në vendin më të keq – ata janë më së largu nga rruga e drejtë.

<sup>35</sup> Ne ia dhamë Musait Librin dhe e caktuam vëllain e tij Harunin t’i ndihmojë. <sup>36</sup> Thamë: ‘Shkoni, të dytë, te njerëzit që i kanë refuzuar shenjat Tona.’ Më vonë i shkatërruam ata njerëz plotësisht. <sup>37</sup> Edhe popullin e Nuhut: kur i refuzuan të dërguarit e tyre, i fundosëm dhe i bëmë shembull për tërë popujt. Kemi përgatitur torturë të dhembshme për keqbërësit, <sup>38</sup> siç kemi bërë për popujt e Adit, Themudit dhe al-Ras-it dhe shumë breza ndërmjet. <sup>39</sup> Secilit prej tyre u dhamë paralajmërimë dhe secilin nga ta e shkatërruam plotësisht. <sup>25:40</sup> Këta mosbesimtarë duhet të kenë kaluar kah qyteti që ishte shkatërruar nga shiu i tmerrshëm<sup>c</sup> – a nuk e panë? E megjithatë nuk presin se do të ngriten nga të

---

<sup>a</sup> Krahaso me 23:100

<sup>b</sup> Krahaso me 67:22

<sup>c</sup> Shih 15:74, 76

vdekurit. <sup>41</sup> Kurdo që të shohin [Profet] të përqeshin: ‘A është ky ai që **Allahu** e ka çuar si të dërguar?’ <sup>42</sup> Për pak do të mund të na devijonte nga zotat tanë po të mos qëndronim kaq fort pranë tyre.’ Kur ta shohin ndëshkimin, do ta dinë se kush është më së largu rrugës. <sup>43</sup> Mendo [Profet] për njeriun që e ka marrë pasionin e tij si zot: a do të jesh kujdestari i tij? <sup>44</sup> A mendon se shumica nga ta dëgjojnë apo kuptojnë? Ata janë sikur bagëti – jo, janë edhe më larg nga rruga.

<sup>45</sup> A nuk e shihni se si e zgjat hijen Zoti juaj? Po të donte, do të mund ta bënte të qëndronte në vend – Ne e kemi bërë diellin tregues të saj – <sup>46</sup> por gradualisht e tërheqim kah Ne, pak nga pak. <sup>47</sup> Është Ai që e bëri natën veshje për ju dhe gjumin pushim dhe e bëri ditën si ringjallje. <sup>48</sup> Është Ai që i dërgon erërat si lajmëtarë të lajmeve të mira para Mëshirës Së Tij<sup>a</sup>. Ne zbresim ujë të pastër nga qielli, <sup>49</sup> që të mund ta ringjallim një tokë të vdekur me të dhe ia japim atë si pije shumë kafshëve e njerëzve që i kemi krijuar. <sup>25:50</sup> Shumë herë ia kemi përsëritur këtë njerëzve që të mund të jenë të vëmendshëm, por shumica këmbëngulin në mosmirënjohjen e tyre. <sup>51</sup> Po të kish qenë dëshira Jonë, do t’i kishim dërguar paralajmërues secilës qytezë, <sup>52</sup> pra mos u lëshoni pe mosbesimtarëve: përpiquni fort kundër tyre me këtë Kuran.

<sup>53</sup> Është Ai që i lëshoi dy trupa të ujit rrjedhës, një i ëmbël e i freskët dhe tjetri me kripë e i hidhur dhe vuri pengesë të pakapërcyeshme ndërmjet tyre. <sup>54</sup> Është Ai që krijon qenie njerëzore nga lëngu, pastaj i bën të afërm me lidhje gjaku e me martesë: Zoti juaj është i gjithë-fuqishëm! <sup>55</sup> E megjithatë në vend të **Allahut** adhurojnë gjëra që as s’mund t’u sjellin dobi as t’i dëmtojnë: mosbesimtari gjithmonë ia ka kthyer shpinën Zotit të tij. <sup>56</sup> Ne të dërguam veç për të dhënë lajme të mira dhe paralajmërim. <sup>57</sup> Thuaj: ‘Nuk po kërkoj ndonjë shpërblim nga kjo, por kushdo që dëshiron duhet ta marrë një rrugë kah Zoti i tij.’ <sup>58</sup> Kijeni besimin në Të Gjallin [**Allah**] që nuk vdes kurrë dhe festojeni lëndin E Tij. Ai i di fare mirë mëkatet e shërbyesve Të Tij: <sup>59</sup> është Ai që i krijoi qiejt dhe tokën dhe atë që është ndërmjet tyre për gjashtë Ditë<sup>b</sup> dhe pastaj u vendos te froni – Ai është Zoti i Mëshirës; Ai është I Informuari Më Së Miri<sup>c</sup>. <sup>25:60</sup> E megjithatë kur u thuhet: ‘Përkuluni para Zotit të Mëshirës’, thonë: ‘Çka është Zoti i Mëshirës? A duhet të përkulemi para çdo gjëje që ti na urdhëron?’ dhe largohen edhe më shumë. <sup>61</sup> I Lartësuar është Ai që i vuri yjësitë në qiej, një dritë rrezatuese dhe një hënë ndriçuese – <sup>62</sup> është Ai që e bëri natën dhe ditën ta ndjekin njëra-tjetrën – që kush të dojë të mund të jetë i vetëdijshtë apo të shfaqë mirënjohje.

---

<sup>a</sup> Shiut.

<sup>b</sup> Krahaso me 41:9-12

<sup>c</sup> Lexime të tjera të kësaj fraze përfshijnë ‘pyeteni dikë që di’ apo ‘pyeteni këdo se sa mirë është i informuar Ai’, por shprehja *fas’al*, ‘pyeteni dikë’, në fillim të frazës është mjet retorik që e sugjeron të vërtetën e pohimit dhe nuk duhet të përkthehet fjalë për fjalë.

<sup>63</sup> Shërbyesit e Zotit të Mëshirës janë ata që ecin përlësisht në tokë dhe që, kur u drejtohen budallenjtë, përgjigjen: ‘Paqe’; <sup>64</sup> ata që e kalojnë natën të përkulur apo në këmbë, duke e adhuruar Zotin e tyre, <sup>65</sup> që përgjërohen: ‘Zoti ynë, largoje nga ne vuajtjen e Ferrit, se është torturë e tmerrshme për ta vuajtur! <sup>66</sup> Është shtëpi e keqe, vend i ndyrë i pushimit!’ <sup>67</sup> Këta janë ata që nuk janë as shpërdorues as pa mend kur shpenzojnë, por e mbajnë një ekuilibër të drejtë; <sup>68</sup> ata që nuk thirrin kurrë asnjë hyjni tjetër pos **Allahut**, as s’ marrin jetë, të cilën **Allahu** e ka bërë të shenjtë, përveç në ndjekjen e drejtësisë, as nuk e shkelin kurorën. (Kushdo që i bën këto gjëra do të përballet me ndëshkime: <sup>69</sup> tortura e tyre do të dyfishohet në Ditën e Ringjalljes dhe do të mbesin në torturë, të turpëruar, <sup>25:70</sup> përveç atyre që pendohen, besojnë dhe bëjnë vepra të mira: **Allahu** do t’i shndërrojë veprat e këqija të njerëzve të tillë në të mira. Ai është më falësi, më mëshirëploti. <sup>71</sup> Njerëzit që pendohen dhe bëjnë vepra të mira vërtet kthehen te **Allahu**.)

<sup>72</sup> [Shërbyesit e Zotit të Mëshirës janë] ata që nuk japin dëshmi të rreme dhe që, kur e shohin ndonjë mendjelehtësi, kalojnë atypari me dinjitet; <sup>73</sup> që, kur u përkujtohen shenjat e Zotit të tyre, nuk u kthejnë vesh të shurdhër dhe sy të verbër; <sup>74</sup> ata që luten: ‘Zoti ynë, na jep gëzim në bashkëshortët dhe fëmijët tanë të lindur. Na bëj shembuj të mirë për ata që janë të vetëdijshëm për Ty.’ <sup>75</sup> Këta shërbyes do të shpërblehen me vendin më të lartë në Parajsë për qëndrueshmërinë e tyre. Aty do të hasin përsëritje e paqe. <sup>76</sup> Aty do të rrinë – shtëpi dhe vend i lumtur për pushim! <sup>77</sup> [Profet, thuaju mosbesimtarëve:] ‘Çka jeni ju për Zotin tim pa lutjet tuaja? Por meqë i keni zhvlerësuar të vërtetat si rrena, do të ndodhë e pashmangshmja.’ <sup>a</sup>

---

<sup>a</sup> Ndëshkimi (krahaso me 4:147)

**Përshkrimi para kaptinës 25 nga Abdel Haleem:**

*Sure mekase që fillon me një denoncim të politeizmit, e pastaj merret me argumentet e mosbesimtarëve kundër Profetit, Kuranit dhe Ditës së Gjykimit. I paralajmëron për fatin e tyre, duke përmendur shembuj të popujve të mëparshëm. Surja e përshkruan fuqinë dhe mirësinë e **Allahut** dhe përfundon me cilësitë e besimtarëve të vërtetë (vargjet 63-76).*

## 26: Poetët (ESH-SHU‘ARÂ’)

Në emrin e **Allahut**, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës

<sup>1</sup> *Ta Sin Mim*

<sup>2</sup> Këto janë vargjet e Shkrimit të Shenjtë që i qartësojnë gjërat:

<sup>3</sup> [Profet,] a do të merakosesh jashtëzakonisht shumë se nuk do të besojnë?  
<sup>4</sup> Po të dëshironim, Ne do të mund t’ua zbrisnim një shenjë nga qielli, ndaj të cilës qafat e tyre do të qëndronin të përkulura plotësisht në përulësi të plotë.  
<sup>5</sup> Kurdoherë që u sillet një shpallje e re nga Zoti i Mëshirës, largohen: <sup>6</sup> e refuzojnë, por e vërteta që e përbuznin do t’i godasë së shpejti. <sup>7</sup> A nuk e shohin tokën dhe çfarë gjëra fisnike rrisim në të? <sup>8</sup> Vërtet ka shenjë në këtë, megjithëse shumica nga ta nuk besojnë: <sup>9</sup> veç Zoti juaj është I Gjithë-Fuqishmi, Mëshirëploti.

<sup>26:10</sup> Zoti juaj i thirri Musait: ‘Shko te ata keqbërës, <sup>11</sup> njerëzit e Faraonit. A nuk do të marrin vesh?’ <sup>12</sup> Musai tha: ‘Zoti im, kam frikë se do të më quajnë gënjeshtar, <sup>13</sup> dhe do të ndihem i tensionuar dhe do të më lidhet gjuha, prandaj dërgoje edhe Harunin; <sup>14</sup> pos kësaj, ata kanë padi<sup>a</sup> kundër meje dhe kam frikë se mund të më vrasin.’ <sup>15</sup> **Allahu** tha: ‘Jo [nuk do ta bëjnë]. Shkoni, të dytë, me shenjat Tona – do të jemi me ju, duke dëgjuar. <sup>16</sup> Shkoni, të dytë, te Faraoni dhe thuan: “E sjellim një mesazh nga Zoti i Botëve: <sup>17</sup> lejoni Fëmijët e Izraelit të largohen me ne.” ’

<sup>18</sup> Faraoni tha: ‘A nuk të edukuam si fëmijë në mesin tonë? A nuk ke qëndruar me ne për shumë vite? <sup>19</sup> Pastaj e bëre atë krimin tënd: ishe kaq mosmirënjohës.’  
<sup>26:20</sup> Musai u përgjigj: ‘Isha i keqduhëzuar kur e bëra <sup>21</sup> dhe ika nga ju me frikë; më vonë Zoti im më dha urti dhe më bëri një nga të dërguarit E Tij. <sup>22</sup> Dhe a është kjo – që i ke skllavëruar Fëmijët e Izraelit – favori me të cilin më qorton?’

<sup>23</sup> Faraoni pyeti: ‘Çka është ky farë “Zoti i Botëve”?’ <sup>24</sup> Musai u përgjigj: ‘Ai është Zoti i qiejve dhe i tokës dhe i gjithçkaje ndërmjet tyre. Ah veç po të kishit besim!’ <sup>25</sup> Faraoni u tha të pranishmëve: ‘A po dëgjoni çka po thotë?’ <sup>26</sup> Musai tha: ‘Ai është Zoti juaj dhe Zoti i para-ardhësve tuaj.’ <sup>27</sup> Faraoni tha: ‘Ky i dërguar që jua kanë çuar është vërtet shpirt-pushtuar.’ <sup>28</sup> Musai vazhdoi: ‘...Zoti i Lindjes dhe i Perëndimit dhe i gjithçkaje ndërmjet tyre. Ah veç po ta përdornit arsyen!’ <sup>29</sup> Por Faraoni [i] tha: ‘Nëse merr çfarëdo zoti tjetër pos meje, do të të fus në burg’, <sup>26:30</sup> dhe Musai pyeti: ‘Edhe nëse të tregoj diçka bindëse?’ <sup>31</sup> ‘Tregojë

---

<sup>a</sup> Krahaso me 28:15-20.

pra', tha Faraoni, 'nëse po e thua të vërtetën.' <sup>32</sup> Kështu Musai e hodhi shkopin e tij dhe – shih sa çudi! – u bë gjarpër që ta shohin të gjithë. <sup>33</sup> Pastaj e nxori dorën dhe – shih sa çudi! – ishte e bardhë që ta shohin spektatorët. <sup>34</sup> Faraoni u tha këshilltarëve rreth tij: 'Ky njeri është magjistar i ditur! <sup>35</sup> Synon ta përdorë magjinë e tij për t'ju dëbuar nga vendi juaj! Çka po sugjeroni?' <sup>36</sup> Ata u përgjigjën: 'Mbage atë dhe vëllain e tij për ca kohë dhe ço të dërguar në të gjitha qytetet <sup>37</sup> për të ta sjellë çdo magjistar me aftësi të kompletuara.' <sup>38</sup> Magjistarët [do të] mblidheshin në kohën e dakorduar në ditën e caktuar <sup>39</sup> dhe njerëzve u thuhej: <sup>26:40</sup> 'A po vini të gjithë? Mund t'i ndjekim magjistarët nëse fitojnë!'

<sup>41</sup> Kur erdhën magjistarët, i thanë Faraonit: 'A do të shpërblehemi nëse fitojmë' <sup>42</sup> dhe ai tha: 'Po dhe do t'i bashkoheni oborrit tim të brendshëm.' <sup>43</sup> Musai u tha: 'Hidhni çka të doni.' <sup>44</sup> Ata i hodhën litarët dhe shkopinj të tyre, duke thënë: 'Pasha pushtetin e Faraonit, do të jemi fitues.' <sup>45</sup> Por Musai e hodhi shkopin e tij dhe – shih sa çudi! – i gllabëroi truqet e tyre <sup>46</sup> dhe magjistarët ranë në gjunjë, <sup>47</sup> duke thirrur: 'Besojmë në Zotin e Botëve, <sup>48</sup> Zotin e Musait dhe të Harunit.' <sup>49</sup> Faraoni tha: 'Si guxonit të besoni në të para se t'jua kem dhënë lejen unë? Ai duhet të jetë mjeshtri që jua mësoi magjinë! Tash do ta shihni: do t'jua pres duart dhe shputat alternative<sup>a</sup> dhe pastaj do ta kryqëzoj grupin tuaj!' <sup>26:50</sup> 'Kjo nuk do të na bëjë dëm', thanë, 'se me siguri do të kthehemi te Zoti ynë. <sup>51</sup> Shpresojmë që Zoti ynë do të na i falë mëkatet tona, meqë ishim të parët që besuam.'

<sup>52</sup> Pastaj Ne ia shpallëm vullnetin Tonë Musait: 'Largohu me shërbyesit E Mi gjatë natës, se do t'ju ndjekin!' <sup>53</sup> Faraoni çoi të dërguar nëpër qytete, duke shpallur: <sup>54</sup> 'Këta njerëz janë bandë e dobët – <sup>55</sup> na kanë tërbuar – <sup>56</sup> dhe ne jemi ushtri e madhe, në gjendje gatishmërie.' <sup>57</sup> Kështu u bë që Ne i bëmë t'i lënë kopshtet e tyre dhe burimet e tyre të ujit, <sup>58</sup> thesaret e tyre dhe vend-banimet e tyre fisnike – <sup>59</sup> u dhamë gjëra [të tilla më vonë]<sup>b</sup> Fëmijëve të Izraelit. <sup>26:60</sup> Faraoni dhe populli i tij i ndoqën në lindje të diellit, <sup>61</sup> dhe posa dy palët erdhën brenda pamjes së njëra-tjetrës, ndjekësit e Musait thanë: 'Gjithsesi do të na zënë.' <sup>62</sup> Musai tha: 'Jo, Zoti im është me mua: Ai do të më udhëzojë', <sup>63</sup> dhe Ne i shpallëm Musait: 'Godite detin me shkopin tënd.' Ai u nda – secila anë si mal i fuqishëm – <sup>64</sup> dhe Ne i sollëm të tjerët në atë vend: <sup>65</sup> e shpëtuan Musain dhe të gjithë shoqëruarit e tij, <sup>66</sup> dhe i përmbytëm të tjerët. <sup>67</sup> Vërtet ka shenjë në këtë, megjithëse shumica nga ta nuk besojnë: <sup>68</sup> veç Zoti yt është I Gjithë-Fuqishmi, Mëshirëploti.

<sup>69</sup> Tregojua rrëfimin e Ibrahimit, <sup>26:70</sup> kur e pyeti babanë e tij dhe popullin e tij: 'Çka adhuronit?' <sup>71</sup> Ata thanë: 'I adhurojmë idhujt dhe vazhdimisht u bindemi

---

<sup>a</sup> Shih shënimin për 5:33: Dora e majtë dhe shputa e djathtë apo e kundërta.

<sup>b</sup> Krahaso me 7:137



dëshirave të tyre.’<sup>72</sup> Ai pyeti: ‘Si ju dëgjojnë kur i thirrni?’<sup>73</sup> A ju ndihmojnë apo ju dëmtojnë?’<sup>74</sup> Ata u përgjigjën: ‘Jo, por kështu i kemi parë etërit tanë duke bërë.’<sup>75</sup> Ibrahim i tha: ‘Ata idhuj që i keni adhuruar,<sup>76</sup> ju dhe para-ardhësit tuaj,<sup>77</sup> janë armiq të mi; e jo Zoti i Botëve,<sup>78</sup> që më krijoi. Është Ai që më udhëzon;<sup>79</sup> Ai që më jep ushqim dhe pije;<sup>26:80</sup> Ai që më shëron kur jam i sëmurë;<sup>81</sup> Ai që do të më bëjë të vdes dhe pastaj do të më japë jetë përsëri;<sup>82</sup> dhe Ai që, shpresoj, do të m’i falë gabimet e mi në Ditën e Gjykimit.<sup>83</sup> Zoti im, më jep urti; më bashko me të ndershmit;<sup>84</sup> më jep emër të mirë ndër brezat e ardhshëm;<sup>85</sup> më bëj nga ata që u jepet Kopshti i Lumturisë –<sup>86</sup> fale babanë tim, se është nga ata që kanë devijuar –<sup>87</sup> dhe mos më turpëro në Ditën kur të gjithë njerëzit ringjallen:<sup>88</sup> në Ditën kur as pasuria as fëmijët s’mund të ndihmojnë,<sup>89</sup> kur i vetmi që do të shpëtohet është ai që vjen para **Allahut** me zemër të përkushtuar Atij.’

<sup>26:90</sup> Kur t’u afrohet Kopshti të ndershmëve<sup>91</sup> dhe Zjarri të vendoset në pamje të plotë të të keqduhëzuarve,<sup>92</sup> do t’u thuhet: ‘Ku janë ata që i adhuruat<sup>93</sup> përkrah **Allahut**? A mund t’ju ndihmojnë tani, apo madje ta ndihmojnë veten?’<sup>94</sup> dhe pastaj të gjithë do të hidhen brenda në Ferr, bashkë me ata që i keqduhëzuan,<sup>95</sup> dhe të gjithë përkrahësit e Iblisit.<sup>a</sup><sup>96</sup> Aty do t’u thonë zotave të tyre, gjersa grinden mes vete: <sup>97</sup> ‘Ishim qartas të keqduhëzuar<sup>98</sup> kur ju bëmë të barabartë me Zotin e Botëve.<sup>99</sup> Ishin keqbërësit ata që na devijuan,<sup>26:100</sup> dhe tani nuk kemi kurrfarë ndërmjetësi<sup>101</sup> dhe kurrfarë miku të vërtetë.<sup>102</sup> Ah sikur të mund t’i jetonim jetët tona përsëri, do të ishim besimtarë të vërtetë!’<sup>103</sup> Vërtet ka shenjë në këtë, megjithëse shumica nga ta nuk besojnë:<sup>104</sup> veç Zoti yt është I Gjithë-Fuqishmi, Mëshirëploti.

<sup>105</sup> Edhe populli i Nuhut i quajti gënjeshtarë të dërguarit.<sup>106</sup> Vëllai i tyre Nuhu u tha: ‘A s’do të jeni të vëmendshëm për **Allahun**?<sup>107</sup> Unë jam i dërguar i besuar i çuar te ju:<sup>108</sup> jini të vëmendshëm për **Allahun** dhe bindmuni.<sup>109</sup> Nuk kërkoj kurrfarë shpërblimi nga ju, se shpërblimi im i vetëm është me Zotin e Botëve:<sup>26:110</sup> jini të vëmendshëm për **Allahun** dhe bindmuni.’<sup>111</sup> Ata u përgjigjën: ‘Pse duhet të të besojmë kur ty të ndjek lloji më i keq i njerëzve?’<sup>112</sup> Ai tha: ‘Çfarë njohurie kam për atë që e kanë bërë ata dikur?’<sup>113</sup> Është çështje veç e Zotit tim që t’u kërkojë llogari – veç po ta shihnit –<sup>114</sup> nuk do t’i dëboj besimtarët.<sup>115</sup> Këtu jam veç për t’u dhënë njerëzve paralajmërim të qartë.’<sup>116</sup> Kështu, ata thanë: ‘Nuh, nëse nuk e ndal këtë, do të gurëzohesh.’<sup>117</sup> Ai tha: ‘Zoti im, populli im më kanë refuzuar,<sup>118</sup> pra gjyko vendosmërisht ndërmjet meje e tyre dhe më shpëto mua dhe ndjekësit e mi besimtarë.’<sup>119</sup> Kështu Ne e shpëtuam atë dhe ndjekësit e tij në anijen e ngarkuar plotësisht<sup>26:120</sup> dhe i fundosëm të tjerët.<sup>121</sup> Vërtet ka shenjë në këtë, megjithëse shumica nga ta nuk besojnë:<sup>122</sup> veç Zoti yt është I Gjithë-Fuqishmi, Mëshirëploti.

---

<sup>a</sup> Shih shënimin për 37:173: Në arabishten klasike *xhund* domethënë ‘përkrahësit’, jo vetëm ‘ushtritë’.

<sup>123</sup> Edhe populli i Adit i quajtën gënjeshtarë të dërguarit. <sup>124</sup> Vëllai i tyre Hudi u tha: ‘A nuk do të jeni të vetëdijsëm për **Allahun**? <sup>125</sup> Unë jam i dërguar besnik i çuar te ju: <sup>126</sup> jini të vetëdijsëm për **Allahun** dhe bindmuni. <sup>127</sup> Nuk kërkoj kurrfarë shpërblimi nga ju, se shpërblimi im i vetëm është me Zotin e Botëve. <sup>128</sup> Si mund të jeni kaq mendjelehtë sa që ngritni monumente në çdo vend të lartë? <sup>129</sup> A i ndërtoni kalatë se shpresoni të jeni të pavdekshëm? <sup>26:130</sup> Pse veproni si tiranë kurdo që e sulmoni dikë? <sup>131</sup> Jini të vetëdijsëm për **Allahun** dhe bindmuni; <sup>132</sup> jini të vetëdijsëm për Atë që ju ka furnizuar me gjithçka që dini – <sup>133</sup> Ai ju ka dhënë bagëti, bij, <sup>134</sup> kopshte, burime të ujit – <sup>135</sup> se vërtet druaj se do t’ju kaplojë tortura e një dite të pikëllueshme.’ <sup>136</sup> Ata u përgjigjën: ‘S’ka rëndësi për neve a na paralajmëron a jo, <sup>137</sup> se ne veç bëjmë siç bënin para-ardhësit tanë: <sup>138</sup> nuk do të ndëshkohemi.’ <sup>139</sup> E shpallën si gënjeshtar dhe prandaj Ne i shkatërruam. Vërtet ka shenjë në këtë, megjithëse shumica nga ta nuk besojnë: <sup>26:140</sup> veç Zoti yt është I Gjithë-Fuqishmi, Mëshirëploti.

<sup>141</sup> Edhe populli i Themudit i quajtën gënjeshtarë të dërguarit. <sup>142</sup> Vëllai i tyre Salihu u tha: ‘A nuk do të jeni të vëmendshëm për **Allahun**? <sup>143</sup> Unë jam i dërguar besnik për ju: <sup>144</sup> jini të vetëdijsëm për **Allahun** dhe bindmuni. <sup>145</sup> Nuk kërkoj kurrfarë shpërblimi nga ju, se shpërblimi im i vetëm është me Zotin e Botëve. <sup>146</sup> [A po mendoni se] do të mbeteni të sigurt përgjithmonë në atë që e keni këtu – <sup>147</sup> kopshte, burime të ujit, <sup>148</sup> fusha, palma të mbushura me fruta – <sup>149</sup> duke i gdhendur shtëpitë tuaja të bukura nga malet? <sup>26:150</sup> Jini të vetëdijsëm për **Allahun** dhe bindmuni: <sup>151</sup> mos iu bindni atyre të cilëve u është dhënë me tepri <sup>152</sup> dhe që përhapin korrupsion në tokë, në vend se ta bëjnë atë që është e drejtë.’ <sup>153</sup> Ata thanë: ‘Ti je i pushtuar shpirtërisht! <sup>154</sup> Nuk je asgjë pos njeri si ne. Na e trego një shenjë, nëse po e tregon të vërtetën.’ <sup>155</sup> Ai tha: ‘Ja një deve. Ajo duhet ta ketë radhën e saj për të pirë siç duhet ta keni edhe ju, secili në ditë të caktuar, <sup>156</sup> prandaj mos e dëmtoni përndryshe do t’ju bjerë ndëshkimi i një dite të tmerrshme.’ <sup>157</sup> Por ata e gjymtuan. Në mëngjes kishin arsye për t’u bërë pishman: <sup>158</sup> mbi ta ra ndëshkimi. Vërtet ka shenjë në këtë, megjithëse shumica nga ta nuk do të besojnë: <sup>159</sup> veç Zoti yt është I Gjithë-Fuqishmi, Mëshirëploti.

<sup>26:160</sup> Edhe populli i Lutit i quajtën gënjeshtarë të dërguarit. <sup>161</sup> Vëllai i tyre Luti u tha: ‘A nuk do të jeni të vëmendshëm për **Allahun**? <sup>162</sup> Unë jam i dërguar besnik për ju: <sup>163</sup> jini të vetëdijsëm për **Allahun** dhe bindmuni. <sup>164</sup> Nuk kërkoj kurrfarë shpërblimi nga ju, se shpërblimi im i vetëm është me Zotin e Botëve. <sup>165</sup> A duhet, për dallim nga njerëzit [e tjerë], të keni epsh pas meshkujve <sup>166</sup> dhe t’i braktisni gratë që **Allahu** i krijoi për ju? Jeni duke i tejkaluar të gjithë kufijtë’, <sup>167</sup> por ata u përgjigjën: ‘Lut! Nëse nuk e ndal këtë, do të dëbohesh.’ <sup>168</sup> Prandaj ai tha: ‘Neveritem nga ajo që e bëni: <sup>169</sup> Zot, më shpëto mua dhe familjen time nga kjo që po e bëjnë.’ <sup>26:170</sup> Ne e shpëtuam atë dhe tërë familjen e tij, <sup>171</sup> përveç një gruaje të vjetër që qëndroi prapa, <sup>172</sup> pastaj i shkatërruam të tjerët <sup>173</sup> dhe e

derdhëm një shi të shkatërrimit mbi ta. Sa i tmerrshëm ishte ai shi për ata që ishin paralajmëruar! <sup>174</sup> Vërtet ka shenjë në këtë, megjithëse shumica nga ta nuk do të besojnë: <sup>175</sup> veç Zoti yt është I Gjithë-Fuqishmi, Mëshirëploti.

<sup>176</sup> Edhe banorët e pyllit i quajtën gënjeshtarë të dërguarit. <sup>177</sup> Shuajbi u tha: ‘A nuk do të jeni të vëmendshëm për **Allahun**? <sup>178</sup> Unë jam i dërguar besnik për ju: <sup>179</sup> jini të vetëdijshtëm për **Allahun** dhe bindmuni. <sup>26:180</sup> Nuk kërkoj kurrfarë shpërblimi nga ju, se shpërblimi im i vetëm është me Zotin e Botëve. <sup>181</sup> Jepni masë të plotë: mos u shitni të tjerëve më pak se masa. <sup>182</sup> Peshoni me peshore korrekte: <sup>183</sup> mos i privoni njerëzit nga ajo që është e tyre. Mos përhapni korrupsion në tokë. <sup>184</sup> Jini të vetëdijshtëm për **Allahun** që ju krijoi juve dhe brezat e shkuar’, <sup>185</sup> por ata u përgjigjën: ‘Ti je i pushtuar shpirtërisht! <sup>186</sup> Nuk je asgjë pos njeri si ne. Në fakt mendojmë se je gënjeshtar. <sup>187</sup> Bëj të bien copa të qiellit mbi ne, nëse po e thua të vërtetën.’ <sup>188</sup> Ai tha: ‘Zoti im e di më së miri atë që e bëni.’ <sup>189</sup> Ata e quajtën gënjeshtar dhe kështu u erdhi tortura e Ditës së Hijes – ishte torturë e një dite të tmerrshme. <sup>26:190</sup> Vërtet ka shenjë në këtë, megjithëse shumica nga ta nuk do të besojnë: <sup>191</sup> veç Zoti yt është I Gjithë-Fuqishmi, Mëshirëploti.

<sup>192</sup> Vërtet ky Kuran është zbritur nga Zoti i Botëve: <sup>193</sup> Shpirti i Besueshëm<sup>a</sup> ta zbriti <sup>194</sup> në zemrën tënde [Profet], që të mund të sjellësh paralajmërim <sup>195</sup> në gjuhë të qartë arabe. <sup>196</sup> Kjo ishte parathënë në shkrimet e shenjta të feve të mëparshme. <sup>197</sup> A nuk është provë e mjaftueshme për ta se njerëzit e ditur të Fëmijëve të Izraelit e kanë njohur atë? <sup>198</sup> Po t’ia kishim zbritur dikujt që nuk do të ishte arab,<sup>b</sup> <sup>199</sup> dhe po t’ua kishte recituar, prapë nuk do të kishin besuar në të. <sup>26:200</sup> Prandaj Ne e bëjmë të kalojë drejtpërdrejt nëpër zemrat e fajtorëve: <sup>201</sup> nuk do të besojnë në të deri kur ta shohin torturën pikëlluese, <sup>202</sup> që do t’i godasë befas kur nuk janë duke e pritur, <sup>203</sup> dhe pastaj do të thonë: ‘A mund të kemi ende kohë?’ <sup>204</sup> Si mund të kërkojnë që ndëshkimi Ynë t’u sillet më herët? <sup>205</sup> Mendo, po t’i linim ta shijojnë këtë jetë për ca vite, <sup>206</sup> dhe pastaj t’u vinte tortura e premtuar, <sup>207</sup> çfarë dobie do të kishte për ta kënaqësia e kaluar? <sup>208</sup> Kurrë nuk e kemi shkatërruar një qytet pa i zbritur të dërguarit për ta paralajmëruar, <sup>209</sup> si përkujtues nga Ne: kurrë nuk jemi të padrejtë.

<sup>26:210</sup> Nuk ishin xhindet<sup>c</sup> ata që e zbritën këtë Kuran: <sup>211</sup> nuk është as në interesin as në pushtetin e tyre, <sup>212</sup> vërtet ata janë të penguar për të mos e dëgjuar [teksta zbritet]. <sup>213</sup> Pra [Profet] mos thirr ndonjë zot përveç **Allahut**, përndryshe do të pësosh ndëshkim. <sup>214</sup> Paralajmëroji më të afërmit e tu <sup>215</sup> dhe ji butësisht modest ndaj besimtarëve që të ndjekin. <sup>216</sup> Nëse nuk të binden, thuaj: ‘Nuk mbaj

<sup>a</sup> Përgjithësisht kuptohet se domethënë Engjëlli Xhebrail (Gabriel).

<sup>b</sup> Kjo aludon në refuzimin e shumë arabëve mekasë për të besuar se shpallja mund t’i vijë një njeriu nga mesi i tyre.

<sup>c</sup> Krahaso me: 72:8-9; 37:7-10

kurrfarë përgjegjësie për veprimet tuaja.’<sup>217</sup> Kije besimin tënd në Të Gjithë-Fuqishmin, Mëshirëplotin,<sup>218</sup> që të sheh kur ngritesh në këmbë [për t’u falur]<sup>219</sup> dhe i sheh lëvizjet e tua ndër adhuruesit: <sup>26:220</sup> Ai është Gjithë-Dëgjuesi, I Gjithë-Dijshmi.<sup>221</sup> A t’ju tregoj se kujt i zbresin xhindet? <sup>222</sup> I zbresin secilit mëkatar gënjeshtar <sup>223</sup> që ua jep një vesh me lehtësi dhe shumica nga ta janë gënjeshtarë: <sup>224</sup> veç ata që janë të humbur në gabim i ndjekin poetët.<sup>a</sup> <sup>225</sup> A nuk e sheh se si enden pa objektiv në çdo luginë; <sup>226</sup> si e thonë atë që nuk e bëjnë? <sup>b</sup> <sup>227</sup> Nuk janë të tillë ata [poetë] që besojnë, bëjnë vepra të mira, e kujtojnë **Allahun** shpesh dhe mbrohen pasi t’u bëhet padrejtësi. Keqbërësit do ta zbulojnë se çkahit do t’i kthehen.

---

<sup>a</sup> Mekasit e hodhën poshtë Kuranin si poezi. Pasi Profeti u shpërngul në Medinë, mekasit porositën poetë me pagesë për t’i satirizuar myslimanët dhe disa poetë myslimanë kundër-sulmuan.

<sup>b</sup> Poetët mburreshin dhe ekzagjeronin në poezitë-lavdëruese dhe satirat e tyre.

**Përshkrimi para kaptinës 26 nga Abdel Haleem:**

*Sure mekase që e ka marrë emrin nga referimi i poetëve në vargun 224. Ajo flet për mosbesimtarët që e përçmojnë Kurandin dhe jep shembuj të fuqisë dhe mirësisë së **Allahut** në natyrë. I tregon disa rrëfime të profetëve të mëhershëm, reagimet e popujve të tyre dhe ndëshkimet që iu shkaktuan, duke u përmbyllur me konfirmimin e origjinës hyjnore të Kuranit. Nuk është diçka e zbritur nga xhindet as nuk është poezi.*

## 27: Milingonat (EN-NEML)

Në emrin e **Allahut**, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës

### <sup>1</sup> *Ta Sin*

Këto janë vargjet e Kuranit – shkrim i shenjtë që i qartëson gjërat; <sup>2</sup> udhëzues dhe lajm i gëzueshëm për besimtarët <sup>3</sup> që falen rregullisht, e paguajnë lëmshën e përcaktuar dhe besojnë fort në jetën tjetër. <sup>4</sup> Sa për ata që nuk besojnë në jetën tjetër, Ne ua kemi bërë veprat e tyre t’u duken tërheqëse, kështu që enden verbërisht: <sup>5</sup> janë ata që do ta kenë vuajtjen më të keqe dhe do të jenë ata që do të humbin më së shumti në jetën tjetër. <sup>6</sup> Ty [Profet] të vjen Kurani nga Ai që është i gjithë-urtë, i gjithë-ditur.

<sup>7</sup> Musai i tha familjes së tij: ‘E kam parë një zjarr. Do t’ju sjelli lajme të mira nga atje apo një copë dru të ndezur për ju që të ngrohni.’ <sup>8</sup> Kur arriti te zjarri, një zë thirri: ‘I bekuar është personi afër këtij zjarri<sup>a</sup> dhe ata përreth tij,<sup>b</sup> qoftë i lartësuar **Allahu**, Zoti i Botëve. <sup>9</sup> Musa, Unë jam **Allahu**, I Fuqishmi, I Urti. <sup>27:10</sup> Hidhe shkopin tënd’, por kur ai e pa duke lëvizur si gjarpër, u kthye dhe iku. ‘Musa, mos ki frikë! Të dërguarit nuk kanë nevojë të kenë frikë në prezencën Time, <sup>11</sup> Unë jam vërtet më falësi dhe mëshirëploti ndaj atyre që bëjnë keq,<sup>c</sup> dhe pastaj e zëvendësojnë të keqen e tyre me të mirë. <sup>12</sup> Fute dorën tënde brenda mantelit tënd dhe ajo do të dalë e bardhë, por e padëmtuar. Këto janë ndër nëntë shenjat që do t’ia tregosh Faraonit dhe popullit të tij; ata kanë shkuar vërtet tepër larg.’

<sup>13</sup> Por kur u erdhën shenjat tona përndritëse, thanë: ‘Kjo është qartë [veç] magji!’ <sup>14</sup> I mohuan ato, në ligësinë e tyre dhe krenarinë e tyre, edhe pse shpirtrat e tyre i pranuan si të vërteta. Shih si ndërrojnë jetë ata që përhapin korrupsion!

<sup>15</sup> Ne u dhamë njohuri Daudit dhe Sulejmanit dhe të dytë thanë: ‘Lâvdi qoftë për **Allahun**, që na ka favorizuar mbi shumë nga shërbyesit E Tij besimtarë.’ <sup>16</sup> Sulejmani e pasoi Daudin. Tha: ‘Njerëz, neve na është mësuar gjuha e shpezëve dhe na është dhënë një hise nga gjithçka: ky është qartësisht favor i madh.’ <sup>17</sup> Ushtritë e Sulejmanit me xhinde, njerëz dhe shpezë u rreshtuan në radhë të renditura para tij <sup>18</sup> dhe kur arritën te Lugina e Milingonave, një milingonë tha: ‘Milingona! Shkoni në shtëpitë tuaja, që Sulejmani dhe ushtritë e tij të mos ju dërrmojnë pa dashje.’ <sup>19</sup> Sulejmani buzëqeshi fort me fjalët e saj dhe tha: ‘Zot, më frymëzo të jem falënderues për bekimet që m’i ke dhuruar mua dhe prindërve të

---

<sup>a</sup> Musai ose **Allahu**. Fjalë për fjalë ‘në këtë zjarr’ (*fi al-nari*). Zamakhshari e interpreton *fi* si ‘afër’, ndërsa Qatada dhe Zajjaj e kuptojnë *nar* ‘zjarr’ se domethënë *nur* ‘dritë’ (Razi).

<sup>b</sup> Engjëjt.

<sup>c</sup> Krahaso me 28:15. Ky është aludim për një njeri të cilin Musai e vrau në Egjipt.

mi dhe të bëj vepra të mira që të kënaqin Ty; më prano përmes mirësisë Sate në radhët e shërbyesve të Tu të ndershëm.’

<sup>27:20</sup> Sulejmani i inspektoi shpezët dhe tha: ‘Pse nuk po e shoh pupëzën? A po mungon?’ <sup>21</sup> Do ta ndëshkoj ashpër apo edhe ta vras, nëse nuk më sjell arsyetim bindës për mungesën e saj.’ <sup>22</sup> Por pupëza nuk qëndroi larg për shumë kohë – erdhi dhe tha: ‘Kam mësuar diçka që nuk e dije: vij te ti nga Sheba me lajme të sigurta.’ <sup>23</sup> E gjeta një grua që sundon mbi njerëzit, që i është dhënë një hise nga gjithçka – ajo ka fron madhështor – <sup>24</sup> [por] zbulova se ajo dhe populli i saj e adhuronin diellin në vend të **Allahut**. Satani ua ka bërë veprat e tyre tërheqëse për ta dhe i ka devijuar nga rruga e duhur: nuk mund ta gjejnë rrugën e duhur. <sup>25</sup> A nuk do të duhej ta adhuronin **Allahun**, që e nxjerr atë që është e fshehur në qiej dhe në tokë dhe që e di edhe çka fshihni ju njerëz edhe çka deklaroni? <sup>26</sup> Ai është **Allahu**, nuk ka zot pos Tij, Zoti i fronit të fuqishëm.’ <sup>27</sup> Sulejmani tha: ‘Do ta shohim se a po e tregon të vërtetën a po gënjen.’ <sup>28</sup> Merre këtë letër timen dhe çojua atyre, pastaj tërhiq dhe shih se çfarë përgjigje po kthejnë.’

<sup>29</sup> Mbretëresha e Shebës tha: ‘Këshilltarë, më është dorëzuar një letër dashamirëse. <sup>27:30</sup> Është nga Sulejmani dhe thotë: “Në emrin e **Allahut**, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës, <sup>31</sup> mos e vëni veten mbi mua dhe ejani tek unë në nënshtrim ndaj **Allahut**.”’ <sup>32</sup> Tha: ‘Këshilltarë, ma jepni këshillën tuaj në çështjen me të cilën përballim tani: për çështjet gjithmonë vendosi veç në praninë tuaj.’ <sup>33</sup> Ata u përgjigjën: ‘Ne posedojmë forcë dhe fuqi të madhe në luftë, por ti je komanduesja, pra shqyrto se çfarë urdhra të na japësh.’ <sup>34</sup> Ajo tha: ‘Sa herë që mbretërit shkojnë në një qytet, e shkatërrojnë dhe ia poshtërojnë udhëheqësit – këtë e bëjnë – <sup>35</sup> por unë do t’ua dërgoj një dhuratë, e pastaj ta shoh se çfarë përgjigje do të më sjellin të dërguarit e mi.’

<sup>36</sup> Kur te Sulejmani erdhi i dërguari i saj, Sulejmani tha: ‘Çka?! Po më ofron pasuri? Ajo që ma ka dhënë **Allahu** mua është më e mirë se sa ajo që jua ka dhënë juve, megjithëse kënaqeni me këtë dhuratë tuajën. <sup>37</sup> Kthehu te populli yt: sigurisht që do t’iu vijmë me forca të pazistueshme dhe t’i dëbojmë, të turpëruar e të përlur, nga toka e tyre.’ <sup>38</sup> Pastaj tha: ‘Këshilltarë, cili nga ju mund të ma sjellë fronin e saj para se të vijmë tek unë në nënshtrim?’ <sup>39</sup> Një xhind i fuqishëm e dinak u përgjigj: ‘Unë do të ta sjell madje para se të mund të ngrihesh nga vendi yt. Jam mjaft i fortë e i besueshëm’, <sup>27:40</sup> por një nga ta që kishte ca njohuri për Shkrimin e Shenjtë tha: ‘Unë do të ta sjell sa hap e mbyll sytë.’

Kur Sulejmani e pa t’i vihej përpara, tha: ‘Ky është favor nga Zoti im, për të më provuar se a jam mirënjohës apo jo: nëse dikush është mirënjohës - është për të mirën e tij, nëse dikush është mosmirënjohës atëherë Zoti im është i vetëmjaftueshëm dhe më bujari.’ <sup>41</sup> Pastaj tha: ‘Maskojani fronin asaj dhe ta shohim a

do ta njohë a jo.’<sup>42</sup> Kur ajo arriti, e pyetën: ‘A është ky fronti yt?’ Ajo u përgjigj: ‘Po duket si ai.’ [Sulejmani tha:] ‘Neve na është dhënë njohuri para saj dhe iu përkushtuam **Allahut**;’<sup>43</sup> ajo ishte penguar nga ajo [gjëja] që e adhuronte në vend të **Allahut**, se vinte nga një popull mosbesimtar.’<sup>44</sup> Pastaj i thanë asaj: ‘Hyr në sallë’, por kur ajo e pa atë, mendoi se ishte pishinë e thellë me ujë dhe i zhveshi këmbët. Sulejmani shpjegoi: ‘Është veç sallë e shtruar me xham’ dhe ajo tha: ‘Zoti im, e kam dëmtuar veten: i përkushtohem – me Sulejmanin – **Allahut**, Zotit të Botëve.’

<sup>45</sup> Popullit të Themudit Ne ia çuam vëllain e tyre, Salihun, duke thënë: ‘Adhurojeni veç **Allahun**’, por ata u ndanë në dy fraksione rivale.<sup>46</sup> Salihu tha: ‘Populli im, pse nxitoni ta sillni [më herët] atë që është e keqe e jo e mirë? Pse nuk e kërkon faljen e **Allahut**, që të mund t’ju jepet mëshirë?’<sup>47</sup> Ata thanë: ‘Ne ju shohim si ndjekës të një oguri të lig.’ Ai u përgjigj: ‘**Allahu** do të vendosë për çfarëdo oguri që mund ta shihni: ju njerëz jeni duke u sprovuar.’<sup>48</sup> Ishin nëntë njerëz në qytet që përhapnin korrupsion në vend pa u përmirësuar.<sup>49</sup> Ata thanë: ‘Betohemi për **Allahun**: do ta sulmojmë këtë njeri dhe familjen e tij gjatë natës, pastaj do t’i themi të afërmit të tij: “Nuk e kemi parë shkatërrimin e shtëpisë së tij. Po e tregojmë të vërtetën.”’<sup>27:50</sup> Kështu e hartuan planin e tyre të lig, por edhe Ne e bëmë një plan për të cilin ishin të painformuar.<sup>51</sup> Shih si përfundoi planifikimi i tyre i fshehtë: i shkatërruam plotësisht, bashkë me të gjithë njerëzit e tyre.<sup>52</sup> Si rezultat i veprave të tyre të liga, shtëpitë e tyre janë rrënoja të shkreta – vërtet ka shenjë në këtë për ata që dinë –<sup>53</sup> por i shpëtuam ata që besonin dhe ishin të vetëdijshëm për **Allahun**.

<sup>54</sup> Ne po ashtu e çuam Lutin te populli i tij. Ai u tha: ‘Si mund ta bëni këtë shkelje me sytë hapur gjerë e gjatë?’<sup>55</sup> Si mund të epshoni pas meshkujve në vend të femrave? Sa budallenj që jeni!’<sup>56</sup> Përgjigjja e vetme që e dha populli i tij ishte: ‘Dëboni ndjekësit e Lutit nga qyteti juaj! Këta njerëz duan të mbeten të dëlirë!’<sup>57</sup> e shpëtuam atë dhe familjen e tij – përveç gruas së tij: Ne bëmë të rrijë prapa –<sup>58</sup> dhe e zbritëm shiun mbi ta. Sa i tmerrshëm ishte ai shi për ata që ishin paralajmëruar!

<sup>59</sup> Thuaj [Profet]: ‘Lâvdi qoftë për **Allahun** dhe paqja mbi shërbyesit që i ka zgjedhur<sup>a</sup>. Kush është më i mirë: **Allahu** apo ata që përpilojnë partnerë me Të?’<sup>27:60</sup> Kush i krijoi qiejt dhe tokën? Kush e zbret ujin nga qielli për ju – me të cilin Ne bëjmë të rriten kopshte të kënaqësisë: ju nuk keni fuqi t’i bëni pemët të rriten në to – një zot tjetër krahas **Allahut**? Jo! Por ata janë njerëz që marrin të tjerë si të barabartë me **Allahun**.<sup>61</sup> Kush e bëri tokën vend stabil për jetesë? Kush i bëri lumenjtë të rrjedhin nëpër të? Kush vuri male të palëvizshme në të dhe krijoi pengesë ndërmjet ujit të freskët dhe të kripur? Një zot tjetër krahas **Allahut**? Jo!

---

<sup>a</sup> Si të dërguar, shih p.sh. 3:33



Por shumica nga ta nuk dinë. <sup>62</sup> Kush i përgjigjet të shqetësuarve kur i thirrin Atij? Kush ua heq vuajtjen? Kush ju bën trashëgues në tokë? Një zot tjetër krahas **Allahut**? Sa pak vëreni! <sup>63</sup> Kush ju udhëzon nëpër errësirën në tokë dhe në det? Kush i dërgon erërat si lajmëtarë të lajmeve të mira para mëshirës Së Tij? <sup>a</sup> Një zot tjetër krahas **Allahut**? **Allahu** është larg mbi partnerët që ia vënë përkrah! <sup>64</sup> Kush e krijon jetën dhe e riprodhon? Kush ju jep furnizim nga qiejt dhe toka? Një zot tjetër krahas **Allahut**? Thuaj: ‘Atëherë m’i tregoni provat tuaja, nëse kjo që po e thoni është e vërtetë.’

<sup>65</sup> Thuaj: ‘Askush në qiej a në tokë nuk e di të padukshmen përveç **Allahut**.’ Ata nuk e dinë se kur do të ringjallen nga të vdekurit: <sup>66</sup> dituria e tyre nuk mund ta kuptojë Të Përtejmen; janë në dyshim për të; janë të verbër ndaj saj. <sup>67</sup> Kështu mosbesimtarët thonë: ‘Çka?! Pasi të jemi bërë pluhur ne dhe para-ardhësit tanë, do të kthehemi prapë në jetë?’ <sup>68</sup> Kemi dëgjuar premtime të tilla edhe më parë si edhe para-ardhësit tanë. Këto janë veç fabula të lashta.’ <sup>69</sup> [Profet,] thuaj: ‘Udhëtoni nëpër tokë dhe shihni se si përfunduan keqbërësit.’ <sup>27:70</sup> [Profet,] mos u pikëllo për ta; mos të të shqetësojnë planet e tyre të fshehta. <sup>71</sup> Thonë edhe: ‘Kur do të përmbushet ky premtim nëse kjo që po e thoni është e vërtetë?’ <sup>72</sup> Thuaj: ‘Ndoshta ca nga ato që po kërkonit të shpejtohen janë pranë dorës.’ <sup>73</sup> Zoti yt është bujar për njerëzit, megjithëse shumica nga ta janë mosmirënjohës. <sup>74</sup> Ai di gjithçka që fshehin zemrat e tyre dhe gjithçka që shfaqin: <sup>75</sup> nuk ka asgjë të fshehur në qiej a në tokë që nuk është në një Regjistër të qartë.

<sup>76</sup> Vërtet, ky Kuran ua shpjegon Fëmijëve të Izraelit pjesën dërmuese të asaj për të cilën dallojnë, <sup>77</sup> dhe është udhëzim e mirësi për ata që besojnë. <sup>78</sup> Vërtet, Zoti juaj do të gjykojë mes tyre me urtinë E Tij – Ai është I Gjithë-Fuqishmi, I Gjithë-Dijshmi – <sup>79</sup> pra [Profet], kije besimin tënd në **Allahun** – je në rrugën e të vërtetës së qartë. <sup>27:80</sup> Nuk mund ta bësh të vdekurin të dëgjojë, nuk mund ta bësh të shurdhrin t’ia vërë veshin thirrjes sate kur i kthejnë shpinat dhe largohen, <sup>81</sup> nuk mund t’i udhëzosh të verbrit t’i largohen gabimit të tyre: nuk mund ta bësh askë të dëgjojë pos atyre që besojnë në shenjat Tona dhe [na] nënshtrohen. <sup>82</sup> Kur të jepet aktgjykimi kundër tyre, do ta nxjerrim një krijesë nga toka, që do t’u tregojë se njerëzit nuk kishin besim në shpalljet Tona. <sup>83</sup> Do të vijë Dita kur mbledhim nga çdo komunitet një turmë të atyre që nuk besuan në shenjat Tona dhe do të udhëhiqen në grupe të ndara <sup>84</sup> deri kur – atëherë kur të vijnë para Tij – Ai do të thotë: ‘A i mohuat mesazhet e mija as pa ua kuptuar plotësisht rëndësinë? Apo çka po bënit?’ <sup>85</sup> Aktgjykimi do të jepet kundër tyre për shkak të keqbërjes së tyre: ata nuk do të flasin.

<sup>86</sup> A nuk e panë se Ne ua dhamë natën për pushim dhe ditën për dritë? Vërtet ka shenja në këtë për ata që besojnë. <sup>87</sup> Në Ditën kur dëgjohet Trumpeta,

---

<sup>a</sup> dmth. shiut.

gjithkush në qiej dhe në tokë do të tmerrohet – përveç atyre që do **Allahu** – dhe të gjithë do të vijnë tek Ai në përrulësi të plotë. <sup>88</sup> Do t'i shihni malet dhe do të mendoni se janë të fiksuara mirë, por do të pluskojnë larg si re: kjo është vepra mbresëlënëse e **Allahut I Cili** i ka përsosur të gjitha gjërat. Ai është plotësisht i informuar për atë që e bëni: <sup>89</sup> kushdo që vjen me vepër të mirë do të shpërblehet me diçka më të mirë dhe do të jetë i sigurt nga tmerret e asaj Dite, <sup>27:90</sup> por kushdo që vjen me vepra të këqija do të hidhet me fytyrë përmbys në Zjarr. 'A jeni shpërblyer për ndonjë gjë përveç për atë që e keni bërë?' <sup>91</sup> [Thuaj, Profet:] 'Ajo që jam urdhëruar të bëj është t'i shërbej Mbajtësit Furnizues të këtij qyteti,<sup>a</sup> të cilin Ai e ka bërë të paprekshëm. Gjithçka i përket Atij; jam urdhëruar të jem një nga ata që i përkushtohen Atij; <sup>92</sup> jam urdhëruar ta recitoj Kurandin.' Kushdo që zgjedh ta ndjekë rrugën e duhur e bën këtë për të mirën e tij. Thuaj kujt do që devijon nga ajo: 'Këtu jam veç për të paralajmëruar.' <sup>93</sup> Thuaj: 'Lâvdi i përket **Allahut**: Ai do t'jua tregojë shenjat E Tij ashtu që do t'i njihni.' Zoti juaj nuk është kurrë i pavëmendshëm ndaj asaj që e bëni të gjithë ju.

---

<sup>a</sup> Mekës.

**Përshkrimi para kaptinës 27 nga Abdel Haleem:**

*Sure mekase që e merr titullin nga milingonat e përmendura në rrëfimin e Sulejmanit (vargjet 18–19). Edhe hapet edhe mbyllet duke e përshkruar Kuranin si lajm i gëzueshëm për besimtarët dhe paralajmërim për të tjerët. Jep rrëfime të profetëve të shkuar dhe për shkatërrimin e komuniteteve që nuk besuan në ta. Jepen ilustrime për natyrën e fuqisë së **Allahut**, të kontrastuar me mungesën e plotë të fuqisë së ‘partnerëve’ që ata i adhurojnë përkrah Tij dhe jepen përshkrime të Ditës së Gjykimit për ata që e mohojnë atë.*

## 28: Rrëfimi (EL-KASAS)

Në emrin e **Allahut**, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës

<sup>1</sup> *Ta Sin Mim*

<sup>2</sup> Këto janë vargjet e Shkrimit të Shenjtë që i qartësojnë gjërat: <sup>3</sup> Ne ta rrëfejme [Profet] një pjesë të rrëfimit të Musait dhe Faraonit, duke e paraqitur të vërtetën për njerëzit që besojnë. <sup>4</sup> Faraoni e bëri veten të lartë dhe të fuqishëm në vend dhe e ndau popullin në grupe të ndryshme: një grup e shtypi, duke ua therur djemtë dhe duke ua kursyer gratë – ai ishte një nga ata që përhapën korrupsion – <sup>5</sup> por Ne deshëm t'i favorizojmë ata që ishin të shtypur në vend, t'i bëjmë udhëheqës, asi që mbijetojnë, <sup>6</sup> t'i sistemojmë në vend dhe përmes tyre t'ia tregojmë Faraonit, Hamanit dhe ushtrive të tyre pikërisht gjënë së cilës ia kishin frikën.

<sup>7</sup> Ne e frymëzuam nënën e Musait, duke thënë: 'Jepi gjë dhe pastaj, kur të kesh frikë për sigurinë e tij, vendose në lumë: mos ki frikë dhe mos u pikëllo, se do të ta kthejmë dhe do ta bëjmë të dërguar.' <sup>8</sup> Familja e Faraonit e morën atë – për t'u bërë më vonë armik dhe burim i hidhërimit për ta: Faraoni, Hamani dhe ushtritë e tyre ishin keqbërës – <sup>9</sup> dhe gruaja e Faraonit tha: 'Ja një gëzim për ta parë, për ty dhe për mua! Mos e vrisni: mund të jetë i dobishëm për ne, apo mund ta birësojmë.' Nuk e kuptuan çka po bënin. <sup>28:10</sup> Ditën tjetër, nëna e Musait ndjeu boshllëk në zemër – po të mos e forconim për ta bërë një nga ato që besojnë, do të kishte zbuluar gjithçka për të – <sup>11</sup> dhe i tha motrës së tij: 'Përcille kah po shkon.' Kështu ajo e vëzhgonte nga larg, pa e ditur ata. <sup>12</sup> Ne patëm paracaktuar që ai do të refuzonte të ushqehet nga gratë gjë-dhënëse. Motra e tij iu afrua atyre dhe tha: 'A doni t'juaj gjej një familje që do të mund t'juaj rriste dhe të kujdesej mirë për të?' <sup>13</sup> Kështu e rikthyem te nëna e tij, që ajo të mund të ngushëllohej, të mos pikëllohej dhe ta dinte se premtimi i **Allahut** është i vërtetë, megjithëse shumica nga ta nuk e dinë.

<sup>14</sup> Kur Musai e arriti pjekurinë dhe burrërinë e plotë, Ne i dhamë urti e dije: kështu i shpërblejmë ata që bëjnë mirë. <sup>15</sup> Hyri në qytet, i pavërejtur nga banorët e tij dhe i gjeti dy burra duke u rrahur: njëri nga populli i tij, tjetri armik. Ai që ishte nga populli i tij i thirri për ndihmë kundër armikut. Musai e goditi me grusht dhe e vrau. Tha: 'Kjo duhet të jetë vepër e Satanit: qartë ai është armik çorientues.' <sup>16</sup> Tha: 'Zot, e kam dëmtuar veten. Më fal', kështu që Ai e fali; Ai është vërtet Më Falësi, Më Mëshirëploti. <sup>17</sup> Tha: 'Zoti im, për shkak të bekimeve që m'i ke dhuruar, nuk do t'i përkrah kurrë ata që bëjnë keq.'

<sup>18</sup> Mëngjesin tjetër, po ecte nëpër qytet, i trembur dhe vigjilent, kur befasi njeriu të cilit i kishte ndihmuar ditën e djeshme i thirri për ndihmë. Musai tha: ‘Ti qartë je ngatërrestar.’ <sup>19</sup> Gjersa ishte gati ta sulmonte burrin që ishte armik i të dyve, burri tha: ‘Musa, a do të më vrasësh edhe mua siç e vrave atë personin dje? Qartë po dëshiron të jesh tiran në vend; nuk po synon t’i rregullosh gjërat.’ <sup>28:20</sup> Pastaj një njeri erdhi duke vrapuar nga pjesa më e largët e qytetit e tha: ‘Musa, autoritetet po flasin për të të vrarë, kështu që largohu – kjo është këshilla ime e sigurt.’ <sup>21</sup> Kështu Musai u largua nga qyteti, i trembur e duke u ruajtur dhe u lut: ‘Zoti im, më shpëto nga njerëzit që bëjnë keq.’

<sup>22</sup> Gjersa po e bënte rrugën drejt Medjenit, po thoshte: ‘Zoti im më udhëzoftë në rrugën e drejtë!’ <sup>23</sup> Kur arriti te ujërat e Medjenit, e gjeti një grup të burrave duke [u] dhënë ujë [kopeve të tyre] dhe pranë tyre dy gra që i mbanin kopetë e tyre prapa, kështu që tha: ‘Si është puna me ju dyja?’ Ato thanë: ‘Nuk mund të [u] japim ujë [kopeve tona] deri kur barinjët t’i largojnë delet e tyre: babai ynë është shumë i moshuar.’ <sup>24</sup> Ai u dha ujë kopeve të tyre për to, u tërhoq në hije dhe u lut: ‘Zoti im, jam në zor të madh për çfarëdo gjëje të mirë që mund të ma dërgosh’, <sup>25</sup> dhe pastaj njëra nga dy gratë iu afrua, duke ecur me ndrojtje dhe tha: ‘Po të kërkon babai im: dëshiron të të shpërblejë që u dhe ujë kopeve tona për ne.’

Kur Musai erdhi tek ai dhe ia tregoi rrëfimin e tij, plaku tha: ‘Mos ki frikë, tash je i sigurt nga njerëzit që bëjnë keq.’ <sup>26</sup> Njëra nga gratë tha: ‘Baba, punësoje: një burrë i fuqishëm e i besueshëm është më i miri për ta punësuar.’ <sup>27</sup> Babai tha: ‘Do të doja të ta jap për grua njëren nga këto bijat e mija, me kusht që të më shërbesh tetë vjet: nëse i përfundon dhjetë, do të jetë me vullnetin tënd të lirë. Nuk synoj të ta bëj të vështirë: dashtë **Allahu**, do ta shohësh se jam njeri i drejtë.’ <sup>28</sup> Musai tha: ‘Le të jetë kjo marrëveshja mes nesh – cilindo nga dy afatet që e plotësoj, le të mos ketë padrejtësi ndaj meje – **Allahu** është dëshmitar i kësaj që e themi.’

<sup>29</sup> Pasi Musai e pati kryer afatin dhe po udhëtonte me familjen e tij, i zuri syri një zjarr në anë të malit dhe i tha familjes së tij: ‘Pritni! E kam parë një zjarr. Do t’ju sjell lajme nga atje, apo një copë dru të ndezur për ju që të ngrohni.’ <sup>28:30</sup> Por kur arriti, një zë i thirri nga ana e djathtë e luginës, nga një pemë në tokën e bekuar: ‘Musa, jam **Allahu**, Zoti i Botëve. <sup>31</sup> Hidhe shkopin tënd.’ Kur e pa shkopin e tij duke lëvizur si gjarpër, iku nga frika dhe nuk do të kthehej. Përsëri [u thirr]: ‘Musa! Afrohu! Mos ki frikë, se je nga ata që janë të sigurt. <sup>32</sup> Fute dorën brenda këmbës sate dhe do të dalë e bardhë por e padëmtuar – mbaje krahun tënd afër dhe anash, i lirë nga çdo frikë. Këto do të jenë dy shenjat nga Zoti yt për Faraonin dhe parinë e tij; ata janë vërtet njerëz të ligë.’ <sup>33</sup> Musai tha: ‘Zoti im, e kam vrarë njërin nga njerëzit e tyre dhe kam frikë se mund të më vrasin. <sup>34</sup> Vëllai im Haruni është më gojëtar se unë: dërgoje atë me mua të më ndihmojë dhe t’i vërtetojë fjalët e mija – kam frikë se mund të më quajnë

gënjeshtar.’<sup>35</sup> **Allahu** tha: ‘Ne do të të forcojmë përmes vëllait tënd; do t’ju japim fuqi të dyve që të mos mund t’ju prekin. Me shenjat Tona ju dhe ata që ju ndjekin, do të triumfoni.’

<sup>36</sup> Por kur Musai u erdhi me shenjat Tona të qarta, ata thanë: ‘Këto janë truce të thjeshta mashtruese; nuk e kemi dëgjuar kurrë këtë nga para-ardhësit tanë.’

<sup>37</sup> Musai tha: ‘Zoti im e di më së miri se kush vjen me udhëzim nga Ai dhe kush do ta ketë Shtëpinë e fundit: keqbërësit nuk do të kenë sukses kurrë.’<sup>38</sup> Faraoni tha: ‘Këshilltarë, ju nuk keni zot tjetër që njoh unë pos meje. Haman, ma ndiz një zjarr për të pjekur tulla të baltës, pastaj ndërtoja një ndërtesë të lartë që të mund të ngjitem lart te **Allahu** i Musait: jam i bindur se ai po gënjen.’

<sup>39</sup> Faraoni dhe ushtritë e tij u sollën me arrogancë në vend pa asnjë të drejtë – menduan se nuk do t’i kthenin te Ne –<sup>28:40</sup> kështu që e mbërthyem atë dhe ushtritë e tij dhe i hodhëm në det. Shih çka u bë me keqbërësit!<sup>41</sup> I bëmë udhëheqës që [i] thirrin [të tjerët] veç te Zjarri: në Ditën e Ringjalljes nuk do të ndihmohen.<sup>42</sup> Ne bëmë që refuzimi Ynë t’i ndjekë në këtë botë, dhe në Ditën e Ringjalljes do të jenë ndër të përbuzurit.<sup>43</sup> Pasi i patëm shkatërruar brezat e mëparshëm, ia dhamë Musait Shkrimin e Shenjtë për të ofruar njohuri intuitive, udhëzim dhe mëshirë për njerëzit, që të mund të jenë të vëmendshëm.

<sup>44</sup> Ti [Muhamed] nuk ishe i pranishëm në anën perëndimore të malit kur Ne ia dhamë urdhrin Tonë Musait: nuk ishe aty –<sup>45</sup> kemi sjellë në qenie shumë breza që jetuan jetë të gjata – nuk ke jetuar në mesin e njerëzve të Medjenit apo t’ua recitoje Shpalljen Tonë – gjithmonë u kemi çuar njerëzve të dërguar –<sup>46</sup> as nuk ishe i pranishëm në anën e Malit Sinai kur i thirrëm Musait. Por edhe ti je dërguar si akt mirësie nga Zoti yt, për t’i dhënë paralajmërim një populli të cilit asnjë paralajmërues nuk u ka ardhur më parë, që të mund të jenë të vëmendshëm,<sup>47</sup> dhe të mos mund të thonë, po t’i godiste një fatkeqësi si rezultat i asaj që e kanë bërë me duart e tyre: ‘Zot, veç po të na e kishe çuar një të dërguar, do të kishim mundur ta ndiqnim mesazhin Tënd dhe të bëheshim besimtarë.’<sup>48</sup> Madje edhe tash që u ka ardhur e vërteta Jonë, thonë: ‘Pse nuk i janë dhënë atij shenja si ato që i janë dhënë Musait më parë?’ A nuk e mohuan edhe të vërtetën që i ishte dhënë Musait më parë? Thonë: ‘Dy lloje të magjive që e ndihmojnë njëra-tjetrën’ dhe ‘Refuzojmë dhe nuk e pranojmë asnjërin nga to.’<sup>49</sup> Thuaj [Muhamed]: ‘Atëherë prodhoheni një libër nga **Allahu** që jep udhëzim më të mirë se këta dy dhe unë do t’ju ndjek, nëse po e tregoni të vërtetën.’<sup>28:50</sup> Nëse nuk të përgjigjen, do ta dish se i ndjekin veç merakët e tyre. Kush është më i devijuar se ai që i ndjek merakët e tij pa udhëzim nga **Allahu**? Vërtet **Allahu** nuk i udhëzon ata që bëjnë keq.

<sup>51</sup> Ne kemi bërë që Fjala Jonë t’u vijë që të mund të jenë të vetëdijshëm.<sup>52</sup> Ata të cilëve ua dhamë Shkrimin e Shenjtë më parë – besojnë në të,<sup>53</sup> dhe, kur u recitohet, thonë: ‘Besojmë në të, është e vërteta nga Zoti ynë. Para se të vinte

tashmë iu patëm përkushtuar Atij.’<sup>54</sup> Atyre do t’u jepen shpërblimet e tyre dyfish se janë të qëndrueshëm, e zbrapsin të keqen me të mirë, u japin të tjerëve nga ajo që kemi furnizuar për ta,<sup>55</sup> dhe largohen kurdo që dëgjojnë biseda mendjelehta, duke thënë: ‘Ne i kemi veprat tona dhe ju i keni tuajat. Paqja qoftë me ju! Nuk e kërkojmë shoqërinë e njerëzve të padijshëm.’

<sup>56</sup> [Ti Profet] nuk mund ta udhëzosh në të vërtetën secilin që e do; është **Allahu** Ai që e udhëzon këdo që do ta udhëzojë: Ai i njeh më së miri ata që do ta ndjekin udhëzimin.<sup>57</sup> Ata thonë: ‘Po ta ndiqnim udhëzimin me ty [Profet], do të na fshinin nga toka jonë.’ A nuk e kemi mirë-vendosur për ta një shenjtërore të sigurt ku sillet çdo lloj prodhimi, si furnizim nga Ne? Por shumica nga ta nuk kuptojnë.<sup>58</sup> I kemi shkatërruar shumë komunitete që dikur i gëzoheshin pasurisë së papërmbajtur dhe jetesës së lehtë të saj: që atëherë vendet e tyre të banimit janë banuar shumë pak – Ne jemi trashëguesi i vetëm.<sup>59</sup> Zoti juaj nuk do të shkatërronte kurrë qytete pa e ngritur së pari një të dërguar në mesin e tyre për t’ua recituar mesazhet Tona, as s’do të shkatërronim qytete po të mos i kishin banorët keqbërës.<sup>28:60</sup> Çfarëdo gjëra që ju janë dhënë për jetën e kësaj bote janë thjesht kënaqësi e llukse [të përkohshme]: ajo që është me **Allahun** është më e mirë dhe zgjat më shumë – a nuk do ta përdorni arsyen tuaj?

<sup>61</sup> A mundet personi që do ta shohë përmbushjen e premtimit të mirë që ia kemi dhënë të krahasohet me dikë që ia kemi dhënë ca kënaqësi për këtë jetë tokësore por që, në Ditën e Ringjalljes, do t’i vijë thirrja?<sup>62</sup> Do të vijë Dita kur **Allahu** do t’i thërrasë, duke thënë: ‘Ku janë tani ata që pretendoni se janë partnerët E Mi?’<sup>63</sup> dhe ata [udhëheqësit e të këqijve] kundër të cilëve do të merret vendimi do të thonë: ‘Zoti ynë, këta janë ata që ne i bëmë të devijojnë. Ne i bëmë të devijojnë siç devijuam edhe vetë, por tani heqim dorë nga ta para Teje: ata nuk na shërbyen realisht.’<sup>64</sup> Pastaj do t’u thuhet: ‘Tani thirrni ata që i adhuroat si partnerë’ dhe do t’i thërrasin por nuk do të marrin kurrfarë përgjigje. Do ta shohin vuajtjen dhe do të duan ta kishin ndjekur udhëzimin.<sup>65</sup> Në atë Ditë Ai do t’i thërrasë, duke thënë: ‘Si iu përgjigjët të dërguarve të Mi?’<sup>66</sup> Të gjitha argumentet do t’u duken të turbullta në atë Ditë; nuk do të jenë në gjendje të këshillohen me njëri-tjetrin.<sup>67</sup> E megjithatë, kushdo që është penduar, ka besuar dhe ka bërë vepra të mira mund të shpresojë ta gjejë veten ndër të suksesshmit.<sup>68</sup> Zoti juaj krijon çka t’i pëlqejë dhe i zgjedh ata që do t’i zgjedhë – ata nuk mund të zgjedhin – pra lëndi qoftë për **Allahun** dhe qoftë i lartësuar mbi partnerët që ia përshkruajnë!<sup>69</sup> Zoti juaj e di çka fshehin zemrat e tyre dhe çka shfaqin.<sup>28:70</sup> Ai është **Allahu**; nuk ka zot pos Tij; tërë lavdet i përkasin Atij në këtë botë dhe në tjetrën; I Tij është Gjykimi; dhe tek Ai do t’ju kthejnë.

<sup>71</sup> Thuaj [Profet]: ‘Veç mendoni, po t’jua hidhte **Allahu** përmbi natën e përhershme deri në Ditën e Ringjalljes, çfarë zoti tjetër pos Tij do të mund t’ju sillte dritë? A nuk po dëgjoni?’<sup>72</sup> Thuaj: ‘Veç mendoni, po t’jua hidhte **Allahu** përmbi ditën e përhershme deri në Ditën e Ringjalljes, çfarë zoti tjetër pos Tij do

të mund t'ju sillte natë për të pushuar? A nuk po e shihni? <sup>73</sup> Në mëshirën E Tij jua ka dhënë natën dhe ditën, që të mund të pushoni e ta kërkon mirësinë E Tij dhe të jeni mirënjohës.' <sup>74</sup> Do të vijë Dita kur Ai do t'i thërrasë, duke u thënë: 'Ku janë partnerët që m'i pretendonit Mua?' <sup>75</sup> Ne do ta thërrasim një dëshmitar nga çdo komunitet dhe do të themi: 'Prodhoni provat tuaja' dhe pastaj do ta dinë se e vërteta i përket veç **Allahut**; zotat që i shpikën do t'i braktisin ata.

<sup>76</sup> Karuni ishte një nga populli i Musait, por i shtypte ata. Ne i patëm dhënë thesare të tilla që madje edhe çelësat e tyre do ta bllokoinin me peshë një grup të tërë të burrave të fortë. Njerëzit e tij i thanë: 'Mos u kreno me suksesin tënd e të lumturohesh me dështimin e të tjerëve, se **Allahu** nuk i do njerëzit e tillë. <sup>77</sup> Kërkoje jetën që do të vijë me mjetet që t'i ka dhuruar **Allahu**, por mos e shpërfill hisen tënde të drejtë në këtë botë. Bëju mirë të tjerëve siç të ka bërë mirë **Allahu**. Mos kërko të përhapësh korrupsion në vend, se **Allahu** nuk i do ata që e bëjnë këtë', <sup>78</sup> por ai u përgjigj: 'Kjo pasuri më është dhënë për shkak të njohurive që i kam.' A s'e dinte se **Allahu** kishte shkatërruar shumë breza para tij, që kishin fuqi më të madhe dhe ndërtuan më shumë pasuri se ai? Fajtorët nuk do të merren në pyetje për mëkatet e tyre.<sup>a</sup> <sup>79</sup> Ai doli midis popullit të tij me tërë salltanetin e tij dhe ata që e kishin për qëllim jetën e kësaj bote thanë: 'Veç po të na jepej diçka si ajo që i është dhënë Karunit: vërtet është njeri shumë fatlum', <sup>28:80</sup> por ata që u ishte dhënë dije thanë: 'Të mjerët ju! Shpërblimi i **Allahut** është më i mirë për ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira: veç ata që janë të qëndrueshëm do ta arrijnë këtë.' <sup>81</sup> Ne bëmë që toka ta gëlltiste atë dhe shtëpinë e tij: nuk e kishte askë t'i ndihmonte kundër **Allahut**, as s'mund të mbrohej. <sup>82</sup> Të nesërmen, ata që, një ditë më parë, kishin dëshiruar të ishin në vendin e tij thirrën: 'Mjerisht [për ty, Karun]! Veç **Allahu** ia jep atë që do t'ia japë, me bollëk a me masë, kujt do që do t'ia japë nga krijesat E Tij: po të mos ishte **Allahu** dashamirës ndaj nesh, do të kishte bërë që toka të na gëlltiste edhe neve.' Mjerisht vërtet! Ata që e mohojnë të vërtetën nuk do të përparojnë kurrë.

<sup>83</sup> Ne ua japim Shtëpinë në Të Përtejmen atyre që nuk kërkojnë superioritet në tokë as nuk përhapin korrupsion: fundi i lumtur u shpërblehet atyre që janë të vetëdijshëm për **Allahun**. <sup>84</sup> Kushdo që vjen para **Allahut** me vepër të mirë do të pranojë shpërblim më të mirë; kushdo që vjen me vepër të keqe do të ndëshkohet veç për atë që e ka bërë. <sup>85</sup> Ai që ta ka bërë Kuranin detyrim [Profet] do të të kthejë në shtëpi.<sup>b</sup> Pra thuaj: 'Zoti im e di më së miri se kush ka sjellë udhëzim të vërtetë dhe kush është i devijuar haptas.' <sup>86</sup> Ti vetë nuk do të mund ta pritje që do të të dërgohej Shkrimi i Shenjtë; ai erdhi veç si mëshirë nga Zoti yt. Pra mos u

---

<sup>a</sup> Ka shumë interpretime të këtij vargu, me gjasën më të madhe, sipas Razit, meqenëse fajtorëve nuk do t'u jepet privilegji që të merren në pyetje për mëkatet e tyre, as s'do t'u jepet mundësia të ofrojnë arsyetime.

<sup>b</sup> Tek Ai. Krahaso me vargun 83. Komentues të ndryshëm e marrin se kjo i referohet Mekës apo jetës tjetër.



ndihmo mosbesimtarëve. <sup>87</sup> Mos i lejo të të largojnë nga shpalljet e **Allahut** pasi të janë shpallur. Thirri njerëzit te Zoti yt. Kurrë mos u bëj një nga ata që i përshkruajnë partnerë **Allahut**. <sup>88</sup> Mos i thirr asnjë zoti tjetër pos **Allahut**, se nuk ka zot pos Tij. Gjithçka do të zhduket përveç Fytyrës Së Tij. I Tij është Gjykimi dhe tek Ai do t'ju kthejnë të gjithëve.

**Përshkrimi para kaptinës 28 nga Abdel Haleem:**

*Sure mekase që e ka në qendër rrëfimin e Musait dhe e merr titullin nga referenca e rrëfimit të treguar nga Musai në vargun 25. Tema kryesore e saj është fundi i keq që u vjen atyre që janë arrogantë dhe përhapin korrupsion, si Faraoni dhe Karuni – politeizmi ndëshkohet në pika të ndryshme gjatë sures – dhe bëhet një lidhje ndërmjet tyre dhe mosbesimtarëve të Mekës. Surja ia kujton Profetit se nuk mund ta bëjë secilin të besojë (vargu 56) dhe duhet të mbahet i qëndrueshëm (vargu 87).*

## 29: Merimanga (EL-‘ANKEBÛT)

Në emrin e **Allahut**, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës

<sup>1</sup> *Elif Lam Mim*

<sup>2</sup> A mendojnë njerëzit se do të lihen rehat pasi të thonë ‘Besojmë’ pa u sprovuar?

<sup>3</sup> Ne i sprovuam ata që shkuan para tyre: **Allahu** sigurisht që do t’i shenjojë cilët janë të vërtetë dhe cilët po gënjejnë. <sup>4</sup> A mendojnë keqbërësit se do të shpëtojnë nga Ne? Sa cektë gjykojnë! <sup>5</sup> Por sa u përket atyre që përpiqen për takimin e tyre me **Allahun**, koha e caktuar e **Allahut** do të vijë gjithsesi; Ai është Gjithë-Pamësi, Gjithë-Ditësi. <sup>6</sup> Ata që përpiqen – e bëjnë këtë për dobi të veten – **Allahu** nuk ka nevojë për krijesat E Tij – <sup>7</sup> Ne sigurisht që do t’i fshijmë keqbërjet e atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira dhe do t’i shpërblejmë sipas më të mirës së veprimeve të tyre. <sup>8</sup> I kemi urdhëruar njerëzit të jenë të mirë me prindërit e tyre, por mos iu bindni nëse përpiqen t’ju bëjnë t’i shërbeni, pos Meje, diçkaje për të cilën nuk keni njohuri: të gjithë do të ktheheni tek Unë dhe do t’ju informoj për atë që e keni bërë. <sup>9</sup> Ne do të sigurohemi që ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira t’i pranojmë në radhët e të ndershmeve.

<sup>29:10</sup> Janë disa njerëz që thonë: ‘Besojmë në **Allahun**’, por, kur vuajnë për çështjen E Tij, mendojnë se përndjekja njerëzore është po aq e ashpër sa ndëshkimi i **Allahut** – e megjithatë, nëse të vjen çfarëdo ndihme [Profet] nga Zoti yt, do të thonë: ‘Kemi qenë gjithmonë me ty’. A nuk e di **Allahu** më së miri se çka ka në zemrat e secilit? <sup>11</sup> **Allahu** sigurisht që do të shenjojë se cilët janë besimtarët dhe cilët hipokritët. <sup>12</sup> Ata që nuk besojnë u thonë besimtarëve: ‘Ndiqeni rrugën tonë dhe ne do t’i bartim [pasojet për] mëkatet tuaja’, e megjithatë nuk do ta bëjnë këtë – janë gënjeshtarë. <sup>13</sup> Do t’i bartin barrët e tyre dhe të tjerët për më tepër: do të merren në pyetje për pohimet e tyre të rreme për Ditën e Ringjalljes.

<sup>14</sup> Ne e dërguam Nuhun te populli i tij. Jetoj në mesin e tyre njëmijë vite pa pesëdhjetë por kur i mori Përmbytja, ende po bënin keq. <sup>15</sup> E shpëtuam atë dhe ata që ishin në Arkë me të. E bëmë këtë shenjë për të gjithë njerëzit.

<sup>16</sup> Ne e dërguam edhe Ibrahimin. I tha popullit të tij: ‘Shërbeni **Allahut** dhe jini të vetëdijsëm për Të: kjo është më e mirë për ju, veç po ta dinit. <sup>17</sup> Ata që i adhuronin në vend të **Allahut** janë idhuj të thjeshtë; ajo që e shpikni nuk është asgjë pos falsitet. Ata të cilëve u shërbeni në vend të **Allahut** nuk kanë pushtet t’ju japin furnizime, pra kërkoni furnizime nga **Allahu**, shërbeni Atij dhe falënderohuni Atij. <sup>18</sup> Nëse thoni se kjo është gënjeshtër, [ta dini se] komunitetet

e tjera para jush e thanë të njëjtën. Detyra e vetme e të dërguarit është të japë paralajmërim të qartë.’

<sup>19</sup> A nuk e shohin se **Allahu** e sjell jetën në qenie dhe e riprodhon? Vërtet kjo është e lehtë për **Allahun**. <sup>29:20</sup> Thuaj: ‘Udhëtoni nëpër tokë dhe shihni se si e sjell Ai jetën në qenie: dhe do ta sjellë jetën tjetër në qenie. **Allahu** ka pushtet mbi të gjitha gjërat. <sup>21</sup> E ndëshkon këdo që do ta ndëshkojë dhe i shfaq mëshirë kujtdo që do t’i shfaqë. Të gjithë juve do t’ju kthejnë tek Ai. <sup>22</sup> Nuk mund t’i shpëtoni në tokë as në qiej; nuk do ta keni askë t’ju mbrojë a t’ju ndihmojë pos **Allahut**.’ <sup>23</sup> Ata që e mohojnë Shpalljen e **Allahut** dhe takimin e tyre me Të nuk kanë shpresë ta marrin mirësinë Time: do të kenë torturë të rëndë.

<sup>24</sup> E vetmja përgjigje që e dha populli i Ibrahimit ishte: ‘Vriteni apo digjeni!’ por **Allahu** e shpëtoi nga Zjarri: vërtet ka shenja në këtë për njerëzit që besojnë. <sup>25</sup> Ibrahimimi u tha: ‘Keni zgjedhur idhuj në vend të **Allahut** por dashuria juaj për ta do të zgjasë veç gjatë jetës së tanishme: në Ditën e Ringjalljes, do ta mohoni dhe refuzoni njëri-tjetrin. Ferri do të jetë shtëpia juaj dhe askush s’do t’ju ndihmojë.’ <sup>26</sup> Luti i besoi dhe tha: ‘Do të nxitoj te Zoti im: Ai është I Gjithë-Fuqishmi, I Gjith’-Urti.’ <sup>27</sup> Ne ia dhamë Ibrahimit Is’hakun dhe Jakubin dhe dhamë profeci dhe Shkrim të Shenjtë ndër pasardhësit e tij. Ia dhamë shpërblimet në këtë botë, dhe në jetën e ardhshme do të jetë ndër të ndershmit.

<sup>28</sup> Dhe Luti: kur i tha popullit të tij: ‘Ju praktikoni veprime të egra që asnjë popull para jush nuk i ka bërë kurrë. <sup>29</sup> Si mund të keni epsh për burra, për udhëtarë të rrugës dhe të bëni ligësi në tubimet tuaja?’, përgjigja e vetme që ia dha populli i tij ishte: ‘Na e zbrit ndëshkimin e **Allahut** mbi ne, në qoftë e vërtetë kjo që po e thua.’ <sup>29:30</sup> Prandaj ai u lut: ‘Zoti im, më ndihmo kundër këtyre njerëzve që përhapin korrupsion.’ <sup>31</sup> Kur të dërguarit Tanë ia sollën Ibrahimit lajmin e mirë [të lindjes së një djali],<sup>a</sup> i thanë: ‘Së shpejti do ta shkatërrojmë popullin e atij qyteti. Janë keqbërës.’ <sup>32</sup> Ibrahimimi tha: ‘Por Luti jeton aty.’ Ata u përgjigjën: ‘E dimë se kush jeton aty më mirë se ti. Do ta shpëtojmë atë dhe familjen e tij, pos gruas së tij: ajo do të jetë nga ata që rrinë prapa.’ <sup>33</sup> Kur të dërguarit Tanë erdhën te Luti, ai ishte i trazuar dhe i dëshpëruar për ta. Ata thanë: ‘Mos ki frikë as pikëllim: sigurisht që do të të shpëtojmë ty dhe familjen tënde, përveç gruas sate – ajo do të jetë nga ata që rrinë prapa – <sup>34</sup> dhe do ta zbresim një ndëshkim nga qielli mbi njerëzit e këtij qyteti se bëjnë shkelje [të rregullit të **Allahut**]. <sup>35</sup> Ne lamë ca [nga qyteti] aty si shenjë të qartë për ata që e përdorin arsyen.

<sup>36</sup> Popullit të Medjenit Ne ia dërguam vëllain e tij Shuajbin. Ai tha: ‘Populli im, shërbeni **Allahut** dhe përgatituni për atë që mund të ndodhë në Ditën e

---

<sup>a</sup> Krahaso p.sh. me 51:28

Fundit. Mos bëni keq dhe mos përhapni korrupsion në vend.’<sup>37</sup> E refuzuan dhe kështu i kaploi tërmeti. Kur erdhi mëngjesi, po rrinin shtrirë të vdekur në shtëpitë e tyre.<sup>38</sup> [Kujtoni] fiset e Adit dhe të Themudit: rrëfimi i tyre të është qartësuar me [atë që ka mbetur nga] vendet e tyre të banimit. Satani bëri t’u duken tërheqëse veprat e tyre të ndyra dhe i pengoi nga rruga e duhur, megjithëse ishin të aftë të shihnin.<sup>39</sup> [Kujtoje] Karunin dhe Faraonin dhe Hamanin: Musai u solli shenja të qarta, por u sollën me arrogancë në tokë. Nuk mundën të shpëtonin nga Ne<sup>29:40</sup> dhe e dënuam secilin për mëkatet e tyre: disa i goditëm me furtunë; disa u dërrmuan nga një shpërthim i papritur; për disa e bëmë tokën t’i gëlltiste; dhe disa i fundosëm. Nuk ishte **Allahu** që i dëmtoi; e dëmtuan veten.<sup>41</sup> Ata që marrin mbrojtës të tjerë veç **Allahut** mund të krahasohen me merimangat që i ndërtojnë shtëpi vetes – shtëpia e merimangës është më e dobëta nga të gjitha shtëpitë – veç po të mund ta kuptonin.<sup>42</sup> **Allahu** e di se çfarë gjërave u thërrasin përveç Tij: Ai është I Fuqishmi, I Urti.<sup>43</sup> Të tilla janë krahasimet që i bëjmë për njerëzit, megjithëse veç të urtit mund t’i rrokin ato.<sup>44</sup> **Allahu** i ka krijuar qiejt dhe tokën për një qëllim të vërtetë. Vërtet ka shenjë në këtë për ata që besojnë.

<sup>45</sup> [Profet,] recitoje atë që të është shpallur nga Shkrimi i Shenjtë; falu rregullisht: të falurit e frenon sjelljen e egër e të papranueshme. Të kujtuarit e **Allahut** është diçka më e madhe: **Allahu** di gjithçka që po bën ti.<sup>46</sup> [Besimtarë,] diskutoni veç në mënyrën më të mirë me Njerëzit e Librit, përveç me ata që veprojnë padrejtësisht. Thuaj: ‘Besojmë në atë që na është shpallur neve dhe në atë që ju është shpallur juve; Zoti ynë dhe Zoti juaj janë një [dhe i vetmi]; ne i jemi përkushtuar Atij.’<sup>47</sup> Kjo është mënyra se si ta dërguam Shkrimin e Shenjtë [ty Muhamed]. Ata të cilëve tashmë ua kemi dhënë Shkrimin e Shenjtë besojnë në [Kuran] dhe kështu bëjnë disa nga ata njerëz. Askush nuk refuzon t’i pranojë shpalljet Tona pos përbuzësit.

<sup>48</sup> Kurrë nuk recitove asnjë Shkrim të Shenjtë para se Ne të ta shpallnim këtë; kurrë nuk shkrove me dorën tënde. Po ta kishe bërë, ata që e ndjekin falsitetin do të mund të kishin shkak për të dyshuar.<sup>49</sup> Por jo, [ky Kuran] është shpallje që është e qartë për zemrat e atyre që janë të pajisur me dituri. Askush nuk refuzon t’i njohë shpalljet Tona pos keqbërësve.<sup>29:50</sup> Thonë: ‘Pse nuk i janë dërguar fare mrekulli nga Zoti i tij?’ Thuaj: ‘Mrekullitë janë në duart e **Allahut**; jam thjesht këtu për t’ju paralajmëruar qartë.’<sup>51</sup> A nuk mendojnë se është e mjaftueshme që ta kemi zbritur Shkrimin e Shenjtë që u recitohet? Ka mëshirë në këtë dhe mësim për njerëzit që besojnë.<sup>52</sup> Thuaj: ‘**Allahu** është dëshmitar i mjaftueshëm ndërmjet meje dhe juve: Ai e di se çka ka në qiej dhe në tokë. Ata që besojnë në hyjni të rreme dhe e refuzojnë **Allahun** do të jenë humbësit.’

<sup>53</sup> Të sfidojnë ta ngutësh ndëshkimin: tashmë do ta kishin marrë një ndëshkim po të mos e caktonte **Allahu** një kohë për të dhe vërtet do t’u vijë befasi

e t'i zërë të pavetëdijsëm. <sup>54</sup> Të sfidojnë ta ngutësh ndëshkimin: Ferri do t'i rrethojë të gjithë ata që e refuzojnë të vërtetën, <sup>55</sup> në Ditën kur ndëshkimi i mbizotëron nga përmbi dhe nga nën këmbët e tyre dhe do t'u thuhet: 'Tash shijojeni ndëshkimin për atë që e keni bërë më parë.'

<sup>56</sup> Shërbyes të Mi besimtarë! Toka Ime është e gjerë, pra më adhuroni Mua dhe veç Mua. <sup>57</sup> Secili shpirt do ta shijojë vdekjen, pastaj te Ne do t'ju kthejnë. <sup>58</sup> Ata që besuan dhe bënë vepra të mira do t'i strehojmë në banesa të larta, në Kopshtin e hijeshuar me lumenj rrjedhës, për të mbetur aty. Sa i shkëlqyeshëm është shpërblimi i atyre që punojnë, <sup>59</sup> i atyre që janë të qëndrueshëm, që e patën besimin e tyre në Zotin e tyre! <sup>29:60</sup> Sa të shumta janë krijesat që nuk ruajnë rezerva të furnizimit të tyre! **Allahu** i furnizon ato dhe ju: veç Ai është Gjithë-Dëgjuesi, Gjithë-Ditësi. <sup>61</sup> Nëse i pyet mosbesimtarët kush i krijoi qiejt dhe tokën dhe kush e shfrytëzoi diellin dhe hënën, thonë të sigurt: '**Allahu**'. Pra pse largohen prej Tij? <sup>62</sup> Është **Allahu** që u jep begatshëm cilëvedo shërbyes Të Tij që do t'u japë dhe me masë kujtdo që do t'i japë: Ai ka njohuri të plotë për gjithçka. <sup>63</sup> Nëse i pyet: 'Kush e zbret ujin nga qielli dhe me të i jep jetë tokës pasi të ketë vdekur?' thonë të sigurt: '**Allahu**'. Thuaj: 'Lâvdi i përket **Allahut**!' Vërtet, shumica nga ta nuk e përdorin arsyen e tyre.

<sup>64</sup> Jeta e kësaj bote është thjesht dëfrim dhe hutim; jeta e vërtetë është në Të Përtejmen, veç po ta dinin. <sup>65</sup> Kurdo që hipin në anije i thirrin **Allahut** dhe ia kushtojnë besimin veç Atij, por posa t'i ketë dërguar e kthyer sigurt në tokë, shih si i përshkruajnë partnerë! <sup>66</sup> Le ta shfaqin mosmirënjohjen e tyre për atë që ua kemi dhënë; le ta shijojnë kënaqësinë e tyre – së shpejti do ta dinë. <sup>67</sup> A nuk mund ta shohin se ua kemi bërë [atyre] një shenjtorë<sup>a</sup> të sigurt megjithëse kudo përreth tyre janë rrëmbyer njerëz? Pastaj si mund të besojnë në atë që është e rreme dhe ta refuzojnë besimin e **Allahut**? <sup>68</sup> Kush do të mund të ishte më i lig se personi që shpik gënjeshtër për **Allahun**, apo e mohon të vërtetën kur i vjen? A nuk është Ferri shtëpia për mosbesimtarët? <sup>69</sup> Por Ne do të sigurohemi t'i udhëzojmë në rrugët Tona ata që përpiqen fort për çështjen Tonë: **Allahu** është me ata që bëjnë mirë.

---

<sup>a</sup> Mekën.

**Përshkrimi para kaptinës 29 nga Abdel Haleem:**

*Sure mekase që e merr titullin nga ilustrimi i merimangës në vargun 41. Surja thekson se besimtarët do të sprovohen dhe se duhet të mbahen të qëndrueshëm. Adresohen keqkuptimet e mosbesimtarëve në lidhje me natyrën e shpalljes dhe Profetin. Bëhen referenca me profetët e mëhershëm dhe jepen detale për ndëshkimet që u janë sjellë atyre që i mohuan ata.*

### 30: Bizantinët (ER-RÛM)

Në emrin e **Allahut**, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës

- <sup>1</sup> *Elif Lam Mim*
- <sup>2</sup> Bizantinët janë mundur
- <sup>3</sup> në një tokë të afërt.
- Do të jenë fitues pas disfatës së tyre,
- <sup>4</sup> brenda disa vitesh<sup>a</sup> –
- Allahu** është komanduesi,  
i pari dhe i fundit.
- Në atë ditë  
besimplotët do të ngazëlleshen,
- <sup>5</sup> me ndihmën e **Allahut**.
- Ai i ndihmon kujt të dojë:  
është I Fuqishmi, Mëshirëploti.
- <sup>6</sup> Ky është premtimi i **Allahut**:  
**Allahu** nuk e thyen kurrë premtimin E Tij,  
por shumica e njerëzve nuk e dinë;
- <sup>7</sup> e dinë veç sipërfaqen e jashtme  
të kësaj jete të tashme,  
dhe janë të pavëmendshëm  
për jetën tjetër.
- <sup>8</sup> A nuk kanë menduar për vetet e tyre?<sup>b</sup>
- Allahu** nuk i krijoi qiejt dhe tokën  
dhe gjithçka ndërmjet tyre  
pa destinim serioz dhe afat të caktuar,  
e megjithatë shumë njerëz e mohojnë  
se do ta takojnë Zotin e tyre.

---

<sup>a</sup> Kur fatet u kthyen anasjelltas dhe bizantinët e patën një fitore, kjo ishte për t'i kënaqur besimtarët. Ky ishte edhe viti i fitores myslimane në Bedër. Disfata e mëhershme e bizantinëve ishte parë nga paganët mekasë si fitore për paganizmin.

<sup>b</sup> Apo 'brenda' vetes. Shih edhe 41:53



- 9 A nuk kanë udhëtuar nëpër vend  
e ta shohin si mbaruan ata para tyre?  
Ata ishin më të fuqishëm se këta:  
e kultivuan tokën më shumë,  
dhe ndërtuan më shumë mbi të.  
Të dërguarit e tyre u erdhën po ashtu  
me shenja të qarta:  
**Allahu** nuk i dëmtoi;  
e dëmtuan veten.
- 30:10 Më vonë keqbërësit arritën në fund të tmerrshëm  
se i refuzuan shenjat e **Allahut**  
dhe i morën për shaka [përsëri e përsëri].
- 11 **Allahu** e sjell krijimin në qenie;  
në fund do ta riprodhojë atë  
dhe tek Ai do t'ju rikthejnë.
- 12 Në ditën kur vjen Ora  
fajtorët do të dëshpërohen  
13 dhe nuk do të kenë ndërmjetësues  
ndër partnerët që ia përshkruan **Allahut** –  
ata do t'i refuzojnë këta partnerë.
- 14 Kur të vijë Ora  
në atë Ditë njerëzit do të ndahen:  
15 ata që besuan dhe bënë vepra të mira  
do të kënaqen në një Kopsht;  
16 gjersa ata që nuk besuan  
dhe i mohuan mesazhet Tona  
dhe takimin e Të Përtejmes  
do t'i sjellin për ndëshkim.

- 17 Pra festojeni lavdinë e **Allahut**  
në mbrëmje, në mëngjes –
- 18 lãvdi i përket Atij  
në qiej dhe në tokë –  
në pasditen e vonë dhe në mesditë.
- 19 Ai e sjell të gjallën nga e vdekura,  
dhe të vdekurën nga e gjalla.  
E gjallëron tokën pas vdekjes,  
dhe ju do të nxirreni njësoj.
- 30:20 Një nga shenjat E Tij  
është se ju krijoi nga pluhuri dhe –  
shih sa çudi! –  
u bëtë njerëz dhe u përhapët gjerë-e-gjatë.
- 21 Një shenjë tjetër E Tij  
është se krijoi për ju  
bashkëshortë nga ata që janë në mesin tuaj  
që të jetoni me ta në qetësi:  
Ai paracaktoi dashuri e mirësi ndërmjet jush.  
Vërtet ka shenja në këtë  
për ata që reflektojnë.
- 22 Një nga shenjat E Tij  
është krijimi i qiejve dhe i tokës,  
dhe larmia e gjuhëve dhe ngjyrave tuaja.  
Sigurisht që në këtë ka shenjë për ata që dinë.
- 23 Ndër shenjat E Tij  
janë gjumi juaj, natën dhe ditën,  
dhe kërkimi juaj i mirësisë Së Tij.  
Vërtet ka shenja në këtë për ata që dëgjojnë.
- 24 Ndër shenjat E Tij, po ashtu  
janë se jua tregon rrufenë,  
që tmerron dhe frymëzon shpresë;  
që Ai zbret ujë nga qielli,  
për ta rigjallëruar tokën pas vdekjes.

Sigurisht që ka shenja në këtë  
për ata që e përdorin arsyen e tyre.

<sup>25</sup> Ndër shenjat E Tij, po ashtu  
është fakti se qiejt dhe toka  
qëndrojnë fort sipas komandës Së Tij.  
Në fund, do të dilni të gjithë  
kur Ai ju thërret nga toka.

<sup>26</sup> Atij i përket çdokush  
në qiej dhe në tokë,  
dhe të gjithë janë të bindur ndaj Tij.

<sup>27</sup> Është Ai që e nis krijimin  
dhe do ta bëjë përsëri –  
kjo është edhe më lehtë për Të.  
Ai është mbi çdo krahasim  
në qiej dhe në tokë;  
është I Gjithë-Fuqishmi, I Gjith'-Urti.

<sup>28</sup> Ai jua jep këtë shembull  
të nxjerrë nga jetët tuaja:  
a i bëni skllëvërit tuaj  
partnerë të plotë me hise të barabartë  
në atë që jua kemi dhënë?  
A ua keni frikën siç ia keni frikën njëri-tjetrit?  
Kështu ua bëjmë të qarta mesazhet Tona  
atyre që e përdorin arsyen e tyre.

<sup>29</sup> Dhe prapë idhujtarët  
i ndjekin meraket e tyre pa ndonjë dije.  
Kush mund t'i udhëzojë ata që **Allahu** i lë të devijojnë,  
që nuk e kanë askë t'u ndihmojë?

<sup>30:30</sup> Pra [Profet] si njeri i besimit të pastër,  
mbahu i fortë e besnik

në përkushtimin tënd ndaj<sup>a</sup> fesë.  
Kjo është gjendja natyrale  
që **Allahu** e mbolli në njerëzimin –  
nuk ka ndryshim në krijimin e **Allahut** –  
dhe kjo është feja e drejtë,  
megjithëse shumica e njerëzve nuk e kuptojnë.

- <sup>31</sup> Kthejuni veç Atij, të gjithë.  
Jini të vetëdijshëm për Të;  
faluni rregullisht;  
mos u bashkoni me ata që i përshkruajnë partnerë **Allahut**,  
<sup>32</sup> ata që e ndajnë fenë e tyre nëpër sekte,  
secila palë duke u kënaqur më vete.  
<sup>33</sup> Kur njerëzve u ndodh diçka e keqe,  
i thirrin Zotit të tyre dhe i kthehen për ndihmë,  
por jo më shpejt i lejon ta shijojnë bekimin E Tij se sa –  
shih sa çudi! –  
disa nga ta i përshkruajnë partnerë Zotit të tyre,  
<sup>34</sup> duke mos shfaqur mirënjohje  
për atë që ua kemi dhënë.  
'Kënaquni, pra! Do ta merrni vesh.'  
<sup>35</sup> A u kemi zbritur ndonjë autoritet  
që i miraton partnerët  
që ia përshkruajnë **Allahut**?

- <sup>36</sup> Kur bëjmë që njerëzit  
ta shijojnë mëshirën Tonë,  
ata gëzohen,  
por kur u ndodh diçka e keqe –  
për shkak të veprimeve të tyre –  
bien në dëshpërim të plotë.

---

<sup>a</sup> Fjalë për fjalë 'vëja fytyrën tënde'

- 37 A nuk e shohin se **Allahu**  
i jep me bollëk kujt do që do t'i japë  
dhe me masë [kujt do që do t'i japë]?  
Sigurisht që në këtë ka shenja  
për ata që besojnë.
- 38 Pra jepja atë që i takon të afërmit në familje,  
nevojtërit dhe udhëtarit –  
kjo është më e mira për ata që e kanë për qëllim  
miratimin<sup>a</sup> e **Allahut**:  
këta janë ata që do të përparojnë.
- 39 Çkado që jepni hua në fajde  
për të fituar vlerë përmes pasurisë së njerëzve të tjerë  
nuk do të rritet në sytë e **Allahut**;  
por çkado që jepni në bamirësi,  
në merakun tuaj për miratimin e **Allahut**  
do të sjellë fitime të shumëfishta.
- 30:40 Është **Allahu** që ju krijoi dhe furnizoi për ju,  
që do të bëjë të vdisni  
dhe pastaj do t'ju japë jetë përsëri.  
Cili nga 'partnerët' tuaj  
mund ta bëjë cilëndo nga këto gjëra?  
Lâvdi qoftë për **Allahun**,  
dhe i lartësuar qoftë  
përmbi partnerët që ia përshkruajnë.
- 41 Korrupsioni ka lulëzuar në tokë e në det  
si rezultat i veprimeve të njerëzve  
dhe Ai do t'i bëjë t'i shijojnë  
pasojat e ca veprave të tyre,  
që të mund të kthehen [në përmirësim].
- 42 Thuaj: 'Udhëtoni nëpër tokë dhe shihni  
si mbaruan ata para jush –  
 shumica nga ta ishin idhujtarë.'

---

<sup>a</sup> Fjalë për fjalë: 'fytyrën'.

43 [Profet,] qëndro fort në përkushtimin tënd  
në fenë e drejtë,  
para se të vijë nga **Allahu**  
një Ditë e pafrenueshme.

Në atë Ditë, njerëzimi do të ndahet:

44 ata që e refuzuan të vërtetën  
do ta mbajnë barrën e atij refuzimi,  
dhe ata që bënë vepra të mira  
do të kenë krijuar kushte të mira për vete.

45 **Allahu** do t'i shpërblejë nga mirësia E Tij  
ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira;  
Atij nuk i pëlqejnë  
ata që e refuzojnë të vërtetën.

46 Një nga shenjat E Tij  
është se Ai i dërgon erërat  
që bartin lajme të gëzuara,  
duke jua dhënë një shijim  
të hijeshisë Së Tij,  
duke i bërë anijet të lundrojnë  
sipas komandës Së Tij,  
duke jua mundësuar  
[të udhëtoni që] ta kërkoni  
mirësinë E Tij,  
që të mund të jeni mirënjohës.

47 Para teje [Muhamed],  
kemi çuar të Dërguar,  
secilin popullit të tij:  
ata u sollën prova të qarta  
dhe pastaj i ndëshkuam keqbërësit.  
Ne e bëmë obligim Tonin  
t'u ndihmonim besimtarëve.

- 48 Është **Allahu** që i dërgon erërat;  
ato i gjallërojnë retë;  
i shpërndan nëpër qiej,  
siç i pëlqen Atij;  
i bën të ndahen,  
dhe ti e sheh shiun tek bie nga to.  
Shih si gëzohen ata  
kur Ai e lëshon atë të bie  
mbi këdo që do  
ndër shërbyesit E Tij,
- 49 megjithëse para se të lëshohej,  
mund ta kishin humbur tërë shpresën.
- 30:50 Shih, pra, gjurmët e mëshirës së **Allahut**,  
si e gjallëron tokën pas vdekjes:  
ky **Allahu** i njëjtë është Ai  
që do t'i kthejë njerëzit në jetë pas vdekjes –  
Ai ka pushtet mbi të gjitha gjërat.
- 51 E megjithatë ata do të vazhdojnë në mosbesimin e tyre,  
edhe po ta dërgonim një erë [përvëluese]  
dhe ta shihnin si zverdhen të korrat e tyre.
- 52 [Ti Profet] nuk mund t'i bësh të vdekurit të dëgjojnë,  
dhe s'mund t'i bësh të shurdhrit ta dëgjojnë thirrjen tënde  
kur e kthejnë shpinën dhe largohen;
- 53 nuk mund t'i udhëzosh të verbrit  
t'i largohen gabimit të tyre;  
të vetmit që mund t'i bësh të dëgjojnë  
janë ata që besojnë në shpalljet Tona  
dhe përkushtohen [ndaj Nesh].
- 54 Është **Allahu** që ju krijon të dobët,  
pastaj ju jep fuqi,  
pastaj dobësi pas fuqisë,  
bashkë me flokët tuaj të thinjur:  
Ai krijon çkado që do të krijojë;  
Ai është I Gjithë-Dijshmi, I Gjithë-Fuqishmi.

- 55 Në ditën kur vjen Ora,  
fajtorët do të betohen se mbetën vonë  
jo më shumë se një orë –  
gjithmonë kanë qenë në deluzion –
- 56 por të pajisurit me dije dhe besim do të thonë:  
‘Në përputhje me Dekretin e **Allahut**,  
në fakt keni mbetur vonë,  
deri në Ditën e Ringjalljes:  
kjo është Dita e Ringjalljes,  
e megjithatë nuk e keni ditur.’
- 57 Në atë Ditë arsyetimet e keqbërësve  
nuk do t’u hyjnë në punë:  
nuk do t’u lejohet të bëjnë kompensime.
- 58 Në këtë Kuran e kemi parashtruar  
çdo lloj të ilustrimit para popullit,  
e megjithatë nëse [ti Profet] do t’ua sillje një mrekulli,  
mosbesimtarët prapë do të thoshin:  
‘Ju [profetë] mirreni veç me gënjeshtër.’
- 59 Kështu **Allahu** i vulos zemrat  
e atyre që nuk dinë,  
30:60 pra ji i durueshëm,  
se premtimi i **Allahut** është i vërtetë:  
mos i lejo të të dekurajojnë  
ata pa bindje të qëndrueshme.



**Përshkrimi para kaptinës 30 nga Abdel Haleem:**

*Sure mekase që hapet me një referencë në disfatën e bizantinëve në duart e persëve (613-14 ER) në Siri dhe fitoren pasuese të bizantinëve më 624 ER. Surja i nxit njerëzit të reflektojnë mbi krijimin e vetes, qiejt dhe tokën dhe të gjitha mrekullitë e **Allahut**. Fuqia e **Allahut** për t'i dhënë jetë një toke shterpe përsëritet si tregues edhe i aftësisë Së Tij për t'i ngritur të vdekurit edhe i mëshirës Së Tij për njerëzimin. Mosbesimtarët paralajmërohen të besojnë para se të jetë shumë vonë; Profeti nxitet të ngulmojë dhe t'i injorojë talljet e mosbesimtarëve.*

**Shënimet gjuhësore (Thomas Cleary)**

*Roma (al Ruum) (Kaptina 30)*

Kjo sure u shpall në Mekë. Roma (Ruum) këtu e ka kuptimin e Perandorisë Romake Bizantine, që ishte në luftë me Perandorinë Perse në kohën e misionit të Muhamedit. Qytetet kryesore të Sirisë u morën prej sundimit bizantin nga Persët më 611 dhe Jerusalemi u pushtua dhe u plaçkit më 614-615. Kjo do të dukej të jetë disfata e Romës së cilës i referohet kjo sure. Mirëpo, në 620tat, rrethanat ndryshuan krejtësisht, siç parashikohet në Kuran, deri kur Bizantinët dolën fitimtarë më 628.

- 9 “e ta shohin si mbaruan ata para tyre”: Shoqëri më të fuqishme, më të populluara, më të përparuara dhe më të arsimuara tashmë kishin kapitulluar, kështu që askush nuk mund të jetë i sigurt për shkak të fuqisë, personelit, pasurisë apo arsimimit.

“Ata ishin më të fuqishëm se këta”: Këtu “këta” i referohet njerëzve bashkëkohorë.

- 21 “që të jetoni me ta në qetësi”: Folja është e masës së parë të rrënjës S-K-N, që domethënë të jesh në prehje, i qetë, paqësor, të rrish rehat, të të sigurojnë se çdo gjë është në rregull, të besosh, të kesh besim, të ndihesh si në shtëpi, të jetosh, të banosh.

- 22 Dallimet kulturore dhe raciale kanë shkaktuar grindje midis atyre që e nderojnë veten më shumë se **Allahun**; për ata që i nderojnë shenjat e **Allahut**, për dallim, shumëllojshmëria është begati dhe burim i begatisë, mjet me të

cilin komunitetet mund të mësojnë të bëhen më shumë se shuma e pjesëve të tyre.

- 26 “të gjithë janë të bindur ndaj Tij”: Secili, madje edhe të pabindurit dhe rebelët, u nënshtrohen ligjeve të natyrës.
- 28 “a i bëni skllëverit tuaj”: **Allahu** është përtej fuqisë së të gjitha zotësive të nënrenditura.
- 37 “**Allahu** i jep me bollëk kujtdo që do t’i japë dhe me masë [kujtdo që do t’i japë]”: Njerëzit nuk duhet të bëhen të vetëkënaqur apo të dëshpëruar kur batica e fatit të tyre ngritet apo zbritet; duke ia referuar të gjitha çështjet **Allahut**, mund ta arrijnë gjakftohtësinë.
- 39 “Çkado që jepni hua në fajde për të fituar vlerë”: Ngritja dhe shembja e palavdishme e “perandorive” financiare e bazuar në manipulimin e parave në vend se në prodhimin dhe shpërndarjen e të mirave të nevojshme e të dobishme duket sikur e konfirmon të vërtetën e mosmiratimit Kuranor të praktikave ekonomike që funksionojnë si reaktorë të shumimit për fitim të tepruar.
- 41 “do t’i bëjë t’i shijojnë pasojat e ca veprave të tyre”: Pasojat e këqija të keqbërjeve duhet të shihen si mësim dhe paralajmërime, që njerëzit të mund “të kthehen prapa” nga gabimi.
- 51 “t’i shihnin të korrat e tyre si zverdhjen”: Zverdhja do të thotë tharje, vyshkje, shkatërrim i të korrave të gjelbërta: kur një erë e keqe i than pasuritë e tyre të zakonshme, njerëzit e pasigurt për **Allahun** janë të prirur të dëshpërohen dhe ta mohojnë bujarinë e **Allahut**.
- 59 “Kështu **Allahu** i vulos zemrat”: Fjala për vulosje është nga masa e parë e rrënjës **T-B-**!, që domethënë të vulosësh, të ngulitësh, të lësh përshtypje; në diatezën pësore domethënë të kesh dhunti apo prirje natyrale. Reagimi i ashpër ndaj të vërtetës është karakteristikë e atyre që nuk e ushtrojnë zotësinë e perceptimit dhe aftësinë dalluese (e sugjeruar nga folja arabe “të dish” **-L-M** e përdorur këtu).
- 60 Misioni i Profetit është ta japë mesazhin e shpallur, e jo t’i akomodojë dyshuesit dhe kritikët; prandaj Muhamedi udhëzohet të përqendrohet në të

vërtetën e jo ta ndërrojë drejtimin nga ata që lëkunden. Profet i rremë është ai që kërkon ndjekës personalë, e jo të vërtetën dhe prandaj përthithet nga kërkesat e “konsumuesve” të cilët po mundohet t’i ngopë.

## 31: Lukmani (LUKMÂN)

Në emrin e **Allahut**, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës

- <sup>1</sup> *Elif Lam Mim*
- <sup>2</sup> Këto janë vargjet  
e Shkrimit të Shenjtë të urtë,  
<sup>3</sup> [me] udhëzim e mëshirë  
për ata që bëjnë mirë,  
<sup>4</sup> që luten e falen rregullisht,  
e paguajnë lëmoshën e përcaktuar,  
dhe janë të sigurt për Të Përtejmen:  
<sup>5</sup> këta janë të udhëzuar drejt nga Zoti i tyre,  
dhe janë ata që do të përparojnë.  
<sup>6</sup> Por është lloji i personit  
që paguan për përralla shpërqendruese,  
me synimin, pa ndonjë dije,  
t'i devijojë të tjerët nga rruga e **Allahut**,  
dhe ta bëjë [atë rrugë] objekt për tallje.<sup>a</sup>  
Do të ketë torturë poshtëruese për të!  
<sup>7</sup> Kur i recitohen vargjet Tona,  
largohet me përbuzje  
si të mos i kishte dëgjuar,  
si të kishte rëndim në veshë.  
Tregoji se do të ketë torturë të dhembshme!  
<sup>8</sup> Por për ata që besojnë  
dhe bëjnë vepra të ndershme,  
do të ketë Kopshte të lumturisë  
<sup>9</sup> ku do të rrinë:  
ky është premtimi i vërtetë i **Allahut**,  
dhe Ai është I Gjithë-Fuqishmi, I Gjith'-Urti.

---

<sup>a</sup> Kjo kuptohet se i referohet al-Nadr ibn al-Harith-it, që i bleu disa rrëfime të lashta të Persisë për ta shpërqendruar popullin e Kurjeshëve nga dëgjimi i Kuranit.

- 31:10 Ai i krijoi qiejt  
pa ndonjë mbështetje të dukshme,  
dhe vuri në tokë male të forta –  
në rast se ajo duhet të dridhet nën ju –  
dhe i shpërndau nëpër të  
të gjitha llojet e kafshëve.  
Ne e zbritëm ujin nga qielli,  
me të cilin e bëmë çdo lloj bime të mirë  
të rritet në tokë:
- 11 tërë kjo është krijim i **Allahut**.  
Tani, më trego Mua  
se çka kanë krijuar zotat tuaj të tjerë.  
Jo, mosbesimtarët janë të devijuar qartë.
- 12 Ne e pajisëm Lukmanin me urti:  
‘Ji mirënjohës ndaj **Allahut**:  
kushdo që falënderon  
e bën këtë në dobi të shpirtit të tij,  
dhe sa për ata që janë jofalënderues –  
epo, **Allahu** është i vetë-mjaftueshëm,  
i denjë për tërë lândin.
- 13 Lukmani e këshilloi të birin:  
‘Biri im, mos i shoqëro asnjë partner **Allahut**:  
t’i shoqërosh partnerë është gabim i tmerrshëm.’
- 14 Ne i kemi urdhëruar njerëzit  
të jenë të mirë me prindërit e tyre:  
nënat e tyre i bartën,  
me sforcim mbi sforcim,  
dhe duhen dy vite për t’u hequr nga gjiri.  
M’u falënderoni Mua  
dhe prindërve tuaj –  
të gjithë do të kthehen tek Unë.

- 15 Nëse përpiqen t'ju bëjnë  
të shoqëroni me Mua çkadoqoftë  
për të cilën nuk keni dije,  
atëherë mos iu bindni.  
E megjithatë shoqërohuni me ta  
në mënyrë të sjellshme  
në atë që është e drejtë,  
dhe ndiqeni rrugën  
e atyre që kthehen kah Unë.  
Të gjithë do të ktheheni kah Unë në fund,  
dhe do t'ju tregoj  
gjithçka që keni bërë.
- 16 [Dhe Lukmani vazhdoi:]  
'Biri im, sikur edhe pesha  
e farës së sinapit  
të ishte fshehur në një gur  
apo kudo në qiej a tokë,  
**Allahu** do ta sillte [në dritë],  
se Ai është i gjithë-mprehti  
dhe i gjith'-informuari.
- 17 Lutu e falu rregullisht, biri im;  
urdhëroje atë që është e drejtë;  
ndaloje atë që është e gabuar;  
qëndroji me vendosmëri gjithçkaje që të ndodh:  
këto janë gjërat e aspirueshme.
- 18 Mos i çohundët me nënçmim ndaj njerëzve  
se mendon se nuk janë mjaft të mirë për ty,  
as mos ec nëpër vend me arrogancë,  
se **Allahu** nuk i do arrogantët as mburravecët.
- 19 Ec me ritëm të moderuar  
dhe ule zërin,  
se më i keqi nga të gjithë zërat  
është pëllitja e gomarëve.'

- 31:20 [Njerëz,] a nuk e shihni  
se si **Allahu** i ka bërë  
ato që janë në qiej dhe në tokë  
të dobishme për ju,  
dhe i ka lëshuar begatshëm  
bekimet E Tij në ju  
edhe përjashtë edhe përbrenda?  
E megjithatë disa njerëz  
grinden për **Allahun**,  
pa dije a udhëzim  
a shkrim të shenjtë përndritës.
- 21 Kur u thuhet:  
'Ndiqeni atë që e ka zbritur **Allahu**,'  
thonë: 'Do ta ndjekim atë që e pamë  
se e ndiqnin paraardhësit tanë.'  
Çka?! Edhe nëse Satani po i thërret  
në vuajtjet e Zjarrit Flakërues?
- 22 Kushdo që e drejton veten plotësisht kah **Allahu**  
dhe bën vepër të mirë  
e ka rrokur kapësen më të sigurt,  
se rezultati i gjithçkaje është me **Allahun**.
- 23 Sa për ata që refuzojnë ta bëjnë këtë,  
mos lejo që refuzimi i tyre të të pikëllojë [Profet] –  
do të kthehen te Ne  
dhe do t'u tregojmë se çka kanë bërë:  
**Allahu** e di fare mirë  
tërë atë që e përmbajnë zemrat –
- 24 Ne i lëmë të kënaqen për pak,  
por do t'i dëbojmë në torturë të ashpër.
- 25 Nëse i pyet  
se kush i krijoi qiejt dhe tokën,  
sigurisht që thonë: '**Allahu**.'  
Thuaj: 'Lâvdi i përket **Allahut**,

por shumica nga ta nuk kuptojnë.

<sup>26</sup> Gjithçka në qiej dhe në tokë i përket **Allahut**.

**Allahu** është i vetë-mjaftueshëm  
dhe i denjë për gjithë lâvdin.

<sup>27</sup> Po të ishin pena të gjitha pemët në tokë,  
dhe të gjitha detet –  
edhe me shtatë dete të tjera përkrah [– të ishin bojë],  
prapë nuk do të mbaronin fjalët e **Allahut**:

**Allahu** është i gjithë-fuqishëm dhe i gjith’-urtë.

<sup>28</sup> Krijimi dhe ringjallja e të gjithë juve  
është veç si krijimi a ringjallja e një shpirti të vetëm:  
**Allahu** është gjithë-dëgjues dhe gjithë-pamës.

<sup>29</sup> [Profet,] a nuk e sheh se **Allahu**  
e bën natën të shkrihet në ditë  
dhe ditën të shkrihet në natë;  
se i ka nënshtruar diellin dhe hënën,  
secili të shkojë rrugës së vet për një afat të caktuar;  
se është i informuar për gjithçka që bëni [ju njerëz]?

<sup>31:30</sup> Është kështu për shkak se **Allahu** është E Vërteta,  
dhe ajo që e thërrasin pos Tij është e rreme.  
Ai është Më I Larti, Më I Madhi.

<sup>31</sup> [Profet,] a nuk e sheh  
se anijet lundrojnë nëpër det,  
sipas mirësisë së **Allahut**,  
për t’jua treguar [juve njerëz]  
disa nga mrekullitë E Tij?  
Vërtet ka shenja në këtë  
për çdo person të qëndrueshëm, falënderues.

<sup>32</sup> Kur valët shfaqen me kërcënim  
si hije gjigante mbi ata që janë në anije  
ata i thërrasin **Allahut**,  
duke ia kushtuar plotësisht fenë e tyre.  
Por, kur Ai t’i ketë dërguar



të sigurt në tokë,  
disa nga ta lëkunden –  
veç një person tradhtar, jofalënderues  
refuzon t'i pranojë shenjat Tona.

<sup>33</sup> Njerëz,  
jini të vetëdijshtëm për Zotin tuaj  
dhe frikësojuni një dite  
kur asnjë prind nuk do të kompensojë  
për fëmijën e tij,  
dhe asnjë fëmijë  
për prindin e tij,  
në asnjë mënyrë.

Premtimi i **Allahut** është i vërtetë,  
pra mos e lejoni jetën e tanishme t'ju hutojë,  
as mos e lejoni Mashtruesin  
t'ju hutojë për **Allahun**.

<sup>34</sup> Të diturit e Orës [së Ringjalljes]  
i përket **Allahut**;  
është Ai që e zbret shiun lehtësues  
dhe është Ai që e di atë që është e fshehur në mitra.  
Asnjë shpirt nuk e di  
se çka do të korrë nesër,  
dhe asnjë shpirt nuk e di  
se në çfarë toke do të vdesë;  
është **Allahu** që është i gjithë-dituri  
dhe i gjith'-informuari.

**Përshkrimi para kaptinës 31 nga Abdel Haleem:**

*Sure mekase që e merr titullin nga Urtaku Lukman, këshilla e të cilit për të birin tregohet në vargjet 13-19. Surja hapet me një përshkrim të besimtarëve dhe i ndëshkon ata që përpiqen t'i largojnë të tjerët nga udhëzimi. Ajo e lartëson fuqinë e Allahut dhe i paralajmëron mosbesimtarët për pasojat e veprimeve të tyre. Profetit i thuhet të mos pikëllohet nga mosbesimi i tyre.*

**Shënimet gjuhësore (Thomas Cleary)**

*Lukmani (Kaptina 31)*

Kjo sure u shpall në Mekë. Është emëruar sipas një urtaku të lashtë, fjalët këshilluese të të cilit për të birin e tij e përbëjnë një pjesë të madhe të kaptinës.

12 “dhe sa për ata që janë jofalënderues – epo, **Allahu** është i vetë-mjaftueshëm”: **Allahu** nuk ka nevojë për lavdërime dhe shërbim nga njerëzimi; njerëzimi ka nevojë ta lavdërojë dhe t'i shërbejë **Allahut**.

13 “t'i shoqërosh partnerë Atij është gabim i tmerrshëm”: Nëpër të gjithë Kuranin, idhujtaria (*shirk* apo shoqërimi apo barazimi i çfarëdo gjëje apo kujtdoqoftë me **Allahun**) është mëkati kryesor, se është shprehja thelbësore e pavëmendësisë ndaj natyrës absolute të **Allahut**.

14 “nënat e tyre i bartën, me sforcim mbi sforcim”: Sipas traditës, dikush e pyeti Profetin Muhamed se kush është më meritori për dashamirësinë e njeriut. Profeti u përgjigj: ‘Nëna jote.’ Pyetësi pyeti: ‘Pastaj kush?’ Profeti u përgjigj: ‘Nëna jote.’ Pyetësi pyeti: ‘Pastaj kush?’ Profeti u përgjigj: ‘Nëna jote.’ Pyetësi pyeti: ‘Pastaj kush?’ Profeti u përgjigj: ‘Babai yt.’

15 “në mënyrë të sjellshme” (*ma!ruuf*): Kjo është pjesorja e shkuar pësore e *!arafa*, “të dish” dhe fjalë për fjalë domethënë “i ditur, i njohur”, por kjo i sjell me vete edhe kuptimet e: i pranuar universalisht, i njohur përgjithësisht, konvencional, i përshtatshëm, që është i mirë a i dobishëm, barabarësi, dashamirësi, sjellje miqësore, mirëbërje, mirësjellje. Këtu përdoret në mënyrë ndajfoljore. Njerëzit nuk janë urdhëruar t'u binden prindërve në mënyrë të pakushtëzuar, se E Vërteta është pika vendimtare e referimit (“Ju të gjithë do

të ktheheni kah Unë në fund”); por nga ne kërkohet të jemi të sjellshëm dhe të drejtë me prindërit tanë edhe nëse në parim ka mospajtim.

- 19 “Ec me ritëm të moderuar”: Folja Q-S-D domethënë të jesh i moderuar, të drejtosh në drejtim të mesëm; po ashtu i ka kuptimet: ki qëllim, vazhdo menjëherë, aspiro, syno, reflekto, konsidero, destinim; pra shprehja e përdorur nga Lukmani sugjeron jo vetëm moderim dhe balans por edhe drejtim të qëllimshëm; vepro me paramendim dhe me qëllim, pa shkuar në ekstreme.
- 21 Obsesionuesi apo I Mbrapshti, apo Kokëforti është Pëshpëritësi i sugjerimit që ua bën njerëzve të dashura shprehitë e tyre (“atë që e pamë ta ndiqnin paraardhësit tanë”) në shkallë të tillë sa që injorojnë gjithçka tjetër.
- 25 Njerëzit mund ta pranojnë sipërfaqësisht se gjithësia erdhi nga diku dhe reflekton dizajn madhështor, pa e vërejtur hijeshinë e **Allahut** në zemër.
- 27 Klasiku budist “Shkrimi i shenjtë i zbukurimit të lules” thotë: “Buda ma zbuloi një mësim që quhet syri universal që është sfera e gjithçkaje të përndritur, duke e zbuluar praktikën e qenieve përndritëse, duke e treguar diferencimin e rrafshëve të të gjitha gjithësive, duke i treguar sferat e të gjitha të vërtetave bashkë, dritën që i pastron të gjitha tokat, që i zhdruk të gjithë sfiduesit, që i shkatërron të gjithë demonët e djajtë, që i bën të gjitha qeniet të lumtura, që i ndriçon zbraztësitë e mbetura të fshehura të mendjeve të të gjitha qenieve, që komunikon me të gjitha qeniet në përputhje me mendësitë e tyre, që e ndriçon shpalosjen e shqisave të të gjitha qenieve. Dhe e kam marrë atë mësim të syrit universal, e mbaj në mendje, e zbatoj dhe reflektoj për të, duke e marrë në këtë mënyrë: edhe po të ishte shkruar nga një koleksion i penave me madhësi të maleve polare me po aq bojë sa uji në oqeanë, nuk do të mund të mbarohej kurrë; do të ishte e pamundur ta mbaroje madje edhe veç një pjesë të të një rreshti të vetëm të një formule të vetme të një parimi të vetëm të një doktrine të vetme të një kaptine të vetme të mësimi. Madje as pjesërisht nuk mund të shterohet, e lëre më të shterohet a të kuptohet plotësisht” (Libri XXXIX).
- 33 “as mos e lejoni Mashtruesin t’ju hutojë”: Mashtruesi, Al Gharuur është një tjetër përshkrim i personifikuar i djallit. Nxirret nga rrënja GH-R-R, nga e cila vijnë *gharra*: mashtro, çoriento, gënjeje, mashtro me joshje, verbo, habit; *ghuruur*: mashtrim, deluzion, vetë-qendërzim i tepruar, snobizëm, kotësi, gjëra të vogla, banalitet, rrezik; dhe *ghirra*: moskokëçarje, pavëmendësi.

## 32: Përkulja në adhurim (ES-SEXHDE)

Në emrin e **Allahut**, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës

<sup>1</sup> *Elif Lam Mim*

<sup>2</sup> Ky shkrim i shenjtë, i pastër nga çdo dyshim, është zbritur nga Zoti i Botëve.  
<sup>3</sup> E megjithatë thonë: ‘Muhamedi e ka sajuar.’ Jo në fakt! Është E Vërteta nga Zoti yt për ty [Profet], për ta paralajmëruar një popull që nuk e kanë pasur askë t’i paralajmërojë më parë, që të mund të udhëzohen. <sup>4</sup> Është **Allahu** Ai që i krijoi qiejt dhe tokën dhe gjithçka ndërmjet tyre për gjashtë Ditë. Pastaj u vendos në Fron. [Ju njerëz] nuk e keni askë pos Tij t’ju mbrojë dhe askë të ndërmjetësujë për ju, pra pse nuk jeni të vëmendshëm? <sup>5</sup> Ai menaxhon gjithçka, që nga qiejt deri në tokë dhe gjithçka do të ngritet tek Ai në fund, në një Ditë që do ta ketë masën e njëmijë viteve sipas llogarisë suaj. <sup>6</sup> I tillë është Ai që e di krejt atë që është e padukshme si dhe atë që është e dukshme, I Gjithë-Fuqishmi, Mëshirëploti, <sup>7</sup> që të gjithave ua dha formën e tyre të përsosur. Së pari e krijoi njeriun nga balta, <sup>8</sup> pastaj i bëri pasardhësit e tij nga një ekstrakt i lëngut të nënvlerësuar.<sup>a</sup> <sup>9</sup> Pastaj e formësoi; fryu nga Shpirti I Tij brenda tij; jua dha dëgjimin, të pamurit dhe mendjet. Sa rrallë jeni mirënjohës! <sup>32:10</sup> Thonë: ‘Çka? Kur të jemi zhdukur brenda në tokë, vërtet do të krijohemi rishtas?’ Në fakt, e mohojnë takimin me Zotin e tyre. <sup>11</sup> Thuaj: ‘Engjëlli i Vdekjes i ngarkuar me përgjegjësi për ju do t’ju rimarrë dhe pastaj do t’ju kthejnë te Zoti juaj.’

<sup>12</sup> [Profet,] veç po të mund t’i shihje keqbërësit si i varin kokat e tyre përpara Zotit të tyre: ‘Zoti ynë, tani që kemi parë e dëgjuar, na kthe dhe do të bëjmë mirë. [Tash] jemi të bindur.’ <sup>13</sup> ‘Po të kish qenë vullneti Ynë, sigurisht që do t’ia kishim dhënë secilit shpirt udhëzimin e tij, por fjalët E Mija janë realizuar. “Do të sigurohem ta mbush Ferrin me xhinde dhe njerëz bashkërisht.” <sup>14</sup> Pra meqë e shpërfillët takimin në këtë Ditë tuajën, tash Ne do t’ju shpërfillim juve: shijojeni vuajtjen e vazhdueshme për krejt çka keni bërë.’

<sup>15</sup> Njerëzit e vetëm që vërtet besojnë në mesazhet Tona janë ata që, kur ua përkujtojnë ato, përkulen në adhurim, i festojnë lavdet e Zotit të tyre dhe nuk e mendojnë veten mbi këtë. <sup>16</sup> Të tillët i shmangin shtretërit e tyre në mënyrë që t’i falen Zotit të tyre me frikë e shpresë; u japin të tjerëve ca nga ajo që ua kemi dhënë. <sup>17</sup> Asnjë shpirt nuk e di se çfarë gëzimi ruhet i fshehur për ta si shpërblim për atë që e kanë bërë. <sup>18</sup> Pra, a është dikush që beson – i barabartë me dikë që i kundërvihet **Allahut**? Jo, nuk janë të barabartë. <sup>19</sup> Ata që besojnë dhe bëjnë vepra

---

<sup>a</sup> Sperma.

të mira do të kenë Kopshte që i presin, si shtëpi të tyre dhe si shpërblim për atë që e kanë bërë. <sup>32:20</sup> Sa për ata që i kundërvihen **Allahut**, shtëpia e tyre do të jetë Zjarri. Kurdo që provojnë t'i ikin, do të shtyhen prapa në të dhe do t'u thuhet: 'Shijojeni torturën e Zjarrit, të cilin e mohuat me këmbëngulje.' <sup>21</sup> Sigurisht që do t'i bëjmë ta shijojnë një torturë më të afërt [në këtë jetë] para torturës më të madhe, ashtu që mbase mund të kthehen [në rrugën e duhur]. <sup>22</sup> Kush bën më shumë keq se dikush që, kur i recitohen mesazhet nga Zoti i tij, largohet nga to? Do të shkaktojmë ndëshkim për fajtorët.

<sup>23</sup> Ne ia dhamë Musait Shkrimin e Shenjtë – kështu që [Muhamed] mos dysho që po e pranon atë – dhe e bëmë atë udhëzues për Fëmijët e Izraelit. <sup>24</sup> Kur u bënë të qëndrueshëm dhe besuan fort në mesazhet Tona, ngritëm udhëheqësa ndër ta, duke i udhëzuar sipas urdhrin Tonë. <sup>25</sup> [Profet,] është Zoti yt që do të gjykojë mes tyre në Ditën e Ringjalljes në lidhje me dallimet e tyre.

<sup>26</sup> A nuk është mësim për ta [ta shohin] se sa shumë breza i shkatërroam para atyre, në shtëpitë e të cilëve tani ecin? Vërtet ka shenja në këtë – a nuk dëgjojnë? <sup>27</sup> A nuk e marrin parasysh si e çojmë shiun në tokën djerrë dhe me të prodhojmë bimësi nga të cilat hanë bagëtitë e tyre dhe ata vetë? A nuk shohin? <sup>28</sup> Dhe thonë: 'Kur do të jetë ky Vendim, nëse po e tregon të vërtetën?' <sup>29</sup> Thuaj: 'Në Ditën e Vendimit nuk do të ketë dobi që mosbesimtarët të besojnë; nuk do t'u jepet kurrfarë afati.' <sup>32:30</sup> Pra [Profet], largohu nga ta dhe prit: edhe ata po presin.

**Përshkrimi para kaptinës 32 nga Abdel Haleem:**

*Sure mekase që e merr titullin nga përkulja e besimtarëve të vërtetë në adhurim në vargun 15. Theksohet e vërteta e Kuranit në fillimin e sures dhe në fund të sures Profeti nxitet të mos u kushtojë vëmendje mosbesimtarëve që nuk mund ta shohin domethënien e shenjave të Allahut.*

### 33: Forcat e bashkuara (EL-AHZÂB)

Në emrin e **Allahut**, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës

<sup>1</sup> Profet, ji i vetëdijshëm për **Allahun** dhe mos u lësho pe mosbesimtarëve dhe hipokritëve: **Allahu** është i gjithë-dijshmi, i gjith'-urti. <sup>2</sup> Ndiqe atë që ta shpall Zoti yt: **Allahu** është fare mirë i informuar për të gjitha veprimet tuaja. <sup>3</sup> Kije besimin tënd në **Allahun**: **Allahu** është i mjaftueshëm për të besuar. <sup>4</sup> **Allahu** nuk i vendos dy zemra brenda gjoksit të një njeriu. Nuk i shndërron gratë – që i refuzoni dhe i krahasoni me shpinat e nënave tuaja<sup>a</sup> – në nëna tuaja të vërteta; as nuk jua shndërron bijtë e birësuar në bij të vërtetë. Këto janë veç fjalë nga gojët tuaja, gjersa **Allahu** e flet të vërtetën dhe i udhëzon njerëzit në rrugën e duhur.

<sup>5</sup> Emëroni bijtë tuaj të birësuar sipas etërve të tyre të vërtetë: kjo është më e drejtë në sytë e **Allahut** – nëse nuk e dini se kush janë etërit e tyre [ata janë] ‘vëllezërit tuaj në fe’ dhe të mbrojturit tuaj.<sup>b</sup> Nuk do të fajësoheni nëse e bëni ndonjë gabim, po veç për atë që e synojnë qëllimisht zemrat tuaja; **Allahu** është më falësi dhe mëshirëploti. <sup>6</sup> Profeti është më mbrojtës ndaj besimtarëve se sa ata vetë, gjersa gratë e tij janë nënat e tyre.<sup>c</sup> Në Shkrimin e Shenjtë të **Allahut**, të afërmit e gjakut kanë pretendim më të fortë se besimtarët e tjerë dhe të mërguarit, megjithëse prapë mund t’u jepni dhurata të mbrojturve tuaj. Krejt kjo është e shkruar në Shkrimin e Shenjtë.

<sup>7</sup> Ne morëm premtim solemn nga profetët – nga ti [Muhamed], nga Nuhu, nga Ibrahim, nga Musai, nga Isai, i biri i Merjemes – morëm premtim solemn nga të gjithë ata: <sup>8</sup> **Allahu** do t’i marrë në pyetje [madje] edhe të çiltërit për sinqeritetin e tyre dhe për ata që e refuzojnë të vërtetën ka përgatitur torturë të dhembshme.

<sup>9</sup> Ju që besoni, kujtojeni mirësinë e **Allahut** kur ushtritë e fuqishme u mblodhën kundër jush: Ne e dërguam një erë të fortë dhe forca të padukshme kundër tyre. **Allahu** sheh gjithçka që bëni. <sup>33:10</sup> Ata u mblodhën kundër jush nga lart dhe nga poshtë; sytë tuaj u rrotulluan [me frikë], zemrat tuaja u ngritën gjer te fyti dhe menduat mendime [të këqija] për **Allahun**. <sup>11</sup> Aty besimtarët u sprovuan rëndë dhe u tronditën thellë: <sup>12</sup> hipokritët dhe të sëmuret në zemër thanë: ‘**Allahu** dhe I Dërguari I Tij s’na kanë premtuar asgjë pos deluzione!’

---

<sup>a</sup> Në Arabinë para-islamike burri ndonjëherë i thoshte gruas së tij: ‘Tash e tutje, ti je për mua si shpina e nënës sime’, me çka nënkuptonte se refuzonte të kishte më marrëdhënie bashkëshortore me të, e megjithatë nuk e divorconte dhe t’ia jipte kështu lirinë të ri-martohej. (shih 58:1-4).

<sup>b</sup> *Mawla* arabisht ka shumë kuptime, që përfshijnë ‘i mbrojtur (protégé)’, ‘klient’, ‘shoqëruar’.

<sup>c</sup> Grave të Profetit u ishte dhënë titulli ‘Nënat e Besimtarëve’. Krahaso me vargun 53.

<sup>13</sup> Disa nga ta thanë: ‘Njerëz të Jethribit,<sup>a</sup> nuk do të jeni në gjendje ta përballoni [sulmin], pra kthehuni!’ Disa nga ta e kërkuan lejen e Profetit për t’u larguar, duke thënë: ‘Shtëpitë tona janë të ekspozuara’, edhe pse nuk ishin – veç donin të iknin: <sup>14</sup> po të pushtohej qyteti nga të gjitha anët dhe armiku t’i ftonte të rebeloheshin, do ta bënë këtë pothuaj pa hezitim. <sup>15</sup> E megjithatë tashmë i patën premtuar **Allahut** se nuk do të iknin me bisht ndër këmbë dhe një premtim ndaj **Allahut** do të marrë përgjigje. <sup>16</sup> [Profet,] thuaj: ‘Ikja nuk do t’ju sjellë dobi. Nëse ia dilni t’i shpëtoni vdekjes apo therjes, do të lejoheni ta shijoni [jetën] veç për pak kohë.’ <sup>17</sup> Thuaj: ‘Nëse **Allahu** dëshiron t’ju dëmtojë, kush mund t’ju mbrojë? Nëse **Allahu** dëshiron t’ju shfaqë mëshirë, kush mund ta pengojë?’ Ata nuk do ta gjejnë askë pos **Allahut** për t’i mbrojtur a ndihmuar.

<sup>18</sup> **Allahu** e di saktësisht se kush nga ju i pengon të tjerët, kush u thotë [fshehtas] vëllezërve të tyre: ‘Ejani dhe bashkohuni me ne’, kush del rrallë-e-hiç ndonjëherë për të luftuar, <sup>19</sup> kush jua ka zili [juve besimtarëve] çfarëdo ndihme. Kur të vijë frika,<sup>b</sup> [ti Profet] i sheh duke të shikuar me sytë që rrotullohen si dikush në grahmat e vdekjes; kur frika të ketë kaluar, të sulmojnë me gjuhë të mprehta dhe ta kanë zili për çfarëdo të mire. Njerëzit e tillë nuk besojnë dhe **Allahu** i kthen veprat e tyre në asgjë – kjo është krejt e lehtë për **Allahun**.<sup>33:20</sup> Mendojnë se forcat e bashkuara nuk kanë shkuar dhe nëse forcat e bashkuara do të vinin prapë do të dëshironin të ishin në shkretëtirë, duke bredhur mes beduinëve dhe duke kërkuar lajme për ju [nga një largësi e sigurt]. Edhe po të ishin me ju [besimtarë], vështirë se do të luftonin fare. <sup>21</sup> I Dërguari I **Allahut** është model i shkëlqyeshëm për ata nga ju që e mbajnë shpresën në **Allahun** dhe në Ditën e Fundit dhe e kujtojnë Atë shpesh.

<sup>22</sup> Kur besimtarët i panë forcat e bashkuara, thanë: ‘Kjo është ajo që **Allahu** dhe I Dërguari I Tij na premtuan: premtimi i **Allahut** dhe i Të Dërguarit Të Tij është i vërtetë’ dhe kjo veç shërbeu për ta rritur besimin dhe përuljen e tyre ndaj **Allahut**. <sup>23</sup> Ka njerëz ndër besimtarë të cilët e mbajtën zotimin e tyre ndaj **Allahut**: disa nga ta e kanë plotësuar me vdekje dhe disa po presin ende. Nuk kanë ndryshuar aspak. <sup>24</sup> [Sprovat e tilla janë paracaktuar] që **Allahu** të mund t’i shpërblejë të çiltërit për ndershmerinë e tyre dhe t’i ndëshkojë hipokritët nëse Ai do, apo të mund të zbutet ndaj tyre, se **Allahu** është falës dhe mëshirëplotë. <sup>25</sup> **Allahu** i zbrapsi mosbesimtarët<sup>c</sup> bashkë me zemërimin e tyre – nuk patën kurrfarë dobie – dhe i kurseu besimtarët nga luftimet. Ai është i fortë dhe i fuqishëm. <sup>26</sup> I sollli ata Njerëz të Librit që i përkrahën ata poshtë nga kështjellat e tyre dhe vuri panik në zemrat e tyre. Disa nga ta [ju besimtarë] i vratë dhe disa i

---

<sup>a</sup> Emri para-Islamik për Medinën.

<sup>b</sup> Kjo i referohet specifiku të frikës së ndier në betejën në këtë kontekst (*al-Mu`jam al-Wasit*).

<sup>c</sup> Kjo i referohet stuhisë së rërës që bëri që mosbesimtarët të ktheheshin prapa pa sukses.



zutë robër. <sup>27</sup> Ai jua barti juve tokën e tyre, shtëpitë e tyre, pasuritë e tyre dhe një tokë ku nuk ju pati shkelur këmba: **Allahu** ka pushtet mbi gjithçka.

<sup>28</sup> Profet, thuaju grave tua:<sup>a</sup> ‘Nëse e keni merak jetën e tanishme dhe stolitë e saj, ejani t’ju furnizoj dhe t’ju liroj me mirësi, <sup>29</sup> por nëse e keni merak **Allahun**, Të Dërguarin E Tij dhe Shtëpinë e Fundit, kujtojeni se **Allahu** ka përgatitur shpërblime të mëdha për ato nga ju që bëjnë mirë.’ <sup>33:30</sup> Gra të Profetit, nëse ndonjë nga ju bën diçka qartësisht tronditëse, do të ndëshkohet dyfish – kjo është lehtë për **Allahun** – <sup>31</sup> por nëse ndonjë nga ju është e bindur ndaj **Allahut** dhe Të Dërguarit Të Tij dhe bën vepra të mira, dijeni se Ne do t’i japim shpërblim të dyfishtë dhe do të kemi përgatitur furnizim bujar për të. <sup>32</sup> Gra të Profetit, nuk jeni si asnjë grua tjetër. Në qofshi vërtet të vetëdijshme për **Allahun**, mos flisni tepër butë në rast se i sëmuri në zemër do të ephonte pas jush, por flisni në mënyrë të përshtatshme; <sup>33</sup> rrini në shtëpi dhe mos u mburrni me stolitë tuaja siç bënë në të shkuarën pagane; faluni rregullisht, jepeni lëmoshën e përcaktuar dhe bindjuni **Allahut** dhe Të Dërguarit Të Tij. **Allahu** dëshiron ta mbajë papastërtinë larg jush, njerëz të Shtëpisë [së Profetit] dhe t’ju pastrojë plotësisht. <sup>34</sup> Mbajeni mend atë që recitohet në shtëpitë tuaja të shpalljeve e urtisë së **Allahut**, se **Allahu** është gjithë-subtil, i gjithë-informuar.

<sup>35</sup> Për burrat e gratë që i janë përkushtuar **Allahut** – burra e gra besimtarë, burra e gra të bindur, burra e gra besnikë, burra e gra të qëndrueshëm, burra e gra modestë, burra e gra bamirës, burra e gra agjërues, burra e gra të dëlirë, burra e gra që e kujtojnë **Allahun** shpesh – **Allahu** ka përgatitur falje dhe shpërblim të begatshëm.

<sup>36</sup> Kur **Allahu** dhe I Dërguari I Tij kanë vendosur për një çështje që i preokupon, nuk është e përshtatshme për asnjë burrë a grua besimtare të pretendojnë liri të zgjedhjes në atë çështje: kushdo që nuk i bindet **Allahut** dhe Të Dërguarit Të Tij është i devijuar larg. <sup>37</sup> Kur [ti Profet] i the njeriut që ishte favorizuar nga **Allahu** dhe nga ti: ‘Mbaje gruan tënde dhe ji i vetëdijshëm për **Allahun**’, e fshehe në zemrën tënde atë që **Allahu** do ta shpallte më vonë: ua kishe frikën njerëzve, por është më e përshtatshme t’ia kesh frikën **Allahut**. Kur Zejdi më nuk e dëshironte atë,<sup>b</sup> Ne ta dhamë ty në martesë që të mos ketë faj për besimtarët që martohen me gratë e djemve të tyre të birësuar pasi ata të mos i dëshironin më. Urdhri i **Allahut** duhet të zbatohet: <sup>38</sup> Profeti nuk ka faj për atë që **Allahu** e ka urdhëruar për të. Kjo ishte praktika e **Allahut** me ata që shkuan më parë – komanda e **Allahut** duhet të përmbushet – <sup>39</sup> [dhe me të gjithë] ata që i

---

<sup>a</sup> Disa nga gratë e Profetit vendosën t’i kërkonin më shumë furnizime, duke e parë se ishte bërë udhëheqës i një shteti të ri.

<sup>b</sup> Profeti e martoi Zejdin, djalën e tij të birësuar (të adoptuar), me Zejneben, kushërirën e tij. Zejdi më vonë u divorcua nga ajo dhe Profeti e mori atë si grua të veten. Kjo sure tregon se martesë është e ligjshme meqë birësimi nuk krijon lidhje gjaku që e përjashtojnë martesën.

kumtojnë mesazhet e **Allahut** dhe ia kanë frikën veç Atij dhe askujt tjetër: llogaritja e **Allahut** është e mjaftueshme. <sup>33:40</sup> Muhamedi nuk është babai i asnjërit nga ju njerëz; ai është I Dërguari I **Allahut** dhe vula e profetëve: **Allahu** di gjithçka. <sup>41</sup> Besimtarë, kujtojeni **Allahun** shpesh <sup>42</sup> dhe lavdojeni mëngjes-embrëmje: <sup>43</sup> është Ai që ju bekon, siç bëjnë engjëjt E Tij, që t'ju nxjerrin nga thellësitë e errësirës në dritë. Ai është gjithnjë mëshirëplotë ndaj besimtarëve – <sup>44</sup> kur ta takojnë do të marrin përshëndetje 'Paqe' – dhe Ai ka përgatitur shpërblim bujar për ta.

<sup>45</sup> Profet, Ne të kemi dërguar si dëshmitar, si dhënës të lajmit të mirë dhe të paralajmërimit, <sup>46</sup> si asi që i thërret njerëzit te **Allahu** me lejen E Tij, si llampë dritë-dhënëse. <sup>47</sup> Jepua lajmin e mirë besimtarëve se i pret mirësi e madhe nga **Allahu**. <sup>48</sup> Mos u lësho pe mosbesimtarëve dhe hipokritëve: injoroje dëmin që ta shkaktojnë dhe kije besimin tënd në **Allahun**. **Allahu** mjafton për t'i besuar.

<sup>49</sup> Besimtarë, kur të martoheni me gra besimtare dhe pastaj divorcoheni nga to para se t'i keni prekur – nuk keni të drejtë të kërkoni nga to periudhë të pritjes: bëni furnizime për to dhe lirojini në mënyrë të ndershme. <sup>33:50</sup> Profet, Ne i kemi bërë të ligjshme për ty gratë të cilave ua ke paguar dhuratën e nuses dhe cilatdo skllave që **Allahu** t'i ka caktuar gjatë luftës dhe bijat e xhaxhallarëve e të dajëve dhe të hallave e tezeve, që mërguan me ty. Gjithashtu, çfarëdo gruaje besimtare që i është ofruar Profetit dhe me të cilën Profeti dëshiron të martohet – kjo është veç për ty [Profet] dhe jo për pjesën tjetër të besimtarëve: Ne e dimë saktësisht se çka kemi bërë të obligueshme për ta në lidhje me gratë e tyre dhe vajzat-skllave – pra nuk duhet të fajësohesh: **Allahu** është më falësi, më mëshirëploti. <sup>51</sup> Mund ta bësh cilëndo nga [gratë tuaja] të presë dhe ta pranosh cilëndo nga to si të dëshirosh, por nuk do të jesh fajtor nëse e fton atë radhën e së cilës e ke lënë mënjane më parë: kështu ka më shumë gjasa se do të jenë të kënaqura me atë që ua ke dhënë. **Allahu** e di atë që është në zemrat tuaja: **Allahu** është i gjithë-ditur, i durueshëm. <sup>52</sup> [Profet] nuk lejohet të marrësh gra të tjera, as t'i shkëmbesh gratë që i ke me të tjera, edhe nëse të tërheqin me bukurinë e tyre. Por kjo nuk vlen për vajzat e tua skllave: **Allahu** është vigjilent mbi çdo gjë.

<sup>53</sup> Besimtarë, mos hyni në apartamentet e Profetit për racion ushqimor pos nëse ju është dhënë leje për këtë; mos u sorollatni deri kur [një racion] është gati. Kur të ftoheni, hyni; pastaj, kur ta keni marrë racionin tuaj, largohuni. Mos rrini e të flisni, se kjo do ta ofendonte Profetin, megjithëse do të ndihej ngusht t'ju kërkonte të largoheshit. **Allahu** nuk ndihet ngusht nga e vërteta. Kur i kërkoni gratë e tij për diçka, bëjeni këtë nga prapa një perdeje: kjo është më e pastër edhe për zemrat e tuaja edhe për të tyret. Nuk është e drejtë ta ofendoni Të Dërguarin e **Allahut**, siç nuk do të duhej kurrë të martoheni me gratë e tij pas tij: kjo do të ishte e rëndë në sytë e **Allahut**. <sup>54</sup> **Allahu** ka njohuri të plotë për të gjitha gjërat, qoftë nëse i zbuloni ato apo jo. <sup>55</sup> Gratë e Profetit nuk kanë faj [nëse shihen nga]

etërit e tyre, bijtë e tyre, vëllezërit e tyre, bijtë e vëllezërve të tyre, bijtë e motrave të tyre, gratë e tyre, apo skllëvërit e tyre. [Gra të Profetit,] jini të vetëdijshme për **Allahun**. **Allahu** vëzhgon gjithçka. <sup>56</sup> **Allahu** dhe engjëjt E Tij e bekojnë Profetin – pra, ju që besoni, bekojeni po ashtu dhe jepini përshëndetje të paqes. <sup>57</sup> Ata që e fyejnë **Allahun** dhe Të Dërguarin E Tij do të refuzohen nga **Allahu** në këtë botë dhe në tjetrën – Ai ka përgatitur torturë poshtëruese për ta – <sup>58</sup> dhe ata që i fyejnë pa meritë burrat e gratë besimtare do ta kenë fajin e shpifjes dhe të mëkatit flagrant.

<sup>59</sup> Profet, thuaju grave tua, bijave tua dhe besimtareve gra t'i bëjnë rrobat e tyre të jashtme të varen në nivel të ulët mbi to<sup>a</sup> që të njihen e të mos fyhen: **Allahu** është më falësi, më mëshirëploti. <sup>33:60</sup> Nëse hipokritët, të sëmurët në zemër dhe ata që përhapin gënjeshtër në qytet nuk ndalen, Ne do të të aktivizojmë [Profet] kundër tyre dhe pastaj ata do të jenë fqinjët e tu në këtë qytet veç për pak kohë. <sup>61</sup> Do të refuzohen. Kudo që të gjenden, do të arrestohen dhe do të vriten. <sup>62</sup> Kjo ka qenë praktika e **Allahut** me ata që shkuan më parë. Nuk do të gjesh asnjë ndryshim në praktikat e **Allahut**.

<sup>63</sup> Njerëzit të pyesin për Orën. Thuaj: 'Veç **Allahu** ka njohuri për të.' Si do të mund ta dije [ti Profet]? Ora mund të jetë fare afër. <sup>64</sup> **Allahu** i ka refuzuar mosbesimtarët dhe ka përgatitur zjarr flakërues për ta. <sup>65</sup> Aty do të rrinë përgjithmonë, me askë për t'u miqësuar a për t'i përkrahur. <sup>66</sup> Në Ditën kur fytyrat e tyre janë duke u kthyer rrotull në Zjarr, do të thonë: 'Veç po t'i ishim bindur **Allahut** dhe Të Dërguarit!', <sup>67</sup> dhe 'Zot! Iu bindëm padronëve dhe shefave tanë dhe na kanë devijuar. <sup>68</sup> Zot! Jepu ndëshkim të dyfishtë dhe refuzoji plotësisht.'

<sup>69</sup> Besimtarë, mos jini si ata që e fyen Musain – **Allahu** e pastroi nga trillimet e tyre dhe ai ishte shumë i nderuar në sytë e **Allahut**. <sup>33:70</sup> Besimtarë, jini të vetëdijshëm për **Allahun**, flisni drejtpërdrejt dhe me qëllim të mirë, <sup>71</sup> dhe Ai do t'i korrigojë veprat tuaja për ju dhe do t'ju falë mëkatet. Kushdo që i bindet **Allahut** dhe Të Dërguarit Të Tij do të arrijë vërtet triumf të madh. <sup>72</sup> Ne ia ofruam Përgjegjësinë<sup>b</sup> qiejve, tokës dhe maleve, e megjithatë refuzuan ta marrin përsipër dhe ia kishin frikën; njerëzimi e mori përsipër – gjithmonë kanë qenë të ngathët dhe budallenj. <sup>73</sup> **Allahu** do t'i ndëshkojë hipokritët dhe idhujtarët, edhe burrat edhe gratë dhe do t'u kthehet me mëshirë besimtarëve, edhe burrave edhe grave: **Allahu** është më falësi, më mëshirëploti.

---

<sup>a</sup> Idioma arabe *adna al-xhilbab* domethënë 'bëje të varet në nivel të ulët', e jo 'mbështjell rreth-e-rrotull' siç kanë supozuar përkthyes të tjerë.

<sup>b</sup> [E arsyes së shëndoshë dhe të përgjegjësise morale]

**Përshkrimi para kaptinës 33 nga Abdel Haleem:**

*Sure medinase që e merr titullin nga incidenti i Betejës së Hendekut në vitin AH 5/627 CE (vargjet 9-27), kur forcat e bashkuara të fiseve të ndryshme të mosbesimtarëve e rrethuan Medinën. Besimtarët e hapën një hendek, të cilin mosbesimtarët nuk ishin në gjendje ta kalonin dhe përfundimisht armiku u tërhoq në rrëmujë. Kjo përmendet që besimtarëve t'u përkujtohet mirësia e **Allahut** për ta, që të mund t'u binden udhëzimeve të shumta të dhëna në sure, duke filluar me rregullimin e birësimit dhe duke e përfshirë sjelljen e duhur ndaj Profetit dhe grave të tij. Hipokritët paralajmërohen ta ndalin sjelljen e tyre të keqe.*

### 34: Sheba (SEBE')

Në emrin e **Allahut**, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës

- <sup>1</sup> Lâvdi qoftë për **Allahun**,  
Të Cilit i përket gjithçka  
që është në qiej dhe në tokë,  
dhe lâvdi qoftë për Të në jetën tjetër!  
Është I Gjith'-Urti, I Gjith'-Informuari.
- <sup>2</sup> E di tërë atë që hyn në tokë  
dhe tërë atë që del nga ajo;  
E di tërë atë që zbret nga qiejt  
dhe tërë atë që ngritet te ta.  
Është Mëshirëploti, Falësi.
- <sup>3</sup> E prapë, mosbesimtarët thonë:  
'Ora e Fundit nuk do të na vijë kurrë.'  
Thuaj: 'Po, pasha Zotin tim,  
[do të vijë,] pasha Atë  
që e di të padukshmen!  
Madje as pesha e një grimce pluhuri  
në qiej a në tokë  
nuk i shpëton njohurisë Së Tij,  
dhe asgjë më e vogël a më e madhe.  
E tëra është e regjistruar  
në një Regjistër të qartë
- <sup>4</sup> që Ai të mund t'i shpërblejë  
ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira:  
ata do të kenë falje  
dhe furnizim bujar.'
- <sup>5</sup> Por sa u përket atyre  
që punojnë kundër Shpalljeve Tona,  
duke u munduar t'i dobësojnë,  
do të kenë torturë të vuajtjes plot dhembje.

- 6 [Profet,]  
ata që u është dhënë dija  
mund ta shohin  
se ajo që të është dërguar nga Zoti yt  
është e vërteta,  
dhe se ajo çon  
në rrugën e Të Gjithë-Fuqishmit,  
të denjë për tërë lândin.
- 7 Por mosbesimtarët thonë:  
‘A t’jua tregojmë një njeri që pretendon se,  
kur të jesh bërë plotësisht copë-copë,  
do të ngritesh në krijim të ri?’
- 8 A e ka shpikur një gënjeshtër për **Allahun?**  
A është i çmendur?’  
Jo!  
Janë ata që nuk besojnë në jetën tjetër  
që do ta vuajnë torturën,  
se janë në gabim të rëndë.
- 9 A nuk mendojnë  
për atë që është para tyre  
dhe prapa tyre  
në qiej dhe në tokë?  
Po të donim,  
do të mund ta bënim tokën t’i përbinte,  
apo të bënim copa nga qiejt të binin mbi ta.  
Vërtet ka shenjë në këtë  
për çdo shërbyes që i kthehet **Allahut** në pendesë.

<sup>34:10</sup> Ne i dhamë mirësi Daudit me favorin Tonë. Thamë: ‘Ju male, jepuni jehonë lavdërimeve të **Allahut** bashkë me të dhe ju shpezë po ashtu.’ E zbutëm hekurin për të, <sup>11</sup> duke thënë: ‘Bëj mantele të parzmoreve dhe mati lidhjet mirë.’ ‘Veproni mirë, të gjithë, se Unë shoh gjithçka që bëni.’ <sup>12</sup> Dhe [Ne e nënshtuam] erën për Sylejmanin. Udhëtimi i saj largues zgjati një muaj dhe po aq udhëtimi i saj kthyes. E bëmë një fontanë të bronzit të shkrirë të rrjedhë për të dhe disa nga

xhindet punuan nën kontrollin e tij me lejen e Zotit të tij. Nëse njëri nga ta devijonte nga komanda Jonë, e lejonim ta shijonte vuajtjen e zjarrit flakëruës.<sup>13</sup> I bënin atij çka të donte – pallate,<sup>a</sup> statuja, pellgje të mëdha sa koritat, kazanë të palëvizshëm. Ne thamë: ‘Punoni me falënderim, familje e Daudit, se pak nga shërbyesit e mi janë vërtet falënderues.’<sup>14</sup> Pastaj, kur e dekretuam vdekjen e Sylejmanit, asgjë nuk u tregoi xhindeve se ishte i vdekur, pos një krijesë e tokës që hante te bastuni i tij: kur ra poshtë e kuptuan – po ta dinin se çka ishte e fshehur nuk do të kishin vazhduar me punën e tyre poshtëruese.

<sup>15</sup> Kishte një shenjë edhe për popullin e Shebës, në vendin e tyre të banimit: dy kopshte, njëri djathtas, tjetri majtas: ‘Hani nga ajo që Zoti juaj jua ka furnizuar dhe falënderojeni, se toka juaj është e mirë dhe Zoti juaj më falësi.’<sup>16</sup> Por nuk ishin të vëmendshëm, kështu që Ne e lamë mbi ta një përmbytje nga diga dhe i zëvendësuam dy kopshtet e tyre me të tjera që prodhonin fruta të hidhura, shkurre të mëdha tamariske me gjethe të ngurta dhe ca pemë lotuse Sidri<sup>b</sup>.<sup>17</sup> Kështu i ndëshkuam për mosmirënjohjen e tyre – a do ta ndëshkonim ndokë përveç mosmirënjohësve?<sup>18</sup> Po ashtu, patëm vënë, ndërmjet tyre dhe qyteteve që i patëm bekuar, qytete të tjera të dukshme nga njëri-tjetri te të cilat mund të udhëtonin lehtë – ‘Udhëtoni në mënyrë të sigurt në këtë tokë natën dhe ditën’ –<sup>19</sup> por [prapë] ankoreshin: ‘Zoti ynë e ka bërë largesën ndërmjet stacioneve tona kaq të gjatë!’<sup>c</sup> E dëmtuan veten dhe, në fund, Ne e bëmë fatin e tyre epitet përbuzës dhe i shpërndamë në fragmente të panumërta. Vërtet ka shenja në këtë për çdo person të durueshëm, falënderues.<sup>34:20</sup> Satani doli se kishte të drejtë në opinionin e tij për ta, se të gjithë e ndoqën – përveç një grupi të besimtarëve –<sup>21</sup> megjithëse ai nuk kishte kurrfarë autoriteti mbi ta. Por [Ne synojmë] t’i dallojmë ata që besojnë në jetën tjetër nga ata që dyshojnë në të: [Profet,] Zoti yt vëzhgon gjithçka.

<sup>22</sup> Thuaj:

‘Lutjuni të ashtuquajturve zotave tuaj  
përveç Allahut:  
ata nuk e kontrollojnë madje  
as peshën e një grimce pluhuri  
në qiej a në tokë,  
as nuk kanë ndonjë hise në ta,  
as nuk janë asnjëri

---

<sup>a</sup> *Mihrab* i referohet disa llojeve të ndërtesave të bukura, përfshirë pallatet (*al-Mu`jam al-Wasit*)

<sup>b</sup> Pema lotus (Sidr): pemë me gjemba, e njohur edhe si gjembi i Krishtit, me fruta të ngrënshëm.

<sup>c</sup> Për këtë formë shih A. H. Omar dhe A. S. Makram, *Mu`jam al-Qira`at al-Qur`aniyya* (Teheran, 1999), referencën nën këtë varg. Kjo duket të ketë kuptim më të mirë se sa forma tjetër ‘Zot, bëji udhëtimet tona më të largëta.’

- kurrfarë ndihme për **Allahun**.
- 23 Ndërmjetësimi nuk do të funksionojë me Të,  
përveç nga ata të cilëve Ai u jep leje.’  
Do të pyeten,  
pasi të jetë hequr terrori nga zemrat e tyre  
[në Ditën e Gjykimit]:  
‘Çka ka folur Zoti juaj?’  
dhe do të përgjigjen:  
‘Të Vërtetën.  
Ai është Më I Larti,  
Më I Madhi.’
- 24 Thuaj [Profet]:  
‘Kush ju jep furnizime  
nga qiejt dhe toka?’  
Thuaj ‘**Allahu** ju jep’,  
dhe ‘[Një nga palët tona]  
duhet të jetë e udhëzuar drejt  
dhe tjetra qartë e devijuar.’
- 25 Thuaj:  
‘Ju nuk do të pyeteni  
për mëkatet tona,  
as ne nuk do të pyetemi  
për atë që e bëni ju.’
- 26 Thuaj:  
‘Zoti ynë do të na mbledhë bashkë,  
pastaj do të gjykojë drejt ndërmjet nesh;  
veç Ai është Gjykatësi I Gjithë-Ditur.’
- 27 Thuaj:  
‘M’i tregoni ata  
që ia bashkuat si partnerë.  
Jo në fakt!  
Veç Ai është **Allahu**,  
I Gjithë-Fuqishmi, I Gjithë-Urti.’



28 Në të kemi dërguar [Profet]  
veç për të sjellë lajm të mirë  
dhe paralajmërim për të gjithë njerëzit,  
por shumica nuk kuptojnë.

29 Dhe thonë:  
‘Nëse ajo që e thua është e vërtetë,  
kur do të përmbushet ky premtim?’

34:30 Thuaj:  
‘Keni takim për një Ditë  
që nuk mund ta shtyni as ta nxitoni,  
as për një çast të vetëm.’<sup>a</sup>

31 Mosbesimtarët thonë:  
‘Nuk do ta besojmë  
as këtë Kuran  
as Shkrimet e Shenjta  
që erdhën para tij.’  
Veç po të mund ta shihje [Profet]  
si do të bëhen të rrinë keqbërësit  
para Zotit të tyre,  
duke i bërë qortime njëri-tjetrit.  
Ata që ishin të shtypur do t’u thonë shtypësve:  
‘Po të mos ishit ju, do të kishim qenë besimtarë.’

32 Shtypësit do t’u thonë:  
‘A ishim ne që ju parandaluam ta ndiqnit udhëzimin e drejtë  
pasi ju kishte mbërritur?  
Jo! Vetë ishit mëkatarë.’

33 Të shtypurit do t’u thonë:  
‘Jo, ishte planifikimi juaj i fshehtë,  
natën e ditën,  
duke na urdhëruar të mos besojmë në **Allahun**

---

<sup>a</sup> Jo ‘një orë’ (*al-Mu`jam al-Wasit*).

dhe t'i mveshim rivalë.'

Kur ta shohin ndëshkimin,  
do të bien në heshtje me pishman,  
dhe Ne do të vëmë qafore të hekurta  
në qafat e mosbesimtarëve.

Pse duhet të shpërblehen  
për çkado tjetër pos për atë që e kanë bërë?

34 Kurrë nuk i kemi dërguar paralajmërues një komuniteti  
e të korruptuarit e tyre të mos thonë:

'Nuk besojmë në mesazhin me të cilin je dërguar.'

35 Do të thoshin:

'Kemi pasuri më të madhe  
dhe më shumë fëmijë se ti,  
dhe nuk do të ndëshkohemi.'

36 Thuaj [Profet]:

'Zoti im i jep begatshëm  
kujt do që do t'i japë  
dhe me masë  
kujt do që do t'i japë,  
megjithëse shumica e njerëzve  
nuk kuptojnë.

37 As pasuria as fëmijët  
nuk do t'ju sjellin më afër Nesh,  
por ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira  
do të kenë shpërblime të shumëfishta  
për atë që e kanë bërë,  
dhe do të jetojnë të sigurt

në banesat e larta të Parajsës,  
38 ndërsa ata që punojnë kundër mesazheve Tona,  
duke u munduar t'i dobësojnë,  
do të thirren në ndëshkim.

39 Thuaj:

'Zoti im i jep begatshëm  
cilitdo nga shërbyesit E Tij që do t'i japë,

dhe me masë  
cilitdo që do t'i japë;  
Ai do t'jua zëvendësojë  
çkado që jepni për lëmoshë;  
Ai është më i miri nga furnizuesit.'

34:40 Në Ditën që Ai i mbledh të gjithë bashkë,  
do t'u thotë engjëjve:

'A ishit ju që u adhuruat nga këta njerëz?'

41 Ata do të përgjigjen:

'Qofsh i lartësuar!

Ti je përkrahësi ynë kundër tyre!

Vërtet, ata i adhuruan xhindet –  
shumica e tyre besuan në ta.'

42 'Pra sot

askush nga ju nuk ka ndonjë fuqi

t'i bëjë mirë a ta dëmtojë tjetrin',

do t'u themi keqbërësve,

'Shijojeni torturën e zjarrit

që e quajtët gënjeshtër.'

43 Kur u recitohen mesazhet Tona,

qartë siç janë, thonë:

'Ky është veç një njeri

që dëshiron t'ju largojë

nga ajo që e adhuruan para-ardhësit tuaj',

dhe 'Ky [Kuran] s'është asgjë

pos gënjeshtër që i ka sajuar ai.'

Kur E Vërteta vjen te mosbesimtarët, thonë:

'Kjo është veç magji e thjeshtë',

44 megjithëse nuk u kemi dhënë

ndonjë libër për ta studiuar

as s'ua kemi dërguar

ndonjë paralajmërues para teje.

45 Edhe ata që jetuan para tyre e refuzuan të vërtetën –  
këta njerëz nuk e kanë arritur madje as një të dhjetën  
e asaj që ua dhamë paraardhësve të tyre –  
edhe ata i refuzuan të dërguarit E Mi,  
dhe sa i tmerrshëm ishte ndëshkimi Im!

46 Thuaj [Profet]:  
‘Ju këshilloj ta bëni veç një gjë:  
qëndroni para **Allahut**,  
në çifte apo veçmas,  
dhe reflektoni:  
nuk ka asnjë shenjë të çmendjes  
te shoqëruesi juaj [Profeti] –  
ai veç po ju paralajmëron  
para se të arrijë vuajtja e ashpër.’

47 Thuaj:  
‘Nëse jua kam kërkuar ndonjë shpërblim,  
mund ta mbani.  
Veç **Allahu** është Ai që do të më shpërblejë:  
Ai është dëshmitar i gjithçkaje.’

48 Thuaj:  
‘Zoti im e zbret fuqishëm Të Vërtetën [para jush].  
Ai ka njohuri të plotë për tërë të padukshmen.’

49 Thuaj:  
‘E Vërteta ka ardhur;  
e pavërteta është e pafuqishme.’<sup>a</sup>

34:50 Thuaj: ‘Nëse devijoj,  
është humbja ime,  
e nëse jam i udhëzuar drejt,  
kjo është përmes asaj që ma ka shpallur Zoti im.  
Ai është gjithë-dëgjues dhe gjithmonë afër.’

---

<sup>a</sup> Shprehja arabe *la yubdi' wa-la yu'id* është idiomë që domethënë ‘e pafuqishme’. Shih Zamakhshari, *Asas al-Balagha*.

51 [Profet,] po të mund ta shihje  
terrorin e tyre!<sup>a</sup>  
Nuk do të ketë shpëtim  
kur kapen nga një vend i afërt;  
52 do të thonë:  
‘Tash besojmë në të’,<sup>b</sup>  
por si mund ta arrijnë  
nga një gjendje kaq e largët –  
53 i refuzuan të gjitha në të shkuarën,  
dhe bënë hamendësime<sup>c</sup>  
nga një gjendje e largët –  
54 kur një barrierë ishte vendosur  
ndërmjet tyre dhe asaj që e kanë merak,<sup>d</sup>  
siç ishte bërë me llojin e tyre më parë?  
Ishin thellë në pasiguri e dyshim.

---

<sup>a</sup> Në Ditën e Ringjalljes.

<sup>b</sup> Të Vërtetën.

<sup>c</sup> Për **Allahun** dhe Të Përtejmen.

<sup>d</sup> Që të lejohen të kthehen në botë dhe të besojnë e të bëjnë vepra të mira. Krahaso me 35:37.

**Përshkrimi para kaptinës 34 nga Abdel Haleem:**

*Sure mekase që e merr emrin nga njerëzit e Shebës që ishin të bekuar dhe pastaj të ndëshkuar për mosmirënjohjen e tyre (vargjet 15-21). Profeti së pari inkurajohet përmes referimeve të Daudit e të Sylejmanit dhe si i favorizoi **Allahu** ata. Mosbesimtarët e Mekës paralajmërohen përmes një përshkrimi të ndëshkimit që i pret në Ditën e Ringjalljes. Dy referenca janë bërë për akuzimin e tyre të Profetit për çmenduri (vargjet 8 dhe 46) dhe kjo akuzë refuzohet plotësisht.*

**Shënimet gjuhësore (Thomas Cleary)**

*Sheba (Kaptina 34)*

Kjo sure u shpall në Mekë. Sheba ishte qytet apo popull antik i Jemenit në Arabinë Jugore, popullatë e begatshme që ishte shkatërruar apo zvogëluar nga një përmytje e madhe, që supozohet të jetë shkaktuar me rastin e thyerjes së digës së madhe të Jemenit antik.

- 3 “as asgjë më e vogël a më e madhe. E tëra është e regjistruar në një Regjistër të qartë”: Gjithçka në përmasat makrokozme dhe mikrokozme të ekzistencës, është përfshirë në shpallje. *Shkrimi i Shenjtë Budist i Zbukurimit të Lules* thotë: “Nuk ka askund ku nuk mbërrin dija e të përndriturit. Pse? Nuk ka asnjë qenie të vetme të ndjeshme që nuk është plotësisht e pajisur me dijen e të përndriturit; veç për shkak të nocioneve deluzive, të menduarit të gabuar dhe ngjitjeve me gjërat – ato nuk janë të afta ta kuptojnë atë. Po të mund t’i hiqnin qafe nocionet deluzive, atëherë dija universale, dija spontane dhe dija e papenguar do të shfaqej. Është si të ishte një shkrim i shenjtë i madh, i barabartë për nga shtrirja me një univers me miliarda botë, në të cilin janë të shkruara të gjitha gjërat e universit... Megjithëse ky shkrim i shenjtë është i barabartë për kah masa me një univers me miliarda botë, prapë rri plotësisht në një atom të vetëm; dhe kjo është kështu për një atom dhe është e vërtetë edhe për të gjitha atomet. Pastaj supozojmë se është dikush me dije të qartë e gjithëpërfshirëse, që e ka zhvilluar plotësisht syrin qiellor, i sheh këto shkrime të shenjta brenda atomeve, se si nuk u sjellin fare dobi qenieve të ndjeshme dhe me këtë mendim: ‘Më duhet, përmes fuqisë energjike, t’i çeli këto atome dhe t’i çliroj ato shkrime të shenjta ashtu që të jenë të dobishme për të gjitha qeniet e ndjeshme’ – pastaj i përdor mjetet e përshtatshme për t’i çelur atomet dhe për t’i çliuar shkrimet e mëdha të shenjta, për t’ua mundësuar të gjitha

qenieve të ndjeshme të kenë dobi të madhe. Ngjashëm, dija e të përndriturit, e pakufizuar dhe e papenguar, e aftë të jetë e dobishme universalisht për të gjithë, është plotësisht e integruar në trupat e qenieve të ndjeshme; por të padijshmit, për shkak të kapjes pas nocioneve deluzive, nuk dinë për të, nuk janë të informuar për të dhe kështu nuk kanë dobi nga ajo. Pastaj Buddha, me syrin e pastër të papenguar të dijes, i vëzhgon të gjitha qeniet e ndjeshme në kozmos dhe thotë: ‘Sa çudi! Si është e mundur që këto qenie të ndjeshme e kanë dijen e të përndriturit, por në marrëzinë dhe hutinë e tyre nuk e njohin apo nuk e perceptojnë? Më duhet t’ua mësoj rrugën e urtarëve dhe t’i bëj t’i hedhin nocionet deluzive dhe ngjitjet, ashtu që të mund ta shohin në trupat e tyre dijen e gjerë të të përndriturit’ (Libri XXXVII).

34 Kurrë nuk i kemi dërguar paralajmërues një komuniteti e të korrptuarit e tyre të mos thonë: ‘Nuk besojmë në mesazhin me të cilin je dërguar.’: Sipas Kuranit, **Allahu** i ka dërguar paralajmërues (*nadhiir*) secilit popull. Anëtarët e korrptuar të një komuniteti janë ata me hisen më të madhe në status quo dhe prandaj zakonisht e refuzojnë çfarëdo mesazhi të ri me të cilin dërgohen paralajmëruesit.

37 “dhe do të jetojnë të sigurt në banesat e larta të Parajsës”: Ata do të jenë të stabilizuar në gjendje të larta të afërsisë me Të Vërtetën. “Shpërblimi i përbërë” për veprat e mira besimplota e përfshin rezultatin e asaj mirësie – i cili është natyrshëm i mirë, plus ngritjen e gjendjes shpirtërore që bëhet e mundur përmes besimit në veprim.

39 Sipas mësimëve të Budizmit, madje edhe dhurata më e vogël, kur jepet lirshëm, pa ngjitje, rezulton në shpërblim të pallogaritshëm.

40 “ata i adhuruan xhindet”: Disa njerëz i adhurojnë xhindet, apo fuqitë okulte, apo gjendjet e pazakonshme mendore.

43 ‘Ky është veç një njeri që dëshiron t’ju largojë nga ajo që e adhuruan paraardhësit tuaj’: Buddha u tha njerëzve të mos u përmbaheshin praktikave apo besimeve veç se ishin tradicionale. Ibrahimimi dhe Muhamedi po ashtu përfaqësojnë thyerje të tilla të traditës për kthim tek e vërteta, nga zakoni i trashëguar – te perceptimi i drejtpërdrejtë.

45 “dhe sa i tmerrshëm ishte ndëshkimi Im!”: Ata që i refuzuan të dërguarit e Të Vërtetës ishin, si rezultat natyral, të privuar nga E Vërteta. Një kuptim i “sa” duket të jetë se realiteti shkatërrues i refuzimit nga **Allahu** është i pakonceptueshëm për ata mendimi i të cilëve drejtohet kah kotësitë në refuzimin e paralajmërimeve të **Allahut**.

52 “si mund ta arrijnë atë nga një gjendje kaq e largët”: Siç shpjegohet në vargjet vijuese, “gjendja kaq e largët” është tëhuajësimi nga e vërteta, që rezulton nga pavëmendësia dhe refuzimi që janë bërë zakon.



## 35: Krijuesi (EL-FÂTIR)

Në emrin e **Allahut**, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës

<sup>1</sup> Lâvdi qoftë për **Allahun**, Krijuesin e qiejve dhe të tokës, që i bëri engjëjt të dërguar me dy, tri, katër [palë] krahë. Ai i shton krijimit siç do t'i shtojë: **Allahu** ka pushtet mbi gjithçka. <sup>2</sup> Askush nuk mund ta ndalë bekimin që **Allahu** e hap për njerëzit, as askush pos Tij s'mund të çlirojë çkado që ndal Ai: është I Gjithë-Fuqishmi, I Gjith'-Urti. <sup>3</sup> Njerëz, kujtojeni mirësinë e **Allahut** ndaj jush. A ka ndonjë krijues tjetër pos **Allahut** që t'ju japë furnizim nga qiejt dhe toka? Nuk ka zot pos Tij. Si mund të jeni kaq të deluzionuar?

<sup>4</sup> Nëse të quajnë gënjeshtar [Profet], edhe shumë të dërguar para teje i kanë quajtur gënjeshtarë: pikërisht te **Allahu** do të kthehen të gjitha gjërat. <sup>5</sup> Njerëz! Premtimi i **Allahut** është i vërtetë, pra mos e lejoni jetën e tashme t'ju mashtrojë. Mos e lejoni Mashtruesin t'ju mashtrojë për **Allahun**: <sup>6</sup> Satani është armiku i juaj – pra trajtojeni si armik – dhe i fton ndjekësit e tij veç për të hyrë në zjarrin flakëruës. <sup>7</sup> Ata që nuk besojnë do të ndëshkohen ashpër; ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira do të falen dhe do të shpërblehen begatshëm. <sup>8</sup> Si është puna me ata veprat e këqija të cilëve u bëhen tërheqëse ashtu që mendojnë se janë të mira? **Allahu** e lejon këdo që do ta lejojë të devijojë dhe e udhëzon këdo që do ta udhëzojë. [Profet,] mos e ço dem shpirtin tënd me keqardhje për ta: **Allahu** e di saktësisht se çka bëjnë.

<sup>9</sup> Është **Allahu** që i dërgon erërat; ato i ngrisin retë; Ne i shtyjme te një tokë e vdekur dhe me to e ringjallim tokën pas vdekjes së saj: e tillë do të jetë Ringjallja. <sup>35:10</sup> Nëse dikush e ka merak fuqinë, tërë fuqia i përket **Allahut**; fjalët e mira ngriten tek Ai dhe Ai e ngrit veprën e ndershme, por një torturë e ashpër i pret ata që komplotojnë të këqija dhe komplotimi i tyre do të kthehet në asgjë. <sup>11</sup> Është **Allahu** që ju krijoi nga pluhuri dhe më vonë nga një pikë e lëngut; pastaj ju bëri në dy gjini; asnjë femër nuk ngjizet as s'lind pa dijeninë E Tij; asnjë person nuk plaket as s'i shkurtohet jeta, përveç në pajtim me një Regjistër: krejt kjo është e lehtë për **Allahun**.

<sup>12</sup> Dy masat e ujit nuk janë të ngjashme – njëri është i shijshëm, i ëmbël e i këndshëm për ta pirë, e tjetri i kripur e i hidhur – e megjithatë nga secili hani peshk të freskët dhe nxirri zbukurime për t'i veshur dhe në secilin shihni anije duke e çarë drejtimin e tyre që të mund ta kërkon mirësinë e **Allahut** dhe të jeni mirënjohës. <sup>13</sup> Ai e bën natën të shkrihet në ditë dhe ditën në natë; Ai i ka nënshtuar diellin dhe hënën – secili lëviz për një afat të caktuar. I tillë është **Allahu** – Zoti juaj: tërë kontrolli i përket Atij. Ata që i thirrni përkrah Tij nuk e

kontrollojnë madje as lëkurën e një bërthame të hurmës; <sup>14</sup> nëse i thirrni nuk mund t'ju dëgjojnë; po të mund të dëgjonin, nuk do të mund t'ju përgjigjeshin; në Ditën e Ringjalljes nuk do ta pranojnë idhujtarinë tuaj si të tyren. Askush nuk mund të t'informojë [Profet] si Ai që është i gjith'informuar.

<sup>15</sup> Njerëz, jeni ju që keni nevojë për **Allahun** – **Allahu** nuk ka nevojë për asgjë dhe është i denjë për të gjitha lavdet – <sup>16</sup> nëse Ai do, mund t'ju heqë plotësisht dhe ta sjellë një krijim të ri, <sup>17</sup> kjo nuk është e vështirë për **Allahun**. <sup>18</sup> Asnjë shpirt i ngarkuar nuk do ta bartë barrën e tjetrit: madje edhe nëse një shpirt i ngarkuar rëndë do të thërriste për ndihmë, aspak nga barra e tij nuk do të bartet, madje as nga një familjar i afërm. Por ti [Profet] mundesh veç t'i paralajmërosh ata që ia kanë frikën Zotit të tyre, megjithëse nuk mund ta shohin, dhe që falen rregullisht – kushdo që pastrohet e bën këtë për dobinë e tij – gjithçka kthehet te **Allahu**. <sup>19</sup> I verbri dhe ai që sheh nuk janë të ngjashëm, <sup>35:20</sup> as s'janë errësira dhe drita; <sup>21</sup> hija dhe vapa nuk janë të ngjashme, <sup>22</sup> as s'janë të gjallët dhe të vdekurit. **Allahu** e bën këdo që do ta bëjë të dëgjojë [mesazhin E Tij]: ti nuk mund t'i bësh të dëgjojnë ata që janë në varret e tyre. <sup>23</sup> Je këtu veç për t'i paralajmëruar – <sup>24</sup> Ne të kemi dërguar me Të Vërtetën si sjellës të lajmit të mirë dhe të paralajmërimit – secilit komunitet i është dërguar një paralajmërues. <sup>25</sup> Nëse të quajnë gënjeshtar, para-ardhësit e tyre e bënë të njëjtën: të dërguarit u erdhën me shenja të qarta, me shkrime të shenjta dhe me shpallje përndritëse <sup>26</sup> dhe më pas Unë i mbërtheva mosbesimtarët – sa i tmerrshëm ishte ndëshkimi Im!

<sup>27</sup> A nuk ke reflektuar se si **Allahu** e zbret ujin nga qielli dhe që Ne prodhojmë me të fruta me ngjyra të ndryshme; se ka në male shtresa të t'bardhës e të t'kuqes me ngjyrimë të ndryshme dhe të t'zezës shkëlqyese; <sup>28</sup> se ka edhe ngjyra të ndryshme ndër qeniet njerëzore, kafshët e egra dhe bagëtitë? Pikërisht ata nga shërbyesit E Tij që kanë dije janë ata që kanë frikë-respekt të vërtetë për **Allahun**. **Allahu** është i gjithë-fuqishëm, më falësi. <sup>29</sup> Ata që e recitojnë shkrimin e shenjtë të **Allahut**, falen rregullisht, japin fshehtas dhe haptas nga ajo që Ne kemi furnizuar për ta, mund të shpresojnë për një tregtim që nuk do të bjerë kurrë: <sup>35:30</sup> Ai do t'i shpërblejë plotësisht dhe do t'u japë shtesë nga mirësia E Tij. Është më falësi, më çmuesi.

<sup>31</sup> Shkrimi i Shenjtë që Ne ta kemi shpallur [Profet] është E Vërteta dhe i vërteton shkrimet e shenjta që i paraprinë. **Allahu** është fare mirë i informuar për shërbyesit E Tij, sheh gjithçka. <sup>32</sup> Ne ua dhamë Shkrimin e Shenjtë si trashëgimi shërbyesve Tonë të zgjedhur: disa nga ta i dëmtuan shpirtat e tyre, disa qëndruan ndërmjet [të drejtës e të gabuarës] dhe disa, me lejen e **Allahut**, ishin më të shquarit në vepra të mira. Ky është favorimi më i madh: <sup>33</sup> do të hyjnë në Kopshte të qëndrueshme ku do të zbukurohen me byzylykë të artë dhe perla, ku do të veshin rroba të mëndafshit. <sup>34</sup> Do të thonë: 'Lâvdi qoftë për **Allahun**, që na ka ndarë nga tërë pikëllimi! Zoti ynë është vërtet më falësi, më çmuesi. <sup>35</sup> Në

mirësinë E Tij, na ka rehatuar në Shtëpinë e përhershme ku s’do t’na prekë kurrfarë mundimi a lodhje.’<sup>36</sup> Por ata që e refuzojnë të vërtetën do të qëndrojnë në Zjarr të Ferrit, ku as s’do të mbarohen nga vdekja, as s’do të çlirohen nga tortura e Ferrit: kështu i shpërblejmë mosbesimtarët e ngurtësuar.<sup>37</sup> Do të thërrasin fort në Ferr: ‘Zot, na lësho të dalim dhe do të bëjmë vepra të ndershme, jo çka kemi bërë më parë!’ – ‘A nuk jua dhamë një jetë mjaft të gjatë për ta marrë paralajmërimin po ta kishit ndërmend? Paralajmëruesi ju erdhi, tash shijojeni ndëshkimin.’ Keqbërësit nuk do ta kenë askë t’u ndihmojë.

<sup>38</sup> **Allahu** e di tërë atë që është e fshehur në qiej dhe në tokë; i di mendimet që përmbahen në zemër; <sup>39</sup> është Ai që ju bëri [juve njerëz] trashëgimtarë të vendit. Ata që e refuzojnë të vërtetën do t’i bartin pasojat: refuzimi i tyre veç do t’i bëjë më të neveritshëm për Zotin e tyre dhe do t’ua rrisë veç humbjen.<sup>35:40</sup> Thuaj: ‘Reflektoni për ata “partnerë” tuajt që i thirrni krahas **Allahut**. Më tregoni! Cilën pjesë të tokës e krijuan? Çfarë hise të qiejve posedojnë?’ A u kemi dhënë libër që përmban evidencë të qartë? Jo në fakt! Idhujtarët i premtojnë njëri-tjetrit veç deluzion.

<sup>41</sup> **Allahu** i mban qiejt dhe tokën të mos shuhet; po të shuheshin, askush tjetër nuk do të mund t’i ndalte. **Allahu** është më i durueshmi, më falësi.<sup>42</sup> [Idhujtarët] e bënë betimin e tyre më solemn se, po të vinte dikush t’i paralajmëronte, do të ishin të udhëzuar më drejt se sa cilido komunitet [tjetër], por kur erdhi dikush u larguan edhe më shumë,<sup>43</sup> u bënë më arrogantë në vend dhe e rritën komplotimin e tyre të të keqes – komplotimi i të keqes u kthehet atyre që komplotojnë. A presin ndonjë gjë tjetër pos asaj që u ka ndodhur popujve të mëhershëm? Kurrë nuk do të gjesh ndonjë ndryshim në praktikën e **Allahut**; kurrë nuk do të gjesh ndonjë shmangie aty.<sup>44</sup> A nuk kanë udhëtuar nëpër vend dhe ta kenë parë se si ata para tyre e hasën fundin e tyre, megjithëse ishin superiorë ndaj tyre në forcë? **Allahu** nuk është se frustrohet nga çkadoqoftë në qiej apo në tokë: është i gjithë-dituri, i gjithë-fuqishmi.<sup>45</sup> Po t’i ndëshkonte **Allahu** njerëzit [menjëherë] për gabimin që e kanë bërë, nuk do të ishte as edhe një krijesë e mbetur në sipërfaqen e tokës. Ai u jep afat për një kohë të caktuar dhe, kurdo që u vjen koha, **Allahu** ka qenë duke i vëzhguar shërbyesit E Tij.

**Përshkrimi para kaptinës 35 nga Abdel Haleem:**

*Sure mekase që e pohon fuqinë dhe Krijimin e Allahut dhe e kontraston këtë me pafuqinë dhe padobinë e 'partnerëve' të mveshur nga idhujtarët. Surja i paralajmëron idhujtarët për ndëshkimin e tyre dhe e ngushëllon Profetin përmes përmendjes së të dërguarve të mëparshëm që po ashtu u refuzuan si gënjeshtarë. Përshkruhen shpërblimet e mëdha që i presin besimtarët.*

## 36: Ja Sin (JÂ SÎN)

Në emrin e **Allahut**, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës

<sup>1</sup> Ja Sin

<sup>2</sup> Pasha Kuranin e urtë<sup>a</sup> <sup>3</sup> ti [Muhamed] je vërtet një nga të dërguarit e çuar <sup>4</sup> në rrugë të drejtë, <sup>5</sup> me një shpallje nga I Gjithë-Fuqishmi, Zoti i Mëshirës, <sup>6</sup> për ta paralajmëruar një popull stërgjyshërit e të cilit nuk ishin paralajmëruar dhe prandaj janë të pavetëdijsëm. <sup>7</sup> Vendimi është shqiptuar kundër shumicës së tyre, se refuzojnë të besojnë. <sup>8</sup> [Është sikur] Ne [t']u kemi vendosur qafore [të hekurta] rreth qafës, mu deri te mjekrat që të detyrohen ta mbajnë kokën lart <sup>9</sup> dhe u kemi vënë pengesa para dhe prapa, duke ua bllokuar pamjen: nuk mund të shohin. <sup>36:10</sup> Është krejt njëjtë për ta qoftë i paralajmërove apo jo: nuk do të besojnë. <sup>11</sup> Mund t'i paralajmërosh veç ata që do ta ndjekin Kuranin dhe do të kenë respekt të thellë për Mëshirëplotin, megjithëse s'mund ta shohin: jepjua njerëzve të tillë lajmin e gëzuar të faljes dhe të një shpërblimi bujar. <sup>12</sup> Definitivisht Ne do t'i kthejmë të vdekurit në jetë, dhe regjistrujmë se çka dërgojnë përpara vetes dhe çka lënë prapa: mbajmë të dhëna për gjithçka në një Regjistër të qartë.

<sup>13</sup> Jepjua shembullin e popullit në qytetin e të cilit erdhën të dërguarit. <sup>14</sup> Ne i çuam dy të dërguar por ata i refuzuan të dytë. Pasaj i përforcuam me një të tretë. <sup>15</sup> Thanë: 'Vërtet, jemi të dërguar për ju', <sup>16</sup> por morën përgjigje: 'Jeni veç njerëz si ne. Zoti i Mëshirës nuk ka dërguar asgjë; veç po rreni.' Thanë: 'Zoti ynë e di se jemi dërguar te ju. <sup>17</sup> Detyra jonë është veç ta bartim mesazhin te ju', <sup>18</sup> por morën përgjigje: 'Mendojmë se jeni ogur i zi. Nëse nuk ndaleni, do t'ju gurëzojmë dhe t'ju shkaktojmë torturë të dhembshme.' <sup>19</sup> Të dërguarit thanë: 'Oguri i zi është brenda vetë juve. Pse e merrni si ogur të zi kur dikush jua kujton Të Vërtetën? Po e teproni shumë!' <sup>36:20</sup> Pastaj, nga pjesa më e largët e qytetit, erdhi një njeri duke vrapuar. Tha: 'Populli im, ndiqini të dërguarit. <sup>21</sup> Ndiqini: nuk po kërkojnë t'i shpërbleni dhe janë të udhëzuar drejt. <sup>22</sup> Pse s'do të duhej ta adhuroja Atë që më krijoi? Është Ai tek I Cili do t'ju kthejnë. <sup>23</sup> Si mund të marr zota të tjerë pos Tij, ndërmjetësimi i të cilëve nuk do të më ndihmojë, dhe që nuk do të ishin në gjendje të më shpëtojnë nëse Zoti i Mëshirës do të donte të më dëmtonte? <sup>24</sup> Atëherë qartë do të isha gabim. <sup>25</sup> Besoj në Zotin tuaj, pra dëgjomëni.'

---

<sup>a</sup> *Hakim* kuptohet në mënyra të ndryshme: ta ketë domethënieën 'plot urti', të sugjerojë se jep vendime në çështje dhe të komunikojë se është i perfeksionuar dhe i formuar mirë.

<sup>26</sup> Atij iu tha: ‘Hyr në Kopsht’<sup>a</sup>, kështu që ai tha: ‘Veç po ta dinte populli im <sup>27</sup> si më ka falur Zoti im dhe më ka caktuar ndër ata që nderohen lart.’<sup>28</sup> Pas tij nuk kemi dërguar ndonjë ushtri nga qielli kundër popullit të tyre, as s’e kishim ndërmend: <sup>29</sup> ishte veç një shpërthim dhe ranë të pajetë.

<sup>36:30</sup> Mjerë qeniet njerëzore! Kurdo që u vjen një i dërguar e tallin. <sup>31</sup> A nuk e shohin se sa breza i kemi shkatërruar para tyre dhe asnjëri nga ta s’do t’u kthehet?<sup>b</sup> <sup>32</sup> [E megjithatë] të gjithë do të sillen para Nesh. <sup>33</sup> Ka një shenjë për ta në tokën e pajetë: Ne i japim jetë dhe prodhojmë drithë nga ajo për ta që të hanë; <sup>34</sup> Kemi vendosur kopshte me palma të hurmave dhe me rrush në tokë dhe kemi bërë burime të ujit të gufojnë nga ajo <sup>35</sup> që të mund t’i hanë frutat e saj. Nuk ishin duart e tyre që i bënë të gjitha këto. Si mund të mos falënderojnë? <sup>36</sup> Lâvdi qoftë për Atë që i krijoi të gjitha çiftet<sup>c</sup> e gjërave që i prodhon toka, si dhe vetë ata dhe gjëra të tjera për të cilat nuk dinë. <sup>37</sup> Edhe nata është shenjë për ta: ia heqim dritën e ditës dhe – shih sa çudi! – ata janë në terr. <sup>38</sup> Dielli, po ashtu e kalon shtegun e tij të përcaktuar, të formuluar për të nga I Gjithë-Fuqishmi, I Gjithëdijshmi. <sup>39</sup> I kemi përcaktuar fazat për hënën deri kur përfundimisht të bëhet kërcell i hurmes së vjetër. <sup>36:40</sup> Dielli s’mund ta parakalojë hënën, as nata t’ia kalojë ditës: secili pluskon në orbitë [të vet].

<sup>41</sup> Një shenjë tjetër për ta është se Ne e bartëm farën e tyre në Arkën e ngarkuar, <sup>42</sup> dhe bëmë gjëra të ngjashme për ta që të udhëtojnë. <sup>43</sup> Po të donim, do të mund t’i përmbysnim dhe nuk do të kishte kush t’u ndihmojë: nuk do të mund të shpëtoheshin. <sup>44</sup> Veç nga mëshira Jonë kanë mundur të kenë shtyrje të vdekjes për ta shijuar jetën për ca kohë. <sup>45</sup> E prapë kur u thuhet: ‘Kujdes nga ajo që qëndron para dhe prapa jush, që të mund t’ju jepet mëshirë’, <sup>46</sup> e injorojnë secilën shenjë që u vjen nga Zoti i tyre, <sup>47</sup> dhe kur u thuhet: ‘Jepjuni të tjerëve nga ajo që ka furnizuar **Allahu** për ju’, pabesimtarët u thonë besimtarëve: ‘Pse do të duhej t’i ushqejmë ata që do të mund t’i ushqente **Allahu** po të donte? Me siguri jeni të keqorientuar thellësisht.’

<sup>48</sup> Dhe thonë: ‘Kur do të përmbushet ky premtim, nëse ajo që thoni është e vërtetë?’ <sup>49</sup> Por krejt çka po presin është një shpërthim i vetëm që do t’i pushtojë gjersa janë duke polemizuar ende me njëri-tjetrin. <sup>36:50</sup> Nuk do të kenë kohë të bëjnë teste, as s’do të kenë shans të kthehen te njerëzit e tyre.

<sup>51</sup> Trumpeta do të dëgjohet dhe – shih sa çudi! – do të turren jashtë te Zoti i tyre nga varret e tyre. <sup>52</sup> Do të thonë: ‘Të mjerët ne! Kush na ka ringjallur nga vendet tona të pushimit? [Do t’u thuhet:] ‘Kjo është ajo që e ka premtuar Zoti i Mëshirës, dhe të dërguarit e treguan të vërtetën.’ <sup>53</sup> Ishte veç një shpërthim i

---

<sup>a</sup> Nënkuptimi mund të jetë se ishte martirizuar, meqë populli i tij vdesin pas tij.

<sup>b</sup> Një interpretim tjetër i kësaj fraze është ‘asnjë nga ta nuk mund t’i gjurmojë [gjenealogjitë] prapa te ta’, dmth. Zoti e ka zhdukur tërë linjën.

<sup>c</sup> Apo ‘varietetet’

vetëm dhe – shih sa çudi! – të gjithë i sollën para Nesh. <sup>54</sup> ‘Sot, asnjë shpirti nuk do t’i bëhet e padrejtë aspak: do të shpaguheni veç për veprat tuaja. <sup>55</sup> Njerëzit e Parajsës sot janë në mendime të lumtura – <sup>56</sup> ata dhe bashkëshortët e tyre – të ulur në divane në hije. <sup>57</sup> Aty kanë fruta të gjithçkaje që kërkojnë. <sup>58</sup> “Paqe”, fjalë nga Zoti i Mëshirës. <sup>59</sup> Por shtyhuni sot, ju fajtorë. <sup>36:60</sup> Fëmijë të Ademit, a nuk ju kam urdhëruar të mos i shërbeni Satanit, se ishte armiku juaj i betuar, <sup>61</sup> por të më shërbeni Mua? Kjo është rruga e drejtë. <sup>62</sup> Ai e ka devijuar një pjesë të madhe nga ju. A nuk e keni përdorur arsyen? <sup>63</sup> Pra ky është Zjarri për të cilin ishit paralajmëruar. <sup>64</sup> Futuni në të sot, se vazhduat me injorim [të urdhrave të Mi].’

<sup>65</sup> Në atë Ditë do t’ua vulosim gojën, por duart e tyre do të na flasin dhe këmbët e tyre dëshmojnë për gjithçka që kanë bërë. <sup>66</sup> Po të kish qenë përcaktimi Ynë, do të mund t’ua largonim të pamurit. Do të mundoheshin ta gjenin rrugën, por si do të mund ta shihnin? <sup>67</sup> Po të kish qenë përcaktimi Ynë, do të mund t’i paralizonim aty ku qëndronin, ashtu që s’do të mund të lëviznin as përpara as prapa. <sup>68</sup> Nëse dikujt ia zgjasim jetën, ia kthejmë mbrapa zhvillimin. A nuk e përdorin arsyen?

<sup>69</sup> Ne nuk i kemi mësuar poezi<sup>a</sup> Profetit, as s’do të mund të ishte poet ndonjëherë<sup>b</sup>. <sup>36:70</sup> Kjo është shpallje, Kuran ndriçues për ta paralajmëruar këdo që është vërtet gjallë, ashtu që vendimi i **Allahut** të mund të shqiptohet ndaj pabesimtarëve.

<sup>71</sup> A s’mund ta shohin se si, ndër gjërat e bëra nga duart Tona, e kemi krijuar bagëtinë që e kontrollojnë, <sup>72</sup> dhe i kemi bërë ato të bindura, ashtu që disa mund të përdoren për t’i kalëruar, disa për ushqim, <sup>73</sup> disa për përfitime të tjera dhe disa për pije? A nuk do të falënderojnë? <sup>74</sup> E prapë kanë marrë zota të tjerë pos **Allahut** për t’u ndihmuar, <sup>75</sup> edhe pse këta nuk do të mund ta bënin këtë edhe po ta thirrnin një ushtri të tërë të tyre bashkë! <sup>76</sup> Prandaj [Profet] mos u shqetëso se çka thonë: e dimë se çka fshehin dhe çka zbulojnë.

<sup>77</sup> A s’mund ta shohë njeriu se Ne e krijuam nga një pikë e lëngut? E prapë – shih sa çudi! – polemizon haptas, <sup>78</sup> duke prodhuar mospajtime kundër Nesh, duke e harruar krijimin e tij. Thotë: ‘Kush mund t’ua kthejë jetën eshtrave pasi të jenë kalbur?’ <sup>79</sup> Thuaj: ‘Ai që i krijoi fillimisht do t’u japë jetë përsëri: Ai ka dije të plotë të secilit veprim të krijimit. <sup>36:80</sup> Është Ai që prodhon zjarr për ju nga pema e gjelbër – shih sa çudi! – dhe nga kjo ndezni zjarr. <sup>81</sup> A s’është Ai që i krijoi qiejt dhe tokën – i aftë të krijojë njerëz si këta? Natyrisht që është! Ai është Krijuesi I Gjithëdijshëm: <sup>82</sup> kur vendos që diçka të jetë, mënyra E Tij është të thotë: “Ji” – dhe ajo është! <sup>83</sup> Pra lãvdi qoftë për Të në Dorën e Të Cilit gjendet kontrolli ndaj të gjitha gjërave. Është Ai tek i cili do t’ju kthejnë të gjithëve.’

---

<sup>a</sup> Disa nga arabët e refuzuan vërtetësinë e Kuranit duke e cilësuar si poezi.

<sup>b</sup> Ky është kuptimi klasik i *yanbaghi*.

*Jaa Siin*

NË EMRIN E **ALLAHUT**, DASHAMIRËSIT, MËSHIRËPLOTIT

(1-12)

Jaa Siin

Pasha Recitalin, të begatë në urti,

sigurisht që je një nga Të Dërguarit,

në rrugë të drejtë.

Është shpallje e zbritur  
nga I Fuqishmi, Mëshirëploti,

që të mund ta paralajmërosh një popull  
stërgjyshërit e të cilëve nuk ishin paralajmëruar  
dhe kështu ishin të pavëmendshëm.

Fjala në fakt  
doli të jetë e vërtetë kundër shumicës së tyre,  
por nuk besojnë.

Se Ne u kemi vënë zgjedha në qafë,  
që u arrijnë te mjekra,  
ashtu që kokat u mbahen lart me zor:

dhe u kemi vënë pengesë përpara  
dhe pengesë prapa,  
dhe i kemi mbuluar plotësisht,  
kështu që nuk shohin.



Dhe është njëjtë për ta  
qoftë i paralajmërove apo jo:  
nuk besojnë.

Mund t'i paralajmërosh veç ata  
që e ndjekin Kujtuesin  
dhe i frikësohen Dashamirësit në fshehtësi:  
jepu lajm të faljes  
dhe të një shpërblimi bujar e madhështor.  
Se Ne u japim jetë të vdekurve,  
dhe regjistrojmë se çka dërguan më parë  
dhe çka lanë prapa vetes:  
dhe kemi marrë shënim për të gjitha gjërat  
në një libër të qartë të shembujve.

(13-32)

Dërgojua një alegori  
të grupit të njerëzve të qytetit  
kur u erdhën Përfaqësues  
të çuar si të dërguar.

Kur i dërguam së pari dy,  
i quajtën rrenacakë të dytë;  
kështu që i forcua ata dy  
me një të tretë.

Dhe thanë:

“Jemi të dërguar të çuar te ju.”

Njerëzit thanë:

“Nuk jeni asgjë pos qenie njerëzore si ne.

Dhe Dashamirësi nuk zbret

asgjë fare.

Thjesht po rreni.”

Të dërguarit thanë:

“Zoti ynë e di se jemi vërtet  
të dërguar të çuar te ju.”

Dhe obligimi ynë i vetëm  
është komunikimi i qartë.”

Njerëzit thanë:

“Shohim ogur të zi në ju:  
nëse nuk pushoni,  
do t’ju gurëzojmë,  
dhe një ndëshkim i dhembshëm,  
do t’ju godasë nga ne.”

Të dërguarit thanë:

“Oguri juaj i zi është në veten tuaj;  
a varet ai nga të qenët të qortuar?  
Jo, jeni popull  
që i tejkalon të gjithë kufijtë.”

Dhe erdhi aty,  
nga pjesa më e largët e qytetit,  
një njeri në vrap; tha:  
“O populli im!  
Ndiqni Të Dërguarit:

“Ndiqni ata që nuk ju kërkojnë shpërblim,  
por janë vetë të udhëzuarit.

“Dhe si do të mund të mos i shërbeja  
Atij që më krijoi,  
dhe tek i cili do t’ju kthejnë të gjithëve?

“A të nisi të pëlqej zota të tjerë?  
Nëse Dashamirësi do të ma donte sëmundjen,  
ndërmjetësimi i tyre s’do t’ëmë hynte në punë fare,  
dhe nuk do t’ëmë shpëtonin.

“Vërtet, do të isha qartë gabim.

“Besoj në Zotin tuaj:  
pra dëgjomëni.”

Ishte thënë:

“Futu në kopsht.”

Ai tha:

“Ah, veç po ta dinte populli im  
“Zoti im më ka falur  
dhe më vendosi ndër të nderuarit!”

Dhe Ne nuk i dërguam  
popullit të tij pas tij  
asnjë ushtri nga qielli;  
dhe s’e kishim ndërmend t’i dërgojmë.

Ishte veç një shpërthim i vetëm:  
dhe ishin të shuar!

Mjerë shërbyesit:  
kurdo që u vjen një I Dërguar  
e tallin.

A s’e shohin  
sa shumë komunitete  
i shkatërruam para tyre?  
A tyre s’do t’u kthehen.

Dhe çdonjëri dhe secili,  
të gjithë bashkë,  
do të sillen para Nesh.

(33-50)

Dhe një shenjë për ta  
është toka kur është e vdekur:  
Ne e gjallërojmë  
dhe prodhojmë drithë nga ajo,  
nga i cili marrin të hanë.

Dhe kemi vënë në të  
kopshte me hurma e rrush,  
dhe bëmë që burime të rrjedhin në të,

që të mund të hanë nga frutat e saj,  
edhe pse duart e tyre s'e kanë bërë këtë:  
a s'do të jenë pra falënderues?

Lâvdi për Atë  
që i krijoi çiftet, të gjitha,  
nga të cilat toka prodhon,  
nga vetet e tyre,  
dhe nga ajo që s'e njohin.

Dhe një shenjë për ta është nata,  
nga e cila e heqim ditën,  
pas së cilës zhyten krejt në terr.

Dhe dielli kalon  
në vendin e rregulluar për të  
ky është rendi i urdhëruar  
nga I Gjithë-Fuqishmi, I Gjithëdijshti.  
Dhe për hënën

i kemi matur fazat,  
deri kur të kthehet  
në gjysmëhënë të vockël.

Dielli nuk do ta parakalojë hënë,  
as nata t'ia kalojë ditës;  
dhe secili noton në orbitë.

Dhe një shenjë për ta  
është se Ne e bartëm llojin e tyre  
në Arkën e ngarkuar:

dhe e bëmë për ta  
të ngjashmen me të,  
në të cilën udhëtojnë.

Dhe po të donim,  
do të mund t'i përmbysnim  
ashtu që nuk do të kishin ndihmues,  
dhe nuk do të shpëtoheshin,

përveç si mëshirë nga Ne,  
dhe si furnizim i përkohshëm.

Dhe kur u thuhet,  
“Kini kujdes nga çka ka para jush  
dhe çka ka pas jush,  
që të mund të përkraheni me mëshirë,”

asnjëra nga shenjat e Zotit të tyre  
nuk u vjen e ata të mos i largohen.

Dhe kur u thuhet:

“Shpenzoni nga ajo që **Allahu** ka furnizuar për ju,”

ata që nuk besojnë u thonë atyre që besojnë:

“A do t’i ushqejmë ata

që **Allahu** do të mund t’i kish ushqyer po të donte?

Jeni thjesht në gabim të qartë.”

Dhe thonë:

“Kur do të përmbushet ky premtim,

nëse po e thoni të vërtetën?”

Nuk kanë çka të presin asgjë

pos një shpërthim të vetëm:

do t’i mbërthejë

edhe gjersa polemizojnë,

kështu që s’do të jenë në gjendje

ta bëjnë testamentin e tyre të fundit,

dhe s’do të kthehen te familjet e tyre.

(51-67)

Dhe trumpeta do të dëgjohej,

dhe nga varret te Zoti i tyre

ata do të nxitojnë.

Do të thonë:

“Mjerë ne!

Kush na ka zgjuar

nga shtretërit tanë?”

Kjo është çka **Allahu**

Dashmirësi ka premtuar,

se Profetët e folën të vërtetën.

Do të jetë veç një shpërthim i vetëm,

pas të cilit të gjithë

do të sillen bashkë para Nesh.

Dhe në atë ditë  
asnjë shpirti s'do t'i bëhet e padrejtë në asgjë,  
dhe nuk do të shpërbleheni  
pos për atë që e keni bërë.

Njerëzit e Kopshtit  
do të jenë të lumtur në veprime atë ditë;

ata dhe bashkëshortët e tyre  
do të jenë në hije  
të mbështetur në divane,

çdo komoditet aty për ta,  
dhe kanë çka të kenë nevojë.

Paqe:  
fjalë nga një Zot i mëshirshëm.

Dhe shtyhuni tutje këtë ditë,  
ju që jeni mëkatarë;

a s'ju kam urdhëruar,  
fëmijë të Ademit,  
të mos i shërbeni Obsesionit,  
armik i dukshëm për ju,

dhe t'më shërbeni Mua,  
duke qenë kjo Rrugë e drejtë?

Ai në fakt i ka devijuar  
një numër të madh nga ju;  
a s'e keni kuptuar?

Ky është ferri,  
që ju është premtuar:

digjuni në të sot,  
për atë që keni qenë jomirënjohës.

Në atë ditë Ne do t'ua vulosim gojën,  
dhe duart e tyre do të na flasin,  
dhe këmbët e tyre do të dëshmojnë  
se çka kanë fituar.

Dhe po të donim,  
do të mund t'ua nxirrnim sytë;  
dhe do të kishin nxituar kah rruga,  
por si do të mund të shihnin?

Dhe po të donim,  
do të mund t'i shndërronim  
në vendet e tyre  
ashtu që s'do të mundnin  
as të përparojnë as të kthehen prapa.

(68-83)

Dhe kujt do që i dhurojmë jetë të gjatë,  
e kthejmë mbrapsht në natyrë:  
pra a s'do të kuptojnë?

Dhe nuk i mësuam poezi atij,  
meqë ajo nuk i shkon.  
Ky është veçse Kujtues  
dhe Recital i qartë,



për t'i paralajmëruar ata që janë gjallë,  
dhe për ta vërtetuar Fjalën  
kundër jomirënjohësve që nuk besojnë.

A s'e kanë parë  
që kemi krijuar për ta,  
nga ajo që e kanë bërë duart Tona,  
bagëti, ndaj të cilave kanë kontroll?

Dhe i kemi bërë të bindura,  
ashtu që ca nga to janë për kalërim,  
dhe ca nga to i hanë.

Dhe kanë përdorje të tjera për to,  
përfshirë qumshtin për ta pirë:  
a s'janë pra falënderues?

E prapë i marrin për zota  
të tjerë nga **Allahu**,  
që mbase mund t'u ndihmojnë.

Ata janë të paaftë t'u ndihmojnë:  
por do të bëhen  
si ushtri kundër tyre.  
Pra mos lejo që të folurit e tyre të të brengosë,  
se Ne e dimë çka fshehin  
dhe çka shfaqin.

A s'e ka parë Njeriu se Ne  
e kemi krijuar nga një pikë?  
E prapë ja ku është, kundërshtues i hapur!

Dhe shpik krahasime për Ne,  
duke e harruar origjinën e tij:  
thotë: “Kush mund t’i ngjallë eshtrat e kalbura?”

Thuaj: “Ai që i krijoi  
herën e parë  
do t’i sjellë në jetë  
duke e njohur fare mirë  
çdo lloj të krijuar.

“Ai që e prodhoi zjarrin  
për ju nga pema e gjelbër,  
që ju vetë  
të ndezni zjarr nga ai.

“A s’është Ai që i krijoi  
qiejt dhe tokën  
i aftë t’i krijojë të ngjashmit e tyre?”  
Oh, po! Se ky  
është Krijuesi Suprem,  
I Gjithëdijsmi.

Urdhri i vetëm i **Allahut**  
kur vendos çkado qoftë  
është t’i thotë: “Ji!”  
– dhe ajo është.

Pra lâvdi Atij  
në dorën e Të Cilit  
është kontrolli i të gjitha gjërave,  
dhe tek I Cili do t’ju kthejnë të gjithëve.

**Përshkrimi para kaptinës 36 nga Abdel Haleem:**

*Sure mekase që e thekson burimin hyjnor të Kuranit dhe e mbron atë nga akuza e të qenët poezi e përpiluar nga njeriu (vargjet 5-6, 69-70). Ajo paralajmëron për fatin e njerëzve që janë kokëfortë dhe tallen gjithmonë me shpalljet e **Allahut**. Atyre u përmendet ndëshkimi që u ra brezave të mëhershëm dhe fuqia e **Allahut** siç shfaqet në Krijimin E Tij. Fundi i sures jep argumente të forta për realitetin e Ringjalljes.*

**Shënimet gjuhësore (nga Thomas Cleary)**

*Jaa Siin! (Kaptina 36)*

E shpallur në Mekë, Jaa Siin quhet Zemra e Kuranit. Është emëruar sipas shkronjave mistike të vargut të parë, të cilat disa thonë se i paraqesin fjalët *Yaa Insaan!* që domethënë “O qenie njerëzore!” të adresuara Muhamedit në kapacitetin e tij si I Dërguar i Zotit.

- 2 “Pasha Recitalin”: Kurani vetë konsiderohet mrekullia që e vërteton misionin e Muhamedit si I Dërguar i Zotit.
  
- 8 “zgjedha në qafë”: Këto ka mundësi t’i simbolizojnë merakët (dëshirat) e kësaj bote, që shkaktojnë që të pamurit të largohet nga destinacioni real.
  
- 9 “pengesë para tyre dhe pengesë prapa tyre”: Këto duket t’i referohen të ardhmes dhe të shkuarës, ankthit dhe keqardhjes.  
“i kemi mbuluar plotësisht”: Zoti e lejon njerëzimin të imagjinojë çka të dojë për universin.  
“kështu që nuk shohin” se pikëpamjet e tyre e pengojnë të pamurit.
  
- 19 “a varet ai nga të qenët të qortuar?”: Kuptimi duket të jetë “problemi juaj nuk është thjesht bezdia që e ndjeni teksa qortoheni: është problem që është në karakterin tuaj, pavarësisht a ju bëhet me dije a jo.”

- 20 “nga pjesa më e largët e qytetit”: Veç dikush i shkëputur nga pretendimet arrogante të “shoqërisë së qytetit” do të mund ta perceptonte të vërtetën e Të Dërguarve, të cilët po operonin jashtë sistemit të ndëshkimeve e shpërblimeve të vetë “shoqërisë”.
- 36 “që i krijoi çiftet, të gjitha . . .”: Komplementariteti shihet në botën bimore, botët e kafshëve dhe të njerëzve dhe në botët e padukshme për syrin e njeriut.
- 68 “kujtdo që i dhurojmë jetë të gjatë, Ne e kthejmë mbrapsht në natyrë”: Kujtdo që i dhurohet jetë e gjatë në të njëjtën kohë i hiqet fuqia; paaftësia e moshës së vjetër krahasohet me fëmijërinë dhe foshnjërinë.
- 69 “Ne nuk i mësuam poezi atij”: Kur Muhamedi ishte vizituar herën e parë nga shpallja, frikësohej se ose po çmendej ose po bëhej poet. Në veçanti, “Ne nuk i mësuam poezi atij” domethënë se Kurani nuk është rezultat që Muhamedi është zhytur në letërsi të lashtë, siç pretendonin shumë shpifës të shkuar e të tashëm.
- 75 Domethënë, zotat e rremë do të sillen në Gjykim si “dëshmitarë” kundër “besimtarëve” në ta dhe po ashtu (në rastet e njerëzve, shpirtave apo engjëjve që shkaktuan apo lejuan vetë të adhurohen) si bashkë-komplotistë.
- 78 “Dhe shpik krahasime për Ne”: Njerëzimi arrogant e koncepton Zotin në terma njerëzore dhe vazhdon t’i projektojë në Zotin dobësitë dhe kufizimet njerëzore. Kohëve të fundit madje është bërë modë të pohohet se Zoti është krijim njerëzor: ky është “Zoti” që është deklaruar “i vdekur” nga teologët e popullarizuar bashkëkohorë.

## 37: Të vendosur nëpër rreshta (ES-SÂFFÂT)

Në emrin e **Allahut**, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës

<sup>1</sup> Pasha ata [engjëj] të vendosur në rreshta, <sup>2</sup> që bëjnë mosmiratim të ashpër e qortues <sup>3</sup> dhe e recitojnë fjalën e **Allahut**, <sup>4</sup> vërtet **Allahu** juaj është Një, <sup>5</sup> Zoti i qiejve dhe i tokës dhe i gjithçkaje ndërmjet tyre, Zoti i secilës lindje të diellit. <sup>6</sup> Ne e kemi zbukuruar qiellin më të ulët me yje <sup>7</sup> dhe i bëmë roje mbrojtëse ndaj çdo djalli rebel: <sup>8</sup> ata nuk mund të përgjojnë në Asamblenë që është Më e Lartë<sup>a</sup> – e thurur nga çdo anë – <sup>9</sup> të përzënë, do të kenë torturë të përhershme – <sup>37:10</sup> nëse cilido [nga ta] e rrëmben vjedhurazi ndonjë fragment,<sup>b</sup> do të ndiqet nga një flakë shpuese.

<sup>11</sup> Pra [Profet], pyeti mosbesimtarët: a është më vështirë të krijohen ata se sa qeniet e tjera që i kemi krijuar? <sup>c</sup> Ne i krijuam nga argjila ngjitëse. <sup>12</sup> Çuditësh teksa tallen, <sup>13</sup> nuk janë të vëmendshëm kur paralajmërohen, <sup>14</sup> dhe i kthehen përqeshjes kur e shohin një shenjë, <sup>15</sup> duke thënë: ‘Kjo s’është gjë pos magji pacipërisht e dukshme.’ <sup>16</sup> ‘Çka?! Pasi të kemi vdekur dhe të bëhemi pluhur e eshtra, vërtet do të ringjallemi prapë, <sup>17</sup> bashkë me para-ardhësit tanë?’ <sup>18</sup> Thuaj: ‘Po, në fakt dhe do të poshtëroheni.’ <sup>19</sup> Veç një shpërthim dhe – shih sa çudi! – do të shikojnë <sup>37:20</sup> dhe do të thonë: ‘Mjerë ne! Kjo është Dita e Gjykimit.’ <sup>21</sup> [Do të thuhet:] ‘Kjo është Dita e Vendimit, të cilën e mohoni dikur. <sup>22</sup> [Engjëj,] mblidhni bashkë ata që bënë keq dhe të tjerët si ta, si dhe çkado që kanë adhuruar <sup>23</sup> krahas **Allahut**, çoni të gjithë në rrugën e Ferrit, <sup>24</sup> dhe ndalini për t’i pyetur: <sup>25</sup> “Pse nuk e përkrahni njëri-tjetrin tash?”’ – <sup>26</sup> jo në fakt! Do të jenë në nënshtrim të plotë në atë Ditë – <sup>27</sup> dhe do t’i kthehen njëri-tjetrit me akuza. <sup>28</sup> Do të thonë: ‘Ju na erdhët nga një pozitë e fuqisë.’ <sup>d</sup> <sup>29</sup> Ata do të thonë: ‘Jo! Ishit ju që nuk donit të besonit – <sup>37:30</sup> nuk kishim pushtet ndaj jush – dhe tashmë po i tejkalonit të gjithë kufijtë. <sup>31</sup> Vendimi dënues i Zotit tonë për ne është i drejtë dhe të gjithë duhet ta shijojmë ndëshkimin. <sup>32</sup> Ju devijuam siç ishim vetë të devijuar.’ <sup>33</sup> Në atë Ditë të gjithë do ta kenë torturën bashkë: <sup>34</sup> kështu i trajtojmë fajtorët. <sup>35</sup> Kurdo që u thuhej: ‘Nuk ka hyjni pos **Allahut**’, bëheshin arrogantë <sup>36</sup> dhe thoshin: ‘A t’i braktisim zotat tanë për një poet të çmendur?’ <sup>37</sup> ‘Jo: ai e solli të vërtetën dhe i vërtetoi të dërguarit e mëhershëm; <sup>38</sup> ju do ta shijoni torturën e dhembshme <sup>39</sup> dhe do të shpaguheni veç sipas veprave tuaja.’

---

<sup>a</sup> E engjëjve.

<sup>b</sup> Të diçkaje që e ka përgjuar.

<sup>c</sup> Krahaso me 40:57.

<sup>d</sup> Shprehja arabe ‘nga ana e dorës së djathtë’ e përcjell kuptimin e të qenët në të djathtë apo qasjen nga këndi më i nderuar, apo me fuqi dhe ndikim (shih vargun 30).

<sup>37:40</sup> Por jo shërbyesit e vërtetë të **Allahut**. <sup>41</sup> Ata do të kenë furnizime të njohura<sup>a</sup> – <sup>42</sup> fruta – dhe do të nderohen <sup>43</sup> në kopshte të kënaqësisë; <sup>44</sup> të ulur në divane, përballë njëri-tjetrit. <sup>45</sup> Një pije do të kalohet te secili nga një burim rrjedhës: <sup>46</sup> e bardhë, e shijshme për ata që e shijojnë, <sup>47</sup> që nuk shkakton as trullosje as dehje. <sup>48</sup> Me ta do të jenë bashkëshortë – me vështrimin modest e syrin e bukur – <sup>49</sup> si vezët e mbrojtura.<sup>b</sup>

<sup>37:50</sup> Ata do t'i kthehen njëri-tjetrit me pyetje – <sup>51</sup> njëri do të thotë: 'E kisha një shok të ngushtë në tokë <sup>52</sup> që më pyeste: "A vërtetë beson se <sup>53</sup> pasi të vdesim dhe të bëhemi pluhur e eshtra, do të na sjellin në gjykim?"' <sup>54</sup> Pastaj do të thotë: 'A ta kërkojmë?' <sup>55</sup> Do të shikojë poshtë dhe do ta shohë në mes të Zjarrit, <sup>56</sup> dhe do t'i thotë: 'Pasha **Allahun**, gati më ke shkatërruar! <sup>57</sup> Po të mos ishte mirësia e Zotit tim, edhe mua do të më çonin në Ferr.' <sup>58</sup> Pastaj do t'u thotë [shokëve të tij të bekuar]: 'Nuk do të vdesim më kurrë pas vdekjes sonë të mëhershme? <sup>59</sup> Nuk do të vuajmë më kurrë? <sup>37:60</sup> Ky vërtetë është triumfi suprem!' <sup>61</sup> Secili duhet të përpiqet ta arrijë këtë. <sup>62</sup> A është kjo mirëseardhje më e mirë, apo pema e Zekumit, <sup>63</sup> të cilën e kemi bërë sprovë për keqbërësit? <sup>64</sup> Kjo pemë rritet në zemër të Zjarrit flakërues,<sup>c</sup> <sup>65</sup> dhe frutat e saj janë si koka të djajve. <sup>66</sup> Do ta mbushin barkun duke ngrënë nga ajo; <sup>67</sup> pastaj vazhdojnë të pinë ujë përvëlues; <sup>68</sup> pastaj i kthehen Zjarrit flakërues. <sup>69</sup> I gjetën para-ardhësit e tyre të devijuar <sup>37:70</sup> dhe nxituan t'i ndiqnin gjurmët e tyre – para mosbesimtarëve [të Mekës], <sup>71</sup> shumica e njerëzve në të shkuarën devijuan, <sup>72</sup> megjithëse Ne u çuam të dërguar për t'i paralajmëruar. <sup>73</sup> Shihni se si e hasën fundin e tyre ata që ishin paralajmëruar! <sup>74</sup> Por jo shërbyesit e vërtetë të **Allahut**.

<sup>75</sup> Nuhu na thirri dhe sa e shkëlqyeshme ishte përgjigjja Jonë! <sup>76</sup> Ne e shpëtuam atë dhe popullin e tij nga ankthi i madh, <sup>77</sup> i lamë pasardhësit e tij të mbesin në tokë, <sup>78</sup> lejuam ta lavdërojnë brezat e mëvonshëm: <sup>79</sup> 'Paqja qoftë mbi Nuhun ndër të gjitha kombet' <sup>37:80</sup> Kështu i shpërblejmë ata që bëjnë mirë: <sup>81</sup> ishte vërtetë njëri nga shërbyesit Tanë besnikë. <sup>82</sup> Të tjerët i fundosëm.

<sup>83</sup> Ibrahim i ishte besimit të njëjtë: <sup>84</sup> erdhi te Zoti i tij me zemër të përkushtuar. <sup>85</sup> I tha babait të tij dhe popullit të tij: 'Çka jeni duke adhuruar? <sup>86</sup> Si mund të zgjedhni zota të rremë në vend të **Allahut** të vërtetë? <sup>87</sup> Pra cili është opinionin juaj për Zotin e të gjitha Botëve?' <sup>88</sup> mandej shikoi lart kah yjet. <sup>89</sup> Tha: 'Jam i sëmure.' <sup>37:90</sup> kështu [populli i tij] u larguan nga ai dhe shkuan. <sup>91</sup> U kthye kah zotat e tyre dhe tha: <sup>92</sup> 'A nuk hani ju? Pse nuk flisni?' <sup>93</sup> pastaj u kthye dhe i goditi me krahun e djathtë. <sup>94</sup> Populli i tij nxituan kah ai, <sup>95</sup> por ai tha: 'Si mund të adhuroni gjëra që i gdhendni me duart tuaja, <sup>96</sup> kur është **Allahu** që ju ka

<sup>a</sup> Shih 2:25

<sup>b</sup> Arabët i përshkruanin gratë e bukura se janë po aq të çmuara sa vezët e strucit që i mbronin nga pluhuri me pendët e tyre.

<sup>c</sup> Mosbesimtarët thoshin, me përbuzje: 'Si mund të ketë pemë në Zjarr?'

krijuar juve dhe tërë punëdoren tuaj.’<sup>97</sup> Thanë: ‘Ndërtojeni një turrë të druve dhe hidheni në zjarrin flakërues.’<sup>98</sup> Dëshën ta dëmtonin, por Ne i poshtëruam.

<sup>99</sup> Ai tha: ‘Do të shkoj te Zoti im: Ai sigurisht që do të më udhëzojë.’<sup>37:100</sup> Zot, ma dhuro një djalë të ndershëm’,<sup>101</sup> dhe kështu ia dhamë lajmin e mirë se do ta kishte një djalë të durueshëm.<sup>102</sup> Kur djali ishte mjaft i madh të punonte me të atin, Ibrahim tha: ‘Biri im, e kam parë veten duke të flijuar në një ëndërr. Çka po ta merr mendja?’ Tha: ‘Baba, bëj siç je urdhëruar dhe, dhashtë **Allahu**, do ta shohësh se jam i qëndrueshëm.’<sup>103</sup> Kur të dytë i ishin dorëzuar Zotit dhe ai e kishte shtrirë të birin anash fytyrës së tij,<sup>104</sup> Ne i thirrëm atij: ‘Ibrahim,<sup>105</sup> e ke përmbushur ëndrrën.’ Kështu i shpërblejmë ata që bëjnë mirë –<sup>106</sup> kjo ishte sprovë për të vërtetuar [karakterin e tyre të vërtetë] –<sup>107</sup> ia shpenguam të birin me një flijim shumë të rëndësishëm<sup>108</sup> dhe lejuam të lavdërohet nga brezat vijues:<sup>109</sup> ‘Paqja qoftë mbi Ibrahimin!’<sup>37:110</sup> Kështu i shpërblejmë ata që bëjnë mirë:<sup>111</sup> vërtet ishte nga shërbyesit Tanë besimplotë.

<sup>112</sup> Ne ia dhamë Ibrahimit lajmin e mirë për Is’hakun – profet dhe njeri i ndershëm –<sup>113</sup> dhe e bekuam edhe atë edhe Is’hakun: disa nga pasardhësit e tyre ishin të mirë, por disa e dëmtuan veten qartë.<sup>114</sup> Ne ia dhuruam favorin Tonë edhe Musait dhe Harunit:<sup>115</sup> Ne i shpëtuam ata dhe popullin e tyre nga një ankth i madh;<sup>116</sup> u ndihmuam, kështu që ishin ata që ia dolën;<sup>117</sup> ua dhamë Shkrimin e Shenjtë që i qartëson gjërat:<sup>118</sup> i udhëzuam në rrugën e drejtë;<sup>119</sup> i lejuam të lavdërohen nga brezat pasardhës:<sup>37:120</sup> ‘Paqja qoftë mbi Musain dhe Harunin!’<sup>121</sup> Kështu i shpërblejmë ata që bëjnë mirë:<sup>122</sup> vërtet ishin ndër shërbyesit Tanë besnikë.

<sup>123</sup> Edhe Iljasi ishte një nga të dërguarit.<sup>124</sup> I tha popullit të tij: ‘A nuk ia keni frikën **Allahut**?<sup>125</sup> Si mund t’i thirrni Ba`l-it dhe ta braktisni Krijuesin Më Dashamirës,<sup>126</sup> **Allahun**, Zotin tuaj dhe Zotin e para-ardhësve tuaj?’<sup>127</sup> por e refuzuan. Do t’i sjellin në ndëshkim<sup>a</sup> si pasojë e kësaj;<sup>128</sup> por jo shërbyesit e vërtetë të **Allahut**.<sup>129</sup> Ne lejuam të lavdërohet nga brezat pasardhës:<sup>37:130</sup> ‘Paqja qoftë mbi Iljasin!’<sup>131</sup> Kështu i shpërblejmë ata që bëjnë mirë:<sup>132</sup> vërtet ishte një nga shërbyesit tanë besnikë.

<sup>133</sup> Edhe Luti ishte një nga të dërguarit.<sup>134</sup> Ne e shpëtuam atë dhe tërë familjen e tij –<sup>135</sup> përveç një gruaje të moshuar që qëndroi prapa –<sup>136</sup> dhe i shkatërruam të tjerët.<sup>137</sup> Ju [njerëz] kaloni pranë rrënojave të tyre në mëngjes<sup>138</sup> dhe natën: a nuk do të jeni të vëmendshëm?<sup>139</sup> Edhe Junusi ishte një nga të dërguarit.<sup>37:140</sup> Ai nxitoi tek anija e mbingarkuar.<sup>141</sup> Ata hodhën short, ai pësoi disfatë,<sup>142</sup> dhe një peshk i madh e përpiu, se kishte kryer vepra fajësuese.<sup>143</sup> Po të mos kish qenë një nga ata që e lavdonin **Allahun**,<sup>144</sup> do të kish qëndruar në

---

<sup>a</sup> Është e pasaktë të thuhet “t’i thërrasin në llogari”, meqë kjo do të vliente për të gjithë, përfshirë edhe shërbyesit e vërtetë të **Allahut**.

barkun e tij deri në Ditën kur ringjallen të gjithë,<sup>145</sup> por Ne e qitëm jashtë, të sëmure, mbi një breg të thatë,<sup>146</sup> dhe e bëmë një pemë kungulli të rritet mbi të.<sup>147</sup> E çuam te njëqind mijë a më tepër njerëz.<sup>148</sup> Ata besuan, kështu që i lamë t'i jetojnë jetët e tyre.<sup>a</sup>

<sup>149</sup> Tash [Muhamed], pyeti mosbesimtarët: a është e vërtetë se Zoti juaj ka bija, gjersa ata zgjodhën bij për vete?<sup>b 37:150</sup> A i krijuam engjëjt si femra gjersa ata po shikonin?<sup>151</sup> Jo në fakt! Është një nga gënjeshttrat e tyre kur thonë:<sup>152</sup> ‘**Allahu** është bërë prind.’ Si gënjejnë!<sup>153</sup> A vërtet Ai zgjodhi bija duke i preferuar mbi bijtë?<sup>154</sup> Si është puna me ju? Si i formoni gjykimet tuaja?<sup>155</sup> A nuk reflektoni?<sup>156</sup> A mos kenë mbase autoritet të qartë?<sup>157</sup> Sillni shkrimet tuaja të shenjta, nëse po e tregoni të vërtetën.<sup>158</sup> Pretendojnë se Ai ka lidhje farefisnore me xhindet, e megjithatë vetë xhindet e dinë se do të sillen para Tij.<sup>159</sup> **Allahu** është larg mbi atë që ia atribuojnë – <sup>37:160</sup> shërbyesit e vërtetë të **Allahut** nuk bëjnë gjëra të tilla –<sup>161</sup> dhe as ju as ajo që e adhuroni <sup>162</sup> nuk mund ta joshni larg **Allahut** askë <sup>163</sup> përveç atyre që do të digjen në Ferr.<sup>164</sup> [Engjëjt thonë:] ‘Secili nga ne e ka vendin e tij të caktuar:<sup>165</sup> jemi të vendosur nëpër rreshta.<sup>166</sup> E lavdojmë **Allahun.**’<sup>c</sup>

<sup>167</sup> [Mosbesimtarët] thoshin:<sup>168</sup> ‘Veç ta kishim pasur një shkrim të shenjtë si njerëzit e mëparshëm,<sup>169</sup> do të ishim shërbyes të vërtetë të **Allahut**,<sup>37:170</sup> e megjithatë tani e refuzojnë [Kuranin]. Së shpejti do ta kuptojnë.<sup>171</sup> Fjala Jonë tashmë u është dhënë shërbyesve Tanë – të dërguarve:<sup>172</sup> pikërisht ata do të ndihmohen,<sup>173</sup> dhe ata që e përkrahin<sup>d</sup> çështjen Tonë do të jenë fituesit.<sup>174</sup> Pra [Profet] largohu nga mosbesimtarët për ca kohë.<sup>175</sup> Shikoji: së shpejti do ta shohin.<sup>176</sup> A vërtet duan ta nxitojnë ndëshkimin Tonë?<sup>177</sup> Kur ai të zbresë në oborret e tyre, sa i tmerrshëm do të jetë ai mëngjes për ata që u paralajmëruan!<sup>178</sup> [Profet,] largohu nga mosbesimtarët për ca kohë.<sup>179</sup> Shikoji: së shpejti do ta shohin.<sup>37:180</sup> Zoti yt, Zoti i Lavdisë, është larg mbi atë që ia atribuojnë.<sup>181</sup> Paqja qoftë mbi të dërguarit<sup>182</sup> dhe lãvdi qoftë për **Allahun** – Zotin e të gjitha Botëve.

---

<sup>a</sup> Një ndër kuptimet klasike të *matta`a* është “t’u japësh jetë të gjatë”.

<sup>b</sup> Arabët paganë kishin turp që vetë të kishin bija, e megjithatë ia atribuonin bijat **Allahut**.

<sup>c</sup> Ky është mosmiratimi i ashpër nga engjëjt i referuar në vargun 2.

<sup>d</sup> Në arabishten klasike *xhund* domethënë ‘përkrahësit’, e jo vetëm ‘ushtritë’.



**Përshkrimi para kaptinës 37 nga Abdel Haleem:**

*Pika qendrore e kësaj sureje mekase është njëshmëria e **Allahut** (vargjet 4 dhe 180-182) dhe përgënjeshtrimi i besimit pagan se engjëjt ishin bija të **Allahut** dhe të denja për adhurim. Vetë engjëjt citohen ta hedhin poshtë këtë (vargjet 164-166). Pohohet profetësia e Muhamedit, si dhe E Përtejmyja. Janë dy seksione mbështetëse: skenat në Të Përtejmen (vargjet 19-68) dhe rrëfimet e profetëve të mëhershëm (vargjet 75-148).*

## 38: Sad (SÂD)

Në emrin e Allahut, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës

<sup>1</sup> *Sad*

Pasha Kuranin me përkujtimin e tij . . . !<sup>a</sup> <sup>2</sup> E megjithatë mosbesimtarët janë të zhytur në arrogancë dhe armiqësi. <sup>3</sup> Sa shumë breza i kemi shkatërruar para tyre! Të gjithë thërrisnin, pasi ishte tepër vonë, për shpëtim. <sup>4</sup> Mosbesimtarëve u duket e çuditshme që një profet i popullit të tyre ka ardhur t'i paralajmërojë – thonë: 'Është veç magjistar që gënjen. <sup>5</sup> Si mund të pretendojë se të gjithë zotat janë veç një Zot? Çfarë gjëje e habitshme [për ta pretenduar]!' <sup>6</sup> Udhëheqësit e tyre mënjanojnë, duke thënë: 'Largohuni! Qëndrojeni besnikë zotave tuaj! Këtë duhet ta bëni. <sup>7</sup> Nuk kemi dëgjuar ndonjë pretendim të tillë në fenë e fundit:<sup>b</sup> është krejt shpikje. <sup>8</sup> A iu dërgua mesazhi veç atij ndër të gjithë ne?

Në fakt ata e vënë në dyshim paralajmërimin Tim; në fakt nuk e kanë shijuar ende ndëshkimin Tim. <sup>9</sup> A i posedojnë thesaret e Zotit tënd, Të Fuqishmit, Gjithë-Dhuruesit? <sup>38:10</sup> A i kontrollojnë qiejt dhe tokën dhe gjithçka ndërmjet? Le të ngjiten litarëve të tyre: <sup>c</sup> <sup>11</sup> aleanca e tyre e armatosur është e dobët dhe do të shkatërrohet. <sup>12</sup> Popujt e Nuhut, Adit dhe Faraonit që-ishte-i-mbështetur-fort<sup>d</sup> i refuzuan profetët e tyre para tyre. <sup>13</sup> Themudi, populli i Lutit dhe Banorët e Pyllit secili formoi opozitë [kundër të vetëve]. <sup>14</sup> Ata të gjithë i refuzuan të dërguarit dhe u goditën me meritë nga ndëshkimi Im: <sup>15</sup> krejt çka po presin mosbesimtarët këtu është një shpërthim të vetëm që nuk mund të shtyhet. <sup>16</sup> Thonë: 'Zoti ynë! Na e ngut hisen tonë të ndëshkimit para Ditës së Llogarisë!' <sup>17</sup> Ki durim me fjalët e tyre [Profet].

Kujtoje shërbyesin tonë Daudin, njeri i forcës që gjithmonë u kthye kah Ne: <sup>18</sup> Ne i bëmë malet t'i bashkohen kur na lavdonte gjatë perëndimit dhe lindjes së diellit; <sup>19</sup> dhe shpezët, po ashtu, në tufa, të gjithë e jehonin lāvdin e tij. <sup>38:20</sup> Ia forcuam mbretërinë; i dhamë urti dhe mënyrë bindëse të të folurit. <sup>21</sup> A e ke dëgjuar tregimin e dy njerëzve që ishin palë në gjyq që u ngjitën në lagjet e tij private? <sup>22</sup> Kur arritën te Daudi, ai u frikësua, por ata thanë: 'Mos ki frikë. Jemi dy palë në gjyq, ku njëri e ka dëmtuar tjetrin: gjyko ndërmjet nesh drejt – mos ji i padrejtë – dhe udhëzoni në rrugën e duhur. <sup>23</sup> Ky është vëllai im. I kishte

<sup>a</sup> Plotësimi i këtij betimi kuptohet të jetë 'Është veç një Zot' (shih 50:1-2).

<sup>b</sup> Aludim për Trininë e Krishterë.

<sup>c</sup> Krahaso me shënimin për 22:15: "Shih edhe 6:35. Një interpretim tjetër i këtij vargu është 'ta zgjasë një litar deri në tavan dhe të varet' "

<sup>d</sup> *Dhu'l-awtad* fjalë për fjalë domethënë 'me kunjat e tij', por këtu metaforikisht kuptohet se tregon diçka të fiksuar fort; krahasoje përdorimin e saj duke iu referuar maleve në 78:7.

nëntëdhjetë e nëntë dele e unë veç një rën dhe tha: “Më lejo ta marr përgjegjësinë për të” dhe më mbizotëroi me fjalët e tij.’<sup>24</sup> Daudi tha: ‘Ai të ka dëmtuar duke kërkuar t’ia shtojë delen tënde kopësë së tij. Shumë partnerë e trajtojnë njëri-tjetrin padrejtësisht. Ata që besojnë sinqerisht dhe bëjnë vepra të mira nuk e bëjnë këtë, por këta janë shumë të rrallë.’

[Pastaj] Daudi e kuptoi se e kishim sprovuar,<sup>a</sup> kështu që i kërkoi falje Zotit të tij, ra në gjunjë dhe u pendua: <sup>25</sup> Ne ia falëm [keqbërjen]. Shpërblimi i tij do të jetë afërsia me Ne, një vend i mirë për t’u kthyer. <sup>26</sup> ‘Daud, të kemi dhënë zotërim mbi vendin. Gjyko drejt ndërmjet njerëzve. Mos i ndiq merakët e tua, se mos po të largojnë nga rruga e **Allahut**: ata që bredhin e dalin nga rruga E Tij do të kenë torturë të dhembshme se e injorojnë Ditën e Llogarisë.’

<sup>27</sup> Nuk ishte pa qëllim që i krijuam qiejt dhe tokën dhe gjithçka ndërmjet. Kjo mund të jetë ajo që e supozojnë mosbesimtarët – eh, si do të vuajnë nga Zjarri! – <sup>28</sup> por a do t’i trajtonim si të barabartë ata që besojnë e bëjnë vepra të mira dhe ata që përhapin korrupsion në tokë? A do t’i trajtonim në mënyrën e njëjtë ata që janë të vetëdijshëm për **Allahun** dhe ata që i shkelin me pakujdesi të gjithë kufijtë? <sup>29</sup> Ky është Shkrim i Shenjtë i bekuar që ta zbritëm [ty Muhamed], që njerëzit të mendojnë për mesazhet e tij, dhe që ata që kuptojnë të jenë të vëmendshëm.

<sup>38:30</sup> Ne ia dhamë Daudit Sulejmanin. Ishte shërbyes i shkëlqyeshëm që gjithmonë i kthehej **Allahut**. <sup>31</sup> Kur kuajt e mirë-trajnuar këmbë-lehtë kalonin para tij afër fundit të ditës, <sup>32</sup> vazhdimisht thoshte: ‘Dashuria ime për gjërat e bukura është pjesë e të kujtuarit tim të Zotit tim!’ deri kur [kuajt] u zhdukën nga pamja – <sup>33</sup> ‘Kthejini!’ [tha] dhe nisi t’ua godasë këmbët dhe qafat. <sup>b</sup> <sup>34</sup> Sigurisht që e sprovuam Sulejmanin, duke e zvogëluar në skelet të thjeshtë në fronin e tij.<sup>c</sup> <sup>35</sup> Ai na u kthye dhe u lut: ‘Zot më fal! Më jep fuqi të tillë që askush pas meje s’do ta ketë – Ti je Furnizuesi Më Bujar.’ <sup>36</sup> Kështu i dhamë pushtet ndaj erës, që sipas kërkesës së tij shkante butësisht ku të donte ai, <sup>37</sup> dhe xhindet<sup>d</sup> – çdo lloj ndërtuesi dhe zhytësi <sup>38</sup> dhe të tjerët të lidhur me zinxhirë në pranga. <sup>39</sup> ‘Kjo është dhurata Jonë, pra jep ose mbaj si të duash pa hesap.’ <sup>38:40</sup> Shpërblimi i tij do të jetë afërsia me Ne, vend i mirë për t’u kthyer.

<sup>41</sup> Sille ndërmend shërbyesin tonë Ejubin që i thirri Zotit të tij: ‘Satani më ka munduar me lodhje e vuajtje.’ <sup>42</sup> ‘Përplase këmbën për toke! Ja ujë të ftohtë për ty

---

<sup>a</sup> Kjo me sa duket është aludim te blerja e gruas së një burri tjetër nga Daudi për t’ia shtuar grave të tij të shumta.

<sup>b</sup> Disa thonë se kuajt e shpërqendruan Sulejmanin nga të kujtuarit e **Allahut** dhe se i theri kuajt i zemëruar që e kishte harruar lutjen e pasdites.

<sup>c</sup> Sipas Razi-t, që e citon përdorimin gjuhësor në arabisht, kjo interpretohet se e ka kuptimin që Sulejmani u sëmur kaq shumë sa që ishte si skelet që ecte.

<sup>d</sup> Shih 34:12-13

që të lahesh e të pish’,<sup>43</sup> dhe ia rikthyem familjen, me shumë më shumë si ta: shenjë e mëshirës Sonë dhe mësim për krejt ata që kuptojnë.<sup>44</sup> ‘Merre një tufë të vogël të barit në dorë dhe godite [atë] me të që të mos e shkelësh betimin tënd.’<sup>a</sup> E vërejtëm se ishte i durueshëm në fatkeqësi; shërbyes i shkëlqyeshëm! Edhe ai gjithmonë i kthehej **Allahut**.

<sup>45</sup> Kujtoji shërbyesit Tanë: Ibrahimin, Is’hakun dhe Jakubin, të gjithë njerëz të fuqishëm e vizionarë.<sup>46</sup> Ne bëmë që të jenë të përkushtuar ndaj Nesh<sup>b</sup> përmes përkujtimit të tyre të sinqertë të Shtëpisë së Fundit:<sup>47</sup> me Ne do të jenë ndër të zgjedhurit, që janë vërtet të mirë.<sup>48</sup> Dhe mbani mend shërbyesit Tanë: Ismailin, Eljesain dhe Dhu’l-Kifl-in<sup>c</sup>, secili nga ta vërtet i mirë.<sup>49</sup> Ky është mësim.

Të devotshmit do të kenë vend të mirë për t’u kthyer:<sup>38:50</sup> Kopshte me lumturi të qëndrueshme me portat hap-e-krah.<sup>51</sup> Do të ulen rehat;<sup>52</sup> do të kenë [gra] që përputhen mirë me vështrim modest.<sup>53</sup> ‘Kjo është ajo që ju është premtuar për Ditën e Llogarisë:<sup>54</sup> furnizimi Ynë për ju nuk do të mbarojë kurrë.’

<sup>55</sup> Por keqbërësit do ta kenë vendin më të keq për t’u kthyer:<sup>56</sup> Ferrin për t’u djegur në të, vend i keq për të qëndruar –<sup>57</sup> krejt kjo do të jetë e tyrja: le ta shijojnë – një lëng përvëlues, i errët, i ndyrë<sup>58</sup> dhe tortura të tjera të tilla.<sup>59</sup> [Do të thuhet:] ‘Ja edhe një turmë e njerëzve që po turren me kokë t’ju bashkohen.’ [Përgjigja do të jetë:] ‘Nuk janë të mirëpritur! Do të digjen në Zjarr.’<sup>38:60</sup> Ata do t’u thonë: ‘Nuk jeni të mirëpritur! Ishit pikërisht ju që na e sollët këtë, një vend i keq për të qëndruar’,<sup>61</sup> duke shtuar: ‘Zoti ynë, jepu ndëshkim të dyfishtë atyre që na e sollën këtë.’<sup>62</sup> Do të thonë: ‘Pse nuk i shohim ata që mendonim se ishin të këqij<sup>63</sup> dhe i morëm për budallenj? A s’i panë sytë tanë ata?’<sup>64</sup> Kështu do të jetë realisht: banorët e Zjarrit do ta fajësojnë njëri-tjetrin në këtë mënyrë.

<sup>65</sup> [Profet] thuaj: ‘Jam këtu veç për të paralajmëruar. Nuk ka zot pos **Allahut** Një, Të Gjithë-Fuqiptotit,<sup>66</sup> Zotit të qiejve dhe të tokës dhe të gjithçkaje ndërmjet, Të Gjithë-Fuqishmit, Më Falësit.’<sup>67</sup> Thuaj: ‘Ky mesazh është i fuqishëm,<sup>68</sup> e megjithatë e injoroni.<sup>69</sup> Nuk kam njohuri për atë se çka diskutojnë ata lart:<sup>d</sup> <sup>38:70</sup> veç më është shpallur se jam këtu për të dhënë paralajmërim të qartë.’

<sup>71</sup> Zoti juaj u tha engjëjve: ‘Do ta krijoj një njeri nga balta.’<sup>72</sup> Kur ta kem formësuar dhe t’i kem fryrë nga Shpirti Im përbrenda, përkuluni para tij.’

---

<sup>a</sup> Komentuesit e Kuranit shpjegojnë se, kur gruaja e tij blasfemoi, Ejubi u betua se nëse rikuperohej nga sëmundja e tij, do ta rrihte atë me njëqind goditje me kamzhik. Mirëpo, kur u rikuperua, i ra pishman për betimin e tij të nxituar, kështu që **Allahu** ia dha këtë udhëzim.

<sup>b</sup> Alternativisht: ‘Ne i bëmë ata të pastër’.

<sup>c</sup> Shih shënimin për 21:85: “Disa komentues sugjerojnë se kjo i referohet profetit Ezekiel. Shih *Encyclopaedia of Islam* te *Dhu’l-Kifl*.”

<sup>d</sup> Krahaso me 2:30

<sup>73</sup> Engjëjt të gjithë u përkulën bashkë, <sup>74</sup> por jo Iblisi që ishte tepër krenar. Ai u bë rebel. <sup>75</sup> **Allahu** tha: ‘Iblis, çka të pengon t’i përkulesh njeriut që e kam bërë me duart E Mija? A je tepër i lartë e i fuqishëm?’ <sup>76</sup> Iblisi tha: ‘Unë jam më i mirë se ai: mua më bëre nga zjarri e atë nga balta.’ <sup>77</sup> ‘Dil nga këtu! Je i refuzuar: <sup>78</sup> refuzimi Im do të të ndjekë deri në Ditën e Gjykimit!’ <sup>79</sup> por Iblisi tha: ‘Zoti im, më jep afat deri në Ditën kur të gjithë ringjallen nga të vdekurit’, <sup>38:80</sup> kështu që Ai tha: ‘E ke afatin <sup>81</sup> deri në Ditën e Caktuar.’ <sup>82</sup> Iblisi tha: ‘Beto hem për fuqinë Tënde! Do t’i tundoj të gjithë <sup>83</sup> pos shërbyesve Tu të vërtetë.’ <sup>84</sup> **Allahu** tha: ‘Kjo është e vërteta – Unë e flas veç të vërtetën – <sup>85</sup> do ta mbush Ferrin me ty dhe të gjithë ata që të ndjekin.’

<sup>86</sup> [Profet,] thuaj: ‘Nuk kërkoj shpërblim nga ju për këtë, as nuk pretendoj të jem çka s’jam: <sup>87</sup> ky është veç paralajmërim për krejt njerëzit. <sup>88</sup> Me kohë sigurisht që do ta shihni të vërtetën e tij.’

**Përshkrimi para kaptinës 38 nga Abdel Haleem:**

*Kjo sure mekase i përmend profetët e mëparshëm si përkrahje dhe inkurajim për Muhamedin dhe e bën një lidhje të qartë ndërmjet arrogancës së shfaqur nga mosbesimtarët e Mekës, brezat e mëparshëm dhe Iblisi, rebeli burimor. Vargjet e para dhe të fundit e pohojnë të vërtetën dhe fisnikërinë e Kuranit.*

## 39: Turmat e mëdha (EZ-ZUMER)

Në emrin e **Allahut**, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës

<sup>1</sup> Ky Shkrim i Shenjtë është zbritur nga **Allahu** – I Fuqishmi, I Urti. <sup>2</sup> Jemi pikërisht Ne që ta zbritëm Shkrimin e Shenjtë [Profet] me Të Vërtetën, prandaj adhuroje **Allahun** me përkushtimin tënd të plotë: <sup>3</sup> përkushtimi i vërtetë i takon veç **Allahut**. [Sa për] ata që zgjedhin mbrojtës të tjerë përveç Tij, duke thënë: ‘I adhurojmë veç se na sjellin më afër **Allahut**’, Vetë **Allahu** do të gjykojë ndërmjet tyre në lidhje me dallimet e tyre. **Allahu** nuk e udhëzon asnjë gënjeshtar mosmirënjohës. <sup>4</sup> **Allahu** do të mund ta kishte zgjedhur këdo nga krijimi I Tij që do ta donte për fëmijë të lindur, por Ai është larg mbi këtë! Ai është **Ai**, I Gjithë-Fuqishmi. <sup>5</sup> Ai i krijoi qiejt dhe tokën për qëllim të vërtetë; Ai e mbështjell natën përreth ditës dhe ditën përreth natës; Ai i ka nënshtuar diellin dhe hënën të kalojnë nëpër drejtimet e tyre për një kohë të caktuar; Ai është vërtet I Fuqishmi, Falësi.

<sup>6</sup> Ai ju krijoi të gjithëve nga një qenie e vetme, nga e cila e bëri partneren e tij; jua dha<sup>a</sup> katër lloje të bagëtive në çifte;<sup>b</sup> ju krijon në mitrat e nënave tuaja, fazë pas faze, në thellësitë e trefishta të errësirës. I tillë është **Allahu**, Zoti juaj; Ai e mban kontrollin, nuk ka zot pos Tij. Si mund të largoheni? <sup>7</sup> Në qofshi mosmirënjohës, kujtojeni se **Allahu** nuk jua ka nevojën fare, e megjithatë nuk është i kënaqur me mosmirënjohjen në shërbyesit E Tij; në qofshi mirënjohës, Ai është i kënaqur [ta shohë] atë në ju. Asnjë shpirt nuk do ta bartë barrën e tjetrit. Në fund do të ktheheni te Zoti juaj dhe do t’ju informojë për atë që e keni bërë: Ai e di mirë se çka ka në thellësitë e zemrave [tuaja].

<sup>8</sup> Kur njeriu e vuan ndonjë mundim, i lutet Zotit të tij dhe i kthehet Atij, por posa t’i jetë dhënë një favor nga **Allahu**, e harron Atë të cilit po i lutej dhe i mvesh rivalë **Allahut**, për t’i bërë të tjerët të devijojnë nga rruga E Tij. Thuaj: ‘Shijojë mosmirënjohjen tënde për ca kohë: do të jesh një nga banorët e Zjarrit.’ <sup>9</sup> E si është puna me dikë që adhuron me përkushtim gjatë natës, duke u përkulur, duke qëndruar në këmbë në lutje, gjithmonë i vetëdijsëm për jetën tjetër, duke e shpresuar mëshirën e Zotit të tij? Thuaj: ‘Si mund të jenë ata që dinë të barabartë me ata që nuk dinë?’ Veç ata që janë të kuptueshëm do të jenë të vëmendshëm.

---

<sup>a</sup> Fjalë për fjalë ‘zbriti’, dmth. në Shkrimin e Shenjtë, krahaso me 6:142-4.

<sup>b</sup> Ka pasur ca huti në lidhje me numërimin këtu, duke i bërë disa përkthyes ta përkthejnë këtë fragment ‘tetë çifte’. Në fakt, përkthimi korrekt është ose ‘tetë koka’ ose ‘katër çifte’. Krahaso me 6:143-4.

<sup>39:10</sup> Thuaj: '[**Allahu** thotë:] shërbyes besimtarë, jini të vetëdijshëm për Zotin tuaj! Ata që bëjnë mirë në këtë botë do të kenë shpërblim të mirë – toka e **Allahut** është e gjerë<sup>a</sup> – dhe atyre që qëndrojnë me durim do t'u jepet shpërblim i plotë e i pakursyer.' <sup>11</sup> Thuaj: 'Jam urdhëruar t'i shërbej **Allahut**, duke ia kushtuar adhurimin tim plotësisht Atij. <sup>12</sup> Jam urdhëruar të jem i pari që nënshtrohet.' <sup>13</sup> Thuaj: 'Ja kam frikën torturës së një Dite të tmerrshme nëse nuk i bindem Zotit tim.' <sup>14</sup> Thuaj: 'Është pikërisht **Allahu** Ai të cilit i shërbej, duke ia përkushtuar adhurimin tim plotësisht – <sup>15</sup> ju mund t'i shërbeni kujt të doni krahas Tij.' Thuaj: 'Humbësit e vërtetë janë ata që do ta humbin veten dhe popullin e tyre në Ditën e Ringjalljes: ajo është humbja më e dukshme. <sup>16</sup> Ata do të kenë shtresa të Zjarrit mbi ta dhe përfundi.' Kështu **Allahu** vë frikë në shërbyesit E Tij: shërbyesit E Mi, m'u ruani Mua.

<sup>17</sup> Ka lajm të mirë për ata që e shmangin adhurimin e zotave të rremë dhe i kthehen **Allahut**, prandaj [Profet] jepu lajm të mirë shërbyesve të Mi <sup>18</sup> që dëgjojnë se çka thuhet dhe e ndjekin atë që është më e mira. Këta janë ata që i ka udhëzuar **Allahu**; këta janë njerëzit që kuptojnë. <sup>19</sup> E ai që është gjykuar me ndëshkim? A mund t'i shpëtosh [ti Profet] ata që tashmë janë në Zjarr? <sup>39:20</sup> Por ata që janë të vetëdijshëm për Zotin e tyre do të kenë shtëpi të larta të ndërtuara për ta, njërën mbi tjetrën, të hijeshuara me lumenj rrjedhës. Ky është premtim nga **Allahu**: **Allahu** nuk e shkel premtimin E Tij.

<sup>21</sup> A nuk ke reflektuar se si **Allahu** e zbret ujin nga qielli, e udhëzon të formojë burime në tokë dhe pastaj, me të, sjell bimësi me ngjyra të ndryshme, që më vonë thahen, zverdhen para syve tuaj dhe thërrmohen në pluhur me urdhrin E Tij? Vërtet ka përkujtues në këtë për ata që janë të kuptueshëm.

<sup>22</sup> Po si është puna me atë – zemrën e të cilit **Allahu** e ka hapur në përkushtim ndaj Tij, ashtu që ec në dritë nga Zoti i tij? Mjerë për ata zemrat e të cilëve ngurtësohen në përmendjen e **Allahut**! E kanë humbur qartë rrugën e tyre. <sup>23</sup> **Allahu** e ka zbritur më të bukurin nga të gjitha mësimet: një Shkrim të Shenjtë që është konsistent dhe bën krahasime; që i bën të rrëqethen lëkurat e atyre që kanë frikë-respekt për Zotin e tyre. Pastaj lëkurat e tyre dhe zemrat e tyre zbuten me përmendjen e **Allahut**: i tillë është udhëzimi i **Allahut**. Ai e udhëzon me të këdo që do ta udhëzojë; askush nuk mund t'i udhëzojë ata që **Allahu** i lejon të devijojnë.

<sup>24</sup> Po si është puna me atë që do ta ketë veç fytyrën e tij lakuriqe për t'u mbrojtur nga vuajtja e tmerrshme në Ditën e Ringjalljes? Keqbërësve do t'u thuhet: 'Shijojeni atë që e keni fituar.' <sup>25</sup> Edhe të tjerë para tyre nuk besuan dhe ndëshkimi ra mbi ta të pavetëdijshëm: <sup>26</sup> **Allahu** ua dha ndëshkimin e turpit në

---

<sup>a</sup> Shih 29:56-60



këtë botë për ta shijuar; ndëshkimi do të jetë edhe më i vështirë në Të Përtejmen, veç po ta dinin.

<sup>27</sup> Në këtë Kuran, i kemi paraqitur të gjitha llojet e ilustrimeve për njerëzit, që të mund të jenë të vëmendshëm – <sup>28</sup> Kuran arab, i lirë nga çfarëdo shtrembërimi – që njerëzit të mund të jenë të vetëdijshëm. <sup>29</sup> **Allahu** e paraqet këtë ilustrim: a mund të konsiderohet njeriu që i ka padronë të tij disa partnerë që janë në kundërshtim me njëri-tjetrin – i barabartë me një njeri të përkushtuar plotësisht një padroni? Tërë lëndë i përket **Allahut**, megjithëse shumica nga ta nuk e dinë.

<sup>39:30</sup> Ti [Profet] sigurisht që do të vdesësh, e po kështu edhe ata, <sup>31</sup> dhe, në Ditën e Ringjalljes, do të diskutoni me njëri-tjetrin në prezencë të Zotit tuaj. <sup>32</sup> Pra kush do të mund të ishte më i gabuar se personi që e shpik një rrenë për **Allahun** dhe e refuzon të vërtetën kur i vjen? A nuk ka ndëshkim të bollshëm për mosbesimtarët në Ferr? <sup>33</sup> Pikërisht ai që e sjell të vërtetën dhe ai që e pranon atë si të vërtetë – janë ata që janë të vetëdijshëm për **Allahun**: <sup>34</sup> ata do të kenë gjithçka që ua ka ëndja me Zotin e tyre. I tillë është shpërblimi i atyre që bëjnë mirë: <sup>35</sup> **Allahu** do t'i shfajësojë madje edhe nga veprat e tyre më të këqija dhe do t'i shpërblejë si është më së miri për ta.

<sup>36</sup> A nuk është **Allahu** mjaft për shërbyesin E Tij? E megjithatë të kërcënojnë [Profet] me ata që adhurojnë të tjerë përveç Tij. Nëse **Allahu** e lejon dikë të devijojë ai nuk e ka askë ta udhëzojë; <sup>37</sup> nëse **Allahu** e udhëzon dikë askush s'mund ta devijojë. A nuk është **Allahu** i fuqishëm dhe i aftë për hakmarrje? <sup>38</sup> Nëse [ti Profet] i pyet: 'Kush i krijoi qiejt dhe tokën' janë të sigurt të përgjigjen: '**Allahu**', prandaj thuaj: 'Reflektoni për ata që i thirrni përveç tij: po të donte **Allahu** të më dëmtonte, a do të mund ta zhbënin atë dëm? Po të donte **Allahu** të më shfaqte mëshirë, a do të mund ta ndalnin atë mëshirë?' Thuaj: '**Allahu** është mjaft për mua: të gjithë ata që besojnë duhet ta kenë besimin e tyre në Të.' <sup>39</sup> Thuaj: 'Populli im, bëni çka të keni në dorë – dhe kështu do të bëj edhe unë. Do ta shihni <sup>39:40</sup> kush do të pësojë poshtërim<sup>a</sup> dhe mbi kë do të zbresë një torturë e qëndrueshme.'

<sup>41</sup> Ne ta kemi zbritur Shkrimin e Shenjtë [Profet] me Të Vërtetën për njerëzit. Kushdo që e ndjek udhëzimin e bën këtë për dobinë e tij, kushdo që largohet prej tij e bën këtë në rrezik të vetin: nuk je përgjegjës për ta. <sup>42</sup> **Allahu** i merr shpirtat e të vdekurve dhe shpirtat e të gjallëve gjersa flenë – i mban të atyre që jua ka paracaktuar vdekjen dhe i kthen të tjerët prapa deri në kohën e tyre të caktuar – vërtet ka shenja në këtë për ata që reflektojnë. <sup>43</sup> E megjithatë marrin ndërmjetës krahas **Allahut**! Thuaj: 'Edhe pse këta nuk kanë as fuqi as s'kuptojnë?' <sup>44</sup> Thuaj:

---

<sup>a</sup> Në këtë botë; tortura e vazhdueshme do të jetë në Të Përtejmen.

‘Tërë ndërmjetësimi i përket veç **Allahut**; Ai e mban kontrollin e qiejve dhe të tokës; në fund të gjithë do të ktheheni tek Ai.’

<sup>45</sup> Sa herë që **Allahu** përmendet I Vetëm, zemrat e atyre që nuk besojnë në Të Përtejmen zvogëlohen me neveri, por gëzohen kur përmenden zota të tjerë e jo Ai. <sup>46</sup> Thuaj: ‘**Allah!** Krijues i qiejve dhe i tokës! Njohës i tërë asaj që është e fshehur dhe tërë asaj që është e hapur, Ti do të gjykosh ndërmjet shërbyesve Tu në lidhje me dallimet e tyre.’ <sup>47</sup> Nëse keqbërësit do t’i posedonin pasuritë e tokës dyfish – do t’i ofronin për ta paguar çlirimin e tyre nga vuajtja e tmerrshme në Ditën e Ringjalljes: **Allahu** do t’u tregojë diçka me të cilën nuk kishin llogaritur, <sup>48</sup> e keqja e veprave të tyre do t’u bëhet e qartë dhe do të tronditen nga ajo me të cilën qeshnin dikur.

<sup>49</sup> Kur njeriu e pëson ndonjë mundim, na qahet Neve, por kur e favorizojmë me bekimin Tonë, thotë: ‘Krejt kjo më është dhënë për shkak të dijës sime’ – është veç sprovë, megjithëse shumica nga ta nuk e dinë. <sup>39:50</sup> Ata që jetuan para tyre e thanë të njëjtën. Ajo që e bënë nuk u vlente asgjë; <sup>51</sup> i vuajtën efektet e liga të saj. Edhe keqbërësit e sotëm do t’i vuajnë efektet e liga të veprave të tyre: nuk do të shpëtojnë. <sup>52</sup> A nuk e dinë se **Allahu** furnizon me bollëk për këdo që do të furnizojë dhe i jep me masë kujtdo që do t’i japë? Vërtet ka shenja në këtë për ata që besojnë.

<sup>53</sup> Thuaj: ‘[**Allahu** thotë:] shërbyesit E Mi që e keni dëmtuar veten me teprimet tuaja, mos e humbni shpresën për mëshirën e **Allahut**. **Allahu** i fal të gjitha mëkatet: Ai është vërtet Më Falësi, Më Mëshirëploti. <sup>54</sup> Kthehjuni Zotit tuaj. Nënshtrohjuni para se t’ju kapë ndëshkimi dhe të mos mund të ndihmoheni më. <sup>55</sup> Ndiqeni mësimin më të mirë që ju është zbritur nga Zoti juaj, para se t’ju marrë ndëshkimi, të pavetëdijshëm, <sup>56</sup> dhe shpirti juaj të thotë: “Mjerë për mua që e kam shpërfillur atë që i takon **Allahut** dhe që kam qenë një nga ata që talleshin!” <sup>57</sup> Apo thotë: “Po të më udhëzonte **Allahu**, do t’u isha bashkuar të ndershmeve!” <sup>58</sup> Apo, i përballur me ndëshkimin, thotë: “Veç po ta kisha edhe një shans, do t’u bashkohesha atyre që bëjnë mirë!” <sup>59</sup> Jo në fakt! Mesazhet e mija ju erdhën dhe i refuzuat: ishit arrogantë dhe e refuzuat të vërtetën.’

<sup>39:60</sup> Në Ditën e Ringjalljes, [ti Profet] do t’i shohësh ata që thanë rrena kundër **Allahut**, me fytyrat të errësuar. A nuk ka ndëshkim të bollshëm për arrogantët në Ferr? <sup>61</sup> Por **Allahu** do t’i dërgojë ata që ishin të vëmendshëm për Të në vendin e tyre të sigurisë: asnjë dëmtim nuk do t’i prekë, as s’do të pikëllohen. <sup>62</sup> **Allahu** është krijuesi i të gjitha gjërave; ka mbikëqyrje për gjithçka; <sup>63</sup> çelësat e qiejve dhe të tokës janë Të Tij. Ata që i kanë refuzuar shpalljet e **Allahut** do të jenë humbësit.

<sup>64</sup> Thuaj: ‘A po më urdhëroni ta adhuroj dikë tjetër përveç **Allahut**, o njerëz budallenj?’ <sup>65</sup> Tashmë të është shpallur ty [Profet] dhe atyre para teje: ‘Nëse i

përshkruan ndonjë partner **Allahut**, tërë puna jote do të kthehet në asgjë: do të jesh një nga humbësit. <sup>66</sup> Jo! Adhuroje veç **Allahun** dhe ji një nga ata që i janë mirënjohës Atij.’ <sup>67</sup> Këta njerëz nuk mund ta rrokin me mendje masën e vërtetë të **Allahut**. Në Ditën e Ringjalljes, tërë toka do të jetë në mbërthimin E Tij. Qiejt do të mbështillen rrotull në dorën E Tij të djathtë – Lâvdi qoftë për Të! Është larg mbi partnerët që ia përshkruajnë! <sup>68</sup> Trumpeta do të dëgjohej dhe secili në qiejt dhe në tokë do të bie përtokë pa ndjenja përveç atyre që i kursen **Allahu**. Ajo do të dëgjohej edhe një herë dhe ata do të jenë në këmbët e tyre, duke shikuar. <sup>69</sup> Toka do të shkëlqejë me dritën e Zotit të tyre; do të hapet Regjistri i Veprave gjerë-e-gjatë; do të sillen profetët dhe dëshmitarët. Do të bëhet gjykimi i drejtë ndërmjet tyre: nuk do t’u bëhet e padrejtë <sup>39:70</sup> dhe secili shpirt do të shpaguej plotësisht për atë që e ka bërë. Ai e di më së miri se çka bëjnë ata.

<sup>71</sup> Ata që e refuzuan Të Vërtetën do të çohen në Ferr në turmat e tyre të mëdha. Kur të arrijnë, do të hapen portat e tij dhe rojet e tij do t’u thonë: ‘A nuk jua kanë çuar të dërguarit tuaj që t’jua recitojnë shpalljet e Zotit tuaj dhe t’ju paralajmërojnë se do ta hasni këtë Ditë?’ dhe ata do të thonë: ‘Po në fakt, na i kanë çuar.’ Por gjykimi me ndëshkim do të jetë nxjerrë kundër atyre që e refuzuan të vërtetën. <sup>72</sup> Do të thuhet: ‘Hyni në portat e Ferrit: aty do të mbeteni. Sa i keq është vend-banimi i arrogantëve!’

<sup>73</sup> Ata që ishin të vetëdijsëm për Zotin e tyre do të çohen në turma të mëdha te Kopshti. Kur të arrijnë, do t’i gjejnë portat e tij hap-e-krah dhe rojet e tij do t’u thonë: ‘Paqja qoftë mbi ju! Keni qenë të mirë. Ejani: jeni këtu për të qëndruar, <sup>74</sup> dhe ata do të thonë: ‘Lâvdi qoftë për **Allahun** që na e ka mbajtur premtimin E Tij dhe na e ka dhënë këtë vend si tonin. Tash mund të jetojmë ku të na pëlqejë në Kopsht.’ Sa i shkëlqyeshëm është shpërblimi i atyre që punojnë! <sup>75</sup> [Ti Profet] do t’i shohësh engjëjt përreth Fronit, duke e madhëruar Zotin e tyre me lavde. Gjykimi i vërtetë do të shpallet ndërmjet tyre dhe do të thuhet: ‘Lâvdi qoftë për **Allahun**, Zotin e Botëve.’

**Përshkrimi para kaptinës 39 nga Abdel Haleem:**

*Sure mekase që e merr titullin nga vargjet e saj përmbyllëse. Fokusi kryesor i sures është kontrasti ndërmjet atyre që e ndjekin besimin e vërtetë dhe atyre që i përshkruajnë partnerë **Allahut**. Surja thekson se njerëzit janë të lirë të zgjedhin a të besojnë a të mos besojnë (vargu 41), por i nxit në mënyrën më të fuqishme të mundshme t'i kthehen rrugës së duhur gjersa ka ende kohë për t'u penduar (vargjet 53-61)*

## 40: Falësi (EL-GÂFIR)

Në emrin e **Allahut**, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës

<sup>1</sup> *Ha Mim*

<sup>2</sup> Ky Shkrim i Shenjtë është zbritur nga **Allahu**, I Gjithë-Fuqishmi, I Gjithë-Dijshmi, <sup>3</sup> Falësi i mëkateve dhe Pranuesi i pendimit, i ashpër në ndëshkim, i pafund në mirësi. Nuk ka zot pos Tij; tek Ai është kthimi vendimtar. <sup>4</sup> Veç mosbesimtarët janë ata që i kundërshtojnë shpalljet e Zotit. [Profet,] mos u mahnit nga lëvizjet e tyre andej-këndeje nëpër vend.<sup>a</sup> <sup>5</sup> Para tyre populli i Nuhut e refuzoi të vërtetën dhe po kështu bënë edhe ata që krijuan kundërshti pas tyre: secili komunitet planifikoi fshehtas për ta shkatërruar të dërguarin e tij dhe u përpoqën ta hedhin poshtë të vërtetën me falsitet; por isha Unë që i shkatërrova ata. Sa i tmerrshëm që ishte ndëshkimi Im! <sup>6</sup> Në këtë mënyrë vendimi gjykues i Zotit tënd ishte marrë kundër mosbesimtarëve që ata do të ishin banorë të Zjarrit.

<sup>7</sup> Ata [engjëj] që e mbajnë Fronin dhe ata që e rrethojnë atë e festojnë lëndin e Zotit të tyre dhe kanë besim në Të. Ata luten për falje për besimtarët: ‘Zoti ynë, Ti i përfshin të gjitha gjërat në mëshirë e dije, pra fali ata që të kthehen dhe e ndjekin rrugën Tënde. Ruaji nga dhembjet e Ferrit <sup>8</sup> dhe pranoji, Zot, në Kopshtet e qëndrueshme që jua ke premtuar, bashkë me para-ardhësit e tyre<sup>b</sup> [të ndershëm], bashkëshortët [e ndershëm] dhe fëmijët e lindur të ndershëm: veç Ti je I Gjithë-Fuqishmi, I Gjithë-Urti. <sup>9</sup> Mbroji nga të gjitha veprat e këqija: ata që i mbron në atë Ditë nga [ndëshkimi për] veprat e këqija do ta pranojnë mëshirën Tënde – ky është triumfi suprem.’ <sup>40:10</sup> Por atyre që nuk besuan do t’u thuhet: ‘Kur ju thirrën në besim dhe e refuzuat, neveria e **Allahut** me ju ishte edhe më e madhe se vetë-neveria që e ndjeni [sot].’ <sup>11</sup> Do të thonë: ‘Zoti ynë, dy herë ke bërë të jemi të pajetë<sup>c</sup> dhe dy herë na ke sjellë në jetë. Tash i njohim mëkatet tona. A ka ndonjë rrugëdalje?’ <sup>12</sup> [Do t’u thuhet:] ‘Krejt kjo – për shkak se kur u thirr veç **Allahu** ju e refuzuat këtë, e megjithatë kur u shoqëruan të tjerë me Të – besuat [në ta].’ Gjykimi i përket **Allahut** Më Të Lartit, Më Të Madhit.

<sup>13</sup> Është Ai që jua tregon [juve njerëz] shenjat E Tij dhe lëshon ujë nga qielli për t’ju mbajtur gjallë, megjithëse veç ata që i kthehen **Allahut** do të jenë të

---

<sup>a</sup> Duke bërë pasuri përmes tregtisë.

<sup>b</sup> Fjala *aba*’ i përfshin para-ardhësit meshkuj dhe femra. Babai dhe nëna quhen *abawan*.

<sup>c</sup> Fjalë për fjalë ‘të vdekur’, duke bërë që disa komentues ta interpretojnë këtë sikur po i referohet vdekjes fillestare të personit, të ndjekur menjëherë më pas nga një ‘vdekje’ e dytë pas marrjes në pyetje në varr. Mirëpo, pikëpamja më e pranuar përgjithësisht është se jeta tokësore edhe paraprihet edhe pasohet nga një gjendje e pajetësisë. Prandaj dy aktet e dhënies së jetës i referohen lindjes dhe ringjalljes.

vëmendshëm. <sup>14</sup> Pra thirreni **Allahun** dhe kushtojani fenë tuaj veç Atij, sado qoftë e urryeshme kjo për mosbesimtarët: <sup>15</sup> Ai është i lartësuar në rang, Zoti i Fronit. Ai i dërgon shpallje me mësimet E Tij cilitdo nga shërbyesit E Tij që do t'i dërgojë, që të paralajmërojë për Ditën e Takimit, <sup>16</sup> Ditën kur ata do të dalin dhe asgjë që lidhet me ta nuk do të fshehet nga **Allahu**. 'Kush e ka kontrollin sot?' **Allahu**, I Vetmi, I Gjithë-Fuqishmi. <sup>17</sup> Sot secili shpirt do të shpërblehet për çkado që ka bërë; sot nuk do të bëhet asnjë padrejtësi. **Allahu** është i shpejtë në llogaritje.'

<sup>18</sup> Paralajmëroji [Profet] për Ditën që afrohet gjithnjë e më shumë, kur zemrat janë te fytet, duke ua zënë frymën. Keqbërësi nuk do ta ketë asnjë mik, as ndonjë ndërmjetësues që do ta dëgjojë ndokush. <sup>19</sup> **Allahu** është i informuar edhe për shikimet më dinake dhe për krejt çka fshehin zemrat: <sup>40:20</sup> **Allahu** do të gjykojë me të vërtetën, gjersa ata që thirren krahas Tij nuk do të gjykojnë fare. **Allahu** është Gjithë-Dëgjuesi, Gjithë-Pamësi.

<sup>21</sup> A nuk kanë udhëtuar nëpër tokë dhe ta kenë parë se si e gjetën fundin e tyre ata që jetuan më parë? Ata ishin më të fuqishëm se ta dhe vunë shenjë më mbresëlënëse në tokë, e megjithatë **Allahu** i shkatërroi për mëkatet e tyre – nuk e kishin askë t'i mbrojtë kundër Tij – <sup>22</sup> se të dërguarit u erdhën vazhdimisht me shenja të qarta dhe prapë i refuzuan. **Allahu** i shkatërroi: Ai është vërtet plot fuqi, i ashpër në ndëshkim.

<sup>23</sup> Ne e dërguam Musain me shenjat Tona dhe me autoritet të qartë <sup>24</sup> te Faraoni, Hamani dhe Karuni (Korah-u) dhe ata thanë: 'Magjistar! Gënjeshtar!' <sup>25</sup> Kur ua solli të vërtetën nga Ne, thanë: 'Vrisni djemtë e atyre që besojnë me të; kursejuani veç gratë' – planifikimi i fshehtë i atyre që e refuzojnë të vërtetën mund të shkojë veç keq – <sup>26</sup> dhe Faraoni tha: 'Më lini ta vras Musain – le t'i thërrasë Zotit të tij! – se kam frikë se mund t'ju bëjë ta ndërroni fenë, apo të përhapë çrregullime në vend.' <sup>27</sup> Musai tha: 'Kërkoj strehë te Zoti im dhe i juaj nga çdo tiran që refuzon të besojë në Ditën e Llogarisë.'

<sup>28</sup> Një besimtar i fshehtë nga familja e Faraonit tha: 'Si mund ta vrisni një njeri veç pse thotë: "Zoti im është **Allahu**"?' Ai ju ka sjellë shenja të qarta nga Zoti juaj – nëse është gënjeshtar, e pastë veten në qafë – dhe nëse është i sinqertë, do t'ju ndodhë të paktën diçka nga ato me të cilat ka kërcënuar. **Allahu** nuk e udhëzon asnjë gënjeshtar rebel e të egër. <sup>29</sup> Populli im, sot e keni fuqinë si padronë të vendit, por kush do t'ju ndihmojë kundër fuqisë së **Allahut** po të na vijë?' Por Faraoni tha: 'Ju kam treguar se çka mendoj; po ju udhëzoj nëpër rrugën e duhur.'

<sup>40:30</sup> Besimtari tha: 'Populli im, kam frikë se fati juaj do të jetë fati i atyre të tjerëve që [i] kundërshtuan [profetët e tyre]: <sup>31</sup> fati i popujve të Nuhut, Adit, Themudit dhe të atyre që erdhën pas tyre – **Allahu** kurrë nuk do padrejtësi ndaj

krijësive Të Tij.<sup>32</sup> Populli im, kam frikë për ju në Ditën që do t'i thirrni njëri-tjetrit,<sup>33</sup> Ditën që do t'ia mbathni pa askë që do t'ju mbronte nga **Allahu!** Kushdo që **Allahu** e lë të devijojë nuk do ta ketë askë për ta udhëzuar.<sup>34</sup> Jusufi erdhi te ju më parë me shenja të qarta, por kurrë nuk reshtët së dyshuari në mesazhin që jua solli. Kur vdiq, thatë: "**Allahu** nuk do të çojë të dërguar tjetër."

Kështu **Allahu** i lë të devijojnë rebelët dyshues;<sup>35</sup> ata që i kontestojnë mesazhet e **Allahut** – pa asnjë autoritet të dhënë atyre – janë duke bërë diçka që është neveritëse për **Allahun** dhe për ata që besojnë. Kështu **Allahu** e vulos zemrën e secilit tiran arrogant.<sup>36</sup> Faraoni tha: 'Haman, ndërtoja një kullë të lartë që të mund t'i arrij litarët<sup>a</sup> që çojnë<sup>37</sup> te qiejt që ta kërkoj këtë **Allahun** e Musait. Jam i bindur se ai po rren.' Kështu ligësia e veprës së Faraonit iu bë tërheqëse dhe ai u bllokua nga rruga e duhur – planifikimi i tij i fshehtë çoi veç në shkatërrim.

<sup>38</sup> Besimtari tha: 'Populli im, më ndiqni! Do t'ju udhëzoj në rrugën e duhur.<sup>39</sup> Populli im, jeta e kësaj bote është veç kënaqësi e shkurtër; E Përtejma është ajo shtëpia e përhershme.<sup>40:40</sup> Kushdo që bën keq do të shpaguehet me të ngjashmen e saj; kushdo që bën mirë dhe beson, qoftë burrë a grua, do të hyjë në Parajsë dhe do të furnizohet pa masë.<sup>41</sup> Populli im, pse ju thërras në shpëtim kur ju më thirrni në Zjarr?<sup>42</sup> Ju më thirrni të mos besoj në **Allahun** dhe të shoqëroj me Të gjëra për të cilat nuk kam njohuri; unë ju thërras tek I Fuqishmi, Falësi.<sup>43</sup> Nuk ka dyshim se ajo që po më thirrni t'i shërbej nuk i ka hije të thirret as në këtë botë as në Të Përtejmen: kthimi ynë është veç te **Allahu** dhe do të jenë rebelët ata që do ta banojnë Zjarrin.<sup>44</sup> [Një ditë] do t'ju kujtohet se çka po ju them tani, kështu që po ia besoj **Allahut** rastin tim: **Allahu** është fare mirë i informuar për shërbyesit E Tij.'<sup>45</sup> Kështu **Allahu** e shpëtoi nga dëmi që e kishin planifikuar ata.

Njerëzit e Faraonit i përfshiu një ndëshkim i tmerrshëm;<sup>46</sup> do t'i sjellin para Zjarrit mëngjes-e-mbrëmje.<sup>b</sup> Në Ditën kur vjen Ora, do të thuhet: 'Hidhni njerëzit e Faraonit në torturën më të keqe.'<sup>47</sup> Në Zjarr do të grinden me njëri-tjetrin: të dobëtit do t'u thonë tej-arrogantëve: 'Ne ishim ndjekësit tuaj, pra a mund të na çlironi tash nga një hise e Zjarrit?'<sup>48</sup> por ata do të thonë: 'Jemi të gjithë bashkë në këtë. **Allahu** ka gjykuar ndërmjet krijësive Të Tij.'<sup>49</sup> Ata që janë në Zjarr do t'u thonë rojeve të Ferrit: 'Kërkoni nga Zoti juaj t'i pakësojë vuajtjet tona për një ditë',<sup>40:50</sup> por ata do të thonë: 'A s'ju kanë ardhur të dërguarit tuaj me dëshmi të qartë të të vërtetës?' Do të thonë: 'Po, kanë ardhur' dhe roja do të thotë: 'Atëherë mund të lypni, pra, por lypjet e mosbesimtarëve gjithmonë do të jenë kot.'

---

<sup>a</sup> Krahaso me 22:15, ku *sabab* e ka kuptimin 'litar'

<sup>b</sup> 'Mëngjes-e-mbrëmje' mund ta përçojë kuptimin 'tërë kohën'

<sup>51</sup> Ne i përkrahim të dërguarit dhe besimtarët Tanë, në jetën e tanishme dhe në Ditën kur paraqiten dëshmitarët. <sup>52</sup> Në Ditën kur keqbërësve nuk do t'u hyjnë në punë arsyetimet, fati i tyre do të jetë refuzimi dhe do t'i kenë vend-banimet më të këqija. <sup>53</sup> Ne i dhamë udhëzim Musait dhe e ia bartëm Shkrimin e Shenjtë Fëmijëve të Izraelit, <sup>54</sup> si udhëzim dhe përkujtues për njerëzit që kuptojnë. <sup>55</sup> Pra ki durim, Profet, se ajo që e ka premtuar **Allahu** sigurisht që do të vijë. Kërko falje për mëkatet e tua; lavdoje Zotin tënd mëngjes-e-mbrëmje.<sup>a</sup> <sup>56</sup> Sa për ata që, pa asnjë autoritet për këtë, i kundërshtojnë mesazhet e **Allahut**, nuk ka asgjë në zemrat e tyre pos etje për madhështi të cilën nuk do ta arrijnë kurrë. Kërko strehim në **Allahun**, se është Gjithë-Dëgjuesi, Gjithë-Pamësi.

<sup>57</sup> Krijimi i qiejve dhe i tokës është shumë më i madh se sa krijimi i njerëzimit, megjithëse shumica e njerëzve nuk e dinë atë gjë. <sup>58</sup> Të verbrit dhe ata që shohin nuk janë të barabartë, siç nuk janë të barabartë ata që besojnë dhe bëjnë punë të mira – dhe ata që bëjnë keq: sa rrallë reflektoni! <sup>59</sup> Ora Finale sigurisht që do të vijë, pa dyshim, por shumica e njerëzve nuk besojnë. <sup>40:60</sup> Zoti juaj thotë: 'Më thirrni dhe Unë do t'ju përgjigjem; ata që janë tepër krenarë të më shërbejnë do të hyjnë në Ferr të poshtëruar.'

<sup>61</sup> Është **Allahu** Ai që jua dha natën në të cilën të pushoni dhe ditën në të cilën të shihni. **Allahu** është vërtet bujar me njerëzit, por shumica e njerëzve nuk falënderojnë. <sup>62</sup> I tillë është **Allahu** – Zoti juaj, Krijuesi i krejt gjërave: nuk ka zot pos Tij. Si mund të jeni kaq në deluzion? <sup>63</sup> Ja sa në deluzion janë ata që i refuzojnë mesazhet e **Allahut**. <sup>64</sup> Është **Allahu** Ai që jua dha tokën për vendbanim dhe qiejt për kulm. Ju dha trajtë, ju formoi mirë dhe ju furnizoi me gjëra të mira. I tillë është **Allahu** – Zoti juaj, pra lândi qoftë për Të, Zotin e Botëve. <sup>65</sup> Ai është Jetuesi dhe nuk ka zot pos Tij, pra thirreni dhe kushtojani fenë tuaj plotësisht. Lândi qoftë për **Allahun**, Zotin e Botëve.

<sup>66</sup> Thuaj [Profet]: 'Meqë më kanë ardhur prova të qarta nga Zoti im, më është ndaluar t'u shërbej atyre që i thirrni krahas **Allahut**: jam urdhëruar t'i nënshtrohem Zotit të Botëve.' <sup>67</sup> Është Ai që ju krijoi nga pluhuri, pastaj nga një pikë e lëngut, pastaj nga një formë e vogël ngjitëse, pastaj ju nxori si foshnje, pastaj ju lejoi ta arrinit pjekurinë, pastaj ju la të plakeni – megjithëse disa nga ju vdisni më herët – dhe ta arrini afatin e caktuar që të mund të reflektoni. <sup>68</sup> Është Ai që jep jetë dhe vdekje dhe kur Ai urdhëron diçka, veç thotë 'Ji' dhe është.

<sup>69</sup> [Profet,] a e sheh sa në deluzion janë ata që i kundërshtojnë mesazhet e **Allahut** – <sup>40:70</sup> ata që e refuzojnë Shkrimin e Shenjtë dhe mesazhet që i kemi çuar përmes të dërguarve Tanë? Do ta zbulojnë <sup>71</sup> kur, me qafore të hekurta dhe zinxhirë rreth qafave të tyre, tërhiqen zvarrë <sup>72</sup> në ujë përvëlues dhe pastaj digjen në Zjarr, <sup>73</sup> dhe i pyesin: 'Ku janë tash ata që i thirrni <sup>74</sup> krahas **Allahut**?' Do të thonë: 'Na kanë braktisur: ata që i thirrnim më parë realisht nuk ishin asgjë fare.'

---

<sup>a</sup> Shih shënimin paraprak.



‘Kështu **Allahu** i lë mosbesimtarët të devijojnë,<sup>75</sup> krejt kjo për shkak se në tokë u shfrenuat në të pavërtetën dhe u tërbuat.<sup>76</sup> Hyni në portat e Ferrit, për të mbetur aty – vend-banim i keq për arrogantët.’

<sup>77</sup> Pra ki durim [Profet], se premtimi i **Allahut** është i sigurt: qoftë nëse ta tregojmë një pjesë të asaj që ua kemi premtuar në këtë jetë<sup>a</sup> – apo e kthejmë shpirtin tënd te Ne së pari – pikërisht te Ne do t’i kthejnë.<sup>78</sup> Kemi çuar të dërguar të tjerë para teje – disa t’i kemi përmendur e disa nuk t’i kemi përmendur – dhe asnjë i dërguar nuk ka mundur të sjellë shenjë përveç me lejen e **Allahut**. Kur të vijë [Dita] që **Allahu** e urdhëroi, do të bëhet gjykim i drejtë: aty dhe atëherë, ata që e ndoqën falsitetin do të humben.

<sup>79</sup> Është **Allahu** Ai që furnizon bagëti për ju, disa për t’i kalëruar dhe disa për ushqimin tuaj; <sup>40:80</sup> ju keni edhe përfitime të tjera në to. Mund ta arrini çfarëdo destinacioni që doni mbi to: ju bartin, siç ju bartin anijet [në det].<sup>81</sup> Ai jua tregon shenjat E Tij: cilën nga shenjat e **Allahut** e injoroni ende?

<sup>82</sup> A nuk kanë udhëtuar nëpër vend dhe ta kenë parë se si e hasën fundin e tyre ata që jetuan para tyre? Ishin më të shumtë se ta, më të fortë se ta dhe lanë shenjë më mbresëlënëse në tokë, e megjithatë ajo që e arritën nuk u hyri në punë fare.<sup>83</sup> Kur u erdhën të dërguarit me shenja të qarta, u shfrenuan në dijen që e kishin dhe kështu u gllabëruan pikërisht nga ndëshkimi që e tallnin:<sup>84</sup> kur e panë ndëshkimin Tonë, thanë: ‘Besojmë veç në **Allahun**; e refuzojmë çfarëdo partneri që ia kemi përshkruar’,<sup>85</sup> por të besuarit pas pamjes së ndëshkimit Tonë nuk u hyri në punë fare – kjo ka qenë gjithmonë mënyra e **Allahut** për trajtimin e krijesave Të Tij – aty dhe atëherë mosbesimtarët u humbën.

---

<sup>a</sup> Mosbesimtarëve.

**Përshkrimi para kaptinës 40 nga Abdel Haleem:**

*Sure mekase me dy tema të përsëritura: kundërshtimi i të vërtetës së **Allahut** (vargjet 4, 35, 69) dhe thirrja që i bëhet Atij (vargjet 14, 49, 50, 60, 65, 73). Në vargjet hapëse **Allahu** përshkruhet si Falësi dhe Pranuesi i pendimit, e megjithatë i ashpër në ndëshkim dhe ky aspekt i dyfishtë ilustron në sure. Pjesa qendrore e sures merret me rrëfimin e Faraonit dhe Musait (vargjet 23-54): shkatërrimi i njërit dhe fitorja e tjetrit deklarohen në vargjet 45 dhe 51. Profeti, ndërkaq, nxitet të jetë i qëndrueshëm dhe t'i injorojë talljet e mosbesimtarëve (vargjet 55 dhe 77).*

## 41: [Vargjet] të bëra të dallueshme (FUSSILET)

Në emrin e **Allahut**, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës

<sup>1</sup> *Ha Mim*

<sup>2</sup> Shpallje nga Zoti i Mëshirës, Dhënësi i Mëshirës; <sup>3</sup> Shkrim i Shenjtë vargjet e të cilit janë bërë të dallueshme si Kuran në arabisht për njerëz që kuptojnë, <sup>4</sup> që jep lajme të mira dhe paralajmërim. E megjithatë shumica nga ta largohen dhe pra nuk dëgjojnë. <sup>5</sup> Thonë: ‘Zemrat tona janë të mbyllura si në kuti kundër [besimit] në të cilin po na thërret ti; veshët i kemi të rëndë; ka pengesë ndërmjet nesh e teje. Pra bëj ç’të duash dhe kështu do të bëjmë edhe ne.’ <sup>6</sup> Thuaj [Profet]: ‘Jam veç vdekatar si ju, [por] më është shpallur se Zoti juaj është Një. Shkoni në rrugën e drejtë kah Ai dhe kërkojeni faljen E Tij. Mjerë idhujtarët, <sup>7</sup> që nuk e paguajnë lëmoshën e përcaktuar dhe refuzojnë të besojnë në botën tjetër! <sup>8</sup> Ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira do ta kenë një shpërblim që nuk dështon kurrë.’

<sup>9</sup> Thuaj: ‘Si mund ta shpërfillni Atë që e krijoi tokën për dy Ditë?<sup>a</sup> Si mund t’i mveshni zota të tjerë si të barabartë Të Tij? Ai është Zoti i të gjitha botëve!’ <sup>41:10</sup> Ai vendosi male të forta mbi të, e bekoi, i mati furnizimet e saj të larmishme për krejt ata që i kërkojnë ato – të gjitha për katër Ditë. <sup>11</sup> Pastaj iu kthye qiellit, që ka tym – i tha atij dhe tokës: ‘Ejani në qenie, me a pa dëshirë’ dhe ata thanë: ‘Vijmë me dëshirë’ – <sup>12</sup> dhe për dy Ditë i formoi shtatë qiej dhe ia caktoi një rend secilit. Ne e kemi bërë atë më të afërmin të ndriçuar bukur dhe të sigurt. I tillë është dizajni i Të Gjithë-Fuqishmit, Të Gjithë-Dijshmit.

<sup>13</sup> Nëse largohen, thuaj: ‘Ju kam paralajmëruar për një shpërthim si ai që i goditi Adin dhe Themudin: <sup>14</sup> kur u erdhën të dërguarit e tyre, nga të gjitha këndet,<sup>b</sup> duke thënë: “Mos i shërbeni askujt pos **Allahut**”, thanë: “Po të donte Zoti ynë, do të kishte zbritur engjëj. Nuk besojmë në mesazhin me të cilin jeni dërguar.” <sup>15</sup> Njerëzit e Adit u sollën me arrogancë nëpër vend pa asnjë të drejtë, duke thënë: “Kush do të mund të ishte më i fortë se ne?” A nuk e kuptuan se **Allahu**, që i krijoi, ishte më i fortë se ta?’ Vazhduan ta refuzojnë mesazhin Tonë, <sup>16</sup> kështu që e lamë të lirë mbi ta një erë ulëritëse për disa ditë katastrofike që t’i bëjmë ta shijojnë ndëshkimin e turpit në këtë botë; edhe më turpërues do të jetë ndëshkimi i jetës tjetër dhe ata nuk do të ndihmohen. <sup>17</sup> Sa për Themudin, u

---

<sup>a</sup> Komentuesit i përfshijnë këto dy ditë në ato katër që përmenden në vargun 10, kështu që totali është gjashtë ditë; shih 32:4. Ditët e **Allahut** nuk janë si tonat; shih 22:47.

<sup>b</sup> Fjalë për fjalë: ‘nga përpara dhe nga prapa’, domethënë duke i përdorur të gjitha kënd-vështrimet e argumentit. Të dërguarit e provuan çdo metodë për t’i bindur njerëzit e tyre për të vërtetën e mesazhit të tyre.

dhamë udhëzim por e preferuan verbërinë, kështu që u goditën nga një shpërthim i ndëshkimit poshtërues për veprimet e tyre të gabuara. <sup>18</sup> I shpëtuam ata që besonin dhe ishin të vetëdijshëm për **Allahun**.

<sup>19</sup> Në Ditën kur armiqtë e **Allahut** i grumbullojnë për Zjarrin dhe shtyhen përpara, <sup>41:20</sup> veshët, sytë dhe lëkurat e tyre, kur ta arrijnë atë, do të dëshmojnë kundër tyre për veprat e tyre të gabuara. <sup>21</sup> Ata do t'u thonë lëkurave të tyre: 'Pse dëshmuat kundër nesh?' dhe lëkurat e tyre do të përgjigjen: '**Allahu**, që gjithçkaje i dha aftësi për të folur, na ka dhënë aftësi për të folur – ishte Ai që ju krijoi herën e parë dhe tek Ai ju kanë kthyer – <sup>22</sup> e megjithatë nuk provuat të fsheheshit nga veshët, sytë dhe lëkura juaj për t'i penguar të dëshmojnë kundër jush. Menduat se **Allahu** nuk dinte për shumë nga ato që po bënit, <sup>23</sup> kështu që ishin mendimet që i zhvilluat për Zotin tuaj që çuan në shkatërrimin tuaj dhe u bëtë humbës.' <sup>24</sup> Zjarri do të jetë ende vend-banimi i tyre, edhe nëse e pranojnë durimin dhe nëse lutën që t'u lejohet të bëjnë përmirësime – nuk do t'u jepet leje për ta bërë këtë.

<sup>25</sup> Ne kemi caktuar, për mosbesimtarët, shoqërues<sup>a</sup> që ua bëjnë të shkuarën dhe të tashmen t'u duket e drejtë dhe e duhur, por vendimi i gjykimit tashmë është marrë për ta, bashkë me brezat e xhindeve dhe njerëzve para tyre: ishin humbës. <sup>26</sup> Mosbesimtarët thonë: 'Mos e dëgjoni këtë Kuran; zhyteni atë në biseda mendjelehta: mund ta fitoni epërsinë.' <sup>27</sup> Sigurisht që mosbesimtarëve do t'u japim shijim të ndëshkimit të ashpër. Do t'i shpaguajmë sipas veprave të tyre më të këqija – <sup>28</sup> ky është shpërblimi i armiqve të **Allahut** – Zjarri do të jetë vend-banimi i tyre i qëndrueshëm, pagesë për refuzimin e tyre të shpalljeve Tona. <sup>29</sup> Mosbesimtarët do të thonë: 'Zoti ynë, na i trego ata xhinde dhe njerëz që na devijuan dhe do t'i shkelim me këmbë, që të mund të jenë ndër më të ultit e të ultëve.' <sup>41:30</sup> Sa për ata që thonë: 'Zoti ynë është **Allahu**' dhe shkojnë rrugës së drejtë kah Ai, engjëjt u zbresin dhe thonë: 'Mos kini frikë as pikëllim, po kënaquni me lajmin e mirë të Parajsës, që ju është premtuar. <sup>31</sup> Jemi aleatët tuaj në këtë botë dhe në botën tjetër, ku do të keni gjithçka që keni merak dhe që kërkonit <sup>32</sup> si dhuratë mirëseardhëse nga Më Falësi, Më Mëshirëploti.'

<sup>33</sup> Kush flet më mirë se dikush që i thërret njerëzit të **Allahu**, e bën atë që është e drejtë dhe thotë: 'Jam një nga ata që i kushtohen **Allahut**' ? <sup>34</sup> E mira dhe e keqja nuk mund të jenë të barabarta. [Profet,] zmbrapse të keqen me atë që është më e mirë dhe armiku yt do të bëhet po aq i afërt sa një mik i vjetër e i çmuar, <sup>35</sup> por veç ata që janë të qëndrueshëm në durim, veç ata që janë të bekuar me ndershmëri të madhe, do të arrijnë mirësi të tillë. <sup>36</sup> Nëse ndodh të të trazojë ndonjë nxitje nga Satani, kërko strehë me **Allahun**: Ai është Gjithë-Dëgjuesi dhe I Gjithë-Dijshmi.

---

<sup>a</sup> Shih 43:36; 50:27 e tutje.

<sup>37</sup> Nata, dita, dielli, hëna, janë veç disa nga shenjat E Tij. Mos iu përkulni në adhurim diellit a hënës, po përkuljuni **Allahut** që i krijoi ato, nëse e adhuroni vërtet Atë. <sup>38</sup> Nëse mosbesimtarët janë tepër arrogantë, [mbaje mend, Profet, se] ata që janë me Zotin tënd e lavdojnë pa u lodhur natë e ditë. <sup>39</sup> Një tjetër shenjë E Tij është kjo: e shihni tokën tek rri e shkretë, por kur zbresim ujë në të, gjallërohet dhe rritet. Ai që i jep jetë asaj sigurisht që do t'ua japë jetë të vdekurve. Ai ka pushtet ndaj gjithçkaje.

<sup>41:40</sup> Ata që e shtrembërojnë kuptimin e mesazhit Tonë nuk janë të fshehur nga Ne. A është ai që e hedhin në Zjarr më i mirë, apo ai që ia del sigurt në Ditën e Ringjalljes? Bëni çka të doni, **Allahu** sigurisht që sheh gjithçka që bëni. <sup>41</sup> Ata që e refuzojnë Kuranin kur u vjen – megjithëse është Shkrim i Shenjtë i padiskutueshëm <sup>42</sup> të cilin gënjeshtër nuk mund ta prekë nga asnjë kënd, Shpallje e zbritur nga I Urti, I Denji për Krejt Lâvdet – <sup>43</sup> [duhet ta mbajnë mend se] [ty Profet] nuk të thuhet asgjë që nuk u ishte thënë të dërguarve të mëparshëm: Zoti yt është Zot i faljes, por edhe i ndëshkimit të dhembshëm. <sup>44</sup> Po ta kishim bërë Kuran në gjuhë të huaj, do të kishin thënë: ‘Veç të ishin vargjet e tij të qarta! Çka? Fjalë në gjuhë të huaj për një arab?’ Thuaj: ‘Ai është udhëzim dhe shërim për ata që kanë besim, por veshët e mosbesimtarëve janë të rëndë, ata janë të verbër ndaj tij, është sikur po thirren nga një vend i largët.’ <sup>45</sup> Ne ia dhamë Shkrimin e Shenjtë Musait por rreth tij filluan mosmarrëveshje – po të mos ishte një dekret që tashmë ishte lëshuar nga Zoti yt, tashmë do të ishin gjykuar – dhe prapë janë plot dyshim dhe mosbesues për të.

<sup>46</sup> Kushdo që bën mirë – e bën për shpirtin e tij dhe kushdo që bën keq – e bën kundër shpirtit të tij: Zoti juaj nuk është kurrë i padrejtë ndaj krijesave Të Tij. <sup>47</sup> Të diturit e Orës i përket veç Atij dhe asnjë e korrë nuk del nga mbështjellja e saj dhe asnjë femër nuk mbarset as s'lind pa dijeninë E Tij. Në Ditën që Ai i pyet ata: ‘Ku janë partnerët E Mi?’ do të përgjigjen: ‘Ta pranojmë se asnjëri nga ne s'mund t'i shohë [ata]’: <sup>48</sup> zotat që i thirrën më parë do të jenë zhdukur; do ta dinë se nuk ka shpëtim.

<sup>49</sup> Njeriu nuk lodhet kurrë nga lypja e të mirës, por nëse e prek e keqja e humb tërë shpresën dhe bëhet i dëshpëruar. <sup>41:50</sup> Kurdoherë që e lëmë ta shijojë ca nga mëshira Jonë pasi të ketë pasur mundime, është i sigurt të thotë: ‘Krejt këto janë vepra të mijat: nuk ma merr mendja se do të vijë Ora ndonjëherë, por edhe po të më kthenin te Zoti im, shpërblimi më i mirë do të më priste me Të.’ Ne do t'i informojmë me sigurinë më të madhe mosbesimtarët për atë që e kanë bërë dhe do t'ua japim shijim të torturës së ashpër. <sup>51</sup> Kurdoherë që jemi të mirësjellshëm me njeriun, largohet me mendjemadhësi, por, posa e prek e keqja, i kthehet lutjes së zgjatur. <sup>52</sup> Thuaj [Profet]: ‘A keni menduar ndonjëherë, çka nëse shpallja është vërtet nga **Allahu** dhe prapë e refuzoni? Kush do të ishte më i devijuar se sa dikush që shkëputet kaq larg [nga **Allahu**]?’ <sup>53</sup> Do t'ua tregojmë atyre shenjat

Tona në çdo rajon të tokës dhe në veten, deri kur t'u bëhet e qartë se kjo është E Vërteta. A nuk është e mjaftueshme që Zoti juaj është dëshmitar i gjithçkaje?  
<sup>54</sup> Vërtet, dyshojnë se do ta takojnë Zotin e tyre; vërtet Ai përfshin<sup>a</sup> gjithçka.

---

<sup>a</sup> Kjo është *muhit*, metaforë në arabisht për të pasurit njohuri të plotë dhe fuqi të plotë mbi gjithçka.

**Përshkrimi para kaptinës 41 nga Abdel Haleem:**

*Kjo sure mekase merret me kokëfortësinë e mosbesimtarëve, vërtetësinë e Kuranit, unitetin e Allahut dhe pashmangshmërinë e Ringjalljes. Titulli i referohet një termi që përdoret për ta përshkruar Kuranin në vargun 3 dhe përsëri në vargun 44. Surja i bën disa referenca për shqisat (vargjet 5, 20-22, 44) të cilat mosbesimtarët i ndërpresin ndaj perceptimit të Të Vërtetës në këtë botë dhe të cilat pastaj do të dëshmojnë kundër ‘pronarëve’ të tyre në Ditën e Ringjalljes dhe e përshkruan arrogancën e shfaqur nga njerëzit kur gjithçka është mirë, e kontrastuar me përulësinë dhe dëshpërimin kur godasin vështirësitë (vargjet 49-51).*

## 42: Konsultimi (ESH-SHÛRA)

Në emrin e **Allahut**, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës

<sup>1</sup> *Ha Mim* <sup>2</sup> *`Ajn Sin Kaf*

<sup>3</sup> Kështu **Allahu**, I Fuqishmi, I Urti, ta dërgon shpalljen [Profet] siç ua ka dërguar atyre para teje. <sup>4</sup> Gjithçka në qiej dhe në tokë i përket Atij: Ai është I Lartësuari, I Gjithë-Fuqishmi. <sup>5</sup> Qiejt pothuajse thyhen nga lart gjersa engjëjt i shfaqin lavdet e Zotit të tyre dhe kërkojnë falje për ata në tokë. **Allahu** është vërtet Më Falësi, Më Mëshirëploti. <sup>6</sup> Sa për ata që marrin mbrojtës të tjerë veç Tij, **Allahu** po i vëzhgon; nuk je përgjegjës për ta.

<sup>7</sup> Pra të kemi shpallur Kuran në gjuhën arabe, që të mund ta paralajmërosh kryeqytetin<sup>a</sup> dhe krejt ata që jetojnë afër. Dhe paralajmëro [posaçërisht] për Ditën e Grumbullimit, për të cilën nuk ka dyshim, kur disa do të jenë në Kopsht e disa në Zjarrin flakëruës. <sup>8</sup> Po të donte **Allahu**, do të mund t'i bënte ata një komunitet të vetëm, por Ai e pranon në mëshirën E Tij këdo që do ta pranojë; keqbërësit nuk do ta kenë askë t'i mbrojë as t'u ndihmojë. <sup>9</sup> Si mund të marrin mbrojtës të tjerë pos Tij? Veç **Allahu** është Mbrojtësi; Ai u jep jetë të vdekurve; Ai ka pushtet ndaj të gjitha gjërave. <sup>42:10</sup> Çkado për të cilën mund të keni dallime – i takon **Allahut** ta gjykojë. [Thuaj:] 'I tillë është **Allahu**, Zoti im. Në Të besoj dhe Atij i kthehem, <sup>11</sup> Krijuesit të qiejve e të tokës.' Ai bëri bashkëshortë për ju nga ata në mesin juaj – dhe për kafshët po ashtu – që të mund të shumoheni. Nuk ka asgjë si Ai: Ai është Gjithë-Dëgjuesi, Gjithë-Pamësi. <sup>12</sup> Çelësat e qiejve e të tokës janë Të Tij; Ai furnizon begatshëm apo me masë për këdo që do të furnizojë; Ai ka dije të plotë për të gjitha gjërat.

<sup>13</sup> Në çështjet e besimit, Ai e ka deklaruar për ju [njerëz] urdhëresën e njëjtë që ia dha Nuhut, të cilën Ne ta kemi shpallur [ty Muhamed] dhe të cilën ia kemi urdhëruar Ibrahimit e Musait e Isait: 'Mbajeni besimin dhe mos u ndani në fraksione brenda tij' – ajo që [ti Profet] u bën thirrje idhujtarëve të bëjnë është e vështirë për ta; **Allahu** e zgjedh kë të dojë për Vetën dhe i udhëzon kah Vetja ata që kthehen kah Ai. <sup>14</sup> Ata u përçanë, për shkak të rivalitetit, vetëm pasi u kishte ardhur njohuria, dhe, po të mos kish qenë një dekret i lëshuar tashmë nga Zoti juaj për t'ua shtyrë gjykimin deri në një kohë të caktuar, tashmë do të ishin gjykuar. Ata pas tyre, që e trashëguan Shkrimin e Shenjtë, janë në dyshim turbullues për të. <sup>15</sup> Pra [Profet] thirri njerëzit në atë besim dhe ndiqe rrugën e drejtë siç je urdhëruar. Mos shko sipas asaj që e kanë merak, po thuaj: 'Besoj në

---

<sup>a</sup> Fjalë për fjalë 'nënë e qyteteve', Mekën



çfarëdo Shkrimi të Shenjtë që e ka zbritur **Allahu**. Jam urdhëruar të sjell drejtësi mes jush. **Allahu** është Zoti ynë dhe Zoti juaj – neve veprat tona dhe juve tuajat, pra le të mos ketë grindje mes nesh e jush – **Allahu** do të na mbledhë bashkë dhe tek Ai do të kthehemi.’<sup>16</sup> Sa për ata që grinden për **Allahun** pasi ta kenë pranuar, grindja e tyre nuk ka peshë me Zotin e tyre: mbi ta do të bjerë zemërimi dhe i pret torturë agonizuese.<sup>17</sup> Është **Allahu** Ai që e ka zbritur Shkrimin e Shenjtë me Të Vërtetën dhe Balansin.<sup>a</sup> Si mund ta dini? Ora e Fundit mund të jetë fare afër:<sup>18</sup> ata që nuk besojnë në të kërkojnë ta shpejtojnë, por besimtarët kanë frikë-respekt për të. E dinë se është E Vërteta; ata që grinden për Orën janë të devijuar shumë, shumë larg.

<sup>19</sup> **Allahu** është më subtili ndaj krijesave Të Tij; Ai ofron [bujarisht] për këdo që do të ofrojë; Ai është I Plot-Fuqishmi, I Gjithë-Fuqishmi.<sup>42:20</sup> Nëse dikush ka merak për korrje në jetën tjetër, do t’ia rrisim; nëse dikush ka merak për korrje në këtë botë, do t’ia japim një hise të saj, por në Të Përtejmen nuk do të ketë hise.<sup>21</sup> Si mund të besojnë në të tjerët që urdhërojnë për ta gjëra që **Allahu** nuk i ka miratuar në praktikën e besimit të tyre? Po të mos ishte dekreti i **Allahut** në lidhje me Vendimin përfundimtar, tashmë do të ishte bërë gjykimi ndërmjet tyre. Keqbërësit do të kenë ndëshkim të rëndë –<sup>22</sup> do t’i shihni plot frikë për shkak të asaj që e kanë bërë: ndëshkimi është destinuar të bie mbi ta – por ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira do të jenë në livadhet e lulëzuara të Kopshteve. Do të kenë çka të duan nga Zoti i tyre: kjo është mirësia e madhe;<sup>23</sup> për shkak të kësaj **Allahu** u jep lajme të mira shërbyesve Të Tij që besojnë dhe bëjnë vepra të mira.

Thuaj [Profet]: ‘Nuk kërkoj shpërblim nga ju për këtë, veç afeksion të dashur për shkak të afërsisë familjare.’<sup>b</sup> Nëse dikush bën mirë, do t’ia rrisim; **Allahu** është më falësi dhe më çmuesi.<sup>24</sup> Si mund të thonë: ‘E ka shpikur një rrenë për **Allahun**’? Po të donte **Allahu**, do të mund të ta vuloste zemrën dhe të t’i fshinte rrenat nga kujtesa: **Allahu** e konfirmon Të Vërtetën me fjalët E Tij. Ai ka njohuri të plotë për atë që është në zemër –<sup>25</sup> është Ai që pranon pendesë nga shërbyesit E Tij dhe i fal veprat e këqija – Ai di gjithçka që bëni.<sup>26</sup> Ai u përgjigjet atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira dhe u jep më shumë nga mirësia E Tij; mosbesimtarët i pret torturë agonizuese.<sup>27</sup> Po t’ia dhuronte **Allahu** [të gjitha] krijesave Të Tij furnizimin E Tij të begatshëm, do të vepronin pafytyrësisht në tokë, por Ai zbret në masë të duhur çkado që do të zbresë, se është fare mirë i informuar për shërbyesit E Tij dhe është vëzhgues mbi ta:<sup>28</sup> është Ai që dërgon lehtësim përmes shiut pasi ta kenë humbur shpresën dhe e përhap mëshirën E Tij gjerë-e-gjatë. Ai është Mbrojtësi, I Denjë Për Të Gjitha Lavdet.

---

<sup>a</sup> Balansin e drejtësisë dhe të natyrës; krahaso me vargun 27.

<sup>b</sup> Ose ‘Këtë e bëj veç nga afeksioni për ju si të afërm familjarë.’

<sup>29</sup> Ndër shenjat E Tij është krijimi i qiejve dhe i tokës dhe i të gjitha krijesave të gjalla që i ka shpërndarë nëpër to: Ai e ka fuqinë t'i mbledhë të gjitha bashkë kurdo që do t'i mbledhë. <sup>42:30</sup> Çfarëdo fatkeqësie t'ju godasë [njerëz], është për shkak të asaj që e kanë bërë duart tuaja – **Allahu** fal shumë – <sup>31</sup> nuk mund t'i shpëtoni askund në tokë: nuk keni mbrojtës as ndihmues tjetër veç **Allahut**. <sup>32</sup> Ndër shenjat E Tij janë anijet, që lundrojnë si male pluskuese: <sup>33</sup> po të donte, do të mund ta bënte erën të qëndrojë në vend dhe ato do të rrinin të palëvizshme në sipërfaqen e detit – vërtet ka shenja në këtë për këdo që është i qëndrueshëm dhe falënderues – <sup>34</sup> apo do të mund të bënte që të shkatërrohen për shkak të asaj që e kanë bërë udhëtarët e tyre – **Allahu** fal shumë – <sup>35</sup> për t'ua bërë me dije atyre që grinden për mesazhet Tona se nuk ka shpëtim për ta.

<sup>36</sup> Ajo që ju është dhënë është veç kënaqësia e kësaj bote që kalon shpejt. Shumë më e mirë dhe më e qëndrueshme është ajo që **Allahu** do t'ua japë atyre që besojnë dhe mbështeten në Zotin e tyre; <sup>37</sup> që u shmangen mëkateve të mëdha dhe paturpësive vulgare; që falin kur janë të zemëruar; <sup>38</sup> që i përgjigjen Zotit të tyre; që falen rregullisht; që i kryejnë punët e tyre me konsultim të ndërsjellë; që u japin të tjerëve nga ajo që kemi furnizuar për ta <sup>39</sup> dhe që mbrohen kur shtypen. <sup>42:40</sup> Dëmi le të paguhet nga një dëm i barasvlershëm, megjithëse kushdo që fal dhe i përmirëson situatat e vështira do ta ketë shpërblimin e tyre nga Vetë **Allahu** – Atij nuk i pëlqejnë ata që bëjnë keq. <sup>41</sup> Nuk ka asnjë arsye të veprohet kundër askujt që mbrohet pasi ta kenë dëmtuar, <sup>42</sup> por ka arsye të veprohet kundër atyre që i shtypin njerëzit dhe bëjnë shkelje në vend kundër tërë drejtësisë – ata do të kenë torturë agonizuese – <sup>43</sup> megjithëse nëse një person është i durueshëm dhe fal, kjo është një nga gjërat më të mëdha.

<sup>44</sup> Kushdo që **Allahu** e lejon të devijojë nuk do ta ketë askë tjetër ta mbrojtë: [ti Profet] do t'i shohësh keqbërësit, kur të përballen me ndëshkimin, duke thirrur: 'A ka ndonjë mënyrë për t'u kthyer prapa?' <sup>45</sup> Do t'i shohësh të ekspozuar ndaj Zjarrit, të përulur në poshtërim, duke vështruar dinakërisht, gjersa ata që besuan thirrin: 'Humbësit janë ata që e kanë humbur veten dhe njerëzit e tyre në Ditën e Ringjalljes.' Vërtet keqbërësit do të mbeten në torturë të qëndrueshme; <sup>46</sup> nuk do të kenë aleatë t'u ndihmojnë kundër **Allahut**. Nuk ka rrugë [përpara] për ata që **Allahu** i lejon të devijojnë.

<sup>47</sup> Pra [njerëz] përgjigjuni Zotit tuaj para se të vijë një Ditë që nuk ka mundësi – kundër vullnetit të Zotit – të shmangët; nuk do të keni strehim në atë Ditë dhe asnjë mundësi të mohimit [të mëkateve tuaja]. Nëse ende largohen [kujto se] <sup>48</sup> nuk të kemi çuar [Profet] të jesh kujdestari i tyre: detyra jote e vetme është ta dërgosh mesazhin. Kur i japim njeriut shijim të mëshirës Sonë, kënaqet në të, por nëse i ndodh ndonjë dëm për shkak të asaj që e ka bërë me duart e tij, atëherë është mosmirënjohës. <sup>49</sup> **Allahu** e ka kontrollin e qiejve dhe të tokës; Ai krijon çkado që do të krijojë – i dhuron fëmijë të lindur femër kujtdo që do t'i dhurojë,

<sup>42:50</sup> mashkull kujt do që do t'i dhurojë, apo edhe mashkull edhe femër dhe e bën jopjellor këdo që do ta bëjë: Ai është i gjithë-dijshëm dhe i gjithë-fuqishëm.

<sup>51</sup> Asnjë vdekatari nuk i është lejuar t'i flasë **Allahu** pos përmes shpalljes apo nga pas perdes, apo duke ia çuar një të dërguar për t'ia zbuluar sipas urdhrit Të Tij atë që do ta shpallë Ai: Ai është i lartësuar dhe i urtë. <sup>52</sup> Pra Ne ta kemi shpallur [ty Profet] një shpirt me komandën Tonë: ti s'e ke ditur as Shkrimin e Shenjtë as besimin, por Ne e bëmë atë<sup>a</sup> dritë, duke udhëzuar me të këdo nga shërbyesit Tanë që do ta udhëzojmë. Ti udhëzon në rrugën e drejtë, <sup>53</sup> rrugën e **Allahut**, të cilit i përket krejt çka ka në qiej dhe në tokë: vërtet gjithçka do t'i kthehet **Allahut**.

---

<sup>a</sup> Shkrimin e Shenjtë apo Kuranin.

**Përshkrimi para kaptinës 42 nga Abdel Haleem:**

*Sure mekase që e merr emrin nga vargu 38, ku praktika e konsultimit (shura) renditet si karakteristikë e komunitetit mysliman. Surja e diskuton zakonet e njeriut për të krijuar ndarje dhe dis-harmoni në çështje të fesë dhe fuqinë gjithë-mbizotëruese të **Allahut**, urtinë dhe vendimin përfundimtar Të Tij. Theksohet uniteti i fesë (vargu 13) si dhe vazhdimësia e profetëve (vargu 3). Surja ia rikujton profetit se nuk mund t'i detyrojë njerëzit të besojnë, se ata do të gjykohen sipas veprave të tyre dhe se ai është aty veç ta japë mesazhin. Natyra e shpalljes përshkruhet në vargjet 51-53.*

## 43: Ornamentet e arta (EZ-ZUHRUF)

Në emrin e **Allahut**, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës

<sup>1</sup> *Ha Mim*

<sup>2</sup> Pasha Shkrimin e Shenjtë që i qartëson gjërat, <sup>3</sup> Ne e kemi bërë Kuran në gjuhën arabe që [ju njerëz] të mund të kuptoni. <sup>4</sup> Ai është vërtet i lartësuar në Burimin e Shkrimit të Shenjtë<sup>a</sup> që ruhet me Ne dhe plot urti.

<sup>5</sup> A duhet t'ju injorojmë dhe t'ju largojmë këtë shpallje se jeni njerëz të pafytyrë? <sup>6</sup> Ne u kemi dërguar shumë profetë njerëzve të mëhershëm <sup>7</sup> dhe e tallën secilin nga ta, <sup>8</sup> kështu që kemi shkatërruar njerëz më të fuqishëm se [mosbesimtarët e Mekës] dhe shembulli i tyre ka hyrë në histori. <sup>9</sup> Nëse [ti Profet] i pyet: 'Kush i krijoi qiejt dhe tokën?' janë të sigurt të thonë: 'U krijuan nga I Gjithë-Fuqishmi, I Gjithë-Dijshmi.' <sup>43:10</sup> Është Ai që e sheshoi tokën për ju dhe përshtegtoi rrugë në të që ta gjeni udhën tuaj, <sup>11</sup> që zbret ujë nga qielli në masë të duhur – Ne e ringjallim tokën e vdekur me të dhe ngjashëm do të ringjalleni nga varri – <sup>12</sup> që e krijoi çdo lloj gjëje, që ju dha anije dhe kafshë për t'i kalëruar <sup>13</sup> që të mund ta kujtoni mirësinë e Zotit tuaj kur jeni ulur në to dhe të thoni: 'Lâvdi qoftë për Të që na ka dhënë kontroll ndaj kësaj; vetë nuk do të mund ta bënim. <sup>14</sup> Vërtet po kthehemi te Zoti ynë.'

<sup>15</sup> E megjithatë Atij ia caktojnë disa nga shërbyesit E Tij si fëmijë pasardhës!<sup>b</sup> Njeriu është qartë mosmirënjohës! <sup>16</sup> A i ka marrë Ai vajzat për Vete dhe juve ju favorizoi me djem? <sup>17</sup> Kur njërit nga ta i jepet lajmi i lindjes së një vajze, të tillë që ai kaq lehtë ia atribuon Zotit të Mëshirës, fytyra i terrohet dhe mbushet me mërzi – <sup>18</sup> 'Dikush që është rritur mes xhinglave, që nuk mund ta formulojë një argument të qartë?' <sup>c</sup> <sup>19</sup> I konsiderojnë engjëjt – shërbyesit e **Allahut** – se janë femra. A kanë qenë dëshmitarë të krijimit të tyre? Pretendimi i tyre do të regjistrohet dhe do të merren në pyetje për të.

<sup>43:20</sup> Thonë: 'Po të kishte dashur Zoti i Mëshirës, nuk do t'i kishim adhuruar ata', por nuk e dinë – veç po hamendësojnë – <sup>21</sup> apo a ua kemi dhënë mbase një libër para këtij, të cilit i përmbahen fort? <sup>22</sup> Jo në fakt! Thonë: 'I pamë etërit tanë duke e ndjekur këtë traditë; udhëzohemi nga gjurmët e tyre.' <sup>23</sup> Sa herë që e çuam një të dërguar para teje për ta paralajmëruar një vendbanim, ata që ishin të korruptuar me pasuri thoshin, njësoj: 'I pamë etërit tanë duke e ndjekur këtë

---

<sup>a</sup> Fjalë për fjalë 'nënë e Shkrimit të Shenjtë', që identifikohet me 'Pllakën e Ruajtur'. Krahaso me 13:39; 85:22.

<sup>b</sup> Paganët mekas i konsideronin engjëjt si bija të **Allahut**, e megjithatë ishin mospërfillës për bijat e tyre.

<sup>c</sup> Ky ishte opinioni para-Islamik. Një poet mburrej se ishte frymëzuar nga një *shejtan* mashkull, e jo femër.

traditë; veç po i ndjekim gjurmët e tyre.’<sup>24</sup> I dërguari thoshte: ‘Edhe pse jua sjell një fe më të vërtetë se ajo që e keni parë ta ndjekin etërit tuaj?’ dhe ata përgjigjeshin: ‘Por ne nuk e besojmë mesazhin që e sjell ti.’<sup>25</sup> Ne i ndëshkuam: mendoni për atë se si e hasën fundin e tyre ata që e refuzuan Të Vërtetën.<sup>26</sup> Ibrahim i tha babait të tij dhe popullit të tij: ‘Unë heq dorë nga ajo që e adhuroni ju.’<sup>27</sup> E adhuroj veç Atë që më krijoi dhe është Ai që do të më udhëzojë’,<sup>28</sup> dhe ua la trashëgim këto fjalë pasardhësve të tij që të mund të kthehen [te **Allahu**].

<sup>29</sup> Unë i kam lënë këta njerëz dhe etërit e tyre të gëzojnë jetë të gjata dhe tash ua kam dhënë Të Vërtetën dhe një të dërguar për t’i bërë gjërat të qarta –<sup>43:30</sup> e megjithatë kur u erdhi E Vërteta, thanë: ‘Kjo është magji. Nuk besojmë në të’,<sup>31</sup> dhe thanë: ‘Pse ky Kuran nuk i është zbritur një njeriu të shquar, të njërit nga dy qytetet?’<sup>a</sup> <sup>32</sup> A janë ata që kanë hise në mirësinë e Zotit tënd? Ne jemi ata që ua japim hisen e tyre të jetesës në këtë botë dhe i kemi ngritur disa nga ta mbi të tjerë në rang, ashtu që disa mund t’i marrin të tjerët në shërbim: mirësia e Zotit tënd është më e mirë se gjithçka që grumbullojnë.<sup>33</sup> Po të mos ishte e mundur që tërë njerëzimi të mund të bëhej komb i vetëm [i mosbesimtarëve], do të mund t’u kishim dhënë – të gjithë atyre që nuk besojnë në Zotin e Mëshirës – shtëpi me çati të argjendta, shkallë të vrullshme për t’u ngjitur,<sup>34</sup> porta masive, divane për t’u ulur<sup>35</sup> dhe ornamente të arta. Të gjitha këto janë kënaqësi të thjeshta të kësaj jete; Zoti juaj e rezervon jetën tjetër për ata që janë të vëmendshëm për Të.<sup>36</sup> Ne ia caktojmë një të lig si shok cilitdo që largohet nga shpalljet e Zotit të Mëshirës:<sup>37</sup> të ligët i pengojnë njerëzit nga rruga e duhur, edhe pse mund të mendojnë se janë të udhëzuar mirë.<sup>38</sup> Kur një person i tillë vjen te Ne, do t’i thotë [shokut të tij]: ‘Veç po të kishe qenë kaq larg nga unë sa është lindja nga perëndimi. Çfarë shoku i lig!’<sup>39</sup> [Do t’u thuhet:] ‘Keni bërë keq. Posedimi i partnerëve në ndëshkim nuk do t’ju ngushëllojë sot.’

<sup>43:40</sup> A mundesh [Profet] ta bësh të shurdhrin të dëgjojë? Apo ta udhëzosh qoftë të verbrin qoftë ata që janë në gabim të rëndë?<sup>41</sup> Ose do të të largojmë dhe t’i ndëshkojmë ata – vërtet do t’i ndëshkojmë –<sup>42</sup> ose do të të lejojmë ta dëshmosh ndëshkimin me të cilin i kërcënuam; Ne kemi fuqi të plotë ndaj tyre.<sup>43</sup> Përmbahju fort asaj që të është shpallur – je vërtet në rrugën e duhur –<sup>44</sup> se ajo është kujtues<sup>b</sup> për ty dhe popullin tënd: të gjithë do të merreni në pyetje.<sup>45</sup> Pyeti profetët që i çuam para teje: ‘A kemi caktuar ndonjëherë zota të tjerë për t’u adhuruar përveç Zotit të Mëshirës?’

<sup>46</sup> Ne e çuam Musain te Faraoni dhe oborrtarët e tij dhe ai tha: ‘Jam vërtet i dërguar nga Zoti i Botëve’,<sup>47</sup> por kur ua paraqiti shenjat Tona, qeshën,<sup>48</sup> edhe pse

<sup>a</sup> Meka apo Ta’if, dy qytetet kryesore të rajonit.

<sup>b</sup> *Dhikr* mund ta ketë kuptimin ‘famë’ apo ‘kujtues’.

secila shenjë që ua treguam ishte më e madhe se e mëparshmeja. Ne shkaktuam torturë mbi ta që të mund të ktheheshin në rrugën e drejtë. <sup>49</sup> Thoshin: ‘Magjistar, thirre Zotin tënd për ne, sipas premtimit që ta ka dhënë: sigurisht që do ta pranojmë udhëzimin’, <sup>43:50</sup> por sapo e lehtësonim torturën ndaj tyre, e shkelnin fjalën. <sup>51</sup> Faraoni i shpallte popullit të tij: ‘Populli im, a s’është Mbretëria e Egjiptit e imja? Dhe këta lumenj që rrjedhin te këmbët e mija, a s’janë të mitë? A s’po e shihni?’ <sup>52</sup> A s’jam më i mirë se ky mjeran i përbuzshëm që mezi po shprehet? <sup>53</sup> Pse s’i është dhënë asnjë byzylyk ari? Pse s’ka ardhur asnjë engjëll që ta shoqërojë?’ <sup>54</sup> Kështu e shtyu popullin e tij të pranojnë dhe ata iu bindën – ishin njerëz të mbrapshtë. <sup>55</sup> Kur na provokuan, i ndëshkuam dhe i përmbytëm të gjithë: <sup>56</sup> i bëmë mësim dhe shembull për popujt e mëvonshëm.

<sup>57</sup> Kur përmendet si shembull i biri i Merjemes, populli yt [Profet] qeshin dhe tallen, <sup>58</sup> duke thënë: ‘A janë zotat<sup>a</sup> tanë më të mirë apo ai?’ – e përmendin veç për të të nxitur: janë popull grindavec – <sup>59</sup> por ai është veç shërbyes që e favorizuem dhe e bëmë shembull për Fëmijët e Izraelit: <sup>43:60</sup> po të kish qenë vullneti Ynë, do të mund t’ju bënim engjëj<sup>b</sup>, që e pasoni njëri-tjetrin në tokë.

<sup>61</sup> Ky [Kuran] jep njohuri për Orën: <sup>c</sup> mos dyshoni në të. Më ndiqni Mua se kjo është rruga e duhur; <sup>62</sup> mos e lejoni Satanin t’ju pengojë, se është armiku juaj i betuar. <sup>63</sup> Kur Isai erdhi me shenja të qarta tha: ‘Ju kam sjellë urti; kam ardhur t’jua qartësoj disa nga dallimet tuaja. Jini të vetëdijshtëm për **Allahun** dhe bindmuni: <sup>64</sup> **Allahu** është Zoti im dhe Zoti juaj. Shërbeni Atij: kjo është rruga e drejtë.’ <sup>65</sup> E prapë fraksionet e ndryshme ndër ta nuk u pajtuan – mjerë keqbërësit: do ta vuajnë torturën e një dite të rëndë! – <sup>66</sup> çka po presin pos Orës, që do t’u vijë befasi dhe do t’i marrë të pavetëdijshtëm? <sup>67</sup> Në atë Ditë, miqtë do të bëhen armiqtë e njëri-tjetrit. Por jo të ndershmit – <sup>68</sup> ‘Shërbyesit e Mi, nuk ka frikë për ju sot, as s’do të pikëlloheni’ – <sup>69</sup> ata që besuan në shpalljet Tona dhe na u përkushtuan. <sup>43:70</sup> ‘Hyni në Parajsë, ju dhe bashkëshortët tuaj: do të mbusheni plot gëzim.’ <sup>71</sup> Pjatat dhe gotat e arta do të kalohen rreth tyre me gjithçka që ua ka merak shpirti dhe sytë u kënaqen. ‘Aty do të mbeteni: <sup>72</sup> ky është Kopshti që ju jepet si i juaji, për shkak të asaj që e keni bërë dikur, <sup>73</sup> dhe ka fruta të bollshme në të për të ngrënë.’ <sup>74</sup> Por keqbërësit do të mbeten në ndëshkimin e Ferrit, <sup>75</sup> nga i cili nuk ka lehtësim: aty do të mbeten në dëshpërim të plotë. <sup>76</sup> Ne s’ua kemi bërë kurrë të padrejtë; ata ishin që bënë padrejtësi. <sup>77</sup> Do të thërrasin: ‘Malik,<sup>d</sup> ah sikur të na asgjësonte Zoti yt’, por ai do të përgjigjet: ‘Jo! Jeni këtu për të ndenjur.’ <sup>78</sup> Ne jua kemi sjellë Të Vërtetën por shumica nga ju e përbuzni.

---

<sup>a</sup> Engjëjt femra, të cilat ata i adhuruan si bija të Zotit dhe si më të larta se Isai, të cilin e konsideronin si zot të adhuruar nga të krishterët si I Biri i Zotit.

<sup>b</sup> Ashtu siç mundi Zoti ta krijonte Isain pa baba.

<sup>c</sup> Alternativisht, përemri *hu* mund të merret edhe se i referohet Isait: ‘[Isai] jep njohuri për Orën’.

<sup>d</sup> Engjëlli përgjegjës i Ferrit.

<sup>79</sup> A e kanë menduar këta mosbesimtarë ndonjë plan të fshehtë? Edhe Ne po planifikonim fshehtas. <sup>43:80</sup> A mendojnë se nuk mund t'i dëgjojmë bisedat e tyre të fshehta dhe konsultimet e tyre private? Po, mundemi: të dërguarit Tanë janë anash tyre, duke regjistruar gjithçka.

<sup>81</sup> Thuaj [Profet]: 'Po të kishte Zoti i Mëshirës [vërtet] fëmijë të lindur do të isha i pari në adhurim [të tyre],<sup>a</sup> por – <sup>82</sup> qoftë i lartësuar Zoti i qiejve dhe i tokës, Zoti i Fronit – Ai është larg mbi përshkrimet e tyre të rreme.' <sup>83</sup> Lëri të enden më thellë dhe të luajnë përreth, deri kur të përballen me Ditën që u ishte premtuar. <sup>84</sup> Është Ai që është Zoti në qiell dhe Zoti në tokë; Ai është I Gjith'-Urti, I Gjithë-Dijshmi; <sup>85</sup> I Lartësuar është Ai që e ka kontrollin e qiejve dhe të tokës dhe të gjithçkaje ndërmjet tyre; Ai ka njohuri për Orën; të gjithëve do t'ju kthejnë tek Ai. <sup>86</sup> Ata zota që i thirrin krahas Tij nuk kanë fuqi të ndërmjetësimit, për dallim nga ata<sup>b</sup> që dëshmuar për të vërtetën dhe e njohën atë. <sup>87</sup> Nëse [ti Profet] i pyet se kush i krijoi ata, janë të sigurt të thonë: '**Allahu**', pra pse janë kaq në deluzion? <sup>88</sup> Profeti ka thënë: 'Zoti im, vërtet këta janë njerëz që nuk besojnë', <sup>89</sup> por hiqu tyre dhe thuaj: 'Paqe' – do ta marrin vesh.

---

<sup>a</sup> Një interpretim tjetër është 'Po të kishte Zoti i mëshirës djalë unë do të isha i pari që do ta adhuroja' (Razi).

<sup>b</sup> Ata që e kanë lejen e **Allahut**. Krahaso me 20:109.



**Përshkrimi para kaptinës 43 nga Abdel Haleem:**

*Sure mekase e emëruar sipas ornamenteve të arit të përmendura në vargun 35 dhe të aluduara përsëri në vargun 53: në të dy rastet **Allahu** po e hedh poshtë pretendimin e mosbesimtarëve se një profet i vërtetë do të ishte i pasur. Fakti se engjëjt nuk janë bijat e **Allahut** por shërbyesit E Tij të bindur theksohet përsëri e përsëri (krahaso vargjet 15-20, 60). Ngjashëm, ideja se Isai do të mund të ishte biri i **Allahut** mohohet qartë (vargjet 57-59).*

## 44: Tymi (ED-DUHÂN)

Në emrin e **Allahut**, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës

<sup>1</sup> *Ha Mim*

<sup>2</sup> Pasha Shkrimin e Shenjtë që i qartëson gjërat, <sup>3</sup> vërtet e zbritëm në një natë të bekuar – Ne gjithmonë kemi çuar paralajmërimet – <sup>4</sup> natë kur çdo çështje e urtisë u bë e dalluar <sup>5</sup> me urdhrin Tonë – gjithmonë i kemi çuar mesazhe njeriut – <sup>6</sup> si mëshirë [Profet] nga Zoti yt që i sheh dhe i di të gjitha, <sup>7</sup> Zoti i qiejve dhe i tokës dhe i gjithçkaje ndërmjet – ah po të ishin njerëzit besimtarë të fortë – <sup>8</sup> nuk ka zot pos Tij: Ai jep jetë dhe vdekje – Ai është Zoti juaj dhe Zoti i para-ardhësve tuaj – <sup>9</sup> e megjithatë në [gjendjen e tyre në] dyshim s’ marrin asgjë seriozisht.<sup>a</sup>

<sup>44:10</sup> [Profet,] ruaju Ditës<sup>b</sup> kur qielli i nxjerr retë me tym të dukshëm për të gjithë. <sup>11</sup> Ai [tymi] do t’i mbështjellë njerëzit. Do të thërrasin: ‘Kjo është torturë e tmerrshme! <sup>12</sup> Zot na çliro nga kjo torturë! Besojmë!’ <sup>13</sup> Si do t’u hyjë në punë ky besim [i papritur]? Kur një profet u erdhi t’i paralajmërojë qartë, <sup>14</sup> ia kthyen shpinën, duke thënë: ‘Është i mësuar! Është i pushtuar shpirtërisht!’ <sup>15</sup> Ne do ta ndalim torturën për ca kohë<sup>c</sup> – sigurisht që do të ktheheni [te Ne] – <sup>16</sup> dhe në Ditën që [i] mbërthejmë fuqishëm do ta çojmë ndëshkimin deri në fund.

<sup>17</sup> Para tyre e sprovuam popullin e Faraonit: te ta u çua një i dërguar fisnik, <sup>18</sup> duke thënë: ‘M’i dorëzoni shërbyesit e **Allahut**! Jam i dërguar besnik që është çuar te ju. <sup>19</sup> Mos e konsideroni veten se jeni mbi **Allahun**! Po vij te ju me autoritet të qartë. <sup>44:20</sup> Kërkoj strehë te Zoti im dhe i juaj ndaj fyerjeve tuaja! <sup>d</sup> <sup>21</sup> Nëse nuk më besoni, veç më lini rehat.’

<sup>22</sup> [Musai] i thirri Zotit të tij: ‘Këta njerëz janë keqbërës!’ <sup>23</sup> [**Allahu** u përgjigj:] ‘Arratisu natën me shërbyesit E Mi, se sigurisht që do të t’përndjekin. <sup>24</sup> Lëreni detin prapa të ndarë mëdysh dhe ushtria e tyre do të përmbytet.’ <sup>25</sup> Sa e sa kopshte e burime lanë prapa, <sup>26</sup> sa fusha misri e ndërtesa fisnike, <sup>27</sup> sa shumë gjëra me të cilat ishin të kënaqur: <sup>28</sup> Këto ua dhamë një popull tjetër që t’i trashëgojë. <sup>29</sup> As qiejt as toka s’derdhën lot për ta, as nuk iu dha fare kohë. <sup>44:30</sup> Ne i shpëtuam Fëmijët e Izraelit nga vuajtjet e tyre nënçmuese <sup>31</sup> në duart e Faraonit:

---

<sup>a</sup> Fjalë për fjalë: ‘në dyshim luajnë’.

<sup>b</sup> Disa e interpretojnë këtë se po i referohet një ngjarjeje aktuale që ndodhi gjatë jetës së Profetit – një thatësi dhe uri në Mekë gjatë të cilës uria i bënte sytë të mjegullohen kur të sëmuret e shikonin qiellin – por duket se më shumë ka gjasa t’i referohet Ditës së Gjykimit.

<sup>c</sup> Nëse ky pasazh merret se i referohet Ditës së Gjykimit, këtu tortura çlirohet në vend se të ndalet dhe njerëzit i kthehen mosbesimit në vend se **Allahut**.

<sup>d</sup> Një nga kuptimet e *rajama* është ‘abuzimi’ apo ‘sulumimi i karakterit të dikujt me fjalë të këqija’; një tjetër është ‘të gurëzosh’; një tjetër është ‘të dëbosh’.

ishte tiran që i tejkaloi të gjithë kufijtë. <sup>32</sup> Ne i zgjodhëm ata me qëllim mbi të tjerët: <sup>33</sup> u dhamë shpallje në të cilat kishte sprovë të qartë.

<sup>34</sup> Këta njerëz këtu<sup>a</sup> pohojnë: <sup>35</sup> ‘Nuk ka asgjë përtej një vdekjeje tonës: nuk do të ringjallemi. <sup>36</sup> Ktheni para-ardhësit tanë, në qoftë e vërtetë kjo që po e thoni.’ <sup>37</sup> A janë më të mirë se populli i Tubës<sup>b</sup> dhe ata që lulëzuan para tyre? Ne i shkatërruam të gjithë – ishin fajtorë. <sup>38</sup> Nuk po luanim lojë pa kuptim kur i krijuam qiejt dhe tokën dhe gjithçka ndërmjet; <sup>39</sup> i krijuam për një qëllim të vërtetë, por shumica e njerëzve nuk kuptojnë.

<sup>44:40</sup> Dita e Vendimit është koha e caktuar për të gjithë; <sup>41</sup> Ditë kur asnjë mik nuk mund ta zërë vendin e tjetrit. <sup>42</sup> Askush nuk do ta marrë asnjë ndihmë përveç atyre që **Allahu** u shfaq mëshirë: Ai është I Fuqishmi, Zoti Mëshirëplotë. <sup>43</sup> Pema e Zekumit <sup>44</sup> do të jetë ushqim për mëkatarët: <sup>45</sup> [e nxehtë] si metal i shkrirë, vlon në barkun e tyre <sup>46</sup> si ujë që lëviz shpejt. <sup>47</sup> ‘Merreni! Futeni në thellësitë e Ferrit! <sup>48</sup> Derdhini ujë përvëlues mbi kokë si ndëshkim!’ <sup>49</sup> ‘Shijojë këtë, njeri i fuqishëm, i respektuar! <sup>44:50</sup> Kjo është ajo për të cilën keni dyshuar.’ <sup>51</sup> Por ata që janë të vetëdijshëm për **Allahun** do të jenë në vend të sigurt <sup>52</sup> mes kopshtesh e burimesh të ujit, <sup>53</sup> të veshur me mëndafsh dhe pëlhurë të endur mirë, përballë njëri-tjetrit: <sup>54</sup> kështu do të jetë. Do t’i martojmë me beqare me sy të mëdhenj, të errët. <sup>55</sup> Të sigurt e të kënaqur, do të kërkojnë çdo lloj fruti. <sup>56</sup> Pas një vdekjeje nuk do ta shijojnë vdekjen më. **Allahu** do t’i ruajë nga tortura e Ferrit, <sup>57</sup> mirësi nga Zoti juaj. Ky është triumfi suprem.

<sup>58</sup> Ne e kemi bërë këtë Kuran të lehtë për t’u kuptuar – në gjuhën tënde [Profet] – që ata të mund të jenë të vëmendshëm. <sup>59</sup> Pra prit; edhe mosbesimtarët po presin.

---

<sup>a</sup> Mekasit.

<sup>b</sup> Titull nderi i Mbretit të Jemenit i dhënë një sërë mbretërve të fuqishëm që sunduan mbi Arabinë Jugore në kohërat antike.

**Përshkrimi para kaptinës 44 nga Abdel Haleem:**

*Sure mekase që e merr titullin nga vargu 10, që e përshkruan një ditë të mbushur me tym, që nga shumë njerëz mirret se i referohet Ditës së Gjykimit. Surja e thekson mëshirën që është Kurani, i adresohet kokëfortësisë së pa-arsyeshme të shtypësve të fuqishëm e të pasur dhe bën krahasime ndërmjet popujve të Faraonit, Tubës dhe mekasve. Njerëzit e Parajsës do të gëzojnë lumturi parajsore gjersa ata që ishin të fuqishëm në këtë botë do t'i vuajnë torturat e Ferrit.*

## 45: Gjunjzimi (EL-XHÂTHIJE)

Në emrin e **Allahut**, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës

<sup>1</sup> *Ha Mim*

<sup>2</sup> Ky Shkrim i Shenjtë është zbritur nga **Allahu**, I Fuqishmi, I Urti. <sup>3</sup> Ka shenja në qiej dhe në tokë për ata që besojnë: <sup>4</sup> në krijimin tuaj, në krijesat që **Allahu** i shpërndau në tokë, ka shenja për njerëzit me besim të sigurt; <sup>5</sup> në ndërrimin e natës e të ditës, në shiun që e furnizon **Allahu**, duke e zbritur nga qielli dhe duke e rigjallëruar tokën e vdekur me të dhe në zhvendosjen E Tij të erërave ka shenja për ata që e përdorin arsyen. <sup>6</sup> Këto janë shenjat e **Allahut** që t'i rrëfejmë [ty Profet, për ta shfaqur] Të Vërtetën.

Nëse e mohojnë **Allahun** dhe shpalljet E Tij, në çfarë mesazhi do të besojnë? <sup>7</sup> Mjerë çdo person mëkatar gënjeshtar <sup>8</sup> që i dëgjon shpalljet e **Allahut** duke iu recituar, e megjithatë këmbëngul në arrogancën e tij sikur të mos i kish dëgjuar kurrë – [Profet] jepja lajmin e një torture të dhembshme! – <sup>9</sup> i cili, nëse di diçka për shpalljet Tona, e përqesh atë! Njerëzit e tillë do të kenë torturë poshtëruese: <sup>45:10</sup> Ferri rri në pritë prapa tyre dhe fitimet e tyre nuk do t'u hyjnë në punë, as ato qenie që i morën si mbrojtës krahas **Allahut** – ata i pret një torturë e jashtëzakonshme. <sup>11</sup> Ky është udhëzim i vërtetë; ata që i refuzojnë shpalljet e Zotit do të kenë torturë të mjerë.

<sup>12</sup> Është **Allahu** Ai që e nënshtroi detin për ju – anijet lundrojnë mbi të sipas urdhrit Të Tij që të mund ta kërkon mirësinë E Tij dhe ta falënderoni – <sup>13</sup> Ai ka nënshtuar gjithçka në qiej dhe në tokë për dobinë tuaj, si dhuratë nga Ai. Vërtet ka shenja në këtë për ata që reflektojnë.

<sup>14</sup> Thuaju besimtarëve t'i falin ata që nuk ua kanë frikën ditëve të **Allahut** [të ndëshkimit] <sup>a</sup> – Ai do t'i shpaguajë njerëzit për atë që e kanë bërë. <sup>15</sup> Kushdo që bën mirë – i bën mirë vetes, dhe kushdo që bën keq – e dëmton veten: të gjithëve do t'ju kthejnë te Zoti juaj.

<sup>16</sup> Ne u dhamë Fëmijëve të Izraelit shkrim të shenjtë, urti dhe profetësi; i furnizuam me gjëra të mira dhe i favorizuam mbi të tjerët; <sup>17</sup> u dhamë provë të qartë në çështjet [e fesë]. Ata dallonin ndërmjet vete për shkak të rivalitetit të ndërsjellë, veç pasi u erdhi dija: në Ditën e Ringjalljes Zoti juaj do të gjykojë ndërmjet tyre në lidhje me dallimet e tyre. <sup>18</sup> Tash Ne të kemi vendosur [ty Muhamed] në rrugë të qartë fetare, pra ndiqe. Mos i ndiq merakët e atyre që u

---

<sup>a</sup> 'Ditët e **Allahut**' (shumës) këtu i sugjerojnë ditët në të cilat **Allahu** e jep ndëshkimin E Tij në këtë botë, e jo Ditën e Gjykimit (njëjës).

mungon dija [e vërtetë] – <sup>19</sup> nuk mund të të ndihmojnë kundër **Allahut** kurrsesi. Keqbërësit e kanë veç njëri-tjetrin për t'i mbrojtur; të ndershmit e kanë Vetë **Allahun** si mbrojtës të vetin. <sup>45:20</sup> Kjo [shpallje] është mjet i njohurisë intuitive për njerëzit, burim i udhëzimit dhe mëshirë për ata me besim të sigurt.

<sup>21</sup> A vërtet keqbërësit mendojnë se do të merremi me ta në mënyrën e njëjtë si me ata që besojnë dhe bëjnë vepra të ndershme, se do të jenë të ngjashëm në jetesën dhe vdekjen e tyre? Sa keq që gjykojnë! <sup>22</sup> **Allahu** i krijoi qiejt dhe tokën për qëllim të vërtetë: ta shpërblejë secilin shpirt sipas veprave të tij. Nuk do t'u bëhet e padrejtë. <sup>23</sup> [Profet,] mendo me kujdes për atë që e ka marrë për zot merakun e tij, të cilin **Allahu** e lejon të devijojë përballë dijes, duke ia vulosur veshët dhe zemrën dhe duke ia mbuluar sytë – kush mund ta udhëzojë një person të tillë pas **Allahut** [që e ka bërë këtë]? A nuk do të jeni të vëmendshëm [ju njerëz]?

<sup>24</sup> Thonë: 'Është veç jeta jonë në këtë botë: vdesim, jetojmë, asgjë s'na shkatërron pos kohës.' Nuk kanë dije për këtë; veç e ndjekin hamendjen. Argumenti i tyre i vetëm, <sup>25</sup> kur u recitohen shpalljet Tona të qarta, është të thonë: 'Ktheni para-ardhësit tanë nëse ajo që e thoni është e vërtetë.' <sup>26</sup> [Profet,] thuaj: 'Është **Allahu** Ai që ju jep jetë, pastaj ju bën të vdisni dhe pastaj ju mbledh të gjithëve për Ditën e Ringjalljes për të cilën nuk ka asnjë dyshim, megjithëse shumica e njerëzve nuk kuptojnë.'

<sup>27</sup> Kontrolli i gjithçkaje në qiej dhe në tokë i përket **Allahut**. Kur të vijë Ora, ata që e ndjekin falsitetin do të jenë humbësit në atë Ditë. <sup>28</sup> Do ta shohësh çdo komunitet të gjunjëzuar. Çdo komunitet do të thirret sipas regjistrimit të tij: 'Sot do të shpaguheni për atë që e keni bërë. <sup>29</sup> Ja regjistri Ynë që e tregon të vërtetën për ju: po regjistronim gjithçka që bënit.' <sup>45:30</sup> Ata që besuan dhe bënë vepra të mira do të pranohen nga Zoti i tyre në mëshirën E Tij – ky është triumfi më i qartë – <sup>31</sup> por ata që nuk besuan [do të pyeten]: 'Kur jua recituan shpalljet E Mija, a nuk ishit arrogantë dhe këmbëngulës në vepra të mbrapshta? <sup>32</sup> Kur ju thanë: "Premtimi i **Allahut** është i vërtetë: nuk ka dyshim për Orën", a nuk u përgjigjët: "Nuk dimë asgjë për Orën. Sipas mendimit tonë kjo është veç hamendje. Nuk jemi të bindur." ?'

<sup>33</sup> E keqja e veprimeve të tyre [pastaj] do t'u bëhet e qartë. Ndëshkimi të cilin e tallnin do t'i gllabërojë. <sup>34</sup> Do të thuhet: 'Sot do t'ju injorojmë siç e injoruat ju takimin me këtë Ditë. Zjarri do të jetë shtëpia juaj dhe askush nuk do t'ju ndihmojë, <sup>35</sup> se i pranuat shpalljet e **Allahut** me tallje dhe u mashtruat nga jeta tokësore.' Ata nuk do të nxirren nga Zjarri në atë Ditë, as s'do t'u jepet shansi për përmirësim.

- <sup>36</sup> Pra lândi qoftë për **Allahun**, Zotin e qiejve dhe të tokës, Zotin e botëve.
- <sup>37</sup> Madhështia e vërtetë në qiej dhe në tokë është E Tij me të drejtë: Ai është I Fuqishmi, I Urti.

**Përshkrimi para kaptinës 45 nga Abdel Haleem:**

*Sure mekase që e merr titullin nga vargu 28, ku përshkruhet mbajtja e trupit në gjunjëzim në Ditën e Gjykimit. Surja u adresohet disa argumenteve të paraqitura nga ata që janë skeptikë për vërtetësinë e Kuranit. Theksi vihet në shenjat e ekzistencës së **Allahut** që janë të dallueshme në natyrë dhe në ndëshkimin e dhembshëm që i pret dyshuesit në Ditën e Gjykimit. Arroganca e devijuar e mosbesimtarëve (vargjet 8 dhe 31) kontrastohet me madhësinë e vërtetë të **Allahut** (vargu 37); suren e hapin dhe e mbyllin referencat në urtinë dhe madhërinë e **Allahut**.*



## 46: Kodrat e rërës (EL-AHKÂF)

Në emrin e **Allahut**, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës

<sup>1</sup> *Ha Mim*

<sup>2</sup> Ky Shkrim i Shenjtë është zbritur nga **Allahu**, I Gjithë-Fuqishmi, I Urti.

<sup>3</sup> Kishte qëllim të vërtetë dhe periudhë specifike që e krijuam qiellin dhe tokën dhe gjithçka ndërmjet, e megjithatë ata që e refuzojnë të vërtetën e injorojnë paralajmërimin që u është dhënë. <sup>4</sup> Thuaj [Profet]: ‘Mendoni me kujdes për ata që u luteni përveç **Allahut**: më tregoni se cilën pjesë të tokës e krijuan apo cilën hise të qiejve e zotërojnë; ma sillni një shkrim të shenjtë të mëparshëm apo ndonjë gjurmë të dijes hyjnore – nëse ajo që e thoni është e vërtetë.’ <sup>5</sup> Kush do të ishte më i gabuar se një person që i thërret të tjerët e jo **Allahun**, ata që nuk do t’i përgjigjen deri në Ditën e Ringjalljes, ata që janë të painformuar për lutjet e tij, <sup>6</sup> ata që, kur të mblidhet tërë njerëzimi, do të bëhen armiqtë e tij dhe do ta mohojnë adhurimin e tij?

<sup>7</sup> Kur shpalljet Tona u recitohen në tërë qartësinë e tyre, mosbesimtarët thonë për Të Vërtetën që u ka ardhur: ‘Kjo është qartas magji’, <sup>8</sup> apo thonë: ‘E ka shpikur vetë.’ Thuaj [Profet]: ‘Nëse e kam shpikur vërtet, nuk mund të bëni asgjë që të më shpëtoni nga **Allahu**. Ai e di më së miri se çka thoni ndërmjet vete për të [Të Vërtetën]; Ai është i mjaftueshëm si dëshmitar ndërmjet meje dhe juve; Ai është Më Falësi, Më Mëshirëploti.’ <sup>9</sup> Thuaj: ‘Nuk jam kurrfarë risie ndër të dërguarit e **Allahut**. Nuk e di se çka do të bëhet me mua a me ju; veç e ndjek atë që më shpallet; veç paralajmëroj qartë.’ <sup>46:10</sup> Thuaj: ‘A keni menduar: çka nëse ky Kuran është vërtet nga **Allahu** dhe e refuzoni? Çka nëse një nga Fëmijët e Izraelit dëshmon për ngjashmërinë e tij [me shkrimin e shenjtë të mëhershëm] dhe beson në të, e megjithatë jeni tepër krenarë për [ta bërë të njëjtën]? **Allahu** sigurisht që nuk i udhëzon keqbërësit.’

<sup>11</sup> Ata që nuk besojnë thonë për besimtarët: ‘Po të kishte ndonjë të mirë në këtë Kuran, nuk do të kishin besuar në të para se të besonim ne’, <sup>a</sup> dhe, meqë refuzojnë të udhëzohen nga ai, thonë: ‘Ky është trillim i lashtë.’ <sup>12</sup> E megjithatë, shkrimi i shenjtë i Musait ishte shpallur para tij si udhëzim e mëshirë dhe ky është shkrim i shenjtë që e vërteton atë në gjuhën arabe për t’i paralajmëruar ata që bëjnë keq dhe për t’u sjellë lajm të mirë atyre që bëjnë mirë. <sup>13</sup> Për ata që thonë: ‘Zoti ynë është **Allahu**’ dhe pastaj e ndjekin rrugën e drejtë – nuk ka frikë,

---

<sup>a</sup> Mosbesimtarët patën vështirësi veçanërisht në pranimin e faktit se disa nga ata që besonin në Islam ishin njerëz që i konsideronin si klasë e ulët shoqërore e përuar.

as s'do të pikëllohen: <sup>14</sup> janë njerëzit e Parajsës, për të mbetur aty si shpërblim për atë që po e bënin.

<sup>15</sup> Ne e kemi urdhëruar njeriun të jetë i mirë me prindërit e tij: nëna e tij kishte mundime për ta bartur dhe kishte mundime për ta lindur – barra dhe largimi nga gjiri zgjatën tridhjetë muaj të plotë. Kur të jetë bërë burrë dhe ta ketë arritur moshën dyzet-vjeçe ai [mund të] thotë: 'Zot, më ndihmo të jem vërtet mirënjohës për favoret e Tua ndaj meje dhe prindërve të mi; më ndihmo të bëj punë të mirë që të t'kënaqi; m'i bëj të mirë fëmijët e lindur. Ty të kthehem; jam një nga ata që të përkushtohen.'<sup>16</sup> Nga njerëzit e tillë e pranojmë më të mirën e asaj që e bëjnë dhe nuk ua këqyrim veprat e këqija. Do të jenë ndër njerëzit e Parajsës – premtimi i vërtetë që u është dhënë.

<sup>17</sup> Por disa u thonë prindërve të tyre: 'Çka? Vërtet po më paralajmëroni se do të ringjallem nga varri im, kur kaq shumë breza tashmë kanë kaluar dhe shkuar para meje?' Prindërit e tyre i përgjërohen **Allahut** për ndihmë; thonë: 'I mjeri ti! Beso! Premtimi i **Allahut** është i vërtetë', por ai prapë përgjigjet: 'Këto janë veç fabula të lashta.'<sup>18</sup> Vendimi gjykues është marrë për ata njerëz, bashkë me të gjitha komunitetet që shkuan para tyre, xhinde e njerëz: janë të humbur.<sup>19</sup> Gjithkush do të rangohet sipas veprave të tij dhe **Allahu** do t'i shpaguajë plotësisht për atë që e kanë bërë: nuk do t'u bëhet e padrejtë.<sup>46:20</sup> Në Ditën kur ata që e refuzojnë të vërtetën sillen para Zjarrit, do t'u thuhet: 'I shpërdoruat gjërat e mira që ju janë dhënë në jetën tuaj tokësore, u mbushët kënaqësi atje, kështu që në këtë Ditë ju takon një ndëshkim i turpit: ishit arrogantë në tokë pa asnjë të drejtë dhe i tejkaluat të gjithë kufijtë.'

<sup>21</sup> Përmende [Hudin] të fisit të Adit: i paralajmëroi popullin e tij midis kodrave të rërës – paralajmërues të tjerë kanë ardhur e shkuar para dhe pas tij – 'Mos e adhuron askë pos **Allahut**: kam frikë për ju, se do të ndëshkoheni në një Ditë të tmerrshme',<sup>22</sup> por ata thanë: 'A ke ardhur të na largosh nga zotat tanë? Nëse ajo që e thua është e vërtetë, na e zbrit atë ndëshkim me të cilin na kërcënon!' <sup>23</sup> Tha: 'Veç **Allahu** e di se kur do të vijë ai: unë thjesht jua përcjelli mesazhin me të cilin jam dërguar por po e shoh se jeni njerëz të pafytyrë.'<sup>24</sup> Kur e panë një re duke iu afruar luginës së tyre, thanë: 'Kjo re do të na japë shi!' 'Jo, në fakt! Është ajo që deshët ta shpejtonit: stuhi që bart ndëshkim të dhembshëm <sup>25</sup> që do të shkatërrojë gjithçka sipas urdhrit të Zotit të saj.' Në mëngjes nuk kishte asgjë për të parë përveç shtëpive të tyre [të shkatërruara]: kështu i shpaguajmë fajtorët.

<sup>26</sup> Ne i patëm mirë-vendosur ata në një mënyrë që nuk ju kemi stabilizuar juve [njerëzve të Mekës]; u dhamë dëgjim, shikim dhe zemra, e megjithatë dëgjimi, shikimi dhe zemrat nuk u hynë në punë, meqë i refuzuan shpalljet e **Allahut**. Ishin të mbingarkuar me ndëshkimin që e kishin tallur.<sup>27</sup> Ne kemi shkatërruar

edhe komunitete të tjera që dikur lulëzonin rreth jush – u patëm dhënë shenja të ndryshme që të mund të kthehen në rrugën e duhur – <sup>28</sup> pra pse zotat e tyre nuk iu ndihmuan, ata që i mvëshën si zota përkrah **Allahut** për t'i sjellë më afër Atij? Jo, në fakt! I lanë në baltë plotësisht: ishte krejt gënjeshtër e shpifur nga ta.

<sup>29</sup> Ne e dërguam një grup të xhindeve te ti [Profet] për ta dëgjuar Kuranin. Kur e dëgjuan, i thanë njëri-tjetrit: 'Mbani qetësi!' Pastaj kur mbaroi u kthyen te komuniteti i tyre dhe i paralajmëruan. <sup>46:30</sup> Thanë: 'Populli ynë, po e dëgjonim një Shkrim të Shenjtë që erdhi pas Musait, që i vërteton shkrimet e shenja të mëparshme, që jep udhëzim kah e vërteta dhe rruga e drejtë. <sup>31</sup> Populli ynë, përgjigjuni atij që ju thërret te **Allahu**. Besoni në Të: Ai do t'ju falë mëkatet dhe do t'ju mbrojë nga një torturë e dhembshme.' <sup>32</sup> Ata që dështojnë t'i përgjigjen thirrjes së **Allahut** nuk mund t'i ikin fuqisë së **Allahut** askund në tokë, as s'do të kenë ndonjë mbrojtës kundër Tij: njerëzit e tillë dukshëm kanë devijuar shumë.

<sup>33</sup> A s'e kuptojnë mosbesimtarët se **Allahu**, që i krijoi qiejt dhe tokën dhe nuk u lodh duke e bërë këtë, e ka fuqinë t'i kthejë të vdekurit në jetë? Po, në fakt! Ai ka pushtet ndaj gjithçkaje. <sup>34</sup> Në Ditën që mosbesimtarët sillen para Ferrit [do t'u thuhet]: 'A s'është kjo reale?' 'Po, për Zotin tonë', do të përgjigjen ata Ai do të thotë: 'Atëherë shijojeni ndëshkimin për refuzimin e të vërtetës.'

<sup>35</sup> Ji i qëndrueshëm [Muhamed], si ata të dërguarit me vendosmëri të fortë.<sup>a</sup> Mos kërko ta shpejtosh ndëshkimin për mosbesimtarët: në Ditën që e shohin se për çka ishin paralajmëruar, do t'u duket se kanë qëndruar [në këtë jetë] jo më shumë se një orë të një dite të vetme. Ky është paralajmërim. A do të shkatërrohet ndokush pos të pabindurit?

---

<sup>a</sup> Nuhu, Ibrahim, Musai, Isai dhe Muhamedi tradicionalisht quhen 'të dërguarit me vendosmëri të fortë' për qëndrueshmërinë e tyre në predikimin e mesazhit të **Allahut**.

**Përshkrimi para kaptinës 46 nga Abdel Haleem:**

*Sure mekase. Titulli i referohet kodrave (dunave) të rërës të përmendura në vargun 21, ku jetonin njerëzit e Adit dhe ku u shkatërruan kur e refuzuan paralajmërimin e profetit të tyre. Ajo e reflekton një nga temat kryesore të kësaj sureje: ndëshkimi i pashmangshëm që i pret ata që e refuzojnë të vërtetën dhe Ringjalljen. Theksi vihet në faktin se komunitete më të mirë-vendosura se sa i mekasve ishin shkatërruar dhe se madje edhe xhindet besojnë në Kuran para se të besojnë mosbesimtarët e Mekës. Në fund, Profeti inkurajohet të jetë i qëndrueshëm dhe ta presë gjykimin e **Allahut** mbi mosbesimtarët.*

## 47: Muhamedi (MUHAMMED)

Në emrin e **Allahut**, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës

<sup>1</sup> **Allahu** do t'i shndërrojë në asgjë veprat e atyre që nuk besojnë dhe i pengojnë të tjerët nga rruga e **Allahut**, <sup>2</sup> por nuk do t'i këqyrë veprat e këqija të atyre që kanë besim, bëjnë vepra të mira dhe besojnë në atë që i është zbritur Muhamedit – e vërteta nga Zoti i tyre – dhe do t'i vendosë në gjendje të mirë. <sup>3</sup> Kjo për shkak se mosbesimtarët e ndjekin falsitetin, gjersa besimtarët e ndjekin të vërtetën nga Zoti i tyre. Në këtë mënyrë **Allahu** ua tregon njerëzve llojin e tyre të vërtetë.

<sup>4</sup> Kur t'i hasni mosbesimtarët në betejë, goditini në qafë dhe pasi të mposhten, lidhini robërit fort – më vonë mund t'i çlironi me mirësi<sup>a</sup> a me shpërblesë – deri kur të kenë mbaruar mundimet e luftës. Kështu [është mënyra]. **Allahu** do të mund t'i kishte mundur Vetë po të kishte dashur, por qëllimi I Tij është t'i sprovtojë disa nga ju përmes të tjerëve. Ai nuk do t'i lërë veprat e atyre që janë vrarë për çështjen E Tij të shndërrohen në asgjë; <sup>5</sup> do t'i udhëzojë dhe do t'i vendosë në gjendje të mirë; <sup>6</sup> do t'i pranojë në Kopshtin që tashmë ua ka bërë të njohur. <sup>7</sup> Ju që besoni! Nëse i ndihmoni **Allahut**, Ai do t'ju ndihmojë dhe do t'ju bëjë të qëndroni fort.

<sup>8</sup> Sa për mosbesimtarët, sa e mjerë do të jetë gjendja e tyre! **Allahu** i ka shndërruar veprat e tyre në asgjë. <sup>9</sup> Pikërisht për shkak se e urrejnë atë që e ka zbritur **Allahu**, Ai ka bërë që veprat e tyre të shkojnë huq. <sup>47:10</sup> A nuk kanë udhëtuar nëpër tokë dhe ta kenë parë se si e hasën fundin e tyre ata para tyre? **Allahu** i shkatërroi plotësisht: mosbesimtarët i pret fat i ngjashëm. <sup>11</sup> Kjo për shkak se **Allahu** i mbron besimtarët gjersa mosbesimtarët nuk e kanë askë që t'i mbrojnë: <sup>12</sup> **Allahu** do t'i pranojë ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira në Kopshte të hijeshuara me lumenj rrjedhës; mosbesimtarët mund ta marrin kënaqësinë e plotë në këtë botë dhe të hanë siç bëjnë bagëtitë, por Zjarri do të jetë shtëpia e tyre. <sup>13</sup> Ne kemi shkatërruar shumë qytete më të forta se sa i yti [Profet] – qyteti që [zgjodhi të] të dëbonte – dhe nuk e kishin askë t'u ndihmojë.

<sup>14</sup> A mund të krahasohen ata që e ndjekin provën e qartë nga Zoti i tyre me ata veprat e ndyra të cilëve janë bërë t'u duken tërheqëse, ata që i ndjekin merakët e tyre? <sup>15</sup> Ja një përshkrim i Kopshtit të premtuar për të përkushtuarit: lumenj me ujë të pastër përgjithmonë, lumenj me qumësht të freskët përgjithmonë, lumenj me verë, kënaqësi për ata që pinë, lumenj me mjaltë të kulluar e të pastër, [të gjithë] rrjedhin në të; aty do të gjejnë fruta të çdo lloji; dhe aty do të gjejnë

---

<sup>a</sup> Komentuesit e theksojnë faktin se 'me mirësi' është i pari nga dy opsionet e dhëna këtu, duke konkluduar se ky është drejtimi i preferuar apo i rekomanduar i veprimi.

falje nga Zoti i tyre. Si mund të krahasohet kjo me fatin e të ngecurve në Zjarr, të cilëve u jepet ujë përvëlues për ta pirë që ua gërryen zorrët?

<sup>16</sup> Disa nga këta njerëz të dëgjojnë [Profet], por, posa ta lënë prezencën tënde, i përqeshin ata që u është dhënë dija, duke thënë: ‘Ç’ishte ajo që sapo e tha ai?’ Këta janë ata zemrat e të cilëve **Allahu** i ka vulosur, ata që i ndjekin meraket e tyre. <sup>17</sup> **Allahu** e ka rritur udhëzimin e atyre që e ndjekin rrugën e duhur dhe ua ka dhënë vetëdijen e tyre [për Të]. <sup>18</sup> Çka po presin mosbesimtarët, pos Orës që do t’u vijë e t’i gjejë të pavetëdijshëm? Shenjat e saj janë tashmë këtu, por pasi të ketë ardhur Ora vërtet, çfarë dobie do të kenë pastaj të jenë të vëmendshëm? <sup>19</sup> Pra [Profet], mbaje mend<sup>a</sup> se nuk ka zot pos **Allahut** dhe kërko falje për mëkatet e tua dhe për mëkatet e burrave e grave besimtare. **Allahu** e di kurdo që dikush nga ju lëviz dhe kurdo që dikush nga ju rri pa lëvizur.

<sup>47:20</sup> Ata që besojnë pyesin se pse nuk është zbritur asnjë sure [për luftimin]. E megjithatë kur zbritet një sure vendimtare [që e përmend luftimin], mund t’i shohësh të sëmurët në zemër duke të të shikuar [Profet] dhe duke u ligështuar dukshëm nga mundësia e vdekjes – më e mirë për ta <sup>21</sup> do të ishte dëgjueshmëria dhe fjalët e përshtatshme; po ashtu do të ishte më mirë për ta të jenë të vërtetë ndaj **Allahut** kur të jetë marrë vendimi për të luftuar. <sup>22</sup> ‘Nëse largoheni tani, a mund të ndodhë që do të shkoni të përhapni korrupsion kudo nëpër vend dhe t’i prishni lidhjet tuaja të fafëfisnisë?’ <sup>b</sup> <sup>23</sup> Këta janë ata që i ka refuzuar **Allahu**, duke ua bërë veshët të shurdhër dhe sytë të verbër. <sup>24</sup> A nuk do të reflektojnë për Kuranin? A nuk kanë dryrë në zemrat e tyre? <sup>25</sup> Ata që e kthejnë shpinën pasi u është treguar udhëzimi – i ka bërë budallenj dhe i ka tunduar Satani; <sup>26</sup> ata u thonë atyre që e urrejnë atë që e ka zbritur **Allahu**: ‘Do t’ju bindemi në disa çështje’ <sup>c</sup> – **Allahu** i di planet e tyre të fshehta.

<sup>27</sup> Si do të ndjehen kur engjëjt t’i marrin në vdekje dhe t’ua rrahin fytyrat dhe shpinat <sup>28</sup> se praktikonin gjëra që shkaktonin zemërim të **Allahut** dhe nuk denjuan ta kënaqin? Ai i bën veprat e tyre të shkojnë huq.

<sup>29</sup> A supozojnë të korruptuarit në zemër se **Allahu** nuk do ta zbulojë ligësinë e tyre? <sup>47:30</sup> Madje do të mund të t’i nxirrnim në pah [Profet] po të donim dhe pastaj do të mund t’i identifikojë sipas shenjave të tyre, por do t’i njohësh gjithsesi sipas tonit të të folurit të tyre. **Allahu** di gjithçka që bëni [ju njerëz]. <sup>31</sup> Ne do t’ju sprovovjmë për ta parë se cilët nga ju përpiqeni më së shumti dhe jeni të qëndrueshëm; do ta sprovovjmë sinqeritetin e pohimeve tuaja. <sup>32</sup> Ata që nuk

---

<sup>a</sup> Fjalë për fjalë ‘dije’

<sup>b</sup> Një referencë në pretekstin e dhënë, nga disa që refuzonin të luftonin, se luftimi i prish lidhjet e fafëfisnisë.

<sup>c</sup> Për shembull, do të pajtohen se Muhamedi nuk është profet, por nuk do të pajtohen me adhurimin e idhujve apo refuzimin e Ringjalljes (Razi).

besojnë, që i pengojnë të tjerët nga rruga e **Allahut** dhe që e kundërshtojnë Të Dërguarin kur u është treguar udhëzimi – nuk e dëmtojnë **Allahun** në asnjë mënyrë. Ai do t'i bëjë veprat e tyre të shkojnë huq – <sup>33</sup> besimtarë, bindjuni **Allahut** dhe Të Dërguarit: mos i leni veprat tuaja të shkojnë huq – <sup>34</sup> **Allahu** nuk do t'i falë ata që nuk besojnë, që i pengojnë të tjerët nga rruga e **Allahut** dhe që vdesin si mosbesimtarë.

<sup>35</sup> Pra [besimtarë] mos u dekurajoni e të bini në zor të madh për paqe. Ju jeni ata që e keni epërsinë: **Allahu** është me ju. Ai nuk do të hezitojë t'ju japë shpërblimin për veprat tuaja [të mira]: <sup>36</sup> jeta e kësaj bote është veç lojë, argëtim, por nëse besoni dhe jeni të vetëdijsëm për **Allahun**, do t'ju shpërblejë. Ai nuk ju kërkon të hiqni dorë nga [të gjitha] pasuritë tuaja – <sup>37</sup> do të zemëroheshit nëse do t'ju kërkonte dhe t'ju detyronte për to dhe Ai do ta nxirrte në dritë mospëlqimin tuaj të fortë – <sup>38</sup> megjithëse tash jeni të thirrur të jepni [pak] për hir të **Allahut**, disa nga ju po zemëroheni. Kushdo që po zemërohet po e bën këtë veç ndaj vetes: **Allahu** është burimi i pasurisë dhe ju jeni ata në nevojë. Ai do të vërë njerëz të tjerë në vendin tuaj nëse largoheni dhe ata nuk do të jenë si ju.

**Përshkrimi para kaptinës 47 nga Abdel Haleem:**

*Sure medinase që merret me çështjet e luftës, me ata që përpiqen ta pengojnë kthimin në Islam dhe zbatimin e urdhrave të **Allahut** (temë e zakonshme në suret medinase) dhe me fatin e hipokritëve. Specifikisht e përmend ligësinë e atyre që e dëbuan Profetin nga Meka, e përshkruan kotësinë e përpjekjeve të mosbesimtarëve për t'iu kundërvënë **Allahut** dhe Profetit Të Tij dhe i nxit myslimanët t'i binden **Allahut** në të gjitha çështjet, që veprat e tyre të mira të mos shndërrohen në asgjë në Ditën e Gjykimit si ato të mosbesimtarëve dhe të hipokritëve. Surja e merr titullin nga përmendja e emrit të Muhamedit në vargun 2.*



## 48: Triumfi (EL-FET'H)

Në emrin e **Allahut**, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës

<sup>1</sup> Vërtet ta kemi hapur një rrugë për te triumfi i qartë [Profet], <sup>2</sup> që **Allahu** të mund të t'i falë mëkatet e shkuara e të ardhshme, ta kompletojë mirësinë E Tij mbi ty, të t'udhëzojë në rrugë të drejtë, <sup>3</sup> dhe të t'ndihmojë fuqishëm. <sup>4</sup> Ishte Ai që bëri që qetësia E Tij të zbresë në zemrat e besimtarëve,<sup>a</sup> t'u shtojë besim besimit të tyre – forcat e qiejve dhe të tokës i përkasin **Allahut**; Ai është i gjithë-dijshmi dhe i gjith'-urti – <sup>5</sup> që t'i pranojmë burrat dhe gratë besimtare në Kopshtet e hijeshuara me lumenj rrjedhës, për të mbetur aty, duke ua falur veprat e këqija – triumf i madh në sytë e **Allahut** – <sup>6</sup> dhe t'i torturojmë burrat e gratë hipokritë e idhujtarë që ushqyen mendime të këqija për **Allahun**<sup>b</sup> – janë ata që do të rrethohen nga e keqja! – që e mbajnë barrën e zemërimit të **Allahut**, që **Allahu** i ka refuzuar dhe për të cilët e ka përgatitur Ferrin, një destinacion të keq!  
<sup>7</sup> Forcat e qiellit dhe të tokës i përkasin **Allahut**; Ai është i gjithë-fuqishëm dhe i gjith'-urtë. <sup>8</sup> Ne të kemi çuar [Profet] për të sjellë lajme të mira dhe për të paralajmëruar, <sup>9</sup> që [ju njerëz] të mund të besoni në **Allahun** dhe Të Dërguarin E Tij, ta përkrahni Atë, ta nderoni dhe ta lavdoni mëngjes-e-mbrëmje.

<sup>48:10</sup> Ata që të zotohen për besnikëri [ty Profet] në të vërtetë po i zotohen për besnikëri Vetë **Allahut** – dora e **Allahut** është e vënë mbi të tyret<sup>c</sup> – dhe kushdo që e prish këtë zotim e bën këtë në dëm të vetin: **Allahu** do t'i japë shpërblim të madh atij që ia përmbush zotimin e tij Atij. <sup>11</sup> Arabët e shkretëtirës që qëndruan prapa do të thonë: 'Ishim të zënë me pronën tonë dhe familjet tona: kërko falje për ne', por me gjuhët e tyre do ta thonë atë që nuk është në zemrat e tyre. Thuaj: 'Pavarësisht a është vullneti i **Allahut** për t'ju dëmtuar a për t'ju bërë mirë, kush mund të ndërhyjë për ju?' Jo! **Allahu** është plotësisht i informuar për gjithçka që bëni [ju njerëz]. <sup>12</sup> Jo! Menduat se I Dërguari dhe besimtarët kurrë nuk do t'u ktheheshin familjeve të tyre dhe ky mendim jua ngrohte zemrat. Mendimet tuaja janë të këqija, se jeni njerëz të korrumpuar: <sup>13</sup> e kemi përgatitur një Zjarr flakërues për ata që nuk besojnë në **Allahun** dhe Të Dërguarin E Tij. <sup>14</sup> Kontrolli i qiejve dhe i tokës i përket **Allahut** dhe Ai e fal këdo që do ta falë dhe e ndëshkon këdo që do ta ndëshkojë: **Allahu** është më falësi dhe mëshirëploti.

<sup>15</sup> Kur [ju besimtarë] niseni te një vend që premtonte fitime të luftës, ata që [më parë] qëndruan prapa do të thonë: 'Na lini të vijmë me ju.' Duan t'i ndryshojnë

---

<sup>a</sup> Kur u zotuan ta pranonin vendimin e Profetit. Shih vargun 18.

<sup>b</sup> Shih vargun 12.

<sup>c</sup> Besnikëria u zotua nga të gjithë duke i vendosur duart e tyre të djathta mbi atë të Profetit.

fjalët e **Allahut**, por thuaju [Profet]: ‘Nuk mund të vini me ne: **Allahu** e ka thënë këtë më parë.’ Do të përgjigjen: ‘Na e keni zili nga xhelozia.’ Sa pak që kuptojnë!

<sup>16</sup> Tregoju arabëve të shkretëtirës që qëndruan pas: ‘Do t’ju thërrasin të përballeni me një popull me fuqi të madhe në luftë dhe t’i luftoni, pos nëse dorëzohen: nëse bindeni, **Allahu** do t’ju shpërblejë mirë, por nëse largoheni, siç keni bërë më parë, do t’ju ndëshkojë rëndë – <sup>17</sup> të verbrit, të çalët dhe të sëmurët nuk do të fajësohen.’ **Allahu** do ta pranojë këdo që i bindet Atij dhe Të Dërguarit Të Tij – në Kopshte të hijeshuara me lumenj rrjedhës; Ai do ta ndëshkojë me dhembje këdo që largohet.

<sup>18</sup> **Allahu** ishte i kënaqur me besimtarët kur [ty Profet] t’u betuan nën pemë për besnikëri: Ai e dinte se ç’kishte në zemrat e tyre dhe kështu u zbriti qetësi dhe i shpërbleu me triumf të shpejtë <sup>19</sup> dhe me shumë fitime në të ardhmen: **Allahu** është i fuqishëm dhe i urtë. <sup>48:20</sup> Ai ju ka premtuar [juve njerëzve] shumë fitime në të ardhmen: jua ka shpejtuar këtë fitim. I ka mbajtur larg jush duart e njerëzve armiqësorë si shenjë për besimplotët dhe do t’ju udhëzojë në rrugë të drejtë. <sup>21</sup> Ka shumë fitime të tjera [në të ardhmen], ndaj të cilave nuk keni kurrfarë fuqie. **Allahu** ka kontroll të plotë ndaj tyre. **Allahu** ka pushtet ndaj të gjitha gjërave.

<sup>22</sup> Po të kishin luftuar mosbesimtarët kundër jush, do t’ia mbathnin dhe nuk do ta gjenin askë t’i mbrojtë a t’i përkrahë: <sup>23</sup> e tillë ishte praktika e **Allahut** në të shkuarën dhe nuk do të gjesh asnjë ndryshim në praktikat e **Allahut**. <sup>24</sup> Në luginën e Mekës ishte Ai që i mbajti duart e tyre larg jush dhe duart tuaja larg tyre pasi ju dha juve përparësi ndaj tyre<sup>a</sup> – **Allahu** sheh gjithçka që bëni. <sup>25</sup> Ata ishin ata që nuk besuan, që ju penguan për te Xhamia e Shenjtë dhe që e parandaluan ofertën të mos e arrijë vend-flijimin e saj. Po të mos kish pasur ndër ta, të panjohur për ju, burra e gra besimtare të cilët do t’i kishit shkelur me këmbë, duke shkaktuar faj padashur në llogari të tyre – **Allahu** e sjell këdo që do ta sjellë në mëshirën E Tij – po të ishin ndarë qartë [besimtarët], Ne do ta kishim shkaktuar një ndëshkim të dhembshëm mbi mosbesimtarët. <sup>26</sup> Gjersa mosbesimtarët kishin tërbim në zemrat e tyre – tërbimin e paditurisë – **Allahu** ia zbriti qetësinë E Tij Të Dërguarit Të Tij dhe besimtarëve dhe ua bëri detyrues premtimin [e tyre] për t’iu bindur **Allahut**,<sup>b</sup> se kjo ishte më e duhur dhe më e përshtatshme për ta. **Allahu** ka njohuri të plotë për të gjitha gjërat.

<sup>27</sup> **Allahu** vërtet e ka përmbushur vegimin e Të Dërguarit Të Tij: ‘Dashtë **Allahu**, sigurisht që do të hyni në Xhaminë e Shenjtë në mënyrë të sigurt, me

---

<sup>a</sup> Një çetë prej tetëdhjetë luftëtarësh mekas e sulmuan kampin e Profetit por u kapën. Profeti i liroi pasi u nënshkrua traktati.

<sup>b</sup> Premtimi që e bënë nën pemën në Hudaxhbijja (shih vargun 18).

koka të rruara apo me flokë të prerë,<sup>a</sup> pa frikë!’ – **Allahu** e dinte atë që nuk e dinit – dhe ju ka dhënë triumf të shpejtë.<sup>28</sup> Ishte Ai që e çoi Të Dërguarin E Tij, me udhëzim dhe fe të Të Vërtetës, që ai të tregojë se është mbi tërë fenë [e rreme]. **Allahu** mjafton si dëshmitar:<sup>29</sup> Muhamedi është I Dërguari I **Allahut**.

Ata që e ndjekin atë janë të ashpër ndaj mosbesimtarëve dhe dashamirës ndaj njëri-tjetrit. Ti i sheh duke rënë në gjuhë dhe duke e përulur kokën, duke e kërkuar mirësinë e **Allahut** dhe kënaqësinë E Tij të mirë: në fytyrat e tyre i mbajnë shenjat e përuljeve të kokës. Kështu përshkruhen në Teurat dhe në Ungjill: si farë që i lëshon filizat e saj, forcohet, trashet dhe ngritet në kërcellin e saj për kënaqësinë e mbjellësve të saj. Pra **Allahu** i zemëron mosbesimtarët përmes tyre; **Allahu** u premton falje dhe shpërblim të madh atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të ndershme.

---

<sup>a</sup> Këto janë disa nga ritet e fundit të pelegrinazhit (haxhit).

**Përshkrimi para kaptinës 48 nga Abdel Haleem:**

*Sure medinase që e merr titullin nga vargu 1 dhe flet shkurt për rastin kur Profeti e kishte një vegim se ai dhe ndjekësit e tij do të bënin pelegrinazh në Mekë (vargu 27). Ata u nisën, por mekasit vendosën t'i pengonin te Hudaxhbijja që të mos e arrinin qytetin dhe dërguan emisarë për të bërë diskutime me Profetin. Në fund Profeti e nënshkroi një traktat se ai dhe besimtarët nuk do të hynin në Mekë atë vit, por këtë do ta bënin vitin tjetër. Duke e parë rëndësinë afatgjatë të këtij traktati, në interes të paqes ai u pajtua për një armëpushim prej dhjetë vitesh gjatë të cilit, nëse cilido mekas kalonte kah ana e tij, ai do t'ia kthente atë mekasve, por nëse cilido nga njerëzit e tij kalonte kah mekasit, ata nuk do ta kthenin. Përgjatë sures Profetit i jepet siguri se ky traktat – të cilin ia ka dhënë **Allahu** – është përparim i madh (krahaso vargjet 1-3, 18-21, 27). Besimtarëve u ri-sigurohet se vetë-përmbajtja e tyre dhe bindja ndaj Profetit janë frymëzuar nga **Allahu** (vargjet 4-5, 24-6). Surja i kritikon haptas edhe hipokritët në Medinë (vargu 6) edhe idhujtarët e Mekës (vargjet 6 dhe 26) dhe përmbyllet duke i lavdëruar besimtarët (vargu 29).*

## 49: Dhomat private (EL-HUXHURÂT)

Në emrin e **Allahut**, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës

<sup>1</sup> Besimtarë, mos bini në sy në prani të **Allahut** dhe Të Dërguarit Të Tij – jini të vetëdijsëm për **Allahun**: Ai i dëgjon dhe i di të gjitha – <sup>2</sup> besimtarë, mos e ngritni zërin mbi atë të Profetit, mos e ngritni zërin kur i flisni siç ia bëni njëri-tjetrit, përndryshe veprat tuaja [të mira] mund të anulohen pa e ditur ju. <sup>3</sup> Janë ata që e ulin zërin në praninë e Të Dërguarit të **Allahut** - ata, zemrat e të cilëve **Allahu** e ka provuar se janë të vetëdijshme – ata do të kenë falje dhe shpërblim të madh – <sup>4</sup> por shumicës nga ata që të bërtasin [Profet] nga jashtë dhomave të tua private u mungon të kuptuarit. <sup>5</sup> Do të kish qenë më mirë për ta po të kishin pritur me durim që t'u dalësh por **Allahu** është gjithë-falës dhe mëshirëplotë.

<sup>6</sup> Besimtarë, nëse një ngatërrestar jua sjell ndonjë lajm, së pari kontrollojeni për çdo rast, që të mos i dëmtoni të tjerët pa dashje e të bëheni pishman më vonë për atë që e keni bërë, <sup>7</sup> dhe jini të vetëdijsëm se është I Dërguari I **Allahut** ai që është mes jush: në shumë çështje, po t'jua ndiqte dëshirat, sigurisht që do të vuanit. **Allahu** jua ka shijshmuar besimin dhe ua ka zbukuruar atë zemrave tuaja; Ai jua ka bërë të urrejtshëm mosbesimin, ligësinë dhe mosbindjen. Njerëzit e tillë janë ata që janë udhëzuar si duhet <sup>8</sup> përmes favorit dhe bekimit të **Allahut**: **Allahu** është i gjithë-dijshëm dhe i gjith'-urtë.

<sup>9</sup> Nëse luftojnë dy grupe besimtarësh, ju [besimtarë] duhet të provoni t'i pajtoni; nëse njëri nga ta [qartas] po e shtyp tjetrin, luftoni shtypësit deri kur t'i nënshtrohen urdhrit të **Allahut**, pastaj bëjeni një pajtim të drejtë dhe të pa-anshëm ndërmjet tyre: **Allahu** i do ata që janë të pa-anshëm. <sup>49:10</sup> Besimtarët janë vëllezër, pra bëni paqe ndërmjet dy vëllezërve tuaj dhe jini të vetëdijsëm për **Allahun**, që të mund t'ju jepet mëshirë.

<sup>11</sup> Besimtarë, asnjë grup i burrave nuk duhet të tallet me tjetrin, që në fund të fundit mund të jenë më të mirë se ta; asnjë grup i grave nuk duhet të tallet me tjetrin, që në fund të fundit mund të jenë më të mira se to; mos flisni keq për njëri-tjetrin; mos përdorni nofka ofenduese për njëri-tjetrin. Sa keq është të quhesh asi që bën ligësi<sup>a</sup> pas pranimit të besimit! Ata që nuk pendohen për këtë sjellje janë keqbërës. <sup>12</sup> Besimtarë, shmangiuni bërjes së tepër supozimeve – disa supozime janë të mëkatshme – dhe mos e spiunoni njëri-tjetrin apo të flisni keq për njerëzit prapa shpinës: a do të donte dikush nga ju ta hante mishin e vëllait të tij të vdekur? Jo, do ta urrenit. Pra jini të vetëdijsëm për **Allahun**: **Allahu** është

---

<sup>a</sup> Ata që shkaktojnë telashe duke e bërë ndonjë nga veprimet e mësipërme do ta kenë fituar emrin 'asi që bën ligësi' (Razi).

gjithnjë i butë, më mëshirëploti. <sup>13</sup> Njerëz, Ne ju krijuam të gjithëve nga një burrë i vetëm dhe një grua e vetme dhe ju zhvilluam nëpër raca e fise që ta njihnit njëri-tjetrin. Në sytë e **Allahut**, më të nderuarit nga ju janë ata që janë më të vetëdijshmit për Të. **Allahu** është i gjithë-dituri, i gjith'-informuari.<sup>a</sup>

<sup>14</sup> Arabët e shkretëtirës thonë: ‘Kemi besim.’ [Profet,] thuaju: ‘Nuk keni besim. Ajo që duhet ta thoni në vend të kësaj është: “Jemi nënshtruar” se besimi ende nuk ka hyrë në zemrat tuaja.’ Nëse i bindeni **Allahut** dhe Të Dërguarit Të Tij, Ai nuk do t’jua zvogëlojë asnjë nga veprat tuaja: Ai është më falësi dhe më mëshirëploti. <sup>15</sup> Besimtarët e vërtetë janë ata që kanë besim në **Allahun** dhe Të Dërguarin E Tij dhe nuk lënë prapa asnjë dyshim, ata që kanë bërë përpjekje me pasuritë e tyre dhe vetet e tyre në rrugën e **Allahut**: ata janë ata që janë të vërtetë. <sup>16</sup> Thuaj: ‘A supozoni ta mësoni **Allahun** për fenë tuaj, kur **Allahu** di gjithçka në qiej dhe në tokë dhe ka njohuri të plotë për të gjitha gjërat?’ <sup>17</sup> Mendojnë se të kanë bërë [ty Profet] favor duke u nënshtruar. Thuaj: ‘Mos e konsideroni nënshtrimin tuaj favor ndaj meje; është **Allahu** Ai që ju ka bërë favor, duke ju udhëzuar në besim, në qofshi vërtet të sinqertë.’ <sup>18</sup> **Allahu** i di fshehtësitë e qiejve dhe të tokës: Ai sheh gjithçka që bëni.

---

<sup>a</sup> Për vlerën e vërtetë të njerëzve dhe për mendimet që i ushqejnë (shih edhe 50:16).

**Përshkrimi para kaptinës 49 nga Abdel Haleem:**

*Kjo sure medinase e merr titullin nga përmendja e dhomave private të Profetit në vargun 4. I udhëzon besimtarët se si të sillen me respekt të duhur ndaj udhëheqësit të tyre (vargjet 1-5) dhe me respekt e besim të ndërsjellë ndaj njëri-tjetrit (vargjet 9-12). Surja e thekson unitetin e njerëzimit dhe qëllimin e **Allahut** që do të duhej të jetonin bashkë në harmoni (vargu 13). Ajo i kritikon arabët e shkretëtirës për qëndrimin e tyre të pafytyrë ndaj besimit të tyre dhe ndaj **Allahut** (vargjet 14-18).*

## 50: Kaf (KÂF)

Në emrin e **Allahut**, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës

<sup>1</sup> *Kaf*

Pasha Kuranin e lavdishëm!<sup>a</sup> <sup>2</sup> Por mosbesimtarët çuditen se një paralajmërues ka ardhur nga mesi i tyre dhe thonë: ‘Sa çudi! <sup>3</sup> Të kthehemi [në jetë] pasi të kemi vdekur e të jemi bërë pluhur? Kjo është tepër e vështirë për t’u besuar.’ <sup>4</sup> Ne e dimë shumë mirë se çka merr toka nga ta: e mbajmë një regjistër gjithëpërfshirës. <sup>5</sup> Por mosbesimtarët e refuzojnë të vërtetën kur u vjen; janë në gjendje të hutisë. <sup>6</sup> A nuk e shohin qiellin mbi ta – si e kemi ndërtuar dhe e kemi zbukuruar, pa asnjë çarje në të; <sup>7</sup> si e kemi shtrirë tokën dhe kemi vënë male të forta në të dhe kemi bërë të rritet në të çdo lloj bime e gëzueshme, <sup>8</sup> si mësim dhe përkujtues për çdo shërbyes që i kthehet **Allahut**; <sup>9</sup> dhe si zbresim ujë të bekuar nga qielli dhe me të i rrisim kopshtet, drithërat që korren <sup>50:10</sup> dhe palmat e larta të mbushura me tufa të hurmave, <sup>11</sup> si furnizim për secilin; si i japim me ujë jetë [të re] një toke që është e vdekur? Kështu do të dalin të vdekurit [nga varret e tyre]. <sup>12</sup> Populli i Nuhut nuk besoi shumë kohë para këtyre mosbesimtarëve, siç bënë edhe populli i Ressit, i Themudit, <sup>13</sup> i Adit, i Faraonit, i Lutit, <sup>14</sup> i Banorëve të Pyllit e i Tubës: të gjithë këta popuj nuk u besuan të dërguarve të tyre dhe kështu paralajmërimi Im u realizua.

<sup>15</sup> Pra a ishim të paaftë për krijimin e parë? Jo, në fakt! E megjithatë dyshojnë për një krijim të dytë. <sup>16</sup> Ne e krijuam njeriun – e dimë se çka i pëshpërit shpirti i tij: jemi më afër tij se sa vena e tij e qafës – <sup>17</sup> me dy receptorë<sup>b</sup> të vënë për të regjistruar, njëri nga ana e tij e djathtë dhe tjetri në të majtën: <sup>18</sup> ai nuk e shqipton as një fjalë të vetme pa një vrojtues që-është-gjithmonë-i-pranishëm. <sup>19</sup> Transi i vdekjes do ta sjellë Të Vërtetën me të: ‘Kësaj mundoheshe t’i ikje.’

<sup>50:20</sup> Trumpeta do të fryhet: ‘Kjo është Dita e [për të cilën ishit] paralajmëruar.’ <sup>21</sup> Secili person do të mbërrijë i shoqëruar nga një [engjell] për ta bërë të lëvizë dhe një tjetër për të qenë dëshmitar: <sup>22</sup> ‘Nuk i kushtove vëmendje kësaj [Dite]; por sot Ne ta kemi hequr perden dhe të pamurit tënd është i mprehtë.’ <sup>23</sup> Shoqëruesi i personit do të thotë: ‘Ja çka kam përgatitur’ – <sup>24</sup> ‘Hidheni<sup>c</sup> çdo mosbesimtar kokëfortë në Ferr, <sup>25</sup> secilin që e pengoi të mirën,

---

<sup>a</sup> Ajo për çka bëhet be – se njerëzimi do të ringjallen nga të vdekurit – është lënë jashtë por është e qartë nga vargjet që vijojnë (krahaso me 37:1; 89:1-4).

<sup>b</sup> Zakonisht merret se e ka kuptimin ‘engjëjt regjistruar’.

<sup>c</sup> Kjo folje është në trajtën duale, që merret se i drejtohet ose dy engjëjve regjistruar, ose dy engjëjve që e ruajnë Ferrin.



ishte agresiv, i bëri të tjerët të dyshojnë,<sup>26</sup> dhe mveshi zota të tjerë përkrah **Allahut**. Hidheni në ndëshkim të ashpër! –<sup>27</sup> dhe shoqëruesi i tij [i keq]<sup>a</sup> do të thotë: ‘Zot, unë nuk e kam bërë të mëkatojë; ai tashmë vetë kishte devijuar larg.’<sup>28</sup> **Allahu** do të thotë: ‘Mos u grindni në praninë Time. Jua çova një paralajmërim<sup>29</sup> dhe fjala Ime nuk mund të ndryshohet: Unë nuk jam i padrejtë ndaj asnjë krijese.’<sup>50:30</sup> Ne do t’i themi Ferrit në atë ditë: ‘A je plot?’ dhe ai do të përgjigjet: ‘A nuk ka më?’<sup>31</sup> Por Parajsa do t’u afrohet të ndershmëve dhe më nuk do të jetë e largët: <sup>32</sup> ‘Kjo është ajo që ju ishte premtuar – kjo është për secilin që iu kthye **Allahut** shpesh dhe e mbajti Atë në mendje,<sup>33</sup> që kishte frikë-respekt për Më Dashmirësin, megjithëse është i padukshëm, që vjen para Tij me zemër të kthyer kah Ai në përkushtim –<sup>34</sup> pra hyni në të në paqe. Kjo është Dita e Jetës së përhershme.’<sup>35</sup> Aty do të kenë gjithçka që duan dhe kemi edhe më shumë për ta.

<sup>36</sup> Ne kemi shkatërruar breza edhe më të fuqishëm para këtyre mosbesimtarëve, që udhëtuan nëpër [shumë] vende – a kishte ndonjë shpëtim?<sup>37</sup> Vërtet ka përkujtues në këtë për këdo që ka zemër, për këdo që dëgjon me vëmendje.<sup>38</sup> Ne i krijuam qiejt, tokën dhe gjithçka ndërmjet për gjashtë Ditë pa u lodhur.<sup>39</sup> Pra [Profet], toleroju me durim gjithçka që thonë; festoje lëndin e Zotit tënd para lindjes dhe perëndimit të diellit;<sup>50:40</sup> shpalle lëndin E Tij natën dhe në fund të secilës lutje;<sup>b</sup> <sup>41</sup> mbaj vesh për Ditën kur thirrësi do të thërrasë nga një vend i afërt.<sup>42</sup> Ata do të dalin [nga varret e tyre] në atë Ditë, Ditën kur e dëgjojnë shpërthimin e fuqishëm në realitet.<sup>43</sup> Jemi Ne Ata që japim jetë dhe vdekje; kthimi përfundimtar do të jetë te Ne<sup>44</sup> në Ditën kur toka do të copëtohet duke i lënë të nxitojnë – grumbullimi do të jetë i lehtë për Ne.<sup>45</sup> Ne e dimë më së miri se çka thonë mosbesimtarët. [Ti Profet] nuk je aty për t’i detyruar, pra përkujtojua, me këtë Kuran, atyre që i druhen paralajmërimit Tim.

---

<sup>a</sup> Krahaso me 4:38; 41:25.

<sup>b</sup> Fjalë për fjalë ‘rënie në gjunjë’, *suxhud*. Kjo është figurë e ligjëratës në të cilën pjesa qëndron për tërësinë.

**Përshkrimi para kaptinës 50 nga Abdel Haleem:**

*Sure mekase që merret kryesisht me Ringjalljen dhe Ditën e Gjykimit. U bëhen referenca brezave të mëparshëm të mosbesimtarëve (vargjet 12-14) – edhe për t'i paralajmëruar mosbesimtarët në Mekë, edhe për ta qetësuar Profetin. Krijimi citohet si tregues i aftësisë së **Allahut** për t'i sjellë të vdekurit në jetë përsëri (vargjet 3-11) dhe theksi vihet në pafuqinë e njeriut në Ditën e Ringjalljes (vargjet 20-30). Surja edhe hapet edhe mbyllet me përmendjen e Kuranit.*

## 51: [Erërat] shpërhapëse (EDH-DHÂRIJÂT)

Në emrin e **Allahut**, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës

<sup>1</sup> Pasha ato [erëra] që shpërhapin gjerë-e-gjatë e larg,<sup>a</sup> <sup>2</sup> dhe ato që janë të ngarkuara shumë,<sup>b</sup> <sup>3</sup> që shpejtojnë lirshëm, <sup>4</sup> që shpërndajnë [shi] siç është përcaktuar! <sup>5</sup> Ajo që ju është premtuar [juve njerëzve] është e vërtetë: <sup>6</sup> Gjykimi do të vijë – <sup>7</sup> pasha qiellin me shtigjet e tij, <sup>8</sup> keni dallime në atë që e thoni – <sup>9</sup> ata që largohen nga ai<sup>c</sup> janë [vërtet] të mashtruar. <sup>51:10</sup> Shuani gënjeshtarët, <sup>11</sup> ata që janë të zhytur në gabim dhe të pavetëdijshëm! <sup>12</sup> Pyesin: ‘Kur po vjen kjo farë Dita e Gjykimit?’ <sup>13</sup> Në një Ditë kur do të ndëshkohen nga Zjarri: <sup>14</sup> ‘Shijojeni ndëshkimin! Kjo është ajo që donit ta nxitonit.’ <sup>15</sup> Të ndershmit do të jenë në Kopshte me burime [rrjedhëse]. <sup>16</sup> Do t’u vijnë dhuratat e Zotit të tyre për shkak të të mirës që e bënë më parë: <sup>17</sup> duke fjetur veç pak natën, <sup>18</sup> duke u lutur në agim për faljen e **Allahut**, <sup>19</sup> duke ia dhënë lypësit dhe skamësit një hise të drejtë të pasurisë së tyre. <sup>51:20</sup> Në tokë ka shenja për ata me besim të sigurt – <sup>21</sup> dhe edhe në vetet tuaja, a nuk e shihni? – <sup>22</sup> në qiell është ushqimi juaj dhe gjithçka që ju është premtuar.<sup>d</sup> <sup>23</sup> Pasha Zotin e qiejve dhe të tokës! Krejt kjo është po aq reale sa të folurit tuaj.

<sup>24</sup> [Muhamed,] a e ke dëgjuar rrëfimin e mysafirëve të nderuar të Ibrahimit? <sup>25</sup> Shkuan ta vizitojnë dhe thanë: ‘Paqe.’ ‘Paqe’, tha ai, [duke shtuar me vete] ‘Këta njerëz janë të huaj.’ <sup>26</sup> U kthye shpejt në shtëpinë e tij, e nxori një viç të majmë <sup>27</sup> dhe ua vuri përpara. ‘A s’do të hani?’ tha, <sup>28</sup> duke nisur të ketë frikë nga ta, por ata thanë: ‘Mos ki frikë.’ I dhanë lajm të mirë të një djali që do të kishte prirje për dituri. <sup>29</sup> Gruaja e tij pastaj hyri me klithmë të fortë, e goditi fytyrën e saj<sup>e</sup> dhe tha: ‘Një plakë shterpe?’<sup>f</sup> <sup>51:30</sup> por ata thanë: ‘Do të jetë ashtu. Kështu ka thënë Zoti yt dhe Ai është I Urti, I Gjithë-Dijshmi.’ <sup>31</sup> Ibrahim tha: ‘Cila është porosia juaj, të dërguar?’ <sup>32</sup> Thanë: ‘Jemi çuar te një popull i humbur në mëkat, <sup>33</sup> për të zbritur shkëmbinj prej balte, <sup>34</sup> të shenjuar nga Zoti juaj për ata që i tejkalojnë të gjithë kufijtë.’ <sup>35</sup> Ne i nxorëm besimtarët e tillë që ishin atje – <sup>36</sup> e gjetëm veç një shtëpi që i ishte përkushtuar **Allahut** – <sup>37</sup> dhe e lamë qytetin të jetë shenjë për ata që i frikësohen ndëshkimit të dhembshëm.

---

<sup>a</sup> Shih 15:22; kjo është shpërhapje dashamirëse (për dallim nga ajo në 18:45).

<sup>b</sup> Me shi.

<sup>c</sup> Gjykimi.

<sup>d</sup> Ndëshkimi dhe Gjykimi Përfundimtar/Fati/ushqimi fizik dhe shpirtëror.

<sup>e</sup> Me mosbesim e siklet

<sup>f</sup> Shih 11:72

<sup>38</sup> Është një shenjë tjetër në Musain: Ne e çuam te Faraoni me autoritet të qartë. <sup>39</sup> Faraoni u kthye të flasë me përkrahësit e tij, duke thënë: ‘Ky është magjistar, apo mbase i çmendur’, <sup>51:40</sup> kështu që e mbërthyem atë dhe forcat e tij dhe i hodhëm në det: ai ishte fajtori. <sup>41</sup> Është një shenjë tjetër në Adin: Ne e çuam erën jetë-shkatërruese kundër tyre <sup>42</sup> dhe ajo copëtoi gjithçka së cilës iu sul. <sup>43</sup> Dhe po ashtu në Themudin – atyre u ishte thënë: ‘Nxjerrjani maksimumin jetës suaj për ca kohë’, <sup>44</sup> por u rebeluan kundër urdhrin të Zotit të tyre, kështu që i mori shpërthimi. Shikuan të pashpresë: <sup>45</sup> madje nuk mundnin as të qëndronin në këmbë, e lëre më të mbrohen. <sup>46</sup> Para kësaj e shkatërruam popullin e Nuhut. Ishin vërtet popull mëkatar! <sup>47</sup> Ne i ndërtuam qiejt me fuqinë Tonë dhe i bëmë të stërmëdhën, <sup>48</sup> e shtrimë tokën – sa mirë që e lëmuam! – <sup>49</sup> dhe krijuam çifte të të gjitha gjërave që [ju njerëz] të mund të bëheni të vetëdijsëm.

<sup>51:50</sup> [Pra, thuaju, Profet:] ‘Shpejt, kthehuni **Allahut** – jam dërguar nga Ai t’ju jap paralajmërim të qartë – <sup>51</sup> dhe mos mvëshni ndonjë zot tjetër krahas Tij. Jam dërguar nga Ai t’ju jap paralajmërim të qartë!’ <sup>52</sup> Secili popull i mëparshëm të cilit i ishte çuar një i dërguar thoshte po ashtu: ‘Magjistar, apo mbase i çmendur!’ <sup>53</sup> A i thanë njëri-tjetrit ta bënin këtë? Jo! Janë popull që i tejkalon të gjithë kufijtë, <sup>54</sup> pra injorohet [Profet] – ti nuk ke faj – <sup>55</sup> dhe vazhdo t’ua përkujtohet [njerëzve], është mirë për ata që besojnë t’u përkujtohet.

<sup>56</sup> Unë i krijova xhindet dhe njerëzimin veç për të më adhuruar Mua: <sup>57</sup> nuk dua kurrfarë furnizimi nga ta, as s’dua të më ushqejnë – <sup>58</sup> **Allahu** është Furnizuesi, Zoti I Fuqisë, Gjithmonë-I-Fuqishmi. <sup>59</sup> Keqbërësit, si para-ardhësit e tyre, do ta kenë një hise të ndëshkimit – nuk ka nevojë të kërkojnë nga Unë ta shpejtoj – dhe mjerë ata që e refuzojnë të vërtetën për Ditën që u është premtuar.

**Përshkrimi para kaptinës 51 nga Abdel Haleem:**

*Sure mekase që i jep disa nga shenjat e natyrës si provë të Ringjalljes, ndër të cilat janë erërat shpërhapëse që ia japin titullin sures (vargu 1). Mosbesimtarëve u rikujtohet fati që e pësuan brezat e mëparshëm rebelë dhe Profeti nxitet të vazhdojë t'ua përkujtojë njerëzve.*

## 52: Mali (ET-TÛR)

Në emrin e Allahut, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës

<sup>1</sup> Pasha malin,<sup>a</sup> <sup>2</sup> pasha një Shkrim të Shenjtë të skalitur <sup>3</sup> në pergamenë të pambështjellë, <sup>4</sup> pasha Shtëpinë e vizituar shumë<sup>b</sup>, <sup>5</sup> pasha kulmin e ngritur,<sup>c</sup> <sup>6</sup> pasha oqeanin gjithnjë të mbushur, <sup>7</sup> [Profet,] ndëshkimi i Zotit tënd po vjen – <sup>8</sup> nuk mund të shtyhet – <sup>9</sup> në Ditën kur qielli të lëkundet andej-këndeje <sup>52:10</sup> dhe malet të largohen në pluskim.<sup>d</sup> <sup>11</sup> Në atë Ditë mjerë ata që e refuzojnë Të Vërtetën, <sup>12</sup> që argëtohen me biseda boshe: <sup>13</sup> në atë Ditë do të shtyhen në Zjarrin e Ferrit. <sup>14</sup> ‘Ky është Zjarri që e mohoni dikur. <sup>15</sup> Pra a është magji kjo? A nuk e shihni ende?’ <sup>16</sup> Digjuni në të – nuk ka rëndësi a e duroni të përmbajtur apo jo – veç po shpaguheni për atë që e keni bërë.’

<sup>17</sup> Ata që ishin të vetëdijshëm për Allahun janë në Kopshte dhe në lumturi, <sup>18</sup> duke u kënaqur në dhuratat e Zotit të tyre: Ai i ka shpëtuar nga tortura e Flakës, <sup>19</sup> ‘Hani e pini me kënaqësi të begatshme si shpërblim për atë që e keni bërë.’ <sup>52:20</sup> Janë të ulur rehat<sup>e</sup> në divane të rregulluara në rreshta; Ne i çiftojmë me vasha sy-bukura; <sup>21</sup> i bashkojmë besimtarët me fëmijët e tyre të lindur që i ndoqën në besim – nuk ua mohojmë asnjë nga shpërblimet për veprat e tyre: secili person është nën premtim për veprat e tij – <sup>22</sup> i furnizojmë me çfarëdo fruti apo mishi që e kanë merak. <sup>23</sup> E kalojnë te njëri-tjetri një gotë që nuk çon në ndonjë bisedë boshe a mëkat. <sup>24</sup> Mirëpritën nga të rinj të përkushtuar si perlat e fshehura<sup>f</sup>. <sup>25</sup> I kthehen njëri-tjetrit dhe thonë: <sup>26</sup> ‘Kur ishim ende me familjet tona [në tokë] jetonim në frikë – <sup>27</sup> Allahu ka qenë dashamirës ndaj nesh dhe na shpëtoi nga tortura e nxehtësisë së fortë – <sup>28</sup> i luteshim Atij: Ai është I Miri, Mëshirëploti.’ <sup>29</sup> Pra [Profet] përkujtojua [njerëzve].

Pasha mirësinë e Zotit tënd [Profet], nuk je as fallxhi që e tregon fatin as i çmendur. <sup>52:30</sup> Nëse<sup>g</sup> thonë: ‘Është veç poet: do ta presim fatin e tij’, <sup>31</sup> thuaj: ‘Pritni po të doni; edhe unë po pres’ – <sup>32</sup> a ua thotë arsyeja vërtet ta bëjnë këtë, apo janë thjesht njerëz të paturp?’ <sup>33</sup> Nëse thonë: ‘E ka shpikur vetë’ – sigurisht që

---

<sup>a</sup> Malin Sinai, shih 95:2; 23:20

<sup>b</sup> Është kuptuar se i referohet Qabes në Mekë.

<sup>c</sup> Qiellin.

<sup>d</sup> Shih 27:88.

<sup>e</sup> *Itaka'a* domethënë ‘të ulesh, i mbështetur mirë’ (*al-Mu`jam al-Wasit*) (krahaso me 55:54, 76).

<sup>f</sup> Perlat më të zgjedhura mbaheshin të fshehura për t’i mbrojtur dhe hiqeshin nga vendi i sigurt veç në raste shumë të veçanta.

<sup>g</sup> Njëmbëdhjetë vargje në këtë pjesë nisin me ‘apo’, që është e fuqishme në argumentimin në gjuhën arabe. Kurani i shqyrton të gjitha argumentet e tyre, një nga një, me theks të njëjtë. Prandaj e përdor *am* (‘apo’) që tregon barasvlerë në arabisht. E kemi hequr lidhoren.

nuk besojnë – <sup>34</sup> le ta prodhojnë një si ai, nëse ajo që e thonë është e vërtetë. <sup>35</sup> A ishin krijuar pa asnjë shkaktar? A ishin ata krijuesit? <sup>36</sup> A i krijuan qiejt dhe tokën? Jo! Nuk kanë besim. <sup>37</sup> A i posedojnë thesaret e Zotit tënd apo a kanë kontroll ndaj tyre? <sup>38</sup> A kanë shkallë të ngjiten, që të përgjojnë [fshehtësi të Qiellit]? Le të prodhojë përgjuesi i tyre provë të qartë. <sup>39</sup> A ka **Allahu** bija gjersa ju keni bij?<sup>a 52:40</sup> A kërkon [ti Profet] pagesë nga ta që do t'i ngarkonte me borxhe? <sup>41</sup> A kanë [qasje në] të padukshmen? A do të mund ta shkruanin? <sup>42</sup> A mendojnë se mund të të kurthojnë? Janë mosbesimtarët ata që janë kurthuar. <sup>43</sup> A vërtet e kanë një zot tjetër krahas **Allahut**? **Allahu** është larg mbi çkado që i mveshin përkrah.

<sup>44</sup> Edhe po ta shihnin një copë qielli t'u binte përmbi,<sup>b</sup> do të thoshin: 'Veç një grumbull i reve', <sup>45</sup> pra lëri, Profet, deri kur të përballen me Ditën kur do t'i godasë rrufeja, <sup>46</sup> Ditën kur kurthet e tyre nuk do t'u hyjnë në punë fare, kur nuk do të marrin kurrfarë ndihme. <sup>47</sup> Një ndëshkim tjetër i pret keqbërësit, megjithëse shumica nga ta nuk e kuptojnë. <sup>48</sup> Prite me durim [Profet] gjykimin e Zotit tënd: je nën syrin Tonë vigjilent. Festoje lavdimin e Zotit tënd kur të ngritesh. <sup>49</sup> Lavdoje Atë natën dhe në venitjen e yjeve.

---

<sup>a</sup> Kjo i referohet besimit pagan se engjëjt ishin bijat e **Allahut** dhe zakonisht të tyre të denigrimit (kritikimit zhvlerësues) të lindjes së bijave të tyre.

<sup>b</sup> Mekasit e sfiduan Profetin t'i zbriste qiejt poshtë mbi ta, nëse ishte vërtet I Dërguari I **Allahut**. Krahaso me 17:92.

**Përshkrimi para kaptinës 52 nga Abdel Haleem:**

*Sure mekase që u adresohet shumë argumenteve që i janë paraqitur Profetit nga mosbesimtarët e Mekës (vargjet 29-49). Lumturia që do të shijohet nga besimtarët kontrastohet me torturat e Ferrit dhe Profeti nxitet të presë me durim, të vazhdojë ta japë mesazhin e tij dhe ta presë me konfidencë gjykimin e Allahut. Allahu betohet, ndër të tjera, në Malin Sinai, nga i cili e merr titullin surja, se Dita e Gjykimit është e pashmangshme.*



## 53: Ylli (EN-NEXHM)

Në emrin e **Allahut**, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës

<sup>1</sup> Pasha yllin kur perëndon!<sup>a</sup> <sup>2</sup> Shoqëruesi juaj<sup>b</sup> nuk ka devijuar; nuk është në deluzion; <sup>3</sup> nuk flet siç ka merak vetë. <sup>4</sup> Kurani është hiç më pak se shpallje që i është dërguar. <sup>5</sup> I është mësuar nga [një engjëll]<sup>c</sup> me fuqi mbresëlënëse <sup>6</sup> dhe forcë të madhe, që qëndroi <sup>7</sup> në horizontin më të lartë <sup>8</sup> dhe pastaj u afrua – duke zbritur <sup>9</sup> deri kur ishte dy gjatësi harku larg apo madje edhe më afër – <sup>53:10</sup> dhe ia shpalli shërbyesit të **Allahut** atë që ia shpalli Ai. <sup>11</sup> Zemra e tij [e Profetit] nuk e shtrembëroi atë që e pa. <sup>12</sup> A do të grindeni me të për atë që e pa me sytë e tij? <sup>13</sup> Edhe një herë të dytë e pa: <sup>14</sup> skaj pemës lotus përtej të cilës nuk mund të kalojë askush<sup>d</sup> <sup>15</sup> pranë Kopshtit të Pushimit të Plotë, <sup>16</sup> ku pema ishte e mbuluar me [shkëlqim] të pa-emër<sup>e</sup>. <sup>17</sup> Të pamurit e tij nuk u lëkund kurrë, as s'ish tepër i guximshëm, <sup>18</sup> dhe i pa disa nga shenjat më të mëdha të Zotit të tij.

<sup>19</sup> [Mosbesimtarë,] mendoni për Latën dhe Uzzën, <sup>53:20</sup> dhe të tretën, Menatën<sup>f</sup> – <sup>21</sup> a do ta keni ju maskullin dhe Ai femrën? <sup>22</sup> Kjo do të ishte më e padrejta shpërndarje!<sup>g</sup> – <sup>23</sup> këto nuk janë asgjë pos emra që i keni shpikur vetë, ju dhe para-ardhësit tuaj. **Allahu** nuk ka dërguar autoritet për ta. Këta njerëz thjesht e ndjekin hamendjen dhe tekat e shpirtave të tyre, edhe pse u ka ardhur udhëzimi nga Zoti i tyre. <sup>24</sup> A do të ketë njeriu gjithçka që dëshiron,<sup>h</sup> <sup>25</sup> kur jeta e tanishme dhe jeta tjetër i përkasin veç **Allahut**? <sup>26</sup> Ka shumë engjëj në qiell ndërmjetësimi i të cilëve nuk do të ketë kurrfarë dobie deri kur **Allahu** t'u japë leje atyre që do t'u japë, fjalët e të cilëve do t'i pranojë. <sup>27</sup> Ata që e refuzojnë jetën tjetër u japin engjëjve emra femërorë. <sup>28</sup> Nuk kanë kurrfarë diturie ku e bazojnë këtë: thjesht e ndjekin hamendjen. Hamendja është pa asnjë vlerë ndaj Të Vërtetës. <sup>29</sup> Pra [Profet] injoroi ata që largohen nga shpallja Jonë, që e duan veç jetën e kësaj bote. <sup>53:30</sup> Dija e tyre nuk shkon përtej kësaj. Zoti yt e di më së miri se kush devijon nga rruga E Tij dhe kush e ndjek udhëzimin. <sup>31</sup> Gjithçka në qiej dhe në tokë i përket **Allahut**. Ai do t'i shpaguajë ata që bëjnë keq sipas veprave të tyre dhe do t'i shpërblejë, me atë që është më e mira, ata që bëjnë mirë. <sup>32</sup> Sa për ata që

---

<sup>a</sup> Siriusin, të cilin e adhuronin mekasit (krahaso me vargjet 49 dhe 6:76-9).

<sup>b</sup> Muhamedi.

<sup>c</sup> Kjo i referohet Engëllit Xhebrail (Gabriel).

<sup>d</sup> Krahaso me 56:28.

<sup>e</sup> Diçka e paimagjinueshme, e papërshkrueshme.

<sup>f</sup> Emrat e perëndeshave pagane arabe.

<sup>g</sup> Meqë arabët paganë i konsideronin bijat si poshtërim, Kurani argumenton me ta sipas logjikës së tyre se ishte veçanërisht e palogjikshme për ta t'ia atribuojnë bijat **Allahut**. Shih edhe 16:57-62; 43:16-20.

<sup>h</sup> Mosbesimtarët pretendonin se i adhuronin perëndeshat e tyre ashtu që këto të mund të ndërmjetësonin për ta me **Allahun**, apo t'i afrojnë pranë Tij. Krahaso me 6:94; 39:3.

u shmangen mëkateve fatale dhe veprave të ndyra, megjithëse mund të bëjnë mëkate të vogla, Zoti yt është i gjerë në falje. Ai ka qenë i informuar për ju që nga koha që ju prodhoi nga toka dhe nga vendet tuaja të fshehjes në mitrat e nënave tuaja, pra mos i dilni në mbrojtje mirësisë suaj:<sup>a</sup> Ai e di më së miri se kush është i vetëdijshëm për Të.

<sup>33</sup> [Profet,] mendo për atë njeri që u largua: <sup>34</sup> dha veç pak pastaj u ndal. <sup>35</sup> A ka njohuri për të Padukshmen? A mund të shohë [Të Përtejmen]? <sup>36</sup> A s'i është treguar çka ishte shkruar në Shkrimet e Shenjta të Musait <sup>37</sup> dhe të Ibrahimit, i cili e përmbushi detyrën e tij: <sup>38</sup> se asnjë shpirt nuk do ta bartë barrën e tjetrit; <sup>39</sup> se njeriu do ta ketë veç atë për të cilën ka punuar; <sup>53:40</sup> se mundi i tij do të shihet <sup>41</sup> dhe se në fund do të shpaguehet plotësisht për të; <sup>42</sup> se qëllimi përfundimtar është Zoti yt; <sup>43</sup> se është Ai që i bën njerëzit të qeshin e të qajnë; <sup>44</sup> se është Ai që jep vdekje dhe jetë; <sup>45</sup> se Ai Vetë i krijoi dy gjinitë, mashkull e femër, <sup>46</sup> nga një pikë e gufuar e spermës; <sup>47</sup> se Ai do ta marrë përsipër Krijimin e dytë; <sup>48</sup> se është Ai që jep pasuri e pronë; <sup>49</sup> se Ai është Zoti i Siriusit;<sup>b</sup> <sup>53:50</sup> se ishte Ai që i shkatërroi, plotësisht, Adin e lashtë <sup>51</sup> dhe Themudin, <sup>52</sup> dhe para tyre popullin e Nuhut që ishin edhe më të padrejtë e të paturp; <sup>53</sup> se ishte Ai që i rrëzoi qytetet e rrënuara <sup>54</sup> dhe i mbështolli në ndëshkimin që e urdhëroi për ta? <sup>55</sup> Pra cilin nga bekimet e Zotit tënd po e mohon [ti]<sup>c</sup> ?

<sup>56</sup> Ky është paralajmërim mu sikur paralajmërimet e dërguara në kohërat e mëparshme. <sup>57</sup> Ora e afërt avitet <sup>58</sup> dhe veç **Allahu** mund ta shpërfaqë. <sup>59</sup> A çuditëni [ju njerëz] me këtë? <sup>53:60</sup> Pse qeshni në vend se të qani? <sup>61</sup> Pse nuk jeni fare të vëmendshëm? <sup>62</sup> Përkuluni para **Allahut** dhe adhuroni.

---

<sup>a</sup> Krahaso me 32:10; 50:4.

<sup>b</sup> Yllit të adhuruar nga arabët paganë.

<sup>c</sup> Njeriu që u largua (vargu 33).

**Përshkrimi para kaptinës 53 nga Abdel Haleem:**

*Sure mekase që e vërteton burimin hyjnor të mesazhit të Profetit dhe i referohet ngjitjes së tij në qiell gjatë Udhëtimit të Natës (vargjet 1-18). Surja i hedh poshtë pretendimet e mosbesimtarëve rreth perëndeshave dhe engjëjve (vargjet 19-28) dhe paragrafi i tretë i radhit disa të vërteta për fuqinë e **Allahut**. Surja përmbyllet me një paralajmërim të Ditës së afërt të Gjykimit.*

## 54: Hëna (EL-KAMER)

Në emrin e Allahut, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës

<sup>1</sup> Ora afrohet; hëna është e ndarë mëdysh.<sup>a</sup>

<sup>2</sup> Sa herë që mosbesimtarët e shohin një shenjë, largohen dhe thonë: ‘E njëjta magji e vjetër!’ <sup>3</sup> E refuzojnë të vërtetën dhe i ndjekin meraket e tyre – gjithçka regjistrohet<sup>b</sup> – <sup>4</sup> edhe pse u kanë zbritur rrëfime paralajmëruese që duhej t’i kishin frenuar – <sup>5</sup> urti me ndikim të madh – por këto paralajmërime nuk ndihmojnë: <sup>6</sup> pra [Profet] hiq ty. Në Ditën kur Thirrësi do t’i thërrasë në një ngjarje të tmerrshme, <sup>7</sup> me sy të rrëzuar, do të dalin nga varret e tyre si karkaleca vërshues <sup>8</sup> duke nxituar kah Thirrësi. Mosbesimtarët do të thërrasin: ‘Kjo është ditë e ashpër!’

<sup>9</sup> Populli i Nuhut e refuzuan të vërtetën para tyre: e refuzuan shërbyesin Tonë, duke thënë: ‘Është i çmendur!’ Nuhun e qortuan, <sup>54:10</sup> dhe kështu ai i thirri Zotit të tij: ‘Më mundën: më ndihmo!’ <sup>11</sup> Kështu Ne i hapëm portat e qiellit me ujë të rrëmbyeshëm, <sup>12</sup> e shpërthyem tokën me burime gufuese: ujërat u takuan për një qëllim të paracaktuar. <sup>13</sup> E bartëm atë mbi një anije nga dërrasat e gozhdat <sup>14</sup> që pluskonte nën syrin Tonë vigjilent, shpërblim për atë që ishte refuzuar. <sup>15</sup> E kemi lënë këtë<sup>c</sup> si shenjë: a do të jetë i vëmendshëm ndokush? <sup>16</sup> Sa [i tmerrshëm] ishte ndëshkimi Im dhe [përmbushja për] paralajmërimet E Mija! <sup>17</sup> Ne e kemi bërë të lehtë të mësohen mësimet nga Kurani: a do të jetë i vëmendshëm ndokush?

<sup>18</sup> Edhe njerëzit e Adit e refuzuan të vërtetën. Sa [i tmerrshëm] ishte ndëshkimi Im dhe [përmbushja për] paralajmërimet E Mija! <sup>19</sup> E lëshuam një erë ulëritëse kundër tyre në një ditë të katastrofës së tmerrshme; <sup>54:20</sup> ajo i fshiu njerëzit nga faqja e dheut si trungje të palmave të shkulura. <sup>21</sup> Sa [i tmerrshëm] ishte ndëshkimi Im dhe [përmbushja për] paralajmërimet E Mija! <sup>22</sup> E kemi bërë të lehtë të mësohen mësimet nga Kurani: a do të jetë i vëmendshëm ndokush?

<sup>23</sup> Edhe njerëzit e Themudit i refuzuan paralajmërimet – <sup>24</sup> thanë: ‘Çka? Një njeri? Pse duhet ta ndjekim një njeri të vetëm nga mesi ynë? Kjo do të ishte e gabuar; krejtësisht e çmendur!’ <sup>25</sup> A do t’i jepej një mesazh veç atij nga të gjithë ne? Jo, është gënjeshtar i pafytyrë!’ <sup>26</sup> ‘Nesër do ta dinë se kush është gënjeshtari i

---

<sup>a</sup> Një nga shenjat e Ditës së Gjykimit. Arabishtja e përdor kohën e shkuar, sikur ajo Ditë të ishte këtu tashmë, për t’i ndihmuar lexuesit/dëgjuesit ta imagjinojë se si do të jetë. Disa komentues tradicionalë i mbahen pikëpamjes se kjo e përshkruan një ngjarje aktuale në kohën e Profetit, por kjo qartë i referohet fundit të botës: krahasoje shprehjen e njëjtë në lidhje me qiellin, 55:37; 84:1.

<sup>b</sup> Fjalë për fjalë ‘fiksohet’ në shënimet hyjnore.

<sup>c</sup> ‘Këtë rrëfim’ apo ‘këtë anije’.

pafytyrë,<sup>27</sup> se do t'ua dërgojmë një deve për t'i sprovuar: pra shikoji [Salih] dhe ji i durueshëm.<sup>28</sup> Tregoju se uji duhet të ndahet ndërmjet tyre:<sup>a</sup> secili duhet të pijë me radhë.<sup>29</sup> Por ata e thirrën shoqëruesin e tyre, që e mori një shpatë dhe e gjymtoi deven.<sup>54:30</sup> Sa [i tmerrshëm] ishte ndëshkimi Im dhe [përmbushja për] paralajmërimet E Mija!<sup>31</sup> E lëshuam një shpërthim të vetëm të fuqishëm kundër tyre dhe mbaruan si thuprat e thata të një gardh-ndreqësi.<sup>32</sup> E kemi bërë të lehtë të mësohen mësimet nga Kurani: a do të jetë i vëmendshëm ndokush?

<sup>33</sup> Populli i Lutit i refuzoi paralajmërimet.<sup>34</sup> E lëshuam një erë që bartte gurë kundër tyre, të gjithëve pos familjes së Lutit. I shpëtua para agimit<sup>35</sup> si favor nga Ne: kështu i shpërblejmë falënderuesit.<sup>36</sup> Ai i paralajmëroi për sulmin tonë masiv, por ata e hoqën nga mendja paralajmërimin –<sup>37</sup> madje ia kërkuan mysafirët e tij – prandaj ua vulosëm sytë – ‘Shijojeni ndëshkimin tim [të tmerrshëm] dhe [përmbushjen për] paralajmërimet E Mija!’ –<sup>38</sup> dhe herët në mëngjes i mbërtheu një ndëshkim që mbetet ende –<sup>39</sup> ‘Shijojeni ndëshkimin tim [të tmerrshëm] dhe [përmbushjen për] paralajmërimet E Mija!’<sup>54:40</sup> E kemi bërë të lehtë të mësohen mësimet nga Kurani: a do të jetë i vëmendshëm ndokush?

<sup>41</sup> Edhe njerëzit e Faraonit morën paralajmërimet.<sup>42</sup> I refuzuan të gjitha shenjat Tona kështu që i mbërthyem me tërë fuqinë dhe forcën Tonë.

<sup>43</sup> ‘A janë mosbesimtarët tuaj<sup>b</sup> më të mirë se këta? A ju është dhënë në Shkrimin e Shenjtë lirim nga rregullat?’<sup>44</sup> A thonë mbase: ‘Jemi ushtri e madhe dhe do të jemi fitimtarë?’<sup>45</sup> Forcat e tyre do të shpartallohen dhe do të ikin me bisht ndër këmbë.<sup>c</sup><sup>46</sup> Por Ora është ora e tyre e caktuar – Ora është më e ashpër dhe më e hidhur:<sup>47</sup> vërtet të ligët janë të gabuar dhe krejtësisht të çmendur<sup>d</sup> –<sup>48</sup> në Ditën kur tërhiqen zvarrë për fytyrat e tyre në Ferr. ‘Ndjejeni preken e Ferrit.’<sup>49</sup> Ne i kemi krijuar të gjitha gjërat në masë të duhur;<sup>54:50</sup> kur urdhërojmë diçka ajo ndodh menjëherë, sa hap e mbyll sytë;<sup>51</sup> i kemi shkatërruar të ngjashmit tuaj në të shkuarën. A do të jetë i vëmendshëm ndokush?

<sup>52</sup> Gjithçka që bëjnë shënohet në regjistrat e tyre:<sup>53</sup> çdo veprim, i madh a i vogël, regjistrohet.<sup>54</sup> Të ndershmit do të jetojnë në mënyrë të sigurt në mes të Kopshteve e lumenjve,<sup>55</sup> të sigurt në prezencën e një Sovrani të gjithë-fuqishëm.

---

<sup>a</sup> Dhe deve (shih 26:155).

<sup>b</sup> Të Mekës.

<sup>c</sup> Profeti e përsëriti këtë varg në Betejën e Bedrit.

<sup>d</sup> Shih vargun 24 më lart.

**Përshkrimi para kaptinës 54 nga Abdel Haleem:**

*Sure mekase që merret kryesisht me ndëshkimin që u është dhënë brezave të mëparshëm të mosbesimtarëve. Këto paraqiten si paralajmërim për mosbesimtarët e Mekës, me refrenin ‘A do të jetë i vëmendshëm ndokush?’ që përsëritet nëpër sure. Në fund trajtimi i mosbesimtarëve në Ditën e Gjykimit kontrastohet me lumturinë e përhershme që do ta gëzojnë besimtarët. Titulli është marrë nga vargu 1 dhe është referencë për Ditën e Ringjalljes.*

## 55: Zoti i mëshirës (ER-RAHMÂN)

Në emrin e Allahut, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës

<sup>1</sup> Është Zoti i Mëshirës <sup>2</sup> që e dha mësim Kuranin.<sup>a</sup> <sup>3</sup> Ai e krijoi njeriun <sup>4</sup> dhe e mësoi të komunikojë.<sup>b</sup> <sup>5</sup> Dielli dhe hëna i ndjekin shtigjet e tyre të llogaritura; <sup>6</sup> bimët dhe pemët u nënshtrohen<sup>c</sup> dizajneve Të Tij; <sup>7</sup> Ai e ka ngritur qiellin. E ka vënë baraspeshën <sup>8</sup> që të mos ju lejohet ta teproni në baraspeshë: <sup>9</sup> peshoni me drejtësi dhe mos pakësoni në baraspeshë. <sup>55:10</sup> E vendosi Tokën për krijesat E Tij, <sup>11</sup> me frutat e saj, palmat e saj me tufa të mbështjella, <sup>12</sup> drithërat e saj me lëvore, bimët e saj aromatike. <sup>13</sup> Pra, cilat nga bekimet e Zotit tuaj i refuzoni ju dy <sup>d</sup> ?

<sup>14</sup> Ai e krijoi njerëzimin nga balta e tharë, si poç, <sup>15</sup> e xhindet nga zjarri pa tym. <sup>16</sup> Pra, cilat nga bekimet e Zotit tuaj i refuzoni ju dy?

<sup>17</sup> Ai është Zoti i dy ngritjeve dhe i dy zbritjeve.<sup>e</sup> <sup>18</sup> Pra, cilat nga bekimet e Zotit tuaj i refuzoni ju dy?

<sup>19</sup> Ai i lëshoi dy trupat e ujit [të pakripë dhe të njelmët]. Ata takohen, <sup>55:20</sup> e megjithatë është një pengesë mes tyre që nuk e kalojnë. <sup>21</sup> Pra, cilat nga bekimet e Zotit tuaj i refuzoni ju dy?

<sup>22</sup> Perlat dalin nga ta: të mëdha dhe të vogla, të shkëlqyeshme.<sup>f</sup> <sup>23</sup> Pra, cilat nga bekimet e Zotit tuaj i refuzoni ju dy?

<sup>24</sup> Të Tijat janë anijet lëvizëse që pluskojnë, të larta sa malet, në det. <sup>25</sup> Pra, cilat nga bekimet e Zotit tuaj i refuzoni ju dy?

<sup>26</sup> Secili që është në tokë shuhet; <sup>27</sup> krejt çka mbetet është Fytyra<sup>g</sup> e Zotit tuaj, plot madhështi, duke dhuruar nder. <sup>28</sup> Pra, cilat nga bekimet e Zotit tuaj i refuzoni ju dy?

<sup>29</sup> Secili në qiell dhe në tokë i përgjërohet Atij; çdo ditë është i angazhuar.<sup>a</sup> <sup>55:30</sup> Pra, cilat nga bekimet e Zotit tuaj i refuzoni ju dy?

---

<sup>a</sup> Një interpretim është se *kur'an* këtu domethënë 'të lexosh', krahaso me 96:1.

<sup>b</sup> *Bajan* (komunikimi) e përfshin edhe të shprehurit e vetes edhe të kuptuarit e asaj që është shprehur nga të tjerët, duke e përfshirë Kuranin, që quhet *bajan* dhe *mubin*.

<sup>c</sup> *Saxhada* domethënë 'të nënshtroresh' dhe rrjedhimisht edhe 'të përkuluesh apo 'të gjunjëzohesh'.

<sup>d</sup> Njerëzimi dhe xhindët.

<sup>e</sup> Kjo i referohet lindjes dhe perëndimit të diellit dhe të hënës, apo, alternativisht, pikave të tyre më të largëta të lindjes dhe perëndimit të diellit në verë dhe në dimër.

<sup>f</sup> Shih Abdel Haleem, *Understanding the Qur'an*, 170–1.

<sup>g</sup> Abdel Haleem, *Understanding the Qur'an*, kap. 9.

<sup>31</sup> Ne do të merremi me ju dy ushtritë e mëdha<sup>b</sup> [të xhindeve dhe të njerëzimit]. <sup>32</sup> Pra, cilat nga bekimet e Zotit tuaj i refuzoni ju dy?

<sup>33</sup> Xhinde dhe njerëzim, nëse mund të kaloni përtej rajoneve të qiellit dhe tokës, bëjeni: nuk do të kaloni pa autoritetin Tonë. <sup>34</sup> Pra, cilat nga bekimet e Zotit tuaj i refuzoni ju dy?

<sup>35</sup> Një flakë e zjarrit dhe e tymit do të lëshohet mbi ju dhe askush s'do t'ju vijë në ndihmë. <sup>36</sup> Pra, cilat nga bekimet e Zotit tuaj i refuzoni ju dy?

<sup>37</sup> Kur qielli të copëtohet dhe të bëhet i kuqërremtë, si gëzofi i kuq. <sup>38</sup> Pra, cilat nga bekimet e Zotit tuaj i refuzoni ju dy?

<sup>39</sup> Në atë Ditë as njerëzimi as xhindet nuk do të pyeten për mëkatet e tyre. <sup>55:40</sup> Pra, cilat nga bekimet e Zotit tuaj i refuzoni ju dy?

<sup>41</sup> Fajtorët do të njihen nga shenja e tyre dhe do të mbërthehen për ballët dhe këmbët e tyre. <sup>42</sup> Pra, cilat nga bekimet e Zotit tuaj i refuzoni ju dy?

<sup>43</sup> Ky është Ferri që e refuzojnë fajtorët, <sup>44</sup> por do të rrotullohen ndërmjet flakëve të tij dhe ujit përvëlues. <sup>45</sup> Pra, cilat nga bekimet e Zotit tuaj i refuzoni ju dy?

<sup>46</sup> Për ata që ia kanë frikën [kohës kur do] të qëndrojnë para Zotit të tyre ka dy kopshte. <sup>47</sup> Pra, cilat nga bekimet e Zotit tuaj i refuzoni ju dy?

<sup>48</sup> Me degë hijezuese. <sup>49</sup> Pra, cilat nga bekimet e Zotit tuaj i refuzoni ju dy?

<sup>55:50</sup> Me një çift të burimeve rrjedhëse. <sup>51</sup> Pra, cilat nga bekimet e Zotit tuaj i refuzoni ju dy?

<sup>52</sup> Me çdo lloj fruti në çifte. <sup>53</sup> Pra, cilat nga bekimet e Zotit tuaj i refuzoni ju dy?

<sup>54</sup> Do të ulen në divane të veshura me pëlhurë të mirë me ornamente, fruta të të dy kopshteve që kapen lehtë. <sup>55</sup> Pra, cilat nga bekimet e Zotit tuaj i refuzoni ju dy?

<sup>56</sup> Do të ketë vasha që i përmbajnë shikimet e tyre, të paprekura më parë nga njeriu a xhindi. <sup>57</sup> Pra, cilat nga bekimet e Zotit tuaj i refuzoni ju dy?

---

<sup>a</sup> Fjalë për fjalë 'në ndonjë çështje'. Profetin e pyetën: 'Çka është kjo çështje?'. Ai u përgjigj: 'Ai e fal një mëkat apo e heq një shqetësim.'

<sup>b</sup> *Thakal* është ushtri e fuqishme apo e rëndë: të gjitha forcat e tyre.



<sup>58</sup> Si rubinët dhe perlat e shkëlqyeshme. <sup>59</sup> Pra, cilat nga bekimet e Zotit tuaj i refuzoni ju dy?

<sup>55:60</sup> A do të jetë shpërblimi i së mirës gjë tjetër pos i mirë? <sup>61</sup> Pra, cilat nga bekimet e Zotit tuaj i refuzoni ju dy?

<sup>62</sup> Janë dy kopshte të tjera në këto dyja.<sup>a</sup> <sup>63</sup> Pra, cilat nga bekimet e Zotit tuaj i refuzoni ju dy?

<sup>64</sup> Të dy prej të gjelbrës më të thellë. <sup>65</sup> Pra, cilat nga bekimet e Zotit tuaj i refuzoni ju dy?

<sup>66</sup> Me një çift të burimeve gufuese. <sup>67</sup> Pra, cilat nga bekimet e Zotit tuaj i refuzoni ju dy?

<sup>68</sup> Me fruta – palma të hurmës dhe pemë shegësh. <sup>69</sup> Pra, cilat nga bekimet e Zotit tuaj i refuzoni ju dy?

<sup>55:70</sup> Ka vasha të këndshme, miqësore e të bukura. <sup>71</sup> Pra, cilat nga bekimet e Zotit tuaj i refuzoni ju dy?

<sup>72</sup> Me sy të errët, të strehuara në tenda të zbukuruara. <sup>73</sup> Pra, cilat nga bekimet e Zotit tuaj i refuzoni ju dy?

<sup>74</sup> Të paprekura më parë nga njeriu a xhindi. <sup>75</sup> Pra, cilat nga bekimet e Zotit tuaj i refuzoni ju dy?

<sup>76</sup> Të gjithë do të ulen në shilte të gjelbra dhe qilima cilësorë. <sup>77</sup> Pra, cilat nga bekimet e Zotit tuaj i refuzoni ju dy? <sup>78</sup> I bekuar është emri i Zotit tuaj, plot madhështi, që dhuron nder.

---

<sup>a</sup> Parajsa ekziston në dy shkallë: niveli më i lartë për ata që janë favorizuar vërtet dhe ky nivel më i ulët i përshkruar për të devotshmit më pak të lartësuar. Kjo kozmologji e ferrit, e parajsës së poshtme, parajsës së sipërme përsëritet në suren vijuese: 56:7-56.

**Përshkrimi para kaptinës 55 nga Abdel Haleem:**

*Sure medinase që i thekson mrekullitë e Allahut në këtë botë, e përshkruan fundin e botës dhe e përshkruan një pamje shumë të qartë e të fuqishme të kënaqësive të Parajsës. Ferri kontrastohet shkurtimisht (vargjet 43-4) me gëzimet që i presin të ndershmit. Surja karakterizohet me refrenin ‘Pra, cilat nga bekimet e Zotit tuaj i refuzoni ju dy?’ që e përshkon atë. Surja i ndan njerëzimin dhe xhindet në tri klasa: mosbesimtarët (vargjet 41-5), më të mirët e besimtarëve (vargjet 46-61) dhe besimtarët e zakonshëm (vargjet 62-77).*

## 56: Ajo që po vjen (EL-UÂKI‘A)

Në emrin e Allahut, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës

<sup>1</sup> Kur të arrijë ajo që po vjen, <sup>2</sup> askush nuk do të jetë në gjendje ta mohojë se ka ardhur, <sup>3</sup> disa duke i ulur poshtë e disa duke i ngritur lart. <sup>4</sup> Kur toka të dridhet fort <sup>5</sup> dhe malet të thërrmohen në rërë <sup>6</sup> e të kthehen në pluhur të shpërhapur, <sup>7</sup> pastaj do të ndaheni në tri klasa. <sup>8</sup> Ata në të Djathtë – çfarë njerëz që janë! <sup>9</sup> Ata në të Majtë – çfarë njerëz që janë! <sup>56:10</sup> Dhe ata në pjesën e përparme – vërtet përpara! <sup>11</sup> Se këta do të jenë ata që sillen më së afërmi Allahut <sup>12</sup> në Kopshtet e Lumturisë: <sup>13</sup> shumë nga e shkuara <sup>14</sup> dhe ca nga brezat e mëvonshëm. <sup>15</sup> Në divane me pëlhurë të endur mirë <sup>16</sup> do të ulen përballë njëri-tjetrit; <sup>17</sup> të rinj të përhershëm do t’u sillen përreth <sup>18</sup> me gota, shtamba e kupa me një pije të pastër <sup>19</sup> që nuk shkakton as kokëdhembje as dehje; <sup>56:20</sup> [do të ketë] çfarëdo fruti që e zgjedhin; <sup>21</sup> mishi i çfarëdo shpendi që u pëlqen; <sup>22</sup> dhe shoqërues-e të bukur-a <sup>23</sup> si perla të fshehura: <sup>24</sup> shpërblim për atë që e kanë bërë dikur. <sup>25</sup> Nuk do të dëgjojnë asnjë bisedë boshe a mëkatore aty, <sup>26</sup> veç të folur të pastër e të dobishëm.<sup>a</sup>

<sup>27</sup> Ata në të Djathtë, çfarë njerëz që janë! <sup>28</sup> Do të banojnë mes pemëve të lotuseve pa gjemba <sup>29</sup> dhe akacieve të tufëzuara <sup>56:30</sup> me hije të gjerë, <sup>31</sup> ujë që rrjedh vazhdimisht, <sup>32</sup> fruta të bollshme, <sup>33</sup> të pandryshueshme, të pandaluara, <sup>34</sup> me shoqërues-e të pakrahasueshëm-e<sup>b</sup> <sup>35</sup> që Ne i kemi krijuar posaçërisht – <sup>36</sup> të virgjër-a, <sup>37</sup> të dashur-a, të moshës së përputhshme – <sup>38</sup> për ata në të Djathtë, <sup>39</sup> shumë nga e shkuara <sup>56:40</sup> dhe shumë nga brezat e mëvonshëm.

<sup>41</sup> Por ata në të Majtë, çfarë njerëz që janë! <sup>42</sup> Do të banojnë midis erës përcëlluese dhe ujit përvëlues <sup>43</sup> në hijen e tymit të zi, <sup>44</sup> as i ftohtë as freskues. <sup>45</sup> Më parë, u tej-llastuan në luks <sup>46</sup> dhe ishin vazhdimisht në mëkat të madh, <sup>47</sup> gjithmonë duke thënë: ‘Çka? Kur të kemi vdekur dhe të jemi bërë pluhur e eshtra, do të ngritemi prapë?’ <sup>48</sup> Edhe para-ardhësit tanë të mëhershëm?’ <sup>49</sup> Thuaj [Profet]: ‘Brezat më të hershëm dhe më të vonshëm <sup>56:50</sup> do t’i mbledhin të gjithë në një Ditë të paracaktuar <sup>51</sup> dhe ju që keni devijuar dhe e keni refuzuar të vërtetën <sup>52</sup> do të hani nga pema e hidhur e Zekumit, <sup>53</sup> duke e mbushur barkun me të, <sup>54</sup> dhe do të pini ujë përvëlues, <sup>55</sup> duke e lëpirë me gjuhë si deve të etura.’ <sup>56</sup> Kjo do të jetë mirëseardhja e tyre në Ditën e Gjykimit.

<sup>57</sup> Ishte Ai që ju krijoi: a nuk do të besoni? <sup>58</sup> Mendojeni [spermën] që e gufoni – <sup>59</sup> a e krijoni vetë apo jemi Ne Krijuesi? <sup>56:60</sup> Ne e paracaktuam vdekjen të jetë midis jush. Asgjë s’do të mund të na ndalte <sup>61</sup> po të synonim t’ju ndryshonim e

<sup>a</sup> *Selam* këtu përdoret si mbiemër (Razi). Një interpretim tjetër është ‘Paqe! Paqe!’

<sup>b</sup> Alternativisht ‘divanë të ngritur lart’. Shih Razin për të dy këto interpretime.

t'ju rikrijonim në një mënyrë të panjohur për ju. <sup>62</sup> Keni mësuar se si u krijuat për herë të parë: a nuk do të reflektoni? <sup>63</sup> Mendojini farat që i mbillni në tokë – <sup>64</sup> a jeni ju që i bëni të rriten apo Ne? <sup>65</sup> Po të donim, do të mund t'ju shndërronim të korrat në byk dhe t'ju linim të vajtonit: <sup>66</sup> 'Jemi të ngarkuar me borxhe; <sup>67</sup> jemi shkret.' <sup>68</sup> Mendojeni ujin që e pini – <sup>69</sup> a ishit ju që e zbritët nga reja e shiut apo Ne? <sup>56:70</sup> Po të donim, do të mund ta bënim të hidhur: a nuk do të jeni falënderues? <sup>71</sup> Mendojeni zjarrin që e ndizni – <sup>72</sup> a jeni ju që e bëni të rritet drurin për të apo Ne? <sup>73</sup> E bëmë përkujtues dhe të dobishëm për ata që e ndezin,<sup>a</sup> <sup>74</sup> pra [Profet] lavdoje emrin e Zotit tënd, Supremit.

<sup>75</sup> Pasha pozicionet e yjeve – <sup>76</sup> be e fortë, veç po ta dinit – <sup>77</sup> ky është vërtet Kuran fisnik, <sup>78</sup> në Regjistër të mbrojtur <sup>79</sup> të cilin mund ta prekin veç të pastruarit, <sup>56:80</sup> i zbritur nga Zoti i tërë qenies. <sup>81</sup> Si mund ta përbuzni këtë deklaratë? <sup>82</sup> Dhe si, në këmbim të jetesës që ju është dhënë, mund ta refuzoni? <sup>83</sup> Kur shpirti i një njeriu që po vdes i ngjitet te fyti <sup>84</sup> gjersa vështroni – <sup>85</sup> Ne jemi më afër tij sesa ju, megjithëse nuk na shihni – <sup>86</sup> përse, nëse nuk do të gjykoheni, <sup>87</sup> nuk ia ktheni atij shpirtin e tij, nëse ajo që e thoni është e vërtetë? <sup>88</sup> Nëse ai person që po vdes është një nga ata që do të sillen afër **Allahut**, <sup>89</sup> do të ketë pushim, rehati dhe një Kopsht të Lumturisë; <sup>56:90</sup> nëse është një nga ata në të Djathtë, <sup>91</sup> [do të dëgjojë:] 'Paqja qoftë mbi ty', nga shoqëruesit e tij në të Djathtë; <sup>92</sup> por nëse është një nga ata që e refuzuan të vërtetën dhe devijuan <sup>93</sup> do të mirëpritet me ujë përvëlues. <sup>94</sup> Do të digjet në Ferr.

<sup>95</sup> Kjo është e vërteta e sigurt: <sup>96</sup> [Profet,] lavdoje emrin e Zotit tënd Supremit.

---

<sup>a</sup> Ky interpretim i *mukuin* përkrahet nga Razi. Alternativat për 'ata që e ndezin' janë 'banorët e shkretëtirës' apo 'udhëtarët'.

**Përshkrimi para kaptinës 56 nga Abdel Haleem:**

*Sure mekase mesazhi qendror i së cilës thuhet në vargjet e saj hyrëse, nga të cilat e merr titullin: Dita e Gjykimit është e pashmangshme dhe do t'i klasifikojë njerëzit në të poshtëruarit dhe ata që shpërblehen begatshëm. Si në suren e mëparshme, njerëzit ndahen në tri klasa: ata të sjellurit afër **Allahut** (më të mirët nga besimtarët), ata në të djathtë (besimtarët e zakonshëm) dhe ata në të majtë (mosbesimtarët). Jepet provë e bollshme për fuqinë e **Allahut** dhe rrjedhimisht për aftësinë E Tij ta shkaktojë Ringjalljen (vargjet 57-72).*

## 57: Hekuri (EL-HADÎD)

Në emrin e **Allahut**, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës

<sup>1</sup> Gjithçka në qiej e në tokë e lavdon **Allahun** – Ai është I Gjithë-Fuqishmi, I Gjith'-Urti. <sup>2</sup> Kontrolli i qiejve e i tokës i përket Atij; Ai jep jetë dhe vdekje; ka pushtet ndaj të gjitha gjërave. <sup>3</sup> Është I Pari dhe I Fundit<sup>a</sup>; i Jashtmi dhe i Brendshmi; ka dije për të gjitha gjërat. <sup>4</sup> Ishte Ai që i krijoi qiejt dhe tokën për gjashtë Ditë dhe pastaj e vendosi Vetën në fron. Ai e di se çka futet në tokë dhe çka del nga ajo; çka bie nga qielli dhe çka ngritet në të. Është me ju kudoqofshi; i sheh krejt ato që i bëni; <sup>5</sup> kontrolli i qiejve dhe i tokës i përket Atij. Gjithçka i kthehet **Allahut**. <sup>6</sup> Ai e bën natën të shkrihet në ditë dhe ditën në natë. E di se çka ka në çdo zemër.

<sup>7</sup> Besoni në **Allahun** dhe në Të Dërguarin E Tij dhe shpërndani nga ajo që Ai ka bërë të bartet ndër breza deri te ju: ata nga ju që besojnë dhe që japin do të kenë shpërblim të madh. <sup>8</sup> Pse do të duhej të mos besonit në **Allahun** kur I Dërguari ju thërret të besoni në Zotin tuaj dhe Ai tashmë ka bërë zotim<sup>b</sup> me ju, nëse keni besim? <sup>9</sup> Është Ai që i ka zbritur shpallje të qarta Shërbyesit Të Tij, që të mund t'ju nxjerrë nga thellësitë e errësirës në dritë; **Allahu** është vërtet i dashur dhe mëshirëplotë ndaj jush. <sup>57:10</sup> Pse nuk do të duhej të jepnit për kauzën e **Allahut** kur **Allahu**, i vetëm, do ta trashëgojë atë që është në qiej e në tokë? Ata që dhanë dhe luftuan para triumfit<sup>c</sup> nuk janë si të tjerët: janë më të mëdhenj në gradë se sa ata që dhanë dhe luftuan më vonë. Por **Allahu** u ka premtuar shpërblim të mirë të gjithë atyre: **Allahu** është plotësisht i informuar për gjithçka që bëni.

<sup>11</sup> Kush do t'i japë **Allahut** hua të mirë? Ai do t'ia dyfishojë dhe do ta shpërblejë bujarisht. <sup>12</sup> Në Ditën kur [ti Profet] i sheh besimtarët, edhe burrat edhe gratë, me dritën e tyre duke ndriçuar para tyre dhe djathtas tyre, [do t'u thuhet:] 'Lajmi i mirë për ju sot është se ka Kopshte të hijeshuara me lumenj rrjedhës ku do të rrini: ky është vërtet triumfi suprem!' <sup>13</sup> Në Ditën e njëjtë, hipokritët, edhe meshkujt edhe femrat, do t'u thonë besimtarëve: 'Na pritni! Të kemi ca nga drita juaj!' Do t'u thuhet: 'Kthehuni dhe kërkojeni një dritë.' Ndërmjet tyre do të ngritet një mur me një derë: brenda saj qëndron mëshira, jashtë qëndron vuajtja. <sup>14</sup> Hipokritët do t'u thërrasin besimtarëve: 'A s'ishim me ju?' Ata do të përgjigjen: 'Po. Por e lejuat veten të josheni, ishit të lëkundur, plot dyshim, të mashtruar nga shpresa të rreme deri kur erdhi urdhri i **Allahut** –

---

<sup>a</sup> Teologët shtojnë, 'pa fillim dhe pa fund'.

<sup>b</sup> Shih 7:172.

<sup>c</sup> Kapitullimi i Meka-s.

Mashtruesi ju bëri dredhi në lidhje me **Allahun**.<sup>15</sup> Sot nuk do të pranohet asnjë shpërblesë për çlirim nga ju apo nga mosbesimtarët: shtëpia juaj është Zjarri – aty përkisni – destinacion i mjerë!<sup>16</sup>

<sup>16</sup> A s'është koha që besimtarët t'i përuhin zemrat në kujtim të **Allahut** dhe Të Vërtetës që është shfaqur, e jo të jenë si ata që e pranuan Librin para tyre, koha e të cilëve ishte zgjatur por zemrat e të cilëve u ngurtësuan dhe shumë nga të cilët ishin shkelës të ligjit?<sup>17</sup> Kujtojeni që **Allahu** e rigjallëron tokën pasi të vdesë; Ne jua kemi bërë shpalljen Tonë të qartë ashtu që të mund ta përdorni arsyen.<sup>18</sup> Burrat e gratë bamirëse që i japin **Allahut** hua të mirë do t'u dyfishohet dhe do të kenë shpërblim bujar.<sup>19</sup> Ata që besojnë në **Allahun** dhe në të dërguarit E Tij janë të vërtetët që do të dëshmojnë para Zotit të tyre: do ta kenë shpërblimin e tyre dhe dritën e tyre. Por ata që nuk besojnë dhe i refuzojnë shpalljet Tona janë banorë të Ferrit.<sup>57:20</sup> Mbani mend se jeta e tanishme është veç lojë, argëtim, atraksion, shkak i mburrjes ndërmjet jush, e i konkurrencës në pasuri e në fëmijë. Është si bimët që gufojnë pas shiut: rritja e tyre në fillim u jep kënaqësi mbjellësve, por pastaj i shihni tek vyshken, zverdhen dhe bëhen kashtë. Ka ndëshkim të tmerrshëm në jetën tjetër si dhe falje e miratim nga **Allahu**; jeta e kësaj bote është veç kënaqësi iluzore.<sup>21</sup> Pra shpejtoni me vrull për falje nga Zoti juaj dhe për Kopsht të gjerë sa qiejt e toka, të përgatitur për ata që besojnë në **Allahun** dhe në të dërguarit E Tij: kjo është bujaria e **Allahut**, që ia dhuron kujt të dojë. Bujaria e Zotit është e pafund.

<sup>22</sup> Asnjë fatkeqësi s'mund të ndodhë, as në tokë as në ju, që nuk është shpallur me shkrim para se Ne ta kemi sjellë në qenie – kjo është e lehtë për **Allahun** –<sup>23</sup> prandaj nuk keni nevojë të vleroseni për atë që ju mungon apo të mburreni me lumturi për atë që e fitoni.<sup>24</sup> **Allahu** nuk i do kryelartët, mburracakët, ata që janë dorështrënguar dhe që u thonë njerëzve tjerë të jenë dorështrënguar. Nëse kushdo largohet, kujtojeni se **Allahu** është i vetë-mjaftueshëm dhe i denjë për lavd.<sup>25</sup> Ne i çuam të dërguarit Tanë me shenja të qarta, me Librin dhe me Balansin, që njerëzit të mund ta mbështesin drejtësinë: po ashtu e dërguam hekurin, me forcën e tij të fuqishme dhe me shumë dobi për njerëzimin, që **Allahu** të mund t'i ndante mënjanë ata që do t'i ndihmonin Atij dhe të dërguarve Të Tij megjithëse nuk mund ta shohin Atë.<sup>a</sup> Vërtet **Allahu** është i plot-fuqishëm, i gjithë-mundshëm.

<sup>26</sup> Ne e dërguam Nuhun dhe Ibrahimin dhe u dhamë pasardhësve të tyre profetësi dhe shkrime të shenjta: ndër ta ishin disa që ishin udhëzuar si duhet, por shumë nga ta ishin shkelës të ligjit.<sup>27</sup> Ne çuam të dërguar të tjerë t'i ndiqnin gjurmët e tyre. Pas tyre e çuam Isain, të birin e Merjemes: ia dhamë Ungjillin dhe vumë dhembshuri e mëshirë në zemrat e ndjekësve të tij. Por murgëria ishte

---

<sup>a</sup> Kjo do të mund t'i aplikohet Zotit apo ndihmuesve Të Tij

diçka që e shpikën – nuk ua kemi urdhëruar – veç të kërkohet<sup>a</sup> kënaqësia e **Allahut**, dhe megjithatë, nuk e kanë zbatuar siç duhet. Kështu u dhamë shpërblim atyre - nga ta - që besuan, por shumë nga ta ishin shkelës të ligjit.

<sup>28</sup> Besimtarë, jini të vetëdijshëm për **Allahun** dhe kini besim në Të Dërguarin E Tij: Ai do t’ju japë hise të dyfishtë nga mëshira E Tij; do të japë dritë që t’ju ndihmojë të ecni; do t’ju falë – **Allahu** është më falësi, më mëshirëploti.

<sup>29</sup> Njerëzit e Librit duhet ta dinë se nuk kanë pushtet ndaj ndonjë mirësie të **Allahut** dhe se mirësia është veç në dorën e **Allahut**: Ai ia jep atë kujt do që do t’ia japë. Mirësia e **Allahut** është vërtet gjigante.

---

<sup>a</sup> Alternativisht, ‘vetëm që do të duhej ta kërkonin’



**Përshkrimi para kaptinës 57 nga Abdel Haleem:**

*Sure medinase që i nxit besimtarët të shpenzojnë në kauzën e Allahut dhe ta mbështesin drejtësinë – surja e merr titullin nga hekuri i përmendur në vargun 25. Pohohet gjithëpërhapësia e fuqisë, e dijes, e kontrollit dhe e lavdisë së Allahut për t'i nxitur besimtarët për veprim të duhur dhe përshkruhet fati i hipokritëve. Përmenden profetët e mëparshëm (vargjet 26-7), veçanërisht Nuhi, Ibrahimimi dhe Isai, duke e treguar përgjigjen që e morën. Surja mbyllet me referim të Njerëzve të Librit.*

*Hekuri*

NË EMRIN E **ALLAHUT**, DASHAMIRËSIT, MËSHIRËPLOTIT

(1-10)

Gjithçka në gjithësi  
e lavdon **Allahun**,  
se **Allahu** është i plot-fuqishëm, i gjith’-urtë.

**I Allahut** është kontrolli  
i qiejve dhe i tokës:  
**Allahu** jep jetë dhe **Allahu** vret;  
dhe **Allahu** ka fuqi  
ndaj të gjitha gjërave.

**Allahu** është i pari dhe i fundit,  
e shfaqura dhe e fshehura:  
dhe **Allahu** ka dije të plotë  
për të gjitha gjërat.

**Allahu** është Ai që i krijoi  
qiejt dhe tokën  
për gjashtë ditë,  
pastaj u ul vendosmërisht në Fron.  
**Allahu** e di çka shkon në tokë  
dhe çka del nga ajo;  
çka zbret nga qielli,  
dhe çka ngritet në të.  
Dhe **Allahu** është me të gjithë ju  
kudoqofshi:  
dhe **Allahu** sheh se çka bëni.

**Allahut** i përket kontrolli  
i qiejve dhe i tokës:  
dhe të gjitha çështjet  
kthehen te **Allahu**.

**Allahu** e bën natën të futet në ditë,  
dhe ditën të futet në natë;  
dhe Zoti e di  
çka ka në të gjitha zemrat.

Besoni në **Allahun**  
dhe në Të Dërguarin e **Allahut**,  
dhe shpenzoni nga ajo  
për të cilën Ne ju bëmë trashëgimtarë:  
për ata ndër ju  
që besojnë dhe që shpenzojnë  
ka shpërblim të madh.

Si është puna me ju  
që nuk besoni në **Allahun**  
dhe në Të Dërguarin që ju thërret  
për të besuar në Zotin tuaj?  
Se **Allahu** tashmë e ka marrë pajtimin tuaj  
në qofshi besimtarë të vërtetë.

Është **Allahu** që i zbret  
shërbyesit të hyjnores  
shenja të dukshme  
për t'ju nxjerrë  
nga errësira në dritë.  
Dhe sigurisht **Allahu** është në fakt  
i dashur dhe mëshirëplotë ndaj jush.  
Dhe si është puna me ju

që nuk shpenzoni në rrugën e **Allahut**,  
megjithëqë i **Allahut** është trashëgimi  
i qiejve dhe i tokës?  
Të pabarabartë ndër jush  
janë ata që harxhuan dhe luftuan  
para fitores:  
ata janë më të mëdhenj në gradë  
se sa ata që harxhuan dhe luftuan më vonë.  
Por secilit **Allahu** i ka premtuar përfitim;  
dhe **Allahu** është plotësisht i informuar  
për gjithçka që bëni.

(11-19)

Kush është ai që do t'i japë  
hua të drejtë **Allahut**:  
për të cilin **Allahu** do ta ridyfishojë atë,  
dhe për të cilin ka shpërblim fisnik.

Një ditë do t'i shohësh  
burrat besimplotë dhe gratë besimplota,  
dritën e tyre tek ndriçon para tyre  
dhe kah duart e tyre të djathta:  
“Lajme të mira për ju sot:  
një Kopsht  
nën të cilin rrjedhin lumenj,  
të rroni përgjithmonë aty.”  
Ky është Suksesi Më i Madh.

Një ditë hipokritët, burrat e gratë,  
do t'u thonë besimtarëve të vërtetë,  
“Na pritni,  
që të mund të huazojmë  
nga drita juaj.”  
Do të thuhet,  
“Kthehuni prapa jush  
për të kërkuar dritë,”  
gjersa një mur do të ngrehet  
ndërmjet tyre dhe saj,  
me një derë aty,  
brenda saj mëshirë;  
gjersa jashtë, para saj,  
vuajtje.

Ata do t'i thërrasin,  
“A s'ishim me ju?”  
Ata do të thonë,  
“Po, vërtet, por  
e joshët veten tuaj,  
pritët të fshehur dhe dyshuat,  
dhe meraket ju mashtruan,  
deri kur erdhi urdhri i **Allahut**,  
dhe Mashtruesi ju mashtroi  
për **Allahun**.

“Pra sot asnjë shpërblese për çlirim  
nuk do të pranohet nga ju,  
as nga mosmirënjohësit që nuk besojnë.  
Vendi juaj është zjarri;  
ai është padroni juaj,  
dhe çfarë destinacioni i mjerë!”  
A nuk ka ardhur koha

për ata që besojnë  
që zemrat e tyre duhet t'i përuken  
kujtimit të **Allahut**  
dhe pjesës që **Allahu** e ka shfaqur nga E Vërteta;  
dhe që do të duhej të mos ishin si ata  
të cilëve Libri u është dhënë më parë  
por epokat u zgjatën kaq shumë për ta  
sa që zemrat iu ngurtësuan  
dhe shumë nga ta ishin të shthurur moralisht.

Dijeni që **Allahu** e gjallëron tokën  
pasi të ketë vdekur:  
Ne tashmë ua kemi bërë të qarta shenjat,  
që të mund të kuptoni.

Për burrat që japin lëmoshë  
dhe gratë që japin lëmoshë  
dhe i japin **Allahut** hua të drejtë,  
ajo do të shumëfishohet për ta,  
dhe i tyri është shpërblim fisnik.

Dhe ata që besojnë në **Allahun**  
dhe në Të Dërguarit e **Allahut**,  
ata janë të vërtetët  
dhe dëshmitarët  
në prezencën e Zotit të tyre  
Ata e kanë shpërblimin e tyre  
dhe përndritjen e tyre.  
Dhe ata që s'besojnë  
dhe i refuzojnë shenjat Tona,  
janë banorë të zjarrit të ferrit.

(20-25)

Dijeni se jeta e botës  
është veç argëtim harrues dhe largim i vëmendjes  
salltanet dhe konkurrencë për lavdi ndërmjet jush,  
dhe mundim për sa më shumë pasuri e fëmijë.  
Është si shembulli i shiut,  
bima prej të cilit i kënaq bujqit,  
pastaj vyshket dhe e shihni të zverdhet:  
pastaj thërrmohet.  
Dhe në fund  
është vuajtje e ashpër,  
dhe falje nga **Allahu**,  
dhe pranim.  
Dhe ç'është jeta e botës  
pos material i mashtrimit?

Shpejtoni me vrull për falje  
nga Zoti juaj  
dhe kah një Kopsht  
i gjerë sa qielli e toka,  
i përgatitur për ata që besojnë  
në Zotin dhe në Të Dërguarit e **Allahut**;  
kjo është mirësia e **Allahut**,  
që i dhurohet kujt vendos **Allahu**.  
Dhe **Allahu** e ka Mirësinë Më Të Madhe.

Asnjë vuajtje nuk do të godasë  
në tokë apo në shpirtrat tuaj  
e që s'është në një Libër  
para se Ne ta krijojmë.  
Vërtet kjo është e lehtë për **Allahun**,  
ashtu që të mos pikëlloheni  
për atë që ju largohet,

dhe as të mos ngazëlleheni  
për atë që ju ka ardhur.  
Se **Allahu** nuk e do  
asnjë mburravec kryelartë,

as ata që janë koprracë  
dhe i shtyjnë të tjerët në koprraci.  
Dhe nëse cilëtdo largohen,  
epo, **Allahu** është i vetë-mjaftueshëm,  
Ai që e meriton tërë lâvdin.

Ne i kemi çuar të dërguarit Tanë  
me qartësime:  
dhe e dërguam me ta  
Librin dhe Barabarin,  
që njerëzimi të mund t'i mbahet drejtësisë.  
Dhe e dërguam hekurin,  
në të cilin ka forcë të fuqishme,  
dhe përparësi për njerëzimin,  
që **Allahu** të mund ta dijë  
kush do të jetë ndihmues  
ndaj **Allahut** dhe Të Dërguarve të **Allahut**,  
edhe pse janë të padukshëm  
Vërtet **Allahu** është i gjithë-fuqishëm, i gjithë-mundshëm.



(26-29)

Dhe Ne e zbritëm Nuhun dhe Ibrahimin,  
dhe vendosëm ndër pasardhësit e tyre  
profeci dhe Librin,  
pra ca nga ta ishin të udhëzuar;  
por shumë nga ta ishin të shturur moralisht.

Pastaj çuam Të Dërguar Tanët  
për të vazhduar pas tyre:  
e dërguam Isain të birin e Merjemes,  
duke ia dhënë Ungjillin;  
dhe vumë dhembshuri e mëshirë  
në zemrat e atyre që e ndoqën.  
Por murgëria  
që e shpikën për vete  
nuk ishte urdhëruar nga Ne për ta:  
veç kërkimi i kënaqësisë së **Allahut**.  
Dhe nuk e zbatuan  
si duhej të zbatohej vërtet.  
E prapë ua dhamë atyre  
ndër ta që besuan  
shpagimin e tyre;  
gjersa shumë nga ta janë devijues.

Besimtarë të vërtetë,  
jini të vëmendshëm për **Allahun**  
dhe besojeni Të Dërguarin e **Allahut**:  
**Allahu** do t'ju japë hise të dyfishtë  
të hyjnores mëshirë  
dhe do t'ju japë dritë  
nëpër të cilën të ecni;  
dhe **Allahu** do t'ju falë.  
Dhe **Allahu** është shembulli më i lartë  
i faljes dhe i mëshirës:

që njerëzit e Librit  
të mund ta dinë se nuk kanë fuqi  
ndaj asgjëje nga mirësia e **Allahut**;  
dhe se mirësia  
është në dorën e **Allahut**,  
që ia jep atë kujt do që vendos.  
Dhe **Allahu** e ka Mirësinë e Madhe.

**Shënimet gjuhësore (Thomas Cleary)**

Kjo sure ishte shpallur në Medinë.

- 3 “e shfaqura dhe e fshehura” (*adh Dhaahir w al Baatîn*): Kjo mund të përkthehet edhe “Më I Jashtmi dhe Më i Brendshmi:”
- 7 “për ata ndër ju që besojnë dhe që shpenzojnë”: Të “shpenzohet” në këtë kontekst domethënë të shpenzohet – nga ajo që njeriu e ka – në bamirësi apo në punë të tjera të mira; nganjëherë kësaj i referohemi si “shpenzimi në rrugën e Zotit.” Kjo përdorje është goxha e përhapur në Kuran, duke e ilustruar rëndësinë e kontribuimit në balansin dhe mirëqenien e shoqërisë.
- 8 “në qofshi besimtarë të vërtetë”: Të besosh dhe të kesh besim në Zot është, ipso facto (pashmangshëm), tashmë të marrësh pjesë në gjendje të parapërgatitur të mirësisë.
- 8/10 “Si është puna me ju . . .”: Apo, “Pse nuk . . . ?” apo “Çka ju pengon të . . .?”
- 11 E theksoj kuptimin e “fisnik” për *kariim* këtu se bujaria tashmë është shprehur në pjesën e mëparshme dhe ideja e fisnikërisë sugjeron se as fitimi material as ai shpirtëror nuk është rezultat i veprimeve lakmitare, egoiste.
- 12 “dhe kah duart e tyre të djathta”: Drita do të ndriçojë nga djathtësia (drejtësia) dhe veprat e tyre të mira.
- 13 “Kthehuni prapa jush për të kërkuar dritë” (*rxhi!uu waraa’akum fal tamisuu nuuran*): Apo, “Kthehuni prapa vetë të kërkonit dritë.” Kërkojeni dritën e Zotit jo në projektimet e vetëdijes suaj subjektive por në vetëdijen e Zotit, që është fuqia unike që shtrihet nën gjithësinë dhe çdo gjë të gjallë. Në terma budistë, ky varg e sugjeron fuqishëm praktikën e njohur si “kthimi i vëmendjes mbrapsht për të shikuar prapa” (kinezisht *huiguang fanzhao*), në të cilën njeriu e zhvendos fokusin e vëmendjes nga objektet prezente pikërisht në vetë burimin e vetëdijes. Duke e përdorur këtë aktivitet si kornizë interpretuese, “muri” i ngrehur ndërmjet këtyre njerëzve dhe dritës është egoja dhe subjektiviteti i vetëdijes: “dera aty, brenda saj mëshirë” është dorëzimi i egos dhe heqja dorë nga pikëpamjet subjektive dhe lidhja me

objektet; “vuajtja” që është “jashtë, para saj” është ngatërrimi në mendime dhe gjëra që i vijnë ndërmend vetëdijesisë së zakonshme.

- 16 “epokat u zgjatën kaq shumë për ta”: Përgjatë një periudhe të gjatë të kohës, njerëzit e humbën interesimin në shpalljet e lashta, të cilat më nuk i konsideronin relevante.
- 21 Origjinali, pikë për pikë, thotë: “Mirësia e Madhe”, që domethënë shembulli më i lartë i mirësisë, që vjen nga një rend më i lartë i realitetit.
- 27 “Por murgëria të cilën e shpikën për vete nuk ishte e urdhëruar nga Ne për ta”: Kurani nuk e urdhëron murgërinë dhe Profeti Muhamed po ashtu thoshte se nuk do të duhej të kishte jetë murgu në Islam.

## 58: Polemika (EL-MUXHÂDILE)

Në emrin e **Allahut**, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës

<sup>1</sup> **Allahu** i ka dëgjuar fjalët e gruas që polemizoi me ty [Profet] për burrin e saj dhe iu ankua **Allahut**: **Allahu** e ka dëgjuar atë që kishit për ta thënë ju dy. Ai është gjithë-dëgjuesi, gjithë-pamësi. <sup>2</sup> Edhe nëse dikush nga ju u thotë grave të tyre: ‘Për mua je si shpina e nënës sime’,<sup>a</sup> ato nuk janë nënat tuaja; nënat e tyre të vetme janë ato që i lindën. Ajo që e thonë sigurisht që është e fajshme dhe e rreme, por **Allahu** është falës ndaj gabimeve dhe pendimeve. <sup>3</sup> Ata nga ju që ua thonë një gjë të tillë grave të tyre, e pastaj nuk e bëjnë atë që e kanë thënë, duhet ta lirojnë një skllav-e para se çifti të mund të preken përsëri – këtë urdhëroheni ta bëni dhe **Allahu** është plotësisht i informuar për atë që e bëni – <sup>4</sup> por kushdo që nuk i ka mundësitë duhet të agjërojë dy muaj rresht para se të preken dhe kushdo që nuk është në gjendje ta bëjë këtë duhet t’i ushqejë gjashtëdhjetë njerëz në nevojë. Kjo është kështu që [vërtet] të mund të keni besim në **Allahun** dhe Të Dërguarin E Tij. Këta janë kufijtë e caktuar nga **Allahu**: ata që i injorojnë i pret torturë e pikëllueshme. <sup>5</sup> Ata që i kundërvihen **Allahut** dhe Të Dërguarit Të Tij do të ulen poshtë, si ata para tyre: Ne kemi shpallur mesazhe të qarta dhe ata që i injorojnë i pret torturë poshtëruese <sup>6</sup> në Ditën kur **Allahu** do ta ngrisë secilin dhe t’i bëjë të vetëdijshëm për atë që e kanë bërë. **Allahu** i ka marrë parasysh të gjitha, megjithëse ata mund të kenë harruar: Ai është dëshmitar i gjithçkaje.

<sup>7</sup> A nuk e sheh [Profet] se **Allahu** di gjithçka në qiej dhe në tokë? Nuk ka bisedë të fshehtë midis tre njerëzve ku Ai nuk është i katërti, as ndërmjet pesëve ku Ai nuk është i gjashti, as ndërmjet më pak a më shumë se aq pa qenë Ai me ta, kudo-qofshin. Në Ditën e Ringjalljes, Ai do t’u tregojë se çka kanë bërë: **Allahu** vërtet ka dije të plotë për gjithçka. <sup>8</sup> A nuk e ke parë se si ata që u është ndaluar të mbajnë biseda të fshehta kthehen pastaj dhe i mbajnë, dhe komplotojnë me njëri-tjetrin në atë që është mëkatore, armiqësore dhe me mosbindje ndaj Të Dërguarit? Kur vijnë te ti të përshëndesin me fjalë që **Allahu** nuk i ka përdorur kurrë për të të përshëndetur dhe thonë me vete: ‘Pse nuk na ndëshkon **Allahu** për atë që e themi?’ Ferri do të jetë ndëshkim i mjaftueshëm për ta: do të digjen atje – destinacion i keq.

---

<sup>a</sup> Arabët paganë ndaheshin nga gratë e tyre duke thënë: ‘Për mua je si shpina e nënës sime’, gjë që e privonte gruan nga të drejtat e saj martesore, e megjithatë e pengonte të martohej përsëri. Khaula, e bija e Tha’labës, kundër së cilës ishte deklaruar një formë e tillë e divorcit, iu ankua Profetit dhe ai i tha: ‘Ti je e paligjshme për të tani.’ Kjo shpallje erdhi si rezultat, duke e ndryshuar rregullin për trajtim të tillë mizor të grave (krahaso me 33:4).

<sup>9</sup> Ju që besoni, kur të bisedoni në fshehtësi, mos e bëni këtë në një mënyrë që është mëkatore, armiqësore dhe me mosbindje ndaj Të Dërguarit, por në një mënyrë që është e mirë dhe me vetëdije [për **Allahun**]. Jini të vetëdijshëm për **Allahun**, tek I Cili do të mblidheni të gjithë. <sup>58:10</sup> [Çfarëdo lloji tjetër qoftë,] biseda e fshehtë është vepër e Satanit, e dizajnuar të shkaktojë telashe për besimtarët, megjithëse ajo nuk mund t'i dëmtojë aspak pa e lejuar **Allahu**. Le ta kenë besimtarët besimin e tyre në **Allahun**.

<sup>11</sup> Ju që besoni, nëse ju thuhet t'i bëni vend njëri-tjetrit në kuvendet tuaja, atëherë bëjeni këtë dhe **Allahu** do t'ju bëjë vend dhe nëse ju thuhet të ngriteni, bëjeni këtë: **Allahu** do t'i ngrisë, për shumë shkallë, ata nga ju që besojnë dhe ata që u është dhënë dije: Ai është plotësisht i informuar për atë që e bëni. <sup>12</sup> Ju që besoni, kur vini të flisni privatisht me Të Dërguarin, ofroni diçka në bamirësi para bisedës suaj: kjo është më e mirë për ju dhe më e pastër. Nëse nuk i keni mundësitë, **Allahu** është më falësi dhe mëshirëploti.

<sup>13</sup> A u frikësuar<sup>a</sup> të jepnit bamirësi para se të këshilloheshit me Profetin? Meqë nuk dhatë bamirësi dhe **Allahu** është zbutur ndaj jush, duhet [të paktën] t'i kryeni lutjet tuaja, t'i paguani lëmoshat e përcaktuara dhe t'i bindeni **Allahut** dhe Të Dërguarit Të Tij: **Allahu** është fare mirë i informuar për veprimet tuaja.

<sup>14</sup> A nuk i ke parë [Profet] ata që ua japin besnikërinë e tyre njerëzve me të cilët **Allahu** është i zemëruar? Nuk janë as me ty as me ta dhe me vetëdije betohen në rrena. <sup>15</sup> **Allahu** e ka përgatitur një torturë të ashpër për ta: ajo që e bëjnë është vërtet e ligë. <sup>16</sup> I kanë përdorur betimet e tyre për mbulesë [të veprave të tyre të rreme] dhe i kanë penguar të tjerët nga rruga e **Allahut**. I pret një torturë poshtëruese – <sup>17</sup> as pasuria e tyre as fëmijët e tyre nuk do t'u hyjnë në punë kundër **Allahut** – do të jenë banorë të Ferrit, ku do të mbesin. <sup>18</sup> Në Ditën që **Allahu** i ngrit nga të vdekurit, do të betohen para Tij siç betohen para teje tash, duke menduar se do t'u ndihmojë. Çfarë gënjeshtarë që janë! <sup>19</sup> Satani e ka fituar kontrollin ndaj tyre dhe i ka bërë ta harrojnë **Allahun**. Ata janë në anën e Satanit dhe ana e Satanit do të jenë humbësit: <sup>58:20</sup> ata që i kundërvihen **Allahut** dhe Të Dërguarit Të Tij do të jenë ndër më të poshtëruarit. <sup>21</sup> **Allahu** ka shkruar: 'Sigurisht që do të fitoj, Unë dhe të dërguarit E Mi.' **Allahu** është i plotfuqishëm dhe i gjithëfuqishëm.

---

<sup>a</sup> *Ashfaktum* është në kohën e shkuar. Ka një kalim kohe ndërmjet vargjeve 12 dhe 13 gjatë të cilës ata që e bezdisnin Profetin me pyetje nuk shfaqeshin fare, për shkak se duhej të paguanin bamirësi secilën herë. Vargu 13 e zbuti këtë kërkesë.

<sup>22</sup> [Profet,] nuk do të gjesh njerëz që besojnë vërtet në **Allahun** dhe në Ditën e Fundit duke ia dhënë besnikërinë e tyre atyre që i kundërvihen **Allahut** dhe Të Dërguarit Të Tij, megjithëse mund të jenë etërit e tyre, bijtë, vëllezërit apo lidhje të tjera: këta janë njerëzit në zemrat e të cilëve **Allahu** ka gdhendur besim dhe të cilët i ka forcuar me shpirtin E Tij. Ai do t'i lërë të futen në Kopshte të hijeshuara me lumenj rrjedhës, ku do të rrinë: **Allahu** është shumë i kënaqur me ta dhe ata me Të. Ata janë në anën e **Allahut** dhe ana e **Allahut** do të jetë ajo që do të përparojë.

**Përshkrimi para kaptinës 58 nga Abdel Haleem:**

*Sure medinase që e ndalon një praktikë të veçantë pagane të divorcit: surja e merr titullin nga mosmarrëveshja e përmendur në vargun 1 ndërmjet një gruaje që ishte divorcuar në këtë mënyrë dhe Profetit. Surja e përkrah gruan. Pastaj vazhdon të deklarojë se ata që i kundërvihen **Allahut** dhe të dërguarit **Të Tij**, që fshehurazi bëhen aleatë me Satanin, që gënjejnë në betimet e tyre dhe që bëjnë intriga kundër Profetit – do të mposhten dhe do të vuajnë poshtërim edhe në këtë botë edhe në tjetrën (vargjet 5 dhe 20), gjersa ata që janë në anën e **Allahut** do të triumfojnë (vargu 22).*



## 59: Grumbullimi [i forcave] (EL-HASHR)

Në emrin e **Allahut**, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës

<sup>1</sup> Gjithçka në qiej dhe në tokë e lavdon **Allahun**; Ai është I Gjithë-Fuqishmi, I Urti. <sup>2</sup> Ishte Ai që i dëboi ata Njerëz të Librit që e shkelën besën<sup>a</sup> jashtë shtëpive të tyre në grumbullimin e parë të forcave – [ju besimtarë] nuk menduat kurrë se do të shkonin dhe ata vetë menduan se fortifikimet e tyre do t'i mbronin kundër **Allahut**. **Allahu** u erdhi nga aty ku s'e prisnin dhe vuri panik në zemrat e tyre: shtëpitë e tyre u shkatërruan nga duart e tyre dhe duart e besimtarëve. Mësoni nga kjo, të gjithë ju me njohuri intuitive! <sup>3</sup> Nëse **Allahu** nuk do ta kishte urdhëruar mërgimin për ta, do t'i kishte torturuar [edhe më ashpër] në këtë botë. Në Të Përtejmen do ta kenë torturën e Zjarrit <sup>4</sup> se u bënë kundër **Allahut** dhe Të Dërguarit Të Tij: **Allahu** është i ashpër në ndëshkim ndaj kujtdo që bëhet kundër Tij.

<sup>5</sup> Çkado që [ju besimtarë] mund t'u keni bërë palmave [të tyre] – t'i keni prerë apo t'i keni lënë të qëndrojnë në rrënjët e tyre – është bërë me lejen e **Allahut**, që Ai të mund t'i turpëronte ata që e sfiduan. <sup>6</sup> [Ju besimtarë] nuk kishit pse t'i shponit me mamuze kuajt apo devet tuaja për çfarëdo fitime që **Allahu** ia barti Të Dërguarit Të Tij nga ta. **Allahu** u jep të dërguarve Të Tij autoritet mbi këdo që do t'u japë: **Allahu** ka pushtet ndaj të gjitha gjërave. <sup>7</sup> Çfarëdo fitime që **Allahu** ia ka bartur Të Dërguarit Të Tij nga banorët e fshatrave – i përkasin **Allahut**, Të Dërguarit, farefisit, jetimëve, njerëzve në nevojë, udhëtarit në nevojë – kjo është kështu që ato të mos qarkullojnë veç ndërmjet pasanikëve tuaj – pra pranoni çkado që ju jep I Dërguari dhe abstenoni nga çkado që jua ndalon. Jini të vetëdijshëm për **Allahun**: **Allahu** është i ashpër në ndëshkim.

<sup>8</sup> Mërgimtarët e varfër që u dëbuan nga shtëpitë dhe pasuritë e tyre, që e kërkojnë favorin dhe miratimin e **Allahut**, ata që i ndihmojnë **Allahut** dhe Të Dërguarit Të Tij – këta janë ata që janë besnikë – [do të kenë hise]. <sup>9</sup> Ata që tashmë ishin sistemuar në shtëpitë e tyre [në Medinë] dhe të rrënjësuar fort në besim – shfaqin dashuri për ata që mërguan te ta për strehim dhe nuk ushqejnë kurrfarë merakuri në zemrat e tyre për atë që u është dhënë. Ata u japin përparësi ndaj vetes, edhe në qofshin vetë të varfër: ata që janë shpëtuar nga pangopësia e shpirtrave të tyre janë vërtet të suksesshëm. <sup>59:10</sup> Ata që erdhën pas tyre thonë: 'Zot, na i fal mëkatet tona dhe mëkatet e vëllezërve tanë që besuan para nesh dhe mos lër asnjë ligësi në zemrat tona ndaj atyre që besojnë. Zot, Ti je vërtet dashamirës dhe mëshirëplotë.'

---

<sup>a</sup> Ata ishin të pabesë ndaj marrëveshjeve të tyre me Profetin (shih përmbledhjen e kësaj sureje).

<sup>11</sup> A ke menduar [Profet] për hipokritët që u thonë shokëve të tyre, pjesës së Njerëzve të Librit që janë pa besim: ‘Nëse ju dëbojnë, do të shkojmë me ju – nuk do të bëheshim kurrë me dikë që do t’ju dëmtonte – dhe nëse ju sulmojnë, sigurisht që do t’ju vijmë në ndihmë’ ? **Allahu** është dëshmitar se faktikisht janë gënjeshtarë: <sup>12</sup> nëse i dëbojnë, kurrë nuk do të largohen me ta; nëse i sulmojnë, kurrë nuk do t’u ndihmojnë. Edhe po t’u vinin në ndihmë, së shpejti do të iknin me bisht ndër këmbë – në fund nuk do të kishin ndihmë. <sup>13</sup> Frika nga ju [besimtarë] është më e fortë në zemrat e tyre se sa frika nga **Allahu** se janë popull që u mungon të kuptuarit. <sup>14</sup> Edhe të bashkuar nuk do t’ju luftonin kurrë, përveç nga brenda fortesave të fortifikuara apo prapa mureve të larta. Ka shumë armiqësi ndërmjet tyre: ti mendon se janë të bashkuar por zemrat e tyre janë të ndara se janë njerëz që u mungon arsyeja e shëndoshë. <sup>15</sup> Si ata që sapo shkuan para tyre,<sup>a</sup> e kanë shijuar rezultatin e sjelljes së tyre dhe i pret një ndëshkim i dhembshëm. <sup>16</sup> Posi Satani, që i thotë njeriut: ‘Mos beso!’ por kur njeriu nuk beson, thotë: ‘Nuk të njoh si timin; ia kam frikën **Allahut**, Zotit të Botëve’ – <sup>17</sup> të dytë do të përfundojnë në Zjarr, për të mbetur aty. Ky është shpërblimi i keqbërësve.

<sup>18</sup> Ju që besoni! Jini të vetëdijshëm për **Allahun** dhe çdo shpirt le të mendojë me kujdes për atë se çka çon përpara për nesër; jini të vetëdijshëm për **Allahun**, se **Allahu** është fare mirë i informuar për gjithçka që bëni. <sup>19</sup> Mos jini sikur ata që e harrojnë **Allahun**, andaj **Allahu** i bën t’i harrojnë shpirtat e tyre: këta janë rebelët – <sup>59:20</sup> nuk ka krahasim ndërmjet banorëve të Zjarrit dhe banorëve të Parajsës – dhe banorët e Parajsës janë të suksesshmit. <sup>21</sup> Po t’ia kishim zbritur këtë Kuran një mali, [Profet,] do ta kishe parë të përrulur e të copëtuar në frikë-respektin e tij për **Allahun**: Ne u ofrojmë njerëzve ilustrime të tilla që të mund të reflektojnë.

<sup>22</sup> Ai është **Allahu**: nuk ka zot tjetër pos Tij. Është Ai që e di atë që është e fshehur si dhe atë që është haptas, Ai është Zoti i Mëshirës, Dhënësi i Mëshirës. <sup>23</sup> Ai është **Allahu**: nuk ka zot tjetër pos Tij, Kontrolluesi,<sup>b</sup> I Shenjti, Burim I Paqes, Dhurues I Sigurisë, Ruajtës mbi gjithçka, I Gjithë-Fuqishmi, Detyruesi, Ai që është Vërtet I Madh; **Allahu** është mbi çkado që e konsiderojnë të jetë partner i Tij. <sup>24</sup> Ai është **Allahu**: Krijuesi, Zanafillësi, Formësuesi. Emrat më të mirë i përkasin Atij. Gjithçka në qiej dhe në tokë e lavdon Atë: Ai është I Gjithë-Fuqishmi, I Urti.

---

<sup>a</sup> Kjo me gjasë i referohet Benu Kajnuka-s, një fisi tjetër çifut të dëbuar për shkak të tradhtisë së tyre. Mund t’u referohet edhe paganëve në Bedër.

<sup>b</sup> Apo Mbreti/Sovrani.

**Përshkrimi para kaptinës 59 nga Abdel Haleem:**

*Sure medinase, pjesa më e madhe e së cilës merret se i referohet klanit çifut të Banu al-Nadir, që fillimisht u pajtua me Profetin që nuk do të luftonin as për as kundër tij, e megjithatë, pas disfatës mekase të myslimanëve në Betejën e Uhudit, bënë aleancë me mekasit. Ata u përpoqën edhe ta vrisnin Profetin gjersa ishte në zonën e tyre. Ai u kërkoi të largohen dhe u pajtuan, por Ibn Ubajj, koka e 'hipokritëve' të Medinës, u premtoi se, nëse i luftonin myslimanët, ai dhe kampi i tij do të luftonin me ta (vargjet 11-13), dhe, nëse do t'u duhej ta linin Medinën, ai dhe kampi i tij do të largoheshin me ta. Meqë Banu al-Nadir vazhdimisht i kishte shkelur marrëveshjet, myslimanët i rrethuan në Medinë (në AH 4/626 CE), Ibn Ubajj nuk e mbajti premtimin e tij dhe Banu al-Nadir u pajtuan të largohen, disa duke shkuar në Siri e disa në Khajbar. Në këtë sure, **Allahu** e thekson se çdo fitim ishte vepër **E Tij** dhe kështu duhej të shpërndahej në përputhje me udhëzimet **E Tij** (vargjet 6-10). Fundi i sures, rrjedhimisht, e thekson bindjen dhe frikë-respektin ndaj **Allahut** (vargjet 21-4). Surja e merr emrin nga grumbullimi i forcave në vargun 2.*

## 60: Gratë të sprovuara (EL-MUMTEHINE)

Në emrin e **Allahut**, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës

<sup>1</sup> Ju që besoni, mos i bëni aleatë armiqtë E Mi dhe tuajt, duke u shfaqur miqësi kur e kanë refuzuar të vërtetën që ju ka ardhur [juve] dhe ju kanë dëbuar juve dhe Të Dërguarin thjesht se besoni në **Allahun**, Zotin tuaj<sup>a</sup> – jo nëse vërtet mërguat që të përpiqeni për çështjen Time dhe ta kërkonti kënaqësinë Time të mirë. Ju u shfaqni miqësi fshehtas – Unë e di tërë atë që e fshehni dhe tërë atë që e zbuloni – por kushdo nga ju që e bën këtë po devijon nga rruga e drejtë. <sup>2</sup> Nëse e fitojnë epërsinë ndaj jush, do të rikthehen e të bëhen armiqtë tuaj dhe t'i zgjasin duart e gjuhët e tyre për t'ju dëmtuar; është dëshira e tyre më e ëmbël të hiqni dorë nga besimi juaj.

<sup>3</sup> As farefisi as fëmijët tuaj nuk do t'ju hyjnë në punë në Ditën e Ringjalljes: Ai do t'ju ndajë. **Allahu** sheh gjithçka që bëni. <sup>4</sup> E keni një shembull të mirë tek Ibrahimimi dhe shoqëruesit e tij, kur i thanë popullit të tyre: 'Ju mohojmë juve dhe ata që i adhuronin përveç **Allahut**! Heqim dorë nga ju! Deri kur të besoni veç në **Allahun**, armiqësia dhe urrejtja që ka lindur mes nesh do të vazhdojë!' – përveç kur Ibrahimimi i tha babait të tij: 'Do të lutem për falje për ty edhe pse nuk mund të të mbroj nga **Allahu**' – [ata u lutën:] <sup>5</sup> 'Zot, e kemi mbështetur besimin tonë në Ty; të kthehemi Ty; Ti je destinacioni ynë përfundimtar. Zot, mos na ekspozoj ndaj keqtrajtimit [në duar] të mosbesimtarëve. Falna, Zot, se Ti je I Gjithë-Fuqishmi, I Gjith'-Urti.' <sup>6</sup> Vërtet, janë shembull i mirë për ju [besimtarë] për t'i ndjekur, shembull i mirë për ata që ia kanë frikën **Allahut** dhe Ditës së Fundit. Nëse ndokush largohet, [mbani mend se] **Allahu** është i vetë-mjaftueshëm dhe i denjë për të gjitha lavdet.

<sup>7</sup> **Allahu** prapë mund të sjellë ndjenjë të pëlqimit ndërmjet jush dhe armiqve tuaj aktualë – **Allahu** është i gjithë-fuqishmi, **Allahu** është më falësi dhe mëshirëploti – <sup>8</sup> dhe nuk jua ndalon ta trajtoni këndshëm dhe drejtësisht këdo që nuk ju ka luftuar për besimin tuaj apo t'ju ketë dëbuar nga shtëpitë tuaja: **Allahu** i do të drejtë. <sup>9</sup> Por **Allahu** jua ndalon t'i bëni aleatë ata që kanë luftuar kundër jush për besimin tuaj, ju kanë dëbuar nga shtëpitë tuaja dhe i kanë ndihmuar të tjerët t'ju dëbojnë: cilëtdo nga ju që i bëjnë aleatë ata do të jenë vërtet keqbërës.

---

<sup>a</sup> Një mysliman në Medinë, Hatib bin Abi Balta`a, që e kishte familjen dhe pronën në Mekë, ua çoi një letër të fshehtë udhëheqësve mekasë duke u treguar se Profeti po përgatitej të marshonte në qytetin e tyre dhe duke i paralajmëruar të marrin masa paraprake. Letra ishte zënë dhe kur Profeti i kërkoi ta shpjegonte veprimin e tij, ai tha se veç donte që mekasit ta mbronin familjen dhe pronën e tij.

<sup>60:10</sup> Ju që besoni, sprovoni gratë besimtare kur të vijnë te ju si mërgimtare – **Allahu** e di më së miri për besimin e tyre – dhe në qofshi të sigurt për besimin e tyre, mos ua ktheni mosbesimtarëve: ato nuk janë gra të ligjshme për to, as mosbesimtarët s’janë burra të tyre të ligjshëm. Jepuni mosbesimtarëve çfarëdo dhurata për nuse që të kenë paguar – nëse vendosni të martoheni me to, nuk ka fajësim për ju pasi t’i keni paguar dhuratat e tyre për nuse – dhe mos i mbani lidhjet martesore me gratë mosbesimtare. Kërkojeni kthimin e dhuratave të nuses që i keni paguar dhe të njëjtën le ta bëjnë mosbesimtarët. Ky është gjykimi i **Allahut**: Ai gjykon mes jush, **Allahu** është i gjithë-ditur dhe i urtë. <sup>11</sup> Nëse kushdo nga ju keni gra që ju lënë për mosbesimtarë dhe nëse më pas komuniteti juaj merr [përfitime] nga ta, atëherë paguajani atyre që janë braktisur nga gratë e tyre barasvlerën e çfarëdo dhurate të nuses që e kanë paguar. Jini të vetëdijshëm për **Allahun**, në Të Cilin besoni.

<sup>12</sup> Profet, kur gratë besimtare vijnë dhe të zotohen se nuk do t’i përshkruajnë asnjë partner **Allahut**, as s’do të vjedhin, as s’do ta shkelin kurorën, as s’do t’i vrasin fëmijët e tyre, as s’do të gënjejnë për atë se kush ishte babai i fëmijëve të tyre,<sup>a</sup> as s’do të jenë të pabindura ndaj teje në asnjë gjë të ndershme, atëherë duhet ta pranosh zotimin e tyre të besnikërisë dhe t’i lutesh **Allahut** t’i falë: **Allahu** është më falësi dhe mëshirëploti.

<sup>13</sup> Ju që besoni, mos i bëni aleatë ata me të cilët **Allahu** është i zemëruar: ata dëshpërohen nga jeta tjetër siç dëshpërohen mosbesimtarët nga ata që janë të varrosur në varret e tyre.

---

<sup>a</sup> Ky është interpretim i zakonshëm i idiomës ‘ajo që është ndërmjet duarve dhe këmbëve të tyre’ (Razi).

**Përshkrimi para kaptinës 60 nga Abdel Haleem:**

*Sure medinase, e shpallur ndërmjet Traktatit të Hudebijës dhe pushtimit të Mekës, që e merr titullin nga vargu 10: jepen udhëzime se si të veprohet me gratë që largohen nga Meka dhe u bashkohen myslimanëve dhe procedura për gratë që e lënë Medinën për Mekën (vargjet 10-11). Myslimanët udhëzohen se kujt duhet t'ia japin besnikërinë e tyre (vargjet 1-3, 7-9, 13) dhe Ibrahim i citohet për ta si shembull për të mësuar nga ai (vargjet 4-6).*

## 61: Rreshtat solidë (ES-SAFF)

Në emrin e **Allahut**, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës

<sup>1</sup> Gjithçka në qiej dhe në tokë e lavdëron **Allahun** – Ai është I Gjithë-Fuqishmi, I Urti. <sup>2</sup> Ju që besoni, pse thoni gjëra dhe pastaj nuk i bëni? <sup>a</sup> <sup>3</sup> Për **Allahun** më e urryeshmja është që thoni gjëra dhe pastaj nuk i bëni; <sup>4</sup> **Allahu** vërtet i do ata që luftojnë për çështjen E Tij në rreshta solidë, si mur i ngjeshur mirë.

<sup>5</sup> Musai i tha popullit të tij: ‘Populli im, pse më lëndoni kur e dini se jam dërguar te ju nga **Allahu**?’ Kur devijuan, **Allahu** ua la zemrat të humben: **Allahu** nuk i udhëzon njerëzit rebelë. <sup>6</sup> Isai, i biri i Merjemes, tha: ‘Fëmijë të Izraelit, jam dërguar te ju nga **Allahu**, duke e vërtetuar Teuratin që erdhi para meje dhe duke sjellë lajm të mirë për një të dërguar që do të vijë pas meje emri i të cilit do të jetë Ahmed.’ <sup>b</sup> E megjithatë kur u erdhi me shenja të qarta, thanë: ‘Kjo është qartas magji.’

<sup>7</sup> Kush mund të jetë më i gabuar se dikush që shpik rrena kundër **Allahut** kur thirret për t’iu nënshtruar Atij? **Allahu** nuk i udhëzon keqbërësit: <sup>8</sup> ata duan ta shuajnë dritën E Tij me gojën e tyre. Por Ai do ta përsosë dritën E Tij, edhe pse mosbesimtarët e urrejnë atë; <sup>9</sup> është Ai që e çoi Të Dërguarin E Tij me udhëzim dhe me fenë e të vërtetës për të treguar se është mbi të gjitha fetë [e tjera], edhe pse idhujtarët e urrejnë atë.

<sup>61:10</sup> Ju që besoni, a t’jua tregoj një ujdi<sup>c</sup> që do t’ju shpëtojë nga tortura e dhembshme? <sup>11</sup> Kini besim në **Allahun** dhe Të Dërguarin E Tij dhe përpiquni fort për çështjen E Tij me tërë pronat dhe veten tuaj – kjo është më e mirë për ju, veç po ta dinit – <sup>12</sup> dhe Ai do t’jua falë mëkatet, do t’ju pranojë në Kopshtet e hijeshuara me lumenj rrjedhës, në banesa të këndshme në Kopshtet e Përherësisë. Ky është triumfi suprem. <sup>13</sup> Dhe do t’ju japë diçka tjetër që do t’ju kënaqë: ndihmën E Tij dhe një përparim të afërt. [Profet,] jepua besimplotëve lajmin e mirë. <sup>14</sup> Ju që besoni, jini ndihmues të **Allahut**. Siç u tha Isai, i biri i Merjemes, dishepujve: ‘Kush do të vijë me mua t’i ndihmojë **Allahut**?’ Dishepujt thanë: ‘Ne do të jemi ndihmues të **Allahut**.’ Disa nga Fëmijët e Izraelit besuan dhe disa nuk besuan: Ne i përkrahëm besimtarët kundër armikut të tyre dhe ishin ata që dolën fitues.

---

<sup>a</sup> Disa kërkuan të luftonin, por kur **Allahu** e urdhëroi luftimin dështuan ta bënin këtë.

<sup>b</sup> Ahmed, ashtu si Muhamed, do të thotë 'i lavdëruar' (për karakterin e tij të mirë).

<sup>c</sup> Fjalë për fjalë: 'një tregti'

**Përshkrimi para kaptinës 61 nga Abdel Haleem:**

*Sure medinase që i inkurajon besimtarët të qëndrojnë bashkë në përkrahje të çështjes së **Allahut** (prej nga edhe titulli i sures, krahaso me vargun 4). Ajo i kritikon ata që e shkelën fjalën e tyre (vargu 3) dhe ata që u grindën kundër besimit (vargjet 7-8). Musai dhe Isai citohen si shembuj të profetëve, komunitetet e të cilëve ishin të ndara: rebelët u lanë të devijojnë dhe besimplotëve iu dha sukses (vargjet 5-6, 14). Përshkruhen me hollësi shpërblimet e atyre që përpigën në çështjen e **Allahut** (vargjet 11-13).*



## 62: Dita e mbledhimit (EL-XHUMU‘A)

Në emrin e **Allahut**, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës

<sup>1</sup> Gjithçka në qiej dhe në tokë e lavdëron **Allahun**, Kontrolluesin, Të Shenjtin, Të Gjithë-Fuqishmin, Të Urtin. <sup>2</sup> Është Ai që e ngriti një të dërguar, ndër njerëzit që nuk kishin Shkrim të Shenjtë, që t’ua recitonte shpalljet E Tij, t’i bëjë të rriten shpirtërisht dhe t’ua mësojë Shkrimin e Shenjtë dhe urtinë – para kësaj ishin qartë të devijuar – <sup>3</sup> atyre dhe të tjerëve që do t’u bashkohen. Ai është I Gjithë-Fuqishmi, I Urti: <sup>4</sup> i tillë është favori i **Allahut** të cilin ia jep kujtdo që do t’ia japë; favori i **Allahut** është jashtëzakonisht i madh. <sup>5</sup> Ata që janë caktuar përgjegjës t’i binden Teuratit, por nuk e bëjnë, janë si gomarë<sup>a</sup> që bartin libra: sa të ulët janë njerëzit e tillë që nuk u binden shpalljeve të **Allahut**! **Allahu** nuk i udhëzon njerëzit që sillen keq.

<sup>6</sup> Thuaj [Profet]: ‘Ju që e ndiqni besimin çifut, nëse vërtet pretendoni se nga të gjithë njerëzit veç ju jeni miq të **Allahut**, atëherë do të duhej ta shpresonit vdekjen.’ <sup>7</sup> Po për shkak të asaj që e kanë grumbulluar për vete me duart e tyre nuk do ta shpresonin vdekjen kurrë – **Allahu** i njeh keqbërësit shumë mirë – <sup>8</sup> pra thuaj: ‘Vdekja nga e cila ikni do të vijë e t’ju takojë dhe do t’ju kthejnë tek Ai që e di të padukshmen si edhe të dukshmen: Ai do t’ju tregojë gjithçka që keni bërë.’

<sup>9</sup> Besimtarë! Kur të bëhet thirrja për t’u falur në ditën e mbledhimit, nxitoni drejt përkujtuesit të **Allahut** dhe lëreni tregtinë tuaj – kjo është më mirë për ju, veç po ta dinit – <sup>62:10</sup> e pastaj kur të ketë mbaruar të falurit, shpërndahuni nëpër vend dhe kërkoheni bujarinë e **Allahut**. Kujtojeni **Allahun** shpesh që të mund të përparoni. <sup>11</sup> E megjithatë ata bëhen pikë-e-pesë kah tregtia apo argëtimi kurdo që e vërejnë, dhe të lënë [Profet] duke qëndruar aty.<sup>b</sup> Thuaj: ‘Dhurata e **Allahut** është më e mirë se çdo argëtim a tregti: **Allahu** është furnizuesi më i mirë.’

---

<sup>a</sup> Fjalë për fjalë ‘[një] gomar’ por konstrukti në shumës në anglisht (pra edhe shqip) e kërkon shumësin.

<sup>b</sup> Kjo i referohet dy rasteve. Gjatë lutjeve në mbledhim në një periudhë të urisë, arriti një karvan dhe disa nga adhuruesit nxituan jashtë, duke e lënë Profetin duke qëndruar në *minber* (foltore). Në një rast tjetër, adhuruesit nxituan jashtë sepse ishte një bend që luante muzikë për një dasëm.

**Përshkrimi para kaptinës 62 nga Abdel Haleem:**

*Sure medinase që e merr titullin nga udhëzimi për besimtarët ta kryejnë lutjen e Të Premtes menjëherë dhe me seriozitet kur thirren (vargjet 9-11). Surja ua kujton myslimanëve mirësinë e **Allahut** që ua ka dhuruar një profet dhe mundësinë për t'u rritur shpirtërisht (vargjet 2-4). Ata që nuk veprojnë në përputhje me njohurinë që u është dhënë kritikohen (vargjet 5-8).*

## 63: Hipokritët (EL-MUNÂFIKÛN)

Në emrin e **Allahut**, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës

<sup>1</sup> Kur hipokritët vijnë te ti [Profet], thonë: ‘Dëshmojmë se je I Dërguar i **Allahut**.’ **Allahu** e di se vërtet je I Dërguari I Tij dhe Ai dëshmon se hipokritët janë gënjeshtarë – <sup>2</sup> i përdorin betimet e tyre si mbulesë dhe kështu i pengojnë të tjerët nga rruga e **Allahut**: kjo që po e bënin është vërtet e keqe – <sup>3</sup> se e pohuan besimin dhe pastaj e refuzuan, kështu që zemrat u janë vulosur dhe nuk kuptojnë. <sup>4</sup> Kur i sheh [Profet], pamja e tyre e jashtme të pëlqen; kur flasin, i dëgjon se çka thonë. Por janë si copa druri të mbështetura për të mos u rrëzuar – mendojnë se çdo thirrje që e dëgjojnë është kundër tyre – dhe janë armiku. Ruaju nga ta. **Allahu** i hutoftë! Sa dinakë që janë!

<sup>5</sup> Ata e kthejnë kokën në anën tjetër me përbuzje kur u thuhet: ‘Ejani, që I Dërguari I **Allahut** të mund të kërkojë falje për ju’, dhe i shihni duke u larguar me arrogancë. <sup>6</sup> Nuk çon peshë a kërkon ti falje për ta apo jo, **Allahu** nuk do t’i falë: **Allahu** nuk udhëzon njerëz të tillë tradhtarë. <sup>7</sup> Ata janë asi që thonë: ‘Mos u jepni asgjë atyre që e ndjekin Të Dërguarin e **Allahut**, deri kur ta braktisin’, por **Allahut** i përkasin thesaret e qiejve dhe të tokës, edhe pse hipokritët nuk e kuptojnë këtë. <sup>8</sup> Thonë: ‘Posa të kthehemi në Medinë, të fuqishmit do t’i dëbojnë të dobëtit’, por fuqia i përket **Allahut**, Të Dërguarit Të Tij dhe besimtarëve, edhe pse hipokritët nuk e dinë këtë.

<sup>9</sup> Besimtarë, mos e lejoni pasurinë dhe fëmijët tuaj t’ju shpërqendrojnë nga të kujtuarit e **Allahut**: ata që e bëjnë këtë do të jenë ata që humbin. <sup>63:10</sup> Jepni nga ajo që Ne e kemi furnizuar për ju, para se të vijë vdekja te njëri nga ju dhe ai të thotë: ‘Zoti im, nëse do të ma shtyje afatin për ca kohë, do të jepja në bamirësi dhe do të bëhesha një nga të ndershmit.’ <sup>11</sup> **Allahu** nuk ia shtyn afatin një shpirti kur t’i vijë radha: **Allahu** është plotësisht i informuar për atë që e bëni.

**Përshkrimi para kaptinës 63 nga Abdel Haleem:**

*Sure medinase që i paralajmëron besimtarët për tradhtinë e hipokritëve dhe e përshkruan sjelljen e tyre në ca hollësi. Përshkruhet një rast specifik në të cilin hipokritët u përpoqën ta ndalonin këto që dhuronte para për besimtarët (vargjet 7-8) dhe **Allahu** u bën thirrje myslimanëve ta kompensojnë këtë duke dhënë më shumë nga fondet e tyre për njerëzit në nevojë (vargjet 9-11).*

## 64: Shpërfillja reciproke (ET-TEGÂBUN)

Në emrin e **Allahut**, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës

<sup>1</sup> Gjithçka që është në qiej dhe në tokë e lavdëron **Allahun**; tërë kontrolli dhe tërë lâvdi i përkasin Atij; Ai ka pushtet mbi gjithçka. <sup>2</sup> Është Ai që ju krijoi, e megjithatë disa nga ju nuk besojnë dhe disa besojnë: **Allahu** sheh gjithçka që bëni. <sup>3</sup> Ai i krijoi qiejt dhe tokën për qëllim të vërtetë; ju formoi dhe jua bëri format të mira: të gjithë do të ktheheni tek Ai. <sup>4</sup> Ai e di atë që është në qiej dhe në tokë; e di se çka fshehni dhe çka zbuloni; **Allahu** i di shumë mirë fshehtësitë e çdo zemre.

<sup>5</sup> [Mosbesimtarë,] a nuk keni dëgjuar për ata që nuk besuan para jush? I shijuan pasojat e këqija të sjelljes së tyre dhe i pret një torturë e dhembshme. <sup>6</sup> Kjo për shkak se të dërguarit e tyre u erdhën me shenja të qarta, e megjithatë thanë: ‘A duhet të marrim udhëzim nga vdekatarë të thjeshtë?’, e refuzuan mesazhin dhe u larguan. Por **Allahu** nuk kishte kurrfarë nevojë për ta: Ai është i gjithë-mjaftueshëm, i denjë për tërë lâvdin.

<sup>7</sup> Mosbesimtarët pretendojnë se nuk do të ngriten nga të vdekurit. Thuaj [Profet]: ‘Po në fakt! Betohe për Zotin tim! Do të ngriteni dhe pastaj do të informoheni për gjithçka që keni bërë: çështje e lehtë për **Allahun**.’

<sup>8</sup> Pra besoni në **Allahun**, në Të Dërguarin E Tij dhe në dritën<sup>a</sup> që Ne e kemi zbritur: **Allahu** është plotësisht i informuar për atë që e bëni. <sup>9</sup> Kur Ai t’ju mbledhë për Ditën e Grumbullimit, Ditën e shpërfilljes reciproke,<sup>b</sup> do t’i shlyejë mëkatet e atyre që besuan në Të dhe vepruan ndershmërisht: do t’i pranojë në Kopshte të hijeshuara me lumenj rrjedhës, për të mbetur aty përgjithmonë – triumfi suprem. <sup>64:10</sup> Por ata që nuk besuan dhe i refuzuan shenjat Tona do të jenë banorë të Zjarrit, për të mbetur aty – destinacion i mjerueshëm.

<sup>11</sup> Fatkeqësitë mund të ndodhin veç me lejen e **Allahut**<sup>c</sup> – Ai do ta udhëzojë zemrën e kujtdo që beson në Të: **Allahu** i di të gjitha gjërat – <sup>12</sup> pra bindjuni **Allahut** dhe Të Dërguarit. Nëse largoheni, mbajeni mend se detyra e Të Dërguarit Tonë është veç ta bëjë të qartë mesazhin e tij. <sup>13</sup> **Allahu!** Nuk ka zot pos Tij, pra le ta kenë besimplotët besimin e tyre në Të. <sup>14</sup> Besimtarë, edhe ndër bashkëshortët tuaj dhe fëmijët tuaj i keni disa armiq – ruajuni nga ta – por nëse i

---

<sup>a</sup> Kuranin

<sup>b</sup> *Taghabun* arabisht është reciproke me *ghabina*: ‘të shpërfillësh apo të harrosh’. Secili do të jetë kaq i preokupuar me fatin e tij sa që do t’i shpërfillë të gjithë të tjerët (krahaso me 70:10-11; 80:34-7)

<sup>c</sup> Ebu Muslimi e jep shpjegimin që disa nga familjet e besimtarëve u përpoqën t’ua ndërronin mendjen atyre që t’i largonin nga mërgimi apo nga *xihadi* sepse kishin frikë për sigurinë e tyre (Razi). Shih vargun 14.

anashkaloni shkeljet e tyre, ua falni kur pendohen, ua falni kur gabojnë, atëherë **Allahu** është gjithë-falësi, i gjithë-mëshirshmi e mëshirëploti.

<sup>15</sup> Pasuria dhe fëmijët tuaj janë veç sprovë për ju. Ka shpërblim të madh me **Allahun**: <sup>16</sup> jini të vetëdijshtëm për **Allahun** sa më shumë që mundeni; dëgjoni dhe zbatoni me bindje; jini bamirës – është për të mirën tuaj. Ata që shpëtohen nga koprancia e tyre do të jenë të begatshmit: <sup>17</sup> nëse i bëni hua bujare **Allahut** Ai do ta shumëfishojë për ju dhe do t'ju falë. **Allahu** është gjithnjë falënderues dhe i duruar; <sup>18</sup> Ai e di të padukshmen, si edhe të dukshmen; Ai është I Gjithë-Fuqishmi, I Urti.

**Përshkrimi para kaptinës 64 nga Abdel Haleem:**

*Sure medinase që e merr titullin nga vargu 9. Surja hapet me një përshkrim të fuqisë, urtisë dhe dijes së **Allahut** (vargjet 1-4). Mosbesimtarëve u përkujtohet fundi i atyre para tyre që nuk besuan (vargjet 5-6) dhe refuzimi i tyre i Ringjalljes kundërshtohet fuqishëm (vargu 7). Besimtarët nxiten të jenë të kujdesshëm por falës ndaj armiqve që mund t'i kenë brenda familjeve të tyre (vargjet 14-15) dhe paralajmërohen që të mbahen të qëndrueshëm dhe të shpenzojnë në çështjen e **Allahut** (vargjet 8-10, 16-18).*

## 65: Divorci (ET-TALÂK)

Në emrin e **Allahut**, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës

<sup>1</sup> Profet, kur dikush nga ju e ka ndërmend t'i divorcojë gratë, bëjeni këtë në një kohë kur periudha e tyre e caktuar e pritjes mund të fillojë si duhet,<sup>a</sup> dhe llogariteni periudhën me kujdes: jini të vetëdijshëm për **Allahun**, Zotin tuaj. Mos i dëboni ato nga shtëpitë e tyre – as s'duhet të largohen vetë – pos nëse bëjnë paturpësi flagrante. Këta janë kufijtë e caktuar nga **Allahu** – kushdo që i tejkalon kufijtë e **Allahut** e dëmton shpirtin e tij – se nuk mund ta dini se çfarë situatë të re mbase mund të sjellë **Allahu**.

<sup>2</sup> Kur ato ta kenë kryer afatin e tyre të caktuar, ose mbajini me nder, ose ndahuni me to me nder. Thirrni dy dëshmitarë të drejtë nga populli juaj dhe vendosni dëshmi për hir të **Allahut**. Kushdo që beson në **Allahun** dhe Ditën e fundit duhet të jetë i vëmendshëm për këtë: **Allahu** do ta gjejë një rrugëdalje për ata që janë të vetëdijshëm për Të <sup>3</sup> dhe do të furnizojë për ta nga një burim i papritur; **Allahu** do të jetë i mjaftueshëm për ata që e kanë besimin e tyre në Të. **Allahu** e arrin qëllimin E Tij; **Allahu** ka caktuar masë të duhur për gjithçka.

<sup>4</sup> Nëse jeni në dyshim, periudha e pritjes do të jetë tre muaj për ato gra që u janë ndalë menstruimet dhe për ato që nuk kanë menstruuar [ende]; periudha e pritjes për ato që janë shtatzëna do të jetë deri kur ta lindin barrën e tyre: **Allahu** i bën gjërat të lehta për ata që janë të vetëdijshëm për Të. <sup>5</sup> Ky është urdhri i **Allahut**, që jua ka zbritur. **Allahu** do t'i shlyejë veprat mëkatore dhe do t'i rrisë shpërblimet e kujtdo që është i vetëdijshëm për Të.

<sup>6</sup> Sistemoni gratë që po i divorconi sipas mundësive tuaja, kudo që sistemoheni vetë dhe mos i ngacmoni që t'ua vështirësoni jetën. Nëse janë shtatzëna, mbajini deri kur t'i kenë lindur barrët e tyre; nëse u japin gji foshnjave tuaja, paguajini për këtë. Këshillohuni bashkë në mënyrë të mirë – nëse i krijoni vështirësi njëri-tjetrit, fëmijës mund t'i japë gji një grua tjetër për babanë<sup>b</sup> – <sup>7</sup> dhe njeriu i pasur le të shpenzojë sipas pasurisë së tij. Por ai, furnizimi i të cilit është i kufizuar, le të shpenzojë sipas asaj që i ka dhënë **Allahu**: **Allahu** nuk e ngarkon asnjë shpirt me më shumë se që i ka dhënë – pas vështirësisë, **Allahu** do të sjellë lehtësim.

---

<sup>a</sup> Periudha e pritjes fillon si duhet pas menstruacioneve dhe para se të rifillohen marrëdhëniet seksuale, dhe zgjat tri cikle menstruale.

<sup>b</sup> Në ligjin Islam është përgjegjësia e babait të paguajë që të ushqehet fëmija i tij.



<sup>8</sup> Shumë qytete – që e kundërshtuan me fyerje urdhrin e Zotit të tyre dhe të dërguarve Të Tij – Ne i kemi kritikuar rreptë: i ndëshkuam ashpër <sup>9</sup> për t'i bërë ta shijojnë efektin e keq të sjelljes së tyre – rezultati i sjelljes së tyre ishte shkatërrimi. <sup>65:10</sup> **Allahu** ka përgatitur torturë të ashpër për ta.

Pra, ju që keni aftësi të kuptoni, ju që besoni, ruajuni nga **Allahu**. Ai jua ka çuar Kuranin <sup>11</sup> dhe një të dërguar – duke jua recituar shpalljet e **Allahut** që i qartësojnë gjërat – për t'i nxjerrë nga terri në dritë ata që besojnë dhe bëjnë vepra të nderhme. **Allahu** do t'i pranojë ata që besojnë në Të dhe bëjnë vepra të nderhme në Kopshte të hijeshuara me lumenj rrjedhës, ku do të mbesin përgjithmonë – Ai ka bërë furnizim të mirë për ta.

<sup>12</sup> Është **Allahu** që i krijoi shtatë qiej dhe një [numër] të ngjashëm të tokave. Komanda E Tij<sup>a</sup> zbret përgjatë tyre. Pra duhet ta kuptoni se Ai ka pushtet mbi të gjitha gjërat dhe se dija E Tij përfshin gjithçka.

---

<sup>a</sup> Apo 'shpallja E Tij'.

**Përshkrimi para kaptinës 65 nga Abdel Haleem:**

*Sure medinase që i përshkruan rregulloret në lidhje me divorcin (vargjet 1-7). Surja i nxit fuqishëm njerëzit t'i respektojnë rregulloret dhe udhëzimet e **Allahut**. Për ta përforcuar këtë atyre u rikujtohet fati i popujve të mëhershëm të pabindur dhe shpërblimet e të bindurve. Në fund theksohet fuqia dhe dija e **Allahut** (vargu 12).*

## 66: Ndalesa (ET-TAHRÎM)

Në emrin e **Allahut**, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës

<sup>1</sup> Profet, pse, në merakun tënd për t'i kënaqur gratë e tua, e ndalon atë që **Allahu** ta ka bërë të ligjshme? <sup>a</sup> E megjithatë **Allahu** është falës dhe mëshirëplotë: <sup>2</sup> Ai e ka përcaktuar një mënyrë për ju [besimtarë] t'ju lirojë nga betimet [e tilla]<sup>b</sup> – **Allahu** është ndihmuesi juaj: Ai është I Gjithë-Dijshmi, I Urti.

<sup>3</sup> Profeti i tregoi diçka në besim njërës nga gratë e tij. Kur ajo e tregoi këtë [një gruajë tjetër] dhe **Allahu** ia bëri të ditur këtë atij, ai e konfirmoi një pjesë të asaj, duke e mbajtur pjesën tjetër për vete. Kur ai e ballafaqoi atë me veprën që e kishte bërë, ajo pyeti: 'Kush të tregoi për këtë?' dhe ai u përgjigj: 'Më tregoi I Gjithë-Dijshmi, I Gjith'-Informuari' <sup>4</sup> Nëse ju të dyja [gratë] pendoheni te **Allahu** – se zemrat ju kanë devijuar – [gjithçka do të jetë mirë]; nëse bashkëpunoni kundër tij, [ta dini se] **Allahu** do ta ndihmojë, si edhe Xhebraili dhe të gjithë besimtarët e ndershëm dhe edhe engjëjt do ta mbështesin. <sup>5</sup> Zoti i tij mund t'ju zëvendësojë fare mirë me gra më të mira nëse Profeti vendos ta divorcojë cilëndo nga ju: gra që i përkushtohen **Allahut**, besimtare të vërteta, të devotshme, që i kthehen Atij në pendesë dhe e adhurojnë, të dhëna pas agjërimit, qoftë të martuara më parë apo virgjëresha.

<sup>6</sup> Besimtarë, ruajeni veten dhe familjet tuaja nga Zjarri që lëndë djegëse i ka njerëzit dhe gurët, mbi të cilin qëndrojnë engjëjt, të ashpër dhe të fortë; engjëjt që kurrë nuk i shkelin komandat e **Allahut** për ta, por bëjnë siç urdhërohen: <sup>7</sup> 'Ju që nuk besoni, mos bëni justifikime sot; veç po shpaguheni për atë që e keni bërë.'

<sup>8</sup> Besimtarë, kthehjuni **Allahut** në pendesë të sinqertë. Zoti juaj fare mirë mund t'ju shlyejë veprat e këqija dhe t'ju pranojë në Kopshte të hijeshuara me lumenj rrjedhës, në një Ditë kur **Allahu** nuk do ta turpërojë Profetin apo ata që kanë besuar me të. Me dritat e tyre që u ndriçojnë përpara dhe në të djathtë, thonë: 'Zot, na i përsos dritat dhe na fal: Ti ke pushtet mbi gjithçka.'

<sup>9</sup> Profet, përpiku fort kundër mosbesimtarëve dhe hipokritëve. Trajtoji ashpër. Ferri do të jetë shtëpia e tyre, destinacion i keq! <sup>66:10</sup> **Allahu** ka dhënë shembuj të mosbesimtarëve: gratë e Nuhut dhe të Lutit që u martuan me dy nga shërbyesit Tanë të drejtë por i tradhtuan. Burrat e tyre nuk mundën t'u ndihmojnë kundër **Allahut** – ishte thënë: 'Të dyja hyni në Zjarr me të tjerët.' <sup>11</sup> **Allahu** ka dhënë

---

<sup>a</sup> Profeti e kishte bërë një betim që të përmbahej nga diçka: ose mjalti ose marrëdhëniet bashkëshortore me një apo disa gra të tij. Razi i jep disa rrëfime për ta shpjeguar këtë.

<sup>b</sup> Shih 5:89. Nëse një mysliman e bën një betim që mund të jetë në kundërshtim me atë që është e drejtë, i lejohet lirim, me kusht që e jep shlyerjen.

edhe shembuj të besimtarëve – gruan e Faraonit, që tha: ‘Zot, ma ndërto një shtëpi afër Teje në Kopsht. Më shpëto nga Faraoni dhe veprimet e tij; më shpëto nga keqbërësit’<sup>12</sup> dhe Merjemen, të bijën e Imranit. Ajo e ruajti dëlirësinë e saj, kështu që Ne frymë brenda saj nga shpirti Ynë. Ajo e pranoi të vërtetën e fjalëve dhe të Shkrimeve të Shenjta të Zotit të saj: ishte vërtet e devotshme.

**Përshkrimi para kaptinës 66 nga Abdel Haleem:**

*Sure medinase që diskuton episode në jetën shtëpiake të Profetit. I qorton dy nga gratë e Profetit për një incident kur u tradhtua një fshehtësi e treguar (vargjet 3-5) dhe i nxit të gjithë besimtarët t'i nënshtrohen **Allahut** dhe ta ruajnë veten dhe familjet e tyre nga Zjarri i Ferrit (vargjet 6-8). Surja mbyllet duke dhënë shembuj të grave besimtare dhe mosbesimtare (vargjet 10-12).*

## 67: Kontrolli<sup>a</sup> (EL-MULK)

Në emrin e **Allahut**, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës

<sup>1</sup> I Lartësuar<sup>b</sup> është Ai që e mban tërë kontrollin në duart E Tij; që ka pushtet mbi të gjitha gjërat; <sup>2</sup> që e krijoi vdekjen dhe jetën<sup>c</sup> për t’ju sprovuar [juve njerëzve] dhe për ta zbuluar se cilët nga ju e bëjnë më të mirën – Ai është I Fuqishmi, Falësi; <sup>3</sup> që i krijoi shtatë qiejt, njërin mbi tjetrin. Nuk do ta shohësh asnjë të metë në atë që e krijon Zoti i Mëshirës. Shiko përsëri! A mund ta shohësh ndonjë të metë? <sup>4</sup> Shiko përsëri! Dhe përsëri! Shikimi yt do të të kthehet, i dobët e i mundur.

<sup>5</sup> Ne e kemi zbukuruar qiellin më të ulët me llampa dhe i kemi bërë [predha] për t’i gjuajtur me gurë djajtë<sup>d</sup> për të cilët e kemi përgatitur edhe torturën e një zjarri flakërues. <sup>6</sup> Për ata që e kundërshtojnë Zotin e tyre e kemi përgatitur torturën e Ferrit: destinacion i keq. <sup>7</sup> Do ta dëgjojnë teksa merr frymë kur të gjuhen brenda. Ai flakëron, <sup>8</sup> pothuaj duke shpërthyer me zemërim. Rojet e tij do ta pyesin secilin grup që hidhet brenda: ‘A nuk erdhi askush t’ju paralajmërojë?’ <sup>9</sup> Ata do të përgjigjen: ‘Po, na erdhi një paralajmërues, por nuk i besuam. Thamë: “**Allahu** nuk ka shpallur asgjë: jeni shumë gabim”.’ <sup>67:10</sup> Do të thonë: ‘Veç po të kishim dëgjuar, apo të kishim arsyetuar, nuk do të ishim me banorët e zjarrit flakërues’, dhe <sup>11</sup> do t’i pranojnë mëkatet e tyre. Thyeni qafën banorë të zjarrit flakërues! <sup>12</sup> Por ka falje dhe shpërblim të madh për ata që ia kanë frikën Zotit të tyre megjithëse nuk mund ta shohin.

<sup>13</sup> Pavarësisht a i mbani fjalët tuaja të fshehta a i thoni hapur, Ai e di përmbajtjen e çdo zemre. <sup>14</sup> Si do të mund të mos e njihite krijimin E Tij Ai që krijoi, kur është Më Subtili, I Gjith’-Informuari? <sup>15</sup> Është Ai që e ka bërë tokën të menaxhueshme për ju – udhëtoni nëpër rajonet e saj; hajeni furnizimin E Tij – dhe tek Ai do të ringjalleni. <sup>16</sup> A jeni të sigurt se Ai që është në Qiell nuk do ta bëjë tokën t’ju gëlltisë me dridhje të dhunshme? <sup>17</sup> A jeni të sigurt se Ai që është në Qiell nuk do ta çojë një furtunë t’ju sulmojë me gurë?

Do ta merrni vesh se çka domethënë paralajmërimi Im. <sup>18</sup> Edhe ata që shkuan para tyre nuk besuan – sa i tmerrshëm ishte dënimi Im! <sup>19</sup> A nuk i shohin shpendët mbi ta duke i hapur dhe mbyllur krahët? Është veç Zoti i mëshirës që i mban lart: Ai mbikëqyr gjithçka. <sup>67:20</sup> Çfarë force mund të të ndihmojë nëse Zoti i

---

<sup>a</sup> Apo ‘Sovraniteti’.

<sup>b</sup> Ky kuptim i *tarabak* përkrahet nga Razi dhe është më me vend këtu se sa ‘i bekuar’.

<sup>c</sup> Krahaso me 40:10, 2:28, 53:44, 2:155.

<sup>d</sup> Krahaso me 37:6-10.

Mëshirës nuk të ndihmon? Mosbesimtarët janë vërtet në deluzion. <sup>21</sup> Kush mund të furnizojë për ju nëse Ai e ndal furnizimin E Tij? E megjithatë këmbëngulin në paturpësinë e tyre dhe shmangien e tyre të Të Vërtetës. <sup>22</sup> Kush është i udhëzuar më mirë: dikush që rrëzohet në fytyrën e tij, apo dikush që ec në mënyrë të qëndrueshme në rrugë të drejtë?

<sup>23</sup> Thuaj [Profet]: ‘Është Ai që ju solli në qenie, Ai që ju pajisi me dëgjim, shikim dhe aftësi për të kuptuar – sa pak falënderoheni!’ <sup>24</sup> Thuaj: ‘Është Ai që ju shpërndau nëpër tokë, Ai tek I Cili do të mblidheni.’ <sup>25</sup> Thonë: ‘Nëse ajo që e thoni është e vërtetë, kur do të përmbushet ky premtim?’ <sup>26</sup> Thuaj: ‘Veç **Allahu** ka njohuri për këtë: detyra ime e vetme është të jap paralajmërim të qartë.’ <sup>27</sup> Kur e shohin nga afër, fytyrat e mosbesimtarëve do të jenë të zymta dhe do të thuhet: ‘Kjo është ajo që po e thërrisnit.’ <sup>28</sup> Thuaj: ‘Veç mendoni – pavarësisht se a më shkatërron **Allahu** mua dhe ndjekësit e mi<sup>a</sup> apo a ka mëshirë për ne – kush do t’i mbrojë mosbesimtarët nga një torturë agonizuese?’ <sup>29</sup> Thuaj: ‘Ai është Zoti i Mëshirës; besojmë në Të; e kemi besimin tonë në Të. Do ta merrni vesh me kohë se kush është duke gabuar dukshëm.’ <sup>67:30</sup> Thuaj: ‘Veç mendoni: nëse tërë uji juaj do të fundosej thellë në tokë kush do të mund t’ju jepte ujë të rrjedhshëm në vend të tij?’

---

<sup>a</sup> Raportimet thonë se mekasit shpresonin që Profeti të vdiste, ashtu që ta hiqnin qafe një herë e përgjithmonë.

**Përshkrimi para kaptinës 67 nga Abdel Haleem:**

*Sure mekase që i sfidon mosbesimtarët me deklaratat e fuqisë totale të Allahut mbi ta dhe gjithçka tjetër, në këtë botë dhe në tjetrën. E përshkruan pishmanin që do ta shprehin mosbesimtarët në Ditën e Ringjalljes (vargjet 9-10, 27).*



## 68: Pena (EL-KALEM)

Në emrin e **Allahut**, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës

<sup>1</sup> *Nun*

Pasha penën! Pasha krejt atë që e shkruajnë!<sup>a</sup> <sup>2</sup> Mirësia e Zotit tënd<sup>b</sup> nuk të bën [ty, Profet,] të çmendur: <sup>3</sup> do të kesh shpërblim të pafund – <sup>4</sup> vërtet ke karakter të fortë – <sup>5</sup> dhe së shpejti do ta shohësh, si edhe ata, <sup>6</sup> se cili nga ju është prekur nga çmenduria. <sup>7</sup> Zoti yt e di më së miri se kush devijon nga rruga E Tij dhe kush është i udhëzuar drejt. <sup>8</sup> Pra mos ua vër veshin atyre që e refuzojnë të vërtetën – <sup>9</sup> duan të bësh kompromis me ta dhe pastaj do të bëjnë kompromis me ty – <sup>68:10</sup> mos ia vë veshin asnjë betuesi të neveritshëm, <sup>11</sup> asnjë përgojuesi, asnjë shpifësi reputacion-prishës, <sup>12</sup> apo penguesi të të mirës, askujt që është mëkatar, agresiv, <sup>13</sup> ofendues i vrazhdë dhe mbi të gjitha, mashtrues.<sup>c</sup> <sup>14</sup> Veç se ka pasuri e djem, <sup>15</sup> kur i recitohen shpalljet Tona, thotë: ‘Këto janë veç fabula të lashta.’ <sup>16</sup> Do ta poshtërojme në turi!

<sup>17</sup> Ne i kemi sprovuar siç i sprovuam pronarët e njëfarë kopshti, që betoheshin se do t’i vilnin frutat e tij në mëngjes <sup>18</sup> dhe nuk bënë asnjë dhënie [për Vullnetin e **Allahut**]:<sup>d</sup> <sup>19</sup> gjersa flinin kopshtin e goditi një fatkeqësi nga Zoti juaj <sup>68:20</sup> dhe në mëngjes ishte zhveshur, tokë e shkretë. <sup>21</sup> Megjithatë në agim i thirrën njëri-tjetrit: <sup>22</sup> ‘Shkoni herët në fushat tuaja nëse dëshironi t’ia mblidhni të gjitha frutat’, <sup>23</sup> dhe u nisën, duke pëshpëritur: <sup>24</sup> ‘Sigurohuni që asnjë person i varfër të mos hyjë në kopsht sot!’ – <sup>25</sup> shkuan herët, shumë të vendosur në qëllimin e tyre – <sup>26</sup> por kur e panë kopshtin, thanë: ‘Me siguri e kemi humbur rrugën!’ <sup>27</sup> Jo – jemi të shkatërruar!’ <sup>28</sup> Më i urti nga ta tha: ‘A nuk ju thashë: “A nuk do ta lavdoni **Allahun?**”’ – <sup>29</sup> ata thanë: ‘Lâvdi qoftë për **Allahun**, Zotin tonë! Vërtet, po bënim gabim!’ – <sup>68:30</sup> dhe pastaj iu kthyen njëri-tjetrit duke u qortuar. <sup>31</sup> Thanë: ‘Mjerë ne! Kemi bërë gabim të tmerrshëm, <sup>32</sup> por mbase Zoti ynë do të na japë diçka më të mirë në vend të kësaj: vërtet i kthehem Atij me shpresë.’ <sup>33</sup> I tillë është ndëshkimi [në këtë jetë], por edhe më i madh është ndëshkimi në Të Përtejmen, veç po ta dinin.

---

<sup>a</sup> Kjo do të mund t’i referohej engjëjve dhe asaj që e shkruajnë për veprat e njerëzve apo penës së përgjithshme dhe asaj që e shkruajnë njerëzit, duke u betuar kështu për aftësinë për të shkruar me të cilën **Allahu** i pajisi qeniet njerëzore. Krahaso me 96:4-5.

<sup>b</sup> Marrja e shpalljes së **Allahut**. Shih posaçërisht 15:6 për akuzën e çmendurisë, që shfaqet shumë herë në lidhje me profetë të ndryshëm në Kuran. Një interpretim tjetër është: ‘pasha mirësinë e **Allahut** . . .’.

<sup>c</sup> Kjo thuhet se i referohet el-Velid ibn al-Mughirës, një kundërshtar i vendosur i Profetit.

<sup>d</sup> Apo [për të varfrit].

<sup>34</sup> Për ata që janë të vetëdijsëm për **Allahun** do të ketë Kopshte të lumturisë.  
<sup>35</sup> A duhet t'i trajtojmë Ne ata që na nënshtrohen siç i trajtojmë ata që bëjnë keq?  
<sup>36</sup> Si është puna me ju? Mbi çfarë baze gjykoni? <sup>37</sup> A keni Shkrim të Shenjtë që ju tregon <sup>38</sup> se do t'ju jepet çkado që të zgjedhni? <sup>39</sup> A keni marrë nga Ne betime solemne, që obligojnë në Ditën e Ringjalljes, se do të merrni çka të vendosni vetë? <sup>68:40</sup> Pyeti [Profet] cilët nga ta do ta garantojnë këtë. <sup>41</sup> A kanë 'partnerë' [përveç **Allahut**]? Le t'i prodhojnë 'partnerët' e tyre, nëse ajo që e thonë është e vërtetë. <sup>42</sup> Në Ditën kur çështjet të bëhen të tmerrshme,<sup>a</sup> do të ftohen të bien në gjunjë por do të parandalohen<sup>b</sup> të mos e bëjnë, <sup>43</sup> dhe sytë do t'i kenë të rrëzuar dhe do të jenë të zhytur në turp: ishin ftuar të gjunjëzohen kur ishin të mbrojtur nga dëmet [por refuzuan].

<sup>44</sup> Pra [Profet] m'i lër Mua ata që e refuzojnë këtë shpallje: Ne do t'i çojmë, hap pas hapi, nëpër rrugë përtej njohurive të tyre; <sup>45</sup> Do t'u lejoj më shumë kohë, se plani Im është i fuqishëm. <sup>46</sup> A kërkon ti ndonjë shpërblim nga ta që do t'i ngarkonte me borxh? <sup>47</sup> A kanë njohuri për të padukshmen që ua mundëson ta shkruajnë atë? <sup>48</sup> Prite me durim [Profet] gjykimin e Zotit tënd: mos ji si njeriu në balenë që thirri në ankth: <sup>49</sup> nëse nuk do ta prekte mirësia e Zotit të tij, do të ishte lënë, i braktisur dhe fajtor, në bregun e djerrë, <sup>68:50</sup> por Zoti i tij e zgjodhi dhe e bëri një nga Të Ndershmit. <sup>51</sup> Kur e dëgjojnë Kuranin mosbesimtarët pothuajse të rrëzojnë me shikimet e tyre. Thonë: 'Ai duhet të jetë i çmendur!' <sup>52</sup> por vërtet nuk është gjë tjetër pos Përkujtues për të gjithë njerëzit.

---

<sup>a</sup> Ky është kuptimi i shprehjes arabe 'kur kofshët të jenë zbathur'.

<sup>b</sup> Baydawi sugjeron që kjo ndodh sepse koha për bindje ka mbaruar, apo sepse janë disa të paaftë ta bëjnë këtë (*Tefsiri*).

**Përshkrimi para kaptinës 68 nga Abdel Haleem:**

*Sure e hershme mekase që merret me akuzën se Muhamedi nuk ishte I Dërguari I Allahut por thjesht i çmendur (vargjet 2-6). Hidhet poshtë arroganca e atyre që supozojnë se, meqë i kanë ca nga gjërat e mira ne këtë jetë, mund ta refuzojnë Shpalljen (vargjet 10-16). Jepen shembuj të atyre që i ranë pishman arrogancës së tyre (vargjet 17-33). Profeti nxitet të mbahet i qëndrueshëm (vargjet 48-52).*

## 69: Ora e pashmangshme (EL-HÂKKA)

Në emrin e **Allahut**, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës

<sup>1</sup> Ora e Pashmangshme! <sup>2</sup> Ç'është Ora e Pashmangshme? <sup>3</sup> Çka do të ta shpjegojë se ç'është Ora e Pashmangshme?

<sup>4</sup> Populli i Themudit dhe Adit e mohuan se do të vinte goditja shpartalluese<sup>a</sup>: <sup>5</sup> Themudi u shkatërrua nga një shpërthim shurdhues; <sup>6</sup> Adi u shkatërrua nga një erë e fuqishme <sup>7</sup> që **Allahu** e la të lirë kundër tyre për shtatë net rresht, tetë ditë rresht, që të mund ta shihje popullin e tij të shtrirë të vdekur si trungje boshe të palmave. <sup>8</sup> A mund ta shohësh ndonjë gjurmë të tyre tani? <sup>9</sup> Faraoni, si dhe ata para tij dhe qytetet e shkatërruara: këta popuj bënë mëkate të mëdha dhe nuk iu bindën të dërguarit të Zotit të tyre, kështu që Ai i mbërtheu me kapje gjithnjë e më shtrënguese. <sup>69:10</sup> Por kur Përmbytja u ngrit, <sup>11</sup> Ne ju shpëtuam në anijen lundruese, <sup>12</sup> duke jua bërë atë ngjarje përkujtues: veshët e vëmendshëm mund të dëgjojnë.

<sup>13</sup> Kur Trumpeta të fryhet veç një herë, <sup>14</sup> kur toka dhe malet e saj të ngriten lart e pastaj të thërrmohen me një goditje të vetme, <sup>15</sup> në atë Ditë do të ndodhë Ngjarja e Madhe. <sup>16</sup> Në atë Ditë qielli do të copëtohet, do të jetë kaq i brishtë. <sup>17</sup> Engjëjt do të jenë në të gjitha anët e tij dhe, në atë Ditë, tetë nga ta do ta mbajnë fronin e Zotit tuaj mbi ta. <sup>18</sup> Në atë Ditë do të silleni në gjykim dhe asnjë nga fshehtësitë tuaja s'do të mbetet e fshehur. <sup>19</sup> Kushdo të cilit i jepet Regjistri i tij në dorën e djathtë do të thotë: 'Ja Regjistri im, lexojeni. <sup>69:20</sup> E dija se do ta takoja Vlerësimin tim' <sup>21</sup> dhe kështu ai do të ketë jetë të këndshme <sup>22</sup> në një kopsht të lartë fisnik, <sup>23</sup> me fruta të tufëzuara që i kap lehtë. <sup>24</sup> Do të thuhet: 'Ha dhe pi si ta dojë zemra si shpërblim për atë që e ke bërë në ditët e shkuara.' <sup>25</sup> Por kushdo që i jepet Regjistri i tij në dorën e majtë do të thotë: 'Ah sikur të mos më jepej kurrë Regjistër <sup>26</sup> dhe të mos dija asgjë për Vlerësimin tim. <sup>27</sup> Sa do të doja që vdekja të ishte fundi i vetes sime. <sup>28</sup> Pasuria ime nuk më solli dobi <sup>29</sup> dhe fuqia më është shuar.' <sup>69:30</sup> 'Merreni, vërxani një qafore, <sup>31</sup> çojeni të digjet në Zjarrin flakërues, <sup>32</sup> dhe [lidheni] në një zingjir shtatëdhjetë metra<sup>b</sup> të gjatë: <sup>33</sup> ai nuk do të besonte në **Allahun** e Gjithë-Fuqishëm, <sup>34</sup> kurrë nuk e ka nxitur ushqimin e të varfërve, <sup>35</sup> pra sot nuk e ka asnjë mik të vërtetë këtu <sup>36</sup> dhe ushqimi i vetëm që e ka është ndyrësia <sup>37</sup> që e hanë veç mëkatarët.'

<sup>38</sup> Pra Unë betohem për atë që mund ta shihni <sup>39</sup> dhe për atë që s'mund ta shihni: <sup>69:40</sup> ky [Kuran] është fjalimi i një të dërguari të nderuar, <sup>41</sup> jo fjalët e një

---

<sup>a</sup> Krahaso me suren me këtë emër (Surja 101)

<sup>b</sup> Një *dhira*<sup>c</sup> është gjatësia e një krahu.

poeti – sa pak besoni! – <sup>42</sup> as fjalët e një falltari – sa pak reflektoni! <sup>43</sup> Ky [Kuran] është mesazh i zbritur nga Zoti i Botëve: <sup>44</sup> nëse [Profeti] do të na e kishte mveshur ndonjë trillim, <sup>45</sup> Ne sigurisht që do t'ia kishim mbërthyer dorën e djathtë <sup>46</sup> dhe do t'ia ndërprisnim gjakun jetik<sup>a</sup> <sup>47</sup> dhe askush nga ju nuk do të mund ta mbronte. <sup>48</sup> Ky [Kuran] është përkujtues për ata që janë të vetëdijsëm për **Allahun**. <sup>49</sup> Ne e dimë se disa nga ju konsideroni se është me gënjeshtër – <sup>69:50</sup> kjo do të jetë burim i pishmanit të hidhur për mosbesimtarët – <sup>51</sup> por është në fakt E Vërteta e sigurt. <sup>52</sup> Pra [Profet] lavdoje emrin e Zotit tënd, Të Gjithë-Fuqishmit.

---

<sup>a</sup> Fjalë për fjalë 'arterien'.

**Përshkrimi para kaptinës 69 nga Abdel Haleem:**

*Sure mekase që e përshkruan ndëshkimin në këtë jetë (vargjet 4-12) dhe në tjetrën (vargjet 13-18). Lumturia që do të shijohet nga besimtarët kontrastohet në mënyrë elokumente me torturat e ferrit (vargjet 19-37). Nga vargu 38 e tutje, **Allahu** e pohon Të Vërtetën e Kuranit dhe të Profetit.*

## 70: Rrugët e ngjitjes (EL-ME'ÂRIXH)

Në emrin e **Allahut**, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës

<sup>1</sup> Një njeri [duke u tallur] e kërkoi ndëshkimin. <sup>2</sup> Ai do të bjerë mbi mosbesimtarët – askush s'mund ta shmangë – <sup>3</sup> nga **Allahu**, Zoti i Rrugëve të Ngjitjes, <sup>4</sup> nëpër të cilat ngjiten tek Ai engjëjt dhe Shpirti, në një Ditë që e ka gjatësinë pesëdhjetë mijë vjet. <sup>5</sup> Pra ki durim, [Profet,] siç të ka hije. <sup>6</sup> Mosbesimtarët mendojnë se është larg, <sup>7</sup> por Ne e dimë të jetë afër. <sup>8</sup> Në një Ditë kur qiejt do të jenë si bronz i shkrirë <sup>9</sup> dhe malet si tufa leshi, <sup>70:10</sup> kur asnjë mik nuk do të pyesë për mikun e tij, <sup>11</sup> madje edhe kur janë në pamjen e njëri-tjetrit. Personi fajtor do të dëshirojë të kishte mundur ta shpëtonte veten nga vuajtja e asaj Dite duke i flijuar bijtë e tij, <sup>12</sup> bashkëshorten e tij, vëllanë e tij, <sup>13</sup> farefisnin që i dhanë strehim <sup>14</sup> dhe të gjithë në tokë, po ta shpëtonte kjo. <sup>15</sup> Por jo! Është një flakë e tërbuar <sup>16</sup> që e heq lëkurën <sup>17</sup> dhe do ta marrë secilin që e refuzon të vërtetën, largohet, <sup>18</sup> grumbullon pasuri të madhe dhe e fsheh.

<sup>19</sup> Njeriu vërtet u krijua të jetë plot shqetësime: <sup>70:20</sup> është i ligështuar kur e godet fatkeqësia, <sup>21</sup> por dorë-shtrënguar kur i vjen fati i mirë. <sup>22</sup> Nuk janë të tillë ata që falen <sup>23</sup> dhe janë të vazhdueshëm në faljet e tyre; <sup>24</sup> që ua japin një hise të duhur të pasurisë së tyre <sup>25</sup> lypësve dhe atyre që s'i kanë as gjërat thelbësore; <sup>26</sup> që besojnë në Ditën e Gjykimit <sup>27</sup> dhe ia kanë frikën ndëshkimit të Zotit të tyre – <sup>28</sup> askush nuk mund të ndihet plotësisht i sigurt nga ai [ndëshkim] – <sup>29</sup> që e ruajnë dëlirësinë e tyre <sup>70:30</sup> nga të gjithë pos bashkëshorteve të tyre apo skllaveve të tyre – nuk bëhet faj me [marrëdhëniet me] ta, <sup>31</sup> por ata merakët e të cilëve e tejkalojnë këtë kufi janë vërtet shkelës – <sup>32</sup> që janë besnikë ndaj besave dhe zotimeve të tyre; <sup>33</sup> që japin dëshmi të ndershme <sup>34</sup> dhe janë të qëndrueshëm në lutjet e tyre. <sup>35</sup> Ata do të nderohen në Kopshtet e lumturisë.

<sup>36</sup> Si është puna me mosbesimtarët? Pse nxitojnë të të shikojnë me ngulm [Profet], <sup>37</sup> nga e djathta dhe e majta, në turma? <sup>38</sup> A secili nga ta pret të hyjë në Kopsht të lumturisë? <sup>39</sup> Jo! Ne i krijuam nga substanca që e njohin, <sup>a 70:40</sup> dhe – pasha Zotin e çdo lindjeje dhe perëndimi të diellit – Ne e kemi fuqinë <sup>41</sup> t'i zëvendësojmë me të tjerë më të mirë se ta – asgjë s'mund të na pengojë ta bëjmë këtë. <sup>42</sup> Pra lëri të zhyten në biseda boshe, deri kur të përballen me Ditën e tyre të premtuar, <sup>43</sup> Ditën kur do të nxitojnë jashtë nga varret e tyre sikur të mblidheshin rreth një flamuri, <sup>44</sup> me sy të përulur e të mbuluar me turp: kjo është Dita për të cilën u paralajmëruan.

---

<sup>a</sup> Ata e refuzojnë Ringjalljen dhe kjo ua thekson se **Allahu** e ka fuqinë t'i krijojë nga një fillim kaq i vogël dhe se Ai mund ta shkaktojë Ringjalljen. Krahaso me 56:56-62.

**Përshkrimi para kaptinës 70 nga Abdel Haleem:**

*Sure mekase që e përshkruan Ditën e Gjykimit (vargjet 8-18). Një nga kundërshtarët e Profetit e sfidoi ta shpejtonte ndëshkimin me të cilin ishin kërcënuar (vargu 1), kështu që ekspozohet (vargjet 36-44) marrëzia e mosbesimtarëve në refuzimin e Ringjalljes (vargu 6). Përshkruhen njerëzit të cilëve do t'u jepet Kopshti (vargjet 22-35). Titulli është referencë për rrugët nëpër të cilat engjëjt ngjiten te **Allahu**, të përmendura në vargjet 3-4.*



## 71: Nuhu (NÛH)

Në emrin e **Allahut**, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës

<sup>1</sup> Ne e dërguam Nuhun te populli i tij: ‘Paralajmëroje popullin tënd, para se t’u vijë një dënim i dhembshëm.’ <sup>2</sup> Dhe kështu ai tha: ‘Populli im, jam këtu t’ju paralajmëroj qartë. <sup>3</sup> Shërbeni **Allahut**, jini të vetëdijsëm për Të dhe bindmuni. <sup>4</sup> Ai do t’jua falë mëkatet dhe do t’ju kursejë deri në kohën tuaj të caktuar – kur të vijë koha e caktuar e **Allahut** - nuk mund të shtyhet. Veç po ta kuptonit!’

<sup>5</sup> Tha: ‘Zoti im, e kam thirrur popullin tim natë e ditë, <sup>6</sup> por sa më shumë që i thërras, aq më larg ikin: <sup>7</sup> sa herë që i thërras, që Ti të mund t’ua falësh, i fusin gishtat në veshë, i mbulojnë kokat me rrobat e tyre, këmbëngulin në refuzimin e tyre dhe bëhen më të pafytyrë e arrogantë. <sup>8</sup> Jam përpjekur t’i thërras haptas. <sup>9</sup> Jam përpjekur t’u predikoj publikisht dhe t’u flas privatisht. <sup>71:10</sup> Thashë: “Kërkoni falje nga Zoti juaj: Ai është gjithmonë-falës. <sup>11</sup> Do të zbresë shi të bollshëm nga qielli për ju; <sup>12</sup> do t’ju japë pasuri e fëmijë; do t’ju furnizojë me kopshte e lumenj. <sup>13</sup> Si është puna me ju? Pse nuk do t’ia keni frikën madhështisë së **Allahut**, <sup>14</sup> kur ju ka krijuar fazë pas faze?<sup>a</sup> <sup>15</sup> A jeni çuditur ndonjëherë se si **Allahu** i krijoi shtatë qiejt, njërin mbi tjetrin, <sup>16</sup> e vuri hënën si dritë në ta dhe diellin si llampë, <sup>17</sup> si **Allahu** ju bëri të dilni nga toka si bimë, <sup>18</sup> si do t’ju kthejë në të e pastaj t’ju nxjerrë përsëri <sup>19</sup> dhe si e shtriu Tokën për ju <sup>71:20</sup> të ecni nëpër shtigjet e saj të gjera?” ’

<sup>21</sup> Nuhu tha: ‘Zoti im, nuk m’u bindën dhe i ndoqën ata të cilëve pasuritë dhe fëmijët veç sa ua rrisin rrënimin; <sup>22</sup> që e kanë bërë një plan të madh, <sup>23</sup> duke thënë: “Mos hiqni dorë nga zotat tanë! <sup>24</sup> Mos hiqni dorë nga Veddi, Suvai, Jeguthi, Jauka apo Nesri”<sup>b</sup> Ata kanë devijuar shumë njerëz. Zot, mos zbrit asgjë pos shkatërrimit mbi keqbërësit!’

<sup>25</sup> Ata u fundosën dhe u çuan në Ferr për keqbërjet e tyre: nuk e gjetën askë t’u ndihmojë kundër Zotit. <sup>26</sup> Dhe Nuhu tha: ‘Zot, mos e lër asnjë nga mosbesimtarët në tokë – <sup>27</sup> nëse i lë, do t’i devijojnë shërbyesit e Tu dhe do të lindin veç mëkatarë dhe mosbesimtarë – <sup>28</sup> Zot, më fal mua, prindërit e mi dhe këdo që hyn në shtëpinë time si besimtar. Fali burrat e gratë besimtare por mbi keqbërësit mos zbrit asgjë veç shkatërrimit!’

---

<sup>a</sup> Shih 22:5; 23:12-15.

<sup>b</sup> Emrat e idhujve.

**Përshkrimi para kaptinës 71 nga Abdel Haleem:**

*Sure mekase që jep më shumë hollësi të jetës së Nuhit para Përmbytjes, për ta inkurajuar Profetin dhe për t'i paralajmëruar mosbesimtarët.*

## 72: Xhindet<sup>a</sup> (EL-XHINN)

Në emrin e **Allahut**, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës

- <sup>1</sup> Thuaj [Profet]: ‘Më është shpallur  
se një herë një grup i xhindeve dëgjuan dhe thanë:  
“E kemi dëgjuar një Kuran të mrekullueshëm,  
<sup>2</sup> që udhëzon në rrugën e duhur,  
prandaj jemi bindur dhe e besojmë –  
kurrë nuk do t’i mveshim partnerë Zotit tonë –  
<sup>3</sup> dhe se Ai – lartësuar qoftë madhështia e Zotit tonë! –  
s’ka as bashkëshort[e], as fëmijë.  
<sup>4</sup> Budallenjtë në mesin tonë kanë thënë  
gënjeshtër të tejfryra për **Allahun**,  
<sup>5</sup> megjithëse patëm menduar se asnjë njeri a xhind  
nuk do të [guxonte të] thoshte gënjeshtër për Të.  
<sup>6</sup> Njerëzit kanë kërkuar strehë  
te xhindet në të shkuarën  
por veç sa i çorientuan edhe më shumë.  
<sup>7</sup> Menduan, siç menduat edhe ju,  
se **Allahu** nuk do ta ringjallte askë nga të vdekurit.  
<sup>8</sup> U munduam ta arrinim qiellin,  
por zbuluam se ishte i mbushur  
me roje qëndrestare  
dhe meteorë si zjarre të përndezura –  
<sup>9</sup> uleshim nëpër vende atypari, duke dëgjuar,<sup>b</sup>  
por kushdo që provon të dëgjojë tani  
do ta gjejë një meteor  
që rri duke e pritur –  
<sup>72:10</sup> [pra tash] nuk e dimë për ata që jetojnë në tokë  
a u takon fatkeqësia,

---

<sup>a</sup> Qenie të padukshme.

<sup>b</sup> Ata po dëgjonin për tregues se çka mund të ndodhë tutje, por në vargun 10 thonë se më nuk janë në gjendje ta dinë të ardhmen (krahaso me vargun 26 më poshtë).

- apo Zoti i tyre synon t'i udhëzojë.
- 11 Disa nga ne janë të ndershëm,  
dhe të tjerët më pak:  
ndjekim rrugë të ndryshme.
- 12 E dimë se kurrë s'mund ta frustrojmë  
**Allahun** në tokë;  
kurrë s'mund t'i ikim Atij.
- 13 Kur e dëgjuam udhëzimin,  
u bindëm e besuam në të:  
kushdo që beson në Zotin e tij  
s'ka nevojë t'i frikësohet  
humbjes a padrejtësisë.
- 14 Disa nga ne i dorëzohen Atij,  
dhe disa shkojnë rrugës së gabuar:  
ata që i dorëzohen **Allahut**,  
kanë gjetur udhëzim të urtë,
- 15 por ata që veprojnë padrejtësisht,  
do të jenë lëndë djegëse për Zjarr të Ferrit.” ’
- 16 Nëse ata<sup>a</sup> do ta zgjedhnin rrugën e duhur  
Ne do t'u jepnim ujë të bollshëm për të pirë –
- 17 sprovë për ta<sup>b</sup> –  
por kushdo që largohet  
nga Shpallja e Zotit të tij,  
do të dërgohet nga Ai  
në torturë spirale gjithnjë e më të keqe.
- 18 Vendet e adhurimit  
janë veç për **Allahun** –  
pra mos iu lutni askujt tjetër  
pos **Allahut** –
- 19 e megjithatë kur Shërbyesi i **Allahut**<sup>c</sup>

---

<sup>a</sup> Arabët mekasë

<sup>b</sup> Në Kuran, bollëku është sprovë po aq e madhe sa mungesa (shih 21:35), nëse jo më e madhe (shih 10:21-2).

<sup>c</sup> Muhamedi.

rrinte në këmbë për t'iu lutur Atij,  
i bënin presion.

- 72:20 Thuaj: 'I lutem veç Zotit tim,  
Atij nuk i mveshi kurrfarë partneri'
- 21 Thuaj: 'Nuk kam kontroll ndaj kurrfarë dëmi  
apo të mire që mund t'ju ndodhë.'
- 22 Thuaj: 'Askush s'mund të më mbrojë nga **Allahu**:  
nuk kam strehë pos në Të.
- 23 Unë veç përcjelli [çka pranoj] nga **Allahu** –  
veç mesazhet E Tij.'

- Kushdo që nuk i bindet  
**Allahut** dhe Të Dërguarit Të Tij  
do ta ketë Zjarrin e Ferrit  
si shtëpi të përhershme të veten:
- 24 kur përballen me atë  
për të cilën u paralajmëruan,  
do ta kuptojnë  
se kush e ka mbrojtësin më të dobët  
dhe numrin më të vogël.
- 25 Thuaj: 'Nuk e di  
nëse ajo për të cilën jeni paralajmëruar është afër,  
apo nëse Zoti im i ka caktuar kohë të largët.'
- 26 Ai është Ai që e di ç'është e fshehur.
- 27 Nuk ia zbulon atë askujt  
pos një Të Dërguari që Ai e zgjedh.  
Ai çon vëzhgues  
të shkojnë përpara dhe prapa,
- 28 për të siguruar  
që secili nga të dërguarit E Tij  
e dërgon mesazhin e Zotit të tij:  
Ai di gjithçka për ta  
dhe mban llogari për gjithçka.

**Përshkrimi para kaptinës 72 nga Abdel Haleem:**

*Sure mekase që e jep një përshkrim të asaj që e thanë një grup i xhindeve kur ua kapi veshi një recitim të Kuranit dhe e kuptuan të vërtetën e tij (vargjet 1-15). Ky është leksion për arabët mekasë, të cilëve po ashtu u thuhet se Profeti mund t'u ndihmojë veç duke ua dhënë Mesazhin – **Allahu** është I Gjithë-Fuqishmi (vargjet 16-28). Mosbesimtarët kërcënohen me atë që do ta hasin në Ditën e Gjykimit (vargjet 23-27).*

**Shënimet gjuhësore (Thomas Cleary)**

*Xhindet (Shpirtrat, al Finn Kaptina 72)*

Kjo sure u shpall në Mekë. Jinn është me sa duket burimi i fjalës “xhind” (“genius” anglisht). Fjala arabe *majnun*, teknikisht pjesorja pësore e shkuar e foljes së masës së parë e nxjerrë nga rrënja J-N-N, domethënë i pushtuar nga shpirtrat në kuptimin e çmendjes.

6 “çorientim” (*rahaq* – marrëzi, budallallëk): Kjo është nga rrënja R-H-Q dhe e ka edhe kuptimin e shtypjes. Në masën e parë folja domethënë të shkaktosh vuajtje; në masën e katërt domethënë të imponosh vështirësi apo t’i shkaktosh telashe.

23 “veç përcjelli [çka pranoj] nga **Allahu** – veç mesazhet E Tij.’: Një I Dërguar është “i tëhujësuar” nga **Allahu** në kuptimin e të qenët në mes të jetës së kësaj bote në tokë; por ai “mërgim” është për një destinim, atë të të kujtuarit dhe të profecisë.

“si shtëpi të përhershme”: Ndëshkimi i përhershëm është i përhershëm nga pikëpamja njerëzore, jo nga pikëpamja hyjnore.

## 73: I mbështjelluri (EL-MUZZEMMIL)

Në emrin e **Allahut**, Dashamirësit, Mëshirëplotit

<sup>1</sup> Ti [Profet], i mbështjellë në petkun tënd! <sup>2</sup> Rri zgjuar gjatë natës, të tërën pos një pjese të vogël të saj, <sup>3</sup> gjysmën, apo ca më pak, <sup>4</sup> apo ca më shumë; recitoje Kurantin ngadalë dhe qartë: <sup>5</sup> Ne do të ta zbresim një mesazh shumë të rëndësishëm. <sup>6</sup> Lutja e natës<sup>a</sup> krijon përshtypje më të thellë dhe i mpreh fjalët – <sup>7</sup> ditën je i zënë në periudha të gjata – <sup>8</sup> pra festoje emrin e Zotit tënd dhe përkushtojtu me gjithë zemër Atij. <sup>9</sup> Ai është Zoti i lindjes e i perëndimit, nuk ka zot pos Tij, pra merre Atë si Mbrojtësin tënd, <sup>73:10</sup> me durim qëndro ndaj asaj që e thonë, injoroi me mirësjellje, <sup>11</sup> dhe lërmi Mua ata që e refuzojnë të vërtetën dhe jetojnë në luks. Ki durim me ta për pak kohë; <sup>12</sup> Ne kemi pranga, zjarr flakëruës, <sup>13</sup> ushqim që mbetet në fyt dhe torturë agonizuese të ruajtur për ta <sup>14</sup> në Ditën kur toka dhe malet do të shkunden. Malet do të bëhen grumbull i rërës së rralluar.

<sup>15</sup> Ne jua kemi çuar [juve njerëz] një të dërguar që të jetë dëshmitari juaj, siç ia çuam Faraonit një të dërguar, <sup>16</sup> por Faraoni nuk iu bind të dërguarit dhe prandaj i shkaktuam ndëshkim të rëndë. <sup>17</sup> Pra nëse nuk besoni, si mund të ruheni ndaj një Dite që do t'i thinjë flokët e fëmijëve, <sup>18</sup> Ditë kur qielli do të copëtohet? Sigurisht që premtimi i **Allahut** do të përmbushet. <sup>19</sup> Ky është përkujtues. Kush të dëshirojë le ta marrë rrugën për te Zoti i tij.

<sup>73:20</sup> [Profet,] Zoti yt është fare mirë i informuar se nganjëherë ti i kalon rreth dy të tretat e natës në lutje – nganjëherë gjysmën, nganjëherë një të tretën – si edhe disa nga ndjekësit e tu. **Allahu** e përcakton ndarjen e natës e ditës. Ai e di se nuk do të jeni në gjendje ta matni atë dhe Ai është zbutur ndaj të gjithë juve, kështu që recitoni nga Kurani aq sa është e lehtë për ju. Ai e di se disa nga ju do të jenë të sëmurë, disa duke udhëtuar nëpër vend duke e kërkuar mirësinë e **Allahut**, disa duke luftuar në rrugën e **Allahut**: recitoni aq sa është e lehtë për ju, faluni rregullisht, paguajeni lëmshën e përcaktuar dhe bëni për **Allahun** hua të mirë. Çfarëdo të mirë që e depononi për veten do të përmirësohet dhe do të rritet për ju. Luteni **Allahun** për faljen E Tij, Ai është më falësi, më mëshirëploti.

---

<sup>a</sup> Apo 'orët e natës' / 'zgjimi gjatë natës'



**Përshkrimi para kaptinës 73 nga Abdel Haleem:**

*Sure që është pjesërisht mekase shumë e hershme, e pjesërisht medinase (vargu 20). Ky varg e përshkruan se si e lehtësoi **Allahu** regjimin e hershëm të përkushtimit që iu vendos fillimisht Profetit (në vargjet 1-9) për ta përgatitur për mesazhin me peshë të rëndë. Profeti nxitet të jetë i durueshëm (vargjet 10-11), i tregohet për ndëshkimin që i pret mosbesimtarët mekasë në Ferr (vargjet 12-14) dhe i përkujtohet ndëshkimi që i ndodhi Faraonit në këtë jetë (vargjet 15-16).*

## 74: I mbuluar me petkun e tij (EL-MUDDETHHIR)

Në emrin e Allahut, Dashmirësit, Mëshirëplotit

<sup>1</sup> Ti, i mbuluar me petkun tënd, <sup>2</sup> çohu dhe paralajmëro! <sup>3</sup> Shpalle madhësitinë e Zotit tënd; <sup>4</sup> pastrohu;<sup>a</sup> <sup>5</sup> shmangiu krejt ndyrësive;<sup>b</sup> <sup>6</sup> mos u mbingarko dhe mos u dobëso;<sup>c</sup> <sup>7</sup> ji i qëndrueshëm në kauzën e Zotit tënd.

<sup>8</sup> Kur të bjerë Trumpetja, <sup>9</sup> do të jetë Ditë e ankthit për mosbesimtarët. <sup>74:10</sup> Nuk do të kenë kurrfarë lehtësimit. <sup>11</sup> [Profet,] më lër Mua të merrem me atë që e krijova të pafuqishëm,<sup>d</sup> <sup>12</sup> pastaj i dhashë pasuri shumë të madhe, <sup>13</sup> dhe djem për anash, <sup>14</sup> duke ia bërë gjithçka të lehtë – <sup>15</sup> e megjithatë ende shpreson se do t'i jap më shumë. <sup>16</sup> Jo! Ka qenë me kokëfortësi armiqësor ndaj shpalljes Sonë: <sup>17</sup> do t'i shkaktoj torturë spirale. <sup>18</sup> Planifikonte dhe komplotonte – <sup>19</sup> djallëzisht komplotonte! <sup>74:20</sup> egërsisht komplotonte! <sup>21</sup> – dhe shikonte <sup>22</sup> dhe mërrolej e përqueshte <sup>23</sup> dhe largohej e sillej me arrogancë <sup>24</sup> dhe thoshte: 'Kjo është veç magji e vjetër, <sup>25</sup> veç fjalë të një vdekatar!'

<sup>26</sup> Do ta hedh në Zjarrin përcëllues. <sup>27</sup> Çka do të ta shpjegojë se ç'është Zjarri përcëllues? <sup>28</sup> Ai nuk kursen asgjë dhe nuk lë asgjë; <sup>29</sup> e përcëllon mishin e njerëzve; <sup>74:30</sup> janë nëntëmbëdhjetë që janë përgjegjës për të – <sup>31</sup> askush tjetër pos engjëjve të caktuar nga Ne për ta ruajtur Zjarrin e Ferrit – dhe e bëmë numrin<sup>e</sup> e tyre provë për mosbesimtarët. Pra ata të cilëve u është dhënë Shkrimi i Shenjtë do të jenë të sigurt dhe ata që besojnë do t'u rritet besimi: as ata që u është dhënë Shkrimi i Shenjtë as besimtarët nuk do të kenë ndonjë dyshim, por të sëmuret në zemër dhe mosbesimtarët do të thonë: 'Çka ka mundur të nënkuptojë Allahu me këtë përshkrim?' Allahu e lë këdo që do ta lërë të devijojë dhe e udhëzon këdo që do ta udhëzojë – askush nuk i di forcat e Zotit tënd pos Tij – ky [përshkrim] është paralajmërim për vdekatarët. <sup>32</sup> Po – pasha hënën! <sup>33</sup> Pasha natën kalimtare! <sup>34</sup> Pasha agun e ndritshëm! <sup>35</sup> Është një nga gjërat më të fuqishme, <sup>36</sup> paralajmërim për të gjithë vdekatarët, <sup>37</sup> për ata nga ju që zgjedhin të shkojnë përpara dhe për ata që mbeten prapa.

---

<sup>a</sup> Fjalë për fjalë: 'pastroji rrobat e tua' (shih Razi për këtë përdorje idiomatike të *thijab*)

<sup>b</sup> apo 'krejt idhujtarisë'

<sup>c</sup> Një përkthim alternativ do të ishte: 'mos jip, duke shpresuar veç për të marrë'. Përkthimi i dhënë më sipër bazohet në kuptimin e Muxhahid-it të *manna* si 'të dobësohesh'. Shih Razi-n për këtë interpretim, që duket shumë më i përshtatshëm për kontekstin.

<sup>d</sup> Al-Walid ibn al-Mughira, një nga kundërshtarët kokëfortë të Profetit.

<sup>e</sup> Disa e kanë marrë këtë fjalë për fjalë se aludon në një kuptim të veçantë të numrit 19, por shumë më shumë ka gjasa të jetë `idda në kuptimin e 'numrit, grupit' (*al-Mu`jam al-Wasit*).

<sup>38</sup> Secili shpirt mbahet peng për veprat e tij, <sup>39</sup> por Shoqëruesit e të Drejtës do të rrinë <sup>74:40</sup> në Kopshte dhe do të pyesin <sup>41</sup> për fajtorët. <sup>42</sup> ‘Çka ju çoi drejt Zjarrit Përcëllues?’ [do të pyesin] <sup>43</sup> dhe ata do të përgjigjen: ‘Nuk u lutëm; <sup>44</sup> nuk i ushqyem të varfrit; <sup>45</sup> u kënaqëm me të tjerët [duke i tallur besimtarët]; <sup>46</sup> e mohuam Ditën e Gjykimit <sup>47</sup> deri kur na erdhi Fundi i Sigurt.’ <sup>48</sup> S’ka lutje të asnjë ndërmjetësuasi që do t’u sjellë dobi tani.

<sup>49</sup> Si është puna me ta? Pse largohen nga paralajmërimi <sup>74:50</sup> si gomarë të frikësuar <sup>51</sup> që ikin nga një luan? <sup>52</sup> Secili nga ta kërkon t’i zbritet një shkrim i shenjtë e t’i shpaloset para syve – <sup>53</sup> Jo! Vërtet nuk kanë fare frikë për jetën tjetër – <sup>54</sup> por vërtet ky është përkujtues. <sup>55</sup> Kush të dëshirojë le të jetë i vëmendshëm: <sup>56</sup> do të jenë të vëmendshëm veç nëse dëshiron **Allahu**. Ai është Zoti që duhet t’i kushtohet vëmendje, Zoti i falësisë.

**Përshkrimi para kaptinës 74 nga Abdel Haleem:**

*Pas takimit të tij të parë me Engjëllin e Shpalljes në Shpellën e Hirës, Profeti shkoi në shtëpi duke u dridhur dhe i tha gruas së tij ta mbulonte me petkun e tij. Pastaj u shpallën vargjet e para të kësaj sureje mekase (vargjet 1-7). Surja vazhdon, në një pjesë nga një periudhë e mëvonshme, t'ua kujtojë mosbesimtarëve kokëfortë fatin e tyre në Ditën e Gjykimit (vargjet 8-10) dhe veçohet një kundërshtar specifik i Profetit (vargjet 11-31). Fundi i sures (vargjet 39-53) e ekspozon marrëzinë e qëndrimit mendtor të mosbesimtarëve për Shpalljen dhe Ditën e Ringjalljes.*

## 75: Ringjallja (EL-KIJÂME)

Në emrin e Allahut, Dashmirësit, Mëshirëplotit

<sup>1</sup> Për<sup>a</sup> Ditën e Ringjalljes <sup>2</sup> dhe për shpirtin që e turpëron veten! <sup>3</sup> A mendon njeriu se nuk do t'ia ribashkojmë eshtrat? <sup>4</sup> Në fakt, Ne mund t'ia riformësojmë edhe majat e gishtave. <sup>5</sup> E megjithatë njeriu dëshiron ta mohojë atë që është përpara tij: <sup>6</sup> thotë: 'Pra, kur do të jetë kjo Dita e Ringjalljes?'

<sup>7</sup> Kur sytë të verbohen nga shkëlqimi <sup>8</sup> dhe hëna të eklipsohet, <sup>9</sup> kur dielli dhe hëna të bëhen bashkë, <sup>75:10</sup> në atë Ditë njeriu do të thotë: 'Ku mund të shpëtoj?' <sup>11</sup> Vërtet, nuk ka strehë: <sup>12</sup> të gjithë do të kthehen te Zoti yt në atë Ditë. <sup>13</sup> Në atë Ditë, njeriut do t'i tregohet se çka vuri të parën dhe çka vuri të fundit. <sup>14</sup> Vërtet, njeriu është dëshmitar i qartë kundër vetes, <sup>15</sup> përkundër krejt arsyetimeve që mund t'i paraqesë.

<sup>16</sup> [Profet,] mos e nxito gjuhën në përpjekje për ta shpejtuar [mësimin tënd përmendësh për] Shpalljen: <sup>17</sup> Ne do të sigurohemi për mbledhjen dhe recitimën e sigurt të saj. <sup>18</sup> Kur e kemi recituar, përsërite recitimën, <sup>19</sup> dhe Ne do ta bëjmë të qartë.

<sup>75:20</sup> Vërtet [ju njerëz] e doni këtë botë kalimtare <sup>21</sup> dhe e lini pas dore jetën tjetër. <sup>22</sup> Në atë Ditë do të ketë fytyra të ndritshme, <sup>23</sup> që shikojnë kah Zoti i tyre, <sup>24</sup> dhe në atë Ditë do të ketë fytyra të pikëlluara e të dëshpëruara <sup>25</sup> të atyre që e kuptojnë se së shpejti do t'u ndodhë një katastrofë e madhe.

<sup>26</sup> Vërtet, kur shpirti ta arrijë ashtin e qafës; <sup>27</sup> kur thuhet: 'A mund ta shpëtojë ndonjë shërues i magjepsjeve tani?'; <sup>28</sup> kur e di se është lamtumira e fundit; <sup>29</sup> kur t'i bashkohen këmbët:<sup>b</sup> <sup>75:30</sup> në atë ditë do të dërgohet drejt Zotit tënd. <sup>31</sup> Ai as nuk besoi as nuk u lut, <sup>32</sup> por e mohoi të vërtetën dhe u largua, <sup>33</sup> duke u kthyer te populli i tij me krekosje mendjemadhe.

<sup>34</sup> Gjithnjë e më afër ju vjen. <sup>35</sup> Edhe më afër – gjithnjë e më shumë. <sup>36</sup> A mendon njeriu se do të lihet rehat? <sup>c</sup> <sup>37</sup> A nuk ishte veç pikë e spermës së derdhur, <sup>38</sup> që u bë formë ngjitëse, të cilën Allahu e formësoi në përmasë të duhur, <sup>39</sup> duke i bërë nga ajo me shumë kujdes dy gjinitë, mashkullin dhe femrën? <sup>75:40</sup> A nuk e ka Ai – që mund ta bëjë këtë – fuqinë t'i kthejë të vdekurit në jetë?

---

<sup>a</sup> Kjo paraprihet nga një frazë që mund të përkthehet ose 'Beto hem' ose 'Nuk beto hem' (dmth. nuk ka nevojë të beto hem), varësisht se si lexohet *la*.

<sup>b</sup> Kjo merret se i referohet kur kufoma mbështillet me qefin.

<sup>c</sup> Dhe nuk thirret në llogari.

**Përshkrimi para kaptinës 75 nga Abdel Haleem:**

*Sure mekase që merret me Ditën e Ringjalljes dhe mohimin e njeriut për atë Ditë. Fuqia e Allahut përshkruhet bindshëm në disa skica të hijshme letrare (vargjet 3-4, 26-30, 34-40). Paragrafi i tretë e udhëzon Profetin për mënyrën e duhur të pranimit të shpalljes (vargjet 16-19) dhe kështu shërben për ta theksuar se Kurani është vërtet fjala e Allahut.*

## 76: Njeriu<sup>a</sup> (EL-INSÂN)

Në emrin e **Allahut**, Dashmirësit, Mëshirëplotit

<sup>1</sup> A s'ishte një periudhë e kohës kur njeriu nuk ishte asgjë për të cilën mund të flitej?<sup>b</sup> <sup>2</sup> Ne e krijuam njeriun nga një pikë e lëngut të përzier për ta vënë në sprovë; i dhamë dëgjim dhe shikim; <sup>3</sup> e udhëzuam në rrugën e drejtë, pavarësisht a ishte mirënjohës apo jo.

<sup>4</sup> Ne kemi përgatitur zinxhirë, qafore të hekurta dhe Zjarr flakëruës për mosbesimtarët, por <sup>5</sup> të ndershmit do ta kenë një pije të përzier me *kafur*,<sup>c</sup> <sup>6</sup> gurrë burimore për shërbyesit e **Allahut**, që rrjedh me bollëk sipas dëshirës së tyre. <sup>7</sup> Ata i përmbushin zotimet e tyre; ia kanë frikën një dite të mjerimeve të përhapura; <sup>8</sup> u japin ushqim të varfërve, jetimit dhe robit, megjithëse e duan vetë, <sup>9</sup> duke thënë: 'Ju ushqejmë veç për hir të **Allahut**: nuk kërkojmë as shpërblim as falënderime nga ju. <sup>76:10</sup> Ia kemi frikën Ditës së Zotit tonë – Ditë e zymtë mjerimplotë.' <sup>11</sup> Kështu që **Allahu** do t'i shpëtojë nga mjerimet e asaj Dite, do t'u japë shkëlqim e gëzim, <sup>12</sup> dhe do t'i shpërblejë, për qëndrueshmërinë e tyre, me Kopsht dhe rroba mëndafshi. <sup>13</sup> Do të ulen në divane, duke mos ndier as vapë përcëlluese as të ftohtë të ashpër, <sup>14</sup> me [degë] hije-mira të shpërndara mbi ta dhe tufa frutash që varen afër te dora. <sup>15</sup> Do të shërbehen me pjata të argjendta <sup>16</sup> dhe gota shkëlqyese të argjendta sipas qejfit të tyre <sup>17</sup> dhe do t'u jepet një pije e mbushur me xhenxhefil <sup>18</sup> nga një gurrë burimore e quajtur Salsabil. <sup>19</sup> Për ta do të kujdesen të rinj të përhershëm – po të mund t'i shihnit, do të mendonit se janë perla të shpërndara – <sup>76:20</sup> dhe po të shihnit përreth, do të shihnit lumturi dhe pasuri të madhe: <sup>21</sup> do të veshin rroba prej mëndafshit të gjelbër dhe me pëlhurë të mirë; do të zbukurohen me byzylykë argjendi; Zoti i tyre do t'ua japë një pije të pastër. <sup>22</sup> [Do të thuhet:] 'Ky është shpërblimi juaj. Përpyjekjet tuaja janë çmuar.'

<sup>23</sup> Vetë Ne ta kemi zbritur [ty Profet] këtë Kuran në shpallje graduale. <sup>24</sup> Prite Gjykimin e Zotit tënd me durim; mos i lësho pe asnjërit nga këta mëkatarë apo mosbesimtarë; <sup>25</sup> kujtoje emrin e Zotit tënd në ag e mbrëmje; <sup>26</sup> përkulu para Tij dhe lavdoje gjerësisht gjatë natës.

---

<sup>a</sup> Shih fusnotën g, Surja 89: *Insan* 'njeri' shfaqet gjashtëdhjetë e pesë herë në Kuran. Vlen edhe për burrat edhe për gratë, siç i referohet natyrisht 'njeri' në rastin e përgjithshëm në anglisht (dhe shqip).

<sup>b</sup> Fjalë për fjalë: 'A nuk ka ardhur mbi njeriun një periudhë e kohës kur ai nuk përmendej?' Kjo i referohet kohës para se të lindet një person, ku poenta është se ai ishte asgjë, pastaj **Allahu** e krijoi, siç do ta sjellë Ai prapë në jetë për Gjykim.

<sup>c</sup> Bar aromatik.

<sup>27</sup> Këtyre njerëzve u pëlqen jeta e rrufeshme duke lënë mënjanë [tërë mendimet për] një Ditë të Rëndë. <sup>28</sup> E megjithatë Ne i krijuam; e forcua formimin e tyre fizik; po të duam, mund t'i zëvendësojmë plotësisht njerëzit e tillë.

<sup>29</sup> Ky është përkujtues. Kush të dëshirojë, le ta marrë rrugën kah Zoti i tij. <sup>76:30</sup> Por do të dëshironi ta bëni këtë veç nëse dëshiron **Allahu** – **Allahu** është i gjithë-dituri, i gjith'-urti – <sup>31</sup> Ai e pranon këdo që do ta pranojë në Mëshirën E Tij dhe ka përgatitur torturë të dhembshme për mosbesimtarët.



**Përshkrimi para kaptinës 76 nga Abdel Haleem:**

*Sure medinase që flet se si sprovohet njeriu (vargjet 2-3) dhe çfarë do të jenë rezultatet për keqbërësit (vargu 4) dhe për të ndershmit (vargjet 5-22). Profeti nxitet të këmbëngulë në përkushtimin e tij dhe të qëndrojë me durim (vargjet 23-6).*

## 77: [Erërat] Të çuara përpara<sup>a</sup> (EL-MURSELÂT)

Në emrin e **Allahut**, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës

- 1 Pasha [erërat] e çuara përpara butësisht në seri të shpejtë,
- 2 që mësyjnë stuhishëm,
- 3 që shpërndahen gjerë e gjatë,
- 4 që ndahen me forcë,
- 5 që e dërgojnë një përkujtesë,
- 6 si provë a paralajmërim:
- 7 ajo që ju është premtuar
- sigurisht që do të ndodhë.
- 8 Kur yjet të errësohen
- 9 dhe qielli të copëtohet,
- 77:10 kur malet të kthehen në pluhur
- 11 dhe të dërguarve
- t'u jepet koha e tyre e caktuar<sup>b</sup> –
- 12 për cilën Ditë është caktuar e gjithë kjo?
- 13 Ditën e Vendimit.
- 14 Çka do t'jua shpjegojë
- se ç'është Dita e Vendimit?
- 15 Në atë Ditë, mjerë ata
- që e refuzuan të vërtetën!
- 16 A nuk i shkatërruam Ne
- të parët [nga ta]?
- 17 Do t'i bëjmë të mbramët t'i ndjekin ata:
- 18 kështu i trajtojmë fajtorët.
- 19 Në atë Ditë, mjerë ata
- që e refuzuan të vërtetën!

---

<sup>a</sup> Shih 30:48-51 dhe shumë instanca të tjera.

<sup>b</sup> Për të dhënë dëshmi për komunitetet e tyre (Razi).

77:20 A nuk ju bëmë  
nga një lëng i nënvlerësuar  
21 të cilin e vendosëm  
në strehim të sigurt  
22 për një periudhë të përcaktuar?  
23 Ne e përcaktojmë [atë]:  
sa shkëlqyeshëm përcaktojmë!  
24 Në atë Ditë, mjerë ata  
që e refuzuan të vërtetën!  
25 A nuk e bëmë tokën shtëpi  
26 për të gjallët dhe të vdekurit?  
27 A nuk vendosëm male të forta,  
shumë të larta në të  
për t'ju furnizuar me ujë të ëmbël?  
28 Në atë Ditë, mjerë ata  
që e refuzuan të vërtetën!

29 Do t'u thuhet:  
'Shkoni tek ajo  
që dikur e refuzonit!'  
77:30 Shkoni te një hije e tymit!  
Ajo ngritet në tri shtylla;  
31 as s'jep hije, as lehtësim nga flaka;  
32 lëshon shkëndija të mëdha  
sa trungjet e pemëve<sup>a</sup>  
33 dhe të ndritshme si bakri.<sup>b</sup>  
34 Në atë Ditë, mjerë ata  
që e refuzuan të vërtetën!  
35 Në atë Ditë  
do të mbesin pa fjalë,  
36 dhe nuk do t'u jepet shans

---

<sup>a</sup> Një kuptim alternativ i *qasr* është 'pallate, kështjella' por ky kuptim i 'trungjeve të pemëve' duket se përshtatet më mirë (Razi).

<sup>b</sup> Zakonisht përkthehet si 'devet', por 'bakri' (siç raportohet nga Razi) është alternativë më bindëse.

ta ofrojnë ndonjë arsyetim.

37 Në atë Ditë, mjerë ata  
që e refuzuan të vërtetën!

38 [Do t'u thuhet:]  
'Kjo është Dita e Vendimit:  
Ne ju kemi mbledhur juve  
dhe brezat e mëhershëm.

39 Nëse keni çfarëdo plane të fshehta kundër Meje,  
provoni ato tani.'

77:40 Në atë Ditë, mjerë ata  
që e refuzuan të vërtetën!

41 Por ata që ishin të vëmendshëm për **Allahun**  
do të shijojnë hije të freskët, burime,

42 dhe çfarëdo fruti që e kanë merak;

43 [do t'u thuhet:]  
'Hani e pini  
çka t'jua dojë zemra  
si shpërblim për veprat tuaja:

44 kështu i shpërblejmë  
ata që bëjnë mirë.'

45 Në atë Ditë, mjerë ata  
që e refuzuan të vërtetën!

46 [Mund] të hani dhe të kënaqeni për pak kohë,  
ju keqbërësit që jeni.

47 Në atë Ditë, mjerë ata  
që e refuzuan të vërtetën!

48 Kur u thuhet:  
'Përkuluni në lutje',  
nuk veprojnë ashtu.

49 Në atë Ditë, mjerë ata  
që e refuzuan të vërtetën!

77:50 Pra, në çfarë shpallje,

pas kësaj,  
do të besojnë?

**Përshkrimi para kaptinës 77 nga Abdel Haleem:**

*Sure mekase që e përshkruan Ditën e Vendimit: pashmangshmërinë e saj, argumentet për ardhjen e saj dhe ngjarjet që do ta paralajmërojnë Gjykimin, si dhe fatet e besimtarëve dhe mosbesimtarëve.*

**Shënimet gjuhësore (Thomas Cleary)**

*Ata/ato të çuara përpara (al Mursalaat, Kaptina 77)*

Kjo sure u shpall në Mekë. “Ata/ato të çuara përpara” interpretohet se haptas i referohet erërave, duke i simbolizuar Të Dërguarit e **Allahut**.

- 1 “[erërat] e çuara përpara butësisht”: Fjala për “butësisht”, *!urfan*, ka shumë kuptime e nuansa të tjera: drejtësisht, favorshëm, dobishëm, me mirësi, në seri të vazhdueshme. Si emër *!urf* po ashtu domethënë traditë. Rrënja themelore është *!-R-F*, me kuptimin primitiv të dijes. Të dërguarit vijnë me drejtësi, me dobi, me mirësi dhe me dije. E zgjedha kuptimin “butësisht” për ta kontrastuar me “stuhizimin e shpejtë” të rreshtit tjetër, duke iu referuar Mesazhit që fillimisht prezentohej butësisht si lajm i gëzuar, e pastaj mësyn stuhishëm kundër mosmirënjohësve dhe hipokritëve.

## 78: Lajmi i madh<sup>a</sup> (EN-NEBE')

Në emrin e **Allahut**, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës

<sup>1</sup> Për çka po pyesin? <sup>2</sup> Për Lajmin e madh <sup>3</sup> për të cilin dallojnë. <sup>4</sup> Do ta marrin vesh. <sup>5</sup> Në fund do ta marrin vesh. <sup>6</sup> A nuk e bëmë Ne token të lëmuar, <sup>7</sup> dhe i bëmë malet ta mbanin stabile?<sup>b</sup> <sup>8</sup> A nuk ju krijuam në çifte, <sup>9</sup> jua dhamë gjumin për pushim, <sup>78:10</sup> natën si mbulesë, <sup>11</sup> dhe ditën për jetesën tuaj? <sup>12</sup> A nuk i ndërtoam shtatë [qiej] të fortë mbi ju, <sup>13</sup> dhe e bëmë një llambë flakëruese? <sup>14</sup> A nuk dërguam ujë që derdhet nga retë <sup>15</sup> për të sjellë me të drithëra, bimë <sup>16</sup> dhe kopshte të begatshme? <sup>17</sup> Është caktuar një kohë për Ditën e Vendimit: <sup>18</sup> Ditë kur Trumpeta do të tingëllojë dhe do të dilni përpara në turma, <sup>19</sup> kur qielli do të çelet si portale të gjera, <sup>78:20</sup> kur malet do të zhduken si mirazh. <sup>21</sup> Ferri qëndron në pritje, <sup>22</sup> shtëpi për shtypësit <sup>23</sup> që të rrinë shumë, shumë kohë, <sup>24</sup> ku s'do të shijojnë as freski as pije <sup>25</sup> pos asaj që është përvëluese dhe e errët<sup>c</sup> – <sup>26</sup> shpagim i përshtatshëm, <sup>27</sup> se nuk ia kishin dronë llogarisë, <sup>28</sup> dhe i refuzuan mesazhet Tona si gënjeshtër. <sup>29</sup> Kemi regjistruar gjithçka në një Regjistër. <sup>78:30</sup> 'Shijojeni këtë: krejt çka do të merrni nga Ne është më shumë torturë.'

<sup>31</sup> Për ata që ishin të vetëdijshëm për **Allahun** ka përmëshje supreme: <sup>32</sup> kopshte private, vreshta, <sup>33</sup> shoqërues-e të pjekur-a e tërheqës-e, që përshtaten, <sup>34</sup> dhe gotë të tejmbushur. <sup>35</sup> Aty nuk do të dëgjojnë kurrfarë bisede të kotë a gënjeshtare: <sup>36</sup> shpërblim nga Zoti juaj, dhuratë e përshtatshme <sup>37</sup> nga Zoti i qiejve dhe i tokës dhe i gjithçkaje ndërmjet, Zoti i Mëshirës.

Ata nuk do të kenë kurrfarë autoriteti nga Ai për të folur. <sup>38</sup> Në Ditën kur Shpirti<sup>d</sup> dhe engjëjt qëndrojnë në rreshta, ata nuk do të flasin përveç atyre që Zoti i Mëshirës u jep leje, që do ta thonë veç atë që është e drejtë. <sup>39</sup> Ajo është Dita e Të Vërtetës. Pra kushdo që dëshiron ta bëjë këtë duhet ta marrë rrugën që çon te Zoti i tij. <sup>78:40</sup> Ju kemi paralajmëruar për torturë të pashmangshme, në Ditën kur secili person do ta shohë se çka kanë çuar duart e tij përpara për të, kur mosbesimtari do të thotë: 'Ah, t'isha pluhur!' <sup>e</sup>

---

<sup>a</sup> I Ringjalljes dhe Gjykimit.

<sup>b</sup> Fjalë për fjalë: 'dhe malet [si] kunjat [të saj]'

<sup>c</sup> Krahaso me 38:57

<sup>d</sup> Engjëlli Xhebrail (Gabriel)

<sup>e</sup> Në këtë botë, ata shpesh thanë: 'Çka? Kur jemi pluhur, do të ringjallemi prapë?'

**Përshkrimi para kaptinës 78 nga Abdel Haleem:**

*Sure mekase. Mosbesimtarët shpesh pyesnin me mosbesim për Ringjalljen. Kjo sure jep prova të fuqisë së **Allahut**, pastaj e shpjegon se çka do të ndodhë në Ditën e Ringjalljes, si dhe fatet përkatëse të besimtarëve dhe mosbesimtarëve.*



## 79: Kuajt e fuqishëm të luftës (EN-NÂZI‘ÂT)

Në emrin e Allahut, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës

<sup>1</sup> Pasha kuajt e fuqishëm të luftës<sup>a</sup> <sup>2</sup> që mezi presin të nisen, <sup>3</sup> të çajnë përpara me kapacitet të plotë, <sup>4</sup> të tejkalojnë shpejt <sup>5</sup> për ta mbaruar çështjen, <sup>6</sup> në Ditën kur shpërthimi jehon <sup>7</sup> dhe shpërthimi i dytë pason, <sup>8</sup> zemrat do të dridhen <sup>9</sup> dhe sytë do të jenë përdhe. <sup>79:10</sup> Ata<sup>b</sup> thonë: ‘Çka? a do të kthehemi në jetë, <sup>11</sup> pasi që jemi kthyer në eshtra të kalbur?’ <sup>12</sup> dhe thonë: ‘Një kthim i tillë është i pamundur!’ <sup>c</sup> <sup>13</sup> Por do të duhet veç një shpërthim i vetëm, <sup>14</sup> dhe do të kthehen mbi tokë.

<sup>15</sup> A e ke dëgjuar [Profet] rrëfimin e Musait? <sup>16</sup> Zoti i tij i thirri atij në luginën e shenjtë të Tuva-s: <sup>17</sup> ‘Shko te Faraoni, se i ka tejkualuar të gjithë kufijtë, <sup>18</sup> dhe pyete: “A dëshiron të pastrohesh [nga mëkati]? <sup>19</sup> A dëshiron të të udhëzoj te Zoti yt, që të mund të kesh frikë-respekt për Të?”’ <sup>79:20</sup> Musai ia tregoi atij shenjen e madhe, <sup>21</sup> por ai e mohoi dhe [e] refuzoi [besimin]. <sup>22</sup> U largua dhe me ngut <sup>23</sup> i mbloodhi njerëzit e tij, duke shpallur: <sup>24</sup> ‘Unë jam zoti juaj suprem’, <sup>25</sup> kështu që **Allahu** e ndëshkoi me ndëshkim në jetën tjetër si dhe në këtë jetë: <sup>26</sup> vërtet ka mësim në këtë për këdo që ka frikë-respekt për **Allahun**.

<sup>27</sup> Cila është më e vështirë për t’u krjuar: ju njerëz apo qielli që e ndërtoi Ai, <sup>28</sup> duke e ngritur e përsosur, <sup>29</sup> duke i dhënë errësirë natës së tij dhe duke e sjellë shkëlqimin e tij të mëngjesit, <sup>79:30</sup> dhe tokën, po ashtu, e shtriu Ai, <sup>31</sup> duke nxjerrë ujëra e kullota nga ajo, <sup>32</sup> dhe duke vendosur male të qëndrueshme [në të] <sup>33</sup> që ju dhe kafshët tuaja të kënaqeni? <sup>34</sup> Kur të arrijë ngjarja gjigante e perezistueshme <sup>35</sup> në Ditën kur njeriu kujtohet se çka ka bërë <sup>36</sup> dhe Ferri është aty që ta shohin të gjithë, <sup>37</sup> për këdo që ka bërë shkelje <sup>38</sup> dhe e ka preferuar jetën e tanishme <sup>39</sup> Ferri do të jetë shtëpi; <sup>79:40</sup> për këdo që ia kishte dronë takimit me Zotin e tij dhe përmbahej nga meraket më të ulëta, <sup>41</sup> Parajsa do të jetë shtëpi.

<sup>42</sup> Të pyesin [Profet] për Orën, <sup>43</sup> duke thënë: ‘Kur do të arrijë?’ por si mund të [ua] tregosh [atë]? <sup>44</sup> Koha e saj është e njohur veç për Zotin tënd; <sup>45</sup> ti je dërguar veç t’i paralajmërosh ata që ia kanë dronë asaj. <sup>46</sup> Në Ditën që e shohin, do të duket sikur janë sorollatur [në këtë jetë] një mbrëmje [të shumtën,] apo mëngjesin<sup>d</sup> e saj.

---

<sup>a</sup> Ka interpretime të ndryshme për *nazi`at*. Një është se ata janë engjëj që vijnë t’i marrin shpirtrat gjatë vdekjes, që është një zotim i përshtatshëm, meqë kjo është ngjarje e frikshme që nuk mund të shmanget, siç nuk mund të shmanget ora e fundit të botës. Një tjetër është se ata janë kuaj që po shkojnë në ekspeditë ushtarake, duke i bërë zemrat e armikut të dridhen. Për mendimin tim kjo ka më shumë gjasa (shih surën 100). Papritshmëria dhe ndjenja e alarmit në këtë skenë është parashikim simbolik i papritshmërisë dhe tronditjes që do ta shoqërojë fundin e botës.

<sup>b</sup> Mosbesimtarët e Mekës.

<sup>c</sup> Apo (me tallje): ‘Ai do të ishte kthim me humbje!’.

<sup>d</sup> Krahazo me 46:35.

**Përshkrimi para kaptinës 79 nga Abdel Haleem:**

*Sure mekase, tema kryesore e së cilës është mundësia dhe pashmangshmëria e Ringjalljes, e rezultateve dhe e kohës së saj. Rrëfimet e Musait dhe të Faraonit veprojnë si inkurajim për Profetin dhe paralajmërim për mosbesimtarët.*

## 80: Ai u mrrol ('ABESE)

Në emrin e **Allahut**, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës

<sup>1</sup> Ai u mrrol dhe e ktheu shpinën <sup>2</sup> kur iu afrua i verbri – <sup>3</sup> nëse do ta dish,<sup>a</sup> ai do të mund të ngritej shpirtërisht, <sup>4</sup> apo të merrte parasysh diçka të dobishme për të. <sup>5</sup> Për të vetë-kënaqurin <sup>6</sup> përpiqesh posaçërisht – <sup>7</sup> megjithëse nuk je fajtor për mungesën e tij të ngritjes shpirtërore – <sup>8</sup> por nga ai që të ka ardhur plot zell <sup>9</sup> e frikë-respekt <sup>80:10</sup> lejon të shpërqendrohesh. <sup>11</sup> Jo në fakt! Ky [Kuran] është mësim <sup>12</sup> nga i cili ata që duan të mësohen duhet të mësojnë, <sup>13</sup> [i shkruar] në faqe të nderuara, <sup>14</sup> të lartësuara e të pastra <sup>15</sup> nga duart e shkruesve <sup>16</sup> fisnikë e të virtytshëm.

<sup>17</sup> Mjerë njeriu! Sa mosmirënjohës që është! <sup>18</sup> Prej çfarë gjëje e krijon **Allahu**? <sup>19</sup> E krijon nga një pikë, e përpjesëton, <sup>80:20</sup> Ia bën rrugën të lehtë, <sup>21</sup> pastaj shkakton që të vdesë dhe të varroset. <sup>22</sup> Kur Ai do, do ta ngrisë përsëri. <sup>23</sup> E megjithatë njeriu<sup>b</sup> nuk i përmbush urdhrat e **Allahut**. <sup>24</sup> Le ta ketë parasysh njeriu ushqimin që e ha! <sup>25</sup> Ne<sup>c</sup> derdhim ujë të begatshëm <sup>26</sup> dhe bëjmë që toka të çahet. <sup>27</sup> I bëjmë drithërat të rriten, <sup>28</sup> dhe hardhitë, bimësinë e freskët, <sup>29</sup> pemët e ullirit, palmat e hurmave, <sup>80:30</sup> kopshtet e lezetshme, <sup>31</sup> frutat dhe tagjinë: <sup>32</sup> të gjitha që t'i shijoni ju dhe bagëtia juaj.

<sup>33</sup> Kur të vijë Shpërthimi Shurdhues – <sup>34</sup> Dita kur njeriu do të ikë nga vëllai i tij, <sup>35</sup> e ëma, i ati, <sup>36</sup> gruaja, fëmijët e tij: <sup>37</sup> secili nga ta do të preokupohet me shqetësimet e tij në atë Ditë – <sup>38</sup> në atë Ditë disa fytyra do të jenë duke shkëlqyer, <sup>39</sup> duke qeshur e duke u gëzuar, <sup>80:40</sup> por disa fytyra do të jenë të pluhurosura <sup>41</sup> dhe të mbuluara me errësirë: <sup>42</sup> ata janë mosbesimtarët, të shthururit.

---

<sup>a</sup> Kalimi nga të folurit për Profetin në adresimin atij drejtpërdrejt e përforcon qortimin.

<sup>b</sup> Disa komentues konsiderojnë se kjo i referohet veç mosbesimtarëve.

<sup>c</sup> Kjo është zhvendosje në shumësin e madhësisë hyjnore për ta theksuar madhësinë e veprimit; shih *iltifat* në shtojcën “Nga parathëniet e përkthimeve”.

**Përshkrimi para kaptinës 80 nga Abdel Haleem:**

*Sure mekase. Gjersa Profeti po u fliste disa mosbesimtarëve të shquar, duke shpresuar t'i konvertojë, një burrë i verbër mysliman erdhi që të mësojë nga ai, por nga zelli i tij për t'i tërhequr mosbesimtarët në Islam, Profeti iu mrrol atij. Profeti pastaj qortohet dhe i thuhet të mos shqetësohet me mosbesimtarët. Në paragrafin e dytë është një ndëshkim për mosmirënjohjen e njeriut: njeriu bëhet i vetë-kënaqur dhe e harron origjinën e tij dhe kthimin e tij përfundimtar te **Allahu**.*

## 81: Mbështjellë në errësirë (ET-TEKUÎR)

Në emrin e **Allahut**, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës

<sup>1</sup> Kur dielli të mbështillet në errësirë, <sup>2</sup> kur yjet të terrohen, <sup>3</sup> kur malet të vihen në lëvizje, <sup>4</sup> kur devetë shtatzëna të dështojnë, <sup>5</sup> kur bishat e egra të tufëzohen, <sup>6</sup> kur detet të tejklojnë, <sup>7</sup> kur shpirtrat të renditen në klasa, <sup>8</sup> kur foshnjën vajzë të varrosur të gjallë ta pyesin <sup>9</sup> se për çfarë mëkati ishte vrarë,<sup>a</sup> <sup>81:10</sup> kur regjistrat e veprave të hapen gjerë-e-gjatë, <sup>11</sup> kur qielli të zhvishet, <sup>12</sup> kur Ferri të flakërohet, <sup>13</sup> kur Parajsa të sillet pranë: <sup>14</sup> çdo shpirt do ta dijë çka ka shkaktuar.

<sup>15</sup> Beto hem për planetet, <sup>16</sup> që rrotullohen, lëvizin e fshehen, <sup>17</sup> për natën që zbret, <sup>18</sup> për agun që merr frymë butësisht: <sup>19</sup> ky është fjalimi i një të dërguari fisnik,<sup>b</sup> <sup>81:20</sup> që zotëron fuqi të madhe dhe konsiderohet i shquar nga Zoti i Fronit – <sup>21</sup> atij i binden aty dhe i besojnë denjësisht. <sup>22</sup> Shoqëruesi juaj<sup>c</sup> nuk është i çmendur: <sup>23</sup> ai e pa atë<sup>d</sup> në horizontin e qartë. <sup>24</sup> Ai nuk e ndal atë që i shpallet nga përtej. <sup>25</sup> Kjo nuk është fjala e një djalli të dëbuar.

<sup>26</sup> Pra ku po shkoni [ju njerëz]? <sup>27</sup> Ky është mesazh për të gjithë njerëzit; <sup>28</sup> për ata që duan të shkojnë rrugës së drejtë. <sup>29</sup> Por këtë do të dëshironi ta bëni veç me vullnetin e **Allahut**, Zotit të të gjithë njerëzve.

---

<sup>a</sup> Krahaso me 16:58-9. Zakoni arab i infanticidit femëror (vrasjes së fëmijëve femra).

<sup>b</sup> Xhebraili (Gabriel)

<sup>c</sup> Drejtuar mekasve. Shoqëruesi është Profeti.

<sup>d</sup> Xhebrailin.

**Përshkrimi para kaptinës 81 nga Abdel Haleem:**

*Sure mekase që e thekson faktin që njerëzit do të përballen me veprat e tyre në Ditën e Gjykimit, që e pohon të vërtetën e Kuranit dhe që i thërret njerëzit në rrugën e drejtë. Hapet me përshkrim të fuqishëm të ngjarjeve në atë Ditë dhe titulli i sures është marrë nga ky përshkrim.*

## 82: Shkatërruar copa-copa (EL-INFITÂR)

Në emrin e **Allahut**, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës

<sup>1</sup> Kur qielli të shkatërrohet copa-copa, <sup>2</sup> kur yjet të shpartallohen, <sup>3</sup> kur detet të shpërthejnë, <sup>4</sup> kur varret të rrotullohen nga brenda përjashta: <sup>5</sup> secili shpirt do ta dijë se çka ka bërë dhe çka ka lënë pa bërë. <sup>6</sup> Njerëzim, çka ju ka joshur larg **Allahut**, <sup>7</sup> Zotit tuaj bujar, që ju krijoi, ju formësoi, ju përmasoi, <sup>8</sup> në cilëndo formë që zgjodhi? <sup>9</sup> E megjithatë ende e konsideroni Gjykimin gënjeshtër! <sup>82:10</sup> Mbi ju qëndrojnë <sup>11</sup> vëzhgues, regjistruer fisnikë <sup>12</sup> që e dinë se çka bëni: <sup>13</sup> të mirët do të jetojnë në lumturi, <sup>14</sup> dhe të ligët do të digjen në Zjarr. <sup>15</sup> Do të hyjnë në të në Ditën e Gjykimit <sup>16</sup> dhe nuk do të gjejnë shpëtim. <sup>17</sup> Çka do t'jua shpjegojë se ç'është Dita e Gjykimit? <sup>18</sup> Po! Çka do t'jua shpjegojë se ç'është Dita e Gjykimit? <sup>19</sup> Dita kur asnjë shpirt nuk do të mund të bëjë asgjë për një tjetër; në atë Ditë, komanda do t'i përkasë **Allahut**.<sup>a</sup>

---

<sup>a</sup> Apo 'gjithçka varet nga **Allahu**'.

**Përshkrimi para kaptinës 82 nga Abdel Haleem:**

*Sure mekase që merret me mosmirënjohjen e njeriut dhe dështimin e tij që ta pranojë se do të vijë Dita e Gjykimit. Përsëri, surja hapet me përshkrim të fuqishëm të ngjarjeve në Ditën e Gjykimit dhe titulli merret nga ky përshkrim.*



## 83: Ata që matin padrejtësisht (EL-MUTAFFIFÎN)

Në emrin e Allahut, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës

<sup>1</sup> Mjerë ata që matin padrejtësisht, <sup>2</sup> që kërkojnë nga njerëzit e tjerë masë të plotë për veten, <sup>3</sup> por japin më pak se ç'duhet kur janë ata që peshojnë apo matin për të tjerët! <sup>4</sup> A s'e kuptojnë këta njerëz se do të ngriten <sup>5</sup> në një Ditë të fuqishme, <sup>6</sup> Ditë kur secili do të qëndrojë para Zotit të Botëve? <sup>7</sup> Jo në fakt! Lista e të ligëve është në Sixhin<sup>a</sup> – <sup>8</sup> çka do t'jua shpjegojë se ç'është Sixhini? – <sup>9</sup> listë e numërtuar qartë. <sup>83:10</sup> Mjerë mohuesit atë ditë, <sup>11</sup> që e mohojnë Ditën e Gjykimit! <sup>12</sup> Veç agresori i ligë e mohon: <sup>13</sup> kur i recitohen shpalljet Tona, thotë: 'Fabula të lashta!' <sup>14</sup> Jo në fakt! Zemrat e tyre janë mbështjellë me kore me atë që e kanë bërë. <sup>15</sup> Jo në fakt! Në atë Ditë do të ndahen veçmas nga Zoti i tyre, <sup>16</sup> do të digjen në Ferr, <sup>17</sup> dhe do t'u thuhet: 'Kjo është ajo që e quajtët gënjeshtër.'

<sup>18</sup> Jo në fakt! Lista e atyre që janë vërtet të mirë është në Ilijin<sup>b</sup> – <sup>19</sup> çka do t'jua shpjegojë se ç'është Ilijini? – <sup>83:20</sup> listë e shkruar qartë, <sup>21</sup> e dëshmuar nga ata që janë avitur afër. <sup>c</sup> <sup>22</sup> Ata që janë vërtet të mirë do të jetojnë në lumturi, <sup>23</sup> të ulur në divane, duke vështruar përreth. <sup>24</sup> Në ftyrat e tyre do ta vëreni shkëlqimin e lumturisë. <sup>25</sup> Do të shërbehen me nektar të mbyllur mirë, <sup>26</sup> kapaku i tij [i parfumuar me] barishte<sup>d</sup> aromatike – ata që përpiqen, le të përpiqen për këtë – <sup>27</sup> i përzier me ujin e Tesnim-it,<sup>e</sup> <sup>28</sup> burim nga i cili do të pinë ata që janë avitur afër. <sup>29</sup> Të ligët qeshnin me besimtarët – <sup>83:30</sup> ia bënin me sy njëri-tjetrit kur besimtarët u kalonin pranë, <sup>31</sup> talleshin me ta kur ktheheshin te njerëzit e tyre, <sup>32</sup> dhe thoshin, kur i shihnin: 'Këta njerëz janë të kequdhëzuar', <sup>33</sup> megjithëse nuk ishin çuar të jenë kujdestarë të tyre – <sup>34</sup> pra sot<sup>f</sup> besimtarët po qeshin me mosbesimtarët <sup>35</sup> gjersa rrinë ulur në divane, duke vështruar përreth. <sup>36</sup> A [nuk] janë shpaguear mosbesimtarët për veprat e tyre?

---

<sup>a</sup> Rrënja e kësaj fjale, *s-j-n*, është e njëjtë me atë për *sijn* që domethënë 'burg'. Forma është intensive.

<sup>b</sup> Rrënja e kësaj fjale, *'-l-w*, lidhet me lartësinë. Forma është intensive.

<sup>c</sup> Të zgjedhurit. Shih edhe vargun 28.

<sup>d</sup> Një kuptim i *misk* (po ashtu 'myshk').

<sup>e</sup> Rrënja e kësaj fjale, *s-n-m*, sugjeron lartësi dhe begati.

<sup>f</sup> Kjo është në kohën e tashme, sikur të ishte përshkruar në atë Ditë.

**Përshkrimi para kaptinës 83 nga Abdel Haleem:**

*Sure mekase. Praktika e mashtrimit duket të ketë qenë mbizotëruese në Mekë dhe ndëshkohet ashpër këtu dhe gjetiu në Kuran (p.sh. 11:84-8; 7:85). Në sure kontrastohet fati i mashtruesve dhe i mosbesimtarëve me kënaqësinë e rezervuar për të mirët.*

## 84: Shqyer copa-copa (EL-INSHIKÂK)

Në emrin e **Allahut**, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës

<sup>1</sup> Kur qielli të shqyhet copa-copa, <sup>2</sup> duke iu bindur Zotit të tij siç duhet me të drejtë, <sup>3</sup> kur toka të rrafshohet, <sup>4</sup> ta qesë përmbajtjen e saj e të zbrazet, <sup>5</sup> duke iu bindur Zotit të saj siç duhet me të drejtë, <sup>6</sup> ju njerëz, duke u munduar me zell kah Zoti juaj, do ta takoni Atë: <sup>7</sup> kushdo që i jepet regjistri i tij në dorën e djathtë <sup>8</sup> do të ketë llogari të lehtë <sup>9</sup> dhe do të kthehet te njerëzit e tij i kënaqur shumë, <sup>84:10</sup> por kushdo që i jepet regjistri i tij pas shpinës <sup>11</sup> do të lypë shkatërrim – <sup>12</sup> do të digjet në Zjarrin flakëruës. <sup>13</sup> Jetonte në mes të njerëzve të tij i kënaqur shumë. <sup>14</sup> Mendonte se nuk do të kthehej kurrë [te Zoti i tij] – <sup>15</sup> në të vërtetë do të kthehet! Zoti i tij po e vëzhgonte. <sup>16</sup> Beto hem për shkëlqimin e kuqërremtë të perëndimit të diellit, <sup>17</sup> për natën dhe ato që i mbulon, <sup>18</sup> për hënën e plotë: <sup>19</sup> do të kaloni nga faza në fazë.<sup>a</sup>

<sup>84:20</sup> Pra pse nuk besojnë? <sup>21</sup> Pse, kur u lexohet Kurani, nuk [i] bien në gjunjë [Allahut]? <sup>22</sup> Jo! Mosbesimtarët e refuzojnë Kurandin – <sup>23</sup> **Allahu** e di më së miri se çka mbajnë fshehtë përbrenda – <sup>24</sup> pra jepuni lajmin e një torture të dhembshme. <sup>25</sup> Por ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira do të kenë shpërblim të pafund.

---

<sup>a</sup> Siç perëndon dielli, i pasuar nga errësira, që pastaj ndriçohet nga hëna, ju do të lëvizni me faza nga vdekja në ringjallje.

**Përshkrimi para kaptinës 84 nga Abdel Haleem:**

*Sure mekase që merret me pashmangshmërinë e takimit të njeriut me Zotin e tij në Ditën e Gjykimit. Bindja e qiellit dhe e tokës kontrastohet me mosbindjen e mosbesimtarëve. Përshkruhet reagimi i besimtarëve dhe i mosbesimtarëve në Ditën e Gjykimit. Titulli merret nga përshkrimi i ngjarjeve në atë Ditë në vargun hapës.*

## 85: Yjësitë vigane (EL-BURÛXH)

Në emrin e **Allahut**, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës

<sup>1</sup> Pasha qiellin me yjësitë e tij vigane, <sup>2</sup> pasha Ditën e premtuar, <sup>3</sup> pasha Dëshmuesin<sup>a</sup> dhe atë që dëshmohet, <sup>4</sup> të mallkuar ishin ndërtuesit e hendekut,<sup>b</sup> <sup>5</sup> ndërtuesit e zjarrit të ndezur me lëndë djegëse! <sup>6</sup> U ulën përreth <sup>7</sup> për të parë se çka po u bënin besimtarëve. <sup>8</sup> Fyerja e vetme [e besimtarëve] kundër tyre ishte besimi i tyre në **Allahun**, Të Fuqishmin, Të Denjin për Lavd, <sup>9</sup> Të Cilit i përket tërë kontrolli mbi qiejt dhe tokën: **Allahu** është dëshmitar mbi të gjitha gjërat.

<sup>85:10</sup> Për ata që përndjekin burra e gra besimtarë dhe nuk pendohen më pas, do të ketë torturë të Ferrit dhe djegie. <sup>11</sup> Por për ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira do të ketë Kopshte të hijeshuara me lumenj rrjedhës: ky është triumfi i madh. <sup>12</sup> [Profet,] ndëshkimi i Zotit tënd është vërtet i ashpër – <sup>13</sup> është Ai që i sjell njerëzit në jetë dhe do t'i rikthejë në jetë përsëri – <sup>14</sup> dhe Ai është Më Falësi, Më Dashësi. <sup>15</sup> Zoti i Lavdishëm i Fronit, <sup>16</sup> Ai bën çkado që do të bëjë. <sup>17</sup> A [nuk] i ke dëgjuar rrëfimet e forcave <sup>18</sup> të Faraonit e të Themudit? <sup>19</sup> E megjithatë mosbesimtarët këmbëngulin në mohim. <sup>85:20</sup> **Allahu** i rrethon të gjithë.

<sup>21</sup> Ky është vërtet Kuran i lavdishëm <sup>22</sup> [i shkruar] në Pllakë të mbrojtur.<sup>c</sup>

---

<sup>a</sup> **Allahun**.

<sup>b</sup> Janë bërë sugjerime të ndryshme për atë se kush ishin këta ndërtues të hendekut, ndër të tjera, se ishin ata që u urdhëruan ta bëjnë një hendek nga një sundues çifut i Jemenit të shekullit të gjashtë për t'i torturuar të krishterët, po ashtu se pasazhi mund t'i referohet trajtimit që ia bëri Nimrodi Ibrahimit (Razi).

<sup>c</sup> **Allahu** e mban këtë me Vete.

**Përshkrimi para kaptinës 85 nga Abdel Haleem:**

*Kjo sure mekase e forcoi zemrën e Profetit dhe të ndjekësve të tij duke iu referuar fatit të atyre që i torturonin besimtarët e mëhershëm. Titulli e shpreh fuqinë e **Allahut** ndaj tërë gjithësisë, që nga yjet në qiell deri te keqbërësit e përmendur në këtë sure. Në të vërtetë, fuqia E Tij gjithëpërfshirëse është temë e përsëritur nëpër sure.*

## 86: Ai që vjen natën (ET-TÂRIK)

Në emrin e **Allahut**, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës

<sup>1</sup> Pasha qiellin dhe atë që vjen natën – <sup>2</sup> Çka do t’jua shpjegojë se çka është ai që vjen natën? <sup>3</sup> Ylli depërtues – <sup>4</sup> ka vëzhgues për çdo shpirt.

<sup>5</sup> Njeriu duhet të reflektojë për atë se nga çka është krijuar. <sup>6</sup> Është krijuar nga një lëng gufues, <sup>7</sup> pastaj [ai]<sup>a</sup> del nga ndërmjet shtyllës kurrizore dhe kraharorit: <sup>b</sup> <sup>8</sup> **Allahu** sigurisht që është i aftë ta kthejë në jetë. <sup>9</sup> Në Ditën kur zbulohen fshehtësitë <sup>86:10</sup> nuk do të ketë fuqi dhe askë që t’i ndihmojë.

<sup>11</sup> Pasha qiellin dhe shiun e tij të përsëritur, <sup>12</sup> pasha tokën që çahet! <sup>c</sup> <sup>13</sup> Kjo është vërtet deklaratë vendimtare: <sup>14</sup> nuk është për t’u marrë si shaka. <sup>15</sup> Ata komplotojnë e planifikojnë fshehtas, <sup>16</sup> por edhe Unë: <sup>17</sup> [Profet,] ndashtë për mosbesimtarët, ndashtë për ca kohë.

---

<sup>a</sup> Përemri këtu merret se i referohet personit e jo lëngut.

<sup>b</sup> Të nënës, ku ajo e mban foshnjën. Ai del nga mitra siç do të dalë nga varri.

<sup>c</sup> Që të dalin bimët dhe njerëzit në Ditën e Ringjalljes.

**Përshkrimi para kaptinës 86 nga Abdel Haleem:**

*Sure mekase që fokusohet në një seri të shembujve të gjërave që dalin: ylli depërtues i natës, sperma gufuese, foshnja që del befas nga mitra dhe bimët që mbijnë nga toka. Të gjitha këto përdoren për ta ilustruar ringjalljen nga varri.*



## 87: Më i larti (EL-A‘LÂ)

Në emrin e **Allahut**, Dashmirësit, Mëshirëplotit

<sup>1</sup> [Profet,] lavdoje emrin e Zotit Tënd – Më Të Lartit, <sup>2</sup> që [i] krijoi [të gjitha gjërat] në përpjesëtimin e duhur; <sup>3</sup> që i përcaktoi fatet e tyre dhe i udhëzoi ato; <sup>4</sup> që e nxori kullotën e gjelbër <sup>5</sup> pastaj e bëri copëza të errëta <sup>6</sup> [Profet], Ne do të të mësojmë [Kuranin] dhe nuk do të harrosh – <sup>7</sup> pos nëse **Allahu** do; Ai e di edhe çka është e dukshme edhe çka është e fshehur – <sup>8</sup> Ne do të ta tregojmë mënyrën e lehtë.<sup>a</sup> <sup>9</sup> Pra përkujtoji, nëse përkujtimi do të ndihmojë.<sup>b</sup> <sup>87:10</sup> Ata që kanë frikë-respekt për **Allahun** do të jenë të vëmendshëm ndaj përkujtuesit, <sup>11</sup> por ai do të injorohet nga më të ligët, <sup>12</sup> që do të hyjnë në Zjarrin e Madh, <sup>13</sup> ku as s’do të vdesin as s’do të jetojnë.<sup>c</sup> <sup>14</sup> Të përparuar janë ata që pastrohen, <sup>15</sup> e kujtojnë emrin e Zotit të tyre dhe falen e luten. <sup>16</sup> E megjithatë [ju njerëz] e preferoni jetën e kësaj bote, <sup>17</sup> edhe pse E Përtejmeja është më e mirë dhe më e gjatë. <sup>18</sup> Tërë kjo është në shkrimet e shenjta të mëhershme, <sup>19</sup> shkrimet e shenjta të Ibrahimit dhe të Musait.

---

<sup>a</sup> Ose ‘Ne do t’i bëjmë gjërat të lehta për ty’. Fjalë për fjalë: ‘Ne do të ta lehtësojmë kah lehtësia.’

<sup>b</sup> Razi citon shumë raste në Kuran ku kjo strukturë e përcjell kuptimin ‘paralajmëro [të gjithë], pavarësisht a do të ndihmojë paralajmërimi [apo jo?’.

<sup>c</sup> As s’do t’u jepet afati i vdekjes, as s’do të jenë në gjendje ta shijojnë gjendjen e tyre të vazhduar të jetës (Razi).

## *Më i larti*

Në emrin e **Allahut**, Dashmirësit, Mëshirëplotit

1 [Profet,] lavdoje emrin e Zotit Tënd –  
Më Të Lartit,  
2 që [i] krijoi  
[të gjitha gjërat]  
në përpjesëtimin e duhur;  
3 që i përcaktoi fatet e tyre  
dhe i udhëzoi ato;  
4 që e nxori kullotën e gjelbër  
5 pastaj e ktheu në copëza të errëta  
6 [Profet], Ne do të të mësojmë [Kuranin]  
dhe ti nuk do të harrosh –  
7 pos nëse **Allahu** do;  
Ai e di edhe çka është e dukshme  
edhe çka është e fshehur –  
8 Ne do të ta tregojmë  
mënyrën e lehtë.  
9 Pra përkujtoji,  
nëse përkujtimi do të ndihmojë.  
10 Ata që kanë frikë-respekt për **Allahun**  
do të jenë të vëmendshëm ndaj përkujtuesit,  
11 por ai do të injorohet nga më të ligët,  
12 që do të hyjnë në Zjarrin e Madh,  
13 ku as s’do të vdesin as s’do të jetojnë.  
14 Të përparuar janë  
ata që pastrohen,  
15 e kujtojnë emrin e Zotit të tyre,  
dhe luten e falen.

- 16 E megjithatë [ju njerëz]  
e preferoni jetën e kësaj bote,  
17 edhe pse E Përtejmeja  
është më e mirë dhe më e gjatë.  
18 Tërë kjo është  
në shkrimet e shenjta të mëhershme,  
19 shkrimet e shenjta  
të Ibrahimit dhe të Musait.

**Përshkrimi para kaptinës 87 nga Abdel Haleem:**

*Sure mekase që e qetëson Profetin se Allahu do t'i ndihmojë dhe që e nxit të vazhdojë me misionin e tij. Natyra e përkohshme e kësaj bote theksohet përmes përmendjes së jetës së shkurtër të kullotës së gjelbër (krahaso me 10:24; 18:45).*

**Shënimet gjuhësore (Thomas Cleary)**

*Më i larti (al' A'laa) (Kaptina 87)*

Kjo sure u shpall në Mekë.

13 “ku as s’do të vdesin as s’do të jetojnë.”: Ky është njëri nga përshkrimet më të rëndësishme të natyrës së përjetimit të “zjarrit” të “ferrit”.

19 “shkrimet e shenjta të Ibrahimit dhe të Musait”: përsëri natyra vërtet kuint-esenciale (që është shembull i përsosur) dhe prandaj e përhershme e Mesazhit themeltar është rikujtuar duke i cituar traditat antike hanifite dhe çifute si reflektive të Të Vërtetës së njëjtë.

## 88: Ngjarja e fuqishme madhore (EL-GÂSHIJE)

Në emrin e **Allahut**, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës

<sup>1</sup> A të kanë treguar<sup>a</sup> [Profet] për Ngjarjen e Fuqishme Madhore? <sup>2</sup> Në atë Ditë, do të ketë fytyra të poshtëruara, <sup>3</sup> të munduara e të këputura, <sup>4</sup> gjersa hyjnë në Zjarrin flakërues <sup>5</sup> dhe detyrohen të pinë nga një burim që vlon, <sup>6</sup> pa ushqim për ta pos ferrave të hidhura e të thata <sup>7</sup> që as s'ushqejnë as s'e shuajnë urinë. <sup>8</sup> Në atë Ditë do të ketë edhe fytyra rrezatuese me lumturi, <sup>9</sup> të kënaqura shumë me punën e tyre, <sup>88:10</sup> në një kopsht fisnik, <sup>11</sup> ku nuk do ta dëgjojnë asnjë bisedë boshe, <sup>12</sup> me një burim që rrjedh, <sup>13</sup> kolltukë të ngritur, <sup>14</sup> gota të bukura të vëna para tyre, <sup>15</sup> jastëkë të radhitur <sup>16</sup> dhe qilima të shtruar. <sup>17</sup> A nuk e shohin mosbesimtarët se si formohen retë e shiut,<sup>b</sup> <sup>18</sup> si ngriten qiejt lart, <sup>19</sup> si çohen malet përpjetë, <sup>88:20</sup> si shtrihet toka?

<sup>21</sup> Pra [Profet] paralajmëroji: detyra jote e vetme është të paralajmërosh, <sup>22</sup> nuk je aty t'i kontrollosh. <sup>23</sup> Sa për ata që largohen dhe nuk besojnë, <sup>24</sup> **Allahu** do ta shkaktojë torturën më të madhe mbi ta. <sup>25</sup> Te Ne do të kthehen, <sup>26</sup> dhe pastaj na takon Neve t'i thërrasim në llogari.

---

<sup>a</sup> Konstrukt arab për ta tërhequr vëmendjen në atë që vijon.

<sup>b</sup> Fjala *ibl* mund ta ketë kuptimin 'deve' si dhe 're e shiut'. Mirëpo, kjo e dyta është më e mirë në këtë kontekst ndër të gjitha imazhet e tjera gjeografike të paraqitura. Shiu shpesh përdoret për ta ilustruar konceptin e ringjalljes.

**Përshkrimi para kaptinës 88 nga Abdel Haleem:**

*Kjo sure mekase shërben për t'i paralajmëruar mosbesimtarët, për ta trimëruar Profetin dhe besimtarët dhe për ta liruar atë nga përgjegjësia për mosbesimtarët. Titulli vjen nga përshkrimi i ngjarjeve në Ditën e Gjykimit në vargun e parë dhe fytyrat e poshtëruara të mosbesimtarëve në atë Ditë kontrastohen me fytyrat rrezatuese të besimtarëve.*

## 89: Agu (EL-FEXHR)

NË EMRIN E ALLAHUT, DASHAMIRËSIT, MËSHIRËPLOTIT

(1-5)

Pasha agun,

dhe Dhjetë Netët,

Dhe Çiftin e Tekun,

dhe natën kur kalon:

a ka betim në këto  
për ata që kuptojnë?

(14-30)

Zoti yt është vërtet në vëzhgim:

dhe sa për njerëzimin,  
kur Zoti i tyre i sprovon  
duke i nderuar e përkëdhelur,  
thonë:

“Zoti im më ka nderuar!”

Dhe kur Zoti i tyre i sprovon  
duke ua kufizuar jetesën,  
atëherë thonë:

“Zoti im më ka poshtëruar!”

Oh, jo!

Por ju nuk i nderoni jetimët

as s'e nxitni njëri-tjetrin t'i ushqeni të varfrit;

dhe e hani trashëgiminë tuaj  
me grykësi harxhuese,

dhe e doni pasurinë  
me dashuri të tepërt.

Oh, jo!  
Kur toka përimtohet,  
e shtypur në pluhur,

dhe Zoti juaj vjen,  
dhe engjëjt,  
rresht pas rreshti,  
shtyllë pas shtyllë,

dhe në atë ditë  
ferri do të zërë fill  
në atë ditë  
njerëzimi do të kujtohet  
por çfarë dobie do t'u sjellë ai kujtim se?

Do të thonë,  
“Oh, sikur unë  
t'isha përgatitur për jetën time!”

Se në atë ditë  
askush s'mund ta shkaktojë  
ndëshkimin e **Allahut**,

dhe askush s'mund t'i lidhë  
lidhjet e **Allahut**.



O shpirt,  
në paqe të plotnuar,

kthehu te Zoti yt,  
i kënaqur e i pranuar.

Bashkohju shoqërisë së shërbyesve të Mi

dhe hyr në Kopshtin Tim.

89. AGU

Në emrin e Allahut, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës

<sup>1</sup> Pasha Agun, <sup>2</sup> pasha Dhjetë Netët,<sup>a</sup> <sup>3</sup> pasha çiftin e tekun,<sup>b</sup> <sup>4</sup> pasha natën kalimtare<sup>c</sup> – <sup>5</sup> a është ky betim mjaft i fuqishëm për një person racional?

<sup>6</sup> A e ke menduar [Profet] si u mor Zoti yt me [njerëzit] e Adit,<sup>d</sup> <sup>7</sup> të Iremit, [qytetit] të shtyllave fisnike, <sup>8</sup> të tilla që nuk janë bërë në asnjë vend, <sup>9</sup> dhe të Themudit,<sup>e</sup> që gërmuan në shkëmbijtë e luginës, <sup>89:10</sup> dhe të Faraonit të fortë e të fuqishëm<sup>f</sup> ? <sup>11</sup> Të gjithë ata bënë teprime në vendet e tyre, <sup>12</sup> dhe shpërndanë korrupsion atje: <sup>13</sup> Zoti yt e lejoi një kamxhik të ndëshkimit të lëshuar mbi ta. <sup>14</sup> Zoti yt është gjithmonë vigjilent.

<sup>15</sup> [Natyra e] njeriut<sup>g</sup> është që, kur Zoti i tij e sprovon përmes nderimit e bekimeve, ai thotë: ‘Zoti im më ka nderuar’, <sup>16</sup> por kur Ai e sprovon përmes kufizimit të furnizimit të tij, ai thotë: ‘Zoti im më ka poshtëruar’. <sup>17</sup> Jo në fakt! Ju [njerëz] nuk i nderoni jetimët, <sup>18</sup> nuk e nxitni njëri-tjetrin t’i ushqeni të varfrit, <sup>19</sup> e shpenzoni trashëgiminë<sup>h</sup> me lakmi, <sup>89:20</sup> dhe e doni pasurinë me pasion. <sup>21</sup> Jo në fakt! Kur toka të shtypet deri në pluhur, të shtypet e të shtypet, <sup>22</sup> kur Zoti juaj të vijë me engjëjt, rresht pas rreshti, <sup>23</sup> kur Ferri është ajo Ditë e sjellë afër – në atë Ditë njeriu do të jetë i vëmendshëm, por çka do t’i hyjë në punë atëherë se? <sup>24</sup> Do të thotë: ‘Ah po të kisha furnizuar për këtë jetën që po vjen!’ <sup>25</sup> Në atë Ditë, askush nuk do të ndëshkojë siç ndëshkon Ai, <sup>26</sup> dhe askush nuk do të lidhë siç lidh Ai. <sup>27</sup> [Por] ti, shpirt në paqe:<sup>i</sup> <sup>28</sup> kthehu Zotit tënd i kënaqur mirë e që kënaq mirë; <sup>29</sup> shko ndër shërbyesit E Mi; <sup>89:30</sup> dhe në Kopshtin Tim.’

---

<sup>a</sup> Kjo i referohet dhjetë netëve të para të muajit të Dhu ‘1-Hijjah, i shenjtë para dhe pas kohës së Profetit, që kulmon në pelegrinazhin e Haxhit.

<sup>b</sup> Kjo është interpretuar në shumë mënyra: si referencë për numrat (siç është përkthyer këtu); apo p.sh. si shumësia (krijimi i Allahut) dhe Një-shi (Vetë Allahu).

<sup>c</sup> Plotësimi i këtij betimi është lënë i papërmendur, që të kuptohet nga ajo që vijon. Komentuesit e përdorin këtë për ta përfunduar betimin me ‘ata do të ndëshkohen’ në bazë të kontekstit e asaj që vijon. Mospërfundimi e përforcon betimin, meqë njeriu duhet të mendojë më me kujdes për ta rrokur atë, mjet ky i njohur në retorikën arabe si *hadhf al-xhawab* (krahaso me 38:1; 50:1).

<sup>d</sup> Shih 26:123 e tutje.

<sup>e</sup> Shih 26:141 e tutje.

<sup>f</sup> *Dhu’l-awtad*, ‘i kunjave’, shpjegohet si shprehje beduine që përcjell forcë e fuqi. Një interpretim tjetër është se Faraoni i përdorte kunjat si zbatues të torturës.

<sup>g</sup> *Insan* ‘njeri’ shfaqet gjashtëdhjetë e pesë herë në Kuran. Vlen edhe për burrat edhe për gratë, siç i referohet natyrisht ‘njeri’ në rastin e përgjithshëm në anglisht (dhe shqip).

<sup>h</sup> Kjo mund t’i referohet trashëgimisë së jetimëve (shih 4:2 dhe 4:10) apo trashëgimisë në përgjithësi.

<sup>i</sup> Në paqe përmes kujtimit të Allahut në këtë jetë dhe në jetën tjetër (krahaso me 13:28), për dallim nga mosbesimtari që është i vëmendshëm veç në Ditën e Gjykimit, kur nuk do t’i hyjë në punë. Ka *iltifat* këtu: mëkatarët përmenden në vetën e tretë gjersa të nderuarit adresohen drejtpërdrejt nga Zoti i tyre.

**Përshkrimi para kaptinës 89 nga Abdel Haleem:**

*Sure mekase në të cilën Allahu e thekson (me betim) se tiranët e kohës së Profetit do të jenë si ata me të cilët u mor në të shkuarën. Surja e krahason fatin e mosmirënjohësve me atë të shpirtrave në paqe.*

**Shënimet gjuhësore (Thomas Cleary)**

*Agu (al Fajr) (Kaptina 89)*

Kjo sure ishte shpallur në Mekë.

- 1 “Pasha agun”: agu i arritjes së kuptimit (realizimit)
- 2 “Dhjetë Netët”: Ka interpretime të ndryshme: një është se kjo i referohet dhjetë netëve të stinës së pelegrinazhit në faltoren e shenjtë në Mekë; një tjetër është se i referohet dhjetë viteve të misionit të Muhamedit si profet gjatë të cilave iu ekspozua shtypjes së tmerrshme dhe shumica e popullit të tij mbetën në padije.
- 3 “Çiftin e Tekun”: Kur Muhamedi - Profeti – u shpëtoi vrasësve mekasë me shokun e tij të besuar Ebu Bekrin, në një moment ata dy kërkuan strehë në një shpellë. Ndjekësit e tyre, që ishin afër, erdhën të hyrja e shpellës dhe veç çka s’kishin hyrë, ku do ta gjenin Profetin e strehuar dhe shoqëruesin e tij. Kur Ebu Bekri ia shprehu frikën e tij Muhamedit, Profeti tha: “A mendon se jemi vetëm? Është një i tretë me ne”, duke iu referuar Zotit. Ata patën shpëtuar kur vrasësit në tentativë e vërejtën një rrjetë të merimangës përgjatë hyrjes së shpellës dhe erdhën në përfundim se të strehuarit nuk do të kishin mundur të fsheheshin aty. Çifti (“Dy”) i referohet Profetit dhe shoqëruesit të tij; Teku i referohet Zotit.

Po ashtu, Çifti dhe Teku mund të interpretohen se i referohen njerëzimit (apo të gjitha krijesave) dhe Zotit, meqë njerëzimi vjen në çifte (“çifti”) dhe Zoti është unik (“tek”).

- 25 “askush s’mund ta shkaktojë ndëshkimin e **Allahut**”: E Zotit është fuqia vendimtare dhe ndëshkimi i Zotit është përjetim i një shkalle përtej gjithçkaje që mund ta konceptojë mendja e cilitdo njeri.
- 26 “dhe askush s’mund t’i lidhë lidhjet e **Allahut**”: Ngjashëm, afërsia e Zotit dhe intimiteti ndërmjet Zotit dhe shpirttrave të pranuar janë përjetime përtej gjithçkaje në botën e kuptimit, shqisës apo ndjenjës së zakonshme.
- 27 “O shpirt, në paqe të plotnuar” (*yaa ayyuhaa n nafsū l mutma’innatu*): Shpirti në paqe të plotnuar, *al nafs al mutma’inna*, është e katërta nga shtatë fazat e zhvillimit të vetëdijesisë sipas një sistemi Sufi. Mbiemrat në vargun 28: “i kënaqur e i pranuar” (apo “i kënaqur e kënaqës”), *raadiya wa mardiyya*, i paraqesin fazën e pestë dhe të gjashtë. Faza e shtatë në sistemin Sufi është ajo e pastrimit dhe e kompletimit, e përfaqësuar këtu qartësisht me pranimin në shoqërinë e të përkushtuarve të Zotit dhe hyrjen në Kopsht.

## 90: Qyteti (EL-BELED)

NË EMRIN E ALLAHUT, DASHAMIRËSIT, MËSHIRËPLOTIT

(1-20)

Betohem për këtë qytet

– dhe ti je banor i lirë në këtë qytet –

dhe për lindësin dhe të lindurin:

sigurisht që Ne e kemi krijuar njerëzimin në vështirësi.

A mendojnë se askush nuk ka pushtet mbi ta?

Thonë se kanë shpenzuar shumë pasuri;

a mendojnë se askush s'i sheh?

A s'ua kemi dhënë dy sy,

dhe një gjuhë, e dy buzë?

Dhe ua kemi treguar

dy rrugët e gjera.

Por a s'janë nisur

në rrugën e pjerrët

Dhe çka do t'ju njoftojë

se ç'është rruga e pjerrët?

Ta çlirosh një skllav,

apo ta ushqesh në ditë urie

një të afërm jetim

a një të varfër në mjerim.

Atëherë njeriu do të jetë nga ata që besojnë,  
dhe do ta këshillojë fort durimin ndaj tjetrit  
dhe do ta nxisin njëri-tjetrin në mirësi:

ata janë shoqëria në Dorën e Djathtë.

Por ata që i hedhin poshtë shenjat tona,  
ata janë shoqëria në Dorën e Majtë:

mbi ta do të ketë dhomë zjarri me kupolë.

## 90. QYTETI

Në emrin e **Allahut**, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës

<sup>1</sup> Betohe për këtë qytet<sup>a</sup> – <sup>2</sup> dhe ti [Profet] je banor<sup>b</sup> i këtij qyteti – <sup>3</sup> [betohe] për prindin dhe të lindurin, <sup>4</sup> se Ne e kemi krijuar njeriun për punë të rënda dhe sprovë. <sup>5</sup> A mendon ai se askush nuk do të ketë pushtet mbi të? <sup>6</sup> ‘Kam shpenzuar pa hesap pasuri të madhe’, thotë. <sup>7</sup> A mendon se askush nuk e vëzhgon? <sup>8</sup> A s’i dhamë Ne sy, <sup>9</sup> gjuhë, buzë, <sup>90:10</sup> dhe ia treguam dy rrugët e qarta [të të mirës e të të keqes]? <sup>11</sup> E prapë nuk u përpoq në rrugën e pjerrët. <sup>12</sup> Çka do t’jua shpjegojë se ç’është rruga e pjerrët? <sup>13</sup> Është ta çlirosh një skllav, <sup>14</sup> ta ushqesh në kohë urie <sup>15</sup> një të afërm jetim <sup>16</sup> a një person të varfër në ankth, <sup>17</sup> dhe të jesh një nga ata që besojnë dhe e nxisin njëri-tjetrin në qëndrueshmëri e dhembshuri. <sup>18</sup> Ata që e bëjnë këtë do të jenë në anën e dorës së djathtë, <sup>19</sup> por ata që nuk besojnë në shpalljet Tona do të jenë në anën e dorës së majtë, <sup>90:20</sup> dhe Zjarri do t’i rrethojë përmbi.

---

<sup>a</sup> Meka.

<sup>b</sup> *Hillun bi* mund ta ketë kuptimin ‘lojë fer’ për mosbesimtarët, madje edhe në këtë qytet të paprekshëm, ‘banor i përhershëm’, ‘i lirë të jetosh’; disa e shohin se e ka kuptimin se Profeti është banor i përkohshëm, të tjerë se e profetizon kthimin e tij pas emigrimit në Medinë.

**Përshkrimi para kaptinës 90 nga Abdel Haleem:**

*E shpallur në Mekë. Poenta e kësaj sureje është se njeriu është krijuar të punojë dhe të gjykohej. Prandaj ai duhet të kërkojë të bëjë vepra të mira e jo të kënaqet në arrogancë e kotësi.*

**Shënimet gjuhësore (Thomas Cleary)**

*Qyteti (al Balad) (Kaptina 90)*

Kjo sure ishte shpallur në Mekë, që është pikërisht qyteti të cilit i referohet, vendlindja e Profetit Muhamed, i cili adresohet si banor i lirë i qytetit. Simbolikisht, kjo mund t'i referohet Sigurisë (*Salaama*) si e drejtë që nga lindja e çdo shpirti, e arritur duke iu dorëzuar vullnetit të Zotit (*Islaam*), që është realizimi i natyrës së vërtetë të shpirtit.

4 “Ne e kemi krijuar njerëzimin në vështirësi”: fjala për “vështirësi”, *kabad* (“telash, mjerim”), vjen nga rrënja K-B-D. Masa e parë e rrënjës domethënë ta mundosh rëndë, ta dobësosh shumë; masa e dytë domethënë të shkaktosh diçka të pakëndshme; masa e tretë domethënë të durosh, të vuash, të qëndrosh; masa e pestë domethënë të përjetosh diçka të pakëndshme por të nevojshme, të jesh i ekspozuar, të qëndrosh, të të duhet të marrësh diçka mbi vete, ta durosh një kosto, ta marrësh qendrën apo të futesh në mes të një situatë, apo të jesh zeniti. Të gjitha bashkë këto asociacione të nxjerra e pikturojnë një pikturë të gjallë të situatës së vështirë të njerëzimit.

18-19 Shoqëria në Dorën e Djathtë (të Zotit) janë njerëzit e shpëtimit; shoqëria në Dorën e Majtë janë njerëzit e mallkimit.



## 91: Dielli (ESH-SHEMS)

Në emrin e **Allahut**, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës

<sup>1</sup> Pasha diellin në shkëlqimin e tij të mëngjesit <sup>2</sup> dhe pasha hënën siç e vijon, <sup>3</sup> pasha ditën siç e shfaq lavdinë e diellit <sup>4</sup> dhe pasha natën siç e fsheh, <sup>5</sup> pasha qiellin dhe siç e ndërtoi Ai <sup>6</sup> dhe pasha tokën dhe siç e shtriu, <sup>7</sup> pasha shpirtin dhe siç e formoi Ai <sup>8</sup> dhe e frymëzoi [ta njohë] rebelimin dhe devotshmërinë e tij! <sup>9</sup> Ai që e pastron shpirtin e tij ka sukses <sup>9:10</sup> dhe ai që e korrupton – dështon. <sup>11</sup> Në egërsinë e tyre arrogante, njerëzit e Themudit<sup>a</sup> e quajtën [të dërguarin e tyre] gënjeshtar, <sup>12</sup> kur njeriu më i lig ndër ta u ngrit [kundër tij].<sup>b</sup> <sup>13</sup> I dërguari i **Allahut** u tha: ‘Devja e **Allahut** [ta lini] të pijë’, <sup>14</sup> por e quajtën gënjeshtar dhe e gjymtuan atë. Zoti i tyre i shkatërroi për krimin e tyre dhe i rrafshoi. <sup>15</sup> Nuk hezitoi<sup>c</sup> t’i ndëshkojë.<sup>d</sup>

---

<sup>a</sup> Shih p.sh. 7:73-9 (për fisin e Themudit)

<sup>b</sup> Krahaso me 54:29

<sup>c</sup> Fjalë për fjalë ‘nuk ka frikë’

<sup>d</sup> Një nga kuptimet leksikore të ‘*uqba*’ është ‘*jaza*’, këtu ‘të ndëshkosh’; apo ‘nuk i frikësohet pasojave’.

**Përshkrimi para kaptinës 91 nga Abdel Haleem:**

*Sure mekase, tema qendrore e të cilës është pastrimi apo korruptimi i shpirtit, me fisin e Themudit të dhënë si shembull të korrupsionit.*

## 92: Nata (EL-LEJL)

NË EMRIN E ALLAHUT, DASHAMIRËSIT, MËSHIRËPLOTIT

(1-21)

Pasha natën kur është terr,

dhe ditën kur është dritë,

dhe krijimin e mashkullit e të femrës,

sigurisht që përpjekjet tuaja janë të ndryshme.

Sa për ata që japin

dhe janë të vetëdijshëm

dhe besojnë në të mirën e të drejtën,

Ne do t'u mundësojmë lehtësi.

Sa për ata që janë koprracë

dhe të ngopur vetëkënaqshëm

dhe heqin dorë nga e mira dhe e drejta,

do t'u mundësojmë vështirësi.

Dhe pasuria e tyre nuk u hyn në punë

kur të bien.

Se udhëzimi varet nga Ne,

dhe e përtejma dhe kjo botë janë Tonat.

Pra Unë ju paralajmëroj të gjithëve për një zjarr të ashpër flakërues:

askush s' do të hyjë në të pos më të këqinjte,

që e hedhin poshtë të vërtetën dhe refuzojnë.

Dhe më të vetëdijsmit i rrijnë larg atij,

ata që japin nga pasuria e tyre për t'u bërë të pastër,

pa pasur asnjë favor  
t'i shpaguehet askujt,

por veç duke e pasur merak pranimit  
e Zotit të tyre, Më të Lartit,

që sigurisht që do të jenë të kënaqur.

## 92. NATA

Në emrin e **Allahut**, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës

<sup>1</sup> Pasha natën mbështjellëse, <sup>2</sup> pasha ditën rrezatuese, <sup>3</sup> pasha krijimin<sup>a</sup> E Tij të mashkullit e të femrës! <sup>4</sup> Rrugët që i ndërmerrni dallojnë shumë. <sup>5</sup> Është ai që jep, që është i vetëdijshëm për **Allahun**, <sup>6</sup> që dëshmon për mirësinë – <sup>7</sup> Ne do t'ia zbusim rrugën kah lehtësia. <sup>8</sup> Është ai që është koprrac, që është i vetë-kënaqur, <sup>9</sup> që e mohon mirësinë – <sup>92:10</sup> Ne do t'ia lehtësojmë rrugën kah vështirësia <sup>11</sup> dhe pasuria e tij nuk do t'i ndihmojë gjersa ai bie.<sup>b</sup>

<sup>12</sup> Pjesa Jonë është të ofrojmë udhëzim – <sup>13</sup> kjo botë dhe tjetra na përkasin Neve – <sup>14</sup> prandaj Unë ju paralajmëroj për Zjarrin e furishëm, <sup>15</sup> ku s'do të digjet askush pos më i ligu, <sup>16</sup> që [e] refuzoi [të vërtetën] dhe u largua. <sup>17</sup> Më i devotshmi do të kursehet nga kjo – <sup>18</sup> ai që e fal pasurinë e tij si vetë-pastrim, <sup>19</sup> jo për t'ia kthyer një favor dikujt <sup>92:20</sup> por për hir të Zotit të tij Më të Lartit<sup>c</sup> – <sup>21</sup> dhe ai do të jetë i kënaqur shumë.

---

<sup>a</sup> Apo 'pasha Atë që krijoi. . . '

<sup>b</sup> Apo 'çka do t'i hyjë në punë pasuria e tij kur bie?'

<sup>c</sup> Fjalë për fjalë 'për hir të Fytyrës së Zotit të tij'.

**Përshkrimi para kaptinës 92 nga Abdel Haleem:**

*Sure mekase që i tregon pasojat e rrugëve që njerëzit i zgjedhin dhe që e thekson udhëzimin dhe paralajmërimin e Allahut.*

**Shënimet gjuhësore (Thomas Cleary)**

*Nata (al Layl) (Kaptina 92)*

E shpallur në Mekë.

21 “që sigurisht që do të jenë të kënaqur”: Kjo mund të kuptohet, këtu, t’i referohet kënaqësisë së Zotit në veprimet e sapo-përshkruara. Mund të lexohet po ashtu si “dhe (ata) sigurisht që do të jenë të gëzuar me arritjet”, duke iu referuar shpërblimit të atyre që veprojnë në atë mënyrë.

## 93: Shndritja e mëngjesit (ED-DUHÂ)

Në emrin e **Allahut**, Dashmirësit, Mëshirëplotit

<sup>1</sup> Pasha shndritjen e mëngjesit <sup>2</sup> dhe pasha natën kur qetohet në prehje, <sup>3</sup> Zoti yt nuk të ka braktisur [Profet], as nuk të urren, <sup>4</sup> dhe e ardhmja do të jetë për ty më e mirë se e shkuara; <sup>5</sup> sigurisht që Zoti yt do të të japë kaq shumë sa që do të jesh fort i kënaqur. <sup>6</sup> A nuk të gjeti Ai jetim dhe të strehoi? <sup>7</sup> A nuk të gjeti të humbur dhe të udhëzoi? <sup>8</sup> A nuk të gjeti në zor dhe të bëri të vetë-mjaftueshëm?

<sup>9</sup> Pra mos ji i ashpër me jetimin <sup>93:10</sup> dhe mos e qorto atë që lyp ndihmë; <sup>11</sup> fol për bekimet e Zotit tënd.

**Përshkrimi para kaptinës 93 nga Abdel Haleem:**

*Sure e hershme mekase që i drejtohet Profetit, për ta qetësuar e siguruar, pasi nuk kishte pranuar shpallje për ca kohë, se Zoti i tij nuk e kishte braktisur.*



## 94: Lehtësimi (EL-INSHIRÂH)

Në emrin e **Allahut**, Dashamirësit, Mëshirëplotit

<sup>1</sup> A nuk ta lehtësuam Ne zemrën [Profet], <sup>2</sup> dhe ta hoqëm barrën <sup>3</sup> që të peshonte kaq rëndë mbi kurriz, <sup>4</sup> dhe ta rritëm reputacionin fort? <sup>5</sup> Pra vërtet ku ka vështirësi ka edhe lehtësim; <sup>6</sup> vërtet ku ka vështirësi ka edhe lehtësim. <sup>7</sup> Në çastin kur lirohesh [nga një punë] – puno tutje, <sup>8</sup> dhe drejtoju Zotit tënd për gjithçka.

## *Lehtësimi*

Në emrin e Allahut, Dashamirësit, Mëshirëplotit

1       A nuk ta lehtësuam Ne  
          zemrën [Profet],  
2       dhe ta hoqëm barrën  
3       që të peshonte  
          kaq rëndë mbi kurriz,  
4       dhe ta rritëm reputacionin fort?  
5       Pra vërtet ku ka vështirësi  
          ka edhe lehtësim;  
6       vërtet ku ka vështirësi  
          ka edhe lehtësim.  
7       Në çastin kur lirohesh [nga një punë] –  
          puno tutje,  
8       dhe drejtoju Zotit tënd  
          për gjithçka.

**Përshkrimi para kaptinës 94 nga Abdel Haleem:**

*Kjo sure mekase, drejtuar Profetit, është vazhdim i sigurimit dhe trimërimin të dhënë në suren 93.*

**Shënimet gjuhësore (Thomas Cleary)**

*Lehtësimi (al 'Inshiraah) (Kaptina 94)*

Kjo sure u shpall në Mekë.

- 7 “Në çastin kur lirohesh [nga një punë] – puno tutje”: Kurrë mos e lejo veten të kesh vetëbesim e relaksim të tepruar dhe të jesh i vetë-kënaqur, madje edhe kur e ke kryer një detyrë me sukses.
  
- 8 “dhe drejtoju Zotit tënd për gjithçka”: Gjithmonë mbaje mend burimin e tërë suksesit. Frazja e fundit: *wa 'ilaa rabbika fa rghab*, mund të lexohet: “dhe drejtoja lutjet Zotit tënd”, apo “dhe kërko (veç) nga Zoti yt”, duke sugjeruar se njeriu nuk duhet të mbështetet në sukses të kësaj bote apo përkrahje të kësaj bote, edhe në qoftë për sukses e përkrahje më të madhe.

## 95: Fiku (ET-TÎN)

Në emrin e **Allahut**, Dashamirësit, Mëshirëplotit

<sup>1</sup> Pasha fikun, pasha ullirin, <sup>2</sup> pasha Malin Sinai, <sup>3</sup> pasha këtë qytet të sigurt, <sup>a</sup>  
<sup>4</sup> Ne e krijojmë njeriun në gjendjen më të mirë <sup>5</sup> pastaj e zvogëlojmë në më të  
ultën e të ultës, <sup>6</sup> përveç atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira – <sup>7</sup> ata do të kenë  
shpërblim të pandërprerë. Pas kësaj, çka të bën [ty njeri] ta mohosh Gjykimin? <sup>b</sup>  
<sup>8</sup> A nuk është **Allahu** më i vendosuri nga gjykatësit? <sup>c</sup>

---

<sup>a</sup> Meka.

<sup>b</sup> Apo 'kush do të mund të thoshte se [ti Profet] po gënjen për Gjykimin?' (Razi)

<sup>c</sup> **Allahu** nuk do të të krijonte dhe të të linte pa Gjykim (krahaso me 23:115-6).

**Përshkrimi para kaptinës 95 nga Abdel Haleem:**

*Sure mekase që pyet se si mund ta mohojë njeriu Gjykimin dhe që e thekson rëndësinë e besimit dhe veprave të mira.*

## 96: Forma ngjitëse – Recito! (EL-‘ALAK)

*Recito!*

NË EMRIN E **ALLAHUT**, DASHAMIRËSIT, MËSHIRËPLOTIT

(1-19)

Recito,  
në emrin e Zotit tënd,  
që krijoi:

që e krijoi njerëzimin  
nga një dromcë gjaku.

Recito,  
se Zoti yt është më bujari,

që dha mësim përmes penës,

ia mësoi njerëzimit  
atë që [njerëzimi] nuk e dinte.

Oh, jo!  
Vërtet njerëzimi shkon tepër larg

në konsiderimin e vetes si i vetë-mjaftueshëm:

në fakt kthimi është te Zoti juaj.

A e sheh atë që e pengon

shërbyesin të lutet?

A e sheh se a është ai në udhëzim,

apo a i drejton të tjerët të jenë të vetëdijsëm?

A e sheh se a e hedh ai poshtë të vërtetën dhe largohet?

A s'e di ai se **Allahu** sheh?

Oh, jo!

Nëse nuk pushon,

Ne do ta zvarrisim për flokë të ballit,

tufë flokësh gënjeshtare, mëkatare.

Le t'i thërrasë ortakët e tij pastaj:

Ne do t'i thërrasim rojat e ferrit.

Oh, jo!

Mos iu bind:

përkulu dhe avitu më afër **Allahut**.

## 96. FORMA NGJITËSE<sup>a</sup>

Në emrin e **Allahut**, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës

<sup>1</sup> Lexo! Në emrin e Zotit tënd që krijoi: <sup>2</sup> Ai e krijoi njeriun<sup>b</sup> nga një formë ngjitëse. <sup>3</sup> Lexo! Zoti yt është Më Bujari <sup>4</sup> që dha mësim përmes [mjetit të] penës, <sup>5</sup> që ia mësoi njeriut atë që nuk e ka ditur.

<sup>6</sup> Por njeriu i tejkalon të gjithë kufijtë <sup>7</sup> kur mendon se është i vetëmjaftueshëm: <sup>8</sup> [Profet,] të gjithë do të kthehen te Zoti yt. <sup>9</sup> A e ke parë njeriun që e pengon <sup>96:10</sup> shërbyesin [Tonë] të falet? <sup>11</sup> A e ke parë se a është i udhëzuar si duhet, <sup>12</sup> apo a nxit përkushtim të vërtetë? <sup>13</sup> A e ke parë se a e refuzon të vërtetën dhe largohet nga ajo? <sup>14</sup> A s'e kupton ai se **Allahu** i sheh të gjitha? <sup>15</sup> Jo! Nëse nuk ndalet, Ne do ta zvarrisim për ballin e tij<sup>c</sup> – <sup>16</sup> ballin e tij gënjeshtar, mëkatar. <sup>17</sup> Le t'i thërrasë partnerët e tij; <sup>18</sup> Ne do t'i thërrasim rojat e Ferrit. <sup>19</sup> Jo! Mos iu bind [Profet]: përkulu<sup>d</sup> në adhurim dhe avitu afër.

---

<sup>a</sup> Fazë në zhvillimin e fetusit (krahaso me 22:5), dmth. embrionit. '*Alaq* po ashtu domethënë gjithçka që ngjitet: dromcë e gjakut, shushunjë, madje edhe copë balte. Të gjitha këto kuptime e përfshijnë idenë themelore të ngjitjes apo nguljes. Ngjitja e tregon një gjendje të varësisë së plotë në kontrast me vargun 7.

<sup>b</sup> *Insan* - 'njeriu' shfaqet gjashtëdhjetë e pesë herë në Kuran. Vlen edhe për burrat edhe për gratë.

<sup>c</sup> Në Ferr. Shumë përkthyes e japin 'flokë të ballit' në vend të 'ballit' (krahaso me 54:48). Balli i tij është mëkatar, jo flokët e ballit.

<sup>d</sup> *Suxhud* është pozitë në lutjen myslimane me kokën, duart, gjunjët dhe gishtat e këmbëve në tokë, por jo pjesën tjetër të trupit si në 'gjunjëzim'.



**Përshkrimi para kaptinës 96 nga Abdel Haleem:**

*Sure mekase e emëruar sipas termit 'alaq në vargun 2. Pesë vargjet e para njihen të jenë shpallja e parë e Kuranit kur Profeti ishte udhëzuar të lexonte. Pjesa e dytë erdhi më vonë për të treguar se njeriu mëkaton kur bëhet i vetë-kënaqur (siç ilustron me shembull nga një individ specifik, Abu Xhahl).*

**Shënimet gjuhësore (Thomas Cleary)**

*Recito! ('Iqra') (Kaptina 96)*

E shpallur në Mekë. Pesë vargjet e para të kësaj kaptine ishin shpallja fillestare Muhamedit. "Recito" domethënë edhe Lexo apo Deklaro. Kjo sure quhet edhe *al !Ala'q*, "Dromca".

4 "që dha mësim përmes penës": Kjo qartë i referohet Fjalës, Librit, veçanërisht Kuranit, si mjeti i shpalljes. Po ashtu i referohet asaj që "i shkroi" të gjitha "shenjat" e Zotit në gjithësi.

6-7 "Njerëzimi vërtet shkon tepër larg në konsiderimin e vetes si i vetë-mjaftueshëm": Në mënyrë krahasuese, idetë e vona të botës dhe të gjithësisë si sisteme mekanike të cilat njerëzimi mund t'i ndryshojë pa u ndëshkuar dhe që përfundimisht t'i zotërojë e reflektojnë të vërtetën e këtij përshkrimi Kurantik të egotizmit njerëzor.

19 "përkulu dhe avitu më afër **Allahut**": Ky është një varg tjetër i përkuljes, tek i cili lexuesi i përkulet Zotit.

97: Nata e lavdisë – Nata e fuqisë (EL-KADR)

*Nata e Fuqisë*

NË EMRIN E **ALLAHUT**, DASHAMIRËSIT, MËSHIRËPLOTIT

(1-5)

Vërtet Ne e kemi dërguar këtë  
në Natën e Fuqisë.

Dhe çka do të t'informojë  
se ç'është Nata e Fuqisë?

Nata e Fuqisë është më e mirë  
se njëmijë muaj:

engjëjt dhe Shpirti zbresin atë natë,  
me lejen e Zotit të tyre,  
për gjithçka që ka rëndësi.

Është Paqe:

kjo deri kur të gdhijë agimi.

## 97. NATA E LAVDISË

Në emrin e **Allahut**, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës

<sup>1</sup> Ne e zbritëm në Natën e Lavdisë. <sup>2</sup> Çka do të ta shpjegojë se ç'është Nata e Lavdisë? <sup>3</sup> Nata e Lavdisë është më e mirë se njëmijë muaj; <sup>4</sup> në atë natë engjëjt dhe Shpirti<sup>a</sup> zbresin përsëri e përsëri me lejen e Zotit të tyre për çdo çështje; <sup>5</sup> [ka] paqe atë natë deri kur të gdhijë agimi.

---

<sup>a</sup> Engjëlli Xhebrail (Gabriel).

**Përshkrimi para kaptinës 97 nga Abdel Haleem:**

*Kjo sure mekase e lartëson natën kur u zbrit shpallja e parë e Kuranit.*

**Shënimet gjuhësore (Thomas Cleary)**

*Nata e Fuqisë (al Qadr) (Kaptina 97)*

E shpallur në Mekë. Mua më duket se në Natën e Fuqisë, si koha e komunikimeve hyjnore, errësira dhe qetësia e “natës” e simbolizojnë ndërprerjen e konceptualizimit njerëzor; “fuqia” është dija hyjnore që i zbulohet mendjes duke u paraqitur kështu perceptuese për përjetimin më delikat.

Rrënja për fjalën “fuqi” është Q-D-R, që ka shumë derivate të rëndësishme. Folja në masën e parë të kësaj rrënje domethënë të posedosh forcë, fuqi, apo aftësi, të jesh mjeshtër. Folja në masën e dytë domethënë ta caktosh dikë për diçka, të përcaktosh, të dekretosh, të urdhërosh, të vlerësosh, të ushqesh, të mundësosh. Folja në masën e katërt domethënë të mundësosh. Folja në masën e pestë domethënë të jesh i caktuar për diçka, i urdhëruar, i destinuar, i dekretuar. Folja në masën e dhjetë domethënë ta lutësh Zotin për forcë apo fuqi. Po ashtu ka natyrshëm shumë derivate emërore.

## 98: Prova e qartë (EL-BEJJINE)

Në emrin e **Allahut**, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës

<sup>1</sup> Ata që nuk besojnë ndër Njerëzit e Librit dhe idhujtarët nuk e kishin ndërmend t'i ndryshonin mënyrat e tyre deri kur t'u dërgohej provë e qartë, <sup>2</sup> një i dërguar nga **Allahu**, që i lexon faqet [e bekuara] me pastërti, <sup>3</sup> që përmbajnë shkrime të shenjta të vërteta. <sup>4</sup> [E megjithatë] ata të cilëve u ishte dhënë Shkrimi i Shenjtë u bënë të përçarë vetëm pasi u ishte dërguar provë [e tillë] e qartë <sup>5</sup> megjithëse krejt çka janë urdhëruar të bëjnë është ta adhurojnë veç **Allahun**, duke ia përkushtuar Atij sinqerisht fenë e tyre si njerëz të besimit të vërtetë, të luten rregullisht dhe ta paguajnë lëmoshën e përcaktuar, se kjo është feja e vërtetë. <sup>6</sup> Ata që nuk besojnë ndër Njerëzit e Librit dhe idhujtarët do ta kenë Zjarrin e Ferrit, për të mbetur aty. Ata janë më të këqijtë e krijimit.

<sup>7</sup> Ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira janë më të mirët e krijimit. <sup>8</sup> Shpërblimi i tyre me Zotin e tyre janë Kopshtet e përhershme të hijeshuara me lumenj rrjedhës, ku do të rrinë përgjithmonë. **Allahu** është shumë i kënaqur me ta dhe ata me Të. E gjithë kjo është për ata që kanë frikë-respekt për Zotin e tyre.

**Përshkrimi para kaptinës 98 nga Abdel Haleem:**

*Sure medinase që e merr titullin nga prova e qartë që e kërkojnë mosbesimtarët para se të nisnin të besojnë. Ajo i përshkruan parimet themelore të besimit dhe e kontraston Zjarrin e Ferrit me lumturinë e qëndrueshme që do të shijohet nga besimplotët.*

## 99: Tërmeti – Tronditja (EZ-ZELZELE)

### *Tronditja*

NË EMRIN E **ALLAHUT**, DASHAMIRËSIT, MËSHIRËPLOTIT

(1-8)

Kur toka të tundet  
në tronditjen e saj,

dhe toka t'i nxjerrë jashtë  
barrët e saj,

dhe njerëzit të thonë,  
“Ç’po ndodh me të?”

në atë ditë do ta tregojë lajmin e saj,

se Zoti yt e ka frymëzuar.

Në atë ditë njerëzimi  
do të ndahet  
për t’u shfaqur veprat e tyre.

Kështu kushdo që e ka bërë  
një atom të të mirës  
do ta shohë atë.

Dhe kushdo që e ka bërë  
një atom të të keqes  
do ta shohë atë.

## 99. TËRMETI

Në emrin e **Allahut**, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës

<sup>1</sup> Kur toka të tronditet fort në dridhjen e saj [të fundit], <sup>2</sup> kur toka t'i gjuajë jashtë barrët e saj,<sup>a</sup> <sup>3</sup> kur njeriu të bërtasë 'Çka po i ndodh asaj?'; <sup>4</sup> në atë Ditë, do t'i tregojë të gjitha <sup>5</sup> se Zoti yt do ta frymëzojë [të bëjë kështu]. <sup>6</sup> Në atë Ditë, njerëzit do të paraqiten në grupe të ndara për t'u shfaqur veprat e tyre: <sup>7</sup> kushdo që e ka bërë një të mirë me peshë sa atomi do ta shohë atë, <sup>8</sup> por kushdo që e ka bërë një të keqe me peshë sa atomi do ta shohë atë.

---

<sup>a</sup> Kjo i referohet të vdekurve që gjuhen jashtë nga varret e tyre



**Përshkrimi para kaptinës 99 nga Abdel Haleem:**

*Sure medinase, një nga seritë e sureve që merren me skena nga Dita e Gjykimit. Krahaso suret 81, 82, 101 dhe të tjera.*

**Shënimet gjuhësore (Thomas Cleary)**

*Tronditja (al Zilzaal) (Kaptina 99)*

E shpallur në Medinë. Kjo sure e shkurtër është një vegim i Ditës së Fundit.

- 6 “Në atë ditë njerëzimi do të ndahet për t’u shfaqur veprat e tyre”: fjala “ndahet” e përkthen *‘ashtaatan*, nga *shatta*, “e shpërhapur, e ndarë, e shumëfishtë, e shumëllojshme.” Domethënia është se njerëzit do të ndahen në gjendje specifike shpirtërore të cilat i kanë kultivuar përmes punëve të tyre në jetën e botës. Ndarja e njerëzimit në Shoqërinë e Dorës së Djathtë dhe Shoqërinë e Dorës së Majtë, apo Shoqëruesit e Kopshtit dhe Shoqëruesit e Zjarrit, të virtytshmit dhe keqbërësit, është shembull i kësaj “përndarjeje”.

100: Atllarët e shpejtë sulmues – Atkinat e shpejta sulmuese  
(EL-‘ÂDIJÂT)

*Atkinat e shpejta sulmuese*

NË EMRIN E ALLAHUT, DASHAMIRËSIT, MËSHIRËPLOTIT

(1-11)

Pasha atkinat e shpejta sulmuese teksa gulçojnë,

duke trokuar xixa zjarri,

atkina në sulm të shpejtë mëngjesor,

që lënë pluhur prapa,

që futen mu në turmë.

Njerëzimi është vërtet  
mosmirënjohës ndaj Zotit të tij,

dhe vërtet dëshmon për atë fakt,

dhe vërtet është i vrullshëm në dashjen e të mirave.

A nuk e dinë  
se kur të shpartallohet ajo që është në varre

dhe ajo që është në zemra të thirret jashtë,

Zoti i tyre sigurisht i di të gjitha për ta  
në atë ditë.

## 100. ATLLARËT E SHPEJTË SULMUES

Në emrin e **Allahut**, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës

<sup>1</sup> Pasha atllarët e shpejtë sulmues që gulçojnë <sup>2</sup> dhe qesin xixa me patkonjtë e tyre, <sup>3</sup> që bëjnë sulme të befasishme në ag, <sup>4</sup> duke çuar re pluhuri, <sup>5</sup> dhe duke u rrasur në mes të armikut, <sup>6</sup> njeriu është mosmirënjohës ndaj Zotit të tij – <sup>7</sup> dhe Ai është dëshmitar i kësaj<sup>a</sup> – ai është vërtet teprues në dashjen e pasurisë.

<sup>9</sup> A s'e di ai se kur të shpërthejnë brenditë e varreve, <sup>100:10</sup> kur fshehtësitë e zemrave të zbulohen, në atë Ditë, <sup>11</sup> Zoti i tyre do të jetë plotësisht në dijeni për të gjithë ata?

---

<sup>a</sup> Apo njeriu do të jetë, me veprimet e tij, dëshmitar kundër vetes në Ditën e Gjykimit.

**Përshkrimi para kaptinës 100 nga Abdel Haleem:**

*Sure e hershme mekase në të cilën **Allahu** betohet për kuajt e luftës – që Ai i ka nënrenditur të përdoren nga njerëzit<sup>a</sup> – se njeriu është mosmirënjohës dhe i çorientuar.*

**Shënimet gjuhësore (Thomas Cleary)**

*Atkinat e shpejta sulmuese (al !Aadiyyaat) (Kaptina 100)*

E shpallur në Mekë. Atkinat e shpejta sulmuese si duket e simbolizojnë guximin dhe përkushtimin në kauzën e të vërtetës madje edhe përballë kundërshtimit masiv.

---

<sup>a</sup> Krahaso me 36:71-2; 43:12-13.

## 101: Goditja shpartalluese – Katastrofa (EL-KÂRI‘A)

### *Katastrofa*

NË EMRIN E ALLAHUT, DASHAMIRËSIT, MËSHIRËPLOTIT

(1-11)

Katastrofa!

Ç’është Katastrofa,

dhe çka do të t’informojë  
se ç’është Katastrofa?

Ditë kur njerëzimi  
do të jenë si flutura nate të hallakatura,

dhe malet si lesh i mbështjellë.

Dhe sa u përket atyre  
me balans të rëndë,

do të jenë në jetë të kënaqshme;

dhe sa u përket atyre  
me balans të lehtë,

vendi i tyre do të jetë ferr.

Dhe çka do të t’informojë  
se ç’është kjo?

Zjarr i furishëm.

## 101. GODITJA SHPARTALUESE

Në emrin e **Allahut**, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës

<sup>1</sup> Goditja Shpartalluese! <sup>2</sup> Ç'është Goditja Shpartalluese? <sup>3</sup> Çka do të ta shpjegojë se ç'është Goditja Shpartalluese? <sup>4</sup> Në një Ditë kur njerëzit do të jenë si flutura nate të hallakatura <sup>5</sup> dhe malet si tufa leshi, <sup>6</sup> ai që veprat e mira i ka të rënda te peshoret <sup>7</sup> do të ketë jetë të këndshme, <sup>8</sup> por ai që veprat e mira i ka të lehta <sup>9</sup> do të ketë Gropë të Pafundme Ferri si shtëpi të veten<sup>a</sup> – <sup>10:10</sup> çka do të ta shpjegojë se ç'është ajo? – <sup>11</sup> zjarr flakërues.

---

<sup>a</sup> Fjalë për fjalë 'nëna e tij është gropa e pafundme e ferrit'

**Përshkrimi para kaptinës 101 nga Abdel Haleem:**

*Sure mekase që i jep disa skena nga Ringjallja dhe Gjykimi.*

**Shënimet gjuhësore (Thomas Cleary)**

*Katastrofa (al Qaari'a) (Kaptina 101)*

E shpallur në Mekë. Kjo sure e paraqet edhe një vegim tjetër të Ditës së Fundit dhe Gjykimit Final.

102: Stërmundimi për më tepër – Garimi i mundimshëm për gjithnjë e më shumë (ET-TEKÂTHUR)

*Garimi i mundimshëm për gjithnjë e më shumë*

NË EMRIN E **ALLAHUT**, DASHAMIRËSIT, MËSHIRËPLOTIT

(1-8)

Garimi i mundimshëm për gjithnjë e më shumë  
ju shpërqendron

deri kur të shkoni te varret.

Por do ta dini;

vërtet, përkundrazi,  
do ta dini.

Por po ta dinit

me dije të sigurt,

patjetër që do ta shihnit zjarrin e ferrit:

dhe do ta shihnit  
me syrin me siguri absolute.

Pastaj do t'ju bëhen pyetje  
për rehatinë në atë ditë.



## 102. STËRMUNDIMI PËR MË TEPËR

Në emrin e **Allahut**, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës

<sup>1</sup> Stërmundimi për më tepër ju shpërqendron <sup>2</sup> deri kur shkoni në varret tuaja.<sup>a</sup>  
<sup>3</sup> Jo në fakt! Do ta zbuloni e kuptoni. <sup>4</sup> Jo në fakt! Në fund do ta kuptoni. <sup>5</sup> Jo në fakt! Veç po ta dinit sigurt. <sup>6</sup> Me garanci të plotë do ta shihni Zjarrin e ferrit, <sup>7</sup> do ta shihni me syrin absolutisht të sigurt. <sup>8</sup> Në atë Ditë, do t'ju bëhen pyetje për kënaqësitë tuaja.

---

<sup>a</sup> Fjalë për fjalë 'deri kur t'i vizitoni varret'. Qëndrimi i tyre në varr është si vizitë e shkurtër (krahaso me 46:35).

**Përshkrimi para kaptinës 102 nga Abdel Haleem:**

*Sure mekase që e kritikon preokupimin e njeriut me pasurinë tokësore dhe thekson se do të thirret të japë llogari në Ditën e Ringjalljes.*

**Shënimet gjuhësore (Thomas Cleary)**

*Garimi i mundimshëm për gjithnjë e më shumë (al Takaathur) (Kaptina 102)*

E shpallur në Mekë.

4 “vërtet, përkundrazi, do ta dini”: Ata që nuk mendojnë për asgjë pos për gjërat e botës nuk përgatiten për tranzicionin e vdekjes; nuk e vërejnë irealitetin themelor të këtyre gjërave. Mirëpo kur vërtet të vdesin, për dallim nga tash do ta dinë realisht se përpjekjet e tyre materialiste ua kanë larguar vëmendjen nga një çështje edhe më e rëndësishme e urgjente.

5-7 “po ta dinit me dije të sigurt, patjetër që do ta shihnit zjarrin e ferrit”: Dija e sigurt nuk është teori por përjetim. Ata që e dinë me siguri çmimin real të një jete të “garimit të mundimshëm për gjithnjë e më shumë” e shohin zjarrin e ferrit duke u djegur në të madje edhe tani.

103: Dita në mbarim e sipër – Epoka (EL-‘ASR)

*Epoka*

NË EMRIN E **ALLAHUT**, DASHAMIRËSIT, MËSHIRËPLOTIT

(1-3)

Pasha epokën,

njerëzimi është vërtet në humbje,

përveç atyre që kanë besim

dhe bëjnë vepra të mira,

dhe e këshillojnë fuqishëm të vërtetën dhe drejtësinë

ndaj njëri-tjetrit

dhe e këshillojnë fuqishëm durimin

ndaj njëri-tjetrit.

103. DITA NË MBARIM E SIPËR<sup>a</sup>

Në emrin e **Allahut**, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës

<sup>1</sup> Pasha ditën që mbaron, <sup>2</sup> njeriu është [thellësisht] në humbje, <sup>3</sup> përveç atyre që besojnë, bëjnë vepra të mira, e nxisin njëri-tjetrin kah e vërteta dhe e nxisin njëri-tjetrin kah qëndresa.

---

<sup>a</sup> Interpretime të tjera të titullit përfshijnë ‘Koha’ dhe ‘Fluturimi i Kohës’

**Përshkrimi para kaptinës 103 nga Abdel Haleem:**

*Sure mekase që e tregon rrugën kah shpëtimi. Imazhi i një dite që po mbaron e sugjeron fazën në ditë, apo në jetë, kur ka mbetur veç pak për ata që duan ta kompensojnë kohën e humbur.*

**Shënimet gjuhësore (Thomas Cleary)**

*Epoka (al !Asr) (Kaptina 103)*

E shpallur në Mekë. Titulli *al!Asr* domethënë Koha, Epoka dhe po ashtu Shtrydhja, Shkulja dhe po ashtu Pasditja. Të gjitha këto asociacione bashkë krijojnë titull të duhur për këtë sure të shkurtër, që e projekton një vegim të fuqishëm të situatës njerëzore.

## 104: Shpifësi (EL-HUMEZE)

### *Shpifësi*

NË EMRIN E **ALLAHUT**, DASHAMIRËSIT, MËSHIRËPLOTIT

(1-9)

Mjerë secili vajtues shpifës

që grumbullon pasuri  
dhe e ruan mënjanë,

duke llogaritur se pasuria e tij  
do ta bëjë atë të zgjasë.

Jo në fakt!

Ai do të vërtitet  
brenda Shpartalluesit.

Dhe çka do të t'informojë  
se ç'është Shpartalluesi?

Është zjarri i **Allahut** i përflakur,

që rritet në zemra.

Vërtet formon mbulesë mbi ta

në shtylla të stërlarta.

## 104. SHPIFËSI

Në emrin e **Allahut**, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës

<sup>1</sup> Mjerë për secilin shpifës që i kritikon njerëzit për gjithçka padrejtësisht<sup>a</sup> <sup>2</sup> që grumbullon pasurira, duke i numëruar me tepri, <sup>3</sup> duke menduar se do ta bëjnë të jetojë përgjithmonë. <sup>4</sup> Jo në fakt! Ai do të rreset brenda Shpartalluesit! <sup>5</sup> Çka do të ta shpjegojë se ç'është Shpartalluesi? <sup>6</sup> Është Zjarri i **Allahut**, i flakëruar, <sup>7</sup> që ngritet mbi zemrat e njerëzve. <sup>8</sup> I rrethon ata e i mbyll <sup>9</sup> në shtylla vigane.<sup>b</sup>

---

<sup>a</sup> Thuhet t'i referohet ose al-Akhnas ibn Shurayqt, ose al-Walid ibn al-Mughira – një nga kundërshtarët më kokëfortë të Profetit (krahaso me 74:11).

<sup>b</sup> Krahaso me 77:30-3.

**Përshkrimi para kaptinës 104 nga Abdel Haleem:**

*Sure mekase që e ndëshkon shpifësin grykës dhe e jep një përshkrim të Ferrit.*

**Shënimet gjuhësore (Thomas Cleary)**

*Shpifësi (al Humaza) (Kaptina 104)*

E shpallur në Mekë. Materializmi përgjithësisht konsiderohet formë e *shirk*-ut apo idhujtari në Islam. Materialistët që e grumbullojnë pasurinë e tyre duke i sulmuar rregullisht të tjerët janë ndër më të ulët. Kjo mund të bëhet në shumë profesione.



105: Elefanti – Elefantët (EL-FÎL)

*Elefantët*

NË EMRIN E **ALLAHUT**, DASHAMIRËSIT, MËSHIRËPLOTIT

(1-5)

A s'e ke parë ç'iu bëri Zoti yt  
atyre me elefantë?

A s'e pengoi **Allahu** planin e tyre,

duke dërguar tufa të shpezëve kundër tyre,

duke i bombarduar  
me gurë të baltës së pjekur?

Kjo i bëri si bishta të zhveshur të misrit  
frutat e të cilëve janë konsumuar.

105. ELEFANTI

Në emrin e **Allahut**, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës

<sup>1</sup> A nuk e sheh [Profet] se si Zoti yt e trajtoi ushtrinë e elefantit? <sup>2</sup> A nuk ua ngatërroi krejtësisht planet e tyre? <sup>3</sup> Dërgoi rreshta shpezësh kundër tyre, <sup>4</sup> duke i gjuajtur fort me toptha të baltës së pjekur shumë: <sup>5</sup> i bëri [si] kashtë të këputur.

**Përshkrimi para kaptinës 105 nga Abdel Haleem:**

*Kjo sure është referencë ndaj ngjarjeve që ndodhën në vitin 570, viti i lindjes së Profetit, kur ushtria e Abraha-s (sundimtar i krishterë i Jemenit), që përfshinte elefantë të luftës, marshoi për ta sulmuar Mekën, ta shkatërrojë Qaben dhe t'i ridrejtojë haxhinjtë (pelegrinët) kah katedralja e re në San`a. Shkatërrimi i kësaj ushtrie citohet këtu për t'u dhënë zemër besimtarëve dhe për t'i paralajmëruar mosbesimtarët.*

**Shënimet gjuhësore (Thomas Cleary)**

*Elefantët (al Fiil) (Kaptina 105)*

E shpallur në Mekë. Si në traditat Konfuçiane, Taoiste dhe Chan Budiste, Kurani i përdor si metafora shumë ngjarje historike dhe mitologjike. Në terma historikë, “Ata me elefant(ë)” i referohet një ekspedite kundër Mekës të udhëhequr nga sundimtari kolonial Abisinian i Jemenit në gjysmën e dytë të shekullit të gjashtë, rreth kohës së lindjes së Muhamedit. Abisinia në Afrikën Lindore dhe Jemeni në Arabinë Jugore ishin të pasura atëbotë dhe kjo ekspeditë si duket ishte forcë masive. Rojat e faltores në Mekë nuk ndërtuan mbrojtje, duke i gjykuar pushtuesit tepër të fuqishëm; por qartë ndodhi diçka natyrale apo e mbinatyreshme për ta zbrapsur agresorin. Ky rrëfim ishte pa dyshim shumë i freskët në kohën e Muhamedit dhe duhet të ketë qenë për Arabët e Mekës diçka siç ishte për japonezët rrëfimi i Frymës Hyjnore që i përzuri hordhitë pushtuese Mongole në shekullin e trembëdhjetë.

Metaforikisht, ky rrëfim e përfaqëson fatin e asgjësimit që i pret ata idhujtaria e të cilëve është lakmuese për pasuri materiale dhe fuqi të përkohshme, që në çdo rast duhet të jetë e paqëndrueshme.

## 106: Kurejshët (EL-KUREJSH)

### *Kurejshët*

NË EMRIN E **ALLAHUT**, DASHAMIRËSIT, MËSHIRËPLOTIT

(1-4)

Sa i përket marrëveshjes Kurejshe

bashkëpunimit të tyre në udhëtime  
dimër e verë,

le t'i shërbejnë Zotit të kësaj shtëpie,

që i ushqen në rast se uriten fort  
dhe u jep siguri nga frika.

## 106. KUREJSHËT

Në emrin e **Allahut**, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës

<sup>1</sup> [Ai e bëri këtë] për t'i bërë Kurejshët të ndihen të sigurt,<sup>a</sup> <sup>2</sup> të sigurt në udhëtimet e tyre dimërore dhe verore.<sup>b</sup> <sup>3</sup> Pra le ta adhurojnë Zotin e kësaj Shtëpie:<sup>c</sup> <sup>4</sup> që i pajis me ushqim për ta mënjanuar urinë dhe siguri për ta mënjanuar frikën.

---

<sup>a</sup> Apo 'ashtu që marrëveshjet e tyre të sigurisë [nga fqinjët e tyre do të vazhdonin]' apo 'ashtu që ata të vazhdojnë siç janë mësuar me udhëtimet e tyre tregtare dhe të mos ndalen'.

<sup>b</sup> Dy karavanet e tyre tregtare vjetore – për Jemen në dimër dhe për Siri në verë – nga të cilat varej mirëqenia e Kurejshëve.

<sup>c</sup> Qabes.

**Përshkrimi para kaptinës 106 nga Abdel Haleem:**

*Kjo sure mekase lidhet gramatikisht me përshkrimin e ngjarjeve të sures së kaluar për atë se si **Allahu** e mposhti kërcënimin ndaj Mekës që iu bë nga Abraha, duke e bërë kështu të sigurt për fisin e Kurejshëve për t'i vazhduar udhëtimet e tyre tregtare.*

**Shënimet gjuhësore (Thomas Cleary)**

*Kurejshët*

E shpallur në Mekë. Kurejshët, të cilëve u përkiste vetë Muhamedi, ishin fisi më i fuqishëm ndër arabët e Arabisë Veriore. Siç dihet mirë, kurejshët ishin rojtarët tradicionalë të Qabes, faltores së shenjtë në Mekë, e cila këtu referohet si “kjo shtëpi”. Ky varg është qortim i thjeshtë e në anën tjetër elokuent kundër idhujtarisë dhe materializmit në sensin që ua kujton njerëzve të jenë mirënjohës për burimin e bekimeve në vend se t'i përvetësojnë bekimet vetë si e drejtë e trashëguar.

107: Mirësitë e rëndomta – Nevojat (EL-MÂ‘ÛN)

*Nevojat*

NË EMRIN E **ALLAHUT**, DASHAMIRËSIT, MËSHIRËPLOTIT

(1-7)

A e sheh atë që e mohon fenë?

Ai është ai që refuzon të flasë me jetimin

dhe nuk e inkurajon ushqyerjen e të varfrit.

Pra mjerë ata që luten

pa u kushtuar vëmendje lutjeve të tyre;

ata që duken se luten

por grabisin nga njerëzit në nevojë.

## 107. MIRËSITË E RËNDOMTA

Në emrin e **Allahut**, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës

<sup>1</sup> [Profet], a e ke vrarë mendjen për personin që e mohon Gjykimin? <sup>2</sup> Është ai që e shtyn mënjatë jetimin <sup>3</sup> dhe nuk i nxit të tjerët t'i ushqejnë ata në nevojë. <sup>4</sup> Për mjerë për ata që luten <sup>5</sup> por janë të pavëmendshëm për lutjen e tyre; <sup>6</sup> ata që janë tërësisht shfaqës <sup>7</sup> dhe i pengojnë mirësitë e rëndomta.



**Përshkrimi para kaptinës 107 nga Abdel Haleem:**

*Sure mekase që i përshkruan ca karakteristika të personit që e mohon Gjykimin.*

**Shënimet gjuhësore (Thomas Cleary)**

*Nevojat (al Maa'uun) (Kaptina 107)*

E shpallur në Mekë.

- 5 “ata që luten pa u kushtuar vëmendje lutjeve të tyre”: Ata që së jashtmi luten (apo praktikojnë rite të tjera religjioze formale) por nuk veprojnë në frymë të fesë. Kujdesi për ata që nuk i kanë ca të drejta dhe për të varfrit këshillohet fuqishëm për besimtarët përsëri e përsëri në Kuran.

## 108: Begatia (EL-KEUTHER)

Në emrin e **Allahut**, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës

<sup>1</sup> Ne vërtet të kemi dhënë begati<sup>a</sup> [ty Profet] – <sup>2</sup> pra falju Zotit tënd dhe bëja fljimin tënd veç Atij – <sup>3</sup> fatprerë është pikërisht ai që të urren.

---

<sup>a</sup> Fjala *kawthar*, ‘begati’, interpretohet këtu se i referohet edhe një lumi specifik në Parajsë.

**Përshkrimi para kaptinës 108 nga Abdel Haleem:**

*Kur Profeti e humbi djalin e tij të fundit, një kundërshtar që e urrente e tallte se ishte 'fatprerë' pa pasardhës. Kjo sure mekase vjen për ta qetësuar Profetin dhe si replikë për armikun e tij.*

## 109: Mosbesimtarët (EL-KÂFIRÛN)

Në emrin e **Allahut**, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës

<sup>1</sup> Thuaj [Profet]: ‘Mosbesimtarë, <sup>2</sup> unë nuk adhuroj çka adhuroni ju, <sup>3</sup> as ju nuk adhuroni çka adhuroj unë, <sup>4</sup> unë nuk do të adhuroj kurrë çka adhuroni ju, <sup>5</sup> as ju nuk do të adhuroni kurrë çka adhuroj unë: <sup>a</sup> <sup>6</sup> ju e keni fenë tuaj dhe unë e kam timen.

---

<sup>a</sup> Nëse u përmbaheni zotave tuaj të tanishëm (shih Zamakhshari, *al-Kashshaf*, vëll. iv).

**Përshkrimi para kaptinës 109 nga Abdel Haleem:**

*Disa nga idhujtarët mekasë i sugjeruan Profetit si kompromis që ai duhet t'i adhuronte zotat e tyre për një vit dhe ata duhej ta adhuronin të tijin për një vit. Kjo ishte përgjigjja.*

## 110: Ndhima (EN-NASR)

### *Ndhima*

NË EMRIN E **ALLAHUT**, DASHAMIRËSIT, MËSHIRËPLOTIT

(1-3)

Kur të vijë ndihma e **Allahut**,  
dhe fitorja,

dhe t'i kesh parë njerëzit  
të hyjnë në fenë e **Allahut** në turma,

lëvdoje Zotin tënd  
dhe kërko falje nga **Allahu**:  
se **Allahu** është më falësi.

## 110. NDIHMA

Në emrin e **Allahut**, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës

<sup>1</sup> Kur vjen ndihma e **Allahut** dhe Ai ta çel<sup>a</sup> rrugën [Profet], <sup>2</sup> kur i sheh njerëzit tek e përqafojnë besimin e **Allahut** në turma, <sup>3</sup> festoje lâvdin e Zotit tënd dhe kërkoje faljen E Tij: Ai është gjithmonë gati për të pranuar pendesë.

---

<sup>a</sup> Kjo sure kryesisht kuptohet nga përkthyesit t'i referohet dorëzimit të Mekës – Profetit. Prandaj shumë e përkthejnë fjalën *fath* si 'fitore', edhe pse nuk kishte luftime. Shih po ashtu Suren 48, *Surat al-Fath*. *Fath* në Arabishten klasike domethënë 'hapje' apo 'vendim'. Në një lutje, Profeti thotë: 'Zot, hapi portat e Mëshirës Sate për mua.' Surja 1 quhet *al-Fatiha*, meqë e hap Kuranin. Te 7:89, *iftah* domethënë 'vendos ndërmjet nesh dhe armikut tonë'.

**Përshkrimi para kaptinës 110 nga Abdel Haleem:**

*Sure medinase që thuhet të jetë ndër shpalljet e fundit që i ka pranuar Profeti para vdekjes së tij.*

**Shënimet gjuhësore (Thomas Cleary)**

*Ndihma (al Nasr) (Kaptina 110)*

E shpallur në Medinë. Kur ky pasazh lexohet në kontekstin historik të përpjekjeve të Islamit të hershëm për vetë ekzistencën e tij dhe triumfin e tij suprem, është veçanërisht i mrekullueshëm si model i frymës së amnistisë dhe i lirisë nga mllef i hakmarrësisë. Fjala për “ndihmë”, *nasr*, domethënë edhe fitore, që në këtë kontekst i atribuohet natyrshëm ndihmës nga Zoti.



111: Fija e palmës – Flaka (EL-MESED)

*Flaka*

NË EMRIN E **ALLAHUT**, DASHAMIRËSIT, MËSHIRËPLOTIT

(1-5)

Duart e të përflakurit janë afër shuarjes  
dhe ai është afër shuarjes.

Pasuria e tij nuk e pasuron  
dhe nuk i jep fitim.

Do të digjet në zjarr flakërues,

me gruan e tij që i sjell drutë e zjarrit,

litar rreth qafës së saj.

## 111. FIJA E PALMËS

Në emrin e **Allahut**, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës

<sup>1</sup> U shkatërrofshin duart e Ebu Leheb-it! U shkatërroftë edhe ai! <sup>2</sup> As pasuria e tij as fitimet e tij nuk do t'i ndihmojnë: <sup>3</sup> do të digjet në Zjarrin Flakërues<sup>a</sup> – <sup>4</sup> dhe njëjtë gruaja e tij, bartësja e druve të zjarrit,<sup>b</sup> <sup>5</sup> me litar të fijeve të palmës rreth qafës së saj.

---

<sup>a</sup> Ebu Leheb domethënë 'Njeriu Flakë' dhe ky varg përmban lojë fjalësh me emrin e tij.

<sup>b</sup> Ajo lidhte tufa ferrash me litarë të fijeve të përdredhura të palmës dhe i hidhte në rrugën e Profetit.

**Përshkrimi para kaptinës 111 nga Abdel Haleem:**

*Kjo sure i referohet një xhaxhai të Profetit që e kundërshtonte egërsisht, siç bënte edhe gruaja e tij. Ai e fyejti Profetin me “Tabbak yadak” (“t’u shkatërrofshin duart”). Kjo sure mekase është kundërpërgjigja.*

**Shënimet gjuhësore (Thomas Cleary)**

*Flaka (al Lahab) (Kaptina 111)*

E shpallur në Mekë. Historikisht kjo sure i referohet një xhaxhai (mixhe) të Muhamedit që e ka pasur nofkën Abu Lahab “I përflakuri”, për shkak të temperamentit të tij të nxehtë. Ai dhe gruaja e tij ishin ndër kundërshtarët më të vrullshëm të Islamit të hershëm. Metaforikisht kjo i referohet fundit vendimtar të cilësive të zemërimit dhe të agresionit të përfaqësuara nga Abu Lahab dhe gruaja e tij.

- 2 “Pasuria e tij nuk e pasuron dhe nuk i jep fitim”. Parimi kundër-idhujtar – kundërmaterialist i Islamit i shprehur në Kuran nuk është mospranim apo refuzim i gjërave të botës po nënrenditje e duhur e gjërave të botës – ndaj Zotit si Realiteti suprem (*al Haqq*). Kjo domethënë se pasuria e botës nuk është e mirë apo e keqe në vete, por prodhimet e saj varen nga përdorja e saj.

## 112: Pastërtia [e besimit] – E vërteta e pastër (EL-IHLÂS)

### *E vërteta e pastër*

NË EMRIN E **ALLAHUT**, DASHAMIRËSIT, MËSHIRËPLOTIT

(1-4)

Thuaj:

“Është **Allahu**, Unik,

**Allahu** Supremi.

**Allahu** nuk riprodhon

dhe nuk riprodhohet.

Dhe nuk ka kurrfarë gjëje

të barasvlefshme me **Allahun**.”

## 112. PASTËRTIA [E BESIMIT]

Në emrin e **Allahut**, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës

<sup>1</sup> Thuaj: ‘Ai është **Allahu** – ai që është Një, <sup>2</sup> **Allahu** i përhershmi.<sup>a</sup> <sup>3</sup> Nuk iu bë prind askujt dhe as s’kishte prind. <sup>4</sup> Askush s’është i krahasueshëm me Të.’

---

<sup>a</sup> *Samad*: përkthimet të tjera të përkrahura nga shumë përfshijnë ‘i vetë-mjaftueshmi’ dhe ‘i kërkuari që u duhet të gjithëve’ (Razi).

**Përshkrimi para kaptinës 112 nga Abdel Haleem:**

*Kjo sure është e pazakontë se e ka titull një term të papërmendur në trupin e sures. Ikhlas e komunikon kuptimin e singëritetit në fenë e dikujt dhe dedikimin total në **Allahun** Një të vërtetë. Për shkak të rëndësisë së kësaj teme në Islam, Profeti tha se kjo sure, përkundër shkurtësisë së saj, ishte e barabartë me një të tretën e Kuranit.*

**Shënimet gjuhësore (Thomas Cleary)**

*E vërteta e pastër (al 'Ikhlās) (Kaptina 112)*

E shpallur në Mekë. Kjo është ndër shpalljet më të famshme në Kuran, e konsideruar si formulim klasik i unitetit absolut të Zotit.

- 2 “Supremi” (as Samad): Ky epitete i Zotit mund të përkthehet edhe si I Përhershmi apo I Përgjithmonshmi. Nga rrënja S-M-D vijnë fjalët me kuptimin të nisësh të lëvizësh dhe të qëndrosh dhe të mbrosh kundër diçkaje: Zoti është qëllimi vendimtar kah i cili nisim të lëvizim dhe Zoti si e vërtetë absolute u qëndron dhe mbron, pafundësisht, kundër çfarëdo falsiteti që mund ta konceptojë mendja njerëzore apo demonike. Fjala *samadaaniy* nga kjo rrënjë po ashtu domethënë i përgjithmonshëm apo i përhershëm.

## 113: Agu (EL-FELEK)

### *Agu*

NË EMRIN E **ALLAHUT**, DASHAMIRËSIT, MËSHIRËPLOTIT

(1-5)

Thuaj:

“Unë gjej siguri  
në Zotin e agut

nga e keqja  
e atyre që i ka krijuar,

dhe nga e keqja  
e errësirës kur është gjithëpërfshirëse,

dhe nga e keqja  
e mallkuesve,

dhe nga e keqja e ziliqarëve  
kur kanë zili.”

113. AGU

Në emrin e **Allahut**, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës

<sup>1</sup> Thuaj [Profet]: ‘Kërkoj siguri me Zotin e agut <sup>2</sup> kundër dëmit në atë që e ka krijuar Ai, <sup>3</sup> dëmit në natën kur grumbullohet errësira, <sup>4</sup> dëmit në shtrigat kur fryjnë në nyja, <sup>a 5</sup> dëmit në smirëziun kur ka smirë.’

---

<sup>a</sup> Thuhet të jetë mënyrë e praktikimit të magjisë së keqe dhe bërjes magji ndaj dikujt.



**Përshkrimi para kaptinës 113 nga Abdel Haleem:**

*Sure mekase që përdoret si thirrje kundër të keqes.*

**Shënimet gjuhësore (Thomas Cleary)**

*Agu (al Falaq) (Kaptina 113)*

E shpallur në Mekë.

- 2 “nga e keqja e atyre që i ka krijuar”: Domethënë, nga “agu” (akti i krijimit) të krijuar. Gjej siguri nga ligësia e gjërave të krijuara.

## 114: Njerëzit – Njerëzimi (EN-NÂS)

### *Njerëzimi*

NË EMRIN E **ALLAHUT**, DASHAMIRËSIT, MËSHIRËPLOTIT

(1-6)

Thuaj:

“Unë gjej siguri  
në Zotin e njerëzimit,

Kontrolluesin e njerëzimit,

**Zotin** e njerëzimit,

nga e keqja e sugjerimit tinëzar

që pëshpërit në zemrat njerëzore

nga burime demonike dhe njerëzore.”

## 114. NJERËZIT

Në emrin e **Allahut**, Zotit të Mëshirës, Dhënësit të Mëshirës

<sup>1</sup> Thuaj, ‘Kërkoj siguri me Zotin e njerëzve, <sup>2</sup> Kontrolluesin<sup>a</sup> e njerëzve, <sup>3</sup> **Zotin** e njerëzve, <sup>4</sup> kundër dëmit të përgojuesit dredhacak – <sup>5</sup> që pëshpërit në zemrat e njerëzve – <sup>6</sup> qofshin xhinde apo njerëz.

---

<sup>a</sup> Apo ‘Mbretin’ apo ‘Pronarin’.

**Përshkrimi para kaptinës 114 nga Abdel Haleem:**

*Një sure tjetër mekase që përdoret zakonisht si thirrje kundër të keqes.*

Shënimet gjuhësore (nga Thomas Cleary)

*Njerëzimi (al Naas) (Kaptina 114)*

E shpallur në Mekë.

- 4 “sugjerimit tinëzar” (*al waswaas al khannaas*): “Pëshpëritësi që Fshihet” është personifikim i djallit; rreshti i fundit tregon se nuk kuptohet si qenie individuale *per se* por si lloj i ndikimit që mund të funksionojë përmes qenieve njerëzore apo përmes xhindeve a zanave (e përkthyer këtu si “demonë” për shkak të aftësisë së tyre mashtruese).

## Për përkthimet anglisht

### Biografite e përkthyesve

#### Muhamed Abdel-Halim

Muhamed A. S. Abdel-Halim (arabisht: محمد عبد الحليم سعيد, i lindur më 1930), OBE (Order of the British Empire - Titulli: Urdhri i Perandorisë Britanike), FCIL (Fellow of Chartered Institute of Linguists – Anëtar i veçantë i Institutit të Kualifikuar të Gjuhëtarëve), është profesor me titull “Mbreti Fahd” i Studimeve Islame në Shkollën e Studimeve Orientale dhe Afrikane, Universiteti i Londrës (SOAS) dhe redaktor i Journal of Qur'anic Studies (Revistës së Studimeve Kur'anore).

I lindur në Egjipt në vitin 1930, Abdel-Halim e mësoi Kuranin përmendësh gjatë fëmijërisë së tij, dhe tani është hafiz. Studioi në Universitetin Al-Az'har dhe e mbaroi doktoraturën në Universitetin e Kembrixhit. Ka ligjëruar në Shkollën e Studimeve Orientale dhe Afrikane (SOAS) që nga viti 1971. Në vitin 2004, Oxford University Press e botoi përkthimin e tij të Kuranit në anglisht. Ai i ka botuar edhe disa vepra të tjera në këtë fushë.

Abdel-Halim u emërua oficer i Urdhrit të Perandorisë Britanike (OBE) në Nderimet e Ditëlindjes së Mbretëreshës në vitin 2008, në shenjë mirënjohjeje të shërbimeve të tij ndaj kulturës e letërsisë arabe dhe mirëkuptimit ndërjetar.

#### Veprat:

- 2006 with Robinson, Danielle (eds.), *The Moral World of the Qur'an*, London: IB Tauris.
- 2006 "Islam, Religion of the Environment" in Cotran, E. and Lau, M. (eds.), *Yearbook of Islamic and Middle Eastern Law*, Netherlands: E.J. Brill, pp. 403–410.
- 2006 "Arabic and Islam" in Brown, Keith (ed.), *Encyclopedia of Language and Linguistics*, Oxford: Elsevier, pp. 34–37.
- 2006 "Qur'an and Hadith" in Winter, Tim (ed.), *The Cambridge Companion to Classical Islamic Theology*, UK: Cambridge University Press.
- 2005 with Badawi, Elsaid M., *Dictionary of Qur'anic Usage*, E. J. Brill.

- 2004 *The Qur'an: a New Translation*, Oxford, UK: Oxford University Press (Oxford World's Classics Hardcovers Series).
- 2002 "The Prophet Muhammad as a Teacher: implications for Hadith literature" in *Islamic Quarterly* vol. XLVI (2), pp. 121–137.
- 1999 *Understanding the Qur'an: themes and style*, London: I B Tauris.
- 1999 "Human Rights in Islam and the United Nations Instruments" in Cotran, E. and Sherif, A. (eds.), *Democracy the rule of law and Islam*, London: Kluwer Law International, pp. 435–453.
- 1995 (as translator) *Chance or creation? God's design in the Universe (attributed to Jahiz, translated and introduced)*, Reading, Berkshire: Garnet.
- 1994 "Qu'ranic Orthography: the written presentation of the recited text of the Qur'an" in *Islamic Quarterly*, vol. 38 (3), pp. 171–192.

## **Thomas Cleary**

Thomas Cleary (1949 - 20 qershor 2021) ishte autor dhe përkthyes produktiv i mbi 80 librave të ndërlidhur me klasikët budistë, taoistë, konfucianë dhe myslimanë, dhe i Artit të Luftës – traktat mbi menaxhimin, strategjinë ushtarake dhe aftësitë politike shtetërore. Ka përkthyer libra nga gjuha pali, sanskritishtja, arabishtja, kinezishtja, japonishtja dhe irlandishtja e vjetër në anglisht.

Cleary u interesua për Budizmin kur ishte adoleshent; kërkimet e tij në mendimin budist filluan me dëshirën për të mësuar gjatë kësaj kohe të jetës së tij. Kur e filloi përkthimin, zgjodhi ose vepra të papërkthyer ose - si në rastin e Artit të Luftës të Sun Tzu - libra, përkthimet e të cilëve ishin "shumë të kufizuara". Cleary mori doktoraturë në Gjuhët dhe Qytetërimet e Azisë Lindore nga Universiteti i Harvardit, dhe JD (Juris Doctor, gradë profesionale tri-vjeçare) nga Shkolla Juridike Boalt Hall në Universitetin e Kalifornisë, Berkeley. Pas përfundimit të studimeve të doktoratës, Cleary kishte pak përfshirje me botën akademike. "Ka shumë trajtim mizor në mjedis universitar", tha ai. "Dua të qëndroj i pavarur dhe të arrij tek ata që duan të mësojnë drejtpërdrejt përmes librave të mi."

Vëllai i Cleary-t, Jonathon gjithashtu e përfundoi punën e doktoratës në EALC në Harvard. Dy vëllezërit punuan së bashku për të përkthyer koleksionin koan "The Blue Cliff Record"; Shambhala e botoi përkthimin në vitin 1977. Përkthimi më i përhapur i Thomas Cleary ka qenë ai i Artit të Luftës të Sun Tzu (Sunzi Bingfa). Ai e përktheu edhe veprën monumentale Avatamsaka Sutra (e quajtur edhe Huayan Jing, ose Shkrimi i Shenjtë i Ornamentit të Luleve) botuar më 1993. Një përkthim tjetër i madh ishte i komenteve të urtakut taoist të shekullit të 18-të Liu Yiming, e cili shpjegon kodimin metaforik të teksteve kryesore taoiste që kanë të bëjnë me transformimin e vetëdijes dhe shkrirjen e mendjes njerëzore me mendjen e Tao-s.

Në vitin 2000, përkthimet e ndryshme të teksteve taoiste të Cleary-t u mblodhën në katër vëllime nga Botimet Shambhala si *Klasikët Taoistë*. Pas suksesit të këtyre botimeve, u mblodh një koleksion me pesë vëllime i përkthimeve budiste si *Klasikët e Budizmit dhe Zenit*. Një përkthim tjetër nga tradita e urtësisë myslimane është "*Të jetosh dhe të vdesësh me mirësi*". Më 1993 Cleary botoi një përkthim të *Librit të Pesë Unazave* të Miyamoto Musashi-t.

## Nga parathëniet e përkthimeve

**Thomas Cleary:**

### **Hyrje**

Kurani njihet universalisht si libri i shenjtë i Islamit, feja e nënshtrimit ndaj vullnetit të Zotit. Kapitujt dhe vargjet në këtë vëllim të ekstrakteve nga Kurani janë zgjedhur për ta formuar një rruzare të leximeve dhe recitimeve që synojnë ta njoftojnë lexuesin jo-mysliman me urtinë thelbësore, bukurinë dhe madhësinë e këtij libri të shenjtë.

Kurani është në mënyrë të pamohueshme libër me rëndësi të madhe madje edhe për jo-myslimanët, mbase sot më shumë se kurrë, nëse kjo është e mundur. Një aspekt i Islamit që është i papritur e megjithatë tërheqës për mendjen sekulare post-kristiane është ndërvoja harmonike e besimit dhe arsyes. Islami nuk kërkon besim të pa-arsyeshëm. Në vend të kësaj, fton për besim inteligjent, që del nga vëzhgimi, reflektimi dhe zhytja në mendime, duke filluar me natyrën dhe atë që është kudo rreth nesh. Prandaj, antagonizmi midis fesë dhe shkencës si ai që është i njohur për perëndimorët është i huaj për Islamin.

Kjo lidhje ndërmjet besimit dhe arsyes ia mundësoi qytetërimin islam të përthithë dhe të gjallërojë dije të dobishme, duke i përfshirë edhe ato të popujve të lashtë, me të cilën pas një kohe e ndihmoi Europën të dalë nga Epoka e Errët, duke i hedhur themelet për Rilindjen. Mirëpo, kur Europa u ngrit në këmbët e saj kulturore dhe e dëboi Islamin, mendja europiane u shqye nga paaftësia e Kishës së krishterë për ta toleruar pandashmërinë e të shenjtës dhe sekulares që e karakterizonte Islamin dhe ia kishte mundësuar qytetërimin islam ta zhvillojë shkencën natyrore dhe artin abstrakt si dhe filozofinë dhe shkencën shoqërore. Rezultati ishte një divorc i dhembshëm, fatkeq ndërmjet shkencës dhe fesë në Europë, asi me pasojat që kanë ndikuar negativisht në mbarë botën.

Në Perëndimin e pas-krishterë – ku njerëzit mendimtarë, përfshirë prapë edhe vetë shkencëtarët, po kërkojnë zgjidhje për vështirësitë e krijuara nga divorci i krishterë ndërmjet fesë dhe shkencës – Kurani e ofron një mënyrë të eksplorohej një qasje që e përfaqëson plotësisht kërkimin për dije dhe kuptim që është thelbi i shkencës, gjersa në të njëjtën kohë, dhe në të vërtetë për arsyet e njëjta, e përfaqëson plotësisht frikë-respektin, përvulësinë, nderimin dhe vetëdijen pa të cilën “njerëzimi vërtetë shkon tepër larg në konsiderimin e vetes si i vetë-mjaftueshëm” (Kuran 96:6-7).

Madje edhe për perëndimorin sekular, pavarësisht nga çfarëdolloj pyetje të besimit fetar, ka përfitime të menjëhershme për t’u gjetur në leximin e Kuranit.



Së pari, duke e pasur parasysh shenjtërinë dhe rëndësinë jetike të Kuranit për afërsisht një të pestën e tërë njerëzimit, një qytetar mendimtar i botës vështirë mund të zhvillojë vetëdijesi racionale dhe të pjekur shoqërore pa e marrë parasysh mesazhin e Kuranit dhe kuptimin e tij për komunitetin mysliman.

Me rënien e komunizmit, është bërë veçanërisht e qartë se paqja globale, rendi dhe vetë-vendosja e popujve nuk mund të arrihet pa respekt inteligjent për Islamit dhe të drejtën e patjetërsueshme të myslimanëve për ta jetuar fenë e tyre. Përfitimi i dytë i menjëhershëm në leximin e Kuranit, pra, është se është hap i nevojshëm drejt kuptimit të tolerancës pa të cilën paqja botërore është në fakt e paimagjinueshme.

Për jo-myslimanët, një përparësi e veçantë në leximin e Kuranit është se ofron pikë autentike të referimit nga e cila mund të shqyrtohen stereotipet e anuara të Islamit ndaj të cilave ekspozohen zakonisht perëndimorët. Informacioni parësor është thelbësor për ta bërë dallimin ndërmjet opinionit dhe faktit në mënyrë të arsyeshme. Ky ushtrim gjithashtu mund t'ia mundësojë individit mendimtar ta kuptojë natyrën qenësish të defektive të vetë paragjykimit, dhe kështu të jetë përgjithësisht më pranues ndaj tërë informacionit dhe dijes me dobi të mundshme për njerëzimin.

## **Kurani**

Emri Kuran domethënë Recitimi apo Leximi. Sipas vetë fjalës së tij, Kurani është Libër i shpallur në traditën shpirtërore të Teuratit dhe Ungjillit të transmetuar nga Moisiu-Musai dhe Jezusi-Isai. Duke e lidhur veten dhe këta paraardhës të shquar me sisteme fetare edhe më të hershme të fesë origjinale, Kurani i paraqet mësimet e tij si vërtetuese dhe qartësuese të të vërtetës së asaj që ishte në ato mesazhe.

Kurani është në mënyrë të pamohueshme unik në këtë traditë, dhe vërtet unik në tërë kontekstin e traditës së shenjtë klasike në të gjithë botën, në atë që është shpallur në dritën e plotë të historisë, përmes zyrave të një Profeti që ishte i njohur mirë.

Si lidhja e fundit në një zinxhir të shpalljes që kthehet prapa në kohë të stërlashta, madje deri te vetë origjina e njerëzimit, Kurani e ka funksionin e veçantë të rikujtimit të mesazhit esencial të të gjithë Librave të shpallur dhe të dallimit të kësaj nga opinionet dhe reagimet e shtuara nëpër tekstet antike, shpërndarja origjinale e të cilave kishte ndodhur në kohë të largëta dhe madje të panjohura.

Prandaj Kurani nuk quhet veç Leximi apo Recitimi por edhe Kriteri: quhet Kujtues dhe po ashtu Qartësim. Një pasardhës bashkëkohor i Profetit Muhamed shkroi për këtë fushëveprim dhe funksion të Librit në këto terma:

*“Kurani nuk është gjë tjetër veçse librat e vjetër të pastruar nga aliazhi njerëzor, dhe i përmban të vërtetat transcendentë të mishëruara në të gjitha shkrimet e shenjtë me shtesa të plota, të nevojshme për zhvillimin e të gjitha zotësive njerëzore. I përsërit të vërtetat e dhëna në Vedat e Shenjtë, në Bibël, në fjalët e Gitës, në thëniet e Budës dhe të gjithë profetëve të tjerë, dhe e shton atë që nuk ishte në to, dhe jep ligje të reja për t’iu adresuar pasigurive të kohës së tashme kur anëtarët e ndryshëm të familjes së Zotit që jetonin të ndarë nga njëri-tjetri në ditët e shpalljeve të vjetra ishin afruar me njëri-tjetrin.”*

(Sirdar Iqbal Ali Shah, *Islamic Sufism* (New York: Samuel Weiser, 1971), f. 41)

Për shkak se Kurani i sintetizon dhe i përsos shpalljet e mëhershme, funksioni i tij si Kriter për ta bërë dallimin ndërmjet të vërtetës dhe gënjeshtërisë nuk kryhet në formën e pohimit apo ndëshkimit dogmatik të një feje apo një tjetre, por në formën e dallimit ndërmjet dredhisë njerëzore dhe kuptimit esencial të fesë, ndërmjet hipokrizisë dhe besimit të vërtetë. Kështu i njëjti shkrimtar shpjegon: “Kurani e quan veten *Hakam* – ‘gjykatës’, për të vendosur ndërmjet të krishterit dhe të krishterit, ndërmjet hindusë dhe hindusë, ndërmjet budistit dhe budistit, dhe kështu edhe bëri.” (Po aty, f. 43). Observimi se Kurani e bën dallimin e ndryshimeve brenda ithtarëve të secilit sistem fetar, e jo ndërmjet vetë sistemeve fetare për se, duket të jetë çelës për t’iu qasur Kuranit pa anim fetar.

Kurani nuk do të mund të funksiononte në këtë mënyrë në kontekstin e feve botërore po të ishte jo më shumë se koleksion i dogmave apo doracak i një sektit a kultit të ri. Kurani i flet njerëzimit si tërësi, kombeve, komuniteteve, familjeve dhe individëve; i kompletuar edhe me mësim të jashtëm edhe me mësim të brendshëm, u flet edhe personave dhe shpirtave, individualisht dhe kolektivisht. Një pasardhës bashkëkohor i Profetit shkruan për thellësinë e pakontestuar, begatinë dhe gjerësinë e qenësishme të Kuranit në këto terma:

*“Për sufitetë e periudhës klasike, Kurani është dokumenti i koduar që i përmban mësimet sufiste. Teologët prirën të supozojnë se ai është i aftë për interpretim veç në mënyrë konvencionale fetare; historianët prirën të kërkojnë burime më të hershme letrare apo fetare; të tjerët kërkojnë evidencë të ngjarjeve bashkëkohore të reflektuara*

*në faqet e tij. Për sufitetë, Kurani është dokument me shumë nivele të transmetimit, ku secili e ka një kuptim në përputhje me kapacitetin e lexuesit për kuptim. Është ky qëndrim ndaj librit që e bërë të mundur kuptimin ndërmjet njerëzve që ishin me prejardhje formalisht të krishterë, pagane apo çifute – një ndjesi të cilën fetarët e hershëm nuk mund ta kuptonin. Kurani në një kuptim është pra dokument me rëndësi psikologjike.”*

(Idries Shah, *The Sufis* (New York and London: Doubleday, 1964), f. 412.)

Këtu përsëri mund të shihet se përparësia më e vogël e mundshme që mund ta nxjerrim nga leximi i Kuranit është shansi për ta shqyrtuar subjektivitetin tonë në kuptimin e një teksti të kësaj natyre. Kjo mund të ketë pasoja të rëndësishme edukative, edhe të menjëhershme edhe afatgjata, që vështirë mund të nxirren thjesht duke i përvetësuar opinionet dhe qëndrimet e pranuar pa të menduar dhe reflektim individual.

## **Ardhja e Kuranit**

Siç dihet, Kurani u shpall përmes Profetit Muhamed, që ishte lindur rreth vitit 570. Muhamedi ishte nga fisi fisnik Kurejsh, kujdestarët e faltores së shenjtë të Mekës, që besoet se është ndërtuar nga Ibrahim (Abrahami) në të shkuarën e largët.

I mbetur jetim në moshë të re, Muhamedi u bë i ri i matur e i përgjegjshëm, i njohur për besueshmërinë e tij. Kur ishte njëzet e pesë vjeç, u martua me punëdhënësen e tij, një biznesmene e suksesshme të cilës i kishte bërë shumë përshtypje mirësia e Muhamedit.

Shpallja e parë erdhi kur Muhamedi ishte dyzet vjeç, njeri i pjekur me karakter pa asnjë cen. Ajo ndodhi gjatë një rës nga tërheqjet e tij medituese periodike në një shpellë malore jashtë Mekës. Larg nga të krekosurit nga përjetimi, Muhamedi ishte plot frikë dhe hezitues; nxitoi në shtëpi te gruaja e tij dhe ia zbuloi në ankth se çka i kishte ndodhur. Duke ia kujtuar atij virtytet e tij të njohura, ajo e siguroi se ai nuk ishte i çmendur. Pastaj e çoi te një kusheri, një i krishterë, që i dëgjoi fillimet e Recitimit dhe deklaroi se janë të të njëjtës Të Vërtetë si ajo që është sjellë nga Moisiu (Musa) dhe Jezusi (Isai).

Myslmanët e parë ishin anëtarët e shtëpisë së Muhamedit. Krahas gruas së tij Khaddija-s, ishte skllavi i liruar Zaid dhe kushëriri i ri i Muhamedit dhe dhëndri i ardhshëm Aliu. Pak më vonë edhe Ebu Bekri, mik i vjetër i Muhamedit, iu bashkua komunitetit të sapoformuar të Islamit.

Pas një pauze të shkurtër, shpalljet vazhduan, dhe fjala e lëvizjes së re myslimane së shpejti nisi të qarkullojë. Kjo i zemëroi udhëheqësit e Kurejshëve sepse ndiheshin se Islami ua minonte autoritetin. Duke mësuar se sipas natyrës mund të jetë veç një Zot real, Islami e minoi autoritetin fetar të Kurejshëve si udhëheqës të politeizmit të vjetër fisnor. Duke tërhequr shumë të konvertuar nga skllëverit dhe njerëz të tjerë të pafuqishëm, Islami shihej edhe si minues i autoritetit politik të etërve dominues të klaneve. Duke e predikuar një nivel të humanizmit dhe të përgjegjësisë shoqërore goxha mbi atë që realizohej nga praktikat ekzistuese, Islami shihej edhe si dobësues i popullaritetit moral të patriarkëve fisnorë.

Për dhjetë vjet Muhamedi dhe myslimanët e Meikës kishin përjetuar abuzë dhe torturë. Një grup i myslimanëve mërguan në Abisini, të siguruar nga Profeti se mbreti i asaj toke ishte i krishterë dhe do t'i mbronte. Pas një kohe udhëheqësit e Kurejshëve u përpoqën ta vrisnin Muhamedin, dhe kështu Profeti përfundimisht u detyruar të ikte nga Meka në vitin 622. Kjo u bë e njohur si Viti i Emigrimit, viti nga i cili numërohen të gjitha datat në historinë islame.

Myslimanët e përndjekur migruan masovikisht në Jathrib, më vonë i njohur si Medina Al Nabiy, "Qyteti i Profetit", apo thjesht al Medina, "Qyteti". Armiqësitë dhe intrigat kundër tyre u zgjeruan, megjithatë, meqë forca evidente morelae e lëvizjes i ngjalli shpresat dhe frikat e rritjes së numrave të individëve dhe grupeve. Si rezultat i kësaj, gjatë afër një dekade të qëndrimit në Medinë, Muhamedi ishte vazhdimisht i detyruar t'i udhëhiqte myslimanët në luftë. Në një betejë Profeti u plagos rëndë në kokë dhe në fytyrë, dhe u supozuar si i vdekur.

Pas një kohe të gjatë Muhamedi dhe myslimanët dolën triumfues, jo për shkak të ndonjë fitoreje dërrmuese ushtarake por nga përkushtimi i vazhdueshëm ndaj Islamit dhe rezistenca e palodhur ndaj trajtimit mizor. Myslimanët e armatosur dobët do të përballeshin me , dhe nganjëherë madje edhe t'i mundnin, batalionet me luftëtarë të stërvitur që ishin dhjetë herë më shumë në sasi. Dhe lëvizja vazhdoi të rritet, me gjithë kundërshtimin dhe vështirësitë.

Në vitin e shtatë të Emigrimit, Muhamedi e bëri pelegrinazhin në Mekë, dhe në vitin tjetër Profeti hyri në Mekë me një grup të madh të myslimanëve, i pa kundërshtuar. E pastroi faltoren e shenjtë nga idhujt dhe e mirë-vendosi adhurimin e Zotit një, real, duke i përfshirë praktikat e lutjeve, bamirësisë dhe agjërimit. Përmes përhapjes së Kuranit dhe shembullit të tij si Profet i frymëzuar, Muhamedi i reformoi edhe shumë aspekte të jetës familjare, shoqërore dhe ekonomike.

*Nga parathënia e librit: The essential Koran: the heart of Islam: an introductory selection of readings from the Qur'an. Cleary, Thomas F., HarperCollins, 1993*

## **Abdel Halim:**

### **Stili i përgjithshëm**

Ky përkthim synon të shkojë më larg se veprat e mëparshme në saktësi, qartësi, rrjedhë dhe aktualitet të gjuhës. Është shkruar në stil bashkëkohor, të lehtë, duke e shmangur aty ku ka qenë e mundur përdorjen e gjuhës kriptike apo të arkaizmave që priren ta errësojnë kuptimin. Synimi është që Kurani të bëhet i qasshëm për këdo që flet anglisht (përkatesisht shqip me këtë shqipërim), qofshin myslimanë apo jo. Mesazhi i Kuranit ishte, në fund të fundit, i adresuar drejtpërdrejt të gjithë njerëzve pa dallim në klasë, gjini a moshë: ai nuk mbështetet në arkaizma apo gjuhë pompoze për efekt. Megjithëse gjuha e këtij përkthimi është e thjeshtë dhe e drejtpërdrejtë, shpresojmë se nuk zbrit në nivel të paduhur.

Vëmendje e veçantë i është kushtuar kriterëve të caktuara që, nëse shpërfillen, do të mund të kishin çuar në hutë, keq-paraqitje të kuptimit arab, apo përkthim të kapshëm veç për një akademik apo entuziast. Përkthyesi (Abdel-Halim) e njeh plotësisht faktin se sa e vështirë është detyra e përkthimit të Kuranit, dhe vërejtjet e mëposhtme nuk kanë për qëllim t'i nënvlerësojnë përpjekjet apo cilësitë e përkthyesve të mëparshëm, të cilët të gjithë kanë dhënë kontribut të dobishëm, por thjesht për ta ilustruar se si metodologjia e përdorur në këtë përkthim mund të çojë në më shumë saktësi dhe qartësi të kuptimit.

### **Ndërtëkstualiteti**

Shpesh është vërejtur se pjesë të ndryshme të Kuranit e shpjegojnë njëra-tjetrën dhe Ibn Tejmije ka konsideruar se përdorimi i relacioneve ndërmjet pjesëve të Kuranit është metoda më korrekte. Ai shpjegoi: 'Ajo që thuhet në një mënyrë të përgjithshme në një vend shpjegohet në hollësi në një vend tjetër; ajo që thuhet shkurtimisht në një vend shpjegohet gjerësisht në një tjetër.' Lexuesi do të gjejë në fusnota të përkthimit shembuj se sa e dobishme është kjo teknikë në shpjegimin e kuptimit të pasazheve të Kuranit që mund të kuptohen në disa mënyra.

## **Konteksti**

Konteksti është vendimtar në interpretimin e kuptimit të çdo ligjërimi, qoftë Kuranit apo ndonjë tjetër. Për shembull, kur Profeti po ikte nga Meka për ta shpëtuar jetën, u fsheh me Ebu Bekrin në një shpellë në rrugën drejt Medinës. Armiqtë e tij mekas po e ndiqnin, por kaluan pranë grykës së shpellës dhe i humbën gjurmët, duke ia mundur Profetit që përfundimisht të arrinte në Medinë i padëmtuar. Në këtë përkthim fragmenti Kuranor që e përshkruan përjetimin e Profetit gjersa priste i tensionuar në shpellë është përkthyer: **Allahu** e zbriti qetësinë E Tij në të, i ndihmoi me forca të padukshme për ju dhe *e prishi planin e mosbesimtarëve*. Plani i **Allahut** është më i lartë' (9:40) por Dawood e ndjek metaforën luftarake të nënkuptuar të 'forca të padukshme për ju' (të kuptuar nga komentuesit se e përfshin një merimangë që i shpërqendroi ndjekësit të mos shikonin në shpellë duke e endur një rrjetë nëpër hyrjen e saj) për ta përkthyer fragmentin si: **Allahu** bëri që qetësia E Tij të zbriste në të, dhe i çoi si ndihmë luftëtarë të padukshëm ashtu që *ai i shpartalloi mosbesimtarët* dhe e lartësoi Fjalën e **Allahut**. Ai e merr se subjekti i shpartalluesit/zbritësit të jetë Muhamedi në vend të **Allahut** që është kontekstualisht evident, dhe rrjedhimisht prodhon përkthim të pasaktë të tekstit arab që nuk përputhet me kontekstin e fragmentit, në të cilin Profeti ishte krejtësisht i pafuqishëm, duke u strehuar në shpellë.

## **Identifikimi i aspekteve të kuptimit**

Termet kryesorë përdoren shpesh në Kuran me kuptime të ndryshme për kontekste të ndryshme, një veçori e njohur në arabisht si *wuxhuh al-Kur'an*. Këto u njohën që në ditët e para të interpretimit Kuranor dhe janë theksuar në shumë botime. Siç do të tregohet më vonë, injorimi i kësaj veçorie dhe detyrimi që një fjalë ta ketë një kuptim të vetëm për hir të konsistentës rezulton në mohim të kontekstit dhe paraqitje të gabuar të materialit. Ka shumë koncepte të Kuranit që e ilustronë këtë veçori, duke e përfshirë *amr*, *xhihad*, *awlija* dhe *takwa*. Kështu *amr* zakonisht përkthehet si 'komandë' kur në shumë situata ka kuptime të tjera, përfshirë 'çështje' apo 'punë'; *xhihad* zakonisht përkthehet 'luftim', megjithëse në situata të caktuara është më e përshtatshme të përkthehet si 'përpjekje'; *awlija* zakonisht përkthehet si 'miq' kur në fakt përgjithësisht domethënë 'aleatë' apo 'përkrahës'; dhe *takwa* zakonisht përkthehet si 'frikë nga **Allahu**' por kuptimi i vërtetë është më afër konceptit të 'të qenët të vetëdijshëm për **Allahun**'. Është me rëndësi për përkthyesin ta njohë se kur është e përshtatshme të jetë konsistent në përkthimin e një termi të përsëritur, dhe kur ta reflektojë kontekstin. Kjo vlen edhe për terme aq themeltare si *islam*, *muslimun*, *kafirun*, *fasikun*, *dhalimun* dhe *din*. Fjalorët e arabishtes klasike përfshijnë shumëllojshmëri të kuptimeve për këto terme.

## Strukturat dhe idiomat arabe

Gjatë këtij përkthimi është bërë kujdes të shmanget përputhja e panevojshme ndaj strukturave dhe idiomave arabe, që pothuajse gjithmonë tingëllojnë të panatyrshme në anglisht (dhe shqip). Përkthimet fjalë për fjalë të idiomave arabe shpesh rezultojnë në anglishte (dhe shqipe) të pakuptimtë. Për më tepër gjuha arabe në kohën e Kuranit ishte shumë koncize. Pjesë të fjalive do të mund të lireshin jashtë sepse ishin të kuptueshme mirë nga konteksti, dhe elizioni (heqja e një tingulli kur thuhet një fjalë a grup fjalësh) është veçori e dukshme në Kuran: nganjëherë hiqen klauzola të tëra. Ky lloj elizioni është veçanërisht i dukshëm në fjali me kusht, në betime dhe në kontraste (p.sh. 11:17, 50:1, 13:31 dhe 38:9). Në disa raste është e mundur të përdoren pikat për të treguar se diçka mungon. Në të tjerat është më mirë të jepet klauzola e lënë jashtë.

Një shembull tjetër ku ndjekja e plotë e arabishtes mund të jetë çorientuese është përshkrimi i Parajsës, rregullisht e përshkruar në Kuran se ka rrjedha. Një përkthim fjalë për fjalë i frazës arabe *taxhri min tahtiha al-anhar* mendohet nga disa të jetë ‘nën të cilën rrjedhin lumenjtë’. Mirëpo kjo mund t’i sugjerojë lexuesit anglez (dhe shqiptar) se lumenjtë rrjedhin nën tokë, gjë e cila nuk nënkuptohet në arabisht; në vend të kësaj nënkuptohet imazhi i një kopshti me hije i ujitur nga shumë rrjedha. Përkthimi aktual e jep ‘hijeshuar me lumenj rrjedhës’. ‘Hijeshuar’ është synuar ta përcjellë bujarinë në dhuratën e Allahut për njerëzit e Parajsës që është implicite në tekstin Kuranor; mbiemri ‘rrjedhës’ merret nga folja arabe *taxhri* e përdorur në lidhje me këta ‘lumenj’; gjersa ‘rrjedha’ është zgjedhur mbi ‘lumenjtë’ më të përgjithshëm si pështypje e një apo më shumë rrjedhëzave të kalojnë nëpër kopsht, duke e mbajtur të ujitur, të bukur dhe të freskët. Në arabishten klasike, termi *nahr* vlen për çdo lloj uji të rrjedhshëm, që nga rrjedhat më të vogla deri te lumenjtë më të gjerë. Në arabishten moderne termi është kufizuar në lumenj dhe kjo në disa raste mund të ketë çuar në keqkuptim të termit.

Gjithashtu problematik mund të jetë një lloj i veçantë i pyetjes retorike, i shpesh të në Kuran, që e shpreh mosmiratimin përmes strukturës së saj gramatikore e jo me ndonjë shtesë leksikore. Është vendosur për këtë përkthim të përdoret ‘Si’ për ta përcjellë këtë ndjenjë të mosmiratimit. Për shembull, në përshkrimin e veprimeve të mosbesimtarëve në 16:72 përkthimi i tanishëm e jep: ‘Si mund të besojnë në falsitet dhe t’i refuzojnë bekimet e Allahut?’; në pyetjen e bërë nga mosbesimtarët në 17:94: ‘Si do të mund të kishte dërguar Allahu qenie njerëzore si të dërguar?’ përkthimet fjalë për fjalë ‘A besojnë në falsitet?’ apo ‘A ka dërguar Allahu qenie njerëzore?’ nuk do ta përcillnin mosmiratimin e qenësishëm në origjinalin arab.

Në raste të tjera një përkthim fjalë për fjalë i arabishtes do të prodhonte tekst të pakuptueshëm për shumicën e lexuesve. Kështu për shembull 20:113, që e përshkruan përmbajtjen e Kuranit, i përkthyer fjalë për fjalë si: ‘Ne kemi rrotulluar në të diçka nga kërcënimet’, këtu përkthehet si: ‘Ne ...i kemi dhënë të gjitha llojet e paralajmërimeve në të’. Apo 74:45 ‘u turrëm si pa krye *bashkë me turrësit*’ është përshtatur në këtë përkthim në ‘u kënaqëm me të tjerët [duke i tallur besimtarët]’.

## **Përemrat**

Identifikimi i referencës së duhur të përemrave vetorë është problematik në Kuran pasi këta nganjëherë ndryshojnë në të njëjtin varg me rrezikun të kuptohen në disa mënyra dhe të shtrembërimit të kuptimit nëse këto ndryshime nuk identifikohen saktë. Ka shembuj të shumtë në Kuran ku ka ndryshim të të adresuarit nga Profeti te besimtarët dhe të tjerët dhe anasjelltas. Si shumë gjuhë të tjera, arabishtja e bën dallimin ndërmjet ‘ti’ njëjës dhe ‘ju’ shumës; në anglishten moderne ‘you’ përdoret për njëjës dhe shumës pa dallim. E megjithatë në arabishten e Kuranit, në shumicën e rasteve ku ‘ti’ përdoret në njëjës është Profeti që po adresohet. Në këtë përkthim, prandaj, ‘Profet’ i shtohet tekstit anglisht (dhe shqip) aty ku është e qartë se është ai që po adresohet, për t’i bërë fragmentet po aq të qarta në anglisht (dhe shqip) sa janë në arabisht. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në fragmente ku, brenda vargut të njëjtë, ka zhvendosje ndërmjet adresimit shumës dhe njëjës. Për shembull në 10:61 në arabisht lexohet: ‘Në çfarëdo çështje ti (njëjës, pra duke iu drejtuar Profetit) mund të jesh i angazhuar dhe çfarëdo pjese të Kuranit (ti, njëjës, pra duke iu drejtuar Profetit) qofsh duke e recituar, çfarëdo punë që po bëni (ju njerëz, shumës, pra duke iu drejtuar të gjithë komunitetit), Ne ju jemi (juve, shumës) dëshmitarë kur (ju, shumës) jeni të angazhuar në të.’

## **Përdorimi i arabishtes klasike**

Është me rëndësi të identifikohet kuptimi i fjalëve arabe siç janë përdorur në kohën e shpalljes së Kuranit e jo ai apo ato kuptime që i kanë fituar në arabishten moderne. Përkthimi i tanishëm ka vënë theks të madh në informacionin e mbledhur nga fjalorët e arabishtes klasike, duke e përfshirë *Lisan al-‘Arab* nga Ibn Mandhur, *al-Qamus al-Muhit* nga al-Fayruzabadi dhe *al-Mu’jam al-Wasit* nga Akademia e Gjuhës Arabe në Kajro. Është interesante të jepet një shembull si ka ndryshuar shpërndarja semantike e një termi të caktuar kryesor: *walad* në arabishten klasike (Kuranore) domethënë ‘fëmijë’ njëjës apo shumës pa gjini të specifikuar, gjersa në arabishten moderne mund ta ketë kuptimin veç ‘djalosh’



apo 'bir'. Pretendimi i arabëve paganë se Allahu ka *walad* përsëritet disa herë në Kuran. Meqë mekasit besonin se engjëjt ishin bija, e jo bij, të Allahut, menjëherë është e evidente se kuptimi modern i *walad* është tepër kufizues për ta shprehur me saktësi kuptimin e synuar të origjinalit të arabishtes klasike në këtë kontekst. Megjithëse më vonë, në Medinë, u bënë referenca për besimin e krishterë se Jezusi ishte biri i Zotit, ta përdorësh 'bir' kur flitet për besimet e arabëve mekasë është e pasaktë dhe çorientuese.

### **Paragrafizimi dhe pikësimi**

Konventa arabe gjatë gjithë epokave ka qenë që secila sure të vendoset në një paragraf të vazhdueshëm, sado shumë faqe të duhen për këtë. Kjo qartë nuk është përdorim normal në anglisht (dhe në shqip). Për më tepër, vëllimi mund të duket i pakalueshëm për dikë që nuk e njeh përmbajtjen e saj. Për ta qartësuar kuptimin dhe strukturën e mendimeve dhe për t'i përmbushur pritjet e lexuesve bashkëkohorë, përkthimi aktual e ndan materialin nëpër paragrafe. Gjithashtu e kemi shënuar fillimin e secilit varg në indeks të sipërm (superscript) që t'u ndihmohet atyre që duan të konsultojnë fragmente të veçanta (gjersa, shpresojmë, nuk e ndërprejmë rrjedhën apo ta shpërqendrojmë lexuesin). Ky kombinim është i ri në paraqitjen e Kuranit dhe do të duhej ta shtojë qartësinë dhe ta ndihmojë referimin e shpejtë në çdo varg në Kuran. Ndër përkthimet aktuale janë dy konventa: ose të ndahet çdo sure në vargje individuale të dhëna në rreshta të veçantë, ose të përdoren paragrafe me rrjedhje të lirë por të jepen numrat e vargjeve vetëm në intervale prej pesë apo dhjetë vargjeve. Asnjëri nga këto sisteme nuk është i kënaqshëm: i pari i bën përkthimet të duken, në disa vende, më shumë si listë se si tekst dhe e ndërpreu rrjedhën dhe në të vërtetë kuptimin e tekstit si të tërë, gjersa sistemi i dytë e lë lexuesin të paaftë ta gjejë se ku fillojnë dhe mbarojnë vargjet ndërhyrëse, diçka që është jashtëzakonisht e rëndësishme për referim dhe ndër-referim që kontribuon kaq shumë në kuptimin e domethënies së tekstit.

Dhe as Kurani arab nuk përdor sistem pikësimi në mënyrën e njëjtë si anglishtja (dhe shqipja) moderne. Kurani e ka sistemin e tij të shënimit të pauzave, në fakt një degë e tërë e studimit i është kushtuar atij, por sistemi aktual konvencional i presjeve, pikave, dy-pikave dhe pikëpresjeve, pikëpyetjeve, vizave, thonjzave etj. nuk është përdorur në Kuran. Këto janë futur me kujdes dhe me vetëdije në këtë përkthim. Thonjzat janë të rëndësishme sepse Kurani shumë shpesh e paraqet dialogun dhe të folurit e drejtpërdrejtë, nganjëherë të pa-prezentuar apo as të atribuar, e megjithatë është e domosdoshme të identifikohet në përkthim se ku e përfundon një folës dhe tjetri fillon. Vizat janë përdorur shpesh sepse është veçori e gjuhës Kuranore, e njohur prej kohësh nga studiuesit

arabë, ku për shembull Kurani do t'i raportojë pikëpamjet e mosbesimtarëve dhe do ta ndërpresë deklarin e tyre me komente si 'kështu pretendojnë'. Gjithashtu, nganjëherë do ta ndërpresë shpjegimin e një argumenti të përgjithshëm me një episod më të detajuar, para se të kthehet në argumentin e përgjithshëm. Materiali i tillë është vendosur ndërmjet vizave në këtë përkthim për ta bërë më të qartë strukturën e fjalisë dhe rrjedhën e ideve. Dy-pikëshat përdoren veçanërisht afër fundit të vargjeve, ku një deklaratë e shkurtër e përmyll dhe e komenton fjalinë.

Nganjëherë ka qenë e nevojshme të ndahet ajo që mund të duket fjali e vetme në njësi më të vogla, në mënyrë që të shmangët krijimi i fjalive që ishin të gjata disa rreshta, dhe për t'i zgjidhur problemet e zhvendosjes së përemrave në arabisht: një veçori e rëndësishme stilistike e Kuranit e quajtur *iltifat* (ndërrime gramatikore për qëllime retorike) e përmendur më herët. Kështu, në një varg, mund të ketë ndryshime në përemra nga veta e parë tek e dyta tek e treta apo ndryshime në kohë nga e tashmja në të ardhmen. Kjo qartë nuk korrespondon me normat e strukturës së fjalive në gjuhën angleze (dhe shqipe). Një zgjidhje ishte të ndahen madje edhe vargjet e shkurtra që tradicionalisht janë mbajtur bashkë në dëm të qartësisë. Nganjëherë ka ndodhur që një paragraf i ri të fillohej në mes të vargut në përpjekje për t'i zgjidhur vështirësitë stilistike.

### **Fusnotat dhe hyrjet shpjeguese**

Për të mos e mbingarkuar lexuesin apo të udhëzohet me tejpërkushtim me komente të gjera, janë dhënë veç hyrje të shkurtra të sureve. Këto janë dizajnuar t'i ndihmojnë lexuesit duke e identifikuar se prej nga vjen titulli, dhe duke dhënë ca informacion për prejardhjen dhe strukturën e përgjithshme të sures. Fusnotat janë menduar të jenë minimale dhe për t'i shpjeguar aludimet, referencat dhe prejardhjen kulturore vetëm kur ndiheshim se ishin absolutisht të nevojshme për ta qartësuar kuptimin dhe kontekstin. Nganjëherë fusnotat i shpjegojnë arsyet për shmangien nga përkthime të pranuar, japin alternativa apo bëjnë ndërreferenca. Fusnotat po ashtu japin shpjegime (aty ku konsiderohen të jenë të dobishme apo me interes) të fragmenteve që mund të kuptohen në disa mënyra të cilat janë qartësuar në komentet arabe të Kuranit, klasike dhe moderne. Veçanërisht është përdorur "*Mafatih al-Ghayb*" i Fakhr al-Din al-Razi-t i shekullit të dymbëdhjetë, "*Al-Bahr al-Muhit*" i Ebu Hajjan-it i fillimit të shekullit të katërbëdhjetë dhe "*Anwar al-Tanzil wa Asrar al-Ta'wil*" i Bajdawit i fundit të shekullit të katërbëdhjetë.

Razi duhet të veçohet si mjeti më i dobishëm në kuptimin e Kuranit. Ai është gjuhëtar i gjithanshëm *par excellence*, duke i vënë në dukje dhe duke i diskutuar pyetjet gjuhësore të huqura nga mbase të gjithë të tjerët, dhe duke hapur fusha

për diskutim ku të tjerët nuk i hapin. Është gjithmonë i vetëdijshëm për kontekstin dhe pozitën e vargut në tërë strukturën e sures. Mendja e tij është matematike, analitike, gjersa e zbërthen shumë qartë funksionin gjuhësor të çdo vargu apo fjalie. I citon të gjitha referencat dhe opinionet e mundshme dhe i vlerëson normalisht ato, duke përdorur vargje të tjera të Kuranit dhe referenca në poezinë arabe si dhe komente të tjera. Të gjitha këto cilësi i kualifikojnë mënyrat e tij të mendimit si më 'modernet' nga të gjithë komentuesit, analizën e tij gjuhësore të ndriçuar nga filozofia, logjika dhe arsyetimi i shëndoshë.

Nga parathënia e librit: *The Qur'an, A new translation* by M. A. S. Abdel Haleem, Oxford world's classics (Oxford University Press), originally published: 2004.

## Bibliografia e përmbledhur e tërë botimit

1. *The Qur'an, A new translation* by M. A. S. Abdel Haleem, Oxford world's classics (Oxford University Press), originally published: 2004.
2. *Kurani i madhërishëm*, përktheu kuptimet e tij nga gjuha arabe: Prof. Hasan I. Nahi, përgatiti për botim: Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam, Tiranë, 2006
3. *The essential Koran: the heart of Islam: an introductory selection of readings from the Qur'an*. Cleary, Thomas F., HarperCollins, 1993
4. *The Qur'an: A New Translation*, Dr. Thomas Cleary, (USA: Starlatch, July 2004)
5. *Kur'an Časni*, prijevod Kur'ana od Besima Korkuta, u izdanju Orijentalnog instituta u Sarajevu, 1977
6. *quran.com* (për krahasime të disa vargjeve)
7. *Kur'ani, përkthim me komentim në gjuhën shqipe*; përktheu dhe komentoi: H. Sherif Ahmeti, Kompleksi i Mbretit Fehd, Arabia Saudite
8. *The Qur'an, A Monotheist Translation*, The Monotheist Group, United States of America, 2014
9. *Quran, A Reformist Translation*, Translated and Annotated by: Edip Yuksel, Layth Saleh al-Shaiban, Martha Schulte-Nafeh, Brainbow Press, Hundred Fourteen Books, United States of America, 2007
10. *yaqb.org*, web-faqe për krahasimin e përkthimeve të vargjeve individuale nga disa përkthime anglisht dhe frëngjisht
11. *RISTalks: Ustad Nouman Ali Khan - "Gratitude: A Way of Life"*, rismultimedia, published on Aug 8, 2013, <https://youtu.be/FfvsOD3R0gE>
12. *The Study Quran: A New Translation and Commentary*. Nasr, Seyyed Hossein, Caner K. Dagli, Maria Massi Dakake, Joseph EB Lumbard, and Mohammed Rustom. Harper Collins, 2015.

## Online

<https://botimetr.b.wordpress.com/>

## Licensimi

Ky publikim lëshohet nën licensën



Attribution-NonCommercial-ShareAlike

CC BY-NC-SA

This license lets others remix, tweak, and build upon your work non-commercially, as long as they credit you and license their new creations under the identical terms.

që nënkupton se i lejon të tjerët ta shkarkojnë dhe ta shpërndajnë te të tjerët, ta ndryshojnë punën në mënyrë jokomerciale, përderisa e përmendin burimin dhe i licencojnë krijimet e reja nën terma identike. Për më tepër, shih:

<http://creativecommons.org/licenses/>